




Me Emrin e All- llahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"(Kujto) edhe Dhun-nunin (Junusin), kur ai u largua me zemërim dhe mori me mend se Ne nuk do ta ndëshkojmë atë (fatkeqësitë që i ranë)! Por ai thirri nëpër errësirë: "Nuk ka të adhuruar tjetër të merituar përveç Teje, o Allah; i lavdishëm dhe i lartësuar je Ti përmbi çdo të keqe që të mveshin Ty. Vërtet që kam qenë prej të gabuarve."[1]

[1]Kur'an, 21: 87

"Kujto edhe Ejubin a.s. kur ai i thirri Zotit të Tij: "Vërtet që më ka kapur mjerimi dhe Ti je më Mëshiruesi i mëshiruesve."[2]

" Por nëse ata kthejnë kurrizin, atëherë thuaju (o Muhammed a.s.m.): "All-llahu është më se i mjaftueshëm për mua. Nuk ka Zot tjetër përveç Atij. Tek Ai unë mbështetem plotësisht dhe Ai është Zoti i Arshit Madhështor".

"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".[3]

Nuk ka as fuqi e as forcë veçse nëpërmjet Allahut, Të Lartësuarit, Madhështorit. I Qëndrueshmi i Vetëm, Ti je i Qëndrueshmi i Vetëm!

"Thuaj: Ai është për ata që besojnë udhëzim e shërim."[4]

[Kjo, pjesa e parë e Letrës së Tridhjetë e Një, përbëhet nga gjashtë shkreptima, secila nga ato paraqet një prej shumë dritave të vërseteve dhe të frazave të lartëpërmendura. Recitimi tridhjetë e tri herë i secilës prej këtyre, dhe veçanërisht ndërmjet Akshamit dhe Jacisë, është një veprim shumë i lavdërueshëm.]

[2]Kur'an, 21:83
[3]Kur'an, 3: 173
[4]Kur'an, 41: 44

SHKREPTIMA E PARË

Duaja e Hazreti Junus Ibn Meta (Paqja qoftë mbi profetin tonë dhe mbi të) është duaja më e fuqishme, është mjeti më i efektshëm për përgjigjjen e duasë dhe për pranimin e saj. Tregimi i mirënjohur i Junusit a.s. është siç vijon:

Ai u hodh në det dhe u gllabërua nga një peshk i madh. Deti ishte i trazuar, nata e stuhishme dhe e errët, shpresa ishte e këputur. Por ndërsa ishte pikërisht në një situatë të tillë, duaja e tij:

لَآ إِلَٰهَ إِلَّآ أَنتَ سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنتُ مِنَ الظَّالِمِينَ

"Nuk ka Zot tjetër përveç Teje. O Allah, lavdia të takon Ty! Në të vërtetë që kam qenë prej të gabuarve", veproi për të si një mjet i shpejtë shpëtimi. Sekreti i fuqisë së duasë së tij ishte ky:

Në atë situatë të frikshme, të gjitha shkaqet u pezulluan, u ndërprenë, dhe kjo për arsye se ai i cili do të mund ta shpëtonte atë nga ajo situatë, nuk ishte askush tjetër përveç Atij, fuqia e të cilit depërton në brendësi të balenës dhe i Cili ka nën sundim detin, natën dhe qiellin. Nata, deti dhe balena u bashkuan për ta sulmuar atë. Vetëm Ai, urdhërit të të Cilit u nënshtrohen të trija ato, do të mund ta nxirrte atë në bregun e shpëtimit. Madje edhe sikur të gjitha krijesat të bëheshin shërbyesit dhe ndihmësit e tij, ato nuk do t'i bënin asnjë dobi atij; sepse shkaqet nuk kanë asnjë efekt.

Meqenëse Junusi a.s. pa me syrin e sigurisë se nuk kishte asnjë strehim tjetër përveç atij të Shkaktarit të shkaqeve, burimit të shkaqeve, atij iu zbulua kuptimi i Njësisë Hyjnore brenda Dritës së Unitetit Hyjnor, saqë ajo dua e sinqertë e tij ishte në gjendje të nënshtrojë befas natën, detin dhe balenën. Nëpërmjet Dritës së Unitetit Hyjnor ai qe në gjendje ta transformojë barkun e Balenës në diçka që i ngjason brendësisë së një nëndetëseje të sigurt; ai det i dallgëzuar e i trazuar u bë si fushë e qetë, si një vend i këndshëm ekskursioni e shëtitjeje.

Nëpërmjet Dritës së Unitetit, ai qe në gjendje -nëpërmjet asaj duaje- ta pastronte faqen e qiellit prej të gjitha reve dhe të vendoste hënën sipër kokës së tij si një fener ndriçues..

Dhe kështu krijesat që e kishin shtypur e kërcënuar atë nga të gjitha anët, tani i treguan atij një fytyrë miqësore e të ngrohtë nga çdo drejtim. Kështu, ai doli në bregun e shpëtimit dhe pa përkujdesjen e Zotit Mëshirëplotë nën bimën -pemën- e kungullujëses.

Tani ne jemi në një situatë njëqind herë më të tmerrshme se sa ajo në të cilën Hazreti Junusi a.s. e gjeti vetveten, meqë nata jonë është e ardhmja. Kur ne e vështrojmë të ardhmen tonë me syrin e mospërfilljes, ajo bëhet njëqind herë më e errët e më e frikshme se sa nata e tij. Deti ynë është ky glob rrotullues. Çdo valë e këtij deti mban mbi vete mijëra kufoma, dhe kështu ai është një mijë herë më i tmerrshëm se sa deti në të cilin u hodh Junusi a.s..

Balena jonë është teka e nefsit tonë, i cili është urdhërues për të liga dhe që përpiqet të lëkundë e të shkatërrojë bazat e jetës sonë të amshuar. Kjo balenë është një mijë herë më e dëmshme se sa balena e cila gëlltiti Hazreti Junusin a.s., sepse ajo balenë ishte në gjendje të shkatërronte një jetë, periudha e së cilës ishte njëqind vjet, ndërsa kjo balena jonë përpiqet të asgjësojë e të shkatërrojë një jetë prej qindra miliona vitesh prej viteve të një jete të amshuar.

Meqenëse kjo është gjendja jonë e vërtetë, atëherë ne duhet të imitojmë Hazreti Junusin a.s. duke i larguar vetet tona nga të gjitha shkaqet dhe të kërkojmë strehim drejtëpërdrejt tek Shkaktari i shkaqeve, domethënë, tek Krijuesi ynë. Ne duhet të themi:

لَآ اِلٰهَ اِلَّآ اَنْتَ سُبْحَانَكَ اِنِّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِينَ

"Nuk ka Zot tjetër përveç Teje, O Allah, Lavdia të takon Ty! Vërtet që kam qenë prej të gabuarve." Dhe të kuptojmë me siguri të plotë se vetëm Krijuesi është Ai që mund ta largojë nga ne dëmin e së ardhmes, këtë botë dhe tekat e nefsit urdhërues për të liga, që janë bashkuar kundra nesh për shkak të mospërfilljes sonë dhe të çudhëzimit. Sepse e ardhmja i është nënshtruar urdhrit të Tij, dynjaja i është nënshtruar autoritetit të Tij, dhe nefsi ynë drejtimit të Tij.

Çfarë shkaku dhe kush tjetër përveç Krijuesit të qiejve dhe të tokës mund t'i dijë mendimet më të holla dhe të fshehta të zemrës sonë; dhe kush tjetër përveç Tij mund ta ndriçojë të ardhmen për ne nëpërmjet krijimit të Ahiretit; dhe kush tjetër përveç Tij mund të na shpëtojë neve nga mijëra dallgët përmbytëse të botës? Jo, ruajna Zot! Asgjë dhe askush tjetër përveç Krijuesit të Vetëm të domosdoshëm, nuk mund të na japë asnjë ndihmë apo ndonjë efekt shpëtimi veçse nëpërmjet lejes dhe urdhërit të Tij.

Duke qenë kjo gjendja, duke e konsideruar atë si një rezultat i lutjes së tij, balena u bë për Junusin a.s. një mjet transporti ose një nëndetëse, dhe deti u bë një fushë e qetë dhe nata u bë një dritë e këndshme për të nëpërmjet hënës; edhe ne gjithashtu duhet të bëjmë të njëjtën lutje:

لَآ اِلٰهَ اِلَّآ اَنْتَ سُبْحَانَكَ اِنِّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِينَ

Nuk ka Zot tjetër përveç Teje, o Allah, Lavdia të takon Ty! Vërtet që kam qenë prej të gabuarve."

Me frazën لَآ اِلٰهَ اِلَّآ اَنْتَ *"Nuk ka Zot tjetër përveç Teje",* ne tërheqim shikimin e Mëshirës Hyjnore për të ardhmen tonë; me frazën, سُبْحَانَكَ *"Lavdia të takon Ty!"* ne e tërheqim atë mbi botën tonë; dhe me frazën اِنِّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِينَ *"Vërtet që kam qenë prej të gabuarve",* ne e tërheqim atë për tek nefset tonë, duke shpresuar që ajo t'i shohë shpirtërat tonë me dhembshuri e përdëllim. Kështu që e ardhmja jonë të ndriçohet me dritën e besimit dhe me ndriçimin e hënës së Kur'anit dhe që frika dhe tmerri i natës të transformohen në qetësi e gëzim.

Pastaj gjithashtu, duke hipur në anijen e të vërtetës së Kur'anit, të cilën e ndërtoi në kantierin e tij Kur'ani Madhështor, ne mund të kalojmë të sigurtë e pa rrezik mbi detin e kësaj banesës sonë tokësore, e cila nëpërmjet ndërkëmbimit të jetës dhe të vdekjes, është e mbushur me kufoma të panumërta, duke i mbajtur ato mbi valët e viteve dhe të shekujve, të cilat i hedh në asgjësi ndërkëmbimi i vdekjes dhe i jetës. Sapo të hipim në atë anije, ne mund të dalim në bregun e shpëtimit dhe mund të përmbushim detyrat e jetës sonë. Stuhitë dhe trazirat e detit do të shfaqen si një varg i imazheve të këndshëm në një ekran dhe, në vend të futjes së frikës e të tmerrit, ato do të kënaqin, ledhatojnë e

ndriçojnë shikimin reflektues dhe hulumtues për krijesat. Në sajë të misterit të Kur'anit dhe të ndikimit të atij kriteri dallues midis së vërtetës dhe të shtrembërës, nefsi ynë nuk do të na sundojë më, por do të jetë mjeti ynë mbi të cilin kemi hipur dhe do t'i nënshtrohet drejtimit tonë. Dhe meqenëse ne do ta drejtojmë atë, ai do të jetë për ne një mjet i fuqishëm e i dobishëm për të fituar një jetë të përhershme.

Shkurtazi: Njeriu, në përputhje me natyrën gjithëpërfshirëse të qënies së tij, ashtu siç vuan e ndien dhimbje nga ethet, po ashtu ai vuan nga tërmetet dhe lëkundjet e tokës dhe vuan nga tronditja më e madhe e të gjitha qënieve në ditën e kijametit. Ashtu siç ka frikë ai nga një mikrob shumë i vogël, po ashtu ka frikë meteorët që shfaqen midis trupave qiellorë. Ai ashtu siç do shtëpinë e tij, gjithashtu do botën e gjërë. Ai ashtu siç do kopshtin e tij, gjithashtu do me zell të madh Parajsën e përjetshme dhe mallëngjehet shumë për të.

Meqenëse çështja e njeriut është kështu, atëherë i Adhuruari i tij, Mbështetësi, Strehuesi, Shpëtimtari dhe synimi mund të jetë vetëm Ai i Vetëm, në Dorën e të Cilit janë frerët e drejtimit të qiejve dhe të tokës, të grimcave dhe të planetëve; dhe çdo gjë është nën sundimin e Tij dhe i nënshtrohet urdhërit të Tij...

Prandaj, njeriu duhet që në mënyrë të vazhdueshme të thotë ashtu si Hazreti Junusi a.s.:

لَآ إِلَٰهَ إِلَّآ أَنتَ سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنتُ مِنَ الظَّالِمِينَ

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَآ إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَآ إِنَّكَ أَنتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

Nuk ka Zot tjetër përveç Teje, o Allah, Lavdia të takon Ty! Vërtet që kam qenë prej të gabuarve."

"Lavdia të takon Ty ! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtet që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".

*** * ***

SHKREPTIMA E DYTË



Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Kujto edhe Ejjubin a.s. kur ai i thirri Zotit të Tij: Vërtet që më ka kapur mjerimi dhe Ti je më Mëshiruesi i mëshiruesve".[1]

Duaja e Ejjubit a.s., kampioni i durimtarëve, është edhe e mirësprovuar, edhe e efektshme. Edhe ne duhet të marrim nga drita e këtij vërseti dhe të themi në lutjet tona:



O Zoti im ! Vërtet që më ka kapur mjerimi, dhe Ti je më Mëshiruesi i Mëshiruesve".

Thelbi i tregimit të mirënjohur të Ejjubit a.s. është sa vijon:

Ndërsa i vuajtur e i munduar me plagë të shumta dhe me lëndime për një kohë të gjatë, ai thirri dhe shpresoi një shpërblim të madh për sëmundjen e tij nga i Lartësuari i Vetëm i Gjithëfuqishëm dhe e përballoi sëmundjen me durimin më të madh. Por më vonë, kur krimbat e shkaktuar nga plagët e tij depërtuan tek zemra dhe tek gjuha e tij, të cilat janë vendi i përmendjes së Zotit xh.sh. dhe vendi i njohjes së Tij,

[1] (Kur'an, 21:83)

ai u frikësua se detyra e tij e adhurimit do të pësonte goditje e dëm dhe prandaj tha në dua, jo për hir të qetësisë së tij, po për hir të adhurimit të tij ndaj Allahut:

"O Zot! Vërtet që më ka kapur mjerimi dhe Ti je më Mëshiruesi i mëshiruesve",

"O Zot! Dëmi ka rënë mbi mua; përmendja ime Ty me gjuhën time dhe adhurimi im ndaj Teje me zemrën time do të pësojnë dëm". Atëherë, Allahu i Lartësuar e i Gjithëfuqishëm ia pranoi atë lutje të sinqertë, të pastër e të përshpirtshme në një mënyrë të mrekullueshme. Ai i dhuroi Hazreti Ejjubit shëndet të mirë të plotë dhe shfaqi tek ai të gjitha llojet e mëshirës.

Kjo Shkreptimë përmban Pesë pika:

■ **Pika e Parë:**

Duke u korresponduar atyre plagëve të jashtme dhe sëmundjes me të cilat u godit Ejjubi a.s., edhe ne kemi sëmundje të shpirtit dhe të zemrës. Në qoftë se qënia jonë e brendshme do të kthehej e të dilte jashtë dhe qënia jonë e jashtme do të kthehej brenda, ne do të dukeshim më shumë të plagosur e të sëmurë se sa Ejjubi a.s..

Çdo mëkat që ne bëjmë dhe çdo dyshim që hyn në mendjen tonë, shkakton plagë në zemrën dhe në shpirtin tonë.

Plagët e Ejjubit a.s. ishin të një natyre të tillë që kërcënonin jetën e tij të shkurtër të kësaj bote, kurse plagët tona të brendshme kërcënojnë jetën tonë të gjatë të amshuar të Ahiretit. Ne kemi një mijë herë më shumë nevojë për duanë e Ejjubit a.s. se sa kishte nevojë vetë ai. Ashtu siç depërtuan në zemrën dhe në gjuhën e tij krimbat që u shkaktuan nga plagët e tij, po ashtu vesveset, tundimet dhe dyshimet që rezultojnë tek ne nga plagët që shkaktohen nga gjynahet dhe mëkatet -ruajna Zot!- do të futen në brendësi të zemrës, e cila është vendi i besimit dhe, kështu plagosim e lëkundim imanin; gjithashtu ato do të preknin edhe gjuhën, e cila është interpretuesja e imanit, dhe plaçkisin prej saj kënaqësinë e *dhikrit* dhe ëndjen shpirtërore, dhe vazhdojnë ta ftohin e ta largojnë nga *dhikri* -përmendja e Zotit xh.sh.- derisa ta heshtin atë plotësisht.

Mëkati, duke depërtuar në zemër, do ta nxijë e do ta errësojë atë derisa ta shuajë dritën e besimit. Brenda çdo mëkati është një rrugë që të çon në mosbesim. Në qoftë se ai mëkat nuk pastrohet, nuk fshihet menjëherë nëpërmjet *istigfarit* -kërkimit të faljes-, ai transformohet në krim jolëndor, madje shndërrohet në një gjarpër që kafshon zemrën dhe e lëndon.

Për shembull, një njeri që kryen fshehtas një mëkat të turpshëm, do t'i frikësohej e druhej turpërimit që shkaktohet nëse të tjerët janë në dijeni të atij mëkati. Kështu ekzistenca e engjëjve dhe e qënieve shpirtërore do të jetë e rëndë për të që ta durojë; dhe ai do të dëshironte ta mohonte atë, madje edhe me fuqinë e treguesit më të vogël.

Dhe për shembull, ai që bën një gjynah të madh që meriton ndëshkimin e Xhehennemit, në qoftë se nuk do të mbrohej e fortifikohej përballë atij mëkati nëpërmjet *istigfarit* -kërkimit të faljes- dhe pendesës, ai do të dëshironte me gjithë zemër mosekzistencën e Ferrit sa herë që ai dëgjon kërcënimet e tij dhe, madje ai do të guxonte ta mohonte Ferrin edhe me fuqinë e treguesit më të vogël dhe të dyshimit.

Dhe për shembull, ai që nuk i kryen namazet e detyruar dhe që nuk i përmbush detyrat e tij të adhurimit, do të preket e lëndohet nga dëshpërimi e nga ankthi, ashtu siç do të ishte i pikëlluar në ndonjë rast kur nuk përfill një detyrë të vogël ndaj një sunduesi të thjeshtë. Kështu dembelia e tij në përmbushjen e detyrës, pavarësisht urdhëresave të përsëritura që lëshohen nga Allahu i Madhërishëm, do ta hidhërojnë shumë atë dhe do t'i shkaktojnë një ngushtësi të fortë dhe një errësirë në shpirtin e tij. Kjo ngushtësi do nxiste një dëshirë tek ai dhe të thonte me vete: "Ah sikur Ai të mos kishte dhënë urdhër për kryerjen e atij ibadeti"; dhe nga kjo dëshirë do të lindte dëshira për të mohuar Zotin dhe për të ushqyer armiqësi ndaj Tij. Në qoftë se do të vinte ndonjë dyshim në zemrën e tij lidhur me ekzistencën e Krijuesit, ai do të prirej e anonte nga ai -dyshimi- sikur ai të ishte një provë vendimtare. Një portë e madhe shkatërrimi do të hapej përpara tij. Por ky fatzi nuk e kupton se e ka bërë veten -nëpërmjet këtij mohimi- objekt për ngushtësi shpirtërore e për hidhërim miliona herë më të rëndë e më të tmerrshëm se sa ai shqetësim i vogël që ndiente nga dembelia ndaj detyrës së adhurimit; është tamam si ai që ikën nga pickimi i mushkonjës për tek kafshimi i gjarpërit.

Le të kuptohet në dritën e këtyre tre shembujve misteri i vërsetit Kur'anor,

بَلْ رَانَ عَلَىٰ قُلُوبِهِم *"Jo, kurrë nuk është kështu! Por zemrat e tyre janë të njollosura (prej gjynaheve) që ata patën fituar".*[2]

■ **Pika e Dytë**

Ashtu siç u shpjegua në Fjalën e Njëzet e Gjashtë, lidhur me Kaderin Hyjnor, njerëzit nuk kanë të drejtë të ankohen në raste fatkeqësish dhe sëmundjesh për tre arsyet e mëposhtme:

Arsyeja e Parë:

Allahu xh.sh. e ka bërë mantelin e trupit, me të cilën Ai e ka veshur njeriun, një manifestim të artit të Tij. Ai e ka bërë njeriun të jetë një model mbi të cilin Ai pret, rregullon, zbukuron, modifikon e ndryshon mantelin e trupit, duke shfaqur kështu manifestimin e Emrave të Tij të ndryshëm. Ashtu si Emri ***El-Shafi*** *Shëruesi*, që bën të domosdoshëm ekzistencën e sëmundjes, gjithashtu Emri ***Er-Rezzak,*** *Furnizuesi*, kërkon ekzistencën e urisë; dhe kështu me radhë...

Pronari i gjithësundimit vepron si të dojë me autoritet absolut mbi pronën e Tij. مَالِكُ الْمُلْكِ يَتَصَرَّفُ فِي مُلْكِهِ كَيْفَ يَشَاءُ

Arsyeja e Dytë:

Nëpërmjet fatkeqësive dhe sëmundjeve jeta pastrohet, përsoset, forcohet dhe përparon; domethënë arrin rezultate, fiton plotësim dhe përmbush qëllimin e saj. Ndërsa jeta që, në mënyrë të pandryshueshme, monotone, kalon mbi divanin e rehatisë dhe mbi shtratin e lehtësisë i ngjason më shumë mosekzistencës e cila është thjesht e keqe e pastër se sa ekzistencës e cila është thjesht e mirë e pastër. Në fakt ajo ka prirje të shkojë drejt mosekzistencës.

[2] (Kur'an, 83:14)

Arsyeja e Tretë:

Kjo banesa e dynjasë është një fushë provimi, është banesë e shërbimit dhe vendi i punës dhe i ibadetit. Ajo nuk është vendi i kënaqësisë, i ëndjes dhe i marrjes së shpërblimit. Meqënëse banesa e dynjasë është vendi i punës dhe i ibadetit, atëherë sëmundjet dhe fatkeqësitë -për sa kohë që ato nuk prekin besimin dhe përballohen me durim- janë në harmoni të plotë me shërbimin dhe adhurimin, dhe madje ato i forcojnë ato. Meqenëse ato sëmundje e fatkeqësi e bëjnë adhurimin e një ore të barazvlershëm me atë të një dite, njeriu në vend të ankesave duhet të japë falënderime.

Adhurimi, në fakt, përbëhet nga dy lloje: Njëri pozitiv, dhe tjetri negativ.

*Lloji i par*ë, pozitivi, është i qartë për të gjithë. Sa për adhurimin negativ, ky është se, kur njeriu goditet me fatkeqësi ose me sëmundje ai kupton dhe ndjen dobësinë e tij dhe paaftësinë, dhe duke u kthyer tek Krijuesi i tij Mëshirëplotë, kërkon strehim tek Ai, mendon për Të, i lutet Atij, dhe kështu ai kryen një formë të pastër adhurimi në të cilën nuk futet fare hipokrizia. Në qoftë se njeriu e përballon me durim, mendon për shpërblimin që vjen nga Allahu në raste fatkeqësish, dhe jep falënderime, atëherë çdo orë që ai kalon do të vlerësohet e quhet si një ditë e plotë e harxhuar në adhurim. Jeta e tij e shkurtër bëhet shumë e gjatë. Madje ka raste në të cilat një minut konsiderohet i barasvlershëm me adhurimin e një dite të plotë.

Njëherë unë isha shumë i mërzitur për shkak të një sëmundjeje të rëndë që goditi njërin nga vëllezërit e mi të Ahiretit, Muhaxhir Hafiz Ahmedin.[3] Por ndërkohë zemrës sime i erdhi një paralajmërim, siç vijon:

"Përgëzoje atë dhe uroje! Çdo minut që ai kalon vlerësohet si adhurimi i një dite të plotë"

[3] Muhaxhir Hafiz Ahmed ishte një tregtar në Barla dhe ndër stundentët e parë të Risale-i Nurit. Bediuzzaman qëndroi në shtëpinë e tij qysh në fillim kur arriti në Barla në shkurt të vitit 1926, dhe Ai e ndihmoi Bediuzzamanin për më shumë se tetë vite gjatë qëndrimit të tij në Barla.

Ai, në të vërtet, po shprehte falënderime ndaj Krijuesit të tij Mëshirëplotë duke e përballuar sëmundjen e tij me durim.

■ **Pika e Tretë:**

Ashtu siç e kemi shpjeguar në një ose dy nga Fjalët e mëparshme, sa herë që dikush mendon për të kaluarën e jetës së tij, ai do të thonte në zemrën e tij apo me gojën e tij ose '*oh, sa keq!'* ose ***EL-hamdu lil-lah***. Domethënë, ai ose do të shprehte keqardhje, ose do të thonte *Falenderimet dhe Lavdërimi i takojnë Allahut.* Keqardhja frymëzohet nga dhimbjet që burojnë nga ndërprerja e kënaqësive të mëparshme dhe nga ndarja prej tyre. Sepse ndërprerja e kënaqësisë është një dhimbje në vetvete. Ndonjëherë një kënaqësi e çastit shkakton dhimbje të përhershme. Të menduarit për të do ta shtypte e shtrydhte atë plagë dhe do të pikonte prej saj pikëllimi e keqardhja. Ndërsa kënaqësia e vazhdueshme shpirtërore që buron nga ndërprerja e zhdukja e dhimbjeve të përkohshme të cilat i ka kaluar njeriu në të shkuarën e jetës së tij, e bëjnë gjuhën e tij të shprehë falënderime e lavdërime për Krijuesin, duke e nxitur njeriun të thotë ***El-Hamdu lil-lah!*** Përveç kësaj prirjeje të brendshme të njeriut, në qoftë se ai do të mendonte për shpërblimin që rezulton nga fatkeqësia dhe për thevabin që e pret atë në Ahiret, në qoftë se ai do të kuptonte se jeta e tij e shkurtër me fatkeqësi do të transformohet në një jetë të gjatë, atëherë ai nuk do të ishte thjesht dhe vetëm durimtar, por do të ngjitej në shkallën e mirënjohjes ndaj Zotit xh.sh., dhe do të ishte i kënaqur me Kaderin e Tij. Gjuha e tij do të niste të bëjë falënderime e lavdërime duke thënë:

اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ عَلٰى كُلِّ حَالٍ سِوَى الْكُفْرِ وَالضَّلَالِ

El-Hamdu lil-lah ala kul-li halin sivel-kufri ved- dalali*. Lavdi Zotit për çdo gjendje përveç mohimit e çudhëzimit.*

Është bërë proverbë tek njerëzit thënia: "*Sa e gjatë është koha e fatkeqësisë"*. Po, ashtu është, veçse ama jo për shkak se ajo është e mërzitshme dhe pikëlluese ashtu siç imagjinojnë njerëzit zakonisht, por për shkak se ajo fiton rezultate të mëdha jetësore ashtu si një jetë e gjatë.

■ **Pika e Katërt:**

Ashtu siç u shpjegua në Stacionin e Parë të Fjalës së Njëzet e Një, në qoftë se njeriu nuk e shpërndan forcën e durimit të cilën ia ka dhënë Allahu xh.sh. dhe nuk e shpërndan nëpër frikësime e dyshime të pabaza, ajo forcë mund të jetë e mjaftueshme për të qëndruar përballë çdo fatkeqësie e belaje, mirëpo nëpërmjet mbisundimit të iluzionit e të mashtrimit, mospërfillja e njeriut dhe të imagjinuarit e tij këtë jetë të përkohshme si të përhershme, ai e shpërndan forcën e tij të durimit mbi dhimbjet e së shkuarës dhe mbi ankthet e së ardhmes, dhe si rrjedhojë, nuk i mjafton durimi që ia ka dhënë Allahu xh.sh. për të mbajtur fatkeqësinë që i bie dhe për t'i bërë ballë asaj, dhe fillon të ankohet. Kjo është -ruajna Zot!- sikur ai t'i ankohej Allahut për njerëzit. Në mënyrën më të pajustifikuar dhe madje të marrë, ai ankohet dhe demonstron mungesën e tij të durimit.

Në qoftë se dita që kaloi pati fatkeqësi, pikëllimi tashmë ka ikur, dhe vetëm qetësia mbetet; dhimbja është zhdukur dhe me ndërprerjen e saj mbetet kënaqësia; brenga ka ikur dhe mbetet shpërblimi. Prandaj njeriu nuk duhet të ankohet, por të japë falënderime për kënaqësinë. Njeriu nuk duhet të zemërohet nga fatkeqësia, por duhet ta dojë. Jeta e përkohshme e së shkuarës konsiderohet si një jetë e përhershme dhe e bekuar për shkak të fatkeqësisë. Do të ishte marrëzi nëse njeriu e shpërndan një pjesë të durimit të tij dhe e humbet me iluzione dhe duke menduar mbi dhimbjet dhe fatkeqësitë e kaluara.

Për sa ka të bëjë me ditët që do të vijnë, meqenëse ato nuk kanë ardhur akoma, të mendosh qysh tani për sëmundjet dhe fatkeqësitë që do të shkaktohen gjatë tyre dhe të shfaqësh padurim, është gjithashtu marrëzi.

Ashtu siç do të ishte marrëzi nëse njeriu do të hante sot shumë bukë dhe do të pinte shumë ujë se ndoshta mund të goditet nga uria dhe etja nesër ose mbasnesër, po ashtu të hidhërohesh e të mërzitesh qysh tani se mbase do të sprovohesh me sëmundje e fatkeqësi në të ardhmen të cilat ato tani janë mosekzistuese; të vuash që tani prej tyre, të shfaqësh padurim dhe ta shtypësh e ta mbytësh veten pa ndonjë shtrëngim, është një çmenduri e tillë e cila nuk meriton më keqardhje e mëshirë.

Shkurtazi, ashtu siç e shton mirënjohja mirësinë Hyjnore, po ashtu ankesa e rrit fatkeqësinë, dhe largon mëshirën dhe keqardhjen për njeriun që është goditur.

Gjatë luftës së Parë botërore, një njeri i bekuar në Erzurum u godit me një sëmundje të rëndë. Unë shkova për ta vizituar dhe ai më tha duke u ankuar hidhur:

"Unë, nuk kam qenë në gjendje ta vë kokën në jastëk e të fle që prej njëqind netësh". Unë u dëshpërova shumë. Papritmas më erdhi një mendim dhe thashë:

"Vëlla, njëqind ditët e vështira që ke kaluar janë tani si njëqind ditë të lumtura. Mos mendo për to dhe mos u anko! Por shikoji nga këndvështrimi i zhdukjes dhe i ikjes së tyre, dhe falënderoje Krijuesin tënd për to. Sa për ditët e ardhme, meqenëse ato ende nuk kanë ardhur, vendose besimin në Krijuesin tënd të Gjithëmëshirshëm e Mëshirëplotë dhe rri i qetë. Mos qaj para se të goditesh, mos u tremb nga asgjëja dhe mos ia jep mosqënies ngjyrën e qënies. Mendo pikërisht për orën e tanishme; forca jote e durimit është e mjaftueshme për të bërë qëndresë për këtë orë. Mos vepro si ai komandant i çmendur i cili i shpërndau forcat e tij në qendër nga e djathta dhe nga e majta në një kohë kur krahu i majtë i armikut iu bashkua krahut të djathtë të ushtrisë së tij duke e përforcuar dhe në kohën kur krahu i djathtë i armikut nuk ishte bërë akoma gati për luftë.. Dhe sapo e mësoi këtë armiku, mobilizoi një forcë shumë të vogël në qendër dhe atëherë e shkatërroi qendrën e tij që u la e dobët, dhe ia shpartalloi ushtrinë e tij.

O vëlla, mos ji si ai. Mobilizoje të gjithë forcën tënde për këtë orë të tanishme dhe mendo për mëshirën Hyjnore, për shpërblimin në Ahiret dhe si jeta jote e shkurtër dhe kalimtare transformohet në një jetë të gjatë e të përhershme. Në vend që të ankohesh me hidhërim, jep falënderime të gëzueshme".

Ai person u lehtësua shumë dhe tha: "Lavdërimet dhe falënderimet i takojnë Allahut, tani sëmundja ime është një e dhjeta e asaj që ishte më parë".

▪ **Pika e Pestë** përbëhet nga tre çështje**.**

Çështja e parë: Fatkeqësia e cila quhet vërtet fatkeqësi dhe është vërtet e dëmshme është ajo e cila prek e dëmton fenë. Duhet patjetër të kërkojmë strehim tek All-llahu xh.sh. në të gjitha kohët, ta hedhim vetveten përpara Tij dhe t'i lutemi me përgjërim që të na mbrojë nga fatkeqësia në çështjet e fesë dhe të thërrasim për ndihmë. Sa për fatkeqësitë të cilat nuk prekin fenë dhe nuk e dëmtojnë, ato në realitet nuk janë fatkeqësi. Një pjesë nga ato janë paralajmërime nga i Gjithëmëshirshmi i Vetëm për t'i zgjuar nga pakujdesia. Në qoftë se një bari, hedh një gurë tek delet e tij kur ato shkelin në kullotën e një tjetri, ato, delet, e kuptojnë se bariu synon, me atë gurë që t'i paralajmërojë dhe t'i shpëtojë nga një veprim i rrezikshëm e i dëmshëm; kështu ato kthehen në kullotën e tyre me qetësi e mirënjohje.

Po kështu ka shumë fatkeqësi të jashtme të cilat janë paralajmërime Hyjnore, qortime dhe zgjim Hyjnor për njeriun.

Ndërsa pjesa tjetër e fatkeqësive është pendesë e shlyerje e mëkateve.

Gjithashtu një pjesë tjetër prej fatkeqësive shkrin gjendjen e pakujdesisë tek njeriu, i kujton atij dhe e bën të kujtojë pafuqinë dhe varfërinë e tij duke i dhënë kështu një formë qetësie.

Ndërsa fatkeqësia që godet njeriun, e cila është sëmundja, ajo nuk është një fatkeqësi reale, por përkundrazi, ashtu siç është përmendur më parë, ajo është një mirësi Hyjnore dhe një mjet pastrimi prej gjynaheve dhe mëkateve. Ndodhet një hadith profetik i cili thotë:

"Ashtu si një pemë që lëshon frutat e saj të pjekura kur shkundet, po ashtu bien mëkatet e zhduken nëpërmjet goditjes nga ethet."[4]

Dhe kështu Hazreti Ejubi a.s. nuk u lut në duanë e tij për lehtësimin e vetvetes, por kërkoi shërim për qëllimin e adhurimit, kur sëmundja u bë penguese për ta përmendur Zotin me gojë dhe pengim për të reflektuar me zemër në dimensionet e brendshme të gjërave që ka krijuar Zoti xh.sh..

[4] Buhari

Ne gjithashtu duhet ta bëjmë qëllimin tonë parësor -kur bëjmë atë dua- shërimin e plagëve tona të brendshme e shpirtërore që burojnë nga mëkatimi.

Për sa ka të bëjë me sëmundjet fizike, ne mund të kërkojmë strehim tek Allahu i Gjithëfuqishëm kur ato pengojnë adhurimin tonë. Por ama ne duhet të lutemi në një mënyrë të përvuajtur, varfërisht dhe të përshpirtshme, dhe jo me protestë e me ton ankues. Në qoftë se e pranojmë Allahun si Zotin tonë dhe si Krijuesin tonë, atëherë ne gjithashtu duhet të pranojmë gjithçka që Ai na jep nëpërmjet Hyjnisë së Tij. Të psherëtish e të ankohesh në një mënyrë që nënkupton protestë e kundërshtim ndaj Kaderit Hyjnor dhe ndaj vendimit, është një lloj kritike ndaj Kaderit Hyjnor, një akuzë e bërë ndaj mëshirës së gjërë Hyjnore. Ai që kritikon Kaderin Hyjnor e përplas dhe e thyen kokën e tij në një kudhër.

Kushdo që akuzon mëshirën e Zotit xh.sh., në mënyrë të pashmangshme do të privohet nga ajo. Të përdorësh një dorë të thyer për hakmarrje, do t'i shkaktonte vetëm dëmtim të mëtejshëm dorës.

Po kështu, një njeri, i cili është goditur me fatkeqësi, në qoftë se do t'i përgjigjej me ankesë, protestë dhe me mërzitje, fatkeqësia e tij vetëm do të shtohej.

Çështja e Dytë: Fatkeqësitë fizike shtohen kur ato shihen si të mëdha, dhe zvogëlohen kur shihen si të vogëla. Për shembull, sa herë që njeriu i jep rëndësi ndonjë iluzioni që i shfaqet natën në ëndërr, ajo ënjtet e zmadhohet në shikimin e tij; por në qoftë se ai nuk i jep rëndësi, ajo zhduket.

Po kështu, në qoftë se dikush përpiqet të shmangë një sulm që lëshohet nga grerëzat, ato do të bëhen më agresive; ndërsa në qoftë se ai nuk do t'u jepte rëndësi, ato do të shpërndaheshin. Kështu, në qoftë njeriu i shikon fatkeqësitë fizike si të mëdha dhe u jep rëndësi, ato do të shtohen, dhe për shkak të merakut dhe mërzitjes ato kalojnë nga trupi dhe lëshojnë rrënjë në zemër.

Atëherë rezultati do të jetë, një goditje e brendshme në zemër tek e cila mbërthehet e lidhet fatkeqësia e jashtme për të vazhduar e për të qëndruar gjatë.

Por në qoftë se mërzitja largohet nëpërmjet pranimit të Kaderit Hyjnor dhe mbështetjes tek Allahu, fatkeqësia fizike do të zvogëlohet, thahet e zhduket, ashtu si një pemë të cilës i janë prerë rrënjët.

Unë një ditë e përshkrova këtë të vërtetë siç vijon:

Mos bërtit në fatkeqësi, o i mjerë, eja e mbështetu tek Allahu!

Dije se të rënkuarit e shton fatkeqësinë dhe është një gabim i madh.

Gjeje Dërguesin e fatkeqësisë, dhe dije se ajo është një dhuratë brenda dhuratës dhe një kënaqësi.

Prandaj lëre vajtimin dhe jep falënderime; ashtu si bilbili buzëqesh nëpërmjet lotëve të tu!

Në qoftë se nuk e gjen Atë, dije se dynjaja është e gjitha dhimbje brenda dhimbjes, përkohshmëri dhe humbje.

Atëherë pse vajton nga një fatkeqësi e vogël ndërsa mbi ty është një botë plot me brenga e fatkeqësi? Eja, beso në Zotin!

Mbështetu tek Allahu! Buzëqesh në fytyrën e fatkeqësisë; edhe ajo gjithashtu do të buzëqeshë.

Ndërsa buzëqesh, ajo zvogëlohet; do të ndryshohet e transformohet.

Po...! Njeriu ashtu siç e zbut, e zvogëlon armiqësinë e zemërimin e armikut të tij kur e pret me gëzim e me pamje të qeshur; madje armiqësia do të transformohej në pajtim e miqësi, dhe kështu armiqësia do të bëhej thjesht si një shaka, do të përfundonte e do të zhdukej, po ashtu në qoftë se njeriu përballet me fatkeqësinë me mbështetje në Allahun e Gjithëfuqishëm, do të zhdukej ndikimi i saj.

Çështja e Tretë: Çdo shekull ka veçoritë e tij. Në këtë shekull të pakujdesisë, fatkeqësia ka ndryshuar formën e saj. Për disa mosha dhe për disa persona, fatkeqësia në realitet nuk është fatkeqësi, por një mirësi Hyjnore. Meqenëse unë i konsideroj ata që janë goditur me

sëmundje në kohën aktuale fatlumë -me kusht që sëmundja e tyre të mos prekë e dëmtojë fenë e tyre, të mos më bëjë ta kundërshtoj sëmundjen dhe fatkeqësinë dhe të mos më bëjnë të ndjej keqardhje për të goditurit.

Sa herë që unë hasja ndonjë të ri të goditur, unë gjeja se ai ishte më shumë i lidhur dhe i interesuar me detyrat e tij fetare dhe me Ahiretin se sa shokët e tij. Nga kjo unë nxora si përfundim se sëmundja nuk përbën një fatkeqësi për njerëz të tillë, por një mirësi nga Zoti xh.sh..

Është e vërtetë se sëmundja i shkakton atij hidhërim në jetën e tij të shkurtër e të përkohshme të dynjasë, por ajo është e dobishme për jetën e tij të përhershme të Ahiretit. Ajo duhet të shikohet si një lloj adhurimi.

Po, në qoftë se ai djalosh do të ishte i shëndetshëm, nuk do të mundej të ruajë atë gjendje përkushtimi ndaj urdhëresave Hyjnore që kishte në kohën e sëmundjes; madje ai mund të binte në shthurje, si rrjedhojë e vrullit dhe e nxitjes së rinisë dhe natyrës së shthurur së kësaj kohe.

* * *

Përfundim

Allahu i Gjithëfuqishëm, me qëllim që të shfaqë fuqinë e Tij të pafund dhe mëshirën e Tij të pakufishme, ka bërë të bashkëlindur, të brendaqenësishme tek njeriu pafuqinë e pafundme dhe nevojën e pakufishme. Për më tepër, me qëllim që të shfaqë qëndisjet e pafundme të Emrave të Tij, Ai e ka krijuar njeriun si një makineri të çuditshme e cila përmban qindra instrumente dhe aparate, ku secila prej tyre ka dhimbjet e saj të ndryshme, kënaqësitë, detyrat e ndryshme dhe shpërblimet dhe thevabet.

Thjesht, të gjithë Emrat e bukur Hyjnorë të shfaqur në botë, e cila është një njeri i madh, gjithashtu kanë manifestime në botën më të vogël që është njeriu. Çështjet e dobishme si: shëndeti i mirë, mirëqenia dhe kënaqësitë e bëjnë njeriun të japë falënderime dhe e shtyjnë makinerinë humane të kryejë detyrat e saj në shumë drejtime, dhe kështu njeriu bëhet si një fabrikë që prodhon falënderime.

Gjithashtu, nëpërmjet fatkeqësisë, sëmundjes dhe dhimbjes dhe nëpërmjet mundësive të tjera nxitëse e lëvizëse, rrotat e tjera të makinerisë njerëzore janë vënë në punë e në lëvizje. Mineralet e dobësisë, të pafuqisë dhe të varfërisë të bashkëlindura në natyrën njerëzore vihen në punë. Kjo nxit tek njeriu një gjendje me anë të së cilës ai kërkon strehim e ndihmë jo vetëm me një gjuhë të vetme, por me gjuhën e secilës prej gjymtyrëve të tij. Kështu nëpërmjet atyre mundësive njeriu bëhet si një laps lëvizës që përmban mijëra lapsa të ndryshëm. Ai e shkruan rrjedhën e përcaktuar të ekzistencës së tij në faqen e jetës së tij ose në pllakën në botën e shëmbëllesës; ai bën një shpallje të Emrave Hyjnorë, ai qëndis një tablo të shkëlqyer të Emrave Hyjnorë; dhe bëhet vetë një poemë për lavdinë e Zotit xh.sh., duke përmbushur kështu detyrat e natyrës së tij.

* * *

SHKREPTIMA E TRETË

[Në këtë shkreptimë, kënaqësitë shpirtërore dhe ndjenjat janë bërë disi të përziera, prandaj unë shpresoj që ju të mos i vlerësoni ato me peshat e logjikës, sepse ajo çfarë ndezin a shpërthejnë ndjenjat nuk i respekton shumë parimet e intelektit dhe nuk u kushton vëmendje peshave të mendimit.]



Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Çdo gjë do të shuhet e do të shkatërrohet përveç Fytyrës së Tij. Atij i takon gjykimi e vendimi dhe tek Ai ju të gjithë do të ktheheni."[1]

Dy frazat, يَابَاقِي أَنْتَ الْبَاقِي ❁ يَابَاقِي أَنْتَ الْبَاقِي

'*I Qëndrueshmi i Vetëm, Ai është i Qëndrueshmi i Vetëm*' shprehin kuptimin e vërsetit të lartëpërmendur dhe gjithashtu ato pohojnë dy të vërteta të rëndësishme. Është për shkak të kësaj që disa nga drejtuesit e Tarikatit Nakshibendi, bënë vetë një dua të veçantë me përsëritjen e frazës, në formën e një duaje të përmbledhur të Nakshibendive. Duke parë se dy frazat shprehnin kuptimin e vërsetit madhështor të lartëpërmendur, ne do të shpjegojmë disa pika lidhur me të vërtetën domethënëse që ato pohojnë.

[8](Kuran 28:88)

Pika e Parë:

Përsëritja e frazës, يَا بَاقِي أَنْتَ الْبَاقِي *'i Qëndrueshmi i Vetëm, Ai është i Qëndrueshmi i Vetëm'*, për herë të parë, e pastron zemrën nga çdo gjë tjetër përveç Allahut xh.sh. çka i ngjason një operacioni kirurgjikal në të; ajo e këput dhe e veçon zemrën nga çdo gjë tjetër përveç Krijuesit. Kjo është siç vijon:

Për sa ka të bëjë me gjithëpërfshirjen e natyrës së tij, njeriu është pothuajse i lidhur me të gjitha qëniet, dhe përveç kësaj, një aftësi e pakufishme dashurie është përfshirë në natyrën e tij. Për këto arsye njeriu ushqen dashuri ndaj të gjitha qënieve. Ashtu siç e do ai botën e madhe sikur ajo të ishte një shtëpi, po ashtu ai do parajsën e përjetshme sikur ajo të ishte një kopsht . Por qëniet të cilat ai i do nuk ndalojnë, ato largohen, dhe ai vuan vazhdimisht dhimbjen e ndarjes. Ajo dashuri e pakufishme e tij bëhet mjeti i një torture të pafundme.

Faji për vuajtjen e një torturimi të tillë është i tij, sepse aftësia e pafundme e zemrës së tij për dashuri i është dhënë me qëllim që ai të mund ta drejtojë për tek Ai që ka një bukuri të përjetshme absolute. Duke e keqpërdorur atë dashuri dhe duke e harxhuar mbi qëniet e përkohshme e kalimtare, ai bën padrejtësi dhe vuan dënimin për fajin e tij për shkak të dhimbjes së ndarjes.

Kështu, kur njeriu përsërit frazën, يَا بَاقِي أَنْتَ الْبَاقِي ***Ja Baki Entel Baki,*** *I Qëndrueshmi i Vetëm, Ti je i Qëndrueshmi i Vetëm*, ajo këput lidhjen e tij me qëniet e përkohshme kalimtare; ai i lë ato objekte dashurie përpara se ato ta lënë atë dhe kështu pastrohet prej fajit të tij. Ajo deklaron se dashuria është e kufizuar për të Dashurin e Qëndrueshëm, që është Allahu xh.sh. dhe ajo shpreh këtë kuptim:

I Qëndrueshmi i vetëm i vërtetë je Ti, o Zoti im!

Gjithçka përveç Teje është e përkohshme. Ai që është i përkohshëm nuk mund të jetë objekt lidhjeje për zemrën time, e cila është krijuar për dashuri të përhershme, për një ashk që vazhdon nga parapërjetësia për në paspërjetësi. Meqenëse ato të dashura -qënie- të panumërta janë të përkohshme dhe do të më lënë mua dhe do të largohen, para se ato ta

bëjnë këtë, duke deklaruar, يَابَاقِي أَنْتَ الْبَاقِي *'I Qëndrueshmi i vetëm, Ti je i Qëndrueshmi i Vetëm!',* unë do t'i lë ato. Vetëm Ti je i pavdekshëm, dhe unë e di dhe besoj se qëniet mund të jenë të pavdekshme vetëm duke i bërë Ti ato të tilla. Prandaj, ato duhet të duhen me dashurinë Tënde. Përndryshe ato nuk janë të denja që të lidhësh zemrën me to".

Kjo gjendje e bën zemrën e njeriut që t'i braktisë objektet e panumërt të dashurisë, duke parë vulën e përkohshmërisë mbi bukurinë dhe mbi hijeshinë e tyre, ajo këput lidhjet e saj prej tyre. Në qoftë se zemra nuk do t'i këpuste lidhjet me to, ajo do të vuante plagë aq sa numri i të dashurave të saj të përkohshme.

Ndërsa Fraza e dytë: يَابَاقِي أَنْتَ الْبَاقِي *'I Qëndrueshmi i Vetëm, Ti je i Qëndrueshmi i Vetëm!',* është edhe balsam, edhe kundërhelm për ato plagë.

Domethënë, يَابَاقِي *"O i Qëndrueshmi i Përjetshëm! Meqenëse Ti je i Qëndrueshëm, domethënë i mjaftueshëm, Ti merr vendin e çdo gjëje. Meqenëse Ti ekziston, gjithçka ekziston"*.

Po, bukuria, mirësia dhe plotësimi në qëniet, të cilat janë shkak dashurie, janë përgjithësisht shenjat e bukurisë së të Qëndrueshmit të vetëm të vërtetë, të mirëbërësisë së Tij dhe të plotësisë së Tij, dhe duke kaluar nëpërmjet shumë perdeve, ato janë hije të zbehta të tyre; në të vërtetë ato janë hijet e hijeve të manifestimeve të Emrave të Tij më të bukur.

Pika e Dytë:

Në natyrën njerëzore është përfshirë një dashuri e fortë për qëndrueshmëri, saqë ai imagjinon një lloj pavdekshmërie në çdo gjë që ai do; madje ai nuk e do diçka veçse pasi të përfytyrojë qëndrueshmërinë në të. Sa herë që ai mendon për zhdukjen e saj ose sheh përkohshmërinë dhe kalimin e saj, ai lëshon klithma e vajton nga thellësitë e qënies së tij. Të gjitha vajtimet dhe rënkimet që burojnë nga llojet e ndarjes janë interpretime vajtimi që shkaktohen nga dashuria për pavdekshmëri. Në qoftë se nuk do të ishte përfytyrimi i pavdekshmërisë, njeriu nuk do të kishte dashur asgjë. Madje mund të

thuhet se një arsye për ekzistencën e botës së përjetshme dhe të parajsës së amshuar është dëshira e fortë për pavdekshmëri e cila buron nga ajo dashuri e zjarrtë për pavdekshmëri, dhe nga duaja e bashkëlindur dhe e përgjithshme për qëndrueshmëri.

I Qëndrueshmi i Vetëm i Madhështisë e pranoi dëshirën e fortë, të ngulitur e të bashkëlindur dhe duanë e tij të fuqishme, efektive e të përgjithshme, sepse Ai krijoi për njeriun kalimtar një botë të përjetshme.

A do të ishte e mundur që Krijuesi Gjithëbujar dhe Mëshirëplotë të mos i përgjigjej duasë të cilën e bën i gjithë njerëzimi nëpërmjet gjuhës së gjendjes së tij dhe fjalës, atë dua universale, të vazhdueshme, të vërtetë e të sinqertë e cila buron nga thellësia e nevojës së tij të bashkëlindur dhe nga thellësitë e dëshirës së tij të fortë, në një kohë që Ai pranon duanë e një stomaku të vogël, të cilën e bën nëpërmjet gjuhës së gjendjes së tij, duke krijuar për të lloje të panumërt prej ushqimeve të shijshme dhe duke ngopur e kënaqur dëshirën e tij të pjesshme për një qëndrueshmëri të përkohshme? Ruajna Zot, njëqind mijë herë! Do të ishte e pamundur që Ai të mos e pranojë atë dua. Sepse mospranimi i saj nga ana e Tij xh.sh. do të ishte në kundërshtim me urtësinë e Tij të përjetshme, me drejtësinë e Tij, me mëshirën e Tij të gjërë dhe me fuqinë e Tij absolute.

Meqenëse njeriu është shumë i dëshiruar për pavdekshmëri, të gjitha plotësimet e tij dhe kënaqësitë varen gjithashtu nga pavdekshmëria. Dhe meqenëse pavdekshmëria është e veçantë për të Qëndrueshmin e Vetëm të madhështisë; dhe meqenëse Emrat e të Qëndrueshmit të Vetëm janë të përhershëm e të pavdekshëm; dhe meqenëse pasqyrat e të Qëndrueshmit të Vetëm të cilat reflektojnë shfaqjet e atyre Emrave të Bukur ngjyrosen me ngjyrimin e tyre dhe reflektojnë vendimin e tyre, domethënë manifestojnë një lloj pavdekshmërie; sigurisht çështja më e rëndësishme për njeriun, detyra e tij më e lartë, është të formojë një lidhje me atë të Qëndrueshëm të Vetëm dhe të kapet pas Emrave të Tij të Bukur. Sepse gjithçka që shpenzohet në Rrugën e të Qëndrueshmit të Vetëm merr një lloj pavdekshmërie. Kështu, fjalia e dytë,

يَابَاقِيَ أَنْتَ الْبَاقِي *'I Qëndrueshmi i Vetëm, Ti je i Qëndrueshmi i Vetëm'* e shpreh këtë të vërtetë. Dhe përveç shërimit të plagëve të panumërta shpirtërore të tij, ajo kënaq e përmbush dëshirën e fortë për pavdekshmëri e cila është e bashkëlindur në natyrën e tij.

Pika e Tretë:

Në këtë botë, efektet e kohës mbi gjërat dhe mbi përkohshmërinë e tyre dhe mbi zhdukjen, ndryshojnë shumë. Dhe ndërsa qëniet janë njëra brenda tjetrës si rrathë bashkëqendrorë, ato janë të ndryshme për sa ka të bëjë me shpejtësinë e zhdukjes dhe të përkohshmërisë.

Ashtu si akrepat e një ore që numërojnë sekondat, dhe ato që numërojnë minutat, orët dhe ditët, pavarësisht se i ngjasojnë në dukje njëri-tjetrit, veçse ama ndryshojnë për sa ka të bëjë me shpejtësinë, po ashtu sferat e trupit, të nefsit, të zemrës dhe të shpirtit tek njeriu ndryshojnë nga njëra-tjetra. Për shembull, trupi ka një pavdekshmëri, një jetë dhe një ekzistencë në ditën aktuale, dhe madje në orën e tanishme. Ti i shikon jetën e trupit, qëndrueshmërinë dhe ekzistencën e tij, të kufizuara në ditën që ai jeton në të ose në orën e tij, kurse e shkuara dhe e ardhmja e tij janë mosekzistuese për të. Megjithatë sfera e jetës së zemrës së tij dhe fusha e ekzistencës së tij shtrihen që nga shumë ditë përpara ditës së tij të tanishme deri tek shumë ditë në të ardhmen. Pastaj sfera e shpirtit është e gjërë; sfera e jetës së tij dhe ekzistenca e tij shtrihen që nga shumë vite përpara ditës së tij të tanishme për në shumë vite pas saj.

Po kështu, për shkak të kësaj aftësie, jeta e përkohshme e njeriut përmban një jetë të përhershme për sa ka të bëjë me jetën e tij të zemrës e të shpirtit të cilat jetojnë me njohjen Hyjnore, me dashurinë Hyjnore, me adhurimin ndaj Krijuesit dhe me kënaqësinë e të Gjithëmëshirshmit, madje jep si rezultat këtë jetë të qëndrueshme e të amshuar në banesën e përjetshmërisë dhe të qëndrueshmërisë, dhe kjo jetë e përkohshme i ngjason jetës së përhershme.

Po, një sekond që njeriu e kalon në rrugën e Allahut, të Qëndrueshmit të Vetëm të Vërtetë, në rrugën e dashurisë së Tij, në rrugën e njohjes së Tij dhe për të fituar kënaqësinë e Tij, numërohet si një vit i plotë, madje ai sekond është i qëndrueshëm dhe i përjetshëm dhe nuk e godet përkohshmëria. Ndërsa një vit nga jeta në qoftë se nuk

do të harxhohej në rrugën e Allahut, meqenëse përfundimisht zhduket - është si një sekond, si një çast. Njëqind vite nga jeta e njerëzve të shkujdesjes lidhur me këtë botë janë si një sekond i vetëm.

Ndodhet një thënie e famshme që e tregon këtë realitet.

سِنَةُ ٱلْفِرَاقِ سَنَةٌ وَسَنَةُ ٱلْوِصَالِ سِنَةٌ

"*Ndarja e një momenti zgjat një vit, dhe bashkimi i një viti kalon aq shpejt si një çast"*

Domethënë, një sekond i vetëm nga ndarja është shumë i gjatë si të ishte një vit, ndërsa një vit i plot bashkimi duket aq i shkurtër si një çast i vetëm.

Ndërsa unë e kundërshtoj këtë fjalë të shquar, dhe them:

Një sekond i vetëm të cilin njeriu e kalon brenda kënaqësisë së Allahut dhe në rrugën e të Qëndrueshmit të Vetëm dhe për hir të Tij, domethënë një sekond i vetëm nga ky bashkim nuk është vetëm si një vit, përkundrazi, ai është si një dritare që shikon nga një jetë e përhershme dhe e qëndrueshme. Kurse jo një vit, por ndoshta një mijë vite të harxhuara në pakujdesi e në çudhëzim kalojnë si të ishin një çast i vetëm.

Ndodhet një proverbë më e famshme se sa ajo e mëparshmja që e mbështet këtë që ne themi:

اَرْضُ ٱلْفَلَاتِ مَعَ ٱلْاَعْدَاءِ فِنْجَانٌ سَمُّ ٱلْخِيَاطِ مَعَ ٱلْاَحْبَابِ مَيْدَانٌ

"Toka e gjërë me armiq bëhet si një gotë, ndërsa vrima e gjilpërës me miq bëhet si një fushë e gjërë".

Një kuptim i qartë i thënies së parë të mirënjohur të lartëpërmendur është ky: Meqenëse bashkimi me qëniet e përkohshme është kalimtar, sado i gjatë që ai të jetë, ai duket i shkurtër. Një vit nga një bashkim i tillë kalon aq shpejt si një sekond, dhe bëhet si një iluzion, si një ëndërr që shkakton brengë e dëshpërim.

Zemra njerëzore, e cila dëshiron pavdekshmëri, mund të marrë nga një bashkim prej një viti kënaqësinë më të vogël aq sa është brenda një sekondi. Një sekond i vetëm nga ndarja, nuk është si të ishte një vit por shumë vite. Sepse arena e ndarjes është e gjërë. Edhe sikur për një sekond, ndarja shkakton vite shkatërrimi e dhembje në zemër, e cila përmallohet për përjetësi, sepse ajo ndarje i kujton dhe e paralajmëron për lloje të panumërta ndarjesh. Ndërsa për dashuritë fizike e të ulëta, e shkuara dhe e ardhmja janë mbushur me ndarje.

Në lidhje me këtë çështje, ne themi këtë: O njeri! A dëshiron ta transformosh jetën tënde të shkurtër e të padobishme në jetë të pavdekshme, të gjatë, të dobishme e të frytshme?

Meqenëse përgjigjja është po! Dhe kështu këkohet nga humanizmi, atëherë shpenzoje jetën tënde në rrugën e të Qëndrueshmit të Vetëm të Vërtetë. Sepse çdo gjë që kthehet e orientohet drejt të Qëndrueshmit të Vetëm merr manifestimin e pavdekshmërisë. Meqenëse gjithësecili dëshiron fort një jetë të gjatë dhe mallëngjehet për pavdekshmëri; dhe meqenëse ekziston një mjet për ta transformuar këtë jetë të përkohshme në jetë të përhershme dhe është e mundur për ta bërë atë një jetë të gjatë në efekt, atëherë, sigurisht, ai që nuk e ka humbur humanizmin e tij do ta kërkonte atë mjet dhe do të përpiqej ta kthejë mundësinë në realitet dhe do të vepronte për ta arritur atë qëllim. Po, mjeti është ky: Punoni për hir të Allahut, takohuni me të tjerët për hir të Allahut, le të jenë të gjitha lëvizjet tuaja brenda kënaqësisë së Allahut, veproni brenda sferës *"Për Zotin, për hir të Zotit, në Emër të Zotit"*. Atëherë të gjitha minutat e jetës suaj të shkurtër do të bëhen si vite.

Duke aluduar për këtë të vërtetë, vërsetet e Kur'anit tregojnë se një natë e tillë e veçantë si *Nata e Kadrit* është sa një mijë muaj, domethënë, rreth tetëdhjetë vite. Gjithashtu duke aluduar për këtë të vërtetë, *'shtrirja e kohës'* është një parim i provuar midis njerëzve të shenjtërisë dhe të realitetit, nëpërmjet misterit të të cilit, ngjitja për pak minuta bëhet si shumë vite dhe e provon ekzistencën e kësaj të vërtete dhe e demonstron në fakt. Pak orë nga Miraxhi i Profetit a.s.m. patën gjatësinë, gjërësinë dhe gjithëpërfshirjen e mijëra viteve, sepse nëpërmjet Miraxhit ai u fut në botën e përjetësisë, dhe vetëm pak minuta të asaj bote përmbajnë mijëra vite të kësaj bote. Përveç kësaj, ka shumë ndodhi të *'shtrirjes së kohës'* të përjetuara nga Evlijatë, shenjtorët, të ndërtuara mbi këtë të vërtetë. Rrëfehet se disa Evlija e

realizuan punën e një dite në një minut të vetëm, disa i kryen detyrat e një viti në një orë, dhe recituan të gjithë Kur'anin për një minut të vetëm. Njerëz të tillë të drejtë të së vërtetës nuk do ta bënin kurrë veten të gënjenin. Nuk mund të ketë dyshim se ata e vështruan saktë realitetin e *'shtrirjes së kohës'*, që është raportuar kështu unanimisht me shumicë[2]. Një lloj i shtrirjes së kohës e vërtetuar nga gjithësecili përjetohet në ëndrra, sepse ai mund të shohë një ëndërr e cila nuk zgjat veçse një minut, ndërkohë që ai kalon situata në të, flet fjalë, gjen kënaqësi dhe pikëllohet me dhimbje, të cilat kërkojnë një ditë të plotë në kohë zgjimi dhe ndoshta shumë ditë.

Shkurtazi: Njeriu, sigurisht, është kalimtar, por ama ai u krijua për pavdekshmëri dhe për të qenë një pasqyrë në të cilën reflektohen manifestimet e të Qëndrueshmit të Vetëm, dhe ai u ngarkua me detyra të cilat prodhojnë frute të përhershëm, dhe atij iu dha një formë e cila është boshti i skalitjeve të manifestimeve të Emrave të bukur të të Qëndrueshmit të Vetëm. Prandaj, detyra e vërtetë dhe lumturia e njeriut është që ai të orientohet drejt Atij të Qëndrueshmi të Vetëm me të gjitha forcat e tij, me të gjitha aftësitë e tij të bashkëlindura dhe me të gjitha gjymtyrët duke përparuar në rrugën e kënaqësisë së Krijuesit, duke u kapur pas Emrave të Tij të bukur, dhe duke përsëritur me të gjitha aftësitë e tij të holla si zemra, shpirti dhe mendja atë që përsërit gjuha e tij,

يَابَاقِى اَنْتَ اَلْبَاقِى *" Ja Baki, Ente El - Baki" O i Qëndrueshmi i Vetëm, Ti je i Qëndrueshmi i Vetëm,* dhe duhet të deklarojë*:*

---

[2] Vërsetet, Njëri prej tyre tha: قَالَ قَآئِلٌ مِّنْهُمْ كَمْ لَبِثْتُمْ قَالُوا لَبِثْنَا يَوْمًا أَوْ بَعْضَ يَوْمٍ "*Sa kohë keni qëndruar (këtu në gjumë)" Ata iu përgjigjën: " Kemi ndenjur mbase një ditë ose një pjesë të saj"*. (Kur'an, 18: 19)

وَلَبِثُوا فِي كَهْفِهِمْ ثَلَاثَ مِائَةٍ سِنِينَ وَازْدَادُوا تِسْعًا *"E ata qëndruan në shpellën e tyre treqind vjet (diellore) duke shtuar nëntë (për vitet hënore)*" (Kur'an, 18:25) tregojnë **Kalimin e kohës**, ndërsa vërseti

وَإِنَّ يَوْمًا عِندَ رَبِّكَ كَأَلْفِ سَنَةٍ مِّمَّا تَعُدُّونَ *"Dhe një ditë tek Zoti yt është sa një mijë vjet sipas llogarisë suaj"*, tregon **shtrirjen e kohës**.

هُوَ الْبَاقِي ۞ هُوَ الْأَزَلِيُّ الْأَبَدِيُّ ۞ هُوَ السَّرْمَدِيُّ ۞ هُوَ الدَّائِمُ،
هُوَ الْمَطْلُوبُ ۞ هُوَ الْمَحْبُوبُ ۞ هُوَ الْمَقْصُودُ ۞ هُوَ الْمَعْبُودُ

"Ai është i Qëndrueshmi i Vetëm! Ai është i parapërjetshëm dhe i paspërjetshëm!

Ai është i Përhershmi! Ai është i Vazhdueshmi! Ai është i Kërkuari! Ai është i Dashuri! Ai është i Synuari! Ai është i Adhuruari!"

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَا إِنْ نَسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا

" Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".[3]

" Zoti ynë! Mos na ndëshko në qoftë se harrojmë, apo biem në gabime".[4]

* * *


[3] Kur'an, 2:32
[4] Kur'an, 2: 286


SHKREPTIMA E KATËRT


Titulli***: "Rruga e sunnetit të Profetit Muhammed a.s.m."*** u konsiderua i përshtatshëm për këtë trajtesë.

[Megjithëse '*çështja e Imamatit'* është një çështje e rëndësisë dytësore, por meqenëse asaj i është dhënë një rëndësi shumë e madhe dhe, për shkak të lidhjes së saj me detyrën tonë themelore, me shërbimin tonë ndaj Kur'anit dhe besimit, ajo është diskutuar pjesërisht këtu për sa ka të bëjë me këtë aspekt dhe me qënien e saj si një temë e shqyrtuar në shkencat e teologjisë -*Ilm el-kelam*- dhe në parimet e fesë.]


بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ


لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُم بِالْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَّحِيمٌ ﴿١٢٨﴾ فَإِن تَوَلَّوْا فَقُلْ حَسْبِيَ اللَّهُ لَا إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ


عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَهُوَ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ ﴿١٢٩﴾


قُل لَّا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ أَجْرًا إِلَّا الْمَوَدَّةَ فِي الْقُرْبَىٰ

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Vërtet që ju ka ardhur juve një i Dërguar (Muhammedi a.s.m.) nga vetë ju (të cilin ju e njihni fare mirë)."

Ai pikëllohet nëse juve ju bie ndonjë lëndim a vështirësi. Ai (Muhammedi a.s.m.) është i merakosur dhe i dëshiruar për ju; për besimtarët ai (a.s.m.) është që ndjen shumë, mëshirues."

Por nëse ata kthejnë kurrizin, atëherë thuaju (O Muhammed a.s.m.): "Allahu është më se i mjaftueshëm për mua. Nuk ka Zot tjetër përveç Tij. Tek Ai unë mbështetem plotësisht dhe Ai është Zoti i Arshit Madhështor".[1] *"Thuaju (O Muhammed a.s.m.) "Asnjë shpërblim nuk ju kërkoj juve për këtë, përveç dashurisë për të afërmit e mi, (dashurinë për Ehli Bejtin, njerëzit e familjes sime)".*[2]

Ne do të tregojmë në dy 'Stacione' dy prej shumë të vërtetave të mëdhaja të përfshira në këto vërsete madhështore.

[1] Kur'an, 9:128-9
[2] Kur'an, 42:23

STACIONI I PARË

Stacioni i parë përbëhet nga katër 'pika'

●Pika e Parë:

Kjo përshkruan dhembshurinë dhe mëshirën e plotë të profetit Muhammed a.s.m. ndaj ummetit, komunitetit të tij.

Po, sipas disa haditheve të saktë, gjatë tmerrit dhe panikut të Ditës së Ringjalljes së madhe, në kohën që gjithësecili dhe, madje edhe Pejgamberët do të luten e do të thërrasin për vetveten duke thënë: *"Nefsi, nefsi! Vetja ime!",* kurse Profeti Muhammed a.s.m.do të lutet e do të thërrasë duke thënë: "*Ummeti im! Ummeti im!"*.[3]

Ashtu siç tregojnë këto rrëfenja të shëndosha dhembshurinë e madhe të Profetit Muhammed a.s.m. për Ummetin e tij, kur Profeti a.s.m. u lind, nëna e tij dëgjoi midis duave të Profetit a.s.m. fjalët: *"Ummeti, Ummeti! Komuniteti im! Komuniteti im!",* siç është vërtetuar prej Evlijave të drejtë të cilëve u zbulohen misteret e krijimit. Gjithashtu, e gjithë historia e jetës së tij dhe sjellja e mirë dhe e mëshirshme të cilën e përhapi, demonstrojnë dhembshurinë dhe shpirtëbutësinë e tij të plotë. Gjithashtu nëpërmjet shjaqjes së një nevoje të pakufishme për salavate të panumërta prej Ummetit të tij, Profeti shfaqi dhembshurinë e tij të madhe; sepse nëpërmjet dhembshurisë së tij të plotë ai shfaqi se sa shumë i lidhur e i merakosur është ai me lumturinë e të gjithë ummetit të tij.

Atëherë, ju mund të kuptoni se sa mosmirënjohje dhe sa mungesë vetëdijeje do të ishte mosvënia në praktikë e Sunnetit të një udhëzuesi kaq të dhembshur e të mëshirshëm. Atëherë, krahasoje këtë me veten tënde dhe vlerësoje!..

[3] Transmeton Buhariu

●Pika e Dytë:

Midis detyrave universale të profetësisë së tij, profeti më i nderuar a.s.m. shfaqi dhembshuri të madhe ndaj disa çështjeve të veçanta e të pjesshme. Harxhimi i asaj dhembshurie e mëshire të madhe në ato çështje të pjesshme e të veçanta nuk i përshtatet -në pamje të jashtme- rëndësisë së madhe të funksionit të profetësisë. Por e vërteta dhe realiteti është se ajo çështje e pjesshme dhe e veçantë përfaqëson majen e një zinxhiri i cili në të ardhmen do të ishte mjeti për përmbushjen e një funksioni universal e të përgjithshëm të profetësisë. Prandaj, rëndësia më e madhe iu dha shembullit për hir të zinxhirit madhështor.

Për shembull, dhembshuria e jashtëzakonshme dhe rëndësia e madhe që i shfaqi profeti a.s.m. ndaj Hasanit dhe Hysejnit në fëmijërinë e tyre nuk ishin vetëm për shkak të dhembshurisë së natyrshme dhe të dashurisë që buronte nga ndjenja e lidhjes familjare, por ajo gjithashtu buronte nga ajo që ata të dy do të ishin fillimi, maja e një zinxhiri të ndritshëm për funksionin e madh të profetësisë dhe, secili prej të dyve do të ishte burimi i një xhemati të madh prej atyre që do të merrnin trashëgiminë e profetësisë, si përfaqësues dhe si model i saj.

Po, profeti më i nderuar a.s.m. e merrte Hasanin, Radiajall-llahu anhu, me dhembshuri e mëshirë të plotë në krahët e tij dhe puthte kokën e tij për hir të shumë pasardhësve prej trashëgimtarëve të profetësisë të ngjashëm me Mehdiun, të cilët do të mbanin sheriatin e shquar të Muhammedit a.s.m., që do ta kishin prejardhjen prej imam Hasanit duke buruar prej origjinës së tij të ndritshme e të bekuar si shembulli i shejh Gejlanit[4], iu shenjtëroftë sekreti i tij. Muhammedi a.s.m. shikoi me syrin e Profetësisë shërbimin e shenjtë dhe detyrën që ata do të kryenin në të ardhmen dhe i miratoi dhe i lavdëroi.

[4] Abdul Kadir Gejlani, u lind në vitin 470 sipas Hixhretit dhe ndërroi jetë në vitin 561. ai qe themeluesi i tarikatit Kadiri. Përkthyesi.

Ai e puthi kokën e Hasanit, Zoti qoftë i kënaqur me të, si shenjë vlerësimi dhe nxitje.

Gjithashtu, Profeti i nderuar a.s.m. e përqafoi Hysejnin, Radijall-llahu anhu, i dha një rëndësi të madhe dhe shfaqi një dhembshuri të fortë ndaj tij për hir të imamëve të shquar e të mëdhenj të ngjashëm me Mehdiun si Imam Zejn AL-Abidine, Xhafer Es-sadik dhe të disa personaliteteve të ndritshëm, trashëgimtarë të vërtetë të profetësisë, të cilët do ta kishin prejardhjen prej linjës së tij të ndritshme.

Po, Profeti a.s.m. e puthi qafën e Husejnit, Zoti qoftë i kënaqur me të, shfaqi dhembshurinë e madhe ndaj tij dhe i dha rëndësi të madhe për hir të atyre që do ta mbanin lart dinjitetin e islamit dhe të cilët do ta përmbushnin detyrën e profetësisë pas tij.

Po, meqenëse me zemrën e tij e cila kishte njohje nga e padukshmja, shikimi i ndritshëm i Profetit a.s.m. dhe syri depërtues tek e ardhmja, panë nga Epoka e Lumturisë në këtë botë Fushën e Ringjalljes e cila shrihet në paspërjetësi.. i cili pa xhennetin në qiejt më të lartë dhe atje shikoi melekët ndërsa vetë ishte në tokë.. Ai i cili shikoi ngjarjet që kishin ndodhur qysh nga koha e Ademit a.s. dhe që ishin mbuluar në perdet e errëta të së shkuarës, saqë ai a.s.m. u nderua me shikimin e Krijuesit xh.sh... Atëherë ky shikim i ndritshëm dhe kjo intuitë, ky sy depërtues tek e ardhmja, sigurisht panë polet e mëdhenj shpirtërorë, dhe imamët e trashëgimisë së profetësisë dhe Mehditë që do të vijonin në linjat e Hasanit dhe të Hysejnit. Dhe sigurisht ai do t'i puthte kokat e tyre në emrin e të gjithë atyre. Po, Shejh Gejlani ka një pjesë të madhe në puthjen e kokës së Hasanit, Radiall-llahu anhu, nga ana e Profetit Muhammed a.s.m..

●Pika e Tretë

Sipas një interpretimi, kuptimi i vërsetit,

إِلَّا الْمَوَدَّةَ فِي الْقُرْبَىٰ *"Thuaju: Asnjë shpërblim nuk ju kërkoj juve për këtë përveç dashurisë ndaj të afërmve (njerëzve të familjes sime)",*[5] është se Profeti më i nderuar a.s.m. nuk kërkon prej ndokujt asnjë shpërblim për kryerjen e detyrës së profetësisë; ai dëshiron vetëm dashurinë për familjen e tij, për Ehli Bejtin.

Në qoftë se do të thuhej: "Sipas këtij kuptimi, duket se u arrit një avantazh dhe u fitua një shpërblim duke marrë parasysh lidhjen familjare, ndërsa sipas kuptimit të vërsetit,

إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِندَ اللَّهِ أَتْقَاكُمْ *"Padyshim se më i nderuari prej jush tek Allahu, është ai që është më i përkushtuar në fe, ai më me takva,"*[6] tregohet se detyra e profetësisë vazhdon duke qenë i afërt me Allahun nëpërmjet takvasë, frikës ndaj Allahut, dhe jo nëpërmjet lidhjeve familjare".

Përgjigja: Me shikimin e tij të profetësisë që depërtoi tek e Padukshmja, Profeti Muhammed a.s.m. shikoi se familja e tij, njerëzit e Ehli Bejtit, do të bëheshin si një pemë dritëdhënëse degët e së cilës do të shtriheshin në botën e islamit. Shumica dërrmuese, të cilët do të kryenin detyrën e udhëzuesve duke instruktuar çdo nivel të botës islame në mirësi, udhëzim, në arritjen njerëzore dhe në integrim dhe të cilët do të ishin shembuj e modele plotësimi, do të shfaqeshin prej Ehli Bejtit, familjes së Profetit Muhammed a.s.m..

Ai zbuloi se duaja e Ummetit të tij për Ehli Bejtin në pjesën e fundit të namazeve të detyruara:

اَللّٰهُمَّ صَلِّ عَلٰى سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ وَ عَلٰى اٰلِ سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ كَمَا صَلَّيْتَ

عَلٰى اِبْرَاهِيمَ وَ عَلٰى اٰلِ اِبْرَاهِيمَ اِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ

[5] Kur'an, 42:23
[6] Kur'an, 49:13

"O Zot! Jepi bekime shkëlqesisë sonë Muhammedit a.s.m. dhe familjes së shkëlqesisë sonë Muhammedit a.s.m, ashtu siç i dhe bekime Ibrahimit dhe familjes së Ibrahimit në botëra; Sigurisht Ti je i denjë për lavdërime, je më i lartësuari -zbuloi se kjo dua- do të pranohej. Domethënë, ashtu si pjesa më e madhe e udhëzuesve të ndritshëm midis njerëzve të Ibrahimit ishin profetë prej familjes dhe prej linjës së Ibrahimit a.s., po ashtu Profeti Muhammed a.s.m. pa se polet shpirtërorë prej Ehli Bejtit do të ishin si pejgamberët e bijve të Israilit në Ummetin Muhammedan duke përmbushur detyrën e shërbimit të madh të islamit në shumë tarikate e metoda.

Prandaj, Profeti Muhammed a.s.m. u urdhërua të thotë:

قُلْ لَآ اَسْـَٔلُكُمْ عَلَيْهِ اَجْرًا اِلَّا الْمَوَدَّةَ فِى الْقُرْبٰى

"Thuaju (o Muhammed a.s.m.): Asnjë shpërblim nuk ju kërkoj juve për këtë, përveç dashurisë për Ehli Bejtin".

Ai i kërkoi komunitetit të tij që ta dojë familjen e tij.

Ndodhen rrëfenja të shumta duke e mbështetur këtë fakt. Profeti a.s.m. në mënyrë të përsëritur tha*: "O njerëz! Unë ju kam lënë dy gjëra. Në qoftë se do t'i përkrahni e do të kapeni pas tyre, ju nuk do të humbisni dhe do të gjeni shpëtim: njëra është libri i Zotit xh.sh., tjetra është familja ime, Ehli Bejti"*[7]; sepse njerëzit e Ehli Bejtit janë burimi dhe ruajtësit e sunnetit të Profetit dhe janë të ngarkuar pikë së pari për ta zbatuar atë në çdo drejtim.

Dhe kështu u bë i qartë realiteti i këtij hadithi duke u mbështetur në atë që u përmend më lartë, domethënë: duke ndjekur plotësisht librin e Zotit xh.sh. dhe sunnetin e pastër. Pra, ajo që kërkohej nga familja e Profetit lidhur me funksionin e profetësisë ishte ndjekja e sunnetit të profetit a.s.m.. Ashtu si ndokush i cili braktis sunnetin e Profetit Muhammed a.s.m. që nuk mund të jetë një anëtar i vërtetë i familjes së

[7] Trasnsmeton Tirmidhiu

tij, po ashtu një person i tillë nuk mund të ishte një përkrahës i vërtetë i Ehli Bejtit.

Pastaj, urtësia se përse Profeti a.s.m. deshi që komuniteti i tij të grumbulloheshin rreth familjes së Tij, ishte sa vijon: Profeti a.s.m. njohu me lejen e Allahut se Ehli Bejti -familja e tij- do të shumohej tepër me kalimin e kohës dhe se islami do të bëhej i dobët. Prandaj në një gjendje të këtillë do të ishte e domosdoshme të ekzistonte një grup tej mase i fortë, i madh në numër dhe me lidhje e mbështetje të ndërsjellë me qëllim që të ishte boshti dhe qendra për përparimin shpirtëror dhe moral të botës islame. Muhammedi a.s.m. e njohu këtë nëpërmjet lejes Hyjnore dhe dëshiroi që komuniteti i tij të mblidheshin përreth familjes së tij, Ehli Bejtit.

Po, anëtarët e Ehli Bejtit edhe në qoftë se nuk do të ishin më të hershëm e më të mëparshëm se sa të tjerët në çështjet e imanit dhe të fesë, veçse ama ata janë shumë më përpara atyre për sa ka të bëjë me nënshtrimin, zbatimin dhe mbështetjen ndaj islamit; sepse ata ishin ndjekësit e islamit nga natyra, nga prejardhja dhe nga temperamenti. Edhe në qoftë se përkrahja e natyrshme do të ishte e dobët, e padenjë ose madje e pajustifikueshme, e kotë, ajo nuk mund të braktiset.

Atëherë, a do të ishte e mundur për një njeri të braktiste përkrahjen ndaj një të vërtete me të cilën ishte lidhur zinxhiri i paraardhësve të tij të cilët i sakrifikuan lirë shpirtërat e tyre në rrugën e saj dhe ata kishin fituar nder e lavdi dhe, ajo e vërtetë është në kulmin e fuqisë dhe të nderit dhe është realiteti i qartë; a do të ishte e mundur për një person që të braktiste përkrahjen e tij ndaj një të vërteteje të cilën ai e ndjeu qartë se ishte shumë themelore dhe e natyrshme? Kështu, për shkak të kësaj përkrahjeje të fortë dhe të këtij nënshtrimi natyral, anëtarët e familjes së Profetit e pranojnë edhe aluzionin më të vogël në favor të fesë islame si të ishte një provë e fuqishme, sepse ata e përkrahën islamin nga natyra, ndërsa të tjerët nuk e përkrahin veçse pasi të jenë bindur me ndonjë provë të fuqishme.

●Pika e Katërt

Në lidhje me Pikën e Tretë, ne do të tregojmë shkurtazi një çështje e cila është një çështje kundërshtie midis Shiitëve dhe Sunitëve dhe është zmadhuar deri në një shkallë të madhe saqë ka hyrë në librat mbi çështjet e besimit dhe midis themeleve të imanit.

Çështja është kjo:

Sunitët thonë: Hazreti Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të, ishte i katërti i kalifëve të udhëzuar drejt. Ebu Bekr El-siddik, Zoti qoftë i kënaqur me të, ishte më i lartë se sa ai dhe më i denjë për kalifatin, dhe prandaj e mori i pari kalifatin.

Shiitët thonë: "E Drejta e kalifatit ishte e Aliut, Zoti qoftë i kënaqur me të, por atij iu bë një padrejtësi. Dhe Hazreti Aliu ishte më i denji i atyre të gjithëve". Përmbledhja e argumenteve që ata sjellin për pretendimin e tyre është se ata thonë: Ardhja e haditheve të shumta profetike lidhur me virtytet e Hazreti Aliut, Zoti qoftë i kënaqur prej tij dhe, nëpërmjet titullit të tij "Sulltani i Evlijave", qënia e tij si burimi për shumicën absolute të shenjtorëve, Evlijave dhe të rrugëve shpirtërore, tarikateve të sufizmit; njohuria e tij e jashtëzakonshme, guximi dhe adhurimi dhe lidhja e fuqishme që Profeti Muhammed a.s.m. e shfaqi ndaj tij dhe ndaj të gjithë pasardhësve të Ehli Bejtit që do ta kishin prejardhjen prej tij, e gjitha kjo tregon se imam Aliu ishte më i denji, më i merituesshmi. Kalifati ishte gjithmonë e drejta e tij; kalifati iu rrëmbye.

Përgjigjja: Fakti që imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, ndoqi tre kalifët e parë, të cilët në mënyrë të përsëritur i njohu dhe i pranoi, dhe fakti që ai mbajti postin e Shejhul islamit, Gjykatësit më të lartë të drejtësisë, për më shumë se njëzet vjet, i hedh poshtë këto pretendime të Shiitëve. Për më tepër, fitoret e islamit dhe luftërat kundra armiqve të tij në kohën e tre kalifëve të parë ndryshe nga ngjarjet e rënda dhe trazirat që ndodhën në kohën e imam Aliut; të gjitha këto i refuzojnë

përsëri pretendimet e Shiitëve nga këndvështrimi i kalifatit. Domethënë, pretendimi i Sunitëve është i drejtë.

Në qoftë se do të thuhej: Shiitët janë dy grupe: Njëri janë 'Shiitët *e Shenjtërisë'* dhe tjetri janë '*Shiitët e kalifatit'*.

Për shkak të përzierjes së urrejtjes dhe të politikave në pretendimet e tij, grupi i dytë mund të jetë i padrejtë, mirëpo grupi i parë nuk ka synime apo ambicie politike. Përveç kësaj, Shiitët e shenjtërisë iu bashkuan shiitëve të kalifatit. Domethënë, disa shenjtorë, Evlija të tarikateve Sufi e konsideruan Imam Aliun, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, se ishte më i larti dhe miratuan e mbështetën pretendimet e shiitëve të kalifatit.

***Përgjigjja*:** Është e domosdoshme të shikohet Hazreti Aliu nga dy këndvështrime ose dy drejtime:

Drejtimi i parë: Ai duhet të shikohet nga këndvështrimi i virtyteve të tij personale dhe nga këndvështrimi i rangut të lartë të personit të tij.

Drejtimi i dytë: Duhet që ai të shikohet nga këndvështrimi i përfaqësimit të tij personalitetin kolektiv të Ehli Bejtit. Personaliteti kolektiv i Ehli Bejtit reflekton një aspekt të natyrës esenciale të Profetit më të nderuar a.s.m...

Dhe kështu, për sa ka të bëjë me drejtimin e parë, të gjithë njerëzit e së vërtetës me në krye Hazreti Aliun u dhanë përparësi Hazreti Ebu Bekrit dhe Hazreti Umerit, Zoti qoftë i kënaqur me ta. Ata i shikuan rangjet e atyre të dyve si më të larta në shërbimin e islamit dhe në afërsinë me Krijuesin.

Sa për drejtimin e dytë lidhur me qënien e tij si përfaqësuesi i personalitetit kolektiv të Ehli Bejtit, personaliteti kolektiv i familjes së profetit a.s.m. duke përfaqësuar një aspekt të së vërtetës Muhammedane, Hazreti Aliu nuk ka të barabartë, shok. Kështu, hadithet e shumta profetike që lavdërojnë Hazreti Aliun, Zoti qoftë i kënaqur me të, dhe që tregojnë virtytet e tij janë për hir të këtij

drejtimit të dytë. Ndodhet një rrëfenjë e shëndoshë e cila e mbështet këtë fakt. Profeti Muhammed a.s.m. tha: *"Pasardhësit e çdo profeti janë nga vetë profeti, ndërsa pasardhësit e mi janë ata prej Aliut".*[8]

Arsyeja pse hadithet që lavdërojnë Hazreti Aliun më shumë se sa tre kalifët e tjerë janë të përhapur gjërë është se njerëzit e së vërtetës, domethënë sunitët i përhapën rrëfenjat që erdhën lidhur me personalitetin e Hazreti Aliut, Zoti qoftë i kënaqur me të, përballë sulmeve të Umevitëve dhe Havarixhëve kundra tij dhe kundra përçmimit të tyre të padrejtë ndaj tij. Meqenëse kalifët e tjerë të udhëzuar drejtë nuk u zbuluan para kritikave dhe përçmimeve të tilla, nuk u ndie nevoja për të përhapur hadithe rreth tyre.

Për më tepër, Profeti Muhammed a.s.m. shikoi me syrin e profetësisë se Hazreti Aliu në të ardhmen do të zbulohej para ngjarjesh të dhimbshme dhe konfliktesh të brendshme dhe, me qëllim që ta shpëtonte atë nga dëshpërimi dhe ta shpëtonte komunitetin e tij nga të menduarit keq për të, ai e ngushëlloi imam Aliun dhe e udhëzoi komunitetin e tij me hadithe të rëndësishëm të tillë, si مَنْ كُنْتُ مَوْلَاهُ فَعَلِيٌّ مَوْلَاهُ *"Prijësi i cilitdo që të jem, edhe Aliu gjithashtu është prijësi i tij".*[9]

Dashuria e tepruar e Shiitëve të shenjtërisë ndaj imam Aliut dhe vlerësimi i tyre për të duke e konsideruar si më të lartin për shkak të ndikimit të Tarikatit Sufi nuk i bën ata përgjegjës deri tek shkalla e përgjegjësisë së Shiitëve të kalifatit, sepse sipas rrugës së tyre njerëzit e shenjtërisë shikojnë me dashuri drejt udhëheqësve të tyre shpirtërorë. Dhe shenja e dashurisë është tepria, ajo dëshiron ta shohë të dashurin si më të madh se sa rangu i tij. Ata në fakt e shikojnë kështu çështjen.

Njerëzit e dalldisur mund të jenë të shfajësuar gjatë shpërthimit të dashurisë tek ato dhe gjatë kohës që ajo i sundon, por me kusht që

[8] Transmeton Tibraniu
[9] Transmetojnë Ahmedi dhe Tirmidhiu

vlerësimi i tyre për Aliun si më i denji, vlerësimi që buron nga dashuria e tyre, të mos shndërrohet në përçmim e armiqësi ndaj kalifëve të tjerë të drejtë dhe të mos kalojnë përtej mësimeve themelore të islamit, ky vlerësim mund të jetë i justifikueshëm.

Sa për Shiitët e kalifatit, meqenëse i mbërtheu paragjykymi politik, ata nuk mund të shpëtojnë nga urrejtja dhe nga agresioni dhe, ata e humbën të drejtën për t'u shfajësuar. Madje ata e shfaqin hakmarrjen e tyre ndaj *Umerit* në formën e dashurisë së *Aliut,* meqë krenaria kombëtare Persiane u plagos nga dora e Hazreti Umerit, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, saqë ata miratuan dhe mbështetën thënien: لَا لِحُبِّ عَلِيٍّ بَلْ لِبُغْضِ عُمَرَ "Jo për dashurinë e Aliut, por nga urrejtja për Umerin". Gjithashtu rebelimi i Amr Ibn El-A's kundra Hazreti Aliut, Zoti qoftë i kënaqur prej tij dhe luftimi tragjik i Umer Ibn El-Sad kundra Hazreti Hysejnit, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, zgjuan tek Shiitët një zemërim të fortë dhe një armiqësi të tepruar ndaj Emrit 'Umer'.

Shiitët e shenjtërisë nuk kanë të drejtë t'i kritikojnë Sunitët, sepse Sunitët nuk e përçmojnë Hazreti Aliun, përkundrazi, ata e duan atë me sinqeritet. Por ata i shmangen dashurisë së tepruar e cila përshkruhet si e dëmshme dhe e rrezikshme në hadithe. Lavdërimi i Profetit a.s.m. për ndjekësit e Hazreti Aliut në hadithe u referohet Sunitëve, sepse ndjekësit e Hazreti Aliut që e duan atë në mënyrë të moderuar janë Sunitët, të cilët janë njerëzit e së vërtetës.

Ashtu si dashuria e tepruar për Jezusin, Isain a.s., që është e rrezikshme për krishterët, po ashtu është bërë e qartë në hadithe të sakta se *"Ai lloj i tepruar dashurie për Hazreti Aliun është e rrezikshme"*[10].

Në qoftë se Shiitët e Shenjtërisë thonë: "Pasi të pranohen virtytet dhe cilësitë e jashtëzakonshme të Hazreti Aliut, Zoti qoftë i kënaqur

[10] Transmeton Buhariu

prej tij, nuk mund të preferohet Hazreti Ebu Bekri El-Siddik dhe nuk mund të pranohet epërsia e tij mbi imam Aliun"

Përgjigjja: Në qoftë se do të vendoseshin në pjatën e peshores virtytet personale të Hazreti Ebu Bekrit ose virtytet e Hazreti Umerit, Zoti qoftë i kënaqur prej të dyve së bashku me arritjet dhe shërbimet e tyre të mëdhaja në kohën e kalifateve të tyre të realizuara nëpërmjet përmbushjes së funksioneve të tyre të trashëguara nga profetësia, dhe të vendoseshin në pjatën tjetër të peshores veçoritë e jashtëzakonshme të Hazreti Aliut, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, së bashku me konfliktet e brendshme të kalifatit në kohën e tij të cilat u shkaktuan prej ngjarjeve tragjike tek të cilat ai qe i detyruar të futej dhe të cilat ishin objekte dyshimi e mendimi të keq, nuk ka dyshim se pjata e peshores së Hazreti Ebu Bekrit ose pjata e peshores së Hazreti Umer El-Farukut ose pjata e peshores së Hazreti Uthman Dhun-Nurejnit do të ishin më të rënda, do të peshonin më shumë. Dhe këtë peshim më të rëndë e panë Sunitët dhe prandaj ata i preferuan ata të tre mbi imam Aliun.

Për më tepër, ashtu siç është provuar në Fjalën e Dymbëdhjetë dhe në Fjalën e Njëzet e Katërt, shkalla e profetësisë është aq e lartë në krahasim me shkallën e shenjtërisë, saqë një manifestim i vogël i saj është më i lartë se sa manifestimi më i madh i shkallës së shenjtërisë.

Atëherë nga ky këndvështrim, pjesa e secilit prej *El-Siddikul Al-Ekber*, dhe ajo e *Faruk El-A'dhami,* për sa i përket trashëgimisë së Profetësisë dhe themelimit të ligjeve të saj, u shtua nga ana Hyjnore. Atëherë suksesi që ata të dy patën gjatë kalifatit të tyre u bë një tregues dhe një argument për Sunitët. Dhe meqenëse virtytet personale të jashtëzakonshme të Hazreti Aliut nuk e hedhin poshtë atë pjesë të shumtë të shtuar që erdhi nga trashëgimia e Profetësisë, Hazreti Aliu veproi si Shejhul Islam -Gjykatësi më i lartë i drejtësisë- për dy Shejhët e nderuar Ebu Bekrin dhe Umerin në kohën e kalifateve të tyre dhe mbajti qëndrim të bindur ndaj atyre të dyve. A është e mundur që njerëzit e së vërtetës, Sunitët të cilët e duan dhe e nderojnë Hazreti Aliun, të mos i duan e t'i respektojnë dy Shejhët të cilët vetë Hazreti

Aliu i deshi dhe i nderoi me sinqeritet? Le ta sqarojmë këtë të vërtetë nëpërmjet një shembulli:

Një burrë shumë i pasur e shpërndau trashëgiminë dhe pasurinë e tij të madhe midis fëmijëve të tij. Kështu, ai i dha njërit prej tyre njëzet *rotl* (gur, peshë) argjend dhe katër *rotl* flori; një tjetri i dha pesë *rotl* argjend dhe pesë *rotl* flori dhe një tjetri i dha tre *rotl* argjend dhe pesë *rotl* flori: Nuk ka dyshim se dy të fundit pavarësisht se morën më pak se i pari nga sasia, por ama ata të dy morën më shumë se ai nga cilësia.

Dhe kështu në dritën e këtij shembulli, shtesa e pakët në pjesën e dy Shejhëve prej floririt të "*afërsisë së menjëhershme Hyjnore*" që u manifestua prej trashëgimisë së profetësisë dhe themelimit të ligjeve të saj peshon më shumë se sa virtytet personale, xhevahiret e shenjtërisë dhe të 'Afërsisë Hyjnore' të Hazreti Aliut, Zoti qoftë i kënaqur me të. Këto pika gjithashtu duhet të merren në konsideratë kur bëhet peshimi. Por në qoftë se ata do të krahasoheshin me njëri-tjetrin nga këndvështrimi i guximit personal, i njohurisë dhe i aspektit të shenjtërisë, atëherë forma e së vërtetës, do të ndryshonte.

Gjithashtu nuk mund të ketë krahasim lidhur me personalitetin kolektiv të Ehli Bejtit, i cili u përfaqësua me personin e Imam Aliut, Zoti qoftë i kënaqur me të dhe, lidhur me të vërtetën Muhammedane e cila u përfaqësua në atë personalitet kolektiv nëpërmjet trashëgimisë absolute të profetësisë; sepse në këtë anë është përfshirë misteri madhështor i Profetit më të madh a.s.m..

Sa për Shiitët e kalifatit, ata nuk kanë të drejtë përveç turpit përpara Sunitëve, sepse megjithëse pretendojnë se kanë dashuri shumë të madhe ndaj Hazreti Aliut, ata e përçmojnë atë, sepse medhhebi i tyre bën të domosdoshëm akuzën ndaj tij për pamoralshmëri -Ruajna Zot!, sepse ata thonë: "Megjithëse Ebu Bekër El-Siddiku dhe Umer El-Faruku vepruan me padrejtësi, Hazreti Aliu u shtir në miratimin e tyre dhe i pati frikë". Dhe sipas terminologjisë Shiite, Imam Aliu, u shtir -fshehu qëllimin, ndjenjat-. Domethënë ai u frikësua prej tyre dhe veproi me hipokrizi.

Ta përshkruash këtë hero të madh të islamit i cili fitoi titullin "*Luani i Allahut*", dhe i cili u bë komandant e ministër tek Dy të Vërtetit..

Unë them se ta përshkruash atë se qenka shtirur, qenka frikësuar, se qenka hequr sikur i do ata që nuk i do me të vërtetë dhe se paska ndjekur të padrejtët më shumë se njëzet vite duke i miratuar me shtirje nën sundimin e frikës, kjo nuk është dashuri. Hazreti Aliu nuk do ta pranonte një dashuri të tillë.

Kështu medhhebi i njerëzve të së vërtetës nuk e përçmon absolutisht Hazreti Aliun, as nuk e akuzon atë për pamoralshmëri. Ky medhheb nuk i atribuon frikë këtij heroi të shquar, por njerëzit e këtij medhhebi, Sunitët, thonë: "Në qoftë se Hazreti Aliu nuk do ta kishte parë të drejtë, tek kalifët e udhëzuar drejtë, ai nuk do t'i kishte pranuar ata as edhe për një minut dhe nuk do t'u ishte bindur atyre". Kjo do të thotë se meqenëse Hazreti Aliu e njohu se ata janë të drejtë dhe pranoi qënien e tyre më të preferueshëm, ai e sakrifikoi trimërinë e tij të jashtëzakonshme në rrugën e dashurisë për të vërtetën, në rrugën e drejtësisë.

Shkurtazi: Nuk është e mirë as ajo që kalon cakun, as ajo që lihet e mangët. Moderimi është rruga e mesme dhe këtë kanë zgjedhur Sunitët. Por me keqardhje, ashtu siç kanë hyrë deri në një farë shkalle idetë e Havarixhëve tek Sunitët, po ashtu ato janë të joshur pas politikës dhe ateistët e kritikojnë Hazreti Aliun, Zoti qoftë i kënaqur me të, dhe thonë, Ruajna Zot! "Meqenëse nuk i kuptoi politikat, ai nuk ishte plotësisht i denjë për kalifatin dhe nuk mundi ta drejtonte". Dhe për shkak të këtyre akuzave të padrejta të tyre, Alevitët -Shiitët- ndjehen të fyer e të indinjuar prej Sunitëve. Gjendja është se parimet e sunitëve dhe themelet e medhhebit të tyre nuk i bëjnë të domosdoshme këto ide, përkundrazi ato provojnë të kundërtën.

Prandaj, Sunitët nuk mund të dënohen për shkak të ideve të tilla që vijnë nga Havarixhët dhe nga Ateistët. Përkundrazi, Sunitët janë ndjekës e përkrahës më të fortë ndaj Hazreti Aliut se sa Shiitët. Sunitët

e përmendin Imam Aliun në mënyrën lavdëruese që ai e meriton në të gjitha hutbet e predikimet, dhe në duatë e tyre. Në mënyrë të veçantë Evlijatë dhe dijetarët e pastër, shumica absolute e të cilëve ishin prej medhhebit të Sunitëve, e pranuan atë si udhëzuesin e tyre shpirtëror dhe si prijësin, mbretin e shenjtërisë.

Shiitët duhet t'i shpërfillin Havarixhët dhe ateistët të cilët në mënyrë të meritueshme kanë fituar armiqësinë si atë të Shiitëve po ashtu edhe atë të Sunitëve dhe të mos marrin anën kundra njerëzve të së vërtetës.

Madje disa Shiitë e braktisin Sunnetin e Profetit nga inati për Sunitët!

Dhe kështu, o Sunitë që jeni njerëzit e së vërtetës!

Dhe o Shiitë që e keni marrë dashurinë për Ehli Bejtin si rrugën tuaj!

I jepni fund menjëherë këtij kundërshtimi të pakuptim, të pabesë, të padrejtë dhe të dëmshëm ndërmjet jush.

Përndryshe, rryma ateiste, e cila sundon tani dhe ka shumë influencë, do ta bëjë njërin prej jush një vegël kundra tjetrit dhe do ta përdorë njërin për të shtypur e dërrmuar tjetrin.

Dhe pasi të shpartallojë njërin, ajo do të shkatërrojë veglën, instrumentin. Meqenëse ju jeni besimtarë në Unitetin Hyjnor, do të ishte e domosdoshme që t'i lini mënjanë çështjet e pjesshme e të parëndësishme të cilat shkaktojnë grindje e kundërshti ndërsa ndodhen qindra lidhje të shenjta midis jush të cilat urdhërojnë e bëjnë thirrje për vëllazëri e unitet.

* * *

STACIONI I DYTË[11]

Stacioni i dytë do të jetë rreth të vërtetës së dytë të vërsetit,

فَإِنْ تَوَلَّوْا فَقُلْ حَسْبِيَ اللَّهُ لَا إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَهُوَ
رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ

"Por nëse ata kthejnë kurrizin, atëherë thuaju (o Muhammed a.s.m.): "Allahu është më se i mjaftueshëm për mua.

Nuk ka Zot tjetër përveç Atij. Tek Ai unë mbështetem plotësisht dhe Ai është Zoti i Arshit Madhështor"[12]

* * *

[11] Shënim: Ky stacioni i dytë u shkrua më vete; ai është shkreptima e Njëmbëdhjetë. Autori.

[12] Kur'an, 9:129

SHKREPTIMA E PESTË

Një trajtesë u synua për të shpjeguar në pesëmbëdhjetë shkallë një të vërtetë më të rëndësishme të vërsetit, حَسْبُنَا اللهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ *"Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve"*.[1]

Por meqenëse ajo do të kishte qenë e lidhur më shumë me mendimin reflektiv dhe me përmendjen e Zotit se sa me realitetin dhe me njohjen intelektuale, ajo u shty për më vonë tani. Në fakt, trajtesa e rëndësishme e titulluar '*Rruga e Sunnetit profetik dhe kundërhelmi ndaj sëmundjes së bidatit'* në fillim u njoh si Shkreptima e Pestë, por duke u ndarë në njëmbëdhjetë Pika, ajo u bë Shkreptima e njëmbëdhjetë, dhe vendi i Shkreptimës së Pestë mbeti i pazënë, bosh.

* * *

[1] Kur'an, 3: 173.

Mësuesi ynë, hazreti ustad Said Nursi, tha në shpjegimin e këtyre dy frazave në shënimin e kapitullit të gjashtë të Shkreptimës së Njëzet e Nëntë, e cila është në arabisht: "Shkallët e këtyre dy frazave u shkruan në arabisht për arsye se janë reflektim dhe përmendje për Allahun më shumë se sa njohje intelektuale"...

حَسْبُنَا اللهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ Rrezja e katërt e quajtur "***Hasbije Risalesi***" rreth këtij vërseti u shkrua më vonë në Turqisht.

Nënshkruan studentët e Ustadh Beduizzaman Said Nursi.

SHKREPTIMA E GJASHTË


Përsëri, duhej të kishte qenë një trajtesë për të shpjeguar në Njëzet e pesë shkallët e mendimit reflektiv të vërtetën e rëndësishme të pohuar në vërsete të shumta të Kur'anit dhe të shprehur nga fraza: لَاحَوْلَ وَلَاقُوَّةَ اِلَّابِاللهِ الْعَلِيِّ الْعَظِيمِ *"Nuk ka forcë e fuqi përveçse nëpërmjet Allahut, të Lartësuarit, Madhështorit"*[1]. Ashtu si Shkreptima e Pestë, kjo gjithashtu formoi shkallët që unë i kisha ndjerë në veten time dhe i kisha vëzhguar nëpërmjet reflektimit dhe përmendjes së Allahut në udhëtimin tim të shpirtit. Prandaj, meqenëse ajo ishte mjeti për ndriçimin dhe për kënaqësinë shpirtërore më shumë se sa njohje intelektuale dhe se sa realitet, u konsiderua e përshtatshme të përfshihej në fundin e Shkreptimave, të cilat janë rreth realitetit, më shumë se midis tyre.

* * *

[1] Kjo është vendosur brenda Shkreptimës së Njëzet e Nëntë në arabisht...

SHKREPTIMA E SHTATË

[Kjo është rreth shtatë llojeve të njoftimeve që lidhen me të padukshmen në fundin e sures *El- Fet'h*]



Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Pa dyshim që Allahu do ta përmbushë ëndrrën e vërtetë të cilën Ai ia shfaqi të Dërguarit të Tij a.s.m. tamam me vërtetësi. Padyshim që ju do të hyni në El-Mesxhid El-Haram -Qabe- në dashtë Allahu, të sigurt, disa me kokën të rruar e disa me flokë të shkurtuar pa pasur aspak frikë. Ai e dinte çfarë ju nuk dinit dhe Ai ju dhuroi, përveç kësaj, fitore të afërt.

Ai është i Cili ka çuar të Dërguarin e Tij, Muhammedin a.s.m., me udhëzim dhe fenë e vërtetë, që Ai ta shpallë e ta bëjë atë përmbi të gjitha fetë. Dhe i Gjithëmjaftueshëm është Allahu si Dëshmues.

Muhammedi a.s.m. është i Dërguari i Allahut dhe ata që janë me të janë të ashpër ndaj mohuesve (të Allahut) dhe të mëshirshëm ndërmjet tyre.

I sheh ata të përkulen (në Ruku) dhe të lëshohen me fytyrë në tokë (në sexhde kur i falen Allahut), duke kërkuar begati nga Allahu dhe kënaqësinë e Tij. Shenja e tyre (e besimit të tyre) është në fytyrat e tyre nga gjurmët e sexhdes. Ky është përshkrimi i tyre në Teurat, ndërsa shembulli i tyre në Ungjill përshkruhet si një farë (e mbjellë) e cila lëshon llastarin, pastaj e forcon atë dhe ai pastaj qëndron vetë në trungun e vet duke i mrekulluar mbjellësit, që Ai t'i tërbojë mosbesimtarët me anë të tyre. Allahu u ka premtuar atyre nga mesi i tyre të cilët besojnë dhe punojnë mirësi e drejtësi falje dhe shpërblim tepër të madh.[1]

Këto tre vërsete nga sure *El-Fet'h* përmbajnë shumë aspekte të mrekullisë.

Nga dhjetë aspekte të përgjithshme të mrekullisë së Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm, aspekti që ka të bëjë me dhënien e njoftimeve të tij rreth të padukshmes mund të shihet në shtatë ose tetë mënyra në këto tre vërsete.

E Para

لَقَدْ صَدَقَ اللَّهُ رَسُولَهُ الرُّؤْيَا *"Padyshim që Allahu do ta përmbushë ëndrrën e vërtetë të cilën Ai ia shfaqi të Dërguarit të Tij..."* deri në fund të vërsetit, dha njoftime të sigurta për pushtimin e Mekës para se të

[1] Kur'an, 48 : 27-29

ndodhte. Ajo ndodhi dy vjet më vonë ashtu siç u paratha e u parashikua.

E Dyta

فَجَعَلَ مِنْ دُونِ ذٰلِكَ فَتْحًا قَرِيبًا

"Dhe Ai ju dhuroi përveç kësaj një fitore të afërt" pohon se megjithëse paqja e Hudejbies dukej në pamje të jashtme në kundërshtim me interesat e islamit dhe kurejshët ishin fitimtarë deri diku, mirëpo në realitet ajo do të ishte një fitore e madhe dhe çelësi për pushtime të mëtejshme. Sepse ndonëse me paqen e Hudejbies shpata materiale mbeti e varur në këllëf përkohësisht, shpata xixëlluese prej diamanti e Kuranit u zhvesh, doli nga këllëfi, dhe pushtoi mendjet dhe zemrat. Nëpërmjet armëpushimit, të dyja palët u përzien me njëra-tjetrën. Virtytet e islamit dhe dritat e Kuranit i grisën perdet e kryeneçësisë dhe të fanatizmit të egër fisnor, dhe përmbushën dekretet e tyre.

Për shembull, njerëzit si Halid Ibn Velid, një luftëtar i shkëlqyer, dhe Amr Ibn El-A's, një politikan i shquar, të cilët nuk mund ta pranonin humbjen, u shpartalluan nga shpata Kuranore e shfaqur nëpërmjet armëpushimit të Hudejbies. Pas nënshtrimit me bindje të plotë ndaj islamit në Medine, Halidi u bë një 'shpatë e Allahut', një shpatë në pushtimet e islamit.

Një pyetje e rëndësishme: Cila është urtësia në humbjet e sahabëve, shokëve të profetit Muhammed a.s.m., e lavdisë së botës dhe e të Dashurit të Zotit të të gjitha botëve, nga idhujtarët në fundin e betejës së Uhudit dhe në fillimin e betejës së Hunejnit?

Përgjigjja: Midis idhujtarëve gjendeshin shumë persona si Halidi të cilët në të ardhmen do të ishin të barabartë me Sahabët kryesues të asaj kohe. Prandaj, me qëllim që të mos poshtëroheshin krejtësisht në shikimin e së ardhmes, e cila për ta do të ishte e lavdishme dhe e nderuar, Urtësia Hyjnore u dha atyre në të shkuarën një shpërblim të menjëhershëm për veprat e tyre të mira të së ardhmes dhe nuk e shkatërroi plotësisht krenarinë e tyre. Domethënë, Sahabët e së shkuarës u mundën nga Sahabët e së ardhmes, me qëllim që sahabët e së ardhmes të hynin në islam, jo nëpërmjet frikës së shpatës xixëlluese,

por nëpërmjet zellit për shkreptimën e së vërtetës, dhe me qëllim që ata dhe trimëria e tyre të mos poshtëroheshin.

E Treta

Fjalët, لَا تَخَافُونَ *"pa pasur aspak frikë"* tregojnë këtë: "Ju do të silleni rreth Qabes, do të bëni tavaf, në një siguri të plotë", ndonëse në atë kohë shumica e popujve nomadë të gadishullit arabik dhe shumica e rrethinave të Mekës dhe fisi i Kurejshëve ishin armiqësorë kundra myslimanëve. Nëpërmjet parashikimit se "Së shpejti do të bëni tavaf rreth qabes pa pasur aspak frikë", kjo tregonte e parathonte se gadishulli arabik do të nënshtrohej dhe të gjithë kurejshitët do të hynin në islam dhe një siguri e plotë do të vendoset. Dhe ajo ndodhi ekzaktësisht ashtu siç u parashikua.

E Katërta

هُوَ الَّذِي أَرْسَلَ رَسُولَهُ بِالْهُدَىٰ وَدِينِ الْحَقِّ لِيُظْهِرَهُ عَلَى الدِّينِ كُلِّهِ

"Ai është i Cili ka çuar të Dërguarin e Tij me udhëzim dhe fenë e vërtetë që Ai ta shpallë e ta bëjë atë përmbi të gjitha fetë". Ky vërset parashikon e njofton me të gjithë sigurinë se feja të cilën e solli profeti i nderuar a.s.m. do të triumfojë përmbi të gjitha fetë, megjithëse në atë kohë, krishterimi, judaizmi dhe zoroastrizmi kishin qindra milionë ndjekës dhe ishin fetë zyrtare të shteteve mbisunduese të botës si Roma, Kina dhe Persia, që kishin qindra milionë nënshtetas, dhe Muhammedi arab a.s.m. nuk ishte në gjendje të nënshtronte madje as fisin e tij të vogël. Megjithatë ajo parathotë se feja që ai solli do të triumfonte përmbi të gjitha fetë dhe do të ishte fitimtare përmbi të gjithë shtetet. Dhe ajo e njofton këtë në mënyrën më të qartë e më të sigurt. E ardhmja e vërtetoi këtë parashikim me shpatën e islamit duke u shtrirë nga Oqeani Paqësor në lindje për tek Oqeani Atlantik në perëndim.

E Pesta

مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ وَالَّذِينَ مَعَهُ أَشِدَّاءُ عَلَى الْكُفَّارِ رُحَمَاءُ بَيْنَهُمْ تَرَاهُمْ رُكَّعًا سُجَّدًا

Muhammedi a.s.m. është i dërguari i Allahut dhe ata që janë me të janë të ashpër ndaj mohuesve (të Allahut) dhe të mëshirshëm ndërmjet tyre.

I sheh ata të përkulen (në ruku) dhe të lëshohen me fytyra në tokë (në sexhde kur i falen Allahut), duke kërkuar begati nga Allahu dhe kënaqësinë e Tij. Shenja e tyre (e besimit të tyre) është në fytyrat e tyre nga gjurmët e sexhdes...". Nëpërmjet njoftimit të cilësive të larta dhe veçorive të cilat ishin arsyeja për sahabët të ishin më të lartësuarit e llojit njerëzor pas profetëve, fillimi i këtij vërseti përshkruan nëpërmjet kuptimit të tij të qartë cilësitë e shkëlqyera që do të shënonin e veçonin klasën e sahabëve. Dhe nëpërmjet kuptimit të tij të nënkuptuar, vërseti aludon për kalifët e drejtë, të cilët do të ndiqnin detyrën e profetit a.s.m. pas vdekjes së tij nëpërmjet institucionit të kalifatit, dhe jep njoftimet për cilësitë më të shquara e të veçanta për gjithësecilin prej tyre me të cilat ata do të dalloheshin e veçoheshin. Kjo është siç vijon:

وَالَّذِينَ مَعَهُۥٓ *"Dhe ata që janë me të ..."* aludon për Ebu Bekrin El-Siddik, i cili ishte i dalluar dhe i famshëm për qënien midis ndjekësve më të veçantë të profetit a.s.m. dhe për pjesëmarrjen e shoqërimin në bashkëbisedimin me të, dhe përsëri për hyrjen midis ndjekësve të tij të veçantë duke qenë i pari që vdiq, që ndoqi profetin a.s.m. për në botën tjetër.

Ndërsa أَشِدَّآءُ عَلَى ٱلْكُفَّارِ , *"... janë të ashpër ndaj mohuesve..."* tregon Hazreti Umerin, i cili në të ardhmen do t'i bënte popujt e globit të trembeshin nga pushtimet e tij, dhe me drejtësinë e tij që do të binte mbi tiranët si rrufe. Dhe رُحَمَآءُ بَيْنَهُمْ *"... të mëshirshëm ndërmjet tyre..."* jep njoftime për Hazreti Uthmanin r.a, i cili në të ardhmen kur debati më serioz do të ndizej, ai do të sakrifikonte vetë jetën e tij dhe shpirtin nga dhembshuria e tij e plotë dhe nga mëshira me qëllim që të mos derdhej gjaku i muslimanëve, duke preferuar të martirizohej padrejtësisht ndërsa po lexonte Kur'an.

Dhe تَرَىٰهُمْ رُكَّعًا سُجَّدًا يَبْتَغُونَ فَضْلًا مِّنَ ٱللَّهِ وَرِضْوَٰنًا *"... I sheh ata të përkulen (në ruku) dhe të lëshohen me fytyrë në tokë (në sexhde kur i falen Allahut), duke kërkuar begati nga Allahu dhe kënaqësinë e Tij..."* tregon se me meritën e tij më të plotë për të marrë përsipër kalifatin dhe qeverisjen, me heroizmin dhe me zgjedhjen e shkallës më të plotë të asketizmit, të adhurimit, të varfërisë para Allahut, të kursimit, dhe

vazhdimësinë në ruku e në sexhde gjatë faljeve ashtu siç vërtetohet nga të gjithë njerëzit, imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të, nuk ishte përgjegjës për pozitën e tij në të ardhmen dhe për luftërat dhe mosmarrëveshjet në të cilat ai u përfshi, dhe qëllimi i tij dhe dëshira ishin për të fituar mirësinë dhe kënaqësinë e Allahut.

E Gjashta

Fraza, ذَٰلِكَ مَثَلُهُمْ فِي التَّوْرَاةِ *"...ky është përshkrimi i tyre në Teurat..."* bën njoftime e parashikime për të Padukshmen në dy drejtime:

I Pari: Ajo jep njoftime për cilësitë e sahabëve që përmenden në Teurat, të cilat ishin si një pjesë e Botës së Padukshme për një njeri analfabet si profeti Muhammed a.s.. Po, ashtu siç u përshkrua në Letrën e Nëntëmbëdhjetë, në Teurat ndodhen rreshtat vijues rreth sahabëve të Profetit a.s.m. të cilët do të vinin në fundin e kohës: *"Flamurët e shenjtorëve janë së bashku me ta!"* Domethënë, sahabët e tij do të ishin adhurues të devotshëm, të drejtë dhe shenjtorë, dhe prandaj ata u përshkruan me termin "*Shenjtorët e pastër*". Megjithëse Teurati u ndryshua duke u përkthyer në disa gjuhë, përsëri ai e mbështet në shumë nga vërsetet e tij pohimin e sures *El-Fet'h,* مَثَلُهُمْ فِي التَّوْرَاةِ *"...ky është përshkrimi i tyre në Teurat..."*

Drejtimi i dytë i tij duke dhënë njoftime nga e padukshmja është ky: Me frazën *".* مَثَلُهُمْ فِي التَّوْرَاةِ *..ky është përshkrimi i tyre në Teurat"*, ai jep njoftim e parashikon se sahabët dhe gjenerata që do t'i ndiqte ato do të arrinin një shkallë të tillë adhurimi saqë dritësia e shpirtërave të tyre do të ndriçonte fytyrat e tyre, dhe shenjat do të ishin të dukshme në ballet e tyre, si një lloj vule e shenjtërisë, e shkaktuar nga sexhdet e tyre të përsëritura. Dhe në të vërtetë, e ardhmja e provoi këtë në mënyrë të shkëlqyer me qartësi e siguri të plotë. Persona të shumtë të rëndësishëm, pavarësisht atyre mosmarrëveshjeve të çuditshme dhe përmbysjeve politike, demonstron misterin e vërsetit مَثَلُهُمْ فِي التَّوْرَاةِ *"... ky është përshkrimi i tyre në Teurat"*, të tillë si: Zejn El-Abidin i cili

kryente një mijë rekatë ditën e natën dhe, si Tavus El-Jamani, i cili e kreu namazin e Sabahut me avdesin e jacisë gjatë dyzet viteve.

Shtata

Fjalia وَمَثَلُهُمْ فِي ٱلْإِنجِيلِ كَزَرْعٍ أَخْرَجَ شَطْـَٔهُۥ فَـَٔازَرَهُۥ فَٱسْتَغْلَظَ فَٱسْتَوَىٰ عَلَىٰ سُوقِهِۦ يُعْجِبُ ٱلزُّرَّاعَ لِيَغِيظَ بِهِمُ ٱلْكُفَّارَ

"...ndërsa shembulli i tyre në ungjill përshkruhet si një farë (e mbjellë) e cila lëshon llastarin, pastaj e forcon atë dhe ai pastaj qëndron vetë në trungun e vet duke i mrekullluar mbjellësit, që Ai t'i tërbojë mosbesimtarët me anë të tyre..."

jep njoftime për të padukshmen në dy aspekte :

I Pari është parashikimi lidhur me cilësitë e Sahabëve që tregohen në Ungjill, të cilat sikur i përkasin të Padukshmes për një profet a.s.m. i cili nuk dinte shkrim e këndim.

Po, në Ungjill janë vërsete të tilla si:

مَعَهُۥ قَضِيبٌ مِّنْ حَدِيدٍ وَأُمَّتُهُۥ كَذَٰلِكَ *"...Me të është një shkop prej hekuri, edhe komuniteti i tij është si ai..."* duke përshkruar profetin që do të vinte në fundin e kohës. Domethënë, një profet do të vinte i cili nuk do të ishte i paarmatosur ashtu si Isai a.s. -Jezusi- por do të mbante një shpatë dhe do të ngarkohej me tundjen e xhihadit, dhe sahabët, shokët e tij gjithashtu do të mbanin shpata dhe do të ngarkoheshin me xhihad. Ai që do të mbante قَضِيبِ حَدِيدٍ "shkopin prej hekuri" do të ishte Sundimtari i Botës. Sepse në një vend në Ungjill ai thotë: *"Unë do të shkoj me qëllim që të vijë Sundimtari i botës"*. Domethënë, Sundimtari i botës është duke ardhur. Kështu ne kuptojmë nga këto dy paragrafe të Ungjillit se në fillim sahabët do të shfaqeshin të pakët në numër dhe të dobët, megjithatë ata do të mugullonin e do të nxirrnin gonxhe si farërat, do të rriteshin, trasheshin dhe do të gjenin forcë. Dhe kur ata të qëndrojnë vetë në trungun e vet derisa t'i tërbojnë mosbesimtarët me anë të tyre, ata do ta nënshtronin njerëzimin me shpatat e tyre dhe do të

provonin se Profeti Muhammed a.s.m., udhëheqësi i tyre, ishte sundimtari i botës. Vërsetet shprehin me saktësi kuptimin e vërseteve të lartëpërmendur të sures *El-Fet'h.*

***Aspekti i Dytë*:** Këto fjali parashikojnë sa vijon:

Sahabët sigurisht e pranuan marrëveshjen e Hudejbijes për shkak të dobësisë së tyre dhe numrit të tyre të vogël në atë kohë, por brenda një kohe të shkurtër ata u shtuan dhe fituan një fuqi të tillë dhe një lartësi saqë, të mbjellur nga Dora e Fuqisë në fushën e faqes së tokës, ata u shumuan në mënyrën më të lartësuar, më të fuqishme, më të frytshme dhe më të bollshme e të begatë.

Në mënyrë të veçantë në lidhje me filizat e njerëzimit në atë kohë, të cilat ishin të shkurtëra, të dobëta, të mangëta dhe të pakta për shkak të mospërfilljes dhe të pakujdesisë, ata do të rriteshin të fortë dhe do t'u shkaktonin shteteve të lavdishme të inatoseshin kundër tyre me smirë, xhelozi e zemërim. Po, e ardhmja e verifikoi këtë parashikim në mënyrën më të shkëlqyer.

Në këtë parashikim ndodhet një aluzion tjetër i hollë:

Ai megjithëse i lavdëron Sahabët e nderuar për cilësitë e larta e të shkëlqyera që kishin, dhe duhej t'u premtohej më i madhi i shpërblimeve, veçse ama ai aludon me fjalën مَغْفِرَةً *Magfireh* - amnisti, falje- se do të ndodhnin gabime e faje të mëdha si rezultat i mosmarrëveshjeve që ndodhën midis Sahabëve, sepse fjala مَغْفِرَةً *Magfireh* tregon ekzistencën e fajeve. Në atë kohë gjëja më e kërkuar nga Sahabët, mirësia më e madhe, do të ishte amnistia, falja. Shpërblimi më i madh do të ishte mosdhënia ndëshkim, për shkak të amnistisë. Ashtu si fjala *Magfireh*, amnisti, e cila e bën këtë aluzion të hollë, po kështu ajo lidhet me vërsetin në fillimin e sures,

لِيَغْفِرَ لَكَ اللَّهُ مَا تَقَدَّمَ مِن ذَنبِكَ وَمَا تَأَخَّرَ *"... Që Allahu të të falë ty gjynahet e tua të kaluara dhe të ardhshme...".*[2] Nëpërmjet dhënies së sihariqeve të fajfaljes në fillimin e sures për gjynahe jo të vërteta, sepse profetët janë të përjashtuar nga mëkatimi, dhe ata nuk bëjnë gjynahe,

[2] Kur'an, 48:2

pasi janë të mbrojtur, por falja -amnistia- në një kuptim që i përshtatet rangut të profetësisë, dhe duke dhënë lajmet e gëzueshme të amnistisë për sahabët në fundin e sures, ajo i shton një hollësi tjetër atij aluzioni.

Nga dhjetë aspekte të mrekullisë të përfshira në tre vërsetet e lartëpërmendur në fundin e sures *El-Fet'h*, ne kemi diskutuar këtu vetëm aspektin e parashikimeve që lidhen me të padukshmen, madje nuk kemi diskutuar veçse në shtatë aspekte prej aspekteve të panumërt të këtij lloji njoftimesh.

Në fundin e Fjalës së Njëzet e Gjashtë, e cila është rreth Kaderit Hyjnor dhe vullnetit të njeriut, një shkreptimë kuptimplote e mrekullisë është treguar në pozicionimin e shkronjave të këtij vërseti të fundit. Ky vërset është i orientuar me fjalitë e tij drejt sahabëve ashtu siç i shikon situatat e tyre me frazat e tij. Dhe ashtu siç i përshkruan cilësitë e tyre me fjalët e tij, po ashtu me shkronjat e tij dhe me përsëritjen e numrit të shkronjave, ai aludon për klasat e sahabëve të shquar si: Sahabët e Bedrit, të Uhudit, të Hunejnit, të Hendekut dhe të Ridvanit.

Dhe kështu ai gjithashtu shpreh edhe shumë mistere të tjerë nëpërmjet *tevafukat*, 'koinçidencave' dhe llogoritjes së shkronjave, *Ebxhed*, të cilat janë degët e shkencës së *xhefrit*, dhe kodet për të.

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtet që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti.

* * *

[Në lidhje me parashikimet lidhur me të padukshmen të treguara nga "kuptimet aluduese" të vërseteve tek fundi i sures El-Fet'h, parashikime të ngjashme në vërsetet vijuese, gjithashtu nëpërmjet kuptimeve të tyre aluduese, do të diskutohen shkurt këtu]

Një passhkrim, Shtojcë.

وَلَهَدَيْنَاهُمْ صِرَاطًا مُسْتَقِيمًا وَمَنْ يُطِعِ اللَّهَ وَالرَّسُولَ فَأُولَٰئِكَ مَعَ الَّذِينَ
أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ مِنَ النَّبِيِّينَ وَالصِّدِّيقِينَ وَالشُّهَدَاءِ وَالصَّالِحِينَ
وَحَسُنَ أُولَٰئِكَ رَفِيقًا

" Dhe sigurisht që Ne do t'i kishim drejtuar ata në Rrugë të Drejtë".

" Dhe kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit, Muhammed a.s.m., atëherë ata do të jenë në shoqërinë e atyre mbi të cilët Allahu ka derdhur mirësinë e Tij, (në shoqërinë) e pejgamberëve, të të vërtetëve, të martirëve, të të drejtëve. Dhe sa të shkëlqyer janë këta shoqërues!"[3].

Ne do të tregojmë vetëm dy prej mijëra pikave të holla të këtyre vërseteve.

Pika e Parë

Kur'ani i mrekullueshëm ashtu siç i shpreh të vërtetat nëpërmjet kuptimeve dhe nocioneve të tij të qarta, po ashtu ai shpreh shumë kuptime aluduese nëpërmjet stileve të tij dhe formave. Secili nga vërsetet e tij përmban nivele të shumtë kuptimesh.

Meqenëse Kur'ani vjen nga njohja gjithëpërfshirëse, të gjitha kuptimet e tij mund të synohen. Ai nuk mund të kufizohet e ngushtohet në një ose dy kuptime ashtu si ligjërata e njeriut që është rezultati i mendimit të tij të kufizuar dhe i dëshirës së tij të pjesshme.

[3] Kur'an, 4: 68 - 69

Është për shkak të kësaj që të vërteta të panumërta të përfshira në vërsetet e Kur'anit janë shpjeguar nga komentatorë të ndryshëm, dhe ndodhen shumë të tjerë që nuk janë shpjeguar akoma prej tyre dhe sidomos shkronjat e Kur'anit dhe aluzionet e tij; në to përfshihen njohuri shumë të rëndësishme përveç kuptimeve të tij të qarta..

Pika e Dytë

Me termat

مِنَ النَّبِيِّينَ وَالصِّدِّيقِينَ وَالشُّهَدَاءِ وَالصَّالِحِينَ وَحَسُنَ أُولَٰئِكَ رَفِيقًا

"... En-nebijjine e pejgamberëve, Ves-siddikine (të vërtetëve), Vesh-shuheda e (martirëve), Ves-salihinë (të drejtëve), Ve hasune ulaike refika (dhe sa të shkëlqyer janë këta shoqërues)!"

Ky vërset përshkruan njerëzit e Rrugës së Drejtë dhe grupet e profetëve, karvanin e të vërtetëve, komunitetin e martirëve, grupin e të drejtëve dhe ata të cilët i ndjekin, të cilët janë ata midis njerëzimit që vërtetë marrin mirësi Hyjnore. Për më tepër, duke pasur treguar në mënyrë të qartë më të plotësuarin e atyre pesë grupeve në botën e islamit, ai i tregon udhëheqësit dhe drejtuesit e pesë grupeve duke përmendur cilësitë e tyre të mirënjohura. Përveç kësaj, me një shkreptimë mrekullie duke dhënë njoftime për të padukshmen, ai specifikon, përcakton një aspekt të imamëve të atyre grupeve në të ardhmen dhe pozitat -gjendjet- e tyre në të ardhmen.

Po, paragrafi مِنَ النَّبِيِّينَ *"(në shoqërinë) e pejgamberëve..."* shikon në mënyrë të qartë profetin Muhammed a.s.m., dhe fraza وَالصِّدِّيقِينَ *"... të vërtetët",* shikon tek Ebu Bekir Es-siddik, duke treguar se ai do të ishte i dyti pas profetit Muhammed a.s.m. dhe i pari që do ta zëvendësonte në postin e tij, dhe që do të njihej me një titull të veçantë *"Es-siddik*", dhe do të shihej në krye të të gjithë të vërtetëve.

Ashtu siç tregon fjala وَالشُّهَدَاءِ *"...e martirëve (ose e dëshmuesve)..."* Hazreti Umerin, Uthmanin dhe Aliun, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata, gjithashtu në mënyrë të tërthortë, nga e padukshmja, tregon se të tre ata do të merrnin drejtimin e kalifatit pas El-Siddikut, dhe se të

tre ata do të martirizoheshin dhe meritat e martirizimit do t'iu shtoheshin virtyteve të tjera të tyre.

Ashtu siç aludon me fjalën وَالصَّالِحِينَ *"...të drejtët"* për Sahabët Es-suffa, të Bedrit dhe të Ridvanit, ndërsa me kuptimin e tij të qartë të وَحَسُنَ أُولَٰئِكَ رَفِيقًا *"... dhe sa të shkëlqyer janë këta shoqërues!"* ai i nxit të tjerët që t'i ndjekin ata, dhe me kuptimin e tij të nënkuptuar, duke treguar se gjenerata që do t'i ndiqte ata do të jenë të nderuar e të shquar, ai aludon për Imam Hasanin, Allahu qoftë i kënaqur me të, i cili si kalif i pestë vërtetoi hadithin profetik që thotë:

إِنَّ الْخِلَافَةَ بَعْدِي ثَلَاثُونَ سَنَةً *"Pas meje kalifati do të zgjasë tridhjetë vjet"* -me qëllim që të tregojë vlerën e tij të madhe pavarësisht kohës së shkurtër të kalifatit të tij.

Shkurtazi:

Ajeti i fundit i sures El-Fet'h shikon tek katër kalifët ashtu siç i shikon ky ajet dhe siç tregon në mënyrë të pjesshme dhe aluduese për të ardhmen e pozitave të tyre dhe i mbështet ata me një lloj të njoftimeve të së Padukshmes.

Njoftimi i së padukshmes i cili është njëri nga llojet e mrekullisë së Kur'anit, ka shkreptima aq të shumta mrekullie saqë nuk numërohen. Dijetarët që i vlerësojnë gjërat vetëm nga aspekti i jashtëm i përkufizojnë ato në dyzet ose pesëdhjetë ajete për shkak të shikimit të tyre sipërfaqësor, por në realitet ato janë më shumë se një mijë. Ndonjëherë ndodhen katër ose pesë aspekte duke dhënë njoftime rreth të Padukshmes vetëm në një vërset të vetëm.

رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَا إِن نَّسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

" Zoti ynë! Mos na ndëshko në qoftë se harrojmë, apo biem në gabime".[4]

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtet që Vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".[5]

*** * ***

Një Shpjegim i Dytë i Passhkrimit të Mëparshëm[6]

Përveç mbështetjes së parashikimeve rreth të padukshmes tek fundi i sures *El-Fet'h*, vërseti,

فَأُولَٰئِكَ مَعَ الَّذِينَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ مِنَ النَّبِيِّينَ وَالصِّدِّيقِينَ
وَالشُّهَدَاءِ وَالصَّالِحِينَ وَحَسُنَ أُولَٰئِكَ رَفِيقًا

"...ata do të jenë në shoqërinë e atyre mbi të cilët Allahu ka derdhur mirësinë e Tij, (në shoqërinë) e pejgamberëve, të vërtetëve, të martirëve, të drejtëve, dhe sa të shkëlqyer janë këta shoqërues!" [7]

Gjithashtu shpjegon e sqaron çfarë synohet nga njerëzit e Rrugës së Drejtë, ndërsa vërseti صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ *"...Në rrugën e atyre të cilëve Ti u ke dhuruar mirësinë Tënde..."*[8], përshkruan karvanin e ndritshëm, të madh, të njohur e tërheqës duke udhëtuar në rrugën e gjatë që të çon në përjetësi, dhe në një mënyrë të përmbledhur e të

[4] Kur'an, 2:286
[5] Kur'an, 2: 32
[6] Vëllezërit e mi i shënuan edhe shpjegimet meqë ata i gjetën të dobishme. Përndryshe vetëm njëri prej tyre do të kishte qenë i mjaftueshëm.
[7] Kur'an, 4: 69
[8] Kur'an, 1: 7

ngutshme, të menjëhershme, i nxit besimtarët dhe të vetëdijshmit për t'iu bashkuar për ta ndjekur e për ta shoqëruar karvanin. Përveç kuptimit të tij të qartë, si vërsetet tek fundi i sures *El-Fet'h*, ky vërset tregon, nëpërmjet kuptimeve aluduese dhe figurative -të quajtura në Retorikë *Mearid el-kelam* dhe *Mustatbaat el-terakib*-, katër kalifët e drejtë të shquar dhe imam Hasanin, Zoti qoftë i kënaqur me të, kalifin e pestë. Ai jep njoftime të së padukshmes në disa drejtime siç vijon:

Ashtu siç tregon vërseti i lartëpërmendur nëpërmjet kuptimit të tij të qartë se karvani i profetëve, grupi i të vërtetëve, komuniteti i martirëve dhe i dëshmuesve, kategoria e të drejtëve, dhe klasa e gjeneratës që ndjek sahabët janë njerëzit e Rrugës së drejtë dhe ata midis njerëzimit të cilët marrin mirësitë e lartësuara Hyjnore, dhe janë *Mirëpunuesit*, po ashtu ai tregon në një mënyrë duke parashikuar të padukshmen se më të mirët dhe më të shkëlqyerit e atyre grupeve gjenden në Botën islame, si kjo: Ai tregon për trashëgimtarët e profetëve të cilët vijojnë me radhë, një pas një, nëpërmjet misterit të trashëgimisë së profetësisë së Pejgamberit të kohës së fundit, tregon karvanin e të vërtetëve që vijojnë qysh nga burimi i vërtetësisë së më të vërtetit, tregon autokolonën e martirëve, të cilët janë lidhur nëpërmjet rangut të martirizimit me tre kalifët e drejtë dhe me komunitetin e të drejtëve, të cilët janë lidhur me të nëpërmjet misterit të وَٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَعَمِلُوا۟ ٱلصَّٰلِحَٰتِ *"dhe ata të cilët besojnë dhe punojnë mirësi e drejtësi"*[9], dhe kategoritë e gjeneratës që vijuan Sahabët, të cilët përfaqësuan misterin e قُلْ إِن كُنتُمْ تُحِبُّونَ ٱللَّهَ فَٱتَّبِعُونِى يُحْبِبْكُمُ ٱللَّهُ *"Thuaj (o Muhammed a.s.m.): Nëse vërtet e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, Allahu do t'ju dojë ju dhe do t'ju falë juve gjynahet tuaja. Dhe Allahu është gjithnjë Falës i madh, Mëshirëplotë,"*[10] dhe qenë në shoqërinë e sahabëve dhe të katër kalifëve të shquar. Po kështu, nëpërmjet kuptimit të tij aludues, ai jep lajme nëpërmjet termit وَٱلصِّدِّيقِينَ *"...dhe të vërtetët..."* se Ebu Bekri, i vërteti, do të zinte vendin e profetit të nderuar a.s.m. pas tij, do të ishte kalif, i dalluar midis komunitetit mysliman me titullin *Siddik*, i vërteti, dhe do të ishte drejtuesi i karvanit të *"të vërtetëve"*.

[9] Kur'an, 2: 82
[10] Kur'an, 3: 31

Me Frazën وَالشُّهَدَاءِ *"...të martirëve..."* ai parashikon martirizimin e tre kalifëve të nderuar, dhe se pas të Vërtetit do të ishin tre kalifët martirë. Për shkak se شُهَدَاءِ *Shuhedaë* -martirët- është në numrin shumës, dhe se numri më i ulët apo më i vogël i shumësit (në gramatikën arabe) është tre, ajo do të thotë se Umeri, Uthmani dhe Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me ta, do të udhëheqnin islamin pas "të Vërtetit" dhe do të martirizoheshin. Dhe kjo ndodhi tamam ashtu siç u parashikua.

Gjithashtu, ai po jep njoftime nëpërmjet frazës وَالصَّالِحِينَ *"...të drejtët"* se njerëzit si sahabët e Es-suffa, të cilët kryen vepra të mira dhe që lavdërohen në Teurat, do të ishin të shumtë në të ardhmen. Ndërsa fraza وَحَسُنَ أُولَٰئِكَ رَفِيقًا *"...Dhe sa të shkëlqyer janë këta shoqërues!"* lavdëron gjeneratën që ndoqi sahabët dhe që i shoqëruan ata në dije e në vepra të mira.

Dhe përveç të treguarit se t'i shoqërosh ata katër grupe në rrugën për në përjetësi është një veprim i mirë dhe i lavdërueshëm, ai tregon se periudha e shkurtër e imam Hasanit si kalif ishte e rëndësishme, ashtu siç u konfirmua nga parashikimet e profetit a.s. m.: إِنَّ الْخِلَافَةَ بَعْدِي ثَلَاثُونَ سَنَةً *"Kalifati pas meje do të zgjasë tridhjetë vjet"*[11],

Dhe إِنَّ ابْنِي حَسَنٌ هٰذَا سَيِّدٌ سَيُصْلِحُ اللهُ بِهِ بَيْنَ فِئَتَيْنِ عَظِيمَتَيْنِ

"ky nipi im Hasani është një Shkëlqesi, prijës i njerëzve, nëpërmjet tij Allahu do të pajtojë dy grupe të mëdha".[12] Duke shtypur kështu grindjet dhe konfliktet dhe duke i qetësuar palët në mosmarrëveshje. Në këtë mënyrë, ai tregon se Hasani do të ishte kalifi i pestë duke ndjekur katër kalifët e drejtë. Ndërsa nëpërmjet një figure –embleme- e quajtur në retorikë "*Mustatbaat al-tarakib"*, ai aludon për

[11] Tirmidhiu
[12] Buhari

emrin e kalifit të pestë me frazën وَحَسُنَ أُولَٰئِكَ رَفِيقًا *"... Dhe sa të shkëlqyer 'Hasune' janë këta shoqërues!"*

Ndodhen edhe shumë mistere të tjerë si këto parashikime aluduese, por meqenëse ato janë jashtë qëllimit tonë, ajo derë nuk është përgjigjur për tani. Ka shumë vërsete të Kur'anit të gjithurtë të cilët japin njoftime të së Padukshmes në shumë drejtime. Ky lloj i parashikimeve të Kur'anit për të padukshmen numërohet me mijëra.

رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَا إِن نَّسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

*"Zoti ynë! Mos na ndëshko në qoftë se harrojmë apo biem në gabim*e"[13]

" Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtet që Vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".[14]

* * *

[13] Kuran, 2: 286
[14] Kur'an, 2: 32

PËRFUNDIM

Njëra nga pikat e mrekullueshme të Kur'anit të gjithurtë manifestohet nëpërmjet *tevafukat*, koinçidencave[15], është siç vijon:


Në Kur'anin e gjithurtë, numri i përgjithshëm i shembujve të Emrave të Allahut, ***Er-Rahman**, i Gjithëmëshirshmi, **Er-Rahim**, Mëshirëploti, **Er-Rabb,** Mbështetësi,* dhe ***Hu**, Ai*, në vend të Emrit '***Allah'*** është afërsisht katër mijë. Sipas llojit të dytë të llogarisë "*Ebxhed*" i cili është në përputhje me renditjen e alfabetit, vlera e بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ "***Bismil-lahir-Rrahmanir-Rahim"*** është gjithashtu rreth katër mijë.

Meqenëse thyesat e vogla të numrave të mëdhenj nuk e prishin *koinçidencën,* nuk janë marrë parasysh. Gjithashtu së bashku me dy *wavët* lidhës të cilët i përfshijnë الٓمٓ *Elif. Lam. Mim*. kjo bën afërsisht dyqind e tetëdhjetë. Përveç përkimit a koinçidimit me afërsisht dyqind e tetëdhjetë shembujt e fjalës ***Allah*** në suren *EL-Bekare* dhe me afërsisht dyqind e tetëdhjetë vërsetet e të njëjtës sure, në qoftë se llogaritet me llojin e dytë sipas llogarisë së *Ebxhetit*, ajo përsëri bën katër mijë. Ajo koinçidon edhe me pesë Emrat e mirënjohur Hyjnorë që u përmendën lart, dhe në qoftë se thyesat nuk merren parasysh, me vlerën numerike të بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ ***"Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim".*** Domethënë, si rrjedhojë e këtij misteri të koinçidencës, الٓمٓ *Elif. Lam. Mim.* janë edhe si një titull që përmban Atë që ai tregon, edhe një emër për *EL-Bekare*, edhe një emër të Kur'anit, edhe një indeks të përmbledhur për të dyja ato, edhe një model, një përmbledhje e bërthamë për të dy, dhe një përmbledhje e بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ ***"Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim".***

Sipas sistemit të mirënjohur të Ebxhedit,

[15] Koinçidencë -*tevafuk*: korrespondencë e shkronjave ose e fjalëve në rreshta ose në fjali tek njëra ose tek disa faqe. Përkthyesi

 ***"Bismil-lahir-Rahmanir-rahim"*** është e barabartë në vlerë numerike me Emrin e ***Er-Rabb,*** *Mbështetësi.*

Gjithashtu, në qoftë se ***Ra***-ja e dubluar tek  ***"Er-Rahman, Er-Rahim"*** numërohet dy herë, ajo bëhet nëntëqind e nëntëdhjetë dhe një çelës për mistere të rëndësishëm - me nëntëmbëdhjetë shkronjat e saj, çelës për nëntëmbëdhjetë mijë botët.

Midis *koinçidencave* të Fjalës ***Allah*** në Kur'anin e shpjegimit të mrekullueshëm është se në të gjithë Kur'anin tetëdhjetë shembujt e fjalës Allah në fillimin e rreshtit të fundit të faqes shikojnë njëra-tjetrën në mënyrë korresponduese. Po kështu bëjnë tetëdhjetë shembujt e Emrit tek mbarimi i rreshtit të fundit duke vështruar njëri-tjetrin në të njëjtën mënyrë. Dhe përsëri pesëdhjetë e pesë shembujt e Fjalës Allah mu në qendër të rreshtit të fundit bien njëri sipër tjetrit, duke u bashkuar sikur të bënin një shembull të vetëm të Emrit ***Allah***.

A do të ishte e mundur që një koinçidencë e tillë e hollë, e bukur, e rregulluar, e drejtëpeshuar dhe e mrekullueshme të ishte pa urtësi apo bukuri? Ruajna Zot, një gjë e tillë nuk do të mund të ishte! Sigurisht thesare të rëndësishëm do të mund të hapeshin me majën e këtyre koinçidencave!



*"Zoti ynë! Mos na ndëshko në qoftë se harrojmë apo biem në gabim*e"[16]

" Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtet që Vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".[17]

* * *

[16] Kuran, 2: 286
[17] Kur'an, 2: 32

SHKREPTIMA E TETË

Kjo do të botohet brenda një koleksioni tjetër në dashtë Zoti.

*** * ***

SHKREPTIMA E NËNTË

[Nuk duhet që të gjithë ta lexojnë këtë shkreptimë, sepse nuk do të mund t'i shohin gabimet e holla të Unitetit të ekzistencës; prandaj ata nuk janë në nevojë të saj.]



Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

"Dhe s'ka ndonjë gjë që të mos e lëvdojë Lartësinë e Tij".

Paqja dhe Mëshira e Allahut qofshin mbi ju!

Vëllai im i dashur, i sinqertë e i ndërgjegjshëm!

Arsyeja që unë nuk i shkrova një letër të veçantë vëllait tim Abdul-Mexhidit[1], ishte se unë i konsiderova letrat që i pata shkruar për ju si të mjaftueshme.

Pas Hulusiut[2], Abdul Mexhidi është një vëlla i vlefshëm për mua dhe një student. Çdo mëngjes dhe mbrëmje ai është i pranishëm me emër në duatë e mia së bashku me Hulusiun, dhe ndonjëherë duke u përmendur para tij. Në fillim Sabriu[3], pastaj Hakki Efendiu[4] përfituan

[1] Abdul-Mexhidi ishte vëllai më i vogël i Ustadh Bediuzamanit. Ishte mësues i shkencave fetare, pastaj myfti; Ai përktheu pjesë të Risale-i Nurit në arabisht, dhe *isharatul* ixhazin dhe *methnevi en'nurijjeh* i përktheu nga arabishtja në Turqisht.

Ai vdiq në vitin 1967.

[2] Hulusi Jahja Gil ishte njëri nga studentët e parë të Risale-i Nurit, nga Elazig në Turqinë lindore, në atë kohë ai shërbente si komandant në ushtri. Ai për herë të parë e vizitoi Bediuzzamanin në 1929, dhe në Fjalët e Bediuzzamanit, " zelli dhe serioziteti i tij ishin arsyeja më e rëndësishme që *Fjalët e fundit*, ***Sozler*** dhe *Letrat*, ***Mektubati*** të shkruheshin; ai vdiq në vitin 1986.

[3] Sabri Arseven. I njohur si 'Santral Sabri', ishte njëri nga studentët më të rëndësishëm të Bediuzzamanit në Barla dhe gjithashtu ishte imam në fshatin fqinj të Bedres. Ai vdiq në vitin 1954.

nga letrat që unë ju shkruaj juve. Unë as letra të veçanta, të mëvetësishme nuk u shkruaj atyre.

Allahu i Gjithëfuqishëm të bëri ty një vëlla të madh të bekuar për ata. Mba ti korrespondencë me Abdul Mexhidin në vendin tim! Ai nuk duhet të shqetësohet; pas Hulusiut, unë mendoj për të.

Pyetja juaj e parë:

Ti bën një pyetje private, të veçantë, rreth njërit prej paraardhësve të tu duke nënshkruar me Emrin, *El-Sejjid Muhammed*. (Domethënë, nga Ehli Bejti).

Vëllai im, unë nuk mund të jap një përgjigje të bazuar mbi dijen, mbi verifikimin apo mbi një studim. Megjithatë unë u thashë shokëve të mi: "Hulusiu nuk u ngjason as turqve të sotëm, as kurdve. Unë shoh cilësi të tjera tek ai".

Ata u pajtuan me këtë. Ne thamë në përputhje me thënien,

"Mirësia Hyjnore nuk e bën aftësinë tek personi një kusht."

Fisnikëria që vëzhgohet tek Hulusiu është një dhunti Hyjnore. Ju gjithashtu duhet ta dini me siguri se i Dërguari i Allahut xh.sh. kishte dy familje. Njëra janë pasardhësit nga familja e tij, dhe tjetra është familja për sa ka të bëjë me personalitetin e ndritshëm kolektiv të profetësisë së Tij. Përveç përfshirjes tënde me siguri në këtë familjen e dytë, unë kam një bindje të pavërtetuar, të paprovuar, se për sa ka të bëjë me familjen e tij të parë, nënshkrimi i stërgjyshit tënd me emrin *Sejjid* nuk ishte pa arsye.

Vëllai im i dashur!

Një përmbledhje e Pyetjes tënde të Dytë:

Muhjiddin el Arabi[5] tha: "Krijueshmëria e shpirtit përbëhet nga zbulimi i tij". Me këtë pyetje ti po detyron një të mjerë të pafuqishëm si

[4] Hakki Tiğli. Ai ishte nga Eğridir dhe u burgos së bashku me Bediuzzamanin në Eskishehir në 1935. Ai gjithashtu veproi si Avokati i Bediuzzamanit.

[5] Muhjid-din ibn El-Arebij, është një dijetar i shquar dhe një mendimtar i cili influencoi thellë zhvillimin e Sufizmit. Ai u lind në Andaluzi në vitin 560 sipas

unë të diskutojë një dijetar të madh e të shkëlqyer të realitetit dhe një gjeni të shkencave okulte si Muhjid-din Ibn El-Arebij. Megjithatë duke u mbështetur në mësimet e Kur'anit unë do të orvatem të diskutoj, madje edhe në qoftë se do të isha vetëm një mizë, unë mund të fluturoj më lartë se një shqiponjë e tillë.

Vëllai im! Ti duhet ta kuptosh se Hazreti Muhjiddin Ibn Arebij nuk do të mashtronte, por ai mundi të mashtrohej. Ai është i drejtuar mirë, por nuk mund të jetë drejtues në të gjitha veprat e tij. Ajo që ai pa ishte e saktë, por ama ajo nuk ishte Hakikati, Realiteti. Realiteti i shpirtit të njeriut, subjekti i pyetjes tënde, është shpjeguar në Fjalën e Njëzet e Nëntë, në diskutimin rreth shpirtit.

Po, për sa ka të bëjë me natyrën e tij, shpirti është një ligj që vjen nga urdhri Hyjnor, por ai është një ligj i gjallë të cilit i është veshur një ekzistencë e jashtme dhe është një kanun me një ekzistencë të jashtme. Hazreti Muhjiddini e shikoi shpirtin vetëm nga këndvështrimi i natyrës së tij esenciale. Rruga e Unitetit të ekzistencës e konsideron ekzistencën e gjërave të jetë imagjinatë. Së bashku me ndriçimet e tij të jashtëzakonshme dhe me vëzhgimet, por meqenëse ai pati zgjedhur një rrugë të rëndësishme e të pavarur, ai u detyrua të zbatojë disa vërsete Kur'anore për rrugën e tij e për vëzhgimet, në mënyrë artificiale dhe me interpretime të dobëta e të detyrueshme, kështu duke shëmtuar e dëmtuar qartësinë e vërseteve. Në trajtesat e tjera të tij, ai shpjegon rrugën e drejtë të Kur'anit dhe të sunnetit.

Shejh Ibn Arebij ka një pozitë të veçantë më vete, dhe ai është midis atyre që janë të pranueshëm. Por ai tejkalon limitet në ndriçimet e tij të çekuilibruara, dhe në shumë çështje ai kundërshton shumicën e dijetarëve verifikues.

Është për shkak të kësaj që megjithëse ai ishte një pol i tillë i lartësuar dhe i jashtëzakonshëm, i pakrahasueshëm për kohën e tij; është sikur rruga e tij e veçantë ishte shumë e shkurtër dhe e kufizuar tek Sadrud-din El-Qunavi[6], dhe se vetëm rrallë mund të përfitojnë prej veprave të tij ata që ndjekin rrugën e drejtë. Disa nga dijetarët

---

hixhretit dhe ai vdiq në Damask në vitin 638 sipas Hixhretit. Midis veprave të tij më të mirënjohura janë *Fusus el- Hikam* dhe *EL-Futuhat El-Mekkijeh.*

[6] Sadr el-Din el-Qunavi. Njëri nga studentët kryesorë të Ibn el-Arebij, ai shkroi një mori veprash mbi sufizmin, midis të cilave është *El-nusus Fi Tahkik al-mahsus.*

autoritarë nuk shfaqin asnjë prirje për t'i studiuar ato vepra të vlefshme, ndërsa disa prej tyre madje ndalojnë që të lexohen ato.

Për të dalluar ndryshimet themelore së bashku me burimet e tyre midis rrugës së Shejh Muhjiddin Ibn Arebij me atë të dijetarëve të saktë, do të ishte i nevojshëm të bëhej një studim i thellë dhe një vështrim i gjërë dhe i lartë.

Po, ndryshimet janë aq të holla e të thella, dhe burimet janë aq të larta dhe të shtrira, sa që Shejh Muhjiddin Ibn Arebij nuk është qortuar për gabimin e tij, por vazhdoi të qëndrojë i pranueshëm midis dijetarëve, sepse në qoftë se për sa ka të bëjë me mendimin, njohurinë dhe ndriçimin, ndryshimet dhe burimet do të kishin qenë të dukshme, do të kishte një rënie tej mase të rëndë për të dhe një gabim shumë i madh për të. Meqenëse ndryshimi është shumë i thellë, ne do të përpiqemi ta shfaqim atë dhe burimet në mënyrë të shkurtuar nëpërmjet një krahasimi dhe do të tregojmë gabimet e Shejh Muhjiddinit në çështje.

Për shembull, dielli shfaqet në pasqyrë. Pasqyra edhe e përmban diellin edhe cilësohet prej tij. Domethënë, nga njëri aspekt dielli është i pranishëm në pasqyrë, dhe nga një aspekt tjetër, ai e stolis pasqyrën, duke u bërë një ngjyrë e ndritshme, atributi dhe cilësia e tij. Në qoftë se pasqyra do të ishte një aparat fotografik, ajo do të kishte fiksuar imazhin e diellit në një letër fotografike.

Në këto raste, dielli duke u shfaqur në pasqyrë, shëmbëllimi i tij në letrat fotografike, dhe aspekti i tij që stolis pasqyrën duke u bërë si një cilësi e pasqyrës, ato janë të tjera dhe ndryshe nga dielli i vërtetë. Ato nuk janë dielli, por hyrja e manifestimit të diellit në një ekzistencë tjetër.

Sa për ekzistencën e diellit që është i dukshëm në pasqyrë, edhe në qoftë se nuk është i njëjtë me diellin i cili është i dukshëm jashtë, por meqenëse ai është i lidhur me të dhe tregon atë, supozohet të ketë të njëjtën ekzistencë.

Si rrjedhojë e këtij krahasimi, pohimi se: "Në pasqyrë nuk ndodhet asgjë tjetër përveç diellit të vërtetë", mund të jetë e drejtë duke e konsideruar se pasqyra e përmban atë dhe synon ekzistencën e jashtme të diellit në pasqyrë. Por në qoftë se do të thuhej se reflektimi i shtrirë i

diellit i cili është bërë si një atribut apo cilësi e pasqyrës, dhe imazhi i tij i cili është ndërkëmbyer në fletë fotografike, -nëse thuhet- se ai është dielli, ky do të ishte gabim; dhe shprehja: "Në pasqyrë nuk ndodhet asgjë tjetër përveç diellit", është gabim, sepse ndodhet reflektimi në faqen e shndritshme të pasqyrës dhe imazhi i formuar në anën e prapme të saj, edhe këto kanë ekzistencat e tyre të veçanta. Sigurisht ato ekzistenca janë nga manifestimi i diellit, por ato nuk janë dielli. Mendja e njeriut dhe imagjinata i ngjasojnë këtij shembullit të pasqyrës. Ai është siç vijon:

Njoftimet që gjenden në pasqyrën e mendimit të njeriut kanë gjithashtu dy faqe: në njërin drejtim ajo është njohje, ndërsa në tjetrin, është e njohur. Në qoftë se ne do ta mendonim që të përmbajë atë që është e njohur, atëherë gjëja e njohur bëhet diçka e ditur me mendje; ekzistenca e saj është diçka e ndryshme për mendjen. Në qoftë se ne do ta supozonim mendjen të cilësuar me atë gjë që erdhi tek ajo, atëherë ajo bëhet një atribut ose një cilësi e mendjes; atëherë gjëja bëhet njohje dhe ka një ekzistencë të jashtme. Madje edhe në qoftë se ekzistenca e gjësë së njohur është thelbësore, ajo ka një ekzistencë aksidentale të jashtme si njohja.

Kështu, në përputhje me këto dy krahasime, universi është një pasqyrë. Natyra e vërtetë e qënieve është gjithashtu një pasqyrë. Këto pasqyra i nënshtrohen aktivitetit Krijues Hyjnor nëpërmjet Fuqisë së parapërjetshme. Nga një drejtim, çdo qënie bëhet një lloj pasqyre për njërin nga Emrat e Bukur Hyjnorë të Diellit të Parapërjetshëm, duke shfaqur një nga qëndisjet dhe skalitjet e Tij.

Ata të cilët janë në rrugën e Shehj Muhjiddin Ibn Arebij i zbuluan ato në aspektin e qënies së tyre si pasqyra dhe si mjete mbajtës, duke treguar shembëllimin e ekzistencës së tyre në pasqyrë -nga këndvështrimi i mohimit-, dhe duke e supozuar reflektimin të jetë i njëjti me gjënë e reflektuar, ata nuk menduan për nivele të tjerë. Ata thanë: "Nuk ka të ekzistuar tjetër përveç Atij", dhe ishin në gabim. Ata pothuajse shkuan aq larg sa të mohonin rregullin bazë: *"Realiteti i gjërave është i qëndrueshëm, i vazhdueshëm".*

Sa për njerëzit e realitetit, ata kanë parë nëpërmjet misterit të trashëgimisë dhe të pohimeve të qarta e përcaktuese të Kur'anit se qëndisjet dhe skalitjet që gjenden në pasqyrat e qënieve nëpërmjet

fuqisë së Allahut dhe të Vullnetit të Tij janë vetëm veprat e Tij. Ato janë "të gjitha prej Tij"; "ato qënie nuk janë Ai"[7]. Gjërat kanë një ekzistencë dhe ekzistenca e tyre është e qëndrueshme deri në një farë shkalle. Në qoftë se kjo ekzistencë do të ishte një ekzistencë e dobët ashtu si një iluzion ose imagjinatë në krahasim me ekzistencën e Krijuesit xh.sh., por ama ajo ekziston vetëm se nëpërmjet aktivitetit krijues të të Gjithëfuqishmit të Parapërjetshëm dhe nëpërmjet dëshirës dhe fuqisë së Tij xh.sh..

Në krahasim, dielli në pasqyrë ka një ekzistencë nëpërmjet shëmbëllimit përveç ekzistencës së tij të jashtme. Dhe reflektimi i tij i shtrirë, gjithashtu, i cili i jep ngjyrë dhe e stolis pasqyrën, ka një ekzistencë të jashtme aksidentale dhe të veçantë. Dhe imazhi i diellit i cili pikturohet në letrën fotografike në anën e prapme të pasqyrës, gjithashtu ka një ekzistencë të jashtme të veçantë dhe aksidentale.

E ngjashme me këtë, skalitjet e qënieve, të cilat shfaqen nëpërmjet manifestimeve të Emrave të Shenjtë Hyjnorë -duke ndodhur nëpërmjet Dëshirës Hyjnore, zgjedhjes dhe Fuqisë së Saj- në pasqyrën e universit dhe në pasqyrat e natyrave thelbësore të gjërave, kanë një ekzistencë të krijuar të mëvetësishme, të veçantë, nga ekzistenca e Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm. Dhe kësaj ekzistence i është dhënë një qëndrueshmëri nëpërmjet fuqisë së parapërjetshme. Por në qoftë se lidhja do të këputej, atëherë të gjitha gjërat menjëherë do të pushonin së ekzistuari. Për ekzistencën e tyre të vazhdueshme të gjitha gjërat në çdo çast janë në nevojë të Krijuesit të tyre që t'i ruajë ato. Edhe në qoftë se "Realiteti i gjërave është i qëndrueshëm", veçse ama ai është i qëndrueshëm dhe i vazhdueshëm vetëm nëpërmjet bërjes së tij të tillë nga Krijuesi xh.sh..

Kështu, thënia e Shejh Muhjiddin Ibn Arebij se "Shpirti nuk është krijuar; por ai është një realitet që vjen nga bota e Urdhrit Hyjnor dhe nga atributi i Dëshirës" është në kundërshtim me shumë pohime të qarta të Kur'anit dhe të hadithe, dhe sipas hetimit të lartëpërmendur, ai qe i ngatërruar, i mashtruar, dhe nuk i pati parë ekzistencat e dobëta të gjërave.

[7] Domethënë, gjithçka është prej Tij; Ai e krijon atë, jo çdo gjë është Ai sa të mund të thuhet " Nuk ka ekzistues përveç Atij".

Vendet e manifestimit të Emrave të Bukur Hyjnorë si: ***El-Hal-lak*** dhe ***Er-Rezzak,*** *Krijuesi, Furnizuesi*, nuk mund të jenë iluzione apo imagjinarë.

Meqenëse ato Emra kanë një realitet, atëherë edhe vendet e tyre të manifestimit kanë gjithashtu një realitet të jashtëm.

***Pyetja juaj e Tretë*:**

Ju kërkoni një instruksion në shkencën e *Xhefrit*, i cili do të formojë një çelës për të.

Përgjigjja: Ne nuk po e përmbushim këtë detyrë dhe këtë shërbim me dëshirën tonë dhe me planifikimin tonë, por një dëshirë më e mirë se sa ajo e jona sundon në këtë punën tonë; ajo është mbi dëshirën tonë dhe jashtë zgjedhjes sonë. Shkenca e *Xhefrit* është një prokopi tërheqëse dhe e këndshme, prandaj ajo na zë ne dhe na pengon nga detyrat tona të vërteta. Madje në shumë raste, disa mistere të Kur'anit zbuloheshin nëpërmjet atij çelësi a kodi. Por kur unë e orientova veten drejt atyre me entuziazëm të plotë dhe me ëndje, ato më shmangeshin mua, më mbylleshin ato dyer. Unë zbulova dy shembuj urtësie në këtë:

I Pari: Është e mundur që kjo të jetë e pasjellshme ndaj rregullit themelor, ndaj urdhrit ndalues "*Askush nuk e di të padukshmen përveç Allahut".*

I Dyti: Puna për të udhëzuar komunitetin islam rreth të vërtetave themelore të besimit dhe disa provave të Kur'anit ka vlera dhe merita që tejkalon njëqind shkallë punën për udhëzimin e tyre në shkencat okulte të tilla si *Xhefri*. Dëshmia e fuqishme dhe provat kategorike të përdorura në atë detyrë të shenjtë nuk lejojnë rast shfrytëzimi e abuzimi. Kurse në shkencat okulte si *Xhefri*, të cilat nuk lidhen me ndonjë rregull të fortë, ka mundësi abuzimi dhe sharlatanët i shfrytëzojnë ato. Në fakt, sa herë që lindte nevoja për shërbimin e realitetit, më dhurohej pak nga ajo sipas nevojës.

Midis kodeve të *Xhefrit*, më të thjeshtit, dhe ndoshta më të pastërtit dhe më të bukurit janë llojet e ndryshme të 'koinçidencave', të cilat burojnë nga Emri Hyjnor ***El-Bediu***, *Themeluesi, Krijuesi*, dhe që janë manifestuar në Emrin e ***Allahut*** në Kur'an si dhe zbukurojnë veprat që

ne i kemi publikuar. Ato janë sqaruar deri diku në vende të tjera në veprën ***Keramet-i Gavsije,*** *Çudirat e Gauth el-Aëdham*.

Për shembull, në qoftë se 'koinçidencat' tregojnë diçka në aspekte të shumtë, kjo është një shenjë që ka fuqinë e një prove.

Ndonjëherë, me një numër deduksionesh, një 'koinçidencë' e vetme mund të përbëjë një provë. Megjithatë, kjo është e mjaftueshme për tani. Në qoftë se do të ketë ndonjë nevojë serioze, ajo do t'ju bëhet e njohur.

Pyetja juaj e Katërt

Kjo nuk është pyetja juaj, por e Imam Umer Efendiut, e cila ka të bëjë me një doktor fatkeq që pretendon se Jezusi, Isai a.s., është lindur nëpërmjet një babai.

Me një interpretim prej të marri, doktori[8] u përpoq të tregojë se një vërset Kur'anor e justifikon atë që ta thotë këtë.

Njëherë ai person fatkeq u përpoq të shkaktojë diçka me 'shkronjat e shkëputura'. Ai punonte tek kjo si ndër ethe. Pastaj unë kuptova se ai kishte ndijuar nga qëndrimi i ateistëve se ata do të përpiqeshin të suprimonin e zhduknin shkronjat islame. Personi në fjalë po punonte më kot sikur ai të shpëtonte atë shkrim përballë asaj rryme. Tani në këtë çështje, dhe në çështjen e tij të dytë, ai kuptoi sulmet e tmerrshme të ateistëve kundra themeleve të islamit. Dhe unë gjykova se ai donte të gjejë një mënyrë kompromentuese nëpërmjet interpretimeve të pakuptimta si ajo.

[8] Arritjet e jashtëzakonshme të një individi të jashtëzakonshëm human i cili është udhëheqësi i një të katërtës së njerëzimit, e transformoi njerëzimin -në një aspekt- nga lloji njerëzor në atë engjëllor, dhe e la këtë botë me qëllim që t'i bënte qiejt si vendbanimin e tij -këto arritje të jashtëzakonshme të tij kërkojnë një formë të jashtëzakonshme të ligjit të riprodhimit. Sepse qënia e tij i përfshirë nën atë ligj në një mënyrë të dyshimtë, të panjohur, të panatyrshëm dhe madje të ulët, kurrësesi nuk do të kishte qenë e përshtatshme për të, as nuk kishte ndonjë domosdoshmëri për t'u përfshirë nën atë ligj. Për më tepër, pohimet e qarta të Kur'anit nuk e mbajnë interpretimin. Si do të mundej që ligji i seksualizmit të engjëjve, i cili është jashtë riprodhimit dhe që kurrësesi nuk mund të thyhet për hir të ndreqjes apo korrigjimit të ligjit të riprodhimit njerëzor, i cili është thyer në njëqind mënyra- si mundet ky ligj së bashku me ligjet si ligji i vërseteve të qarta të Kur'anit të mund të shkelen?

Në përputhje me vërsetet e përcaktuara me qartësi,

"*Vërtet që shembulli i Isait tek Allahu është si shembulli i Ademit..."*[9]

Jezusi a.s. nuk kishte baba. Atëherë asnjë rëndësi nuk duhet t'i jepet fjalës së atyre që përpiqen të ndryshojnë një të vërtetë të tillë të qëndrueshme, të sigurtë dhe autentike nëpërmjet interpretimeve prej të marri e të detyruara, për shkak se ata supozojnë të jetë e pamundur shkelja apo thyerja e një ligji të riprodhimit njerëzor. Sepse nuk ka asnjë ligj që të mos ketë ndonjë përjashtim dhe të cilit të mos i jenë nënshtruar individët. Dhe nuk ekziston ndonjë ligj i përgjithshëm e universal që të mos jetë duke u shkelur nga individë të jashtëzakonshëm.

Që nga koha e Ademit a.s. nuk ka pasur ndonjë ligj ndaj të cilit nuk ka patur përjashtime individuale, pra që të mos kenë dalur kundra tij individë të caktuar. Së pari, ligji i riprodhimit u shkel ndaj origjinave nga origjinat e dyqind mijë llojeve shtazore deri sa u zhduk përfundimisht. Domethënë, dyqind mijë paraardhësit e specieve, që janë si Ademët për to, e shkelën ligjin e riprodhimit. Domethënë, ato nuk u lindën nga një baba e nënë, por atyre iu dha ekzistenca jashtë atij ligji.

Për më tepër, pjesa më e madhe -individë të panumërt prej njëqind mijë speciesh që ne i shikojmë me sytë tonë në çdo pranverë krijohen jashtë atij ligji mbi faqen e gjetheve dhe mbi lëndë të kalbura e të prishura. Kështu ju mund të shikoni se sa i paarsyeshëm është dikush i cili nuk mund të pranojë me arsyen e tij përjashtimin e një individi të veçantë; në një mijë e nëntëqind vite, nga një ligj i cili u shkel e u thye me gjithë atë shumicë në origjinën e tij dhe madje është shkelur në çdo vit; por kapet pas interpretimeve të rëndomta ndaj pohimeve të qarta të Kur'anit.

Gjërat që ata fatkëqinj i quajnë ligje natyrale, janë ligjet e quajtura *A'datull-llah* ose *praktikat Hyjnore*, të cilat janë një manifestim universal i urdhrit Hyjnor dhe i Vullnetit Hyjnor, dhe të cilat Allahu i Plotfuqishëm i ndryshon për disa shembuj urtësie. Ai tregon se Vullneti i Tij dhe zgjedhja sundojnë mbi gjithçka dhe në çdo ligj. Disa individë

[9] Kur'an, 3:59

të jashtëzakonshëm i thyejnë ato 'Praktika'. Këtë të vërtetë Ai e tregon nëpërmjet dekretit të Tij:

"Vërtet që shembulli i Isait tek Allahu është si shembulli i Ademit..."

Pyetja e Dytë e Umer Efendiut lidhur me atë doktor.

Doktori sillet në këtë çështje si budalla, kështu, ta dëgjosh atë çfarë thotë ai apo t'i japësh rëndësi do të ishte shumë poshtëruese. Ai fatkeq dëshiron të gjendet në mes të rrugës ndërmjet besimit dhe mosbesimit. Unë them sa vijon në përgjigje, jo të diskutimit të tij të parëndësishëm, por të pyetjes së Umer Efendiut:

Arsyeja për urdhëresat dhe ndalesat e Sheriatit janë Urdhri Hyjnor dhe urdhri ndalues Hyjnor. Avantazhet dhe shembujt e urtësisë janë për t'u dhënë atyre peshë, dhe mund të jenë arsyeja për urdhrin apo ndalimin nga këndvështrimi i Emrit Hyjnor ***El-Hakim**, i Gjithurti.*

Për shembull, dikush duke qenë në udhëtim i shkurton namazet e detyruara. Ndodhet një arsye, një qëllim apo një urtësi për t'i shkurtuar ato. Arsyeja është udhëtimi, ndërsa urtësia apo qëllimi është vështirësia që përfshihet në to.

Në qoftë se ndodhet udhëtimi, namazi përsëri shkurtohet edhe në qoftë se nuk do të kishte vështirësi. Ndërsa në qoftë se do të ndodheshin njëqind vështirësi në shtëpi, nuk shkurtohet namazi pa udhëtim, sepse vështirësia që ndodh në disa udhëtime është e mjaftueshme si qëllim për shkurtimin e faljeve, dhe është përsëri e mjaftueshme për ta bërë udhëtimin arsye.

Kështu, në përputhje me këtë rregull të Sheriatit, urdhëresat e Sheriatit nuk ndryshojnë si rrjedhojë e qëllimeve ose shembujve të urtësisë; ato shikojnë tek arsyet e vërteta.

Përveç dëmit dhe sëmundjes së shkaktuar nga ngrënia e mishit të derrit, ashtu siç tha ai doktor, sipas rregullit, "Ai që ha mishin e derrit, bëhet si derr në disa drejtime"[10], por ama në të ka dëme e sëmundje të

[10]Unë pyesja: Fakti se, pavarësisht të gjithë progresit të jashtëzakonshëm dhe civilizimit të Europës dhe përparimeve të saj në shkenca e dije të dobishme për njerëzimin, çudhëzimi i tyre është bërë si ai i derrave në erësirat e filozofisë materialiste e natyraliste, të cilat janë krejtësisht e kundërta e përparimit, njohjes dhe

tjera të cilat nuk i di ai doktor; derri nuk u ngjason kafshëve të tjera shtëpiake të cilat janë të dobishme e të padëmshme. Madje i gjithë mishi i tij shkakton dëme më shumë se sa dobi; dhe kjo përveç asaj që është provuar nga mjekësia se dhjami i fuqishëm në mishin e tij është gjithashtu i dëmshëm, në vendet shumë të ftohta të Evropës, atëherë në fakt dhe në kuptim ai është shumë i dëmshëm.

Kështu, shembujt e urtësisë si këto janë një qëllim për urdhrin ndalues Hyjnor dhe për qënien e mishit të tij haram. Nuk është e domosdoshme që urtësia të jetë e pranishme në çdo shembull dhe në të gjitha kohët. Arsyeja nuk ndryshon me ndryshimin e asaj urtësie; edhe në qoftë se nuk ndryshon arsyeja, nuk ndryshon urdhëri.

Dhe kështu, mund të shihet nëpërmjet këtij rregulli se sa larg nga sheriati ka qenë ai doktor fatkeq kur u shpreh kështu. Asnjë rëndësi nuk duhet t'i jepet fjalës që ai tha lidhur me sheriatin. Krijuesi ka shumë kafshë në formën e filozofëve të paarsyeshëm.

* * *

Një Shtojcë si përgjigje për pyetjen tuaj rreth Muhjiddin El-Arabi

*Pyetje***:** Muhjiddin Ibn Arabi e konsideroi Unitetin e ekzistencës të jetë e më të lartit nivel. Disa nga Evlijatë e mëdhenj, të cilët morën rrugën e dashurisë, e ndoqën atë.

Megjithatë, ti thua se kjo rrugë nuk ishte më e larta e niveleve të imanit, dhe ajo nuk është një rrugë reale, përkundrazi, ajo është rruga, deri diku, e atyre që bëhen të dehur dhe që janë zhytur në Hyjni si dhe e njerëzve të ashkut dhe të dalldisë. Në qoftë se çështja është siç thua ti, atëherë na e shpjego shkurtazi: Cili është niveli më i lartë i vërtetimit të Unitetit Hyjnor i treguar nga vërsetet e qarta të Kur'anit, nëpërmjet misterit të trashëgimisë së profetësisë?

---

arritjes? Unë ju pyes ju. Dëshmia se temperamenti i njeriut preket e ndikohet nga ushqimi që ai ha, është thënia: "Ai që ha Mish dyzet ditë pa ndërprerë do të vuajë mërzitjen dhe dëshpërimin në zemrën e tij", thënie e cila është bërë proverbiale.

Përgjigjja: Është njëqind herë përtej aftësisë së një të mjeri krejtësisht të pafuqishëm si unë që t'i gjykojë ato stacione të lartësuara me mendimin e tij të kufizuar. Unë do të shpjegoj vetëm një ose dy pika tej mase të shkurtëra që burojnë nga shkëlqimi i Kur'anit të gjithurtë. Ndoshta ato do të jenë të dobishme për ta kuptuar çështjen.

Pika e Parë

Ndodhen shumë arsye për rrugën e Unitetit të Ekzistencës, dhe për t'u ndërlikuar në të; unë do të shpjegoj shumë shkurt dy arsye prej tyre:

Arsyeja e Parë: Për shkak se ata nuk qenë në gjendje të përfshinin në mendjet e tyre aktivitetin krijues të Hyjnisë dhe nuk mundën të vendosnin plotësisht në zemrat e tyre se gjithçka, nëpërmjet misterit të Njësisë Hyjnore, mbahet drejtpërdrejtë në kapjen e Hyjnisë dhe se të gjitha gjërat kanë ekzistencë nëpërmjet Fuqisë Hyjnore, zgjedhjes dhe vullnetit, ata të cilët e marrin atë rrugë u detyruan të thonin se çdo gjë është ose Ai xh.sh., ose ajo gjë nuk ka ekzistencë, ose është imagjinare, ose ajo është manifestimi i Tij apo rrezatimi.

Arsyeja e Dytë: Shenja e dashurisë së pasionuar është se ajo kurrë nuk do të ndahet nga i dashuri dhe ikën me dëshpërim nga një ndarje e tillë; është dridhja tek mendimi i ndarjes, është frika e largimit nga i dashuri sikur i frikësohet xhehennemit, dhe e urren përkohshmërinë; ai e do bashkimin siç do shpirtin e tij dhe vetveten, dhe dëshiron me mallëngjim të pafund si mallëngjimi i tij për xhennetin për të fituar afërsinë e të dashurit. Duke u kapur tek një manifestim i menjëhershmërisë Hyjnore në të gjitha gjërat, ata të cilët morën rrugën e unitetit të Ekzistencës e shpërfillën ndarjen dhe largimin; duke i supozuar bashkimin dhe takimin të qëndrueshëm, ata thanë: "Nuk ka ekzistues përveç Atij". Nëpërmjet dehjes së dashurisë dhe siç kërkohet nga përmallimi i qëndrueshmërisë, i takimit dhe i bashkimit, ata imagjinuan se në Unitetin e ekzistencës nuk ishte një rrugë e këndshme ndriçimi me anë të të cilës ata mund të shpëtonin nga tmerri i ndarjes.

Domethënë, burimi i arsyes së parë ishte nga paaftësia e dorës së mendjes për të arritur tek disa prej të vërtetave të besimit, të cilat ishin tej mase të gjëra dhe të lartësuara; nga pamundësia e saj për t'i përfshirë ato dhe nga moszhvillimi i saj plotësisht lidhur me besimin. Ndërsa burimi i arsyes së dytë ishte zbulimi i jashtëzakonshëm i

zemrës nga këndvështrimi i ndikimit të dashurisë dhe i shtrirjes së saj të jashtëzakonshme dhe gjërësisë.

Kurse, niveli më i lartë i Unitetit Hyjnor, të cilin e panë të pastërtit, janë njerëzit e kthjelltësisë së mendimit dhe Evlijatë e trashëgimisë së profetësisë nëpërmjet shpjegimeve të qarta të Kuranit, është edhe jashtë mase i lartësuar si dhe tregon edhe nivelin më të lartë të Hyjnisë dhe të krijueshmërisë, dhe se të gjithë Emrat Hyjnorë janë realë. Ai i ruan bazat dhe nuk e prish ekuilibrin e shkallëve të Hyjnisë. Sepse ata thonë se së bashku me Njësinë e Esencës së Tij dhe qënien e Tij të lirë nga hapësira, jashtë vendit dhe hapësirës, me njohurinë e Tij Allahu i Gjithëfuqishëm i rrethon dhe i përcakton drejtpërdrejtë të gjitha gjërat së bashku me të gjitha cilësitë e tyre, dhe nëpërmjet vullnetit të Tij, Ai i zgjedh dhe i specifikon ato, dhe nëpërmjet fuqisë së Tij, Ai i krijon ato. Ai e krijon dhe e drejton të gjithë universin si të ishte një qënie e vetme.

Ai e krijon pranverën e madhe me të njëjtën lehtësi si krijimin e një luleje.

Asgjë nuk mund të jetë pengesë për diçka tjetër. Nuk ka pjesëzim e copëzim në shikimin dhe drejtimin e gjërave nga ana e Tij. Ai është i pranishëm gjithandej në të njëjtin çast me anë të vendosjes së Njohurisë dhe të Fuqisë së Tij. Ky mister është shpjeguar dhe provuar plotësisht në Fjalën e Gjashtëmbëdhjetë dhe në vendqëndrimin e dytë të Fjalës së Tridhjetë e Dy. Meqenëse, në përputhje me rregullin, "krahasimet janë të pakundërshtueshme" nuk duhet t'u jepet rëndësi të metave në krahasim dhe në alegori, unë do të parashtroj një krahasim me shumë të meta me qëllim që ndryshimi ndërmjet dy rrugëve të mund të kuptohet deri diku.

Për shembull, le të imagjinojmë një pallua vigan, të pashoq dhe të zbukuruar në mënyrë të mrekullueshme, i cili mund të fluturojë nga lindja në perëndim për një çast, dhe i hap e i mbyll krahët e tij, që shtrihen nga veriu gjer në jug, dhe të cilët janë stolisur me qindra e mijëra modele të bukur, dhe në çdo pendë -pupël- të të cilit janë përfshirë arte të ndritshme.

Tani, ndodhen dy njerëz duke e vëzhguar atë; ata dëshirojnë të fluturojnë me krahët e mendjes e të zemrës lart tek cilësitë e lartësuara të këtij shpendi; tek zbulimet e tij të çuditshme.

Njëri shikon tek gjendja e palloit, tek forma dhe tek skalitjet e mrekullueshme të fuqisë Hyjnore në të gjitha puplat e tij; ai e shikon atë me pasion të skajshëm dhe me ashk; ai pjesërisht e braktis mendimin e tij të kujdesshëm reflektiv, dhe i ngjitet dashurisë. Por, atëherë ai shikon se çdo ditë ato zbukurime të këndshme ndryshojnë dhe transformohen. Ato objekte të dashurisë së tij, të cilat ai i dhuron, zhduken dhe humbasin.

Ndërsa ai duhej të thonte se nëpërmjet Unitetit të Vërtetë Hyjnor, të cilin ai nuk mundi ta përfshijë me mendjen e tij, dhe nëpërmjet një Hyjnie Absolute dhe Njësisë dhe Esencës Hyjnore, ato ishin zbukurime artistike të Një Mjeshtri të vetëm skalitës i cili zotëron një aftësi universale krijueshmërie, ai në vend të kësaj tha -me qëllim që të ngushëllonte vetveten- se shpirti i palloit ishte aq i lartë saqë autori i tij ishte brenda tij, ose se meqenëse shpirti i tij është bërë një brenda qënies së tij, dhe qënia e tij e kombinuar me paraqitjen e tij të jashtme, plotësimi i shpirtit të tij dhe lartësia e qënies i shfaqën ato manifestime duke treguar një skalitje të ndryshme dhe bukuri në çdo moment, ai nuk ishte një krijim i vërtetë nëpërmjet vullnetit të tij, por një manifestim, një rrezatim.

Sa për njeriun tjetër, ai tha se ato zbukurime harmonike e të renditura mirë plot art sigurisht kërkojnë vullnet, zgjedhje, motiv dhe synim. Kështu është e pamundur që atje të ketë një manifestim pa vullnet, dhe një rrezatim pa zgjedhje.

Po, palloi kishte një natyrë të bukur e të lartësuar, por ai nuk mund të ishte Autori -Bërësi- ai ishte pasiv. Ai nuk do të mund të bëhej një me vepruesin aktiv. Shpirti i tij ishte i mirë dhe i lartësuar, por ai nuk mund të ishte Krijuesi dhe Rregulluesi, por vetëm marrësi dhe një mjet. Sepse duke vëzhguar me vëmendje secilën nga puplat e tij ndodhej një art i kryer me një urtësi të pafundme dhe një skalitje e zbukurim i bërë nëpërmjet një fuqie të pafundme. Dhe këto nuk mund të ndodhin pa vullnet dhe zgjedhje. Këto arte duke treguar urtësi të plotë brenda fuqisë së plotë dhe Hyjni të përkryer dhe mëshirë brenda urtësisë së plotë nuk ishin vepra e ndonjë lloji manifestimi. Shkruesi i cili e ka shkruar atë libër të zbukuruar nuk mund të ishte brenda tij dhe të bashkohej me të. Përkundrazi libri ka pas kontakt vetëm me majën e penës së shkruesit.

Prandaj zbukurimet e çuditshme të shëmbëllesës së palloit i njohur si universi ishin një mesazh i zbukuruar i Krijuesit të palloit.

Tani, hidhe vështrimin tek palloi dhe lexo një mesazh. Thuaj Shkruesit të saj. ***Mashaall-llah***! *Çfarë çudirash ka dashur Zoti xh.sh.! Sa i lartësuar është All-llahu! Lavdia i takon Krijuesit*; Njeriu i cili e supozon mesazhin të jetë Shkruesi, ose e pandeh Shkruesin të jetë brenda letrës ose e përfytyron mesazhin të jetë imagjinatë, sigurisht ai ka mbuluar -fshehur- arsyen në perdet e dashurisë dhe ka qenë i paaftë të shikojë formën e vërtetë të realitetit.

Midis shumëllojshmërive të dashurisë së pasionuar -dalldisë- njëra që i jep më shumë shkas rrugës së Unitetit të Ekzistencës, është dashuria e kësaj dynjaje. Kur kthehet në dashuri të vërtetë, dashuria e kësaj dynjaje, e cila është metaforike, transformohet në unitetin e ekzistencës. Njeriu e do të dashurin personal me dashuri metaforike. Atëherë, i pamundur të vendosë përkohshmërinë e të dashurit të tij dhe jetëshkurtësinë në zemrën e tij, ai e ngushëllon vetveten duke thënë se ajo është një pasqyrë për objektin e vërtetë të dashurisë dhe të adhurimit dhe e lidh vetveten me realitetin, duke fituar kështu përhershmëri për të nëpërmjet dashurisë së vërtetë.

Në të njëjtën mënyrë, kur dashuria e çuditshme e dikujt i cili e merr dynjanë e madhe dhe universin si të dashurat e tij, dhe të dashurat e tij transformohen në dashuri të vërtetë nëpërmjet goditjeve të përhershme të vdekjes dhe të ndarjes, ai kërkon mbrojtje në rrugën e Unitetit të ekzistencës, me qëllim që t'i shpëtojë ato të dashurat e tij nga vdekja dhe ndarja.

Në qoftë se ai ka forcë të skajshme dhe besim të lartësuar, ai bëhet një nivel i këndshëm, i ndritshëm dhe i pranueshëm, si me ato të cilët i ngjasojnë Muhjiddin Ibn El Arebi. Ndodhet mundësia e rënies në humnera, duke hyrë në materie, dhe duke u zhytur në shkaqe.

Sa për Unitetin e të shikuarit, ai është i padëmshëm; ajo është një rrugë e lartësuar e njerëzve të kthjelltësisë së mendimit -maturisë.

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ


O Zot, na e trego ne të vërtetën të vërtetë, dhe na bëj ta ndjekim atë!

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtet që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti."[11]

* * *

[11] Kuran, 2:32

SHKREPTIMA E DHJETË



“Shuplaka të dhëna nga mëshira Hyjnore”.

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

“Ditën kur gjithësecilit do t’i vihen përpara të gjitha mirësitë që ka bërë dhe të gjithë të këqijat që ka bërë, atëherë ai do të dëshironte t’i kishte sa më larg veprat e tij të ulëta.

Kështu Allahu ju këshillon përkundër Vetes së Tij (ndaj ndëshkimit të Tij) dhe Allahu është Dhurues i mirësive për robët e Tij.” [1]

Një kuptim i vërsetit të lartëpërmendur është sqaruar nga shpjegimi tek ‘shuplakat e dhëna nga mëshira Hyjnore’ me të cilat goditen shokët e mi në shërbimin e Kuranit si rrjedhojë e gabimeve dhe fajeve që ata bëjnë për shkak të natyrës njerëzore.

Do të shpjegohen një sërë kerametesh, të cilat i realizon Allahu xh.sh. në shërbimin e Kuranit të Tij madhështor.. dhe duke sqaruar një shembull të kerametit të Shejh Gejlanit i cili me lejen e Allahut e mbikëqyr këtë shërbim të shenjtë dhe e mbështet dhe e ndihmon atë me duanë e tij dhe me influencën e tij prej shenjtërie, me qëllim që ata të

[1] Kuran 3:30

cilët e kryejnë atë të mund të vazhdojnë me seriozitet në shërbimin e tyre.

Ndodhen tre lloje kerametesh të shoqëruara me këtë shërbim të shenjtë:

Lloji i Parë është ai aspekt i cili përgatit shërbimin dhe i nxit ata që janë vënë në punë për ta përmbushur këtë shërbim.

Lloji i Dytë heq pengesat dhe zmbraps të keqen e atyre që e kundërshtojnë atë dhe u jep atyre goditje. Ndodhen shembuj të shumtë të këtij llojit të dytë, dhe ato janë shumë të zgjatur[2], kështu duke i shtyrë ato për një kohë tjetër, ne do të diskutojmë llojin e tretë, i cili është më i lehti dhe më i thjeshti për t'u kuptuar.

Lloji i tretë është ky: Sa herë që ata të cilët punojnë me sinqeritet në këtë shërbim tregohen të shkujdesur në zbatimin e detyrave, ata marrin një shuplakë dhembshurie e mëshire. Ndodhitë e këtij lloji numërohen më shumë se njëqind. Vetëm nga njëzet ngjarje që u ndodhën vëllezërve tonë, trembëdhjetë ose katërmbëdhjetë prej tyre morën 'shuplaka dhembshurie e mëshire', ndërsa gjashtë ose shtatë prej tyre morën 'goditje të ashpra ndaluese'.

I Pari

Prej tyre është ky Said i mjerë: Sa herë që fishkesha e dobësohesha në kryerjen e detyrave të mia, dhe duke thënë, "çfarë është ajo për mua?", dhe sa herë që merresha me çështjet e mia private, unë merrja një shuplakë. Kështu unë kam formuar bindje të plotë se unë e merrja shuplakën për shkak të neglizhencës sime dhe të ftohjes nga shërbimi i Kur'anit; sepse unë e merrja shuplakën që ishte e kundërta që më nxiste mua për të vepruar sipas dëshirës sime. Dhe duke i studiuar të gjitha këto shuplaka mëshire që i morën miqtë e mi të sinqertë, ato shuplaka ishin e kundërta e cilitdo që të ishte qëllimi i tyre nëse -ata ishin mospërfillës- saqë ne kemi ardhur në përfundimin se ngjarjet ishin keramete që buronin nga shërbimi i Kur'anit.

[2] Për shembull, ata që e kundërshtojnë fenë vuajnë vetë në këtë botë një dënim më të madh se sa torturat, pikëllimi dhe tradhtia që ata u shkaktojnë studentëve të Risale-i Nurit, dhe marrin atë që kanë dhënë.

Për shembull, për sa kohë që ky Said i mjerë ishte i zënë me mësimdhënien e të vërtetave të Kur'anit në Van në kohën e ngjarjeve të Shejh Saidit[3], qeveria e cila ishte dyshuese për cilindo person, nuk më preku e nuk më trazoi mua. Ndërsa kur unë thashë "Ç'është kjo për mua?" dhe duke menduar për veten time, u tërhoqa që të rrija i veçuar në një shpellë të rrënuar në Malin Erek me qëllim që të shpëtoja jetën time në Ahiret, ata më morën mua pa asnjë shkak dhe më syrgjynosën duke më dërguar në Budur.

Atje, përsëri, sa herë që unë i shërbeja Kur'anit -dhe në atë kohë në atë qytet të gjithë të internuarit mbikëqyreshin e vëzhgoheshin shumë rreptë, dhe të gjithë atyre u kërkohej që të raportonin tek policia në çdo mbrëmje për praninë e tyre, ndërsa unë dhe studentët e mi të sinqertë u përjashtuam nga kjo punë, sa kohë që i shërbenim Kur'anit, dhe nuk shkuam që të raportonim praninë tonë dhe nuk e njihja asnjërin nga ata zyrtarë të policisë. Saqë guvernatori iu ankua Fevzi Pashës[4] për punën tonë kur i bëri vizitë. Por Fevzi Pasha tha: "Mos e trazoni atë; trajtojeni me respekt". Ajo që e bëri atë të shprehet kështu ishte natyra e shenjtë e shërbimit të Kur'anit.

Por sa herë që unë mposhtesha nga ideja për të shpëtuar veten, nga mendimi vetëm për jetën time në Ahiret, dhe kur ulja ritmin duke pakësuar përpjekjet përkohësisht në shërbimin tim të Kur'anit, unë merrja një shuplakë në kundërshtim me qëllimet e mia. Domethënë, unë dërgohesha nga njëri vend në tjetrin për internim. Unë u internova nga Burda për në Isparta.

Në Ispartë unë nisa përsëri punën në shërbim të Kur'anit.

Por pasi kaluan njëzet ditë në shërbim të Kur'anit, disa frikacakë po më thonin në formë paralajmërimi: "Ndoshta qeveria nuk do ta shohë me sy të mirë këtë situatë dhe nuk do ta miratojë; do të ishte më mirë të tregoheshe pak më i vëmendshëm në këtë çështje". Përsëri ideja e të menduarit vetëm për vete më mori, dhe unë thashë:

---

[3] Shejh Saidi i Palus ishte një Shejh Nakshibendi i cili udhëhoqi një kryengritje në Turqinë lindore kundra qeverisë së Ankarasë herët në vitin 1925. Ai u arrestua dhe u dënua me vdekje në Dijar Bakir, me 29 qershor 1925 (Përkthyesi).

[4] kjo i referohet Mareshall Fevzi Çakmak, i Shtabit të përgjithshëm të Ushtrisë Turke

Njerëzit nuk duhet të vijnë tek unë 'dhe porosita shokët që të mos më takojnë duke u tërhequr kështu nga detyra'. Dhe përsëri u dërgova në internim, u syrgjynosa në një mërgim të tretë, në Barla.

Edhe në Barla, sa herë që ulja ritmin në shërbimin e Kur'anit dhe më sundonte ideja e të menduarit për veten time dhe për të shpëtuar Ahiretin tim, njëri nga gjarpërinjtë e njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje më sundonte, ose njëri nga hipokritët më binin në qafë, më mundonin.

Gjatë tetë viteve që kam kaluar në Barla më kanë rënë tetëdhjetë ngjarje të tilla; unë mund t'i tregoj ato. Por me qëllim që të mos i mërzis njerëzit, unë po i shkurtoj.

Vëllezërit e mi! Unë tregova shuplakat e Mëshirës që kam marrë; tani në qoftë se ju do të më lejonit dhe do të më falnit, unë do t'i tregoj edhe ato që u kanë rënë ju. Mos u lëndoni. Në qoftë se ndonjëri prej jush do të prekej, unë nuk do ta vendos emrin e tij.

Shembulli i Dytë

Vëllai im i vërtetë, Abdul Mexhidi, i cili është nga studentët e mi të sinqertë e vetësakrifikues, kishte një shtëpi të mirë në Van. Ai ishte i kamur dhe ushtronte profesionin e mësuesit. Duke ndjekur mendimet e tij, ai nuk iu bashkua atyre që po përpiqeshin të më dërgojnë mua tek zona kufitare kundra dëshirave të mia, i cili ishte një vend më tepër në nevojë për t'i shërbyer Kur'anit dhe nuk e miratoi, dhe sikur ai pa se do të ishte më e mirë që unë të mos shkoja gjithashtu, sepse në qoftë se unë do të shkoja tek ajo zonë kufitare, edhe shërbimi i Kur'anit do të përzihej diçka me politikë, nuk do të ishte i pastër, edhe do ta dëbonin atë nga Vani -prandaj ai nuk mori pjesë. Por ai mori një shuplakë mëshire kundra qëllimeve të tij, sepse ai duhej të linte edhe Vanin, edhe shtëpinë e tij të bukur, edhe vendlindjen; ai u detyrua të shkojë në Ergani.

I Treti

Hulusi Bej ishte një pjesëmarrës i rëndësishëm në shërbimin tonë të Kur'anit. Kur ai u kthye tek vendlindja e tij nga Egridir, ndodheshin faktorë që do t'i lejonin atij kënaqësi të mëdha dhe lumturi të kësaj bote, dhe ato ndoshta do t'i shkaktonin të pakësonte përpjekjet në

shërbimin e Kur'anit, që lidhet vetëm me Ahiretin. Sepse ai u ribashkua me prindërit e tij, të cilët nuk i kishte parë qysh prej një kohe të gjatë, dhe se ai ishte kthyer në shtëpi, dhe për shkak se ai ishte kthyer atje me rang e nderim, bota po i buzëqeshte atij dhe u shfaq e mirë për të.

Mirëpo për ata të cilët janë vënë në punë për t'i shërbyer Kur'anit, ose dynjaja duhet të jetë e zemëruar me ta, ose ata duhet të jenë të zemëruar me dynjanë, me qëllim që ata të mund ta përmbushin atë qëllim me sinqeritet dhe me seriozitet.

Sigurisht zemra e Hulusiut ishte e patundur, por meqenëse një situatë e tillë i shkaktoi atij ftohje, e bëri të ulë ritmin, ai mori një shuplakë nga mëshira Hyjnore. Për një ose dy vite një numër hipokritësh iu qepën atij duke e bezdisur, dhe ia larguan atij të gjitha kënaqësitë e kësaj bote. Ata e bënë botën të pezmatuar për të, dhe ai u mërzit nga ajo. Atëherë ai me kuptimin e vërtetë të Fjalës e përqafoi detyrën e tij me seriozitet.

I Katërti

Ky është Muhaxhir Hafiz Ahmed. Ai vetë tha ç'ka vijon:

"Po, unë pranoj se kam bërë një gabim në interpretimin tim në shërbimin e Kur'anit, pasi mendova për të shpëtuar vetëm Ahiretin tim. Unë pata një dëshirë që do të më shkaktonte mua të jem i shkujdesur në zbatimin e detyrave të shërbimit, dhe unë mora një shuplakë që ishte e mëshirshme, madje, ajo në realitet ishte e ashpër dhe ndaluese. I lutem Allahut që ajo të jetë një shlyerje e mëkatit për pakujdesinë time në shërbimin ndaj Kur'anit madhështor. Ngjarja është siç vijon: Profesori im -Ustadhi- nuk ishte në favor të bidateve[5], xhamia ime ishte afër shtëpisë së tij, dhe muajt e bekuar -Rexhep, Shaban dhe Ramazani- po na afroheshin.

Në qoftë se nuk do ta kryeja namazin në mënyrën e re -me bidat- do të ndalohesha nga puna; në qoftë se do ta lija xhaminë, nëse nuk do të falesha në të si imam për xhematin, do të më humbiste një shpërblim i madh shpirtëror, sidomos në këto tre muaj, dhe njerëzit e kësaj krahine

[5] Domethënë, bidatet që kundërshtuan shenjat e islamit, si thirrja e ezanit në Turqisht që ndodhën që nga viti 1920 dhe vazhduan deri në vitin 1950.

do ta bënin zakon braktisjen e xhematit.. Kështu, sipas interpretimit tim, unë dëshirova në vetvete, sikur Ustadhi -të cilin e dua më shumë se shpirtin- të largohej përkohësisht nga fshati Barla; dhe të shkonte tek ndonjë vend tjetër, me qëllim që unë t'i kryeja detyrat në përputhje me çështjet e risisë. Por mua më humbi diçka që është se, nëse ustadhi do të largohej nga ky vend, do të dobësohej e ngadalësohej puna në shërbimin e Kuranit. Dhe gjatë këtyre mendimeve më erdhi ndëshkimi; Ajo ishte një goditje mëshire, por aq e rëndë saqë edhe pasi kaluan tre muaj unë akoma nuk erdha në vete. Megjithatë lavdi Zotit, në përputhje me atë çfarë thotë profesori im: siç i është inspiruar atij se ne mund të shpresojmë nga mëshira Hyjnore se çdo minut në fatkeqësi është i barasvlershëm me adhurimin e një dite. Sepse gabimi nuk ishte për shkak të armiqësisë; dëshira më ndodhi mua vetëm për shkak se po mendoja për jetën time në Ahiret.

I Pesti

Ky është Hakki Efendiu. Meqenëse ai nuk është tani këtu, unë do të veproj në emrin e tij ashtu siç bëra për Hulusi Beun, dhe them këtë: ndërsa Hakki Efendiu po e përmbushte siç duhet detyrën e tij si student në shërbimin e Kur'anit, veçse ama kur një kajmakam -drejtues- i shthurur u caktua në atë krahinë, Hakki Efendiu mendoi t'i fshihte letrat që i kishte shkruar me qëllim që të mos dëmtohej as profesori i tij dhe as ai vetë. Ai përkohësisht hoqi dorë nga shërbimi i tij për Risale-i Nurin. Papritmas një çështje gjyqësore u hap kundra tij, e cila kishte kuptimin e një shuplake të dhënë nga mëshira Hyjnore, si rrjedhojë e të cilës do të duhej të paguante një gjobë prej një mijë lirash. Ai mbeti i zbuluar para kërcënimit për një vit derisa erdhi këtu duke u kthyer në detyrën e tij dhe si student në shërbim të Kur'anit.

Atëherë Allahu xh.sh. e shpëtoi atë nga rënia në greminë, dhe shuplaka u shmang, u ngrit dhe atij iu dha pafajësia.

Pastaj më vonë kur u hap përpara studentëve një fushë e re veprimi për Kur'anin, që lidhej me të shkruarin e Kur'anit në një mënyrë të re, iu dha Hakki Efendiut pjesa e tij për ta tejshkruar. Ai e kreu mirë detyrën që iu ngarkua dhe shkroi për bukuri një xhuz të plotë (1/30) nga Kur'ani. Por për shkak të rethanave të tij të ngushta ekonomike ai u ndie i detyruar që në mënyrë të fshehtë të marrë përsipër mbrojtjen e

dikujt në një çështje gjyqësore. Ai papritmas mori një shuplakë tjetër mëshire. Gishti me të cilin mbante penën që shkruante Kur'anin u thye.

Meqenëse ne nuk e dinim përfshirjen e tij në këtë punë -aferë- ne ishim të habitur për atë që i ndodhi.

Por më vonë u kuptua se shërbimi i shenjtë e i pastër i Kur'anit nuk dëshironte të përfshiheshin gishtat të cilët ishin të veçantë për të në punë tjetër. Sikur gishti do ta paralajmëronte atë duke i thënë: "Ky gisht nuk mund të shkruajë edhe çështjet e gjyqësorit edhe atë të Kur'anit.

Sidoqoftë, unë e vura veten time në pozitën e Hulusi Beut dhe fola në vend të tij, edhe Hakki Efendiu është tamam si ai. Në qoftë se ai nuk është i kënaqur me mua si përfaqësues, le ta shkruajë vetë shuplakën që ai mori.

I Gjashti

Ky është Bekir Efendi.[6] Ai nuk është këtu për tani, kështu unë po veproj si përfaqësues si për vëllain tim Abdul-Mexhidin, duke u mbështetur tek mirëbesimi i tij, tek sinqeriteti, besnikëria dhe tek qëndrueshmëria e tij në shërbim, dhe duke u mbështetur tek ajo që tregojnë vëllezërit dhe të dashurit e mi si Sulejman Efendiu dhe Hafiz Teufik Shamli, unë them këtë: Bekir Efendiu i cili mori përsipër botimin e Fjalës së Dhjetë në Stamboll, dhe ne deshëm gjithashtu të botojmë atje trajtesën e mrekullive të Kur'anit përpara se të hynte në fuqi përdorimi i ri i shkronjave latine, dhe i dërgova atij një letër në të cilën shkrova: Ne do të të dërgojmë çmimin, koston e botimit ashtu siç dërguam koston e botimit të Fjalës së Dhjetë. Por duke menduar për varfërinë time dhe duke parë se botimi do të mund të kushtonte rreth katërqind lira, Bekir Efendiu mendoi me vete: "Ndoshta Hoxha nuk do të jetë i kënaqur në qoftë se unë do të paguaja nga xhepi im", dhe nefsi i tij e mashtroi atë. Ajo nuk u botua dhe i shkaktoi dëm të konsiderueshëm shërbimit tonë të Kur'anit.

Dy muaj më vonë nëntëqind lira të tij iu vodhën, dhe ai mori një shuplakë mëshire por të rëndë. I lutemi Allahut që t'i bëjë ato para të humbura si sadaka për të.

[6] Bekir Dikmen 1898-1954. Ai ishte një tregtar i Barlës

I Shtati

Ky është Shamli Hafiz Teufik.[7] Ai vetë thotë: Ndërmora veprime të tilla që më shtynë mua të ulja ritmin e të ftohem në shërbimin e Kur'anit. Si rrjedhojë, më erdhi një shuplakë. Unë formova bindje të sigurt, e cila s'pranon asnjë dyshim, se kjo shuplakë më erdhi vetëm për shkak të atij aspekti, dhe ndodhi si rezultat i një gabimi nga ana ime, dhe nga mungesa e vlerësimit për shkak të injorancës.

***Shuplaka e Parë*:** Kur Ustadhi ynë na shpërndau pjesët e Kur'anit, më caktoi mua të transkriptoja, të kopjoja, tre xhuze -një xhuz është një e tridhjeta e Kur'anit- meqë Allahu më kishte dhënë aftësi në transkriptimin e arabishtes, për kopjimin e Kur'anit Kerim dhe i ndau xhuzet e tjerë midis studentëve. Përmallimi për të shkruar Kur'anin më shkatërroi dëshirën time për të kryer shërbimin në shkrimin e drafteve të përgjithshme paraprake të pjesëve të Risale-i Nurit. Unë madje u godita nga mburrja meqë e quaja veten time më të përparuar se sa shokët e mi në këtë punë, meqë gjeja në veten time përshtatshmëri -mjaftueshmëri- në transkriptimin mirë të arabishtes.

Madje njëherë kur ustadhi më tha mua si masë paraprake dhe për të më udhëzuar drejt në çështjet që lidhen me transkriptimin e arabishtes, unë i thashë me mendjemadhësi: Unë e di këtë. "Nuk kam nevojë të mësoj". Dhe kështu, unë mora një shuplakë dhembshurie e mëshire si rezultat i këtij gabimit tim, dhe ajo që shkrova nuk ishte aq e mirë sa ajo e vëllait tim, Husrevit, pavarësisht se unë shquhesha për transkriptim. Ne të gjithë u çuditëm. Dhe ne tani kemi kuptuar se ajo ishte një shuplakë mëshire me të cilën më goditi kerameti i shërbimit të Kur'anit, i cili nuk pranon mendjemadhësi!

E Dyta: Unë pranoj se dy nga qëndrimet e mia po ma shkatërronin sinqeritetin e plotë të domosdoshëm për shërbimin ndaj Kur'anit, i cili duhet të jetë thjesht për hir të Allahut, dhe unë mora një goditje të ashpër.

Meqenëse unë jam si një i huaj në një vend të huaj; gjithashtu -meqenëse unë nuk e zbatova kursimtarinë dhe vetëmjaftueshmërinë,

[7] Teufik Gosku, 1887-1965, ishte studenti i Bediuzzamanit dhe shkrues në Barla. Ai u burgos së bashku me të në Eskishehir dhe Denizli. Ai e pa Bediuzzamanin në Damask në 1911, ku babai i tij po shërbente në Ushtri, dhe prandaj u quajt Shamli.

rregullat e rëndësishme të profesorit tim, unë vuaj nga varfëria. Unë jam i detyruar të përzihem me njerëz egoistë e arrogantë, dhe kështu-Allahu më faltë, unë u detyrova të isha bujarë në mënyrë shtinjake e me lajka. Ustadhi im më paralajmëronte shpesh, ma kujtonte dhe më qortonte, por unë fatkeqësisht nuk munda ta shpëtoj veten time. Nga njëra anë Shejtanët midis xhindeve dhe njerëzve po përfitonin nga kjo situatë e imja e cila ishte në kundërshtim me shpirtin e shërbimit të Kur'anit të gjithurtë, dhe nga ana tjetër, ajo ftohtësi dhe ulje të ritmit në shërbimin tonë.

"Përballë këtij gabimit tim unë mora një shuplakë të ashpër por mëshire në dashtë Allahu. Unë nuk kam dyshim se ajo ndodhi si rrjedhojë e atij gabimi. Shuplaka ishte kjo: Megjithëse për tetë vite pune unë kam pasur edhe lidhje të ngushta me profesorin dhe kam qenë shkruesi i drafteve të tij të përgjithshme dhe i drafteve përfundimtare, veçse ama për afro tetë muaj, unë nuk kam qenë në gjendje të përfitoj nga Risale-i Nuri.

Ne u çuditëm tek kjo situatë. Edhe unë, edhe profesori im kërkuam arsye, duke u habitur përse ishte kjo. Ne tani ndihemi të sigurt se ato të vërteta të Kur'anit janë dritë dhe të ndritshme, dhe nuk mund të bashkohen me errësirën e artificializmit, me lajkatarinë dhe me poshtërimin. Atëherë, kuptimet e të vërtetave të këtyre dritave po largoheshin prej meje, duke u shfaqur si të huaja për mua.

Unë i lutem Zotit të Plotfuqishëm që Ai të më japë sinqeritet të denjë për një shërbim të tillë, dhe të më shpëtojë nga hipokrizia dhe nga artificializmi ndaj "Njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje". Unë së pari kërkoj nga profesori im dhe nga të gjithë vëllezërit e mi që të bëjnë dua për mua. "Robi me të meta" Shamli Hafiz Teufik.

E Teta:

Ky është Sejrani. Ashtu si Husrevi, ai është njëri nga studentët e mi i cili ishte i entuziazmuar për Risale-i Nurin dhe kishte një konceptim të mirë për të. Unë i shikova idetë e studentëve të mi në Isparta rreth 'Koinçidencave', të cilat janë si një kod -çelës- për misteret e Kur'anit dhe për shkencën e *xhefrit*. Të tjerët iu përgjigjën dhe morën pjesë seriozisht, por për shkak se kishte ide të tjera dhe pika interesi, ai nuk u përgjigj. Madje ai donte të më largonte mua nga ajo që unë e dija me siguri lidhur me të vërtetat. Ai më shkroi një letër e cila më mërziti

shumë. Unë thashë: Ah medet! E humba këtë student. "Sigurisht unë desha t'i ndriçoja mendimet e tij, por një kuptim i mëtejshëm i ngatërroi çështjet. Ai mori një goditje nga mëshira Hyjnore; ai qëndroi për gati një vit në një vend tjetër izolimi (domethënë, në burg).

E Nënta*:*

Ky është Hafiz Zyhti i madh. Në një kohë ai ishte si një mbikëqyrës i punës së studentëve të Risale-i Nurit në Ağrus. Duke mos vlerësuar nderin shpirtëror të studentëve të jetë i mjaftueshëm, të cilët kishin marrë si rrugën e tyre ndjekjen e sunnetit të Profetit a.s.m. dhe shmangien e bidateve, ai mori përsipër të jepte mësim një bidat të madh me shpresën e rritjes së pozitës së tij në sytë e *Ehluddynjas*, e njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj Dynjaje. Ai bëri një gabim i cili ishte drejtëpërdrejt dhe krejtësisht i kundërt me metodën tonë, dhe mori një shuplakë të rëndë nga mëshira Hyjnore.

Një ngjarje e shkatërroi plotësisht nderin e familjes së tij. Fatkeqësisht, Hafiz Zyhti më i riu u prek gjithashtu nga ngjarja e rëndë megjithëse ai nuk meritonte asnjë goditje. Por në dashtë Allahu, kjo do të jetë si një operacion i dobishëm kirurgjikal duke e shpëtuar zemrën e tij nga kjo dynja dhe që ta shtyjë atë që t'i afrohet punës së Kur'anit thjesht për hir të Allahut, dhe t'i vlejë atij në Ditën e Kijametit.

E Dhjeta

Ky është Hafiz Ahmedi (Allahu e mëshiroftë). Për dy apo tre vite ai shkroi trajtesa në mënyrë kurajuese dhe ai përfitoi prej tyre. Atëherë, njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj bote, e shfrytëzuan një tipar të dobët të karakterit të tij. Entuziazmi i tij u ftoh, i ra zelli. Pastaj ai u përzi me njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje me shpresë se ndoshta nuk do të dëmtohej nga e keqja që vjen prej tyre, që t'u thotë ndonjë fjalë të mirë dhe që të fitojë ndonjë lloj pozite tek ata, dhe që të ardhurat e tij të pakta, të mjaftueshme, të bëheshin më të bollshme.

Dhe kështu, si shpërblim për pakësimin e përpjekjeve dhe për dëmin që iu shkaktua kështu shërbimit të tij ndaj Kur'anit ai mori dy shuplaka. *Njëra* ishte se pesë njerëz më shumë duhej të mbështeteshin nga të ardhurat e tij të pamjaftueshme dhe situata e tij u bë vërtet e mjerueshme. *Shuplaka e dytë:* pavarësisht se ai ishte i ndjeshëm lidhur me nderin dhe sedrën dhe nuk mund t'i duronte kritikat apo

kundërshtimet e ndokujt, ai pa dijeni e pa dashur u përdor si mburojë nga disa njerëz tinëzarë e dredharakë saqë nderi i tij u njollos.

Nëntëdhjetë përqind e nderit të tij u shkatërrua dhe nëntëdhjetë përqind e njerëzve u kthyen kundra tij. Megjithatë... Allahu e faltë, në dashtë Allahu do të vijë në vete dhe do të kthehet në detyrën e tij në shërbim të Kur'anit.

E Njëmbëdhjeta

Kjo nuk u shkrua meqë ndoshta ai nuk do të ishte dakort.

E Dymbëdhjeta

Ky është mësues Galipi (Allahu e mëshiroftë). Po, Ai kreu shërbime të mëdha me besnikëri e në mënyrë lavdëruese në shkrimin e drafteve të Fundit të trajtesave, duke mos treguar asnjë dobësi përballë asnjë vështirësie. Në shumicën e kohëve ai vinte në mësim dhe dëgjonte me seriozitet të plotë dhe me dëshirë si dhe i kopjonte trajtesat e Risale-i Nurit. Pastaj në shkëmbim për një çmim prej tridhjetë lirash ai i kishte tejshkruar, kopjuar, të gjitha *Fjalët* dhe *Letrat*.

Qëllimi i tij ishte që t'i shpërndante ato në qytetin e vendlindjes së tij dhe që t'i ndriçonte njerëzit atje. Por për shkak të disa ideve, ai nuk i shpërndau trajtesat ashtu siç e kishte parashikuar dhe i la ato në kutinë e tyre. Papritmas ndodhi një ngjarje e dhimbshme nga e cila ai vuajti brenga e dëshpërime për gjatë një viti. Ai fitoi armiq të padrejtë dhe despotë të panumërt në vend të një grushti armiqsh zyrtarë të cilët do të kishin qenë armiqësorë vetëm për shkak që ai i kishte shpërndarë trajtesat, dhe humbi shumë nga shokët e miqtë e tij.

E Trembëdhjeta

Ky është Hafiz Halidi[8] -Allahu e mëshiroftë. Ai tha:

Po, unë pranoj se punoja me dëshirë të fortë e me entuziazëm në shkrimin e drafteve të përgjithshme të Risale-i Nurit të cilat profesori

[8] Një mësues me profesion, Hafiz Halid Tekini ishte një vendës i Barlës. Ai ishte njëri nga studentët e afërm të Bediuzzamanit atje, gjithashtu duke vepruar si shkrues i tij.

im i shpërndau në shërbim të Kur'anit; atje kishte një vend pune të pazënë, ishte detyra e imamit të xhamisë në lagjen tonë. Me qëllimin që ta vishja edhe njëherë tjetër mantelin e mëparshëm -xhyben- dhe të vishesha me çallmë, unë përkohësisht i pakësova përpjekjet e mia në punë dhe ra zelli im në shërbim të Kur'anit si dhe u tërhoqa, për shkak të injorancës, nga aktiviteti në shërbim të Kur'anit. Por ama unë mora një shuplakë mëshire kundra qëllimeve të mia. Megjithëse për tetë ose nëntë muaj unë veprova si imam, në mënyrë të jashtëzakonshme unë nuk qeshë në gjendje që ta vishja çallmën, pavarësisht premtimeve të përsëritura të myftiut për emrimin tim në atë detyrë. Unë nuk kam dyshim se kjo shuplakë mëshire, ishte rezultati i gabimit tim. Mësuesi im më adresohej mua në mënyrë të veçantë në mësim, përveç qënies sime si shkruesi i tij lidhur me draftet paraprake. Ai vuajti vështirësi për shkak të neglizhencës sime.

Megjithatë, të gjitha falënderimet i takojnë vetëm Allahut i Cili na bëri ne të kuptojmë gabimin tonë dhe të mësojmë se sa i shenjtë është ky shërbim. Ne ishim të sigurt se nga prapa nesh ishte një profesor, si një engjëll mbrojtës, si Shejh Gejlani.

Më i dobëti i shërbëtorëve të Zotit

Hafiz Halid

E Katërmbëdhjeta

Kjo përbëhet nga tre shuplaka të vogla që morën tre persona, Emrat e të cilëve ishin 'Mustafa'.

I Pari i tyre: për tetë vite Mustafa Çavushi (Allahu e mëshiroftë) shërbente në xhaminë tonë të vogël private, dhe kujdesej për sobën e saj, për parafinën dhe madje edhe për shkrepëset. Më vonë unë mësova se për tetë vite ai i kishte sjellë parafinën dhe shkrepëset nga xhepi i tij. Ai nuk mbetej kurrë prapa xhematit, dhe sidomos në netët e bekuara të xhumasë, veçse në qoftë se do të ishte shumë i detyruar për ndonjë arsye. Pastaj, në një ditë, duke shfrytëzuar padjallëzinë e çiltërsinë e tij, njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje i thanë: Njoftoje Filan Hafiz -i cili ishte njëri nga studentët e Risale-i Nurit- që ta heqë çallmën përpara se të lëndohet e të detyrohet ta heqë dhe, njoftoje xhematin që ta lënë thirrjen e Ezanit në fshehtësi. "Ata nuk e dinin se për një person si Mustafa Çavushin me një shpirt të lartë dhe i vënë në shërbim të

Kur'anit, njoftimi për një fjalë të tillë për heqjen e çallmës ishte shumë e vështirë.

Por ai, nga çiltërsia, i tregoi shokut të tij çfarë i kishin thënë ata.

Në atë mbrëmje unë pashë në ëndërr se Mustafa Çavushi erdhi tek dhoma ime me duar të pista duke ecur prapa kajmakamit dhe të dy u futën në dhomën time. Të nesërmen, unë i thashë: "Mustafa Çavush, kë pe ti sot? Unë të pashë në ëndërr me duar të pista duke ecur prapa kajmakamit". Ai u përgjigj: "Ah, medet! Muhtari më tha një fjalë dhe unë ia thashë Hafizit, shkruesit, dhe nuk e dija se çfarë dredhie kishte pas saj.

Gjithashtu, në të njëjtën ditë, ai solli pothuajse një okka peshë nga parafina në xhami. Në një mënyrë që ai kurrë nuk e kishte vepruar më parë, ai e la të hapur derën e xhamisë dhe hyri në të një mickë -kotele- dhe ndoti shumë prej Sixhadeve të mia; pastaj njëri prej tyre hyri në xhami dhe deshi ta pastronte vendin, mirëpo nuk gjeti përveç enës së parafinës, dhe duke e pandehur atë të ishte ujë e hodhi atë në të gjithë xhaminë duke e spërkatur dhe për çudi, ai nuk e kishte nuhatur parafinën. Domethënë, sikur xhamia po i thonte me gjuhën e gjendjes së saj: "Ne nuk kemi nevojë për parafinën tënde. Unë s'e kam pranuar atë për shkak të gabimit që bëre". Si shenjë e kësaj fjale jolëndore, ai person nuk e kishte nuhatur aromën e parafinës, madje edhe Mustafai nuk pati mundësi të marrë pjesë në faljen me xhemat në atë ditë dhe në natën e bekuar të xhumasë pavarësisht përpjekjeve të tij. Pastaj u pendua me shumë sinqeritet, dhe i kërkoi shumë falje Allahut, dhe u kthye në pastërtinë e zemrës së tij dhe në kryerjen e ibadetit me devocion e pastërti El-hamdu lil-lah.

Dy personat e tjerë të quajtur secili prej tyre 'Mustafa', i Pari është Mustafai nga Fshati Kuleonu i cili është nga studentët e zellshëm, të vlefshëm e të rëndësishëm, dhe tjetri është Shoku i tij besnik i cili është Hafiz Mustafa. Pas festës fetare, unë u çova fjalë duke u thënë që ata të mos vinin për të më vizituar në këtë kohë me qëllim që njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj bote të mos na bezdisnin dhe që të mos shkaktonin asnjë ftohje apo pakësim të përpjekjeve në shërbimin tonë të Kur'anit. Por në qoftë se duhej të vinin, ata duhej të vinin një e nga një. Pastaj një natë, tre nga ata erdhën të gjithë së bashku. Ata synuan të largoheshin para agimit. Në një mënyrë që kurrë nuk kishte ndodhur

më parë, as Mustafa Çavushi as Sulejman Efendi, as unë dhe as vetë ata nuk kishim menduar për të marrë masat paraprake për t'i dalë së keqes përpara: ne kishim harruar për të bërë diçka të tillë. Secili nga ne hoqi dorë duke ua lënë të tjerëve marrjen e masave. Ata u larguan para agimit. Pastaj për dy orë ata në mënyrë të vazhdueshme u goditën nga një furtunë e tillë -saqë unë u tremba se nuk do të shpëtonin të gjallë prej saj. Ne nuk kishim parë furtunë si ajo në këtë dimër, dhe as nuk më kishte ardhur aq shumë keq për dikë si për ata. Si një ndëshkim për mosmarrjen e masave paraprake, unë doja të dërgoja Sulejmanin pas tyre për t'i gjetur dhe nëse ata ishin shëndoshë e mirë. Mustafa Çavushi tha: "Në qoftë se shkon, edhe ai gjithashtu do të mbetet, dhe mua më duhet të shkoj pas tij për ta gjetur.

Atëherë, duhet që Abdull-llah Çavushi të vijë pas meje". Kështu duke thënë: "Ne e vendosim besimin tonë në Allahun", ne e lamë çështjen në dorë të Tij, dhe pritëm.

Pyetje: Ti i konsideron fatkeqësitë që ranë mbi vëllezërit e tu të veçantë dhe mbi shokët se janë si shuplaka disiplinuese, si ndëshkim për ftohjen dhe për pakësimin e përpjekjeve në shërbimin e tyre ndaj Kur'anit. Ndërsa ata të cilët janë vërtetë armiqësorë ndaj teje dhe ndaj shërbimit të Kur'anit, mbeten të padëmtuar dhe shëndoshë e mirë. Përse miqtë e Kur'anit zbulohen para goditjeve, kurse armiqtë e tij mbeten të pashqetësuar?

Përgjigjja: Sipas thënies së urtë, اَلظُّلْمُ لَا يَدُوْمُ وَالْكُفْرُ يَدُوْمُ *"Padrejtësia nuk vazhdon, por kufri -mohimi- vazhdon"*. Gabimet e punonjësve në radhët e shërbimit të Kur'anit janë një lloj padrejtësie në këtë shërbimin tonë të Kur'anit, dhe prandaj ndëshkohen shpejt; ata marrin një shuplakë mëshire, dhe në qoftë se janë të ndjeshëm, e kuptojnë gabimin e tyre. Ndërsa, kundërshtimet e armiqve ndaj shërbimit të Kur'anit, dhe përpjekjet e tyre për ta penguar atë, janë për llogari të çudhëzimit. Me dijeni apo pa dijeni, agresioni kundra shërbimit tonë e ndihmon ateizmin.

Meqenëse kufri -mohimi- vazhdon, ata në përgjithësi nuk marrin goditje të menjëhershme. Ashtu si dënimet e atyre që kryejnë krime të vogla në vend, jepen brenda vendit, kurse krimet e rënda dërgohen për tek gjykatat e larta, po ashtu, sipas rregullit, gabimet e vogla të

besimtarëve dhe të shokëve të ngushtë të Kur'anit ndëshkohen shpejt dhe pjesërisht në këtë botë, me qëllim që t'i pastrojë shpejt ata prej atyre fajeve. Ndërsa krimet e njerëzve të çudhëzimit janë aq të mëdha saqë meqenëse ndëshkimet ndaj tyre nuk mund t'i përmbajë jeta e shkurtër e kësaj dynjaje, ashtu siç kërkohet, ato i dërgohen Gjykatës më të lartë në Botën e përjetshme, dhe shumica e tyre nuk marrin ndonjë ndëshkim këtu në këtë dynja.

Hadithi Sherif: اَلدُّنْيَا سِجْنُ الْمُؤْمِنِ وَجَنَّةُ الْكَافِرِ *"Dynjaja është burgu i besimtarëve dhe Parajsa e jobesimtarëve",*[9] aludon gjithashtu për këtë të vërtetë. Domethënë, për shkak se besimtari merr një ndëshkim të pjesshëm për gabimet e tij në këtë dynja, natyrisht për të ai është një vend ndëshkimi. Në lidhje me lumturinë e tij në Ahiret, kjo dynja është si një burg i nëndheshëm dhe si Ferri. Dhe meqenëse jobesimtarët do të jenë të përjetshëm në ferr, ata marrin pjesërisht shpërblimet për punët e tyre të mira në dynja dhe mëkatet e tyre të mëdha shtyhen për në Ahiretin e përjetshëm; kjo dynja është parajsa e tyre në krahasim me jetën e tyre në Ahiret. Sepse në realitet dhe në kuptim besimtari është gjithashtu shumë më i lumtur në këtë dynja se sa jobesimtari. Mjaft thjesht, besimi i një besimtari është si një parajsë në shpirtin e tij; ndërsa mohimi i jobesimtarit ndez një lloj Ferri në qënien e tij.

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".[10]

* * *

[9] Muslimi, Tirmidhi.
[60]Kur'an, 2:32

SHKREPTIMA E NJËMBËDHJETË

Shkalla e Sunnetit të Profetit dhe kundërhelmi ndaj sëmundjes së bidatit, risisë.

[Stacioni i parë i këtij vërseti është '***Rruga e Sunnetit të Profetit'*** ndërsa stacioni i Dytë është '***Shkalla e sunnetit'***]

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ

عَلَيْكُم بِالْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَّحِيمٌ

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Vërtet që ju ka ardhur juve një i Dërguar (Muhammedi a.s.m.) nga vetë ju (të cilin ju e njihni fare mirë). Ai pikëllohet nëse juve ju bie ndonjë lëndim a vështirësi. Ai është i merakosur dhe i dëshiruar për ju, për besimtarët ai a.s.m. është që ndjen shumë, mëshirues"[1]

فَإِن تَوَلَّوْا فَقُلْ حَسْبِيَ اللَّهُ لَا إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ

وَهُوَ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ

Por nëse ata kthejnë kurrizin, atëherë thuaju (o Muhammed a.s.m.): "Allahu është më se i mjatueshëm për mua. Nuk ka Zot tjetër përveç Atij. Tek Ai unë mbështetem plotësisht dhe Ai është Zoti i Arshit Madhështor"[2]*.*

[1] Kur'an, 9:128

[2] Kur'an, 9:129

Thuaj (o Muhammed a.s.m.): "Nëse vërtet e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, Allahu do t'ju dojë ju dhe do t'ju falë juve gjynahet tuaja;

Dhe Allahu është gjithnjë Falës i Madh, Mëshirëplotë"[3].

Ne do të shpjegojmë në mënyrë të përmbledhur njëmbëdhjetë pika të holla prej qindra çështjeve të holla të cilat i përfshijnë këto dy ajete të lartësuar.

● **Pika e Parë**

Profeti Muhammed a.s.m. ka thënë:

مَنْ تَمَسَّكَ بِسُنَّتِي عِنْدَ فَسَادِ أُمَّتِي فَلَهُ أَجْرُ مِأَةِ شَهِيدٍ

"*Ai që kapet pas sunnetit tim kur të jetë prishur komuniteti im, ai do të marrë shpërblimin e njëqind martirëve*".[4]

Po, ndjekja e sunnetit të profetit Muhammed a.s.m. është më e çmueshmja, dhe sidomos kur sundojnë bidatet ndjekja e sunnetit profetik është më e vlefshmja dhe më sublimja; dhe në mënyrë të veçantë kur të jetë prishur ummeti i Muhammedit a.s.m., zbatimi dhe respektimi i një çështjeje të vogël të etikës së Sunnetit shpreh dhe nënkupton një besim të fuqishëm të rrënjosur dhe një përkushtim e frikë ndaj Allahut; sepse ndjekja drejtpërdrejtë e sunnetit të pastër, të sjell ndërmend pejgamberin më të madh a.s.m. dhe, kjo kujtesë a përmendje që buron nga ajo ndjekje e sunnetit transformohet në sjellje ndërmend të Pranisë Hyjnore; madje në çastet në të cilat zbatohet sunneti Profetik në më të thjeshtën e trajtimeve në etikën e të ngrënit, të pirjes ose të gjumit, akte të tilla natyrale e të zakonshme bëhen akte të lavdërueshme adhurimi -ibadeti- në përputhje me sheriatin, sepse nëpërmjet akteve të tilla të zakonshme njeriu mendon për ndjekjen e profetit Muhammed a.s.m. dhe përfytyron se ai po kryen një nga etikat e sheriatit. Pastaj ai kujton se profeti Muhammed a.s.m. është pronari i Sheriatit; dhe prej kësaj, zemra e tij kthehet e orientohet drejt Ligjvënësit të Vërtetë që është Allahu i Gjithëfuqishëm dhe kështu fiton një ndijim të Pranisë Hyjnore dhe një lloj ibadeti.

[3] Kur'an, 3:31

[4] Transmetojnë Ibn Adij e Tabarani

Dhe kështu, për shkak të këtij misteri, ai që e bën ndjekjen e sunnetit të profetit si zakonin e vet ai i ka transformuar adetet e tij në ibadete (zakonet e tij në akte adhurimi) dhe ai mund ta bëjë të gjithë jetën e tij të frutshme dhe të fitojë shpërblim.

● **Pika e Dytë**

Imam Rabbani, Ahmed Faruku, Zoti e mëshiroftë, tha:

"Ndërsa isha duke kaluar shkallët në udhëtimin tim shpirtëror, unë pashë se më i shndritshmi, më i shkëlqyeri, më i holli, më i larti, më i shëndoshi dhe më i sigurti midis niveleve të Evlijave ishte ai i atyre që e kanë marrë ndjekjen e sunnetit si bazën për tarikatin e tyre; madje edhe Evlijatë e zakonshëm të atij niveli shfaqen të jenë më të shndritshëm se sa Evlijatë më të lartë të niveleve të tjerë".

Po, Imam Rabbani, ripërtëritësi i mijëvjeçarit të dytë, flet të drejtën. Ai që e merr sunnetin e profetit si bazë ngjitet tek stacioni i të qënit i dashuri i Zotit xh.sh. nën hijen e të Dashurit të Zotit.

● **Pika e Tretë**

Në kohën kur ky Said i varfër para Allahut po përpiqej të dilte nga gjendja e Saidit të vjetër, mendja dhe zemra e tij po përpëliteshin e rrokulliseshin brenda të vërtetave në një stuhi të tmerrshme shpirtërore që shkaktohej nga mungesa e një udhëzuesi dhe për shkak të mburrjes së nefsit urdhërues për të liga. Ato hidheshin e fluturonin, njëherë duke u ngritur lart dhe njëherë duke rënë; ndonjëherë binin nga plejadat në tokë dhe ndonjëherë ngjiteshin nga toka në plejada.

Ndërkaq unë pashë se çështjet e sunnetit të pastër profetik, madje edhe më e thjeshta e etikave të tij, secila prej tyre ishte si një tregues i shigjetës së busullës që tregon drejtimin e lëvizjes në anije; dhe secila prej tyre ishte si një çelës i një llambe elektrike që ndriçon midis rrugëve të panumërta të rrezikshme e të errëta.

Dhe ndërsa e shikoja veten time në atë udhëtim shpirtëror nën presionin e mërzitjes dhe të shqetësimeve të shumta dhe nën barët e peshave të mëdha, papritmas ndjeja e përjetoja një lehtësi sa herë që ndiqja çështjet e sunnetit të pastër profetik që lidheshin me ato gjendje,

sikur ato i mbanin të gjitha peshat e mia dhe sikur i hiqnin ato barë prej shpatullave të mia.

Nëpërmjet nënshtrimit tim të plotë ndaj sunnetit të pastër profetik, unë shpëtoja prej dyshimeve, ngurrimeve dhe vesveseve, iluzioneve të tilla, si: "A ka dobi në këtë veprim? Jam kureshtar të di, a është i drejtë një veprim i tillë?"

Sa herë që e tërhiqja prapa dorën time prej sunnetit profetik, valët e shqetësimeve shtoheshin dhe intensifikoheshin më shumë dhe presioni ishte më i madh. Kishte rrugë të shumta, por nuk dihej se ku të çonin ato; peshat ishin shumë të rënda.. unë isha krejtësisht i pafuqishëm, shikimi im ishte shumë i shkurtër dhe rruga ishte e errët.

Sa herë që kapesha pas sunnetit, rruga ndriçohej para meje dhe shfaqej se ajo ishte një rrugë e sigurtë, e shëndoshë dhe pa rreziqe, peshat lehtësoheshin dhe pengesat hiqeshin.

Po, kështu në atë periudhë kohe unë vërtetova nëpërmjet vëzhgimeve të mia atë çfarë tha Imam Rabbani.

● **Pika e Katërt**

Një herë më mposhti një gjendje shpirtërore e cila buroi nga shqyrtimi i çështjes së 'lidhjes së vdekjes' dhe nga besimi në çështjen اَلْمَوْتُ حَقٌّ 'vdekja është një realitet' dhe nga meditimi lidhur me përkohshmërinë dhe kalimin e dynjasë.

E pashë veten time në një botë të çuditshme. Hodha vështrimin dhe e pashë veten time si një kufomë duke qëndruar në krye të tre kufomave të rëndësishme e të mëdhaja.

E Para: Unë isha si një gur varri në krye të kufomës jolëndore të të gjitha krijesave të gjalla me të cilat isha i lidhur nëpërmjet jetës sime dhe të cilat kishin hyrë në varrin e së shkuarës.

E Dyta: Një kufomë e madhe që përmbante e mbulonte të gjitha llojet e gjallesave me të cilat njerëzimi është i lidhur nëpërmjet jetës së tij që kishin vdekur e ishin varrosur në varrin e së shkuarës i cili përfshinte globin tokësor; unë isha vetëm se një pikë që do të fshihej

shpejt dhe një mizë e vogël që do të vdiste shpejt në fytyrën e këtij shekulli i cili është guri i varrit të asaj kufome.

E Treta: Kufoma gjigante që do ta mbështjellë këtë univers në Ditën e Kijametit, dhe meqenëse universi me siguri do të vdesë në atë Ditë, kjo u bë në shikimin tim sikur po ndodh tani.

Ndërkohë më mori çudia dhe u habita nga tmerri i agonive të vdekjes së asaj kufome gjigante. Edhe vdekja ime gjithashtu, e cila me siguri do të ndodhte në të ardhmen, m'u shfaq sikur po ndodhte tani. Ashtu siç erdhi në vërsetin Kur'anor,

فَإِنْ تَوَلَّوْا *"Por nëse ata kthejnë kurrizin..."* të gjitha qëniet dhe të gjithë të dashurit më kthyen kurrizin dhe kaluan duke më braktisur e duke më lënë të vetmuar. Unë ndjeva se sikur shpirti im po shtyhej drejt së ardhmes që shtrihej drejt paspërjetësisë, e cila kishte marrë formën e një oqeani madhështor të pakufishëm, pa brigje me dëshirë apo pa dëshirë, nefsi duhej të hidhej në atë oqean të madh.

Dhe kështu, ndërsa isha në gjendjen më të çuditshme e të trishtueshme të mendjes dhe të shpirtit, befas më erdhi ndihmë nga Kur'ani i Gjithurtë dhe nga imani. Vërseti

فَإِنْ تَوَلَّوْا فَقُلْ حَسْبِيَ اللَّهُ لَا إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَهُوَ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ

"*Por nëse ata kthejnë kurrizin, atëherë thuaju (o Muhammed a.s.m.) "Allahu është më se i mjaftueshëm për mua. Nuk ka Zot tjetër përveç Atij. Tek Ai unë mbështetem plotësisht dhe Ai është Zoti i Arshit Madhështor"* më erdhi në ndihmë dhe u bë si një anije e sigurt dhe e besuar. Shpirti im hyri i sigurt dhe i qetë në mbrojtjen dhe në vendstrehimin e këtij vërseti të gjithurtë. Ndërkaq unë kuptova se përveç kuptimit të qartë të vërsetit, një kuptim aludues më ngushëlloi aq shumë saqë unë kisha gjetur qetësinë dhe paqen.

Po, kuptimi i qartë i vërsetit i thotë profetit më të nderuar a.s.m. "Në qoftë se njerëzit e çudhëzimit largohen, i shmangen sheriatit dhe sunnetit tënd dhe nuk i kushtojnë vëmendje Kur'anit, mos u shqetëso e mos u dëshpëro. Thuaju: Allahu i Gjithëfuqishëm është më se i

mjaftueshëm për mua. Unë e vendos besimin tim tek Ai. Ai do të bëjë të tjerë në vendin tuaj të cilët do të më ndjekin mua. Froni Madhështor i Sundimit të Tij, rrethon gjithçka. Të pabindurit, rebelët nuk mund të ikin prej Tij, as ata që i kërkojnë ndihmë nuk mbeten pa mbështetje e pa ndihmë prej Tij".

Ndërsa kuptimi aludues i vërsetit thotë këtë:

"O njeri! O ti që ke marrë përsipër udhëheqjen dhe drejtimin e njeriut. Në qoftë se të gjitha qëniet të lënë ty dhe largohen për në mosekzistencë në rrugën e përkohshme; në qoftë se të gjitha qëniet e gjalla ndahen prej teje dhe shpejtojnë poshtë rrugës së vdekjes; në qoftë se njerëzit të braktisin dhe futen në varreza... në qoftë se njerëzit e neglizhencës dhe të çudhëzimit nuk ta vënë veshin ty dhe bien në errësirë, mos u mërzit.

Thuaj: Allahu vetëm më mjafton. Meqenëse Ai ekziston, gjithçka ekziston... Dhe kështu, ata që janë larguar, nuk kanë shkuar në mosekzistencë;

Ata janë larguar për tek një mbretëri tjetër e Krijuesit të Arshit Madhështor. Nga bujaria e Tij e pafundme dhe prej ushtarëve të Tij të panumërt, Ai Pronar i Fronit më të lartë do të dërgojë ushtarë të tjerë në vend të tyre; Dhe ata që kanë hyrë në varreza, nuk janë asgjësuar; ata janë larguar për tek një botë tjetër. Ai do të dërgojë nëpunës të tjerë në vend të tyre. Dhe Ai mund të dërgojë shërbëtorë të bindur që të ndjekin rrugën e vërtetë në vend të atyre që bien në çudhëzim.

Meqenëse është kështu, atëherë Ai merr vendin e gjithçkaje; Ai është Garanti, Siguruesi. Të gjitha gjërat mund ta marrin shikimin dhe vëmendjen e Tij.

Dhe kështu, nëpërmjet këtij kuptimi aludues, të trija kufomat e tmerrshme, të cilat më mbushën me panik, morën një formë tjetër prej formave të bukurisë dhe familjaritetit, sa vijon:

Qëniet luhaten duke ardhur e duke shkuar në një largësi të madhe, duke përfunduar shërbime të vazhdueshme, duke u ngarkuar me detyra që ripërtërihen vazhdimisht, nëpërmjet një udhëtimi që shpreh urtësi, një ekskursioni instruktiv, një shëtitje për përmbushjen e detyrave në hijen e administrimit të të Gjithurtit, Mëshirëplotit, të Drejtit, të

Gjithëfuqishmit të Gjithëlavdishëm dhe, brenda Hyjnisë së Tij Madhështore, Urtësisë së Tij të thellë dhe Mëshirës së Tij të gjërë.

● **Pika e Pestë**

Vërseti i lartë, قُلْ إِن كُنتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ

Thuaj (o Muhammed a.s.m.) "Nëse vërtet e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, Allahu do t'ju dojë ju..." shpall në mënyrë të sigurt se sa e domosdoshme dhe e rëndësishme është ndjekja e sunnetit të Profetit Muhammed a.s.m..

Po, midis silogjizmave logjike -arsyetimeve deduktive- ky vërset është më i fuqishmi dhe më i sigurti i llojit të quajtur silogjizmi hipotetik ose kushtor. Kjo është siç vijon:

Si një shembull i silogjizmit hipotetik thuhet në logjikë: "Në qoftë se del, shfaqet dielli, atëherë do të jetë ditë". Për një rezultat pozitiv thuhet: "Dielli ka dalë, është shfaqur". Atëherë kjo tregon konkluzionin se "tani është ditë". Për një rezultat negativ, thuhet: "Nuk është ditë. Atëherë njeriu nxjerr si përfundim se dielli nuk ka lindur, nuk ka dalë". Sipas logjikës, këto dy përfundime, negativja dhe pozitivja, janë të sigurta, të prera.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, vërseti i lartëpërmendur thotë: "Në qoftë se ju e doni Allahun, ju duhet ta ndiqni të dashurin e Allahut". Në qoftë se ju nuk e ndiqni atë, kjo nxjerr si përfundim se ju nuk e doni Allahun. "Në qoftë se një njeri e do Allahun, kjo do të lindte si pasojë, do të shkaktonte si rezultat, ndjekjen e sunnetit të të dashurit të Allahut".

Po, Ai që beson në Allahun, sigurisht që do t'i bindet Atij. Nuk ka dyshim se rruga më e shkurtër për tek Ai, më e pranueshmja tek Ai dhe më e drejta -midis rrugëve të bindjes të cilat të çojnë tek Ai- është rruga të cilën e tregoi dhe e ndoqi i dashuri i Allahut.

Po, Gjithëbujari Hirplot i Cili e mbushi këtë univers me kaq shumë mirësi e dhurata, në mënyrë të vetëkuptueshme, madje të domosdoshme, do të kërkonte falënderime prej qënieve të vetëdijshme kundrejt atyre mirësive.

Dhe i Gjithurti i Gjithëlavdishëm i Cili e stolisi këtë univers me kaq shumë mrekulli të artit të Tij, në mënyrë të vetëkuptueshme do ta bënte atë që është i zgjedhur e i dalluar midis krijesave të vetëdijshme personin që do të merrte adresimin prej Tij, -do ta bënte- interpretues të urdhërave të Tij, lajmëtar për robët e Tij dhe imam për ta.

Dhe Hirploti Zotërues i Plotësisë i Cili e bëri këtë univers të reflektojë manifestimet e panumërta të bukurisë dhe të plotësimeve të Tij, në mënyrë të vetëkuptueshme do t'i jepte atij që është modeli më gjithëpërfshirës i mrekullive të artit të Tij, masa dhe mjeti më i plotë për të shfaqur Bukurinë e Tij, Plotësinë, Emrat e Bukur Hyjnorë dhe artin, të cilat Ai, në mënyrë të qartë, i do dhe dëshiron t'i shfaqë; sigurisht do t'i jepte atij gjendjen më të plotë të adhurimit duke e bërë atë një model, shembull të mirë për të tjerët dhe duke i nxitur të tjerët që ta duan me qëllim që sjellja e tij e hollë dhe e bukur të mund të shfaqet edhe tek të tjerët gjithashtu.

Shkurtazi: Dashuria ndaj Allahut bën të domosdoshme rezultatet në ndjekjen e Sunnetit të pastër Profetik. Myzhde dhe sa fatlum është ai person pjesa e të cilit në ndjekjen e Sunnetit është e madhe! Dhe mjerë ai njeri që nuk e vlerëson sunnetin siç duhet dhe zhytet në bidate.

● **Pika e Gjashtë**

Profeti Muhammed a.s.m. ka thënë:

كُلُّ بِدْعَةٍ ضَلَالَةٌ وَكُلُّ ضَلَالَةٍ فِي النَّارِ *"Çdo bidat është çudhëzim dhe çdo çudhëzim të çon në Ferr"* [5]

Domethënë sipas vërsetit, اَلْيَوْمَ اَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ *"Këtë ditë Unë e përsosa (plotësova) për ju fenë tuaj",*[6] të mos i miratosh ato rregulla të Sheriatit të shquar dhe ato parime të sunnetit të pastër profetik pasi ato janë plotësuar e përsosur dhe, të adaptosh mënyra e shpikje të reja ose të krijosh -Ruajna Zot- bidate, risi të cilat nënkuptojnë vlerësimin e atyre rregullave si të mangëta, kjo do të ishte një çudhëzim, vendi i të cilit është vetëm Zjarri. Sunneti i pastër Profetik ka shkallë:

[5] Transmetoi Muslimi
[6] Kur'an, 5:3

Një pjesë prej sunnetit është *Vaxhib -i detyrueshëm*: pjesa që është *Vaxhib* nuk mund të lihet. Ky lloj sunneti është përshkruar në mënyrë të hollësishme në Sheriatin e shquar. *Vaxhibet* janë të pakundërshtueshëm dhe në asnjë mënyrë nuk mund të ndryshohen.

Një pjesë tjetër e sunnetit është prej llojit të *Nafileve -i vullnetshëm, i padetyrueshëm*. Kjo pjesë me rolin e saj është dy llojesh:

Njëri lloj janë sunnetet që lidhen me ibadetet -adhurimin; edhe këto gjithashtu janë përshkruar në librat e Sheriatit dhe, ndryshimi i këtyre suneteve është bidat, risi.

Ndërsa lloji tjetër quhet *Adab -etika, sjellja-* dhe është përmendur në librat e biografisë së Profetit a.s.m.. Kundërshtimi i këtij lloji nuk quhet bidat, por ama ai është kundërshtim ndaj një lloji të etikës dhe mënyrës së Profetit duke mos përfituar nga drita e tyre dhe nga etika e vërtetë. Ky lloj është: Ndjekja e veprimeve të Profetit në aktet e zakonshme dhe të natyrshme dhe në sjelljet e trajtimet të cilat janë të njohura nëpërmjet raportimeve me unanimitet, me njëzëshmëri. Për shembull, ka sunnete të shumta të cilat tregojnë mënyrat e etikës së të folurit dhe shpjegojnë parimet e etikës së të ngrënit, të pirjes dhe të gjumit dhe ato që lidhen me marrëdhëniet shoqërore, bashkëshoqërore. Sunnetet e këtij lloji quhen *A'dab.* Ai që e ndjek këtë lloj sunneti i transformon aktet e tij të zakonshme në akte adhurimi, i shndërron adetet e tij në ibadete dhe merr shkëlqim prej dritës së asaj Etike Profetike.

Vënia në praktikë e aspektit më të vogël e më të thjeshtë të një etike të tillë të sjell ndërmend Profetin më të madh e më të nderuar a.s.m. dhe i jep një dritë zemrës.

Më të rëndësishmet midis sunneteve të Profetit a.s.m. janë ato sunnete të cilat janë shenjat e islamit dhe janë të lidhura me ritet, sepse ritet janë ibadet prej llojit të të drejtave të përgjithshme të cilat kanë të bëjnë me shoqërinë.

Ashtu si vënia në zbatim nga një individ që bën që i gjithë komuniteti të përfitojë, po ashtu braktisja e tyre e bën përgjegjës të gjithë komunitetin. Nuk mund të ketë hipokrizi në kryerjen e këtij lloji dhe ato duhet të shpallen. Madje edhe pse ato janë prej llojit të *nafileve*

-të vullnetshme, të padetyrueshme- përsëri ato janë më të rëndësishme se sa farzet individuale -aktet e detyrueshme personale.

● **Pika e Shtatë**

Sunneti i pastër Profetik në realitetin e vet është një etikë e madhe. Nuk ka ndonjë çështje midis tyre që të mos përfshijë brenda saj një etikë dhe një dritë të madhe. Profeti Muhammed foli të drejtën kur tha: أَدَّبَنِي رَبِّي فَأَحْسَنَ تَأْدِيبِي "*Krijuesi im më mësoi mua sjellje të mirë dhe sa mirë më mësoi".*

Po, ai që e studion biografinë e Profetit dhe e njeh sunnetin e tij, sigurisht ai do të kuptojë se Allahu i Plotëfuqishëm i ka grumbulluar së bashku të gjitha parimet dhe rregullat e mirësjelljes dhe të etikës së bukur. Ai që braktis sunnetin e tij të pastër dhe e kundërshton, sigurisht ka braktisur burimet e etikës dhe parimet e saj; ai do ta privonte vetveten nga një mirësi e madhe, do të mbetej i privuar prej mirësisë së Krijuesit Gjithëbujar dhe do të ishte i pasjellshëm, i panjerëzishëm në një mënyrë që do t'i shkaktonte atij humbje. Për të do të bëhej realitet rregulli, بِأَدَبْ مَحْرُومْ بَاشَدْ أَزْ لُطْفِ رَبْ "njeriu i pasjellshëm privohet nga mirësia Hyjnore".

***Pyetje*:** Si mund të kemi etikë me Krijuesin, Njohësin e të gjitha gjërave, i Cili shikon e njeh gjithçka dhe prej të Cilit nuk mund të fshihet asgjë, meqë ndodhen situata që e bëjnë njeriun të ndjehet me turp ose të zihet ngushtë dhe nuk mund të fshihen prej Tij xh.sh..

Ndërsa një lloj i etikës, është mbulimi i gjymtyrëve të domosdoshme dhe mbulimi i gjendjeve që janë të pakëndshme e të papëlqyeshme; mirëpo asgjë nuk mund të fshihet nga shikimi i Njohësit të të gjitha gjërave?

Përgjigjja

Së pari: Ashtu si Krijuesi i Gjithëlavdishëm që e shfaq artin e Tij në mënyrë të bukur në shikimin e krijesave të Tij, i mbulon gjërat e urryera e të papëlqyeshme dhe i stolis dhe i zbukuron mirësitë e Tij me qëllim që të tërheqë e t'i mallëngjejë shikimet, po ashtu Krijuesi kërkon nga krijesat dhe nga robët e Tij që të shfaqen para qënieve të

vetëdijshme në formën e tyre më të bukur, më të hijshme e më të këndshme, sepse shfaqja e tyre para krijesave në gjendje të shëmtuara, të urryera e të papëlqyeshme, do të ishte në kundërshtim me Etikën e bukur, dhe do të ishte një lloj rebelemi ndaj shenjtërisë së Emrave të bukur Hyjnorë, të tillë, si: ***El-Xhemilu, El-Muzejjinu, El-Letifu, El-Hakimu,*** *i Bukuri (Hirploti). Zbukuruesi, i Holli (i Këndshmi)* dhe i *Gjithurti*. Dhe kështu etika që është në sunnetin e pastër profetik është të marrësh një mënyrë të etikës së pastër që të jetë brenda caqeve të Emrave të bukur Hyjnorë të Krijuesit të Gjithëlavdishëm.

Së Dyti: Doktori mund të shikojë e të konrollojë gjymtyrën më private të dikujt i cili me kanun është i huaj për të, dhe këtë veprim e bën nga këndvështrimi i mjekësisë dhe i shërimit; madje, në raste të domosdoshme, ai ia zbulon ato pjesë private dhe ky veprim nuk mund të konsiderohet të jetë në kundërshtim me etikën, por konsiderohet të jetë prej kërkesave të mjekësisë. Por ama pikërisht atij doktori nuk i lejohet t'i shikojë ato vende të ndaluara si një burrë apo nën titullin e predikuesit ose të mësuesit; etika nuk e lejon absolutisht që ato t'i shfaqen atij nëpërmjet atyre titujve apo cilësive; kjo do të konsiderohej si mungesë e ndjesisë së turpit.

"*Dhe Allahut i takon krahasimi më i lartë*", Allahu i Gjithëlavdishëm ka Emra të bukur të shumtë dhe, secili Emër ka një manifestim të ndryshëm. Për shembull, ashtu siç kërkon Emri ***El-Gaffar,*** *Fajfalësi* ekzistencën e gjynaheve dhe Emri ***Es-Settar,*** *Mbuluesi* ekzistencën e mangësive, të metave, po ashtu, Emri ***El-Xhemil,*** *i Bukuri, Hirploti* nuk dëshiron të shohë shëmti. Dhe Emrat që i përkasin bukurisë dhe Plotësisë Hyjnore të tillë, si: ***El-Letifu, El-Kerimu, El-Hakimu, Er-Rahimu***, *i Këndshmi (i Holli), Gjithëbujari, i Gjithurti* dhe *Mëshirëploti* kërkojnë që qëniet të jenë në formën më të bukur dhe në situatat më të mira të mundshme. Ato Emra Hyjnorë, që i përkasin bukurisë dhe plotësimit, kërkojnë shfaqjen e bukurisë së tyre nëpërmjet situatave të bukura të krijesave dhe nëpërmjet etikës së bukur të tyre.

Kështu, mënyrat e etikës që i përmban sunneti i pastër janë shenjat e kësaj etike të lartë dhe aluzione për parimet dhe shembujt e tij.

● **Pika e Tetë**

Vërseti Kur'anor, لَقَدْ جَآءَكُمْ رَسُولٌ

"*Vërtet që ju ka ardhur juve një i dërguar (Muhammedi a.s.m.) nga vetë ju (të cilin ju e njihni fare mirë)...* (deri në fund), tregon mëshirën dhe dhembshurinë e plotë të Profetit Muhammed a.s.m. ndaj ummetit të tij.

Ndërsa vërseti tjetër që vijon më pas, فَإِنْ تَوَلَّوْا فَقُلْ حَسْبِيَ اللَّهُ *"Por nëse ata kthejnë kurrizin, atëherë thuaju: "Allahu është më se i mjaftueshëm për mua..."*, thotë:

O njerëz! O muslimanë! Ju duhet ta kuptoni se sa mungesë ndëgjegjje dhe sa mungesë arsyeje do të ishte largimi i juaj prej sunneteve të këtij Profeti të dhembshur e të mëshirshëm dhe prej dekreteve që ai përçoi; është sikur ju po shpifni mëshirën dhe dhembshurinë e tij të vëtëkuptueshme; sepse ai ju udhëzoi me dhembshurinë e tij të gjërë duke harxhuar të gjithë fuqinë e tij për interesin e dobinë tuaj dhe duke shëruar, me sunnetin e pastër dhe me dekretet që solli, plagët tuaja shpirtërore.

"Dhe o Profet i dashur, i dhembshur e i mëshirshëm! Në qoftë se këta nuk e njohin këtë dhembshurinë tënde të madhe për shkak të marrëzisë së tyre dhe, nuk do ta vlerësonin këtë mëshirën tënde të gjërë, të kthejnë ty kurrizin dhe nuk të dëgjojnë, mos u mërzit... Mos u shqetëso, sepse Krijuesi i Arshit Madhështor nën urdhrin e të Cilit janë ushtritë e qiejve dhe të tokës dhe sovraniteti i Hyjnisë së të Cilit sundon Arshin Madhështor që rrethon gjithçka, sigurisht është më se i mjaftueshëm për ty. Ai do të grumbullojë rreth teje trupat e Tij të vërtetë e të bindur dhe do t'i bëjë ato të të dëgjojnë dhe t'i pranojnë dekretet e tua!"

Po, nuk ka ndonjë çështje në Sheriatin e Profetit a.s.m. që të mos ketë shembuj të shumtë urtësie. Edhe unë i varfëri e pretendoj këtë dhe jam gati që ta provoj këtë pretendim, pavarësisht pafuqisë dhe mangësive të mia. Për më tepër, shtatëdhjetë deri në tetëdhjetë trajtesat e Risale-i Nurit që janë shkruar deri tani janë dëshmitarë të vërtetë që dëshmojnë se sa me plot urtësi e të vërteta janë Çështjet e Sunnetit të Profetit Muhammed dhe të Sheriatit të Tij a.s.m..

Në qoftë se do të ishte e mundur dhe të shkruhej kjo temë, nuk do të mjaftonin shtatëdhjetë trajtesa, dhe as shtatëmijë të tilla për t'i përshkruar plotësisht ato shembuj urtësie.

Për më tepër, unë kam parë, kam përjetuar e provuar ndoshta një mijë herë në veten time se parimet e çështjeve të Sheriatit dhe të sunnetit të pastër Profetik janë ilaçi më i mirë e më i dobishëm për sëmundjet shpirtërore, mendore dhe kardiale -të zemrës- dhe veçanërisht për sëmundjet shoqërore. Dhe unë shpall nëpërmjet këtyre që kam parë dhe që kam përjetuar, dhe ua kam bërë të njohur të tjerëve deri në një farë shkalle në Risale-i Nur se, "çështjet e parashtruara nga filozofia nuk mund ta zënë kurrë vendin e tyre".

Ata që dyshojnë nga ky pretendimi im le t'u referohen pjesëve të Risale-i Nurit. Nga kjo mund të shikohet se sa e leverdisshme e fitimprurëse është përpjekja për të ndjekur, sa të jetë e mundur, sunnetin e këtij personaliteti të bekuar, sa e volitshme për lumturinë e jetës së amshuar dhe sa e dobishme për jetën e dynjasë.

● **Pika e Nëntë**

Ndoshta nuk do ta kishte të lehtë dhe të mundur ndjekjen në mënyrë praktike të plotë të çdo lloji prej llojeve të sunnetit të pastër veçse supërelita, më të zgjedhurit e njerëzve.

Por në qoftë se është e pamundur ndjekja e sunneteve në praktikë, gjithësecili ka mundësi ta përmbushë këtë ndjekje sunneti nëpërmjet nijetit -qëllimit- synimit, dëshirës për t'i zbatuar dhe duke i pranuar ato. Është e njohur se duhet të ndiqen llojet e farzeve dhe të vaxhibit.

Ndërsa sunnetet që janë të llojit *Mustehabb* -të pëlqyeshme- në ibadet, edhe në qoftë se lënia e tyre dhe neglizhenca ndaj tyre nuk përbëjnë mëkat, por ama kjo do të ishte një humbje për të marrë një thevab të madh; dhe në qoftë se ato ndryshohen, ky do të ishte një gabim i madh.

Kurse sunnetet profetike në *Adete* -veprime të zakonshme- dhe në *Muamelat* -trajtime, në qoftë se do të ndiqeshin, atëherë këto e bëjnë adetin ibadet, pra aktet e zakonshme i transformojnë në akte adhurimi, pavarësisht se nuk qortohet ai që i braktis akte të këtilla, por ama përfitimi i tij pakësohet e zvogëlohet prej dritës së Etikave jetësore të të Dashurit të Allahut".

Ndërsa *bidatet* -risitë, janë krijimi i gjërave të reja në dekretet që lidhen me adhurimin; ato bidate refuzohen, hidhen poshtë sepse

kundërshtojnë vërsetin Kur'anor. اَلْيَوْمَ اَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ *"Këtë ditë Unë përsosa (plotësova) për ju fenë tuaj..."*.[7]

Por në qoftë se ato gjëra të reja janë prej llojit të *virdeve, dhikrit* dhe të mënyrave si ato të tarikateve të sufizmit, ato nuk janë bidate me kusht që origjinat e tyre të jenë prej Librit -Kur'anit- dhe Sunnetit, sepse edhe në qoftë se ato janë në forma e në mënyra të ndryshme, bazat dhe parimet e tyre nuk i kundërshtojnë sunnetet e Profetit a.s.m. dhe as nuk i ndryshojnë. Pavarësisht kësaj, disa dijetarë i klasifikuan disa prej këtyre çështjeve si bidate por i quajtën ato "Bidate të lavdërueshme". Mirëpo, Imam Rabbani thotë:

"Në udhëtimin tim shpirtëror, Unë pashë se fjalët e transmetuara prej Profetit më të madh a.s.m. ishin vezulluese dhe të ndriçuara me rrezet e sunnetit të tij të pastër. Ndërsa kur pashë virdet e mëdhaja dhe gjendjet e ndritshme që nuk ishin transmetuar prej tij, tek ato nuk ishte ajo dritë dhe ai shkëlqim.

Më e ndritshmja e këtij lloji të fundit, nuk ishte i barabartë me më të vogëlën e llojit të parë, sunnetit. Unë kuptova nga kjo se rrezet e Sunnetit të pastër ishin një elikzir.

Gjthashtu sunneti i pastër është i mjaftueshëm për ata që kërkojnë dritë; nuk ka nevojë të kërkosh dritë jashtë sunnetit".

Ky pohim i një heroi të tillë të realitetit dhe të sheriatit na tregon se sunneti i pastër është guri themeltar i lumturisë së të dyja botëve dhe burimi i të gjitha arritjeve, i plotësisë dhe i mirësisë.

اَللّٰهُمَّ ارْزُقْنَا اِتِّبَاعَ السُّنَّةِ السَّنِيَّةِ

رَبَّنَا آمَنَّا بِمَا اَنْزَلْتَ وَاتَّبَعْنَا الرَّسُولَ فَاكْتُبْنَا مَعَ الشَّاهِدِينَ

O Zot! Na dhuro aftësi për të ndjekur sunnetin e Profetit Muhammed a.s.m.

[7] Kur'an, 5:3

"Zoti ynë! Ne besojmë në atë çfarë Ti na ke dërguar dhe ndejkim të Dërguarin Tënd;

Na shkruaj pra prej dëshmuesve (të së vërtetës)".[8]

● **Pika e Dhjetë**

Në vërsetin, Thuaj: قُلْ إِن كُنتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ

"Nëse vërtetë e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, Allahu do t'ju dojë ju..." është një thukëti e mrekullueshme stili, sepse shumë fraza janë përfshirë në këto tri fraza. Kjo është siç vijon: Vërseti thotë: "Në qoftë se ju besoni në Zotin, sigurisht që ju e doni Atë. Meqenëse ju e doni Zotin, atëherë ju do të veproni në përputhje me mënyrën që Ai e pëlqen. Për ta bërë këtë, ju duhet t'i ngjasoni atij të cilin e do Zoti. Dhe përngjasimi juaj me të dashurin e Tij është vetëm se nëpërmjet ndjekjes së tij.

Sa herë që ju do ta ndiqni atë, Allahu do t'ju dojë ju gjithashtu. Dihet se ju e doni Allahun me qëllim që Ai t'ju dojë ju".

Këto fraza formojnë vetëm një kuptim të shkurtër e të përmbledhur të vërsetit. Kjo do të thotë se qëllimi më i lartë për njeriun është që të bëhet i merituesheëm për dashurinë e Allahut. Vërseti na tregon se rruga për të arritur këtë qëllim të lartë është nëpërmjet ndjekjes së të "Dashurit të Zotit xh.sh. dhe vënies në praktikë të sunnetit të pastër. Në qoftë se në këtë stacion provohen tre pika, e vërteta e lartëpërmendur do të bëhej krejtësisht e qartë.

***Pika e Parë*:** Njeriu u krijua me një dashuri të pafundme për Krijuesin e Universit; sepse e përfshirë në natyrën njerëzore është dashuria për bukurinë, adhurimi për plotësinë dhe joshja pas mirëbërësisë. Ajo dashuri shtohet në përputhje me shkallët e bukurisë, plotësisë dhe të mirëbërësisë derisa arrin në më të skajshmen e shkallëve të dashurisë.

Po, e përfshirë në zemrën e vogël të këtij njeriu të vogël mund të jetë një dashuri aq e madhe sa universi.

[8] Kur'an, 3:53

Po, fakti që shkrimet e barasvlershme me një librari që ka mijëra libra mund të shkruhen e depozitohen në aftësinë e kujtesës, e cila është sa një kokërr thjerrëze, tregon se zemra e njeriut mund ta përfshijë universin dhe mund të mbajë dashuri po aq të madhe sa universi.

Meqenëse natyra njerëzore ka një kapacitet të tillë të pakuptueshëm për dashuri ndaj mirëbërësisë, bukurisë dhe plotësisë; dhe meqenëse Krijuesi i universit zotëron një bukuri të shenjtë të pafundme, ekzistenca e sigurt e së cilës në mënyrë të vetëkuptueshme vërtetohet nga veprat e Tij që shihen qartë në univers; dhe meqenëse Ai zotëron një plotësi të shenjtë të pakufishme, ekzistenca e së cilës në mënyrë të domosdoshme provohet nga qëndisjet e artit të Tij që është i dukshëm në qëniet; dhe meqenëse Ai ka një mirëbërësi të pakufishme, ekzistenca e së cilës vërtetohet në mënyrë të sigurt, e cila mund të preket dhe të shikohet brenda mirësive të Tij të dukshme në të gjitha llojet e gjallesave, atëherë sigurisht Ai kërkon dashuri të pakufishme prej njeriut i cili është më gjithëpërfshirësi i qënieve të vetëdijshme në cilësi, më i nevojshmi i tyre, më i madhi i tyre në reflektim dhe më i mallëngjyeri i tyre për Të.

Po, ashtu si çdo njeri që ka një aftësi të pakufishme dashurie ndaj Krijuesit të Gjithëlavdishëm, po ashtu Krijuesi xh.sh. është i denjë dhe më i merituesHëm se çdokush tjetër për t'u dashur për hir të bukurisë së Tij, të plotësisë dhe të mirëbërësisë. Të gjitha shumëllojshmëritë dhe shkallët e saj në zemrën e njeriut besimtar për ata me të cilët ka lidhje të caktuara, të veçanta, dhe sidomos dashuria që është në zemrën e tij për jetën e tij, për pavdekshmërinë, për ekzistencën, për veten dhe për qëniet e tjera, janë vetëm pikëla prej kapacitetit të tij për të dashur Zotin.

Madje edhe llojet e emocioneve të thella -tek njeriu- janë transformimet e atij kapaciteti të tij për dashuri dhe distilimet e tij në forma të tjera.

Dihet se njeriu ashtu siç kënaqet me lumturinë e tij vetjake, po ashtu kënaqet edhe me lumturinë e atyre me të cilët është i lidhur dhe që i do, dhe ashtu siç e do ai dikë i cili e shpëton nga fatkeqësia, po ashtu ai e do atë që i shpëton nga fatkeqësitë ata që ai i do.

Dhe kështu, si rrjedhojë e kësaj gjendjeje mendore, në qoftë se njeriu do ta mendonte vetë këtë prej të gjitha shumëllojshmërive të mirësive të mëdha Hyjnore që u janë dhuruar të gjithë njerëzve, ai do të mendonte sa vijon:

"Krijuesi im i Cili më shpëtoi mua nga errësirat e mosekzistencës së përhershme dhe i Cili më dha dhuratën e krijimit dhe të ekzistencës dhe që më dha një botë të bukur bukuria e së cilës më kënaq mua këtu në këtë tokë. Pastaj kur të më vijë koha e exhelit -çasti i vdekjes- Ai përsëri do të përkujdeset duke më ardhur në ndihmë dhe do të më shpëtojë gjithashtu nga errësirat e mosekzistencës së përjetshme dhe nga asgjësia e amshuar dhe, do të më japë mua -nga mirësia e bujarisë së Tij- një botë të përjetshme, të ndritshme e të lulëzuar në botën e përjetshmërisë në Ahiret... Dhe Ai do të më dhurojë mua shqisa dhe ndjenja të jashtme e të brendshme me anë të të cilave për të fituar nga të gjitha shumëllojshmëritë e kënaqësive dhe të gjërave të mira të saj dhe për të shëtitur midis llojeve të ëndjeve të asaj bote të bukur e të pastër.

Ashtu siç do t'i bëjë Ai të gjithë të afërmit dhe të gjithë të dashurit të llojit tim njerëzor të cilët i dua shumë dhe me të cilët jam i lidhur ngushtë, do t'i bëjë të merituesëm për këto mirësi e dhurata të pakufishme... këto mirësi janë gjithashtu të miat nga një aspekt -sepse unë jam i lumtur dhe gjej kënaqësi në lumturinë e tyre. Meqenëse tek çdo njeri është një dashuri e thellë dhe një joshje pas dhuratës, ashtu siç thuhet në proverbën اَلْإِنْسَانُ عَبِيدُ الْإِحْسَانِ "*Njeriu është skllavi i dhuratës, i mirëbërësisë"*, atëherë sigurisht njeriu para kësaj mirëbërësie të përjetshme të pakufishme do të thonte:

Në qoftë se do të kisha pasur një zemër aq të madhe sa universi, do të kërkoja që ajo të mbushej me dashuri e mallëngjim ndaj asaj mirëbërësie Hyjnore, dhe unë jam i përmalluar për ta mbushur, por pavarësisht se unë nuk jam në fakt në nivelin e asaj dashurie, veçse ama unë jam i denjë për të nëpërmjet kapacitetit dhe imanit, me nijet e me pranim, me vlerësim e përmallim dhe me përkushtim e me dëshirë.

Dhe kështu duhet të bëhet analogjia për dashurinë që shfaq njeriu ndaj 'bukurisë' dhe ndaj 'plotësisë' me krahasimin e dashurisë ndaj 'mirëbërësisë' për të cilën aluduam në mënyrë të shkurtuar.

Sa për mosbesimtarët, ata janë pafundësisht armiqësorë për shkak të mosbesimit të tyre dhe madje mbajnë një armiqësi të padrejtë dhe fyese ndaj universit dhe ndaj qënieve.

Pika e Dytë: Dashuria për Zotin bën të domosdoshme ndjekjen e sunnetit të pastër të Profetit Muhammed a.s.m., sepse ta duash Zotin, është të bësh atë gjë që e kënaq Zotin. Dhe gjërat që e kënaqin Atë janë manifestuar e shfaqur në formën më të plotë në personin e Muhammedit a.s.m.. Dhe përngjasimi me personalitetin e tij të bekuar në lëvizje dhe në vepra vjen nga dy aspekte:

I Pari: Aspekti i dashurisë së Zotit xh.sh. dhe bindja ndaj urdhërave të Tij, lëvizja brenda caqeve të asaj çfarë e kënaq Atë. Ky aspekt e kërkon atë ndjekje, sepse imami më i përsosur dhe modeli më shembullor në këtë çështje është Muhammedi a.s.m..

I Dyti: Aspekti i "Personalitetit të tij të bekuar" i Cili është ndërmjetësi më i lartë për favore e mirëbërësi Hyjnore të panumërta për njerëzimin. Atëherë ai është i denjë për dashuri të pakufishme për hir të Zotit dhe në rrugën e Tij.

Njeriu nga natyra dëshiron t'i përngjasojë dikujt të cilin e do aq sa të mundet; kjo sigurisht bën të domosdoshme se ata që e duan të Dashurin e Zotit xh.sh. duhet të përpiqen t'i përngjasojnë duke ndjekur sunnetin e tij të pastër.

Pika e Tretë: Allahu i Gjithëfuqishëm ashtu siç ka mëshirë të pafundme, po ashtu Ai ka edhe dashuri të pafundme. Dhe ashtu siç e do Ai Vetveten në mënyrë të pakufishme, po ashtu Ai i do edhe krijesat e Tij dhe sidomos qëniet e vetëdijshme të cilët i përgjigjen me dashuri e madhërim shfaqjes së dashurisë së Tij për ta. Mund të kuptohet qartë se sa qëllim i lartë e i rëndësishëm për njeriun është përpjekja për të tërhequr dashurinë e Një Qënieje, një manifestim i vetëm i mëshirës së të Cilit, janë të gjitha bukuritë, çudirat e Tij të holla, me gjërat e mira dhe me kënaqësitë e Parajsës.

Meqenëse siç u pohua qartë se dashuria për Zotin xh.sh. fitohet vetëm nëpërmjet ndjekjes së sunnetit të profetit Muhammed a.s.m., atëherë sigurisht që ndjekja e sunnetit duhet të jetë qëllimi më i madh i njeriut dhe detyra e tij më e rëndësishme.

● **Pika e Njëmbëdhjetë**

Kjo përbëhet nga tri çështje

Çështja e Parë:

Sunneti i Profetit më të nderuar a.s.m. ka tre burime, ato janë: fjalët e tij, veprat e tij dhe gjendjet -sjellja. Dhe ndodhen tre kategori prej secilës nga këto të trija:

Farzet -të detyrueshmet; *nafilet* -të vullnetshmet, të padetyrueshmet-; dhe *Adetet* e Profetit -të lavdërueshme. Është urdhëruese, domosdoshmëri të ndjekësh ato çështje që janë *Farze* dhe *Vaxhibe*. Besimtari është i detyruar për këtë ndjekje për shkak të besimit të tij. Të gjithë pa përjashtim janë të ngarkuar për të kryer farzin dhe vaxhibin. Ka dënime e ndëshkime për braktisjen e tyre dhe për neglizhencën ndaj tyre.

Sa për llojin e *nafileve*, njerëzit e besimit janë gjithashtu të ngarkuar për t'i kryer sipas urdhërit *Mustehabb* -të pëlqyeshme, por nuk ka dënime e ndëshkime në qoftë se lihen *nafilet*.

Megjithatë, ka një shpërblim të madh në të vepruarit në përputhje me to dhe me ndjekjen e tyre. Ndryshimi i *nafileve* është bidat, një çudhëzim dhe një gabim i madh. Ndërsa *Adetet*, aktet e zakonshme të Profetit a.s.m., t'i ndjekësh dhe t'i imitosh është shumë e lavdërueshme dhe në përputhje me urtësinë, dhe është e dobishme edhe për jetën personale, edhe për jetën shoqërore dhe për llojin njerëzor; sepse në të gjitha aktet e tij ka gjëra të shumta të dobishme për jetën dhe, për më tepër, nëpërmjet ndjekjes së tyre ato sjellje dhe ato adete bëhen si ibadete, akte adhurimi.

Po, meqenëse si miqtë po ashtu edhe armiqtë bien dakort se Personi i Muhammedit a.s.m. manifestoi shkallën më të lartë të virtyteve morale; dhe meqenëse siç janë pajtuar unanimisht në mendim, ai ishte individi më i shquar dhe më i shkëlqyer në llojin njerëzor; dhe meqenëse, ashtu siç përshkruhet nga mijëra mrekullitë e tij dhe siç dëshmohet nga bota e islamit të cilën ai e themeloi dhe nga arritjet e tij, dhe siç vërtetohet nga të vërtetat e Kur'anit të Gjithurtë për të cilat ai ishte lajmëtar dhe interpretues, ai ishte shembulli më i përkryer dhe udhëzuesi më i plotë... Dhe meqenëse me miliona prej njerëzve të

plotësimit u ngjitën në shkallët e plotësimeve dhe përparuan në to nëpërmjet frutave të ndjekjes së tij dhe arritën në lumturinë e të dyja botëve... atëherë sigurisht sunneti i këtij Profeti të nderuar a.s.m. dhe lëvizjet e Tij janë modeli më i mirë për t'u vënë në praktikë dhe udhëzuesi më i plotë për t'u ndjekur, dhe janë ligjet më të sigurta e të shëndosha për t'u marrë si parime. I lumtur është ai që pjesa e të cilit në këtë ndjekje të sunnetit të pastër është e madhe. Ndërsa ata që janë dembelë dhe nuk e ndjekin pësojnë humbje të mëdha; dhe ata që i konsiderojnë ato të jenë të parëndësishme, bëjnë një krim të madh. Ndërsa në qoftë se ata i kritikojnë ato, të cilat nënkuptojnë përgënjeshtrimin e tyre, janë në një çudhëzim të madh.

Çështja e Dytë

Allahu xh.sh. e përshkroi Profetin Muhammed a.s.m. në Kur'anin e gjithurtë me fjalët:

وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ *"Dhe Vërtet ti (Muhammed a.s.m.) je në një shkallë të lartë karakteri, morali[9]".* Sipas rrëfenjave të shëndosha, sahabët e nderuar e përshkruan atë siç e përshkroi Sahabeja e shquar Aisheja e vërtetë, Zoti qoftë i kënaqur me të, duke thënë:

"Morali i tij ishte Kur'ani"[10].

Domethënë, Profeti Muhammed a.s.m. është shembulli i cilësive të bukura morale të cilat i shpjegon Kur'ani. Profeti a.s.m. iu përshtat atyre cilësive më shumë se çdokush dhe, natyra e tij u krijua në përputhje me to".

Kështu, ndërsa veprat, gjendjet, fjalët dhe aktet e një personaliteti të tillë janë secila të denja për të qenë një model për njerëzimin, sa fatkëqinj do të ishin ata njerëz të pakujdesshëm të komunitetit të tij të cilët i besojnë atij por përsëri nuk i japin rëndësi Sunnetit të tij ose duan ta ndryshojnë, sa fatzinj janë ata!

Çështja e Tretë: Meqenëse Profeti Muhammed a.s.m. u krijua me karakterin më të moderuar dhe në formën më të përsosur, atëherë aktet,

[9] Kur'an, 68:4
[10] Transmeton Muslimi

lëvizjet dhe pushimi i tij, që të gjitha vepruan në përputhje me moderimin dhe drejtësinë. Biografia e tij tregon qartë se në të gjitha aktet e tij ai veproi me moderim dhe me drejtësi duke shmangur eksesin dhe neglizhencën, teprinë dhe mangësinë. Po, Profeti Muhammed a.s.m. iu përshtat plotësisht urdhrit Kur'anor,

فَاسْتَقِمْ كَمَآ أُمِرْتَ *"Qëndro pra drejt siç je urdhëruar"*.[11]

Dhe kështu moderimi është i dukshëm në të gjitha aktet e tij, në fjalët e në sjelljet. Për shembull, aftësia e tij e të menduarit veproi gjithmonë brenda urtësisë e cila është boshti i moderimit, i mezit të artë, duke qenë larg atyre që e prishin apo e ndrydhin atë, që janë tepria, kalimi i masës, dhe lënia mangët e saj, domethënë marrëzia dhe dredhia.

Fuqia e tij e zemërimit veproi gjithmonë brenda kurajos së shenjtë e cila është rruga e mesme dhe boshti i moderimit të asaj fuqie, duke qenë larg prej atyre gjërave që e prishin duke kaluar cakun dhe duke e lënë të mangët; pra nga zemërimi i madh dhe nga frika, burracakëria.

Fuqia e tij epshore, e pasionit, mori gjithmonë dëlirësinë - ndershmërinë- mjetin e moderimit të asaj fuqie, si udhëzues në shkallën më të lartë të virtytshmërisë, dhe qëndroi i pastër dhe larg prishjes së asaj fuqie nëpërmjet teprisë dhe lënies mangët. Domethënë, shthurjes morale dhe ftohjes seksuale.

Dhe kështu Profeti Muhammed a.s.m. zgjodhi rrugën e moderimit në të gjitha sunnetet e tij të pastërta, në të gjitha gjendjet e tij të natyrshme dhe në të gjitha dekretet e sheriatit dhe iu shmang plotësisht padrejtësisë dhe errësirës, domethënë, teprisë dhe lënies të mangët, harxhimit të tepërt dhe prishjes pa hesap. Ai e mori kursimin si udhëzuesin e tij duke iu shmangur përfundimisht teprisë, madje edhe në fjalën e tij, në ngrënien dhe në pirjen e tij.

Mijëra libra janë shkruar duke përshkruar detajet e këtyre të vërtetave.

[11] Kur'an, 11:112

Në përputhje me thënien اَلْعَارِفُ تَكْفِيهِ الْإِشَارَةُ "*Një shenjë është e mjaftueshme për të mençurin*", ne mjaftohemi me këtë pikë nga oqeani dhe e ndërpresim tregimin këtu.

اَللّٰهُمَّ صَلِّ عَلٰى جَامِعِ مَكَارِمِ الْاَخْلَاقِ وَمَظْهَرِ سِرِّ (وَاِنَّكَ لَعَلٰى خُلُقٍ
عَظِيمٍ) اَلَّذِى قَالَ : مَنْ تَمَسَّكَ بِسُنَّتِى عِنْدَ فَسَادِ اُمَّتِى فَلَهُ اَجْرُ مِاَةِ
شَهِيدٍ ۞ وَقَالُوا الْحَمْدُ لِلّٰهِ الَّذِى هَدٰينَا لِهٰذَا وَمَا كُنَّا لِنَهْتَدِىَ لَوْلَآ اَنْ
هَدٰينَا اللّٰهُ لَقَدْ جَآئَتْ رُسُلُ رَبِّنَا بِالْحَقِّ
سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَآ اِلَّا مَا عَلَّمْتَنَآ اِنَّكَ اَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

O Zot, jepi bekime atij që grumbulloi në personin e tij të gjitha cilësitë e bukura morale, dhe i cili manifestoi misterin e "*Dhe vërtet ti je në një shkallë të lartë karakteri, morali",* dhe i cili tha:

"Ai që kapet pas sunnetit tim në kohën kur të jetë prishur komuniteti im, do të marrë shpërblimin e njëqind martirëve".

"Ndërsa ata thonë: "Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun i Cili na udhëzoi ne për tek kjo (fatbardhësi); kurrë nuk do të ishim gjetur ne drejtim, po të mos na kishte udhëhequr Allahu. Vërtet që të Dërguarit e Zotit tonë erdhën me të vërtetën".[12]

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk mund të dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti". [13]

* * *

[12] Kur'an, 7:43
[13] Kur'an, 2:32

SHKREPTIMA E DYMBËDHJETË

[Kjo përbëhet nga shpjegimi i dy pikave të holla që i përkasin Kur'anit, të shkruara në lidhje me dy çështje të pjesshme të cilat i bëri pyetje Refet Bei]

بِاسْمِهِ سُبْحَانَهُ وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ

اَلسَّلَامُ عَلَيْكُمْ وَعَلَى إِخْوَانِكُمْ وَرَحْمَةُ اللهِ وَبَرَكَاتُهُ

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

"Dhe s'ka ndonjë gjë që të mos e lëvdojë Lartësinë e Tij".

Paqja qoftë mbi ju dhe mbi vëllezërit tuaj, si dhe mëshira e Allahut dhe bekimet!

Vëllai im i dashur e besnik, Re'fet bej![1]

Pyetjet e tua në këtë kohë të vështirë më vënë mua në një pozitë të vështirë, sepse dy pyetjet e tua këtë herë edhe në qoftë se janë të pjesshme, por meqenëse ato lidhen me dy pika të Kur'anit, dhe pyetja jote rreth globit tokësor duke prekur kritikat lidhur me Shtatë nivelet e tokës dhe të qiejve të bëra nga gjeografia dhe astronomia, u dukën për mua të rëndësishme.

Prandaj, ne do të shpjegojmë këtu në mënyrë shkencore e të përgjithshme dy pikat që lidhen me Kur'anin pavarësisht nga natyra e pjesshme e pyetjeve, dhe ti do të marrësh pjesën tënde prej atij shpjegimi lidhur me dy pyetjet e tua të pjesshme.

[1] Refet Barutçu, 1886 - 1975. Ai për herë të parë e vizitoi Bediuzzamanin në Barla më 1931, dhe pastaj u bë njëri nga studentët e tij më të afërt, të cilët morën mësim nga Said Nursi në Burgun e Eski Shehirit dhe të Denizlit. Ishte komandant në ushtri.

● **Pyetja e Parë**

Kjo përbëhet nga dy pika:

Pika e Parë: sipas vërsetit,

وَكَأَيِّن مِّن دَآبَّةٍ لَّا تَحْمِلُ رِزْقَهَا اللَّهُ يَرْزُقُهَا وَإِيَّاكُمْ ۚ
إِنَّ اللَّهَ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ

"Dhe sa shumë krijesa të gjalla nuk mbartin dot ushqimin e tyre! Allahu është i Cili i ushqen ata dhe ju".[2]

"Vërtet që Allahu, Ai është pa dyshim Gjithëfurnizuesi, Zotëruesi i Fuqisë, i Përhershmi më i Fuqishëm",[3] furnizimi është vetëm në Dorën e të Gjithëfuqishmit të Gjithëlavdishëm dhe vjen drejtpërdrejt nga thesari i mëshirës së Tij. Meqenëse furnizimi i të gjitha krijesave të gjalla është i garantuar nga Furnizuesi, atëherë nuk duhet që askush të vdesë nga uria. Mirëpo, duket se ata që vdesin nga uria, ose nga mungesa e ushqimit janë të shumtë. Ky fakt nga njëra anë dhe misteri nga ana tjetër, mund të zgjidhen siç vijon:

Garancia e Furnizuesit për të siguruar ushqimin është një realitet; askush nuk vdes nga mungesa e ushqimit, sepse ushqimin që e dërgon i Gjithurti i Madhështisë tek trupat e qënieve të gjalla, një pjesë prej tij ruhet si rezervë në formën e dhjamit dhe yndyrës së brendshme, madje Ai e ruan një pjesë të ushqimit të dërguar në qelizat e trupit, me qëllim që ta shpenzojë atë për domosdoshmëritë e trupit në ato raste kur nuk i vjen ushqim nga jashtë.

Atëherë, ata që vdesin, vdesin para se të harxhohet ky ushqim rezervë i depozituar. Domethënë, ajo vdekje nuk shkaktohet nga mosekzistenca e ushqimit, por nga ndonjë sëmundje që vjen nga braktisja e ndonjë zakoni të keq që e ka fituar nëpërmjet një zgjedhjeje të keqe.

Po, ushqimi natyral i ruajtur në trupat e qënieve të gjalla në formën e dhjamit apo të yndyrës përgjithësisht zgjat dhe vazhdon plotësisht për

[2] Kur'an, 29:60
[3] Kur'an, 51:58

dyzet ditë. Ai madje mund të vazhdojë sa dyfishi i atij numri ditësh si rezultat i ndonjë sëmundje ose i ndonjë gjendjeje të dalldisur shpirtërore. Para tridhjetë e nëntë vitesh u shkrua nëpër gazeta se nga kokëfortësia e skajshme një burrë në burg në Londër arriti të jetojë në mënyrë të shëndetshme për shtatëdhjetë ditë duke mos ngrënë asgjë fare.

Meqenëse ushqimi natyral vazhdon nga dyzet ditë deri në shtatëdhjetë ose tetëdhjetë ditë; dhe meqenëse manifestimi i Emrit Hyjnor ***Er-Rezzak****, Furnizuesi* është i dukshëm në faqen e tokës vërtet në shkallë të gjërë; dhe meqenëse ushqimet vërshojnë nga kraharorët dhe nga drurët në një mënyrë krejtësisht të paparashikuar; në qoftë se njeriu kaq shumë i mbushur me të keqe nuk ndërhyn me zgjedhjet e tij të gabuara dhe nuk i ngatërron gjërat, Ai Emër Hyjnor do t'u vinte në ndihmë qënieve të gjalla përpara se të harxhohej ushqimi natyral, duke parandaluar vdekjen nga uria. Prandaj, ata që vdesin nga uria para dyzet ditësh, ata sigurisht nuk vdesin nga mungesa e ushqimit, përkundrazi, sipas thënies: "Lënia e zakonit është një nga ato gjëra që janë fatale, vdekjeprurëse", ajo ndodh ose nga një zakon i keq ose nga një sëmundje që shkaktohet prej lënies së ndonjë zakoni. Atëherë, mund të thuhet se "Nuk ka vdekje nga uria".

Në të vërtetë, mund të shikohet qartë se ushqimi është në raport të kundërt me fuqinë dhe me vullnetin e lirë, me zgjedhjen. Për shembull, fëmija para se të lindë, duke qenë në mitër, nuk ka absolutisht as fuqi dhe as zgjedhje, por megjithatë ushqimi i jepet derisa të ngopet, madje duke mos qenë nevoja të lëvizë edhe buzët e tij.

Por kur vijnë në dynja, ata ende nuk kanë fuqi dhe zgjedhje; mirëpo meqenëse ai ka një lloj aftësie dhe shqisa të pazbuluara, ai ka nevojë vetëm për një lëvizje që të ngjisë gojën e tij tek kraharori, gjiri dhe burimet e kraharorit vërshojnë me ushqimin më të plotë, më ushqyes dhe që tretet më me lehtësi, në formën më të butë e në mënyrën më të çuditshme. Pastaj, ndërsa fëmijët fitojnë një sasi të vogël fuqie e zgjedhje, ai ushqim i disponueshëm lehtë, i gatshëm dhe i mirë fillon të tërhiqet prej tyre. Burimet e kraharorëve thahen dhe ushqimi i tyre dërgohet nga vende të tjera. Por meqenëse fuqia e tyre dhe zgjedhja janë të pamjaftueshme për ta kërkuar ushqimin, atëherë Furnizuesi Gjithëbujar i bën dhembshurinë dhe mëshirën e dy prindërve si ndihmues e mbështetës për ta. Sa herë që plotësohen fuqia dhe zgjedhja

e tyre, ushqimi i tyre nuk nxiton për tek ata dhe nuk shtyhet për të shkuar tek ata. Ushqimi qëndron në vendin e tij, duke thënë: "Eja, më kërko dhe më merr!" Domethënë, ushqimi është në raport të kundërt me fuqinë dhe zgjedhjen. Ne, në të vërtetë, kemi shpjeguar në shumë pjesë të Risale-i Nurit se kafshët që janë më në mungesë të fuqisë dhe të zgjedhjes ushqehen më mirë dhe jetojnë më mirë se sa ato me fuqi dhe me zgjedhje më të madhe.

Pika e Dytë: ka lloje të ndryshme mundësie, si: 'Mundësia e arsyeshme', 'Mundësia e zakonshme' dhe 'Mundësia e shquar -tipike, normale'. Në qoftë se një ngjarje nuk është brenda caqeve të 'mundësisë së arsyeshme', ajo refuzohet e hidhet poshtë; në qoftë se ajo nuk është brenda caqeve të 'mundësisë së zakonshme', ajo është një mrekulli, por nuk mund të jetë lehtë një keramet. Në qoftë se nuk ka asgjë të ngjashme me të, as në përputhje me një përdorim të përgjithshëm e as në parim, ajo mund të pranohet veçse nëpërmjet provave të prera me shkallën e të shikuarit dhe të dëgjuarit. Duke u mbështetur mbi këtë, gjendjet e jashtëzakonshme të Sejjid Ahmed Bedevij (iu shenjtëroftë sekreti) i cili nuk hëngri bukë madje për dyzet ditë, janë brenda caqeve të mundësisë së shquar -normale, të zakonshme. Ajo mund të ketë qenë keramet për të, madje ndoshta ajo është një praktikë e jashtëzakonshme për të.

Po, ndodhen raportime të shumta me unanimitet lidhur me gjendjet e çuditshme dhe dalldie me Sejjid Ahmed Bedeviun[4] (iu shenjtëroftë sekreti).

Ai gjatë kredhjes së tij në gjendje shpirtërore, në ekstazë, hante vetëm një herë në dyzet ditë. "Ngjarja ndodhi me të vërtetë, por nuk ishte e vazhdueshme gjithmonë; ajo ndodhi disa herë si keramet. Ka një mundësi për shkak se ai nuk ndjeu nevojë për të ngrënë ndërsa ishte në ekstazë e i kredhur në gjendje shpirtërore, kjo u bë si një zakon për të. Çudirat e këtij lloji janë raportuar në mënyrë të besueshme e të sigurt rreth shumë Evlijave si shembulli i Sejjid Ahmed Bedevi (iu shenjtëroftë sekreti i tij).

[4] Sejjid Ahmed Bedeviu. Një sufi shumë i shquar në Egjipt. Shumë njerëz aderuan tek tarikati i tij. Ai vdiq dhe u varros në Tanta ku në çdo vit organizohet një treg i madh tek i cili vijnë njerëzit nga të gjitha anët e Egjiptit duke festuar ditëlindjen e tij.

Meqenëse ushqimi i rezervuar e i ruajtur vazhdon për më shumë se dyzet ditë -ashtu siç e provuam në Pikën e parë- dhe është e mundur nëpërmjet ndonjë zakoni të mos hash gjatë asaj periudhe të gjatë kohe dhe një gjendje e tillë është njoftuar në mënyrë të besueshme rreth njerëzve që ishin jashtë të zakonshmes, atëherë kjo nuk mund të refuzohet e të hidhet poshtë.

● **Pyetja e Dytë:**

Në lidhje me këtë pyetje, ne do të shpjegojmë dy çështje të rëndësishme, sepse meqenëse shkencat e gjeografisë dhe të astronomisë kanë qenë të paafta për t'u ngjitur në qiejt e Kur'anit me ligjet e tyre të cunguar, me parimet e tyre të ngushta dhe me masat e vockëla, dhe meqenëse ato kanë qenë të pamundura t'i zbulojnë shtatë nivelet e kuptimeve të tij, ata e kanë kritikuar vërsetin dhe, madje marrëzisht janë përpjekur që ta mohojnë atë.

Çështja e Parë e Rëndësishme.

Kjo është rreth tokës duke pasur shtatë nivele si qiejt. Kjo çështje duket për filozofët e kohës së tanishme se është e pavërtetë; shkencat e tyre rreth tokës dhe qiejve nuk e pranojnë atë. Dhe duke e bërë pretekst këtë, ata kundërshtojnë disa nga të vërtetat e Kur'anit. Ne do të tregojmë në mënyrë të përmbledhur disa pika rreth saj.

E Para: Së pari, kuptimi i vërsetit është një gjë dhe pjesët e atij kuptimi dhe pikat që e konfirmojnë atë, është gjë tjetër. Kuptimi nuk mund të mohohet në qoftë se njëra prej pjesëve të kuptimit të përgjithshëm e universal është munguese. Nga pjesë të shumta të kuptimit universal lidhur me shtatë nivelet e qiejve dhe shtatë shtresat e tokës, shtatë pikave duke e konfirmuar atë, janë të dukshme qartë.

Së dyti: Vërseti nuk e përmend qartë se "toka ka shtatë shtresa" kuptimi i qartë i vërsetit është,

اَللَّهُ الَّذِي خَلَقَ سَبْعَ سَمَوَاتٍ وَمِنَ الْأَرْضِ مِثْلَهُنَّ *"Allahu është i Cili ka krijuar shtatë qiej dhe nga toka po të tilla...(deri në fund të vërsetit)*"[5] "Ai e krijoi tokën si shtatë qiejt dhe e bëri atë një vendbanim për krijesat e Tij".

[5] Kur'an, 65:12

Vërseti nuk thotë: "Unë e krijova tokën si shtatë nivele". Qënia e saj e ngjashme është për sa ka të bëjë me krijueshmërinë dhe me qënien e saj si një vendbanim për krijesat.

Treguesi i Dytë: Globi tokësor, sigurisht është shumë i vogël në krahasim me qiejt, por meqenëse ai është si një ekspozitë, shfaqje, një vend tubimi, qendra e artifakteve të panumërta Hyjnore, si një zemër dhe si qendra jolëndore e qiejve të gjërë dhe të pafundmë, ai -globi- është i barasvlershëm me qiejt, ashtu si zemra që mund të shihet si e barasvlershme me trupin. Për këtë arsye, toka duke pasur shtatë krahina, siç supozohej prej kohëve të lashta në masë të zvogëluar; Gjithashtu, shtatë kontinentet e mirënjohur, Europa, Afrika, Oqeania (Australia), dy Azitë, dy Amerikat; gjithashtu së bashku me detet, Lindjen, Perëndimin, Veriun dhe Jugun, janë shtatë krahinat e njohura të kësaj faqe dhe në faqen e Botës së Re; gjithashtu, shtatë nivelet e ndryshme të ngjitura duke filluar nga qendra e tokës gjer në koren e saj, të cilat janë vërtetuar nga shkenca, dhe shtatë elementet e famshëm universalë të quajtur "Shtatë nivelet", të cilët përmbajnë shtatëdhjetë elemente të thjeshtë që janë boshti i përjetësimit të jetëve të krijesave të gjalla; gjithashtu, katër elementet e ujit, ajrit, zjarrit dhe tokës së bashku me botërat shtazore, bimore dhe të mineraleve, duke bërë shtatë nivele dhe botëra; gjithashtu shtatë botërat e tokës të verifikuara nga ata që zbulojnë të fshehtat e krijimit dhe nga njerëzit e vizionit dhe të dëshmimit, të cilët janë të shumtë; dëshmia e tyre se ato janë botëra dhe vendbanimet e xhindëve, të shejtanëve dhe të gjallesave të tjera të ndryshme të ndjeshme e të vetëdijshme; gjithashtu shtatë nivelet që tregojnë se ekzistojnë shtatë globe të tjerë duke i ngjasuar globit tonë, dhe se ato janë vendbanimet e krijesave të gjalla - nga këto tregues kuptohet prej këtyre vërseteve të Kur'anit se edhe toka gjithashtu ka shtatë nivele.

Kështu bëhet e qartë se shtatë llojet e niveleve të tokës ekzistojnë në shtatë mënyra. I teti i cili është kuptimi i fundit, është i rëndësishëm nga një këndvështrim tjetër; ai nuk është përfshirë në shtatë kuptimet e numëruara.

Treguesi i Tretë: Meqenëse Krijuesi i Gjithurtë nuk harxhon asgjë për kot, dhe meqenëse krijesat ekzistojnë për qëniet e vetëdijshme dhe e gjejnë plotësimin e tyre nëpërmjet qënieve të vetëdijshme, gëzohen nëpërmjet qënieve të vetëdijshme dhe shpëtojnë nga kotësia nëpërmjet

qënieve të vetëdijshme; dhe meqenëse, siç shihet qartë, i Gjithurti Absolut dhe i Gjithëfuqishmi Madhështor i mbush elementin e ajrit, botën e ujit dhe shtresat e tokës me gjallesa të panumërta; dhe ashtu si ajri dhe uji që nuk janë pengesa për lëvizjen e kafshëve, po ashtu lëndët e dendura si dheu dhe guri nuk formojnë pengesa për kalimin e elektricitetit dhe të rrezeve rëntgen.. atëherë Ai i Gjithurti i Plotësisë dhe Autori i Qëndrueshëm përjetësisht nuk do t'i linte bosh e të pabanuara hapësirat e gjëra, botërat, shpellat dhe shtatë shtresat e ngjitura të tokës duke filluar nga qendra e globit tonë tokësor për tek korja e tij e jashtme e cila është banesa jonë dhe qendra. Ai, sigurisht, i ka populluar, ka krijuar dhe ka vendosur atje qënie të vetëdijshme të përshtatshme për ato botëra. Meqenëse ato krijesa të ndjeshme duhet të jenë llojet e engjëjve dhe të qënieve me shpirtëra, për të cilët edhe shtresat më të dendura dhe më të ashpëra janë si deti për peshqit dhe ajri për zogjtë. Madje edhe nxehtësia e tmerrshme në qendër të tokës duhet të jetë për ato krijesa të vetëdijshme si nxehtësia e diellit për ne. Meqenëse shpirtërorët e vetëdijshëm janë krijesa prej drite, atëherë zjarri është tregues si drita për ta.

*Treguesi i katërt***:** E përmendur në Letrën e Tetëmbëdhjetë është një krahasim rreth përshkrimeve -pikturimeve, pasqyrimeve- të çuditshme të shtresave të tokës, të cilat janë jashtë caqeve të arsyes, të bëra prej njerëzve të shikimit. Një përmbledhje e saj është kjo:

Në Botën e dukshme globi tokësor është një farë, ndërsa në Botën e shembëllesës dhe në Botën e ndërmjetme, ai është i një gjërësie sa ajo e qiejve, pra është si një pemë gjigante që shtrihet me madhësinë e yjeve në këto dy botëra. Në qoftë se njerëzit e vizionit dhe të dëshmimit kanë parë një nivel në tokë të posaçëm për shejtanët i cili ka një distancë prej një mijë vitesh, ai nuk është në farën e tokës që i përket Botës së Dukshme; por ai është një manifestim i degëve të saj dhe i niveleve në Botën e Shëmbëllesës. Meqenëse një nivel i vetëm -i parëndësishëm në dukje- prej niveleve të tokës ka një manifestim të tillë të madh në një botë tjetër, sigurisht mund të thuhet se toka ka shtatë nivele që janë të barasvlershëm me shtatë nivelet e qiejve. Me qëllim që të kujtojnë pikat e lartëpërmendura, vërsetet e Kur'anit aludojnë për to duke i shfaqur ato në një mënyrë të mrekullueshme të përmbledhur se kjo tokë e vogël është e barasvlershme me shtatë nivelet e qiejve.

Çështja e Dytë e Rëndësishme

تُسَبِّحُ لَهُ السَّمَاوَاتُ السَّبْعُ وَالْأَرْضُ وَمَنْ فِيهِنَّ

"E lavdërojnë dhe e ngrenë në lavdi e madhështi Atë shtatë qiejt dhe toka dhe gjithë ç'është në to (deri në fund të vërsetit)."[6]

ثُمَّ اسْتَوَىٰ إِلَى السَّمَاءِ فَسَوَّاهُنَّ سَبْعَ سَمَاوَاتٍ وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ

"Dhe pastaj Ai drejtoi synimin e Tij tek qielli dukę i bërë ata shtatë qiej, Dhe Ai është i Gjithëdituri për çdo gjë.[7]

Vërsete të shumta si këto të dy i përshkruajnë qiejt si shtatë qiej. Është e përshtatshme të shkruhet këtu vetëm një përmbledhje e kësaj çështje, të cilën ne e kemi shpjeguar nga domosdoshmëria në mënyrë shumë të përmbledhur në komentin ***Isharatul-Ixhaz*** në frontin e luftës gjatë vitit të parë të luftës së Parë Botërore, pasi në të erdhi kjo çështje shumë e përmbledhur dhe e shkurtuar për shkak të rrethanave të luftës.

Filozofia e lashtë i përshkroi qiejt se ato janë nëntë qiej; ajo u shtoi shtatë qiejve, Arshin dhe Kursin të pranuara në gjuhën e sheriatit; ky ishte një përshkrim i çuditshëm për to.

Termat kumbuese të filozofëve brilantë të asaj kohe e mbajtën njerëzimin nën ndikimin e tyre për shumë shekuj. Shumë komentatorë të Kur'anit u detyruan që t'i bënin kuptimet e jashtme të vërseteve që t'u përshtateshin shkollës së tyre. Në këtë mënyrë, mrekullia e Kur'anit të gjithurtë u mbulua deri diku. Sa për filozofinë e re, e cila quhet filozofia moderne dhe shkenca, përballë ekzagjërimeve dhe teprimeve të filozofisë së lashtë rreth qiejve, shkoi në një ekstrem tjetër dhe, mjaft thjesht, ajo mohon ekzistencën e qiejve. Të parat shkuan në ekstrem, në tepri, të dytat, të mëvonshmet, qenë të mangëta; ato qenë të paafta ta portretizojnë e ta përshkruajnë realitetin në tërësinë e tij.

Sa për urtësinë e shenjtë të Kur'anit të Gjithurtë, ajo i lë mënjanë ekstreme të tilla dhe mangësi dhe, duke zgjedhur rrugën e mesme, ajo tha:

---

[6] Kur'an, 17:44
[7] Kur'an, 2:29

Krijuesi i Gjithëlavdishëm krijoi shtatë nivele të qiejve. Planetet notojnë nëpër qiej si peshqit në dete dhe lavdërojnë Zotin.

Në një hadith profetik thuhet:

اَلسَّمَاءُ مَوْجٌ مَكْفُوفٌ *"Qiejt janë valë të përmbajtura"*[8]

Domethënë, 'qiejt janë një oqean, valët e të cilit janë të qëndrueshëm, të palëvizshëm.'

Ne do ta provojmë shumë shkurt këtë të vërtetë të Kur'anit nëpërmjet shtatë rregullave dhe shtatë aspekteve të kuptimit.

Rregulli i Parë: Është vërtetuar nga shkenca dhe nga filozofia se hapësira e pakufishme nuk është një zbrazëti e pafundme, por e mbushur me një lëndë e quajtur eter.

I Dyti: Është vërtetuar nga shkenca, nga arsyeja dhe madje nga vëzhgimi se lidhja e ligjeve që sundojnë trupat qiellorë si ato të tërheqjes dhe të shtytjes dhe përçuesi e përcjellësi i forcave në lëndë si drita, nxehtësia dhe elektriciteti, janë një lëndë e cila mbush hapësirën.

I Treti: Është vërtetuar me empirizëm -me prova- se lënda e eterit së bashku më të qëndruarit si eter, ashtu si lëndët e tjera, ka forma dhe trajtëzime të ndryshme.

Ashtu siç ndodhen tre gjendje prej të njëjtës lëndë, e lëngshme si gaz dhe e ngurtë, për shembull, avulli, uji dhe akulli, po kështu nuk ka asgjë, në mënyrë të arsyeshme, që të pengojë shtatë llojet e shtresave, gjendjet e shtresave apo niveleve prej një lënde eteri, as ta kundërshtojë atë ndonjë mënyrë.

I Katërti: Në qoftë se trupat qiellorë do të studioheshin me kujdes, do të shikohej se ka një ndryshim në nivele. Niveli i cili përmban sferën e gjërë të mjegullnajës e quajtur Rruga e Qumështit, natyrisht nuk i ngjason nivelit të yjeve të ngulët. Është sikur niveli i yjeve të ngulët të ishte pjekur e bërë ashtu si frutat e verës, ndërsa yjet e panumërt që duken në formën e një reje në Rrugën e Qumështit shfaqen vazhdimisht dhe fillojnë të piqen e të bëhen. Sipas një teorie të

[8] Tirmidhi, Musned

saktë -supozimi, intuite- niveli i yjeve të ngulët gjithashtu shfaqet i ndryshëm nga niveli i sistemit diellor. Dhe kështu me radhë, mund të kapet me intuitë e mund të percetohen shtatë sistemet dhe shtatë nivelet të cilat ndryshojnë nga njëri-tjetri.

Rregulli i Pestë: Është vërtetuar me teori, me intuitë, me shqise, me arsyetim induktiv dhe me eksperimente se në qoftë se një materiali i jepet rregulli dhe forma dhe në qoftë se artifaktet e tjera bëhen prej atij materiali, atëherë ai merr forma dhe nivele të ndryshëm. Për shembull, kur fillojnë format në mineralin e diamantit, prodhohen prej atij materiali hiri, qymyri dhe diamanti. Dhe për shembull, kur zjarri fillon të marrë formë, ai ndahet në nivele flake, tymi dhe prushi. Dhe për shembull, kur kombinohen shkaktuesi i ujit dhe shkaktuesi i aciditetit formohen nivelet si uji, akulli dhe avulli. Domethënë, nga kjo kuptohet se kur ndodh formimi në një lëndë, ajo ndahet në nivele. Prandaj kur Fuqia krijuese fillon të punojë në lëndën e quajtur eter, sipas vërsetit فَسَوّٰىهُنَّ سَبۡعَ سَمٰوَاتٍ *"dhe i formoi ato në shtatë qiej"* ajo krijoi prej saj shtatë lloje qiejsh si nivele të ndryshëm.

I Gjashti: Treguesit e lartëpërmendur domosdoshmërisht tregojnë edhe ekzistencën e qiejve, edhe shumësinë e tyre. Meqenëse yjet sigurisht janë të shumtë dhe nëpërmjet gjuhës së Kur'anit, njoftuesi i lajmeve të sigurta tha se ato janë shtatë, atëherë sigurisht ato janë shtatë.

Rregulli i Shtatë: Meqenëse në arabisht, termat si shtatë, shtatëdhjetë dhe shtatëqind shprehin shumësi, atëherë ato shtatë nivele universalë mund të përfshijnë nivele të shumtë.

Shkurtazi:

I Gjithëfuqishmi i Gjithëlavdishëm i krijoi shtatë qiejt nga lënda e eterit, dhe duke e formuar atë në nivele, e përsosi dhe e rregulloi atë me një rregull vërtet të hollë e të çuditshëm dhe mbolli në të yjet. Meqenëse Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm është një fjalim i parapërjetshëm duke u folur të gjitha klasave të të gjithë njerëzimit dhe të xhindeve, sigurisht secila nga ato klasa do të marrë pjesën e saj nga vërsetet e Kur'anit dhe vërsetet e tij do të përmbajnë kuptime të ndryshme e të shumta, dhe të shprehura qartë, edhe me nënkuptime, në një mënyrë që do të kënaqë shkallën e të kuptuarit të gjithësecilit.

Po, gjërësia e fjalimit të Kur'anit, gjithëpërfshirja e kuptimeve të tij, treguesit, përshtatshmëria, dhe begenia e tij për të gjitha shkallët e të kuptuarit duke filluar nga njerëzit më të zakonshëm për tek niveli më i lartë i elitës, tregon se të gjithë vërsetet e tij kanë një aspekt që shikon tek secila klasë. Kështu, si rrjedhojë e këtij misteri, si një shembull, shtatë klasat e njerëzve e kapin kuptimin e shtatë niveleve të ndryshëm prej kuptimit universal të "Shtatë qiejve", siç vijon:

Një klasë dritëshkurtër dhe mendjengushtë prej njerëzve e kuptojnë atmosferën nga vërseti فَسَوَّىٰهُنَّ سَبْعَ سَمَٰوَاتٍ "*Dhe i formoi ato në shtatë qiej".*

Ndërsa një klasë tjetër njerëzish të mjegulluar nga astronomia i kuptojnë yjet e shquar të njohur në mënyrë popullore si Shtatë Planetët dhe orbitat e tyre.

Një grup tjetër nga njerëzit kuptojnë shtatë sferat qiellore që i ngjasojnë globit tonë, të cilat janë të banuara nga krijesat e gjalla.

Një grup tjetër njerëzish kupton sistemin diellor të ndarë në shtatë nivele dhe shtatë sisteme diellorë me sistemin tonë.

Një grup tjetër kupton eterin të ndarë në shtatë nivele.

Një klasë tjetër njerëzish me ide më të gjëra i kuptojnë të gjithë qiejt e dukshëm të zbukuruar me yje si një qiell i vetëm i cili është qielli i dynjasë, dhe ndodhen gjashtë qiej të tjerë sipër tij që nuk shihen.

Dhe klasa më e lartë prej njerëzve dhe e shtata nuk i shikojnë shtatë qiejt se janë kufizuar vetëm tek Bota e dukshme, dhe kuptojnë se botërat e Ahiretit, të së Padukshmes, kjo botë dhe bota e shëmbëllesës, që të gjitha kanë shtatë qiej, secili prej tyre është si një përfshirës rrethues dhe si një çati i të gjithë atyre.

Gjithashtu, ndodhen shumë kuptime të tjera të veçanta në universalitetin e vërsetit, si shtatë nivelet e lartëpërmendur të kuptimit të shtatë niveleve prej njerëzve. Gjithësecili merr pjesën e tij sipas shkallës së tij të të kuptuarit dhe gjithësecili gjen ushqimin e tij tek ajo tryezë qiellore.


Meqenëse ky vërset përmban kaq shumë kuptime që e konfirmojnë atë deri në këtë shkallë, atëherë mohimi i filozofëve të paarsyeshëm aktualë dhe i astronomëve të marrë duke sulmuar vërsetin dhe duke e marrë atë mohim si pretekst për të kundërshtuar vërsetet e tjera të ngjashëm me këtë, një veprim ky që u ngjason fëmijëve idiotë që hedhin gurë tek një yll me shpresë që ta bëjnë atë të bie, sepse në qoftë se një kuptim i vetëm i këtij vërseti prej atyre kuptimeve të shumta, është i vërtetë, atëherë kuptimi universal është i saktë; madje edhe sikur ndonjë aspekt i pjesshëm prej atyre kuptimeve të mos kishte ekzistencë në realitet veçse në gjuhët e njerëzve, mund të përfshihet brenda atij kuptimi universal duke iu përshtatur e respektuar mendimet e përgjithshme. Ndërsa ne shohim shumë të pjesshme të cilat janë të sakta e të vërteta.

Tani shikoje këtë gjeografi të padrejtë dhe këtë astronomi të dehur: Sa të padrejta kanë qenë këto dy shkenca, duke i mbyllur sytë e tyre ndaj kuptimit universal, i cili është i drejtë, i saktë dhe i vërtetë, dhe duke mos shikuar aspektet që e konfirmojnë atë dhe janë absolutisht të drejta; ata e kanë pandehur diçka të pjesshme imagjinare e të jashtëzakonshme se është kuptimi i vërsetit dhe kanë hedhur gurë mbi vërsetin! Kështu ata kanë thyer kokat e veta, kanë humbur besimin e tyre dhe të drejtën!

Shkurtazi: Meqenëse idetë materialiste ateiste, si shejtanët dhe xhindet, kanë qenë të paafta për t'u ngjitur tek shtatë nivelet e qiejve të Kur'anit, i cili u shpall në shtatë recitime, në shtatë aspekte, me shtatë lloje mrekullish, me shtatë të vërteta dhe me shtatë shtylla, ata nuk dinë se çfarë kuptimesh ndodhen dhe çfarë nuk ndodhen në yjet e vërseteve të tij, dhe japin njoftime të rreme dhe të pasakta. Dhe yjet rënës -gjuajtës- si diskutimi i lartëpërmendur bien mbi kokat e tyre nga yjet e atyre vërseteve dhe i djegin ata.

Po, nuk është e mundur ngjitja tek ato qiej Kur'anorë nëpërmjet një filozofie, filozofët e së cilës kanë ide djallëzore të ulëta.

Ngjitja për tek yjet e atyre vërseteve është e mundshme nëpërmjet Miëraxhit -ngjitjes- së urtësisë së vërtetë dhe është i mundur fluturimi nëpërmjet krahëve të besimit dhe të islamit.



O Zot! Jepi bekime Diellit të qiejve të Profetësisë dhe të hënës së boshtit të profetësisë, dhe familjes së tij, sahabëve, yjeve të udhëzimit për të udhëzuarit drejtë.

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtet që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".

O Allah! O Krijuesi i qiejve dhe i tokës! Zbukuroji zemrat e shkruesit të kësaj trajtese dhe të shokëve të tij me yjet e të vërtetave të Kur'anit dhe të besimit... Amin.

* * *

SHKREPTIMA E TREMBËDHJETË

Kjo, Shkreptima e Trembëdhjetë, shpjegon kuptimin e

أَعُوذُ بِاللهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ *"Eudhu bil-lahi minesh-shejtanir-Raxhim".* *I mbështetem Allahut që të më ruajë nga pështëritjet e shejtanit të mallkuar.*

بِسْمِ اللهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَقُلْ رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ هَمَزَاتِ الشَّيَاطِينِ وَأَعُوذُ بِكَ رَبِّ أَنْ يَحْضُرُونِ

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

Dhe thuaj: "Zoti im! Të mbështetem Ty (të më ruash) nga pështëritjet e shejtanit.

"Dhe të mbështetem Ty, o Zoti im! Se përndryshe ata do të më afroheshin"[1].

[Kjo trajtesë është rreth të kërkuarit mbrojtje Allahut prej shejtanit. Do të shkruhen trembëdhjetë tregues. Disa prej tyre janë shpjeguar e provuar në Fjalën e Njëzet e Gjashtë dhe në pjesët e tjera të Risale-i Nurit në mënyrë të veçuar. Prandaj këtu kjo do të diskutohet shkurtimisht.]

[1] Kur'an, 23:97-98

● **Treguesi i Parë**

Pyetje: Megjithëse shpirtërat e këqinj, shejtanët, nuk ndërhyjnë në univers në asnjë mënyrë lidhur me krijimin dhe, se nëpërmjet Mëshirës së Tij dhe përkujdesjes Allahu i Gjithëfuqishëm merr pjesën e njerëzve të së vërtetës duke i mbështetur; dhe bukuritë tërheqëse dhe virtytet e së vërtetës dhe të realitetit forcojnë dhe nxisin njerëzit e së vërtetës, ndërsa shëmtia e neveritshme e çudhëzimit revolton dhe zgjon neverinë e njerëzve të çudhëzimit; cila është urtësia që Partia e shejtanit në shumicën e rasteve është fituesja? Dhe cila është arsyeja që njerëzit e së vërtetës i kërkojnë gjithmonë mbrojtje Allahut prej të keqes së shejtanit?

*Përgjigjja***:** Urtësia dhe qëllimi janë siç vijon: Çudhëzimi dhe e keqja me shumicën e tyre absolute janë negative, shkatërruese dhe i përkasin mosekzistencës. Ndërsa udhëzimi dhe e mira me shumicën e tyre absolute janë pozitive, ndërtimore, rregulluese dhe i përkasin ekzistencës. Gjithkush e di se një njeri mund ta shkatërrojë për një ditë atë që ndërtuan njëzet burra për njëzet ditë.

Dhe jeta e njeriut e cila qëndron me vazhdimësinë e gjymtyrëve të tij bazë brenda kushteve të jetës, megjithëse ajo i përket Fuqisë së Krijuesit xh.sh., veçse ajo zbulohet para vdekjes e cila është mosekzistencë në krahasim me jetën, në qoftë se një tiran do të priste një gjymtyrë prej trupit të atij njeriu.

Prandaj, është bërë proverbë thënia,

"Shkatërrimi është më i lehtë se sa ndërtimi."

Për shkak të kësaj, njerëzit e çudhëzimit me fuqinë e tyre vërtet të dobët triumfojnë ndonjëherë mbi njerëzit e së vërtetës të cilët janë shumë të fuqishëm. Por njerëzit e së vërtetës kanë një kala aq të pasulmueshme saqë kur ata kërkojnë strehim e mbrojtje në të, ata armiq të frikësuar nuk mund t'u afrohen; ata nuk mund të bëjnë asgjë. Edhe në qoftë se ata do të goditeshin prej tyre nga një dëm, përkohësisht, por fitorja dhe shpërblimi i përhershëm që i pret ata në sihariqin e Kur'anit.

وَٱلْعَٰقِبَةُ لِلْمُتَّقِينَ *"Dhe fundi (i shkëlqyer) është për të përkushtuarit (në besim të drejtë)"*[2] e largon ndikimin e atij dëmi e plage. Dhe ajo kështjellë e pamposhtur, ajo kala e fortifikuar, është sheriati Hyjnor dhe sunneti profetik a.s.m..

● **Treguesi i Dytë**

Kjo është një çështje që u vjen ndërmend shumë njerëzve.

Pyetje: Krijimi i shejtanëve, të cilët janë thjesht e keqe, sulmi dhe bezdisjet e tyre ndaj njerëzve të besimit, nxitja që ata u bëjnë shumë njerëzve dhe hyrja e tyre në zjarr për shkak të dredhive dhe intrigave të tyre, shfaqet se është e tmerrshme dhe e shëmtuar. Si e pranon mëshira e Atij Mëshirëploti Absolut dhe si e lejon Bukuria e Atij Hirploti Absolut i Cili është i Gjithëmëshirshmi i Bukurisë, këtë shëmti të pafundme dhe katastrofë të madhe?!

Përgjigjja: Përveç të këqijave të pjesshme të shejtanëve, ndodhen shumë qëllime të mira universale në ekzistencën e tyre, si dhe arritje njerëzore, plotësime e përparime.

Po, ashtu siç ndodhen shkallë të shumta duke filluar nga bërthama për tek pema gjigante, po ashtu edhe aftësitë e ngulitura në natyrën njerëzore janë më të shumta se sa ajo, madje mund të arrijnë shkallët që gjenden ndërmjet grimcës dhe diellit. Me qëllim që të shfaqen këto aftësi dhe të zhvillohen mundësitë, kërkohet patjetër një lëvizje a një akt, pra një veprim është i domosdoshëm. Lëvizja e mekanizmit të progresit në një veprim të tillë shkaktohet nëpërmjet 'përpjekjes, luftës'. Dhe kjo përpjekje apo luftë ndodh veçse nëpërmjet ekzistencës së shejtanëve dhe të gjërave të dëmshme; sepse në qoftë se nuk do të kishte qenë ajo 'përpjekje', shkalla e njeriut do të kishte mbetur e fiksuar, e pandryshueshme ashtu si ajo e melekëve; nuk do të kishte pasur rangje e klasa në llojin njerëzor të cilat u ngjasojnë mijërave të llojeve e specieve. Dhe do të ishte në kundërshtim me urtësinë dhe drejtësinë nëse do të lihej një mirësi shumë e madhe për të shmangur ndodhjen e një të keqeje të vogël të pjesshme. Sigurisht shumica e njerëzve përqafojnë çudhëzimin për shkak të shejtanit, mirëpo rëndësia

[2] Kur'an, 7:128

dhe vlera shikojnë kryesisht tek 'cilësia'; ato e shikojnë pak sasinë ose hiç fare.

Për shembull, në qoftë se një njeri ka një mijë e dhjetë farëra, të cilat ai i mbjell në tokë, dhe nën dhé farërat i nënshtrohen një reaksioni kimik, si rezultat i të cilit dhjetë farëra bëhen pemë dhe një mijë kalben, atëherë fitimi që merr njeriu nga dhjetë farërat të cilat janë bërë pemë sigurisht e eliminon humbjen që pësoi nga një mijë farërat e kalbura e të prishura.

Dhe në të njëjtën mënyrë, nëpërmjet luftës dhe përpjekjes kundra nefsit dhe shejtanit, fitimi, nderi, ndriçimi dhe vlera për llojin njerëzor i arritur dhe i fituar nga dhjetë njerëz të përkryer, të cilët janë si yje, sigurisht e zvogëlojnë dhe e pakësojnë deri në asgjë dëmin që i është shkaktuar njerëzimit nga njerëzit e çudhëzimit të cilët përqafojnë mosbesimin dhe konsiderohen si kafshë parazitare për qënien e tyre të ulët e të papërfillshëm. Meqenëse është kështu, Mëshira Hyjnore, urtësia dhe drejtësia kanë lejuar ekzistencën e Shejtanëve dhe i lejoi ata t'i shqetësojnë njerëzit.

O Njerëzit e besimit! Mjeti juaj i blinduar kundra këtij armiku të tmerrshëm është frika ndaj Zotit që prodhohet në punishten e Kur'anit të gjithurtë. Dhe mbulesa mbrojtëse, mburoja, është sunneti i Profetit Muhammed a.s., dhe arma e juaj është kërkimi i mbrojtjes, kërkimi i faljes dhe kërkimi i strehimit tek mbrojtja Hyjnore.

● **Treguesi i Tretë**

Pyetje: Ku fshihen misteri dhe urtësia e kërcënimeve të ashpra të Kur'anit dhe të kanosjeve të tij ndaj njerëzve të çudhëzimit kundrejt një veprimi të pjesshëm që ka buruar prej tyre, gjë e cila nuk shfaqet për arsyen se është në harmoni me drejtësinë e tij, me elokuencën e saktë, me përshtatshmërinë dhe me maturinë e stilit të tij. Është sikur ai të grumbullonte ushtri të mëdha kundra një personi të vetëm. Dhe ai e kërcënon atë për atë shkak të një akti të pjesshëm sikur ai të kishte kryer me mijëra krime; dhe i jep atij një pozitë dhe ankohet për të sikur ai të ishte një ortak agresiv pavarësisht qënies së tij i falimentuar dhe duke mos pasur pjesë nga prona dhe sundimi?

Përgjigjja: Misteri dhe urtësia në të është kjo: Për shkak se shejtanët dhe ata që i ndjekin marrin rrugën e çudhëzimit, ata mund të

bëjnë shkatërrim të madh me një akt të vogël, ata mund të shkelin të drejtat e krijesave të shumta dhe të shkaktojnë shumë dëm me një veprim të vogël.

Për shembull, nëpërmjet një veprimi të vogël ose duke neglizhuar në një detyrë të vogël, një njeri në një anije të madhe tregtare të një mbreti mund të jetë shkak që të humbasin dhe të shkojnë krejtësisht kot të gjitha përpjekjet e atyre që janë punësuar në anije dhe të gjitha frutat dhe rezultatet e punës së tyre. Prandaj, Mbreti, Pronari i shquar i anijes shfaq pakënaqësi dhe e kërcënon njeriun rebel të pabindur në mënyrën më të ashpër në emrin e të gjithë nënshtetasve të tij të cilët janë të lidhur me anijen. Dhe ai i jep atij një ndëshkim të rreptë, duke marrë në konsideratë jo lëvizjen e tij të pjesshme apo lënien e detyrës nga ana e tij, por rezultatet që u shkaktuan nga ajo lëvizje e nga ajo braktisje e thjeshtë, dhe jo në emrin e tij, por në atë të të drejtave të nënshtetasve të tij.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, nëpërmjet gabimeve dhe gjynaheve të vogla në dukje, njerëzit e çudhëzimit, partia e shejtanit, të cilët janë në anijen e tokës së bashku me njerëzit e udhëzimit, bëjnë shkelje kundra të drejtave të krijesave të shumta dhe shfuqizojnë rezultatet e detyrave të lartësuara. Prandaj kërcënimet e ashpra të Sulltanit të Parapërjetësisë e të paspërjetësisë dhe shfaqja e pakënaqësisë ndaj tyre dhe mobilizimi i forcave nga ana e Tij janë thjesht drejtësi e pastër brenda elokuencës së plotë dhe janë më me vend dhe më të përshtatshmet. Kjo është në harmoni me kërkesat e situatës, e cila është përcaktimi i elokuencës dhe bazat e saj, dhe ajo është pa ekzagjerime, e cila është tepri në fjalë a harxhim i shumë fjalëve.

Sa i mjeruar e i humbur është ai që nuk kërkon strehim e mbrojtje në një kala të sigurt përballë atyre armiqve të tmerrshëm të cilët bëjnë shkatërrime e rrënime të llahtarshme me një lëvizje të vogël! O Njerëzit e besimit! Përpara jush është kalaja qiellore e fortë e çelikosur.. Ajo është Kur'ani Kerim... Prandaj hyni në të dhe shpëtojeni vetveten tuaj!

- **Treguesi i Katërt**

Dijetarët hetues dhe njerëzit e zbulesave kanë pajtueshmëri mendimi se mosekzistenca është thjesht e keqe e pastër, kurse ekzistenca është thjesht e mirë e pastër.

Po, në shumicën e rasteve, e mira, virtytet dhe plotësimet bazohen mbi ekzistencën dhe lidhen me të. Madje edhe në qoftë se ato duken nga ana e jashtme negative dhe aludojnë për mosekzistencë, baza e tyre është në ekzistencë dhe i përket ekzistencës.

Ndërsa baza dhe fara e të gjithë shëmtisë, çudhëzimit, të keqes, fatkeqësive dhe e mëkateve është mosekzistencë dhe mohim. E keqja dhe shëmtia burojnë nga mosekzistenca. Madje edhe në qoftë se ato duken në anë të jashtme se janë pozitive dhe se i përkasin ekzistencës, në bazë ato janë mosekzistencë dhe mohim.

Gjithashtu, siç shihet qartë, ekzistenca e ndërtesës, për shembull, vërtetohet e përcaktohet me anë të ekzistencës së të gjitha pjesëve të saj. Ndërsa shkatërrimi i saj mund të ndodhë nëpërmjet rrënimit të njërës prej pjesëve të saj, të mosqënies së njërës nga pjesët e saj kryesore dhe të mosekzistencës.

Domethënë, ekzistenca kërkon një shkak ekzistues; ajo bazohet mbi një shkak që ka realitet aktual. Ndërsa mosekzistenca mund të mbështetet mbi gjëra të cilat i përkasin mosekzistencës dhe gjëra të tilla mund të jenë shkaku i diçkaje mosekzistuese.

Atëherë duke u mbështetur mbi këto dy rregulla, 'shejtanët prej njerëzve' dhe xhindeve nuk kanë pjesë as sa një grimcë në aktivitetin krijues, në sjelljen në ekzistencë, dhe nuk kanë asnjë pjesë në Sovranitetin Hyjnor, pavarësisht shkatërrimit të tyre të tmerrshëm në univers, llojeve të mohimit, të çudhëzimit dhe akteve të këqija e rrënuese. Për më tepër, ata nuk i kryejnë ato vepra nëpërmjet ndonjë fuqie të tyre apo aftësie; madje në shumicën e akteve të tyre nuk ka ndonjë veprim apo fuqi reale, por ato janë nga lloji: lënia e një veprimi, shfuqizimi i një pune dhe ndalimi nga e mira, ata i bëjnë të këqiat duke mos lejuar të bëhet e mira, dhe kështu ndodhin të këqijat. Meqenëse të këqijat dhe të ligat janë një lloj shkatërrimi, shkaqet e tyre nuk duhet të jenë një fuqi ekzistuese dhe një krijueshmëri aktive, sepse shkatërrimi i madh mund të kryhet nëpërmjet një urdhri që i përket mosekzistencës dhe një kushti duke qenë i prishur.

Për shkak se zoroastrianët nuk e zhvilluan këtë mister, nuk e patën të qartë, ata besuan se ndodhej një krijues për të mirën dhe e quajtën *Jazdan* dhe një krijues për të keqen që e quajtën *Ahriman*. Por zoti i imagjinuar i së keqes që ata e quajtën Ahriman ishte Shejtani, i cili e

shkaktoi të keqen nëpërmjet fuqisë së zgjedhjes -vullnetit të lirë- dhe fitimit -fuqisë për të vepruar- por që nuk ka aftësi për të krijuar.

O Njerëzit e besimit! Arma juaj më e efektshme kundra shkatërrimeve të tmerrshme të shejtanëve dhe mjeti juaj më i rëndësishëm për ndërtim e rregullim, është: Të kërkuarit falje dhe të kërkuarit strehim e mbrojtje nga Allahu duke thënë***: Eudhu bil-lah***, "*i kërkoj mbrojtje Allahut*" .Dhe dijeni se kalaja e juaj është sunneti i profetit Muhammed alijhissalatu ves-selam.

● **Treguesi i Pestë**

Pavarësisht pasjes së shumë shkaqeve udhëzuese për njerëzit për t'i çuar tek e drejta dhe pavarësisht se Allahu xh.sh. ka dhënë shumë përkujtues, paralajmërime, kërcënime, udhëzime e nxitje dhe duke u treguar njerëzimit në librat e shenjtë qiellorë shpërblimet e mëdhaja si Xhenneti dhe dënimet e tmerrshme si Xhehennemi, pavarësisht pasjes së kaq shumë mjeteve për t'i udhërrëfyer ata tek rruga e drejtë, njerëzit e besimit shpartallohen përpara dredhive të ulëta e të dobëta të neveritshme e të pa merita që burojnë nga Partia e Shejtanit!! Në një kohë, kjo më shkaktoi shumë mendim. Si është e mundur që, ndërsa besojnë, ata nuk u kushtojnë vëmendje kërcënimeve të rrepta të Allahut të Plotëfuqishëm? Si nuk zhduket imani i tij ndërsa ai kundërshton Krijuesin e tij duke ndjekur gjurmët e shejtanit dhe dredhitë e tij të dobëta ashtu si në vërsetin,

إِنَّ كَيْدَ الشَّيْطَانِ كَانَ ضَعِيفًا *"Vërtet komploti i shejtanit është gjithnjë shumë i dobët?"* saqë madje disa nga shokët e mi, megjithëse i vërtetuan me sinqeritet mësimet rreth realitetit që ata kanë marrë prej meje njëqind herë dhe patën një opinion tej mase të mirë ndaj meje dhe në lidhje me mua, ata u rrëmbyen dhe u entuziazmuan nga komplimente të parëndësishme e shtinjake të një personi të korruptuar dhe morën nga një pozitë në favor të tij dhe kundra meje. Ndërkohë unë thashë me vete: "***Ja Subhanall-llah***! Sa e çuditshme! A mund të bie njeriu kaq poshtë? Sa njeri i pavlerë ishte ai". Unë e përgojova atë njeri dhe bëra mëkat.

Më vonë, realiteti i shpjeguar në treguesit e mëparshëm u bë i qartë dhe ndriçoi shumë pika të errëta, lavdi Zotit. Nëpërmjet asaj drite unë

kuptova se: Përsëritja e nxitjeve dhe inkurajimeve në Kur'anin Kerim është shumë e domosdoshme, shumë e përshtatshme e me vend.. dhe mashtrimi i njerëzve të besimit me intrigat e dredhitë e shejtanit nuk vjen për shkak të mungesës së besimit.. Unë kuptova gjithashtu se ai që kryen gjynahe të mëdha, nuk bëhet kafir -mohues- dhe se *muëtezilitët* dhe disa sekte Havarixhe janë të gabuar duke pohuar se "*Ai që kryen një gjynah të madh, ose bëhet mohues, ose është në një gjendje ndërmjet besimit dhe mosbesimit"*.. dhe se ai shok i mjerë i imi i cili sakrifikoi njëqind mësime besimi për të fituar lavdërimin e vlerësimin e një njeriu të poshtër nuk kishte rënë shumë në humnerë, nuk kishte rënë krejtësisht në fund -ashtu siç e përfytyrova- dhe falënderova Allahun i Cili më shpëtoi mua nga humnera, sepse shejtani, ashtu siç thashë më parë, nëpërmjet një çështjeje të pjesshme që i përket mosekzistencës, e hedh njeriun në një rrezik serioz. Për më tepër, nefsi i njeriut e dëgjon gjithnjë shejtanin. Dhe se fuqia e tij e zemërimit dhe dëshirat shtazore janë si aparate marrëse e dhënëse, si marrëse e përcjellëse të pëshpëritjeve të Shejtanit.

Për shkak të kësaj, Allahu i Gjithëfuqishëm ka posaçëruar dy Emrat ***El-Gafur, Er-Rahim***, *Fajëfalësi, Mëshirëploti*, midis Emrave të Bukur Hyjnorë, që ato të dy të shfaqen me një manifestim më të madh dhe të orientohen tek njerëzit e Imanit. Dhe Ai tregon në Kur'anin e Gjithurtë se mirësia e Tij më e madhe për Profetët është falja -amnistia- dhe u bën thirrje atyre të kërkojnë falje. Dhe nëpërmjet përsëritjes së Fjalëve të Bekuara بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ "***Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim***" në fillimin e çdo sureje dhe duke urdhëruar që ajo të thuhet në fillimin e të gjitha punëve të mira, Allahu xh.sh. tregon se mëshira e Tij gjithëpërfshirëse rrethon e përfshin universin dhe është një kala dhe vendstrehim për njerëzit e besimit. Ndërsa nëpërmjet urdhrit,

فَاسْتَعِذْ "*Atëherë kërko mbrojtje e mbështetje tek Allahu"*[3], Ai e bën një mburojë të frazës,

أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ *"I kërkoj mbrojtje Allahut prej Shejtanit të mallkuar".*

[3] Kur'an, 7:200

● **Treguesi i Gjashtë**

Njëra nga dredhitë më të rrezikshme të shejtanit është kjo: Ai i bën disa njerëz të ndjeshëm, mendjehollë e zemërmirë të ngatërrojnë të imagjinuarin e kufrit -mohimit- me vërtetimin e tij -kufrit; dhe ua shfaq të përfytyruarin se është vërtetimi i vetë çudhëzimit. Ai ndjell dhe sjell në imagjinatat e tyre mendime të shëmtuara për individë dhe për çështje të pastërta e të shenjta. Ai gjithashtu i shfaq gjërat të cilat janë të mundshme në mënyrë të qenësishme -thelbësore- së bashku me ato që janë të mundshme me arsye, duke i bërë kështu ato gjëra të shfaqen se janë dyshime në kundërshtim me sigurinë e besimit. Atëherë njeriu i ndjeshëm i mjerë supozon se ai ka rënë në çudhëzim e në mosbesim dhe se siguria e tij e besimit ka humbur; ai kështu bie në dëshpërim të pashpresë dhe bëhet një lodër zbavitëse e shejtanit. Ndërkohë shejtani përdor edhe dëshpërimin e tij, atë damar të tij të dobët, edhe ngatërresën e tij, me qëllim që ai ose të çmendet, ose duke thënë: "Gjithçka është humbur", bie në humnerën e çudhëzimit. Ne kemi shpjeguar në disa pjesë të Risale-i Nurit papërfillshmërinë dhe parëndësinë e këtyre dredhive e pështpëritjeve dhe, si ato nuk kanë bazë e mbështetje. Ndërsa këtu ne do t'i diskutojmë ato në mënyrë të shkurtuar, siç vijon:

Ashtu si imazhi i gjarpërit në një pasqyrë që nuk mund të kafshojë, as shëmbëllimi, as reflektimi i zjarrit në të nuk djeg, as hija e ndyrësisë në të nuk ndot, po ashtu ajo çfarë reflektohet në pasqyrën e imagjinatës apo të mendimit prej imazheve të mohimit e të idhujtarisë, prej hijeve të çudhëzimit dhe prej imagjinatave të fjalëve të neveritshme, të shëmtuara dhe sharjesh, nuk e prishin besimin dhe sigurinë dhe nuk e ndryshojnë imanin dhe nuk e dëmtojnë etikën e respektuar dhe mirësjelljen.

Sepse rregulli i mirënjohur është: "Të imagjinuarit e sharjes nuk është sharje, të imagjinuarit e mohimit nuk është mohim dhe të përfytyruarit e çudhëzimit nuk është çudhëzim".

Sa për çështjen e dyshimeve në besim, mundësitë që janë të mundshme në mënyrë të qenësishme -thelbësore- nuk e kundërshtojnë mundësinë e besimit dhe nuk e dëmtojnë atë. Njëri nga rregullat e vërtetuara të shkencës së parimeve të fesë është ky:

إِنَّ لِإِمْكَانِ الذَّاتِيِّ لَا يُنَافِي الْيَقِينَ الْعِلْمِيَّ *"Diçka që është e mundshme nga vetvetja, nuk e kundërshton sigurinë e dhënë nga njohja".* Për shembull, ne jemi të sigurt se liqeni i Barlës është në vendin e tij dhe i mbushur me ujë, veçse është e mundur nga vetvetja që liqeni të fundoset e të batiset nën tokë në këtë moment.

Kështu fundosja apo zhytja e tij është brenda caqeve të mundësisë. Por meqenëse kjo mundësi thelbësore -e qenësishme- nuk buron nga ndonjë tregues, ajo nuk mund të jetë një mundësi e arsyeshme, dhe kështu ajo nuk ka ndonjë rëndësi që të shkaktojë dyshim, sepse një rregull tjetër i vërtetuar i parimeve të fesë është*:*

لَا عِبْرَةَ لِلِاحْتِمَالِ الْغَيْرِ النَّاشِئِ عَنْ دَلِيلٍ *"Një mundësi që nuk buron nga ndonjë shenjë nuk mund të jetë një mundësi e arsyeshme saqë të shkaktojë dyshime dhe nuk ka rëndësi".*

Kështu, njeriu i mjerë i zbuluar para atyre pështpëritjeve djallëzore supozon se për shkak të mundësive të tilla të qenësishme ai ka humbur besimin e tij të sigurt në të vërtetat e imanit. Për shembull, mundësi të shumta të qenësishme rreth aspekteve humane të profetit Muhammed a.s.m. mund t'i vijnë ndërmend atij; nuk ka dyshim se ato nuk i shkaktojnë dëm sigurisë së besimit të tij, mirëpo supozimi i tij se kjo shkakton dëm është pikërisht ajo që i shkakton dëm atij.

Gjithashtu, ndonjëherë shejtani sugjeron gjëra të këqija lidhur me Allahun e Gjithëfuqishëm në formën e pështpëritjeve në zemër. Njeriu tronditet e dridhet duke supozuar se zemra e tij është prishur dhe thotë gjëra të tilla. Por tronditja e tij, frika dhe mungesa e kënaqësisë është tregues se ato fjalë nuk dalin nga zemra e tij; përkundrazi, ato vijnë nga pështpëritjet djallëzore, dhe u transmetuan e u shkaktuan të imagjinohen nga shejtani.

Gjithashtu midis aftësive të holla të njeriut ndodhen një ose dy për të cilat unë kam qenë i pamundur t'i specifikoj e t'i përcaktoj; këto nuk u kushtojnë vëmendje dëshirës dhe fuqisë së zgjedhjes dhe nuk futen në trysninë dhe detyrimin e përgjegjësisë. Ndonjëherë ato sundojnë, nuk e dëgjojnë të vërtetën dhe futen në gjëra të gabuara. Atëherë shejtani i pështpërit atij njeriu të sprovuar sa vijon:

"Aftësia jote nuk harmonizohet me të vërtetën dhe besimin, a nuk shikon se ajo futet në mënyrë të pavullnetshme në bërjen e atyre gjërave të cilat janë të gabuara e të kota? Kjo do të thotë se Fati yt të ka dënuar me mjerim e humbje "Njeriu i mjerë bie në dëshpërim të pashpresë e shkatërrohet".

Dhe kështu kalaja e fortifikuar e besimtarit përballë dredhive të mëparshme të shejtanit janë të vërtetat e besimit dhe çështjet e pakundërshtueshme të Kur'anit, caqet e të cilave janë përcaktuar nga parimet e dijetarëve të saktë e të pastër. Ndërsa përballë dredhive të fundit, kalaja e besimtarit është "të kërkuarit strehim e mbrojtje nga Allahu dhe të mos u japë rëndësi atyre dredhive", sepse është në natyrën e atyre pështpëritjeve të rriten e të zmadhohen sa herë që t'u jepet rëndësi; pra, sa më shumë rëndësi t'u japësh, aq më shumë, ato tërheqin vëmendjen. Kundërhelmi i besimtarit dhe ilaçi për plagë të tilla shpirtërore është ndjekja e sunnetit të pastër profetik.

● **Treguesi i Shtatë**

Pyetje: Imamët Muëtezilitë e konsideruan krijimin e të keqes se është e keqe dhe, prandaj ata nuk ia atribuuan krijimin e mosbesimit dhe të çudhëzimit Allahut xh.sh; ata me këtë sikur po e shfajësonin dhe po e shenjtëronin Atë. Ata thanë: "Njeriu është krijuesi i veprave të tij", dhe me këtë ata u çudhëzuan, shkuan në drejtim të gabuar. Ata gjithashtu thanë: "Një besimtar i cili kryen një gjynah të madh humbet besimin e tij", sepse vërtetimi i besimit në Allahun nuk është i pajtueshëm me kryerjen e gjynaheve të tilla të mëdha. Nga frika e dënimit prej një burgimi të përkohshëm në këtë botë, njeriu përmbahet e ruhet nga të vepruarit në kundërshtim me ligjin, atëherë në qoftë se ai kryen gjynahe të mëdha duke mos e përfillur zemërimin e Krijuesit Madhështor dhe as dënimin e përjetshëm të Xhehennemit, sigurisht kjo tregon mungesën e tij të besimit".

Përgjigjja për pjesën e parë të pyetjes: Siç është shpjeguar në trajtesën rreth "Kaderit Hyjnor", krijimi i të keqes nuk është e keqe; por prirja drejt të keqes, është e keqe; sepse krijimi dhe sjellja në ekzistencë shikojnë tek rezultatet e përgjithshme. Meqenëse ekzistenca e një të keqeje të vetme është parathënie për rezultate të shumta të mira, atëherë krijimi i të keqes bëhet e mirë për sa ka të bëjë me ato rezultate; domethënë ajo sikur është e mirë. Për shembull, zjarri ka

njëqind rezultate të mira, mirëpo disa njerëz të cilët nëpërmjet zgjedhjes së tyre të keqe të keqpërdorimit dhe, duke e bërë atë të keqe për veten e tyre nuk mund të thonë se krijimi i zjarrit është e keqe. Në të njëjtën mënyrë, krijimi i shejtanëve ka rezultate të urta e të shumta për njeriun, si ngjitja e tij në shkallët e plotësimit e të përparimit; Kështu në qoftë se një njeri shpartallohet nga shejtani për shkak të dëshirës dhe zgjedhjes së tij të gabuar dhe të prirjeve të gabuara, ai nuk mund të thotë se krijimi i shejtanit është e keqe, sepse ai e bëri të keqen për vetveten për shkak të prirjes së tij të keqe.

Po, meqenëse prirja është një lidhje e pjesshme e çështjes, ajo ka një rezultat të keq të veçantë dhe bëhet e keqe. Por meqenëse krijimi shikon tek të gjitha rezultatet, krijimi i të keqes nuk është e keqe, në të vërtet ajo është e mirë. Për shkak se Muëtezilitët nuk e kuptuan këtë mister, ata thanë:

"Krijimi i së keqes është e keqe dhe krijimi i të shëmtuarës është e shëmtuar". Dhe me qëllim që ta shpallin Allahun e Plotëfuqishëm të pastër e të përjashtuar nga gabimet, ata nuk ia atribuuan krijimin e të keqes Atij; ata ranë në çudhëzim dhe e interpretuan gabimisht shtyllën e besimit وَبِالْقَدَرِ خَيْرِهِ وَشَرِّهِ '*Besimin në Kaderin Hyjnor, si e mira e tij po ashtu dhe e keqja e tij janë prej Allahut'.*

Përgjigjja për pjesën e dytë të pyetjes: "Si mund të mbetet besimtar ai që kryen gjynahe të mëdhaja?"

Së pari, gabimi i tyre është kuptuar qartë në treguesit e mëparshëm, kështu që nuk është nevoja që të përsëritet.

Së Dyti, nefsi urdhërues për të liga i njeriut preferon një ons prej një kënaqësie të tanishme të menjëhershme mbi një ton të një kënaqësie të mëvonshme të fshehur; gjithashtu ai stepet nga frika e një shuplake të tanishme më shumë se sa dënimi i një viti në të ardhmen. Për më tepër, në qoftë se emocionet -ndjenjat- janë mbisunduese tek një njeri, ato nuk i kushtojnë vëmendje arsyetimit të mendjes. Dëshirat dhe iluzionet sundojnë dhe ai preferon një kënaqësi shumë të vogël të tanishme mbi shpërblimin shumë më të madh në të ardhmen. Dhe ai shmanget nga një shqetësim i pjesshëm i tanishëm më shumë se sa një ndëshkim i tmerrshëm i mëvonshëm. Dhe meqenëse dëshirat, iluzionet dhe emocionet nuk e shikojnë të ardhmen; madje ato mund ta mohojnë

atë, dhe meqenëse ato nxiten e ndihmohen nga nefsi, atëherë zemra dhe mendja, të cilat janë vendi i imanit, heshtin dhe mposhten në çështjen e tyre. Kështu kryerja e gjynaheve të mëdha nuk buron nga mungesa e besimit, por nga mposhtja e zemrës dhe e mendjes nëpërmjet mbisundimit të emocioneve, dëshirave dhe iluzioneve.

Për më tepër, ashtu siç kuptohet nga treguesit e mëparshëm, rruga e pasioneve dhe e së keqes është shkatërrim e rrënim dhe, prandaj ajo është shumë e lehtë. Shejtanët prej xhindëve dhe njerëzve i shtyjnë njerëzit me shumë lehtësi për tek ajo rrugë.

Është shumë e çuditshme kur shikon se një prej njerëzve të dobët i ndjekin gjurmët e shejtanit duke preferuar kënaqësitë e kësaj dynjaje kalimtare, të cilat janë të barasvlershme me krahun e një mize, mbi kënaqësitë e asaj bote të përjetshme, në një kohë që siç vërtetohet nga hadithi sherif: "*Një dritë sa krahu i një mize prej botës së përjetësisë krahasohet dhe ua kalon të gjitha kënaqësive dhe mirësive që merr një njeri gjatë gjithë jetës së tij në këtë dynja".*

Për këto arsye e urtësi, Kur'ani i gjithurtë, në mënyrë të përsëritur e me këmbëngulje dhe me inkurajime e kërcënime, i ndalon besimtarët nga bërja e gjynaheve dhe i nxit ata për të bërë vepra të mira e të drejta.

Një herë ky udhëzim i fortë i Kur'anit të gjithurtë më dha idenë se këto paralajmërime të vazhdueshme dhe këto përkujtues i shfaqin besimtarët se janë të paqëndrueshëm dhe të mangët në veprat e mira. Kjo nxjerr si rrjedhim një pozitë që nuk i përshtatet nderit e prestigjit të njeriut, sepse përsëritja e një urdhri të vetëm për nëpunësin nga eprori i tij do ta bënte atë të mendonte se ai gjendet në një pozitë sikur të ishte i akuzuar për sinqeritetin e tij dhe për devocionin, dhe do të ofendohej rëndë në qoftë se eprori e përsërit dhjetë herë të njëjtin urdhër? Megjithatë, Kur'ani i gjithurtë i përsërit urdhëresat e tij me këmbëngulje për besimtarët më të sinqertë?

Në kohën që kjo ide po shqetësonte mendjen time, ishin me mua dy apo tre nga shokët e mi besnikë. Unë në mënyrë të vazhdueshme i paralajmëroja dhe ua kujtoja me qëllim që ata të mos mashtrohen nga intrigat e njerëzve djallëzorë, dhe unë nuk pashë asnjë shenjë tek ata që tregojnë se mbetën të ofenduar dhe asnjëri prej tyre nuk tha: Ti po na akuzon ne për sinqeritetin tonë. Kurse unë i flisja vetes sime dhe thoja: Unë jam duke i fyer ata me këto paralajmërime të vazhdueshme. Unë

po i akuzoj ata për mungesë besnikërie dhe për paqëndrueshmëri. Ndërkaq, papritmas m'u zbulua e vërteta e shpjeguar dhe e provuar në treguesit e lartëpërmendur. Unë kuptova se këmbëngulja e Kur'anit të gjithurtë dhe përsëritjet ishin me vend dhe ekzaktësisht siç kërkohen nga situata të urta dhe as të tepërta e as fyese; ato ishin thjesht urtësi e pastër dhe elokuencë e pastër.

Gjithashtu, unë kuptova arsyen se përse ata shokët e mi besnikë nuk u ofenduan nga përsëritja e atyre paralajmërimeve.

Një përmbledhje e asaj të vërtete është kjo: Veprimi i pjesshëm dhe i pakët i cili buron nga shejtanët bëhet shkak që të ndodhin të këqija të shumta, meqë ai është shkatërrim e rrënim.

Prandaj, ata që marrin rrugën e të vërtetës dhe të udhëzimit janë shumë në nevojë për të qenë të kujdesur e të vëmendshëm dhe për paralajmërime të përsëritura dhe për ndihmesë të vazhdueshme. Për këtë arsye, Allahu i Gjithëfuqishëm u jep ndihmë njerëzve të besimit nëpërmjet një mijë e një Emrave të Tij të Bukur lidhur me ato përsëritje dhe shtrin mijërat e duarve të mëshirës dhe të dhembshurisë për t'i ndihmuar ata. Ai nuk e shkatërron nderin e tyre, por e mbron. Ai nuk e zhvlerëson dhe nuk e përçmon dinjitetin e njeriut, por shfaq se e keqja e shejtanit është e madhe.

O Njerëzit e së vërtetës dhe o njerëzit e udhëzimit! Rruga për të shpëtuar nga të këqijat dhe nga dredhitë e lartëpërmendura të xhindëve dhe të njerëzve djallëzorë është kjo: Bëjeni selinë -vendtakimin- tuaj shkollën e njerëzve të së vërtetës, Sunitët, ose Ehl es-suneh vel-xhemaah; hyni në kalanë e fortifikuar të çështjeve të pakundërshtueshme të Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm; dhe merreni sunnetin e profetit Muhammed a.s.m. si udhëzuesin tuaj dhe gjeni shpëtim me ndihmën e Zotit xh.sh.!

- **Treguesi i Tetë**

Pyetje: Ti ke provuar në treguesit e lartëpërmendur se meqenëse rruga e çudhëzimit është e lehtë, shkatërrim dhe agresion, shumë e ndjekin atë rrugë. Ndërsa në pjesët e tjera të Risale-i Nurit ti ke provuar në mënyrë vendimtare se rruga e mosbesimit dhe e çudhëzimit është aq shumë e mbushur me vështirësi e probleme saqë askush nuk duhet ta marrë atë; dhe se është e pamundur ta ndjekësh atë. Dhe Ti ke provuar

se rruga e besimit dhe e udhëzimit është aq e lehtë dhe e qartë saqë të gjithë duhet ta ndjekin atë?!

Përgjigjja: Ka dy lloje mosbesimi e çudhëzimi. Njëri u përket veprimeve dhe çështjeve dytësore, dhe është gjithashtu mohim dhe refuzim i çështjeve të besimit. Ky lloj çudhëzimi është i lehtë. Ai është mospranim i të vërtetës, është heqje dorë, mosekzistencë dhe mungesë pranimi. Kështu, në Risale-i Nur ky lloj është treguar të jetë shumë i lehtë.

Sa për llojin e dytë, ai nuk u përket veprimeve dhe çështjeve dytësore, por është një gjykim me mendje dhe i përket besimit. Ai nuk mohon vetëm besimin, por hap një rrugë, e cila është e kundërta e besimit. Ai është pranimi i asaj që është e rreme, e pavlefshme dhe e anuluar, është prova e të kundërtës së të vërtetës. Ky nuk është vetëm mohim dhe refuzim i besimit, por është e kundërta e tij. Ai nuk është mospranim saqë të jetë i lehtë, por pranimi i mosqënies, dhe mund të provohet vetëm nëpërmjet të provuarit të mosekzistencës. Në përputhje me rregullin اَلْعَدَمُ لَا يُثْبَتُ "Mosekzistenca nuk mund të provohet", sigurisht nuk është e lehtë për ta provuar atë.

Kështu, ajo që është treguar në pjesët e tjera të Risale-i Nurit është ky lloj nga rruga e mosbesimit dhe e çudhëzimit të cilat janë aq të vështira e problematike saqë janë të pamundura. Kushdo që ka sa një grimcë arsye nuk do ta merrte këtë rrugë. Për më tepër, ashtu siç është demonstruar, kjo rrugë përmban dhimbje të tilla pikëlluese dhe errësira mbytëse saqë dikush i arsyeshëm në shkallën më të vogël, nuk do ta ndiqte atë.

Në qoftë se do të thuhej: Në qoftë se kjo rrugë është kaq e dhimbshme, e errët dhe e vështirë, atëherë përse e ndjekin atë shumica e njerëzve? Ata kanë rënë në të dhe nuk mund të dalin prej saj. Dhe për shkak se fuqitë shtazore dhe vegjetale tek njeriu nuk i shikojnë pasojat dhe nuk mendojnë për to dhe, ato i mbisundojnë aftësitë e holla të njeriut dhe e ngushëllojnë vetveten me një kënaqësi të tanishme të përkohshme.

Pyetje: Në qoftë se thuhet: Meqenëse në mohim është kjo dhimbje pikëlluese dhe kjo frikë e tmerrshme dhe se mohuesi, si njeri, dëshiron gjëra të panumërta, e do jetën dhe shikon vazhdimisht nëpërmjet

mohimit të tij, se vdekja e tij është një zhdukje e përhershme dhe ndarje e përjetshme dhe, se kalimi i qënieve dhe vdekjet e të dashurve të tij dhe ato të atyre që ai i do i shikon si asgjësim dhe si ndarje të përjetshme, atëherë si mund të jetojë një njeri i tillë? Si mundet ai të marrë kënaqësi nga jeta?

Përgjigjja: Ai e mashtron vetveten nëpërmjet një sofistike të jashtëzakonshme të shejtanit dhe jeton. Ai supozon se merr një kënaqësi të sipërfaqshme.

Ne do të aludojmë për natyrën e vërtetë të kësaj me krahasimin e mirënjohur:

Tregohet se njëherë iu tha strucit: "Ti ke krahë, atëherë përse nuk fluturon!" Por ai i palosi krahët e tij dhe tha: "Unë jam deve", dhe nuk fluturoj. Kështu ai ra në kurthin e gjahtarit dhe, duke mos dashur që gjahtari ta shikojë, struci e fut kokën në rërë.

Megjithatë ai e la trupin e tij të madh të zbuluar dhe ishte objektivi i gjuetarit. Pastaj i thanë atij: "Meqenëse ti je një deve ashtu siç pretendon, atëherë mbaji për ne këto pesha". Pastaj ai hapi krahët e tij dhe tha: "Unë jam zog" dhe u shpëtua nga vështirësia e mbajtjes së peshave. Por duke mos pasur as mbrojtje, as ushqim, ai u ndoq nga gjahtarët.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, mohuesi pasi lëvizi e u tërhoq prej mosbesimit të tij absolut përballë paralajmërimeve qiellore të Kur'anit, ra në një mohim të dyshimtë, në skepticizëm. Në qoftë se ai do të pyetej: Si mundet të jetosh ndërsa para teje është vdekja dhe zhdukja të cilat ti i mendon se ato janë një asgjësim i përjetshëm? A mund të marrë kënaqësi nga jeta ai që shkon me hapat e tij drejt litarëve të varjes?

Për shkak të pjesës që ai ka marrë prej mëshirës universale të Kur'anit dhe nga drita e tij gjithëpërfshirëse, filloi të dyshojë prej mohimit absolut dhe u përgjigj: "vdekja nuk është asgjësim; ka një mundësi pavdekshmërie pas saj". Ose ndryshe, ai e fut kokën e tij në rërën e pavëmendshmërisë, si struci, me qëllim që të mos e shohë Exheli, të mos e vështrojë atë varri dhe, të mos e gjuajë atë zhdukja me shigjeta!

Shkurtazi: Mohuesi, ashtu si struci, kur e shikon vdekjen dhe zhdukjen të jenë asgjësim për shkak të skepticizmit, përpiqet që ta shpëtojë vetveten prej atyre dhimbjeve duke u kapur pas njoftimeve të sigurta të Kur'anit dhe të gjitha librave qiellorë lidhur me إِيمَانٌ بِالْآخِرَةِ "Besimin në Ahiret", njoftime të cilat i japin atij një mundësi për jetën pas vdekjes.

Në qoftë se do t'i thuhej atij: Përderisa fundi është për tek një botë e përjetshme, për një jetë të mirë atje, atëherë përse nuk i kryen detyrat me të cilat të obligon ky besim, feja, me qëllim që të gëzohesh në atë botë? Personi do të përgjigjej nga këndvështrimi i mohimit të tij të dyshuar: "Ndoshta nuk ekziston një botë e tillë, atëherë përse duhet të punoj për diçka që nuk ekziston? Domethënë, ai e shpëton veten e tij nga dhimbjet e asgjësimit të përhershëm në vdekje me premtimet që jep Kur'ani për jetën e pavdekshme, ndërsa kur përballet me vështirësitë e obligimeve fetare, ai kapet pas mundësisë së mosbesimit dhe shpëton nga vështirësia e atyre obligimeve. Domethënë, mosbesimtari, nga ky këndvështrim, pandeh se ai merr më shumë kënaqësi nga kjo jetë e dynjasë se sa besimtarët, sepse ai shpëton nga vështirësitë e obligimeve fetare nëpërmjet mundësive të mohimit të tij dhe, në të njëjtën kohë, për shkak të mundësisë së dhënë nga besimi, ai nuk e zbulon vetveten para dhimbjeve të përhershme.

Megjithatë, kjo sofistikë djallëzore është shumë e sipërfaqshme, e përkohshme dhe pa dobi.

Dhe kështu bëhet e qartë se si ndodhet një aspekt prej mëshirës gjithëpërfshirëse të Kur'anit edhe për mohuesit, i cili i shpëton ata deri diku nga një jetë si Xhehennemi dhe, i bëri ata që të mund të jetojnë një jetë në jetën e dynjasë me një lloj dyshimi në mohimin e tyre absolut. Përndryshe, ata do të kishin vuajtur torturat e një lloji xhehennemi edhe në këtë botë gjithashtu, duke u kujtuar atyre Ferrin e Botës tjetër, dhe ata do të detyroheshin të vrisnin vetveten.

O Njerëzit e besimit! Me të gjithë sigurinë, me mirëbesim dhe me qetësi, hyni nën mbrojtjen e Kur'anit, i cili do t'ju shpëtojë ju nga asgjësimi i përjetshëm i ferrëve të kësaj bote dhe të botës tjetër. Dhe me nënshtrim të plotë e me admirim qëndroni brenda caqeve të sunnetit

të profetit Muhammed a.s.m... dhe shpëtojini vetet tuaja nga mjerimi i dynjasë dhe nga dënimi i Ahiretit...

● **Treguesi i Nëntë**

Pyetje: Përse ndodh që njerëzit e udhëzimit, të cilët janë Partia e Zotit xh.sh., mposhten aq shumë herë nga njerëzit e çudhëzimit, të cilët janë partia e shejtanit? Pavarësisht se ata të udhëzuarit janë të rrethuar nga përkujdesja dhe nga mëshira Hyjnore dhe marrin shumë ndihmë e favore nga Krijuesi, dhe në krye të radhëve të tyre qëndrojnë pejgamberët e nderuar, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ta dhe ata të gjithë i udhëheq Krenaria e Botës a.s.m.? Cila ishte arsyeja për hipokritët e Medinesë që këmbëngulnin në çudhëzim dhe që nuk e përqafuan udhëzimin, pavarësisht se ata ishin afër Profetit më të nderuar a.s.m., profetësia dhe mesazhi i të cilit ndriçojnë si dielli dhe ai u kujton Kur'anin e mrekullueshëm i cili ndikon në shpirtëra si elikziri më i madh dhe i udhëzon ata me të vërtetat Kur'anore, të cilat i tërheqin të gjithë me një fuqi më të madhe se sa ligjet universale të gravitetit?

Përgjigjja: Është e domosdoshme të shpjegohet një parim i thellë me qëllim që të zgjidhim dy pjesët e kësaj pyetje të çuditshme. Ai është sa vijon:

Krijuesi i gjithësisë ka dy lloj Emrash, ato që i përkasin Madhështisë së Tij dhe ato që i përkasin Bukurisë së Tij. Meqenëse këto Emra kërkojnë të demonstrojnë shkallët e tyre nëpërmjet manifestimeve të ndryshme, Krijuesi i Gjithëlavdishëm i ka kombinuar së bashku të kundërtat në univers. Duke i sjellë ato ballë për ballë, Ai u dha atyre pozita agresive dhe mbrojtëse, në formën e një lloji urtësie dhe të një kundërshtimi të dobishëm. Duke i bërë të kundërtat të tejkalojnë limitet e njëra-tjetrës, Ai solli konfliktin në qënie, dhe e bëri universin t'i nënshtrohet ligjit të ndryshimit e të transformimit dhe parimeve të përparimit dhe të progresit. Prandaj Ai e bëri njeriun, i cili është fruti gjithëpërfshirës i pemës së krijimit, ta ndjekë atë ligj kundërshtimi në formën më të çuditshme, domethënë ligjin e dyluftimit dhe të mbrojtjes, dhe duke hapur para tij derën e "Luftës e të përpjekjes", e cila do të ishte boshti për të gjithë përparimin njerëzor dhe për plotësimet, Ai i dha partisë së shejtanit disa aftësi me të cilat ata të kenë mundësi të përballen me Partinë e Allahut në fushën e

betejës. Për shkak të këtij misteri të hollë, profetët shpesh mposhteshin para njerëzve të çudhëzimit. Dhe njerëzit e çudhëzimit, që janë shumë të dobët e të pafuqishëm, triumfojnë përkohësisht mbi njerëzit e së vërtetës, të cilët në realitet janë shumë të fuqishëm, dhe luftojnë kundra tyre. Urtësia në këtë kundërshtim të çuditshëm është sa vijon:

Në çudhëzim e në mohim është edhe mosekzistenca edhe mohimi, kështu që ai është shumë i lehtë dhe nuk kërkon lëvizje a veprim.. dhe në të është gjithashtu shkatërrimi, i cili është jashtëzakonisht i kollajtë dhe për të cilin nevojitet vetëm një lëvizje e pakët.. Gjithashtu në të ndodhet agresion, ku një veprim i pakët dhe i kollajtë prej tij shkakton dëm tek shumë, dhe nga këndvështrimi i kërcënimit ndaj të tjerëve dhe lidhur me kënaqjen e dëshirës së nefsit për fuqi, ai bën të fitojë rang dhe pozitë për një person..

Pastaj njeriu ka shqisa lëndore dhe forca shtazore e vegjetale të cilat nuk i shohin pasojat fundin dhe as nuk mendojnë për to dhe të cilat magjepsen e pushtohen nga kënaqësitë e tanishme të çastit. Të kënaqurit e këtyre forcave, përmbushja e dëshirave dhe orekseve të tyre dhe t'i lësh të lira, i bën aftësitë e holla të njeriut si mendja dhe zemra, të heqin dorë nga detyrat e tyre themelore, të cilat janë ndjenjat e larta njerëzore që marrin në konsideratë pasojat e përfundimin.

Sa për rrugën e shenjtë të njerëzve të udhëzimit dhe atë të profetëve me në krye të Dashurin e Zotit të të gjitha botëve a.s.m., ajo i përket ekzistencës, është pozitive dhe ndërtimore; gjithashtu ajo bazohet mbi parime të rëndësishme si të vepruarit, maturia -mesi i artë, e drejta-, merr në konsideratë pasojat dhe adhurimin e pastër; gjithashtu ajo e copëton tiraninë e nefsit urdhërues për të liga dhe pavarësinë e tij. Për shkak të kësaj, hipokritët e kohës së profetit në Medine i mbyllën sytë e tyre para atij dielli rrezatues, ashtu si lakuriqësat, dhe duke ua nënshtruar vetet e tyre forcës zmbrapëse të shejtanit, mbetën në çudhëzim dhe nuk u tërhoqën nga ajo tërheqje e madhe e Kur'anit dhe e të vërtetave të tij të përjetshme.

Në qoftë se do të thuhej: Meqenëse Profeti Muhammed a.s.m. ishte i Dashuri i Krijuesit të të gjitha botëve; dhe në dorën e tij ishte e vërteta dhe, në gjuhën e tij ishte realiteti; të cilin e mbështeti Allahu në betejat e tij me melekët si ushtarë të fortë; i cili ngopi me një grusht ujë që shpërtheu nga gishtërinjtë e tij; i cili ngopi një mijë njerëz me një kec të

pjekur me katër grushta grurë, dhe i cili e bëri ushtrinë e mosbesimtarëve të ikin nga beteja duke u hedhur atyre një grusht pluhur i cili hyri tek të gjithë sytë e tyre; Si është e mundur që ky komandant Hyjnor i cili realizoi një mijë mrekulli të ngjashme me këto u mposht në fund të luftës së Uhudit dhe në fillim të betejës së Hunejnit?

Përgjigjja: Profeti Muhammed a.s.m. u dërgua për të gjithë njerëzimin si model, si imam e si udhëzues për t'u ndjekur me qëllim që njerëzit të mësojnë prej tij rregullat e jetës shoqërore dhe personale dhe, që të mësohen me bindjen ndaj ligjeve të urta të Dëshirës Hyjnore dhe të veprojnë në përputhje me parimet e Urtësisë së Tij. Në qoftë se i Dërguari a.s.m. do të mbështetej gjithmonë mbi mrekullitë dhe mbi kerametet në të gjitha aktet e tij personale e shoqërore, atëherë ai nuk do të mund të kishte qenë as një imam absolut dhe as shembull i plotë i mirë për të gjithë njerëzimin.

Për shkak të kësaj, nga koha në kohë, ai i shfaqi mrekullitë, në përgjigje të nevojës, vetëm me qëllim që t'i bënte ata të vërtetojnë pretendimin e tij të profetësisë dhe të shfuqizonte e të hidhte poshtë mohimin e jobesimtarëve. Në kohët e tjera, ai iu bind urdhëresave Hyjnore më shumë se kushdo, ai veproi në përputhshmëri me ligjet Hyjnore në krijim të themeluara nëpërmjet Urtësisë Hyjnore dhe dëshirës dhe iu nënshtrua atyre. Ai vishte mburojën kur ndeshej me armikun dhe urdhëronte ushtarët e tij të futeshin në llogoret e tyre. Ai mori plagë dhe vuajti tortura e mundim. Në këtë mënyrë ai iu bind dhe iu përmbajt plotësisht ligjeve të Urtësisë Hyjnore dhe sheriatit më të madh të krijimit.

- **Treguesi i Dhjetë**

Njëra nga dredhitë më të mëdha të Iblisit -shejtanit- është bërja e atyre të cilët e ndjekin që të mohojnë vetveten. Meqenëse në këtë kohë ata që i kanë mendjet të njollosura nga filozofia materialiste kanë qenë veçanërisht ngurrues në këto çështje të vetëkuptueshme, ne do të themi një ose dy gjëra përballë kësaj dredhie të Shejtanit. Ato janë siç vijon:

Ashtu siç është vërtetuar prerazi, nëpërmjet shikimit, ekzistenca e shpirtërave të këqinj në trupat njerëzorë në botën e njeriut, të cilët kryejnë detyrën e Shejtanit dhe të veprave të tij; po ashtu është vërtetuar në mënyrë të prerë ekzistenca e shpirtërave të këqinj pa trupa

në botën e xhindëve. Në qoftë se këtyre do t'u visheshin trupa fizikë, do të ishin të njëjtë si ata qënie të këqija njerëzore. Gjithashtu, në qoftë se ata shejtanë të cilët janë në formën njerëzore do të ishin në gjendje të zhvisheshin nga trupat e tyre, ata do të bëheshin shejtanë prej xhindësh.

Si rrjedhojë e kësaj lidhjeje të tmerrshme, një shkollë devijuese - njëri nga medhhebet e shmangura- deklaroi duke thënë: "Shpirtërat e ndyrë të këqinj të trupëzuar në formën njerëzore transformohen në shejtanë pas vdekjes së tyre".

Dihet qartë se kur prishet diçka e çmueshme, e shtrenjtë, ajo bëhet më e prishur se sa diçka me çmim të lirë. Për shembull, Në qoftë se prishen kosi e qumështi, ato përsëri mund të hahen, por në qoftë se prishet vaji -yndyra-, bëhet e pangrënshme, madje helmuese. Po kështu njeriu i cili është më i nderuari i krijesave dhe madje më i larti i tyre, në qoftë se ai prishet, do të bëhej më i prishur dhe më i ulët se sa vetë kafsha e prishur. Ashtu si insektet, parazitët të cilët kënaqen duke pickuar nëpër gjëra të kalbura dhe me erëra të këqija, dhe si gjarpërinjtë që kënaqen duke kafshuar e helmuar të tjerët, edhe ata krenohen e gjejnë kënaqësi me të ligat dhe me moralet e prishura të moçalit të çudhëzimit, duke u kënaqur me dëmet dhe me krimet që burojnë nga errësirat e keqbërjes; atëherë ata marrin natyrën e shejtanit...

Po, një tregues vendimtar për ekzistencën e shejtanëve prej xhindëve është ekzistenca e shejtanëve prej njerëzve.

Së Dyti: Të gjithë qindrat e dëshmive vendimtare duke provuar ekzistencën e engjëjve dhe të qënieve shpirtërore në Fjalën e Njëzet e Nëntë provojnë gjithashtu ekzistencën e shpirtërave të këqinj. Ne ia referojmë këtë aspekt asaj Fjale.

Së Treti**:** Ekzistenca e melekëve, të cilët janë përfaqësuesit dhe mbikëqyrësit e ligjeve të çështjeve të mira në univers, është vërtetuar e pranuar unanimisht nga të gjitha fetë. Po ashtu ekzistenca e shpirtërave të këqinj djallëzorë, të cilët janë përfaqësuesit, sipërmarrësit e treguesit e çështjeve të këqija dhe mjetet e ligjeve të atyre gjërave të atilla, kërkohet nga urtësia dhe nga realiteti dhe është e sigurt.

Madje, ekzistenca e një shkaku apo e një perdeje të fshehur prej një qënieje të vetëdijshme në ushtrimin e çështjeve të këqija mund të jetë

më e domosdoshmja; pra, në çështjet e liga, një perde e vetëdijshme është më e domosdoshmja; sepse ashtu siç e përmendëm në fillim të Fjalës së Njëzet e Dy, meqenëse çdo njeri nuk mund ta shohë bukurinë e vërtetë të të gjitha gjërave, Krijuesi i Gjithëlavdishëm i ka bërë ndërmjetësitë e dukshme një perde për të këqiat dhe për mangësitë e dukshme, me qëllim që kundërshtimet të mos i drejtohen atij, që të mos akuzohet mëshira e Tij, as të mos kritikohet urtësia e Tij apo t'i ankohen padrejtësisht dhe, me qëllim që kundërshtimet, kritikat dhe ankesat të drejtohen tek perdet dhe jo të drejtohen tek Krijuesi Gjithëbujar dhe tek i Gjithurti i Gjithëditur. Ashtu siç e ka bërë Ai sëmundjen një perde për Exhelin e vdekjes me qëllim që ta shpëtojë Azrailin, "Melekun e vdekjes, nga ankesat e shërbëtorëve të Tij të cilët vdesin, po ashtu Ai e ka bërë Azrailin një perde për marrjen e shpirtërave të të vdekurve me qëllim që ankesat në atë situatë, e cila imagjinohet se është mungesë në mëshirë, të mos i drejtohet Allahut të Plotëfuqishëm.. Po kështu, me një siguri më të madhe urtësia Hyjnore kërkoi ekzistencën e shejtanit, me qëllim që kundërshtimet dhe kritikat përballë të ligave dhe gjërave të këqija të mos drejtohen tek Krijuesi i Gjithëlavdishëm.

Së Katërti: Ashtu si njeriu që është një botë e vogël, po ashtu bota është një qënie e madhe njerëzore. Ky njeri i vogël është një ideks dhe një përmbledhje e botës së madhe.

Origjinat e mëdhaja të shembujve e modeleve të zvogëluara në njeriun, do të gjenden domosdoshmërisht në njeriun e madh - Universin. Për shembull, ekzistenca e aftësisë së memories së njeriut është një tregues i sigurt i ekzistencës së Pllakës së Ruajtur në Botë. Gjithashtu, gjithësecili nga ne ndjen dhe përjeton në vetvete aftësinë e brendshme të vendosur në një qoshe të zemrës së tij e cila është mjeti i pëshpëritjeve dhe i sugjerimeve djallëzore, i tundimeve dhe i gjuhës së Shejtanit që flet nëpërmjet nxitjeve e pëshpëritjeve të imagjinatës, e cila bëhet si një Shejtan i vogël dhe vepron në kundërshtim me vullnetin e pronarit të saj dhe në kundërshtim me dëshirat e tij - këto janë dëshmi të sigurta për ekzistencën e Shejtanëve të mëdhenj në botë. Pastaj kjo aftësi e brendshme e cila është mjeti për nxitjet e pëshpëritjet djallëzore dhe ajo fuqi e imagjinatës, deduktojnë e nxjerrin si rrjedhim ekzistencën e një individi të keq të jashtëm i cili fryn në të parën, bën të flasë në të dytën dhe i vë ato në shërbim si veshin dhe gjuhën.

● **Treguesi i Njëmbëdhjetë**

Kur'ani i Gjithurtë shpreh në mënyrë të mrekullueshme se universi zemërohet nga e keqja e njerëzve të çudhëzimit, elementet e gjithësisë bëhen të zemëruar dhe të gjitha qëniet bëhen të tërbuara. Në mënyrë madhështore ai përshkruan pjesëmarrjen e qiellit e të tokës në sulmet kundra popullit të Nuhut a.s. në tufanin -përmbytjen- që u ra atyre, stuhitë mbi popullin e Adit, ulurimën e erës mbi popullin e Themudit; tërbimin e detit dhe i elementit të ujit mbi popullin e Faraonit, dhe zemërimin e madh të elementit të tokës mbi Karunin... dhe në përputhje me vërsetin,

تَكَادُ تَمَيَّزُ مِنَ الْغَيْظِ *"Ai pothuaj shpërthen me vrull e tërbim..."*[4] edhe zjarri i xhehennemit tërbohet e zemërohet mbi njerëzit e mohimit në Ahiret, dhe zemërimi i qënieve të tjera ndaj jobesimtarëve dhe ndaj njerëzve të çudhëzimit; në mënyrë të mrekullueshme, ai i ndalon njerëzit e çudhëzimit dhe të mosbindjes.

Pyetje: Përse veprat e parëndësishme dhe mëkatet personale të njerëzve të parëndësishëm tërheqin zemërimin e universit në këtë mënyrë?

Përgjigjja: siç është provuar në pjesët e tjera të Risale-i Nurit dhe në treguesit e mëparshëm, mohimi dhe çudhëzimi janë agresion i tmerrshëm dhe krime që prekin të gjitha qëniet që lidhen me to, sepse njëri nga rezultatet më të rëndësishëm të krijimit të universit është adhurimi i njeriut dhe përgjigjja e tij me besim, me bindje e nënshtrim ndaj Hyjnisë së Perëndisë. Atëherë, mohimi i këtij rezultati më të madh nga ana e tyre -i cili është shkaku përfundimtar i qënieve dhe arsyeja për ekzistencën e tyre të vazhdueshme- është një lloj agresioni e shkelje ndaj të drejtave të të gjitha qënieve.

Për më tepër, meqenëse mosbesimtarët mohojnë manifestimet e Emrave Hyjnorë të cilët janë të dukshëm në pasqyrat e në qëniet dhe ngrejnë vlerën e tyre, me këtë mohim ndaj atyre Emrave të Bukur, të asaj pozite të lartë të qënieve dhe të rëndësisë së tyre, ata i fyejnë rëndë ato Emra të shenjtë, ulin vlerën e të gjitha qënieve dhe i përçmojnë shumë ato. Dhe ndërsa të gjitha qëniet janë nëpunës Hyjnorë të

[4] Kur'an, 67:8

ngarkuar me detyra të larta, njerëzit e çudhëzimit i poshtërojnë ato dhe, duke i treguar se ato janë të pajeta, të përkohshme dhe krijesa të pakuptimta, ata në një mënyrë shkelin të drejtat e të gjithë atyre.

Kështu, meqenëse çudhëzimi me llojet e tij të ndryshëm -secili sipas shkallës së tij- mohojnë urtësinë Hyjnore në krijimin e universit dhe refuzojnë qëllimet Hyjnore në ekzistencën e vazhdueshme të botës, atëherë universi bëhet i zemëruar mbi njerëzit e mosbindjes dhe të çudhëzimit, ashtu siç zemërohen kundra tyre të gjitha qëniet dhe krijesat.

O Njeri i mjerë i pafuqishëm! O ti i mjerë që e ke trupin të vogël, por fajet dhe mëkatet i ke të rënda! Në qoftë se dëshiron të shpëtosh nga zemërimi i universit, nga tërbimi i qënieve dhe nga neveria e krijesave, atëherë ja rruga e shpëtimit: Është hyrja në sferën e shenjtë të Kur'anit të gjithurtë dhe ndjekja e sunnetit të pastër Profetik, i cili ishte lajmëtari i Kur'anit. Prandaj, hyr në ato limite dhe ndiqe sunnetin e Profetit a.s.m.!

● **Treguesi i Dymbëdhjetë**

Ky përbëhet nga katër pyetje dhe përgjigje.

Pyetja e Parë:

Si mund të jetë drejtësi një dënim i pakufishëm në një xhehennem të pafundmë për gjynahe të kufizuara në një jetë të kufizuar?

Përgjigjja: Është kuptuar në mënyrë të qartë në treguesit e lartëpërmendur dhe veçanërisht në treguesin e Njëmbëdhjetë, se mohimi dhe çudhëzimi janë një krim i pafundmë dhe një agresion e shkelje ndaj të drejtave të pakufishme.

Pyetja e Dytë: Në sheriat thuhet se Xhehennemi është ndëshkim për veprat, kurse Xhenneti është një favor Hyjnor?

Përgjigjja: Është treguar qartë në treguesit e lartëpërmendur se: njeriu është shkak për një shkatërrim të madh dhe për të këqija të shumta me një dëshirë të pjesshme pa krijueshmëri, me një prirje e një fitim të pjesshëm dhe duke i dhënë formë e realitet diçkaje mosekzistuese ose teorike. Gjithashtu, meqenëse nefsi i tij dhe dëshirat e ulëta priren gjithmonë drejt të këqijave dhe dëmeve, ai është

përgjegjës për të këqijat që burojnë nga ajo pirje e lehtë dhe nga ai fitim, sepse nefsi i tij i deshi ato dhe dëshirat e tij u japin shkas atyre. Dhe meqenëse e keqja i përket mosekzistencës, shërbëtori është vepruesi i saj; ndërsa Allahu i Plotëfuqishëm e krijon atë.

Duke qenë përgjegjës për atë krim të pafundmë, ai sigurisht meriton ndëshkim të pafund.

Ndërsa lidhur me veprat e mira, meqenëse ato i përkasin ekzistencës, dëshira e pjesshme e njeriut dhe prirja nuk mund të jenë shkaku i drejtpërdrejtë i ekzistencës së tyre. Njeriu nuk mund të jetë vepruesi i vërtetë në një akt të tillë. Gjithashtu, nefsi urdhërues për të liga i njeriut nuk priret drejt veprave të mira, por është Mëshira Hyjnore ajo e cila i kërkon ato, dhe Fuqia Hyjnore i krijon. Veçse ama njeriu mund të jetë pronar i atyre veprave të mira nëpërmjet imanit, dëshirës dhe nijetit. Dhe pasi t'i ketë shtënë në dorë si pronë, ato vepra të mira të tilla janë në vetvete falënderim ndaj mirësive Hyjnore të pafundme të cilat Allahu xh.sh. ia ka dhuruar njeriut, dhe në krye të të cilave është mirësia e ekzistencës dhe mirësia e imanit. Domethënë, ato vepra të mira janë falënderim për mirësitë e mëparshme. Ndërsa Xhenneti, të cilin Allahu ua ka premtuar për t'ua dhënë shërbëtorëve të Tij, dhurohet nëpërmjet thjesht favorit të pastër Hyjnor. Ai edhe në qoftë se në anën e jashtme duket si një shpërblim për besimtarin, por ama, në të vërtetë, ai është një mirësi e një favor nga ana e Zotit xh.sh.. Domethënë, në të këqijat nefsi njerëzor është shkaku dhe meriton ndëshkim; ndërsa në veprat e mira, meqenëse shkaku e arsyeja janë prej Allahut, mund t'i pretendojë për t'i shtënë në dorë vetëm nëpërmjet besimit. Ai nuk mund të thotë: "Unë dua shpërblimin e tyre", por ai mund të thotë: "Unë shpresoj favor prej Allahut xh.sh.."

Pyetja e Tretë: Siç u kuptua nga shpjegimet e mëparshme se, meqenëse të këqijat bëhen të shumta nëpërmjet agresionit dhe përhapjes, një vepër e keqe e vetme duhet të regjistrohet si një mijë. Ndërsa veprat e mira, meqenëse janë pozitive dhe i përkasin ekzistencës, ato nuk bëhen të shumta nga aspekti lëndor, dhe meqenëse ato nuk ndodhin nëpërmjet krijimit të shërbëtorëve apo të dëshirave të nefsit të tij, ato nuk duhet të shkruhen vetëm si një e mirë e vetme. Atëherë, përse vepra e keqe shkruhet si një e keqe, kurse e mira shkruhet sa dhjetë të mira, dhe ndonjëherë sa një mijë?

Përgjigjja: Allahu i Plotëfuqishëm e demonstron mëshirën e Tij të plotë dhe bukurinë e mëshirëgjërësisë së Tij për robët e Tij në këtë mënyrë.

Pyetja e Katërt: Sukseset që kanë arritur njerëzit e çudhëzimit, fuqia që ata demonstrojnë dhe fitoret e tyre mbi njerëzit e udhëzimit tregojnë se ata mbështeten mbi ndonjë fuqi dhe të vërtetë. Kjo do të thotë se ose ka dobësi tek njerëzit e udhëzimit, ose ka ndonjë të vërtetë tek njerëzit e çudhëzimit?

Përgjigjja: Ruajna Zot! As tek njerëzit e udhëzimit nuk ka dobësi dhe as tek njerëzit e çudhëzimit nuk ka ndonjë realitet. Por, me keqardhje disa nga njerëzit e zakonshëm të cilët janë dritëshkurtër dhe të paarsyeshëm bëhen dyshues e ngurrues, dhe dënimi i vjen besimit të tyre; sepse ata thonë: "Në qoftë se njerëzit e së vërtetës do të kishin pasur të drejtën e plotë dhe realitetin, ata nuk do të kishin pësuar humbje e poshtërim deri në këtë shkallë, sepse e vërteta është e fuqishme dhe sipas parimit themelor: اَلْحَقُّ يَعْلُوْ وَلَا يُعْلٰى عَلَيْهِ *"E vërteta është më e lartësuara dhe nuk do të mposhtet", fuqia qëndron në të vërtetën*, në qoftë se njerëzit e çudhëzimit, të cilët kanë mbisunduar mbi njerëzit e së vërtetës, nuk do të kishin pasur një fuqi të vërtetë dhe një pikë mbështetjeje, nuk do të kishin qenë të suksesshëm dhe triumfatorë deri në këtë shkallë".

Përgjigjja: Siç është provuar në treguesit e mëparshëm: Mposhtja e njerëzve të së vërtetës përballë njerëzve të së shtrembërës nuk buron nga mungesa e fuqisë dhe as se janë të dobët, dhe fitorja e njerëzve të çudhëzimit dhe mbisundimi i tyre nuk buron nga fuqia e tyre e nga aftësia dhe as nga ekzistenca e ndonjë pike mbështetjeje për ata; kështu përgjigjja për këtë pyetje jepet nga të gjithë treguesit e lartëpërmendur. Ne këtu do të tregojmë dredhitë e tyre dhe diçka nga armët e tyre që i përdorin.

Unë vetë kam vëzhguar shpeshherë se keqbërësit, të cilët përbëjnë dhjetë përqind, i mposhtin njerëzit e drejtë, të cilët përbëjnë nëntëdhjetë përqind. Unë çuditesha shumë në këtë çështje. Pastaj duke e hetuar çështjen, unë kuptova me siguri se fitorja e tyre nuk rezultonte nga fuqia, por nga rruga e tyre e prishur, nga e keqja, poshtërsia dhe nga shkatërrimi duke shfrytëzuar ndryshimet e grindjet ndërmjet njerëzve të

së vërtetës, duke mbjellur konflikte midis tyre, duke shfrytëzuar pikat e tyre të dobëta të karakterit dhe duke i shartuar ata me tipare të tilla, duke nxitur ndjenjat e nefsit dhe urrejtjen personale dhe duke përdorur aftësitë e këqija në natyrën njerëzore të cilat janë si mineralet e prishjes, dhe nëpërmjet lajkave shtinjake të tiranisë së nefsit në emrin e famës, lavdisë dhe influencës.. dhe frika e njerëzve nga shkatërrimet e tyre të padrejta e rrënuese...

Nëpërmjet dredhive djallëzore të tilla si këto, ata triumfojnë përkohësisht mbi njerëzit e së vërtetës. Por kjo fitore e përkohshme e tyre nuk ka vlerë e rëndësi përpara sihariqeve të Allahut xh.sh..

وَٱلْعَـٰقِبَةُ لِلْمُتَّقِينَ *"Dhe fundi (i shkëlqyer) është për të përkushtuarit në besim"*[5] dhe përpara rregullit: ٱلْحَقُّ يَعْلُوا وَلَا يُعْلَىٰ عَلَيْهِ "*E vërteta është më e lartësuara dhe ajo nuk do të mposhtet"*; sepse triumfi i tyre i përkohshëm bëhet shkak për hyrjen e tyre në zjarr dhe për fitimin e Xhennetit nga njerëzit e së vërtetës.

Kështu, për shkak se në çudhëzim ata pa fuqi shfaqen të fuqishëm dhe të papërfillshmit fitojnë famë, ata marrin një pozitë që i kundërshtojnë njerëzit e së vërtetës. Në këtë rrugë njerëzit mendjemëdhenj, famëkërkues e hipokritë demonstrojnë fuqinë e tyre, që është shumë e vogël, dhe fitojnë një pozitë për vetveten duke i kërcënuar të tjerët dhe duke u shkaktuar dëm atyre me qëllim që të shikohen nga njerëzit dhe që të tërheqin vëmedjen e tyre, dhe me qëllim që ata t'i përmendin dhe që t'ua atribuojnë atyre aktet e shkatërrimit, të cilat nuk burojnë nga fuqia dhe aftësia e tyre, por nga braktisja e të mirës dhe nga shfuqizimi i saj. Saqë përmendet si proverbë se "një njeri i joshur e i robëruar pas famës dhunoi e ndoti një faltore vetëm me qëllim që ta përmendnin njerëzit, dhe në të vërtetë e përmendën... por me mallkim; mirëpo lakmia e tij e fortë për famë ia zbukuroi atij këtë përmendje të keqe të mallkuar dhe ai e pa si të bukur.

O Njeri i mjerë që je krijuar për botën e përjetësisë dhe që je i sprovuar dhe i joshur pas kësaj dynjaje të përkohshme! Studioje kuptimin e vërsetit,

[5] Kur'an, 7:128

فَمَا بَكَتْ عَلَيْهِمُ السَّمَاءُ وَالْأَرْضُ *"Dhe nuk qanë për ta as qielli e as toka".*[6]

dhe kushtoji vëmedje atij. Shiko çfarë thotë ai? Me kuptimin e tij të qartë, ai thotë: Kur njerëzit e çudhëzimit vdesin, qiejt dhe toka, të cilat janë të lidhura me njeriun, nuk qajnë për ta; domethënë, ato janë të kënaqur me vdekjet e tyre. Ndërsa me kuptimin e tij të nënkuptuar, ai thotë: "Qiejt dhe toka qajnë mbi kufomat e njerëzve të udhëzimit kur ata vdesin; ato nuk dëshirojnë që ata të largohen e të ndahen, sepse i gjithë universi është i lidhur me njerëzit e besimit dhe janë të lumtur me ta; sepse meqenëse ata e njohin Krijuesin e universit nëpërmjet besimit, ata e çmojnë vlerën e universit, e respektojnë atë dhe e duan. Ata nuk ushqejnë armiqësi të nënkuptuar dhe përbuzje për të ashtu si njerëzit e çudhëzimit.

O Njeri! Mendo për fundin tënd dhe mendo për të ardhmen tënde! Nuk ka dyshim se ti do të vdesësh. Në qoftë se ti ndjek nefsin tënd dhe Shejtanin, atëherë të gjithë komshinjtë e tu dhe madje edhe të afërmit do të gëzohen që shpëtuan nga të këqijat e tua. Por në qoftë se duke thënë: "I kërkoj strehim e mbështetem tek Allahu që të më ruajë nga djalli i mallkuar", ti ndjek urdhërat e Kur'anit të gjithurtë dhe sunnetin e të Dashurit të Krijuesit të të gjitha botëve, atëherë, sipas shkallës tënde, qiejt, toka dhe të gjitha qëniet do të dëshpërohen për ndarjen tënde, dhe në efekt ato qajnë. Duke mbajtur zi në mënyrë të lartësuar dhe duke të të dhënë ty një përcjellje të shkëlqyeshme, ato të tregojnë se në përputhje me shkallën tënde, ti do të kesh një mirëseardhje të këndshme në botën e përjetësisë, kur ti hyn tek ajo nëpërmjet derës së varrit.

● Treguesi i Trembëdhjetë

Kjo përbëhet nga tre pika

Pika e Parë:

Njëra nga dredhitë më të mëdhaja të Shejtanit është t'i mashtrojë njerëzit me mendje të ngushta, miopë dhe me zemra të ngushtuara lidhur me aspektin e madhështisë së të vërtetave të besimit. Ai thotë: Thuhet se një Qënie e vetme i drejton dhe i administron brenda Hyjnisë së Tij të gjitha grimcat dhe planetët e yjet dhe të gjitha qëniet e tjera

[6] kur'an, 44:29

dhe të gjitha gjendjet e tyre. Si mundet një person të besojë në një çështje të tillë të stërmadhe e të jashtëzakonshme? Si mund të përfshihet në zemër kjo çështje e çuditshme? Si mund ta pranojë mendja këtë?" Duke zgjuar me këtë një ndjenjë mohimi nga pika e pafuqisë së njeriut dhe e dobësisë së tij.

Përgjigjja: Rruga për ta heshtur këtë dredhi të Shejtanit është ***All-llahu Ekber****" Allahu është më i madhi*! Dhe përgjigjja e saj e vërtetë është ***"All-llahu Ekber***". Po, përsëritja e shpeshtë e ***All-llahu Ekber*** në të gjitha ritet e islamit e eliminon këtë dredhi; sepse nëpërmjet dritës së ***All-llahu Ekber***, pafuqia e njeriut, dobësia e tij, mungesa e forcës dhe mendimi i ngushtë i shikojnë ato të vërteta të mëdha të tilla të pakufishme dhe i vërtetojnë ato. Dhe nëpërmjet fuqisë së ***All-llahu Ekber,*** njeriu i mbështet ato të vërteta dhe i vendos ato brenda sferës së "***All-llahu Ekber***!" Dhe ai i thotë zemrës së tij e cila fillon të dyshojë:

Është e vetëkuptueshme dhe e qartë se universi drejtohet në mënyrën më të rregullt të cilën e vështron gjithkush që shikon, dhe kjo mund të shpjegohet veçse nëpërmjet dy mënyrave:

*Mënyra e Parë***:** Ajo është e mundur por është një mrekulli e jashtëzakonshme. Sigurisht, një vepër e tillë e çuditshme mund të ndodhë vetëm nëpërmjet një arti të çuditshëm në një mënyrë të çuditshme. Sa për këtë mënyrë, kjo është se të gjitha qëniet nuk janë krijuar veçse nëpërmjet Hyjnisë, dëshirës dhe fuqisë së Një të Adhuruari të Vetëm të Përjetshëm, për ekzistencën e të Cilit ndodhen dëshmitarë sa numri i qënieve, madje sa numri i grimcave të vockëla.

Mënyra e Dytë: Kjo është rruga e mohimit dhe e shirkut, e cila nuk është kurrsesi e mundur dhe është e vështirë deri në shkallën e qënies së saj e pamundur dhe aspak e arsyeshme, sepse ashtu siç është provuar në mënyrë vendimtare në shumë pjesë të Risale-i Nurit të tilla si Letra e Njëzet dhe Fjala e Njëzet e Dytë se do të duhej të ishte e pranishme në të gjitha qëniet në univers dhe madje në çdo grimcë një Hyjni absolute, një njohuri gjithëpërfshirëse dhe një fuqi e pafundme me qëllim që sistemi i plotë, rregullsia, balanca e ndjeshme, dallimi dhe qëndisjet e përkryera e të zbukuruara të artit për t'u vëzhguar në qëniet të mund të vinin në ekzistencë.

Shkurtazi: Në qoftë se nuk do të ishte një Hyjni Madhështore dhe e lartësuar e përshtatshme plotësisht për të drejtuar çështjet, atëherë do

të bëhej e domosdoshme të ndjekësh një rrugë e cila është e paarsyeshme në çdo drejtim dhe është e papranueshme. Madje edhe vetë shejtani nuk mund të propozojë ikjen prej asaj madhështie të tillë, e cila është e përshtatshme, e meritueshme dhe e domosdoshme, dhe të sugjerojë hyrjen në këtë pamundësi.

Pika e Dytë:

Një tjetër nga dredhitë e rëndësishme të shejtanit është: shtytja e njeriut për të mos pranuar fajet e tij, me qëllim që t'ia bllokojë atij rrugën e kërkimit të faljes dhe atë të kërkimit mbrojtje Allahut prej shejtanit. Ai gjithashtu nxit egoizmin e nefsit njerëzor me qëllim që nefsi të mbrojë vetveten si një avokat, duke e shfajësuar vetveten nga të gjitha fajet.

Po, një nefs që dëgjon shejtanin, nuk dëshiron t'i shohë gabimet e tij. Edhe sikur t'i shikonte, ai i shpjegon ato në njëqind mënyra. Në përputhje me thënien: وَعَيْنُ ٱلرِّضَا عَنْ كُلِّ عَيْبٍ كَلِيلَةٌ "*Syri i kënaqësisë është i verbër ndaj fajeve*", kur një person e shikon me kënaqësi veten e tij, ai nuk i sheh fajet e veta. Dhe për shkak se ai nuk i sheh fajet e veta, nuk i pranon ato dhe nuk kërkon falje, as nuk i kërkon mbrojtje Allahut prej tyre, dhe bëhet një lodër zbavitëse e Shejtanit. Si mund të besohet ky nefs urdhërues për të liga dhe të mbështetesh tek ai, ndërsa Kur'ani i gjithurtë e përmend atë nëpërmjet gjuhës së një Profeti të madh, Jusufit a.s. i cili tha:

وَمَآ أُبَرِّئُ نَفْسِىٓ إِنَّ ٱلنَّفْسَ لَأَمَّارَةٌۢ بِٱلسُّوٓءِ إِلَّا مَا رَحِمَ رَبِّىٓ

"Edhe unë nuk e shfajësoj veten time (nuk e liroj nga faji). Padyshim që Uni (nefsi njerëzor) është i prirur drejt së keqes, përveç kur Zoti derdh Mëshirën e Tij (mbi atë që do Ai)"[7].

Ai që e akuzon nefsin e tij, i shikon fajet e tij. Dhe ai që pranon gabimet e tij, kërkon falje për to. Dhe ai që kërkon falje, i kërkon mbrojtje Allahut, dhe ai që kërkon mbrojtje tek Allahu, shpëton nga e keqja e shejtanit. Faji më i madh është kur njeriu nuk shikon të metat e tij. Gjithashtu mangësia më e madhe do të ishte kur njeriu nuk pranon

[7] Kur'an, 12:53

mangësitë e veta. Mospranimi i fajit është një defekt i madh. Në qoftë se njeriu i shikon të metat, atëherë faji pushon së ekzistuari. Në qoftë se njeriu e pranon fajin, ai bëhet i denjë për falje.

Pika e Tretë:

Një dredhi djallëzore e cila prish jetën e shoqërisë është kjo: Ajo është mosshikimi i të gjitha virtyteve të një besimtari për shkak të një pike të keqe të vetme. Ata njerëz të padrejtë të cilët e dëgjojnë këtë dredhi djallëzore janë armiqësorë ndaj besimtarëve në atë mënyrë. Ndërsa kur Zoti i Plotëfuqishëm do t'i peshojë veprat (e njerëzve të përgjegjshëm) me drejtësi absolute në peshoret më të larta në Gjyqin e fundit, Ai do të gjykojë në përputhje me mbisundimin e veprave të mira mbi ato të këqijat dhe anasjelltas. Dhe meqenëse shkaqet e veprave të këqija janë të shumta dhe ekzistenca e tyre është e lehtë, ndonjëherë Ai i mbulon shumë vepra të këqija me një vepër të mirë të vetme.

Domethënë, trajtimet në këtë dynja duhet të jenë në përputhje me atë drejtësi Hyjnore. Në qoftë se pikat e mira të një personi janë më të mëdhaja për sa ka të bëjë me cilësinë ose me sasinë se sa pikat e këqija të tij, atëherë ai person është i meritueshëm për dashuri e respekt. Në të vërtetë, njeriu duhet të falë shumë pika të dobëta për hir të një virtyti të vetëm të vlefshëm.

Por ama, për shkak të damarit të tiranisë në natyrën e tij dhe nëpërmjet pështpëritjeve të shejtanit, njeriu për shkak të një pike të dobët të vetme të tij harron dhe bëhet armiqësor ndaj vëllait të tij besimtar, dhe kështu bën mëkat. Ashtu si vendosja e krahut të një mize mu përpara syrit e cila do të mbulonte e fshehte një mal, po ashtu, për shkak të mbulesës së urrejtjes, njeriu mbulon e fsheh virtyte aq të mëdha sa një mal për shkak të një të keqeje sa krahu i një mize; kështu njeriu i harron ato të mira, bëhet armiqësor ndaj vëllait të tij besimtar dhe bëhet një instrument shkatërrues në jetën e shoqërisë.

Nëpërmjet një dredhie tjetër që i ngjason kësaj, shejtani prish pastërtinë e saktësinë e mendimeve të njerëzve. Ai shkatërron gjykimin e shëndoshë lidhur me të vërtetat e besimit dhe dëmton pastërtinë dhe saktësinë e mendimit. Kjo është siç vijon:

Ai dëshiron të shkatërrojë qindra dëshmi duke provuar të vërtetat e besimit me anë të një aluzioni të vogël duke i refuzuar ato. Ndërsa është një parim i vërtetuar se "Një provë e vetme është më eprore se sa njëqind mohime"; deklarimi i një dëshmitari të vetëm duke provuar një pretendim është më e preferueshme se sa njëqind njerëz që e mohojnë atë.

Shqyrtoje këtë të vërtetë nëpërmjet krahasimit vijues:

Ndodhet një pallat me njëqind dyer, të gjitha të mbyllura. Në qoftë se njëra nga dyert e tij është e hapur, në pallat mund të hyhet dhe dyert e tjera mund të hapen. Në qoftë se të gjitha dyert janë të hapura dhe njëra derë ose dy janë të mbyllura, nuk mund të thuhet se në pallat nuk mund të hyhet. Kështu, të vërtetat e besimit janë pallati. Çdo dëshmi është një çelës; ai i provon të vërtetat dhe hap një derë. Nuk mund të mohohet ajo e vërtetë e imanit dhe as të braktiset vetëm pse mbetet një derë e vetme e mbyllur prej atyre qindra dyerve të hapura. Mirëpo shejtani e bind një grup prej njerëzve -duke u mbështetur mbi shkaqe si injoranca e pakujdesia- dhe u thotë: Nuk mund të hyhet në këtë pallat duke u treguar atyre atë derë e cila ka mbetur e mbyllur, dhe kështu ai i bën njerëzit t'i shpërfillin të gjitha dëshmitë pozitive. Duke thënë: "Shikoni, tek ky pallat nuk mund të hyhet; ju e pandehni atë se është pallat; ai nuk është pallat, dhe asgjë nuk ndodhet brenda tij", ai kështu i mashtron njerëzit.

O Njeri i mjerë i sprovuar me dredhitë e djallit e me pështpëritjet e tij! Në qoftë se ti e dëshiron jetën tënde fetare, jetën tënde personale dhe jetën tënde shoqërore të jenë të shëndosha, dhe në qoftë se ti kërkon saktësinë e mendimit, shikim të shëndoshë dhe zemër të sinqertë, peshoji aktet, veprimet dhe mendimet e tua me peshoret e çështjeve të pakundërshtueshme të Kur'anit dhe me peshat e sunnetit të pastër të Muhammedit a.s.m.. Gjithmonë merre Kur'anin dhe sunnetin si urdhëzuesin tënd. Thuaj: أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ "*Eudhu bil-lahi minesh-shejtanir-Raxhim "I kërkoj mbrojtje Allahut të më ruajë nga Shejtani i mallkuar".*

Kështu, trembëdhjetë treguesit e lartëpërmendur janë trembëdhjetë çelësa. Përdori ato me qëllim që të hapësh kalanë e fortifikuar të sures,

أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ *"I mbështetem Allahut që të më mbrojë nga Djalli i mallkuar".*

أَسْتَعِيذُ بِاللَّهِ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ ۝ مَلِكِ النَّاسِ ۝ إِلَٰهِ النَّاسِ ۝ مِن شَرِّ الْوَسْوَاسِ
الْخَنَّاسِ ۝ الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ ۝ مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ ۝

Me Emrin e Allahut i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti:

Thuaj: "I mbështetem (Allahut) Zotit të njerëzve, Mbisunduesit të njerëzve, të Adhuruarit të njerëzve (të më ruajë) nga e keqja e pëshpëritësit (të së keqes) i cili pëshpërit në gjokset e njerëzve. (Qoftë pëshpëritësi) nga xhindet dhe nga njerëzit"; hyr në këtë kështjellë të sigurt dhe gjej paqe e qetësi!

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

وَقُل رَّبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ هَمَزَاتِ الشَّيَاطِينِ ۝ وَأَعُوذُ بِكَ رَبِّ أَن يَحْضُرُونِ

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtet që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti"[8].

Dhe thuaj: "Zoti im! Të mbështetem Ty (të më ruash) nga pëshpëritjet e Shejtanit. Dhe të mbështetem Ty, O Zoti im! Se përndryshe ata do të më afroheshin"[9].

* * *

[8] Kur'an, 2:32
[9] Kur'an, 23:97

SHKREPTIMA E KATËRMBËDHJETË

Kjo përbëhet nga dy “Stacione”.

Stacioni i Parë përbëhet nga një përgjigjje për dy pyetje.

بِاسْمِهِ سُبْحَانَهُ وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ

اَلسَّلَامُ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَةُ اللهِ وَبَرَكَاتُهُ

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

“Dhe s’ka ndonjë gjë që të mos e lëvdojë Lartësinë e Tij”.

Paqja qoftë mbi ju, edhe mëshira dhe bekimet e Allahut.

Vëllai im i dashur e besnik, Refet Bej!

Përgjigjja për pyetjen që ti bëre rreth “Demit dhe Peshkut” gjendet në disa pjesë të Risale-i Nurit. Pyetjet e atij lloji janë shpjeguar në Degën e Tretë të Fjalës së Njëzet e Katërt sipas Dymbëdhjetë rregullave të rëndësishme të quajtura “Dymbëdhjetë Parimet”. Ato rregulla përfaqësojnë parime të rëndësishme për të larguar dyshimet e iluzionet që mund të burojnë nga hadithet.

Secili rregull është një orientim a direktivë lidhur me interpretimet e ndryshme të hadithëve të Profetit a.s.m.. Për fat të keq, për kohën e tanishme ndodhen disa rrethana që më pengojnë për t’u preokupuar me çështje studimore që nuk janë inspirim. Prandaj, unë nuk mund të përpiqem në përputhje me pyetjen tënde. Në qoftë se inspirimet më vijnë në zemër, unë do të detyrohem të merrem me të. Disa pyetjeve mund t’u përgjigjem, sepse ato koinçidojnë me inspirimet, prandaj mos u ofendo. Për këtë arsye, unë nuk mund t’u përgjigjem të gjitha

pyetjeve ashtu siç e meritojnë. Atëherë, le t'i përgjigjemi në mënyrë të shkurtuar pyetjes tënde këtë herë.

Ti, o vëllai im, pyet në pyetjen tënde: "Hoxhallarët thonë se toka qëndron mbi një dem dhe një peshk. Ndërsa gjeografia e shikon se ajo është varur në hapësirë dhe udhëton si një yll. Nuk ka as dem e as peshk?"

Përgjigjja: Ndodhet një rrëfenjë e shëndoshë që u atribuohet njerëzve si Ibn Abbas, Allahu qoftë i kënaqur me të, e cila thotë se i dërguari i Allahut u pyet: "Mbi çfarë gjëje qëndron toka?" Ai u përgjigj: عَلَى ٱلثَّوْرِ وَٱلْحُوتِ "*Mbi Demin e mbi Peshkun*". Në një rrëfenjë tjetër, njëherë ai tha: عَلَى ٱلثَّوْرِ "*Mbi Demin*", dhe në një rast tjetër, ai tha: عَلَى ٱلْحُوتِ "*Mbi Peshkun*". Disa nga dijetarët e hadithеve profetike ia atribuojnë këtë hadith bestytnive dhe tregimeve të marra nga Israilijjatë, të rrëfyera qysh prej kohëve të hershme. Në mënyrë të veçantë, disa nga dijetarët e bijve të Israilit të cilët u bënë muslimanë, këta e ndryshuan kuptimin e hadithit dhe e transformuan atë në një kuptim shumë të çuditshëm, ku e zbatuan hadithin për historitë rreth Demit dhe Peshkut që i kishin parë në librat e mëparshëm qiellorë. Për tani, unë do të shkruaj Tre 'Parime' dhe Tre 'Aspekte' në lidhje me pyetjen tënde.

Parimi i Parë

Kur disa nga dijetarët e bijve të Israilit u bënë muslimanë, edhe njohuritë e tyre të mëparshme u bënë muslimane së bashku me ata dhe ato iu atribuuan Islamit. Por dihet se njohuritë e tyre të mëparshme kanë gabime. Dhe ato gabime, sigurisht u atribuohen atyre dhe jo islamit.

Parimi i dytë

Sa herë që krahasimet dhe metaforat kalojnë nga elita për tek njerëzit e zakonshëm, domethënë, rënia e tyre nga duart e dijes për tek ato të padijes, me kalimin e kohës, ato imagjinohen të jenë të vërteta të mirëfillta. Për shembull, kur unë isha fëmijë ndodhi një eklips i hënës. Unë i thashë nënës sime: "Çfarë i ka ndodhur hënës?" Ajo u përgjigj:

"Një gjarpër e ka gëlltitur atë"! Unë i thashë: "Por ajo mund të shihet akoma?" Ajo u përgjigj: "Gjarpërinjtë atje janë si qelqi-xhami; ato i tregojnë gjërat që janë brenda tyre!"

Për një kohë të gjatë në fëmijëri unë e kujtoja këtë ngjarje. Unë thoja me vete: "Si është e mundur që një bestytëni e tillë të përsëritet nga njerëz seriozë si nëna ime?" pastaj kur studiova astronominë, unë kuptova se ata të cilët thonin ashtu siç thonte nëna ime, e supozonin metaforën të jetë realiteti, sepse mbi rrethin e gjërë të quajtur Zodiak, i cili është rrethi i shkallëve të Diellit, dhe rrethi i ndëruljes -shmangies- së hënës, i cili është rrethi i vendbanimeve të saj, duke kaluar mbi njëri-tjetrin, kjo u jep secilit prej dy rretheve formën e një harku. Duke përdorur një metaforë të hollë, astronomët i quajtën dy harqet: "Dy gjarpërinjtë e mëdhenj". Ata i quajtën pikat e ndërprerjes -kryqëzimit- të të dy rretheve "koka" dhe "bishti". Kur hëna vjen tek koka dhe dielli tek bishti, në terminologjinë e astronomisë ndodh "një ndërprerje e tokës". Domethënë, globi tokësor kalon pikërisht ndërmjet atyre të dyve dhe hëna eklipsohet. Sipas metaforës së lartëpërmendur "hëna ka hyrë në gojën e gjarpërit". Kështu, kur kjo metaforë e lartësuar dhe studimore hyri në gjuhën e njerëzve të zakonshëm, me kalimin e kohës ajo mori formën e një gjarpri gjigant e madhështor duke gëlltitur hënën.

Kështu, me një metaforë të shenjtë e të hollë dhe me një aluzion domethënës, dy Engjëjve të mëdhenj iu dhanë emrat Demi dhe Peshku, *Thaur ve Hut*. Por pasi metafora e hollë kaloi nga gjuha e lartë dhe elokuente e profetësisë për tek gjuha e njerëzve të zakonshëm, metafora u transformua në kuptim të mirëfilltë, dhe mjaft thjesht, dy melekët morën formën e një Demi madhështor dhe të një Peshku gjigant.

Parimi i Tretë

Ashtu si Kur'ani që përmban alegori e krahasime, dhe nëpërmjet tyre u jep si mësim çështje të thella njerëzve të zakonshëm, po ashtu edhe hadithet përmbajnë krahasime dhe alegori; ato shprehin të vërtetat më të thella nëpërmjet krahasimeve të njohura nga njerëzit e zakonshëm. Për shembull, ashtu siç e kemi shpjeguar në dy vende të tjera, një herë në prani të Profetit a.s.m. një gurgullimë e thellë -zhurmë- u dëgjua. Profeti tha: "Është zhurma e një shkëmbi që ka qenë duke u rrokullisur teposhtë për shtatëdhjetë vjet dhe tani ka prekur

fundin e Xhehennemit". Pak minuta më vonë arriti një person dhe njoftoi se hipokriti i famshëm i cili kishte qenë shtatëdhjetë vjeç kishte vdekur, kështu duke bërë të ditur realitetin e krahasimit të lartë elokuent të cilin e përmendi Profeti a.s.m..

Për tani, do të shpjegohen tre aspekte në përgjigje të pyetjes tënde:

Aspekti i Parë:

Allahu i Plotëfuqishëm ka caktuar katër melekë të mëdhenj në Arshin dhe në qiejt si mbikëqyrës në Sovranitetin e Hyjnisë së Tij. Emri i njërit prej tyre është Shqiponjë -*Nesr*- dhe emri i një tjetri është Demi -*Thaur*. Ai gjithashtu caktoi dy engjëj si mbikëqyrës e mbajtës të globit tokësor, që është një vëlla i vogël i qiejve dhe një shok i planetëve. Njëri nga ata dy engjëj u quajt '*Demi*' dhe tjetri '*Peshku*'. Urtësia për dhënien e këtyre Emrave atyre është kjo:

Ndodhen dy pjesë për tokën, njëra është ujë dhe tjetra është dhé. Ai që e mbush dhe jeton në det ose në ujë është peshku, ndërsa ai që banon në pjesën e tokës që është dhé, është Demi; meqenëse boshti i jetës së njeriut është bujqësia që mbahet mbi shpatullat e demit. Meqenëse dy engjëjt e caktuar për tokën janë komandantë edhe mbikëqyrës, Ata sigurisht duhet të kenë ndonjë lloj lidhje -nga një aspekt- me specien e peshqive dhe me llojin e buajve -demëve. Në të vërtetë, وَٱلْعِلْمُ عِندَ ٱللَّهِ *'dhe dija është vetëm me Allahun*', Melekët përfaqësohen në Botën e Dimensioneve të brendshme të gjërave dhe në Botën e shëmbëllesës në format e një Demi dhe të një Peshku[1]. Kështu, duke aluduar për atë lidhje e mbikëqyrje dhe për ato dy specie të rëndësishme të krijesave të tokës, Profeti a.s.m. pohoi në mënyrën e tij të mrekullueshme të shprehjes:

[1] Globi tokësor është një anije Hyjnore duke çarë oqeanët e hapësirës, dhe në përputhje me hadithin, ajo është toka e lëruar për Ahiretin, domethënë, një fushë e punueshme dhe një fidanishte. Kështu, është e qartë se sa të përshtatshëm janë Emri i Peshkut për Melekun që komandon atë anije gjigante të pajetë e të pavetëdijshme dhe e bën atë të notojë përmes atyre me urdhrin Hyjnor në një mënyrë të rregullt dhe të urtë, dhe emri i Demit për melekun i cili me lejen Hyjnore mbikëqyr atë fushë të lërueshme.

اَلْاَرْضُ عَلَى الثَّوْرِ وَالْحُوْتِ *"Toka është mbi Demin dhe mbi Peshkun"*, duke shprehur kështu në një fjali të lartë e të përmbledhur një faqe të të vërtetave të thella.

Aspekti i Dytë:

Për shembull, në qoftë se do të thuhej: "Mbi çfarë qëndron ky shtet? Do të thuhej në përgjigje: عَلَى السَّيْفِ وَالْقَلَمِ Mbi shpatën dhe mbi lapsin": domethënë, ai mbështetet mbi fuqinë e shpatës së ushtrisë dhe mbi guximin e saj si dhe mbi mendjemprehtësinë dhe drejtësinë e lapsit të nëpunësve.

Në të njëjtën mënyrë, meqenëse toka është një vendbanim i qënieve të gjalla dhe prijësi i gjallesave është njeriu; dhe peshqit janë mjeti i jetesës për shumicën e njerëzve që jetojnë pranë detit, dhe mjeti i jetesës së shumicës së atyre që nuk jetojnë pranë detit është nëpërmjet bujqësisë e cila është mbi shpatullat e buajve dhe qeve, dhe peshqit gjithashtu janë mjete të rëndësishëm për tregti; Dhe ashtu siç mund të thuhet fjala se "Shteti qëndron mbi shpatën dhe mbi lapsin, po ashtu mund të thuhet se toka qëndron mbi peshkun; sepse kur demi nuk punon dhe në qoftë se peshqit nuk do të prodhonin miliona vezë, njeriu nuk do të mund të jetonte, jeta do të pushonte së ekzistuari dhe Krijuesi i Gjithurtë do ta shkatërronte tokën. Kështu, me një përgjigje të mrekullueshme, të lartësuar e të urtë, i Dërguari i Allahut xh.sh. tha: اَلْاَرْضُ عَلَى الثَّوْرِ وَالْحُوْتِ *"Toka qëndron mbi Demin dhe mbi Peshkun"*. Ai dha mësim një të vërtete të gjërë me dy Fjalë, duke treguar se sa të lidhura ngushtë janë jeta e njeriut me jetën e specieve shtazore.

Aspekti i Tretë:

Në këndvështrimin e kozmologjisë së lashtë, dielli udhëtonte, rrotullohej, ndërsa toka ishte e qëndrueshme. Ata përcaktuan një vijësi në çdo tridhjet shkallë prej shkallëve të diellit. Në qoftë se do të shtriheshin vijat hipotetike midis yjeve të atyre yjësive, do të rezultonte një situatë që ndonjëherë i ngjasonte formës së Luanit, ndonjëherë formës së peshores, ndonjëherë formës së demit dhe ndonjëherë i ngjasonte formës së peshkut, prandaj ata i shpjeguan ato yjësi - grumbull yjesh- me ato Emra.

Ndërsa astronomia e tanishme shikon se dielli nuk rrotullohet rreth tokës, por toka rrotullohet rreth tij. Domethënë, e ndalon punën në ato yjësi. Atëherë duhet që ato yjësi të papuna dhe ato sfera të mëdha duhet të kenë sfera me përmasa më të vogëla në boshtin vjetor të tokës. Domethënë yjësitë qiellore u bënë të përfaqësohen në boshtin vjetor të tokës, dhe atëherë në çdo muaj toka futet në hijen e njërës prej yjësive dhe është brenda reflektimit të saj; sikur boshti vjetor i tokës të ishte një pasqyrë në të cilën përfaqësohet forma e yjësive qiellore.

Kështu në këtë drejtim, ashtu siç e përmendëm më lartë, Profeti i nderuar a.s.m. në një rast tjetër tha: عَلَى ٱلثَّوْرِ "*Mbi Demin"* dhe në një rast tjetër tha: عَلَى ٱلْحُوتِ "*Mbi Peshkun*". Po, duke treguar një të vërtetë të thellë e cila do të kuptohej shumë shekuj më vonë, ai njëherë tha me gjuhën e mrekullueshme të profetësisë: عَلَى ٱلثَّوْرِ "*Mbi Demin*", për shkak se në kohën e pyetjes, toka ishte në ngjashmërinë -shëmbëllimin- e yjësisë së Demit. Dhe kur iu bë kjo e njëjta pyetje më vonë, ai tha: عَلَى ٱلْحُوتِ "*Mbi Peshkun*", sepse atëherë toka ishte në hijen e yjësisë së peshkut.

Kështu, duke treguar një të vërtetë të lartë që do të kuptohej në të ardhmen dhe, duke aluduar për detyrën e lëvizjes së tokës dhe të udhëtimit të saj... dhe aludoi se yjet qiellorë realë dhe punonjëse janë ato në orbitën vjetore të tokës dhe, se është toka ajo e cila udhëton dhe kryen detyrat në ato yjësi, ndërsa ato në krahasim me diellin janë të papuna, pa trupa lëvizës në to.

وَٱللَّهُ أَعْلَمُ بِالصَّوَابِ *"Dhe Allahu e di më së miri se cila është e drejtë."*

Tregimet e jashtëzakonshme të paarsyeshme në disa libra islamikë janë ose Israilijjate, ose janë alegori, ose janë interpretime të dijetarëve të hadithit, të cilat disa njerëz të pakujdesshëm i kanë supozuar të jenë hadithe dhe ia kanë atribuuar ato të dërguarit të Zotit xh.sh.

رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَا إِن نَّسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

Zoti ynë! Mos na ndëshko në qoftë se harrojmë, apo biem në gabime".[2]

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtet që Vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".[3]

* * *

Pyetja e Dytë është rreth njerëzve të mantelit, mbulesës.

Vëllai im! Përsa ka të bëjë me pyetjen tënde rreth njerëzve të mantelit, vetëm njëri nga shumë shembujt e urtësisë lidhur me të do të shpjegohet, sa vijon:

I Dërguari i Allahut, duke i mbuluar Aliun, Zoti qoftë i kënaqur me të, dhe Fatimen, Zoti qoftë i kënaqur me të, dhe Hasanin e Hysejnin, Zoti qoftë i kënaqur me ta, me mantelin -xhyben- e tij të bekuar që e vishte; dhe duaja e tij për ta dhe, me vërsetin,

"(Allahu vetëm se dëshiron) ta largojë prej jush papastërtinë (ndotjen) o pjesëtarë të familjes (së profetit, Ehlibejtit) dhe t'ju bëjë ju të pastër plotësisht e pa asnjë njollë"[4], përmban shumë mistere e shembuj urtësie. Unë nuk do t'i diskutoj misteret; një shembull urtësie i lidhur me funksionin e profetësisë është ky:

I Dërguari i Zotit xh.sh. shikoi me syrin e profetësisë i cili depërtoi tek e padukshmja dhe shikoi të ardhmen, se tridhjetë ose dyzet vjet më vonë do të shpërthenin konflikte të rënda në radhët e sahabëve dhe të tabiinëve -gjeneratës vijuese të sahabëve- dhe se do të derdhej gjaku i pastër. Ai shikoi se më të shquarit midis tyre do të ishin tre personat të cilët Ai i mbuloi me mantelin e tij. Kështu, ai i mbuloi ata së bashku me vetveten në atë mantel duke u dhënë atyre titullin e nderuar, "*Pesë njerëzit e Mantelit"*. Në këtë mënyrë Ai deshi të shfajësojë e të nxjerrë të larë Aliun, Zoti qoftë i kënaqur me të, në shikimin e komunitetit islamik, dhe të qetësonte e t'i shprehte ngushëllimet Hysejnit, Zoti

[2] Kur'an, 2:285
[3] Kur'an, 2:32
[4] Kur'an, 33:33

qoftë i kënaqur me të, dhe të përshëndeste Hasanin dhe shpalli nderin që ai do të fitonte duke larguar nëpërmjet pajtimit mosmarrëveshjet e rënda, dhe vlerën e tij të lartë për komunitetin islam, dhe për të treguar se pasardhësit e Fatimesë do të ishin të pastër e të nderuar, dhe do të ishin të përshtatshëm për të fituar titullin e lartë e fisnik të ***Ehli Bejtit.***

Sigurisht, Hazreti Aliu, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, ishte kalif i drejtë për muslimanët por meqenëse gjaku që do të derdhej ishte i një rëndësie të madhe dhe, meqenëse në shikimin e komunitetit, pafajësia dhe pastërtia e tij ishin të rëndësishme për sa ka të bëjë me funksionin e profetësisë, i dërguari i Zotit në këtë mënyrë e shfajësoi atë. Ai i fton të heshtin, lidhur me të, të gjithë ata që e kritikojnë, që e akuzojnë për gabim e çudhëzim prej Havarixhëve dhe përkrahësve agresorë të Umevive.

Po, sjelljet e shfrenuara të kryera kundra Hazreti Aliut, Zoti qoftë i kënaqur me të, nga përkrahësit ekstremistë të Havarixhëve dhe Umevitëve dhe akuzat e tyre të çudhëzimit, dhe ngjarjet vërtet tragjike e pikëlluese në kohën e Hazreti Hysejnit, Zoti qoftë i kënaqur me të, së bashku me veprimet e shfrenuara dhe risitë e Shiitëve dhe shfajësimi i tyre prej dy Shejhëve, të gjitha kanë qenë shumë të dëmshme për njerëzit e islamit.

Kështu, me mantelin e tij, i dërguari i Zotit xh.sh. e shfajësoi Husejnin nga përgjegjësia dhe e pastroi atë nga akuzat dhe nga mendimi i keq i komunitetit islam. Gjithashtu, ai përshëndeti Imam Hasanin për të mirën që ai do të bënte për ummetin nëpërmjet vendosjes së pajtimit. Dhe Ai njoftoi se duke u njohur Familja e Profetit -Ehli Bejti, pasardhësit e Hazreti Fatimes do të ishin shumë të nderuar, si ata të nënës së Merjemit, e cila tha:

"Dhe kërkoj mbështetjen -mbrojtjen- Tënde për të dhe për pasardhësit e saj nga shejtani i mallkuar".[5]

O Zot! Jepi bekime shkëlqesisë sonë Muhammedit a.s.m. dhe familjes së tij të drejtë, të pastër e të devotshme, si dhe Sahabëve të tij, luftëtarëve të nderuar e të zgjedhur në rrugën e Zotit. Amin.

* * *

[5] Kur'an, 3:36

STACIONI I DYTË
I SHKREPTIMËS SË KATËRMBËDHJETË

Ky stacion, është përfshirë këtu për shkak të lidhjes së tij me këtë subjekt

Ai përmban



gjashtë

nga mijëra mistere

që përfshihen

në "*Bismil-Lahir-Rrahmanir-Rrahim",*

SHËNIM: Një dritë vezulluese nga "Bismil-Lahir-Rrahmanir-Rrahim", lidhur me Mëshirën Hyjnore, iu shfaq nga larg mendjes sime të shuar. Unë desha ta regjistroja atë për veten time në formën e shënimeve dhe u përpoqa ta gjuaja atë, ta kapja dhe ta rrethshkruaja dritën me njëzet deri në tridhjetë mistere, por fatkeqësisht unë nuk isha i mundur ta bëja një gjë të tillë tani; kështu ato u pakësuan dhe u përmblodhën vetëm në pesë gjashtë mistere.

Kur unë them: "O Njeri!" Unë i drejtohem nefsit tim. Dhe megjithëse ky mësim i drejtohet në mënyrë të veçantë nefsit tim, unë po e përcjell atë si "Stacionin e Dytë të Shkreptimës së Katërmbëdhjetë" për miratimin e vëllezërve të mi të përpiktë, duke shpresuar se ajo do t'u vlejë atyre me të cilët unë jam i lidhur shpirtërisht, dhe që shpirtërat e të cilëve janë më të kujdesshëm se sa shpirti im. Ky mësim i drejtohet zemrës më shumë se sa mendjes, dhe e vlerëson kënaqësinë shpirtërore më shumë se sa provat e arsyeshme.



"Me Emrin e All-llahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

[Mbretëresha] tha: "O prijës! Me të vërtetë që më është sjellë një letër e denjë për respekt. Ajo është nga Sulejmani dhe është "Bismil-lahir-Rrahmanirr-Rrahim."[6]

Një numër misteresh do të përmenden në këtë stacion.

• **MISTERI I PARË:** Gjatë hulumtimit tim mbi "*Besmelen*", unë pashë një tregues të بِسْمِ اللهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ "*Bismil-Lahir-Rrahmanir-Rrahim"*, siç vijon:

Në **faqen e universit**, në **faqen e tokës** dhe në **faqen e njeriut** janë **tre shenja të Hyjnisë** njëra brenda tjetrës dhe secila tregon modelet e të tjerave**.**

Shenja e parë është Vula e madhe e Perëndisë, e cila shfaqet nëpër-mjet ndihmës së ndërsjellë, bashkëpunimit, përqafimit dhe bashkëpërgji-gjjes që ndodh në të gjitha pjesët përbërëse të universit. **"*Bismil-lahi*"**, shikon tek ajo vulë.

Shenja e dytë është Vula e madhe e Mëshirës Hyjnorë, e cila shfaqet përmes ngjashmërisë, simetrisë, rregullit, harmonisë, mirësisë dhe mësh-irës që ndodh në sistemimin, në ngritjen dhe në zhvillimin e bimëve dhe të kafshëve në faqen e tokës. **"*Bismil-Lahir-Rrahman"i*,** shikon tek ajo vulë e madhe e Gjithëmëshirshmërisë Hyjnore.

Pastaj ***Shenja e tretë*** është Vula e Mëshirëgjërësisë, ajo shejnë e lartë, e cila shfaqet përmes hollësive të dhembshurisë Hyjnore dhe të Mirëbërësisë Hyjnore në faqen e natyrës gjithëpërfshirëse të njeriut. Kjo shikon tek Emri الرَّحِيمِ *"Er-Rrahim"* "*Mëshirëploti*" tek بِسْمِ اللهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ *"Bismil-Lahir-Rrahmanir-Rrahim", "Me Emrin e All-llahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti*.

Domethënë, بِسْمِ اللهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ *Bismil-lahir-Rrahmanirr-Rrahim,* është titulli i shenjtë i të tre Vulave të Njësisë Hyjnore, e cila

[6] Kur'an, 27: 29-30

formon një rresht dritëdhënës në faqen e botës, një kordon të fortë dhe një filament të ndritshëm. Me fjalë të tjera, duke zbritur nga Froni më i Madh, maja e بِسْمِ اللهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ *Bismil-lahir-Rrahmanir-Rrahim* mbështetet mbi njeriun, i cili është fruti i universit dhe kopja e zvogëluar e botës. Ajo lidh botën e ulët me Fronin Hyjnor. Ajo është një rrugë për njeriun që të ngjitet tek Froni i plotësimeve të tij.

• **MISTERI I DYTË:** Me qëllim që të mos mbyten mendjet nga Uniteti Hyjnor, i cili është i dukshëm në shumësinë e pafund të krijesave, Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm në mënyrë të vazhdueshme tregon shfaqjen e Njësisë Hyjnore brenda Unitetit Hyjnor. Për shembull, dielli me dritën e tij rrethon gjëra të panumërta. Me qëllim që të vërehet vetë dielli, në tërësinë e dritës së tij, është e domosdoshme të jetë një përfytyrim shumë i gjërë konceptor dhe një shikim gjithë-përfshirës. Kështu, që të mos harrohet vetë dielli, ai shfaqet në çdo objekt të shndrit-shëm nëpërmjet reflektimit të vet. Dhe në përputhje me kapacitetin e secilës, të gjitha objektet e shndritshme shfaqin cilësitë e diellit, si dritën e tij dhe nxehtësinë së bashku me treguesin e esencës së vetë diellit. Dhe ashtu si në përputhje me kapacitetet e tyre, të gjitha objektet e ndritshme e tregojnë diellin së bashku me të gjitha cilësitë e tij, po ashtu bëjnë cilësitë e diellit, si drita e tij, nxehtësia dhe shtatë ngjyrat në dritën e tij, të cilat të gjitha rrethojnë gjithçka që është përballë tij. Dhe në të njëjtën mënyrë, وَلِلّٰهِ الْمَثَلُ الْاَعْلٰى *"Dhe për All-llahun është krahasimi më i lartë."*[7]

-Le të mos ketë gabim në krahasim- Ashtu siç ka Krijuesi i Përjetshëm dhe Hyjnia e Vetme një tregues së bashku me të gjithë Emrat Hyjnorë në çdo gjë, sidomos tek gjallesat dhe në mënyrë të veçantë në pasqyrën e natyrës së njeriut, po ashtu nëpërmjet Unitetit Hyjnor, secili Emër nga Emrat e Bukur që lidhen me krijesat, i rrethon të gjitha qëniet. Kështu, me qëllim që të mos mbyten mendjet nga Uniteti Hyjnor, dhe që të mos e harrojnë zemrat Esencën e Shenjtë Hyjnore, Kur'ani, në mënyrë të vazhdueshme, vendos përpara syve Vulën e Njësisë Hyjnore brenda Unitetit Hyjnor. Dhe ajo është

[7] Kur'an, 16: 60

بِسْمِ اللهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ *"Bismil-lahir-Rrahmanir-Rrahim,* e cila tregon tre nyjet e rëndësishme të asaj Vule.

- **MISTERI I TRETË:** Ajo që e bën këtë univers të pafund të gëzohet është, në mënyrë të vetëkuptueshme, Mëshira Hyjnore. Dhe ajo që i ndriçon këto qënie të errëta është, në mënyrë të qartë, Mëshira Hyjnore. Dhe ajo që i rrit dhe i edukon krijesat duke u përpjekur brenda këtyre nevojave të pafund, në mënyrë të vetëkuptueshme, është përsëri Mëshira Hyjnore. Dhe ajo që e bën të gjithë universin të kthehet drejt njeriut, siç kthehen të gjitha pjesët e pemës drejt frutit të saj, dhe që i shkakton universit ta shikojë atë dhe të shpejtojë për ta ndihmuar njeriun është, në mënyrë të qartë, Mëshira Hyjnore. Dhe ajo që e mbush dhe e ndriçon hapësirën e pafund dhe që e stolisi këtë botë të zbrazur, në mënyrë të vetëkuptueshme, është Mëshira Hyjnore. Dhe ajo që e caktoi këtë njeri kalimtar për përjetësi, që e bëri atë marrësin e Mesazhit Hyjnor dhe të dashurin e Krijuesit të Vetëm të para e të paspërjetësisë, në mënyrë të vetëkuptueshme, është Mëshira Hyjnore.

O njeri! Meqenëse Mëshira Hyjnore është një e vërtetë kaq e fuqishme, tërheqëse, e këndshme, mbështetëse dhe e dashur, atëherë thuaj: بِسْمِ اللهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ *"Bismil-lahir-Rrahmanirr-Rrahim";* kapu fort pas kësaj të vërtete dhe shpëtoje veten tënde nga vetmia absolute dhe nga dhimbjet e nevojave të pafund. Dhe afrohu për tek Froni i Sulltanit të përjetshëm të para dhe paspërjetësisë, dhe nëpërmjet dhembshurisë dhe ndërmjetësisë dhe rrezeve të Mëshirës Hyjnore, bëhu marrësi i mesazhit, miku dhe i dashuri i Atij Sulltani!

Po, në të vërtetë, të grumbullosh me urtësi rreth njeriut botët e qënieve në univers, dhe t'i bësh ato të shpejtojnë për t'ia plotësuar të gjitha nevojat e tij me një rregull perfekt e me mirësi, në mënyrë të qartë, është njëra nga dy situatat. Ose secili lloj nga llojet e krijesave e njeh njeriun e i bindet atij dhe shpejton për ta ndihmuar atë, gjë e cila ashtu siç është krejtësisht e paarsyeshme, dhe gjithashtu e pamundur në shumë aspekte, ose një qënie absolutisht e pafuqishme si njeriu të kishte forcën e Sovranit më të fuqishëm absolut, ose kjo ndihmë ndodh përmes njohurisë së Një të Gjithëfuqishmi absolut prapa perdes së universit. Domethënë, qëniet e ndryshme në univers nuk e njohin

njeriun, por ato janë dëshmi e tregues për Atë që e njeh këtë njeri, që e mëshiron dhe që e di gjendjen e tij; Ai është Krijuesi Mëshirëplotë.

O njeri! Eja në vete! A do të ishte e mundur që mos të të njihte e mos të të shikonte ty Krijuesi i Gjithëlavdishëm i Cili bën që të gjitha llojet e krijesave të kthehen drejt teje, dhe të shtrijnë duart që të të ndihmojnë dhe që i bën ato të thonë: **Urdhëro, ja ku jemi!**, përballë nevojave të tua; a do të ishte e mundur që Ai mos të të njohë ty, të mos njihet me ty dhe mos të të shohë ty? Meqenëse të njeh ty, Ai të njofton se të njeh përmes Mëshirës së Tij. Atëherë, edhe ti njihe Atë gjithashtu, dhe përpiqu ta njohësh Atë duke respektuar urdhërat e Tij, dhe kupto me siguri se ajo që nënshtron universin e gjërë ndaj teje dhe që e bën universin të të ndihmojë ty, megjithëse ti je një krijesë absolutisht e varfër, e dobët, e vogël, e pafuqishme, dhe kalimtare, është e vërteta e Mëshirës Hyjnore e cila përmban urtësi, mirësi, njohje dhe fuqi.

Me siguri, një mëshirë e tillë si kjo kërkon prej teje falënderime të përgjithshme e të sinqerta, dhe një respekt të madh e të papërzier. Prandaj thuaj: بِسْمِ اللهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ *Bismil-Lahirr-Rrahmanirr-Rrahim*, e cila është interpretuesja dhe shprehja e atyre falënderimeve të sinqerta dhe e atij respekti të madh e të papërzier. Dhe bëje atë si mjet për të shkuar tek dera e asaj Mëshire, dhe si ndërmjetësin tënd tek i Gjithëmëshirshmi Mëshirëplotë.

Po, në të vërtetë, ekzistenca dhe realiteti i Mëshirës Hyjnore është aq e qartë si dielli, sepse ashtu siç ndodh thurja e një sargie të bukur në qendër nga vendosja harmonike e indit dhe endëses bazë dhe nga rregulli dhe pozicionet e fijeve që shtrihen drejt qendrës nga çdo drejtim, po ashtu fijet dritëdhënëse që shtrihen nga shfaqja e njëmijë e një Emrave Hyjnorë në sferën e gjërë të universit, endin një qëndisje të tillë dhembshurie në fytyrën e universit dhe një stampë mirëbërësie brenda një vule mëshire, e cila e shfaq vetveten për mendjet në mënyrë më të ndritshme se sa dielli.

Po, Ai i Cili organizon diellin, hënën, elementet, mineralet, bimët dhe kafshët, dhe i vendos ato të gjitha në harmoni me rrezet e njëmijë e një Emrave, si të ishin indet dhe endësja bazë dhe fijet e saj dritëdhënëse, dhe i nënshtron ato të gjitha në shërbimin e jetës; dhe Ai i Cili shfaq mëshirën dhe dhembshurinë e Tij për krijesat duke vendosur

tek të gjitha nënat -prej bimëve dhe kafshëve- atë mëshirë e dhembshuri të ëmbël e sakrifikuese ndaj të vegjëlve të tyre; dhe Ai i Cili ia nënshtron gjallesat jetës njerëzore; nga kjo demonstron rëndësinë e njeriut dhe treguesit më të ndritshëm të mëshirës së Tij dhe skalitjet më të bukura e të ëmbëla të Hyjnisë, dhe e ka bërë këtë mëshirën e Tij të gjërë si ndërmjetësuese të pranueshme e të njohur tek pasuria e Tij absolute nëpërmjet së cilës kërkojnë ndërmjetësim gjallesat dhe njeriu, i cili ndjen nevojën më të madhe për atë Mëshirë.

O njeri! Në qoftë se je njeri i vërtetë, thuaj

بِسْمِ اللهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ *"Bismil-Lahirr-Rrahmanirr-Rrahim",* që kjo të jetë ndërmjetësuese për ty. Sigurisht është e qartë dhe e vetëkuptueshme se është Mëshira Hyjnore ajo e cila pa harruar e pa ngatërruar asnjërën prej tyre, i ngre, i ushqen, i edukon dhe i administron katërqindmijë llojet e ndryshme të bimëve dhe kafshëve në tokë, pikërisht në kohën e duhur, me rregull perfekt, me urtësi e mirëbërësi, saqë me këtë administrim e zhvillim ka vendosur shenjat dhe Vulën e Njësisë Hyjnore në faqen e globit tokësor. Dhe ashtu si ekzistenca e Mëshirës Hyjnore që është aq e sigurt sa ekzistenca e krijesave në faqen e tokës, po ashtu krijesat formojnë aq shumë dëshmi për realitetin e asaj Mëshire, sa vetë numri i tyre.

Po, ashtu siç shikojmë në fytyrën e tokës vulën e mëshirës dhe stampën e Njësisë Hyjnore, po ashtu në fytyrën e natyrës shpirtërore të njeriut ndodhet një stampë e Mëshirës Hyjnore e cila nuk është më e ulët se sa vula e madhe e Mëshirës në fytyrën e universit. Madje njeriu posedon një gjithëpërfshirje si qënia e një pike qëndrore për shfaqjen e njëmijë e një Emrave të Bukur Hyjnorë.

O njeri! A do të ishte e mundur për Atë që të dha ty këtë fytyrë dhe që vendosi në të një stampë të tillë mëshire dhe Vulën e Njësisë, të të lërë ty në tekat e tua, mos të të japë rëndësi, mos t'u kushtojë vëmendje veprave të tua, apo ta bënte të gjithë universin, i cili është kthyer drejt teje, kot më kot e pa qëllim, dhe ta bënte të kalbur pemën e krijimit, të parëndësishme e me fruta të prishura? A do të ishte e mundur që Ai ta bënte Mëshirën e Tij të mohohet, e cila është aq e qartë sa dielli, apo t'i shkaktonte urtësisë së Tij, e cila është e qartë si drita, të dyshohet, kur

asnjëra prej tyre kurrësesi nuk mund të dyshohet dhe nuk është e mangët? Ruajna Zot! Jo, kurrë!..

O njeri! Ti duhet ta dish se ndodhet një rrugë që ti të ngjitesh tek Mëshira Hyjnore dhe ajo është بِسْمِ اللهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ *Bismil-Lahirr-Rrahmanirr-Rrahim.* Në qoftë se dëshiron ta kuptosh se sa e rëndësishme është kjo rrugë ngjitjeje, shiko tek fillimi i njëqind e katërmbëdhjetë kapitujve të Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm dhe në krye të të gjithë librave të bekuar dhe tek fillimi i të gjitha punëve të bekuara, saqë përbën një provë vendimtare për madhështinë e *Bismil-lahit* dhe për lartësinë e vlerës së saj, ajo që tha Imam Shafiu, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, dhe dijetarët e mëdhenj të Islamit:

"***Megjithëse "Bismil-Lahirr-Rrahmanirr-Rrahim" është një vërset, ai është shpallur njëqind e katërmbëdhjetë herë në Kur'an."***

- **MISTERI I KATËRT:** Shfaqja e Unitetit Hyjnor në krijesa është e pakufishme; atë nuk e rrethon gjithkush që thotë; ... اِيَّاكَ نَعْبُدُ *"Vetëm Ty ne të adhurojmë",* pra nuk do t'i mjaftonte gjithësecilit që e shpreh atë, sepse mendimi shpërndahet dhe bredh në atë shumësi, kështu do të duhej të ekzistonte një zemër aq e madhe sa globi tokësor për të vëzhguar Krijuesin e Vetëm e të pashoq nëpërmjet tërësisë së krijesave tek thënia اِيَّاكَ نَعْبُدُ وَاِيَّاكَ نَسْتَعِيْنُ *"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë."*

Duke u mbështetur mbi këtë mister të hollë, Allahu xh.sh. e demonstroi me qartësi Vulën e Njësisë Hyjnore në çdo pjesë, ashtu siç e shfaq atë në çdo lloj; dhe kjo ndodh me qëllim që të tërhiqen shikimet për tek vetë Krijuesi i Vetëm dhe që të tregojë vulën e njësisë brenda stampës së gjithëmëshirshmërisë me qëllim që të mundet çdo person -i çdo niveli- të orientohet drejtpërdrejtë e pa ndonjë vështirësi në thënien e tij اِيَّاكَ نَعْبُدُ وَاِيَّاكَ نَسْتَعِيْنُ *"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë"* tek Esenca e Pastër dhe e Shenjtë e të Vetmit Krijues. Dhe me qëllim që të shprehet ky mister i madh dhe të tregohet qartë Vula e Mëshirës Hyjnore, Kur'ani i gjithurtë menjëherë përmend sferën më të vogël dhe çështjen më të veçantë -kur përshkruan sferën më të madhe të universit.. Për shembull, kur Kur'ani shpjegon vërsetet e

krijimit të qiejve e të tokës, ai i ndjek ato me vërsetet e krijimit të njeriut dhe shpje-gon detajet e holla të mirësive në zërin e tij, dhe urtësinë në tiparet e tij që të mos shpërndahet mendimi në horizontet e mëdha, të mos mbytet zemra në shumësinë e pafund, dhe që shpirti ta gjejë drejtpërdrejtë të Adhuruarin e vërtetë pa ndërmjetësim.

Ajeti vijues e shpjegon këtë të vërtetë në mënyrë të mrekullueshme:

وَمِنْ ءَايَٰتِهِۦ خَلْقُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ وَٱخْتِلَٰفُ أَلْسِنَتِكُمْ وَأَلْوَٰنِكُمْ

"Dhe nga treguesit e Tij është krijimi i qiejve dhe i tokës dhe dallimi i gjuhëve dhe i ngjyrave tuaja."[8]

Po, në të vërtetë, brenda krijesave të një shumësie të pafund ndodhen lloje dhe shkallë të vulave të Unitetit Hyjnor si rrathë bashkë-qendrorë nga vula më e madhe për tek ajo më e vogla. Por, sado i qartë të jetë Uniteti, ai ende është një Unitet brenda shumësisë. Ai nuk mund t'u adresohet siç duhet vëzhguesve. Për shkak të kësaj, duhet të jetë stampa e Njësisë Hyjnore prapa Unitetit me qëllim që të hapë rrugën përpara zemrës për të arritur tek Esenca e Pastër dhe e Shenjtë Hyjnore pa i përkujtuar atij shumësinë.

Pastaj, me qëllim që të drejtohen shikimet drejt stampës së Njësisë Hyjnore dhe për të tërhequr zemrat drejt saj, është vendosur sipër saj një skalitje shumë e mrekullueshme dhe tërheqëse, një dritë shumë vezu-lluese, një ëmbëlsi shumë e shijshme, një bukuri e këndshme dhe një e vërtetë shumë e fuqishme, e cila është stampa e Mëshirës Hyjnore dhe vula e Dhembshurisë Hyjnore. Po, sigurisht, është fuqia e asaj Mëshire, ajo që tërheq shikimet e qënieve të vetëdijshme, që i sjell ato tek ajo dhe që u shkakton atyre të arrijnë vulën e Njësisë dhe të vëzhgojnë të Vetmin e pashoq, dhe nga ajo të shfaqet adresimi i vërtetë në: إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ *"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë."*

Kështu, بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ *Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim,* meqenëse është indeksi i sures *El-Fatiha* dhe një përmbledhje e

[8] Kur'an, 30: 22

shkurtër e Kur'anit, ajo u bë titulli dhe interpretuesi i këtij misteri të madh. Ai i Cili e merr në dorë këtë titull mund të udhëtojë përmes niveleve të Mëshirës Hyjnore. Dhe ai i cili e bën këtë interpretues të flasë, mund të mësojë misteret e Mëshirës Hyjnore dhe shikon Dritat e Dhembshurisë dhe të Përdëllimit Hyjnor.

- **MISTERI I PESTË:** Ndodhet një hadith sherif i cili është siç vijon: إِنَّ اللهَ خَلَقَ الْإِنْسَانَ عَلَى صُورَةِ الرَّحْمٰنِ *"All-llahu xh.sh. e krijoi njeriun në formën e të Gjithëmëshirshmit."* Ai është interpretuar nga disa sufi në një mënyrë të jashtëzakonshme duke mos iu përshtatur bazave të besimit. Disa prej tyre, që ishin të dalldisur, e konsideruan fytyrën shpirtërore të njeriut në formën e të Gjithëmëshirshmit. Meqe-nëse të dalldisurit janë kryesisht të kredhur në mendime të ngatërruara, ata ndoshta justifikohen për pikëpamjet e tyre të kundërta me realitetin. Por ata që janë në vete, të vetëdijshëm, nuk mund t'i pranojnë ato ide që janë kundra themeleve të besimit. Në qoftë se do t'i pranonin, ata do të ishin të gabuar.

Po, në të vërtetë, Ai i Cili drejton me rregull të gjithë universin si të ishte një pallat apo shtëpi, Ajo Esencë e Shenjtë Hyjnore që rrotullon yjet si të ishin grimca dhe i bën ato të udhëtojnë përmes hapësirës me urtësi e lehtësi dhe që i përdor grimcat e vockëla si të ishin nëpunës e vartës të rregullt, Ai nuk ka përngjasues, nuk ka ortakë, nuk ka oponentë e as të barabartë. Atëherë, gjithashtu sipas kuptimit të vërsetit:

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ *"Asgjë nuk i përngjet Atij dhe Ai është Gjithëdëgjuesi, Githëshikuesi."*[9]

Ai nuk ka formë, as të barabartë, as shok, dhe asgjë nuk i përngjet Atij. Megjithatë, sipas kuptimit dhe mënyrës së krahasimit të vërsetit vijues:

وَلَهُ الْمَثَلُ الْأَعْلَى فِي السَّمٰوَاتِ وَالْأَرْضِ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ *"Dhe Atij i takon krahasimi më i lartë në qiej dhe në tokë. Dhe Ai është i Gjithëfuqishmi, i*

[9] Kur'an, 42: 11

Gjithurti."[10] veprat e Tij, Atributet dhe Emrat mund të merren në konsideratë.

Domethënë, ka alegori e krahasim në lidhje me veprat. Njëri qëllim i hadithit të lartpërmendur është siç vijon: "Njeriu është në një formë që shfaq treguesin e Emrit ***"Er-Rahman"****, i Gjithëmëshirshmi,* në tërësinë e tij."

Po, sigurisht, siç e shpjeguam më parë, ashtu siç shfaqet Emri Hyjnor ***"Er-Rahman"****,* nëpërmjet rrezeve të njëmijë e një Emrave në fytyrën e universit, dhe ashtu siç shfaqet Emri **"*Er-Rahman"*** me tregues të pafund të Hyjnisë absolute të Perëndisë në fytyrën e sipërfaqes së tokës, po ashtu Zoti xh.sh. e shfaq treguesin më të plotë të Atij Emri ***"Er-Rahman",*** në një masë të zvogëluar në formën përmbledhëse të njeriut, e shfaq atë në masë të zvogëluar siç e tregon në faqen e tokës, dhe në masë më të gjërë e më të madhe në faqen e universit.

Në hadithin sherif është gjithashtu një tregues tjetër që nënkupton, se tek njeriu dhe gjallesat ka shfaqje që tregojnë **"*Er-Rahman"****, "**Er-Rahim"** të Gjithëmëshirshmin, Mëshirëplotin,* të cilat janë provat dhe pasqyrat e të Gjithëmëshirshmit dhe Mëshirëplotit të Vetëm dhe janë aq të sigurta, të qarta e të dukshme, saqë ashtu siç mund të thuhet për një pasqyrë të shndritshme e cila reflekton imazhin e diellit se "Ajo pasqyrë është dielli", duke treguar qartësinë e shkëlqimit të saj dhe dëshminë, po ashtu është thënë e mund të thuhet se: "Tek njeriu ekziston forma e të Gjithëmëshirshmit të Vetëm" duke treguar qartësinë e dëshmisë së Tij dhe plotësimin e lidhjes së tij me Të. Si rrjedhojë e këtij misteri, më të moderuarit e atyre që besuan në Unitetin e ekzistencës, thanë: **"Nuk ka tjetër ekzistues përveç Atij!",** si një mënyrë për të shprehur qartësinë e kësaj dëshmie dhe plotësimin e lidhjes.

اَللّٰهُمَّ يَا رَحْمٰنُ يَا رَحِيْمُ بِحَقِّ بِسْمِ اللهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيْمِ اِرْحَمْنَا كَمَا يَلِيقُ
بِرَحِيْمِيَّتِكَ وَفَهِّمْنَا اَسْرَارَ بِسْمِ اللهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيْمِ كَمَا يَلِيقُ
بِرَحْمَانِيَّتِكَ اٰمِيْن

[10] Kur'an, 30: 27

O Zot! O i Gjithëmëshirshëm! O Mëshirëplotë! Nëpërmjet të vërtetës së Bismil-Lahirr-Rrahmanirr-Rrahim, na mëshiro neve siç i përshtatet Mëshirës Tënde dhe na bëj të kuptojmë misteret e "Bismil-Lahirr-Rrahmanirr-Rrahim", siç i shkon mëshirëgjërësisë Tënde. Amin.

- **MISTERI I GJASHTË:** O njeri i mjerë që po përpiqesh të luftosh brenda pafuqisë së pakufishme dhe nevojave të pafund! Në qoftë se dëshiron të kuptosh se si Mëshira Hyjnore është mjeti më i madh dhe ndërmjetësuesi më i pranueshëm, mësoje se Mëshira është mjeti më i fuqishëm për të arritur tek Sulltani i Gjithëlavdishëm, në ushtrinë e të Cilit, si yjet ashtu edhe grimcat e vockëla, shërbejnë së bashku si ushtarë të bindur plotësisht e me disiplinë të përkryer. Ai sulltan i Gjithëlav-dishëm i parapërjetësisë dhe i paspërjetësisë është i Vetëmjaftueshëm, Ai është absolutisht i panevojshëm për krijesat. Ai është i Pasuri Absolut duke mos pasur aspak nevojë për universin e për qëniet. I gjithë universi është nën urdhrin dhe nën drejtimin e Tij, të gjitha qëniet në të i nënshtrohen plotësisht Madhështisë së Tij dhe Madhërisë dhe i dorëzohen tërësisht Lartësisë së Tij.

Atëherë, mëshira, -o njeri!- të ngre ty tek prania e Atij Pasaniku Absolut, dhe të bën ty mik të Atij Sulltani të Përjetshëm Madhështor, madje të ngjit ty tek pozita e të qënit marrësi i mesazheve të Tij, dhe të bën ty shërbëtor të nderuar e të dashur pranë Tij. Por, ashtu siç nuk mund ta arrish ti diellin për shkak të largësisë prej tij, madje në asnjë mënyrë nuk mund t'i afrohesh atij, megjithatë drita e diellit të jep ty reflektimin dhe treguesin e vet nëpërmjet pasqyrës në dorën tënde. Në të njëjtën mënyrë, ndonëse ne jemi shumë larg nga Esenca më e shenjtë Hyjnore dhe nga Dielli i Para dhe i Paspërjetësisë, prapëseprapë Drita e Mëshirës së Tij e bën Atë të jetë më afër nesh.

Dhe kështu o njeri! Ai që gjen këtë Mëshirë, ka gjetur një thesar të pashtershëm drite: Rruga për ta gjetur atë është nëpërmjet ndjekjes së sunnetit të profetit Muhammed a.s.m. i cili ishte shembulli më brilant dhe përfaqësuesi i Mëshirës, gjuha e saj më elokuente dhe lajmëtari i saj, dhe që u përshkrua në Kur'anin e shenjtë si ***"Mëshirë për të gjitha botët."*** Por, si mund të arrihet tek profeti i dashur, i cili u cilësua si ***"Mëshirë për të gjitha botët"*** dhe me çfarë mjeti? Mësoje se mjeti për tek ai është rënia salevat mbi të.

Po, salevati mbi të do të thotë mëshirë; salevati mbi të është lutje mëshire, për atë mëshirë të gjallë të mishëruar; është mjeti i arritjes së mëshirës së të gjitha botëve. **Kështu o njeri!,** Bëje salevatin mbi të mjetin e arritjes për tek ai, pastaj kapu pas tij që të të bëjë ty të arrish Mëshirën e të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

I gjithë Ummeti musliman me duatë e shumta dhe me salevatet e tij të pakufishme për Profetin a.s.m. provon, në mënyrën më të shndritshme, se çfarë dhurate e vlefshme Hyjnore është Mëshira Hyjnore, dhe sa e gjërë është sfera e saj.

***Si përfundim*:** Ashtu siç është profeti Muhammed a.s.m. xhevahiri më i çmueshëm në thesarin e Mëshirës dhe derëtari i tij, po ashtu çelësi i parë i tij është بِسْمِ اللهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ *"Bismil-Lahir-Rrahmanir-Rrahim."*

Dhe një çelës i tij më i kollajt është salevati për Profetin a.s.m.

اَللّٰهُمَّ بِحَقِّ اَسْرَارِ بِسْمِ اللهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ صَلِّ وَسَلِّمْ عَلٰى مَنْ اَرْسَلْتَهُ رَحْمَةً
لِلْعَالَمِيْنَ كَمَا يَلِيقُ بِرَحْمَتِكَ وَبِحُرْمَتِهِ وَعَلٰى اٰلِهِ وَاَصْحَابِهِ اَجْمَعِيْنَ
وَارْحَمْنَا رَحْمَةً نُغْنِيْنَا بِهَا عَنْ رَحْمَةِ مَنْ سِوَاكَ مِنْ خَلْقِكَ اٰمِيْنْ

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا اِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا اِنَّكَ اَنْتَ الْعَلِيْمُ الْحَكِيْمُ

O Zot! Nëpërmjet të vërtetës së "Bismil-lahirr-Rrahmanirr-Rrahim" jepi bekime e paqe atij të cilin Ti e dërgove si mëshirë për të gjitha botët siç i përshtatet Mëshirës Tënde, dhe në nderim të tij, të gjithë familjes dhe shokëve të tij. Dhe na jep ne aq mëshirë sa të na çlirosh ne nga nevoja për mëshirën e dikujt tjetër përveç Teje midis krijesave. Amin!

Lavdia të takon Ty! Ne nuk kemi njohuri përveç asaj që Ti na e ke mësuar. Në të vërtetë Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti."

* * *

SHKREPTIMA E PESËMBËDHJETË

Kjo përbëhet nga indekset e Sözler (Fjalëve), Mektubatit (Letrave) dhe Lemeatit (Shkeptimave), nga shkreptima e Parë gjer tek e Katërmbëdhjeta.

Meqenëse ato janë përfshirë në vëllimet përkatës, ato nuk janë botuar këtu.

* * *

SHKREPTIMA E GJASHTËMBËDHJETË

بِاسْمِهِ وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ

اَلسَّلَامُ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَةُ اللهِ وَبَرَكَاتُهُ

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

"Dhe s'ka ndonjë gjë që të mos e lëvdojë Lartësinë e Tij".

Paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ju!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë, Hoxha Sabri, Hafiz Ali, Mes'ud, Mustafatë, Husrev, Refet, Bekir Beu, Rushtu, Lutfitë, Hafiz Ahmet, Shejh Mustafa, dhe të tjerët! Më erdhi në zemrën time që t'ju shpjegoj në mënyrë të përmbledhur e instruktive katër çështje të vogëla të cilat kanë qenë subjekt kureshtjeje dhe pyetjesh.

■ *E Para*

Disa nga vëllezërit tonë si Çaprazzade Abdull-llah efendi kishte dëgjuar të tregohet prej atyre që zbulojnë realitetet, se në këtë Ramazanin e fundit një lehtësim nga vështirësitë dhe një fitore do të ndodhë për Sunnitët -për Ehl-es-Sunneh Vel-Xhemaah-, ndërsa ajo nuk ndodhi. Ata më pyetën mua: Përse Njerëzit e shenjtërisë dhe të ndriçimit të tillë si ai bëjnë parashikime që janë në kundërshtim me realitetin? Dhe përmbledhja e saj që ua dhashë si përgjigje, me të cilën unë u inspirova, është kjo:

"*Disa herë fatkeqësia bie mbi një person, por ajo ndeshet me sadekanë -lëmoshën- dhe e largon atë (fatkeqësinë)*"[1]. Kuptimi i nënkuptuar i këtij Hadithi tregon se kur vijnë ngjarjet e paracaktuara nga e padukshmja, vijnë të lidhura me disa kushte.

[1] Hakim, el Mustedrek

Ndodhja e tyre vonohet me vonimin e kushteve. Gjithashtu vonohen edhe ngjarjet e paracaktuara të cilat i shikojnë Evlijatë nga njerëzit e zbulesës, pasi ato nuk janë ngjarje të paracaktuara absolute, por të kufizuara me kushte dhe, për shkak të mosqënies së atyre kushteve, nuk ndodh ajo ngjarje; sepse ajo ngjarje është si exheli i lidhur i cili është shkruar e paracaktuar në *Tabelën e zhdukjes dhe të ripohimit* –në Pllakën e fshirjes dhe të vërtetimit- që është një lloj nga llojet e regjistrit të Pllakës së Parapërjetshme. Zbulesat, tepër rrallë, mund të ngjiten tek Pllaka e Parapërjetshme, madje pjesa më e madhe e zbulesave nuk mund të ngjitet atje. Atëherë duke u mbështetur në këtë:

Parashikimet që u bënë si rezultat i interpretimeve ose zbulesave -ndriçimeve- në këtë Ramazan dhe në Festën e Kurban Bajramit dhe në kohë të tjera nuk ndodhën, nuk u bënë realitet, sepse kushtet mbi të cilat ato vareshin nuk u plotësuan. Parashikuesit e atyre ngjarjeve nuk përgënjeshtrohen, sepse ato ngjarje ishin paracaktuar, por ato nuk ndodhin veçse kur përmbushen kushtet; pra, në qoftë se nuk vijnë kushtet, nuk ndodh ngjarja.

Po, duatë e sinqerta që bëjnë shumica e Sunnitëve -Ehli-es-sunneh Vel Xhemaah- në Ramazanin e bekuar për të larguar bidatet, ishin një kusht dhe një shkak i rëndësishëm, por meqenëse bidatet kishin hyrë nëpër xhami në Ramazan, ato formuan një pengesë për pranimin e duave, dhe lehtësimi e fitorja nuk erdhi. Ashtu si në përputhje me Hadithin e lartëpërmendur që sadekaja e largon fatkeqësinë, edhe duatë e sinqerta të bëra nga shumica tërheqin e sjellin një lehtësim të përgjithshëm, por meqenëse forca tërheqëse nuk erdhi në ekzistencë, ai lehtësim edhe ajo fitore nuk u dhanë.

■ *Pyetja e Dytë Kureshtare:*

Në dy muajt e fundit ka qenë një situatë e gjallë politike përballë të cilës ndonjë përpjekje duhej të ishte bërë për të lehtësuar kushtet edhe për veten time, edhe për vëllezërit me të cilët unë jam lidhur. Ndërsa kishte një mundësi të fortë që kjo mund të ishte arritur, unë nuk i dhashë rëndësi situatës, por në kundërshtim me këtë, unë kisha një ide në mbështetje të "njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje" të cilët më ngushtojnë e më shtypin mua! Disa njerëz u çuditën për këtë. Ata thanë: "Çfarë mendon rreth politikave të cilat i ndjekin ata njerëz të

bidateve që janë kundra teje dhe një grup nga hipokritët kryesues të cilët të mundojnë ty, saqë ti nuk po i sulmon ato?

Një përmbledhje e përgjigjes sime është sa vijon:

Rreziku më i madh me të cilin përballen muslimanët në këtë kohë është prishja e zemrave dhe lëkundja e besimit që vjen nëpërmjet çudhëzimit që buron nga shkenca dhe nga filozofia. Ilaçi i vetëm për rregullimin e zemrës dhe për shpëtimin e besimit, është drita, është t'ua shfaqësh dritën që ata të reformohen. Në qoftë se dikush do të vepronte me topuzin e politikave dhe i sundon ata, mohuesit do të zbrisnin në shkallën e hipokritëve. Dhe hipokritët janë më të këqinj se sa mohuesit. Domethënë, topuzi nuk mund ta rregullojë zemrën në këtë kohë, pasi mohimi zbret e futet në thellësitë e zemrës, fshihet atje dhe transformohet në hipokrizi.

Pastaj, në këtë kohë, një person i pafuqishëm si unë, nuk mund t'i përdorë edhe dritën, edhe topuzin njëherësh. Prandaj unë jam i detyruar ta përqafoj dritën me të gjithë fuqinë time dhe duhet të mos kthehem tek topuzi i politikave si do që të jetë lloji i tij. Çfarëdo që të kërkoj Xhihadi fizik, ne nuk jemi të ngarkuar me atë detyrë aktualisht -tani. Po, topuzi është për të ndaluar agresionet dhe sulmet e mohuesve ose të felëshuesve; por ne kemi vetëm dy duar. Madje edhe në qoftë se do të kishim njëqind duar, ato do të ishin të mjaftueshme vetëm për dritën. Ne nuk kemi ndonjë dorë tjetër me të cilën të mbahet topuzi i politikës!

■ *Pyetja e Tretë Kureshtare*

Sulmet e të huajve si ato të Anglisë dhe të Italisë mbi këtë qeveri në këtë kohën e fundit çojnë në nxitjen e zellit islamik -pikën e vërtetë të mbështetjes dhe burimin e fuqisë morale të qeverisë së këtij vendi qysh prej një kohe të gjatë dhe do të ishin një mjet deri diku për rigjallërimin e shenjave islame- dhe për t'i larguar e zmbrapsur deri diku bidatet -risitë.. Përse e kundërshtove me vrull këtë luftë dhe i bëre lutje Allahut që çështja të zgjidhet me mjete paqësore, dhe u bëre i bashkuar e në favor të një qeverie që bën bidate. A nuk është kjo me rezultatet e saj një mbështetje e tërthortë për bidatet?

Përgjigjja: Ne duam lehtësim, qetësi, lumturi dhe fitore, por jo me shpatën e mohuesve.. le të jenë shpatat e mohuesve fundi i tyre! Ne nuk kemi nevojë për asnjë avantazh që vjen nga shpatat e tyre. Në fakt janë

ata europianë kryeneçë të cilët i kanë vendosur hipokritët për t'u rënë në qafë besimtarëve dhe kanë zhvilluar e edukuar ateistët midis tyre.

Sa për fatkeqësinë e luftës, ajo do të shkaktonte një dëm të madh për shërbimin tonë ndaj Kur'anit. Meqenëse shumica e vëllezërve tonë më të çmueshëm e vetësakrifikues janë nën moshën dyzet e pesë vjeç, ata do të detyroheshin për shkak të luftës të lënë shërbimin e tyre të shenjtë ndaj Kur'anit dhe do të shkonin ushtarë. Në qoftë se unë do të kisha pasur para, do të paguaja me kënaqësi një mijë lira të domosdoshme për ta liruar secilin prej atyre vëllezërve të vlefshëm nga shërbimi ushtarak. Qindrat e vëllezërve të mi të vlefshëm duke lënë shërbimin Kur'anor të Risale-i Nurit dhe duke ushtruar xhihadin fizik, do të ishte një dëm i madh për shërbimin tonë, unë ndjej se ajo humbje është më shumë se njëqind mijë lira, madje këto dy vitet e shërbimit ushtarak të Zekais kanë shkaktuar ndoshta që të humbasin njëqind mijë lirat e përfitimit të tij jolëndor.

Sidoqoftë ashtu si i Gjithëfuqishmi i Gjithëlavdishëm i Cili e pastron për një minut atmosferën e mbushur me re dhe shfaq diellin e shndritshëm në qiejt e pastër, po ashtu Ai mund t'i largojë këto re të zeza e të pamëshirshme dhe t'i shfaqë të vërtetat e sheriatit si dielli ndriçues me të gjithë lehtësinë e kollajllëkun dhe pa humbje. Ne e presim atë nga mëshira e Tij e gjërë dhe i lutemi Atij xh.sh. që Ai të mos na i shesë ato ne shtrenjtë. U dhëntë Ai mend kokave të atyre që janë në kryesi dhe u dhëntë besim zemrave të tyre. Ajo do të ishte e mjaftueshme, dhe atëherë çështjet do të drejtoheshin e do të rregulloheshin.

■ *Pyetja e Katër Kureshtare*

Ata thonë: "Meqenëse ajo që ju e mbani në duart tuaja është dritë, dhe jo topuz, drita nuk mund të kundërshtohet, dhe as nuk mund të iket prej saj dhe as dëm nuk mund të vijë nga shfaqja e saj. Atëherë, përse i porosisni shokët tuaj që të kujdesen e të ruhen dhe i pengoni ata që t'u shfaqin njerëzve pjesët e shumta të mbushura me dritë të Risale-i Nurit?

Një përgjigje për këtë pyetje është kjo: Kokat e shumicës së atyre që janë në kryesi janë të dehura dhe nuk mund t'i lexojnë. Edhe në qoftë se do t'i lexonin, ata nuk mund t'i kuptojnë; ata u japin atyre

kuptim të gabuar, dhe ndërhyjnë e sulmojnë. Me qëllim që ata të mos ndërhyjnë, ato nuk duhet t'u tregohen atyre derisa të vijnë vetë.

Pastaj ndodhen shumë njerëz të padrejtë të cilët nga inati, ose nga ambicia ose nga frika, e mohojnë dritën, ose i mbyllin sytë e tyre ndaj saj. Prandaj, unë i këshilloj vëllezërit e mi të jenë të kujdesshëm dhe të mos ua japin të vërtetat atyre të cilët janë të papërshtatshëm, dhe të mos bëjnë gjëra që nxisin dyshimet e "Njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj Dynjaje"[2].

Përfundim

Sot unë mora një letër nga Refet Bej. Në lidhje me pyetjen e tij rreth mjekrës së Profetit a.s.m, unë them këtë:

Është vërtetuar nga hadithe se numri i qimeve nga mjekra e bekuar e Profetit a.s.m. ishte i kufizuar pavarësisht qënies së tyre të pakta në numër, rreth tridhjetë, dyzet, pesëdhjetë ose gjashtëdhjetë; fakti se ndodhen qime prej mjekrës së bekuar në mijëra vende më bëri mua të mendoj shumë në një kohë rreth saj. Në atë kohë m'u shfaq në zemrën time, sa vijon:

Qimet e mjekrës së bekuar që gjenden tani, në çdo vend, nuk janë vetëm qimet e mjekrës së bekuar, por ndoshta janë edhe qimet e kokës së tij të bekuar, sepse Sahabët e nderuar, të cilët nuk neglizhonin asgjë, i ruajtën flokët e kokës së tij të bekuar, kur ai i qethte. Flokët e Tij të

[2] Një anektodë rreth një çështjeje që do të kishte çuar në ngjarje serioze. Dje në mëngjes Sejjid Muhammed i cili ishte dhëndri i njërit prej shokëve të mi erdhi tek unë dhe tha i gëzuar dhe si dikush që jep lajme të gëzueshme: Kanë botuar në Isparta një libër prej librave të tu dhe shumë njerëz e lexojnë. Unë i thashë: Ai nuk është botim i ndaluar por është ai i cili është marrë prej kopjeve, është shumëfishuar me hektograf -makinë shumëfishimi-, dhe për atë qeveria nuk thotë asgjë. Unë i thashë gjithashtu; ki kujdes që mos t'ua thuash këtë shokëve të tu hipokritë, pasi ata kërkojnë gjëra që t'i përdorin si pretekst për të sulmuar. O shokët e mi! Njeriu ishte dhëndri i njërit prej shokëve të mi, dhe me këtë lidhje ai konsiderohet nga të dashurit e mi, por ama nëpërmjet qënies berber, ai është shoku i mësuesit të pandërgjegjshëm dhe i drejtorit hipokrit. Këtë haber e dha njëri nga vëllezërit tonë atje duke qenë i pavetëdijshëm për të. Kështu ishte gjë e mirë që ai më njoftoi më parë dhe i thashë të kujdeset. Dhe me rolin tim i paralajmërova edhe vëllezërit gjithashtu. Dhe me të u bllokua fesadi -e keqja. Dhe makina shumëfishuese botoi mijëra kopje nën këtë perde. Autori.

bekuara, të cilat mbetën përgjithmonë, numërohen me mijëra dhe mund të jenë të barabarta me ato që janë ekzistuese tani.

Gjithashtu unë isha kureshtar të dija në atë kohë nëse është vërtetuar me hadithe të sakta ose jo për qimet që gjenden në çdo xhami a ishin të Profetit a.s.m. me qëllim që vizitat tona të ishin të arsyeshme në të, ndërkohë papritmas m'u shfaq sa vijon:

Të vizituarit e atyre qimeve janë thjesht një *Vesile* -një mjet-; është një shkak për të kënduar salevate për profetin Muhammed a.s.m., dhe është boshti i dashurisë për të dhe i respektit e nderimit ndaj tij. Meqenëse ai ishte mjeti -*vesileja*-, natyra esenciale e gjësë nuk merret në konsideratë, por natyra e saj si një mjet. Prandaj, edhe në qoftë se ajo nuk ishte qimja e vërtetë nga qimet e profetit Muhammed a.s.m., ajo e kryen misionin e atij mjeti përderisa konsiderohet -nga ana e jashtme- të jetë kështu dhe njerëzit e kanë marrë atë se është njëra nga qimet e tij a.s.m.. Dhe meqenëse ajo qime është mjet për nderimin e tij, për dashurinë e tij dhe për të kënduar salevate mbi të, atëherë nuk është e domosdoshme për ta përcaktuar saktë dhe për të vërtetuar saktësinë e qimes por do të ishte e mjaftueshme, veçse në qoftë se do të kishte ndonjë dëshmi të sigurt për të kundërtën; sepse mendimet e mbajtura në përgjithësi dhe pranueshmëria që ka treguar komuniteti iskamik konsiderohet si një lloj prove.

Edhe në qoftë se disa njerëz të përkushtuar -me takva- do t'i kundërshtonin çështje të këtilla qoftë nga aspekti i frikës ndaj Zotit -takvasë- ose nga aspekti i marrjes së masave për t'u ruajtur, ose nga aspekti i të vepruarit me *Azimen* -vendosmëri-, ata kundërshtojnë qime të veçanta. Edhe në qoftë se ata do ta quanin një veprim të tillë si bidat -risi- përsëri ai përfshihet brenda "*Bidatit Haseneh"* -bidate të lavdërueshme, të miratueshme-, sepse ai është mjet për të kënduar salevate për Profetin Muhammed a.s.m..

Refet Bei tha në letrën e tij: "Kjo çështje ka qenë shkak debati e diskutimi midis vëllezërve". Unë i këshilloj vëllezërit e mi që të mos debatojnë në një mënyrë që do të shkaktonte grindje e përçarje; ata duhet të mësohen t'i diskutojnë gjërat si një shkëmbim idesh, pa hyrë në polimika.

* * *

بِاسْمِهِ سُبْحَانَهُ وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ

اَلسَّلَامُ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَةُ اللهِ وَبَرَكَاتُهُ

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

"Dhe s'ka ndonjë gjë që të mos e lëvdojë Lartësinë e Tij".

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë nga Senirkenti[3], Ibrahim, Shukru, Hafiz Bekkir, Hafiz Husejn, Hafiz Rexhep Efendi!

Ateistët, për një kohë të gjatë kanë kundërshtuar tri çështjet të cilat ti i dërgove nëpërmjet Hafiz Teufikut.

E Para

Sipas kuptimit të qartë të vërsetit,

حَتَّىٰٓ إِذَا بَلَغَ مَغْرِبَ الشَّمْسِ وَجَدَهَا تَغْرُبُ فِي عَيْنٍ حَمِئَةٍ *"Derisa, kur arriti vendperëndimin e Diellit, pa që ai perëndonte, në një vend ku buronte ujë i zi i nxehtë i turbulluar"*,[4] ai pa diellin duke perënduar në një burim uji të nxehtë e me baltë.

E Dyta

Ku është: Pengesa e Dhul-Karnejnit?

E Treta

Kjo është rreth Isait -Jezusit- a.s. që do të vijë në Fundin e kohës dhe që do të vrasë Dexhalin.

Përgjigjet për këto pyetje janë të gjata, por ne do t'i tregojmë ato në mënyrë të shkurtuar dhe themi: Meqenëse vërsetet e Kur'anit i shprehin çështjet sipas stileve të gjuhës Arabe, në përshtatje me paraqitjet e

[3] Një qytet pranë Barlas, në të cilin u internua Ustadhi.
[4] Kur'an, 18:86

jashtme, në një mënyrë që t'i kuptojnë njerëzit në përgjithësi, ato shpeshherë i shpjegojnë gjërat në formën e metaforave, të alegorive dhe të krahasimeve.

Atëherë vërseti تَغْرُبُ فِي عَيْنٍ حَمِئَةٍ *"pa që ai perëndonte, në një vend ku buronte ujë i zi i nxehtë i turbullуar"*, do të thotë: Dhul-Karnejni shikoi diellin duke perënduar në brigjet e oqeanit Atlantik, i cili u duk si të ishte një burim me ujë të valuar e me baltë, ose e pa atë të perëndojë në një grykë të zjarrtë e të tymosur vullkanik. Domethënë, në shikimin e jashtëm, Oqeani Atlantik u duk për Dhul-Karnejnin në largësi si një pellg i një burimi të madh i rrethuar nga një moçal me një nxehtësi të fortë të diellit të verës duke lëshuar avull dhe si i turbullt; ai e pa perëndimin e dukshëm të diellit në një pjesë të tij. Ose ai e pa diellin, syrin e qiejve, duke u fshehur në një pellg të zjarrtë në majë të vullkanit, i cili po villte llavë dhe ishte i përzier me dhé, me shkëmbinj dhe me minerale të lëngshme.

Po, shprehjet elokuente e të mrekullueshme të Kur'anit të gjithurtë udhëzojnë nëpërmjet kësaj fjalie në çështje të shumta:

Së pari, duke shpjeguar se udhëtimi i Dhul-karnejnit për në perëndim përkoi e koinçidoi me nxehtësinë e fortë të verës, me zonën e moçalit, me kohën e perëndimit të diellit dhe me kohën e një shpërthimi vullkanik, vërseti aludon për shumë mësime udhëzuese të tilla, si: Pushtimi i plotë i Afrikës nga Dhul-karnejni dhe mbisundimi i tij në të.

Dihet qartë se lëvizja e dukshme e diellit është vetëm se një lëvizje e jashtme, dhe ajo tregon lëvizjen e fshehur të tokës dhe të pandjeshme; pra, ajo njofton atë lëvizje. Dhe çfarë ajo synon nuk është perëndimi i vërtetë i diellit.

Gjithashtu fjala 'Burim' është një metaforë, sepse një det i madh shikohet nga larg si një pellg i vogël. Shëmbëllimi i detit duke u shfaqur pas moçaleve dhe, mjegullat e avujt duke u ngritur prej tij për shkak të nxehtësisë, me 'një burim të turbullt'; po ashtu përdorimi i Fjalës عَيْنٍ *Ajn,* e cila në arabisht ka kuptimin edhe *burim*, edhe *diell,*

edhe *sy*, është më kuptimplota dhe më me vend në përputhje me misteret e elokuencës.[5]

Dhe siç u duk kështu perëndimi -i diellit- për Dhul-karnejnin nga largësia, po ashtu edhe adresimi qiellor i Kur'anit duke ardhur nga Froni më i madh dhe duke sunduar mbi trupat qiellorë, pohon se dielli i nënshtruar, i cili kryen detyrën e një llambeje në këtë bujtinë të të Gjithëmëshirshmit të Vetëm, është i fshehur në një burim Hyjnor ashtu si Oqeani Atlantik, dhe kjo është e përshtatshme për lartësinë, madhështinë dhe epërsinë e adresimit qiellor; nëpërmjet stilit të tij të mrekullueshëm, ai e shfaq detin të jetë një burim i nxehtë dhe një sy plot avull. Po, kështu duket deti për sytë qiellorë.

Shkurtazi: Duke e quajtur oqeanin Atlantik një burim me ujë të nxehtë e të turbulluar, tregon se Dhul-karnejni e shikoi atë oqean të madh si një burim për shkak të largësisë. Mirëpo për shkak se Kur'ani e shikon çdo gjë nga afër, ai nuk e pa atë që pa Dhul-karnejni, i cili ishte një lloj iluzioni. Në të vërtetë, meqenëse Kur'ani vjen nga qiejt dhe i shikon ato, ai e shikon tokën ndonjëherë si një faqe. Kështu, duke e quajtur *Ajn* -burim- detin madhështor i cili është Oqeani Atlantik që është mbuluar me mjegulla dhe me avuj, ai sigurisht tregon lartësinë, epërsinë dhe madhështinë e tij.

* * *

Pyetja juaj e dytë

Ku ndodhet pengesa e Dhul-karnejnit? Kush ishin Xhuxh Maxhuxhët -Gog e Mangogët?

---

[5] Fjala "burim" عَيْنٍ ***-ajn-*** tek فِي عَيْنٍ حَمِئَةٍ *"një burim me ujë të nxehtë e të turbulluar"* aludon për një kuptim të hollë në përputhje me misteret e retorikës, siç vijon:

Fytyra e qiellit pasi shikon nëpërmjet syrit të diellit bukurinë e mëshirës Hyjnore në faqen e tokës, dhe faqja e tokës pasi të shikojë nëpërmjet syrit të detit madhështinë Hyjnore në qiell, mbulohen dy sytë njëri brenda tjetrit dhe mbulohen burimet në faqen e tokës: vërseti Kur'anor me një fjalë të vetme dhe me një elokuencë të bukur e përmend këtë kuptim të hollë duke aluduar për atë që përfundon detyrën e syve, burimeve. Autori.

Prej shumë kohësh unë pata shkruar një trajtesë rreth kësaj pyetjeje. Ateistët mbetën të heshtur prej saj në atë kohë. Por unë nuk e kam atë trajtesë tani. Për më tepër, kujtesa ime nuk është në punë dhe nuk po më ndihmon. Gjithashtu kjo çështje është diskutuar pak në Degën e Tretë të Fjalës së Njëzet e Katërt. Prandaj, ne do të tregojmë në mënyrë shumë të shkurtuar vetëm dy ose tre pika rreth saj, sa vijon:

Sipas shpjegimeve të dhëna nga dijetarët shqyrtues e hetues, dhe siç tregohet nga titulli i Dhul-karnejnit, emrat që fillojnë me *Dhu*, si "Dhul-Jazan", përdoreshin nga mbretërit e Jemenit, prandaj ky Dhul-Karnejn nuk ishte Aleksandri -Leka- i madh. Përkundrazi, ai ishte njëri nga mbretërit e Jemenit që jetoi në kohën e Ibrahimit a.s dhe mori mësim e udhëzim nga Hizri a.s.. Ndërsa Aleksandri grek jetoi afërsisht treqind vjet para krishtit -Hazreti Isait a.s.- dhe mori mësim nga Aristoteli.

Historia njerëzore daton në mënyrë të rregullt afërsisht që prej tre mijë vitesh. Ky shikim i mangët e i shkurtër i historisë nuk është i saktë lidhur me ngjarjet para kohës së Ibrahimit a.s.. Ajo ose i përmend ato si bestytni, ose i mohon ose i sjell në mënyrë shumë të shkurtuar. Arsyeja që ky Dhul-karnejni i Jemenit u bë i njohur qysh prej kohëve të hershme në komentimin e Kur'anit me emrin Aleksandër, ishte ose për shkak se ai ishte njëri nga Emrat e tij, dhe kështu ai Aleksandri i Madh ose Aleksandri i kohëve të lashta, ose ndryshe për shkak se Kur'ani duke e përmendur për qënien e saj si një majë e ngjarjeve universale, dhe kështu Aleksandri i madh i cili ishte Dhul-karnejni ndërtoi një barrierë -pengesë- ndërmjet njerëzve të cilët ishin shtypës dhe midis atyre që ishin të shtypur dhe ndërtoi murin kinez për të penguar sulmet e atyre armiqve mizorë. Gjithashtu, shumë mbretër të fuqishëm dhe pushtues të botës si Aleksandri Grek ndoqën rrugën e Dhul-karnejnit -në aspektin material- ndërsa një grup prej Profetëve dhe poleve shpirtërorë -Evlijave- të cilët janë mbretërit e botës shpirtërore të njerëzimit, e ndoqën atë në aspektin e çështjeve shpirtërore dhe të udhëzimit.. Ata ndërtuan barriera ndërmjet maleve, njëra nga mjetet më të efektshme për t'i mbrojtur të shtypurit nga shtypësit, dhe më vonë ndërtuan kala në maje të maleve. Ata i ndërtuan vetë ato barriera ose nëpërmjet fuqisë së tyre materiale, ose nëpërmjet udhëzimit të tyre, orientimit e planimetrive të tyre. Pastaj ata ndërtuan mure përreth qyteteve dhe kështjella brenda qyteteve dhe, së fundi ata prodhuan mitralozë të lehtë koracata, topa e mburoja, të cilat ishin si kështjella të

lëvizshme. Barriera më e famshme në tokë, muri më i madh kinez, mbulon një distancë të barabartë me shtatë ditë udhëtimi dhe u ndërtua për të ndaluar sulmet kundra njerëzve të shtypur të indisë e të kinës nga fiset e egra barbare të njohura në Kur'an si Xhuxh e Maxhuxh -Gog e Magog- ose si ndryshe të njohur nga historia si Mongolë e Mançurianë. Këto fise disa herë e kanë shkatërruar qytetërimin njerëzor. Duke u shfaqur nga prapa Maleve të Himalajës, ata shkatërruan njerëzit dhe rrënuan vendet në lindje e në perëndim. Kështu, ai mur, ajo barrierë e ndërtuar ndërmjet dy maleve afër vargmaleve të Himalajës u bë për një kohë të gjatë një pengesë përballë sulmeve të shpeshta të këtyre njerëzve të egër barbarë. Ashtu siç e ndërtoi Dhul-karnejni këtë barrierë, po ashtu u ndërtuan barriera të tjera të shumta nëpërmjet përpjekjeve të Mbretërve të Persisë së lashtë, të cilët i ngjasuan Dhul-karnejnit, në malet e Kaukazit, në krahinën e Darbandit -Darit, për të penguar sulmet e befasishme të popujve grabitqarë e plaçkitës të Tartarit. Ndodhen shumë barriera të këtij lloji: Meqenëse Kur'ani i gjithurtë i flet të gjithë njerëzimit, ai përmend atë që në dukje është një ngjarje e veçantë, duke të sjellë ndërmend të gjitha ngjarjet e ngjashme me të.

Për shkak të këtij këndvështrimi, rrëfenjat dhe thëniet e komentatorëve rreth Barrierës dhe Xhuxh e Maxhuxhëve, janë të gjitha të ndryshme.

Për më tepër, për sa ka të bëjë me temat e lidhura e të treguara, Kur'ani i gjithurtë kalon nga njëra ngjarje për tek një ngjarje e largët prej saj. Dikush që nuk mendon për këtë lidhje, i supozon dy ngjarjet se janë afër në kohë. Kështu, njoftimi i Kur'anit për ndodhjen e kijametit menjëherë pas shembjes së Barrierës, nuk është në lidhje me dy ngjarjet duke qenë afër njëra-tjetrës në kohë, por për dy pika të holla për sa ka të bëjë me lidhjen e subjekteve. Domethënë, ashtu siç do të shembet kjo barrierë, gjithashtu do të shembet edhe kjo dynja. Pastaj ashtu si malet që janë barriera të natyrshme Hyjnore e të ngulura fort dhe do të shkatërrohen vetëm në fundin e botës, po ashtu kjo barrierë e fortë si një mal, do të rrafshohet me tokën vetëm me shkatërrimin e Dynjasë në Kijamet. Madje edhe në qoftë se ajo do të pësojë dëmtime e shkatërrime nga sulmet e kohës, por pjesa më e madhe e saj do të mbetet e padëmtuar.

Por, megjithëse muri i madh kinez, i cili është njëri kuptim i pjesshëm e i veçantë nga kuptimi universal i Barrierës së Dhulkarnejnit ka mbetur për mijëra vite dhe akoma është për të gjithë për ta shikuar, ai lexohet si një rresht i gjatë i mishëruar, i gurëzuar dhe kuptimplotë nga historia e lashtë e shkruar nga dora e njeriut në faqen e tokës.

* * *

Pyetja juaj e Tretë

"Ndodhen përgjigje të shkurtëra lidhur me Isain a.s. -Jezusin- duke e vrarë Dexhalin, edhe në Mektubin –Letrën- e Parë edhe në Mektubin e Pesëmbëdhjetë , të cilat janë të mjaftueshme për ju dhe janë tepër të përmbledhura.

* * *

بِاسْمِهِ وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ

اَلسَّلَامُ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَةُ اللهِ وَبَرَكَاتُهُ

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

"Dhe s'ka ndonjë gjë që të mos e lëvdojë Lartësinë e Tij".

Paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ju!

Vëllezërit e mi vetësakrifikues, besnikë e të përgjegjshëm, Hoxha Sabri dhe Hafiz Ali!

Megjithëse pyetja juaj e rëndësishme rreth vërsetit në fundin e Sures Lukman rreth Pesë gjërave të fshehura meriton një përgjigje të rëndësishme, fatkeqësisht as gjendja ime e tanishme e mendjes e as rrethanat e mia fizike nuk e lejojnë një përgjigje të tillë. Megjithatë, unë do të aludoj në mënyrë shumë të përmbledhur vetëm për disa pika që lidhen me pyetjen tuaj.

Pyetja juaj tregon se ateistët, të cilët janë shmangur nga rruga e vërtetë e fesë, kanë bërë kundërshtime e kritika lidhur me natyrën e embrionit në mitër që janë prej pesë gjërave të fshehura. Ata kanë thënë: "Instrumentet në observator mund të zbulojnë kohën kur bie shiu, atëherë këtë gjithashtu e di edhe dikush tjetër përveç Zotit xh.sh..

Gjithashtu edhe seksi i embrionit mund të njihet nëpërmjet rrezeve Rëntgen. Kjo do të thotë se është e mundur të njihen *'Pesë gjërat e Fshehura'.*

Përgjigjja: Meqenëse koha e rënies së shiut nuk lidhet me ndonjë ligj, atëherë ajo lidhet drejtpërdrejtë me Dëshirën Hyjnore. Një shembull urtësie në shfaqjen e tij nga thesari i Mëshirës duke u varur nga një dëshirë e veçantë Hyjnore është sa vijon:

E vërteta më e rëndësishme në univers dhe esenca më e çmueshme në të është ekzistenca, jeta, drita dhe mëshira; këto të katërta orientohen drejtpërdrejtë dhe pa ndërmjetësi e perde tek Fuqia Hyjnore dhe tek dëshira e Tij e veçantë. Tek krijesat e tjera, shkaqet e jashtme janë perde për ushtrimin e Fuqisë Hyjnore, dhe ligjet e caktuara dhe parimet deri diku janë një perde për dëshirën dhe për vullnetin Hyjnor, veçse ama ato perde e mbulesa nuk janë vënë para jetës, dritës dhe mëshirës, për shkak të mosrrjedhjes së urtësisë së ekzistencës së tyre në ato gjëra.

Meqenëse të vërtetat më të rëndësishme në ekzistencë janë mëshira dhe jeta, dhe shiu është burimi i jetës dhe boshti i mëshirës, madje ai është vetë mëshira, atëherë sigurisht ndërmjetësitë nuk mund të jenë perde para saj, as ligjet nuk mund ta mbulojnë dëshirën e veçantë Hyjnore për të, dhe kjo me qëllim që të detyrohet çdo individ në çdo kohë dhe për çdo çështje të japë falënderime e të bëjë adhurim, dua e lutje. Në qoftë se shiu do të kishte qenë përfshirë nën ndonjë ligj, atëherë gjithkush do të kishte qenë mbështetur tek ai ligj dhe, si rrjedhojë, dera e dhënies së falënderimeve dhe e bërjes së duave do të ishte mbyllur. Është e qartë se ndodhen dobi të shumta në lindjen e diellit. Por meqenëse ai lidhet me një ligj të caktuar, nuk i bëhen lutje Allahut për lindjen e tij, as nuk i bëhet ndonjë falënderim i veçantë.

Dhe meqenëse nëpërmjet atij ligji njihet nga njohuria njerëzore se ai do të lind të nesërmen, ajo nuk konsiderohet midis çështjeve të së Padukshmes. Por meqenëse ndodhitë e veçanta të shiut nuk ndjekin

ndonjë ligj, njerëzit detyrohen në çdo kohë që të drejtojnë lutjet tek dera e Mëshirës Hyjnore dhe të kërkojnë mirësitë e Tij. Dhe meqenëse njohuria njerëzore ka qenë e pamundur që të përcaktojë kohën e reshjes së shiut, ata e kanë konsideruar atë si një mirësi të veçantë që buron vetëm nga thesari i mëshirës, dhe i bëjnë falënderime të vërteta Allahut për të.

Për shkak të kësaj, vërseti e përfshin kohën e rënies së shiut midis pesë gjërave të fshehura.

Nxjerrja e përfundimeve paraprake të rënies së shiut nëpërmjet instrumenteve në observatore dhe pastaj përcaktimi i kohëve të reshjes nuk është njohje e së padukshmes, por nëpërmjet studimit të disa shenjave paraprake kur ato janë shfaqur nga Bota e Padukshme dhe afrohen tek bota e Dukshme.

Kur ndodhin ngjarjet më të fshehta të së padukshmes, ose kur ato janë afër ndodhjes, kjo nuk konsiderohet njohje e së padukshmes, por është njohje për diçka ekzistuese ose për qënien e saj afër ekzistencës. Madje unë vetë, nëpërmjet një ndjeshmërie në nervat e mia e kapja dhe e parandjeja ardhjen e shiut, dhe ndonjëherë e parandjeja Njëzet e katër orë para se ai të vinte. Domethënë, shiu ka shenja paraprake, shenja paralajmëruese. Ato e shfaqin vetveten nëpërmjet një lagështire duke bërë të njohur se pas saj do të vijnë reshjet e shiut. Kjo gjendje, ashtu si një ligj, është një mjet për të arritur njohja njerëzore tek çështjet të cilat e kanë lënë Botën e Padukshme, por nuk kanë hyrë akoma në Botën e dukshme. Ndërsa njohja e rënies së shiut i cili nuk i ka vënë akoma këmbët në Botën e dukshme, as nuk kanë dalë akoma prej mëshirës së veçantë Hyjnore nëpërmjet dëshirës së Tij të veçantë, kjo është e posaçme për njohjen e të Gjithëditurit të së Padukshmes.

* * *

Çështja e Dytë

Njohja nëpërmjet rrezeve Rëntgen nëse një fëmijë në mitër është mashkull apo femër nuk është në kundërshtim me kuptimin e vërsetit,

وَيَعْلَمُ مَا فِي الْأَرْحَامِ *"Dhe ai di se çfarë ka në mitra"*,[6] i cili i referohet të Padukshmes, sepse ajo që synohet nga vërseti janë shenjat paraprake të aftësisë së veçantë të fëmijës, rrjedhja e caktuar e jetës së tij dhe boshti i saj, të cilat ai do t'i fitojë në të ardhmen, madje edhe stampa e çuditshme i të Adhuruarit të Përjetshëm në fytyrën e tij - që fëmija të njihet në këtë mënyrë, kjo është e veçantë për njohjen e të Gjithëditurit të së Padukshmes. Edhe në qoftë se do të kombinoheshin qindra e mijëra rreze rëntgen, si mendjet e njerëzve, ato përsëri nuk do të mund t'i zbulonin tiparet e tij të vërteta, secila nga ato tipare është një shenjë që e dallon fëmijën nga çdo individ prej individëve të të gjithë njerëzimit. Atëherë si do të mundeshin ata t'i zbulonin tiparet jolëndore të aftësive të tij, të cilat janë njëqind herë më shumë të çuditshme se sa tiparet e tij fizike.

Ne thamë në fillim se ekzistenca, jeta dhe mëshira janë të vërtetat më të rëndësishme në univers, dhe pozita më e lartë në të është ajo e tyre. Prandaj, një arsye për atë të vërtetë gjithëpërfshirëse të jetës duke shikuar me të gjitha pikat e saj të holla dhe me hollësitë e saj tek Vullneti dhe Mëshira Hyjnore, të cilat janë të posaçme për Allahun e Gjithëfuqishëm, është kjo:

Për shkak se jeta me të gjitha aftësitë e saj është burimi për dhënien e falënderimeve dhe boshti për adhurim e për tesbihate, ligjet dhe njëtrajtësia që janë një perde për dëshirën, e cila është vetëm e Allahut, dhe ndërmjetësitë e jashtme që mbulojnë mëshirën, e cila është e veçantë për Zotin e Gjithëfuqishëm, nuk janë vënë mbi të. Allahu i Plotëfuqishëm shfaq dy manifestime në tiparet fizike dhe jofizike të fëmijëve të palindur -të embrionit.

I Pari shfaq Unitetin Hyjnor, Njësinë dhe përjetshmërinë e Tij absolute, sepse embrioni -fëmija- dëshmon Unitetin e Krijuesit të tij dhe të Shpikësit nëpërmjet përshtatshmërisë së gjymtyrëve të tij themelore dhe harmonisë së organeve njerëzore me qëniet e tjera humane. Me këtë gjuhë, ai fëmijë thërret e bërtet: "Ai i Cili m'i dha këto tipare dhe gjymtyrë është Ai që ua dha ato të gjitha qënieve njerëzore, të cilët kanë ngjashmëri me mua lidhur me gjymtyrët themelore dhe Ai është Krijuesi i të gjitha qënieve të gjalla".

[6] Kur'an, 32:34

Kështu, kjo gjuhë e fëmijës në mitër nuk i përket të padukshmes; ajo mund të njihet meqenëse ajo ndjek një ligj, vepron sipas një rregulli të caktuar dhe mbështetet tek natyra e embrionit -llojit. Kjo njohje është një gjuhë folëse dhe një degë e cila është varur nga bota e padukshme për tek Bota e dukshme.

Aspekti i Dytë: Nëpërmjet gjuhës së tipareve të aftësive të tij të veçanta dhe të veçorive individuale, embrioni -fëmija- shpall zgjedhjen e Krijuesit të tij, dëshirën e Tij absolute, vullnetin e Tij të posaçëm dhe mëshirën e Tij të veçantë. Kjo gjuhë është një gjuhë e së padukshmes duke ardhur prej andej; askush nuk ka mundësi ta shohë atë para se të vijë në ekzistencë përveç Njohjes së Parapërjetshme. Dhe këto tipare e veçori nuk mund t'i rrethojë a t'i përfshijë askush tjetër përveç Tij xh.sh..

Shkurtazi: Në tiparet e aftësisë së brendaqenësishme të embrionit dhe në tiparet e tij fizike ndodhen edhe dëshmia për Unitetin Hyjnor, edhe provat e Vullnetit Hyjnor dhe të Dëshirës Hyjnore.

Në qoftë se Allahu i Plotëfuqishëm do të japë sukses, do të shkruhen disa pika rreth '*Pesë gjërave të fshehura'*. Por për tani unë nuk kam më shumë kohë dhe gjendja ime nuk e lejon atë dhe, kështu po e mbyll fjalën time.

اَلْبَاقِي هُوَ الْبَاقِي

I Qëndrueshmi i Vetëm, Ai është i Qëndrueshmi i Vetëm!

Said Nursi

*** * ***

بِاسْمِهِ وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ

اَلسَّلَامُ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَةُ اللهِ وَبَرَكَاتُهُ

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

"Dhe s'ka ndonjë gjë që të mos e lëvdojë Lartësinë e Tij".

Vëllai im i dashur, besnik e kureshtar, Refet Bei!

Ti në letrën tënde pyet rreth Dhjetë aftësive të holla. Nuk është e përshtatshme që të jap udhëzim për Tarikatin Sufi në kohën e tanishme; sidoqoftë ndodhen veprat e dijetarëve Nakshibendi lidhur me Dhjetë aftësitë e holla. Detyra jonë në kohën e tanishme është të zbulojmë misteret e Kur'anit, dhe jo të tregojmë çështjet ekzistuese tashmë të njohura! Mos u ofendo, unë nuk mund të jap hollësira. Unë vetëm do të them këtë:

Imam Rabbani i përcaktoi dhjetë aftësitë e holla si zemra, shpirti, sekreti -zemra e brendshme-, e fshehta dhe më e fshehta. Ai përmendi se secili element nga katër elemetet tek njeriu ka një aftësi njerëzore të përshtatshme e në harmoni me të. Ai në mënyrë të përmbledhur përmendi përparimin dhe ngjitjen e secilës prej atyre aftësive dhe të gjendjeve të tyre në çdo shkallë të udhëtimit shpirtëror.

Unë vetë shikoj se ndodhen aftësi të shumta të holla të përfshira në natyrën gjithëpërfshirëse të njeriut dhe në mundësitë e tij jetike prej të cilave dhjetë janë bërë më të famshmet; saqë filozofët dhe dijetarët e aspekteve të jashtme të gjërave i morën ato Dhjetë aftësi si bazat e teorive të tyre në një formë tjetër, duke i quajtur ato pesë shqiset e jashtme dhe pesë shqiset e brendshme, të cilat janë dritaret ose modelet e atyre Dhjetë aftësive. Në fakt, dhjetë aftësitë e holla, të cilat njihen si nga njerëzit e ditur ashtu edhe nga njerëzit e zakonshëm, lidhen me dhjetë aftësitë e holla të Tarikateve Sufi, dhe janë në harmoni me to. Për shembull, në qoftë se aftësitë, si: ndërgjegjja, nervat, ndjenjat, mendja, dëshirat, fuqia e dëshirave shtazore dhe fuqia e zemërimit do t'u shtoheshin a bashkëngjiteshin zemrës, shpirtit dhe zemrës së

brendshme, atëherë dhjetë aftësitë e holla do të shfaqeshin në një formë tjetër. Përveç këtyre, ndodhen shumë aftësi të tjera të holla, si parandjenja dhe fuqitë e ndryshme shtytëse e stimuluese. Në qoftë se do të shkruhej realiteti i kësaj çështje, do të zgjatej shumë. Prandaj unë detyrohem ta pres shkurt duke mos hyrë në detaje meqenëse e kam kohën shumë të kufizuar.

Sa për pyetjen tënde të dytë rreth aspektit të gjërave të cilat shikojnë tek vetvetja dhe aspektit i cili shikon tek Krijuesi i tyre -*Mana-ismi dhe Maëna harfijj*-, ato janë shpjeguar në fillimin e të gjitha librave të gramatikës së arabishtes. Për më tepër, ndodhen shpjegime të mjaftueshme për to, së bashku me krahasimet, në veprat e shkencës së *Hakikatit* -realitetit- të quajtura *Fjalët* dhe *Letrat*. Për dikë të zgjuar e të saktë si shembulli yt, një diskutim i mëtejshëm do të ishte tepër i panevojshëm.

Në qoftë se ti do ta shikoje pasqyrën lidhur me qënien e saj si xham, ti do të shihje materialin e saj prej xhami, dhe imazhi i shfaqur në të do të dukej si diçka dytësore. Kurse në qoftë se qëllimi yt është për ta shikuar pasqyrën me qëllim që të shohësh imazhin e shfaqur në të -fytyrën tënde-, atëherë imazhi shfaqet i qartë para teje saqë të shtyn ty të thuash: *"I shenjtëruar është Allahu, më i Miri i krijuesve",*[7] dhe xhami i pasqyrës do të mbetej diçka dytësore.

Shikimi i parë përfaqëson kuptimin *Ismijj* i cili shikon tek vetë gjëja. Domethënë, xhami i pasqyrës është kuptimi i synuar, kurse imazhi i njeriut që shfaqet në të është kuptim *Harfijj*, jo i synuar. Ndërsa tek Shikimi i dytë, imazhi i personit që shfaqet në të është i synuar, atëherë ky është kuptimi *Ismijj*, kurse xhami është kuptimi *Harfijj*.

Në librat e gramatikës thuhet lidhur me përkufizimin e *ismit* -emrit- se ai tregon një kuptim në vetvete, ndërsa *Harfi* tregon diçka tjetër përveç vetvetes. Sipas shikimit Kur'anor, të gjitha qëniet në univers janë shkronja duke shprehur një kuptim tjetër përtej vetvetes; domethënë ato shprehin manifestimet e Emrave të bukur Hyjnorë dhe Atributet Madhështore të Krijuesit Fuqiplotë që shfaqen tek krijesat.

[7] Kur'an, 23:14

Ndërsa shikimi i pashpirt -i vdekur- i filozofisë në shumicën e rasteve i shikon qëniet në përputhje me kuptimin i cili shikon tek vetë gjëja; dhe u shmang e ra në moçalin e natyrës.

Megjithatë... unë nuk kam kohë tani për të folur më shumë. Në fakt, unë madje nuk mund të shkruaj as pjesën e fundit të rëndësishme të indeksit e cila është shumë e lehtë dhe e kollajtë. Përcjellua selamet e mia shokëve të tu në studim dhe në mënyrë të veçantë, Husrevit, Bekirit, Rushdiut, Lutfiut, Shejh Mustafa, Hafiz Ahmedit, Sezaiut, Mehmetëve dhe Hoxhallarëve dhe unë lutem për fëmijët tuaj të pafajshëm e të bekuar në shtëpinë tuaj të bekuar.

اَلْبَاقِي هُوَ الْبَاقِي

I Qëndrueshmi i Vetëm, Ai është I Qëndrueshmi i Vetëm!

Vëllai juaj, Said Nursi

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

Lavdia të takon Ty! Ne nuk kemi njohuri përveç asaj që Ti na e ke mësuar. Në të vërtetë Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti."

* * *

SHKREPTIMA E SHTATËMBËDHJETË

Kjo shkreptimë përbëhet nga pesëmbëdhjetë shënime të marra nga trajtesa "*Zuhre*".



"Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti".

Parathënie

Dymbëdhjetë vjet para se të shkruhej kjo shkreptimë,[1] unë shkrova në formën e shënimit në arabisht në trajtesa të tilla, si: *Zuhre, Shuëleh, Habbe, Shemme, Zerre* dhe *Katre*, një numër shkreptimash lidhur me Unitetin Hyjnor të cilat m'u bënë të qarta nëpërmjet mirësisë Hyjnore gjatë një zbulese të shpirtit, gjatë përparimit të mendjes dhe gjatë udhëtimit të zemrës në ngjitjen nëpër shkallët e njohjes Hyjnore.

Meqenëse ato u shkruan për të treguar vetëm majën e fillimin e një të vërteteje madhështore të gjërë dhe për të shfaqur një rreze prej rrezeve të një drite vezulluese dhe, meqenëse secila ishte në formën e një përkujtese, të shënimeve dhe të paralajmërimeve vetëm për veten time, dobitë e tyre për të tjerët ishin të kufizuara; dhe në mënyrë të veçantë, meqenëse pjesa më e madhe nga vëllezërit e mi më të sinqertë dhe ajka e tyre nuk e kishin studiuar arabishten, unë u detyrova përballë këmbënguljes dhe insistimit të tyre për t'i shkruar sqarimet e një pjese prej atyre kujtesave dhe shkreptimave në gjuhën turke. Dhe unë po mjaftohem me përkthimin e pjesës së fundit të tyre. Meqenëse këto shënime dhe trajtesat arabisht formojnë veprat e para të Saidit të Ri që burojnë nga njohja e realitetit, të cilat ai, deri diku, i pa në formën e ndriçimit, kuptimet e tyre janë shkruar të pandryshuara. Për shkak të kësaj, një numër nga fjalitë janë përfshirë këtu pavarësisht qënies së

[1] Domethënë në vitin 1340 H/1921

tyre të përmendura në disa pjesë të tjera të Risale-i Nurit. Dhe disa të tjera nuk janë shpjeguar pavarësisht qënies së tyre shumë të përmbledhura me qëllim që të mos humbasë hollësia e origjinalit.

● Shënimi i Parë

Iu adresova nefsit tim duke thënë: O Said i pavëmendshëm! Dije se nuk është e denjë për ty që ta lidhësh zemrën tënde me diçka që nuk do të të shoqërojë ty pasi t'i vijë fundi dynjasë dhe që do të ndahet prej teje kur ajo të shkatërrohet. Nuk do të ishte e arsyeshme ta lidhësh zemrën tënde me gjërat kalimtare të cilat do të të kthejnë shpinën dhe do të të lënë kur shekulli në të cilin ti jeton vjen në fund, dhe nuk të shoqëron në udhëtimin përmes Botës së ndërmjetme, as nuk të përcjell ty tek dera e varrit, dhe të cilat duke të të lënë ty përgjithmonë pas një ose dy vitesh, do të të rëndojnë me gjynahet e tyre, dhe pavarësisht inatit tënd, ato të lënë në momentin e kënaqësisë tënde dhe në kohën që ti e arrin atë.

Në qoftë se je i ndjeshëm, ti do t'i lije gjërat që do të dërrmohen e shkatërrohen nën goditjet e revolucioneve dhe të përmbysjeve të kësaj dynjaje dhe nën zhvillimet e botës së ndërmjetme dhe nën përmbytjet e përplasjet e Ahiretit; gjëra të cilat nuk janë në gjendje të të shoqërojnë e të të zënë mik në udhëtimin drejt përjetësisë. Mos u jep rëndësi atyre. Mos u dëshpëro për kalimin e tyre.

Shqyrtoje natyrën tënde. Midis aftësive të tua të holla është njëra e cila nuk mund të jetë e kënaqur me asgjë përveç përjetësisë dhe të Përjetshmit. Ajo nuk mund të orientohet tek asgjë dhe askush tjetër përveç Atij të Përjetshmi, ajo nuk mund ta poshtërojë veten për ato. Sikur asaj t'i jepej e gjithë dynjaja, ajo nuk do ta kënaqte atë nevojë të bashkëlindur -të natyrshme... Ajo është monarkja e aftësive të tua të holla dhe e shqisave të tua. Kështu, bindiu monarkes së aftësive të tua të holla, e cila i bindet urdhrit të Krijuesit të saj të Gjithurtë dhe gjej shpëtim...!

●Shënimi i Dytë

Unë kam parë në një ëndërr të vërtetë në të cilën u thashë njerëzve:

O Njeri! Njëri nga parimet e Kur'anit është ky: Mos konsidero ndonjë gjë përveç Allahut të Plotëfuqishëm të jetë më e madhe se sa ti

dhe ta ngresh atë në shkallën e adhurimit, dhe mos pandeh se ti je më i madh se çdo gjë prej gjërave duke shfaqur arrogancë mbi të, sepse përveç Krijuesit, barazohet në dimension lidhur me 'adhurimin' dhe për sa ka të bëjë me 'krijueshmërinë'.

●Shënimi i Tretë

O Said i pavëmendshëm! Ti ke iluzione dhe e shikon dynjanë që kalon shpejt si të pavdekshme e të qëndrueshme. Kur ti shikon horizontet përreth teje dhe i sheh ato si të qëndrueshme e të vazhdueshme, deri diku, si lloj dhe si tërësi. Dhe kështu, duke i parë me të njëjtin shikim edhe ti gjithashtu e sheh nefsin tënd kalimtar të jetë i vazhdueshëm, dhe tek kjo nuk trembesh veçse nga tmerri i Ditës së fundit -kijametit; dhe sikur ti do të jetoje deri në ditën e kijametit, dhe tronditesh veçse prej saj!

Përdore arsyen tënde! Ti dhe dynjaja jote e veçantë jeni të zbuluar vazhdimisht, në çdo moment, para goditjeve të vdekjes dhe të zhdukjes.. iluzioni yt dhe sofistika i ngjasojnë këtij krahasimi:

Në qoftë se ti ke një pasqyrë në dorën tënde të cilën e ke kthyer drejt një shtëpie ose një qyteti ose një kopshti, imazhi i shtëpisë, i qytetit ose i kopshtit do të shfaqen në pasqyrë. Në qoftë se do t'i ndodhte pasqyrës edhe lëvizja më e vogël ose ndryshimi më i pakët, imazhet bëhen të ngatërruara, të shtrembëruara e të shformuara. Fakti që shtëpia e vërtetë, qyteti apo kopshti jashtë pasqyrës vazhdojnë dhe janë të qëndrueshëm, nuk të sjellin aspak dobi, sepse ti ke prej tyre veçse atë që të jep pasqyra jote me shkallët dhe me përpjesëtimet e saj.

Dije se jeta jote është një pasqyrë! Mbështetja dhe pasqyra e jetës tënde dhe qendra e saj është jeta jote. Në çdo minut është e mundur që shtëpia, qyteti dhe kopshti të vdesin e të shkatërrohen; gjendja e tyre është e tillë saqë në çdo minut mund të shemben mbi kokën tënde dhe kijameti yt do të vijë. Meqenëse është kështu, mos e ngarko jetën dhe dynjanë tënde me pesha që ato nuk mund t'i mbajnë!

●Shënimi i Katërt

Dije se përgjithësisht është praktika e Krijuesit të Gjithurtë t'i rikthejë gjërat e rëndësishme e të vlefshme krejtësisht njashtu -të njëjta. Domethënë, ripërtëritja e shumicës së gjërave në formë të ngjashme në

ndryshimin e stinëve dhe në ndërrimin e shekujve. Ai i rikthen ato gjëra të çmueshme pikërisht të njëjta. Ky ligj i praktikës Hyjnore shihet kryesisht se është i pandryshueshëm në ringjalljet e ditës, të viteve dhe të shekujve.

Kështu, duke u mbështetur mbi këtë ligj të qëndrueshëm, ne themi: Meqenëse sipas pajtueshmërisë dhe dëshmisë së shkencave, fruti më i përkryer i pemës së krijimit është njeriu, dhe midis krijesave, më i rëndësishmi është njeriu, dhe midis qënieve më i çmueshmi është njeriu, dhe meqenëse një individ njerëzor është i barasvlershëm me një specie prej kafshëve të tjera, atëherë mund të kapet me intuitë të sigurtë se në Ringjalljen më të madhe, çdo qënie njerëzore do të rikthehet krejtësisht i njëjti, me trupin e tij, me emrin e tij, me formën dhe me të gjitha cilësitë.

●Shënimi i Pestë

Meqenëse shkenca perëndimore dhe civilizimi kishin deri diku një vend në mendimin e Saidit të Vjetër, kur Saidi i Ri u nis në udhëtimet e tij të mendjes e të zemrës, ato shkenca e filozofi u transformuan në sëmundje të zemrës dhe ishin shkaku i vështirësive të shumta. Prandaj Saidi i ri deshi ta hiqte nga mendja e tij atë filozofi të rreme e mashtruese dhe atë civilizim të shthurur. Me qëllim që t'i heshtë ndjenjat e nefsit të tij urdhërues për të liga, të cilat dëshmuan në favor të Europës, ai u detyrua të mbajë në shpirtin e tij diskutimin e mëposhtëm -i cili nga një drejtim është shumë i shkurtër dhe në një drejtim tjetër është shumë i gjatë- me personalitetin kolektiv të Europës.

Nuk duhet të keqkuptohet: Europa është Dy: Njëra ndjek shkencat që i shërbejnë drejtësisë, të vërtetës dhe industrive të dobishme për jetën e shoqërisë nëpërmjet inspirimit që ajo ka marrë nga krishterimi i vërtetë; Unë nuk i drejtohem kësaj Europës së Parë, përkundrazi, unë i drejtohem Europës së dytë të korruptuar e cila, nëpërmjet errësirës së filozofisë së Natyralizmit, duke i pandehur të këqijat e civilizimit se janë virtytet e saj, e ka shtyrë njerëzimin në shthurje e në çudhëzim.

Në udhëtimin tim të shpirtit në atë kohë, unë i thashë personalitetit kolektiv të Europës, i cili përveç dijeve të dobishme dhe të virtyteve të civilizimit, mban në dorën e tij filozofinë e pakuptim e të dëmshme si dhe civilizimin e keq e të shthurur... Unë i fola asaj duke i thënë:

O Europa e Dytë! Dije mirë se ti mban në dorën tënde të djathtë një filozofi të sëmurë e të çudhëzuar, ndërsa në të majtën ti mban një civilizim të dëmshëm e të prishur, dhe pretendon se "Lumturia e njerëzimit është me këto të dyja!" t'u thefshin duart dhe qofshin këto dy dhuratat e tua vdekja jote!... Dhe kështu do të jetë!

O shpirt i keq që po përhap mosbesimin dhe mosmirënjohjen! A mundet një njeri i cili është duke vuajtur tortura dhe është goditur me fatkeqësi të tmerrshme në shpirtin e tij, në ndërgjegje, në mendje dhe në zemrën e tij të ishte i lumtur nëpërmjet trupit të tij duke u zhgënjyer në një stoli sipërfaqësore e mashtruese dhe në një pasuri të madhe? A mund të thuhet se ai është i lumtur? A nuk shikon ti se ai që dëshpërohet nga një çështje e pjesshme, që i këputet shpresa nga një dëshirë e rreme dhe që zhgënjehet nga një punë e papërfillshme, imagjinatat e ëmbëla të një personi të tillë shndërrohen në gjëra më të hidhura për të, ajo që është e këndshme e torturon atë dhe bota ngushtohet për të dhe bëhet një burg! Por çfarë lumturie mund të sigurosh ti për një njeri të tillë të mjerë i cili nëpërmjet mbrapshtisë tënde dhe orës tënde të ligë ka vuajtur goditjet e çudhëzimit në qoshet më të thella të zemrës së tij deri tek pikërisht themelet e shpirtit të tij, dhe për shkak të kësaj, të gjitha shpresat e tij janë shuar dhe prej të cilës burojnë të gjitha dhimbjet e tij. A mund të thuhet për dikë, trupi i të cilit është në një parajsë të rreme e kalimtare ndërsa zemra dhe shpirti i të cilit janë duke vuajtur torturat e Zjarrit, se ai është i lumtur?

Shiko! Ti e ke çudhëzuar njerëzimin e mjerë në këtë mënyrë. Ti i bën ata të vuajnë torturat e Ferrit në një Parajsë të rreme.

O Nefsi urdhërues për të liga i njerëzimit! Shqyrtoje krahasimin e mëposhtëm dhe shiko se ku e ke çuar njerëzimin! Për shembull, ndodhen dy rrugë përpara nesh. Ne marrim njërën nga ato.

Në çdo hap që ne kalojmë në rrugën e parë ne shohim të mjerë të pafuqishëm të cilët sulmohen nga tiranët, duke ua marrë me forcë pasuritë dhe mallrat e tyre dhe duke ua shkatërruar shtëpitë e tyre të thjeshta, madje i plagosin rëndë ata të mjerë, saqë pothuajse edhe qiejt qajnë për gjendjen e tyre të mjerueshme. Kudo që të drejtohet shikimi, shihet e njëjta gjendje dhe në këtë rrugë dëgjohen veçse britmat e tiranëve dhe rënkimet e murmurimat e pakënaqësisë së të shtypurve; dhe sikur një zi e përgjithshme e mbulon të gjithë rrugën. Meqenëse

nëpërmjet humanizmit të tij, njeriu lëndohet nga dhimbjet e të tjerëve, ai goditet me një dhimbje të pakufishme. Por për shkak se ndërgjegjja e tij nuk mund ta durojë e përballojë aq shumë dhimbjen, ai që udhëton në këtë rrugë detyrohet të bëjë njërën nga këto dy gjëra: ose të zhvishet nga humanizmi i tij dhe të mbante një zemër të ashpër dhe shumë mizore që të mos lëndohet e të mos ndiejë dhimbje edhe sikur të zhdukej gjithë njerëzimi sa kohë që ai është shëndoshë e mirë, ose ndryshe të shtypë e të ndalojë kërkesat e zemrës dhe të arsyes.

O Europa e korruptuar me shthurje e me çudhëzim dhe e larguar prej fesë së Isait -Jezusit a.s.! Ti ia ke dhuruar këtë gjendje si Skëterrë shpirtit njerëzor me gjenialitetin tënd të verbër i cili, ashtu si Dexhali, ka vetëm një sy të vetëm. Pastaj ti e kuptove se kjo sëmundje e pakurueshme e hedh njeriun nga maja më e lartë për tek ultësira më e ulët dhe e zbret atë tek niveli më i ulët i kafshërisë. Ilaçi i vetëm që ti ke gjetur për këtë sëmundje janë fantazitë e dëfrimeve e të zbavitjeve të cilat shërbejnë për një mpirje të përkohshme të ndjenjave. Qofshin vdekja jote këto ilaçet e tua, dhe kështu do të jetë. Ja! Rruga që ti ke hapur për njerëzimin dhe lumturia që u ke dhënë atyre i ngjason këtij krahasimi.

Rruga e Dytë të cilën Kur'ani i gjithurtë ia ka dhuruar njerëzimit, është si kjo: Ne shohim se në çdo vendqëndrim, në çdo pikë dhe në çdo qytet në këtë rrugë janë patrullat e ushtarëve të drejtë të Sulltanit të drejtë duke bërë kontrollet e shërbimit të rojes. Kohë pas kohe me urdhrin e mbretit një grup ushtarësh lirohen nga shërbimi. Pushkët e tyre, kuajt dhe takëmet e pajimet që i përkasin shtetit u merren atyre dhe u jepet fletë lirimi. Ushtarët e liruar janë të dëshpëruar në dukje që po dorëzojnë pushkët dhe kuajt e tyre me të cilët ata janë mësuar, por ama në realitet ata janë të lumtur që janë liruar dhe janë shumë të kënaqur që po vizitojnë Monarkun e që po kthehen tek Divani i Tij...

Ndonjëherë ushtarët e çmobilizuar mund të takojnë ndonjë ushtar të ri i cili nuk i njeh ata. Dhe kur ata i thonë: Dorëzoje armën tënde! Ushtari u përgjigjet:"Unë jam një ushtar i Sulltanit dhe unë jam në shërbim të Tij. Unë do të shkoj tek Ai më vonë. Po kush jeni ju? Në qoftë se ju vini me lejen dhe me miratimin e Tij, unë ju përshëndes ju me gjithë kënaqësi, atëherë ma tregoni urdhrin e Tij. Përndryshe, largohuni dhe qëndroni larg meje. Edhe sikur të isha i vetëm ndërsa ju të ishit me mijëra, unë përsëri do të luftoja kundër jush; unë nuk luftoj

për veten time, sepse ajo nuk është e imja, ajo i përket mbretit. Në të vërtetë, vetja ime dhe pushka që kam më janë lënë në amanet nga Pronari im. Unë ju nënshtrohem ju sepse unë duhet të mbroj amanetin dhe të ruaj nderin dhe dinjitetin e mbretit tim".

Atëherë kjo është njëra nga mijërat e situatave në rrugën e dytë e cila shkakton gëzim e lumturi. Ti mund t'i nxjerrësh si përfundim të tjerat për vete.

Gjatë udhëtimit në rrugën e dytë është mobilizimi dhe dërgimi i trupave ushtarakë me gëzim dhe me festime, të cilat quhen '*lindje*', dhe çmobilizimi dhe lirimi i trupave që realizohet gjithashtu me gaz e hare përmes thirrjeve ***Lailahe il-lall-llah,*** dhe ***All-llahu Ekber***, të cilat quhen 'Vdekje'. Kur'ani i Gjithurtë ia ka dhënë këtë rrugë njerëzimit. Kushdo që e pranon me zemër këtë dhuratë, këtë rrugë, do të udhëtojë në këtë rrugën e dytë e cila të çon në lumturinë e të dyja botëve. Ai nuk ndjehet as i dëshpëruar për gjërat e së shkuarës dhe as nuk ndjen ankth e frikë për ato të së ardhmes, saqë për të do të bëhej realitet vërseti Kur'anor,

"Për ta nuk do të ketë as frikë dhe as nuk do të pikëllohen".[2]

O Europa e dytë e prishur! Ti mbështetesh mbi themele të kalbura e të shpërbëra dhe ti pretendon se:

"Çdo qënie e gjallë, duke filluar nga engjëlli më i madh dhe duke përfunduar tek peshku më i vogël, është pronare e vetvetes, punon vetëm për vetveten dhe lufton vetëm për kënaqësinë e vet, dhe prandaj ajo ka të drejtën e jetës. Qëllimi dhe objektivi i saj dhe e gjithë përpjekja e saj është të jetojë dhe të vazhdojë jetën e saj". Pastaj ti e shikon "ligjin e bashkëpunimit" që vepron midis krijesave, duke iu bindur urdhrit të Krijuesit Gjithëbujar, që manifestohet qartë në të gjitha anët e universit si nxitimi i bimëve për t'u ardhur në ndihmë kafshëve dhe kafshët duke shpejtuar për të ndihmuar njeriun duke e supozuar këtë ligj, këtë praktikë Hyjnore dhe ato manifestime të qarta të Mëshirëplotit të shfaqura prej atij kooperimi universal të jenë konflikt e luftë, saqë ti si e marrë deklaron se "Jeta është konflikt".

[2] Kur'an, 2:262

Subhanall-llah! Sa çudi! Si munden grimcat e ushqimit të nxitojnë me zell të plotë për të ushqyer qelizat e trupit -një manifestim i atij parimi të ndihmës së ndërsjellë- të jetë konflikt? Si mund të jetë ai një përplasje dhe luftë? Përkundrazi, ai nxitim, ajo asistencë është ndihma e ndërsjellë që realizohet nëpërmjet urdhrit të një Krijuesi të Gjithurtë e Gjithëbujar!

Dhe njëra nga themelet e tua të kalbura është ajo që ti thua: "Çdo gjë është pronare e vetvetes". Një provë e qartë se asnjë gjë nuk është pronare e vetvetes është kjo: Midis shkaqeve më i nderuari dhe, në lidhje me zgjedhjen, ai me dëshirën më të shtrirë është njeriu. Por nga njëqind pjesët e akteve më të dukshme lidhur me dëshirën e njeriut, si: të menduarit, të folurit dhe të ngrënit, vetëm një pjesë e veçantë e dyshuese i jepet dorës së dëshirës së tij dhe është brenda sferës së fuqisë së tij. Atëherë si mund të thuhet për dikë, i cili nuk ka pronësi një të qindën e akteve më të dukshme të tilla si ato, të jetë pronari i vetvetes?

Në qoftë se më të lartët e qënieve me dëshirën më të shtrirë janë kështu të penguar nga pasja në pronësi dhe nga një fuqi reale deri në këtë shkallë, atëherë ai që thotë se "Qëniet e tjera, frymore ose jofrymore, janë pronare të vetvetes", ai thjesht provon se ai është më kafshë se sa kafshët dhe më i pajetë dhe i pavetëdijshëm se sa qëniet e pashpirta.

O Europë! Ajo që të shtyn ty për tek një gabim i tillë dhe të hedh në një humnerë është gjenialiteti yt me një sy. Domethënë, zgjuarsia jote e jashtëzakonshme dhe ndjellakeqe; sepse për shkak të atij gjenialitetit tënd të verbër, ti e ke harruar Mbështetësin Tënd, i Cili është Krijuesi i të gjitha gjërave; ti ia ke atribuar veprat e Tij natyrës imagjinare dhe shkaqeve; ti e ke ndarë pronën e Krijuesit Gjithëbujar midis idhujve, zotrave të rremë. Duke u nisur nga ky këndvështrim, nëpërmjet të cilit shikon gjenialiteti yt me një sy, çdo qënie e gjallë dhe çdo qënie humane duhet t'u rezistojë vetë armiqve të panumërt dhe të luftojë e të përpiqet vetë për t'i siguruar kërkesat dhe nevojat e pafundme. Dhe ato do të detyroheshin t'u bënin ballë atyre armiqve dhe nevojave të panumërta me fuqinë e tyre sa një grimcë, me një dëshirë sa një fije e hollë peri, me një vetëdije sa një shkreptimë kalimtare dhe me një jetë si një flakërimë që shuhet. Por kapitali i atyre krijesave të gjalla të mjera është i pamjaftueshëm për t'iu përgjigjur madje një të mijtës së

kërkesave të tyre. Kur goditen, për shembull, nga fatkeqësia, ata nuk mund të shpresojnë asnjë ilaç për dhimbjen e tyre përveç vdekjes, shkaqeve të verbëra. Ata manifestojnë kuptimin e vërsetit,

وَمَا دُعَاءُ الْكَافِرِينَ إِلَّا فِي ضَلَالٍ *"Dhe thirrja, duaja, e mohuesve s'është tjetër veçse gabim (trashanik e lajthitje pa asnjë vlerë)".*[3]

Gjenialiteti yt i errët e ka transformuar ditën e njerëzimit në natë, në natë të zezë me padrejtësi e tirani dhe, pastaj dëshiron ta ndriçosh atë errësirë të tmerrshme me llamba të rreme të përkohshme!.. këto llamba nuk buzëqeshin me gëzim në fytyrën e njerëzimit, përkundrazi, ato zgërdhihen e gërbuzen marrëzisht tek gjendja e dhimbshme dhe e vajtueshme. Ato drita tallin, qesëndisin e bëjnë humor me ta.

Në këndvështrimin e nxënësve të tu, të gjitha qëniet e gjalla janë të mjera të goditura me fatkeqësi dhe të zbuluara para sulmeve të shtypësve tiranë. Bota është një vend i përgjithshëm zie. Tingujt në botë janë britmat dhe vajtimet që burojnë nga vdekja dhe vuajtja.

Nxënësi i cili merr mësim prej teje dhe udhëzohet prej teje bëhet faraon tiran.. po, ai është një faraon i poshtëruar, sepse ai adhuron gjënë më të ulët dhe e konsideron vetveten të jetë zot mbi çdo gjë prej të cilës ai përfiton.

Studenti yt është kryeneç, por një kryeneç i mjerë i cili pranon poshtërimin më të madh për hir të një kënaqësie të vogël. Ai shfaq poshtërsi deri në shkallën e puthjes së këmbës së shejtanit për hir të ndonjë dobie të pavlefshme.

Dhe ai është tiran, Por për shkak se ai nuk ka pikë mbështetjeje në zemrën e tij, ai në fakt është një tiran i pafuqishëm mburravec.

Qëllimi dhe përpjekja e këtij nxënësi është të kënaqë dëshirat e nefsit, për të kërkuar me dredhi interesat e tij vetjake nën maskën e patriotizmit dhe të vetëmohimit dhe, punon për të kënaqur ambicien dhe krenarinë e tij. Ai në të vërtetë nuk do asgjë përveç vetes së tij, madje sakrifikon gjithçka për hir të vetes së tij.

[3] Kur'an, 13:14

Ndërsa studenti i sinqertë i urtësisë së Kur'anit është një 'shërbëtor', por ai nuk përulet për të adhuruar as më të madhen e krijesave; ai është një rob i vlerësuar i cili nuk e merr as parajsën, atë mirësi të madhe, si qëllimin e adhurimit të tij. Ai është 'zemërbutë dhe i urtë', por në të njëjtën kohë ai është fisnik dhe i dashur dhe nuk e poshtëron vetveten para ndokujt përveç Krijuesit të tij të Gjithëlavdishëm. Dhe përveç se me lejen e Tij dhe me urdhrin e Tij, ai nuk përkulet para të ulëtive.

Dhe ai është 'i varfër' por për shkak se shpërblimi i Pronarit të tij Gjithëbujar është depozituar për të në të ardhmen, ai në të njëjtën kohë është i vetëmjaftueshëm.

Dhe ai është 'i dobët', por ai është i fuqishëm në dobësinë e tij, sepse ai mbështetet në fuqinë e Krijuesit të tij Fuqia e të Cilit është absolute. Studenti i sinqertë i Kur'anit nuk do ta merrte as edhe parajsën e përjetshme si synimin e qëllimin e tij, dhe jo më këtë dynja të përkohshme kalimtare; Si mund ta merrte ai dynjanë si qëllimin e tij? Kështu ti mund ta kuptosh se sa të ndryshme nga njëri-tjetri janë qëllimet dhe përpjekjet e dy studentëve.

Dhe kështu ju mund t'i krahasoni zellin dhe vetësakrificën e studentëve të Kur'anit të gjithurtë me studentët e filozofisë së sëmurë me sa vijon:

Studenti i filozofisë ikën prej vëllait të tij për hir të nefsit të vet dhe ngre padi kundër atij. Ndërsa studenti i Kur'anit, duke i konsideruar të gjithë adhuruesit e drejtë e të sinqertë të Allahut si vëllezër të tij, bën dua për ta në mënyrën më të sinqertë. Ai është i lumtur me lumturinë e tyre dhe ndien një lidhje të fuqishme me ta në shpirtin e tij, sa që në lutjet e tij ai thotë: "O Zot, jepu falje të gjithë burrave dhe grave besimtarë!" Për më tepër, ai i shikon gjërat më të mëdhaja, Fronin Hyjnor dhe diellin, si nëpunës të nënshtruar dhe shërbëtorë e krijesa si ai vetë.

Gjithashtu, krahaso në vijim lartësinë dhe shtrirjen e shpirtit të të dy studentëve:

Kur'ani i gjithurtë u jep një gëzim të tillë dhe një lartësi shpirtërave të studentëve të tij saqë në vend të nëntëdhjetë e nëntë rruazave - kokrrave të tespive- ai vendos në duart e tyre grimcat e vockëla të

nëntëdhjetë e nëntë botëve duke shfaqur manifestimet e nëntëdhjetë e nëntë Emrave të Bukur Hyjnorë dhe u thotë atyre: "Recitoni lutjet tuaja me këto!" Dëgjojini duatë e studentëve të Kur'anit midis Evlijave të drejtë si shembulli i Shejh Gejlanit, Rufaijut dhe Shazeliut, Zoti qoftë i kënaqur prej tyre!

Shikoni, ata i këndojnë virdet e tyre me këto vargje tesbish; ata me rolin e tyre i këndojnë virdet e tyre me ato tesbihe të çuditshëm dhe e kujtojnë Zotin e tyre Gjithëbujar me numrat e tyre të pafundme. Shikoni, se si ata kanë marrë në duart e tyre vargjet e grimcave, numrat e pikëlave të krijesave, dhe frymët e të gjitha krijesave dhe e përmendin Allahun me to, e lavdërojnë Atë dhe e Shenjtërojnë.. Ata e lavdërojnë dhe e lartësojnë Allahun me to dhe përmendin Emrat e Tij më të bukur.

Kështu, shikoje udhëzimin e mrekullueshëm të Kur'anit të gjithurtë dhe vështro se si njeriu lartësohet me të -njeriu i vogël që thumbohet nga mikrobi më i vogël dhe që mposhtet nga dëshpërimi e brenga më e pjesshme. Shiko se si shtrihen shqiset e tij të brendshme, saqë ai i shikon qëniet madhështore të dynjasë së madhe të jenë të papërshtatshme si kokrra tespihesh për virdet e tij; dhe megjithëse ai e shikon parajsën të pamjaftueshme si qëllimin e virdeve të tij dhe recitimeve të Emrave Hyjnorë, ai njëkohësisht nuk e shikon veten e tij si më epror edhe mbi më të ultën e krijesave të Zotit të Plotëfuqishëm.. Ai e kombinon dinjitetin më të skajshëm me përulësinë e modestinë më të skajshme.. Ju mund të shikoni nga kjo se sa të ulët e të poshtëruar janë studentët e filozofisë.

Kështu, të vërtetat që filozofia e sëmurë europiane me gjenialitetin e saj me një sy i shikon gabimisht e të shtrembëruara, udhëzimi i Kur'anit i shikon ato të qarta e të dukshme, ai udhëzim dhe ajo dritë e cila i shikon të dyja botërat përnjëherësh me dy sy vezullues e depërtues tek e padukshmja, dhe që me dy duart e saj tregon dy lumturitë dhe i flet njerëzimit duke i thënë:

O Njeri! Vetja dhe pasuria që ti i ke nuk janë të tuat; ato janë një amanet tek ti. Pronari i atij amaneti është i Plotëfuqishëm mbi gjithçka, është i Gjithëditur për çdo gjë dhe Mëshirëplotë Gjithëbujarë, i Cili dëshiron që ta blejë prej teje Pronën e Vet që është tek ty me qëllim që ta ruajë atë për ty dhe që ajo të mos humbasë në dorën tënde, dhe do të

të japë ty një shpërblim të madh në të ardhmen. Ti je thjesht një ushtar nën urdhër dhe i ngarkuar me detyra. Puno në emrin e Tij dhe vepro për hir të Tij, sepse Ai t'i dërgon ty gjërat që të nevojiten si ushqim dhe të mbron ty nga gjërat që nuk mund t'i përballosh. Qëllimi dhe rezultati i kësaj jetës tënde është të manifestosh Emrat dhe Atributet e Pronarit Tënd. Kur një fatkeqësi të godet, thuaj:

إِنَّا لِلّٰهِ وَإِنَّآ إِلَيْهِ رَاجِعُونَ *"Vërtet të Allahut jemi dhe padyshim tek Ai do të kthehemi".*[4]

"Domethënë, unë jam në shërbimin e Pronarit tim". Dhe kështu, o fatkeqësi! Në qoftë se ti ke ardhur me lejen e Tij dhe me Emrin e Tij, atëherë ti je e mirëseardhur dhe e përshëndetur! Ne padyshim do të kthehemi dhe do të futemi në praninë e Tij dhe ne jemi vërtet të përmalluar për Të. Meqenëse Ai do të na lirojë një ditë nga përgjegjësitë e jetës, le të jetë lirimi e shkarkimi në dorën tënde, o fatkeqësi, unë e pranoj atë. Por në qoftë se Ai e ka urdhëruar e dekretuar ardhjen tënde si një provë për detyrën time dhe për besnikërinë në ruajtjen e amanetit tim, atëherë unë nuk do t'ua dorëzoj me sa mundem amanetin e Pronarit tim duarve të pasigurta, dhe nuk do të dorëzohem pa urdhrin dhe pa kënaqësinë e Tij xh.sh..

Kështu, vështroje këtë shembull prej mijërave dhe shiko shkallët në udhëzimin që jepen nga gjenialiteti i filozofisë dhe nga udhëzimi i Kur'anit. Në të vërtetë, realiteti i dy anëve buron në mënyrën e përshkruar lartë. Por shkallët e njerëzve në udhëzim dhe në çudhëzim janë të ndryshme dhe, shkallët e pakujdesisë janë të ndryshme. Jo gjithkush mund ta perceptojë plotësisht këtë të vërtetë në çdo shkallë, sepse pakujdesia i mpin ndjenjat. Dhe në këtë kohë ajo i ka mpirë ndjenjat deri në një shkallë të tillë saqë të qytetëruarit nuk e ndjejnë këtë dhimbje pikëlluese dhe vuajtjen.

Por, perdja e pakujdesisë griset nëpërmjet ndjeshmërisë së shtuar për shkak të zhvillimeve në shkencë dhe të paralajmërimeve të vdekjes e cila në çdo ditë zbulon tridhjetë mijë kufoma. Neveri të plota dhe një mijë hidhërime duhet të ndjehen për ata që ndjekin rrugën e çudhëzimit për shkak të idhujve europianë dhe të shkencave të natyralizmit dhe për ata që i ndjekin dhe i imitojnë verbërisht ato!

[4] Kur'an, 2:156

O bijt e kësaj toke! Mos u përpiqni të imitoni europianët! A edhe pasi keni marrë të gjithë atë tirani të pakufishme dhe atë armiqësi që ka treguar Europa i ndiqni ata në shthurjen e tyre dhe shkoni pas mendimeve të tyre të pavlefshme?

Ju që i imitoni ata në shthurje, ju nuk po i ndiqni, por në mënyrë të pavetëdijshme ju po u bashkoheni radhëve të tyre dhe po ekzekutoni me vdekje edhe veten tuaj, edhe vëllezërit tuaj.. Jini të arsyeshëm!

Dijeni se sa më shumë që t'i ndiqni ata në shthurje, aq më shumë ju gënjeni në pretendimin tuaj se jeni patriotë e vetëmohues! Sepse kjo ndjekje është përbuzje për kombin tuaj dhe përqeshje ndaj nacionalizmit tuaj.

هَدٰينَا اللّٰهُ وَاِيَّاكُمْ اِلَى الصِّرَاطِ الْمُسْتَقِيمِ

Na drejtoftë Zoti ne dhe ju në rrugën e drejtë!

●Shënimi i Gjashtë

O Njeri i shqetësuar që alarmohesh nga numrat e mëdhenj të mohuesve dhe në pajtueshmërinë e tyre për mohimin e disa të vërtetave të besimit dhe, si rrjedhojë tronditesh në besimin tënd! Ti, o i mjerë, duhet ta dish se vlera dhe rëndësia nuk qëndrojnë në sasi e në numër, sepse në qoftë se nuk është një qënie e vërtetë humane, ai transformohet në një kafshë djallëzore dhe, sa më shumë të shtohet lakmia shtazore, aq më shumë shtazor ai bëhet -ashtu si disa europianë dhe si imituesit e tyre. Ti mund të shohësh se lidhur me sasinë dhe numrin, njerëzit janë shumë të pakët në krahasim me numrat e pakufishme të kafshëve, dhe megjithatë ato janë sundues sovranë mbi speciet e kafshëve dhe kalifët e Zotit në tokë.

Kështu, mohuesit e dëmshëm dhe ata të cilët ndjekin gjurmët e tyre në shthurje, janë një lloj i ndyrë prej specieve të kafshëve të cilat Allahu i Plotëfuqishëm i ka krijuar për zhvillimin dhe prosperitetin e botës. Ai i ka bërë ato një njësi matëse me qëllim që shërbëtorët e Tij besimtarë të njohin shkallët e mirësive që ua ka dhuruar, dhe më në fund do t'i dërgojë ata kafshë në Xhehennemin që ata e meritojnë.

Nuk ka fuqi tek mohuesit dhe tek të çudhëzuarit të cilët mohojnë e refuzojnë një të vërtetë nga të vërtetat e besimit. Pajtueshmëria e tyre

në mendim nuk ka rëndësi; sepse ai është mohim; një mijë mohues janë të barabartë me një mohues të vetëm. Për shembull, madje edhe në qoftë se të gjithë njerëzit e Stambollit do të mohonin shikimin e hënës së re në fillimin e Ramazanit, dëshmia e provuar e dy dëshmitarëve -shikuesve- do ta zhvlerësonte e anulonte mohimin dhe pajtueshmërinë e asaj shumice të madhe. Meqenëse në realitet mosbesimi dhe çudhëzimi janë mohim e refuzim, ato janë injorancë e mosekzistencë dhe, pajtueshmëria e mosbesimtarëve në numra të mëdhenj nuk ka aspak rëndësi. Në çështjet e besimit, të cilat janë të vërteta të vërtetuara dhe që vlera e të cilave është provuar, gjykimi i dy besimtarëve i bazuar mbi një shikim -dëshmi- të sigurt preferohet dhe sundon mbi pajtueshmërinë e atyre numrave të mëdhenj të të çudhëzuarve. Arsyeja për këtë fakt është si më poshtë vijon:

Në mënyrë të sipërfaqshme, pretendimet e atyre që mohojnë janë të njëjta, por në fakt ato janë të ndryshme dhe nuk mund të bashkohen me qëllim që të fitojnë fuqi. Ndërsa pretendimet e atyre që vërtetojnë, bashkohen e marrin fuqi nga njëra-tjetra. Kjo është për shkak se një person, i cili nuk e shikon hënën e re të Ramazanit në qiell, thotë: "Sipas mendimit tim, hëna e re nuk ekziston. Ajo nuk është shfaqur që unë të mund ta shoh". Një tjetër thotë: "Në shikimin tim, hëna e re nuk është shfaqur". Dhe secili prej tyre mohon nga këndvështrimi i tij duke thënë se nuk ka hënë të Re. Meqenëse shikimi i gjithësecilit dhe shkaqet që i pengojnë ata për ta shikuar mund të jenë gjithashtu të ndryshme, edhe pretendimet e tyre gjithashtu janë të gjitha të ndryshme; cilido pretendim nuk mund t'i mbështesë pretendimet e të tjerëve. Ndërsa ata që e vërtetojnë atë nuk thonë: "Në shikimin tim dhe sipas mendimit tim, hëna e re ndodhet atje, ekziston". Por, "Realiteti i situatës është se hëna e re është shfaqur në qiell".

Të gjithë shikuesit e vërtetojnë atë në këtë pretendimin e tij dhe e mbështesin atë në pikërisht të njëjtën gjë duke thënë: Realiteti i situatës është se hëna e re ekziston.. Domethënë, të gjithë pretendimet janë të njëjta. Ndërsa, meqenëse shikimet e atyre që e mohojnë atë janë të gjitha të ndryshme, edhe pretendimet e tyre janë gjithashtu të ndryshme. Ata nuk e bëjnë gjykimin në përputhje me realitetin e situatës, sepse mohimi i realitetit të situatës nuk mund të provohet; për të, një provë gjithëpërfshirëse është e domosdoshme. Prandaj është bërë prej rregullave themelore se

وَالْعَدَمُ الْمُطْلَقُ لَا يُثْبَتُ إِلَّا بِمُشْكِلَاتٍ عَظِيمَةٍ

"Mosekzistenca absolute mund të provohet vetëm me vështirësi shumë të mëdha".

Po, në qoftë se ti pretendon se një gjë e veçantë ekziston në botë, do të ishte e mjaftueshme vetëm ta tregosh atë gjë. Por në qoftë se ti thua se ajo gjë nuk ekziston dhe e mohon, e gjithë bota duhet të kërkohet që ta demonstrojë dhe kështu të mund të provohet mohimi.

Duke u mbështetur mbi këtë mister, mohimi i një të vërteteje nga mosbesimtarët është si zgjidhja e një problemi ose kalimi përmes një vrime të ngushtë ose kapërcimi mbi një hendek, të cilat nuk mund ta mbështesin njëra-tjetrën; një mijë njerëz janë të njëjtë si një i vetëm. Por meqenëse ata të cilët vërtetojnë shikojnë thelbin e çështjes dhe realitetin e situatës, pretendimet e tyre bashkohen, dhe fuqia individuale e të gjithë atyre kombinohet dhe ndihmojnë njëra-tjetrën. Ajo i ngjason ngritjes së një shkrepi të madh; sa më shumë burra të grumbullohen tek ai, aq më shumë do të lehtësohej ngritja e tij, dhe aq më shumë fuqi marrin ata prej njëri-tjetrit.

● **Shënimi i Shtatë**

O pseudopatriot i mjerë që me pasion po i nxit myslimanët ta përqafojnë këtë botë dhe forcërisht po i shtyn ata për tek industritë europiane dhe që të kapen pas bishtave të progresit të tyre! Ruhu, mos lejo që të këputen lidhjet me të cilat disa anëtarë të këtij kombi janë lidhur me fenë! Në qoftë se duke imituar marrëzisht e verbërisht dhe të shtypur nën këmbë këputen lidhjet e tyre me fenë, ata ateistë do të bëheshin aq të dëmshëm për jetën e shoqërisë aq sa helmi vdekjeprurës, sepse meqenëse ndërgjegjja e femohuesit -apostatit- është krejtësisht e prishur, ai bëhet si helm në jetën e shoqërisë. Për shkak të kësaj, sipas shkencës së parimeve të fesë, "apostati nuk ka të drejtën e jetës, ndërsa në qoftë se një mohues është një anëtar i minoriteteve të mbrojtura ose që ka bërë paqë, ai ka të drejtën e jetës"; ky është një parim i sheriatit. Për më tepër, sipas medhhebit Hanefi, dëshmia e një mohuesi të tillë prej minoriteteve të mbrojtura është e pranueshme, ndërsa dëshmia e dikujt që ka devijuar prej rrugës së sheriatit nuk pranohet; sepse ai është i pabesë -tradhtar.

O mëkatar i mjerë që ke devijuar nga sheriati! Mos shiko shumicën e të shthururve dhe të mashtrohesh; mos thuaj: "Shumica e njerëzve mendojnë njësoj si unë!" sepse të shthururit nuk dëshirojnë ta përqafojnë shthurjen; përkundrazi, ata bien në shthurje dhe nuk mund të dalin prej saj. Nuk ka mëkatar që nuk do të jetë i drejtë dhe që nuk dëshiron ta shohë eprorin dhe kryetarin e tij si fetar. Përndryshe -Ruajna Zot!- në qoftë se ndërgjegjja e tij është e prishur nga apostazia-felëshimi-, ai gjen kënaqësi nga helmosja, si një gjarpër.

O kokë e çmendur dhe o zemër e prishur! Mos e supozo se muslimanët nuk e duan dynjanë apo se ata nuk mendojnë rreth varfërisë në të cilën kanë rënë, dhe se kanë nevojë për paralajmërime me qëllim që të mos e harrojnë pjesën e tyre nga dynjaja?

Supozimi yt është i rremë dhe hamendja jote është e gabuar. Përkundrazi, është shtuar lakmia e tyre dhe kjo është arsyeja pse ata janë varfëruar, sepse lakmia për besimtarin është shkak zhgënjimi, humbjeje dhe varfërie. Dhe thënia: اَلْحَرِيصُ خَائِبٌ خَاسِرٌ *"Lakmitari zbulohet para humbjes dhe zhgënjimit"* është bërë proverbiale.

Po, ndodhen shumë gjëra që e thërrasin dhe e shtyjnë njeriun për tek dynjaja dhe mjetet që e nxisin për tek ajo janë të shumta, në krye të të cilave janë nefsi dhe dëshirat e tij, nevoja, shqisat e tij, ndjenjat, emocionet, shejtani, ngashënjimi sipërfaqësor i dynjasë, shokët e rremë -si shembulli yt- dhe ëmbëlsira e kënaqësisë së çastit... dhe faktorët e tjerë nxitës për tek ajo janë të shumtë, ndërsa thirrësat për tek Ahireti, i cili është i përjetshëm, dhe udhëzuesit për tek jeta e amshuar janë të pakët. Nëse ti do të kishe sa një grimcë entuziazëm dhe aspirata të larta ndaj këtij kombi, dhe në qoftë se do të ishe i sinqertë në pretendimin tënd për vetësakrifikim, vetëmohim dhe preferencën e të tjerëve, atëherë ti duhet t'u japësh ndihmë atyre pak thirrësve për tek jeta e përhershme; përndryshe ti ke ndihmuar shumicën dhe ua ke mbyllur gojët thirrësve të pakët, dhe kështu do të bëheshe shoqëruesi i shejtanit, sa shoqërues i keq!

A mos vallë pandeh ti se varfëria e këtij kombi është një lloj i asketizmit fetar ose një lloj dembelie që buron nga të braktisurit e kësaj dynjaje? Ti do të ishe shumë i gabuar nëse do ta pandehje këtë.. A nuk e shikon ti se kombet e dominuar nga Europa, si Kina, Brahmanët, zoroastrianët e Indisë dhe zezakët e Afrikës janë më të varfër se sa ne?

Dhe a nuk e shikon ti se asgjë përveç mjeteve më themelore të jetesës nuk është lënë në duart e muslimanëve? Ndërsa pjesa e mbetur ose u është plaçkitur ose u është rrëmbyer atyre nga tiranët ateistë europianë ose nga hipokritët e Azisë.

Ti duhet të jesh i sigurt se në qoftë se qëllimi juaj në shtyrjen forcërisht të njerëzve të besimit në këtë mënyrë për tek civilizimi i ulët është rendi në vend, siguria dhe miradministrimi i tij, ju jeni shumë të gabuar dhe po e shtyni kombin në rrugë të gabuar, sepse është më e vështirë të qeverisësh njëqind njerëz të shthurur, besimi i të cilëve është i lëkundur dhe moralet e të cilëve janë të prishura, dhe të sigurosh rendin publik midis tyre, se sa të qeverisësh një mijë njerëz të drejtë.

Kështu, në përputhje me këto parime, njerëzit e islamit nuk kanë nevojë të inkurajohen e të shtyhen për tek dashuria e dynjasë dhe tek lakmia për të. Përparimi dhe rendi e qetësia publike nuk mund të sigurohen në këtë mënyrë. Përkundrazi ata kanë nevojë që të organizojnë përpjekjet e tyre dhe rrethanat e punës dhe që të vendoset mirëbesimi midis tyre, për të lehtësuar mjetet e bashkëpunimit midis tyre dhe për të nxitur parimin e kooperimit. Dhe këto nevoja mund të realizohen e plotësohen veçse duke ndjekur urdhëresat e shenjta të fesë, duke qenë të qëndrueshëm në besim, duke pasur frikë Allahun xh.sh. dhe duke kërkuar kënaqësinë e Zotit xh,sh...

●Shënimi i Tetë

O Njeri përtac që nuk e njeh kënaqësinë e përpjekjes dhe lumturinë e punës! Dije se nga bujaria e tij e plotë, Allahu i Plotëfuqishëm e ka vendosur shpërblimin për punën brenda saj. Ai e ka përfshirë rrogën për punën brenda vetë punës. Për këtë arsye, të gjitha krijesat duke përfshirë edhe qëniet e pajeta, nga një këndvështrim i veçantë, u nënshtrohen urdhërave Hyjnore, të cilat quhen "Urdhërat krijuese", me entuziazëm të plotë dhe me një lloj kënaqësie.

Çdo gjë duke filluar nga bletat, mizat dhe shpendët.. dhe duke përfunduar tek dielli dhe hëna, të gjithë i zbatojnë detyrat e tyre me kënaqësi të plotë. Kjo do të thotë se ndodhet një kënaqësi në punën e tyre meqë ato e kryejnë atë në mënyrë perfekte, pavarësisht se ato nuk mendojnë për rezultatet dhe përfundimet pasi ato nuk kanë aftësi mendore.

Në qoftë se ti thua: "Ekzistenca e kënaqësisë tek gjallesat është e mundshme, por si mund ta përjetojnë qëniet e pashpirta entuziazmin dhe kënaqësinë?

Përgjigjja: Qëniet e pashpirta dëshirojnë e kërkojnë një pozitë, një rang, një plotësim, një bukuri dhe një rregull, jo për veten e tyre, por për hir të shfaqjes së Emrave të bukur Hyjnorë të manifestuar tek to. Ato ndriçohen, përparojnë e ngjiten gjatë kryerjes së detyrave të tyre të natyrshme; ato bëhen si pasqyra dhe vende reflektimi për manifestimet e Emrave të "*Dritës së Dritave*".

Për shembull, një pikë uji ose një copë xhami, pavarësisht se janë të papërfillshme dhe në të vërtetë janë pa dritë, kur kthehen me zemrat e tyre të pastëra drejt diellit, transformohen e bëhen si lloje froni për diellin dhe të buzëqeshin ty!

Gjithashtu, duke qenë pasqyra, për sa ka të bëjë me detyrat e tyre, për manifestimet e Emrave të Bukur të të Gjithëlavdishmit të Vetëm i Cili zotëron një bukuri e plotësim Absolut, ashtu si pikat e ujit dhe copat e xhamit, grimcat dhe qëniet ngrihen nga një pozitë shumë e ulët për tek shkalla më e lartësuar e manifestimit dhe ndriçimit. Meqenëse, për sa ka të bëjë me detyrat e tyre, ato ngrihen në një rang të ndritshëm e të lartësuar, atëherë mund të thuhet se qëniet i kryejnë detyrat e tyre me ëndje e kënaqësi; ato kanë kapacitetin për të marrë kënaqësi. Domethënë, në qoftë se qëniet marrin një pjesë nga jeta e përgjithshme, ato i kryejnë detyrat e tyre me kënaqësi të plotë.

Dëshmia më e qartë se në kryerjen e vetë detyrës gjendet kënaqësi, është sa vijon:

Shqyrto tek detyrat e gjymtyrëve dhe të shqisave të tua, që të shohësh se çdo njëra prej tyre gjen kënaqësi të ndryshme gjatë kryerjes së detyrave për mbijetesën tënde personale dhe për mbijetesën e racës njerëzore. Vetë detyrat janë si një mjet kënaqësie dhe si ëndje për to, madje braktisja e detyrës dhe e punës është torturë e dhimbshme për atë gjymtyrë.

Një dëshmi tjetër e qartë është vetëflijimi dhe guximi që shfaqin kafshët, si gjelat e pulat me zogjt, në kryerjen e detyrave të tyre: Edhe në qoftë se është i uritur, gjeli preferon pulat mbi veten e tij, duke i ftuar ato të hanë nga drithërat e rizkut të tij; ai nuk ha vetë, por i lejon

ato të hanë. Dhe është e qartë se ai ndien kënaqësi, krenari dhe ëndje në kryerjen e kësaj detyre. Kjo do të thotë se ai gjen kënaqësi më të madhe nga kryerja e detyrës se sa nga e ngrënia. Edhe pula gjithashtu do të sakrifikonte jetën për zogjtë e saj; ajo do të sulmonte edhe një qen për të mbrojtur zogjtë e saj. Ajo gjithashtu do të mbetej e uritur dhe do t'u jepte atyre të hanë. Domethënë, ajo merr një kënaqësi të tillë në detyrën e saj saqë e bën atë të preferojë dhimbjet e urisë dhe vuajtjet e vdekjes.

Nënat tek kafshët gjejnë një kënaqësi të madhe në përpjekje për të mbrojtur të vegjëlit e tyre sa kohë që ato janë të vegjël, por sapo i vogli të rritet, përfundon detyra e nënës, edhe kënaqësia gjithashtu ikën. Dhe nënat fillojnë t'i godasin fëmijët e tyre dhe ua marrin atyre kokrrat e ushqimit.Kjo praktikë Hyjnore vepron tek të gjitha kafshët. Vetëm për nënat njerëzore detyrat vazhdojnë për disa kohë, sepse në lidhje me dobësinë dhe pafuqinë e tyre, njerëzit janë gjithnjë fëmijë nga një drejtim, dhe për të gjithë kohën ata kanë nevojë për mëshirë e dhembshuri.

Shqyrtoji të gjithë meshkujt dhe femrat e specieve të kafshëve, si pula nënë dhe si gjeli, të cilët veprojnë si bari dhe kupto se ato nuk i kryejnë këto detyra për hir të vetes së tyre, as në emrin e vet dhe as për plotësimet e tyre, pasi ato do të vetëflijonin edhe jetët e tyre nëse do ta kërkonte nevoja. Përkundrazi, ato e kryejnë atë detyrë për hir të Mirëbërësit Gjithëbujar, i Cili ua ka dhuruar mirësitë, dhe për hir të Krijuesit të Gjithëlavdishëm, i Cili i ka vënë ato në shërbim në atë detyrë dhe i Cili, nëpërmjet mëshirës së Tij të gjërë, ka përfshirë një kënaqësi brenda detyrës së saj dhe një ëndje brenda shërbimit të saj.

Një dëshmi se rroga është e pranishme në vetë detyrën është kjo:

Bimët dhe pemët u nënshtrohen urdhërave të Krijuesit të Gjithëlavdishëm në një mënyrë që nënkupton zell e kënaqësi, sepse erërat -parfumet- e mira që ato përhapin dhe qënia e tyre të stolisura me zbukurime e dekorime që tërheqin shikimet e blerësve të tyre dhe, vetëflijimi i tyre për hir të filizave dhe të frutave të tyre derisa ato kalben.. e gjitha kjo shpall për të vëmendshmit se ato marrin një kënaqësi të tillë duke iu bindur urdhërave Hyjnorë saqë ato kalbëzojnë e shkatërrojnë vetveten për hir të asaj kënaqësie.. A nuk e shikon arrën e kokut dhe pemën e fikut, si frutat, të cilët japin ushqimin më të hollë si qumështi i pastër që e kërkojnë nga thesari i mëshirës Hyjnore

nëpërmjet gjuhës së gjendjes së tyre të natyrshme; ato e marrin atë dhe ua japin frutave të tyre për ta ngrënë, ndërsa vetë ato e kënaqin dhe e ngopin vetveten me ujë të turbullt e me baltë.

Edhe në farëra gjithashtu një dëshirë është krejtësisht e qartë në detyrën e tyre të mbirjes, mugullimit dhe të nxjerrjes së filizave, ashtu siç dëshiron i burgosuri në një vend të ngushtë të dalë jashtë në një kopsht ose në një vend të hapur; një dëshirë e tillë, një gjendje e tillë e gëzueshme është gjithashtu e dukshme në farëra, në detyrën e tyre të mugullimit.

Kështu, për shkak të kësaj dëshire dhe të këtij parimi misterioz i cili është në fuqi në univers dhe i cili quhet '*Praktika Hyjnore*', ata njerëz të papunë e dembelë të cilët jetojnë në rehati e në mes të gjitha të mirave në pjesën më të madhe vuajnë më shumë dhe janë më të dëshpëruar se sa ata që luftojnë e përpiqen, sepse dembelët gjithmonë ankohen për jetët e tyre dhe dëshirojnë t'i kalojnë ato shpejt në qejfe, dëfrime e zbavitje. Ndërsa ai që punon e përpiqet është mirënjohës ndaj Zotit xh.sh. dhe e lavdëron Atë dhe ai nuk dëshiron që jeta e tij të kalojë shpejt.

اَلْمُسْتَرِيحُ اَلْعَاطِلُ شَاكٍ مِنْ عُمْرِهِ وَالسَّاعِي اَلْعَامِلُ شَاكِرٌ

"Ai që jeton në dembeli e rehati ankohet për jetën e tij, ndërsa punëtori i zellshëm është mirënjohës" është një parim universal. Gjithashtu, për këtë arsye, thënia "*Rehatia qëndron në vështirësi dhe vështirësia në rehati"* është bërë proverbiale.

Po, në qoftë se qëniet e pashpirta do të studioheshin me vëmendje, Praktika Hyjnore që u përmend lart do të shihej qartë.

Qëniet e pashpirta, kapacitetet dhe aftësitë e bashkëlindura të të cilave nuk janë zhvilluar dhe kanë mbetur të mangëta nga kjo anë, ti i sheh ato të përpiqen fort dhe të bëjnë një luftë të madhe me qëllim që të shtrihen dhe të kalojnë nga gjendja e 'fuqisë' së 'fshehur' për tek gjendja e 'veprimit'; pra nga potencialja për tek aktualja. Kjo gjendje tregon se në atë detyrë natyrale ka entuziazëm e kënaqësi. Në qoftë se ajo qënie e pashpirt do të kishte pjesë nga jeta e përgjithshme, entuziazmi është i vetë asaj; përndryshe ai i përket Atij që përfaqëson dhe mbikëqyr qënien e pashpirt. Madje, duke u mbështetur mbi këtë

mister, mund të thuhet se uji i hollë e delikat sapo të marrë urdhrin për të ngrirë, ai i nënshtrohet atij urdhri me një entuziazëm të fortë të tillë, saqë ai çan hekurin, duke e thyer atë në copa. Domethënë, kur i ftohti dhe shkallët e ngrirjes përçojnë urdhrin Hyjnor të 'zgjerimit' me gjuhën e ngrirjes nën temperaturën zero të ujit në një konteiner -enë- të mbyllur hekuri; ai e thyen konteinerin me zellin e tij të fortë; ai e çan hekurin dhe vetë bëhet akull.

Ti mund të bësh analogji me këtë për gjithçka në gjithësi prej përpjekjeve dhe lëvizjeve duke filluar nga rrotullimet e diejve në boshtet e tyre dhe duke përfunduar tek lëvizjet rrotulluese të grimcave -si mevlevi ashikë- dhe tek udhëtimet e lëkundjet e tyre.. Gjithçka që përpiqet e lëviz në univers vepron duke u mbështetur mbi ligjin e Kaderit Hyjnor dhe buron nga Dora e Fuqisë Hyjnore dhe manifestohet nëpërmjet urdhrit krijues i cili përmban Dëshirën Hyjnore, njohjen dhe urdhrin.

Madje çdo grimcë, çdo qënie dhe çdo gjallesë, i ngjason një ushtari i cili ka lidhje të ndryshme me të gjitha grupet e sferat e ushtrisë dhe me detyrat e ndryshme të gjithësecilit; të gjitha grimcat dhe qëniet e gjalla janë të ngjashme me këtë. Për shembull, një grimcë në syrin tënd ka një lidhje me qelizat e syrit, me syrin, me nervat e syrit në fytyrë, me enët e gjakut të trupit; ajo ka detyra në përputhje me ato lidhje, dhe sjell dobi në përputhje me secilën prej atyre detyrave. Dhe kështu me radhë, ti mund të krahasosh me këtë gjithçka në ekzistencë.

Kështu, çdo gjë dëshmon për domosdoshmërinë e ekzistencës së të Gjithëfuqishmit absolut në dy drejtime:

I Pari: Duke kryer detyrat që kalojnë mijëra herë përtej fuqisë së saj, ndonëse ajo është e pafuqishme për to, çdo gjë dëshmon nëpërmjet gjuhës së pafuqisë së saj për ekzistencën e atij të Gjithëfuqishmi Absolut.

I Dyti: Nëpërmjet të vepruarit në harmoni me ligjet që formojnë rregullin e botës dhe përjetësojnë e ruajnë ekuilibrin e qënieve, çdo gjë dëshmon -me këtë harmoni e ekuilibër- për ekzistencën e Atij të Gjithëdituri të Gjithëfuqishëm, sepse gjërat e pajeta si grimcat -ose një insekt si bleta- nuk mund t'i njohin rregullin dhe balancën, të cilat janë të holla dhe çështje të rëndësishme të *Librit të Qartë*. Si mundet një grimcë e pajetë dhe një bletë e vogël të lexojnë çështjet e holla e

domethënëse të *Librit të Qartë*, i cili është në Dorën e të Gjithëlavdishmit të Vetëm, i Cili i hap, i mbyll dhe i grumbullon nivelet e qiejve sikur të ishin fletët e një regjistri? Në qoftë se ti marrëzisht supozon se grimca ka një sy të aftë për të lexuar shkronjat e holla të atij libri, atëherë ti mund të përpiqesh ta hedhësh poshtë dëshminë e grimcës!

Po, Krijuesi i Gjithurtë i përmbledh parimet e Librit të Qartë në formën më të bukur dhe në mënyrë të përmbledhur dhe me një kënaqësi të veçantë dhe i përfshin ato qënie. Në qoftë se çdo gjë vepron kështu me një kënaqësi të veçantë nga një nevojë e veçantë, ajo pa e ditur u bindet parimeve të Librit të Qartë. Për shembull, mushkonja në kohën e lindjes së saj dhe të ardhjes së saj në këtë botë, shfaqet prej shtëpisë së saj dhe, duke mos ndaluar, sulmon fytyrën e njeriut; ajo e godet atë me shkopin e saj të gjatë dhe me sondën e saj të hollë dhe me të shpërthen ujin e jetës, dhe ajo e pi atë. Ajo tregon aftësinë e një luftëtari në shmangien e goditjeve të drejtuara ndaj saj. Kush ia mësoi kësaj krijese të vockël, të papërvojë dhe të porsalindur shkencën e luftës dhe artin e nxjerrjes së ujit? Dhe ku i mësoi ajo këto?... Unë, ky Saidi i mjerë, pranoj se në qoftë se do të kisha qenë në vendin e asaj mushkonje me sondat e saj, unë nuk do ta kisha mësuar këtë art, këtë luftim të sulmit dhe të tërheqjes dhe këtë nxjerrje të ujit, vetëm se pas një instruksioni të gjatë, pas provave të shumta dhe pas një kohe të gjatë.

Krahasoji me mushkonjën bletët që inspirohen, merimangën dhe bilbilin, i cili thur dhe ndërton folenë e vet si çorape në mënyrë të mrekullueshme, dhe ti mund t'i krahasosh bimët për këto kafshë pikërisht në të njëjtën mënyrë.

Po, Gjithëbujari Absolut xh.sh. i ka dhënë çdo qënieje të gjallë një biletë 'përkujtuese' të shkruar me penën e kënaqësisë dhe me bojën e nevojës, dhe Krijuesi xh.sh. ka vendosur tek ajo qënie programin e urdhërave krijuese dhe indeksin e detyrave të saj. Shikoje se si i Gjithurti i Gjithëlavdisë ka shkruar mbi një dëftesë sasinë që lidhet me detyrat e bletës, nga parimet e librit të Qartë dhe, e ka vendosur atë në kasafortën tek koka e bletës. Dhe çelësi për kasafortën është kënaqësia e veçantë për bletën e zellshme. Me atë, ajo hap kasafortën, lexon programin, kupton urdhrin dhe vepron. Ajo shpall kuptimin e vërsetit,

وَأَوْحَىٰ رَبُّكَ إِلَى النَّحْلِ *"Dhe Zoti yt inspiroi edhe bletën"*[5].

Në qoftë se ti e ke dëgjuar tërësinë e këtij *Shënimit të Tetë* dhe e ke kuptuar plotësisht, nëpërmjet intuitës së besimit, ti do të kuptoje një kuptim të

وَسِعَتْ رَحْمَتُهُ كُلَّ شَيْءٍ *"dhe mëshira e Tij përfshin gjithçka",*[6] një të vërtetë të vërsetit,

وَإِن مِّن شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ *"Dhe s'ka gjë që të mos e lëvdojë Lartësinë e Tij"*,[7] një parim të vërsetit,

إِنَّمَا أَمْرُهُ إِذَا أَرَادَ شَيْئًا أَن يَقُولَ لَهُ كُن فَيَكُونُ *"Sigurisht që Urdhri i Tij kur Ai do një gjë, është vetëm se Ai t'i thotë asaj: "Bëhu!" dhe ajo është bërë (në çast)!"*[8] dhe një pikë të vërsetit,

فَسُبْحَانَ الَّذِي بِيَدِهِ مَلَكُوتُ كُلِّ شَيْءٍ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ "*Kështu pra, i lavdëruar është Ai dhe i lartësuar mbi gjithçka që ata ia bashkojnë Atij në Duart e të Cilit është mbizotërimi i çdo gjëje dhe tek Ai ju të gjithë do të ktheheni"*.[9]

- **Shënimi i Nëntë**

Dije se profetësia në njerëzimin është përmbledhja dhe themeli i të mirës së njeriut dhe i plotësimeve; feja e vërtetë është indeksi i përparimit dhe i lumturisë; dhe besimi është e mira e pastër e mirëfilltë dhe bukuria e thjeshtë e papërzier. Meqenëse në këtë botë një bukuri e ndritshme, një e mirë e shtrirë dhe e lartësuar, një e vërtetë e qartë dhe një plotësim epror janë të dukshme, atëherë në mënyrë të vetëkuptueshme e vërteta dhe realiteti qëndrojnë në profetësi dhe në duart e profetëve. Ndërsa e keqja, çudhëzimi dhe humbja qëndrojnë me ata që janë kundra profetëve.

---

[5] Kur'an, 16:68
[6] Kur'an, 7: 156
[7] Kur'an, 17:44
[8] Kur'an, 36:82
[9] Kur'an, 36:83

Në qoftë se dëshiron, shiko vetëm njërin prej mijëra shembujve të meritave dhe të vlerave të adhurimit të cilat i solli profeti a.s.m. i cili është ky:

Profeti Muhammed a.s.m. i bashkon zemrat e atyre që vertetojnë Unitetin Hyjnor në faljet në festa, në ditën e xhuma dhe në faljet që kryhen me xhematë dhe ai i bashkon së bashku të gjitha gjuhët e tyre në një frazë të vetme. Kjo është në një mënyrë të tillë saqë një njeri i përgjigjet adresimit sublim e të lartësuar të të Adhuruarit të Parapërjetshëm me zërat, duatë dhe me thirrjet e lëshuara nga zemra e gjuhë të panumërta. Duke e forcuar njëri-tjetrin, duke e ndihmuar njëri-tjetrin dhe duke u bashkuar, ato zëra, dua e thirrje shfaqin një adhurim aq të shtrirë përpara Hyjnisë së të Adhuruarit të vërtetë të Parapërjetshëm, saqë është sikur globi tokësor po i reciton ato thirrje lavdëruese -dhikr- dhe po i bën ato lutje dhe po i kryen faljet me krahinat e tij dhe i bindet me vendet e tij urdhrit të أَقِيمُوا الصَّلٰوةَ *"Dhe falni namazin"*[10], i cili u shpall me lavdi e madhështi prej lart matanë shtatë qiejve.

Nëpërmjet këtij misteri të unitetit, njeriu, i cili është një krijesë e dobët dhe e vogël si një grimcë në këto botëra, u bë si një shërbëtor i dashur i Krijuesit të qiejve dhe të tokës nga aspekti i madhështisë së adhurimit ndaj Tij dhe u bë kalif i Zotit xh.sh. në tokë, sunduesi i tokës, udhëheqësi i kafshëve dhe rezultati dhe qëllimi i krijimit të universit.

Po, në qoftë se zërat e qindra milionë njerëzve besimtarë duke thënë *'All-llahu Ekber'* pas pesë namazeve të përditshëm të detyruar dhe në mënyrë të veçantë 'në faljet e festave' do të bashkoheshin në Botën e Dukshme ashtu siç bëjnë ato në Botën e Padukshme, globi tokësor në tërësinë e tij do të bëhej si një qënie e madhe njerëzore. Meqenëse fraza "*All-llahu Ekber*" të cilën ai e shpreh me një zë madhështor është e barabartë me madhështinë e globit, atëherë besimtarët e Unitetit Hyjnor duke thënë *"All-llahu Ekber*!" në të njëjtin moment njëzëri, pra duke i bashkuar *tekbiret*, ato bëhen si një *tekbir* i Vetëm Madhështor i shprehur nga globi tokësor. Është sikur toka të lëkundej me një tërmet të fuqishëm nëpërmjet duave, lavdërimeve e thirrjeve të Botës së islamit në faljet e ditëve të festave. Duke thënë

[10] Kur'an, 2:43

All-llahu Ekber, *Zoti është më i madhi* me të gjitha vendet e krahinat e tij, globi tokësor formon qëllimin e tij -bën nijetin- nga thellësia e zemrës së Qabesë së tij që është Kibleja e tij, dhe thotë *All-llahu Ekber* me gjuhën e Malit *Arefat* nga goja e Mekës; ajo frazë e vetme *All-llahu Ekber* merr një formë në ajrin e gjuhëve, si shpella, të të gjithë besimtarëve në të gjitha anët e tokës. Ashtu si me jehonën e Fjalëve *All-llahu Ekber* që shumë shprehje të tilla tekbiri vijnë në qënie, po ashtu ai recitim i pranueshëm dhe ato *tekbire* e përmendje i bëjnë qiejt të kumbojnë e të ushtojnë duke u ngritur e ulur në Botërat e ndërmjetme.

Ne e lavdërojmë, e madhërojmë dhe e lartësojmë sa numri i grimcave të tokës Allahun e Gjithëlavdishëm, i Cili e bëri tokën kështu të bie në sexhde përpara tij në adhurim duke e lavdëruar e lartësuar Atë, që e bëri atë një xhami për shërbëtorët e Tij dhe një djep për krijesat e Tij. Dhe ne e madhërojmë dhe e lavdërojmë Atë sa numri i qënieve që na bëri ne anëtarë të Ummetit të Profetit të Tij më të nderuar a.s.m. dhe që na e mësoi ne këtë lloj adhurimi.

● **Shënimi i Dhjetë**

Dije, O Said i pavëmendshëm e i ngatërruar! Dije se arritja për tek drita e njohjes së Allahut të Vërtetë dhe për tek shikimi i manifestimeve të Tij në pasqyrat e shenjave dhe dëshmitarëve, dhe për të vështruar provat e Tij, bën të domosdoshme që të mos i verifikosh ato me gishtat e kritikës. Mos e shqyrto në mënyrë kritike çdo dritë që kalon tek ti ose që i ndodh zemrës tënde, ose i shfaqet zemrës tënde, as mos e kritiko atë me dorën e hezitimit. Mos e shtrij dorën tënde që të marrësh një dritë që t'u shfaq ty. Përkundrazi, tërhiqu nga gjërat që shkaktojnë pavëmendshmëri, zbulohu para asaj drite, kthehu drejt saj dhe prit; sepse unë kam vëzhguar se dëshmitarët e provave të Njohjes rreth Zotit xh.sh. janë tre llojesh:

Njëri lloj është si uji. Ai është i dukshëm dhe i ndjeshëm -konkret- por nuk mund të mbahet me gishta. Për këtë lloj, njeriu duhet ta shkëpusë vetveten nga iluzionet, të zhvishet nga imagjinatat dhe të zhytet në të me të gjithë qënien e tij. Mos e zhbiro e mos e spiuno -zbulo- atë me gishtin e kritikës, sepse ai rrjedh e humbet. Uji i jetës nuk mund ta bëjë gishtin si vendbanimin e tij; uji nuk mund ta pranonte këtë!

Lloji i Dytë është si ajri: Ai mund të ndijohet, por ai as nuk është i dukshëm, as nuk mund të mbahet. Ti duhet të kthehesh drejt tij me fytyrën tënde, me gojën tënde, me shpirtin tënd dhe mbaje veten tënde përballë atij flladi të mëshirës. Por mos e shtrij dorën e kritikës ndaj tij, sepse ti je i pamundur ta mbash. Thithe atë me shpirtin tënd. Në qoftë se ti e shikon atë me syrin e ngurrimit dhe shtrin duart e kritikës mbi të, ai do të të lërë ty e do të largohet. Ai nuk do ta bënte dorën tënde si banesën e tij; ai nuk do të ishte i kënaqur me të si shtëpi!

Sa për llojin e Tretë, ai është si drita. Ajo është e dukshme, por as nuk ndijohet e as nuk mund të mbahet. Kështu, ti duhet ta mbash veten tënde përpara asaj me syrin e zemrës dhe me shikimin e shpirtit; ti duhet ta drejtosh shikimin tënd drejt saj dhe pastaj prit. Ndoshta ajo do të vijë vetë, sepse drita nuk mund të mbahet në dorë dhe as nuk mund të gjuhet -gjahtohet- me gishtërinj. Ajo mund të gjahtohet veçse me dritën e mendjemprehtësisë dhe të intuitës. Në qoftë se ti do të shtrije tek ajo një dorë fizike e lakmitare dhe do ta peshoje atë me peshore lëndore, ajo do ta fshihte vetveten edhe në qoftë se nuk do të shuhej, sepse një dritë e tillë nuk do të ishte e kënaqur të burgosej në materie, kështu ajo nuk mund të ngushtohet, as nuk i pranon gjërat e dendura si pronarë e si padronë të saj.

● **Shënimi i Njëmbëdhjetë**

Shikoje shkallën e mëshirës së gjërë në mënyrën e shprehjes së Kur'anit dhe mirësinë e dhembshurinë e tij për shumicën e atyre të cilëve ai u adresohet të cilët janë masat e njerëzve të zakonshëm. Mendjet e tyre janë të thjeshta dhe, meqenëse shikimi i tyre nuk depërton tek gjërat e holla, ai i përsërit shenjat e qarta të shkruara në faqen e qiejve dhe të tokës me qëllim që të ledhatojë mendjet e tyre të thjeshta. Ai ua lehtëson atyre leximin e atyre shkronjave të mëdha. Për shembull, ai ua mëson shenjat që duken qartë dhe që lexohen lehtë, si krijimi i qiejve e i tokës, dhe rënia e shiut nga qielli dhe ringjallja e tokës.. dhe si shembulli i këtyre shenjave.. Ai rrallëherë e drejton vëmendjen për tek shenjat e holla të shkruara në shkronjat e vogëla midis atyre shkronjave të mëdha, me qëllim që njerëzit e zakonshëm të mos përjetojnë vështirësi në leximin e tyre.

Pastaj shikoje elokuencën, rrjedhshmërinë dhe natyrshmërinë në stilet e Kur'anit, si ai reciton vërsetet e shkruara me penën e fuqisë

Hyjnore në fletët e universit. Sikur Kur'ani të ishte recitimi i librit të universit dhe shprehja gojore e rregullit të tij, dhe lexon atributet e Skalitësit të Parapërjetshëm dhe shkruan aktet e Tij. Në qoftë se dëshiron ta shohësh këtë elokuencë të shprehjes, dëgjo me një zemër të vetëdijshme e të vëmendshme dekretet si Sureja *Amme,*[11] dhe vërsetin;

قُلِ اللَّهُمَّ مَالِكَ الْمُلْكِ *"Thuaj: "O Allah! Zotëruesi i Mbretërimit".*[12]

● **Shënimi i Dymbëdhjetë**

O të dashurit e mi që po i dëgjoni këto *Shënime*! Ju duhet ta dini se arsyeja pse unë i shkruaj përgjërimet e zemrës sime dhe lutjet që ia drejtoj Allahut, të cilat duhet të mbeten sekret, është që t'i kërkoj mëshirës Hyjnore që t'i pranojë fjalët e shkrimit tim kur vdekja të ketë heshtur fjalët e gjuhës sime. Po, pendimi i gjuhës sime në jetën time të shkurtër nuk është e mjaftueshme për shlyerjen e gjynaheve të mia të panumërta. Gjuha e të shkruarit është e vazhdueshme dhe e qëndrueshme deri diku dhe më e dobishme. Kështu, para trembëdhjetë viteve gjatë një tronditjeje të fortë të shpirtit tim dhe gjatë një stuhie që i transformoi të qeshurat e 'Saidit të Vjetër' në qarje të Saidit të Ri -në kohën që u zgjova nga gjumi i pakujdesisë së Rinisë- unë i shkrova këto përgjërime e lutje në arabisht. Kuptimi në turqisht i një pjese të tyre është sa vijon:

O Krijuesi im Mëshirëplotë dhe o Zoti im Gjithëbujar!

Nëpërmjet zgjedhjeve të mia të gabuara, jeta ime dhe rinia kanë humbur e kanë ikur, dhe e gjitha ajo që ka mbetur tek unë si frutat e tyre janë gjynahet e dhimbshme, dëshpërimet fyese, dyshimet çudhëzuese dhe shqetësimet. Unë po i afrohem varrit me këtë peshë të rëndë, me zemër të sëmurë dhe me fytyrë të turpëruar. Ashtu si të gjithë të dashurit e mi shokët dhe të afërmit që janë duke vdekur përpara syve të mi pa zgjedhje dhe pa u shmangur majtas apo djathtas, edhe unë gjithashtu po i afrohem derës së varrit. Varri është vendqëndrimi i parë në rrugën që të çon nga kjo banesë vetmie në rrugë drejt të gjithë përjetësisë, për ndarjen e përhershme prej këtij vendbanimi kalimtar i cili sigurisht do të shkatërrohet; ai është dera e

[11] Kur'an, 78
[12] Kur'an, 3:26

parë drejt saj. Unë kam kuptuar me siguri absolute se mbretëria e kësaj bote tek e cila unë jam lidhur dhe pas të cilës unë jam robëruar, është kalimtare, do të vdesë, do të shkatërrohet e largohet. Dhe ashtu siç shihet qartë, qëniet brenda saj udhëtojnë karvan pas karvani dhe zhduken, në mënyrë të veçantë për ata si unë me nefse urdhërues për të liga, kjo është shumë mizore e tradhtare. Për një kënaqësi, ajo të jep një mijë dhimbje. Për një kokërr të vetme rrushi, ajo të jep njëqind shuplaka.

O Krijuesi im Mëshirëplotë dhe o Zoti im Gjithëbujar!

Në përputhje me thënien كُلُّ آتٍ قَرِيبٌ *"Gjithçka që është duke ardhur është e afërt*", unë tani shoh se së shpejti do të jem mbështjellur me qefin, dhe do t'u kem thënë lamtumirë të dashurve të mi që më përcjellin në varr.

Duke iu afruar varrit tim, unë pres faljen Tënde dhe thërras për Mëshirën Tënde nëpërmjet gjuhës së heshtur të kufomës sime dhe gjuhës së qartë të shpirtit tim, duke thënë:

Mëshirë! Mëshirë! O i Dashur! O i Dhembshur! Më shpëto mua nga turpi i gjynaheve të mia!"

Tani unë kam arritur tek buza e varrit tim. Unë po qëndroj në krye të varrit i shtrirë pranë tij. Duke ngritur kokën time për tek dera e Mëshirës Tënde, unë thërras duke kërkuar me të gjithë fuqinë time: "Mëshirë! Mëshirë! O Zemërbutë! O i Përzemërt! Më shpëto mua nga pesha e rëndë e mëkateve të mia!

Tani unë kam hyrë në varrin tim, jam mbështjellur me qefinin tim. Ata që erdhën të më përcjellin në rrugën time më kanë lënë të vetmuar dhe janë larguar. Unë pres faljen dhe Mëshirën Tënde. Unë e shikoj qartë se nuk ka vend strehimi ose ngushëllimi përveç Teje. Unë thërras me të gjithë fuqinë time në fytyrën e shëmtuar të mëkatit, në formën e egër të mosbindjes kundra Zotit xh.sh. nga ngushtësia e vendit;

"Mëshirë! Mëshirë! O i Gjithëmëshirshëm! O Zemërbutë! O i Dhembshur! O Bamirës! Më shpëto mua nga shoqërimi i mëkateve të mia të shëmtuara! Zgjeroma vendin tim! O Zoti im! Mëshira Jote është mjeti im për strehim; i Dashuri Yt, mëshira për të gjitha botët është

ndërmjetësi për mëshirën Tënde. Unë ankohem, jo rreth Teje, por për nefsin tim dhe për gjendjen time."

O Krijuesi im Gjithëbujar, dhe O Zoti im Mëshirëplotë!

O Pronari im dhe o Padroni im!.. krijesa Jote dhe shërbëtori Yt i quajtur Said është edhe i pabindur, edhe i pafuqishëm, edhe i pavëmendshëm, edhe i paditur, i sëmurë, i ulët, mëkatar, i moshuar, keqbërës dhe si një skllav i arratisur; por pas dyzet vjetësh ai është penduar dëshiron të kthehet tek dera Jote duke kërkuar strehim tek Mëshira Jote. Ai i pranon mëkatet dhe fajet e tij të panumërta. Duke vuajtur nga dyshimet dhe nga çdo lloj sprove, ai të kërkon e të përgjërohet Ty.. Në qoftë se do ta falësh e ta mëshirosh atë, Ti je më Mëshiruesi i Mëshiruesve dhe kjo është Shenja Jote. Në qoftë se Ti nuk më pranon, derës së kujt mund t'i afrohem? Çfarë dere tjetër mund të ndodhet? Nuk ka krijues tjetër përveç Teje që mund të synohet; nuk ka të adhuruar tjetër të vërtetë përveç Teje tek i cili mund të kërkoj strehim!

Nuk ka zot përveç Teje! Ti je Një i Vetëm! Ti nuk ke ortakë.. Fjala e fundit në dynja dhe fjala e parë në Ahiret dhe në varr; është:

لَآ اِلٰهَ اِلَّآ اَنْتَ وَحْدَكَ لَا شَرِيْكَ لَكَ اٰخِرُ الْكَلَامِ فِي الدُّنْيَا وَاَوَّلُ الْكَلَامِ فِي الْاٰخِرَةِ

وَفِي الْقَبْرِ اَشْهَدُ اَنْ لَآ اِلٰهَ اِلَّا اللّٰهُ وَاَشْهَدُ اَنَّ مُحَمَّدًا رَسُوْلُ اللّٰهِ صَلَّى اللّٰهُ تَعَالٰى عَلَيْهِ وَسَلَّمَ

Unë dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, dhe dëshmoj se Muhammedi është i Dërguari i Tij, Allahu i Plotëfuqishëm i dhëntë bekime e paqe!

● **Shënimi i Trembëdhjetë**

Kjo përbëhet nga pesë çështje të cilat kanë qenë bosht konfuzioni.

Çështja e Parë

Megjithëse ata që punojnë dhe përpiqen në rrugën e së vërtetës duhet të mendojnë vetëm për detyrat e tyre, ata mendojnë për ato që i përkasin Zotit të Plotëfuqishëm, dhe i bazojnë veprat e tyre mbi to dhe bien në gabime. Në veprën "*Adab al-Din Wa'l-Dynja"* është shkruar se

shejtani e tundoi Isain -Jezusin a.s.- duke i thënë: "Meqenëse Exheli i vdekjes është i përcaktuar dhe të gjitha gjërat janë paracaktuar nga Kaderi Hyjnor, atëherë hidhe poshtë veten tënde nga ky vend i lartë, sepse nëse Ai ka paracaktuar për ty shpëtimin, do të shpëtosh".

Isai a.s. iu përgjigj: O i mallkuar!

إِنَّ لِلَّهِ أَنْ يَخْتَبِرَ عَبْدَهُ وَلَيْسَ لِلْعَبْدِ أَنْ يَخْتَبِرَ رَبَّهُ *"Allahu i vë në provë shërbëtorët e Vet, kurse shërbëtorët nuk mund ta vënë në provë Krijuesin e tyre"*. Domethënë, Allahu i Plotëfuqishëm e vë në provë robin e Tij duke i thënë: Në qoftë se ti do të veprosh kështu, Unë do të të shpërblej me këtë, le të shohim, a do të jesh në gjendje ta bësh këtë. Ndërsa Robi i Tij nuk ka të drejtë dhe fuqi ta vërë në provë Allahun duke i thënë: "Në qoftë se unë do ta bëja këtë punë, a do të bësh Ti për mua këtë? Duke marrë kështu një mënyrë të tillë sikur të nënshtroje Hyjninë e Zotit të Plotëfuqishëm për testim e provim, kjo do të ishte një sjellje e keqe dhe në kundërshtim me adhurimin dhe me qënien e njeriut rob i Zotit". "Meqenëse çështja është kështu, njeriu duhet të kryejë detyrën e tij dhe të mos ndërhyjë në punët e Allahut të Plotëfuqishëm.

Është e mirënjohur se kur njëri nga heronjtë e islamit i cili shumë herë e shpartalloi ushtrinë e Xhengis Khanit, Xhelaluddin Khurazmshah, po shkonte në luftë, ministrat dhe përkrahësit e tij i thanë: "Ti do të jesh fitimtar", Allahu i Plotëfuqishëm do të të bëjë ty triumfator: Ai u përgjigj: "Unë jam i ngarkuar nga urdhri i Zotit xh.sh. që të veproj në rrugën e xhihadit; unë nuk ndërhyj në çështjet që i përkasin Allahut xh.sh.. Që të na bëjë ne fitimtarë apo të mposhtur është një çështje që i përket Atij". Kështu, për shkak se e kuptoi misterin e nënshtrimit, ai hero i madh ishte triumfator në mënyrë të mrekullueshme në raste të shumta. Në të vërtetë, në veprat e tij të vullnetshme, njeriu nuk duhet të mendojë për rezultatet të cilat i përkasin Allahut të Plotëfuqishëm. Për shembull, shtohet entuziazmi i disa vëllezërve tonë dhe përpjekja e tyre kur njerëzit i përgjigjen dhe i bashkohen Risale-i Nurit.. Ndërsa kur njerëzit nuk u përgjigjen, të dobëtit prej tyre demoralizohen dhe entuziazmi i tyre shuhet deri diku. Ndërsa i dërguari më i madh i Allahut xh.sh. i cili ishte profesori më i madh, udhëheqësi universal dhe udhëzuesi i përkryer, mori si udhëzuesin e tij absolut Dekretin Hyjnor:

وَمَا عَلَى الرَّسُولِ إِلَّا الْبَلَاغُ *"Detyra e të Dërguarit është vetëm që të bëjë të njohur (mesazhin)".*[13]

Dhe kur njerëzit largoheshin dhe nuk e dëgjonin, ai e përcjellte mesazhin me përpjekjen më të madhe dhe shtonte orvatjen dhe seriozitetin, sepse në përputhje me vërsetin,

إِنَّكَ لَا تَهْدِي مَنْ أَحْبَبْتَ وَلَٰكِنَّ اللَّهَ يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ *"Në të vërtetë ti (Muhammed a.s.m.) nuk udhëzon kë të duash ti, por Allahu udhëzon atë që Ai do".*[14]

Ai e kuptoi se të bërit e njerëzve të dëgjojnë dhe të udhëzuarit e tyre i përkiste vetëm Allahut xh.sh.. Dhe kështu, o vëllezërit e mi! Edhe ju gjithashtu mos ndërhyni në punë e në çështje që nuk kthehen tek ju, dhe mos i ndërtoni aktet tuaja mbi atë që nuk është puna juaj, dhe mos merrni një pozitë që vë në provë Krijuesin tuaj!

Çështja e Dytë

Adhurimi dhe robëria ndaj Allahut shikojnë tek urdhri Hyjnor dhe tek kënaqësia Hyjnore. Arsyeja për adhurimin është urdhri Hyjnor dhe rezultati i tij është kënaqësia Hyjnore. Frutat e tij dhe dobitë shikojnë tek Ahireti; veçse ama nuk është në kundërshtim me adhurimin në qoftë se jepen fruta, dobitë e të cilëve shikojnë tek kjo dynja, me kusht që ato të mos jenë arsyeja përfundimtare dhe të mos synohen në kërkimin e tyre. Dobitë që shikojnë tek dynjaja dhe frutat që vijnë nga vetvetja dhe jepen pa i kërkuar, nuk e kundërshtojnë adhurimin. Përkundrazi, ato janë për të inkurajuar të dobëtit dhe për t'i bërë ata të priren drejt adhurimit. Por në qoftë se ato fruta e dobi do të bëheshin arsyeja për duanë ose për recitimin, ose një pjesë e arsyes, atëherë kjo do ta zhvlerësonte e shfuqizonte pjesërisht adhurimin, madje do ta bënte atë *vird* -recitim-, i cili ka veçori e merita të shumta, shterp, të pafrutshëm dhe nuk do të prodhonte rezultate.

Kështu, ata që nuk e kuptojnë këtë mister, dhe lexojnë *virdet* e shenjta të Shejh Nakshibendit, të cilat kanë qindra merita, veçori e

[13] Kur'an, 5:99
[14] Kur'an, 28:56

dobi, ose lexojnë "*Xheushen El-kebir*", i cili ka një mijë nga meritat e dobitë duke i bërë disa nga ato merita e dobi qëllimin e tyre kryesor, nuk i gjejnë ato dobi, madje nuk do t'i gjejnë dhe nuk do t'i shohin dhe as nuk kanë të drejtë që t'i shikojnë; sepse ato dobi nuk mund të jenë arsye për ato virde -recitime- dhe ato nuk mund të synohen e kërkohen, sepse ato dobi vijnë në formën e një favori Hyjnor për atë vird i cili recitohet në mënyrë të sinqertë dhe pa kërkuar gjë. Ndërsa, në qoftë se recituesi do t'i synonte ato dobi, atëherë nijeti për to do ta prishte sinqeritetin e tij pjesërisht; madje kjo do ta shkatërronte qënien e saj si adhurim dhe do të humbiste të gjithë vlerën.

Megjithatë, ka një çështje tjetër, ka njerëz të dobët të cilët janë të nevojshëm për diçka që t'i inkurajosh për të recituar virde të tilla të vlefshme si ato. Në qoftë se ata mendojnë për dobitë dhe i recitojnë me zell thjesht për hir të Zotit xh.sh. dhe për Ahiretin, kjo nuk sjell dëm dhe madje është e pranueshme. Për shkak se ky shembull urtësie nuk ka qenë kuptuar, kur ata prej poleve shpirtërorë dhe prej të drejtëve të gjeneratave të mëparshme nuk i merrnin dobitë e treguara, shumë prej tyre u bënë dyshues ose madje i hodhën poshtë.

Çështja e Tretë

طُوبَىٰ لِمَنْ عَرَفَ حَدَّهُ وَلَمْ يَتَجَاوَزْ طَوْرَهُ "Myzhde, i lumtur është njeriu që i njeh caqet e tij dhe nuk i tejkalon ato."[15] Dielli ka manifestime mbi çdo gjë, duke filluar nga grimca më e vockël, copë xhami dhe një pikë uji prej një pellgu të madh dhe një oqeani dhe duke përfunduar tek hëna dhe planetët. Secila prej tyre përmban reflektimin e diellit dhe imazhin në përputhje me kapacitetin e vet dhe i njeh limitet e saj. Në përputhje me kapacitetin e saj, një pikë uje thotë: "Ndodhet një reflektim i diellit tek unë", por ajo nuk guxon të thotë: "Unë jam një pasqyrë si oqeani". Pikërisht në të njëjtën mënyrë, ndodhen shkallë në rangjet e Evlijave -shenjtorëve- në përputhje me shumëllojshmërinë e manifestimeve të Emrave Hyjnorë, secili nga Emrat Hyjnorë ka manifestime si dielli në krahasim -duke filluar nga zemra dhe duke përfunduar tek Froni Hyjnor. Edhe zemra gjithashtu është një Fron, por ajo nuk mund të thotë: "Unë gjithashtu jam si Froni i madh Hyjnor".

[15] AL-Ajluni, Kafshal-khafa

Kështu, ata që ecin me ngurrim dhe me krenari e mburrje në vend të njohjes së pafuqisë së tyre, të varfërisë, gabimeve dhe të metave dhe rënies në sexhde me përgjërim përpara Divanit Hyjnor, e cila formon bazën e adhurimit, e mbajnë zemrën e tyre të vogël të barabartë me Fronin Hyjnor; ata i ngatërrojnë stacionet e tyre sa një pikë uji me stacionet si oqeanët të Evlijave të mëdhenj. Ata përkulen para artificializmit e vetëmburrjes me qëllim që t'i bëjnë vetet e tyre të përshtaten për ato rangje të larta dhe u shkaktojnë vetveteve të tyre shumë vështirësi.

Shkurtazi

Ndodhet një hadith i cili thotë:

هَلَكَ ٱلنَّاسُ إِلَّا ٱلْعَالِمُونَ وَهَلَكَ ٱلْعَالِمُونَ إِلَّا ٱلْعَامِلُونَ وَهَلَكَ ٱلْعَامِلُونَ

إِلَّا ٱلْمُخْلِصُونَ وَٱلْمُخْلِصُونَ عَلَىٰ خَطَرٍ عَظِيمٍ

"Të gjithë do të shkatërrohen përveç të diturve; dhe të diturit do të shkatërrohen përveç atyre që punojnë; edhe vepruesit do të shkatërrohen përveç të sinqertëve dhe të sinqertët janë në një rrezik të madh". Domethënë, boshti i vetëm i shpëtimit dhe i çlirimit është sinqeriteti. Atëherë të fituarit e sinqeritetit është nga rëndësitë më të mëdhaja. Veprimi më i vogël i kryer me sinqeritet është më i preferueshëm se sa tonelata prej akteve të kryera pa sinqeritet. Një person duhet të mendojë se ajo që i jep sinqeritet në veprat e tij është bërja e tyre thjesht për shkak se ato janë një urdhër Hyjnor dhe rezultati i tyre është kënaqësia Hyjnore, dhe ai nuk duhet të ndërhyjë në çështjet që i përkasin Allahut.

Ka sinqeritet në çdo gjë. Madje një pikë nga dashuria e pastër dhe e sinqertë është më e lartë se tonelata prej dashurisë formale. Dikush e përshkroi këtë dashuri të sinqertë sa vijon:

وَمَا أَنَا بِٱلْبَاغِي عَلَى ٱلْحُبِّ رِشْوَةً ضَعِيفٌ هَوًى يُبْغَىٰ عَلَيْهِ ثَوَابُ

"*Unë nuk dua ryshfet, shpërblim për dashurinë, sepse dashuria që kërkon një çmim si shkëmbim është e dobët dhe jetëshkurtër".* Dashuria e sinqertë është përfshirë në natyrën njerëzore dhe në të gjitha nënat.

Mëshira, dhembshuria e nënave e manifeston këtë dashuri të sinqertë në kuptimin e saj të vërtetë. Dëshmia se nëpërmjet misterit të kësaj dhembshurie nënat nuk duan e nuk kërkojnë një shpërblim apo ryshfet si shkëmbim për të vegjëlit e tyre, është vetëflijimi i jetëve të tyre dhe madje i lumturisë së tyre të përjetshme për fëmijët, saqë ti e shikon pulën të sulmojë edhe qenin me qëllim që të shpëtojë zogjt e saj nga nofullat e tij -siç e ka dëshmuar këtë Husrevi- duke ditur se i gjithë kapitali i pulës është jeta e saj.

Çështja e Katërt

Njeriu nuk duhet t'i marrë mirësitë të cilat vijnë nëpërmjet duarve të shkaqeve të jashtme për llogari të atyre shkaqeve dhe mjeteve. Në qoftë se një shkak nuk posedon dëshirë, ashtu si një kafshë apo si pemët e bimët për shembull, atëherë ai e sjell mirësinë drejtëpërdrejtë për llogari të Allahut të Plotëfuqishëm. Ai thotë: ***Bismil-lah,*** *Me Emrin e Allahut* dhe nuk e merr prej atij shkaku veçse pasi të ketë përmendur Emrin e Zotit xh.sh.. Në qoftë se shkaku do të kishte dëshirë, ai duhet të thonte: "*Me Emrin e Zotit*", atëherë ti duhet ta marrësh atë, përndryshe ti nuk duhet ta marrësh atë veçse pasi ai të thotë: "*Bismil-lah*".

Sepse, përveç kuptimit të qartë të vërsetit,

وَلَا تَأْكُلُوا مِمَّا لَمْ يُذْكَرِ اسْمُ اللَّهِ عَلَيْهِ *"Mos hani (o besimtarë) nga ai (mish) mbi të cilin nuk është përmendur Emri i Allahut (kur është therrur kafsha)."*[16] një kuptim aludues i nënkuptuar është ky:

Mos hani nga një mirësi mbi të cilën nuk është përmendur Emri i Pronarit të saj të Vërtetë i Cili është Allahu ose në qoftë se ajo nuk të është dhënë me Emrin e Tij.

Meqenëse kjo është kështu, edhe ai i cili jep, duhet të thotë: ***Bismil-lah****, në Emrin e Zotit*, edhe ai që merr duhet të thotë ***Bismil-lah***. Në qoftë se ai që jep nuk thotë ***Bismil-lah***, ndërsa ti je në nevojë për ta marrë, atëherë thuaj ti ***Bismil-lah*** *-me Emrin e Zotit-*, por ngrije shikimin tënd lartë mbi kokën e dhënësit dhe shikoje Dorën e Mëshirës Hyjnore e cila ta dha ty atë mirësi, puthe atë dorë me falënderim dhe

[16] Kur'an, 6:121

merre prej Saj mirësinë. Domethënë, shikoje mirëbërësinë -dhuratën- nëpërmjet mirësisë dhe shikoje Dhuruesin e Vërtetë nëpërmjet dhuratës. Të mendosh në këtë mënyrë është falënderim. Atëherë, në qoftë se ti dëshiron, ktheje shikimin tënd dhe shiko shkakun dhe mjetin, dhe bëj dua për të mirë për të, dhe vlerësoje, meqenëse ajo mirësi erdhi nëpërmjet duarve të tij.

Ajo që i mashtron ata të cilët adhurojnë shkaqet e jashtme është: vlerësimi -shikimi- i njërës nga dy gjërat si shkak për tjetrën kur ato të dyja vijnë së bashku; dhe kjo është ajo që quhet "Bashkëshoqërim". Ata supozojnë se dy gjërat shkaktojnë njëra-tjetrën. Gjithashtu, meqenëse mosekzistenca e një gjëje bëhet shkak për mosqënien e një mirësie, ata supozojnë se ekzistenca e asaj gjëje është shkaku për ekzistencën e asaj mirësie; dhe ata fillojnë t'ia japin falënderimet e mirënjohjen asaj gjëje dhe kështu bien në gabim, sepse ekzistenca e një mirësie vjen nga premisa e kushte të shumta paraprake, kurse mosekzistenca e asaj mirësie ndodh vetëm nëpërmjet mosekzistencës së një kushti të vetëm.

Për shembull, dikush që nuk e hap kanalin e ujit për të vaditur një kopsht bëhet arsyeja dhe shkaku për tharjen e kopshtit dhe për mosekzistencën e mirësive që janë në të. Por ekzistenca e mirësive të atij kopshti kushtëzohet e varet nga qindra kushte të tjera përkrah punës së atij personi; madje të gjitha ato mirësi nuk vijnë në ekzistencë veçse nëpërmjet shkakut të vërtetë i cili është Fuqia dhe Dëshira Hyjnore.

Kupto nga kjo se sa i qartë është gabimi i kësaj sofistike dhe sa të gabuar janë ata të cilët adhurojnë shkaqet!

Po, bashkëshoqërimi është një gjë, ndërsa shkaku është gjë tjetër. Mirësia e cila të vjen ty dhe që u bashkëshoqërua me nijetin -qëllimin- e mirëbërësisë nga ndonjëri prej tyre për tek ti, shkaku i saj është Mëshira Hyjnore. Ndërsa ai person nuk ka veçse bashkëshoqërimin pa shkakun.

Po, në qoftë se ai person nuk do ta kishte bërë atë nijet për të ta dhënë ty mirësinë, nuk do të të kishte ardhur ty ajo mirësi; domethënë, mosekzistenca e nijetit të tij ishte shkaku i mosardhjes së mirësisë; por si rrjedhojë e rregullit të lartëpërmendur, dëshira për të dhuruar mirëbërësi, nuk mund të jetë kurrë shkaku i mirësisë, përkundrazi,

ndoshta mund të jetë thjesht një kusht i vetëm prej qindra kushteve të tjera.

Për shembull, disa prej studentëve të Risale-i Nurit -si Husrevi dhe Refeti...- të cilët kanë marrë mirësi nga Allahu i Plotëfuqishëm i kanë ngatërruar *Bashkëshoqërimin* me *shkakun* dhe kanë qenë më mirënjohës e mbivlerësues ndaj profesorit të tyre më shumë se sa duhet. Çështja është se Allahu i Plotëfuqishëm i bashkëshoqëroi dhe i vendosi së bashku mirësinë e përfitimit të tyre prej mësimeve të Kur'anit që u ishte dhuruar atyre me mirësinë udhëzuese të cilën Ai ia kishte dhuruar Profesorit të tyre; por çështja është thjesht *Bashkëshoqërim* dhe jo tjetër.

Ata thonë: "Në qoftë se profesori ynë nuk do të kishte ardhur këtu, ne nuk do ta kishim marrë këtë mësim imani, kështu instruksioni i tij është shkaku i përfitimit tonë". Unë do të thoja: "O vëllezërit e mi të dashur! Allahu i Plotëfuqishëm e ka bashkëshoqëruar mirësinë që ma ka dhënë me atë mirësi që ua ka dhënë juve". Atëherë shkaku i të dyja mirësive është mëshira Hyjnore. Ashtu si ju, unë një herë e ngatërrova *Bashkëshoqërimin* me *shkakun*, dhe ndjeva mirënjohje ndaj qindra studentëve të Risale-i Nurit me penat e tyre prej diamanti si ju. Unë thoja: "Në qoftë se nuk do të kishin qenë këta studentë, si do të kishte mundur një gjysëmanalfabet, si shembulli im, ta kishte përmbushur këtë shërbim?" Pastaj unë kuptova se pasi Allahu i Gjithëfuqishëm u dhuroi juve mirësinë e shenjtë të shkrimit të bukur, Ai më dhuroi mua suksesin në këtë shërbim të Kur'anit. Ai i bashkëshoqëroi të dyja; ata nuk ishin shkaku për njëra-tjetrën; prandaj unë nuk ju falënderoj ju, por ju përshëndes ju. Edhe ju gjithashtu bëni dua për mua që të kem sukses e bekim dhe më përshëndetni, në vend të qënies suaj mirënjohës ndaj meje".

Në këtë çështje ndodhet një peshore e hollë nëpërmjet të cilës njihen shkallët e pakujdesisë dhe të shirkut të fshehtë.

Çështja e Pestë

Ashtu siç është padrejtësi në qoftë se pasuria e komunitetit i jepet njeriut; ose në qoftë se një njeri do të fuste duart në kapitalet e lëna për mirëbërësi të cilat i përkasin komunitetit që do të bënte padrejtësi; po ashtu t'ia atribuosh udhëheqësit, profesorit ose udhëzuesit të një kombi rezultatet e punëve të atij komuniteti ose nderin e meritat që burojnë

nga kolektivi dhe vlerat e tij, do të ishte padrejtësi edhe ndaj komunitetit edhe ndaj udhëheqësit apo profesorit; sepse kjo do të ledhatonte egoizmin e tij dhe do ta shtynte atë për në vetëmburrje. Ndërsa duke qenë derëtari -portieri- për xhematin, ai e pandeh vetveten se është mbreti. Ai gjithashtu i bën padrejtësi vetvetes; madje ai hap rrugën për një lloj të të përshkruarit ortakë me Zotin në mënyrë të fshehtë.

Po, koloneli nuk mund t'i pretendojë plaçkat e luftës, fitoren dhe lavdinë që i përkasin një regjimenti i cili pushtoi një kështjellë të fortifikuar. Prandaj profesori dhe udhëheqësi shpirtëror nuk duhet të konsiderohen se janë burimi dhe origjina, por duhet të konsiderohen e shikohen vetëm si vende reflektimi e manifestimi. Për shembull, nxehtësia dhe drita të arrijnë ty nëpërmjet një pasqyre. Do të ishte marrëzi ta konsiderosh pasqyrën si të ishte burimi për ato të dyja dhe harron vetë diellin, dhe pastaj t'ia japësh rëndësinë tënde dhe mirënjohjen pasqyrës në vend të diellit!

Po, pasqyra duhet të ruhet, sepse ajo është vendi i manifestimit të atyre cilësive. Kështu shpirti i udhëzuesit dhe zemra e tij janë një pasqyrë; ajo është vendi për reflektimin e shkëlqimit që rrezaton nga Allahu i Plotëfuqishëm. Dhe kështu udhëzuesi -Murshidi- bëhet si mjet për reflektimin e atyre rrezatimeve tek ndjekësit e tij -muridat. Atij nuk duhet t'i atribuohet ndonjë stacion më i lartë për sa ka të bëjë me ato rrezatime- se sa qënia e tij thjesht një mjet. Madje ndonjëherë ndodh që një profesor të konsiderohet se është burimi, por nuk është as vendi i manifestimit, dhe as burimi. Ndjekësi supozon se shkëlqimet që ai merr për shkak të pastërtisë së sinqeritetit të tij ose të fuqisë së lidhjes së tij ose për shkak të përqëndrimit të tij tek shejhu -mësuesi- i tij, ose në rrugë të tjera -i supozon- t'i kenë ardhur nga pasqyra e shpirtit të udhëzuesit të tij. Ashtu si nëpërmjet mesmerizmit -magnetizmit, hipnotizmit- disa njerëz hapin një dritare për tek bota e shëmbëllesave duke vështruar me vëmendje në një pasqyrë, dhe shikojnë gjëra të çuditshme e të habitshme në pasqyrë, duke ditur se ato pamje nuk janë në pasqyrë por jashtë pasqyrës, sepse duke e përqendruar shikimin e tyre në pasqyrë, një dritare hapet në imagjinatat e tyre. Për këtë arsye, ndojëherë studenti i sinqertë mund të jetë më i përparuar se sa një Shejh -udhëzues- i mangët. Ai kthehet, e udhëzon Shejhun e vet dhe bëhet Shejhu i Shejhit - udhëzuesi i uzdhëzuesit.

●Shënimi i Katërmbëdhjetë

Kjo përbëhet nga katër Shenja të shkurtëra duke aluduar për Unitetin Hyjnor.

Shenja e Parë

O adhurues i shkaqeve! Ti shikon një pallat të modeluar me xhevahire të rrallë e të çuditshëm; disa nga xhevahiret e përdorur në ndërtimin e tij gjenden vetëm në Kinë; të tjerët në Andaluzi; të tjerët në Jemen; ndërsa të tjerët nuk gjenden askund veç Siberisë. Në qoftë se ti do të shikoje se ndërtesa plotësohet në mënyrën më të mirë dhe vijnë ato gurë të çmuar nga lindja, perëndimi, veriu dhe nga jugu në kohën më të shpejtë dhe me lehtësi të plotë dhe në të njëjtën ditë... a do të mbetej ndonjë dyshim tek ti se Ndërtuesi i atij Pallati e ka shtrirë Sundimin e Tij në të gjithë globin tokësor?

Kështu, çdo qënie a ndërtesë është pallat Hyjnor dhe sidomos njeriu; ai është më i bukuri i atyre pallateve dhe më i çuditshmi, sepse disa nga gurët e çmuar të këtij pallati të mrekullueshëm i quajtur njeri vijnë nga bota e shpirtërave; disa nga Bota e shëmbëllesave dhe nga Pllaka e Ruajtur, dhe të tjerët nga Bota e ajrit, nga bota e dritës dhe nga bota e elementeve. Ai gjithashtu është si një pallat i mrekullueshëm nevojat e të cilit shtrihen në përjetësi, shpresat e të cilit janë shpërndarë tek të gjitha zonat e qiejve e të tokës dhe i cili ka lidhje e hallka me të gjitha epokat e nivelet e dynjasë dhe të Ahiretit. O ti që e quan veten se je një njeri i vërtetë! Ti je një pallat shumë i çuditshëm dhe një ndërtesë shumë e mahnitshme.. Meqenëse natyra jote e vërtetë është kështu, atëherë Krijuesi yt nuk mund të jetë veçse Ai që ka kontroll të plotë e sundon me lehtësi absolute në dynja e në Ahiret si të ishin dy shtëpi, që drejton tokën dhe qiellin si të ishin dy fletë dhe që ka autoritet sundues mbi parapërjetësinë e paspërjetësinë, sikur ato të ishin e djeshmja dhe e nesërmja. Prandaj, nuk ka adhurues të vërtetë për njeriun, as vendstrehim dhe as shpëtimtar përveç Atij i cili sundon e drejton tokën e qiejt dhe që ka në dorë frerat e kësaj bote dhe të botës tjetër.

Shenja e Dytë

Ndodhen disa njerëz idiotë të cilët për shkak se nuk e njohin diellin, në qoftë se ata do ta shihnin atë në pasqyrë, fillojnë ta duan pasqyrën. Me pasion të fortë, ata përpiqen ta ruajnë pasqyrën me qëllim që dielli

brenda saj të mos humbasë. Sa herë që personi i marrë e kupton që dielli nuk vdes me vdekjen e pasqyrës dhe as nuk zhduket me thyerjen e saj, ai e kthen të gjithë dashurinë e tij tek dielli që është në qiell. Pastaj ai kupton se dielli i shikuar në pasqyrë nuk varet nga pasqyra, as ekzistenca e tij e vazhdueshme nuk varet nga ajo. Përkundrazi, vazhdimësia e shkëlqimit të gjallë të pasqyrës dhe rrezatimi i saj varen nga vazhdimësia e manifestimeve të diellit dhe të reflektimit të tij. Pra, qëndrueshmëria e pasqyrës varet nga qëndrueshmëria e diellit.

O Njeri! Zemra jote, identiteti yt dhe natyra jote janë një pasqyrë. Dashuria jote e fortë për pavdekshmëri në natyrën tënde dhe në zemër nuk duhet të jetë për pasqyrën, as për zemrën e natyrën tënde, por për manifestimin e të Qëndrueshmit të Vetëm të Gjithëlavdisë, manifestimi i të Cilit reflektohet në pasqyrë sipas kapacitetit të pasqyrës, sipas kapacitetit të çdo njeriu. Mirëpo për shkak të marrëzisë, është kthyer fytyra e asaj dashurie në vende të tjera. Meqenëse çështja është kështu, thuaj: *"O i Qëndrueshëm i Vetëm, Ti je i Qëndrueshmi i Vetëm"*. Domethënë, "Meqenëse Ti ekziston dhe Ti je i Qëndrueshëm, le të bëjë çfarë të dojë përkohshmëria e mosekzistenca, s'ka rëndësi fare, nuk shqetësohemi aspak!"

Shenja e Tretë

O Njeri! Gjendja më e çuditshme që Krijuesi i Gjithurtë ka vendosur në natyrën tënde është se ndonjëherë ti nuk mund të vendosesh në të gjithë botën; si dikush i ndrydhur e i mbytur në burg, ti kërkon një vend më të gjërë se sa ajo. Megjithatë ti mund të futesh në gjënë më të vockël, në një kujtesë, një moment, dhe të vendosësh në të zemrën dhe mendjen tënde të cilat nuk mund t'i përfshijë -nxë- dynjaja e gjërë, ato i nxë grimca e vockël. Ti endesh me ndjenjat dhe me emocionet e tua më të forta në atë moment të shkurtër në atë kujtesë të vockël.

Dhe Ai i dha natyrës tënde fuqi jolëndore dhe aftësi të holla që janë të tilla saqë në qoftë se disa prej tyre do të gëlltisnin dynjanë, ato nuk do të ngopeshin; dhe disa prej tyre nuk mund të mbajnë madje as edhe një grimcë të vogël brenda vetvetes. Ashtu si syri që nuk mund të mbajë një qime, megjithëse koka mund të mbajë gurë të rëndë, pesha të rënda, ato aftësi nuk mund të mbajnë as peshën e një qimeje, domethënë nuk mund ta mbajnë ndonjë gjendje të papërfillshme që

buron nga pakujdesia e çudhëzimi; madje ato ndonjëherë mund të shuhen e të vdesin.

Meqenëse është kështu, ji i kujdesshëm, ec me maturi, frikësohu nga mbytja! Mos u mbyt në një kafshatë, apo në një fjalë, apo në një farë, në një shkreptimë, në një shenjë, apo në një puthje. Mos i zhyt aftësitë e tua të shtrira, të cilat mund të gëlltisin dynjanë në gjëra të tilla, sepse ndodhen gjëra të cilat janë shumë të vogla që në një drejtim gëlltisin gjëra që janë shumë të mëdhaja.

Qielli së bashku me yjet e tij mund të hyjnë në një copë të vogël xhami dhe të mbyten. Dhe shumica e faqeve të veprave të tua dhe fletët e jetës tënde futen në aftësinë tënde të kujtesës -memories- aq të vogël sa një farë sinapi.

Gjithashtu ndodhen gjëra të vockëla të cilat gëlltisin gjëra kaq të mëdha dhe i nxënë ato.

Shenja e Katërt

O adhuruesi i dynjasë! Dynjaja të cilën ti e përfytyron të gjërë e të madhe, ajo nuk është veçse si një varr i ngushtë. Por meqenëse murret e asaj banese të ngushtë si varri janë prej xhami, ato reflektohen njëra brenda tjetrës dhe shtrihen aq shumë larg sa mund të shtrihet shikimi. Ndërsa duke qenë e ngushtë si varri, banesa jote shfaqet të jetë si një qytet i madh, sepse muri i djathtë dhe i majtë i asaj dynjaje të cilët përfaqësojnë të ardhmen- pavarësisht se ato të dy janë mosekzistues e mosqënës- ato të dy si pasqyra reflektohen njëri brenda tjetrit, duke hapur e zhvilluar krahët e kohës së tashme e cila është shumë e shkurtër dhe e ngushtë. Realiteti përzihet me imagjinatën, dhe e supozon dynjanë mosekzistuese si ekzistuese. Ashtu si duke u rrotulluar përqark me shpejtësi, një vijë shfaqet të jetë e gjërë si një sipërfaqe, ndonëse në realitet është një vijë e hollë, edhe bota jote gjithashtu është e ngushtë në realitet, por për shkak të pakujdesisë tënde, iluzioneve dhe imagjinatave, muret e saja janë zgjeruar e shtrirë. Në qoftë se i shtyrë nga një fatkeqësi që të ka rënë, ti do ta lëvizje kokën tënde, ti do ta përplasësh kokën tënde në mur, të cilin ti e supozove të jetë shumë larg. Kjo do t'i largonte iluzionet në kokën tënde dhe do të dëbonte gjumin tënd. Atëherë ti do të shikoje se dynjaja jote është më e ngushtë se sa varri, më e hollë se sa ura e Siratit; jeta

jote kalon më shpejt se sa vetëtima dhe derdhet më shpejt se sa çaja, vërshon më shpejt se sa lumi.

Meqenëse jeta e kësaj bote dhe jeta materiale dhe jeta shtazore janë kështu, atëherë shkundu e çlirohu nga kafshëria, flake kafshërinë, lëre prapa trupësinë, materialen, hyr në nivelin e jetës së zemrës dhe të shpirtit! Ti do të gjesh një sferë të jetës, një botë drite më të gjërë se sa dynjaja të cilën ti e imagjinon të jetë e gjërë. Çelësi për atë botë është ta bësh zemrën të shprehë fjalët e shenjta,

"La i lahe il-lAll-llah", "Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut", të cilat shprehin misteret e Unitetit Hyjnor dhe njohjen e Zotit xh.sh. dhe ta bësh shpirtin të punojë me to.

● **Shënimi i Pesëmbëdhjetë**

Kjo përbëhet nga tre çështje

Çështja e Parë

Ky është vërseti

فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ ۞ وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ

"Kësisoj kushdo që bën mirësi sa një thërrmijë qoftë, do ta shohë atë"[17], i cili tregon manifestimin më të plotë të Emrit Hyjnor ***El-Hafidhu***. Në qoftë se dëshiron provë për këtë të vërtetë të Kur'anit të gjithurtë, hidhe vështrimin tek faqet e librit të universit, i cili është shkruar mbi modelin dhe skicën e Librit të Qartë, që të shohësh manifestimin më të lartë të Emrit Hyjnor ***El-Hafidhu,*** *Ruajtësi* dhe shumë gjëra të ngjashme në shumë mënyra me të vërtetën më të lartë të këtij vërseti.

Për shembull, merr një grusht farëra prej pemëve të ndryshme, luleve dhe bimëve. Pastaj groposi farërat, të cilat janë si arka të vogla të atyre luleve të ndryshme, të pemëve dhe të bimëve, dhe vetë janë të ndryshme e të larmishme në errësirën e dheut të thjeshtë e të pajetë. Pastaj ujiti ato me ujë i cili s'ka peshore, nuk mund t'i dallojë gjërat dhe kudo që ta drejtosh derdhet e shkon. Pastaj kthehu tek ai në pranverë e cila është fusha e ringjalljes vjetore dhe shiko! Vështroje me

[17] Kur'an, 99:7-8

vëmendje se si meleku i rrufesë i fryn fyellit të tij në pranverë si Fryerja e Israfilit, duke bërë thirrje për shi dhe duke u dhënë lajme të gëzueshme farërave të groposura nën dhe për ringjalljen pas vdekjes; dhe ti do të shohësh se nën manifestimin e Emrit Hyjnor ***El-Hafidhu Ruajtësi***, ato farëra që u ngjasojnë njëra-tjetrës dhe janë të gjitha të përziera e të ngatërruara, u përshtaten në mënyrë të përkryer dhe pa gabim urdhërave krijuese që burojnë nga Krijuesi i Gjithurtë. Ato u binden e u përshtaten atyre urdhërave me aq saktësi saqë në rritjen e tyre shfaqen shkreptimat e plotësimit të urtësisë, të njohjes, dëshirës, qëllimit dhe të vetëdijes, sepse ti shikon se ato farëra të cilat që të gjitha u ngjasojnë njëra-tjetrës, ndahen dhe dallohen nga njëra-tjetra.

Për shembull, kjo farë e vockël është bërë pemë fiku; ajo ka filluar t'i shpërndajë mirësitë e Krijuesit të Gjithurtë mbi kokat e tyre. Ajo i shpërndan ato duke i shtrirë mbi ne me duart e saj. Dhe këto dy farëra të cilat në mënyrë të sipërfaqshme janë të njëjtat kanë prodhuar lulet e quajtura lulet e diellit dhe manushaqe tringjyrëshe. Dhe lule të shumta si këto e kanë zbukuruar vetveten për ne. Ato buzëqeshin në fytyrat tona, duke na bërë që t'i duam.. Ndërsa kjo lloj fare ka prodhuar fruta të mira; ato bëhen filiza dhe pastaj pemë. Duke na mprehur orekset tona me shijet e tyre të këndshme, me aromat dhe me format, ato na bëjnë ftesë për tek vetvetja e tyre. Ato vetflijojnë vetvetet për blerësit e tyre me qëllim që ato mund të ngrihen nga niveli i jetës bimore në atë të jetës shtazore. Dhe kështu me radhë, ju mund të bëni shembuj të mëtejshëm në të njëjtën mënyrë. Farërat e zhvilluara në një mënyrë të tillë sa që një grusht i vetëm prej tyre u bënë -me lejen e Krijuesit të tyre- një kopsht i mbushur me pemë të ndryshme dhe me lule. Shiko, a mund të vëresh ndonjë gabim apo defekt midis tyre. Ato demonstrojnë kuptimin e vërsetit,

فَارْجِعِ الْبَصَرَ هَلْ تَرَىٰ مِن فُطُورٍ

"Kthe pra shikimin përsëri! "A mund të shohësh ndonjë të çarë?"[18].

Nëpërmjet manifestimit dhe mirëbërësisë së Emrit Hyjnor ***El-Hafidhu*** secila nga farërat ruan dhe tregon pa ngatërresë apo defekt trashëgiminë e lënë nga prindi i saj dhe origjinat.

[18] Kur'an, 67:3

Kështu, ky është një tregues i sigurt se *Ruajtësi,* i Cili kryen këtë vepër të çuditshme, do të demonstrojë manifestimin më të madh të ruajtjes së Tij në ditën e Ringjalljes më të madhe dhe të Kijametit më të madh.

Po, manifestimi i ruajtjes i cili është i patëmeta dhe i padefekt deri në këtë shkallë në këto gjëra të papërfillshme e kalimtare është një provë vendimtare se aktet, veprat, fjalët dhe veprat e mira e të këqija të njeriut, mbajtësit të amanetit më të madh dhe kalifit të Zotit në tokë - vepra që kanë një efekt të përjetshëm dhe rëndësinë më të lartë- ruhen saktësisht dhe do t'i nënshtrohen llogarisë.

A mos vallë njeriu supozon se do të lihet në tekat e veta?

"A mendon njeriu që do të lihet i harruar".[19]

Ruajna Zot! Njeriu është i caktuar për përjetësi, për lumturi të përhershme ose për mjerim të vazhdueshëm. Atij do t'i bëhet thirrje për të dhënë llogari për të gjitha veprat e tij, të vogla e të mëdhaja, të shumta ose të pakta. Ai do të marrë ose shpërblim, ose dënim.

Kështu, ndodhen dëshmitarë të pallogaritshëm për manifestimin e Emrit Hyjnor ***El-Hafidhu,*** *Ruajtësi* dhe për të vërtetën e vërsetit të lartëpërmendur. Ato që kemi treguar në këtë çështje janë thjesht një pikë nga oqeani dhe një grimcë nga mali!

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që vetëm Ti je i Gjithëdituri, Gjithurti"[20]*.*

* * *

[19] Kur'an, 75:36
[20] Kur'an, 2:32

SHKREPTIMA E TETËMBËDHJETË

Kjo është botuar në Trajtesën *Sikkei Tasdiki Gajbi* dhe në koleksionin e shkreptimave.


* * *

SHKREPTIMA E NËNTËMBËDHJETË

TRAJTESA LIDHUR ME KURSIMIN

[Kjo trajtesë është rreth kursimit e mjaftueshmërisë dhe paralajmëron për të mos tepruar në shpenzime dhe për të mos prishur pa hesap]





Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Hani e pini, por mos shpërdoroni me prishje pa hesap (e me harxhime pa masë)".[1]

Ky vërset jep udhëzimin më të rëndësishëm dhe më të urtë në formën e urdhrit të prerë për të bërë kursime dhe në mënyrë të qartë ndalon nga prishja pa hesap dhe nga harxhimi i tepërt.

Kjo çështje përmban shtatë pika.

● **Pika e Parë**

Krijuesi Mëshirëplotë kërkon falënderime si shkëmbim për mirësitë që Ai i ka dhuruar njerëzimit, kurse harxhimi i tepërt është në kundërshtim me falënderimet dhe është fyerje ndaj mirësisë dhe shkakton humbje të madhe.

Kursimi tregon respekt ndaj mirësisë dhe është fitimprurës. Po, kursimi është edhe një lloj falënderimi dhe tregon respekt ndaj mëshirës Hyjnore e manifestuar në mirësitë, dhe është një shkak i sigurt vendimtar për bereqet.

[1] Kur'an, 7:31

Po kështu, kursimi është boshti i shëndetit të mirë për trupin ashtu si dieta.. dhe meqenëse ai e shpëton njeriun nga poshtërimi i asaj që në efekt është lypje, është shkaku i vetënderimit -i sedrës.. Ai gjithashtu është një mjet i fuqishëm për të përjetuar e ndjerë kënaqësinë që gjendet në mirësitë dhe të shijojë ëndjen në mirësitë të cilat në dukje nuk japin kënaqësi. Sa për shpenzimin e tepërt ose prishjen pa hesap, meqenëse është në kundërshtim me këto shembuj urtësie që u përmendën lart, pasojat e saj janë të rënda.

- **Pika e Dytë**

Krijuesi i Gjithurtë e krijoi trupin njerëzor në formën e një pallati të mrekullueshëm duke i ngjasuar një qyteti të mirësistemuar. Shqisa e të shijuarit në gojë është si një portier, ndërsa nervat dhe enët e gjakut si tela telefoni e telegrafi; ato janë mjete nëpërmjet të cilave shqisa e të shijuarit komunikon me stomakun, i cili është qendra e trupit, dhe e njofton atë për ushqimin që futet në gojë. Në qoftë se trupi dhe stomaku nuk e përdorin atë, ai thotë: "Ndal, ndalohet hyrja" dhe e nxjerr atë. Dhe ndonjëherë ushqimi është i dëmshëm dhe i hidhur si dhe jo i dobishëm për trupin, dhe ai e nxjerr, e vjell atë menjëherë.

Kështu meqenëse shqisa e të shijuarit në gojë kryen rolin e portierit -rojtarit- dhe stomaku është prijësi dhe sunduesi për sa ka të bëjë me administrimin, atëherë në qoftë se dhuratat që arrijnë në pallat ose në qytet dhe ato që i jepen sunduesit të pallatit kanë vlerën e njëqind lirave, vetëm vlera e pesë lirave i lejohet t'i jepet rojtarit dhe jo më shumë në formën e një bakshishi me qëllim që ai të mos bëhet mendjemadh, të mos harrojë detyrën e tij dhe të mos fusë në pallat çdo element turbullues e keqbërës i cili do t'i jepte bakshish më të madh. Duke u mbështetur mbi këtë mister, ne tani do të imagjinojmë dy kafshata, njëra përbëhet nga një lëndë ushqyese si djathi dhe veza, dhe kushton dyzet para, ndërsa kafshata tjetër është nga ëmbëlsirat më të zgjedhura. Para se të hynë në gojë nuk ka ndryshim midis dy kafshatave për sa ka të bëjë me trupin; pra ato janë të njëllojta. Kurse pasi të kalojnë poshtë gurmazit, ato përsëri janë njëlloj, të njëjta, lidhur me të ushqyerit e trupit. Madje, ndonjëherë djathi, i cili kushton dyzet para, është më ushqyes se sa kafshata tjetër. Atëherë vetëm lidhur me llastimin -përkëdheljen- e shqisës së të shijuarit në gojë, ka një ndryshim që nuk zgjat veçse gjysëm minuti. Ti mund të shikosh nga kjo se çfarë harxhimi i pakuptim e i dëmshëm do të ishte të shpenzosh

dhjetë qindarka në vend të një qindarke të vetme për hir të një gjysme minuti.

Atëherë, t'i japësh rojtarit një shpërblim nëntë herë më të madh se sa e meriton nga dhuratat që arrijnë për sundimtarin e pallatit, padyshim do ta çonte atë në mburrje e do ta bënte të korruptuar. Dhe si rrjedhojë, ai do të thonte:

"Unë jam sundimtari", dhe do të lejonte të hynte cilido që i jep atij bakshishin më të madh dhe kënaqësinë më të madhe, duke shkaktuar prishjen e rregullit atje dhe duke bërë të shpërthente revolucioni e të ndizej zjarri. Atëherë, ai do të detyrohej të bërtiste duke kërkuar ndihmë "Oh! Thirreni doktorin të ma shuajë këtë zjarr në stomakun tim dhe të më ulë temperaturën!"

Kështu, kursimi dhe mjaftueshmëria janë në harmoni me urtësinë Hyjnore; ato e trajtojnë shqisën e të shijuarit si një portier dhe e paguajnë atë sipas asaj detyre. Sa për harxhimin e tepërt, meqenëse ajo vepron në kundërshtim me urtësinë, ajo merr shpejt ndëshkim, e zemëron stomakun dhe e bën oreksin e vërtetë të humbasë. Duke prodhuar nga shumëllojshmëritë e panevojshme të ushqimit një oreks të rremë dhe artificial dhe shkakton mostretje dhe sëmundje.

- **Pika e Tretë**

Ne thamë në pikën e dytë se shqisa e të shijuarit luan rolin e një portieri. Po, ajo gjithashtu tek të pakujdesurit të cilët nuk kanë përparuar shpirtërisht dhe nuk kanë avancuar në rrugën e dhënies së falënderimeve dhe që nuk janë ngjitur në shkallët e saj, ajo është si një derëtare. Po, nuk duhet të zhytesh në harxhim të tepërt -si shpenzimi me një çmim dhjetë herë më të lartë vetëm për t'i dhënë kënaqësi ndjenjës së të shijuarit. Kurse shqisa e të shijuarit e atyre që janë vërtetë në rrugën e dhënies së falënderimeve, e atyre që kërkojnë realitetin, dhe e atyre që i afrohen asaj me zemrat e tyre, është si një mbikëqyrëse dhe inspektore në kuzhinat e mëshirës Hyjnore, ashtu siç është shpjeguar në krahasimin tek Fjala e Gjashtë. Detyra e saj është të njohë e të peshojë shumëllojshmëritë e mirësive Hyjnore me peshat e saj të vockëla e të shumta sa numri i ushqimeve, dhe për t'i dërguar trupit dhe stomakut lajmet rreth ushqimit në formën e falënderimeve.

Në këtë drejtim, shqisa e të shijuarit nuk shikon vetëm tek stomaku fizik; përkundrazi, meqenëse ajo shikon gjithashtu tek zemra, shpirti dhe mendja, ajo ka një pozitë dhe një rëndësi më të lartë se për detyrën e stomakut. Me kusht që të mos harxhojë tepër, të plotësojë detyrën e saj të falënderimeve dhe të njohë e të kapë shumëllojshmëritë e mirësive Hyjnore dhe, me kusht që të jetë e ligjshme dhe mos të çojë në poshtërim e lypje, ajo mund ta ndjekë kënaqësinë për vetveten. Në fakt ushqimi i shijshëm mund të preferohet me qëllim që ta përdorim gjuhën e cila mban shqisën e të shijuarit në dhënien e falënderimeve. Kjo ç'ka vijon është një shembull, nga kerametet e Shejh Gejlanit, iu shenjtëroftë sekreti i tij, që aludon për këtë të vërtetë.

Një djalë i vetëm i një gruaje të respektuar merrte mësim dhe edukim nga Shejh Gejlani (iu shenjtëroftë sekreti i tij). Një ditë gruaja e nderuar kishte shkuar në qelën -dhomëzën- e djalit të saj dhe kishte parë se ai nuk kishte asgjë për të ngrënë përveç një cope buke të thatë e të zezë. Kjo gjendje nxiti dhembshurinë e saj prej nëne dhe nga gjendja e tij i dobësuar për shkak të asketizmit të tij. Asaj i erdhi shumë keq për të dhe pastaj shkoi tek Gauth el-Aëdham me qëllim që t'i ankohej dhe e pa shejh Gejlanin që i ishte përveshur pulës së pjekur. Për shkak të shqetësimit të saj ajo i tha atij: O mësues, o Shejh! Djali im po vdes nga uria ndërsa ti po ha pula! Ndërkaq shehu i tha pulës. "Ngrihu, me leje të Zotit xh.sh." Menjëherë, kockat e pulës së pjekur u grumbulluan dhe u hodhën duke dalë jashtë enës si një pulë e gjallë. Kjo ngjarje është treguar me unanimitet nëpërmjet shumë kanaleve të besueshëm e të dokumentuara si një keramet i dikujt; kerametet e të cilit janë me famë botërore. Shejh Gejlani i tha asaj: "Kur djali yt ta arrijë këtë nivel, atëherë edhe ai gjithashtu mund të hajë pula". Kështu, kuptimi i fjalëve të Sheh Gejlanit është ky: Sa herë që shpirti i djalit tënd të sundojë trupin e tij dhe zemra të sundojë dëshirat e nefsit të tij dhe arsyeja të sundojë stomakun e tij dhe ai ta dëshirojë kënaqësinë për hir të dhënies së falënderimeve, atëherë ai mund të hajë gjëra të shijshme.

- **Pika e Katërt**

Në përputhje me hadithin, kuptimi i të cilit është: لَا يَعُولُ مَنِ اقْتَصَدَ *"Ai që është kursimtar nuk do të ketë vështirësi familjare lidhur me*

mjetet e jetesës"[2], nikoqiri dhe njeriu ekonomik nuk do të vuajnë shumë shqetësim e vështirësi në mbështetjen e familjes së tij.

Ndodhen prova të panumërta se rezultatet e kursimit janë, shtimi i bereqetit dhe themeli i jetesës së mirë. Për shembull, unë kam parë vetë dhe mund të them sipas dëshmisë së atyre që më kanë mbështetur në shërbimin tim dhe kanë mbajtur shoqëri me mua me sinqeritet se për shkak të kursimit, unë ndonjëherë kam parë një shtim të dhjetëfishtë bereqeti, po kështu kanë pasur edhe shokët e mi. Madje para nëntë vitesh[3] disa kryetarë fisesh të cilët ishin syrgjynosur në Burdur së bashku me mua ndërhynë për shkak të mendimit të tyre të mirë që kishin për mua që të më bënin të pranoja zeqatin e tyre me qëllim që të mos vuaja skamje dhe poshtërim nga mungesa e parave. Unë u thashë atyre kryetarëve të pasur:

"Megjithëse unë kam shumë pak para, unë jam kursimtar e nikoqir dhe i mësuar me mjaftueshmëri. Unë jam më i pasur se ju". Unë i refuzova ofertat e tyre të përsëritura e ngulmuese. Ia vlen të përmendet se dy vite më vonë disa nga ata që më kishin dhënë zeqatin e tyre ishin në borxh për shkak se nuk kishin qenë kursimtarë. Lavdi Zotit, qysh prej shtatë vitesh, nëpërmjet bereqetit duke rezultuar nga kursimi, ajo shumë e vogël (parash) ka qenë ende e mjaftueshme për mua; ajo nuk më ka poshtëruar, as nuk më ka detyruar të paraqes nevojat e mia tek njerëzit dhe as nuk më ka bërë të shmangem nga rruga ime e vetëmjaftueshmërisë dhe nga të qënurit i pavarur nga njerëzit, i cili është njëri nga parimet e jetës sime.

Ai që nuk është kursimtar, sigurisht do të poshtërohet e do të bie në varfëri dhe në efekt në lypje. Në këtë kohë, paraja që përdoret në harxhime të tepërta e në prishje pa hesap, është jashtëzakonisht e shtrenjtë, saqë ndonjëherë një njeri shet nderin e tij, sedrën e krenarinë dhe merr ryshfete për ta shtënë në dorë atë; madje ndonjëherë shiten edhe gjërat e shenjta të fesë, pastaj para ogurzeza merren si shkëmbim. Domethënë, artikuj materialë me vlerën e dhjetë kurushëve - qindarkave- lëndorë merren si shkëmbim e në llogari të qindra lirave prej kurushëve jolëndorë. Ndërsa në qoftë se njeriu është kursimtar dhe i ngushton e i kufizon nevojat e tij tek elementet e domosdoshëm, tek

[2] Transmetojnë Ahmedi nga Ibnu Mes'udi
[3] Domethënë në vitin 1926, Përkthyesi

gjërat kryesore, atëherë sipas kuptimit të aluduar e të nënkuptuar të vërsetit,

إِنَّ اللَّهَ هُوَ الرَّزَّاقُ ذُو الْقُوَّةِ الْمَتِينُ *"Vërtet që Allahu, Ai është pa dyshim Gjithëfurnizuesi, Zotëruesi i Fuqisë, i Përhershmi më i Fortë,"*[4] dhe sipas kuptimit të qartë të vërsetit,

وَمَا مِنْ دَابَّةٍ فِي الْأَرْضِ إِلَّا عَلَى اللَّهِ رِزْقُهَا *"Nuk ka krijesë të gjallë në tokë që të mos e ketë furnizimin e përshtatur nga Allahu...",*[5] ai do të gjejë një mënyrë të paparashikuar furnizimi të bollshëm për të jetuar, sepse këtë e garanton vërseti Kur'anor.

Po, ndodhen dy lloje furnizimi -rizku:

Lloji i parë është furnizimi i vërtetë tek i cili varet e kushtëzohet jeta e njeriut. Ashtu siç dekreton vërseti, ky furnizim garantohet nga Krijuesi. Për sa kohë që të mos ndërhyjë prirja e njeriut ndaj së keqes apo zgjedhja e keqe e tij, ai do ta gjejë këtë furnizim të domosdoshëm sido që të jenë rrethanat. Ai nuk do të detyrohet të sakrifikojë fenë e tij, as nderin e tij dhe as sedrën e tij.

Lloji i dytë është furnizimi metaforik. Me këtë, nëpërmjet keqpërdorimit, nevojat jo të domosdoshme bëhen si ato të domosdoshmet dhe si rezultat i sprovimit me fatkeqësinë e traditës, njerëzit bëhen të dhënë pas tyre dhe nuk mund t'i braktisin. Meqenëse ky furnizim nuk është i garantuar nga Furnizuesi, futja e tij në dorë është tepër i shtrenjtë -dhe sidomos në këtë kohë. Këto artikuj të pafrytshëm e orëzi futen në dorë para së gjithash duke sakrifikuar nderin e sedrën dhe duke pranuar poshtërimin dhe ndonjëherë duke u përkulur para asaj që në efekt është lypje, puthje e këmbëve të të ligëve dhe ndonjëherë duke sakrifikuar gjërat e shenjta të fesë të cilat janë drita e jetës së përhershme.

Gjithashtu, në këtë kohë varfërie e mundimi, dhimbja që përjetojnë ata me ndërgjegje në ankthin e urisë, dhimbjet që vuajnë nevojtarët, e prishin kënaqësinë e arritur nga paratë e fituara në rrugë të paligjshme.

[4] Kur'an, 51:58
[5] Kur'an, 11:6

Në kohë të çuditshme si këto, njeriu duhet të mjaftohet me minimumin e nevojshëm në mallrat e dyshimta, sepse sipas rregullit, إِنَّ الضَّرُورَةَ تُقَدَّرُ بِقَدْرِهَا *"Domosdoshmëria paracaktohet sipas shtrirjes (masës) së saj"*, kur je i detyruar, mund të merret nga mallrat e paligjshme masa e minimumit të nevojshëm, dhe jo më shumë. Dikush në nevojë të madhe mund të hajë mish të vdekur, por jo të mbushë e ngopë stomakun e tij; ai mund të hajë aq sa t'i mjaftojë për të mos vdekur. Gjithashtu, nuk hahet ushqimi me lakmi e grykësi në prani të njëqind njerëzve të cilët janë të uritur.

Tregimi që vijon tregon se kursimi është shkaku i dinjitetit dhe i shquarsisë:

Njëherë, Hatim Taijju, i cili ishte me famë botërore për bujarinë e tij, u dha dhurata me tepricë miqve të tij në një gosti të madhe. Pastaj ai doli për të shëtitur në shkretëtirë dhe pa një plak të varfër i cili mbante mbi shpinë një peshë të rëndë me dru dhe me shkurre me gjemba. Gjembat po çjerrnin lëkurën e tij dhe po e përgjaknin. Hatimi i tha atij: "Hatimi Taijju ka shtru një gosti të madhe dhe po jep dhurata të shumta. Shko edhe ti atje se ndoshta ti do të marrësh pesëqind kurush si shpërblim për peshën tënde me vlerë pesë kurush. Plaku kursimtar iu përgjigj: "Unë e ngrej dhe e mbaj këtë peshë me gjemba me vetënderimin tim e me krenari, unë nuk kam ndërmend të bëhem i obliguar e borxhli ndaj Hatim Taijjut".

Pastaj, Hatim Taijju u pyet një ditë: "A ke takuar ndokënd më bujar dhe me të shquar se sa ti?" Ai u përgjigj: "Plaku i moshuar të cilin e takova në shkretëtirë ishte më i shquar, më i lartësuar dhe më bujar se sa unë".

● **Pika e Pestë**

Nga Bujaria e Tij e plotë. Allahu i Plotëfuqishëm e bën një njeri të varfër të kuptojë kënaqësinë e mirësive të Tij ashtu siç i bën t'i kuptojnë të pasurit. Kështu, i varfëri e përjeton kënaqësinë dhe e ndjen njëlloj si mbreti. Në të vërtetë, kënaqësia që merr një njeri i varfër prej një cope buke të thatë të zezë për shkak të urisë dhe kursimit është më e madhe se kënaqësia që arrin një mbret apo një njeri i pasur nga ëmbëlsira e ngrënë me mërzitje dhe me mungesë oreksi që shkaktohet nga tepria e prishja pa hesap. Është vërtet për t'u çuditur se si disa

njerëz të shthurur e prishanikë guxojnë t'i akuzojnë kursimtarët e nikoqirët duke u thënë 'kurnacë', e 'koprracë'. Ruajna Zot! Kursimi është dinjitet dhe bujari ndërsa koprracia dhe poshtërsia janë fytyra e brendshme e një bujarie të sipërfaqshme të njerëzve të shthurur e prishanikë të cilët bëjnë harxhime të tepruara. Ndodhet një ngjarje që e mbështet këtë fakt i cili ndodhi në dhomën time në Isparta në vitin kur u shkrua kjo trajtesë. Ajo është siç vijon:

Njëri nga studentët e mi ngulmoi shumë që të pranoja dhuratën e tij prej mjalti që peshonte dy okka e gjysëm, gjë e cila ishte në kundërshtim me rregullin tim dhe me parimin e jetës sime. Sado që u përpoqa për t'ia shpjeguar domosdoshmërinë për t'iu përmbajtur parimit tim, ai nuk u bind. Unë u detyrova ta pranoj atë i detyruar me nijetin që të merrnin pjesë tre vëllezër me mua në dhomë dhe të hanin prej tij me kursim për tridhjetë ose dyzet ditë në muajt Shaëban e Ramazan me qëllim që ai që e solli si dhuratë të merrte sevab dhe ata të mos mbeteshin pa ndonjë ëmbëlsirë për ta ngrënë. Prandaj unë i porosita ata që ta pranonin dhuratën duke ditur se unë vetë kisha gjithashtu një okë mjalt. Megjithëse shokët e mi ishin të matur dhe e vlerësonin kursimin, por duke ia dhënë mjaltin njëri-tjetrit, duke ledhatuar ndjenjat e njëri-tjetrit dhe secili duke preferuar tjetrin mbi vetveten, gjë e cila nga një drejtim është si një cilësi e mirë, ata harruan rreth të qënurit kursimtarë. Për tre netë ata mbaruan dy okë e gjysëm mjalt. Duke u buzëqeshur unë u thashë:

"Nijeti im ishte që t'ju bëja ta provonit shijen e mjaltit tridhjetë ditë ose më shumë, por ju e harxhuat atë vetëm për tre ditë.. Ju pastë bërë mirë!" Ndërsa unë e kam përdorur okën time të mjaltit me kursim dhe e kam përdorur në ngrënie gjatë dy muajve Shaëban e Ramazan, përveç faktit se ai u bë -lavdi Zotit- shkak për një sevab të madh, pasi i dhashë secilit prej atyre vëllezërve nga një lugë prej tij në kohën e Iftarit në çdo mbrëmje. Ndoshta ata që e panë këtë sjelljen time menduan se ajo ishte koprraci ndërsa sjelljen e vëllezërve të mi në tri netë si dorëgjërësi. Por në fakt unë pashë se e fshehur nën atë koprraci të dukshme qëndronte një dinjitet i lartë, një shtim bereqeti e bollëk dhe një sevab i madh. Ndërsa nën atë dorëgjërësi e harxhim të tepruar -në qoftë se nuk do të ishin lënë- do të lindte diçka shumë më e ulët se sa koprracia, si lypja, të shikuarit e dorës së tjetrit me lakmi dhe pritja për të marrë gjëra të tjera si këto.

● **Pika e Gjashtë**

Ndodhet një ndryshim i madh ndërmjet kursimit dhe koprracisë. Ashtu si modestia që është prej cilësive të lavdërueshme dhe që në mënyrë të sipërfaqshme është e ngjashme por e ndryshme nga cilësia e keqe e servilizmit dhe, ashtu si dinjiteti që është një virtyt i lavdërueshëm dhe i ngjashëm në sipërfaqe por i ndryshëm nga cilësia e keqe e mendjemadhësisë, po ashtu kursimi, i cili ishte njëri nga cilësitë e lartësuara të Profetit a.s.m., madje njëri nga boshtet mbi të cilin rrotullohet rregulli i urtësisë Hyjnore që mbisundon në univers, nuk ka asnjë lidhje me koprracinë e cila është një përzierje prej poshtërsisë, lakmisë, kurnacërisë dhe makutërisë. Ndodhet vetëm një përngjasim i sipërfaqshëm. Kjo që vijon është një ngjarje që e mbështet këtë fakt:

"Abdull-llah Ibn Umer i cili ishte njëri nga sahabët e shquar të Profetit a.s.m. dhe njëri nga '*Shtatë Abdull-llahët'* ishte më i madhi e më i rëndësishmi i kalifit Umer El-Faruku el-Adham, dhe njëri midis më të dalluarve e më të diturve të Sahabëve.

Një ditë ndërsa po tregtonte në pazar, me qëllim që të ishte kursimtar, të ruante mirëbesimin, pastërtinë dhe integritetin mbi të cilat varej tregtia, ai polemizoi me zemërim për diçka me vlerë pesë kurush, qindarka. Njëri nga Sahabët e pa dhe, duke imagjinuar emirin e besimtarëve, kalifin në tokë, se po grindet për pesë qindarka të ishte një akt koprracie i jashtëzakonshëm, e ndoqi atë për në shtëpinë e tij që të kuptonte diçka nga gjendjet e tij. Pastaj ai pa se Abdullahu kaloi ca kohë me një njeri të varfër tek dera dhe shkëmbeu fjalë me të me mirësjellje e dashuri; pastaj doli nga dera e dytë e shtëpisë dhe pa një njeri tjetër të varfër; ai bisedoi edhe me të për pak kohë; edhe njeriu i dytë i varfër u largua. Ndërkohë, sahabiu i nderuar, i cili po vështronte nga larg, u bë kureshtar të dinte për këtë çështje. Ai shkoi me nxitim tek të dy të varfërit dhe i pyeti: A nuk do të më thoni se çfarë bëri Ibnu Umer kur ndaloi për pak kohë me ju të dy? Të dy ata u përgjigjën:"Ai na dha ne të dyve nga një monedhë ari". Ai mendoi me vete dhe tha me habi, "Ja subhanall-llah!... Sa e çuditshme qenka: Si është e mundur që ai u grind në atë mënyrë për pesë qindarka në Pazar, dhe pastaj dha me shumicë si dhuratë dyqind kurush në shtëpinë e tij pa dijeninë e ndokujt?"

Ndërkaq, ai shkoi tek Abdullahu dhe i tha: "O imam! A do të ma zgjidhësh mua këtë vështirësi? Në treg ti veprove ashtu ndërsa në shtëpinë tënde ti veprove kështu". Abdullahu iu përgjigj duke i thënë:

"Në treg nuk ishte koprraci, por një sjellje që buronte nga kursimi; një veprim i tillë ishte krejtësisht i arsyeshëm; unë veprova ashtu për të ruajtur amanetin dhe ndershmërinë, të cilat janë bazat dhe shpirti i tregtisë. Ndërsa sjellja në shtëpinë time buroi nga dhembshuria e zemrës dhe nga shpirtmadhësia e plotësia e shpirtit. As e para nuk ishte koprraci, as e dyta nuk ishte tepri -mospërmbajtje.

Duke aluduar për këtë, Imam Ebu Hanifeja tha:

لَا إِسْرَافَ فِي الْخَيْرِ كَمَا لَا خَيْرَ فِي الْإِسْرَافِ *"Nuk mund të ketë tepri në mirësi ashtu siç nuk ka mirësi në tepri"*. Domethënë, ashtu siç nuk ka tepri - harxhime të tepërta- në veprat e mira e në mirëbërësi për atë që e meriton, po ashtu nuk ka absolutisht asnjë të mirë në prishjen pa hesap e në mospërmbajtje.

●Pika e Shtatë

Tepria dhe prishja pa hesap çojnë në lakmi dhe lakmia ka tri pasoja:

E Para: është pakënaqësia, mungesa e mjaftueshmërisë. Kjo pakënaqësi shkatërron përpjekjen dhe entuziazmin për punë dhe e bën personin e pakënaqur, me mungesë mjaftueshmërie, që të ankohet në vend të dhënies së falënderimeve dhe e bën atë dembel. Një njeri i tillë i braktis pasuritë të cilat ndonëse të pakta në numër janë hallall -të ligjshme[6]- dhe kërkon pasuri të cilat janë të paligjshme e pamundim. Dhe Ai sakrifikon sedrën e tij në këtë rrugë, madje edhe nderin e tij.

Pasoja e dytë e lakmisë është zhgënjimi dhe humbja. Njeriu lakmitar e prish -e humbet- atë që ai dëshiron, gjendet i papëlqyer, i mërzitur dhe privohet nga ndihma e përkrahja. Madje për të bëhet

[6]Konsumatorët shtohen dhe prodhuesit pakësohen si rrjedhojë e harxhimit të tepruar dhe mungesës së kursimit. Gjithësecili i fikson sytë tek dera e qeverisë. Atëherë industria, tregtia dhe bujqësia mbi të cilat varet jeta shoqërore ulen e pakësohen. Dhe kombi bie dhe varfërohet.

realitet thënia: اَلْحَرِيصُ خَائِبٌ خَاسِرٌ *"Njeriu lakmitar është i pasuksesshëm dhe pëson humbje".*

Lakmia dhe kënaqësia -mjaftueshmëria- kanë efektet e tyre në botën e gjallesave në përputhje me një ligj të shtrirë e të gjithanshëm. Për shembull, mjaftueshmëria e natyrshme e pemëve dhe e bimëve të nevojshme për furnizim -ushqim- e bën ushqimin e tyre të nxitojë për tek ato; kjo tregon dobitë e mëdha të mjaftueshmërisë -kënaqësisë. Ndërsa kafshët duke rendur pas ushqimit të tyre me lakmi, me vështirësi e me mangësi, kjo demonstron humbjen e madhe të lakmisë.

Gjithashtu mjaftueshmëria e dukshme nëpërmjet gjuhëve të prirjeve të tyre të natyrshme të të gjithë të vegjëlve të dobët dhe ushqimi i këndshëm si qumështi duke vërshuar për ta nga vende të paparashikuara, ndërsa kafshët e egra duke sulmuar me lakmi ushqimin e tyre të mangët e të ndotur, e provojnë pretendimin tonë në mënyrën më të qartë.

Gjithashtu, qëndrimi i mjaftueshëm, i kënaqur, i peshqive të dhjamuar, të trashë e jo të zgjuar për arritjen e ushqimeve tek ato në mënyrë të plotë, kurse kafshët e zgjuara si dhelprat e majmunët duke qëndruar të dobëta e shëndetliga për shkak se ato nuk mund të gjejnë ushqim të mjaftueshëm, megjithëse ato e ndjekin atë me lakmi, përsëri tregon se deri në çfarë shkalle është lakmia shkaku i vështirësisë, ndërsa mjaftueshmëria -kënaqësia- është shkaku i lehtësisë. Ashtu si ushqimi i siguruar nga ana e çifutëve nëpërmjet rrugëve të paligjshme dhe i përzier me poshtërimin dhe mjerimin e tyre për shkak të lakmisë së tyre, të marrjes me kamatë dhe për shkak të dredhive e mashtrimeve të tyre dhe, qëndrimi i mjaftueshëm dhe i kënaqur i nomadëve dhe të jetuarit e tyre me dinjitet dhe duke gjetur ushqim të mjaftueshëm, e provon edhe më shumë në mënyrë vendimtare atë që ne themi.

Gjithashtu, shumë dijetarë e figura letrare duke rënë në varfëri për shkak të lakmisë së tyre që buron nga inteligjenca e tyre, dhe se shumë njerëz të trashë e të paaftë duke u bërë të pasur nëpërmjet mjaftueshmërisë së tyre të bashkëlindur, provon prerazi se ushqimi hallall -i lejuar- vjen nëpërmjet pafuqisë dhe nevojës dhe jo nëpërmjet aftësisë dhe vullnetit. Madje ushqimi hallall është në raport të kundërt me aftësinë, dëshirën e zgjedhjes; sepse sa më shumë të shtohet aftësia

dhe zgjedhja e fëmijëve, aq më shumë pakësohet ushqimi i tyre dhe largohet e vështirësohet arritja për tek ai.

Në përputhje me hadithin profetik: اَلْقَنَاعَةُ كَنْزٌ لَا يَفْنَى *"Mjaftueshmëria (kënaqësia) është një thesar i pashtershëm*[7], kënaqësia është një thesar për një jetë të mirë dhe për rehati në jetë, ndërsa lakmia është minerali i humbjes dhe i poshtërimit."

Pasoja e Tretë: Lakmia shkatërron sinqeritetin dhe dëmton veprat që lidhen me Ahiretin, sepse në qoftë se një njeri i devotshëm do të vuante nga lakmia, ai do të dëshironte vlerësimin e njerëzve. Dhe ai që konsideron vlerësimin e të tjerëve, nuk mund të ketë sinqeritet të plotë. Kjo pasojë është shumë e rëndësishme dhe e denjë për t'u vërejtur.

*Shkurtazi***:** Harxhimi i tepërt dhe prishja pa hesap çojnë në mungesë kënaqësie, në mungesë mjaftueshmërie, pakënaqësia shkatërron entuziazmin për punë, shkakton dembeli, hap derën e ankesës për jetën dhe e bën njeriun e pakënaqur të ankohet vazhdimisht[8]. Gjithashtu mungesa e mjaftueshmërisë shkatërron vetënderimin -sedrën, dinjitetin dhe i tregon atij rrugën e lypsarisë.

---

[7] Veziri i Persisë Shah Nushirvan, i drejti dhe i urti, pyeti Bozorgmehrin: Përse shikohen dijetarët nëpër dyert e sundimtarëve dhe nuk shikohen sundimtarët tek dyert e dijetarëve, në një kohë që dija është më e lartë se sa sundimi?" Ai u përgjigj: "Për shkak të diturisë së dijetarëve dhe të injorancës së sundimtarëve. Domethënë, sundimtarët nuk dinë vlerën e dijes dhe prandaj nuk vijnë tek dyert e dijetarëve që ta kërkojnë atë, kurse dijetarët e dinë vlerën e saj tek dyert e sundimtarëve!

Kësaj përgjigjje të hollë, elegante e komike, për lakminë e dijetarëve që buron nga zgjuarsia e tyre duke i çuar ata në poshtërim e në varfëri, Bozorgmehri iu përgjigj në një mënyrë të përsosur.

Nënshkroi **Husrevi**

Një ngjarje që e mbështet këtë: Në Francë, një autorizim lypësi u jepet figurave letrare për shkak se ata ishin mjeshtër, njohës të lypjes. Nënshkroi:

Sulejman Rushtu

[7] Në të vërtetë, sa herë që takohesh me një njeri prishanik e të papërmbajtur, ti dëgjon ankesa. S'ka rëndësi se sa i pasur është; gjuha e tij përsëri ankohet. Ndërsa kur ti takon personin më të varfër por të kënaqur (të vetëmjaftueshëm), ti dëgjon vetëm falënderime.

Sa për kursimin dhe ekonominë, këto sjellin kënaqësi, vetëmjaftueshmëri. Sipas Hadithit, عَزَّ مَنْ قَنَعَ وَذَلَّ مَنْ طَمَعَ *"Personi i kënaqur (që ka mjaftueshmëri) është i respektuar, ndërsa personi lakmitar është i përbuzur",* një pasojë e vetëmjaftueshmërisë është sedra -vetënderimi. Ajo gjithashtu nxit përpjekjen dhe punën. Ajo shton entuziazmin dhe nxit për të vepruar. Për shembull, një njeri punoi për një ditë. Për shkak të kënaqësisë së tij -vetëmjaftueshmërisë, me pagën e vogël që mori në mbrëmje, ai punoi përsëri në ditën e dytë. Kurse për shkak se personi prishanik dhe i papërmbajtur nuk ishte i vetëmjaftueshëm, ai nuk punoi përsëri në ditën vijuese. Ose në qoftë se ai do të punonte, do të punonte pa entuziazëm.

Gjithashtu, vetëmjaftueshmëria që buron nga kursimi hap derën e falënderimeve dhe mbyll derën e ankesës. Gjatë gjithë jetës së tij, njeriu i vetëmjaftueshëm është mirënjohës. Dhe përderisa ai është i pavarur nga të tjerët nëpërmjet vetëmjaftueshmërisë së tij, ai nuk kërkon vlerësimin e njerëzve. Dera e sinqeritetit hapet dhe dera e hipokrizisë mbyllet.

Unë kam vërejtur dëme të mëdha e pasoja të rënda të cilat shkaktohen nga harxhimi i tepërt dhe nga mospërdorimi i kursimit; Unë i kam vëzhguar ato të trupëzuara në një shkallë të gjërë e të shtrirë siç vijon:

Para nëntë vitesh, unë vizitova një qytet të bekuar. Meqenëse ishte stinë dimri, unë nuk munda t'i shihja burimet e pasurisë dhe aspektet e prodhimit të atij qyteti.

Disa herë, myftiu i qytetit, Zoti e mëshiroftë, më tha, "Njerëzit tonë këtu janë të varfër", këto fjalë më prekën. Për pesë ose gjashtë vite, unë ndjeva keqardhje për njerëzit e qytetit. Tetë vite më vonë në stinën e verës, unë përsëri e vizitova qytetin. Hodha vështrimin tek kopshtet e tij dhe m'u kujtuan fjalët e myftiut të ndjerë. Unë thashë me habi, "Ja subhanall-llah! Prodhimet e këtyre kopshteve janë shumë më të larta se sa nevojat e qytetit. Njerëzit e tij duhet të jenë shumë të pasur". Unë mbeta shumë i habitur. Pastaj unë kuptova nëpërmjet të kujtuarit të një fakti i cili nuk më kishte mashtruar asnjëherë dhe është udhëzuesi për kuptimin e të vërtetave të tjera, se bereqeti e bollëku ishin zhdukur për shkak të harxhimit të tepërt dhe të prishjes pa hesap, saqë ndonëse

qyteti kishte burime të tilla pasurie, Myftiu i ndjerë më thonte: "Njerëzit tonë janë të varfër".

Po, ashtu si dhënia e zeqatit dhe qënia kursimtar dhe i përmbajtur që janë provuar me eksperimente se janë shkaku për shtimin e bereqetit dhe të begatisë në mirësi e në pasuri, po ashtu harxhimi i tepërt dhe mosdhënia e zeqatit janë shkaku për të ikur bereqeti e begatia.

Platoni i filozofëve muslimanë, shejhu i mjekëve dhe profesori i filozofëve, gjeniu i famshëm Ibnu Sina e shpjegoi vërsetin, كُلُوا وَاشْرَبُوا وَلَا تُسْرِفُوا "*Hani e pini, por mos shpërdoroni me prishje pa hesap"*[9] vetëm nga këndvështrimi i mjekësisë, siç vijon:

جَمَعْتُ الطِّبَ فِي الْبَيْتَيْنِ جَمْعًا وَحُسْنُ الْقَوْلِ فِي قَصْرِ الْكَلَامِ فَقَلِّلْ إِنْ أَكَلْتَ

وَبَعْدَ كُلِّ جَنَبْ وَالشِّفَاءُ فِي الْإِنْهِضَامِ وَلَيْسَ عَلَى النُّفُوسِ أَشَدُّ

حَالًا مِنْ إِدْخَالِ الطَّعَامِ عَلَى الطَّعَامِ

"Unë e përqëndrova -grupova- mjekësinë në dy vargje poezie,

Fjala më e mirë është ajo më e shkurtëra;

Kur ti të hash, ha pak, dhe jo të hash përsëri pas katër apo pesë orësh.

Shëndeti qëndron në tretje. Domethënë, ha aq sa mund ta tretësh me lehtësi.

Gjëja më e rëndë e më e lodhshme për stomakun tënd është të ngrënit e shumë gjërave njëra mbi tjetrën".[10]

[9] Kur'an, 7:31

[10] Domethënë gjëja më e dëmshme për trupin është mosdhënia atij një afat ndërmjet vakteve të ushqimit -pra një afat rreth 4-5 orë- ose mbushja e stomakut duke futur ushqim në mënyrë të pandërprerë për hir të ëndjes, shijes. Autori

Një koinçidencë e jashtëzakonshme dhe instruktive:

Në të gjitha kopjet e trajtesës rreth kursimit të shkruara nga pesë apo gjashtë shkrues -tre prej të cilëve ishin të papërvojë, në shkrim dhe ishin në vende të ndryshme të largëta nga njëri-tjetri, e shkruan atë prej kopjeve të ndryshme, dorëshkrimi i të cilëve ishte krejt i ndryshëm dhe të cilët nuk i morrën fare në konsideratë Elifat; Elifat të cilët përkuan e koinçiduan me numrin "pesëdhjetë e një" të çdo kopjeje -pa dua- ose të numrit pesëdhjetë e tre me dua.

Këto numra koinçidonin me datën në të cilën u shkrua e u kopjua trajtesa rreth kursimit, datë e cila ishte [13]51 sipas kalendarit diellor dhe [13]53 sipas kalendarit hënor, padyshim kjo nuk mund të jetë rastësi. Ajo është një tregues se bekimet e bereqetit që shkaktohen nga kursimi ngjiten deri në shkallën e kerametit, dhe se ky vit është i përshtatshëm të quhet "*Viti i kursimit*".

Po, ky keramet i kursimit u provua dy vite më vonë gjatë luftës së dytë Botërore, nga një uri e përhapur gjërë, nga një shkatërrim dhe nga një harxhim i tepruar, dhe njerëzimi dhe gjithësecili u detyruan të jenë të kursyer".

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që vetëm Ti i Gjithëdituri, i Gjithurti".[11]

* * *

[11] Kur'an, 2:32

SHKREPTIMA E NJËZET

SINQERITETI

[Ndërsa duke qenë e para prej pesë pikave të cilat formojnë të Dytën e shtatë çështjeve të Shkreptimës së Shtatëmbëdhjetë, kjo trajtesë u bë shkreptima e Njëzet për shkak të rëndësisë së saj.]

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

إِنَّا أَنزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ فَاعْبُدِ اللَّهَ مُخْلِصًا لَّهُ الدِّينَ ۝

أَلَا لِلَّهِ الدِّينُ الْخَالِصُ

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

Vërseti,

"Vërtet që Ne ta kemi zbritur Librin ty me të vërtetën, prandaj adhuroje Zotin me sinqeritet, sepse Zotit i takon feja e praktikuar me sinqeritet.",[1]

dhe thënia e profetit më të nderuar a.s.m.:

هَلَكَ النَّاسُ إِلَّا الْعَالِمُونَ وَهَلَكَ الْعَالِمُونَ إِلَّا الْعَامِلُونَ

[1] Kur'an, 39:2

وَهَلَكَ ٱلْعَامِلُونَ إِلَّا ٱلْمُخْلِصُونَ وَٱلْمُخْلِصُونَ عَلَىٰ خَطَرٍ عَظِيمٍ

"*Të gjithë njerëzit do të shkatërrohen me përjashtim të dijetarëve; dhe të gjithë dijetarët do të shkatërrohen, përveç atyre që veprojnë në përputhje me njohjen e tyre; dhe prej këtyre të gjithë do të shkatërrohen përveç të sinqertëve; madje edhe të sinqertit janë në rrezik të madh",*

Vërseti Kur'anor së bashku me hadithin profetik na tregojnë se sa parim i rëndësishëm i islamit është sinqeriteti. Nga shumë pika që kanë të bëjnë me sinqeritetin, ne do të shpjegojmë shkurtazi vetëm pesë.[2]

● **Pika e Parë**

Një pyetje e rëndësishme dhe që të shkakton dobi.

Përse ndodh që ndërsa njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj bote, të shkujdesurit dhe madje edhe të çudhëzuarit e hipokritët, të bashkëpunojnë pa rivalitet, kurse njerëzit e fesë, dijetarët fetarë dhe ata që ndjekin tarikatin Sufi e kundërshtojnë njëri-tjetrin me rivalitet, ndonëse këta janë njerëzit e së vërtetës dhe të bashkimit?

Në të vërtetë harmonia i përket popullit të pajtimit, ndërsa konflikti hipokritëve:

Si është që këto të dyja të kenë ndryshuar vendet, ku e vërteta u bë të qëndrojë përkrah këtyre, dhe e shtrembëra përbri atyre?

Përgjigjja: Ne do të parashtrojmë shtatë nga numri shumë i madh i shkaqeve, për këtë gjendje të dhimbshme, të turpshme dhe të tmerrshme, e cila i shkakton një njeriu me zell të qajë.

[2] *Shënim:* Ajo që të detyron të falënderosh Allahun për këtë krahinë të bekuar Ispartën, të cilës Ai i dhuroi një fat të madh, është se atje nuk shfaqet ndonjë polemikë e përzier me smirë midis të devotshmive, të atyre që ndjekin tarikatin Sufi dhe midis dijetarëve fetarë; madje edhe në qoftë se ajo do të shfaqej, ajo është shumë më e vogël në krahasim me krahinat e tjera. Dhe megjithëse dashuria e vërtetë dhe bashkimi nuk janë ashtu siç duhet, përsëri rivaliteti i dëmshëm dhe smira e urryer nuk ekzistojnë këtu në krahasim me vendet e tjera. Autori.

Shkaku i Parë

Ashtu si kundërshtimi ndërmjet njerëzve të së vërtetës që nuk buron nga mungesa e së vërtetës, po ashtu marrëveshja që sundon ndërmjet njerëzve të shkujdesjes nuk buron nga besimi i tyre tek e vërteta. Përkundrazi, detyrat e njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje, ato të politikës, dhe ato të atyre që kanë marrë edukim laik si dhe funksionet e të tjerëve si shembulli i këtyre në klasat e shoqërisë, janë paracaktuar e dalluar. Kështu detyrat dhe funksionet e grupeve të ndryshme, të shoqërive dhe të komuniteteve janë përcaktuar dhe janë bërë të dalluara nga njëra-tjetra.

Gjithashtu, shpërblimi material që ata marrin për detyrat e tyre me qëllim që të sigurojnë mjetet e jetesës, si dhe shpërblimi moral që qëndron në vëmendjen që ata marrin nga njerëzit për hir të ambicies së tyre dhe krenarisë e postit -edhe këto gjithashtu janë paracaktuar dhe vendosur[3]. Prandaj, nuk ndodhet asgjë që të shkaktojë përplasjet, kundërshtimet dhe rivalitetin. Sado e keqe të jetë rruga që ata ndjekin, përsëri ata janë të aftë të ruajnë bashkimin dhe pajtimin. Sa për njerëzit e fesë, dijetarët dhe ata që ndjekin tarikatin, detyra e gjithësecilit prej tyre ka të bëjë me të gjithë njerëzit, pra detyra orientohet e shikon tek të gjithë; shpërblimi i tyre i shpejtë material nuk është vendosur dhe nuk është përcaktuar; po ashtu, pjesa e tyre nga posti dhe rangu shoqëror, orientimi i njerëzve drejt tyre dhe mirëpritja gjithashtu, nuk janë paravendosur e paracaktuar. Shumë mund të jenë kandidatët dhe pretendentët për të njëjtin post; Shumë duar mund të shtrihen për cilindo shpërblim që ofrohet -jepet- qoftë moral apo material. Dhe që

[3] Dihet se të tërhequrit e njerëzve -për t'i bërë ata për vete- nuk mund të kërkohet, ajo vetëm dhurohet. Prandaj askush nuk duhet të gëzohet që njerëzit janë orientuar drejt tij, sepse kjo sjell humbjen e sinqeritetit dhe vendin do ta zinte hipokrizia. Në qoftë se të tërhequrit e njerëzve do të shoqërohej nga dëshira për famë e nderim, atëherë kjo nuk do të ishte më një shpërblim e çmim, por qortim dhe ndëshkim i rreptë për mungesë sinqeriteti.

Po, të tërhequrit e vëmendjes së njerëzve drejt tij dhe kërkimi i famës dhe i një nderimi të tillë, dëmton sinqeritetin, i cili është burimi i jetshmërisë, i forcës jetësore, për të gjitha veprat e mira; madje edhe në qoftë se ata dhurojnë një kënaqësi të vogël e cila vazhdon deri tek dera e varrit, mirëpo nga ana tjetër e asaj dere, matanë, asnjë njeri nuk duhet të dëshirojë të tërhequrit e vëmendjes së njerëzve për t'i bërë ata për vete, por t'ua mbathë këmbëve dhe të largohet shpejt prej saj. Prandaj ruhuni nga fama e nga pozita dhe mos vraponi pas tyre!

këtu buron përplasja dhe rivaliteti; harmonia shndërrohet në grindje dhe marrëveshja në mosmarrëveshje.

Tani ilaçi dhe mjekimi për këtë sëmundje të tmerrshme është sinqeriteti. Sinqeriteti mund të arrihet duke preferuar adhurimin e Zotit mbi adhurimin e nefsit, duke preferuar të vërtetën mbi egoizmin dhe nefsin, dhe kështu duke manifestuar kuptimin e vërsetit:

إِنْ أَجْرِيَ إِلَّا عَلَى اللَّهِ *"Sigurisht që shpërblimi im është vetëm prej Allahut",*[4] Duke hequr dorë nga shpërblimi material e moral që jepet nga njerëzit, duke shfaqur kështu kuptimin e[5] vërsetit,

وَمَا عَلَى الرَّسُولِ إِلَّا الْبَلَاغُ "*Detyra e të dërguarit është vetëm që të bëjë të njohur mesazhin"*[6]*,* dhe duke perceptuar se mirëpritja e fjalës së tij nga njerëzit, ndikimi i mirë i saj tek ata, lënia e përshtypjes së mirë, dhe tërheqja e vëmendjes së tyre për tek ai, kanë të bëjnë vetëm me mirësinë e Zotit ndaj tij, dhe ato nuk përfshihen brenda detyrës së tij e cila përkufizohet vetëm në dhënien e mesazhit; madje ato nuk janë të

[4] Kur'an, 11:29

[5]Shënim: Duhet gjithashtu që njeriu të marrë si udhëzuesin e tij cilësinë e "Të preferuarit e të tjerëve mbi vetveten", të njëjtën cilësi të Sahabëve të Profetit a.s.m. e cila vlerësohet në Kur'anin e shenjtë. Për shembull, kur jepet një dhuratë ose kur përmbushet një sadeka -akt bamirësie-, njeriu duhet gjithmonë të preferojë marrësit e tjerë mbi vetveten, dhe të mos pranojë ndonjë shpërblim material për shërbimet fetare, madje ai nuk duhet ta kërkojë atë shpërblim as edhe me zemër. Dhe në qoftë se do të fitonte diçka nga ky lloj, le ta konsiderojë atë thjesht një mirësi Hyjnore, duke mos mbetur nën obligimin e njerëzve. Asgjë materiale nuk duhet të kërkohet si shpërblim për shërbimin fetar, me qëllim që të mos humbasë sinqeriteti. Komuniteti edhe në qoftë se e ka për detyrë të garantojë jetesën e këtyre. Ashtu siç ata meritojnë edhe zeqat, veçse ama këta punonjës nuk duhet t'u kërkojnë gjë njerëzve; ndoshta ajo mund t'iu dhurohet atyre. Madje edhe në qoftë se atyre do t'u dhurohej ndonjë gjë, ata të mos e marrin atë si shpërblim për shërbimin e tyre ndaj fesë. Do të ishte mirë që njeriu të preferonte mbi vetveten të tjerët të cilët janë më të merituesheëm, të kishte kënaqësi të plotë me atë furnizim që i ka caktuar Zoti xh.sh; dhe të mjaftohej me të, duke manifestuar kështu kuptimin e vërsetit,

وَيُؤْثِرُونَ عَلَى أَنفُسِهِمْ وَلَوْ كَانَ بِهِمْ خَصَاصَةٌ *"Dhe i parapëlqejnë (të shpërngulurit) mbi veten e tyre, edhe pse ata vetë kishin nevojë për të"*, (Kur'an, 59:9) dhe atëherë njeriu do të mund të ishte i shpëtuar nga ky rrezik i tmerrshëm dhe do të fitonte sinqeritetin.

[6] Kur'an, 5:99

domosdoshme për të, dhe ai nuk është i urdhëruar për t'i fituar ato -dhe duke kuptuar këtë, njeriu do të ishte i suksesshëm në fitimin e sinqeritetit, ose përndryshe do t'i humbiste atij mirësia e madhe.

Shkaku i Dytë

Marrëveshja ndërmjet njerëzve të çudhëzimit buron nga poshtërimi i tyre, ndërsa kundërshtimi midis njerëzve të udhëzimit buron nga dinjiteti dhe nderi i tyre, sepse meqenëse njerëzit e dhënë vetëm pas dynjasë, njerëzit e çudhëzimit dhe të shkujdesurit nuk mbështeten tek e vërteta dhe realiteti, ata janë të dobët dhe të poshtëruar. Për shkak të poshtërimit të tyre, ata kanë nevojë të rrisin fuqinë e tyre, dhe për shkak të kësaj nevoje, ata e përqafojnë përzemërsisht ndihmën dhe bashkëpunimin e të tjerëve. Megjithëse rruga që ata ndjekin është çudhëzimi, përsëri ata e ruajnë pajtimin e tyre. Është sikur ata ta bënin pafesinë e tyre në formën e adhurimit të së vërtetës, çudhëzimin e tyre në formën e sinqeritetit, ateizmin e tyre në formën e solidaritetit dhe hipokrizinë e tyre në formën e pajtimit, dhe kështu arrijnë sukses. Sepse sinqeriteti i vërtetë, madje edhe për hir të së keqes, nuk mund të dështojë në arritjen e rezultateve, dhe çfarëdo që kërkon njeriu me sinqeritet, Zoti do t'ia jepte atij atë.[7]

Sa për njerëzit e udhëzimit e të fesë, dijetarët fetarë dhe ata të cilët ndjekin tarikatin Sufi, meqenëse ata mbështeten tek e vërteta dhe realiteti, dhe gjithësecili prej tyre në rrugën e së vërtetës mendon vetëm për kënaqësinë e Mbështetësit -Krijuesit- të tij dhe beson në ndihmën e Tij, ata gjejnë dinjitet shpirtëror e fisnikëri nga pikërisht rruga e tyre e besimit. Kur ata ndjejnë dobësi, ata nuk kthehen nga njerëzit, por drejtohen e mbështeten tek Zoti xh.sh. dhe i kërkojnë ndihmë Atij. Për shkak të ndryshimit në pikëpamje, ata nuk ndjejnë ndonjë nevojë reale për ndihmën e dikujt, pikëpamja e të cilit në dukje, e kundërshton atë të tyren, dhe nuk shikojnë nevojë për marrëveshje e unitet. Në të vërtetë, në qoftë se kokëfortësia dhe egoizmi janë të pranishme, njeriu do ta imagjinonte vetveten të jetë i drejtë ndërsa të tjerët që kanë pikëpamje

[7] Po, مَنْ طَلَبَ وَجَدَّ وَجَدَ *"kushdo që kërkon me seriozitet, do të gjejë"*, është një rregull i të vërtetës. Rrezja e tij është gjithëpërfshirëse dhe përfshin edhe çështjen tonë gjithashtu.

të ndryshme me ato të tijat, i imagjinon të jenë të gabuar; atëherë përçarja dhe rivaliteti marrin vendin e harmonisë dhe të dashurisë.

Kështu, sinqeriteti dëbohet, shporret, dhe funksioni i tij prishet.

Tani i vetmi mjekim për pasojat e rënda të kësaj gjendjeje të frikshme përbëhet nga nëntë urdhëresat vijuese:

1. Të vepruarit pozitivisht, domethënë, të vepruarit e njeriut vetëm sipas dashurisë së tij për rrugën e tij, duke e shmangur armiqësinë ndaj pikëpamjeve të tjera, duke mos i kritikuar ato, duke mos ndërhyrë në rrugët dhe dijet e tyre, domethënë, të mos ngatërrohet aspak me ta.

2. Të bashkuarit brenda islamit, pavarësisht nga pikëpamja e veçantë, dhe të kujtuarit e atyre lidhjeve të shumta të unitetit që ngjallin dashuri, vëllazëri e pajtim.

3. Të zbatuarit e parimit të drejtë të sjelljes që ndjekësit e çdo pikëpamje të drejtë kanë të drejtë të thonë, "Rruga, pikëpamja ime është e vërtetë, ose më e mira", por jo se "vetëm rruga ime është e vërtetë", as që, "Vetëm rruga ime është më e mirë", sepse kjo nënkupton shfuqizimin ose përgënjeshtrimin e të gjitha rrugëve dhe pikëpamjeve të tjera.

4. Marrja në konsideratë se bashkimi me njerëzit e të vërtetës është njëri nga shkaqet e ndihmës Hyjnore dhe njëri nga burimet e dinjitetit të lartë të fesë.

5. Ruajtja e drejtësisë dhe e të drejtës me krijimin e një personaliteti kolektiv, dhe kjo të realizohet duke u bashkuar me njerëzit e së vërtetës për të bërë qëndresë ndaj njerëzve të çudhëzimit dhe të së shtrembërës të cilët e mbrojnë me xhelozi dinakërinë e personalitetit të fuqishëm kolektiv të tyre që buron nga solidariteti i tyre; dhe pastaj të kuptuarit se çdo qëndresë individuale -sado e fuqishme të jetë- do të shpartallohej përballë atij personaliteti kolektiv të çudhëzimit.

6. Qëllimi që të mbrohet e vërteta nga sulmet e gënjeshtrës.

7. Braktisja e nefsit dhe e egoizmit të tij.

8. Heqja dorë nga koncepti i gabuar i vetëkrenarisë.

9. Braktisja e motiveve të smirës, rivalitetit dhe e ndjenjave të papërfillshme të nefsit.

Me këto nëntë pika, sinqeriteti do të ruhej dhe funksioni i tij do të përmbushej plotësisht.[8]

Shkaku i Tretë

Mosmarrëveshja ndërmjet njerëzve të së vërtetës nuk buron nga mungesa e zellit dhe e aspiratës, as bashkimi i njerëzve të çudhëzimit nuk buron nga lartësia e aspiratës. Ajo i nxit njerëzit e udhëzimit që ta keqpërdorin aspiratën e tyre të lartë, dhe si rrjedhojë të bien në mosmarrëveshje dhe rivalitet, është dëshira e tepruar për shpërblimin që lidhet me Ahiretin i cili, në vetvete, është e lavdërueshme dhe entuziazmi i papërmbajtur lidhur me detyrat që kanë të bëjnë me Ahiretin.

Duke menduar me vetveten, "Le ta fitoj unë këtë shpërblim, le t'i udhëzoj unë këta njerëz, le të më dëgjojnë ata mua", ai merr një qëndrim rivaliteti ndaj vëllait të vërtetë i cili ndodhet përballë tij dhe që është në një nevojë reale për dashurinë e tij, ndihmën, vëllazërinë dhe për përkrahjen. Duke thënë me vete, "përse të shkojnë nxënësit e mi tek ai? Përse të mos kem edhe unë aq shumë nxënës, aq sa ai?" Ai bie pre e egoizmit, anon nga sëmundja kronike e ambicies, humbet gjithë sinqeritetin dhe hap derën e hipokrizisë për veten e tij.

Ilaçi i këtij gabimi, i kësaj plage dhe i kësaj sëmundjeje të tmerrshme të shpirtit është parimi se, *"Kënaqësia e Zotit xh.sh. fitohet vetëm nëpërmjet sinqeritetit"*, dhe jo nëpërmjet pasjes së shumë ndjekësve apo sukses të madh. Sepse këto të fundit janë një funksion i Vullnetit të Zotit xh.sh. dhe i përkasin vetëm mirësisë dhe nderimit të Tij; ato nuk mund të kërkohen; përkundrazi, Zoti xh.sh. ia jep ato atij që do.

Po, ndonjëherë edhe një fjalë e vetme do të rezultonte në shpëtimin e ndokujt dhe, si rrjedhojë në kënaqësinë e Zotit xh.sh.. Sasisë nuk

[8] Madje vërtetohet në një hadith të saktë profetik se Muhammedi a.s.m. ka thënë: Në Fundin e botës besimtarët e vërtetë krishterë do të bashkohen me pasuesit e Kur'anit dhe do të luftojnë armikun e tyre të përbashkët, pafesinë. Gjithashtu në fundin e botës, njerëzit e fesë dhe të vërtetës do ta ndjejnë nevojën për t'u bashkuar me sinqeritet jo vetëm me vëllezërit e tyre, por edhe me besimtarët e vërtetë dhe shpirtërore kristianë, duke i ndërprerë përkohësisht debatet dhe polemikat për pikëpamjet e kundërta, me qëllim që të luftojnë armikun e përbashkët agresiv, ateizmin. Autori

duhet t'i kushtohet shumë vëmendje, sepse ndonjëherë të udhëzosh një njeri të vetëm për tek e vërteta mund të jetë aq e kënaqshme për Zotin aq sa të drejtoje një mijë njerëz. Për më tepër, sinqeriteti dhe bashkimi me të vërtetën kërkojnë që njeriu duhet të dëshirojë që muslimanët të përfitojnë nga njëri-tjetri, cilido që të jetë burimi i përfitimit dhe cilido të jetë personi nga i cili vjen ai përfitim.Të mendosh, duke thënë "Le t'i marrin ata mësimet prej meje me qëllim që unë të fitoj shpërblimin", kjo është dredhia e nefsit dhe mashtrimi i egos.

O Njeri lakmitar për shpërblimin në Ahiret dhe për kryerjen e veprave që të japin ty të drejtë për atë shpërblim! Dije se Zoti xh.sh. dërgoi shumë profetë të nderuar, por shumë pak njerëz u besuan atyre. Megjithatë ata morën shpërblimin e pafundmë të detyrës së shenjtë të profetësisë. Atëherë, arritja e vërtetë nuk qëndron në fitimin e një numri të madh ndjekësish, por në fitimin e kënaqësisë së Zotit xh.sh... Po kush je ti, o lakmitar, saqë dëshiron që të të dëgjojnë ty të gjithë njerëzit; ti po harron detyrën tënde, dhe po ndërhyn në atë që i përket plotësisht Fuqisë së Zotit xh.sh.. Bërja e njerëzve të besojnë fjalën tënde, mirëpritja e thirrjes tënde nga ana e tyre, dhe grumbullimi i tyre rreth teje, të gjitha këto janë vetëm nga mirësia e Zotit xh.sh. të cilat ia dhuron atij që dëshiron. Prandaj shiko detyrën tënde dhe atë që të takon ty, dhe mos u ngatërro me çështjet e Krijuesit. Për më tepër, dëgjimi i së vërtetës, i së drejtës si dhe marrja e shpërblimit prej tyre nuk kufizohet vetëm tek lloji njerëzor, por edhe tek krijesat e ndjeshme e tek shpirtërorët e Allahut, si engjëjt, të cilët e kanë mbushur dhe zbukuruar universin në çdo pjesë.

Në qoftë se ti dëshiron një shpërblim të bollshëm e të madh në Ahiret, merre sinqeritetin si parimin tënd themelor në punë dhe, me të, syno vetëm kënaqësinë e Zotit xh.sh.. Atëherë çdo rrokje nga fjalët e bekuara që dalin nga gjuha jote vjen në jetë dhe merr fuqi jetësore nga sinqeriteti yt dhe nga qëllimi i vërtetë.

Fjalët e shqiptuara arrijnë në veshët e shumë qënieve të ndryshme e të panumërta dhe i ndriçojnë ato krijesa, kurse ty të sjellin shpërblim. Sepse, për shembull, kur ti thua: ***El-Hamdu Lil-lah,*** *Lavdërimi e falënderimi i takon Zotit xh.sh.,* sapo ta shqiptosh atë, me urdhër të Zotit xh.sh., do të shkruhen në faqen e kozmosit me miliona nga këto Fjalë, pra shkruhen me miliona ***El-Hamdu Lil-lah***, të mëdha e të vogla në hapësirë.

Meqenëse Krijuesi i Gjithurtë nuk bëri asgjë me shkapërdarje, me çuarje dëm, dhe asgjë më kot, Ai krijoi vesh të panumërt, aq të shumtë aq sa ishte e nevojshme për t'i dëgjuar ato fjalë të shumta të bekuara. Në qoftë se ato fjalë vijnë në jetë në atmosferë nga sinqeriteti dhe nga qëllimi i vërtetë, ato do të futen në veshët e qënieve shpirtërore, ashtu si disa fruta të shijshëm në gojë. Por në qoftë se ato fjalë nuk sjellin në jetë kënaqësinë e Zotit xh.sh. dhe sinqeritetin, atëherë ato nuk do të dëgjohen. Kështu, shpërblimi varet nga ajo çfarë e si e shqiptoi gjuha.

Le ta dëgjojnë këtë lexuesit e Kur'anit, të cilët janë të dëshpëruar që zërat e tyre nuk janë më të bukur dhe që shumë njerëz nuk i dëgjojnë ata!

Shkaku i Katërt

Ashtu si rivaliteti dhe mosmarrëveshja midis njerëzve të udhëzimit që nuk buron nga dështimi për të parashikuar pasojat, as nga miopia -dritëshkurtësia-, po ashtu marrëveshja e përzemërt ndërmjet njerëzve të çudhëzimit nuk buron nga largpamësia apo nga lartësia e shikimit. Përkundrazi, njerëzit e udhëzimit, nëpërmjet ndikimit të së vërtetës dhe realitetit, nuk u dorëzohen emocioneve të verbëra të nefsit, por, në vend të tyre, ata ndjekin prirjet largpamëse të zemrës dhe të mendjes. Megjithatë, meqenëse dështojnë të ruajnë sensin e drejtimit të tyre dhe sinqeritetin e tyre, ata janë të paaftë të mbajnë rangun e tyre të lartë dhe bien në polemikë.

Sa për njerëzit e çudhëzimit nën ndikimin e nefsit dhe të tekave, dhe sundimit të ndijimit të shqisave, të cilat janë të verbëra ndaj të gjitha pasojave, dhe gjithmonë preferojnë një gram të kënaqësisë së çastit mbi një ton të kënaqësisë së të ardhmes, ata bashkohen me një pajtim të zellshëm për hir të një përfitimi të çastit dhe të një kënaqësie të momentit. Po, adhuruesit e ulët e zemërgurë të egos bashkohen dhe arrijnë marrëveshje midis tyre për kënaqësitë dhe përfitimet e menjëhershme të kësaj dynjaje.

Është e vërtetë se njerëzit e udhëzimit i kanë orientuar fytyrat e tyre drejt shpërblimeve të Ahiretit dhe drejt plotësimeve të tij, duke vepruar në përputhje me udhëzimet dhe porositë e larta morale të zemrës dhe të mendjes së shëndoshë, por meqenëse ata nuk e çlirojnë veten nga egoizmi, nga mendjemadhësia dhe ekstremizmi, humbasin një burim të

madh fuqie. Ky është bashkimi. Kështu ata lejojnë të cënohet sinqeriteti e, për pasojë, edhe misioni i tyre në lidhje me botën tjetër është i pasuksesshëm. Prandaj, kënaqësia e Zotit nuk arrihet lehtë.

Ilaçi dhe mjekimi i kësaj sëmundjeje të rëndë arrihet duke u ndier krenar si bashkudhëtar me ata që ecin në rrugën e vërtetë dhe të forcosh lidhjet dhe dashurinë në përputhje me parimin e shprehur në hadith: *"Dashuria të jetë për hir të Allahut"*; duke u shkuar atyre pas, duke ua lënë udhëheqjen, duke luftuar vetëpëlqimin, mendjemadhësinë dhe, duke e konsideruar çdo ndjekës të rrugës së Zotit xh.sh., cilido qoftë ai, më të mirë se sa vetveten. Kështu ti e frenon egon dhe fiton sinqeritetin. Shpëtimi prej asaj sëmundjeje arrihet, gjithashtu, kur e di se një gram nga veprat e mira që kryhen me sinqeritet është më i preferueshëm se sa një ton nga veprat që kryhen pa sinqeritet, dhe kur vlerëson statusin e ndjekësit mbi atë të drejtuesit, sepse marrja e përgjegjësive zor se mund të shpëtojë pa rreziqe. Kështu arrihet sinqeriteti dhe i kryen me përpikëri detyrat e përgatitjes për botën tjetër.

Shkaku i Pestë

Kundërshtimi dhe mosmarrëveshja midis njerëzve të udhëzimit nuk janë si pasojë e dobësisë. Po kështu bashkimi i fuqishëm i njerëzve të çudhëzimit nuk buron nga fuqia e tyre. Përkundrazi, mungesa e bashkimit të njerëzve të udhëzimit vjen nga fuqia që rezulton nga mbështetja e siguruar prej besimit të plotë. Dhe bashkimi i njerëzve të shkujdesjes dhe të çudhëzimit vjen nga dobësia dhe pafuqia që ata përjetojnë si rrjedhojë e mungesës së ndonjë mbështetjeje të brendshme për ta. Të dobëtit formojnë bashkim të fuqishëm pikërisht për shkak të nevojës së tyre për bashkim.[9]

Meqenëse të fuqishmit nuk ndjejnë nevojë për një bashkim të tillë, unionet e tyre janë të dobët. Luanët nuk ndjejnë nevojë për bashkim

[9] Ajo çfarë e mbështet këtë pretendimin tonë është se, "Organizata më e fuqishme dhe më efektive në Perëndim është ajo e të drejtave të gruas dhe e lirisë së saj, megjithëse gratë konsiderohen seks i butë dhe të brishta. Po kështu edhe organizatat armene, pavarësisht se janë të dobëta në krahasim me ato të popujve të tjerë, me fuqinë dhe vetëmohimin janë një provë tjetër që mbështet mendimin tonë. Autori

ashtu si dhelprat dhe prandaj ata jetojnë të veçuar si individë, kurse dhitë e egra formojnë kope për t'u mbrojtur nga ujqërit.

Komuniteti dhe personaliteti kolektiv i të dobtëve është i fortë, ndërsa komuniteti dhe personaliteti kolektiv i të fortëve është i dobët. Ndodhet një aluzion i hollë për këtë në Kur'an tek fjalët,

وَقَالَ نِسْوَةٌ فِي الْمَدِينَةِ "*Ndërsa gratë në qytet thanë*",[10]

Folja قَالَ *thanë* është e formës së gjinisë mashkullore [11], megjithëse duhet forma e gjinisë femërore për dy arsye: e para se *gra* është një emër femëror, dhe e dyta se shumësi i quajtur në arabisht *I thyer*, konsiderohet gjithmonë femëror. Por, në kontrast, shiko fjalët, قَالَتِ الْأَعْرَابُ *"Arabët e shkretëtirës thanë"*[12], folja قَالَتْ *thanë*, këtu është e gjinisë femërore, ndonëse kryefjala e saj përcakton një komunitet burrash. Këtu ndodhet një tregues i hollë se një shoqëri e dobët, e butë dhe delikate e përbërë nga gratë, mund të fitojë forcë e ashpërsi dhe madje një lloj burrërie.

Prandaj përdorimi i formës mashkullore tek folja وَقَالَ نِسْوَةٌ këtu është më e përshtatshme. Në kontrast, burrat e fuqishëm, sidomos beduinët arabë, besojnë në fuqinë e tyre (dhe jetojnë të ndarë): Shoqëritë e tyre janë të dobëta, për arsye se veçimi u jep atyre një pozitë butësie, dobësie e frike, sikur kjo u jep atyre një veçori femërie; prandaj përdorimi i formës femërore tek folja قَالَتِ الْأَعْرَابُ këtu është shumë i përshtatshëm. Gjithashtu, njerëzit e së vërtetës nënshtrohen dhe mbështeten në burimin e sigurt të mbështetjes, i cili është besimi në Zotin xh.sh; dhe që këtu ata nuk ua paraqesin nevojat e tyre të tjerëve, as nuk kërkojnë ndihmë e përkrahje nga ata. Në qoftë se ata ndonjëherë kishin nevojë për të tjerët, nuk i mbështesin interesat e tyre për hir të nevojës që kanë, por me çdo çmim ata u përmbahen parimeve të veta. Ndërsa njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje, meqenëse u

[10] Kur'an, 12:30
[11] arabishtja ka forma të veçanta për të dyja gjinitë - përkthyesi
[12] Kur'an, 49:14

mungon baza e vërtetë e mbështetjes, ata ndiejnë në vetveten e tyre - për shkak të pafuqisë dhe dobësisë së tyre- një nevojë të madhe për ndihmë, dhe si rrjedhojë ata formojnë një bashkim të tillë serioz sa që sakrifikojnë edhe vetveten.

Meqenëse njerëzit e së vërtetës nuk i japin rëndësi fuqisë së vërtetë që duhet të gjendet në bashkim, prandaj ata bien në polemika, si një pasojë e keqe dhe e dëmshme e këtij dështimi. Në kontrast, njerëzit e çudhëzimit dhe të gënjeshtrës e nuhasin fuqinë që gjendet në bashkim, në sajë të pikërisht dobësisë së tyre, dhe kështu fitojnë unionin, që është mjeti më i rëndësishëm për arritjen e qëllimeve.

Ilaçi dhe mjekimi për këtë sëmundje të përçarjes midis njerëzve të së vërtetës, është të marrë si parim ndalesën Hyjnore që përfshihet në këtë vërset,

وَلَا تَنَازَعُوا فَتَفْشَلُوا وَتَذْهَبَ رِيحُكُمْ *"Mos hyni në polemika me njëri-tjetrin, që të mos humbni kurajon dhe të mos ju lënë fuqitë"*[13] dhe, zbatimi i urdhrit Hyjnor lidhur me jetën sociale i përfshirë në këtë vërset,

وَتَعَاوَنُوا عَلَى الْبِرِّ وَالتَّقْوَىٰ *"Ndihmojeni njëri-tjetrin në mirësi e në përkushtimin ndaj fesë".*[14] Për më tepër, njeriu duhet të kuptojë se sa i dëmshëm është kundërshtimi për islamin, dhe si ai ndihmon njerëzit e çudhëzimit të triumfojnë mbi njerëzit e së vërtetës. Atëherë, përzemërsisht dhe me sakrificë bashkojuni karvanit të njerëzve të së vërtetës, me një ndjenjë që buron nga pafuqia e plotë dhe paaftësia.

Përfundimisht, njeriu duhet ta harrojë personin e tij, të braktisë hipokrizinë dhe pretendimin, dhe të kërkojë për të arritur tek sinqeriteti.

Shkaku i Gjashtë

Mosmarrëveshja midis njerëzve të së vërtetës nuk buron nga mungesa e burrërisë, e aspiratës dhe e zellit. Po kështu, bashkimi i përzemërt ndërmjet të çudhëzuarve, të shkujdesurve dhe të atyre që janë dhënë vetëm pas kësaj dynjaje lidhur me çështjet e tyre të kësaj

[13] Kur'an, 8:46
[14] Kur'an, 5:2

bote nuk buron nga burrëria, nga aspirata dhe nga zelli i tyre. Përkundrazi, njerëzit e së vërtetës, në përgjithësi, janë të interesuar e të lidhur me mirësitë dhe dobitë që përjetohen në botën tjetër, dhe që këtu drejtohen zelli i tyre, aspirata dhe burrëria tek ato çështje të rëndësishme e të shumta. Meqenëse ata nuk ia kushtojnë kohën -kapitalin e vërtetë të njeriut- një çështjeje të vetme të përcaktuar, atëherë bashkimi i tyre me shokët e tyre në rrugën e së vërtetës nuk do të bëhej kurrë i qëndrueshëm, sepse çështjet janë të shumta dhe fusha është shumë e gjërë.

Sa për të shkujdesurit dhe ata që janë të dhënë vetë pas kësaj dynjaje, dhe i përqafojnë fort interesat e jetës së kësaj bote me të gjitha shqisat e tyre, me shpirtin dhe zemrën e tyre, dhe kapen fort pas cilitdo që i ndihmon ata në përmbushjen e atyre interesave. Ashtu si një tregtar i çmendur i cili jep një çmim të lartë për një copë qelqi që nuk vlen pothuajse asgjë, ata ua kushtojnë kohën, e cila është më e larta në vlerë, atyre çështjeve të cilat në realitet dhe në pikëpamjen e njerëzve të së vërtetës nuk vlejnë asgjë. Duke paguar një çmim të tillë të lartë dhe duke e dhënë veten me përkushtimin e të gjitha shqisave, natyrisht kjo do të rezultonte në një sinqeritet të përzemërt që do të jepte sukses në çështjen që e kanë në dorë, dhe prandaj shpartallohen njerëzit e së vërtetës. Si pasojë e këtij shpartallimi, njerëzit e së vërtetës bien në një gjendje poshtërimi, përuljeje, hipokrizie dhe mburrjeje, dhe humbasin sinqeritetin. Dhe si rrjedhojë, njerëzit e së vërtetës janë të detyruar të lajkatohen e të përulen përpara një grushti njerëzish të këqinj e të ulët të dynjasë.

O njerëzit e së vërtetës! O njerëzit e Sheriatit, O njerëzit e Hakikatit -Realitetit- dhe o njerëzit e Tarikatit! O ju që e vlerësoni të vërtetën për hir të së vërtesës! Përpiquni ta largoni këtë sëmundje të tmerrshme, sëmundjen e kundërshtimit e të polemikës, mos i vini re të metat e njëri-tjetrit, i mbyllni sytë tuaj ndaj dobësive të njëri-tjetrit. Silluni në përputhje me parimin e mirësjelljes që është vendosur nga Kur'ani i mrekullueshëm në vërsetin,

وَإِذَا مَرُّوا بِاللَّغْوِ مَرُّوا كِرَامًا *"Dhe kur kalojnë pranë ndonjë loje të ligë e bisedë boshe, largohen prej saj me dinjitet e nder".*[15] Vlerësojeni atë si

[15] Kur'an, 25:72

detyrën tuaj themelore, pasi nga përmbushja e saj varet shpërblimi i juaj në botën tjetër. Shmangini grindjet e brendshme meqë po sulmoheni nga armiq të jashtëm, dhe kështu t'i mbroni njerëzit e së vërtetës nga poshtërimi dhe përulja! Praktikojeni me ngulm vëllazërinë, dashurinë dhe bashkimin që urdhërohen në qindra vërsete Kur'anore dhe në hadithe profetike. Themeloni me të gjitha fuqitë tuaja një bashkim të rinjsh dhe një vëllazëri në fe që të jetë më e fortë se sa unioni i njerëzve të dhënë vetëm pas dynjasë! Mos bini në kundërshtime! Askush prej jush të mos thotë: Në vend që ta shpenzoj kohën time të vlefshme në gjëra të tilla të vogla, le ta shpenzoj atë në gjëra më të vlefshme të tilla si lutjet dhe studimi", duke u tërhequr kështu nga sheshi e duke dobësuar njëherësh unitetin midis muslimanëve. Sepse pikërisht ajo që ti e imagjinon të jetë një çështje e një rëndësie të vogël në këtë xhihad moral -xhihad maënevi- mund të jetë, në fakt, shumë e madhe.

Ashtu si në disa rrethana të pazakonta e të veçanta, ku vrojtimi i një ushtari për çështje islame barazohet në shpërblim me një vit adhurimi -ibadeti- po ashtu në këtë periudhë kur njerëzit e së vërtetës janë dëmtuar keq, dita e vlefshme që ju shpenzoni për disa çështje të vogla në dukje që kanë të bëjnë me luftën morale, mund të jetë e vlefshme sa një mijë ditë, pikërisht ashtu si ora e atij ushtari në vendrojë.

Çfarëdo veprimi që ndërmerret për hir të Zotit xh.sh, nuk mund të ndahet në sasira të vogla apo të mëdha, të vlefshme apo të pavlefshme. Një akt sa një atom që kryhet me sinqeritet dhe për hir të kënaqësisë së Zotit xh.sh. bëhet e zmadhohet si një yll. Ajo që është e rëndësishme nuk është natyra e mjetit të përdorur, pra lloji i punës, por përfundimi që ai sjell. Meqenëse përfundimi është kënaqësia e Zotit xh.sh., dhe substanca e përdorur në punë, pra themeli i punës, është sinqeriteti, atëherë ajo nuk është çështje e vogël, por shumë e madhe.

Shkaku i Shtatë

Kundërshtimi dhe rivaliteti ndërmjet njerëzve të së vërtetës që buron nga xhelozia dhe lakmia për dynjanë; dhe anasjelltas unioni midis njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj bote dhe të shkujdesurve nuk buron nga bujaria dhe nga madhështia. Përkundrazi, njerëzit e së vërtetës nuk mundën ta ruanin plotësisht madhështinë dhe aspiratën e lartë që burojnë nga e vërteta, dhe as formën e lavdërueshme të

konkurrencës që ekziston në rrugën e Zotit xh.sh.. Me depërtimin e të padenjive prej tyre, ata pjesërisht e keqpërdorin atë formë të palavdërueshme konkurrenceje dhe bien në rivalitet e kundërshtim, duke dëmtuar rëndë si veten ashtu dhe komunitetin islam. Sa për njerëzit e shkujdesjes dhe të çudhëzimit, duke parë se ata kanë humbur burrërinë dhe zellin dhe për shkak të pafuqisë dhe poshtërimit të tyre, i shtrinë duart e ndihmës dhe formuan një bashkim të sinqertë me njerëzit, si do që të ishin ata, madje bien në ujdi edhe me të poshtërit, të urryerit dhe me më të pabesët midis njerëzve, me qëllim që të mos u humbasin përfitimet dhe interesat pas të cilave ata tërbohen; ata nuk i fyejnë drejtuesit dhe shokët që i adhurojnë për hir të interesit; prandaj ata bëjnë marrëveshje serioze me ortakët e tyre në çështje dhe bashkohen rreth atyre përfitimeve, në çdo formë që mund t'u sugjerohet nga interesat e tyre të përbashkëta. Dhe si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi të sinqertë, ata fitojnë dobitë dhe përfitimet e dëshiruara.

O njerëzit e së vërtetës që jeni përfshirë në kundërshtime dhe që jeni sprovuar me fatkeqësi për shkak të humbjes së sinqeritetit tuaj dhe dështimet për ta bërë kënaqësinë e Zotit xh.sh. synimin tuaj të vetëm në këtë jetë të fatkeqësisë, dhe u keni shkaktuar njerëzve të së vërtetës poshtërimin dhe humbjen. Në çështjet që lidhen me fenë dhe Ahiretin, nuk duhet të ketë rivalitet, smirë apo xhelozi; në këndvështrimin e realitetit, nuk ka në to si shembulli i këtyre gjërave. Sepse smira dhe xhelozia lindin atëherë kur disa duar shtrihen për të kapur një objekt të vetëm, atëherë kur disa sy fiksohen në një pikë të vetme, dhe kur shumë stomakë vriten për një copë bukë. Së pari, smira buron si pasojë e konfliktit, si pasojë e kundërshtimit dhe rivalitetit, dhe pastaj e xhelozisë. Meqenëse shumë njerëz dëshirojnë të njëjtën gjë, dhe meqenëse dynjaja është kalimtare, nuk mundet t'i kënaqë dëshirat e pakufishme të njeriut, njerëzit bëhen rivalë ndaj njëri-tjetrit.

Ndërsa në botën tjetër, në Ahiret, do t'i jepet një individi të vetëm pesëqind vjetë parajsë, dhe shtatëdhjetë mijë pallate dhe huri; dhe gjithësecili nga njerëzit e parajsës do të jetë plotësisht i kënaqur me pjesën e tij.[16]

[16] Një pyetje e rëndësishme që vjen nga një person i shquar:
Sipas hadithit të profetit Muhammed a.s.m., *"gjithësecilit në parajsë do t'i jepet pesëqind vjet"*, si mund ta kapë këtë të vërtetë aftësia jonë mendore?

Kështu pra është e qartë se nuk ka arsye për rivalitet në Botën tjetër, as nuk mund të ketë atje konkurrencë. Kjo na tregon ne se nuk ka smirë e grindje në veprat e mira që arrijnë në Ahiret. Domethënë, nuk ka vend për xhelozi këtu. Xhelozi i vetëm këtu ose është një hipokrit, i cili kërkon rezultatet materiale të kësaj bote nëpërmjet kryerjes së veprave të mira, ose një njeri i sinqertë por injorant, që duke mos kuptuar qëllimin e vërtetë të veprave të mira, dhe duke mos e kuptuar se sinqeriteti është shpirti dhe themeli i të gjitha veprave të mira, mbjell një lloj rivaliteti dhe armiqësie ndaj njerëzve të graduar nga Zoti xh.sh., ndaj shenjtorëve; ai në fakt po vë në dyshim gjërësinë e mëshirës së Allahut.

Do të përmend këtu një shembull i cili e mbështet këtë të vërtetë:

Përgjigjja: Ashtu si në këtë dynja, gjithësecili ka botën e tij private të përkohshme dhe të kufizuar, që shtylla e saj është jeta e tij, dhe kënaqet prej saj me çfarë të dojë me anë të shqisave të tij të jashtme e të brendshme, saqë ai madje mund të thotë: "Dielli është llamba ime, yjet janë qirinjtë e mi", dhe prania e krijesave të tjera dhe e qënieve të gjalla në asnjë mënyrë nuk e mohojnë të drejtën e kësaj pronësisë së tij, pasi këto gjëra ndrisin, shkëlqejnë dhe ndriçojnë botën e tij private. Po kështu në xhennet -megjithëse me një ndryshim shumë të madh- përveç kopshteve të secilit besimtar që përmbajnë mijëra pallate e huri, ai besimtar ka pesëqind vjet nga parajsa e përgjithshme. Ai do të përfitojë nga kjo parajsë dhe nga kjo përjetësi nëpërmjet shqisave dhe ndjenjave të tij, sipas shkallës së zhvillimit që ka arritur çdo besimtar. Prania e të tjerëve dhe shoqërimi i tyre me të, në parajsën e përgjithshme, nuk i pakësojnë mirësitë e tij, as shijet e tij dhe as të drejtën e pronësisë së tij; por përkundrazi, ata e gjallërojnë Xhennetin e tij të veçantë dhe e stolisin atë parajsë të gjërë. Ashtu siç kënaqet njeriu në dynja me gojën e tij, me veshin e tij, me syrin e tij, dhe me të gjitha shqisat dhe ndjenjat e tij për një orë në një kopsht, ose në një shëtitje, ose në një periudhë një mujore në një mbretëri, ose në një vit të jetës së tij kur kënaqet në një udhëtim, po kështu është në parajsë, por kënaqësia e shijes dhe e nuhatjes në atë mbretëri të përjetshme në një hapësirë kohore prej një viti të plotë, është si ajo e një oreje të vetme që kaloi njeriu në këtë jetë të përkohshme në një kopsht.

Shqisat e të parit dhe e të dëgjuarit kënaqen në atë mbretëri të përhershme nga njëri skaj në tjetrin, brenda një udhëtimi pesëqindvjeçar duke provuar kënaqësitë që i përshtaten përjetshmërisë së asaj bote; një kënaqësi e tillë prej atij udhëtimi pesëqindvjeçar është si kënaqësia që e provon njeriu brenda një udhëtimi që ai kalon gjatë një viti në këtë dynja.

Çdo besimtar do të përfitojë atje sipas rangut të tij shpirtëror, dhe do të fitojë gëzim e kënaqësi nëpërmjet shqiseve të tij të cilat do të shtrihen dhe zhvillohen në lidhje me shpërblimin që ai ka fituar në këtë dynja dhe me veprat e mira që ai ka kryer.

Njëri nga shokët e mi të mëparshëm kishte urrejtje e armiqësi ndaj një tjetri. Kur këtë të fundit e lavdëruan duke thënë për të: "Ai është burrë i drejtë, Ai është i pranuar tek Zoti xh.sh.", ne pamë se këto fjalë nuk i shkaktuan atij ndonjë xhelozi ndaj shokut të tij", pra lëvdata për kundërshtarin nuk e shqetësoi atë. Mirëpo kur dikush tha: "Ai armiku yt është i fuqishëm dhe trim", ne panë se, papritmas, tek ai u shfaq damari i xhelozisë dhe i rivalitetit. Ndërkohë ne i thamë atij:

"Shenjtëria, drejtësia dhe përkushtimi në fe sigurojnë pozitat më të larta në Ahiret dhe asgjë nuk mund të krahasohet me to; ku është toka me yjet -plejadat? Sa largësi ka ndërmjet tyre! Ne pamë se kur u përmend pozita për kundërshtarin tënd, ty s'të turbulloi, s'të bëri fare përshtypje; ndërsa kur u zu në gojë forca dhe trimëria e tij fizike që gjenden edhe tek demi midis kafshëve të egra, ti shfaqe shenjat e smirës dhe të xhelozisë". Burri ia ktheu: Në këtë botë, të dy i kemi fiksuar sytë tanë në një objekt të vetëm dhe fuqia, trimëria e veti të tjera të ngjashme me to janë mjetet më të rëndësishme që çojnë në arritjen e pikësynimeve të lidhura me këtë botë. Ishte pikërisht kjo arsyeja që unë u bëra xheloz. Ndërsa lidhur me banesat e botës tjetër dhe me pozitat e saja, ato janë të panumërta dhe atje ndoshta bëhet miku më i dashur e më i ngushtë ai që ka qenë armiku im".

O njerëzit e të vërtetës dhe të Sufizmit! Që t'i shërbesh të vërtetës nuk është kollaj dhe e lehtë, është si të ruash një peshë të madhe thesari. Ata të cilët e mbajnë atë amanet mbi shpatullat e tyre do të ishin të lumtur e mirënjohës sa herë që duar të fuqishme nxitojnë për të dhënë ndihmën e tyre në mbajtjen e tij.

Kështu, ata që afrohen, duhen pritur me dashuri të sinqertë. Fuqia, ndihma dhe efekti i tyre duhet të vlerësohen më shumë se sa personat e tyre dhe të takohen me respektin e përshtatshëm, pasi ata janë vëllezër të vërtetë sakrifikues. Meqenëse kjo është një detyrë e domosdoshme, atëherë pse i shikoni ata me syrin e rivalitetit dhe të smirës duke humbur kështu sinqeritetin? Ju, kështu do të zbuloheshit para akuzave të frikshme të njerëzve të çudhëzimit, dhe do t'ju vendosnin juve në një nivel shumë më të ulët se sa ky i rrugës që ndiqni, madje ju përqasin me ata që sigurojnë interesat materiale nëpërmjet fesë nën perden e dijes së vërtetë, ju karakterizojnë ju rivalë lakmues të dynjasë dhe me akuza të tjera të padrejta!

Për këtë sëmundje, ilaçi i vetëm është të dënosh nefsin tënd para se të tjerët të të akuzojnë dhe të mos mbash anën e tij; por të shokut. Sipas dijetarëve, arti i debatit është ky: "Kushdo që dëshion, në debatin mbi një çështje, që e vërteta të shfaqet nëpërmjet gjuhës së tij dhe jo nëpërmjet gjuhës së tjetrit, si dhe gëzohet e qetësohet që kundërshtari i tij është në gabim dhe jo në të drejtë, atëherë një person i tillë do të vepronte me padrejtësi". Jo vetëm kaq, por një person i tillë humbet, sepse kur ai shfaqet fitues në një debat të tillë, ai nuk ka mësuar ndonjë gjë të re, dhe krenaria e tij ndoshta do t'i shkaktojë humbje atij. Ndërsa, në qoftë se e vërteta do të shfaqej nga gjuha e kundërshtarit të tij, kjo nuk do ta dëmtonte atë dhe as nuk do t'i shkaktonte mendjemadhësi, veç do të mësonte një gjë të re. Domethënë, kërkuesi i së drejtës e frenon nefsin e tij për hir të së vërtetës. Edhe në qoftë se të drejtën e gjen te kundërshtari i tij, ai do ta pranonte me dëshirë dhe do ta mbështeste atë me gëzim.

Atëherë, në qoftë se njerëzit e fesë, njerëzit e së vërtetës, njerëzit e tarikatit sufi dhe njerëzit e dijes, do ta merrnin këtë parim si udhëzuesin e tyre, ata do të fitonin sinqeritetin, dhe do të ishin të suksesshëm në ato detyra që i përgatisin ata për Ahiretin. Nëpërmjet mëshirës së Zotit xh.sh., ata do të çlirohen nga kjo fatkeqësi dhe nga ky mjerim i tmerrshëm prej të cilave po vuajnë aktualisht.

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

"Lavdia të takon ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtet që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti.[17]

* * *

[17] Kur'an, 2:32

SHKREPTIMA E NJËZET E NJË

SINQERITETI

[Megjithëse në origjinë ishte e katërta e shtatë çështjeve të shënimit të shkreptimës së shtatëmbëdhjetë, por për shkak të lidhjes së saj me sinqeritetin, ajo u bë pika e dytë e shkreptimës së njëzet.

Më në fund, për shkak të karakterit të saj ndriçues, ajo u përfshi në koleksionin e Shkreptimave si Shkreptima e Njëzet e Një]

Kjo Shkreptimë duhet të lexohet të paktën njëherë në pesëmbëdhjetë ditë.



Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Mos hyni në polemika me njëri-tjetrin që të mos humbni kurajon dhe të mos ju lënë fuqitë".[1]

"Dhe qëndroni para Allahut me bindje e përkushtim (gjatë faljes)".[2]

[1] Kur'an, 8:46

"Vërtet që do të ngadhënjejë ai i cili e pastron vetveten".

"Dhe vërtet që dështon ai i cili e prish vetveten".[3]

"Dhe mos blini (fitoni) me Ajetet e mia çmim të ulët".

(Mos i shisni shenjat tona për një çmim të vogël)".[4]

O Vëllezërit e mi të Ahiretit! Dhe o shokët e mi në shërbim të Kur'anit!

Ju duhet t'a dini -dhe e dini- se sinqeriteti në këtë botë është parimi më i rëndësishëm, sidomos në punët që i përkasin botës tjetër; ai është forca më e madhe, ndërmjetësi më i pranueshëm, pika më e fortë e mbështetjes, rruga më e shkurtër për tek e vërteta, lutja më e pranueshme, mjeti më i mirë për arritjen e qëllimeve dhe, cilësia më e lartë dhe adhurimi më i pastër.

Meqenëse në sinqeritet ka shumë drita si ato që u përmendën më lart; dhe meqenëse, në këtë kohë të llahtarshme, pavarësisht nga numri ynë i vogël, nga dobësia dhe gjendja jonë e varfër, e pafuqishme, e të përballur me armiq të tmerrshëm të bidateve -risive- e të çudhëzimit, një detyrë tej mase e rëndë, e rëndësishme, e përgjithshme dhe e shenjtë është vendosur nga mirësia Hyjnore mbi shpatullat tona. Ne jemi të detyruar më shumë se çdokush tjetër që të bëjmë të gjitha përpjekjet tona për të fituar sinqeritetin. Ne kemi një nevojë shumë të madhe për ta ngulitur sinqeritetin brenda vetvetes sonë. Përndryshe ajo që kemi arritur, pjesërisht deri tani në shërbimin tonë të shenjtë do të humbiste e nuk do të vazhdonte; Atëherë do të mbanim përgjegjësi e do të ishim prej atyre që i përfshin ndalesa Hyjnore dhe kërcënimi i Tij i ashpër në Fjalën e Tij:

وَلَا تَشْتَرُوا بِآيَاتِي ثَمَنًا قَلِيلًا *"Dhe mos blini (fitoni) me ajetet e mia çmim të ulët",* [5] dhe do ta shkatërronim sinqeritetin, duke dëmtuar kështu

[2] Kur'an, 2:238
[3] Kur'an, 91:9-10
[4] Kur'an, 2:41
[5] Kur'an, 2:41

lumturinë e përjetshme për hir të ndjenjave të ulëta të parëndësishme të botës, të pakuptimta, jo të domosdoshme, të dëmshme, të shëmtuara, të mërzitshme e shtinjake. Dhe duke vepruar kështu ne do të dhunonim të drejtat e vëllezërve tanë, do të bënim shkelje kundra detyrës së shërbimit të Kur'anit dhe do të ishim të pa respekt ndaj shenjtërisë së të vërtetave të besimit.

Vëllezërit e mi! Ka shumë pengesa përpara punëve të mëdha të së mirës. Shejtanët bëjnë një luftë të fuqishme kundra atyre që i ndërmarrin ato vepra. Prandaj, njeriu duhet të mbështetet në forcën e sinqeritetit përballë këtyre pengesave e para këtyre djajve. Ju duhet të shmangeni nga gjërat që dëmtojnë sinqeritetin ashtu siç shmangeni nga gjarpërinjtë dhe nga akrepat. Duhet të mos mbështetemi tek nefsi urdhërues për të liga -tek egoja- por të veprojmë sipas Fjalëve të profetit Jusuf a.s. në Kur'anin e shenjtë,

إِنَّ النَّفْسَ لَأَمَّارَةٌ بِالسُّوءِ إِلَّا مَا رَحِمَ رَبِّي *"Edhe unë nuk e shfajësoj veten time (nuk e nxjerr atë të larë). Padyshim që uni (nefsi njerëzor) është i prirur drejt së keqes, përveç kur Zoti im derdh Mëshirën e Tij (mbi atë që do Ai)".*[6] Mos e lër nefsin dhe egoizmin të të mashtrojnë; ju duhet t'i merrni si udhëzuesin tuaj rregullat e mëposhtëm me qëllim që të fitoni sinqeritetin e ta ruani atë:

- **Rregulli Juaj i Parë:**

Ju duhet të kërkoni kënaqësinë Hyjnore në punët tuaja. Në qoftë se Allahu i Plotëfuqishëm kënaqet, s'ka rëndësi, madje, sikur e gjithë bota të ishte e pakënaqur.

Në qoftë se Ai do ta pranonte një punë, ndërsa e gjithë njerëzia do ta refuzonte, kjo s'do të kishte asnjë ndikim. Në qoftë se Allahu do ta dëshironte, nëse do ta kërkonte urtësia e Tij pasi të jetë i kënaqur e ta ketë pranuar një punë, Ai gjithashtu i bën njerëzit ta pranojnë e të kënaqen me atë punë, edhe në qoftë se ju nuk ia kërkoni Atij një gjë të tillë. Për këtë arsye, qëllimi i vetëm në këtë kohë shërbimi duhet të jetë kërkimi i mirëfilltë i kënaqësisë Hyjnore.

[6] Kur'an, 12:53

● **Rregulli Juaj i Dytë**

Ky është moskritikimi i vëllezërve tuaj të cilët janë duke punuar në shërbim të Kur'anit, dhe moszgjimi i motiveve të smirës së tyre duke u krenuar e duke shfaqur vlera më të larta. Sepse ashtu siç nuk mund të konkurrojë njëra nga duart e njeriut me tjetrën, as njëri nga sytë e tij nuk mund të kritikojë tjetrin, as gjuha e tij nuk e kundërshton veshin e tij, as zemra e tij nuk i shikon gabimet e shpirtit të tij; Gjithashtu secila nga gjymtyrët e tij plotëson mangësitë e të tjerave, mbulon gabimet e tyre, ndihmon nevojat e tyre. Ose përndryshe, jeta e njeriut do të shuhej, shpirti i tij do të largohej dhe trupi i tij do të tretej. E ngjashme me këtë, pjesët përbërëse të makinerisë në një fabrikë nuk mund të konkurojnë apo të hahen me njëra-tjetrën në rivalitet, apo të kenë përparësi ndaj njëra-tjetrës, apo të dominojnë njëra-tjetrën. Ato nuk mund të zbulojnë të metat e njëra-tjetrës, të kritikojnë njëra-tjetrën, të shkatërrojnë entuziazmin për punë e t'u shkaktojnë atyre papunësi; ato marshojnë drejt qëllimit, për të cilin u krijuan, në solidaritet e unitet të vërtetë. Sikur të ndërhynte edhe agresioni më i vogël ose dëshira për të dominuar, ajo gjë do ta flakte fabrikën në rrëmujë duke i shkaktuar asaj mungesën e prodhimit e të rezultatit. Atëherë pronari i fabrikës do ta shkatërronte krejtësisht atë. Kështu, o studentët e Risale-i Nurit dhe o shërbyesit e Kur'anit! Ju dhe unë jemi anëtarë në një personalitet kolektiv të tillë i cili vlen të titullohet: '***Njeriu i plotë***'. Ne jemi si pjesët përbërëse të një makinerie të një fabrike e cila prodhon lumturi të përjetshme brenda një jete të amshuar. Ne jemi duar punonjëse në një anije Hyjnore e cila do ta zbarkojë komunitetin e Muhammedit a.s.m. në bregun e shpëtimit i cili është bota e paqes. Kështu ne sigurisht kemi nevojë për solidaritet e për bashkim të vërtetë që realizohen nëpërmjet fitimit të sinqeritetit -sepse misteri i sinqeritetit siguron nëpërmjet katër individëve fuqinë morale të një mijë e njëqind e njëmbëdhjetë vetave. Në të vërtetë, ne duhet ta fitojmë atë. Po, në qoftë se tre *Elifa*[7] nuk bashkohen, ato kanë vlerën e treshit. Ndërsa në qoftë se ato bashkohen, atëherë nëpërmjet misterit të numrave, ato fitojnë vlerën e njëqind e njëmbëdhjetës. Kështu do të ishte gjendja me katër katra; në qoftë se secila do të shkruhej e veçuar nga të tjerat, shuma do të ishte gjashtëmbëdhjetë. Ndërsa, në qoftë se nëpërmjet misterit të vëllazërimit dhe pasjes së një qëllimi të përbashkët ato

[7] Elif: Shkronja e parë e alfabetit arab, e shkruar si një vizë vertikale dhe vlera numerike e së cilës është një. Përkthyesi

bashkohen duke ardhur së bashku sup më sup në një rresht, atëherë ato kanë fuqinë dhe vlerën e katër mijë e katërqind e dyzet e katër.

Ka ngjarje të shumta historike që dëshmojnë se fuqia morale dhe vlera e gjashtëmbëdhjetë vetave vetësakrifikues ka qenë më e madhe se ajo e katër mijë vetave. Urtësia e këtij misteri është ky: Çdo anëtar i një unioni të vërtetë e të sinqertë mund të shikojë gjithashtu me sytë e vëllezërve të tjerë dhe të dëgjojë me veshët e tyre. Është sikur çdo person i një unioni të vërtetë prej dhjetë vetash të kishte vlerën dhe fuqinë e të shikuarit me njëzet sy, mendon me dhjetë mendje, dëgjon me njëzet veshë dhe punon me njëzet duar.[8]

- **Rregulli Juaj i Tretë**

Ju duhet ta dini se e gjithë fuqia e juaj qëndron tek sinqeriteti dhe e vërteta. Po, forca qëndron tek e vërteta e tek sinqeriteti. Madje edhe ata që janë të gabuar fitojnë fuqi nga sinqeriteti i tyre në rrugën e mbrapshtë që ata kanë marrë.

Dëshmia se fuqia qëndron tek e vërteta dhe sinqeriteti është ky shërbimi ynë në rrugën e besimit dhe të Kur'anit. Një sasi e vogël e sinqeritetit në shërbimin tonë e provon këtë pretendim dhe është dëshmi për vetveten. Sepse shtatë apo tetë vite në rrugën e besimit dhe të dijeve të sheriatit këtu ka tejkaluar njëqindfish njëzet vitet e shërbimit që kam kryer në zonën e vendlindjes sime e në Stamboll. Në vendlindjen time e në Stamboll ata të cilët më ndihmuan ishin njëqind apo një mijë herë më shumë se sa vëllezërit e mi këtu që punojnë së bashku me mua, ku unë jam i vetmuar, pa kërkënd, i huaj, gjysmëanalfabet,[9] nën mbikëqyrjen e pushtetarëve të padrejtë e i

[8] Po, solidariteti i përzemërt dhe unioni nëpërmjet misterit të sinqeritetit janë mjetet për përfitime të pafundme. Gjithashtu ato janë një mburojë efektive dhe pikë e fortë mbështetjeje kundra frikësimeve të shumta, madje edhe kundra vdekjes. Sepse në qoftë se vjen vdekja, ajo merr shpirtin e njërit. Por, meqenëse nëpërmjet misterit të vëllazërisë së vërtetë në rrugën e kënaqësisë Hyjnore, në punët që lidhen me Ahiretin, ndodhen shpirtëra sa numri i vëllezërve, në qoftë se ndonjëri nga ata vdes, ai e takon vdekjen me kënaqësi duke thënë: "Le të mbeten gjallë shpirtërat e mi të tjerë, sepse ato në të vërtetë e bëjnë jetën të vazhdojë për mua duke fituar vazhdimisht shpërblim për mua, kështu unë nuk vdes. Nëpërmjet shpirtërave të tjerë, unë jetoj me ato shpirtëra për sa ka të bëjë me shpërblimin.

[9] E ka fjalën për shkrimin e tij të keq. Përkthyesi

persekutuar prej tyre. Unë nuk kam absolutisht dyshim se shërbimi që kam kryer me ju këto shtatë apo tetë vite dhe forca morale që ka rezultuar me sukses njëqind herë më e madhe se ajo e mëparshmja, ka ardhur nga sinqeriteti që ju keni. Unë gjithashtu, duhet të pranoj se nëpërmjet sinqeritetit tuaj të përzemërt, ju më keni shpëtuar mua në një farë mase nga hipokrizia e cila lajkatonte e mburrte nefsin tim nga poshtë perdes së famës e të emrit. Në dashtë Zoti, ju do të keni sukses me fitimin e sinqeritetit të plotë dhe do të më bëni që edhe unë gjithashtu ta fitoj atë.

Ju duhet të jeni në dijeni se Hazreti Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, dhe Shejh Gilani, iu shenjtëroftë misteri i tij, ju nderojnë juve me kerametet e tyre dhe me vizionet e tyre të mrekullueshme nga e padukshmja, për shkak të këtij misteri të sinqeritetit. Në qoftë se ju, me dashje, do ta dëmtonit këtë sinqeritet, atëherë ju do të merrnit goditjet e tyre. Ju duhet të kujtoni gjithmonë goditjet e mëshirës në *Shkreptimën e Dhjetë*. Në qoftë se dëshironi të keni mbështetjen e heronjve si këta të dy e t'i keni ata si mësues tek koka e juaj, fitoni sinqeritet të plotë në përputhje me vërsetin Kur'anor,

وَيُؤْثِرُونَ عَلَىٰٓ أَنفُسِهِمْ "*Dhe i parapëlqejnë ata (të shpërngulurit) mbi veten e tyre, edhe pse ata vetë kishin nevojë për të*".[10] Preferoni vëllezërit tuaj mbi vetveten tuaj me nderim, rang e brohoritje, dhe me gjërat që shpirti juaj kënaqet, si përfitimet materiale. Madje edhe në dobitë më të pastërta e të padëmshme si të dhënit mësim një besimtari lidhur me të vërtetat e holla të besimit. Në qoftë se është e mundur, inkurajoje njërin nga shokët e tu, i cili nuk dëshiron ta bëjë një gjë të tillë, me qëllim që shpirti i juaj të mos bëhet mendjemadh. Ndoshta dikush nga ju mund të ketë dëshirë që ta fitojë vetë shpërblimin e kështu përpiqet ta shpjegojë vetë një çështje të rëndësishme në lidhje me besimin. Megjithëse këtu nuk ka ndonjë dëm apo mëkat, mirëpo kuptimi i sinqeritetit midis jush do të dëmtohej.

- **Rregulli Juaj i Katërt**

Ky është t'i përfytyroni vëllezërit tuaj dhe t'i konsideroni virtytet dhe meritat e tyre në vetveten tuaj me falënderime, si dhe krenaria me lavdinë e tyre. Sufitë kanë terma që i përdorin ndërmjet tyre, si

[10] Kur'an, 59:9

‘Asgjësim në Shehun’ -në mësuesin e tyre shpirtëror. Unë nuk jam Sufi, por këto parimet e tyre përbëjnë një rregull të mirë në rrugën tonë, në formën e ‘asgjësimit në vëllezër’. Midis vëllezërve kjo do të thotë, “Asgjësim brenda njëri-tjetrit”, me fjalë të tjera, çdo vëlla të harrojë ndjenjat e tij të nefsit dhe të jetojë në mendim me ndjenjat dhe virtytet e vëllezërve të tij. Në çdo situatë themeli i rrugës sonë është ‘vëllazërimi’ për hir të Zotit xh.sh, dhe marrëdhëniet që na lidhin neve janë ‘vëllazërimi i vërtetë’, jo marrëdhënia e babait me djalin, apo marrëdhënia e Shehut me ndjekësit e tij. Tek e shumta një ustadh -profesor- ndërhyn. Rruga jonë është shoqëria më e ngushtë. Kjo shoqëri bën të domosdoshme një shok më të ngushtë, shokun më sakrifikues, mikun më vlerësues dhe vëllain më fisnik. Esenca e kësaj shoqërie është sinqeriteti i vërtetë. Ai që në mesin tuaj e prish këtë sinqeritet të vërtetë bie nga maja e lartë e kësaj shoqërie; ai mund të bie në fundin e një ultësire të thellë, meqë nuk ka aty në mes ndonjë vend për t’u ngjitur. Po, rruga shihet të jetë dy. Ka mundësi se ata që ndahen tani nga kjo rruga e jonë, nga rruga e madhe e Kur’anit, ata pa e ditur e pa dashje, ndihmojnë forcat e pafesisë, të cilat janë armiqtë tanë. Ata që hyjnë në fushën e shërbimit të Kur’anit të mrekullueshëm, nëpërmjet Risale-i Nurit, në dashtë Zoti, nuk do të bien në kurthe të tilla, por do të mbështesin me fuqi dritën, sinqeritetin dhe besimin.

O Shokët e mi në shërbim të Kur’anit! Njëri nga mjetet më të efektshëm për ta fituar e ruajtur sinqeritetin është, “*Të kujtuarit e vdekjes*”. Po, ashtu si ambiciet e kësaj dynjaje që dëmtojnë sinqeritetin dhe e shtyjnë njeriun në hipokrizi dhe në dashurinë e kësaj bote, po kështu të kujtuarit dhe lidhja me vdekjen shkakton largim e neveri ndaj hipokrizisë dhe e bëjnë njeriun të fitojë sinqeritetin. Domethënë, të mendosh për vdekjen e të kuptosh se kjo botë është kalimtare, dhe kështu shpëton nga dredhitë e nefsit. Po, sufitë dhe njerëzit e së vërtetës e kanë marrë “*të kujtuarin e vdekjes*” si themelin në udhëtimin e tyre shpirtëror, duke iu referuar vërseteve Kur’anore:

كُلُّ نَفْسٍ ذَآئِقَةُ الْمَوْتِ ۗ إِنَّكَ مَيِّتٌ وَإِنَّهُم مَّيِّتُونَ *“Gjithësecili do ta shijojë vdekjen”.*[11]

[11] Kur’an, 3:185

"Sigurisht që ti (Muhammed a.s.m.) do të vdesësh dhe padyshim që edhe ata do të vdesin".[12]

Kështu ata, duke u lidhur në këtë mënyrë me vdekjen, dëbojnë iluzionin e përjetshmërisë, që është burimi i ambicies së kësaj bote. Ata duke i përfytyruar dhe duke i mashtruar vetvetet e tyre si të vdekur ose sikur po vendosen tani në varr... kur ata mendojnë në këtë mënyrë, nefsi urdhërues për të liga bëhet i trishtuar dhe preket nga një imagjinatë e tillë, saqë pak nga pak heq dorë nga shpresat e tij të mëdha e të gjëra. Kështu ka disa avantazhe në "*të kujtuarin e vdekjes*".

Hadithi profetik, kuptimi i të cilit është,

أَكْثِرُوا ذِكْرَ هَادِمِ اللَّذَّاتِ *"Kujtojeni shpesh vdekjen e cila zhduk kënaqësinë dhe e bën atë të hidhur"*[13] jep mësimin për ta shqyrtuar vdekjen. Megjithatë, meqenëse rruga jonë nuk është një tarikat Sufizmi, por *rruga e realitetit*, ne nuk do të detyrohemi ta kryejmë këtë shqyrtim apo lidhje në formë të imagjinuar -hipotetike- si Sufitë. Në qoftë se do të veproje kështu, nuk do t'i përshtateshe rrugës së realitetit. Rruga jonë nuk është të sjellim të ardhmen në të tashmen nëpërmjet mendimit të fundit, por të shikojmë me mendim nga e tashmja në të ardhmen dhe ta shikojmë të ardhmen nëpërmjet të tashmes aktuale siç është realiteti. Po, duke mos patur nevojë për imagjinatën ose konceptin, njeriu mund të shikojë kufomën e tij, frutin e vetëm në pemën e kësaj jete të shkurtër. Njeriu në këtë rrugë nëse do ta ndryshonte pak shikimin e tij, por gjithashtu, edhe vdekjen e botës dhe shkatërrimin e saj, dhe tek ajo do t'i hapet para tij rruga për tek "sinqeriteti i plotë".

Mjeti i dytë për të arritur sinqeritetin është të fitosh një sens të pranisë Hyjnore nëpërmjet forcës së besimit të sigurt e të verifikuar dhe nëpërmjet dritave që burojnë nga mendimi reflektues mbi krijesat, i cili të çon në njohjen e Krijuesit; duke menduar se Krijuesi i Gjithëmëshirshëm është gjithmonë i pranishëm dhe e shikon vazhdimisht; duke mos kërkuar tërheqjen e vëmendjes së askujt tjetër përveç se atë të Krijuesit, dhe duke kuptuar se orientimi drejt të tjerëve dhe të kërkuarit ndihmë prej tyre është kundër sjelljes së drejtë në

[12] Kur'an, 39:30
[13] Tirmidhi, Nisai

praninë e Tij, njeriu mund të shpëtojë nga një hipokrizi e tillë dhe fiton sinqeritetin.

Megjithatë, ndodhen shumë grada e stade në këtë 'shqyrtim', kështu pjesa e çdo personi është ajo që ai fitoi prej tij sipas aftësisë e mundësisë që ai ka.

Shumë të vërteta janë përmendur në Risale-i Nur të cilat do ta shpëtojnë njeriun nga hipokrizia dhe do ta bëjnë atë të fitojë sinqeritetin. Atëherë duke e referuar atë tek ato të vërteta, ne e presim shkurt diskutimin këtu.

Do të përmendim shkurtimisht disa nga shkaqet e shumta që e prishin sinqeritetin, që e pengojnë e që e shtyjnë njeriun në hipokrizi.

I Pari, penguesi i parë i sinqeritetit.

Rivaliteti ose smira lidhur me përfitimet materiale e shkatërron gradualisht sinqeritetin. Ai gjithashtu është i dëmshëm për rezultatet e shërbimit tonë. Kështu, ai gjithashtu shkakton që përfitimet materiale të humbasin. Ky komb ka ushqyer gjithmonë respekt për ata që punojnë për të vërtetën dhe Ahiretin dhe i kanë ndihmuar ata për hir të Zotit xh.sh... Me qëllimin dhe pjesëmarrjen aktive në sinqeritetin e tyre të pastër dhe në punët që ata kryejnë me devocion, kombi ka treguar gjithmonë respekt duke i ndihmuar me përfitime materiale si lëmosha - sadeka- e dhurata me qëllim që ata të mos bëhen të preokupuar për të siguruar nevojat e tyre materiale e të harxhojnë kohën e tyre. Por kjo ndihmesë e dobi mund të mos kërkohet; ajo jepet. Madje ajo nuk mund të kërkohet as me gjuhën e gjendjes, duke e dëshiruar atë me zemër e duke e pritur. Por ajo duhet t'i jepet kur nuk parashikohet, ose ndryshe do të dëmtohej sinqeriteti. Një gjë e tillë gati përfshihet brenda ndalesës Hyjnore në vërsetin: وَلَا تَشْتَرُوا بِآيَاتِي ثَمَنًا قَلِيلًا "*Mos blini (fitoni) me ajetet e mia çmim të ulët".*

(Mos i shisni shenjat tona për një çmim të vogël)"[14] dhe pjesërisht shkatërron veprimin.

[14] Kur'an, 2:41

Kështu, dëshira për këto përfitime materiale dhe pritja për ato gjëra, në një mënyrë të tillë duke mos i lejuar ato të shkojnë tek një tjetër, nefsi urdhërues për të liga nxit me egoizëm e smirë një ndjenjë rivaliteti ndaj një vëllai të vërtetë dhe ndaj një shoku në atë shpërblim të veçantë. Sinqeriteti i tij prishet, shenjtëria e shpërblimit humbet dhe personi bëhet i padëshiruar në sytë e njerëzve të realitetit. Ai gjithashtu humbet përfitimin material. Kjo çështje ka diskutim të gjatë, por unë do ta pres shkurtazi, dhe vetëm do të përmend dy shembuj të cilët do të forcojnë sinqeritetin dhe unionin e vërtetë midis vëllezërve të vërtetë.

Shembulli i Parë

Njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje, dhe madje edhe disa politikanë dhe disa grupe të fshehta dhe manipulatorët e shoqërisë kanë marrë si udhërrëfyesin e tyre parimin e 'pronës së përbashkët', e ndarjes së pronës, me qëllim që të sigurojnë pasuri e fuqi të madhe. Ata kërkojnë një fuqi të jashtëzakonshme dhe avantazh, pavarësisht të gjitha shfrytëzimeve të tyre dhe humbjeve. Megjithatë, natyra e pronës së përbashkët nuk ndryshon me ndarjen, pavarësisht dëmeve të shumta të saj. Megjithëse çdo partner, ortakë, sipas këtij parimi është sikur të ishte pronari dhe mbikëqyrësi i të gjithë pasurisë nga këndvështrimi i pjesëmarrjes në pasuri dhe i mbikëqyrjes së saj, por pavarësisht nga kjo, ai përsëri nuk mund të fitojë gjë nga ajo. Megjithatë, në qoftë se ky parimi i pronës së ndarë do të zbatohej në punët që i përkasin botës tjetër, ai do të grumbullonte përfitime të mëdha e pa shkaktuar ndonjë humbje. Sepse ajo do të thotë se e gjithë pasuria të kalonte tek duart e çdo partneri. Për shembull, ndodhen katër ose pesë njerëz me idenë e pjesëmarrjes dhe të partneritetit; njëri prej tyre sjell parafinën -naftën-, një tjetër fitilin, i treti shishen e llambës, i katërti vetë llambën dhe i fundit, kutinë e shkrepëses. Ndërkohë ata e mbërthejnë llambën dhe e ndezin. Gjithësecili nga ata bëhet pronari i krejt llambës. Në qoftë se secili nga ata partnerë do të kishte një pasqyrë të madhe në mur, ai do të reflektohej në të së bashku me llambën e me dhomën pa mangësi dhe e pazbërthyer. Është e njëjta me pjesëmarrjen e ndërsjellë në pasuritë e botës tjetër nëpërmjet misterit të sinqeritetit, bashkëpunimit përmes vëllazërimit dhe iniciativës së përbashkët nëpërmjet misterit të unitetit. Shuma e përgjithshme e siguruar nëpërmjet atyre punëve të përbashkëta si dhe e gjithë drita që buron prej tyre - hyjnë në librin e veprave të mira të secilit nga ato pjesëmarrës. Ky është një fakt dhe

është dëshmuar nga njerëzit e realitetit. Ai gjithashtu kërkohet nga zemërgjërësia e mëshirës Hyjnore dhe Bujaria e Tij absolute.

Prandaj, o vëllezërit e mi, në dashtë Zoti, përfitimet materiale nuk do të nxisin smirë midis jush. Është e mundur që ju të mashtroheni në lidhje me përfitimet e Ahiretit si disa nga ata që ndjekin Tarikatin Sufi. Por kujtoni, ku do të ishte merita personale dhe e pjesshme kur krahasohet me meritën dhe dritën e shfaqur në lidhje me veprimet e përbashkëta të përmendura në shembullin e dhënë lart?

Shembulli i Dytë - për vazhdimësinë e sinqeritetit.

Zejtarët fitojnë pasuri të madhe nëpërmjet bashkëpunimit me qëllim që të përfitojnë më shumë nga prodhimet e profesioneve të tyre.

Dikur në një kohë, Dhjetë burra që prodhonin gjilpëra qepjeje, secili punonte veçmas dhe rezultati i punës së tyre individuale ishte prodhimi i tre gjilpërave në ditë. Ndërkohë, sipas parimit të iniciativës së përbashkët, dhjetë burrat u bashkuan. Njëri prej tyre solli hekurin, tjetri ndezi furrën, i treti shpoi gjilpërat, një tjetër i fuste ato në zjarr - furrë-, një tjetër mprehte majat e tyre, e kështu me radhë. Gjithësecili merrej me pjesën e tij të proçesit të prodhimit të gjilpërave. Meqenëse puna, në të cilën ushtrohej, ishte e thjeshtë dhe koha nuk harxhohej, secili fitoi aftësi profesionale dhe e realizonte punën me shpejtësi të konsiderueshme. Atëherë ata e ndanë punën që kishin bërë sipas parimit të sipërmarrjes së përbashkët dhe ndarjes së punës: Ata panë se në vend të tre gjilpërave në ditë, prodhonin treqind për secilin. Kjo ngjarje u përhap gjërësisht midis zejtarëve dhe atyre të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje, me qëllim që t'i inkurajonin për të bashkuar punën e tyre.

Prandaj o vëllezërit e mi! Meqenëse bashkimi e marrëveshja në çështjet e kësaj bote dhe në lëndët e ngjeshura sjellin rezultate e përfitime të mëdha të përgjithshme, ju mund të krahasoni se sa shumë fitimprurës e dritëdhënës do të ishte shpërblimi i punëve të Ahiretit! Dhe sa i madh do të ishte shpërblimi i reflektuar nga të gjitha punët e xhematit -kolektivit- nëpërmjet mirësisë Hyjnore në pasqyrën e çdo individi, ato punë që nuk kanë nevojë të ndahen e të copëzohen. Atëherë ju duhet ta vlerësoni atë përfitim shumë të madh. Ky përfitim i madh nuk duhet të humbasë për shkak të smirës -rivalitetit- dhe për shkak të mungesës së sinqeritetit.

Pengesa e Dytë që shkatërron sinqeritetin.

Kjo është mburrja e egos dhe dhënia e një statusi të lartë nefsit urdhërues për të liga, i cili ka dëshirë për famë, për emër, pozitë, për brohoritjen e publikut dhe tërheqjen e vëmendjes së tyre. Kjo është një sëmundje e rëndë shpirtërore. Gjithashtu ajo i hap derën hipokrizisë dhe egocentrizmit -vetëdashjes- e quajtur shoqërim i fshehur të përshkruarit ortakë me Zotin xh.sh., dhe shkatërron sinqeritetin.

Vëllezërit e mi! Rruga jonë në shërbim të Kur'anit është realiteti i vëllazërisë dhe, kuptimi i vërtetë i vëllazërisë është të asgjësojë personin e tij brenda personalitetit të vëllezërve dhe të preferojë shpirtërat e tyre mbi shpirtin e tij.[15]

Atëherë, rivaliteti, smira e këtij lloji që buron nga dëshira për rang e pozitë nuk duhet të zgjohet, pasi ai është krejtësisht i kundërt me rrugën tonë. Meqenëse nderi i të gjithë vëllezërve lidhet me nderin e gjithësecilit në xhemat, atëherë ta sakrifikosh atë nder të madh kolektiv për hir të famës së pjesshme e të pozitës që burojnë nga egoizmi... unë kam besim e shpresë se kjo është shumë larg që të ndodh nga studentët e Risale-i Nurit. Po, zemra, mendja dhe shpirti i studentëve të Risale-i Nurit nuk do ta ulnin veten kaq poshtë në gjëra të dëmshme e të ulëta si kjo, por çdo njeri ka një nefs urdhërues për të liga dhe ndonjëherë emocionet e nefsit ndikojnë në disa damarë të karakterit dhe sundojnë në një farë mase, pavarësisht nga zemra, mendja dhe shpirti; Unë nuk po akuzoj zemrat tuaja, mendjet dhe shpirtërat. Unë kam besim tek ju për shkak të ndikimit të Risale-i Nurit. Por nefsi, dëshirat, emocionet dhe imagjinatat ndonjëherë mashtrojnë.

Për këtë arsye, ju ndonjëherë merrni paralajmërime të ashpra. Dhe kjo ashpërsi i drejtohet nefsit, emocioneve, dëshirave dhe imagjinatës; prandaj veproni me vëmendje!

Po, në qoftë se rruga jonë do të kishte qenë një tarikat i veçantë dhe nënshtrim ndaj një shejhu, atëherë do të kishte pasur vetëm një rang ose rangje të kufizuara, për të cilat do të kishin dalë shumë kandidatë për to. Dhe do të ishte e mundur të shfaqej tek ato smira dhe egoizmi.

[15] Po, i lumtur është ai i cili, me qëllim që të fitojë hyrje në një pellg të madh uji të ëmbël e të kulluar nga burimi i Kur'anit, e flak personin e tij dhe egon -të cilat janë si copa akulli- në atë pellg dhe i shkrin ato, Autori

Kurse rruga jonë është vëllazëria. Nuk ka pozitë apo baba midis vëllezërve, as nuk mund të marrin pozitën e udhëheqësit shpirtëror. Rangu në vëllazëri është i gjërë; ai rang nuk mund të jetë shkak për shtyrje bërrylash prej ziliqari. Tek e shumta vëllai ndihmon vëllain e tij; ai plotëson shërbimin e tij.

Ndodhen dëshmi që tregojnë se shumë pasoja janë shkaktuar nga rivaliteti e lakmia për shpërblim shpirtëror. Dhe aspiratat e larta të rrugëve të udhëheqësve shpirtërorë janë konflikti dhe rivaliteti ndërmjet atyre që ndjekin Tarikatin Sufi. Arritjet e tyre, dobitë e përfitimet kanë pasur pasoja shkatërrimtare ndaj asaj fuqie të madhe të shenjtë të tyre, gjë që i kanë bërë ata të pamundur të qëndrojnë përpara stuhive të bidatit -risisë.

Penguesi i Tretë: Është frika dhe lakmia. Ky tregues është shpjeguar me qartësi të plotë tek *"gjashtë sulmet*" së bashku me dy pengues të tjerë. Prandaj ne ua referojmë atë juve, dhe duke i bërë të gjithë Emrat e Tij të Bukur ndërmjetësit tanë, ne i kërkojmë të Gjithëmëshirshmit që të na japë sukses në fitimin e sinqeritetit të plotë.

اَللّٰهُمَّ بِحَقِّ سُوْرَةِ الْاِخْلَاصِ اجْعَلْنَا مِنْ عِبَادِكَ الْمُخْلِصِيْنَ الْمُخْلَصِيْنَ اٰمِيْنَ اٰمِيْنَ

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَآ اِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا اِنَّكَ اَنْتَ الْعَلِيْمُ الْحَكِيْمُ

O Zot! Për hir të sures Ihlas na bëj neve midis robërve të Tu të sinqertë që janë të shpëtuar. Amin... Amin.

Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtet që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".[16]

*** * ***

[16] Kur'an, 2:32

Një letër private për njërin nga vëllezërit e mi.

Unë do të përmend një pikë rreth dy hadithe për vëllezërit e mi të cilët bëhen të lodhur nga të shkruarit e Risale-i Nurit dhe që preferojnë recitimin e virdeve në tre Muajt, në muajt e adhurimit, mbi shkrimin e Risale-i Nurit që konsiderohet ibadet në tre aspekte.[17]

Dy hadithet janë këto:

I Pari: يُوزَنُ مِدَادُ الْعُلَمَاءِ بِدِمَاءِ الشُّهَدَاءِ *Në ditën e Gjykimit, boja e harxhuar nga dijetarët e fesë do të vihet në peshë me gjakun e martirëve dhe do të jenë të barabartë në peshë.*[18]

I Dyti: مَنْ تَمَسَّكَ بِسُنَّتِي عِنْدَ فَسَادِ أُمَّتِي فَلَهُ أَجْرُ مِأَةِ شَهِيدٍ *"Kushdo që kapet pas sunnetit tim kur prishet ummeti - komuniteti- im, ai do të fitojë shpërblimin e njëqind martirëve".* Domethënë, Ata që aderojnë dhe i shërbejnë sunnetit të profetit dhe të vërtetave të Kur'anit kur të jenë përhapur bidatet dhe çudhëzimi, ata mund të fitojnë shpërblimin e njëqind martirëve.

O vëllezërit e mi që mërziteni e lodheni nga shkrimi për shkak të dembelisë! Dhe o vëllezërit e mi që keni prirje për sufizmin! Këto dy hadithe, së bashku, tregojnë se drita e zezë që rrjedh nga penat e bekuara e të pastra duke u shërbyer të vërtetave të besimit, mistereve të Sheriatit dhe sunnetit të Profetit a.s.m. në një kohë të tillë si kjo, madje

---

[17] Ne e pyetëm profesorin tonë rreth pesë llojeve të adhurimit të cilat i tregoi në këtë letër të vlefshme. Shpjegimi që ne morëm është si më poshtë vijon:

1- Ai është xhihad shpirtëror kundra njerëzve të çudhëzimit dhe ai xhihad është më i rëndësishmi.

2- Ai është shërbim ndaj profesorit tonë dhe ndihmë për të në përhapjen e së vërtetës.

3- Është shërbim për të gjithë muslimanët lidhur me besimin.

4- Është përfitim diturie nëpërmjet penës.

5- Është kryerje ibadeti në formën e mendimit reflektiv, një orë e të cilit mund të jetë ndonjëherë e barabartë me adhurimin e një viti.

Nëshkroi: Rushtu, Husrev, Refet.

[18] Al-Gazali, Ihja 'Ulum al-Din, I.G/Ajluni, Kashf al-Khafa, etj...

edhe një pikë prej ujit të tyre -të jetës- si boja, mund të sjellë për ty një avantazh në Ditën e Gjykimit që do të jetë i barabartë me njëqind pika nga gjaku i martirëve. Prandaj ti duhet të përpiqesh ta fitosh atë shpërblim të madh!

Në qoftë se ju thoni: Ajo që erdhi në hadith është dija, ndërsa disa nga ne jemi vetëm shkrues.

Përgjigjja: Ai që i lexon këto trajtesa të Risale-i Nurit për një vit, duke i kuptuar e duke i pranuar ato, bëhet një dijetar i rëndësishëm e i saktë i kësaj kohe. Madje edhe në qoftë se ai nuk do t'i kuptonte ato, meqenëse studentët e Risale-i Nurit kanë një personalitet kolektiv, nuk ka dyshim se ai është njëri nga dijetarët e kësaj kohe. Sa për penat tuaja, ato janë gishtërinj jolëndorë të atij personaliteti kolektiv, megjithëse në mendimin tim unë jam i pavëmendshëm për shkak të mendimit të mirë që keni ju për mua, ju më keni dhënë mua pozitën e profesorit -ustad- dhe të dijetarit fetar si dhe jeni bashkuar me mua. Meqenëse unë jam analfabet dhe kam vështirësi në të shkruar, penat tuaja mund të mendohen se janë penat e mia; ju do të merrni shpërblimin e treguar në hadith.

Said Nursi

* * *

SHKREPTIMA E NJËZET E DYTË

بِاسْمِهِ سُبْحَانَهُ


Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Kjo trajtesë e shkurtër të cilën e shkrova para njëzet e dy vitesh ndërsa isha në fshatin e Barlës në provincën e Ispartës, është një trajtesë private për vëllezërit e mi më të afërm e më të zgjedhur e të sinqertë, gjithashtu e shkrova në fshehtësinë më të madhe. Meqenëse kjo ka lidhje me familjet dhe me administratën e Ispartës, unë po ia kushtoj guvernatorit të drejtë të Ispartës dhe zyrtarëve në sferat e drejtësisë dhe të rendit. Në qoftë se është e përshtatshme, disa kopje duhet të shkruhen nga makina e shkrimit ose me shkronjat e vjetëra ose me shkronjat e reja me qëllim që ato që më kanë mbajtur nën mbikëqyrje dhe kanë hetuar sekretet e mia gjatë këtyre njëzet e pesë viteve mund ta mësojnë se unë nuk kam asnjë sekret të fshehur!

Said Nursi

Tre Tregues

[Ndërsa duke qenë çështja e tretë e Shënimit të Shtatëmbëdhjetë të Shkreptimës së Shtatëmbëdhjetë, për shkak të rreptësisë dhe gjithëpërfshirjes së pyetjeve, të fuqisë dhe shkëlqimit të përgjigjeve, u përfshi në koleksionin e Shkreptimave si Shkreptima e Njëzet e Dytë e Letrës së Tridhjetë e Njëtë. Shkreptimat duhej t'i jepnin asaj një vend. Kjo është një trajtesë private dhe e veçantë për vëllezërit e mi më të zgjedhur, të sinqertë e besnikë.]



Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Dhe kushdo që mbështetet e vë shpresat tek Allahu, atëherë Ai do t'i mjaftojë atij plotësisht. Padyshim që Allahu do t'ia përmbushë qëllimin atij. Sigurisht që Allahu ka vendosur masë për çdo gjë".[1]

Kjo çështje përbëhet nga tre Tregues:

● **Treguesi i Parë**

Një pyetje e rëndësishme rreth personit tim dhe Risale-i Nurit: Shumë njerëz pyesin: "Përse ndërhyjnë njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje në çështjet e Ahiretit tënd sa herë që t'u jepet rasti, ndonëse ti nuk ndërhyn në çështjet e dynjasë së tyre? Duke ditur se ligjet e asnjë qeverie nuk ndërhyjnë tek çështjet e atyre që jetojnë në vetmi dhe që kanë hequr dorë nga dynjaja?"

Përgjigjja: Përgjigjja e Saidit të Ri ndaj kësaj pyetjeje është heshtja. Saidi i Ri thotë: "Le të japë përgjigje për mua Kaderi Hyjnor".

Megjithatë, ai thotë me mendjen e Saidit të vjetër për të cilën u detyrua që ta huazojë: Ata që duhet t'i japin përgjigje kësaj pyetje janë autoritetet e provincës së Ispartës dhe njerëzit e saj, sepse këta pushtetarë zyrtarë dhe njerëzit janë të lidhur më shumë se unë me kuptimin që përmban kjo pyetje.

[1] Kur'an, 65:3

Meqenëse administrata e cila përbëhet nga mijëra njerëz dhe njerëzit që numërohen me qindra e mijëra janë të detyruar ta shqyrtojnë e ta mbrojnë atë në vendin tim, përse duhet të flas unë me prokurorët më kot, pa qenë nevoja, që të mbroj vetveten?

Unë kam qenë në këtë provincë që prej nëntë vitesh dhe gradualisht po ia kthej shpinën time gjithnjë e më shumë dynjasë së tyre. Asnjë aspekt i jetës sime nuk ka mbetur i fshehur. Madje edhe trajtesat e mia private kanë qarkulluar nëpër duart e pushtetarëve në qeveri dhe tek disa deputetë. Në qoftë se do të kisha ndërhyrë sado pak ose nëse do të kisha bërë ndonjë përpjekje për të turbulluar e trazuar dynjanë e tyre ose madje në qoftë se thjesht do të kisha menduar për këtë çështje, nuk do ta kishin preferuar heshtjen këta autoritete e prokurorë ndaj meje e të mos më kishin shqetësuar, pavarësisht se ata më mbajnë nën mbikëqyrje, më përgjojnë dhe kanë vendosur spiunë kundra meje gjatë nëntë viteve.

Gjithashtu unë nuk kam ngurruar që t'i nxjerr të fshehtat e mia për ata që më kanë vizituar; autoritetet kanë qëndruar të heshtur dhe nuk më kanë ngacmuar. Në qoftë se do të kisha pasur ndonjë faj që mund të kishte qenë i dëmshëm për lumturinë e këtij vendi, për të ardhmen e tij ose për popullin e tij gjatë këtyre viteve, të gjithë individët e qeverisë duke filluar nga guvernatori deri tek zyrtari më i ulët, shefi i policisë së këtij fshati, do të mbanin përgjegjësi, do ta bënin vetveten përgjegjës. Ata janë të detyruar të më mbrojnë përballë atyre që e bëjnë qimen tra, që e bëjnë mizën buall; ata duhet t'i zvogëlojnë ato çfarë zmadhuan ata. Prandaj unë ua referoj atyre përgjigjjen e kësaj pyetje.

Arsyeja pse njerëzit e kësaj province janë më shumë të detyruar për të më mbrojtur mua se sa unë, është se nëpërmjet qindra trajtesave të cilat kanë demonstruar efektshmërinë e tyre në mënyrë të ndjeshme e lëndore dhe në fakt, unë kam punuar gjatë këtyre nëntë viteve për jetën e përhershme të këtyre njerëzve, për të mbështetur fuqinë e besimit të tyre dhe për lumturinë e jetës, të cilët janë edhe vëllezër, edhe shokë edhe të mirë e të bekuar. Dhe asnjë shqetësim apo dëm nuk ka pësuar askush për shkak të këtyre trajtesave, sepse nuk është vërejtur prej tyre as edhe shenja më e vogël prej ndonjë synimi politik apo ndonjë përfitimi që lidhet me këtë dynja. Dhe, lavdi Zotit xh.sh., nëpërmjet Risale-i Nurit kjo Provincë e Ispartës ka fituar, lidhur me fuqinë e besimit dhe me qëndrueshmërinë në fe, një shkallë të tillë bekimi që i

ngjason bekimit që fitoi Damasku në kohët e hershme dhe bekimit të universitetit të Al-Az'harit në Egjipt që është shkolla e botës islame në përgjithësi; Risale-i Nuri e ka bërë fuqinë e besimit të dominojë mbi indiferentizmin dhe e ka bërë dëshirën për adhurim të dominojë mbi shthurjen e mbi të keqen në provincë duke e bërë atë një provincë më fetare se sa provincat e tjera. Prandaj,meqenëse çështja është kështu, të gjithë njerëzit e saj, madje edhe nëse do të supozonim se ndodhet ndonjë ateist, janë të detyruar të më mbrojnë mua dhe Risale-i Nurin.

Ndërsa ata kanë të drejta të tilla të rëndësishme për mbrojtje, e drejta ime e parëndësishme dhe e pjesshme nuk më shtyn mua për të mbrojtur veten time dhe sidomos në një kohë kur unë e kam plotësuar detyrën time, Lavdi Zotit, kur mijëra nga studentët kanë punuar e punojnë në vendin tim, në vendin e këtij të pafuqishmi. Atëherë, Ai që ka mijëra avokatë e përfaqësues nuk e mbron vetë çështjen e tij.

● **Treguesi i Dytë**

Përgjigjja për një pyetje kritike.

Njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje pyesin:

"Përse ti je i zemëruar me ne dhe nuk na je drejtuar dhe nuk na ke bërë kërkesë as edhe një herë të vetme, dhe rri i heshtur? Pastaj, ti ankohesh shumë rëndë ndaj nesh duke thënë se ne jemi të padrejtë ndaj teje. Mirëpo ne kemi parimet tona, ne kemi rregullat tona të veçanta siç kërkohet nga ky shekull, ndërsa ti nuk i zbaton këto parime për veten tënde dhe i refuzon ato, duke ditur se kush e zbaton ligjin nuk është tiran, ndërsa ai që nuk e pranon ligjin është rebel, i pabindur. Për shembull, në këtë kohë lirie dhe në epokën e re republikane, të cilën e kemi filluar, vepron parimi i heqjes së shtypjes dhe i mbisundimit ndaj të tjerëve, sepse barazia është një ligj themelor i fesë sonë, kurse ti që po përpiqesh të tërheqësh shikimin dhe vëmendjen e njerëzve drejt teje një herë me mantelin e dijes dhe njëherë me asketizëm dhe përpiqesh të formosh një fuqi dhe një rang shoqëror jashtë influencës së shtetit.

Kështu, kuptohet nga sjellja jote e jashtme dhe kështu na e tregon rrjedha e jetës tënde të mëparshme. Kjo mund të duket e dëshirueshme -sipas terminologjisë së sotme- brenda tiranisë arbitrare të borgjezisë. Por meqenëse parimet e socializmit të pastër dhe të bolshevizmit, të cilat janë shfaqur me zgjimin e njerëzve tonë të zakonshëm dhe me

epërsinë e tyre, janë më të përshtatshme me interesat tona, ne i kemi pranuar ato, ndërsa pozita jote është e papëlqyeshme për ne; ajo del kundër parimeve tona. Për këtë arsye, ti nuk ke të drejtë të shfaqësh ankesa e të zemërohesh për shqetësimet që të vijnë nga ne.

Përgjigjja: Në qoftë se ai i cili hap një rrugë të re në jetën e shoqërisë njerëzore ose themelon një lëvizje nuk vepron në harmoni me ligjet natyrale që janë në fuqi në univers, ai nuk mund të jetë i suksesshëm në veprat e dobishme dhe në përparim. Të gjitha veprat e tij bëhen për llogarinë e së keqes dhe të shkatërrimit. Meqenëse veprat duhet të jenë në harmoni me ligjet natyrale, atëherë zbatimi i ligjit të barazisë absolute nuk është i mundshëm veçse duke ndryshuar natyrën e njeriut dhe duke hequr urtësinë themelore në krijimin e llojit njerëzor.

Po, përsa ka të bëjë me prejardhjen dhe me mënyrën e të jetuarit, unë vij nga shtresa e njerëzve të zakonshëm dhe jam njëri nga ata që, nga natyra dhe me arsye kam pranuar "*Barazinë e të drejtave*". Dhe për shkak të mëshirës dhe të drejtësisë që burojnë nga islami, unë jam njëri nga ata që për një kohë të gjatë kam kundërshtuar dhe kam punuar kundër despotizmit dhe shtypjes së shtresës së lartë, klasës së lartë e quajtur borgjezi. Prandaj, unë e mbështes drejtësinë e plotë me të gjithë fuqinë time dhe e kundërshtoj tiraninë, shtypjen, forcën arbitrare dhe despotizmin.

Megjithatë, natyra njerëzore dhe urtësia që gjendet në krijimin e llojit njerëzor janë kundra ligjit të barazisë absolute, sepse me qëllim që të demonstrojë fuqinë e Tij të Plotë dhe urtësinë e Tij Absolute, Krijuesi i Gjithurtë prodhon shumë prodhime nga një gjë e vetme, bën që të shkruhen shumë libra në një faqe të vetme dhe bën të kryhen shumë funksione nga një gjë e vetme; dhe në të njëjtën mënyrë, Ai realizon nëpërmjet llojit njerëzor detyrat e mijëra specieve.

Për shkak të asaj urtësie madhështore, Allahu xh.sh. e krijoi njeriun me një natyrë gjithëpërfshirëse që do të prodhonte filizat e mijëra specieve dhe do të shfaqte nivelet e mijëra specieve të tjera të krijesave të gjalla. Allahu Fuqiplotë nuk vendosi asnjë limit tek forcat e njeriut, tek aftësitë e tij të holla dhe tek shqiset e tij, ashtu siç është rasti me kafshët; përkundrazi, Ai e la atë të lirë dhe i dha një aftësi nëpërmjet së cilës ai të ishte në gjendje të shëtisë e të bredhë përmes shkallëve të pafundme; Dhe ndërsa duke qenë një lloj i vetëm, njerëzimi bëhet si

mijërat e specieve. Për këtë arsye, njeriu u bë kalif i Zotit në tokë.. rezultati i universit.. dhe monarku i kafshëve.

Kështu, fara -tharmi- më i rëndësishëm dhe mekanizmi për shumëllojshmërinë e llojit njerëzor është gara -konkursi, provat- dhe virtyti i vërtetë që buron nga besimi. Virtyti nuk mund të hiqet veçse duke ndryshuar natyrën njerëzore, duke shuar arsyen, duke vrarë zemrën dhe duke asgjësuar shpirtin.

Nuk është e mundur nëpërmjet tiranisë dhe padrejtësisë ta shkatërrosh lirinë. Përpiqu ta heqësh vetëdijen, ndërgjegjen po të mundesh, nga lloji njerëzor![2]

Unë në vend të këtyre rreshtave them:

"Është e pamundur nëpërmjet tiranisë dhe padrejtësisë ta shkatërrosh realitetin. Përpiqu ta asgjësosh zemrën, po të mundesh, nga lloji njerëzor". Ose është e pamundur nëpërmjet tiranisë dhe padrejtësisë ta shkatërrosh virtytin; provo ta asgjësosh ndërgjegjen nga lloji njerëzor, nëse do të mundeshe.

Po, ashtu siç nuk mund të jetë mjet për shtypje virtyti që buron nga besimi, po ashtu ai nuk mund të jetë shkaku i despotizmit. Shtypja dhe despotizmi arbitrar tregojnë mungesën e virtytit. Dhe rruga më e rëndësishme e njerëzve të virtytit në veçanti është të ndërhyjnë në jetën e shoqërisë vetëm nëpërmjet pafuqisë, varfërisë dhe modestisë. Lavdi Zotit, jeta ime ka kaluar në këtë rrugë dhe vazhdon të kalojë në përputhje me këtë rrugë. Unë nuk pretendoj nga krenaria duke thënë se jam pronar i virtytit. Unë e them këtë që vijon me qëllimin e dhënies së falënderimeve ndaj Zotit xh.sh. dhe me nijetin e bërjes së njohur të një mirësie Hyjnore mbi mua:

Nëpërmjet mirësisë dhe Bujarisë së tij, Allahu i Plotëfuqishëm më dhuroi mua virtytin e punës për shkencat e besimit dhe të Kur'anit. Lavdi Zotit, gjatë jetës sime unë e kam shpenzuar këtë mirësi Hyjnore për dobinë e lumturinë e këtij kombi musliman. Dhe ashtu siç nuk e kam bërë atë asnjëherë mjetin e dominimit e të shtypjes së të tjerëve,

[2] Kjo fjalë serioze u paraqit gabimisht në fytyrën e një personi shumë të rëndësishëm i cili nuk e meritonte një goditje të tillë, por me këtë fjalë, me këto rreshta, vlen të goditet fytyra tradhëtare e këtij shekulli që mban tiraninë e tmerrshme nën maskën e lirisë.

po ashtu për një arsye të rëndësishme, unë e urrej orientimin e vëmendjes së njerëzve dhe të qenurit i pëlqyer nga ana e tyre, gjëra të cilat janë të dëshiruara nga njerëzit e pakujdesshëm; unë iki prej tyre. Njëzet vite nga jeta ime e mëparshme humbën për shkak të tyre. Prandaj unë i konsideroj ato të dëmshme për mua. Por meqenëse i shoh ato të dyja si një shenjë e drejtimit të vëmendjes së publikut ndaj Risale-i Nurit duke e pëlqyer atë, unë nuk do t'i zemëroj ata.

O Njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje! Unë në asnjë mënyrë nuk kam ndërhyrë në dynjanë tuaj, as nuk kam patur ndonjë lidhje me parimet tuaja, as nuk kam pasur ndonjë qëllim të ndërhyj përsëri në dynja, madje nuk kam aspak dëshirë për të, siç dëshmon për këtë jeta ime, të cilën e kalova si i zënë rob në internim për nëntë vjet. Atëherë, në përputhje me cilin ligj më keni dhënë gjithë këtë mbikëqyrje e shtypje sikur të kisha qenë një tiran i vjetër që paska qenë gjithmonë i gatshëm për të shfrytëzuar çdo rast dhe që paska mbështetur tiraninë dhe despotizmin? Asnjë qeveri në botë nuk do të dilte e të vepronte mbi ligjin dhe nuk do ta lejonte një trajtim të tillë të keq me të cilin trajtohem unë dhe të cilin nuk do ta pranonte asnjë njeri cilido qoftë.

Këto keqtrajtime që i bëni ndaj meje nuk ngjallin vetëm zemërimin tim, përkundrazi, ato indinjojnë të gjithë llojin njerëzor dhe, madje të gjithë universin nëse do të perceptonte.

● **Treguesi i Tretë**

Një pyetje e cila vjen në formë marrëzie e të pabazuar.

Disa anëtarë të gjyqësorit thonë: Meqenëse ti banon në këtë vend, ti duhet t'u përmbahesh ligjeve Republikane. Përse mundohesh ta shpëtosh vetveten duke iu shmangur atyre ligjeve nën perden e të jetuarit i veçuar nga njerëzit?

Për shembull, ai që ushtron fuqi e influencë mbi të tjerët jashtë detyrës së shtetit duke marrë ndonjë virtyt apo meritë për veten e tij kundërshton ligjin e qeverisë së tanishme dhe njërin nga parimet republikane i cili ka në themel barazinë. Përse i bën njerëzit të të puthin dorën ndonëse ti nuk ke ndonjë pozitë në shtet? Përse ti merr një pozitë duke reklamuar vetveten e duke thënë: "Le të më dëgjojnë mua njerëzit?"

Përgjigjja: Ata që e zbatojnë ligjin, duhet së pari ta zbatojnë për veten e tyre, pastaj mund ta zbatojnë atë për të tjerët. Të zbatosh një parim për të tjerët të cilin nuk e zbatoni për veten tuaj ju po shkelni e po kundërshtoni parimin dhe ligjin tuaj para çdokujt, sepse ju kërkoni ta zbatoni tek unë këtë ligj të barazisë absolute në një kohë që ju nuk e zbatoni për veten tuaj. Atëherë unë them këtë:

Sa herë që një ushtar i thjeshtë ngrihet në rangun shoqëror të një mareshalli dhe ndan respektin e nderimin që i drejtojnë atij njerëzit, do ta fitonte njëlloj si ai atë vlerësim të njerëzve dhe atë respekt ose sa herë që mareshalli do të bëhej si një ushtar i thjeshtë dhe do të merrte pozitën e ulët të ushtarit, ai do të humbiste të gjithë vlerën jashtë detyrës së tij.. Dhe gjithashtu sa herë që një komandant ushtarak mendjemprehtë i cili e çon ushtrinë në fitore, do të barazohej me një ushtar torollak në marrjen e vlerësimit të publikut, respektit dhe dashurisë, atëherë, siç kërkohet nga ky ligj i juaj i barazisë, ju mund të më thoni mua: "Mos e quaj veten tënde Hoxhë! Mos prano respekt nga njerëzit, mohoje virtytin tënd! Shërbeji shërbëtorit tënd dhe shoqëro lypësit."

Në qoftë se ju thoni: "Ky respekt, ky rang shoqëror dhe vëmendja publike janë të posaçme për zyrtarët gjatë ushtrimit të tyre të funksioneve të tyre, ndërsa ti nuk ke funksion, kështu ti nuk mund ta pranosh respektin e njerëzve ashtu si zyrtarët".

Përgjigjja: Në qoftë se njeriu do të përbëhej vetëm nga trupi.. dhe do të jetonte në këtë botë përgjithmonë.. dhe në qoftë se dera e varrit do të mbyllej.. dhe vdekja do të vritej.. dhe detyrat e funksionet do të kufizoheshin vetëm tek ata në ushtri dhe tek zyrtarët në qeveri.. atëherë fjala që ju thoni do të kishte ndonjë kuptim. Por meqenëse njeriu nuk përbëhet vetëm nga trupi dhe zemra e tij, gjuha, mendja e truri nuk mund të shkulen për të ushqyer trupin e tij; ato nuk mund të asgjësohen; ato gjithashtu duhet të administrohen.

Dhe meqenëse dera e varrit nuk mbyllet, dhe meqenëse ankthi për të ardhmen përtej varrit është çështja më e rëndësishme për gjithësecilin, atëherë detyrat që mbështeten mbi respektin dhe bindjen ndaj kombit kufizohen tek detyrat shoqërore, politike dhe ushtarake të cilat i përkasin jetës së kësaj dynjaje të kombit. Po, ashtu siç është një detyrë që t'u japësh një pashaportë atyre që udhëtojnë jashtë, po ashtu

është detyrë t'u japësh pashaportë atyre që udhëtojnë për në paspërjetësi dhe t'u japësh atyre një dritë për atë rrugë të errët, dhe ajo është një detyrë e tillë saqë asnjë detyrë tjetër nuk e mban rëndësinë e saj. Atëherë, mohimi i një detyre të madhe si kjo nuk është e mundur veçse duke mohuar vdekjen dhe duke përgënjeshtruar dëshminë e tridhjetë mijë xhenazeve të cilat në çdo ditë vërtetojnë pretendimin: اَلْمَوْتُ حَقٌّ "*Vdekja është një realitet*". Meqenëse ka detyra morale e shpirtërore që mbështeten mbi nevoja morale e shpirtërore dhe më të rëndësishmet e atyre detyrave të tij janë besimi, forcimi i tij, dhe udhëzimi për tek ai janë pashaporta drejt rrugës për në paspërjetësi, pishtari i zemrës në errësirat e botës së ndërmjetme dhe çelësi i banesës së lumturisë së përjetshme, atëherë nuk ka dyshim se të diturit që e kryejnë atë detyrë, detyrën e imanit, nuk i zhvlerësojnë me mosmirënjohje mirësitë Hyjnore që u janë dhuruar atyre, as nuk i përçmojnë virtytet e besimit që ua ka dhënë Zoti xh.sh., as nuk bien në nivelin e mëkatarëve dhe të të shthururve dhe as nuk e ndotin vetveten me bidatet dhe me të ligat e njerëzve të ulët. Kështu, të jetuarit i vetmuar e i veçuar nga njerëzit gjë të cilën ju nuk e pëlqeni dhe që e supozoni të jetë në kundërshtim me pabarazinë është për shkak të kësaj.

Përveç kësaj të vërtete, unë u them sa vijon jo atyre si ju që më torturoni e më mundoni dhe që me egoizmin tuaj dhe me shpërfilljen ndaj ligjit të barazisë jeni aq arrogantë sa Faraoni -sepse arrogantët e pandehin modestinë të jetë poshtërim -përulësi- kështu njeriu nuk duhet të jetë i përulur përpara arrogantëve- përkundrazi, unë u them të paanshmive, modestëve dhe të drejtëve prej njerëzve të urtë:

Lavdi Zotit, unë i njoh gabimet e mia dhe pafuqinë. Unë nuk pretendoj me arrogancë ndonjë pozitë respekti më të lartë ndaj muslimanëve që kërkojnë respekt. Përkundrazi, në mënyrë të vazhdueshme unë i shoh mangësitë e mia të pafundme dhe parëndësinë time. Duke gjetur ngushëllim nëpërmjet *istigfarit* -kërkimit të faljes- unë nuk kërkoj respekt nga njerëzit, por duatë e tyre. Unë besoj se kjo sjellja ime është e njohur tek të gjithë. Veçse ama ndodh diçka që ndërsa duke i shërbyer Kur'anit të gjithurtë dhe duke dhënë mësim të vërtetat e besimit, me qëllim që të mbroj dinjitetin dhe krenarinë e dijes të cilat i kërkon një rang i tillë, për llogari të atyre të vërtetave dhe në nderim të Kur'anit dhe me qëllim që të mos përkulem para njerëzve të

mosbesimit, unë përkohësisht e marr atë pozitë plot dinjitet. Unë nuk mendoj se ligjet e kësaj bote mund t'i kundërshtojnë këto pika!

Një trajtim i çuditshëm: Është i mirënjohur fakti se kudo mësuesit, tek njerëzit e njohjes, i gjykojnë dhe i peshojnë çështjet me peshoret e dijes e të njohjes. Kudo që ata gjejnë njohje të saktë dhe tek cilido që ata hasin njohje e dije, ata do të ushqejnë shoqërinë dhe respektin për personin për shkak të rrugës së dijes. Madje edhe në qoftë se një profesor nga një vend armik do të vinte për ta vizituar këtë vend, mësuesit do ta vizitonin atë për shkak të respektit për njohjen dhe dijen e tij dhe i shfaqin atij respekt.

Kur këshilli më i lartë shkencor i kishës Anglikane kërkoi nga meshihati islam një përgjigje me gjashtëqind fjalë për gjashtë pyetje, e cila i erdhi meshihatit, një dijetar dhe një mësues i cili hasi mosrespekt prej autoriteteve të arsimit këtu, nga njerëzit e këtij vendi, iu përgjigj atyre gjashtë pyetjeve me gjashtë Fjalë saqë përgjigja që ai dha gjeti miratim dhe admirim. Ai iu përgjigj me njohje e me dije të vërtetë parimeve më të rëndësishme e themelore të europianëve dhe të filozofëve të tyre dhe i shpartalloi. Nëpërmjet fuqisë që mori nga Kur'ani, ai i sfidoi ata filozofë europianë. Dhe në Stamboll gjashtë muaj para shpalljes së lirisë, ai u bëri ftesë dijetarëve fetarë dhe dijetarëve të shkencës moderne për të debatuar, dhe përgjigjja e tij ndaj pyetjeve të tyre pa e pyetur atë askush për ndonjë gjë; dhe ai iu përgjigj krejtësisht në mënyrë të saktë pa përjashtim të gjitha pyetjeve që iu bënë.[3]

Ata të cilët i shkaktuan pikëllimin më të madh këtij dijetari e mësuesi, i cili ia ka kushtuar të gjithë jetën e tij lumturisë së këtij kombi dhe, duke botuar qindra trajtesa në gjuhën e tij, në gjuhën turke, i ka ndriçuar ata, është edhe bashkëqytetar edhe njëfetar, i së njëjtës fe, dhe mik e vëlla, ata që kanë ushqyer armiqësi ndaj tij dhe në të vërtetë kanë qenë të parespekt ndaj tij kanë qenë disa anëtarë të institucionit arsimor si dhe disa hoxhallarë zyrtarë.

[3] Saidi i ri thotë: Unë nuk shoqëroj Saidin e vjetër në këto Fjalët e tij të cilat i thotë me krenari këtu në këtë pozitë, por unë nuk mund ta hesht atë meqenëse unë i dhashë fjalën me të drejtë në këtë trajtesë. Duke menduar, le të shfaqë ai pak egoizëm përpara egoistëve, unë preferoj të rri i heshtur ndaj tij.

Dhe kështu, hajde, çfarë ke për të thënë për këtë? A civilizim është ky? A dashuri për dijen dhe njohjen është kjo? A patriotizëm është ky? A nacionalizëm është ky? Apo thirrje për t'u kapur pas objektivave të republikanizmit? Ruajna Zot! kjo nuk është asgjë fare!

Përkundrazi, ai është Kaderi i Drejtë Hyjnor që shfaqi nëpërmjet njerëzve të dijes armiqësi ndaj këtij personi, kur ky dijetar e mësues shpresoi miqësi e shoqëri nga ana e tyre, me qëllim që të mos përzihej në dijen e tij hipokrizia për shkak të pritjes së respektit dhe që të mund të fitonte sinqeritetin.

*** * ***

Përfundim

Një sulm që në këndvështrimin tim ishte i çuditshëm, por ishte mjet për të dhënë falënderime!

Arrogantët dhe egoistët prej njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje, me një egoizëm të jashtëzakonshëm, kanë një ndjeshmëri të fortë në njohjen e egoizmit e të vetëmburrjes, saqë në qoftë se ai trajtim do të kishte qenë me vetëdije prej tyre, do të konsiderohej keramet ose një gjenialitet i madh. Kjo është si më poshtë vijon:

Nëpërmjet balancës së ndjeshme të egoizmit dhe të mendjemadhësisë së tyre, ata kapën tek unë një egoizëm të pakët hipokrizie të cilin unë nuk e pata kapur me nefsin e me mendjen time, dhe në mënyrë të tërbuar i dalin përballë këtij egoizmit tim të cilin unë nuk e kisha kuptuar.

Gjatë këtyre tetë apo nëntë viteve unë kam përjetuar tetë ose nëntë herë sa vijon: pasi ata më kanë trajtuar mua padrejtësisht e keq, unë kam bërë shqyrtime lidhur me Kaderin Hyjnor dhe kam hulumtuar rreth dredhive të nefsit tim, duke thënë:

"Përse Kaderi Hyjnor i ka bërë këta të më mundojnë mua?"

Në çdo herë unë kuptoja se nefsi im me vetëdije dhe natyrshëm prirej nga egoizmi e nga mendjemadhësia, ose ndryshe ai me dijeni më

ka mashtruar mua. Atëherë unë thashë se brenda padrejtësisë së atyre tiranëve, Kaderi Hyjnor ka vepruar me drejtësi ndaj meje.

Për shembull, në këtë verë shokët e mi më bënë mua të hipi mbi një kalë të këndshëm dhe unë e ngava atë në një fshat. Sapo u zgjua një dëshirë e përzier me egoizëm në nefsin tim për kënaqësitë e kësaj bote duke qenë i pavetëdijshëm për të, njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje e kundërshtuan atë dëshirë të fshehur timen aq me tërbim saqë ata nuk e shkatërruan vetëm atë, por gjithashtu edhe dëshirat e mia për shumë gjëra të tjera.

Në këtë herë, pas muajit të bekuar të Ramazanit dhe në një atmosferë prej sinqeritetit të vëllezërve të nderuar, devocionit të tyre dhe respektit të vizitorëve dhe mendimit të mirë të tyre, menjëherë pas vëmendjes që drejtoi drejt nesh një imam i madh i lartë i kohëve të hershme nëpërmjet një kerameti të së padukshmes, nefsi im, pa vetëdijen time, deshi, me krenari të merrte një pozitë shtinjake nën perden e të qenurit mirënjohës. Papritmas me ndjeshmërinë e tyre të fortë dhe në një mënyrë, në të cilën pikërisht grimcat e hipokrizisë të mund të ndjeheshin, njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje më sulmuan mua. Unë falënderoj Allahun e Plotëfuqishëm që tirania e tyre u bë një mjet për të fituar sinqeritetin.

رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ هَمَزَاتِ الشَّيَاطِينِ وَأَعُوذُ بِكَ رَبِّ أَنْ يَحْضُرُونِ ۞ اَللّٰهُمَّ
يَا حَافِظُ يَا حَفِيظُ يَا خَيْرَ الْحَافِظِينَ احْفَظْنِي وَاحْفَظْ رُفَقَائِي مِنْ شَرِّ النَّفْسِ وَ
الشَّيْطَانِ وَمِنْ شَرِّ الْجِنِّ وَالْإِنْسَانِ وَمِنْ شَرِّ أَهْلِ الضَّلَالَةِ وَأَهْلِ الطُّغْيَانِ
آمِينَ آمِينَ آمِينَ
سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

"Dhe thuaj: "Zoti im! Të mbështetem Ty (të më ruash) nga pështëritjet e Shejtanit".

Dhe të mbështetem Ty, O Zoti im! Se përndryshe ata do të më afroheshin".[4]

O Zot! O Mbrojtës! O Ruajtës! O më i Miri i mbrojtësve! Më ruaj mua dhe shokët nga e keqja e nefsit dhe nga e njerëzve të çudhëzimit e të mosbindjes.

Amin. Amin. Amin.

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".[5]

*** * ***

[4] Kur'an, 23:97-98
[5] Kur'an, 2:32

SHKREPTIMA E NJËZET E TRE

Trajtesa rreth Natyrës

[E shkruar si Shënimi i Gjashtëmbëdhjetë i Shkreptimës së Shtatëmbëdhjetë, kjo pjesë e Risale-i Nurit më vonë u emërtua si Shkreptima e Njëzet e Tretë për shkak të rëndësisë së saj. Sepse kjo e shkatërron tërësisht rrymën ateiste që buron nga koncepti i 'Natyrës' duke mos i dhënë më shans për t'u rimëkëmbë, dhe i rrënon plotësisht gurët themeltarë të mosbesimit.]

Një Kujtues

Kjo trajtesë shpjegon nëpërmjet nëntë '*Pamundësive*', të cilat në vetvete përmbajnë të paktën nëntëdhjetë pamundësi, se sa e paarsyeshme, e trashë e bestytnore është rruga të cilën e ndjekin Natyralistët ateistë. Meqenëse disa nga ato pamundësi janë shpjeguar pjesërisht në vende të tjera të Risale-i Nurit, ato kanë ardhur këtu të përmbledhura brenda "pamundësish" të tjera, ose kanë ardhur disi të shkurtuara.

Pyetja që më vjen në mendje është kjo: "Si është e mundur që ata filozofë të famshëm dhe të ashtuquajtur brilantë e pranuan një bestytni të turpshme të tillë, ia dorëzuan asaj mendjet e tyre dhe vazhdojnë ta ndjekin atë rrugë?

*Përgjigjja***:** Fakti se ata nuk mund as ta shohin realitetin e rrugës së tyre, as anën e brendshme të metodës së tyre, as nuk kanë kapur '*Pamundësitë*' -që ua kërkon rruga e tyre- dhe gjërat e prishura e të paarsyeshme që ua kërkon medoemos metoda e tyre, dhe ato që janë përmendur në fillimin e çdo pamundësie vijnë në këtë trajtesë. [1]

[1] Shtytësit më të fortë për të shkruar këtë trajtesë ishin sulmet që bëheshin kundra Kur'anit nga ata të cilët e quajtën bestytni çdo gjë që medjet e tyre të prishura nuk

Unë jam krejtësisht i gatshëm të shpjegoj me hollësi dhe ta provoj nëpërmjet argumenteve të qarta e vendimtare për ata që i bëjnë dyshimet dhe t'ua shpjegoj atyre në mënyrë të shtjelluar e të detajuar.



Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Të dërguarit e tyre u thanë: "(çfarë)?! A ka dyshim për Allahun, Krijuesin e qiejve e të tokës?"[2]

Duke deklaruar nëpërmjet përdorimit të një pyetjeje retorike se nuk mundet të ketë e nuk duhet të ketë asnjë dyshim rreth Allahut të Plotëfuqishëm, ky vërset demonstron qartë ekzistencën e Zotit xh.sh. dhe Unitetin e Tij.

Para se të shpjegojmë këtë mister, dëshiroj të përmend çka vijon: Kur shkova në Ankara në vitin 1920, morali i njerëzve të besimit ishte shumë i lartë si rezultat i fitores së ushtrisë islame mbi grekët. Por unë pashë se një rrymë e urryer ateizmi po përpiqej pabesisht e tradhëtisht për të prishur, helmosur dhe për të shkatërruar mendjet e tyre. "O Zot!" Unë thirra, "kjo kuçedër synon të dëmtojë themelet e besimit". Në këtë pikë, meqenëse vërseti i lartëpërmendur shpjegon në mënyrë të vetëkuptueshme ekzistencën e Allahut dhe qartësinë e unitetit të Tij, unë kërkova ndihmë prej tij dhe shkrova një trajtesë në arabisht që përbëhet nga një provë e cila u mor nga Kur'ani i gjithurtë dhe ishte mjaft e fuqishme për ta shpartalluar e dërrmuar atë rrymë ateiste. Unë e

---

mund ta kapnin, të cilët përdornin *Natyrën* për të justifikuar mosbesimin dhe të cilët i nënvlerësonin të vërtetat e besimit në mënyrën më agresive e të shëmtuar. Ato sulme ndozën në zemrën time një zemërim të madh i cili rezultoi që ata ateistë të çoroditur dhe ata shtrembërues të së vërtetës të merrnin shuplaka të forta e të rrepta. Përndryshe, rruga e ndjekur përgjithësisht nga Risale-i Nuri është e shtruar, e sjellshme dhe bindëse.

[2] Kur'an, 14:10

botova atë në Ankara në shtypshkronjën Jeni Gyn. Por, medet, ata të cilët e njihnin arabishten ishin të pakët në numër, ndërsa ata të cilët e shqyrtuan atë me seriozitet ishin të rrallë. Gjithashtu argumenti i saj ishte në një formë tej mase të përmbledhur e të shkurtuar. Si rrjedhojë, trajtesa nuk e pati efektin që duhet ta kishte dhënë dhe, me keqardhje, ajo rrymë ateizmi grufulloi, u shtua dhe fitoi fuqi. Tani unë ndjehem i detyruar ta shpjegoj përsëri atë trajtesë me provat e saja në turqisht. Meqenëse disa pjesë prej atyre argumenteve janë shpjeguar plotësisht në pjesët e tjera të Risale-i Nurit, ajo do të shkruhet në mënyrë të përmbledhur këtu.

Ato prova të shumta bashkohen pjesërisht në këtë provë; prandaj secila prej tyre mund të shikohet si një element i kësaj trajtese.

*** * ***

Parathënie

O Njeri! Ti duhet të jesh në dijeni se ndodhen disa fraza të cilat përdoren gjërësisht dhe nënkuptojnë mosbesimin. Gjithashtu edhe besimtarët i përdorin ato, por pa i kuptuar nënkuptimet e tyre të rrezikshme. Ne do të shpjegojmë tre prej më të rëndësishmeve të tyre.

E Para: Thënia e tyre për diçka: "Shkaqet e krijuan këtë".

E Dyta: Thënia e tyre për diçka: "Ajo gjë formon vetveten, formohet vetë".

Domethënë, ajo vjen në ekzistencë vetvetiu, e krijon vetë vetveten, dhe përfundon në formën tek e cila ka mbaruar, ashtu siç është ajo tani".

E Treta: Thënia e tyre për diçka: "Është natyror -joartificial; Natyra e bëri atë të domosdoshëm dhe e krijoi atë".

Po, meqenëse gjërat ekzistojnë dhe kjo nuk mund të mohohet, dhe meqenëse çdo qënie vjen në ekzistencë në një mënyrë të urtë e artistike dhe, meqenëse secila prej tyre nuk është jashtë kohës por ripërtërihet vazhdimisht, atëherë o ateist, o shtrembëruesi i së vërtetës, ti ose detyrohesh të thuash se shkaqet në botë i krijojnë gjërat, për shembull, këtë kafshë; domethënë, ajo vjen në ekzistencë nëpërmjet grumbullimit të shkaqeve, ose se ajo formon vetveten, ose se ardhja e saj në ekzistencë është një kërkesë dhe një efekt i domosdoshëm i natyrës, ose se ajo është krijuar nëpërmjet fuqisë së Krijuesit të Gjithëfuqishëm e të Gjithëlavdishëm. Meqenëse arsyeja nuk mund të gjejë asnjë rrugë përveç këtyre të katërtave, në qoftë se tre të parat janë provuar prerazi se janë të pamundura, të shfuqizuara dhe absurde, rruga e Unitetit Hyjnor, e cila është Rruga e katërt, në mënyrë të domosdoshme, të vetëkuptueshme dhe padyshim, do të provohet e vërtetë.

○ **Rruga e Parë**

Kjo është të imagjinuarit se formimi dhe ekzistenca e gjërave, krijesave, ndodh nëpërmjet grumbullimit së bashku të shkaqeve në univers. Ne do të përmendim vetëm tre nga pamundësitë e saj të shumta.

Pamundësia e Parë

Imagjino se ndodhet një farmaci në të cilën ndodhen qindra enë -kavanozë- dhe shishe të vogëla -ampula- të mbushura me substanca kimike krejtësisht të ndryshme, dhe për ndonjë arsye, ne jemi të nevojshëm për një përgatesë farmaceutike të gjallë prej atyre substancave dhe lëndëve për të përgatitur një lëndë të gjallë të jashtëzakonshme kundra helmimit.. Kur futemi në farmaci ne gjejmë në të shumë prej llojeve të asaj përgateseje farmaceutike të gjallë dhe prej asaj substance të gjallë kundra helmimit, dhe kur ne fillojmë të analizojmë e shqyrtojmë secilën përgatesë, shohim se elementet përbërës janë marrë në sasi të ndryshme por të sakta nga secila prej kavanozëve dhe shisheve të vogla; një gram prej kësaj, tre nga ajo, dhjetë gram nga tjetra dhe kështu me rradhë. Në qoftë se do të ishte marrë një gram më shumë ose më pak, përgatesa nuk do të kishte qenë e gjallë dhe nuk do ta kishte shfaqur cilësinë e saj të veçantë. Tani ne vijmë tek "substanca e gjallë kundra helmimit" dhe e studiojmë nga këndvështrimi kimik; ne shohim se përgatesat janë marrë nga shishet e vogla në një masë të caktuar saqë në qoftë se sasia më e vogël do të ishte marrë më shumë ose më pak, atëherë ilaçi do ta kishte humbur veçorinë e tij të veçantë.

Tani, megjithëse enët -shishet- janë më shumë se pesëdhjetë, përgatesat janë marrë nga secila në përputhje me masat dhe sasitë të cilat që të gjitha janë të ndryshme.

A do të ishte e mundur apo e arsyeshme që përgatesat dhe shishet e vogla të ishin goditur nga një rastësi e çuditshme ose nga një hov i befasishëm i erës dhe se vetëm sasitë e sakta, ndonëse të ndryshme, të ishin marrë prej secilës prej tyre, duhet të ishin derdhur dhe pastaj të ishin sistemuar e përgatitur vetë dhe të vinin së bashku për të formuar ilaçin e gjallë? A ka ndonjë gjë më bestytnore, më të pamundur e më absurde se sa kjo? Në qoftë se një gomar do të mund të fliste, do të thonte: "Unë nuk mund ta pranoj këtë ide!", dhe do të ikte me të katra!

E ngjashme me këtë, çdo qënie e gjallë mund t'i përngjasojë përgatesës së gjallë në krahasim, dhe çdo bimë i ngjason një ilaçi të gjallë kundra helmimit, sepse ato janë përbërë nga lënda e cila është marrë në masën më të saktë nga substanca vërtetë të shumta e të ndryshme. Atëherë, në qoftë se krijimi i kësaj qënieje të mahnitshme do t'u atribuohej shkaqeve materiale dhe elementëve dhe do të pretendohej e thuhej se "Shkaqet e krijuan këtë", kjo do të ishte e pamundur dhe absurde njëqind herë më shumë, ashtu si të pretenduarit se përgatesa farmaceutike në farmaci erdhi në ekzistencë, u krijua nga shishet e vogla të cilat u goditën rastësisht -aksidentalisht.

Shkurtazi: Substancat e gjalla në këtë farmaci të gjërë të universit, të cilat janë matur e peshuar me peshoret e Kaderit Hyjnor dhe me vendimin -dekretin- e të Gjithurtit të Gjithëditur, mund të vijnë në ekzistencë vetëm se nëpërmjet një urtësie të pakufishme, një njohje të pafundme dhe të një Dëshire gjithëpërfshirëse të gjithanshme.

Përndryshe, sa i mjerë e fatkeq është ai njeri që imagjinon se "Këto qënie janë vepra e elementeve të përgjithshme të gjithësisë, të cilat janë të verbëra e të shurdhëta që vërshojnë si rrymat; ose ato janë prej veprave të natyrës së lëndëve ose "prej veprës së shkaqeve materiale!"

Nuk ka dyshim se personi i marrë e në kllapi i cili pretendon se ai ilaç i çuditshëm u gjet vetvetiu nga përplasja e shisheve të vogla dhe nga derdhja e asaj që ishte brenda tyre, dhe si rrjedhojë e kësaj, ai formoi vetveten. Po, një mohim i tillë është kllapia e një të çmenduri dhe marrëzia e një të dehuri.

Pamundësia e Dytë

Në qoftë se krijimi i çdo gjëje nuk do t'i atribuohej të Vetmit të Gjithëfuqishëm e të Gjithëlavdishëm, por do t'i atribuohej shkaqeve materiale, atëherë do të bëhej e domosdoshme që shumica e elementeve të universit dhe të shkaqeve të tij të ndërhynin e të kishin ndikim në ekzistencën e çdo qënieje të gjallë.

Gjendja është se ardhja së bashku e shkaqeve të kundërta e të ndryshme midis tyre vetë, vetvetiu, në përputhje me një rregull të plotë, me masë të hollë dhe me një harmoni të plotë në trupin e një krijese të vogël si miza për shembull, është një pamundësi e tillë e dukshme saqë

cilido që ka mend sa krahu i një mize do ta refuzonte atë duke thënë: kjo është e pamundur, kjo është absurde.. kjo nuk mund të jetë..!

Kjo për arsye se trupi i vockël i një mize është i lidhur me shumicën e elementeve dhe të shkaqeve në univers; madje ai është një përmbledhje e tyre; në qoftë se krijimi i tij nuk do t'i atribuohej fuqisë Absolute Hyjnore, do të bëhej e domosdoshme që ato shkaqe materiale të ishin vetë të pranishëm në afërsi të menjëhershme të trupit të mizës, madje do të bëhej e domosdoshme që të hynin në trupin e saj të vogël, madje do të duhej të hynin në qelizën e syrit e cila përfaqëson modelin e trupit, sepse shkaqet në qoftë se janë të një natyre materiale është e domosdoshme që ato të jenë të pranishme në afërsi të menjëhershme dhe brenda efekteve të tyre. Dhe kjo do të bënte të domosdoshme të pranosh se pjesët përbërëse dhe elementet e universit të jenë fizikisht të pranishëm brenda asaj qelizeje të vockël, dhe të punojnë në atë qelizë shumë të vockël me mjeshtëri të lartë dhe me një harmoni si një mjeshtër.

A nuk do të turpëroheshin nga kjo fjalë edhe sofistët më të çmendur.

Pamundësia e Tretë

Është një rregull i vërtetuar se, اَلْوَاحِدُ لَا يَصْدُرُ اِلَّا عَنِ الْوَاحِدِ *"Në qoftë se një qënie ka unitet, ajo mund të dalë vetëm nga një qënie e vetme, nga një dorë e vetme".* Në mënyrë të veçantë në qoftë se ajo shfaq një jetë gjithëpërfshirëse brenda një rregulli të përkryer dhe një balance të ndjeshme, ajo demonstron në mënyrë të vetëkuptueshme se ajo nuk ka dalë prej duarve të shumta, të cilat janë shkaku i konfliktit dhe i konfuzionit, por se ajo ka dalë nga Dora e Vetme e të Gjithëfuqishmit të Gjithurtë.

Prandaj t'ia atribuosh një qënie të mirërenditur e të drejtpeshuar e cila ka një unitet të tillë, duarve të shkaqeve të shumta natyrore, të verbëra, të shurdhëta, të pajeta, të paditura, agresive, të pavetëdijshme e të rrëmujshme; verbëria dhe shurdhësia e tyre shtohet për shkak të ardhjes së tyre së bashku e të përzier midis rrugëve të mundësive të panumërta; pastaj të pretendosh se ato shkaqe e krijojnë atë qënie të mrekullueshme dhe e zgjedhin atë midis mundësive dhe probabiliteteve të pakufishme; unë them se të pranuarit e këtij atribuimi dhe këtij

pretendimi, do të ishte, në realitet, një pranim i njëqind e një pamundësive, sepse është shumë larg të gjitha peshave të logjikës dhe balancave të saj.

Le ta lëmë mënjanë këtë pamundësi dhe ta anashkalojmë përkohësisht. Le të shikojmë ndikimin e shkaqeve materiale; këto efekte mund të ndodhin vetëm nëpërmjet kontaktit dhe të prekjes së drejtëpërdrejtë. Megjithatë kontakti i shkaqeve natyrore është vetëm me anët e jashtme të qënieve të gjalla. Ndërsa ne shohim se anët e brendshme të qënieve të tilla, të cilat duart e shkaqeve as nuk mund t'i arrijnë e as nuk mund t'i prekin, janë dhjetë herë më të holla, më të mirorganizuara dhe më të përkryera lidhur me artin se sa anët e tyre të jashtme.

Madje gjallesat e vockëla dhe krijesat e holla të cilat nuk mund t'i përfshijnë kurrë këto shkaqe materiale, as nuk arrijnë tek ato duart e tyre, dhe as mjetet e tyre nuk janë më të çuditshme e më të mrekullueshme lidhur me artin dhe me krijimin se sa më të mëdhajat e krijesave, t'ia atribuosh atyre shkaqeve të verbëra, të shurdhëta, të pajeta, të paditura, të trasha, të largëta nga njëri-tjetri dhe të kundërta me njëri-tjetrin; kjo mund të shkaktohet vetëm nga një shurdhësi e një verbëri e shumëfishtë sa numri i qënieve të gjalla.

○ **Rruga e Dytë**

Kjo shprehet nga thënia e tyre për diçka, "Ajo formon vetveten, formohet vetë". Edhe kjo frazë gjithashtu përfshin shumë pamundësi dhe është absurde dhe e pamundur në shumë aspekte. Ne do të shpjegojmë tre shembuj të këtyre pamundësive.

Pamundësia e Parë

O mohues kryeneç! Egoizmi yt të ka bërë aq idiot saqë ti në një farë mënyre vendos të pranosh njëqind e një pamundësi! Sepse ti, o mohues kokëfortë, padyshim je një qënie dhe ti nuk je nga një substancë e thjeshtë dhe e pajetë që nuk pranon ndryshim; përkundrazi ti je si një makineri jashtëzakonisht e mirësistemuar që në mënyrë të vazhdueshme është duke u ripërtërirë dhe je si një pallat i mrekullueshëm anët e të cilit janë gjithmonë në transformim.. Grimcat e trupit tënd punojnë vazhdimisht dhe përpiqen pa pushim. Trupi yt ka

lidhje dhe marrëdhënie të ndërsjella me universin, në mënyrë të veçantë për sa ka të bëjë me furnizimin dhe me përjetësimin e specieve.. Grimcat që punojnë brenda trupit tënd janë të kujdesshme dhe nuk i prishin ato lidhje dhe janë të vëmendshme që mos t'i këpusin ato marrëdhënie. Në këtë mënyrë të kujdesshme ato nisin punën e tyre, sikur ta merrnin parasysh të gjithë universin; pastaj ato kontrollojnë vendndodhjen tënde në lidhje me të. Dhe ti me rolin tënd përfiton në përputhje me pozitat e mrekullueshme që marrin ato grimca dhe përfiton me shqisat e ndjenjat e tua të jashtme e të brendshme. Në qoftë se ti nuk pranon se grimcat në trupin tënd janë nëpunëse të vockëla të të Gjithëfuqishmit të Parapërjetshëm, dhe të nënshtruara e të bindura ndaj ligjeve të Tij xh.sh., ose se janë ushtarë të organizuar në ushtrinë e Tij madhështore, ose se ato janë majat e penës së Kaderit Hyjnor, ose janë pika të cilat i vë pena e fuqisë Hyjnore.. atëherë do të bëhej e domosdoshme të thoje se çdo grimcë që punon në syrin tënd duhej të kishte një sy të tillë që të mund t'i shikonte të gjitha pjesët dhe anët e trupit tënd, dhe të shikonte të gjitha qëniet që lidhen me të, të njihte të gjithë të shkuarën tënde e të ardhmen, të njihte origjinën tënde, baballarët e paraardhësit e tu së bashku me pasardhësit e tu e nipërit dhe të kapte origjinat e të gjithë elementeve të qënies tënde si dhe burimet e të gjithë furnizimit tënd.. Atëherë ajo na qenka me një mendje e zgjuarsi të madhe!! T'ia atribuosh njohjen dhe vetëdijen e një mijë Platonëve një grimceje të vetme të dikujt si ti që nuk ke as një grimcë zgjuarsi në çështjet e këtij lloji, do të ishte një bestytni e çmendur një mijë herë më shumë?!

Pamundësia e Dytë

Trupi yt, o njeri, i ngjason një pallati të mahnitshëm që ka një mijë e një kube dhe tek çdo kube qëndrojnë të varur e pa mbështetje gurët. Madje, qënia jote është një mijë herë më e mrekullueshme se sa një pallat i tillë, sepse pallati i qënies tënde ripërtërihet vazhdimisht me rregull të plotë. Duke lënë mënjanë shpirtin tënd vërtetë të mrekullueshëm, zemrën dhe aftësitë e tjera të holla shpirtërore, të cilat në vetvete janë mrekulli, dhe të merrnim në konsideratë e të shqyrtonim vetëm një gjymtyrë të vetme, cilado gjymtyrë qoftë prej gjymtyrëve të trupit tënd që secila i ngjason një banese me kube, një pjese me kube të pallatit. Ashtu si gurët e një kubeje, grimcat qëndrojnë së bashku në drejtpeshim të plotë dhe me rregull duke demonstruar se secila prej tyre është një ndërtesë e mrekullueshme, një vepër e

jashtëzakonshme arti dhe në mrekulli e fuqisë Hyjnore, si për shembull 'syri dhe gjuha'. Në qoftë se këto grimca nuk do të ishin nëpunëse të nënshtruara ndaj urdhrit të Autorit të Gjithëfuqishëm, atëherë çdo grimcë duhej të kishte një dominim absolut mbi të gjitha grimcat e tjera në trup dhe të ishte gjithashtu e varur në mënyrë absolute prej secilës prej tyre; dhe të ishte e barabartë me secilën prej tyre, dhe njëkohësisht kundra secilës prej tyre, përsa ka të bëjë me pozitën dominuese të saj! Dhe të ishte origjina e burimi i shumicës së Atributeve që i përkasin vetëm Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm, dhe të ishin krejtësisht të kufizuara, dhe në të njëjtën kohë tërësisht të lira...!

Artifakti i vetëm i mirorganizuar dhe i vënë në harmoni mund të jetë, nëpërmjet misterit të unitetit, vetëm se një vepër prej veprave të të Vetmit të Unitetit.

Çdokush me një grimcë vetëdije do ta kuptonte se çfarë pamundësie e qartë do të ishte "nëse do t'ia atribuoje një artifakt të tillë atyre grimcave".

Pamundësia e Tretë

Në qoftë se ky trupi yt nuk do të ishte shkruar nga pena e të gjithëfuqishmit të Vetëm të Parapërjetshëm, por të ishte shtypur -shkruar- nga natyra dhe shkaqet, atëherë do të bëhej e domosdoshme të ekzistonin kallëpe e tipografi në natyrë jo vetëm sa numri i qelizave në trupin tënd, por sa kombinacionet e mijëra numrave të tyre, të cilët janë përtej llogaritjes, duke filluar nga më e vogla e qelizave që punon me një kujdes të skajshëm dhe duke përfunduar tek më i gjëri i organeve që funksionon në të.

Për ta kuptuar këtë pamundësi le të marrim librin i cili është para nesh, si shembull, dhe themi: Në qoftë se beson se ky libër është i shkruar me dorë, atëherë do të mjaftonte një penë e vetme për kopjimin -transkriptimin- e tij; ajo penë do të mund ta shkruante duke u mbështetur në njohjen e shkruesit të saj; pra atë e lëviz njohja e shkruesit të saj që të shkruajë çfarë të dojë. Ndërsa, në qoftë se, nga ana tjetër, nuk do të besohej se ai është shkruar me dorë dhe në qoftë se nuk do t'i atribuohej penës së shkruesit dhe, në qoftë se do të supozohej se ai është shkruar vetvetiu, ose në qoftë se shkrimi do t'i atribuohej natyrës, atëherë, ashtu si një libër i shtypur, do të bëhej e domosdoshme që të kishte enkas për çdo shkronjë një penë metalike

dhe të ishte numri i penave sa numri i atyre shkronjave, me qëllim që ai të mund të shtypej. Në shtypshkronjë duhej të kishte një detal -pjesë-shtypi aq sa numri i shkronjave të alfabetit me qëllim që shkronjat në libër të vijnë në ekzistencë nëpërmjet tyre; do të duhej ekzistenca e penave sa numri i shkronjave në vend të një pene të vetme për ta shkruar me dorë.

Siç mund të shihet, ndonjëherë një faqe e plotë shkruhet në një shkronjë të vetme të madhe prej atyre shkronjave me një penë të vogël në një shkrim të hollë; prandaj një mijë pena do të ishin të domosdoshme për një shkronjë. Tani, çfarë do të thoje, në qoftë se ato shkronja me të gjitha pjesët përbërëse do të ishin të ndërtuara si rrathë bashkëqendrorë brenda njëra-tjetrës me një rregull të plotë e me një sistem të përkryer duke marrë formën dhe trajtën e trupit tënd? Atëherë do të bëhej e domosdoshme që për çdo pjesë përbërëse të çdo rrethi, nga rrethet e lartëpërmendur, të kishte kallëpe të shumtë sa numri i atyre kombinacioneve që ato formojnë.

Tani, supozo në qoftë se ti do ta pretendoje këtë, e cila përmban njëqind pamundësi, se është e mundshme të ndodhë! Atëherë, edhe në qoftë se do të supozohej si e mundur kjo gjendje, a nuk do të bëheshin të domosdoshme për shpikjen e atyre penave dhe për punimin e atyre kallëpeve dhe shkronjave metalike pena, kallëpe dhe shkronja aq sa numri i tyre që të derdheshin në to, në qoftë se shpikja e atyre të gjithëve nuk do t'i atribuohej një pene të vetme? Sepse të gjitha ato duhej të ishin prodhuar, të ishin vënë në rregull, të modeloheshin artistikisht dhe të ishin të nevojshme për një autor që t'i prodhonte, për një shpikës që t'i shpikte.

Atëherë, kuptoje ti gjithashtu! Kjo mënyrë e të menduarit është e tillë që përmban pamundësi e bestytni sa numri i grimcave në trupin tënd.

O Mohues...! Shikoje këtë dhe hiq dorë prej rrugës së çudhëzimit!

○ Rruga e Tretë

"Natyra e bëri të domosdoshme atë", "Natyra e bën atë". Ky pohim përmban shumë pamundësi. Ne do të përmendim tre nga ato nëpërmjet shembujve.

Pamundësia e Parë

Në qoftë se arti dhe krijueshmëria, të cilat janë të dallueshme dhe të urta, që shihen tek qëniet dhe në mënyrë të veçantë tek qëniet e gjalla nuk do t'i atribuoheshin penës së Kaderit Hyjnor dhe fuqisë së Diellit të Parapërjetshëm, por u atribuohen natyrës dhe forcës të cilat janë të verbëra, të shurdhëta dhe të pamend, atëherë do të bëhej e domosdoshme që natyra duhej të ishte e pranishme në çdo gjë, për hir të krijueshmërisë dhe duhej të ishin të pranishme makineri e shtypshkronja jolëndore të pakufishme në çdo gjë, ose do të duhej të përfshihej në çdo gjë fuqi e urtësi e mjaftueshme për të krijuar dhe administruar universin. Arsyeja për këtë është siç vijon:

Manifestimet dhe reflektimet e diellit shfaqen në të gjitha copat e vogëla të qelqit dhe në pikëlat në faqen e tokës. Në qoftë se ato diej të zvogëluar, të reflektuar dhe imagjinarë nuk do t'i atribuoheshin diellit në qiell, atëherë do të bëhej e domosdoshme që të pranohej ekzistenca e jashtme e diellit të vërtetë në çdo copë të vogël xhami më të vogël se sa një kokë shkrepëseje, e cila posedon cilësitë e diellit dhe e cila, ndonëse e vogël në masë, mban kuptim të thellë. Domethënë, do të duhej të besoje ekzistencën e diejve realë aq sa numri i copave të xhamit.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, në qoftë se krijesat dhe qëniet e gjalla nuk i atribuohen drejtëpërdrejtë manifestimit të Emrave të Diellit të parapërjetshëm, atëherë do të bëhej e domosdoshme të besoje ekzistencën e një natyre dhe të një force të cilat posedojnë fuqi absolute dhe dëshirë absolute së bashku me një njohje absolute dhe një urtësi absolute në çdo qënie dhe veçanërisht tek gjallesat; domethënë do të bëhej e domosdoshme pranimi i një Hyjnie në çdo qënie! Një ide e tillë është më absurdja dhe më bestytnorja e të gjitha pamundësive në univers. Ajo demonstron se një njeri i cili ia atribuon artin e Krijuesit të Universit Natyrës imagjinare, të papërfillshme e të pavetëdijshme, padyshim është më pak i vetëdijshëm për të vërtetën se sa një kafshë.

Pamundësia e Dytë

Në qoftë se këto qënie të cilat janë më të mirërregulluarat, më të drejtëpeshuarat, të urta dhe të modeluara artistikisht, nuk do t'i atribuoheshin Një të Vetmi i Cili është i Gjithëfuqishëm me fuqi absolute dhe i Gjithurtë me urtësi absolute, por i atribuohen natyrës,

atëherë do të bëhej e domosdoshme që në çdo grusht dheu të ishin aq shumë fabrika e shtypshkronja aq sa ndodhen në Europë me qëllim që ai grusht dheu të jetë mjeti për rritjen dhe formimin e luleve dhe të frutave të panumërta të bukura e të këndshme për të cilat është vendi i origjinës dhe punishtja. Farërat e luleve mbillen me radhë në një tas -enë- me dhé i cili kryen detyrën e një saksie për to. Një aftësi është e dukshme në grushtin e dheut që do të japë trajtat dhe format të cilat ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra për të gjitha lulet e mbjella në të. Në qoftë se ajo aftësi do t'i atribuohej fuqisë së Krijuesit të Gjithëlavdishëm e Fuqiplotë, atëherë do të duhej medoemos që të gjendej në atë grusht dheu një makineri jolëndore natyrore e veçantë për çdo lule, ose përndryshe nuk do të mund të shfaqeshin lloje lulesh e frutash që ne i shohim në ekzistencë!

Kjo është për shkak se lënda nga e cila përbëhen farërat, si spermat e vezët, është e njëjta. Domethënë, ato përbëhen nga një përzierje si brumë pa një formë të caktuar prej oksigjeni, hidrogjeni, karboni dhe nga azoti. Së bashku me këtë, meqenëse ajri, uji, nxehtësia dhe drita secila prej këtyre është e thjeshtë, e pavetëdijshme dhe vërshojnë kundra gjithçkaje si rryma, fakti se të gjitha format e ndryshme të atyre luleve shfaqen nga dheu në mënyrën më të mirërregulluar e artistike, në mënyrë të vetëkuptueshme e të domosdoshme kërkon që të jenë të pranishme në grushtin e dheut fabrika dhe shtypshkronja jolëndore të zvogëluara sa numri i fabrikave dhe i shtypshkronjave në Europë me qëllim që të endin këtë numër të madh të pëlhurave të gjalla dhe mijërat e tekstileve të ndryshme të qëndisura.

Kështu, ti mund të kuptosh se sa shumë është shmangur mendimi ateist i natyralistëve nga bota e arsyes, ndonëse pretenduesit e patru, të cilët e imagjinojnë natyrën se është krijuesi, pretendojnë se janë 'Njerëzit e shkencës e të arsyes'; shiko se sa larg arsyes dhe shkencës është mendimi i tyre; ata kanë marrë një bestytni, e cila është absolutisht e pamundur dhe e pagjasë, si një rrugë për veten e tyre. Shikoje këtë dhe tallu me ta!

Në qoftë se ti pyet: Në qoftë se pamundësi të tilla të jashtëzakonshme dhe vështirësi të pakapërcyeshme ndodhin kur qëniet i atribuohen Natyrës, atëherë si largohen ato vështirësi kur ato i atribuohen të Vetmit Krijues të Përjetshëm e Absolut? Dhe si transformohet pamundësia e vështirë në atë domosdoshmëri të lehtë?

Përgjigjja: Ne pamë në pamundësinë e parë se manifestimi i reflektimit të diellit i shfaq shkëlqimin dhe efektet e tij nëpërmjet diejve të zvogëluar imagjinarë me lehtësi të plotë dhe pa shqetësim në çdo gjë duke filluar nga grimca më e vockël e pajetë deri tek sipërfaqja më e gjërë e oqeanëve. Në qoftë se do të këputej lidhja e çdo grimce me diellin, atëherë do të bëhej e domosdoshme të pranoje se ekzistenca e jashtme e një dielli natyral -real- do të ekzistonte në secilën nga ato grimca të vockëla. Dhe këtë nuk e pranon arsyeja, madje kjo është një pamundësi, është e pamundur.

E ngjashme me këtë, në qoftë se çdo qënie do t'i atribuohej drejtëpërdrejt të Vetmit të Përjetshëm Absolut, gjithçka e domosdoshme për çdo qënie mund t'i përcjellej Atij nëpërmjet një lidhjeje dhe një manifestimi me lehtësi e kollajllëk që është në nivelin e domosdoshmërisë.

Por në qoftë se këputet lidhja dhe secila qënie do të kthehej nga pozita e saj si një nëpunëse e nënshtruar për tek qënia e saj pa detyra dhe i lihet natyrës dhe tekave të saja, atëherë do të bëhej e domosdoshme të supozoje me qindra e mijëra vështirësi e pengesa që arrijnë shkallën e pamundësisë, saqë ne shohim se krijimi i një mize të vogël do të kërkonte medoemos që tek ajo të ishte natyra e verbër duke poseduar një fuqi absolute me anë të të cilës të kishte mundësi të krijonte e ta administronte të gjithë Universin me qëllim që të mund të sillte në ekzistencë makinerinë e mrekullueshme të qënies së një qënieje të gjallë si një mizë, e cila është si një indeks i vockël i universit. Dhe kjo nuk është vetëm një pamundësi e vetme, por një mijë e një pamundësi...!

Shkurtazi: Ashtu siç është e pamundur dhe e përjashtuar për Ekzistuesin e Vetëm të domosdoshëm që të ketë ndonjë ortak apo të ngjashëm përsa ka të bëjë me Esencën e Tij, po ashtu ndërhyrja e të tjerëve në Hyjninë e Tij dhe në krijimin e Tij të qënieve është e pamundur dhe e përjashtuar.

Sa për vështirësitë e përfshira në pamundësinë e Dytë, ashtu siç është provuar në shumë pjesë të Risale-i Nurit, në qoftë se të gjitha qëniet do t'i atribuoheshin Krijuesit të Vetëm të Unitetit, atëherë të gjitha gjërat do të bëheshin aq të lehta e pa shqetësime sa një gjë e

vetme. Ndërsa në qoftë se ato do t'i atribuoheshin shkaqeve dhe natyrës, një gjë e vetme do të bëhej aq e vështirë sa të gjitha gjërat.

Kjo është demonstruar me prova të shumta vendimtare, dhe një përmbledhje e njërës prej tyre është sa vijon:

Në qoftë se një njeri është i lidhur me një mbret duke qenë një ushtar ose një nëpunës, nëpërmjet forcës së asaj lidhjeje ai mund t'i kryejë detyrat të cilat kalojnë shumë përtej forcës së tij individuale. Ai në ndonjë rast mund të zërë rob një komandant të madh në emrin e mbretit të tij, edhe pse ai është vetëm një ushtar; sepse ai vetë nuk i mban parimet dhe burimet e fuqisë të domosdoshme për të zbatuar detyrat dhe punën që ai e kryen, as nuk është i detyruar që t'i mbajë ato. Nëpërmjet lidhjes së tij me mbretin, me thesaret e Sulltanit dhe me ushtrinë e cila është prapa tij dhe është pika e tij e mbështetjes; domethënë, detyrat që ai kryen mund të jenë aq të mëdha sa puna e një mbreti, dhe aq madhështore sa aktet e një ushtrie.

Miza lidhur me atë detyrë si nëpunëse, mund të shkatërrojë një pallat të një Faraoni tiran. Mushkonja mund të vrasë një Nimrud zullumqar me fuqinë e asaj lidhje. Dhe nëpërmjet lidhjes, fara e një pishe me madhësinë e një kokrre gruri prodhon të gjitha pjesët e një peme të madhe pishe.[3]

Në qoftë se lidhja do të pritej dhe njeriu do të shkarkohej nga detyrat e tij si një nëpunës, ai do të detyrohej t'i mbante vetë pajimet dhe burimet e fuqisë të domosdoshme për vetë punën e tij.

Atëherë ai do të ishte në gjendje vetëm të kryente detyrat në përputhje me burimet e fuqisë dhe municionin që ai mundi t'i mbante.

[3] Po, duke qenë me këtë lidhje, fara merr një urdhër nga Kaderi Hyjnor dhe i shfaq ato detyra të mrekullueshme. Por në qoftë se do të këputej ajo lidhje, atëherë krijimi i asaj fare do të kërkonte aparatura, fuqi dhe mjeshtëri më shumë se sa kërkon krijimi i pemës së madhe të pishës; sepse të gjitha pjesët e pemës së pishës të cilat veshin -mbulojnë- malet dhe u shtojnë atyre bukuri e hijeshi dhe të cilat përfaqësojnë një vepër të mishëruar të qartë të Kaderit Hyjnor; do të duhej të ishin të pranishme në pemën jolëndore e cila është vepra i Kaderit Hyjnor dhe e cila është përfshirë në atë farë, sepse fabrika e asaj peme gjigante fshihet në atë farë.

Dhe pema e paracaktuar e mundshme brenda farës bëhet e dukshme në botën e jashtme nëpërmjet fuqisë së Kaderit dhe bëhet një pishë e madhe fizike. Autori

Në qoftë se atij do t'i kërkohej në këtë situatë të zbatonte detyrat e tij me lehtësinë e skajshme të situatës së parë, ai do të shfaqte paaftësinë e tij, veçse në qoftë se do të mundej të ngarkonte mbi shpinën e tij e në krahët forcën e një ushtrie të plotë dhe fabrikat e arsenalit dhe të municionit të shtetit!! Madje edhe hokatarët -klounat e cirkut-, të cilët sajojnë tregime e bestytni për t'i bërë njerëzit të qeshin, do të turpëroheshin me këtë ide trillane.

Shkurtazi: T'ia atribuosh të gjitha qëniet Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm është aq e lehtë sa të jetë e domosdoshme. Ndërsa t'ua atribuosh krijimin e tyre natyrës, është aq e vështirë sa është e pamundur dhe jashtë botës së arsyes.

Pamundësia e Tretë

Dy krahasimet e mëposhtme, të cilat janë të përfshira në pjesët e tjera të Risale-i Nurit, e shpjegojnë këtë pamundësi.

Një njeri i egër, i paqytetëruar, hyri në një pallat i cili ishte ndërtuar në një shkretëtirë të zbrazur, dhe ishte plotësuar e zbukuruar me të gjitha frutet e civilizimit. Ndërkaq ai hodhi një sy tek ana e brendshme e tij dhe pa mijëra objekte të mirëvendosura e të punuara artistikisht. Për shkak të trashësisë së tij dhe mungesës së inteligjencës, ai tha: "askush nga jashtë nuk ka pasur dorë në këtë; njëri nga objektet nga brenda duhet ta ketë ndërtuar këtë pallat së bashku me të gjitha përmbajtjet e tij", dhe filloi të hetojë dhe të hulumtojë.

Por çfarëdo gjëje që ai pa, ngurroi në të e dyshoi se ajo mund të ishte e aftë për të ndërtuar këtë pallat të mahnitshëm.

Më vonë, ai pa një bllok shënimesh në të cilin ishin shkruar plani dhe programi i ndërtimit të pallatit, një indeks i përmbajtjeve të tij dhe rregullat e administrimit të tij. Sigurisht edhe bllokut të shënimeve gjithashtu, i cili ishte pa dorë, pa sy apo pa mjet e pajisje, ashtu si objektet e tjera në pallat, i mungonte plotësisht aftësia për të ndërtuar e për të zbukuruar pallatin. Por meqenëse ai pa se në krahasim me të gjitha gjërat e tjera, blloku i shënimeve ishte i lidhur me të gjithë pallatin nëpërmjet përfshirjes së tij të të gjitha ligjeve të tij teorike, ai u detyrua të thotë: "Ja, është ky bllok shënimesh që ka organizuar, ka vënë në rregull, ka zbukuruar këtë pallat, ka modeluar të gjitha këto

objekte dhe i ka vënë ato në vendet e tyre". Ai e transformoi trashësinë e tij në një dërdëllitje qesharake.

Kështu, tamam si ky krahasim, një trashaman i cili pajtohet me mendimin natyralist, i cili mohon Zotin xh.sh., hyri në pallatin e universit, që është më i mirësistemuar, më i plotë dhe gjithandej plot me shembuj të mrekullueshëm urtësie se sa pallati në krahasim. Duke mos menduar se ajo ishte puna e artit të Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm, i Cili është jashtë sferës së mundësisë, dhe duke iu shmangur asaj ideje, ai pa një koleksion ligjesh të praktikës Hyjnore dhe një indeks të Artit Hyjnor, të cilat janë si një Pllakë për të shkruar e për të fshirë shkrimet e Kaderit Hyjnor në sferën e mundësisë dhe, ashtu si një bllok shënimesh duke ndryshuar vazhdimisht për ligjet e funksionit të fuqisë Hyjnore të cilave u jepet gabimisht Emri 'Natyra', dhe tha:

"Këto gjëra kërkojnë një shkak që t'i sjellë në ekzistencë dhe nuk ka gjë që të ketë lidhje më të madhe me to se sa ky bllok shënimesh. Dhe unë nxjerr një përfundim të arsyeshëm nga kjo se ky 'Bllok shënimesh', me ligjet e shkrimit dhe të fshirjes që ai përmban, është ai i cili i ka sjellë në ekzistencë këto gjëra përderisa unë nuk shoh të mirë të besoj në Krijuesin e Gjithëlavdishëm, pavarësisht se mendja e shëndoshë do ta refuzonte krejtësisht, brenda arsyetimit të saj, që t'ia atribuonte çështjet e Hyjnisë absolute, të cilat kërkojnë fuqi absolute, këtij '*Blloku shënimesh*' të verbër, të shurdhët e të pafuqishëm.

Ne themi: O fatkeq i marrë e i gabuar! Marrëzia jote kalon çdo gjë të imagjinueshme!

Nxirre kokën tënde nga moçali i natyrës.. që ta shohësh Krijuesin e Gjithëlavdishëm për të Cilin dëshmojnë të gjitha qëniet duke filluar nga grimcat për tek planetët me gjuhë të ndryshme dhe për të Cilin aludojnë e tregojnë tregues të ndryshëm.. Shikoji manifestimet e Atij Formëdhënësi të Gjithëlavdishëm i Cili e ndërtoi pallatin luksoz të universit dhe që shkroi planet e tij, programet dhe ligjet në atë Bllok shënimesh.. Dhe shpëtoje veten tënde nga kjo përçartje e dalldisur!

*Krahasimi i Dytë***:** Një njeri trashanik hyri në botën e civilizimit e të qytetërimit dhe atje pa uniforma të njëtrajtshme të një ushtrie tej mase të disiplinuar duke kryer ushtrime të ndryshme. Ai vëzhgoi një batalion, një regjiment dhe një divizion duke qëndruar gatitu, të lirshëm

dhe duke marshuar dhe, hapi zjarr me të marrë urdhrin sikur të ishte një individ i vetëm. Meqenëse mendja e tij e trashë dhe e pagdhendur nuk mundi ta perceptonte se udhëheqja e një komandanti madhështor ishte ajo që i zbatonte urdhërat nëpërmjet ligjeve të shtetit dhe të dekretit mbretëror, ai imagjinoi se ushtarët ishin lidhur me njëri-tjetrin me litarë.. Pastaj ai filloi të mendojë me imagjinatë se sa i çuditshëm ishte ky litar i përfytyruar. Dhe nisi t'i shtohej habia.

Pastaj, ai vazhdoi në rrugën e tij derisa ndeshi rastësisht me një Xhami madhështore si *Aja Sofia*. Ai hyri brenda saj në kohën e faljes së xhumasë dhe shikoi xhematin e muslimanëve duke u ngritur, duke rënë në *ruku* dhe duke rënë në *sexhde* dhe duke qëndruar ulur pas një burri të vetëm duke iu bindur thirrjes së tij. Meqenëse ai nuk kishte njohuri rreth sheriatit Hyjnor dhe rreth rregullave jolëndore që burojnë nga urdhërat e autorit të sheriatit, ai përfytyroi se ky xhemat janë të lidhur me njëri-tjetrin me litarë fizikë dhe, se ky litar i mrekullueshëm i ka nënshtruar ata dhe i bën të lëvizin si kukulla. Dhe duke ardhur me këtë ide, e cila është aq qesharake saqë do ta bënte edhe njeriun më injorant të shkulej së qeshuri, ai vazhdoi rrugën e tij.

Tamam si ky krahasim, një ateist i cili pajtohej me mendimin materialist, mendim i cili është mohim dhe trullosje e pastër, hyri në univers, i cili është një kazermë madhështore dhe e shkëlqyeshme e ushtarëve të Monarkut të Gjithëlavdishëm, dhe është një xhami e mirërregulluar e Atij të Adhuruari të Vetëm të Parapërjetshëm. Ai i imagjinoi ligjet jolëndore të rregullit të universit, të cilat burojnë nga "Urtësia" e Krijuesit të Parapërjetshëm që secili prej tyre të kishte një ekzistencë materiale e fizike; dhe i supozoi ligjet teorike të Sovranitetit të Hyjnisë dhe rregullat dhe urdhëresat e Sheriatit më të madh, Sheriatit të krijimit, të cilat janë jolëndore dhe ekzistojnë vetëm si njohje, i supozoi secilin prej tyre të ketë një ekzistencë të jashtme, lëndore e fizike..

Por t'i vendosësh në vend të fuqisë Hyjnore ato ligje, të cilat burojnë nga atributet e Njohjes Hyjnore dhe Fjalës Hyjnore dhe të cilat ekzistojnë vetëm si njohje, dhe t'ua atribuosh krijimin atyre; pastaj t'u japësh atyre emrin "Natyrë" dhe ta vlerësosh forcën që është vetëm një manifestim i fuqisë Hyjnore, të jetë pronarja e një fuqie vepruese dhe e plotëfuqishme e pavarur në vetvete:

A ka injorancë e marrëzi më të madhe se sa kjo? A nuk është kjo një injorancë një mijë herë më e madhe se sa injoranca në krahasim?

Shkurtazi:

Gjëja imagjinare dhe jolëndore që natyralistët e quajnë Natyrë, nuk ka një realitet; në qoftë se ajo duhet të ketë një ekzistencë reale të jashtme, atëherë kjo "ekzistencë" është: një vepër arti; ajo nuk mund të jetë Artisti. Ajo është një qëndisje dhe nuk mund të jetë Qëndistari. Ajo është një koleksion dekretesh; ajo nuk mund të jetë lëshuesi i dekreteve. Ajo është një përmbledhje e ligjeve të krijimit; ajo nuk është ligjvënësi. Ajo është vetëm një perde e krijuar për dinjitetin e Zotit xh.sh.; ajo nuk mund të jetë krijuesi. Ajo është pasive dhe e krijuar; ajo nuk mund të jetë autorja krijuese. Ajo është një ligj, jo një fuqi dhe nuk mund të posedojë fuqi. Ajo është marrëse -përfituese-, ajo nuk mund të jetë burimi.

Për të përfunduar: Meqenëse qëniet ekzistojnë, dhe ashtu siç u pohua në fillim të kësaj trajtese, mendja është e paaftë të përfytyrojë më shumë se katër rrugë për të shpjeguar ekzistencën e qënieve; dhe u provua në një mënyrë vendimtare shfuqizimi dhe pavlefshmëria e tre prej atyre katër rrugëve nëpërmjet shpjegimit të tre pamundësive të qarta në secilën prej tyre; atëherë në mënyrë të domosdoshme e të vetëkuptueshme rruga e Unitetit Hyjnor, e cila është rruga e katërt, u provua në mënyrë vendimtare e përfundimtare. Rruga e katërt, në përputhje me vërsetin e cituar në fillim:

أَفِي اللَّهِ شَكٌّ فَاطِرِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ *"... A ka dyshim për Allahun, Krijuesin e Qiejve e të Tokës?"*[4] i cili demonstron qartë e prerazi duke mos lënë vend për dyshim apo për ngurrim për ekzistencën e Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm, për Hyjninë dominuese dhe se të gjitha gjërat burojnë drejtpërdrejtë prej Dorës së Fuqisë së Tij dhe se qiejt e toka janë nën pushtetin e Tij.

O adhurues i shkaqeve!

O fatkeq i joshur pas Natyrës!

[4] Kur'an, 14:10

Meqenëse Natyra e çdo gjëje është e krijuar ashtu si vetë gjëja, sepse ajo është plot art dhe ripërtërihet vazhdimisht dhe, ashtu si pasoja, shkaku i jashtëm i çdo gjëje është gjithashtu e krijuar; dhe meqenëse për çdo gjë për të ekzistuar ka nevojë për shumë pajisje, mjete e vegla, atëherë duhet patjetër të ekzistojë një i Gjithëfuqishëm me fuqi absolute që ta krijojë gjënë dhe ta krijojë atë shkak për të, të sjellë shkakun në ekzistencë dhe, duhet medoemos që ky i Gjithëfuqishëm me fuqi absolute të jetë absolutisht i panevojshëm për ndërmjetësitë e pafuqishme që të ndajë me to Hyjninë e Tij dhe krijimin.

Ruajna Zot! Ai i krijon njëherësh shkakun dhe pasojën drejtpërdrejtë. Me qëllim që të demonstrojë Urtësinë e Tij dhe manifestimin e Emrave të Tij të bukur, duke vendosur një lidhje shkakore të dukshme e formale dhe një marrëdhënie midis tyre nëpërmjet rregullit dhe radhës, Ai i bën shkaqet dhe Natyrën një perde për Dorën e Fuqisë së Tij Madhështore dhe si një mask për Dinjitetin e Tij dhe Madhështinë me qëllim që padrejtësia e jashtme, gjendjet e rënda dhe mangësitë në gjëra t'u atribuohen atyre shkaqeve dhe, në këtë mënyrë të ruhet Dinjiteti i Tij.

A është më e lehtë për orëndreqësin të bëjë rrotat e dhëmbëzuara -ingranazhet- e një ore dhe pajisjet e saj dhe pastaj t'i rregullojë e t'i vendosë ato në gjendje të mirë për të formuar orën?

Apo është më e lehtë për atë të bëjë një makineri të jashtëzakonshme në secilën nga rrotat e dhëmbëzuara, dhe pastaj t'ua lërë bërjen e orës duarve të pajeta të atyre makinerive? A nuk është kjo përtej limiteve të mundësisë? Hajde, gjyko ti me arsyen tënde të padrejtë dhe thuaj!

Dhe a është më e lehtë për një shkrues që ta shkruajë vetë një libër pasi të sjellë gjërat e domosdoshme për shkrim, bojën, penën dhe letrën?

Apo është më e lehtë për atë shkrues që të krijojë një makinë shkrimi të veçantë për atë libër gjë e cila kërkon më shumë art dhe shqetësim se sa libri, dhe pastaj t'i thotë shtypshkronjës së pavetëdijshme: Hajde, ti shkruaje atë!", dhe vetë të mos ndërhynte? A nuk do të ishte kjo njëqind herë më e vështirë se sa të shkruarit e tij vetë?

Në qoftë se ti thua: Po, është njëqind herë më e vështirë të krijosh një makinë që të shkruajë një libër se sa ta shkruash vetë atë, veçse ama makina e shkrimit -shtypshkronja- është e aftë të botojë mijëra kopje nga i njëjti libër për një kohë të shkurtër dhe ky është mjet për lehtësim?

Përgjigjja: Nëpërmjet fuqisë së Tij Absolute, Skalitësi i parapërjetshëm në mënyrë të vazhdueshme ripërtërin manifestimet e pafundme të Emrave të Tij me qëllim që t'i shfaqë ato në mënyra gjithmonë të ndryshme. Dhe nëpërmjet kësaj ripërtëritje të vazhdueshme, Ai krijon identitetet dhe tiparet e veçanta në gjëra në një mënyrë të tillë saqë asnjë mesazh i të Adhuruarit të Përjetshëm apo libër Hyjnor nuk mund të jetë i njëjti si ndonjë libër tjetër, dhe asnjë krijesë nuk i ngjason plotësisht një krijese tjetër. Prandaj, secila do të ketë tipare të ndryshme me qëllim që të shprehin kuptime të ndryshme.

Në qoftë se ke sy, shikoje fytyrën e njeriut, që të shohësh se qysh nga koha e Ademit a.s. e deri sot dhe madje deri në paspërjetësi, së bashku me përshtatshmërinë e organeve të tyre esenciale -kryesore- çdo fytyrë ka shenjë dalluese në lidhje me të gjitha fytyrat e tjera; ky është një fakt i sigurtë. Prandaj çdo fytyrë mund të mendohet si një libër i ndryshëm; ai është një libër i pavarur në vetvete nga të tjerët.. Dhe me qëllim që ta nxjerrësh, ta botosh këtë libër të veçantë dhe për të vendosur artin mjeshtëror dhe rregullimin, do të bëhej e domosdoshme ekzistenca e grupit të plotë të shkronjave të alfabetit dhe përshtatja e tyre në madhësi me të, dhe do të kërkohej rradhitja e këtyre shkronjave në vendet e tyre prej pllakës së rradhitjes që të plotësohet një vepër e veçantë në këtë mënyrë që të jetë ndryshe nga hartimet e të tjerëve.

Dhe kjo çështje do të bënte të domosdoshme të sjellësh lëndët e veçanta për shpikjen e saj, pastaj t'i vendosësh në vendet e tyre të posaçme, pastaj të përfshish të gjitha elementet për ndërtim që kërkon ekzistenca e kësaj fytyre në vetë fytyrën, dhe kjo padyshim kërkon një uzinë, punishte të pavarur posaçërisht për të, domethënë për një shtypshkronjë të posaçme në të gjitha gjërat e saj për çdo fytyrë.

Pastaj a nuk ka nevojë kjo shtypshkronjë e veçantë -duke supozuar ekzistencën e saj për një organizim të veçantë, për një rregullim të posaçëm, atëherë edhe vetë çështja e botimit- duke lënë vënien në

rregull të shkronjave dhe rradhitjen e tyre, edhe kjo ka nevojë gjithashtu për organizim?..

Atëherë substancat që formojnë trupin e qënieve të gjalla, krijimi i të cilave është njëqind herë më e vështirë se sa ajo e rradhitjes dhe e rregullimit të lëndëve të shtypshkronjës; sjellja e këtyre lëndëve prej vendeve të botës brenda llogaritjeve e përpjesëtimeve të veçanta e me balanca të holla. Pastaj rradhitja e tyre sipas kërkesave të nevojës së saj dhe së fundi vendosja e tyre nën dorën e asaj shtypshkronje.. ky zinxhir i gjatë procesesh, domethënë me qëllim që të bëhen të gjitha këto gjëra, ka nevojë, para së gjithash, për dikë që të krijojë atë shtypshkronjë të supozuar, dhe kjo është vetëm fuqia krijuese e Krijuesit të Gjithëfuqishëm dhe Vullneti i Tij depërtues.

Kështu, mundësia e qënies së natyrës si të ishte shtypshkronjë është një bestytni krejtësisht e pakuptim..!

Atëherë, ashtu si krahasimet e orës e të librit që pamë më parë, Krijuesi i Gjithëlavdishëm, i Cili është i Plotëfuqishëm mbi të gjitha gjërat, ka krijuar shkaqet dhe pasojat. Nëpërmjet Urtësisë së Tij, Ai e lidh pasojën tek shkaku. Nëpërmjet vullnetit të Tij, Ai ka përcaktuar Natyrën e qënieve dhe i ka bërë ato një pasqyrë që reflekton manifestimet e Sheriatit më të madh, Sheriatit të krijimit, i cili përbëhet nga ligje Hyjnore të cilat lidhen me organizimin e çështjeve të universit. Dhe nëpërmjet Fuqisë së Tij, Ai e ka krijuar fytyrën e asaj natyre e cila ka marrë një ekzistencë të jashtme dhe i ka krijuar gjërat mbi atë natyrë, dhe i ka përzier ato me njëra-tjetrën me urtësinë më të plotë.

A është më e lehtë të pranosh këtë fakt, i cili është konkluzioni i shumë provave të arsyeshme të panumërta, të cilat të detyrojnë deri në shkallën e domosdoshmërisë, apo t'u japësh mjetet e panumërta dhe pajisjet e domosdoshme për ekzistencën e çdo gjëje, dhe t'ua atribuosh ato punë, të cilat kryhen me urtësi e mendjemprehtësi, vetë gjërave? Apo t'ua atribuoni atyre, që ju i quani 'Natyrë' dhe 'Shkaqe' të cilat janë lëndë të pajeta, të pavetëdijshme të krijuara, të modeluara e të thjeshta? A nuk është kjo krejtësisht përtej limiteve të mundësisë? Ne ta lëmë ty të vendosësh, me mendjen tënde të paarsyeshme!

Adhuruesi i Natyrës, ai mohues, përgjigjet duke thënë: "Meqenëse ti më fton mua të jem i drejtë dhe i arsyeshëm, unë duhet të pranoj se

rruga e gabuar që unë kam ndjekur deri tani, ashtu siç është një pamundësi e qindfishtë, po ashtu ajo është tej mase e dëmshme dhe e shëmtuar. Gjithkush që ka sa një grimcë vetëdije do ta kuptonte nga analizat e tua të lartëpërmendura se t'ua atribuosh artin e krijimit shkaqeve dhe Natyrës është krejtësisht e pamundur dhe e papranueshme, dhe që t'ia atribuosh të gjitha gjërat drejtpërdrejtë Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm është e domosdoshme dhe e arsyeshme. Unë falënderoj Allahun i Cili më udhëzoi mua në këtë besim.

"Unë besoj tek Allahu". Por, kam vetëm një dyshim:

"Unë besoj se Allahu i Plotëfuqishëm është Krijuesi, Krijuesi i gjithçkaje, por unë pyes:

Çfarë do ta dëmtonte madhështinë e Tij dhe çfarë do ta dëmtonte Sovranitetin e Hyjnisë së Tij në qoftë se do t'u jepnim ndonjë lavdërim apo vlerësim disa shkaqeve të pjesshme në krijimin e disa gjërave të pjesshme e të papërfillshme? A mos vallë kjo do ta zvogëlonte Sovranitetin e Tij në ndonjë mënyrë?"

Përgjigjja: Ashtu siç e kemi provuar në mënyrë përfundimtare në pjesët e tjera të Risale-i Nurit, shenja e sundimit është se ai refuzon e mohon ndërhyrjen. Sundimtari më i papërfillshëm ose ndonjë nëpunës zyrtar nuk do të pranonte e nuk do të toleronte as ndërhyrjen e të birit të tij brenda sferës së sundimit të tij. Madje përfytyrimi i ndërhyrjes në sundim i shtyu disa mbretër që të vrisnin fëmijët e tyre të pafajshëm pavarësisht se ata kishin diçka nga devocioni e drejtësia, gjë e cila demonstron se sa themeltar është ky ligj i refuzimit të ndërhyrjes në sundim. Ky ligj sundon në çdo gjë duke filluar nga dy guvernatorë që rivalizojnë për të administruar një qytet të vogël deri tek dy mbretër që rivalizojnë për të sunduar në një vend. Dhe gjithashtu ka treguar në një mënyrë që s'lë dyshim, *"ligjin e ndalimit të pjesëmarrjes*" të cilin e kërkon medoemos pavarësia e sundimit dhe ka sqaruar influencën dhe forcën e tij gjatë historisë së gjatë njerëzore gjë që ka çuar në përmbysje, trazira, vrasje, internime e në gjakderdhje.

Kështu, në qoftë se sensi i sundimit dhe i sovranitetit, i cili është vetëm një hije në qëniet njerëzore, të cilët janë të pafuqishëm dhe në nevojë për ndihmë, e refuzon ndërhyrjen deri në këtë shkallë, parandalon ndërhyrjen e të tjerëve, nuk pranon pjesëmarrjen në

sovranitetin e tij, atëherë në qoftë se ti ke mundësi, krahasoje këtë me Sundimtarin Absolut, sovraniteti i të Cilit është tek shkalla e Hyjnisë, sundimi i të Cilit është tek shkalla e Hyjnisë, pavarësia absolute e të Cilit është tek shkalla e Njësisë, që mungesa absolute e nevojës për të tjerët është në shkallën e fuqisë Absolute, dhe kupto se çfarë kërkese e domosdoshme dhe çfarë domosdoshmërie e pashmangshme e atij sundimi është ky mohim i ndërhyrjes, ndalimi i pjesëmarrjes dhe dëbimi i ortakëve.

Tani, bëj krahasime midis sundimit të njeriut që është i kufizuar, i ngushtë dhe i nevojshëm për ndihmën e të tjerëve dhe midis sundimit absolut të Allahut i Cili nuk ka nevojë për askënd, që është mbisundues dhe i Gjithanshëm. Lidhur me pjesën e dytë të dyshimit tënd, ti the: "Në qoftë se ndonjë adhurim prej disa gjërave të pjesshme do t'u drejtohej disa shkaqeve, çfarë mangësie do t'i shkaktonte adhurimit të të gjitha qënieve, duke filluar nga grimcat për tek planetët, adhurim i cili i drejtohet Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm, të Adhuruarit të Vetëm Absolut?"

Përgjigjja: Krijuesi i Gjithurtë i universit e bëri universin si një pemë me qënie të vetëdijshme si frutat e saj më të plotë dhe, midis qënieve të vetëdijshme e bëri njeriun frutin e saj më gjithëpërfshirës. Dhe fruti më i rëndësishëm i njeriut, madje rezultati i krijimit të tij, qëllimi i natyrës së tij dhe fruti i jetës së tij janë falënderimet e Tij dhe adhurimi.

A do të ishte e mundur me arsye që Ky Sundimtar Absolut, Ky Sovran i pavarur dhe i Vetmi në Unitet, i Cili krijoi universin me qëllim që ta bëjë Vetveten të njohur e të dashur, t'ua jepte të tjerëve njeriun, frutin e të gjithë Universit dhe falënderimet dhe adhurimet e njeriut, frutin më të lartësuar të Tij. Krejtësisht në kundërshtim me Urtësinë e Tij, a do ta bënte të kotë e pa qëllim rezultatin e krijimit dhe frutin e Universit? Ruajna Zot! A do ta pranonte Ai që t'ua jepte të tjerëve adhurimin e krijesave në një mënyrë që do të mohonte Urtësinë dhe Hyjninë e Tij? Dhe megjithëse Ai demonstron nëpërmjet akteve të Tij se Ai dëshiron ta bëjë Vetveten të njohur e të dashur në një shkallë të pakufishme, a do të mund t'i bënte Ai krijesat e Tij më të plota ta harronin Atë duke ua dorëzuar shkaqeve falënderimet e tyre dhe mirënjohjen, dashurinë dhe adhurimin, dhe t'i bënte ato të mohonin qëllimet e larta në univers?

"O shok që e ke braktisur adhurimin e Natyrës! Tani duhet që të flasësh ti!" të cilës ai iu përgjigj:

"Lavdi Zotit, tani këto dy dyshimet e mia janë larguar. Dhe dy provat e tua lidhur me Unitetin Hyjnor të cilat demonstrojnë se i Adhuruari i Vetëm i Vërtetë është Ai dhe asgjë përveç Tij nuk është i denjë për adhurim janë aq të ndritshme e të fuqishme saqë janë të pamohueshme; t'i mohosh ato do të kërkonte aq shumë arrogancë e kryeneçësi sa të mohoje diellin dhe ditën".

* * *

PËRFUNDIM

Personi, i cili braktisi Natyralizmin ateist dhe hyri në besim, tha: "***EL-Hamdu Lil-lah****" Lavdi Zotit"* Unë nuk kam më asnjë dyshim, por unë akoma kam ca pyetje rreth të cilave jam kureshtar".

Pyetja e Parë

"Ne dëgjojmë shumë njerëz dembelë dhe ata që neglizhojnë në kryerjen e pesë faljeve të përditshme të thonë: "Çfarë nevoje ka Allahu i Plotëfuqishëm për adhurimin tonë që në Kur'an Ai me ashpërsi e me ngulmim i qorton ata të cilët heqin dorë nga adhurimi dhe i kërcënon me një ndëshkim të tmerrshëm si Ferri? Si mund të harmonizohet e të bëhet koherent ky stil -tepër kërcënues ndaj një gabimi të pjesshëm e të papërfillshëm- me stilin e tij të mrekullueshëm i cili është i moderuar, i butë, i qetë dhe i mirë në vende të tjera?

Përgjigjja: Në të vërtetë, Allahu i Plotëfuqishëm nuk ka nevojë për adhurimin tuaj dhe as për asgjë tjetër absolutisht. Por ti, njeri, je ai që ke nevojë për të bërë adhurim, sepse në të vërtetë ti je i sëmurë në kuptim. Ashtu siç e kemi provuar në shumë pjesë të Risale-i Nurit, adhurimi është një lloj ilaçi për plagët shpirtërore. Në qoftë se dikush që është sëmurë do t'i përgjigjej ndonjë doktori të dhembshur e të mëshirshëm i cili ngulmon që i sëmuri të marrë ilaçe të cilat janë të dobishme për gjendjen e tij duke i thënë: "Çfarë nevoje ke ti për këtë ilaç derisa po ngulmon kaq shumë për ta përdorur? Ju mund ta kuptoni se sa absurde do të ishte kjo fjala e tij.

Sa për kërcënimet e ashpra dhe ndëshkimet e rrepta të Kur'anit lidhur me braktisjen e adhurimit, ato mund t'i ngjasojnë një mbreti i cili me qëllim që të mbrojë të "drejtat" e nënshtetasve, do t'i jepte ndëshkim të rreptë një njeriu të zakonshëm i cili ka bërë një krim që prek të drejtat e të tjerëve. Në të njëjtën mënyrë Sulltani i Parapërjetshëm e i Paspërjetshëm e ndëshkon rreptë atë që braktis adhurimin dhe faljet rituale, sepse ai shkel e dhunon në kuptim të drejtat e qënieve, të cilat janë si nënshtetëset e Atij Sulltani të Përjetshëm, dhe në fakt ai vepron padrejtësisht ndaj tyre, sepse plotësimet e qënieve manifestohen nëpërmjet lavdërimit dhe adhurimit

të kryera nga ai aspekt i tyre që orientohet drejt Krijuesit të tyre të Gjithurtë. Ai që e braktis adhurimin nuk e shikon adhurimin e qënieve dhe as nuk do të jetë në gjendje ta shohë.

Madje ai e mohon atë. Për më tepër, qëniet zënë një pozitë të lartë nëpërmjet adhurimit dhe tesbihatit të tyre, dhe secila prej tyre është një mesazh i lartë i të Adhuruarit të përjetshëm dhe si një pasqyrë për reflektimin e Emrave Dritëdhënës të Krijuesit të saj. Ai, me këtë mohim, i zbret qëniet nga pozitat e tyre të larta dhe i shikon ato si të parëndësishme, të pajeta, pa qëllim dhe pa detyra dhe, në këtë mënyrë, ai i fyen ato, i mohon, i përçmon dhe shkel e cënon plotësimet e tyre.

Po, gjithësecili shikon botën në pasqyrën e vet. Allahu i Plotëfuqishëm e krijoi njeriun në një formë me të cilën mund ta masë universin dhe mund ta vlerësojë me peshat e saj. Dhe Ai i dha njeriut një botë të veçantë prej kësaj bote të madhe. Këtë botë të veçantë Ai e ngjyros për të në përputhje me besimin e tij të sinqertë.

Për shembull, një person i dëshpëruar, dhe ankues e vajtues i shikon qëniet si vajtuese dhe në pikëllim, kurse një njeri gazmor optimist dhe i hareshëm e shikon universin si të gëzuar e të buzëqeshur. Një njeri reflektues, meditues i dhënë pas adhurimit dhe tesbihateve në mënyrë serioze zbulon e shikon deri diku adhurimin dhe tesbihatet e qënieve, madje mund t'i shohë ato si një realitet ekzistues i sigurt. Ndërsa ai që e braktis adhurimin nga pakujdesia ose që e mohon atë, ai do t'i imagjinonte qëniet në mënyrë shumë të gabuar në një mënyrë krejtësisht në kundërshtim e në opozitë me realitetin e plotësimeve të tyre, duke shkelur kështu të drejtat e tyre.

Për më tepër, ai që braktis namazin i bën gjithashtu padrejtësi vetvetes nëpërmjet lënies së tyre, pasi ai nuk është pronar i vetes së tij; ai, nefsi, është një rob i Pronarit të Tij të vërtetë, i Krijuesit dhe i Përkrahësit të tij. Pronari i tij lëshon kërcënime të rrepta me qëllim që të mbrojë të drejtat e robit të Tij nga nefsi urdhërues për të liga. Gjithashtu, meqenëse ai e ka braktisur adhurimin, i cili është rezultati i krijimit të tij dhe qëllimi i natyrës së tij, ky është si një akt agresioni kundra Urtësisë Hyjnore dhe vullnetit Hyjnor dhe, prandaj ai merr ndëshkim.

Shkurtazi: Ai që braktis adhurimin, i bën padrejtësi edhe vetes së tij, që është robi dhe krejtësisht pronë në pronësi të Allahut të

Plotëfuqishëm, dhe bën padrejtësi e shkel të drejtat e plotësimeve të universit.

Sigurisht, ashtu si mosbesimi që është një fyerje ndaj qënieve, po ashtu braktisja e adhurimit është një mohim i plotësimeve të Universit. Dhe meqenëse ky është një akt agresioni kundra Urtësisë Hyjnore, ai meriton kërcënime të rrepta dhe dënim të ashpër.

Kështu, për t'i shprehur këtë meritim dhe faktet e lartëpërmendura që zgjedh Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm në mënyrë të mrekullueshme, stili i rreptë i cili është në përshtatje me parimet e elokuencës, u korrespondon kërkesave të situatës.

Pyetja e Dytë

Personi, i cili pati braktisur Natyralizmin dhe që hyri në besim, përsëri pyeti:

"Është një e vërtetë e madhe se çdo qënie varet nga Vullneti Hyjnor dhe nga Fuqia Hyjnore në çdo aspekt; në të gjitha funksionet e saj, në cilësitë dhe në veprat. Për shkak të madhështisë e të gjërësisë së saj, mendjet tona të ngushta nuk mund ta kapin atë.

Megjithatë, bollëku i pafundmë që ne shohim përreth nesh, dhe lehtësia e pakufishme në krijimin e në formimin e gjërave dhe, kollajllëku i pafundmë e lehtësia në rrugën e Unitetit, e cila u vërtetua nëpërmjet provave të tua më parë, dhe lehtësia e pafundme që vërsetet e Kur'anit si këto që vijojnë demonstrojnë qartë dhe shpjegojnë se

مَا خَلْقُكُمْ وَلَا بَعْثُكُمْ إِلَّا كَنَفْسٍ وَاحِدَةٍ ۗ وَمَا أَمْرُ السَّاعَةِ
إِلَّا كَلَمْحِ الْبَصَرِ أَوْ هُوَ أَقْرَبُ

"Krijimi i ju të gjithëve dhe ringjallja e ju të gjithëve janë si (krijimi e ringjallja) e një njeriu të vetëm",[5] dhe

"...Dhe çështja e orës (çastit të fundit) është sa një 'hap e mbyll sytë' ose edhe më afër";[6] ato e tregojnë këtë të vërtetë madhështore të jetë një

[5] Kur'an, 31:28
[6] Kur'an, 16:77

çështje që është më e pranueshmja dhe më e arsyeshmja. Cila është arsyeja dhe sekreti i kësaj lehtësie?

Përgjigjja: Kjo çështje u sqarua në mënyrën më të qartë, më vendimtare e bindëse në shpjegimin e,



"Dhe Ai është i Gjithëfuqishëm për të gjitha gjërat" i cili formon frazën e Dhjetë të Letrës së Njëzet. Madje ajo në mënyrë të veçantë, demonstroi më qartë tek shtojca e asaj letre se kur u atribuohen Një Krijuesi të Vetëm, të gjitha qëniet bëhen aq të lehta sa një qënie e vetme. Kurse në qoftë se nuk i atribuohet Atij të Vetmit në Unitet, krijimi i një krijese të vetme bëhet aq e vështirë sa ajo e të gjitha qënieve dhe, një farë do të bëhej aq problematike sa një pemë. Kur i atribuohen Krijuesit të tyre të Vërtetë, Universi bëhet aq i lehtë e pa shqetësim sa një pemë, pema aq e lehtë sa një farë, Parajsa aq e lehtë sa pranvera dhe pranvera aq e lehtë sa një lule. Ne tani do të shpjegojmë shkurt një ose dy dëshmi prej qindra dëshmive që janë shtjelluar në detaje në pjesët e tjera të Risale-i Nurit; ato dëshmi shpjegojnë misteret dhe shembujt e urtësisë në bollëkun e dukshëm e të pakufishëm dhe në shumicën e qënieve, lehtësinë e numrit të madh të individëve në çdo specie dhe faktin se qëniet e mirërregulluara, të punuara me mjeshtëri të lartë artistike dhe të vlefshme vijnë në ekzistencë me një shpejtësi shumë të madhe dhe me lehtësi të skajshme.

Për shembull, drejtimi i njëqind ushtarëve nën komandën e një oficeri të vetëm është njëqind herë më e lehtë se sa drejtimi i një ushtari të vetëm nën komandën e njëqind oficerëve.

Dhe kur çështja e pajisjes së një ushtrie të plotë me pajimet e domosdoshme ushtarake i ngarkohet një qendre të vetme me një ligj të vetëm, një uzine të vetme dhe komandës që lëshon një komandant i vetëm, atëherë kjo do të ishte aq e lehtë dhe e kollajtë, përsa i përket sasisë dhe shumicës, sa lehtësia e pajisjes së një ushtari të vetëm. Ndërsa në qoftë se pajisja e një ushtari të vetëm me pajimet e domosdoshme ushtarake do t'u referohej qendrave të shumta, uzinave të shumta dhe komandantëve të shumtë, kjo do të bëhej aq e vështirë sa pajisja e një ushtrie të plotë, sepse me qëllim që të pajisësh një ushtar të

vetëm, do të kërkonte aq shumë fabrika aq sa janë të domosdoshme për një ushtri të plotë.

Përsëri, meqenëse nëpërmjet misterit të unitetit, domosdoshmëritë jetike të një peme sigurohen nëpërmjet një rrënje, një qendre dhe një ligji, ajo prodhon mijëra fruta me aq lehtësi sa një frut i vetëm; kjo është e qartë për shikimin. Ndërsa në qoftë se Uniteti ndryshohet me shumësinë dhe të gjitha domosdoshmëritë jetike për secilin frut do të siguroheshin nga vende të ndryshme, atëherë prodhimi i secilit frut do të bëhej aq i vështirë sa prodhimi i të gjithë pemës. Dhe madje të prodhosh një farë të vetme, e cila është një model dhe indeks i pemës, do të bëhej aq e vështirë sa pema, sepse të gjitha domosdoshmëritë jetike për jetën e pemës janë të domosdoshme edhe për farën gjithashtu.

Kështu, ndodhen qindra shembuj si këto të cilët tregojnë se është më e lehtë për mijëra qënie që të vijnë në ekzistencë nëpërmjet Unitetit se sa për një qënie të vetme për të ardhur në ekzistencë nëpërmjet shumësisë dhe të përshkruarit ortakë me Zotin xh.sh.. Meqenëse kjo e vërtetë është provuar me siguri absolute në pjesët e tjera të Risale-i Nurit, ne ua referojmë ato, dhe këtu vetëm do të shpjegojmë një mister të madh që lidhet me këtë lehtësi e kollajllëk nga këndvështrimi i Njohjes Hyjnore, i Kaderit Hyjnor dhe i Fuqisë Hyjnore, dhe ky mister është ky:

Ti je një qënie. Në qoftë se ti ia atribuon veten tënde të Gjithëfuqishmit me fuqi Absolute, Ai të krijon ty nga asgjëja me një urdhër të vetëm dhe me fuqinë e Tij Absolute për një çast, si ndezja e një fije shkrepëseje. Por në qoftë se nuk do t'ia dorëzoje veten Atij, por ia atribuon 'Natyrës' dhe shkaqeve fizike, atëherë do të bëhej e domosdoshme, për të të krijuar ty, një punë e hollë, të shoshisësh me një shoshë të hollë universin dhe elementet e tij dhe të grumbullosh në masë të saktë e të drejtëpeshuar nga të gjitha qoshet e universit substancat prej të cilave përbëhet trupi yt, sepse ti je një përmbledhje e mirorganizuar e universit, je fruti i tij i shijshëm, indeksi i tij i zvogëluar dhe lista e universit. Sepse shkaqet materiale vetëm grumbullohen e renditen. Është konfirmuar nga njerëzit e arsyes se shkaqet fizike nuk mund të krijojnë atë çfarë nuk është e pranishme në to; nga mosqënia e nga asgjëja. Prandaj ato do të detyroheshin të

grumbullonin lëndët e domosdoshme të trupit të një qënieje të gjallë të vogël nga të gjitha vendet e botës.

Kuptoje nga kjo lehtësinë absolute në Unitet e në Njësi, dhe çfarë vështirësish qëndrojnë në çudhëzim dhe në të atribuuarit ortakë Krijuesit!

Ndodhet një lehtësi absolute në krijimin dhe në sjelljen në ekzistencë që buron nga këndvështrimi i "Njohjes Hyjnore", që shpjegimi i saj i hollësishëm është siç vijon:

Kaderi Hyjnor është një lloj prej Njohjes Hyjnore; ai përcakton një masë për çdo gjë, i cili është si një kallëp i tij jolëndor dhe i veçantë; masa e paracaktuar është si një plan ose si një model për qënien e gjësë. Kur fuqia Hyjnore krijon, ajo vepron kështu me një lehtësi të skajshme në përputhje me masën e paracaktuar. Në qoftë se gjëja nuk i atribuohet të Gjithëfuqishmit të Vetëm të Gjithëlavdishëm, i Cili Zotëron një Njohje gjithëpërfshirëse të pafundme të parapërjetshme, ashtu siç u përshkrua lart, shfaqen jo vetëm mijëra vështirësi, por qindra pamundësi; sepse në qoftë se nuk do të ishte masa e paracaktuar e cila ekziston në Njohjen Hyjnore, mijëra kallëpe fizike me ekzistenca të jashtme duhet të viheshin në shërbim në trupin e madje të një qënieje të vockël.

Atëherë kupto nga kjo një mister prej mistereve të lehtësisë absolute në Unitet e në Njësi dhe vështirësitë e pafundme në çudhëzim e në të përshkruarit ortakë Allahut. Dhe mësoje se çfarë e vërtete e saktë, korrekte dhe e lartësuar shprehet nga vërseti,

وَمَآ أَمۡرُ ٱلسَّاعَةِ إِلَّا كَلَمۡحِ ٱلۡبَصَرِ أَوۡ هُوَ أَقۡرَبُ *"Dhe çështja e Orës (çastit të fundit) është sa një 'hap e mbyll sytë' ose edhe më afër".*[7]

Pyetja e Tretë

Armiku i mëparshëm dhe miku i udhëzuar drejt, tani pyeti: 'Filozofët', të cilët kanë bërë shumë përparime këto ditë, pretendojnë se asgjë nuk krijohet nga hiçi, dhe asgjë nuk asgjësohet prej

[7] Kur'an, 16:77

ekzistencës. "Ka vetëm përbërje të lëndës dhe shpërbërje të saj"! Dhe kjo e drejton këtë univers. A është kjo e saktë?"

Përgjigjja: Meqenëse filozofët më të avancuar të cilët nuk i shikuan qëniet me dritën e Kur'anit, panë se formimi dhe ekzistenca e qënieve nëpërmjet Natyrës dhe shkaqeve ishte aq e vështirë sa të jetë e pamundur -ashtu siç u provua lart në shpjegimin e mundësive dhe të pamundësive- dhe këta filozofë u ndanë në dy grupe.

Njëri grup u bë sofist; ata hoqën dorë nga arsyeja e cila është e posaçme për qëniet njerëzore dhe, duke rënë më poshtë se sa kafshët, ata e gjetën më të lehtë të mohonin ekzistencën e universit dhe madje edhe vetë ekzistencën e tyre, se sa të ndjekin rrugën e çudhëzimit, e cila pretendon se shkaqet dhe Natyra kanë fuqinë për të krijuar. Prandaj ata mohuan edhe vetveten, edhe universin dhe ranë në një injorancë absolute.

Grupi i Dytë pa se në çudhëzim, sipas të cilit shkaqet dhe Natyra janë krijues, krijimi madje i një mize apo i një fare hap vështirësi të panumërta dhe kërkon një fuqi të madhe të cilën nuk e kap arsyeja. Prandaj ata u detyruan të mohonin aktin e krijimit dhe të thonin: Asgjë nuk mund të ekzistojë prej asgjësë -të paqenës-". Duke parë gjithashtu asgjësimin e plotë të jetë i pamundur, ata deklaruan: "Ajo që ekziston nuk mund të shkojë në asgjësi".

Ata përfytyruan një situatë imagjinare në të cilën përbërja dhe shpërbërja, grumbullimi dhe shpërndarja, ndodhin nëpërmjet lëvizjes së grimcave dhe erërave të rastësisë.

Tani shiko! Ata që e konsiderojnë veten të jenë më të zgjuarit, janë më injorantët e më të çmendurit, dhe mëso nga kjo se sa qesharak, të poshtëruar e injorant e bën çudhëzimi këtë njeri të nderuar, kur ky mohon besimin. (Ne me rolin tonë i pyesim këto:)

Në të vërtetë, Fuqia e Parapërjetshme i krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë; në çdo vit krijon katërqind mijë specie në të njëjtën kohë në faqen e tokës, dhe në gjashtë javë në çdo pranverë ndërton një botë të gjallë me plot art e urtësi se sa vetë bota. Kështu do të ishte më i marrë e më injorant se sa sofistët -grupi i parë lart- të cilët mohojnë aktin e krijimit dhe që e vlerësojnë atë si të pagjasë, ashtu si një lëndë kimike e cila kur përdoret shfaq shkrimin e padukshëm (pra, ajo fuqi

krijon me lehtësi absolute si lehtësia e shfaqjes së shkrimit të padukshëm me anë të kalimit sipër tij të një lënde kimike), po ashtu fuqia e parapërjetshme duhet t'u japë ekzistencë të jashtme qënieve, të cilat, ndonëse nga ana e jashtme janë mosekzistuese, ekzistojnë si njohje dhe, planet dhe masat e të cilave janë paracaktuar në Botën e Njohjes së Parapërjetshme.

Këta fatkëqinj janë krejtësisht të pafuqishëm dhe nuk kanë asgjë në dispozicion përveç një aftësie të pjesshme dëshire. Megjithëse fryhen e mburren si Faraonë, ata as nuk mund të asgjësojnë ndonjë gjë dhe as nuk mund të krijojnë diçka prej asgjësë, dhe madje nuk mund të krijojnë as edhe një grimcë të vockël. Dhe kështu, ndonëse asgjë nuk vjen në ekzistencë prej asgjësë tek dora e shkaqeve dhe e Natyrës mbi të cilat ata mbështeten, por nga marrëzia e tyre ata thonë: "Asgjë nuk vjen nga mosqënia dhe asgjë nuk shkon në mosqënie".

Madje ata përpiqen ta përgjithësojnë e ta shtrijnë këtë parim absurd e të gabuar edhe mbi fuqinë e të Gjithëfuqishmit me fuqi absolute xh.sh..

Po, i Gjithëfuqishmi absolut i Gjithëlavdishëm ka dy mënyra krijimi:

E Para është nëpërmjet zanafillës -krijimit- dhe shpikjes.

Domethënë, Ai e krijon ekzistencën nga mosekzistenca duke e krijuar nga asgjëja, dhe krijon të gjitha gjërat e domosdoshme për këtë ekzistencë nga mosekzistenca dhe ia dorëzon ato asaj.

E Dyta është nëpërmjet kompozimit -krijimit-, nëpërmjet artit. Domethënë, Ai i formon disa qënie nga elementet e universit me qëllim që të demonstrojë shembuj të hollë urtësie dhe për të shfaqur plotësimet e Urtësisë së Tij dhe manifestimet e Emrave të Tij të bukur.. dhe për shembuj të tjerë të hollë urtësie si këto. Nëpërmjet ligjit të furnizueshmërisë, Ai ua dërgon grimcat dhe lëndën, të cilat janë të varura nga komanda e Tij, këtyre qënieve dhe i vë grimcat në punë në ato.

Po, i Gjithëfuqishmi me fuqi absolute krijon me dy mënyra; Ai krijon edhe nga zanafilla, edhe kompozon -përbën. Të asgjësuarit e asaj që ekziston dhe bërja të ekzistojë atë çfarë nuk ekziston është gjëja më

e thjeshtë e më e lehtë për Të. Kjo është një nga ligjet e Tij të qëndrueshme dhe universale. Prandaj, njeriu i cili thotë: "Ai nuk mund t'i japë ekzistencë asaj që nuk ekziston", përballë një fuqie e cila në një pranverë bën nga asgjëja të ekzistojnë format dhe cilësitë e treqind mijë qënieve të gjalla, dhe përveç grimcave të tyre, u jep të gjitha kushtet dhe gjendjet e tyre, një njeri i tillë duhet patjetër që vetë të bie në errësirën e mosekzistencës!

Personi i cili e flaku tutje Natyrën dhe që përqafoi të vërtetën tha:

Lavdi Zotit! Dhe falënderime sa numri i grimcave në ekzistencë që kam fituar besim të plotë. Unë kam shpëtuar nga mashtrimi e çudhëzimi. Të gjitha dyshimet janë larguar prej meje.

اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ عَلٰى دِيْنِ الْإِسْلَامِ وَكَمَالِ الْإِيْمَانِ

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيْمُ الْحَكِيْمُ

"LAVDI ZOTIT PËR FENË ISLAME DHE PËR PLOTËSIMIN E IMANIT!"

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që Vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti.[8]

* * *


[8] Kur'an,2:32

SHKREPTIMA E NJËZET E KATËRT

Trajtesa e Hixhabit, e veshjes islame për gratë.

[Ndërsa duke qenë çështja e dytë dhe e tretë e shënimit të pesëmbëdhjetë, kjo trajtesë u bë shkreptima e Njëzet e Katërt për shkak të rëndësisë së saj.]





Me Emrin e All-llahut i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

O Pejgamber! Thuaju bashkëshorteve të tua dhe bijave të tua edhe bashkëshorteve të besimtarëve të lëshojnë vellon (mbulesën) e tyre mbi personat e tyre (kur janë jashtë shtëpisë së tyre). Deri në fund të vërsetit[1]*...*"

Ky vërset urdhëron mbulesën e grave. Ndërsa civilizimi i shthurur e kundërshton këtë urdhër të Kur'anit; ai nuk e shikon mbulesën e grave si një çështje të natyrshme për to, por e konsideron hixhabin si një lloj skllavërie e robërie për to.[2]

[1] Kur'an, 33:59

[2] Kjo është pjesë e mbrojtjes sime për gjykatën e apelit, e cila e kundërshtoi gjykatën e Eskishehirit dhe e bëri atë të heshtë: Unë i them kësaj gjykate të drejtësisë se, në qoftë se ka ndonjë drejtësi në faqen e tokës, ajo sigurisht do ta shfuqizonte vendimin që dënon një person i cili ka shpjeguar të vërtetën më të shenjtë dhe parimin më të drejtë Hyjnor i cili ka qenë në fuqi në jetën shoqërore të treqind e pesëdhjetë milionë njerëzve në çdo shekull për një mijë e treqind e pesëdhjetë vjet, duke u mbështetur në konfirmimin dhe unanimitetin e treqind e pesëdhjetë mijë

Përgjigjja: Ne do të shpjegojmë vetëm katër prej shumë shembujve të urtësisë që tregon se kjo urdhëresë e Kur'anit është krejtësisht e natyrshme, kurse ata që e kundërshtojnë atë, dalin kundra gjendjes së natyrshme të grave.

Shembulli i parë i urtësisë

Hixhabi -mbulesa- është një çështje e natyrshme dhe këtë e kërkon vetë natyra e tyre; sepse gratë janë të dobëta e delikate dhe, meqenëse ato kanë nevojë për mbrojtjen dhe ndihmën e një burri për veten e tyre dhe për fëmijët të cilët ato i duan më shumë se sa jetën e tyre; ato kanë një dëshirë të natyrshme për t'i bërë vetvetet e tyre të dashura për të tjerët dhe jo të urryera, dhe jo të kundërshtohen -të hidhen poshtë.

Gjithashtu, shtatë nga dhjetë gra janë të vjetra ose të shëmtuara dhe ato nuk dëshirojnë që t'ia tregojnë moshën e tyre dhe shëmtinë gjithkujt. Ose ato janë xheloze dhe nuk duan të shfaqen të shëmtuara në lidhje me të tjerat të cilat janë më të bukura. Ose ato kanë frikë nga sulmet ose nga shpifjet e përgojimet, dhe dëshirojnë nga natyra të mbulojnë vetveten me qëllim që të mos pësojnë sulme dhe të mos akuzohen për mungesë besnikërie në sytë e bashkëshortëve të tyre. Në qoftë se do të vërehej me kujdes, ato që e fshehin vetveten më shumë janë të moshuarat. Dhe nga dhjetë gra, vetëm dy ose tre mund të gjenden se janë edhe të reja edhe të bukura dhe nuk bezdisen e nuk ngushtohen nga shfaqja e bukurive të tyre (e pjesëve joshëse).

Është e qartë se njerëzit bezdisen e ngushtohen nga shikimet e atyre që ata nuk i duan ose që i gjejnë të mërzitshëm; ata shqetësohen prej tyre. Në qoftë se një grua e bukur e veshur në mënyrë të pahijshme gjen kënaqësi e dëshiron ta shikojnë dy ose tre burra të cilët janë të huaj me kanon -ligj-, por ajo përfundimisht mërzitet nga shikimet e shtatë ose tetë prej tyre, madje bezdiset prej tyre. Gjithashtu, meqenëse një grua, moralet e së cilës janë të paprishura, është e ndjeshme dhe preket lehtë, ajo sigurisht do të dëshpërohej nga shikimet e pista të cilat kanë një ndikim fizik si helmi, ashtu siç është provuar. Madje ne dëgjojmë se shumë gra në Europë, që është vendi i rrobave të hapura dhe i zbulimit të grave, bezdisen duke qenë objekt i shikimit dhe

komentatorëve të Kur'anit dhe i cili ndjek besimin e stërgjyshërve tonë për një mijë e treqind e pesëdhjetë vite; ajo sigurisht do ta shfuqizonte një vendim të tillë.

ankohen në polici, duke thënë: këta njerëz të ulët brutalë na shqetësojnë duke na ndjekur me shikime."

Kjo do të thotë se heqja e mbulesës për gratë nga civilizimi i sotëm dhe zbulimi i tyre është në kundërshtim me natyrën e tyre. Dhe së bashku me qënien në përputhje me natyrën e tyre, urdhri i Kur'anit për mbulesën e tyre i shpëton gratë, ato thesare mëshire të cilat mund të jenë shoqëruese të dashura e të denja për bashkëshortët e tyre për të gjithë përjetësinë, -i shpëton- nga degradimi e poshtërimi që në efekt është skllavëri e mjerim.

Për më tepër, nga natyra gratë janë të frikësuara nga burrat të cilët janë të huaj, dhe janë të shqetësuara prej tyre. Kjo frikë natyrisht kërkon mbulesën e grave dhe moszbulimin e tyre; sepse përveç vuajtjes së vështirësisë së mbajtjes së një fëmije për tetë ose nëntë muaj, gjë e cila hidhëron dhe acaron kënaqësinë e paligjshme të tetë ose nëntë minutave; gjithashtu pastaj ekziston mundësia e vuajtjes së fatkeqësisë së rritjes së fëmijës për tetë ose nëntë vite pa mbrojtës. Dhe meqenëse këto mundësi ndodhin shpesh, gratë nga natyra i kanë frikë vërtetë burrat e huaj dhe dëshirojnë në mënyrë të natyrshme që të fshihen prej tyre. Duke qenë të dobëta, krijimi i tyre kërkon që nëpërmjet mbulimit të personave të tyre ato nuk i nxisin epshet e burrave jashtë shkallëve të paracaktuara të farefisnisë, dhe parandalojnë ndonjë rast për t'u sulmuar; natyra e tyre e dobët jep një paralajmërim të fuqishëm. Kjo tregon se mantelet -mbulesat- e tyre janë mburoja dhe kështjella të fortifikuara.

Sipas njoftimeve që kemi marrë, një lustraxhi këpucësh u vu përballë bashkëshortes së një burri me pozitë të lartë në dynja e cila ishte shalëjashtë dhe e tundoi atë në mes të ditës, në mes të kryeqytetit të vendit në 'Ankara'! A nuk është ky veprim i shëmtuar një goditje e fuqishme në fytyrat e paturpshme të atyre që e kundërshtojnë hixhabin -mbulimin- e grave!

Shembulli i dytë i urtësisë

Lidhja e fortë e besueshme dhe dashuria e thellë mes burrit dhe gruas nuk burojnë vetëm nga nevojat e jetës së kësaj dynjaje. Po, gruaja nuk është vetëm një shoqe për bashkëshortin e saj në jetën e kësaj dynjaje, përkundrazi, ajo është shoqja e tij gjithashtu në jetën e përhershme. Atëherë përderisa ajo është shoqja e bashkëshortit të saj,

në jetën e amshuar, atëherë ajo duhet të mos tërheqë shikimet e të tjerëve përveç ato të bashkëshortit të saj, mikut dhe shokut të saj të përjetshëm, dhe nuk duhet ta fyejë e ta bëjë atë xheloz. Si rrjedhojë e misterit të besimit, lidhjet e marrëdhëniet e bashkëshortit të saj me të nuk përkufizohen vetëm tek jeta e kësaj dynjaje, dhe dashuria e tij nuk është shtazore dhe e përkohshme vetëm gjatë kohës së rinisë dhe bukurisë së saj; ai mban një dashuri e respekt të sinqertë për të për sa ka të bëjë me qënien e saj si shoqja e tij në jetën e përhershme. Dhe ai e mban atë dashuri e respekt për të jo vetëm gjatë rinisë së saj kur ajo është e bukur, por gjithashtu edhe kur ajo është e vjetër dhe e shëmtuar. Atëherë përballë kësaj, gruaja gjithashtu duhet t'ia tregojë bukuritë e saj vetëm atij dhe ta përkufizojë dashurinë e saj vetëm për të; kjo kërkohet nga humanizmi. Përndryshe, ajo do të fitonte shumë pak dhe do të humbiste shumë.

Sipas sheriatit, burri duhet të jetë një bashkëshort i mirë për gruan. Domethënë, ata duhet të jenë të përshtatshëm për njëri-tjetrin. Aspekti më i rëndësishëm i kësaj përshtatshmërie është nga këndvështrimi i fesë. I lumtur është ai burrë i cili shikon fenë e qëndrueshme të bashkëshortes dhe e ndjek atë, e imiton atë, dhe vetë bëhet i përkushtuar në fe me qëllim që të mos e humbasë shoqen e tij besnike në jetën e amshuar! Dhe e lumtur është gruaja e cila e shikon qëndrueshmërinë në fe të bashkëshortit dhe vetë bëhet e devotshme në besim me qëllim që të mos e humbasë shokun e saj të përjetshëm.

Sa keq për burrin që bie në shthurje dhe të cilin do ta humbasë përgjithmonë gruaja e tij e mirë dhe e drejtë.

Dhe sa keq për gruan që nuk e ndjek bashkëshortin e saj të devotshëm dhe humbet shokun e saj të bekuar, fatlum, të përhershëm.

Dhe një mijë mjerime për bashkëshortin e bashkëshorten fatkëqinj të cilët e imitojnë njëri-tjetrin në mëkat, në të liga e në shthurje, duke e ndihmuar njëri-tjetrin për të hyrë në zjarrin e Xhehennemit.

Shembulli i tretë i urtësisë

Lumturia familjare në jetë fillon vetëm nëpërmjet mirëbesimit reciprok mes bashkëshortit e bashkëshortes dhe respektit të përzemërt dhe dashurisë së pastër ndërmjet tyre.

Veshjet e pahijshme dhe sjellja e parezervuar, e shpenguar dhe moskokëçarëse shkatërrojnë mirëbesimin dhe prishin respektin dhe dashurinë e ndërsjellë, sepse nëntë nga dhjetë gra me veshje të pahijshme, të zbuluara, hasin para tyre burra që janë më tërheqës e më të mirë se sa burrat e tyre, ndërkohë që shikon se vetëm njëra prej tyre nuk përpiqet që ta bëjë vetveten të pëlqehet nga të huajt për shkak se nuk i gjen burrat e tjerë më tërheqës se sa bashkëshortin e saj. Dhe vetëm një nga njëzet burra nuk do t'i gjente gratë e tjera më të bukura e më tërheqëse se sa bashkëshorten e tij. Atëherë përveç zhdukjes së dashurisë së vërtetë dhe respektit të ndërsjellë, kjo gjendje mund të nxiste ndjenja shumë të shëmtuara e të ulëta, siç vijon:

Nga natyra, burrat nuk ndjejnë ndonjë epsh ndaj të afërmve, farefisit si motrat e tyre, sepse meqenëse fytyrat e të afërmve të tillë zgjojnë një dhembshuri, mirësi dhe një dashuri të vërtetë për shkak të lidhjes së tyre farefisnore, kjo ndjenjë e lartë fisnike anulon e prapëson çdo prirje epshi e sensualiteti. Por lënia të zbuluar pjesët e trupit të cilat sipas sheriatit nuk lejohen të zbulohen për të afërmit si këmbët, shalët, mund t'i japë shkas zgjimit të ndjenjave tej mase të shëmtuara tek burrat me karakter të ulët, sepse fytyra e një të afërmi i kujton njeriut atë afëri farefisnore dhe nuk i ngjan fytyrës së dikujt jashtë lidhjeve të farefisnisë, prandaj kur zbulohen ato pjesë të trupit që me sheriat janë të palejueshme, atëherë në këtë barazohen ato të të afërmve me ato jashtë lidhjeve fisnore.

Për shkak të mosekzistencës së atyre shenjave dalluese që kërkojnë parandalimin e shikimit të ndaluar, është e mundur që tek disa të afërm nga fisi të zgjohen ndjenjat epshore, sensuale! Të shikosh gjëra të tilla do të ishte një degjenerim nga i cili të rrënqethet trupi.

Shembulli i katërt i urtësisë

Është e qartë se gjithësecili dëshiron të ketë shumë fëmijë. Nuk ka komb apo shtet që të mos mbështesë shtimin e popullsisë.

Profeti më i nderuar, Muhammedi a.s.m. ka thënë:

تَنَاكَحُوا تَكَاثَرُوا فَإِنِّي بَاهِي بِكُمُ الْأُمَمَ *"Martohuni që të shtoheni, sepse në Ditën e fundit unë do të krenohem me ju për numrin tuaj të madh."*[3]

Por braktisja e veshjes islame për gratë dhe zbulimi i tyre nuk e shton martesën, sepse sado i shthurur e i lirshëm të jetë i riu modern, ai e dëshiron gruan e tij të jetë e dëlirë dhe e ndershme; ai nuk e dëshiron atë të jetë e veshur në mënyrë banale, domethënë të pakujdesshme në çështjet e veshjes dhe të moraleve ashtu si vetja e tij. Prandaj ai preferon më mirë të rrijë beqar se sa të martohet. Dhe ndoshta mund të nxitet edhe në të ushtruar prostitucion. Kurse gruaja nuk është si burri pasi ajo nuk mund ta përkufizojë sjelljen e bashkëshortit të saj deri në atë shkallë.

Gruaja, meqenëse është drejtuese për të gjitha punët e brendshme të shtëpisë, dhe e ngarkuar me mbrojtjen dhe ruajtjen e të gjitha gjërave që i përkasin burrit të saj, pasurinë dhe fëmijët, atëherë veçoritë më të mëdhaja e kryesore të grave janë besnikëria dhe besueshmëria. Zbulimi i saj, pakujdesia në veshje e në moral e prish këtë besnikëri; edhe bashkëshorti i saj gjithashtu e humbet besueshmërinë tek ajo dhe e bën atë të vuajë dhimbjen e ndërjegjjes. Madje, edhe në qoftë se dy cilësitë, trimëria dhe bujaria të cilat janë të lavdërueshme tek burrat, do të gjendeshin tek gratë, ato do të konsideroheshin si cilësi të këqija, sepse shkatërrojnë këtë besnikëri e besueshmëri meqë ato çojnë në pafytyrësi e në prishje pa hesap. Por meqenëse detyra e burrit nuk përkufizohet vetëm tek ruajtja e pasurive të saj dhe lidhjes me të, por përfshin mbrojtjen e saj, mëshirën për të dhe respektin ndaj saj; dhe nuk obligohet siç obligohet gruaja; domethënë, nuk mund të kufizohet zgjedhja e tij me një grua të vetme, ai mund të martohet edhe me gra të tjera.

Vendet tona nuk mund të krahasohen me ato të Europës, sepse atje nderi mund të mbrohet deri diku nëpërmjet mjeteve të forta të tilla si dyluftimi e të tjera si kjo, pavarësisht veshjes së pahijshme -zbulimit. Një njeri që shikon ligësht gruan e një njeriu sedërmadh -krenar- ai do të duhej më parë që ta marrë qefinin e vet në qafën e tij. Gjithashtu njerëzit e Europës janë të ftohtë e të ngrirë si klima e tyre.

[3] Transmetojnë Bejhekiu... etj

Ndërsa këtu në vendet islame, ato janë nga vendet e nxehta në krahasim me Evropën. Është i mirënjohur fakti se ambjenti ka një ndikim të madh në moralin e njerëzve. Ndoshta në ato vende të ftohta veshjet e pahijshme, zbulimi, nuk e nxisin epshin dhe nuk i zgjojnë dëshirat sensuale të atyre njerëzve të ftohtë, dhe nuk mund të jenë mjete abuzimi. Ndërsa veshja e pahijshme e cila vazhdimisht nxit epshet shtazore të njerëzve të ndjeshëm të vendeve të nxehta të cilët ndikohen shpejt, sigurisht bëhet shkak për shumë abuzime, shthurje, dhe për dobësimin e brezit të ri, e pasardhësve dhe për humbjen e fuqisë. Në vend të përgjigjjes së nevojave natyrale një herë në muaj ose në çdo tri javë e kështu, burri e konsideron të domosdoshme në çdo pak ditë.

Atëherë, meqenëse ai është i detyruar t'i shmanget gruas së tij për ndoshta dy javë të çdo muaji për shkak të mundësive si menstruacionet, në qoftë se ai do të mposhtej nga epshi i tij, ai do të prirej e nxitej për tek shtëpitë famëkeqe.

Pastaj, banorët e qytetit nuk duhet të imitojnë banorët e fshatrave dhe të nomadëve në jetën e tyre shoqërore dhe të heqin hixhabin mes tyre, sepse banorët e fshatrave janë të zënë me prokopinë e jetesës dhe ata janë të detyruar të harxhojnë shumë energji trupore për të siguruar jetesën e tyre. Shumë shpesh gratë marrin pjesë në punë të lodhshme, prandaj nuk i nxit ajo çfarë mund të zbulohet prej trupave të tyre të ashpra dëshirat shtazore tek të tjerët.

Për më tepër, meqenëse nuk gjenden në fshatra burra dembelë e parazitë aq sa janë në qytete, atëherë as një në dhjetë prej njerëzve imoralë të qyteteve të mëdha nuk mund të gjendet midis tyre. Prandaj nuk mund të krahasohen qytetet me fshatërat dhe vendet nomade.

*** * ***

Një bashkëbisedim me gratë, motrat e mia besimtare të Ahiretit.

بِاسْمِهِ سُبْحَانَهُ

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Në kohën kur u riktheva në Ispartën e bekuar për herë të tretë, e cila mban kuptimin e *Medresetu Ez-Zehra*, unë pata parë interesimin e sinqertë e të entuziazmuar i treguar nga gratë për Risale-i Nurin në disa provinca të tjera dhe, pata kuptuar se ato kishin besim në mësimet dhe udhëzimet e mia që u përkasin dritës në një mënyrë që tejkalonte shumë hakun e meritës time. Pastaj unë dëgjova se gratë në Isparta, motrat e mia të bekuara të Ahiretit, po prisnin për të marrë mësim nga unë, si shembulli i dhënies së dersit dhe vazit -mësimeve, predikimeve- në xhami. Unë isha i sëmurë me pesë a gjashtë sëmundje të ndryshme në një gjendje të mjeruar, madje nuk kisha fuqi as për të folur e menduar. Megjithatë iu shfaq zemrës sime në këtë natë një inspirim i fuqishëm, siç vijon:

Ti shkrove para pesëmbëdhjetë vitesh "*Udhëzuesin për të rinjtë*" me kërkesën e disa të rinjve dhe nga ajo vepër përfituan shumë. Ndërsa gratë kanë shumë nevojë si shembulli i këtij 'udhëzuesi' në këtë kohë.

Pavarësisht dobësisë sime të madhe, mjerimit dhe pafuqisë, përballë këtij inspirimi, unë shkrova në mënyrë shumë të përmbledhur në tre pika një numër të çështjeve të domosdoshme të cilat tani do t'ua shpjegoj motrave të mia të bekuara, të rejave dhe bijave të mia shpirtërore.

● **Pika e Parë**

Meqenëse njëri nga parimet themelore të Risale-i Nurit është "Dhembshuria" dhe se gratë janë kampionet e mëshirës, dhembshurisë, ato nga natyra janë më të lidhura ngushtë me Risale-i Nurin se sa të

tjerët. Lavdi Zotit, kjo simpati natyrale, kjo lidhje e natyrshme, ndjehet në shumë vende. Vetëflijimi brenda kësaj dhembshurie nuk kërkon asgjë në shkëmbim dhe shpreh sinqeritetin e vërtetë dhe gjithashtu ka rëndësinë më të madhe në këtë kohë.

Po, fakti se duke mos kërkuar asgjë si shkëmbim, një nënë do të vetëflijonte edhe jetën e saj për të shpëtuar nga rreziku fëmijën e saj, si kërkesën e natyrës së saj dhe me sinqeritet të vërtetë, tregon se gratë janë të afta për heroizëm të madh. Nëpërmjet zhvillimit të këtij heroizmi, ato mund t'i shpëtojnë jetët e tyre edhe në këtë dynja, edhe në Ahiret nëpërmjet tij.

Përndryshe, kjo cilësi e rëndësishme nuk do të zbulohej nën ndikimin e disa rrymave të këqija mendimi, ose ato rryma do ta shfrytëzonin këtë cilësi duke e keqpërdorur e duke e orientuar pa vend.

Një shembull i vogël nga qindra të tillë është sa vijon:

Një nënë zemërdhembshur ndërmerr çdo lloj vetëflijimi me qëllim që fëmija e saj të mos bie në rrezik në jetën e kësaj bote dhe me qëllim që ta bënte atë të përfitojë në dynja; dhe ajo e rrit fëmijën e saj mbi këtë parim, dhe shpenzon të gjithë pasurinë e saj me qëllim që i biri i saj të bëhet pasha, dinjitoz e drejtues. Ti e sheh nënën ta marrë djalin e saj prej shkollave të dijeve fetare dhe e dërgon atë në Evropë, duke mos menduar për jetën e përhershme të djalit të saj që i kërcënohet me rreziqe. Ajo përpiqet ta shpëtojë atë nga burgu në këtë botë dhe nuk shqetësohet për rënien e tij në burgun e xhehennemit të përhershëm. Dhe duke vepruar në mënyrë krejtësisht të kundërt me natyrën e saj të brendaqenësishme, ajo e bën djalin e saj të pafajshëm një pretendues kundra saj në Ahiret, në një kohë që ai duhet të ishte një ndërmjetësues për të, për shefaat. Djali do të ankohet për të duke i thënë: "Përse nuk e forcove besimin tim dhe kështu u bëre shkak që unë të humbas?" Edhe në këtë dynja gjithashtu, meqenëse ai nuk mori një edukim të përshtatshëm islam ai nuk mund t'i përgjigjet dhembshurisë së jashtëzakonshme të nënës së tij në mënyrën që ajo e meriton; madje ai mund të neglizhojë shumë në përmbushjen e të drejtës së saj.

Por, në qoftë se përpiqet ajo nënë për ta shpëtuar djalin e saj të dobët prej burgut të përhershëm i cili është xhehennemi dhe nga asgjësimi i përhershëm i cili është vdekja në çudhëzim, nëpërmjet dhembshurisë së saj të vërtetë të natyrshme duke mos e keqpërdorur,

atëherë djali i saj në mënyrë të vazhdueshme do t'i dërgojë drita shpirtit të saj pas vdekjes së saj, pasi shkruhen në regjistrin e punëve të saj barasvlera e të gjitha veprave të mira që i kryen djali. Gjithashtu në Ahiret, ai nuk do të jetë një ankues e pretendues kundra saj, por me të gjithë shpirtin dhe jetën e tij do të jetë një ndërmjetësues për të dhe një djalë i bekuar për të gjithë përjetësinë.

Po, profesori i parë i njeriut dhe mësuesi me ndikim më të madh për të është nëna e tij. Në lidhje me këtë, unë do t'ju shpjegoj këtë kuptim të cilin e kam ndjerë gjithmonë fort në personin tim i cili është sa vijon:

Unë jam tetëdhjetë vjeç dhe kam marrë mësime prej tetëdhjetë mijë njerëzve. Por betohem në Zotin xh.sh. se mësimet më të ngulitura dhe më të vërteta që kam marrë, janë ato të ngulitura tek unë nga nëna ime e ndjerë, mësime të cilat kanë mbetur gjithmonë të freskëta tek unë. Ato janë ngulitur në natyrën time si të ishin farëra të mbjella në qënien time fizike. Unë vëzhgova se mësimet e tjera që kam marrë janë ndërtuar mbi ato farëra. Domethënë, mësimet e ngulitura në natyrën dhe në shpirtin tim nga nëna ime kur isha një vjeç, unë tani i shoh në moshën e tetëdhjetave si farërat themelore midis të vërtetave të mëdhaja. Për shembull:

Dhembshuria që është parimi më i rëndësishëm prej katër parimeve të rrugës e të metodës sime në jetë.. dhe butësia dhe mëshira të cilat janë gjithashtu e vërteta më e madhe prej të vërtetave të Risale-i Nurit, i shoh ato të dyja me siguri se ato burojnë nga veprat e asaj nëne të dhembshur dhe nga gjendjet e saja të mëshirshme dhe prej mësimeve të saj shpirtërore.

Po, dhembshuria dhe butësia e amësisë -e nënës- të cilat mbajnë sinqeritetin e vërtetë dhe vetëflijimin e vërtetë, po keqpërdoren në kohën aktuale, pasi nëna nuk mendon për thesaret që do të fitojë djali i saj në Ahiret të cilat janë më të çmueshme se sa diamanti, madje ajo ia kthen fytyrën drejt kësaj dynjaje, e cila u ngjason copave të përkohshme të xhamit dhe e shfaq dhembshurinë dhe butësinë ndaj djalit të saj në këtë aspekt të jetës. Dhe një sjellje e tillë është keqpërdorimi i asaj dhembshurie.

Një provë e këtij heroizmi të grave lidhur me dhembshurinë, e cila nuk kërkon asnjë shpërblim dhe absolutisht asgjë si shkëmbim apo kompensim dhe pa marrë asnjë përfitim për veten e tyre pa ndonjë

hipokrizi dhe pa dashur t'i bëjnë personat e tyre të duken, është gatishmëria e tyre për të vetëflijuar edhe shpirtërat e tyre për hir të fëmijës. Provë për këtë është se pula e cila mban një shembull të zvogëluar të asaj dhembshurie, mëshire -dhembshurinë e nënës-, do ta sulmonte edhe luanin, dhe jetën e saj për të ruajtur zogjtë e saj të vegjël.

Në ditët e sotme, gjëja më e domosdoshme dhe parimi më i rëndësishëm në edukimin islam dhe në punët e Ahiretit është 'sinqeriteti'. Një sinqeritet i tillë duhet të gjendet në heroizmin e këtij lloji dhembshurie. Në qoftë se këto dy pika fillojnë të zhvillohen në atë grupim të bekuar, në grupin e grave, sigurisht ato do të ishin boshti i lumturisë më të madhe në botën islame.

Sa për vetëflijimin e baballarëve, burrave, ai nuk mund të jetë kurrë për asgjë apo pa kompensim; ata gjithmonë kërkojnë kompensim në ndoshta njëqind mënyra. Të paktën ata kërkojnë lavdi e famë. Por, me keqardhje, gratë e bekuara praktikojnë hipokrizinë dhe shtirjen në një formë tjetër me qëllim që të shpëtojnë nga e keqja dhe shtypja e burrave tiranikë; ky lloj buron nga dobësia dhe pafuqia e tyre.

●Pika e Dytë:

Këtë vit, pavarësisht tërheqjes sime nga jeta shoqërore dhe qënies sime i veçuar në vetmi, hodha vështrimin tek dynjaja për hir të disa vëllezërve e motrave të mia të cilët ishin studentët e Risale-i Nurit. Nga shumica e shokëve të mi të cilët erdhën për vizitë tek unë dëgjova ankesa rreth jetës së tyre familjare. U dëshpërova thellë nga kjo dhe thashë:

"Ah sa keq! A paska filluar edhe kjo të prishet gjithashtu? Jeta familjare është kështjella e fortifikuar e njeriut dhe veçanërisht e muslimanëve; Ajo është si xhenneti i tij i zvogëluar dhe bota e tij e vogël".

Ndërkohë kërkova të gjej arsyen e prishjes së saj dhe kuptova se ndodheshin organizata të fshehta që përpiqeshin të humbisnin të rinjtë dhe t'i prishnin ata duke i nxitur tek të ligat nëpërmjet epsheve të tyre me qëllim që të prishin jetën sociale të islamit dhe, si rrjedhojë t'i shkaktonin dëm fesë islame.

Unë gjithashtu kuptova se organizatat punonin në fshehtësi dhe në mënyrë të goditur për t'i shtyrë gratë e shkujdesura në rrugë të gabuar. Unë kuptova gjithashtu se një goditje e fuqishme do t'i vinte këtij kombi musliman nga ai drejtim. Dhe kështu unë deklaroj prerazi ç'ka vijon për ju motrat e mia dhe për bijat e mia shpirtërore.

Ilaçi i vetëm i dobishëm për shpëtimin e lumturisë së grave, dhe lumturia e tyre në këtë botë si dhe ruajtja e cilësive të tyre të larta të bashkëlindura, nga korrupsioni, është edukimi i tyre fetar brenda sferës së gjërë të islamit; nuk ka mjet tjetër shpëtimi. Ju dëgjoni rreth situatës në të cilën kanë rënë gratë e mjera të Rusisë!

Është thënë në një pjesë të Risale-i Nurit:

Burri i mençur nuk e ndërton dashurinë e tij mbi një bukuri të jashtme kalimtare që vazhdon nga pesë deri në dhjetë vite; përkundrazi, ai duhet ta ndërtojë dashurinë e tij për të mbi dhembshurinë e saj e cila është më e qëndrueshmja dhe më e mira e bukurisë, dhe e lidh atë me sjelljen e saj të mirë e cila është e veçantë për qënien e saj femër, me qëllim që të vazhdojë dashuria e tij për të sa herë që ajo grua e mjerë përparon në moshë, në vite, sepse bashkëshortja e tij nuk është vetëm një ndihmëse dhe një shoqe e përkohshme në jetën e kësaj dynjaje, por një shoqe e përjetshme dhe e dashur për jetën e amshuar. Prandaj sa më shumë të plaken aq më shumë shtohet dashuria, dhembshuria dhe respekti për njëri-tjetrin.

Ndërsa jeta familjare, e cila zhvillohet nën maskën e civilizimit modern, është e zbuluar para shkatërrimit e prishjes, meqë ajo e ndërton lidhjen mbi një shoqërim të përkohshëm që ndiqet nga një ndarje e përjetshme.

Gjithashtu është thënë në një pjesë tjetër të Risale-i Nurit:

"Fatlum është ai bashkëshort i cili imiton gruan e tij të drejtë dhe bëhet edhe vetë i drejtë, që të mos humbasë shoqen e tij të përjetësisë.

Dhe e lumtur është gruaja e cila duke e parë bashkëshortin të jetë i drejtë, e ndjek atë në fe me qëllim që të mos e humbasë shokun dhe mikun e saj të përjetshëm.

Fatkeq është burri i cili e ndjek gruan e tij në mëkat, që nuk e bën atë të heqë dorë nga mëkati por e shoqëron atë në mëkat.

Sa fatkeqe është ajo grua e cila e shikon shthurjen dhe mëkatimin e burrit të saj, e ndjek atë në një mënyrë tjetër!

Dhe sa keq për bashkëshortin dhe bashkëshorten të cilët e ndihmojnë njëri-tjetrin për hedhje në zjarr. Domethënë, të cilët e ndjekin njëri-tjetrin për të përqafuar të këqijat e civilizimit".

Kuptimi i këtyre rreshtave nga Risale-i Nuri është ky: Në këtë kohë mjeti i vetëm për edukimin dhe zhvillimin e jetës familjare dhe për gjetjen e lumturisë në këtë botë dhe në Ahiret, dhe për t'i zhvilluar cilësitë e lavdërueshme të grave, është etika islame brenda limiteve të sheriatit.

Tani, pika më e rëndësishme në jetën familjare është kjo: në qoftë se gruaja shikon sjellje të keqe, pabesi e tradhëti tek bashkëshorti i saj dhe, për inat të tij edhe ajo heq dorë dhe braktis detyrën e saj familjare e cila është besnikëria dhe besueshmëria duke u prishur të dy, atëherë si rrjedhojë, sistemi i asaj familje mjegullohet e ngatërrohet plotësisht tamam si prishja e disiplinës në ushtri. Prandaj gruaja duhet të përpiqet të plotësojë mangësinë e bashkëshortit të saj dhe të rregullojë gabimet me qëllim që ta shpëtojë shokun e saj të përjetësisë.

Në qoftë se ajo fillon ta shfaqë vetveten tek të tjerët duke e zbuluar vetveten dhe përpiqet ta bëjë vetveten tërheqëse për të tjerët, kjo do të ishte e dëmshme në çdo drejtim. Sepse ai që e braktis besnikërinë, e gjen dënimi edhe në këtë botë gjithashtu, sepse natyra e saj është e frikësuar dhe e shqetësuar nga shikimet e atyre jashtë caqeve të farefisit, dhe u shmanget atyre. Ajo shqetësohet dhe ruhet nga shikimet e tetëmbëdhjetë prej njëzet personave të huaj, kurse burri mund të shqetësohet nga shikimi i një gruaje të vetme prej njëqind grave të cilat janë të huaja për të. Gruaja ashtu siç vuan tortura nga ky drejtim dhe gjithashtu mund të akuzohet për pabesi e tradhëti, po ashtu për shkak të dobësisë së saj, ajo nuk do të jetë në gjendje të mbrojë të drejtat e saj.

Shkurtazi: Ashtu si në aspektin e dhembshurisë që gratë nuk u ngjasojnë burrave në heroizëm e në sinqeritet dhe burrat nuk mund të krahasohen me ato në atë drejtim -në mëshirë-, po ashtu gratë e pafajshme nuk munden kurrësesi të krahasohen me burrat në të keqe.

Për këtë arsye, nga natyrat e tyre dhe nga dobësia, ato janë vërtet të frikësuara nga të huajt dhe i gjejnë vetvetet e tyre të detyruara që të mbrohen me Hixhab -mbulesë- sepse në qoftë se një burrë bën mëkat, abuzon, për kënaqësinë e tetë minutave, ai vuan dhe pëson vetëm një dëm prej tetë lirash. Ndërsa si dënim për kënaqësinë e mëkatit të tetë minutave, në këtë botë gjithashtu gruaja mban një peshë të rëndë për tetë muaj dhe pastaj ka vuajtjen dhe mundimin e rritjes së fëmijës së pambrojtur për tetë vite. Prandaj ajo nuk mund të konkurojë me burrat në shthurje e në imoralitet dhe si rrjedhojë, ajo paguan një gjobë njëqind herë më të madhe se sa ajo e burrave.

Këto incidente jo të rralla tregojnë se gratë nga natyra janë burimi i moraleve të lartësuara; kështu atyre pothuajse u mungon kapaciteti për shthurje e poshtërsi lidhur me kënaqësitë e kësaj dynjaje.

Domethënë, gratë janë një lloj prej krijesave të bekuara, të krijuara për të kaluar jetë të lumtura në familje brenda caqeve të etikës islame.

Zoti i mallkoftë ato organizata të fshehta që përpiqen t'i prishin këto krijesa të bekuara! Dhe i lutem Allahut të Plotëfuqishëm që t'i mbrojë motrat e mia nga e keqja e këtyre fatkëqinjve të shthurur.

Motrat e mia! Unë kam këtë për t'jua thënë juve privatisht:

Më mirë se sa të hyni nën dominimin e një bashkëshorti të shthurur, imoral e me zakone perëndimore për shkak të ngushticës ekonomike, përpiquni të bëni kursim e t'i siguroni mjetet tuaja të jetesës ashtu si gratë e mira fshatare me mjaftueshmëri e me kursimtari të cilat janë të ngulitura në natyrën tuaj, mos përpiqi ta shisni veten tuaj. Në qoftë se fati i ndonjërës prej jush është të ketë një bashkëshort i cili është i papërshtatshëm për ju, le të kënaqet me fatin e saj dhe t'i nënshtrohet atij, se mbase Allahu do ta regullojë bashkëshortin e saj nëpërmjet kënaqësisë dhe nënshtrimit të saj. Por t'u drejtohesh gjykatave për divorc siç dëgjojmë në kohën e tanishme, kjo nuk i shkon aspak nderit të islamit dhe emrit të mirë të këtij kombi!

●Pika e Tretë

Motrat e mia të dashura!

Duhet të jeni të sigurta se, ashtu siç është demonstruar me prova të fuqishme dhe me shembuj në Risale-i Nur, të pranishme në kënaqësitë dhe në ëndjet jashtë limiteve të së lejuarës ndodhen dhimbje dhe pikëllime dhjetë herë më të mëdhaja. Ju mund t'i gjeni shpjegimet e saj të detajuara të kësaj në Risale-i Nur. Për shembull Fjala e Gjashtë, e Shtata dhe e teta prej '*Fjalëve të vogëla'* dhe '*udhëzuesi për të rinjtë'* e sqarojnë për ju këtë të vërtetë në mënyrë të plotë në vendin tim. Prandaj, mjaftohuni me kënaqësitë e ligjshme dhe jini të kënaqura me to. Biseda juaj me fëmijët tuaj të pafajshëm dhe ledhatimi i tyre në shtëpitë tuaja është më e këndshme se sa njëqind kinema.

Ju gjithashtu duhet ta dini me siguri se kënaqësia e vërtetë në jetën e kësaj bote qëndron në besim dhe në caqet e besimit.

Dhe në çdo vepër të mirë ndodhet një kënaqësi shpirtërore. Risale-i Nuri ka provuar me qindra dëshmi vendimtare se madje në këtë botë vuajtja më e hidhur dhe më e dhimbshme është e pranishme në çudhëzim e shthurje. Unë vetë e kam përjetuar në raste të shumta dhe kam provuar me aq siguri sikur ta shikoja me sytë e mi se e pranishme në besim është një farë e Parajsës, ndërsa në shthurje e çudhëzim është një farë e Ferrit.

Kjo e vërtetë përsëritet shumë herë në Risale-i Nur. Megjithëse Risale-i Nuri ka rënë në duart e atyre që e kundërshtojnë me kryeneçësinë më të madhe dhe me shumë ashpërsi, prapseprapë ata nuk kanë qenë në gjendje që ta hedhin poshtë këtë të vërtetë, as grupet e ekspertëve zyrtarë dhe as gjykatat.

Tani, motrat e mia të bekuara e të pafajshme dhe ju bijat e mia që jeni si fëmijët e mi shpirtërorë, me në krye trajtesën e *Hixhabit*, *Udhëzuesi për të rinjtë* dhe *Fjalët e vogëla*, le të jenë këto që t'ju japin juve mësim në vendin tim.

Kam dëgjuar se ju dëshironi që unë t'ju jap mësim në xhami. Por rrethanat e mia të vështira, sëmundja ime dhe shumë arsye të tjera më pengojnë për të. Prandaj unë kam vendosur që t'ju përfshij ju, o motrat e mia që e pranoni këtë instruksionin tim të cilin e kam shkruar për ju, në të gjitha duatë e mia dhe në përfitimet e mia shpirtërore, ashtu si sudentët e Risale-i Nurit.

Në qoftë se mund ta merrni Risale-i Nurin, ta lexoni atë ose ta dëgjoni në vendin tim, atëherë ju do të bëheni pjesmarrëse në duatë dhe në të gjitha përfitimet shpirtërore të studentëve të Risale-i Nurit, vëllezërve tuaj, sipas rregullit të përcaktuar.

Unë do të dëshiroja t'ju shkruaja më shumë se kaq, por jam shumë i sëmurë, shumë i dobët dhe shumë i vjetër dhe kam shumë detyra si korrigjimin e kopjeve të Risale-i Nurit, kështu sa për tani jam mjaftuar me kaq.

اَلْبَاقِي هُوَ الْبَاقِي

I Qëndrueshmi i Vetëm, Ai është i Qëndrueshmi i Vetëm!

Vëllai juaj i cili ka shumë nevojë për duatë tuaja

Said Nursi

* * *

SHKREPTIMA E NJËZET E PESTË

Mesazh për të sëmurët

[kjo trajtesë përbëhet nga njëzet e pesë 'ilaçe'. Kjo u shkrua si një balsam, ngushëllim dhe një recetë për të sëmurin, si një vizitë për të sëmurët dhe si një urim për shërimin e tyre të shpejtë.]

Një paralajmërim dhe një shfajësim

Kjo recetë shpirtërore u shkrua me një shpejtësi më të madhe se të gjitha shkrimet e mia të tjera,[1] dhe meqenëse nuk gjeta kohë që ta korrigjoja e ta studioja, në kundërshtim me të gjitha të tjerat, ajo u lexua vetëm një herë, dhe ajo me një shpejtësi të madhe si hartimi i saj. Domethënë, ajo ka mbetur në gjendjen e pasistemuar të draftit të parë. Unë nuk e pashë të nevojshme t'i kontrolloja me kujdes gjërat që më kishin ardhur në zemër në një mënyrë të natyrshme, me qëllim që ato të mos prisheshin duke i rregulluar e duke u kushtuar vëmendje të tepruar. Lexuesit dhe veçanërisht të sëmurët nuk duhet të ndihen të shqetësuar e të fyer nga ndonjë shprehje e pakëndshme apo fjalë e fraza të ashpra; më mirë le të bëjnë ata dua për mua.

Said Nursi

[1] Kjo trajtesë u shkrua për katër orë e gjysëm. Nënshkruan Rushtu, Refet, Husrevi, Saidi.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

الَّذِينَ إِذَا أَصَابَتْهُم مُّصِيبَةٌ قَالُوا إِنَّا لِلَّهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاجِعُونَ ۝ وَالَّذِي هُوَ يُطْعِمُنِي وَيَسْقِينِ ۝ وَإِذَا مَرِضْتُ فَهُوَ يَشْفِينِ

Me Emrin e Allahut i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Të cilët thonë kur u bie fatkeqësi, vërtet të Allahut jemi dhe padyshim tek Ai do të kthehemi."[2]

"Dhe Ai është i Cili më ushqen dhe më jep të pi".

"Dhe kur unë jam i sëmurë, është Ai i Cili më shëron;"[3]

Në këtë shkreptimë, ne do të shpjegojmë shkurtazi **Njëzet e Pesë Ilaçe** të cilat mund të japin ngushëllim të vërtetë dhe një kurim të dobishëm për të sëmurët dhe për ata që janë goditur me fatkeqësi, të cilët përbëjnë një të dhjetën e njerëzimit.

● **Ilaçi i parë:**

O i sëmurë i pafuqishëm! Mos u shqetëso, bëj durim! Sëmundja jote nuk është lëngatë për ty, ajo është një lloj ilaçi; sepse jeta është një kapital që zhduket; në qoftë se ajo nuk jep fruta, do të humbiste çdo gjë dhe, në mënyrë të veçantë në qoftë se kalon në rehati e në shkujdesje, ajo do të kalonte shpejt. Sëmundja e bën atë kapitalin tënd të fitojë dobi të mëdhaja. Për më tepër, ajo nuk e lejon jetën tënde të kalojë shpejt, ajo e pengon dhe e zgjat atë, me qëllim që ajo të largohet pasi të ketë marrë frutet e saj. Një tregues se jeta jote zgjatet nëpërmjet sëmundjes është proverba vijuese e përsëritur shumë shpesh:

[2] Kuran 2:156)
[3] Kuran 26:79-80

"*Kohët e fatkeqësisë janë të gjata, kurse kohët e lumturisë janë me të vërtetë të shkurtëra*."

● **Ilaçi i dytë:**

O i sëmurë që të mungon durimi! Ji i duruar! Madje jep falënderime! Sëmundja jote mund t'i transformojë minutat e jetës tënde në barasvlerën e ibadeteve të orëve. Sepse adhurimi është dy llojësh:

I pari është adhurimi pozitiv që mishërohet në kryerjen e namazeve, të duave e të tjera si këto.

I dyti janë format negative të adhurimit si sëmundjet e fatkeqësitë. Nëpërmjet këtyre, të goditurit me to kuptojnë pafuqinë dhe dobësinë e tyre; ata i luten Krijuesit të tyre Mëshirëplotë dhe kërkojnë strehim tek Ai; ata manifestojnë adhurimin i cili është i sinqertë dhe pa hipokrizi. Po, ka rrëfenja të shëndosha që pohojnë se,

"Një jetë e cila kalon në sëmundje, konsiderohet si adhurim për besimtarin, me kusht që Ai të mos ankohet rreth Krijuesit"[4].

Madje është vërtetuar në disa rrëfenja të sakta dhe nga ata që zbulojnë realitetet e krijimit se sëmundja e një minuti i disave, të cilët janë krejtësisht të duruar dhe mirënjohës, bëhet e barasvlefshme me adhurimin e një ore për ta; dhe sëmundja e një minuti e disa njerëzve të plotësuar është e barasvlefshme me adhurimin e një dite të plotë për ta. Prandaj, ti nuk duhet të ankohesh për një sëmundje e cila e transformon një minut të jetës tënde në një mijë minuta që të bën ty të fitosh një jetë të gjatë; përkundrazi ti duhet të japësh falënderime.

● **Ilaçi i tretë:**

O i sëmurë i padurueshëm! Fakti se ato që vijnë në këtë botë largohen në mënyrë të vazhdueshme, të rinjtë plaken dhe, njeriu vazhdimisht rrotullohet midis vdekjes dhe ndarjes, dëshmon se ai nuk ka ardhur në këtë botë që ai të kënaqë vetveten e të gjejë ëndje.

[4] Transmeton Ahmedi

Për më tepër, ndërsa njeriu është më i lartësuari i qënieve të gjalla dhe i pajisuri më mirë për sa ka të bëjë me gjymtyrët dhe aftësitë, madje ai është prijësi i atyre të gjithëve, mirëpo duke menduar për kënaqësitë e shkuara dhe për dhimbjet e së ardhmes, ai kalon vetëm një jetë pikëlluese e të mërzitshme më të ulët se sa kafshët. Kjo do të thotë se njeriu nuk erdhi në këtë dynja të kalojë një jetë të mirë, të rehatshme e në ëndje, përkundrazi, duke pasur në pronësi një kapital të madh, ai erdhi këtu të punojë e të bëjë tregti për një jetë të përhershme e të amshuar. Kapitali që i është dhënë njeriut është jeta e tij. Po të mos kishte pasur sëmundje, shëndeti i mirë dhe mirëqënia do të kishin shkaktuar pakujdesi, sepse ato e shfaqin dynjanë të jetë e këndshme dhe bëjnë të harrohet Ahireti. Ato nuk dëshirojnë që të mendohet për vdekjen dhe për varrin; ato e bëjnë kapitalin e jetës të harxhohet në çikërrima e më kot. Ndërsa sëmundja papritmas t'i hap sytë; ajo i thotë trupit: "Ti nuk je i pavdekshëm. Ti nuk lihesh në tekat e tua. Ti ke një detyrë; braktise mendjemadhësinë, mendo për të Vetmin i Cili të krijoi. Dije se ti po kalon për të hyrë në varr, kështu që përgatitu për të!" Kështu, nga ky këndvështrim sëmundja është një udhëzues i besuar dhe një paralajmërues e këshillues i cili nuk të mashtron kurrë. Atëherë nuk duhet të ankohesh prej saj nga ky drejtim, por duhet të përshtatesh në hijet e dhënies së falënderimeve. Dhe në qoftë se ajo është shumë e rëndë, duhet të kërkosh durim nga Krijuesi xh.sh. që ta përballosh.

● **Ilaçi i katërt:**

O i sëmurë ankimtar! Dije se ti nuk ke të drejtë të ankohesh, por duhet të japësh falënderime dhe të durosh, sepse trupi yt, gjymtyrët dhe aftësitë e holla nuk janë prona jote. Nuk i ke bërë ti ato dhe as nuk i ke blerë nga fabrika të tjera. Kjo do të thotë se ato janë prona e një tjetri, dhe Pronari i tyre vepron mbi pronën e Tij si të dojë.

Ashtu siç tregohet në Fjalën e Njëzet e Gjashtë e cila lidhet me Kaderin Hyjnor, se një mjeshtër shumë i pasur dhe i talentuar, për shembull, e përdor një burrë të varfër si një model me qëllim që të tregojë artin e tij të bukur dhe pasurinë kundrejt një page të caktuar për

një periudhë kohe prej një ore. Ai e vesh burrin e varfër me një mantel të zbukuruar e të modeluar me mjeshtëri. Ai e punon mantelin mbi të dhe i jep atij gjendje të ndryshme. Me qëllim që të shfaqë shumëllojshmëritë e jashtëzakonshme të artit të tij, Ai e pret mantelin, e modifikon, e zgjat dhe e shkurton. A ka të drejtë ai burrë i varfër, i cili punon për shpërblim, t'i thotë atij Personi: "Ti po më jep shumë shqetësim, ti po më bezdis shumë me formën që i ke dhënë mantelit, duke më bërë mua një herë të përkulem dhe një herë të rri drejtë"; a ka ai të drejtë t'i thotë Atij se po ia prish paraqitjen e tij të bukur nëpërmjet rregullimit dhe shkurtimit të mantelit i cili e bën atë të bukur? A mundet t'i thotë se ai është mizor dhe i padrejtë?

O njeri i sëmurë! Tamam si në këtë krahasim, me qëllim që të shfaqë mantelin e trupit tënd me të cilin Ai të ka veshur, dhe në të cilin ka vendosur shqiset e ndritshme të zbukuruara si syri, veshi dhe mendja, dhe me qëllim që të shfaqë qëndisjet e Emrave të Tij të bukur, Krijuesi i Gjithëlavdishëm të bën ty të rrokullisesh midis gjendjeve të shumta dhe të ndryshon ty në situata të shumta.

Ashtu siç njihesh ti me Emrin e Tij ***Er-Rezzak***, *Furnizuesi* nëpërmjet urtësisë, gjithashtu eja ta njohësh Emrin e Tij ***Esh-Shafi***, *Shërruesi* nëpërmjet sëmundjes tënde. Meqenëse vuajtjet dhe fatkeqësitë shfaqin dekretet e disave prej Emrave të Tij të bukur, atëherë brenda atyre shkreptimave të urtësisë, rrezeve të mëshirës dhe dritave të bukurisë, gjenden shumë shembuj mirësie. Në qoftë se do të ngrihej perdja e sëmundjes, të cilën ti e ke frikë dhe e urren, pas saj ti do të gjeje shumë kuptime të këndshme e të bukura.

● **Ilaçi i pestë:**

O ti që je sprovuar me sëmundje! Nëpërmjet përvojës, unë kam formuar bindjen në këtë kohë se *"Sëmundja është një mirësi Hyjnore dhe një dhuratë e të Gjithëmëshirshmit të vetëm."*[5]

[5] Transmeton Buhariu, Maliku

Megjithëse nuk jam i denjë për të, gjatë tetë apo nëntë viteve të kaluara kanë ardhur tek unë disa të rinj lidhur me vuajtjen e tyre nga sëmundja duke kërkuar duatë e mia. Unë kam vërejtur se të gjithë ata të rinj të sëmurë kanë filluar të mendojnë më shumë për Ahiretin se sa të rinjtë e tjerë. Ata nuk janë të dehur nga pakujdesia e rinisë. Ata i shpëtojnë vetet e tyre deri diku nga dëshirat shtazore dhe nga pakujdesia.

U kujtoja atyre se unë shoh se këto sëmundjet e tyre, brenda limitit të durimit të tyre janë një mirësi Hyjnore dhe dhuratë prej Tij xh.sh.. Unë gjithashtu thoja: O vëllai im! Unë jam kundra kësaj sëmundjes suaj. Unë nuk ndjej keqardhje e dhembshuri për ty për shkak të sëmundjes tënde saqë të bëj dua për ty. Përpiqu të jesh i duruar deri sa sëmundja të të zgjojë ty plotësisht dhe, pasi ajo të ketë përmbushur detyrën e saj, insha-Allah Krijuesi Mëshirëplotë do të të shërojë". Gjithashtu u thoja atyre: "Nëpërmjet sprovës së shëndetit të mirë disa të rinj si ti bëhen neglizhentë, heqin dorë nga pesë namazet e detyruara, nuk mendojnë për varrin, dhe e harrojnë Allahun e Plotëfuqishëm.

Nëpërmjet një kënaqësie të sipërfaqshme prej një ore nga jeta e kësaj bote, ata lëkundin e dëmtojnë jetën e tyre të përhershme dhe madje e shkatërrojnë atë. Ndërsa për shkak të sëmundjes, ti i shikon varrin, tek i cili padyshim do të hysh, dhe banesat e Ahiretit përtej tij dhe vepron në përputhje me to. Atëherë sëmundja jote është si shëndet i mirë për ty, ndërsa për disa nga shokët e tu, shëndeti i mirë është një sëmundje."

● **Ilaçi i gjashtë:**

O i sëmurë që ankohesh nga dhimbja! Unë të them: Mendo për jetën tënde të kaluar dhe kujto ditët e këndshme dhe të lumtura dhe kohët dëshpëruese e të mërzitshme.

Ti sigurisht ose do të shprehësh me klithmë ose "Oh!" ose "Ah!". Domethënë zemra jote dhe gjuha ose do të thonë: ***El-Hamdu lil-lahi vesh-shukru lehu****, "Falënderimi dhe lavdërimi i takojnë Allahut*", ose

do të thuash "heu, medet!" Vëre me kujdes! Ajo çfarë të bën ty të thërrasësh ***El-Hamdu lil-lahi vesh-shukru lehu*** është të menduarit e dhimbjeve dhe e fatkeqësive prej të cilave pate vuajtur më parë; kjo nxit një lloj kënaqësie të tillë saqë zemra jote jep falënderime, sepse ikja e dhimbjes është kënaqësi. Sepse ato dhimbje e fatkeqësi kanë mbjellur, me zhdukjen e tyre, një kënaqësi në shpirt, e cila duke buruar nga të menduarit, derdh -zbraz- nga shpirti lavdërime e falënderime.

Ndërsa ajo çfarë të bën ty të thërrasësh: "oh, medet!" janë kohët e kënaqshme e të lumtura që ke përjetuar në kohët e mëparshme, të cilat me kalimin e tyre mbjellin në shpirtin tënd një dhimbje të vazhdueshme. Kurdoherë që ti të mendosh për to, dhimbja përsëri nxitet, duke bërë që të derdhen hidhërimi e dëshpërimi.

Meqenëse kënaqësia e paligjshme ndonjëherë shkakton vuajtjen e një viti në shpirt dhe me dhimbjen e sëmundjes së një dite kalimtare janë kënaqësitë dhe thevabi i shumë ditëve përveç kënaqësisë që je lehtësuar prej saj dhe prej së cilës ke shpëtuar, mendo për rezultatin e kësaj sëmundje të përkohshme me të cilën ti je goditur tani dhe për meritat e fytyrës së saj të brendshme. Thuaj: Gjithçka është nga Zoti! Edhe kjo gjithashtu do të kalojë!", dhe jep falënderime në vend të ankimeve.

● Ilaçi i gjashtë:[6]

O vëlla që mendon për kënaqësitë e kësaj bote dhe vuan pikëllim nga sëmundja! Në qoftë se kjo botë do të ishte e përjetshme dhe në qoftë se nuk do të kishte vdekje në rrugën tonë, në qoftë se erërat e ndarjes dhe të vdekjes nuk do të frynin, dhe në qoftë se nuk do të kishte dimra të shpirtit në të ardhmen e kobshme e të stuhishme, atëherë sigurisht që do të më vinte keq për ty dhe për veten time. Por meqenëse një ditë dynjaja do të na dëbojë prej saj duke thënë: Hajdeni! Dilni prej

[6] Kjo shkreptimë më erdhi në një mënyrë të natyrshme dhe dy ilaçe janë përfshirë në ilaçin e gjashtë. Ne e kemi lënë atë kështu me qëllim që të mos prishet natyrshmëria e saj; ne nuk e ndryshuam duke menduar se mund të përfshihet ndonjë mister në të.

këtu! Dhe do t'i mbyllë veshët e saj përballë britmave tona, atëherë para se ajo të na dëbojë e të na flakë ne duhet t'i dalim para dashurisë sonë për të dhe ta braktisim që tani nëpërmjet paralajmërimeve të këtyre sëmundjeve. Ne duhet të përpiqemi ta braktisim atë në zemrat tona para se ajo të na braktisë.

Po, sëmundja shpreh këtë paralajmërim për ne: Trupi yt nuk përbëhet nga guri e hekuri, por nga materiale të ndryshme të cilat janë gjithmonë të zbuluara para ndarjes, shpërbërjes e kalbjes. Braktise vetëmburrjen tënde, kupto pafuqinë tënde, njihe Pronarin tënd, kuptoji detyrat e tua, dhe mësoje pse ke ardhur në këtë botë!" Sëmundja e shpreh këtë në mënyrë të fshehtë në veshin e zemrës sonë.

Për më tepër, meqenëse kënaqësitë dhe ëndjet e kësaj bote nuk vazhdojnë dhe sidomos në qoftë se janë të paligjshme, ato janë plot dhimbje, të mëkatshme dhe të paqëndrueshme, mos qaj me pretekstin e sëmundjes për shkak se i ke humbur ato kënaqësi. Përkundrazi, mendo për aspektet e adhurimit dhe të shpërblimit në Ahiret që gjenden në sëmundje, dhe përpiqu të marrësh kënaqësi prej tyre.

● **Ilaçi i shtatë:**

O i sëmurë që ke humbur mirësinë e shëndetit! Sëmundja jote nuk e prish kënaqësinë e mirësive Hyjnore, përkundrazi, ajo i bën ato të përjetohen dhe shton kënaqësinë në to. Sepse në qoftë se diçka është e vazhdueshme, ajo e humbet shijen dhe efektin e saj. Madje njerëzit e realitetit thonë: إِنَّمَا الْأَشْيَاءُ تُعْرَفُ بِأَضْدَادِهَا se gjërat njihen me të kundërtat e tyre.

Për shembull, në qoftë se nuk do të kishte errësirë, drita nuk do të njihej dhe nuk do të përmbante kënaqësi. Në qoftë se nuk do të ishte i ftohti, nuk do të njihej nxehtësia dhe nuk do të kuptohej. Në qoftë se nuk do të ishte uria, ushqimi nuk do të jepte shije e kënaqësi. Po të mos ishte etja e stomakut, nuk do të kishte kënaqësi në pirjen e ujit. Në qoftë se nuk do të ishte sëmundja, shëndeti i mirë do të mbetej pa kënaqësi.

Krijuesi i Gjithurtë e zbukuroi njeriun me gjymtyrë dhe aftësi vërtetë të shumta deri në atë shkallë që ai të mund të përjetojë e të njohë shumëllojshmëritë e panumërta të mirësive në univers, kjo tregon se Ai dëshiron ta bëjë njeriun të vetëdijshëm për çdo lloj nga mirësitë e tij dhe t'ia bëjë të njohura, ta bëjë atë të mësohet me to dhe ta shtyjë njeriun për të dhënë falënderime të vazhdueshme. Prandaj duhet patjetër që Ai të zbresë sëmundje, lëngata e vuajtje ashtu siç jep shëndet të mirë e mirëqenie.

Unë të pyes: Në qoftë se nuk do të kishte qenë kjo sëmundje në kokën tënde ose në dorën tënde ose në stomakun tënd, a do ta kishe kuptuar ti mirësinë Hyjnore të kënaqshme e të këndshme të shëndetit të mirë të kokës tënde, të dorës apo të stomakut dhe a do të jepje falënderime? Sigurisht, jo që do të jepje falënderime për të, por madje ti nuk do të kishe menduar për të! Në mënyrë të pavetëdijshme, ti do ta kishe shpenzuar atë shëndet të mirë në pakujdesi dhe ndoshta edhe në shthurje.

● **Ilaçi i tetë:**

O i sëmurë që mendon për Ahiretin! Sëmundja, ashtu si efekti i sapunit, pastron e heq papastërtitë e tua, fshin gjynahet e tua dhe të pastron nga mëkatet.

Vërtetohet nga një hadith i saktë se sëmundjet janë shlyerje për mëkatet. Dhe në një hadith tjetër thuhet:

Ashtu siç bien frutat e pjekura nga pema e tyre kur ajo shkundet, po ashtu bien mëkatet e besimtarit kur ai shkundet me sëmundje.[7]

Gjynahet janë sëmundje kronike të përhershme, në jetën e amshuar dhe në jetën e kësaj bote; ato janë sëmundje për zemrën, për ndërgjegjjen dhe për shpirtin. Në qoftë se je i duruar dhe nuk ankohesh, atëherë ti do ta shpëtoje veten tënde nëpërmjet kësaj sëmundje të përkohshme prej sëmundjeve të shumta të përhershme. Në qoftë se ti

[7] Transmetojnë Buhariu, Muslimi

nuk mendon për gjynahet e tua, ose e harron Ahiretin, ose nuk e njeh Krijuesin tënd, atëherë unë të them me siguri se ti do të vuash nga një sëmundje shumë e rëndë e cila është një milion herë më e keqe se sa këto sëmundjet e tua të tanishme, kështu ik prej asaj dhe bërtit..! Sepse zemra jote, shpirti yt dhe nefsi yt të gjithë janë të lidhur me të gjitha qëniet e dynjasë. Ato lidhje këputen në mënyrë të vazhdueshme nga vdekja dhe nga ndarja, duke hapur tek ty plagë të panumërta të thella. Veçanërisht, meqenëse ti nuk e njeh Ahiretin dhe e imagjinon vdekjen të jetë një mosekzistencë e përjetshme, atëherë mjaft thjesht sikur i shqyer e i lënduar, qënia jote vuan sëmundje me madhësinë e dynjasë.

Kështu, gjëja e parë që ti duhet të bësh është të kërkosh ilaçin e plotë dhe shërimin e vërtetë për qënien tënde të madhe jolëndore të cilën e shqyejnë dhe e copëtojnë sëmundjet e pakufishme dhe lëngatat e pamunërta; unë mendoj se do ta gjesh veçse në ilaçin e besimit dhe në balsamin e tij kurues. Dhe mësoje se arritja për tek ai ilaç është të shikosh nëpërmjet dy dritareve të pafuqisë dhe të varfërisë të cilat hapen me anë të sëmundjes tënde fizike e cila gris perden e pakujdesisë dhe të cilat janë në natyrën e njeriut, dhe si rrjedhojë të arrish tek njohja e fuqisë së të Gjithëfuqishmit të Gjithëlavdishëm dhe tek mëshira e Tij e gjërë.

Po, ai që nuk e njeh Allahun mban mbi kokën e tij shqetësime e fatkeqësi sa gjërësia e dynjasë me çfarë përmban ajo; kurse ai i cili e njeh Krijuesin e vet, bota e tij mbushet me dritë e me kënaqësi shpirtërore; ai i percepton këto sipas fuqisë së besimit të tij. Po, dhimbja e sëmundjeve të pjesshme fizike shkrihet e largohet nga gëzimi shpirtëror; nga kurimi e kënaqësia që burojnë nga ky besim; dhe vuajtja bie e tretet.

● **Ilaçi i nëntë:**

O i sëmurë që beson në Krijuesin tënd! Dhimbja, frika dhe ankthi në sëmundje është për shkak se sëmundja ndonjëherë çon në vdekje e shkatërrim. Meqenëse vdekja, me shikimin e pakujdesisë është e

frikshme dhe e trishtueshme në anë të jashtme, sëmundjet që mund të jenë shkak për të çojnë në shqetësim e në tronditje. Atëherë dije:

Së pari: Beso me siguri se Exheli, çasti i fundit i jetës, është i paracaktuar dhe nuk ndryshon. Ka ndodhur që kanë vdekur ata që qajnë pranë të sëmurëve rëndë ndonëse gëzonin shëndet të mirë, dhe janë shëruar ata që ishin të sëmurë rëndë dhe pastaj kanë jetuar mirë.

Së dyti: Vdekja, në vetvete, nuk është e tmerrshme, ashtu siç na duket në formën e saj të jashtme. Ne e kemi provuar në shumë pjesë të Risale-i Nurit dhe në mënyrë të pakundërshtueshme nëpërmjet dritës së dhënë nga Kurani, se për besimtarët vdekja është një shkarkim nga detyrat e rënda të jetës. Për ta ajo është një pushim, lirim, nga adhurimi, i cili është instruksion e stërvitje në arenën e sprovës së kësaj bote. Ajo është dera e bashkimit për t'u takuar me nëntëdhjetë e nëntë përqind të të dashurve dhe miqve që tashmë kanë udhëtuar për në botën tjetër.. Është një mjet për të hyrë në atdheun e tyre të vërtetë dhe në vendbanimin e lumturisë së përjetshme.. ajo gjithashtu është një ftesë për të kaluar nga burgu i dynjasë për tek kopshtet e pemishtet e Parajsës.. ajo është koha për të marrë shpërblimin e tyre nga thesari i mirësisë së Krijuesit Mëshirëplotë kundrejt shërbimit që i është bërë Atij. Meqenëse realiteti i vdekjes është ky, atëherë ajo nuk duhet të shikohet si e tmerrshme, përkundrazi, ajo duhet të konsiderohet si lajm i gëzueshëm e sihariq i mëshirës dhe i lumturisë.

Për më tepër, disa nga njerëzit e takvasë, e frikës ndaj Zotit, nuk e kishin frikë vdekjen për shkak të vetmisë dhe të tmerrit të saj, por për shkak të dëshirës së tyre që të fitonin më shumë nga veprat e mira nëpërmjet vazhdimësisë së detyrës së jetës.

Po, vdekja për njerëzit e besimit është dera e mëshirës. Ndërsa për njerëzit e çudhëzimit është pusi i një errësire të përhershme.

● **Ilaçi i dhjetë:**

O i sëmurë i shqetësuar pa qenë nevoja! Ti shqetësohesh për gjendjen e rëndë të sëmundjes tënde dhe ky shqetësim e shton mbi ty peshën e sëmundjes. Në qoftë se dëshiron që sëmundja jotë të jetë më pak e rëndë, përpiqu të mos shqetësohesh. Domethënë, mendo për dobitë e sëmundjes tënde, për shpërblimin që vjen nga ajo, dhe se ajo do të kalojë shpejt.

Atëherë, shkuli rrënjët e shqetësimit nga vetja jote që sëmundja të shkulet prej rrënjëve.

Po, shqetësimi, ose vesveseja, e shton dy herë më shumë sëmundjen. Shqetësimi i shkakton një sëmundje jolëndore zemrës nën sëmundjen fizike; sëmundja fizike vazhdon duke u mbështetur tek ajo. Në qoftë se ti i largon prej teje shqetësimin dhe mendimet për të duke iu nënshtruar urdhërit të Zotit xh.sh. dhe kënaqësisë ndaj vendimit të Tij dhe duke menduar rreth urtësisë në sëmundje, atëherë një pjesë e rëndësishme e sëmundjes tënde fizike do të shkulet nga rrënjët; ajo do të bëhet më e lehtë dhe pjesërisht zhduket. Ndonjëherë një sëmundje e pjesshme fizike shtohet dhjetëfish vetëm duke menduar nëpërmjet shqetësimit dhe ankthit për të. Shqetësimi e shton sëmundjen. Gjithashtu shqetësimi e bën të sëmurin sikur ai të akuzonte urtësinë Hyjnore, të kritikonte mëshirën Hyjnore dhe të shfaqte ankesë ndaj Krijuesit të tij Mëshirëplotë. Për këtë arsye, në kundërshtim me qëllimet e tij, i sëmuri merr goditje disiplinuese, gjë e cila ia shton sëmundjen e tij. Po, ashtu si falënderimet që shtojnë mirësinë, po ashtu ankesat shtojnë sëmundjen dhe fatkeqësinë.

Për më tepër, shqetësimi në vetvete është një sëmundje. Ilaçi për të është vetëm të njohësh urtësinë në sëmundje.

Meqenëse ti i ke mësuar qëllimin dhe dobinë e saj, atëherë fshije shqetësimin tënd me atë balsam dhe gjej lehtësim e shpëtim. Dhe në vend të rënkimit dhe ofshamave "Oh, medet", thuaj: ***El Hamdu lil-lah ala kul-li hal**, Lavdi Zotit për çdo gjendje.*

● **Ilaçi i njëmbëdhjetë:**

O vëllai im i sëmurë i paduruar! Megjithëse sëmundja të shkakton ty një dhimbje të menjëhershme, në të njëjtën kohë zhdukja e sëmundjes tënde të kaluar i jep një kënaqësi shpirtërore dhe një lumturi shpirtit që buron nga shpërblimi i marrë nga përballimi i saj me durim.

Atëherë, koha e ardhme pas të sotmes, madje pas kësaj ore, nuk ka sëmundje. Dhe sigurisht asnjë sëmundje nuk mund të jetë nga asgjëja, dhe në qoftë se nuk ka dhimbje, atëherë nuk mund të ketë asnjë brengë apo lëngatë. Por meqenëse ti i imagjinon gjërat në mënyrë të gabuar, dëshpërimi e shqetësimi të bien ty, sepse me zhdukjen e periudhës së sëmundjes fizike është shkrirë edhe dhimbja e asaj periudhe gjithashtu; vetëm shpërblimi i saj dhe kënaqësia e kalimit të saj mbetet. Do të ishte marrëzi të kujtosh pas kohës së tanishme sëmundjen e kaluar e të ndjehesh i dëshpëruar dhe të humbasësh durimin në një kohë që kjo duhet të të japë ty lehtësim e qetësi për shkak të shpërblimit që vjen nga ajo dhe që ka kaluar. Sa për ditët e ardhshme, ato nuk kanë ardhur akoma. Do të ishte çmenduri ta preokuposh veten qysh tani duke menduar për një ditë e cila nuk ka ardhur akoma, për një sëmundje e cila nuk ka rënë akoma dhe për një dhimbje që nuk ka ndodhur akoma; ky lloj imagjinimi si rezultat i mendimit që tregon shqetësim, dhe i rëndimit të vetvetes me një dhimbje të rëndë, kjo çon në humbjen e durimit dhe u jep ngjyrën e ekzistencës tre shkallëve të mosekzistencës; a nuk është marrëzi kjo? Meqenëse kohët e sëmundjes të cilat i kanë paraprirë kësaj ore ngjallin gëzim, dhe meqenëse koha e ardhshme pas kësaj ore është mosekzistuese, edhe sëmundja është mosekzistuese, edhe dhimbja është mosekzistuese.

O vëlla! Mos e shpërndaj fuqinë e durimit, e cila të është dhënë ty nga Allahu i Plotëfuqishëm në të djathtën e në të majtën, por grumbulloje e përqëndroje atë përballë dhimbjes së orës së tanishme; dhe thuaj: !***Ja Sabur***, *O më i Duruari*! dhe bëji ballë asaj.

● **Ilaçi i dymbëdhjetë:**

O njeri i sëmurë që për shkak të sëmundjes nuk mund ta kryesh adhurimin dhe nuk mund t'i bësh virdet, tesbihatet dhe duatë dhe që ndjehesh i dëshpëruar për shkak të këtij privimi! Dije se është pohuar në një hadith profetik se,

"Besimtarit të devotshëm i vjen thevabi i ibadetit, të cilin ai e kryente rregullisht, edhe gjatë sëmundjes së tij; sëmundja nuk e pengon thevabin -shpërblimin."[8]

I sëmuri që i kryen farzet me sa të ketë mundësi me durim e duke u mbështetur tek Zoti xh.sh. gjatë asaj sëmundjeje të rëndë, sëmundja merr vendin e sunneteve të tjera dhe në një formë të sinqertë.

Për më tepër, sëmundja e bën njeriun të kuptojë pafuqinë dhe dobësinë e tij. Ajo i shkakton atij të bëjë dua edhe me gojë edhe nëpërmjet gjuhës së pafuqisë dhe të dobësisë së tij. Allahu i Plotëfuqishëm i dhuroi njeriut një pafuqi të pakufishme dhe një dobësi të pafundme me qëllim që ai në mënyrë të vazhdueshme të kërkojë strehim tek prania Hyjnore dhe t'i lutet e t'i përgjërohet duke shpresuar. Në përputhje me kuptimin e vërsetit,

قُلْ مَا يَعْبَؤُا بِكُمْ رَبِّي لَوْلَا دُعَاؤُكُمْ *"Thuaju (o Muhammed): "Zoti im kujdeset për ju vetëm nga duaja juaj drejtuar Atij."* [9]

Domethënë, çfarë rëndësie do të kishit ju në qoftë se nuk do të bënit dua? Urtësia në krijimin e njeriut dhe arsyeja për vlerën e tij është duaja e sinqertë. Meqenëse një shkak i kësaj duaje të sinqertë është sëmundja, nga ky këndvështrim nuk duhet të ankohesh për të, por duhet të bësh falënderime për të, sepse nuk duhet të thahen burimet e duasë të cilat i shpërthen sëmundja nëpërmjet fitimit të shëndetit.

[8] Transmetojnë Buhariu, Ahmedi
[9] Kuran 25:77

● **Ilaçi i trembëdhjetë:**

O i sëmurë që ankohesh nga sëmundja! Për disa njerëz sëmundja është një thesar i rëndësishëm dhe një dhuratë e çmueshme Hyjnore për ta. Çdo njeri i sëmurë mund ta përfytyrojë sëmundjen e tij prej këtij lloji, me qëllim që ta shpëtojë njeriun nga dëshpërimi dhe nga pakujdesia absolute dhe për ta mbajtur atë midis shpresës dhe frikës dhe kështu për të ruajtur edhe dynjanë edhe Ahiretin e tij; në urtësinë e Tij Allahu i Plotëfuqishëm e ka fshehur çastin e Exhelit. Exheli mund të vijë në çdo kohë; në qoftë se ai e kap njeriun në pakujdesi, kjo mund t'i shkaktojë dëm të rëndë jetës së tij të përhershme. Ndërsa sëmundja e largon pakujdesinë, ajo e bën njeriun të mendojë për Ahiretin; ajo i kujton vdekjen, dhe kështu ai mund të përgatitet. Disa sëmundje janë aq të dobishme saqë ato mund ta bëjnë njeriun të fitojë për njëzet ditë një rang i cili mund të arrihet për njëzet vite.

Për shembull, midis shokëve të mi ishin dy të rinj, Zoti i mëshiroftë. Njëri ishte Sabriu nga fshati Ilema, ndërsa tjetri Mustafa Vezirzade prej Islamköy. Unë vërejta me habi se, megjithëse këta të dy nuk mund të shkruanin, mirëpo ata ishin në rreshtin e parë në besnikëri e siqeritet në shërbim të imanit; unë nuk e kuptova arsyen për këtë në atë moment. Pas vdekjes së tyre kuptova se të dy ata kishin vuajtur nga një sëmundje e rëndë. Nëpërmjet udhëzimit të asaj sëmundjeje, jo si të rinjtë e tjerë neglizhentë të cilët kishin braktisur adhurimin e tyre të detyruar, ata të dy kishin *takva* -frikën ndaj Zotit xh.sh.-, kishin kryer një shërbim shumë të çmueshëm dhe kishin arritur një gjendje të dobishme për Ahiretin. Unë i lutem Zotit xh.sh. që dëshpërimi i sëmundjes prej dy viteve të jetë mjeti për lumturinë e miliona viteve të jetës së përhershme. Unë tani e kuptoj se lutjet që unë kisha bërë për shërimin e tyre, ishin nëmë nga këndvështrimi i dynjasë, por shpresoj që Allahu ta pranojë lutjen time për mirëqënien e tyre në Ahiret.

Kështu, sipas besimit tim, këta dy të rinj arritën një fitim të barabartë me fitimin të cilin e arrin njeriu me përpjekje e devocion të paktën për dhjetë vite.[10]

Në qoftë se këta dy të rinj, ashtu si disa të tjerë, do të ishin mbështetur në rininë e tyre dhe në shëndetin e mirë dhe do ta kishin hedhur vetveten në pakujdesi e shthurje derisa t'u vinte vdekja që i përgjon, do t'i rrëmbente mu në papastërtinë e mëkateve të tyre; ata do t'i bënin varret e tyre strofa akrepash e gjarpërinjsh, në vend të thesareve të dritave.

Meqenëse sëmundja përmban dobi të tilla, nuk duhet të ankohesh prej saj, por duhet të mbështetesh tek mëshira Hyjnore me besim e durim dhe madje duke e falënderuar Zotin xh.sh. dhe duke pasur besim në mëshirën e Tij.

● **Ilaçi i katërmbëdhjetë:**

O i sëmurë që sytë e tu kanë zhvilluar perde katarakt! Në qoftë se do ta dije se çfarë drite dhe çfarë syri shpirtëror gjendet poshtë asaj perdeje që ka mbuluar sytë e besimtarëve, ti do të thoje:

"Një mijë e një falënderime qofshin për Krijuesin tim Fuqiplotë".

Unë do të përmend një ngjarje për ju me qëllim që të shpjegoj këtë balsam. Ai është si më poshtë vijon:

Një herë, halla e Sulejmanit nga Barla, i cili më ka shërbyer tetë vite me besnikëri të plotë me gatishmëri e respekt, u godit me verbërim, dhe u shua drita e syrit të saj. Duke pasur mendim të mirë për mua, duke menduar mirë për mua njëqind herë më shumë se sa unë e meritoj, gruaja e drejtë më ndaloi tek dera e xhamisë kur unë po dilja, duke më thënë: "Për hatrin e Zotit bëj dua Allahut që të më vijë

[10] Kuptimi i hadithit është ky: "Në qoftë se një person ka një pozitë në shikim të Allahut dhe nuk mund ta arrijë atë stacion nëpërmjet veprave të mira dhe takvasë, Allahu e sprovon atë me fatkeqësi të tilla si sëmundja deri sa ta arrijë atë." ***El-Hakim, El- Mustadrek***, 1:344

shikimi. Dhe unë e bëra drejtësinë e asaj gruaje të bekuar besimtare ndërmjetësuesen për duanë time dhe duke iu përgjëruar Allahut të Plotëfuqishëm, unë u luta:

"O Zot! O Krijuesi ynë! Për hir të drejtësisë së saj ktheja prapë shikimin!" Pas dy ditësh erdhi një okulist nga krahina e Burdurit, ia hoqi perden dhe Allahu ia ktheu shikimin. Pas dyzet ditësh ajo e humbi përsëri shikimin e saj. Unë u shqetësova shumë dhe u luta me pasion të fortë për të, se në dashtë Allahu lutja të pranohej për jetën e saj në Ahiret, ose ndryshe duaja ime për të do të kishte qenë gabimisht një nëmë për të. Ajo qëndroi për dyzet ditë deri në vdekjen e saj; pas dyzet ditësh ajo kishte vdekur, Allahu i dhëntë mëshirë.

Kështu, privimi i kësaj gruaje, për të cilën shpresohet mëshira, nga mirësia e shikimit, duke i parë me pikëllim kopshtet e Barlës me syrin e moshës së vjetër, iu kompensua me përfitimin në varrin e saj duke qenë e aftë të shikojë për dyzet mijë ditë në kopshtet e Parajsës, sepse besimi i saj ishte i fortë dhe drejtësia e saj ishte shumë e madhe.

Po, në qoftë se një besimtar humbet shikimin e tij dhe hyn i verbër në varr, ai mundet ta shikojë botën e dritës, sipas shkallës së tij, me një shikim më të gjërë prej shikimit të të tjerëve në varrezat e tyre; sepse ashtu siç shohim ne shumicën e gjërave në këtë dynja, të cilat besimtarët e verbër nuk mund t'i shohin, edhe në varr gjithashtu, ata njerëz të verbër, në qoftë se kanë kaluar me iman, do të shohin me atë shkallë më shumë se sa të vdekurit e tjerë në varret e tyre. Ashtu sikur të shihnim nëpërmjet teleskopëve më të fuqishëm, ata mund të shikojnë e të sodisin kopshtet e parajsës si ekran kinemaje, në përputhje me shkallët e tyre.

Kështu, me falënderime e durim ju mund të gjeni poshtë perdes së syrit tuaj të tanishëm një sy i cili është i mbushur kaq me dritë dhe me të cilin ndërsa je nën tokë ti mund të shikosh e të sodisësh parajsën mbi qiej. Ajo që do ta heqë perden nga syri yt, doktori i syrit i cili do të të lejojë ty të shikosh me atë sy, është Kurani i gjithurtë.

● Ilaçi i pesëmbëdhjetë:

O i sëmurë që psherëtin e vajton! Mos shiko aspektin e jashtëm të sëmundjes dhe tek rënkimi, por shiko tek kuptimi i saj dhe ji i kënaqur. Në qoftë se kuptimi i sëmundjes nuk do të kishte qenë i mirë, Krijuesi Mëshirëplotë nuk do t'u kishte dhënë sëmundje shërbëtorëve të Tij, të cilët Ai i do shumë. Ndodhet një hadith kuptimi i të cilit është ky:

اَشَدُّ النَّاسِ بَلَاءً اَلْاَنْبِيَاءُ ثُمَّ اَلْاَوْلِيَاءُ اَلْاَمْثَلُ فَالْاَمْثَلُ "*Njerëzit që sprovohen me fatkeqësitë më të rënda janë profetët, pastaj Evlijatë dhe pastaj ata që janë më të ngjashëm me ta".*[11]

Domethënë, ata që sprovohen me fatkeqësi e vështirësi janë më të mirët e njerëzimit, më të plotët. Ose ashtu siç tha:

Në krye të atyre që janë sprovuar qëndron profeti i duruar Ejjubi a.s., pastaj profetët e tjerë, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ta, pastaj Evlijatë, shenjtorët, dhe pastaj të drejtët. Të gjithë ata i vlerësuan sëmundjet që u ranë si adhurim i sinqertë, si dhurata të të Gjithëmëshirshmit dhe dhanë falënderime nëpërmjet durimit.

Gjithashtu ata i shikonin ato si operacione kirurgjikale që kryheshin nga ana e të Gjithëmëshirshmit Mëshirëplotë. O i sëmurë që rënkon e vajton! Në qoftë se dëshiron t'i bashkohesh këtij karvani të ndritshëm, jep falënderime me durim. Në qoftë se ti ankohesh, ata nuk do të të pranojnë ty, dhe ti do të biesh në gropat e në kurthet e njerëzve të çudhëzimit dhe do të udhëtosh në rrugë të errët.

Po, ndodhen disa sëmundje të cilat në qoftë se çojnë në vdekje, janë si një lloj martirizimi; ato rezultojnë në një shkallë të shenjtërisë si martirizim.

Për shembull, ata që vdesin nga sëmundjet duke lindur fëmijën[12], që shoqëron lindjen e fëmijës, nga dhimbjet e barkut, nga mbytja, djegia dhe nga flama –murtaja-, arrijnë gradën e një martiri në kuptim.

[11] Transmeton Hakimi

Gjithashtu ka shumë sëmundje të bekuara nëpërmjet të cilave njerëzit fitojnë shkallën e shenjtërisë kur vdesin prej tyre. Për më tepër, meqenëse sëmundja e pakëson dashurinë për dynjanë dhe lidhjen e fortë me të, ajo e lehtëson ndarjen nga dynjaja nëpërmjet vdekjes, gjë e cila për njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje është shumë e hidhur e pikëlluese, dhe madje ajo ndonjëherë e bën atë të dëshirueshme për ta.

● **Ilaçi i gjashtëmbëdhjetë:**

O i sëmurë që ankohesh nga pikëllimi yt! Sëmundja ngjall respekt e dashuri të cilat janë shumë të rëndësishme e të mira në jetën shoqërore humane, sepse ajo e shpëton njeriun nga vetëmjaftueshmëria, pa ua pasur nevojën të tjerëve, gjë e cila të shtyn për në pashoqërueshmëri, në egërsi në sjellje me shokët, dhe e zhvesh njeriun nga mëshira; sepse sipas kuptimit të:

إِنَّ ٱلْإِنسَٰنَ لَيَطْغَىٰٓ ۞ أَن رَّءَاهُ ٱسْتَغْنَىٰٓ *"Por ja! Me të vërtetë që njeriu i kalon të gjithë kufijtë". "Ngaqë e sheh veten të vetëmjaftueshëm".*[13]

Nefsi urdhërues për të liga i cili ndjehet i vetëmjaftueshëm për shkak të shëndetit të mirë dhe të mirëqënies, nuk ndien respekt ndaj vëllezërve të tij në shumë drejtime të cilët janë të merituesheëm për të, dhe ai nuk ndien dashuri e dhembshuri për të sprovuarit me sëmundje e fatkeqësi, ndonëse ato meritojnë mirësi e mëshirë. Por sa herë që sëmuret, ai e kupton pafuqinë dhe varfërinë e tij dhe ndien respekt për vëllezërit e tij të cilët janë të denjë për të. Ai ndien respekt ndaj vëllezërve të tij besimtarë të cilët e vizitojnë ose e ndihmojnë atë. Dhe ai ndien një dashamirësi humane të cilat burojnë nga mirëkuptimi e simpatia, dhe dhembshuri për ata që janë goditur nga fatkeqësia, e cila është veçoria islamike më e rëndësishme ndaj të godiurve. Dhe duke i krahasuar ata me vetveten, ai ndien keqardhje e simpati për ta në

[12] Periudha që mund të fitohet ky martirizim është rreth dyzet ditë prej kohës së lindjes.

[13] Kuran 96:6-7

kuptimin e vërtetë të fjalës dhe ndien dhembshuri për ta. Ai bën çfarë të mundet për t'u ardhur atyre në ndihmë dhe, në qoftë se nuk ka mundësi, ai të paktën bën dua për ta, shkon për vizitë tek ata për t'i pyetur si janë, gjë e cila është sunnet profetik në përputhje me sheriatin dhe kështu fiton një thevab të madh.

● **Ilaçi i shtatëmbëdhjetë:**

O i sëmurë që ankohesh nga pafuqia për të kryer vepra të mira për shkak të sëmundjes! Ji mirënjohës! Unë të sihariqoj se është sëmundja ajo që të hap derën e veprave të mira më të sinqerta. Sëmundja, përveç se e bën njeriun e sëmurë që të fitojë thevab në mënyrë të vazhdueshme dhe për ata që kujdesen për të për hir të Zotit xh.sh., ajo është mjeti më i rëndësishëm për pranimin e duasë.

Po, ka një shpërblim të madh për besimtarët që kujdesen për të sëmurët. Të interesuarit për shëndetin dhe shkuarja për vizitë tek i sëmuri, me kusht që të mos e lodhësh e ta sikletosh, është sunnet dhe njëkohësisht shlyerje për gjynahet. Ndodhet një hadith i cili thotë:

"Kërkoni dua nga të sëmurët sepse duatë e tyre janë të pranuara".[14]

Në mënyrë të veçantë, në qoftë se i sëmuri është nga të afërmit dhe sidomos kur është baba ose nënë, të kujdesesh për ata është një ibadet i rëndësishëm dhe një thevab shumë i madh gjithashtu. Të gëzosh zemrën e një personi dhe ta ngushëllosh atë, konsiderohet si një lëmoshë e rëndësishme. Sa fatlumë janë ata fëmijë që kujdesen për baballarët e për nënat e tyre kur ata janë të sëmurë dhe fusin gëzimin në zemrat e tyre të holla e të prekura dhe fitojnë duanë e prindërve të tyre.

Po, realiteti që meriton respekt më të madh dhe vend më të lartë në jetën shoqërore është dhembshuria e dy prindërve dhe përgjigjja e fëmijëve të tyre ndaj asaj dhembshurie, dhe duke shfaqur respektin e plotë dhe dashamirësinë bijërore ndaj atyre të dyve kur ata vuajnë nga

[14] Transmeton Ibn Maxheh

sëmundja. Kjo është një tablo në të cilën shfaqet qëndrimi i mirë i fëmijëve dhe lartësia e humanizmit saqë shkakton admirimin e habinë e të gjitha krijesave dhe madje dhe të melekëve. Ata i përshëndesin duke i thënë ***La ilahe il-lall-llah, Allahu Ekber*** dhe i brohorasin duke thënë ***Mashaall-llah, Barekallah***.

Po, ka kënaqësi në kohën e sëmundjes të cilat burojnë nga dashamirësia, dhembshuria dhe mëshira e atyre që janë përreth të sëmurit; ato i shkrijnë dhe i pakësojnë dhimbjet e sëmundjes dhe e transformojnë në diçka shumë të kënaqshme e të këndshme. Pranueshmëria e duasë së të sëmurit dhe përgjigjja ndaj saj është një çështje shumë e rëndësishme që meriton t'i kushtohet vëmendje.

Për tridhjetë apo dyzet vitet e kaluara, unë vetë jam lutur për t'u shëruar nga një sëmundje në shpinën time prej së cilës kam vuajtur. Pastaj kuptova se sëmundja ishte dhënë për hir të duasë.

Dhe meqenëse duaja nuk e largon duanë, domethënë, duaja nuk mund ta largojë vetveten, atëherë unë kuptova se rezultatet e duasë i përkasin Ahiretit,[15] dhe se ajo në vetvete është një lloj adhurimi sepse nëpërmjet sëmundjes, njeriu kupton pafuqinë e tij dhe kërkon strehim tek prania Hyjnore.

Prandaj, megjithëse për tridhjet vite unë kam bërë dua për t'u shëruar dhe në dukje duaja ime nuk u pranua, prapëseprapë nuk m'u shfaq që unë ta braktisja duanë, sepse sëmundja është koha e duasë, ndërsa shërimi nuk është rezultati i duasë. Në qoftë se Allahu xh.sh. i Cili është i Gjithurti Mëshirëplotë, jep shërimin, Ai e jep atë nga mirësia dhe nga bujaria e Tij.

Për më tepër, në qoftë se duatë nuk pranohen në formën që ne e dëshirojmë, nuk mund të thuhet se ato nuk janë pranuar. Krijuesi i Gjithurtë e di më mirë se sa ne, kurse ne nuk e dimë; Ai na shtyn ne për

[15] Po, disa sëmundje janë shkak për ekzistencën e lutjes; në qoftë se lutja është shkaku i mosekzistencës së sëmundjes, atëherë ekzistenca e lutjes do të ishte shkaku i mosekzistencës së vetvetes, dhe kjo nuk do të ishte e mundur. Autori

tek ajo, që është më e mirë dhe më e dobishme për ne; Ai ndonjëherë i ruan, i depoziton duatë tona të posaçme për dynjanë tonë me qëllim që të na vlejnë ne në Ahiretin tonë, dhe në këtë mënyrë i pranon duatë. Sidoqoftë një dua e cila fiton sinqeritet për shkak të sëmundjes dhe që buron nga dobësia, pafuqia, përulësia, nënshtrimi dhe nga nevoja, është shumë e afërt për t'u pranuar. Sëmundja është themeli i një duaje të tillë të sinqertë dhe boshti i saj.

Atëherë ashtu si të sëmurët që janë besimtarë, po ashtu edhe besimtarët që kujdesen pas të sëmurëve, duhet të përfitojnë nga kjo lutje.

● **Ilaçi i tetëmbëdhjetë:**

O i sëmurë që ke lënë dhënien e falënderimeve dhe që ke marrë ankesat! Ankesa buron nga një e drejtë. Asnjë nga të drejtat e tua nuk është humbur saqë ti ankohesh. Madje ka shumë të drejta për të cilat ti nuk ke dhënë akoma falënderime që janë obligim për ty. Ti nuk e ke përmbushur të drejtën e Zotit mbi ty. Pa i dhënë të drejtën Krjuesit, ti po ankohesh sikur të kërkoje të drejtat në një mënyrë që nuk është e drejtë. Ti nuk ke të drejtë të ankohesh kur i sheh të tjerët që janë në një shkallë më të lartë se sa ti lidhur me shëndetin, por ty të duhet, nga këndvështrimi i shëndetit t'i shikosh ata të pafuqishëm të sëmurë që janë në shkallë më të ulët se sa ty.

Atëherë ti je i urdhëruar për të dhënë shumë falënderime. Në qoftë se dora jote është thyer, shiko duart e atyre që janë këputur. Në qoftë se ti ke vetëm një sy, shiko ata të verbër të cilëve u mungojnë të dy sytë. Dhe jepi falënderime Zotit xh.sh.!

Sigurisht, asnjë nuk ka të drejtë nga këndvështrimi i mirësive që të drejtojnë shikimin tek ata që janë sipër tyre dhe si rrjedhojë të ankohen. Ndërsa në fatkeqësi njeriu ka të drejtë, nga këndvështrimi i fatkeqësisë, të shikojë tek fatkeqësitë dhe sëmundjet e atyre që janë më të rënda me qëllim që ata të japin falënderime. Ky mister është shpjeguar në disa

pjesë të Risale-i Nurit me një krahasim; një përmbledhje e tij është sa vijon:

Një person merr për dore një njeri të mjerë për ta ngjitur në majë të minares. Në çdo shkelëz të shkallëve të minares, ai i jep atij një dhuratë të ndryshme, një mirësi të ndryshme. Mu në majë të minares ai i jep atij dhuratën më të madhe.

Megjithëse kërkohej medoemos që njeriu i mjerë të jepte falënderime e mirënjohje kundrejt dhuratave të shumëllojshme, ti e sheh atë t'i harrojë të gjitha dhuratat që kishte marrë në çdo shkelëz të shkallëve, ose i vlerëson ato si të parëndësishme dhe duke mos dhënë falënderime, ai i shikon sipër vetes dhe fillon të ankohet duke thënë: "Ah sikur të kishte qenë më e gjatë kjo minare që të mund të ngjitesha edhe më lart". Përse ajo nuk është aq e lartë sa mali atje ose sa minaret e tjera?"

Në qoftë se ai fillon të ankohet në këtë mënyrë, sa shumë mosmirënjohje do të ishte kjo dhe sa padrejtësi!

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, njeriu i cili erdhi në ekzistencë nga mosekzistenca dhe, nuk u bë as shkëmb, as pemë dhe as kafshë, por u bë një njeri e një musliman dhe në pjesën më të madhe të kohës ai gëzon shëndet të mirë dhe fiton një nivel të lartë mirësish. Pavarësisht të gjithë kësaj, të ankohesh e të shfaqësh padurim për shkak se ai nuk është i denjë për disa mirësi, ose për shkak se ai i humbet ato nëpërmjet zgjedhjes së tij të keqe ose të keqpërdorimit, ose për arsye se ai nuk mund t'i arrijë e t'i fitojë ato, dhe pastaj thotë: "Çfarë kam bërë që kjo më ka rënë mua", dhe duke kritikuar kështu Hyjninë e Krijuesit, kjo gjendje është një sëmundje shpirtërore më e kobshme se sa sëmundja fizike. Ashtu si të luftuarit me një dorë të thyer, ankesa e bën sëmundjen e tij më të rëndë e më keq.

I mençur është ai që në përputhje me kuptimin e vërsetit thotë:

الَّذِينَ إِذَا أَصَابَتْهُم مُّصِيبَةٌ قَالُوا إِنَّا لِلَّهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاجِعُونَ *"Të cilët thonë kur u bie fatkeqësi: Vërtet që të Allahut jemi dhe padyshim tek Ai do të kthehemi",* [16] nënshtrohet dhe është i duruar, me qëllim që sëmundja të mund të përmbushë detyrën e saj dhe atëherë të largohet.

● **Ilaçi i nëntëmbëdhjetë:**

Ashtu si termi i *përjetshmërisë* prej *Emrave më të bukur Hyjnorë* që tregon se të gjithë Emrat e bukur të të Gjithëlavdishmit janë të bukur, sepse midis qënieve, pasqyra më e hollë, më e bukur dhe më gjithëpërfshirëse e *të Synuarit të Përjetshëm* është jeta. Pasqyra e të Bukurit është gjithashtu e bukur. Dhe pasqyra që reflekton Bukuritë e të Bukurit, bëhet gjithashtu e bukur, dhe çdo gjë që e godet atë pasqyrë prej Atij të Bukuri është gjithashtu e bukur. Po ashtu, çdo gjë që i bie jetës nga këndvështrimi i realitetit është e mirë, sepse ajo shfaq skalitjet e bukura të atyre Emrave të bukur Hyjnorë të cilët janë të mirë e të bukur.

Në qoftë se jeta kalon në mënyrë të pandryshueshme, monotone, me shëndet të mirë të përtëritshëm dhe në mirëqënie, ajo do të bëhej një pasqyrë e mangët. Madje, nga një drejtim ajo tregon mosekzistencë, mosqënie e asgjësi dhe shkakton mërzi e mundim. Ajo pakëson vlerën e jetës dhe e transformon kënaqësinë e jetës në dëshpërim. Për shkak se duke menduar se ai do ta kalojë kohën e tij shpejt, nga mëzia njeriu e hedh veten e tij ose në shthurje ose në zbavitje. Ashtu si i burgosuri në burg, ai bëhet armiqësor ndaj jetës së tij të çmueshme dhe dëshiron ta vrasë e ta bëjë të kalojë shpejt.

Ndërsa një jetë që rrotullohet në ndryshueshmëri, në veprime e në gjendje të ndryshme, bën të ndihet vlera e saj. Madje edhe në qoftë se është në mundim e fatkeqësi, një njeri i tillë nuk dëshiron që ta kalojë shpejt jetën e tij. Ai nuk ankohet nga mërzia, duke thënë: "Ah, sa keq! Dielli nuk ka perënduar akoma" ose "është akoma natë".

[16] Kuran 2:156

Po, nëse dëshiron, pyete një njeri të pasur e dembel dhe që jeton në mes të të gjitha të mirave, dhe i thuaj: "Si je?" Ti do të dëgjoje prej tij përgjigje prekëse e për të të ardhur keq, si: "Ah kjo kohë, ajo nuk po kalon... eja të bëjmë një tavllë -lojë- ose le të gjejmë ndonjë zbavitje për të kaluar kohën." Ose ndryshe ti do të dëgjosh ankesa që burojnë nga ambiciet e kësaj bote, si, "unë kam lënë të mangët filan punë, ah sikur ta kisha bërë kështu apo ashtu".

Ndërsa në qoftë se do të pyesje një njeri të goditur nga fatkeqësia ose një punonjës, ose një njeri të varfër që jeton në vështirësi e mundim, e t'i thoje: "Si je? Si e ke hallin?" në qoftë se ai do të ishte i ndjeshëm, do të përgjigjej: "Lavdi Zotit dhe të gjitha falënderimet i takojnë Krijuesit tim, unë jam mirë e po punoj. Në qoftë se mbrëmja nuk do të kishte ardhur kaq shpejt, unë do ta kisha mbaruar këtë punë! Koha kalon shumë shpejt, edhe jeta gjithashtu; ato kalojnë shumë shpejt. Sigurisht gjërat janë të vështira për mua, por edhe kjo gjithashtu do të kalojë. Çdo gjë kalon shpejt". Ai me këto fjalë shpreh vlerën e jetës dhe rëndësinë e saj brenda dëshpërimit e keqardhjes së tij për jetën e cila ikën. Kjo do të thotë se ai e kupton kënaqësinë dhe vlerën e jetës nëpërmjet mundimit dhe punës.

Ndërsa, rehatia, lehtësia dhe shëndeti i mirë e bëjnë jetën të hidhur dhe e rëndojnë sa që e bëjnë njeriun të dëshirojë që ajo të kalojë.

O vëllai im i sëmurë! Dije se origjina dhe fara e të gjitha fatkeqësive, e të këqijave dhe madje e të gjitha gjynaheve është mosekzistenca, ashtu siç është provuar në mënyrë vendimtare dhe në detaje në pjesët e tjera të Risale-i Nurit. Sa për mosekzistencën, ajo është thjesht e keqe dhe errësirë e plotë.. Për shkak se gjendjet monotone të pandryshueshme, si, rehatia, heshtja, qetësia, ndalimi e ndërprerja janë të afërta me mosekzistencën dhe asgjësinë, ato bëjnë të ndjehet errësira e mosekzistencës dhe shkaktojnë dëshpërim. Sa për veprimin dhe ndryshimin, ato janë ekzistencë dhe e bëjnë ekzistencën të ndjehet. Ekzistenca është thjesht e mirë e pastër; ajo është dritë.

Meqenëse realiteti është ky, sëmundja jote i është dërguar qënies tënde si një mysafir për të kryer shumë detyra si të pastruarit e jetës tënde të çmueshme, për ta përforcuar, për ta bërë të përparojë dhe për t'i bërë aftësitë e tjera humane në trupin tënd të drejtohen për t'i ardhur në ndihmë gjymtyrës tënde të sëmurë dhe për të shfaqur qëndisjet e Emrave të Krijuesit të Gjithurtë. Në dashtë Zoti xh.sh., ajo do t'i përmbushë detyrat e saj shpejt dhe do të largohet. Dhe ajo do t'i thotë shëndetit të mirë: "Hajde dhe qëndro përgjithmonë në vendin tim dhe zbato detyrat e tua. Kjo shtëpi është e jotja. Qëndro këtu në shëndet të mirë".

● **Ilaçi i njëzet:**

O i sëmurë që kërkon një ilaç për sëmundjen tënde! Dije se sëmundja është dy llojesh: Një lloj është real, tjetri është imagjinar. Sa për llojin real, Shëruesi i Gjithurtë i Gjithëlavdishëm ka bërë për çdo sëmundje ilaç, dhe i ka depozituar në farmacinë e Tij më të madhe e cila është toka. Ato sëmundje kërkojnë ilaçe. Krijuesi xh.sh. ka krijuar ilaçe për çdo sëmundje. Prandaj marrja e ilaçeve dhe përdorimi i tyre për qëllim mjekimi janë të ligjshme nga sheriati. Por njeriu duhet ta dijë se efekti i ilaçit dhe shërimi janë vetëm nga Allahu i Plotëfuqishëm. Ai ashtu siç jep ilaçin, po ashtu jep edhe shërimin.

Të ndjekurit e këshillave të doktorëve të aftë muslimanë dhe të rekomandimeve është një ilaç i rëndësishëm, sepse sëmundjet më të shumta burojnë nga keqpërdorimi, nga mungesa e regjimit dietetik, nga harxhimi i tepërt, nga neglizhimi i udhëzimit, nga gjynahet, shthurja dhe nga mungesa e kujdesit. Një doktor fetar sigurisht do të jepte këshilla e porosi brenda limiteve të të lejuarës. Ai do të ndalonte nga keqpërdorimet dhe tepritë dhe do të ngjallte shpresë tek i sëmuri dhe do t'i jepte ngushëllim; kështu sëmundja e tij do të lehtësohej; ai do të shkaktonte lehtësi për të në vend të pikëllimit.

Sa për llojin imagjinar të sëmundjes, ilaçi më i efektshëm për të është të mos i japësh rëndësi asaj. Sa më shumë rëndësi që t'i japësh, aq më shumë ajo rritet e të ënjt. Në qoftë se nuk i jepet rëndësi, ajo

pakësohet e largohet. Sa më shumë të shqetësohen grerëzat, aq më shumë vërshojnë e mizërojnë rreth kokës së njeriut dhe, në qoftë se atyre nuk u jepet rëndësi, ato ikin prej teje e shpërndahen. Gjithashtu, sa më shumë rëndësi që dikush i jep me imagjinatë një cope spangoje që tundet e valëvitet përpara syve të tij në errësirë, aq më shumë do të zmadhohet para tij ajo imagjinatë derisa ta bëjë të ikë prej saj si një i çmendur.

Ndërsa në qoftë se nuk i jep rëndësi, do të zbulohet për të se ajo është thjesht një copë spango dhe jo gjarpër.. dhe do të fillonte përqeshjen për shkak të tronditjes së mendjes së tij dhe nga imagjinata.

Gjithashtu kjo sëmundje imagjinare në qoftë se vazhdon shumë, do të transformohet në një sëmundje reale. Ajo është një sëmundje e keqe për nervozët dhe për ata të dhënë pas imagjinatave, ëndrrave; njerëz të tillë e bëjnë qimen tra, dhe shkatërrohen forcat e tij shpirtërore, në mënyrë të veçantë kur takohen e qëllojnë me doktorë të pamëshirshëm gjysmakë ose me doktorë të padrejtë të cilët i zgjojnë iluzionet e tyre dhe i lëvizin ata më shumë se më parë derisa të humbasin pasurinë e tyre nëse janë të pasur, ose të humbasin mendjet ose shëndetin e tyre.

● **Ilaçi i njëzet e njëtë:**

O vëllai im i sëmurë! Në të vërtetë në sëmundjen tënde ndodhet dhimbje fizike, veçse ama një kënaqësi jolëndore e rëndësishme të rrethon ty dhe do të largojë të gjitha efektet e asaj dhimbjeje fizike; sepse sëmundja jote fizike nuk i kalon atë dhembshuri e mëshirë të kënaqshme të cilat i ke harruar qysh nga fëmijëria dhe të cilat rizgjohen përsëri tani në zemrat -brendësitë- e dy prindërve të tu dhe të afërmve të tu drejt teje në qoftë se ti i ke prindërit dhe ke të afërm; pasi ti do t'i shohësh përsëri ato shikime dhe atë dhembshuri të këndshme të cilat ishin kthyer drejt teje në fëmijëri. Dhe zbulohet e hiqet perdja prej të dashurve të tu përreth teje që të kujdesen përsëri për ty dhe të orientohen drejt teje me dashurinë e me dhembshurinë e tyre nëpërmjet tërheqjes së sëmundjes e cila i zgjoi ato ndjenja të brendshme.

Atëherë, sa të lira janë ato dhimbje fizike, prej të cilave ti vuan, përballë atyre shërbimeve të mëdha të kombinuara me mëshirë e dhembshuri nëpërmjet dekretit të sëmundjes që tani po të shërben me dashamirësi dhe u bëre nëpërmjet saj prijës e urdhërues për ta. Për më tepër, meqenëse ti ke tërhequr drejt teje butësinë, simpatinë dhe dhembshurinë humane të njerëzve të cilat janë të bashkëlindura tek njeriu. Pastaj nëpërmjet kësaj sëmundjes tënde ti ke marrë leje prej shumë detyrave të rënda dhe ke marrë pushim tani.

Atëherë, nuk duhet që të të shtyjë dhimbja jote e pjesshme në ankesë, por në dhënien e falënderimeve përballë këtyre kënaqësive jolëndore.

● **Ilaçi i njëzet e dytë:**

O vëllai im që vuan nga një sëmundje e rëndë si paraliza -damlla!

Së pari, unë po të jap sihariqet se paraliza konsiderohet e bekuar për besimtarët! Para një kohe të gjatë unë e dëgjoja këtë prej Evlijave të drejtë dhe nuk e dija arsyen. Tani, një arsye për të më shfaqet siç vijon:

Me qëllim që të arrijnë tek i Vërteti xh.sh., që të shpëtojnë nga rreziqet e mëdhaja shpirtërore të kësaj bote dhe që të fitojnë lumturinë e përjetshme, njerëzit e shenjtërisë kanë zgjedhur për të ndjekur dy parime:

I pari është shqyrtimi i vdekjes. Duke menduar se edhe dynjaja është e përkohshme dhe ata vetë gjithashtu janë mysafirë të përkohshëm të ngarkuar me detyra, ata punojnë për jetën e përhershme në këtë mënyrë.

I dyti: Nëpërmjet agjërimit, praktikave fetare dhe asketizmit, ata përpiqen ta vrasin nefsin urdhërues për të liga dhe kështu të shpëtojnë nga rreziqet e tij dhe nga emocionet e verbëra të cilat nuk i shikojnë pasojat.

O vëllai im që ke humbur shëndetin e gjysmës së trupit tënd! Pa zgjedhjen tënde ty të janë dhënë këto dy parime, të cilët janë të shkurtër, të lehtë dhe ato të shtrojnë rrugën drejt lumturisë tënde të përhershme; ato të kujtojnë ty vazhdimisht natyrën kalimtare të dynjasë dhe se njeriu është i përkohshëm.

Kështu dynjaja nuk mund të të mbysë më, as pakujdesia nuk mund t'i mbyllë sytë e tu. Dhe sigurisht, nefsi urdhërues për të liga nuk mund ta mashtrojë me dëshira të ulëta shtazore e me epshe dikë që është në gjendjen e një gjysëm njeriu. Si rrjedhojë, ai shpëton shpejt nga sprovat dhe nga e keqja e nefsit.

Kështu, nëpërmjet misterit të besimit në Allah, dhe të nënshtrimit ndaj Tij dhe të mbështetjes tek Ai, besimtari mund të përfitojë në një kohë të shkurtër prej një sëmundjeje të rëndë si paraliza, ashtu si sprovat e Evlijave -shenjtorëve. Atëherë një sëmundje e tillë si ajo bëhet tej mase e lirë.

● **Ilaçi i njëzet e tretë:**

O i sëmurë i mjerë që je i vetëm dhe i huaj dhe i pafuqishëm! Në qoftë se vetmia dhe mërgimi bashkë me sëmundjen tënde bëhen shkas për të ngjallur simpati e dhembshuri ndaj teje në zemrat më të ashpra dhe të tërheqin zemërbutësinë dhe përdëllimin ndaj teje, atëherë si do të ishe lidhur me mëshirën e Krijuesit tënd Mëshirëplotë, manifestimet e mëshirës së të Cilit në çdo pranverë mbushin faqen e tokës, i Cili e prezanton Vetveten para nesh në fillimin e çdo sure Kurani me Atributet ***Er-Rahman, Er-Rahim****, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti*, dhe që me një shkreptimë të mëshirës së Tij i bën të gjitha nënat t'i ushqejnë të vegjëlit e tyre me atë zemërbutësi të mrekullueshme, me një manifestim të mëshirës së Tij e mbush faqen e tokës me mirësi në çdo pranverë, dhe nëpërmjet një manifestimi të vetëm të mëshirës së Tij, mishërohet jeta e amshuar në parajsë bashkë me të gjitha bukuritë dhe çudirat e saj.

Atëherë, sigurisht lidhja jote me Atë nëpërmjet besimit dhe të kërkuarit strehim tek Ai nëpërmjet gjuhës së pafuqisë së sëmundjes tënde, shpresa jote prej Tij, përgjërimi duke iu lutur dhe sëmundja jote e vetmisë në mërgim, do të tërheqin vështrimin e mëshirës së Tij ndaj teje, vështrim i cili merr vendin e gjithçkaje. Meqenëse Ai ekziston dhe të shikon, gjithçka ekziston për ty.

Me të vërtetë, të vetmuar e në mërgim janë ata të cilët nuk janë të lidhur me Të nëpërmjet besimit dhe nënshtrimit, ose që nuk i japin rëndësi asaj lidhjeje.

● **Ilaçi i njëzet e katërt:**

O ju që kujdeseni për fëmijët e sëmurë të pafajshëm dhe për të moshuarit të cilët janë si fëmijë të pafajshëm! Përpara jush është një tregti e rëndësishme për Ahiretin. Fitojeni atë tregti nëpërmjet zellit dhe përpjekjes së madhe! Është vërtetuar nga njerëzit e realitetit se sëmundjet e fëmijëve të pafajshëm janë si ushtrime e stërvitje për trupat e tyre delikatë, si injeksione zhvilluese e si trajnim Hyjnor që t'i bëjë ata të përballojnë në të ardhmen vështirësitë e jetës dhe mundimet; që përveç shembujve të shumtë të urtësisë që i përkasin jetës së fëmijës në këtë dynja dhe jetës së tyre shpirtërore, ajo e pastron jetën e të vegjëlve me një pastrim shpirtëror ashtu siç e pastron jetën e të mëdhenjve me shlyerje të mëkateve.

Sëmundjet janë si gjilpëra -injektime- të cilat sigurojnë paracaktimin shpirtëror të fëmijës në të ardhmen ose në Ahiret; dhe se meritat që vijnë nga sëmundje të tilla kalojnë tek veprat e mira të prindërve dhe në mënyrë të veçantë tek nëna e cila nëpërmjet misterit të dhembshurisë preferon shëndetin e fëmijës mbi shëndetin e saj, ashtu siç vërtetohet tek njerëzit e *Hakikatit* -Realitetit.

Sa për përkujdesjen ndaj të moshuarve, vërtetohet në rrëfenja të shëndosha dhe nga shumë ngjarje historike se së bashku me marrjen e një shpërblimi të madh, të marrësh duatë e të moshuarve dhe veçanërisht të prindërve, t'i gëzosh zemrat e tyre dhe t'u shërbesh me

besnikëri e sinqeritet, ky është boshti i lumturisë për të si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Dhe është vërtetuar gjithashtu nga shumë ngjarje se fëmija fatlum i cili i respekton dhe u bindet prindërve të tij të pafuqishëm do të trajtohet në të njëjtën mënyrë nga fëmijët e tij dhe se në qoftë se një fëmijë fatkeq i lëndon e i plagos prindërit e tij, do të ndëshkohet me shumë fatkeqësi si në këtë botë ashtu dhe në tjetrën.

Po, të kujdesesh jo vetëm për të afërmit që janë të moshuar apo për të pafajshmit, por gjithashtu edhe për besimtarët nëse njeriu do t'i haste, meqenëse nëpërmjet misterit të besimit ndodhet një vëllazëri e vërtetë, dhe t'i shërbesh me sinqeritet e përkushtim një besimtari të sëmurë të moshuar i cili ka nevojë dhe është i denjë për respekt, kjo kërkohet nga islami.

● **Ilaçi i njëzet e pestë:**

O vëllezërit e sëmurë! Në qoftë se dëshironi një ilaç të dobishëm dhe të shenjtë dhe një balsam për çdo sëmundje, i cili përmban një kënaqësi të vërtetë, zhvilloje besimin tënd! Domethënë, nëpërmjet pendimit dhe të kërkuarit falje dhe të pesë namazeve të detyruara dhe adhurimit, përdore besimin, atë ilaç të shenjtë dhe mjekimin që buron nga besimi.

Po, për shkak të dashurisë së kësaj dynjaje dhe lidhjes së fortë me të, të pakujdesurit janë bërë sikur të ishin qënie jolëndore të sëmura aq të mëdha sa dynjaja. Ne e kemi provuar në shumë pjesë të Risale-i Nurit se besimi i shëron menjëherë ato qënie jolëndore të cilat dërrmohen e shkallmohen nga goditjet e vdekjes dhe të ndarjes, i kuron plagët e tyre dhe i shëron me të vërtetë. Duke mos dashur të zgjatem, unë po e përmbledh diskutimin tim siç vijon:

Sa për ilaçin e besimit, ai e shfaq efektin e tij nëpërmjet zbatimit të detyrave të tua fetare me sa të kesh mundësi.

Pakujdesia, shthurja, dëshirat e ulëta të nefsit dhe zbavitjet e paligjshme e pengojnë efektshmërinë e atij ilaçi. Meqenëse sëmundja e

largon pakujdesinë dhe i pret orekset -dëshirat- dhe është një pengesë për kënaqësitë e paligjshme, atëherë përfitoni prej saj dhe përdorni ilaçin e besimit të vërtetë dhe dritat e tij të shenjta me pendesë, me *istigfar* -kërkim falje-, me dua e duke shpresuar...

Allahu ju dhëntë shëndet e shërim dhe i bëftë sëmundjet tuaja si shlyerje për gjynahet tuaja.

Amin! Amin! Amin!

وَقَالُوا الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي هَدَانَا لِهَٰذَا وَمَا كُنَّا لِنَهْتَدِيَ لَوْلَا أَنْ هَدَانَا اللَّهُ

لَقَدْ جَاءَتْ رُسُلُ رَبِّنَا بِالْحَقِّ

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

اَللّٰهُمَّ صَلِّ عَلَىٰ سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ طِبِّ الْقُلُوبِ وَدَوَائِهَا وَعَافِيَةِ الْأَبْدَانِ

وَشِفَائِهَا وَنُورِ الْأَبْصَارِ وَضِيَائِهَا وَعَلَىٰ آلِهِ وَصَحْبِهِ وَسَلِّمْ

Ndërsa ata thonë:

"Gjithë lavdërimet e falënderimet janë për Allahun i Cili na udhëzoi ne për këtë vend. Kurrë nuk do të kishim gjetur ne drejtimin, po të mos na kishte udhëhequr Allahu. Vërtet që të Dërguarit e Zotit tonë erdhën me të vërtetën".[17]

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga çna ke mësuar Ti. Vërtet që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".[18]

[17] Kuran 7:42
[18] Kuran 2:32

O Zot! Jepi bekime shkëlqesisë sonë Muhammedit,

mjekësisë për zemrat tona dhe ilaçit për to,

shëndetit të mirë për trupat tonë dhe shërimit të tyre,

dhe dritës së syve tonë dhe shkëlqimit të tyre,

dhe familjes së tij dhe sahabëve,

dhe jepu atyre paqe.

*** * ***

Shtojca e Shkreptimës së Njëzet e Pestë.

Kjo është Letra e Shtatëmbëdhjetë, e cila meqenëse është përfshirë në *Mektubat*, nuk është shkruar këtu.

*** * ***

SHKREPTIMA E NJËZET E GJASHTË

Trajtesa për të moshuarit

[Kjo shkreptimë përbëhet nga njëzet e gjashtë shpresa, drita e ngushëllime][1]

Kujtues: Arsyeja pse i kam shkruar dëshpërimet dhe vuajtjet e mia në mënyrën më pikëlluese që do t'ju dëshpëronte ju në fillimin e çdo 'shprese' është me qëllim që t'ju tregoj juve efektshmërinë e ilaçeve që burojnë nga Kurani i gjithurtë.

Kjo shkreptimë, lidhur me të moshuarit, nuk ka qenë në gjendje të ruajë bukurinë e të shprehurit në tre apo katër drejtime:

***E para*:** Meqenëse ajo është rreth historisë së jetës sime, unë shkova përsëri tek ato ngjarje nëpërmjet imagjinatës dhe ajo u shkrua në gjendjen mendore të atyre kohëve. Prandaj, një renditje e saktë nuk mund të ruhej në mënyrën e të shprehurit.


E dyta: Ajo u shkrua në një kohë që unë ndihesha shumë i lodhur pas faljes së agimit, dhe gjithashtu isha i detyruar ta shkruaja shpejt; kështu mënyra e saj e shprehjes u bë e ngatërruar.

E treta: Jo gjithmonë ndodhej dikush me mua për të shkruar dhe shkruesi, i cili në përgjithësi më shoqëronte, kishte katër ose pesë detyra të tjera që lidheshin me Risale-i Nurin. Prandaj ne nuk mund të gjenim kohë të mjaftueshme për ta korrigjuar dhe ajo mbeti në një gjendje të çrregulluar.

***E katërta*:** Ne ndiheshim të lodhur pas kompozimit -hartimit- të saj dhe, duke mos depërtuar në thellësitë e kuptimeve, u mjaftuam vetëm

[1] Në një kopje të shkruar me dorë të kësaj shkreptime dhe të korrigjuar nga autori i respektuar, u shkrua: "shpresat e tjera, nga e katërmbëdhjeta gjer tek e njëzet e gjashta nuk janë shkruar për shkak të fatkeqësisë së njohur (burgu, Eskishehir); për shkak se koha e shkruajtjes së tyre tashmë ka kaluar, kjo trajtesë mbeti e mangët". [e katërmbëdhjeta deri tek e gjashtëmbëdhjeta u shkruan në vijim, më vonë. Përkthyesi.]

me korrigjimet e përcipta; si rrjedhojë duhet të ketë gabime në mënyrën e të shprehurit. Unë kërkoj nga të moshuarit e nderuar që t'i shohin me tolerancë gabimet e tilla dhe, meqenëse mëshira Hyjnore nuk i refuzon duatë e të vjetërve të bekuar kur ata ngrejnë lart duart e tyre duke iu përgjëruar Allahut Mëshirëplotë, le të më përfshijnë mua në duatë e tyre.



Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Kef-Ha-Ja-Ajn-Sad. (ky është) tregimi për mëshirën e Zotit tënd ndaj robit të Tij Zekerijja.

Kur ai iu drejtua Zotit të tij me lutje të fshehtë. Duke thënë:

"Zoti im! Me të vërtetë që kockat më janë dobësuar dhe flokë të thinjura më kanë mbuluar kokën, por unë kurrë nuk kam qenë i pabekuar (prej Teje) në lutjet e mia ndaj Teje, o Zoti im![2]

Kjo shkreptimë përbëhet nga njëzet e gjashtë shpresa.

■ SHPRESA E PARË

O vëllezërit e mi të dashur dhe o motrat e mia të respektuara që keni arritur moshën e pjekurisë, të pleqërisë e të përfundimit! Ashtu si ju, edhe unë jam i moshuar. Unë do të shkruaj shpresat që i kam gjetur

[2] Kuran 19: 1-4

në pleqëri dhe disa nga gjërat që më kanë rënë, nga dëshira për të ndarë me ju dritat e ngushëllimit që ato përmbajnë. Natyrisht dritat që kam parë dhe dyert e shpresës që i kam hasur, qenë parë e hapur në përputhje me aftësitë e mia të mangëta e të ngatërruara. Në dashtë Zoti, gjendjet dhe aftësitë tuaja të pastërta e të sinqerta do t'i bëjnë ato drita që i kam parë të lëshojnë më shumë shkëlqim dhe t'i forcojnë shpresat që i kam gjetur.

Atëherë, burimi dhe origjina e shpresave dhe e dritave që vijojnë është *Imani* -besimi në Zot.

■ SHPRESA E DYTË

Kur hyra në pleqëri, në njërën nga ditët e vjeshtës në kohën e *iqëndisë* - faljes së pasdites- po vështroja dynjanë nga një maje mali.

Papritmas ndjeva një gjendje të trishtueshme, të përvajshme e të pikëlluar bashkë me një errësirë që i kishte rrethuar dhe kishin hyrë në thellësitë e mia.. Unë pashë se isha plakur.

Dita gjithashtu ishte vjetëruar, edhe viti ishte plakur; edhe dynjaja ishte plakur gjithashtu. Kjo pleqëri e cila mbulonte gjithçka rreth meje më tronditi rëndë. U afrua koha e ndarjes nga dynjaja, gati erdhi ndarja nga të dashurit..

Ndërsa nervozohesha i brengosur dhe i hidhëruar, papritmas zbulohet para meje mëshira Hyjnore dhe e transformoi atë dëshpërim pikëllues në një shpresë të fuqishme dhe në një gëzim ndriçues në zemër dhe e transformoi atë ndarje të hidhur nga të dashurit në një dritë vezulluese ngushëllimi.

Po, o ju që jeni plakur si unë! Allahu xh.sh. i Cili e prezanton madhërinë e Tij tek ne në më shumë se njëqind vende në Kur'anin e gjithurtë me atributet e ***Er-Rahman, Er-Rahim***, *i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti* dhe i Cili e dërgon gjithmonë mëshirën e Tij për t'u ardhur në ndihmë krijesave të gjalla në faqen e tokës të cilat i kërkojnë mëshirë Atij, dhe që në çdo vit e mbush pranverën me mirësi të panumërta dhe me dhurata nga e Padukshmja duke na i dërguar neve që jemi të nevojshëm për ushqim dhe, e manifeston mëshirën e Tij të thellë në përputhje me shkallët e dobësisë dhe me shkallët e pafuqisë sonë. Prandaj kjo mëshirë e Krijuesit tonë Mëshirëplotë është shpresa

më e madhe për ne dhe drita më e fuqishme. Kjo mëshirë mund të arrihet duke formuar një lidhje me Atë të Gjithëmëshirshëm të Vetëm nëpërmjet besimit dhe duke iu bindur Atij nëpërmjet kryerjes së pesë namazeve të detyruara dhe farzeve e obligimeve.

■ SHPRESA E TRETË

Një herë kur u zgjova në mëngjesin e pleqërisë nga gjumi i natës së rinisë unë e sodita vetveten dhe pashë se jeta ime po nxitonte drejt varrit sikur po vraponte teposhtë në tatëpjetë.

Ashtu siç tha Njazi Misri:[3]

"Në çdo ditë një gur nga ndërtesa e jetës sime bie në tokë;

O i pakujdesur! Ti po dremitesh i pavetëdijshëm se ndërtesa është rrënuar!

Trupi im, banesa e shpirtit tim, po bëhej e rrënuar duke i rënë një gur në çdo ditë dhe shpresat e mia dhe ndjenjat që më mbanin të lidhur fort me dynjanë, kishin filluar të këputeshin prej saj. Ndërkohë unë ndjeva se koha e ndarjes nga shokët e mi të panumërt dhe nga ata që i doja ishte afruar. Unë kërkoja një balsam për atë plagë të thellë shpirtërore e cila në pamje të jashtme ishte e pashërueshme, por nuk munda ta gjeja. Përsëri ashtu si Njazi Misri, unë thashë:

Ndërsa zemra ime deshi pavdekshmërinë e saj,

Urtësia e Krijuesit kërkoi përkohshmërinë dhe asgjësimin e trupit tim;

Unë jam i goditur me një sëmundje të pashërueshme të cilën madje as Lukmani nuk mundi ta kuronte."

Ndërsa isha në këtë gjendje, papritmas drita dhe shefaati i profetit të gjithëlavdishëm a.s.m., i cili është mëshira e Allahut për të gjitha botët, gjuha, modeli, shembulli, lajmëtari dhe përfaqësuesi i asaj mëshire shpirtërore, dhe dhurata e udhëzimit që ai i solli njerëzimit, e zbuti dhe e shëroi plagën të cilën e pata supozuar se ishte e pashërueshme dhe e pafund.

[3] Njazi Misri është një poet sufi turk (1618-1694). Përkthyesi

Po, o burra të moshuar dhe o gra të moshuara që e ndjeni pleqërinë ashtu si unë. Ne jemi duke u larguar, nuk ia vlen të mashtrojmë vetveten. Në qoftë se ne do t'i mbyllnim sytë ndaj saj, ajo nuk do të na bënte ne të mbeteshim këtu.

Ka një mobilizim. Toka e botës së ndërmjetme, e cila na shfaqet të jetë e errët dhe plot ndarje për shkak të mashtrimeve të errëta të cilat burojnë nga pakujdesia dhe pjesërisht nga njerëzit e çudhëzimit, është vendtakimi i të dashurve. Është bota kur ne do të takohemi me në krye të Dashurin e Zotit dhe ndërmjetësuesin tonë në Ditën e Kijametit dhe me të gjithë të dashurit dhe miqtë tanë.

Po, ai që është Sulltani i treqind e pesëdhjetë milionë njerëzve në çdo shekull dhe për një mijë e treqind e pesëdhjetë vite, dhe zhvilluesi i shpirtërave të tyre, udhëzuesi i mendjeve të tyre, i dashuri i zemrave të tyre dhe, regjistrit të veprave të mira të të Cilit, në përputhje me kuptimin e اَلسَّبَبُ كَالْفَاعِلِ "*shkaku është si vepruesi"*, çdo ditë i shtohet barasvlera e të gjitha veprave të mira të kryera nga ummeti i tij; i Cili është boshti i përmbushjes së qëllimeve të larta Hyjnore në univers dhe për të kuptuar vlerën e lartë të qënieve. Kur ai erdhi në dynja, sipas rrëfenjave të sakta dhe të ndriçimeve të zbulesave të vërteta, ai thirri: *"Ummeti im! Ummeti im!*."[4]

Gjithashtu në Gjyqin e Fundit kur gjithësecili mendon vetëm për vetveten, ai përsëri do të thotë: "*Ummeti im! Ummeti im*!" dhe me vetëflijim të shenjtë e të lartësuar ai shpejton nëpërmjet shefaatit të tij për të mbështetur ummetin e tij dhe për ta ndihmuar atë me mëshirën më të madhe, më të lartë, më të shenjtë e më sublime.

Atëherë ne jemi duke shkuar tek ajo botë në të cilën ka shkuar ky profet i nderuar, ne udhëtojmë për tek bota që u ndriçua me dritën e atij fanari ndriçues dhe e ndriçuar nga yjet e Evlijave të panumërt dhe nga dijetarët e pastër duke u rrotulluar rreth atij dielli.

Po, mjeti për të përfituar nga shefaati dhe nga drita e tij si dhe për të shpëtuar nga errësira e botës së ndërmjetme, është të ndjekësh sunnetin e tij të pastër e të lavdishëm.

[4] Transmetojnë Buhariu, Muslimi

■ SHPRESA E KATËRT

Në kohën që i isha afruar pleqërisë, shëndeti i trupit tim që kishte zgjatur pakujdesinë dhe e kishte shtrirë u thye, u bë i sëmurë. Pleqëria dhe sëmundja më sulmuan në bashkëpunim. Duke më goditur në kokë, ato e larguan nga unë gjumin e pakujdesisë. Unë nuk kisha asgjë që të më lidhte me dynjanë si, familje, fëmijë apo pasuri. Duke i pasë harxhuar frutat e kapitalit të jetës sime nëpërmjet mendjelehtësisë së rinisë, unë i pashë ato fruta të përbëheshin vetëm nga gjynahe e gabime.

Ndërkaq kërkova ndihmë duke thirrur ashtu si Njazi Misri:

Unë e mbylla pa fituar gjë; kapitali i jetës sime humbi i gjithi;

Erdha i pavetëdijshëm tek rruga për të gjetur karvanin që kishte shkuar larg.

Duke rrënkuar vazhdova rrugën krejt i vetmuar, i huaj;

Sytë e mi duke qarë, zemra ime në ankth, mendja ime e hutuar, e pavetëdijshme.

Unë në atë kohë isha në mërgim; ndjeva një brengë dëshpëruese, një keqardhje pendimi, një dëshirë të zjarrtë për ndihmë.

Papritmas, Kur'ani i gjithurtë më erdhi në ndihmë. Ai hapi një derë shprese aq të fuqishme dhe dha një dritë ngushëlluese aq të vërtetë saqë mund të largonte dëshpërimin dhe errësirën njëqind herë më të forta se sa të miat.

Po, o burra dhe o gra të respektuar e të moshuar që lidhjet e marrëdhëniet tuaja me dynjanë kanë filluar të ndahen e të këputen ashtu si unë!

Krijuesi i Gjithëlavdishëm i Cili e krijoi këtë dynja si një qytet të përkryer e të mirorganizuar si të ishte një pallat madhështor, a do të ishte e mundur që ky Krijues Gjithëbujar të mos fliste me të dashurit e Tij dhe me mysafirët e Tij më të nderuar në këtë qytet apo në këtë pallat? Dhe a do të ishte e mundur që Ai të mos i takonte ata?!!

Meqenëse Ai me dijeni e krijoi këtë pallat, e sistemoi atë me vullnet dhe e stolisi me zgjedhje, atëherë sigurisht që Ai do të fliste, sepse ashtu si ndërtuesi që di, edhe ai që njeh, flet. Dhe meqenëse Ai e bëri këtë pallat një bujtinë të bukur e të këndshme dhe këtë qytet si një vend tregtie për ne, atëherë Ai sigurisht duhet të ketë libra e fletë nëpërmjet të cilave të tregojë se çfarë dëshiron Ai prej nesh dhe të sqarojë lidhjet e Tij me ne.

Atëherë nuk ka dyshim se libri më i plotë prej atyre librave të shenjtë, të cilët Ai i shpalli, është Kur'ani i gjithurtë i shpjegimit të mrekullueshëm; mrekullia e tij është vërtetuar në dyzet aspekte; ai lexohet në çdo minutë nga të paktën njëqind milionë njerëz; ai përhap dritë dhe udhëzon për tek e drejta; çdo shkronjë e tij jep të paktën dhjetë merita dhe shpërblime; dhe ndonjëherë dhjetë mijë merita, dhe madje tridhjetë mijë merita ashtu si në *Natën e Kadrit*. Dhe kështu jep nga frutat e Xhennetit dhe nga dritat e botës së ndërmjetme çfarë të dojë Allahu që të japë. Nuk ka libër në univers që të konkurojë me të në këtë pozitë, dhe a do të mundej dikush tjetër ta pretendonte atë?

Përderisa Kurani gjithëbujar që ndodhet para nesh është Fjala e Krijuesit të të gjitha botëve që vjen nga Hyjnia e Tij absolute, nga madhështia e Hyjnisë së Tij, nga mëshira e Tij e gjithanshme dhe është dekreti dhe burimi i mëshirës së Tij, atëherë kapu fort pas tij; në të ka ilaç për çdo sëmundje, një dritë për çdo errësirë dhe shpresë për të gjitha dëshpërimet.

Atëherë, çelësi për këtë thesar të përjetshëm është besimi dhe nënshtrimi ndaj Allahut, ta dëgjosh atë, ta pranosh, ta këndosh e ta recitosh.

■ SHPRESA E PESTË

Në fillimin e pleqërisë sime, duke dashur të jetoj i vetmuar e i veçuar nga njerëzit, unë u tërhoqa dhe u mbylla në vetvete tek Jusha Tepesi, kodra e Joshuas që ka pamje nga Bosfori i Stambollit. Shpirti im po kërkonte qetësi në veçim e vetmi.

Një ditë në atë kodër të lartë, unë vështrova përreth meje në horizontin e gjërë. Pashë nëpërmjet paralajmërimit të pleqërisë një tabllo prej tabllove të kalimit e të ndarjes që pikonte dëshpërim e brengosje. Ndërkohë hodha vështrimin nga maja e pemës së jetës sime

prej degës së dyzet e pestë të saj deri sa përfundova tek thellësitë e niveleve më të ulëta të jetës sime; në secilën prej atyre degëve që ndodheshin atje brenda çdo viti, unë pashë kufoma të panumërta prej kufomave të të dashurve të mi, të shokëve dhe të të gjithë atyre që kishin lidhje me mua.

Duke ndjerë një dëshpërim të mjerueshëm që buronte nga largimi dhe nga ndarja prej të dashurve dhe, duke menduar ashtu si Fuduli El Bagdadi[5] për shkak të ndarjes nga të dashurit, unë qava duke thënë:

Sa herë që më kujtohet shoqërimi i tyre unë vajtoj,

dhe derisa të ketë frymë në këtë trup të thatë, unë do të qaj...

Ndërkaq unë kërkova një ngushëllim, një dritë dhe një derë që të çon tek shpresa. Papritmas besimi në botën tjetër më erdhi në ndihmë duke lëshuar një dritë të pashuar dhe duke dhënë një shpresë të pashkatërrueshme.

Po, o vëllezërit e mi dhe o motrat e mia që jeni moshuar si unë!

Meqenëse ka Ahiret dhe ai është i përhershëm dhe është një botë më e mirë se sa kjo; dhe meqenëse Ai i Cili na krijoi është i Gjithurtë dhe Mëshirëplotë, atëherë nuk duhet që ne të ankohemi për pleqërinë dhe as nuk duhet të dëshpërohemi për të, përkundrazi, meqenëse me pleqërinë njeriu arrin moshën e plotësimit nëpërmjet adhurimit dhe besimit, dhe ajo është një shenjë që ai do të lirohet nga detyrat e jetës dhe do të largohet për tek bota e mëshirës për të jetuar përgjithmonë në rehati, ne duhet të jemi të lumtur me të.

Po, njoftimi me unanimitet të plotë e të sigurt i dhënë nga njëqind e njëzet e katër mijë profetë e mesazhierë të pastër e të zgjedhur a.s. ashtu siç tregojnë për këtë numër hadithet; disa prej tyre duke u mbështetur tek shikimi dhe disa të tjerë tek 'siguria absolute' për ekzistencën e Ahiretit; njoftimet me unanimitet të tyre se njerëzit do të shtyhen për atje dhe se Krijuesi xh.sh. do ta sjellë padyshim vendbanimin e Ahiretit, ashtu siç ka premtuar në mënyrë të prerë.

[5] Fuduli Bagdadi është një poet i cili jetoi në shekullin XVI. Emri i tij i vërtetë është Muhammed. Përkthyesi

Gjithashtu duke i vërtetuar nëpërmjet ndriçimeve dhe shikimeve në formën e 'sigurisë tek shkalla e njohjes' njoftimet e profetëve, njëqind e njëzet e katër milionë Evlija kanë dëshmuar prerazi për ekzistencën e Ahiretit.

Gjithashtu manifestimet e të gjithë Emrave të Bukur Hyjnorë të Krijuesit të gjithësisë që shfaqen në të gjithë botën, kërkojnë në mënyrë të vetëkuptueshme ekzistencën e një bote tjetër të përjetshme, dhe tregojnë prerazi e qartë për ekzistencën e Ahiretit.

Gjithashtu, fuqia Hyjnore dhe urtësia e saj absolute, e cila nuk lejon asgjë të jetë kot e paqëllim, në çdo vit në pranverë sjell në jetë me urdhërin كُنْ فَيَكُونُ '***kun fejekun***, *bëhu! dhe ajo bëhet në çast*, kufomat e panumërta të pemëve të vdekura në faqen e tokës duke i bërë ato të shfaqen pas vdekjes së tyre, dhe duke i bërë si shenjë e 'Ringjalljes pas vdekjes', dhe ringjall duke sjellë në jetë treqind mijë specie bimësh e kafshësh duke treguar me këtë qindra e mijëra shembuj e modele të ringjalljes së të vdekurve; këto në mënyrë të qartë e të vetëkuptueshme bëjnë të domosdoshme ekzistencën e Ahiretit.

Gjithashtu, mëshira gjithëpërfshirëse e cila bën të vazhdojë jeta e të gjitha qënieve të gjalla të cilat kanë nevojë për furnizim -ushqim- duke ua siguruar me dhembshuri të plotë dhe në mënyrë të jashtëzakonshme mjetet e tyre të jetesës dhe, përkujdesja e vazhdueshme e cila shfaq llojet e pallogaritshme të stolisë e të zbukurimit, në një kohë shumë të shkurtër në çdo pranverë; edhe këto në mënyrë të vetëkuptueshme bëjnë të domosdoshme ekzistencën e Ahiretit.

Gjithashtu, dëshira e zjarrtë për qëndrueshmëri, përmallimi për përjetshmëri dhe shpresat për përjetësi të ngulitura thellë në natyrën e këtij njeriu i cili është fruti më i plotë i kësaj gjithësie; krijesa më e dashur e Krijuesit të universit, i cili prej të gjitha krijesave është më i lidhuri ngushtë me qëniet e tjera në univers, nuk ka dyshim se kjo tregon në mënyrë të qartë e të vetëkuptueshme ekzistencën e një bote të përjetshme pas kësaj bote të përkohshme dhe për ekzistencën e botës së Ahiretit dhe të banesës së lumturisë së përjetshme.

Atëherë të gjitha këto dëshmi vërtetojnë prerazi e në mënyrë të qartë e të vetëkuptueshme deri aty ku bën të domosdoshme ta pranosh, ekzistencën e Ahiretit ashtu si qartësia e ekzistencës së dynjasë.[6]

Meqenëse mësimi më i rëndësishëm që na jep Kurani është 'Besimi në botën tjetër' dhe ky mësim, ky besim, është kaq i fuqishëm dhe në atë besim ndodhet një dritë vezulluese, një shpresë e fortë dhe një ngushëllim i madh i tillë saqë, në qoftë se do të grumbulloheshin njëqind mijë pleqëri tek një person i vetëm, ngushëllimi që buron nga ky besim, ajo dritë dhe ajo shpresë do të ishin të mjaftueshme për t'i përballuar ato. Prandaj, ne njerëzit e moshuar duhet të gëzohemi për pleqërinë tonë e të themi:

"Lavdi Zotit për Plotësimin e Imanit".

■ SHPRESA E GJASHTË

Kur isha në internim, në atë robëri pikëlluese, i tërhequr e i veçuar nga njerëzit dhe i vetmuar në majë të malit Çam Dağı -Mali i Pishës- me pamje nga kullotat e Barlës.. unë po kërkoja një dritë në atë vetmi.

Një natë, ndërsa isha i vetmuar në një dhomë të vogël të ngritur në majë të një pishe të lartë në majë të atij mali të lartë, pleqëria më kujtoi tre apo katër mërgime, njëri brenda tjetrit. Ashtu siç është përshkruar në Letrën e Gjashtë, në qetësinë e asaj nate në të cilën nuk kishte asnjë

[6] Lehtësia e njoftimit të një çështjeje të sigurt dhe vështirësia në mohimin e saj mund të shihen në krahasimin që vijon: Në qoftë se një njeri thotë: "Ndodhet një kopshti mrekullueshëm në tokë ku pemët në to kanë fruta si kutia qumështi". Dhe një njeri tjetër e mohon këtë duke i thënë: "Jo, nuk ekziston një kopshti tillë". Personi i parë ka mundësi me lehtësinë më të madhe që ta provojë pretendimin e tij: thjesht duke treguar vendin e atij kopsht i ose disa nga frutat e tij. Ndërsa të dytit, domethënë mohuesit, me qëllim që të provojë mohimin dhe pretendimin e tij, i duhet të shikojë e t'i shfaqë të gjitha anët e globit tokësor me qëllim që të provojë mosekzistencën e atij kopsht i.

Pikërisht kështu është çështja e atyre që njoftojnë për Xhennetin; ata shfaqin qindra e mijëra shenja, fruta dhe tregues të Parajsës, duke ditur se dëshmia e dy dëshmitarëve të vërtetë është i mjaftueshëm për të provuar pretendimin e tyre.

Kurse mohuesit e ekzistencës së tij, për të provuar mohimin e tyre u duhet të shikojnë universin e pakufishëm, dhe kohën e pakufishme duke e kërkuar dhe hetuar atë plotësisht, dhe vetëm atëherë ata mund të demonstrojnë mosekzistencën e tij. Dhe kështu, o vëllezërit e mi të moshuar, ju mund të kuptoni se sa i fuqishëm është besimi për botën tjetër.

ndikim a zë përveç asaj jehone të zymtë, fështërimave dhe murmurimave të pemëve.. unë ndjeva se ai zë melankolik dhe ajo jehonë e trishtueshme goditën thellësitë e emocioneve të mia dhe prekën thellësitë e ndjenjave të mia, dhe prekën thellësitë e pleqërisë sime dhe mërgimin tim. Ndërkohë, pleqëria më dha mendimin që vijon:

Ashtu siç u transformua dita në këtë varr të zi, të errët dhe, dynjaja veshi qefinin e tij të zi, po ashtu edhe dita e jetës tënde do të transformohet në natë, dhe dita e dynjasë do të transformohet në Natën e Berzahut, të Botës së ndërmjetme; gjithashtu edhe dita e verës së jetës do të transformohet e bëhet natë e dimrit të jetës. Atëherë nefsi im u detyrua të thotë:

Po, ashtu siç jam unë i huaj këtu larg vendlindjes e krahinës sime, i ndarë nga ata që unë i kam dashur gjatë pesëdhjetë viteve të jetës sime të cilët kanë vdekur, dhe kam mbetur duke vajtuar për ta, gjë kjo që është një syrgjynosje më e trishtueshme dhe më pikëlluese se sa internimi nga vendi e krahina ime. Për më tepër, unë në këtë natë ndiej një mërgim më të trishtueshëm dhe më pikëllues se sa mërgimi im në këtë mal i vetmuar dhe i syrgjynosur: pleqëria më njofton se po i afrohem kohës së ndarjes nga dynjaja me çfarë përfshin ajo. Pastaj unë fillova të kërkoj një dritë dhe një shpresë nga këto mërgime njëri brenda tjetrit. Papritmas 'besimi në Zotin xh.sh.' më erdhi në ndihmë dhe më dha një familiaritet të madh të tillë saqë në qoftë se vetmia ime e përbërë në të cilën unë e gjeta vetveten do të shtohej e mijëfishohej, ai ngushëllim do të kishte qenë i mjaftueshëm për t'i larguar ato.

Po, o ju burra të moshuar e gra të moshuara! Meqenëse ne kemi një Krijues Mëshirëplotë, atëherë, kurrë nuk ka mërgim për ne! Meqenëse Ai ekziston, gjithçka ekziston për ne. Meqenëse Ai ekziston, edhe engjëjt ekzistojnë gjithashtu. Atëherë kjo dynja nuk është bosh, malet e vetmuar dhe shkretëtirat e zbrazura janë të mbushura plot me shërbëtorë të nderuar të Allahut xh.sh., me melekë të nderuar.

Po, drita e besimit në Zotin xh.sh. dhe shikimi i universit për llogari të Tij, i bën pemët, madje edhe gurët sikur të ishin miq e shokë të dashur, përveç shërbëtorëve të Tij të vetëdijshëm, sepse ato qënie mund të flasin me ne -nëpërmjet gjuhës së gjendjes- dhe na japin ëndje e kënaqësi.

Po, dëshmitë dhe dëshmitarët sa numri i qënieve në univers dhe sa numri i shkronjave të këtij libri të gjërë të kësaj bote të madhe dëshmojnë për ekzistencën e Krijuesit tonë Mëshirëplotë, Gjithëbujar, Mik i ngushtë, i Dashur, Shpikës e Mbrojtës; ato dëshmi na e shfaqin mëshirën e Tij sa numri i gjymtyrëve të krijesave të gjalla, i ushqimeve dhe i mirësive që u përket atyre të cilat janë boshti i dhembshurisë, i mëshirës dhe i përkujdesjes, dhe tregojnë Divanin e Tij. Nuk ka dyshim se pafuqia dhe dobësia janë dy ndërmjetësit më të pranueshëm për tek ai Divan i lartë. Dhe pikërisht koha e pafuqisë dhe e dobësisë është mosha e pleqërisë, atëherë ne duhet ta duam pleqërinë dhe jo të zemërohemi e të prekemi prej saj, pasi ajo është një ndërmjetësuese e pranueshme para Atij Divani të lartë.

■ SHPRESA E SHTATË

Kur e qeshura e Saidit të vjetër po transformohej në qarje të Saidit të ri në kohën e fillimit të pleqërisë, njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje në Ankara më bënë mua ftesë për të shkuar atje, duke pandehur për mua se isha akoma 'Saidi i vjetër', dhe unë iu përgjigja ftesës së tyre.

Në një ditë nga ditët e fundit të vjeshtës, unë u ngjita në majën e kështjellës së Ankarasë, e cila ishte më e plakur, më e rrënuar dhe më e lodhur se sa unë. Ajo m'u duk se ishte formuar nga ngjarje historike të gurëzuara, të ngurosura. Pleqëria e stinës së vitit së bashku me atë të moshës sime, pleqëria e kështjellës, pleqëria e njerëzimit, pleqëria e shtetit osman, vdekja e sundimit të kalifatit dhe pleqëria e dynjasë, që të gjitha më bënë të dukesha në gjendjen më të trishtueshme, të brengosur e të zymtë në atë kështjellë të lartë në luginat e së shkuarës dhe në malet e së ardhmes. Ndërsa unë po përjetoja një gjendje krejtësisht të errët në shpirtin tim në Ankara, gjendje e cila ishte rrethuar nga katër a pesë shtresa prej errësirave të pleqërisë njëra brenda tjetrës[7], unë kërkova një dritë, një ngushëllim dhe një shpresë.

Kur unë hodha vështrimin nga e djathta, e cila është e shkuara, duke kërkuar një dritë e një shpresë, m'u duk ai drejtim nga larg në formën e një varreze të madhe të babait tim, e paraardhësve të mi dhe e

[7] Kjo gjendje shpirtërore në atë kohë më erdhi në formën e lutjes në zemër në gjuhën perse dhe unë e shkrova ashtu siç më erdhi; pastaj u botua në Ankara brenda trajtesës së titulluar ***Hubbab***.

llojit njerëzor dhe, në vend që të më ngushëllonte, më mbushi me zymti e trishtim.

Pastaj, duke kërkuar një ilaç, unë hodha shikimin nga e majta, domethënë nga e ardhmja. Ajo m'u shfaq në formën e një varri të madh të errët për mua, për bashkëkohësit e mi dhe për brezat e ardhshëm dhe, në vend që të më jepte familjaritet, ajo më dha panik e tmerr. Duke u ndjerë i vetmuar përballë të majtës dhe të djathtës, unë hodha vështrimin tek koha ime e tanishme. Ajo kohë u shfaq për shikimin tim të pakujdesshëm dhe historik si një arkivol duke mbajtur trupin tim të munduar e të tronditur si i therruri midis vdekjes dhe jetës. Pastaj, i dëshpëruar nga ky drejtim, unë ngrita lart kokën time dhe hodha vështrimin tek maja e pemës së jetës sime, dhe pashë se në atë pemë ndodhej vetëm një frut dhe ai shikonte tek unë; ajo ishte kufona ime. Duke ndier tmerr nga ky drejtim, unë ula poshtë kokën time duke shikuar tek rrënjët e pemës së jetës sime; unë pashë se dheu që ishte aty ishte pluhuri i kockave të mia dhe dheu i zanafillës së krijimit që ishin përzier së bashku; ato shtypeshin në këmbë. Ai nuk ishte ilaç, ai vetëm se i shtoi një dhimbje tjetër dhimbjes sime.

Pastaj u detyrova të hedh vështrimin nga prapa meje. Unë pashë se kjo dynja e përkohshme kalimtare po rrokullisej poshtë në luginat e asgjësisë dhe po binte në errësirat e mosekzistencës. Ndërsa po kërkoja një balsam për sëmundjen time, ky shikim vetëm se shtoi helm mbi plagët e mia. Kur nuk gjeta në atë drejtim as ndonjë gjë të mirë dhe as shpresë, unë ktheva shikimin tim nga ana e përparme, sodita nga larg, dhe pashë se dera e varrit shihej e hapur mu në mes të rrugës sime; ajo po më vështronte gojë hapur. Pas saj ishte rruga që shtrihej drejt përjetësisë, dhe karvanet e njerëzimit që ecnin në atë rrugë m'u shfaqën mua nga larg. Dhe përveç se një dëshire të pjesshme e të kufizuar, si mbështetja ime dhe arma mbrojtëse përballë këtyre fatkeqësive e tmerreve që vinin nga këto gjashtë drejtime, unë nuk kisha asgjë.

Meqenëse kjo armë e vetme -dëshira e pjesshme- ishte e mangët, e shkurtër, e dobët, e pafuqishme, dhe që s'kishte forcë për të krijuar përballë të gjithë atyre armiqve të panumërt dhe gjërave të dëmshme të pafundme; dhe njeriu nuk ka mundësi tjetër, veçse 'fitimit', pasi ai nuk mund të kalojë as tek koha e shkuar me qëllim që t'i heshtë dëshpërimet që erdhën prej andej, as nuk mund të depërtojë për tek e ardhmja që të pengojë frikësimet e ankthet që vijnë prej saj. Unë pashë

me siguri se nuk kishte asnjë dobi a ndihmë për shpresat dhe dhimbjet e mia lidhur me të shkuarën dhe me të ardhmen.

Ndërsa isha i tronditur në mes të tmerrit, vetmisë, errësirës dhe dëshpërimit që më vinin nga këto gjashtë drejtime, dritat e besimit që shkëlqenin në qiellin e Kuranit të shpjegimit të mrekullueshëm papritmas më erdhën në ndihmë. Ato i ndozën dhe i ndriçuan ato gjashtë drejtime në një shkallë të tillë, saqë sikur të shtoheshin njëqind herë më shumë tmerret dhe errësirat që kisha parë, ato drita do të ishin të mjaftueshme e të plota për t'i rrethuar e për t'i përfshirë ato.

Ato drita e shndërruan atë zinxhir të gjatë vetmie në ngushëllim e shpresë, i transformuan ato tmerre e frikësime në familjaritet, miqësi të ngushtë, në qetësi të zemrës dhe në shpresë të shpirtit një e nga një.

Po, besimi e grisi atë formë të tmerrshme të së shkuarës që ishte si një varrezë e madhe dhe e transformoi në një tubim të ndritshëm e familjar dhe në një vend takimi për të dashurit, dhe këtë e shfaqi me siguri të plotë e me sigurinë absolute...

Pastaj besimi e shfaqi të ardhmen, e cila ishte dukur në formën e një varri të madh për sytë e mi të pavëmendshëm, e shfaqi me sigurinë e njohjes se ishte një vend gostie i të Gjithëmëshirshmit i përgatitur në pallatet e lumturisë së përjetshme.

Pastaj besimi e copëtoi formën e arkivolit të kohës së tanishme që dukej ashtu nëpërmjet shikimit të pakujdesisë dhe e tregoi atë me siguri se ishte vend tregtie për Ahiretin dhe një bujtinë e të Gjithëmëshirshmit.

Pastaj besimi e tregoi me siguri të plotë se fruti i vetëm në majë të pemës së jetës sime nuk ishte një kufomë ashtu siç ishte shfaqur për syrin tim të shkujdesur, por se shpirti im i cili do të manifestonte jetë të amshuar ishte paracaktuar për lumturinë e përjetshme, do ta linte shtëpinë e tij të rrënuar dhe do të udhëtonte përreth yjeve.

Dhe nëpërmjet misterit të tij, besimi tregoi se kockat e mia dhe pluhuri që ishin zanafilla e krijimit tim, nuk ishin thjesht kocka të pavlera të pluhurta që shtypen nën këmbë, por ai pluhur ishte dera e mëshirës Hyjnore dhe perde para sallës së Parajsës.

Nëpërmjet misterit të Kuranit, besimi shfaqi e tregoi se dynjaja e cila qe shfaqur për syrin tim të pavëmendshëm sikur rrokullisej poshtë në errësirat e mosekzistencës dhe në asgjësi -ajo nuk po rrokullisej kështu në errësirat e mosekzistencës ashtu siç u supozua në fillim, por dynjaja me të gjitha gjendjet e saja janë një lloj prej mesazheve Hyjnore dhe si fletë zbukurimi dhe qëndisjeje të Emrave të Bukur të të Përjetshmit Absolut të cilat i kishim përmbushur detyrat e tyre, që i kishin shfaqur kuptimet e tyre dhe kishin lënë prapa rezultatet e tyre në ekzistencë. Kështu më bëri të njohur me siguri të plotë natyrën e vërtetë të dynjasë.

Dhe nëpërmjet Dritës së Kuranit, besimi më tregoi qartë se ai varr, i cili kishte hapur sytë e tij dhe më shikonte duke më pritur, nuk ishte gryka e një pusi, por ai ishte dera për botën e dritës. Dhe ajo rrugë pas tij -e cila shtrihej për në përjetësi- nuk të çonte në asgjësi e në mosekzistencë, por në ekzistencë, në botën e dritës dhe në lumturinë e përjetshme.

Meqenëse besimi e demonstroi këtë deri në një shkallë që dha bindje të plotë, ky qe një ilaç e balsam për sëmundjen time.

Pastaj besimi i jep asaj dëshire të pjesshme, e cila ka vetëm një fitim të pjesshëm, një dokument nëpërmjet të cilit ai mbështetet tek një fuqi absolute, dhe nëpërmjet tij ai lidhet me një mëshirë të pakufishme përballë atyre armiqve të panumërt dhe atyre shtresave të errësirës, madje vetë besimi është një dokument në dorën e dëshirës së pjesshme të njeriut.

Pastaj kjo dëshirë e pjesshme e cila është arma e njeriut, edhe në qoftë se në vetvete është e mangët, e pafuqishme dhe e shkurtër, veçse ama në qoftë se ajo do të përdorej në Emrin e Zotit të Plotëfuqishëm, në rrugën e Tij dhe për hir të Tij, njeriu do të arrinte -nëpërmjet misterit të besimit- një xhennet të përjetshëm me një gjërësi që arrihet për pesëqind vjet. Ashtu si një ushtar që, në qoftë se do të përdorte fuqinë e tij të pjesshme në Emrin e Shtetit, do të ishte e kollajtë për të që të kryente akte që tejkalojnë me mijëra herë forcën e tij individuale.

Besimi ashtu siç i jep një dokument dëshirës së pjesshme, ai i merr prej duarve të trupit frerat e dëshirës së pjesshme, i cili nuk mund të depërtojë në të shkuarën dhe as në të ardhmen, dhe ia dorëzon ato zemrës dhe shpirtit. Meqenëse sferat e jetës së shpirtit dhe të zemrës

nuk kufizohet tek koha e tanishme ashtu si trupi, dhe të përfshira në sferën e asaj jete janë shumë vite nga e shkuara dhe shumë vite nga e ardhmja, atëherë ajo dëshirë e pjesshme niset nga e pjesshmja, pushon së qëni e kufizuar, dhe fiton universalitet. Ashtu si nëpërmjet forcës së besimit, ajo mund të futet në luginat më të thella të së shkuarës dhe largon errësirat dhe hidhërimet e saj, po ashtu me dritën e besimit, ajo mund të ngjitet tek malet më të larta të së ardhmes duke larguar ankthet dhe frikësimet e saj.

O vëllezërit e mi të moshuar dhe o motrat e mia të moshuara që po vuani vështirësitë e pleqërisë ashtu si unë!

Meqenëse, lavdi Zotit, ne jemi besimtarë, dhe në besim gjenden kaq shumë thesare të ndritshëm, të kënaqshëm, të ëmbël e të dashur; dhe meqenëse pleqëria jonë na shtyn neve edhe më shumë për tek kënaqësitë e thesareve, atëherë nuk duhet të shfaqim ankesa për pleqërinë, por duhet t'i paraqesim një mijë e një falënderime Allahut dhe ta lavdërojmë Atë për pleqërinë tonë të ndriçuar me iman.

■ SHPRESA E TETË

Në kohën kur thinjat, të cilat janë shenjat e pleqërisë, filluan të shfaqeshin në flokët e mia, dhe trazirat e luftës së parë botërore dhe pasojat e rënda që la pas mbajtja ime si rob lufte tek rusët, të gjitha këto e bënë akoma më të thellë e më të rëndë gjumin e pakujdesisë së rinisë. Nderimi dhe emri i madh që m'u bënë kur u ktheva në Stamboll, trajtimi i mirë që m'u bë, rëndësia dhe vëmendja që m'u kushtua gjë që ishin shumë më të tepërta se sa e meritoja, qoftë nga ana e kalifit, apo e Shejhul islamit, nga komandanti i përgjithshëm i ushtrisë apo nga studentët e fesë; e gjitha kjo shkaktoi tek unë një gjendje shpirtërore përveç dehjes dhe pakujdesisë së rinisë dhe e bëri atë gjumë tek unë akoma më të thellë e më të rëndë, saqë unë me të përfytyrova se dynjaja ishte e përhershme dhe e qëndrueshme, dhe e pashë veten time në një gjendje të çuditshme të çimentuar e të lidhur fort me dynjanë sikur unë nuk do të vdisja.

Në këtë kohë, unë shkova tek xhamia Bajazit në Stamboll në një ditë të Ramazanit për të dëgjuar Kuranin nga hafizat e sinqertë të Kuranit. Nëpërmjet gjuhëve të atyre hafizëve, recituesve, Kurani i shpjegimit të mrekullueshëm po shpallte me adresimin e tij të lartësuar

qiellor dekretin: كُلُّ نَفْسٍ ذَآئِقَةُ الْمَوْتِ *"Gjithësecili do ta shijojë vdekjen"*[8], i cili në mënyrën më të fuqishme shpall vdekjen e njeriut dhe atë të qënieve të gjalla. Ky njoftim hyri në veshin tim, depërtoi në thellësirat e zemrës sime dhe u vendos atje; ai dekret e dërrmoi dhe e shkatërroi gjumin tim të thellë dhe pakujdesinë. Pastaj unë dola nga xhamia. Për shkak të trullosjes së atij gjumi të thellë i cili për një kohë të gjatë ishte vendosur në kokën time, për disa ditë një shtrëngatë - stuhi, valë- po tërbohej dhe unë e pashë veten time si një anije që lëviste përmes dallgëve të trazuara të detit si një kompas që rrotullohej dhe vetja ime po digjej flakë me zjarrin e atij tymi të dendur.. Sa herë që shihesha në pasqyrë, ato thinja të bardha më drejtoheshin duke më thënë: "Bëj kujdes!"; dhe kështu çështjet u bënë të qarta tek unë nëpërmjet paralajmërimeve të thinjave të mia. Hodha vështrimin dhe pashë se rinia ime e cila më joshte e më robëronte me kënaqësitë e saja po më thonte: Lamtumirë! Dhe se jeta e dynjasë të cilën unë e doja dhe me të cilën unë isha shumë i lidhur, filloi të shuhej pak e nga pak; dhe se dynjaja me të cilën unë isha i lidhur kaq ngushtë dhe pas të cilës unë isha shumë i mallëngjyer dhe isha ashik i saj, po më thonte: "Lamtumirë! Lamtumirë!" Duke më paralajmëruar se unë do të largohesha nga kjo bujtinë dhe do ta lija së shpejti. Dhe e pashë atë - domethënë dynjanë- të thonte gjithashtu: "Lamtumirë" dhe po përgatitej të largohej.

Ndërkohë m'u zbulua në zemër nga universaliteti i këtij vërseti,

كُلُّ نَفْسٍ ذَآئِقَةُ الْمَوْتِ *"Gjithësecili do ta shijojë vdekjen"* dhe nga gjithanshmëria e tij, kuptimi që vijon:

I gjithë lloji njerëzor është si një qënie e vetme; ai do të vdesë me qëllim që të ringjallet. Edhe globi tokësor është një krijesë e gjallë; gjithashtu edhe ai do të vdesë me qëllim që të marrë një formë të përjetshme. Edhe dynjaja gjithashtu është si një krijesë e gjallë; ajo do të vdesë me qëllim që të marrë formën e Ahiretit.

Ndërsa isha në këtë gjendje, unë shqyrtova situatën në të cilën ndodhesha dhe pashë se rinia e cila është burimi i kënaqësisë, po

[8] Kuran 3:158

largohej; ndërsa pleqëria që ishte burimi i dëshpërimit dhe i brengosjes, po afrohej. Ajo jetë, e cila ishte aq e shndritshme dhe brilante po bëhej gati të udhëtonte; kurse vdekja, e cila ishte e tmerrshme dhe errësirë në pamje të jashtme, po bëhej gati të arrinte; dhe ajo dynja e dashur, e cila mendohej të ishte e përhershme dhe që ishte e dashur për shkak të pakujdesisë, po ecte me nxitim drejt asgjësimit e zhdukjes.

Me qëllim që të mashtroj vetveten dhe të zhys kokën përsëri në pakujdesi, unë e drejtova shikimin tim tek kënaqësitë e pozitës shoqërore dhe të rangut që gëzoja në Stamboll, të cilat ishin shumë më të larta se sa e meritoja, por edhe në to nuk kishte asnjë dobi. I gjithë vlerësimi, vëmendja dhe ngushëllimi i njerëzve më shoqëronin vetëm tek caku i afërt i derës së varrit, dhe aty ato do të shuheshin.

Dhe pashë se një hipokrizi e rëndë, një egoizëm i ftohtë dhe një pakujdesi e përkohshme gjendeshin të fshehura në perden e qëndisur të famës dhe të emrit, të cilat janë qëllimi i rremë i atyre që ndjekin famën dhe janë dashuruesit e saj. Unë kuptova se këto gjëra, të cilat më kishin mashtruar mua deri atëherë, nuk qenë në gjendje të më jepnin asnjë ngushëllim, dhe nuk mund të gjendej absolutisht asnjë dritë në to. Unë përsëri fillova të dëgjoj hafizat e nderuar në xhaminë Bajazit me qëllim që të dëgjoj mësimin qiellor të Kur'anit dhe për t'u zgjuar edhe një herë nga pakujdesia ime. Ndërkohë dëgjova sihariqet e atij udhëzimi qiellor nëpërmjet urdhëresave të shenjta Hyjnore në Fjalën e Tij:

وَبَشِّرِ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا *"Dhe përgëzoji ata që besojnë"*[9]

Nëpërmjet shkëlqimit të Kuranit, unë kërkova ngushëllim, shpresë dhe dritë në çdo çështje nga të cilat unë ndjeva tmerr, vetmi e dëshpërim, dhe ato nuk i kërkova jashtë atyre çështjeve. Një mijë e njëqind falënderime bëj për Krijuesin Gjithëbujar i Cili më dha sukses të gjej ilaçin në vetë sëmundjen, të shoh dritën brenda vetë errësirës dhe të ndjej ngushëllimin brenda dhimbjes e tmerrit.

Së pari, unë hodha vështrimin tek fytyra e vdekjes, e cila imagjinohet të jetë gjëja më e tmerrshme dhe që frikëson gjithkënd. Nëpërmjet dritës së Kur'anit unë pashë se, ndonëse perdja e vdekjes është e zezë, e errët dhe e shëmtuar, veçse ama për besimtarët fytyra e

[9] Kuran, 2:25

saj e vërtetë është e ndritshme dhe e bukur. Ne e kemi provuar këtë të vërtetë në mënyrë vendimtare në shumë pjesë të Risale-i Nurit. Për shembull, ashtu siç e kemi shpjeguar në Fjalën e Tetë dhe në Letrën e Njëzet, vdekja nuk është një asgjësim përfundimtar, ajo nuk është ndarje e përhershme, përkundrazi, ajo është një parathënie për jetën e amshuar, për fillimin e saj; është një pushim nga mundimet e vështirësitë e detyrave të jetës, është një çmobilizim; është një ndryshim banese; është një bashkim e takim me karvanin e të dashurve të cilët tashmë kanë udhëtuar për tek Bota e Ndërmjetme.. dhe kështu me radhë. Unë pashë fytyrën e vërtetë e të bukur të vdekjes nëpërmjet të vërtetave të tilla si këto. Unë nuk e pashë me frikë fytyrën e vdekjes; unë, në të vërtetë, e pashë atë me përmallim, nga një aspekt, dhe njoha në atë kohë një mister nga misteret e lidhjes së vdekjes, shqyrtimit të vdekjes të cilën e praktikojnë njerëzit e Tarikatit Sufi.

Pastaj unë shqyrtova periudhën e rinisë që tashmë kishte kaluar, dhe pashë se ajo periudhë moshe e bën gjithësecilin të vajtojë për kalimin e saj, e cila i bën ata të dashurohen marrëzisht pas saj dhe i mbush me mallëngjim; dhe është ajo moshë që kalon në pakujdesi e në mëkate, dhe kështu më kaloi mua. Unë pashë se brenda petkut të saj të qëndisur bukur ndodhej një fytyrë shumë e shëmtuar, e dehur, e topitur dhe e shushatur.

Në qoftë se nuk do ta kisha njohur natyrën e saj të vërtetë, ajo do të më bënte të dëshpëruar e të qaja gjatë gjithë jetës, madje edhe sikur të jetoja njëqind vjet kundrejt pak viteve që kalojnë në dehje e zbavitje, ashtu siç tha një poet duke vajtuar me pikëllim për rininë e tij:

لَيْتَ ٱلشَّبَابَ يَعُودُ يَوْمًا فَأُخْبِرَهُۥ بِمَا فَعَلَ ٱلْمَشِيبُ

"Ah sikur të kthehej një ditë rinia,

t'i tregoja se ç'më ka bërë pleqëria"

Po, njerëzit e moshuar, si poeti i lartëpërmendur, të cilët nuk e njohin natyrën e vërtetë të rinisë, mendojnë për rininë e tyre dhe vajtojnë me pikëllim e përmallim. Mirëpo kur periudha e rinisë dhe shkëlqimi i saj vijnë tek besimtarët me mendje e me zemra të shëndosha; në qoftë se energjia dhe fuqia e rinisë do të harxhoheshin në ibadet, në punë të drejta dhe në tregtinë për Ahiretin, atëherë ajo

periudhë moshe do të bëhej forca më e madhe për mirësi, mjeti më i mirë për tregti, mjeti më i këndshëm ndërmjetësues për mirësitë, dhe madje mjeti më i kënaqshëm.

Po, periudha e rinisë është vërtet e vyer dhe shumë e çmueshme; ajo është një mirësi shumë e madhe Hyjnore dhe një entuziazëm shumë i këndshëm për atë që e njeh detyrën e tij islame dhe për atë që nuk e keqpërdor. Mirëpo në qoftë se rininë nuk do ta shoqëronte *istikameti* - moderimi, drejtësia- dhe nuk do ta shoqëronte ndershmëria, dëlirësia e frika ndaj Zotit xh.sh., atëherë ajo përmban shumë rreziqe; ajo shkatërron lumturinë e tij të përjetshme, jetën e tij të Ahiretit dhe ndoshta do ta rrënonte edhe jetën e tij të kësaj dynjaje gjithashtu. Në të vërtetë, kundrejt kënaqësive dhe ëndjeve për një ose dy vite rini, ajo shkakton shumë vite dëshpërimi e brenge në periudhën e moshës së pleqërisë.

Meqenëse për shumicën e njerëzve rinia është e dëmshme, ne njerëzit e moshuar duhet ta falënderojmë shumë Allahun që ne kemi shpëtuar prej rreziqeve dhe dëmit të saj. Ashtu si çdo gjë tjetër, edhe kënaqësitë e rinisë ikin. Në qoftë se periudha e rinisë do të shpenzohej në ibadet dhe në vepra të mira, atëherë frutet e një rinie të tillë mbeten përjetësisht në vend të saj dhe ato do të bëheshin mjete për të fituar një rini të vazhdueshme e të përhershme në një jetë të amshuar.

Pastaj unë hodha vështrimin tek dynjaja pas së cilës janë të dashuruar marrëzisht shumica e njerëzve dhe me të cilën ata janë të sprovuar.

Nëpërmjet dritës së Kuranit unë pashë se dynjaja ka tri fytyra, njëra brenda tjetrës.

E para është dynjaja e orientuar tek Emrat e bukur Hyjnorë; dhe ajo është pasqyrë për to.

Fytyra e dytë është dynjaja e orientuar drejt Ahiretit, dhe ajo është si tokë e kultivuar e saj.

Fytyra e tretë është dynjaja e orientuar tek njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj bote dhe tek njerëzit e çudhëzimit; ajo është një fushë lojërash për njerëzit e shkujdesur dhe për zbavitjen e tyre.

Për më tepër, gjithësecili ka botën e tij të veçantë të madhe në këtë dynja. Atëherë ndodhen aq shumë botëra njëra brenda tjetrës aq sa numri i qënieve njerëzore. Veçse ama shtylla e botës private të çdonjërit është vetë jeta e tij.

Kurdo që të shembet trupi i personit, atëherë shembet bota e tij dhe bëhet kijameti për të. Dhe meqenëse të pakujdesurit dhe neglizhentët nuk e kuptojnë se bota e tyre private do të shkatërrohet kaq shpejt, ata joshen pas saj dhe e supozojnë atë të qëndrueshme ashtu si dynjanë e përgjithshme që është e qëndrueshme përreth tyre. Ndërkaq unë mendova me vete duke thënë: "Edhe unë gjithashtu kam një botë private që do të shembet shpejt e do të shkallmohet ashtu si botërat e njerëzve të tjerë. Atëherë çfarë vlere e dobie ka në këtë botën time private, në këtë jetën time të shkurtër?"

Atëherë, nëpërmjet dritës së Kuranit, unë pashë se kjo dynja, në lidhje me mua dhe me të tjerët, është vetëm se një vend i përkohshëm tregtie, është një bujtinë që mbushet e zbrazet në çdo ditë; është një treg i ngritur në rrugë me qëllim që kalimtarët të bëjnë tregti; është një libër i hapur i Krijuesit Formëdhënës që ripërtërihet vazhdimisht, i Cili fshin në të çfarë të dëshirojë dhe shkruan në të me urtësi. Dhe çdo pranverë është një letër e zbukuruar dhe e larë në ar, dhe çdo verë është një poemë e shkëlqyer e mirësistemuar; ajo përbëhet nga pasqyra që ripërtërihen duke shfaqur manifestimet e Emrave të bukur të Krijuesit të Gjithëlavdishëm; ajo është një farishte dhe një kopshtpër të mbjellë për Ahiret; është një lulnajë e mëshirës Hyjnore, dhe një fabrikë e përkohshme për të përgatitur e prodhuar tablo e pllaka të përjetshme Hyjnore të cilat do të shfaqen në botën e qëndrueshmërisë dhe të përjetshmërisë.

Ndërkohë unë e falënderova shumë Allahun, Krijuesin Gjithëbujar i Cili e kishte bërë dynjanë në këtë mënyrë. Dhe unë kuptova se, ndërsa dashuria për fytyrat e bukura të brendshme të dynjasë i qe dhënë njerëzimit, meqenëse ata e shpenzojnë atë në fytyrën e saj kalimtare, të shëmtuar, të dëmshme e të pakujdesshme, ata manifestojnë kuptimin e hadithit:

حُبُّ الدُّنْيَا رَأْسُ كُلِّ خَطِيئَةٍ *"Dashuria për dynjanë është kreu i të gjitha gabimeve"*.[10]

Dhe kështu, o njerëzit e moshuar! Unë e kuptova këtë të vërtetë nëpërmjet dritës së Kuranit të Gjithurtë, nëpërmjet paralajmërimeve të pleqërisë sime dhe nëpërmjet dritës së besimit që m'i hapi sytë. Dhe unë e kam demonstruar këtë me prova vendimtare në pjesë të shumta të Risale-i Nurit. Unë pashë se kjo e vërtetë ishte ngushëllimi im i vërtetë, shpresa e fuqishme dhe drita vezulluese. Kështu unë qeshë i kënaqur me pleqërinë time dhe isha i gëzuar që më kishte kaluar rinia.

Atëherë mos u dëshpëroni, dhe mos qani o vëllezërit e mi të moshuar për pleqërinë tuaj dhe falënderojeni dhe lavdërojeni Allahun. Meqenëse ju keni besim dhe e vërteta flet kështu, atëherë le të qajnë ata të shkujdesurit dhe të çudhëzuarit që vajtojnë e rrënkojnë!...

■ SHPRESA E NËNTË

Në luftën e parë botërore, si një rob lufte, unë isha në provincën e largët të Kosturmas në Rusinë verilindore. Ndodhej një xhami e vogël atje që u përkiste Tartarëve pranë lumit të famshëm Vollga. Unë bëhesha i mërzitur midis shokëve të mi, oficerëve të tjerë. Unë preferova vetminë, por nuk mund të bridhja jashtë pa leje. Pastaj m'u lejua që të qëndroja në atë xhami nëpërmjet garancisë së banorëve të lagjes së tartarëve dhe me dorëzaninë e tyre, në brigjet e Vollgës. Unë fleja në xhami i vetmuar. Pranvera u afrua. Netët ishin shumë të gjata në atë tokë verilindore.. Llokoçitjet e trishtueshme të lumit Vollga, kërcitja e zymtë e shiut dhe ofshama melankolike e erës së atyre netëve të errëta në atë mërgim të errët më kishin zgjuar përkohësisht nga një gjumë i thellë i pakujdesisë. Unë akoma nuk e konsideroja veten time të vjetër, kurse ata të cilët e kishin përjetuar luftën e madhe ishin vjetëruar, pasi ditët e luftës, nga tmerri, i bënë edhe fëmijët të plakur, sikur kjo manifeston vërsetin,

يَوْمًا يَجْعَلُ الْوِلْدَانَ شِيبًا *"Ditën -atë ditë- që do t'i bëjë fëmijët të thinjur"*.[11]

[10] Su'juti

Dhe megjithëse isha afërsisht dyzet vjeç, veçse ama unë ndjeva në vetvete si të isha tetëdhjetë vjeç.. Në ato netë të gjata dhe të errëta, në atë mërgim të pikëlluar dhe në atë gjendje të zymtë, unë isha i dëshpëruar nga jeta ime dhe nga atdheu im; dhe sa herë që shikoja pafuqinë dhe vetminë time, këputej shpresa ime.

Atëherë, ndërsa isha në këtë gjendje, më erdhi ngushëllimi e ndihma nga Kurani i gjithurtë. Gjuha ime tha:

حَسْبُنَا اللهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".*[12]

Ndërkohë zemra ime tha duke qarë:

غَرِيبَم بِي كَسَم ضَعِيفَم نَاتُوَانَم اَلْاَمَان كُويَم عَفُوجُويَم
مَدَدْخَوَاهَم زِدَرْگَاهَتْ اِلٰهِي.

"Unë jam i huaj, unë jam i vetmuar, unë jam i dobët, unë jam i pafuqishëm! Unë kërkoj mëshirë, unë kërkoj falje, unë kërkoj ndihmë nga Ti, o Zoti im!"

Ndërsa shpirti im i cili kujtoi të dashurit e mi të vjetër në vendin tim dhe imagjinoi vdekjen time në këtë mërgim, ashtu si Njazi Misri thashë këto rreshta të cilat kërkojnë një shok.

Duke kaluar mes dëshpërimit të dynjasë,

Duke fluturuar në ashk e në pasion,

Duke hapur krahët e mi ndaj privimit,

Duke bërtit në çdo moment:

Shok!.. Shok..!

---

[11] Kuran 73:17
[12]Kur'an, 3: 173

Sidoqoftë.. 'Dobësia ime' dhe 'pafuia ime' u bënë në ato netë të zymta, të gjata e të errëta me ndarje, internime e mërgime dy ndërmjetësues të fuqishëm për t'u afruar tek dera e mëshirës Hyjnore, dhe dy mjete ndërmjetësues për tek prania Hyjnore, saqë unë vazhdoj akoma të jem i habitur se si munda të arratisesha pas pak ditësh, dhe në mënyrë të paparashikuar qeshë në gjendje të përshkoja një distancë e cila do të merrte një vit të plotë për t'u përshkuar në këmbë, dhe duke mos e njohur gjuhën Ruse. Unë shpëtova nga zënia rob lufte në një mënyrë të çuditshme nëpërmjet mirësisë Hyjnore, e cila m'u dhurua si rrjedhojë e pafuqisë dhe e dobësisë sime. Pastaj, duke kaluar nëpërmjet Varshavës dhe Vjenës, unë arrita në Stamboll. Kështu shpëtova nga ajo robëri në këtë mënyrë kaq lehtë që të bën të habitesh. Unë e plotësova udhëtimin e arratisjes me një lehtësi e kollajllëk të tillë, saqë madje edhe individët më guximtarë, më të zgjuar e më finokë prej atyre që flasin gjuhën Ruse nuk do të kishin qenë në gjendje ta realizonin.

Por gjendja ime në atë natë të cilën e kalova në xhami në brigjet e Vollgës më inspiroi mua e më bëri ta marr këtë vendim:

"Unë do ta kaloj pjesën e mbetur të jetës sime nëpër shpella e guva duke jetuar i veçuar nga njerëzit".. Mjaft tani për mua për t'u përzier në këtë jetë sociale të njerëzve. Meqenëse në fund unë do të hyja i vetmuar në varr, unë thashë se tani e tutje, duhet të zgjedh vetminë dhe veçimin nga njerëzit dhe të mësohem me këtë gjendje!"

Po, kështu vendosa.. Por për fat të keq, të dashurit e mi të shumtë të sinqertë në Stamboll, jeta vezulluese e kësaj dynjaje atje dhe në mënyrë të veçantë fama dhe nderi që m'u dhanë, të cilat ishin shumë më të mëdhaja se sa i meritoja, më bënë që ta harroja përkohësisht vendimin tim. Sikur ajo natë mërgimi të ishte e zeza e ndritshme e syrit të jetës sime dhe sikur dita vezulluese e jetës në Stamboll të ishte e bardha e padritë e syrit të jetës sime. Ai sy nuk mundi ta shikonte të largëtën përpara, ai përsëri ra në një gjumë të thellë derisa e hapi atë Shejh Gejlani me librin e tij '*Futuhal Gajb'* pas dy vitesh.

O burra dhe o gra të moshuar! Dijeni se dobësia dhe pafuqia e pleqërisë janë dy mjete ndërmjetësues për të tërhequr mëshirën dhe përkujdesjen Hyjnore. Manifestimi i mëshirës në faqen e tokës e demonstron këtë të vërtetë në mënyrën më të qartë, ashtu siç e kam vëzhguar atë në veten time në disa raste, sepse më të dobëtit dhe më të

pafuqishmit e kafshëve janë të vegjëlit e tyre, por janë pikërisht ato të vegjël të cilët marrin manifestimin më të ëmbël e më të këndshëm të mëshirës.

Pafuqia e një zogu të vogël në folenë e tij në majë të një peme të lartë e vë në shërbim nënën e tij -nëpërmjet shfaqjes së mëshirës- sikur ajo të ishte një ushtare që pret urdhërat. Nëna e tij fluturon në të gjitha drejtimet dhe i sjell atij rizkun -ushqimin- e tij të bollshëm. Por sapo zogu i vogël ta harrojë pafuqinë, nëpërmjet rritjes së krahëve të tij të plotësimit, nëna e tij i thotë: Shko tani dhe gjeje vetë ushqimin tënd! Dhe ajo nuk e dëgjon më thirrjen e tij.

Atëherë ashtu siç është në fuqi ky mister i mëshirës për të vegjëlit, po ashtu ai është në fuqi edhe për të moshuarit, të cilët u ngjasojnë të vegjëlve për sa ka të bëjë me dobësinë dhe me pafuqinë e tyre. Përvoja ime e veçantë më ka dhënë mua një bindje të plotë se ashtu siç dërgohet furnizimi për të vegjëlit në mënyrë të mrekullueshme nga mëshira Hyjnore për shkak të pafuqisë së tyre, mëshirë e cila bën të vërshojnë burimet e kraharorëve, po ashtu ushqimi i të vjetërve besimtarë, të cilët fituan pafajësi, u dërgohet nga mëshira Hyjnore në formën e bereqetit; dhe burimi i bereqetit për çdo shtëpi dhe shtylla e tij janë ata banorë të moshuar, dhe ajo çfarë e ruan atë shtëpi nga fatkeqësitë e katastrofat janë të moshuarit. Kjo e vërtetë gjithashtu provohet nga hadithi profetik i cili thotë:

وَلَوْلَا الشُّيُوخُ الرُّكَّعُ لَصُبَّ عَلَيْكُمُ الْبَلَاءُ صَبًّا "*Në qoftë se nuk do të ishin njerëzit tuaj të moshuar me shpinat e tyre të kërrusura, do të derdheshin me shumicë fatkeqësitë mbi ju".*[13]

Meqenëse dobësia dhe pafuqia e pleqërisë janë kështu mjetet për të tërhequr deri në këtë shkallë mëshirën e gjërë Hyjnore dhe se kurani i gjithurtë u bën thirrje fëmijëve për të treguar respekt e mëshirë ndaj prindërve në pesë shkallë në mënyrën më të mrekullueshme, me vërsetet e tij:

[13] Plotësimi i Hadithit: وَلَوْلَا الْبَهَائِمُ الرُّتَّعُ وَالصِّبْيَانُ الرُّضَّعُ deri në fund. Trasmeton Bejhakiu

إِمَّا يَبْلُغَنَّ عِندَكَ الْكِبَرَ أَحَدُهُمَا أَوْ كِلَاهُمَا فَلَا تَقُل لَّهُمَا أُفٍّ وَلَا تَنْهَرْهُمَا
وَقُل لَّهُمَا قَوْلًا كَرِيمًا ۝ وَاخْفِضْ لَهُمَا جَنَاحَ الذُّلِّ مِنَ الرَّحْمَةِ وَقُل رَّبِّ
ارْحَمْهُمَا كَمَا رَبَّيَانِي صَغِيرًا

"... Në qoftë se njëri prej tyre ose dy arrijnë moshën e pleqërisë dhe ti je gjallë me ta, mos u thuaj atyre ndonjë fjalë pakënaqësie e mosrespekti, as mos e ngrini zërin (dukę u thënë "uf"), por t'u drejtoheni atyre me shprehje nderuese e me respekt. Dhe ule mbi ta krahun e nënshtrimit, të mirësisë e të përuljes me mëshirë dhe thoni: "Zoti im! Dhuro mbi ta mëshirë siç më rritën mua, kur unë isha i mitur".[14]

Meqenëse feja islame urdhëron të tregohet respekt e mëshirë ndaj të moshuarve, dhe meqenëse edhe natyra e njerëzve gjithashtu kërkon respekt e mëshirë ndaj të moshuarve, atëherë sigurisht ne njerëzit e plakur, nuk duhet ta ndryshojmë këtë pleqërinë tonë me njëqind mosha të rinisë, sepse ne kemi në këtë moshë kënaqësi shpirtërore të vazhdueshme e të vlefshme, në vend të kënaqësive fizike dhe epsheve të rinisë, pasi ne marrim kënaqësi shpirtërore që burojnë nga mëshira që vjen prej përkujdesjes Hyjnore dhe prej respektit që buron nga natyra njerëzore.

Po, unë mund t'ju tregoj ju me siguri se në qoftë se do të më jepeshin dhjetë vite të rinisë së 'Saidit të vjetër', unë nuk do t'i ndërroja ato me një vit të vetëm të pleqërisë së 'Saidit të Ri'. Unë jam i kënaqur me pleqërinë time, edhe ju gjithashtu duhet të jeni të kënaqur me tuajën!

■ SHPRESA E DHJETË

Kur u ktheva nga zënia ime si rob lufte, unë u mposhta nga pakujdesia për një vit ose dy në Stamboll. Politikat e ditës e larguan vëmendjen time nga të shqyrtuarit në veten time, dhe e shpërndanë atë në botën jashtë. Pastaj një ditë, kur po rrija ulur tek varreza e Ebu Ejjub Ensarit, Zoti qoftë i kënaqur me të, në një pikë të lartë që kishte pamje

[14] Kuran 17: 23-24

nga një luginë e thellë, duke qenë i zhytur në shqyrtimin e shikimin e horizonteve përreth Stambollit, papritmas unë shoh se botës sime private po i vinte vdekja, saqë ndjeva me imagjinatë, sikur shpirti im po tërhiqej e largohej në disa drejtime.

Ndërkohë, unë thashë: "Nuk e di, a mos vallë mbishkrimet në gurët e varreve janë ato që më japin këtë imagjinatë? Dhe unë e tërhoqa shikimin tim. Unë nuk shikova më në largësi por tek varreza. Pastaj në zemrën time m'u shfaq çfarë vijon:

"Kjo varrezë përreth teje përfshin njëqind Stambolle! Sepse Stambolli është boshatisur këtu njëqind herë. Ti nuk mund të shpëtosh nga Dekreti i të Gjithurtit të Gjithëfuqishëm i Cili i ka zbrazur këtu të gjithë njerëzit e Stambollit; nuk mund të përjashtohesh vetëm ti nga ky dekret; nuk ka dyshim se edhe ti do të largohesh gjithashtu..!

Unë u largova nga varrezat duke mbajtur këtë imagjinatë të frikshme dhe u futa në dhomën e vogël tek shtëpiza e xhamisë së Ebi Ejjub Ensariut, Zoti qoftë i kënaqur me të, në të cilën unë kisha qëndruar disa herë më parë. Ndërkaq unë mendova me vete duke thënë: Unë jam mysafir! Unë jam mysafir në tre drejtime; sepse ashtu siç jam mysafir në këtë dhomë të vogël, unë gjithashtu jam mysafir edhe në Stamboll, madje unë jam një mysafir në dynja dhe do të udhëtoj e do të largohem prej saj. Mysafiri duhet të mendojë për rrugën e tij.

Po, ashtu siç do të dal prej kësaj dhome e do ta lë, po ashtu unë do ta lë një ditë edhe Stambollin dhe do të largohem edhe nga dynjaja gjithashtu.

Ndërsa isha në këtë gjendje mendore, zemra ime po mposhtej e dërrmohej nga një gjendje e dhimbshme, pikëlluese e turbulluese;

Unë nuk do ta lija vetëm pak të dashur, por do të ndahesha gjithashtu nga mijëra të dashur në Stamboll; madje do ta lija vetë Stambollin e dashur dhe do të ndahesha nga qindra e mijëra të dashurish, ashtu siç po ndahem nga dynjaja e bukur pas së cilës ne u robëruam.

Ndërkohë unë u ngjita përsëri tek i njëjti vend i lartë në varrezë dhe m'u dukën të gjithë banorët e Stambollit si kufoma duke ecur në këmbë, pikërisht ashtu siç shfaqen ata që kanë vdekur, persona duke

lëvizur nëpër filmat kinematografikë; unë i frekuentoja ndonjëherë kinematë për të nxjerrë mësime.

Më vonë imagjinata ime më tha:

Meqenëse disa nga ata që janë duke fjetur në këtë varrezë mund të shfaqen si figurat kinematografike, atëherë mendo se edhe këta njerëz gjithashtu do të hyjnë përfundimisht në këtë varrezë, dhe konsideroji ata sikur të kenë hyrë qysh tani.

Papritmas, nëpërmjet Dritës së Kuranit dhe nëpërmjet udhëzimit të *Gauth al-Aëdham*, Shejh Gejlanit, iu shenjtëroftë sekreti i tij, gjendja ime e trishtueshme dhe e dhimbshme u transformua në gjendje të gëzueshme e të lumtur.

Ajo ishte si më poshtë vijon:

Drita që buron nga Kurani më dha mendimin vijues përballë asaj gjendjeje të trishtueshme:

Ti kishe një ose dy shokë oficerë ndërsa ishe rob lufte në mërgim në Kosturma në verilindje të Rusisë. Ti e dije se ata të dy do të ktheheshin në Stamboll. Në qoftë se njëri nga ata të dy do të të bënte të zgjedhje duke thënë: "A do të shkosh ti në Stamboll, apo dëshiron të qëndrosh këtu?" Sigurisht në qoftë se do të kishe sa një grimë inteligjencë, ti me kënaqësi e me gëzim do të kishe zgjedhur të shkoje në Stamboll, sepse prej një mijë e një të dashurve të tu, nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë kanë shkuar tashmë në Stamboll. Vetëm një ose dy kanë mbetur këtu; edhe ata gjithashtu do të largohen për atje. Atëherë shkuarja për në Stamboll për ty nuk do të ishte një ndarje e trishtueshme dhe as një largim i dhimbshëm.. Për më tepër, ti erdhe këtu, a nuk do të bëheshe i lumtur e mirënjohës nëse do të veproje kështu? Ti shpëtove nga vendi i armiqve, nga netët e gjata e të errëta, nga dimri i ashpër e i stuhishëm, dhe erdhe në Stambollin e lulëzuar e të bukur, si një parajsë e kësaj dynjaje.

Dhe kështu është çështja, meqenëse nëntëdhjetë e nëntë prej njëqind vetave prej atyre që ti i ke dashur qysh prej fëmijërisë tënde deri tani, janë larguar për në varrezë, e cila duket për ty e tmerrshme dhe nuk ka mbetur prej tyre në këtë dynja veçse një ose dy; edhe ata gjithashtu janë në rrugën e tyre drejt saj, atëherë vdekja jote në dynja

nuk është një ndarje e as largim, por është bashkim e takim me të gjithë ata të dashur.

Po, ata -domethënë shpirtërat e pavdekshëm- i kanë lënë vendbanimet e strehimet e tyre, dhe disa nga ata po udhëtojnë nëpër yje dhe disa në nivelet e Botës së Ndërmjetme. Kështu ma përkujtoi mua ajo dritë e Kuranit..

Po, Kurani dhe besimi e provuan këtë të vërtetë aq me siguri sa që ai që nuk e ka humbur krejtësisht zemrën dhe shpirtin dhe të cilin nuk e ka mbytur çudhëzimi, padyshim do ta besonte sikur ta shihte atë; sepse Ai që e stolisi këtë dynja me lloje të panumërta dhuratash e mirësish, duke demonstruar me këtë Hyjninë e Tij Gjithëbujare e të Dhembshur, dhe duke i ruajtur madje edhe gjërat shumë të vogëla e të pjesshme, si farërat për shembull; Ai Krijues Gjithëbujar e Mëshirëplotë duhet që medoemos, madje në mënyrë të vetëkuptueshme, që të mos e asgjësojë këtë njeri i cili është më i përkryeri i krijesave të Tij, më i nderuari, më gjithëpërfshirësi, më i rëndësishmi dhe më i dashuri për Të; dhe nuk do ta zhdukte atë me asgjësim e me ekzekutim përfundimtar pa mëshirë dhe pa përfundim -synim- ashtu siç duket në pamje të jashtme, as nuk do ta humbiste kurrë atë.. por Krijuesi Mëshirëplotë e vendos përkohësisht atë krijesë të dashur nën dhé i cili është dera e mëshirës, me qëllim që të prodhojë filiza e të japë fruta në një jetë tjetër, ashtu siç i hedh bujku farërat dhe i shpërndan në tokë[15].

Pasi unë mora këtë përkujtues të Kuranit, ajo varrezë u bë më familjare për mua se sa Stambolli. Vetmia dhe tërheqja u bënë më të kënaqshme për mua se sa bashkëbisedimi dhe shoqërimi. Dhe unë gjeta një vend për të qenë i vetmuar e i veçuar në Sarijer në Bosfor.

Shejh Gejlani, Zoti qoftë i kënaqur me të, u bë profesor për mua, doktor dhe udhëzues me librin e tij *Futuh el-Gajb*, kurse imam Rabbani, Allahu qoftë i kënaqur me të, u bë një mësues i afërt, familjar, i dhembshur dhe i mëshirshëm me librin e tij *Mektubat*.

Atëherë u bëra krejtësisht i lumtur që më ishte afruar pleqëria, që isha tërhequr nga civilizimi dhe që isha çliruar e shkëputur nga jeta sociale; kështu unë e falënderova shumë Allahun për këtë.

[15] Kjo e vërtetë është provuar aq qartë sa dy edhe dy bëjnë katër në pjesët e tjera të Risale-i Nurit, dhe veçanërisht në Fjalën e Dhjetë dhe në Fjalën e Njëzet e Nëntë.

O njerëzit e respektuar që keni hyrë në pleqëri si unë.. dhe që e kujtoni shpesh vdekjen nëpërmjet paralajmërimeve të moshës..! Në përputhje me dritën e mësimeve të besimit të dhëna nga Kurani, ne duhet t'i shikojmë me sy të mirë pleqërinë, vdekjen, sëmundjen, dhe madje t'i duam ato nga një drejtim. Meqenëse ne kemi besimin që është mirësia më e madhe, atëherë pleqëria është e mirë dhe sëmundja është e mirë, edhe vdekja është e mirë gjithashtu.. Në qoftë se ka gjëra që janë tërësisht të shëmtuara, ato janë mëkati, shthurja, bidati dhe çudhëzimi.

■ SHPRESA E NJËMBËDHJETË

Pasi u ktheva nga mbajtja ime si rob lufte, unë jetoja së bashku me djalin e vëllait tim Abdurrahmanin[16] në një vilë në majë të kodrës Çamlixha në Stamboll. Nga këndvështrimi i jetës së kësaj dynjaje, situata ime mund të ishte menduar se ishte më e lumtura për njerëz si ne, sepse shpëtova nga robëria, nga mbajtja si rob lufte, dhe mjetet e përhapjes së njohurisë ishin të hapura para meje në *Dar' el-Hikmeti-el-islamijjeh*, në mënyrën më të lartësuar duke iu përshtatur profesionit tim, profesionit shkencor.

Nderi dhe vlerësimi që m'u dhanë ishin shumë më të mëdhaja se sa e meritoja. Unë jetoja në Çamlixha, në vendin më të bukur në Stamboll. Gjithçka ishte e përkryer për mua. Unë isha së bashku me Abdurrahmanin e ndjerë, nipin tim, i cili ishte shumë i zgjuar dhe vetëflijues dhe ishte edhe studenti im, edhe shërbyes, edhe shkrues, saqë e konsideroja si djalin tim shpirtëror.

Ndërsa ndjeja se unë atëherë isha njeriu më fatlum në botë, unë hodha vështrimin në pasqyrë dhe pashë flokë të thinjura në kokën dhe në mjekrën time.

Papritmas, zgjimi shpirtëror që pata përjetuar në xhami në Kosturma ndërsa isha në robëri, filloi të shfaqej. Ndërkohë, unë fillova të studioja rrethanat dhe shkaqet me të cilat isha i lidhur përzemërsisht

[16] Abdurrahmani ishte djali i vëllait të madh të Bediuzzamanit, Abdullahit. Ai u lind në Nurs në 1903. ishte djali shpirtëror i Bediuzzamanit, student dhe ndihmës. Ai iu bashkua xhaxhait të tij në Stamboll pas luftës së Parë botërore dhe botoi një biografi të shkurtër të tij në atë kohë. Ai vdiq në Ankara në 1928, ku atje është varrosur. Përkthyesi.

dhe të cilat i supozoja se ishin mjeti i lumturisë së kësaj dynjaje. Por cilëndo rrethanë apo cilindo shkak që unë studiova, pashë se ai ishte një shkak i kalbur dhe mashtrues; ai nuk meritonte që të lidhësh zemrën me të e të kapesh pas tij. Në atë kohë, unë vuajta një akt të paparashikuar dhe të paimagjinueshëm pabesie dhe mungese besimi nga një shok i ngushtë i cili konsiderohej nga shokët e mi më besnikë.. E gjitha kjo çoi në ftohje e në neveri për jetën e kësaj dynjaje, dhe i thashë zemrës sime:

"A kam qenë krejtësisht i mashtruar? Unë shikoj se shumë njerëz e shikojnë me xhelozi situatën tonë, jetën tonë, e cila në realitet është për të ardhur keq. A janë të marrë të gjithë këta njerëz apo jam unë i marrë që i shoh të gjithë këta njerëz të dhënë vetëm pas dynjasë si të çmendur?!

Sidoqoftë, si rrjedhojë e këtij zgjimi të ashpër i bërë nga thinjat e pleqërisë më bëri të shikoj së pari përkohshmëritë e të gjitha gjërave kalimtare me të cilat isha i lidhur.

Pastaj u ktheva tek vetja ime, dhe e gjeta atë krejtësisht të pafuqishme. Ndërkaq shpirti im, i cili dëshiron pavdekshmëri dhe ishte i dashuruar marrëzisht pas gjërave të përkohshme duke i imagjinuar ato të jenë të pavdekshme, bërtiti: "Meqenëse unë jam një qënie e përkohshme për sa ka të bëjë me trupin tim, atëherë çfarë e mire mund të vijë nga këto gjëra të përkohshme kalimtare? Meqenëse unë jam i pafuqishëm, çfarë mund të pres nga këto gjëra të pafuqishme? Ajo çfarë unë kam nevojë është Ai që është i përjetshëm dhe i qëndrueshëm, Ai që është i Gjithëfuqishëm dhe i Parapërjetshëm, dhe, i Cili do të sigurojë një ilaç për sëmundjet e mia. Dhe fillova të kërkoj.

Pastaj, para së gjithash, unë iu referova atyre dijeve që i kisha fituar më parë dhe po kërkoja në to ngushëllim e shpresë. Por fatkeqësisht, deri në atë kohë unë e kisha mbushur mendjen time me shkencat e filozofisë si dhe me shkencat islame dhe, duke qenë mjaft në gabim i kisha imagjinuar ato shkenca filozofike të ishin burimi i përparimit dhe i integrimit, dhe boshti i kulturës dhe i ndriçimit të mendimit.

Por, ato çështje filozofike e kishin ndotur shumë shpirtin tim, madje ato u bënë pengesë për zhvillimin tim shpirtëror. Papritmas, nëpërmjet mëshirës, mirësisë dhe bujarisë së Allahut të Gjithëfuqishëm e të lartësuar, urtësia e shenjtë e Kuranit të gjithurtë më erdhi në ndihmë.

Ashtu siç është shpjeguar në pjesë të shumta të Risale-i Nurit, Ai i lau papastërtitë e atyre çështjeve filozofike dhe e pastroi shpirtin tim prej tyre.

Për shembull, errësira shpirtërore që buronte nga shkenca dhe nga filozofia e mbytën shpirtin tim në qëniet e universit. Sa herë që orientohesha me shikimin tim tek ato qënie, nuk shikoja dritë në to dhe nuk mund të gjeja shkëlqim, dhe nuk mund të merrja frymë. Kështu vazhdoi derisa erdhi Drita vezulluese e Unitetit Hyjnor e dhënë nga fraza prej Kuranit të gjithurtë.

Lailahe il-la Hu, *Nuk ka zot tjetër përveç Atij*, frazë e cila i shpërndau dhe i largoi të gjitha ato shtresa errësire me dritën e saj vezulluese, dhe unë munda të marrë frymë me lehtësi. Por nefsi im dhe shejtani, duke u mbështetur në ato mësime që kishin mësuar prej njerëzve të çudhëzimit dhe prej filozofëve, sulmuan arsyen dhe zemrën time. Mirëpo, lavdi Zotit, ky debat psikologjik nisi e përfundoi me fitoren e me triumfin e zemrës sime.

Meqenëse një pjesë e atyre debateve ka ardhur në shumë vende të Risale-i Nurit, ne mjaftohemi me to, veçse këtu do të shpjegojmë vetëm një provë prej mijërave me qëllim që të tregojmë një të mijtën pjesë të asaj fitoreje të zemrës kundra nefsit dhe shejtanit. Le të shërbejë ai argument për të pastruar shpirtërat e atyre të moshuarve të cilët i kanë ndotur shpirtërat e tyre dhe i kanë bërë të sëmura zemrat e tyre, nga gjërat të cilat megjithëse quhen filozofia perëndimore ose shkencat e civilizimit, janë pjesërisht çudhëzim dhe pjesërisht gjëra të rëndomta -banalitete. Dhe nëpërmjet Unitetit Hyjnor ata të mund të shpëtojnë nga e keqja e shejtanit dhe e nefsit. Ai debat është siç vijon:

Nefsi im më tha në emrin e shkencës e të filozofisë: "Sipas natyrës së gjërave, qëniet në univers ndërhyjnë në gjërat e tjera. Çdo gjë shikon tek një shkak. Fruti duhet të kërkohet nga pema dhe farërat nga dheu. Atëherë çfarë do të thotë të kërkosh me dua edhe gjënë më të papërfillshme e më të vogël e të pjesshme nga Zoti xh.sh.?

Nëpërmjet Dritës së Kuranit, kuptimi i Unitetit Hyjnor u shfaq atëherë në mënyrën që vijon:

Zemra ime iu përgjigj nefsit tim i cili filozofonte: Gjëja më e vockël dhe më e pjesshmja, ashtu si gjëja më e madhe, vjen

drejtpërdrejtë nga fuqia e Krijuesit të të gjithë universit dhe shfaqet nga thesari i Tij. Kjo nuk mund të ndodhë në ndonjë mënyrë tjetër. Sa për shkaqet, ato janë thjesht një perde, sepse për sa ka të bëjë me artin dhe me krijueshmërinë, ndonjëherë krijesat, të cilat ne i supozojmë të jenë më të vogëlat dhe më pak të rëndësishme, janë më të mëdhaja se sa krijesat më gjigante.

Për shembull miza, edhe në qoftë se nuk do të ishte më e hollë e më e madhe në art se sa një pulë, veçse ama ajo nuk është më e vogël se ajo në art. Prandaj asnjë ndryshim nuk duhet të bëhet ndërmjet të madhes dhe të voglës. Ose të gjitha duhet të ndahen midis shkaqeve materiale, ose të gjitha duhet t'i atribuohen njëherësh një Qënieje të Vetme. Dhe ashtu siç është e pamundur e para, po ashtu e dyta është e domosdoshme për t'u besuar, sepse në qoftë se të gjitha qëniet i atribuohen një Qënieje të Vetme, domethënë të Gjithëfuqishmit të Parapërjetshëm, meqenëse njohuria e Zotit xh.sh. rrethon e përfshin gjithçka, dhe ekzistenca e së Cilës vërtetohet në mënyrë të sigurt nëpërmjet rregullit të të gjitha krijesave dhe urtësive që gjenden në to; dhe meqenëse masa e të gjitha gjërave është paracaktuar në njohjen e Tij; dhe meqenëse, në mënyrë të qartë, qëniet të cilat janë të mbushura me një art të pafundmë vijnë vazhdimisht në ekzistencë nga asgjëja me një lehtësi të pakufishme; dhe meqenëse në përputhje me dëshmi të panumërta të fuqishme, i Gjithëfuqishmi i Gjithëditur zotëron një fuqi absolute dhe është i aftë të krijojë çdo gjë nëpërmjet urdhërit كُنْ فَيَكُونُ *"Kun fejekun" -"Bëhu! Dhe ajo bëhet në çast"*- sa çel e mbyll sytë..

Dhe ashtu siç është shpjeguar në shumë pjesë të Risale-i Nurit dhe siç është provuar veçanërisht në Letrën e Njëzet dhe në fundin e Shkreptimës së Njëzet e Tretë, atëherë lehtësia e jashtëzakonshme dhe kollajllëku që ne e shohim buron nga ajo Njohje gjithëpërfshirëse dhe nga madhështia e asaj Fuqie absolute.

Për shembull, ashtu si në qoftë se do të kaloje një lëndë të veçantë kimike mbi një libër i cili është shkruar me bojë të padukshme kimike, ai libër gjigand papritmas demonstron ekzistencën e vet në mënyrë të dukshme dhe e bën vetveten të lexueshëm, po ashtu forma e veçantë dhe masa e caktuar e çdo gjëje është e paracaktuar në njohjen gjithëpërfshirëse të të Gjithëfuqishmit të Parapërjetshëm. Nëpërmjet

urdhërit كُنْ فَيَكُونُ *"Kun fejekun" - "Bëhu! Dhe ajo bëhet në çast"*, me fuqinë e Tij të pakufishme, dhe me dëshirën e Tij depërtuese, i Gjithëfuqishmi Absolut përdor një manifestim të fuqisë së Tij për qënien e cila ekziston si njohje dhe me lehtësi të plotë e me kollajllëk si kalimi i asaj lënde kimike në shembull, i jep asaj ekzistencë të jashtme; Ai shfaq dhe bën të lexohen qëndisjet e Urtësisë së Tij.

Por në qoftë se të gjitha gjërat së bashku nuk do t'i atribuoheshin përnjëherësh të Gjithëditurit Absolut dhe të Gjithëfuqishmit të Parapërjetshëm, atëherë krijimi i gjësë më të vogël, si miza për shembull, do të kërkonte medoemos grumbullimin e të gjitha atyre që kanë lidhje me mizën prej shumicës së llojeve në botë, dhe t'i grumbullosh bashkë në një masë të veçantë e shumë të hollë, domethënë t'i grumbullosh të gjitha ato në trupin e mizës; madje do të bëhej e domosdoshme që çdo grimcë që vepron në trupin e mizës të kishte njohuri të plotë për misteret e krijimit të mizës dhe për urtësinë e ekzistencës së saj, madje do të duhej të njihte artin e saj të përkryer me të gjitha detajet e tij të holla.

Meqenëse shkaqet materiale ose natyra nuk mund të krijojnë absolutisht asgjë nga mosqënia, ashtu siç është e vetëkupueshme dhe e pranueshme me unanimitet nga të gjithë njerëzit e mençur; atëherë ato shkaqe edhe në qoftë se do të mundeshin të krijonin, por ama kjo nuk do të ishte e mundur veçse duke e grumbulluar qënien. Dhe meqenëse ato do ta grumbullojnë atë bashkë, çdo qënie e gjallë, cilado qoftë ajo, brenda saj përmban shembujt e shumicës së elementeve dhe të shumicës së specieve të qënieve, sepse krijesat e gjalla, mjaft thjesht, janë si një farë ose si esenca e universit. Atëherë duhet medoemos që t'i grumbullojë grimcat e farës nga një pemë e plotë, dhe t'i grumbullojë elementet e qënies së gjallë dhe grimcat e saj prej të gjitha anëve të botës duke i situr ato nëpërmjet një site të hollë dhe duke i matur me peshoren më të ndjeshme. Dhe meqenëse shkaqet natyrale janë të paditura dhe të pajeta, dhe nuk kanë njohuri me të cilën të përcaktojnë një plan, një ndeks, një model ose një program sipas të cilëve ato të mund të shkrijnë e të derdhin grimcat që hyjnë në kallëpin jolëndor të qënies në çështje, me qëllim që ato të mos shpërndajnë dhe prishin rregullin e saj; është e qartë se sa larg mundësisë dhe arsyes do të ishte nëse do të supozohej kjo, pa kallëp apo masë, që ato të mund t'i bëjnë grimcat e elementeve, që vërshojnë si rrëke, të mbeten njëri mbi

tjetrin në formën e një mase të sistemuar pa u shpërndarë; sepse çdo gjë ka një formë të veçantë dhe një masë midis mundësive të pallogaritshme e të panumërta.

Sigurisht, ai që nuk vuan nga verbëria në zemrën e tij, do ta shohë atë. Po, si rrjedhojë e kësaj të vërtete, sipas kuptimit të vërsetit,

إِنَّ الَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللهِ لَنْ يَخْلُقُوا ذُبَابًا وَلَوِ اجْتَمَعُوا لَهُ *"Me të vërtetë që ata të cilëve ju u drejtoheni në vend të Allahut, nuk mund të krijojnë as edhe një mizë, edhe sikur të mblidheshin të gjithë së bashku për t'ia arritur qëllimit."* [17]

Domethënë, në qoftë se do të mblidheshin bashkë të gjithë shkaqet materiale dhe në qoftë se ato do të kishin dëshirë, ato nuk do të mund të grumbullonin qënien e një mize të vetme dhe sistemet e saj dhe organet me drejtëpeshimin e tyre të veçantë. Dhe madje edhe në qoftë se ato do të mund t'i grumbullonin, ato nuk do të mund t'i bënin të mbeten në masën e përcaktuar të qënies. Edhe në qoftë se do t'i bënin të mbeten kështu, ato nuk mund t'i bëjnë grimcat e vockëla, të cilat përtërihen në mënyrë të vazhdueshme duke ardhur në ekzistencë e duke punuar, nuk mund t'i bëjnë të veprojnë me rregull e me sistem.

Prandaj, në mënyrë të vetëkuptueshme shkaqet nuk mund të pretendojnë pronësi mbi gjërat. Domethënë, Pronari i tyre i Vërtetë është Dikush tjetër.

Po, Pronari i tyre i vërtetë është i Atillë që, sipas vërsetit,

مَا خَلْقُكُمْ وَلَا بَعْثُكُمْ إِلَّا كَنَفْسٍ وَاحِدَةٍ *"Krijimi i ju të gjithëve dhe ringjallja e ju të gjithëve janë si (krijimi dhe ringjallja) e një njeriu të vetëm."* [18]

Ai i sjell në jetë të gjitha qëniet e gjalla mbi faqen e tokës me aq lehtësi siç sjell në jetë një mizë të vetme. Ai e krijon pranverën me aq lehtësi siç krijon një lule të vetme; sepse Ai nuk ka nevojë që t'i grumbullojë gjërat së bashku. Meqenëse Ai është Pronari i urdhërit

[17] Kuran 22:73
[18] Kuran 31:28

كُنْ فَيَكُونُ *"Kun fejekun" -"Bëhu! Dhe ajo bëhet në çast"*, dhe meqenëse në çdo pranverë Ai krijon nga asgjëja cilësi të panumërta, gjendje dhe format e qënieve të panumërta të pranverës së bashku me elementet e qënieve të tyre fizike; dhe meqenëse Ai përcakton planin, modelin, indeksin dhe programin e çdo gjëje në njohjen e Tij; dhe meqenëse të gjitha grimcat e vockëla janë në lëvizje brenda sferës së njohjes dhe të fuqisë së Tij; atëherë Ai krijon çdo gjë me lehtësi absolute dhe sa çel e mbyll sytë. Dhe asgjë absolutisht nuk e ngatërron lëvizjen e saj as sa një thërmijë. Dhe grimcat e vockëla janë si një ushtri e disiplinuar, e rregullt dhe e mirorganizuar për të, po ashtu janë edhe planetet si një ushtri e bindur për të.

Dhe meqenëse të gjitha ato ecin duke u mbështetur tek ajo fuqi e parapërjetshme dhe funksionojnë e lëvizin në përputhje me parimet e asaj njohjeje të parapërjetshme, atëherë ato vepra vijnë në ekzistencë në përputhje me atë fuqi. Prandaj ato nuk mund të vlerësohen të papërfillshme duke konsideruar individualitetet e tyre të parëndësishme, sepse nëpërmjet forcës së qënies e lidhur me atë Fuqi, një mizë mund të heqë qafe e të vrasë një Nimrud, dhe një milingonë mund të shkatërrojë pallatin e Faraonit, dhe një farë e vogël pishe mund të mbajë mbi shpatullat e saj peshën e krejt pishës gjigante që është e lartë sa një mal.

Ne e kemi provuar këtë realitet në pjesë të shumta të Risale-i Nurit. Këtu gjithashtu ne themi: Ashtu si nëpërmjet mobilizimit të tij në ushtri dhe duke qenë i lidhur me mbretin, një ushtar i zakonshëm mund të zërë rob një komandant të madh të armikut gjë e cila tejkalon një mijë herë aftësinë e tij, po ashtu, duke qenë të lidhura me fuqinë e parapërjetshme, të gjitha gjërat mund të manifestojnë mrekulli arti duke tejkaluar me mijëra herë kapacitetin e shkaqeve natyrale.

Shkurtazi: Fakti se të gjitha gjërat vijnë në ekzistencë edhe me art të pafundmë edhe me lehtësi të pafundme, tregon se ato janë veprat e të Gjithëfuqishmit të parapërjetshëm i Cili zotëron njohje gjithëpërfshirëse. Përndryshe kjo do të ishte një pamundësi në njëqind pamundësi që ajo gjë të vijë në ekzistencë; madje atëherë ajo do të dilte nga sfera e mundësisë dhe do të futej në sferën e pamundësisë; madje do të dilte nga limitet e nga forma e mundësisë për tek forma dhe natyra e pamundësisë; madje absolutisht asgjë nuk do të mund të vinte në ekzistencë.

Kështu nëpërmjet këtij argumenti shumë të hollë, të fuqishëm, të thellë e të qartë, nefsi im i cili kishte qenë një student i përkohshëm i shejtanit dhe një zëdhënës i njerëzve të çudhëzimit dhe i filozofëve, u hesht dhe, lavdi Zotit, besoi plotësisht; ai tha:

Po, ajo që kam nevojë është një Krijues dhe Furnizues i Cili zotëron fuqinë për të njohur dhe mendimet më të holla të zemrës sime dhe dëshirat e mia më të fshehura.

Dhe ashtu siç do t'u përgjigjej Ai nevojave më të fshehura të shpirtit tim, po ashtu Ai do ta transformojë tokën madhështore në Ahiret me qëllim që të më japë mua lumturi të përjetshme, dhe që do ta heqë këtë dynja e të vendosë Ahiretin në vendin e saj; i Cili i krijon qiejt ashtu siç krijon një mizë; dhe ashtu siç e lidh dhe e mbërthen diellin si një sy në faqen e qiellit, po ashtu mund të vendosë një grimcë në beben e syrit tim, sepse ai që nuk mund të krijojë një mizë nuk mund të ndërhyjë në mendimet e zemrës sime dhe nuk mund të dëgjojë lutjet e shpirtit tim. Ai që nuk mund të krijojë qiejt, nuk mund të më japë mua lumturi të përjetshme.

Prandaj, Krijuesi im është Ai i Cili dëgjon, madje që rregullon mendimet e zemrës sime; dhe ashtu siç e mbush Ai dhe e boshatis hapësirën e qiellit me re për një orë, po ashtu Ai do ta transformojë këtë dynja në Ahiret, do të bëjë xhennetin, do t'i hapë dyert e tij për mua duke më thënë: Eja, hyr!!

O vëllezërit e mi të moshuar, që si rrjedhojë e fatkeqësisë, ashtu si nefsi im, e keni kaluar një pjesë të jetës suaj në filozofinë e errët materialiste perëndimore dhe në shkencat e saj! Dijeni se dekreti i shenjtë ***La i lahe il-la Hu,*** *Nuk ka zot tjetër përveç Atij* që shprehet vazhdimisht nga gjuha e Kuranit, dhe kuptojeni se çfarë shtylle e fuqishme, e vërtetë e palëkundur, e padëmtueshme, e pandryshueshme dhe e shenjtë e besimit është ajo, dhe si ai dekret i largon të gjitha errësirat shpirtërore dhe i kuron plagët shpirtërore!

Edhe në qoftë se këtë tregim të gjatë e përfshiva brenda dyerve të shpresës dhe ngushëllimit të pleqërisë sime, veçse ama kjo ishte në mënyrë të pavullnetshme. Madje unë nuk doja ta përfshija atë këtu; unë zmbrapsesha nga bërja e diçkaje të tillë pasi mendoja se ajo do të ishte e mërzitshme.

Por unë mund të them se u ndjeva i detyruar që ta shkruaja. Sidoqoftë për t'u rikthyer tek çështja kryesore:

Si rrjedhojë e thinjave që u shfaqën në flokun tim e në mjekrën time dhe si rrjedhojë e pabesisë së një shokut tim besnik, unë u ndjeva i ftohur dhe i neveritur nga kënaqësitë e jetës mondane në Stamboll e cila ishte shumë vezulluese dhe në dukje e këndshme dhe e praruar. Nefsi im kërkoi kënaqësi shpirtërore në vend të kënaqësive pas të cilave ishte robëruar. Ai kërkoi një dritë, një ngushëllim në këtë pleqëri e cila dukej e rëndë, shqetësuese dhe e pakëndshme dhe e ftohtë në shikimin e të pakujdesshmive.

Lavdi Zotit dhe njëqind mijë falënderime qofshin për Të, ashtu siç gjeta kënaqësinë e vërtetë, të vazhdueshme dhe të ëmbël të besimit në ***La i lahe il- la Hu*** dhe në dritën e Unitetit Hyjnor në vend të të gjitha atyre kënaqësive të rreme, të pakëndshme e kalimtare të kësaj bote, po ashtu nëpërmjet dritës së Unitetit Hyjnor, unë e pashë pleqërinë, e cila në shikimin e të pakujdesshmive është e ftohtë dhe e rëndë, të ishte më e lehta, më e ngrohta dhe më e ndritshmja.

O ju burra të moshuar dhe o gra të moshuara!

Meqenëse ju keni besim dhe meqenëse bëni lutje e salevate të cilat e ndriçojnë besimin, madje e shtojnë besimin, ju mund ta shikoni pleqërinë tuaj si një rini e vazhdueshme, sepse nëpërmjet saj ju mund të fitoni një rini të përjetshme. Pleqëria e cila në të vërtetë është e ftohtë, e rëndë, e shëmtuar, e errët dhe plot dhimbje është pleqëria e njerëzve të çudhëzimit, madje edhe rinia e tyre gjithashtu. Ata duhet të qajnë me ofshama e dëshpërime. Ndërsa ju, o njerëz të moshuar të respektuar besimtarë, duhet që me gëzim të bëni falënderime duke thënë: *"Lavdi Zotit në çdo situatë".*

■ SHPRESA E DYMBËDHJETË

Njëherë, unë po mbahesha në provincën e Barlës që i përkiste rrethit të Ispartës në një robëri dëshpëruese nën emrin e internimit, në një gjendje vërtet të mjeruar duke vuajtur edhe nga sëmundje edhe nga pleqëria dhe nga qënia i syrgjynosur, dhe në një fshat i vetmuar duke mos pasur askënd, i ndaluar nga të gjitha shoqërimet dhe nga komunikimi. Ndërsa isha në këtë gjendje pikëlluese, papritmas nga mëshira e Tij e gjërë dhe e plotë Allahu Fuqiplotë më dhuroi një dritë

lidhur me pikat e holla dhe me misteret e Kuranit të Gjithurtë e cila ishte mjet ngushëllimi për mua. Me atë dritë, unë u përpoqa të harroj gjendjen time të mjerueshme, të dhimbshme e të trishtueshme. Unë madje qeshë në gjendje të harroj vendlindjen time, të dashurit dhe të afërmit e mi...

Por medet, sa keq! Ishte një person të cilin nuk mund ta harroja, dhe ai ishte Abdurrahmani, i cili ishte edhe nipi im edhe djali im shpirtëror, edhe studenti im më vetëflijues si dhe shoku im më guximtar. Ai qe ndarë prej meje para gjashtë ose shtatë vitesh, Allahu e mbuloftë me mëshirën e Tij. As ai nuk e dinte se ku ndodhesha që të mund të nxitonte për të më ndihmuar e për të më ngushëlluar, as unë nuk e dija gjendjen e tij që të mund të mbaja korrespondencë me të dhe të ndanim dhimbjet me njëri-tjetrin. Tani në pleqërinë time unë isha shumë në nevojë për dikë besnik dhe vetëflijues si ai.

Pastaj, papritmas dikush më dha mua një letër. Unë e hapa atë dhe pashë se ajo ishte nga Abdurrahmani, e shkruar në një mënyrë e cila shfaqte plotësisht personin e vetë Abdurrahmanit. Një pjesë prej asaj letre u përfshi brenda pjesëve të letrës së Njëzet e Shtatë, e cila tregon qartë tre shembuj kerametesh. Ajo më bëri mua të qaja dhe akoma më bën të qaj. I ndjeri Abdurrahman shkroi një letër me seriozitet e me sinqeritet se ai ishte i neveritur nga kënaqësitë e kësaj dynjaje dhe se dëshira e tij më e madhe ishte që të arrinte tek unë që të kujdesej për mua në pleqërinë time ashtu siç kujdesesha unë për të kur ai ishte i vogël.

Ai gjithashtu donte të më ndihmonte me penën e tij të aftë në përhapjen e mistereve të Kuranit, që ishte detyra ime dhe misioni im i vërtetë në këtë dynja. Ai madje shkroi në letrën e tij: "Më dërgo njëzet ose tridhjetë trajtesa dhe unë do të shkruaj njëzet ose tridhjetë kopje për secilën dhe do t'i bëj edhe të tjerët t'i shkruajnë."

Letra e tij më bëri të ndihem shumë optimist e shpresëtar lidhur me dynjanë. Duke menduar se unë kisha gjetur një student guximtar i cili ishte aq inteligjent sa një gjeni që do të më ndihmonte mua më shumë besnikërisht dhe nga afër se sa një djalë i vërtetë, unë e harrova robërinë time të dhimbshme, vetminë, mërgimin dhe pleqërinë.

Ai kishte siguruar një kopje të Fjalës së Dhjetë për besimin në Botën tjetër para se ta shkruante letrën. Sikur trajtesa kishte qenë një

ilaç për të duke ia shëruar të gjitha plagët shpirtërore që i kishte marrë gjatë këtyre gjashtë ose shtatë viteve.

Ndërkohë ai shkroi letrën për mua sikur ai po priste vdekjen e tij me një besim të vërtetë të fortë e të ndritshëm. Pastaj një ose dy muaj më vonë, ndërsa po mendoja përsëri për kalimin e një jete të lumtur së bashku me Abdurrahmanin, por ah medet, unë papritmas mora njoftimin për vdekjen e tij.

Unë u trondita aq shumë nga ai lajm i hidhur saqë unë vazhdoj akoma të jem nën atë ndikim qysh prej pesë viteve. Ajo më shkaktoi mua një dëshpërim të madh, dhe një dhimbje të thellë për ndarjen e dhimbshme shumë më të madhe se sa robëria ime e dhimbshme, syrgjynosja, pleqëria dhe sëmundja që unë vuajta atëherë.

Unë thoja: Gjysma e botës sime private kishte vdekur me vdekjen e nënës sime, dhe tani me vdekjen e Abdurrahmanit, gjysma tjetër ka vdekur. Tani lidhjet e mia me dynjanë ishin këputur krejtësisht, sepse në qoftë se ai do të kishte jetuar, ai do të mund të kishte qenë edhe një ndihmë e fuqishme në detyrat e mia që shikonin Ahiretin, dhe një pasues i denjë për të mbushur plotësisht vendin tim pas meje, një shok vetëflijues dhe ngushëllim. Ai do të kishte qenë studenti im më i zgjuar dhe shoku dhe, një mbrojtës besnik dhe pronari i Risale-i Nurit.

Po, në lidhje me humanizmin, humbjet e tilla janë jashtëzakonisht dëshpëruese dhe të dhimbshme për njerëz si unë. Pavarësisht se unë përpiqesha t'i përballoja me durim ato dhimbje që vuaja, veçse ama një stuhi e fuqishme po tërbohej në vendet e shpirtit tim. Në qoftë se nga koha në kohë, nuk do të më kishte ngushëlluar ngushëllimi që buron nga drita e Kuranit, nuk do të kishte qenë e mundur që ta duroja. Në atë kohë unë fillova të endesha në malet e në luginat e Barlës. Duke qëndruar në vende të vetmuara në mes të brengave të mia, tablotë dhe përfytyrimet e jetës së lumtur që kisha kaluar në kohët e mëparshme me studentët e mi si Abdurrahmani kalonin përmes imagjinatës si film kinematografik; duke u prekur shpejt për shkak të pleqërisë dhe të syrgjynosjes, ato e thyen rezistencën time. Papritmas kuptimi i shenjtë i vërsetit, كُلُّ شَيْءٍ هَالِكٌ إِلَّا وَجْهَهُ لَهُ الْحُكْمُ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ *"Çdo gjë do të shuhet e do të shkatërrohet përveç Fytyrës së Tij. Atij i takon gjykimi e*

vendimi dhe tek Ai ju të gjithë do të ktheheni"[19], m'u zbulua. Ai më bëri mua të them duke përsëritur: ***Ja Baki Entel Baki, Ja Baki Entel Baki,*** *'O i Qëndrueshmi i Vetëm! Ti je i Qëndrueshmi i Vetëm'! 'O i Qëndrueshmi i Vetëm, Ti je i Qëndrueshmi i Vetëm!'* dhe me të unë gjeta ngushëllimin e vërtetë.

Pastaj, ashtu siç është përshkruar në trajtesën "*Rruga e praktikave të Profetit Muhammed a.s.m.",* nëpërmjet kuptimit të këtij vërseti në atë luginë të vetmuar dhe në atë gjendje të trishtueshme, unë e pashë veten time në krye të tre kufomave të mëdhaja.

E para: Unë e pashë veten time si një gur varri që përmbante pesëdhjetë e pesë Saida që kishin vdekur dhe ishin varrosur në rrjedhën e jetës sime dhe përfshinte moshën time që u ishte afruar të pesëdhjetë e pesave.

E dyta: E pashë veten time si një qënie të gjallë shumë të vogël, si një milingonë, në krye të asaj kufome duke bredhur në faqen e këtij shekulli i cili ishte si një gur varri i kufomës së madhe i të gjithë njerëzve si unë të cilët kishin vdekur që nga koha e Ademit a.s. dhe që ishin varrosur në varrin e së shkuarës.

Kufoma e tretë ishte dynjaja e madhe e cila, ashtu si qëniet humane dhe botët udhëtuese që vdesin në çdo vit, do të vdesë gjithashtu sipas misterit të vërsetit të lartëpërmendur; edhe kjo u mishërua para imagjinatës sime.

Pastaj vërseti,

فَإِنْ تَوَلَّوْا فَقُلْ حَسْبِيَ اللَّهُ لَا إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَهُوَ

رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ

"Por nëse ata kthejnë kurrizin, atëherë thuaju (O Muhammed a.s.): Allahu është mëse i mjaftueshëm për mua, 'La i lahe il-la Huve', 'Nuk ka zot tjetër përveç Atij'. Tek Ai unë mbështetem plotësisht dhe Ai është Zoti i Arshit Madhështor.",[20] ndriçoi me ngushëllimin e tij të vërtetë dhe me

[19] Kuran 28:88
[20] Kuran 9:129

dritën e tij të pashuar atë vizion të tmerrshëm që buroi nga dëshpërimi im për vdekjen e Abdurrahmanit; ai vërset më erdhi në ndihmë me kuptimin e tij aludues, duke deklaruar: Meqenëse Allahu i Plotëfuqishëm ekziston, Ai merr vendin e çdo gjëje. Meqenëse Ai është i Qëndrueshëm përjetësisht, sigurisht Ai është i mjaftueshëm. Një manifestim i vetëm i mirësisë së Tij merr vendin e të gjithë botës. Një manifestim i Dritës së Tij u jep kuptimin e jetës të trija kufomave të mëdhaja që u përmendën lart, duke treguar se ato nuk janë kufoma, por duke pasë përmbushur detyrat e tyre, ata janë larguar për në botëra të tjera. Ky mister është shpjeguar në Shkreptimën e Tretë.

Kështu duke u mjaftuar me atë që u fol lart, këtu unë vetëm do të them se dy përsëritjet e Frazës: ***Ja Baki Entel Baki, Ja Baki Entel Baki!*** *O i Qëndrueshmi i Vetëm! Ti je i Qëndrueshmi i Vetëm!, O i Qëndrueshmi i Vetëm! Ti je i Qëndrueshmi i Vetëm!,* e cila ilustron kuptimin e vërsetit,

كُلُّ شَيْءٍ هَالِكٌ إِلَّا وَجْهَهُ *"Çdo gjë do të zhduket përveç Fytyrës së Tij"* (deri në fund të vërsetit), më shpëtoi mua nga ajo gjendje shumë e dhimbshme dhe e trishtueshme. Ishte si më poshtë vijon:

Kur unë thashë për herë të parë: '***Ja Baki Entel Baki***!', ajo filloi një mjekim si një operacion kirurgjikal në mes të plagëve të pafundme shpirtërore që buronin nga kalimi i botës dhe i të dashurve në këtë botë me të cilët unë isha i lidhur, dhe që buronte nga këputja e lidhjeve të mia me ta.

Ndërsa në herën e dytë, fraza '***Ja Baki Entel Baki'*** ishte edhe si balsam, edhe kundërhelm për të gjitha ato plagë të panumërta shpirtërore, dhe kjo duke shqyrtuar kuptimin vijues,

"Le të largohen ata që largohen, o Krijuesi im! Ti je i Qëndrueshmi i përjetshëm, Ti je i mjaftueshëm."

Meqenëse Ti je i Qëndrueshëm përjetësisht, vetëm një manifestim i mëshirës Tënde është i mjaftueshëm në vendin e të gjitha gjërave, të cilat janë kalimtare. Meqenëse Ti ekziston, atëherë çdo gjë ekziston për atë që e kap kuptimin e lidhjes së tij me Ty nëpërmjet besimit për ekzistencën Tënde dhe i cili vepron e lëviz në përputhje me atë lidhje nëpërmjet misterit të Islamit. Atëherë përkohshmëria, zhdukja, vdekja

dhe mosekzistenca janë thjesht një perde për ripërtëritje, ose mjet për të udhëtuar në banesa të ndryshme dhe për të shëtitur nëpër to".. Duke menduar kështu, gjendja ime e dhimbshme, e trishtueshme, pikëlluese, e errët, e tmerrshme dhe e njollosur me ndarje u transformua në një gjendje të lumtur, të gëzueshme, të këndshme, të ndritshme e familjare. Madje gjuha dhe zemra ime, nëpërmjet gjuhës së gjendjes së të gjitha grimcave të qënies sime përsëritën duke thënë ***El-Hamdu Lil-lah,*** *Lavdia i takon Allahut.*

Një e mijëta e atij manifestimi mëshire është ky:

Kur unë u ktheva në Barla prej asaj lugine të hidhur duke mbajtur me vete ato dëshpërime, pashë një djalë që quhej Mustafa Kuleönlÿ, i cili kishte arrdhur për të më pyetur mua rreth pesë namazeve të detyruara dhe avdesit... Megjithëse unë nuk pranoja vizitorë në atë periudhë, veçse ama sikur shpirti im lexoi sinqeritetin që ishte në shpirtin e atij djali dhe, sikur shpirti im kuptoi me parandjenjë shërbimet që ky djalë do të kryente për Risale-i Nurin në të ardhmen[21] dhe unë nuk e ktheva atë, unë e pranova[22].

---

[21] Me penën e tij të hollë, vëllai më i vogël i Mustafait, küçük Ali, shkroi më shumë se shtatëqind kopje nga pjesët e Risale-i Nurit, dhe vetë ai u bë një Abdurrahman. Gjithashtu ai mësoi e ushtroi shumë Abdurahmana të tjerë.

[22] Ky djalë i ri tregoi me të vërtetë jo vetëm që ishte i denjë për ta pranuar, por gjithashtu i denjë edhe për të ardhmen.

Një ngjarje që vërteton atë parashikim të Ustadhit se Mustafai, Studenti i parë i Risale-i Nurit ishte i denjë për të ardhmen:

Ustadhi dëshironte të shëtiste në ditën para ditës së Arefatit, në festën e Kurban Bajramit, ai më dërgoi mua që t'i bëj gati kalin dhe i thashë: Mos zbrit o ustadhi im, që ta mbyllësh derën, sepse do ta mbyll unë dhe do të dal nga dera e prapme. Ai më tha mua: Jo, dil nga dera.. Ndërkohë ai zbriti dhe e mbylli derën me shul pas meje, pastaj u ngjit në dhomën e tij dhe u mbështet...

Pastaj erdhi Mustafa Kuleönlÿ së bashku me Haxhi Osmanin. Ustadhi nuk pranonte askënd dhe nuk do të pranonte, veçanërisht në atë orë, ai nuk do të pranonte dy njerëz njëherësh, por do t'i kthente ata? Megjithatë sapo vëllai ynë Mustafai, për të cilin po flasim këtu, erdhi me Haxhi Osmanin, sikur dera i tha atij nëpërmjet gjuhës së gjendjes: "Ustadhi nuk do të pranojë, por unë do ta hap atë për ty", dhe megjithëse ajo ishte e mbyllur me shul nga brenda, dera u hap vetë për Mustafain. Domethënë, ashtu siç tregoi e ardhmja atë që tha ustadhi për të: "Mustafai është i denjë për të ardhmen" që u bë realitet, po ashtu edhe dera e dëshmoi këtë.

Nënshkroi Husrevi.

Po, çfarë kishte shkruar Husrevi ishte korrekt dhe unë e vërtetoj. Dera edhe e përshëndeti këtë Mustafa të bekuar në vendin tim, edhe e pranoi atë.

Më vonë u bë e qartë se Allahu i Plotëfuqishëm e dërgoi tek unë Mustafain si një shembull në vend të Abdurrahmanit, i cili si një pasardhës i denjë do të përmbushte plotësisht detyrën e një trashëgimtari të vërtetë në veprën e Risale-i Nurit, sikur Ai thonte: Unë e mora prej teje një Abdurrahman, por unë do të të jap ty si shkëmbim tridhjetë Abdurrahmana si ky djalë i ri Mustafai që ti e shikon, të cilët do të jenë edhe studentë edhe nipër, djem shpirtërorë, vëllezër dhe shokë vetëflijues në këtë detyrë për fenë".

Po, lavdi Zotit, Ai më dha mua tridhjetë Abdurrahmana. Pastaj i fola zemrës sime: o zemra ime vajtuese! Meqenëse ti e ke parë këtë shembull dhe nëpërmjet tij ai ka kuruar më të rëndën e plagëve të tua shpirtërore, ti duhet të jesh i sigurt se Ai do t'i shërojë të gjitha plagët e tjera që të kanë rënë ty.

O vëllezërit e mi të moshuar dhe o motrat e mia të moshuara që ashtu si unë në kohën e pleqërisë keni humbur një fëmijë ose një të afërm që e keni dashur shumë dhe që duhet të duroni dhimbjet përcëlluese të ndarjes së bashku me peshat e pleqërisë! Ju keni kuptuar nga situata ime se ndërsa duke qenë shumë më e rëndë se sa e juaja, ajo u shërua dhe u mjekua nga vërseti i Kuranit. Meqenëse është kështu, gjenden ilaçe në farmacinë e shenjtë të Kuranit të gjithurtë për t'i shëruar të gjitha vështirësitë.

Në qoftë se e përdorni atë nëpërmjet besimit dhe i përdorni ato ilaçe nëpërmjet adhurimit, peshat e rënda të pleqërisë suaj dhe dëshpërimet tuaja do të lehtësohen në mënyrë të konsiderueshme.

Arsyeja për shkruajtjen e kësaj pjese të gjatë ishte për të kërkuar më shumë dua për Abdurrahmanin e ndjerë dhe jo për t'ju mërzitur ju. Gjithashtu qëllimi im në tregimin e plagës sime më të rëndë në një mënyrë shumë të dhimbshme dhe të pakëndshme që mund t'ju shqetësojë e dëshpërojë më shumë, është për të demonstruar se çfarë ilaçi i mrekullueshëm dhe çfarë drite vezulluese është kundërhelmi i shenjtë i Kuranit të gjithurtë.

■ SHPRESA E TREMBËDHJETË[23]

Në këtë shpresë do të përshkruaj një tablo të rëndësishme nga tablotë e ngjarjeve të jetës sime. Ajo duhet të jetë disi e zgjatur, por unë shpresoj se ju nuk do të mërziteni apo të ofendoheni.

Pasi shpëtova nga robëria në Rusi gjatë luftës së parë botërore, unë qëndrova në Stamboll për dy apo tre vite në shërbim të fesë në *Dar'el-Hikmeh*. Ndërkohë nëpërmjet udhëzimit të Kuranit të gjithurtë dhe të influencës shpirtërore të Shejh Gejlanit dhe me zgjimin tim nëpërmjet pleqërisë, unë ndjeva një mërzitje nga jeta e civilizuar e Stambollit dhe një neveritje nga jeta e saj sociale vezulluese.

Një ndjenjë përmallimi për vendlindjen time më shtyu mua atje, duke menduar, meqenëse unë do të vdes, le të vdes në vendin tim.. dhe unë shkova në qytetin e Vanit.

Para çdo gjëje, unë shkova të vizitoj medresenë time në Van që quhej Horhor. Unë pashë se Armenët e kishin rrënuar e djegur gjatë pushtimit rus, ashtu si ndërtesat e tjera të Vanit.. Pastaj u ngjita në kalanë e famshme të Vanit e cila është një strukturë monolite e madhe si një mal dhe që përfshinte nën të medresenë time e cila ishte e ngjitur me të. Shokët e mi të vërtetë, vëllezërit dhe studentët e ngushtë të medresesë me të cilët isha ndarë para shtatë vitesh po personifikoheshin para syve të mi dhe më kalonin imazhet e tyre. Disa nga ata shokët e mi vetëflijues ishin bërë martirë të vërtetë, ndërsa të tjerët që kishin vdekur për shkak të asaj fatkeqësie ishin bërë martirë shpirtërorë në kuptim.

Unë nuk mund ta mbaja veten nga vajtimi. Ndërkohë u ngjita në majë të kështjellës e cila kishte pamje nga medreseja, tek kullat sipër saj me lartësinë e dy minareve. Unë u ktheva në imagjinatën time shtatë ose tetë vite. Duke pasur një imagjinatë të fortë, unë u sorollata gjithandej në atë kohë në mendjen time. Nuk ndodhej asnjë përreth që të më tërhiqte e të më largonte nga ajo imagjinatë në atë kohë, sepse unë isha i vetmuar. Meqenëse shikimi ndaj atyre shtatë ose tetë viteve u

[23] Është një koinçidencë e hollë që incidenti i medresesë, të cilën e përshkruan kjo shpresa e trembëdhjetë, ndodhi trembëdhjetë vite më parë (1921- përkthyesi)

Medrese: shkollë ku jepen mësim shkencat fetare.

shtri e u zgjerua, unë pashë mjaft për të mbushur një shekull, sikur një shekull ishte larguar e kishte kaluar me ngjarjet e tij.

Unë pashë se qendra e qytetit që rrethonte medresenë time, përbri kalasë, ishte djegur plotësisht dhe ishte rrënuar. Unë këtë e pashë me një shikim pikëllues e me keqardhje.. Unë ndjeja një ndryshim të madh midis asaj që kisha parë më parë dhe asaj që shoh tani, sikur kishin kaluar dyqind vjet mbi këtë qytet. Shumica e njerëzve të atyre shtëpive patën qenë shokët e mi të dashur për mua. Shumica e atyre kishin vdekur në internime, Allahu i mëshiroftë, ose kishin shkuar në mërgimet e mjera. Vetëm lagjja e Armenëve kishte mbetur, të gjitha shtëpitë e muslimanëve të Vanit ishin rrafshuar me tokën, ishin shembur. Zemra ime ishte sfilitur. Unë isha aq i prekur, saqë në qoftë se do të kisha patur një mijë sy, ato do të kishin vajtuar së bashku. Unë supozoja se kisha shpëtuar nga mërgimi meqë u ktheva në qytetin tim, por, medet, sa keq! unë pashë mërgimin më të vajtueshëm në vetë qytetin tim. Unë pashë se qindra nga studentët e mi dhe nga të dashurit me të cilët unë isha i lidhur ngushtë shpirtërisht -ashtu si Abdurrahmani që u përmend tek Shpresa e Dymbëdhjetë- se kishin hyrë në varre dhe në vendbanimet e tyre, që tashmë të gjitha ishin rrënoja.

Ndodheshin disa rreshta që kishin qenë për një kohë të gjatë në mendjen time por që nuk e kisha kapur kuptimin e tyre. Tani përpara asaj skene të zymtë unë e kuptova plotësisht kuptimin e tyre.

Rreshtat ishin këto:

لَوْلَا مُفَارَقَةُ الْأَحْبَابِ مَا وَجَدَتْ لَهَا الْمَنَايَا إِلَى أَرْوَاحِنَا سُبُلًا

*"Në qoftë se nuk do të ishte ndarja nga të dashurit, vdekja nuk do të mund të gjente rrugë për tek shpirtërat tonë që mund t'i merr*te".[24]

Domethënë, ajo që e vret më shumë njeriun është ndarja nga ata të cilët ai i do. Po, asgjë tjetër nuk më ka bërë mua të vuaj e të dëshpërohem aq shumë sa ajo situatë. Në qoftë se nuk do të më kishte ardhur ndihma nga Kurani e nga besimi, dëshpërimi im, brengosja dhe vuajtja do ta kishin bërë shpirtin tim të arratisej.

[24] Në arabisht në tekstin origjinal, këto rreshta janë nga Mutenebbi. Përkthyesi.

Meqenëse në kohët e hershme në vargjet e tyre poetët vajtonin mbi vendbanimet e të dashurve të tyre kur ata kalonin tek rrënojat e tyre, edhe unë e pashë këtë skenë të zymtë ndarjeje në formën më të dhimbshme me sytë e mi.. Dhe shpirti e zemra ime qanë së bashku me sytë e mi me dëshpërim të thellë si dikush që kalon pas dyqind vitesh mbi vendbanimet e të dashurve të tij dhe mbi rrënojat e tyre.. Pastaj një nga një kalonin skenat e lumtura e të këndshme të jetës sime para syve dhe imagjinatës sime me të gjithë forcën jetike, ashtu siç kalojnë skenat e filmit kinematografik.. ajo jetë e lumtur të cilën e kalova duke u dhënë mësim studentëve të mi të vlefshëm përafërsisht njëzet vjet, dhe pikërisht në këto vende të cilat ishin të lulëzuara e gazmore, por që tashmë ishin shkatërruar e bërë rrënoja. Unë kalova një kohë të gjatë para këtyre skenave të jetës sime. Pastaj unë u ndjeva i habitur nga gjendja e njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje; si është e mundur që ata i mashtrojnë vetvetet e tyre? Kjo situatë tregon qartë se dynjaja është e përkohshme kalimtare dhe se qëniet njerëzore janë mysafirë brenda saj dhe thjesht udhëtarë.

Unë e pashë me sytë e mi se sa të vërteta janë fjalët që përsëriten vazhdimisht nga njerëzit e realitetit: "Mos u mashtroni me dynjanë, sepse ajo është mizore, tradhëtare, e keqe dhe kalimtare..."

Unë gjithashtu pashë se njeriu ashtu siç është i lidhur me trupin e tij e me shtëpinë, po ashtu ai është i lidhur me qytetin e tij, me vendin dhe madje me dynjanë, sepse ndërsa doja të qaja me sytë e mi për pleqërinë time -duke marrë parasysh trupin tim- doja të qaja gjithashtu me dhjetë sy jo thjesht për plakjen e medresesë sime, por për vdekjen e saj. Dhe unë ndjeva nevojë të qaja me njëqind sy për qytetin tim të ëmbël e të bukur gjysëm i vdekur.

Thuhet në një hadith sherif se në çdo mëngjes thërret një melek: لِدُوا لِلْمَوْتِ وَابْنُوا لِلْخَرَابِ *"Ju lindeni për të vdekur, dhe ndërtoni banesa për t'u shkatërruar".*[25]

Unë po e dëgjoja këtë të vërtetë jo me veshët e mi, por me sytë e mi.

[25] Transmeton Bejhekiu

Pas njëzet vitesh unë akoma qaj kur e imagjinoj atë situatë, pikërisht ashtu siç më bëri të qaja në atë kohë. Po, rrënojat e shtëpive në majë të kështjellës së lashtë, e cila ka jetuar me mijëra vite dhe plakja e qytetit që ishte nën të, gjatë tetë viteve, sikur të kishte kaluar tetëqind vite, vdekja e medresesë sime në rrëzë të kalasë, e cila patë lulëzuar dhe patë qenë vendtakimi për të dashurit.. të gjitha këto tregojnë vdekjen e të gjitha shkollave fetare në shtetin Osman. Dhe tregojnë madhështinë jolëndore të kufomës së madhe të tyre, saqë sikur kalaja që është një strukturë monolite e madhe shkrepi u bë si një gur varri për të gjitha ato.

Unë pashë se studentët e mi, Allahu i mëshiroftë, të cilët ishin me mua në atë medrese, para tetë vitesh, dhe që janë duke fjetur në varret e tyre, i pashë sikur ata po qanin me mua; madje edhe muret e rrënuara të qytetit dhe gurët e tij të shpërndarë po qanin me dëshpërim së bashku me mua.

Po, unë pashë se çdo gjë sikur po qante. Atëherë unë kuptova se nuk mund ta duroja këtë mërgim në qytetin tim. Unë mendova se, ose duhet t'u bashkohem atyre në varreza, ose më duhet të tërhiqem në një shpellë në male e të pres vdekjen time atje. Unë thashë me vete: Meqenëse në dynja ndodhen këto ndarje e largime të cilat nuk mund të durohen dhe nuk mund t'u bëhet ballë dhe të cilat janë pikëlluese dhe dëshpëruese deri në këtë shkallë, atëherë nuk ka dyshim se vdekja është më e mirë se sa kjo jetë dhe është më e preferueshme në situata të këtilla të cilat nuk mund të durohen.. Dhimbjet e jetës të tilla si këto janë të padurueshme.

Prandaj, ndërkohë unë hodha një vështrim mbi gjashtë drejtimet dhe i pashë të gjitha të ishin të errëta. Pakujdesia që buronte nga dëshpërimi im i fortë ma shfaqi dynjanë të ishte e tmerrshme, e boshatisur, e shkretë, dhe gati për t'u shembur mbi kokën time.

Shpirti im kërkoi një pikë mbështetje përballë fatkeqësive të panumërta armiqësore. Dëshirat e tij të pafundme të cilat shtrihen për në përjetësi po kërkonin diçka për t'i përmbushur ato.

Ndërsa duke pritur ngushëllim përballë dëshpërimit e brengosjes që buronin nga ato ndarje të pafundme dhe nga ato vdekje, dhe nga ai shkatërrim i pafundmë, papritmas një realitet i vetëm nga vërsetet e Kuranit të shpjegimit të mrekullueshëm,

سَبَّحَ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ۝ لَهُ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ يُحْيِي وَيُمِيتُ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

"Gjithë ç'është në qiej dhe në tokë lavdërojnë Allahun dhe Ai është i Gjithëfuqishëm, i Gjithurtë".

"I Tij është mbizotërimi i qiejve dhe i tokës, Ai është që jep jetë dhe sjell vdekje dhe Ai është i Zoti për të bërë çdo gjë",[26] m'u shfaq dhe më shpëtoi nga ajo imagjinatë pikëlluese e tmerrshme dhe më shpëtoi nga dhimbja e ndarjes dhe më hapi sytë e mi. Ndërkohë hodha shikimin tek frutat e varur në pemët frutdhënëse të cilat më shikonin mua me buzëqeshje të ëmbëla dhe më thonin: "Mos shiko vetëm tek rrënojat, na vëre edhe ne gjithashtu". Realiteti i vërseteve i solli mendjes kuptimin vijues:

Përse të dëshpëron deri në këtë shkallë rënia e një letre artificiale e shkruar në formën e një qyteti nga dora e njeriut, i cili është një mysafir në faqen e fushës së Vanit? Përse dëshpërohesh për rënien e tij në përroin e kobshëm i quajtur pushtimi Rus i cili fshiu gjurmët e saj dhe e hoqi shikimin e saj? Ngrije kokën tek Krijuesi Formëdhënës i Cili është Krijuesi i çdo gjëje dhe Pronari i saj i vërtetë, çështja e saj është në Dorën e Tij, dhe mesazhet e Tij xh.sh. në faqen e Vanit shkruhen vazhdimisht në formë të ripërtërirë në mënyrë vezulluese e të praruar ashtu siç e shikoje. Vajtimi yt mbi ato rrënoja të shkreta buron nga gabimi që harrohet Pronari i tyre i vërtetë, që nuk mendohen njerëzit se janë mysafirë, dhe duke i imagjinuar ata të jenë pronarë."

Nga ajo situatë pikëlluese dhe nga ai gabim në të imagjinuar u hap një derë për tek një realitet i madh, dhe u përgatit nefsi që ta pranojë plotësisht. Ashtu si hekuri që futet në zjarr që të zbutet dhe që t'i jepet një formë e caktuar e dobishme, edhe ajo gjendje pikëlluese dhe ajo situatë e dhimbshme u bë një zjarr përvëlues që zbuti nefsin tim. Nëpërmjet realitetit të vërseteve të lartëpërmendur, Kurani i shpjegimit të mrekullueshëm i shfaqi atij shkëlqimin e të vërtetave të besimit, duke e bërë atë ta pranojë.

Po, të gjitha lavdërimet i takojnë Allahut, ashtu siç është provuar në mënyrë përfundimtare në pjesët e Risale-i Nurit, si Letra e Njëzet,

[26] Kuran 57: 1-2

nëpërmjet shkëlqimit të besimit në Zotin, realiteti i vërseteve i jep një pikë mbështetjeje shpirtit dhe zemrës të cilat zbulohen në lidhje me fuqinë e besimit të gjithkujt. Kjo ishte aq e fuqishme saqë më dha mua forcë që të përballoj fatkeqësi njëqind herë më të tmerrshme se sa situata që unë pashë. Unë shpreha këtë përkujtues: "çdo gjë i është nënshtruar urdhërit të Pronarit të vërtetë të këtij vendi, Krijuesit tënd. Frerat e të gjitha gjërave janë në Dorën e Tij. Lidhja jote me Të është e mjaftueshme."

Duke e njohur Krijuesin tim e duke u mbështetur tek Ai, të gjitha gjërat të cilat ishin shfaqur armiqësore e braktisën armiqësinë e tyre, dhe gjërat e dhimbshme të cilat më kishin bërë mua të qaja, filluan të më bënin të lumtur.

Dhe ashtu siç e kemi demonstruar me prova të sigurta në shumë vende të Risale-i Nurit, nëpërmjet dritës që buroi nga besimi në Ahiret, kjo dha një pikë të tillë përballë dëshirave të mia të pafundme saqë ajo fuqi ishte e mjaftueshme jo vetëm për ato dëshira të vogëla, të përkohshme e të shkurtëra dhe për ato lidhje me të dashurit e mi në dynja, por ajo mjaftonte gjithashtu për dëshirat e mia të pafundme në botën e përjetësisë, në botën e qëndrueshmërisë dhe në lumturinë e përhershme, sepse nëpërmjet një manifestimi të vetëm prej manifestimeve të mëshirës së të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, Ai shtron e vendos mbi tryezën e pranverës mirësitë e Tij të shijshme e të mrekullueshme në faqen e tokës e cila është një bujtinë nga bujtinat e përkohshme të dynjasë për gosti; Allahu xh.sh. u jep atyre mysafirëve në çdo pranverë dhe përgatit mirësi të ndryshme për ta me qëllim që të hyjë gëzimi në zemrat e tyre për një apo për dy orë, sikur Ai u jep atyre ushqimin e mëngjesit, pastaj i merr ata për tek vendbanimet e tyre të përjetshme në tetë xhennete të amshuar të mbushura me mirësi të pakufishme për një kohë të pakufishme të cilën e ka përgatitur për robët e Tij.

Nuk ka dyshim se ai që beson në mëshirën e Këtij të Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti dhe është i qetë në të duke kuptuar lidhjen e tij me Krijuesin, padyshim se ai do të gjejë një pikë mbështetje të madhe saqë madje edhe në shkallën e saj më të vogël, ajo mbështet shpresa të pakufishme për të arritur përjetësinë, dhe i bën të vazhdojnë. Për më tepër, nëpërmjet realitetit të vërsetit, drita që buron

nga shkëlqimi i besimit u manifestua në një mënyrë të tillë të ndritshme saqë ajo i ndozi dhe i ndriçoi si dita të gjashta drejtimet.

Ajo ndriçoi gjendjen time të dëshpëruar e të vajtueshme për studentët e mi, për të dashurit e mi në medresenë time dhe në qytet të cilët kishin udhëtuar me këtë përkujtues: "Bota tek e cila kanë shkuar të dashurit e tu, nuk është e errët. Ata thjesht kanë shkuar në një vend tjetër; ti do t'i takosh përsëri ata. Kjo u dha fund lotëve të mi dhe më bëri të kuptoj se unë do të gjeja të tjerë të ngjashëm me ta në këtë botë të cilët do të merrnin vendin e tyre.

Po, lavdi Zotit, Ai e gjallëroi medresenë e vdekur të Vanit që ishte transformuar në rrënoja me sjelljen në jetë të medresesë së Ispartës dhe, Ai në kuptim i ngjalli ata të dashur të mi me më shumë studentë të çmueshëm dhe në numër më të madh këtu.

Gjithashtu Ai më mësoi se dynjaja nuk është e boshatisur dhe e pakuptim, dhe se ai nuk ishte një qytet i shkretë dhe i rrënuar ashtu siç e përfytyrova unë në atë mënyrë të gabuar, por se Pronari i vërtetë, ashtu siç e kërkon urtësia e Tij, i ndryshon tablotë dhe skenat artificiale të përkohshme të bëra nga njeriu me tablo të tjera dhe i ripërtërin mesazhet e Tij. Ashtu si, sa më shumë fruta të këputen nga pema, aq më shumë fruta të tjera rriten në vendet e tyre, po ashtu vdekja dhe ndarja në njerëzimin gjithashtu ripërtërihen e ndryshohen. Nga këndvështrimi i besimit, ato janë ripërtëritje të cilat nuk prodhojnë brengosje të dhimbshme e cila buron nga mungesa e të dashurve, por një brengë të ëmbël që buron nga ndarja me qëllim që të takohen përsëri në një vend tjetër më të mirë.

Vërsetet gjithashtu e ndriçuan faqen e qënieve në univers të cilat qenë dukur të errëta në situatën e tmerrshme të mëparshme. Unë desha të jap falënderime për këtë, dhe rreshtat vijues në arabisht m'u shfaqën, të cilat e përshkruan atë realitet në mënyrë të plotë. Unë thashë:

اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ عَلٰى نُوْرِ الْاِيْمَانِ لِلْمُصَوِّرِ مَا يُتَوَهَّمُ جَانِبَ اَعْدَآءً اَمْوَاتًا مُوَحِّشِيْنَ اَيْتَامًا

بَاكِيْنَ ؛ اَوِ دَآءَ اِخْوَانًا اَحْيَآءً مُوْنِسِيْنَ مُرَخَّصِيْنَ مَسْرُوْرِيْنَ ذَاكِرِيْنَ مُسَبِّحِيْنَ

"Lavdi Zotit për dritën e besimit, e cila e largon iluzionin e qënieve si të huaja, armiqësore, të vdekura e të egra, si jetimë vajtues, dhe i shfaq ato të jenë si vëllezër të dashur, të gjallë, familjarë, të gëzuar, të vënë në shërbim për përmbajtjen e Emrave të Zotit xh.sh. dhe për ta lavdëruar Atë."

Domethënë, për shkak të pakujdesisë që buron nga gjendja e dhimbshme shpirtërore, disa nga qëniet në univers u dukën për nefsin tim neglizhent si armiqësore e të huaja, të tjerat u dukën si kufoma të tmerrshme dhe disa të tjera si jetimë duke qarë në vetminë e tyre. Nëpërmjet dritës së besimit unë i pashë me siguri këto se janë që të gjithë shokë e vëllezër. Sa për kufomat e tmerrshme, disa ishin të gjalla e miqësore, ndërsa të tjerat ishin liruar nga detyrat e misionet e tyre. Dhe duke parë nëpërmjet dritës së besimit vajtimin e jetimëve të ishte një murmuritje e përmendjes dhe e lavdërimit të Zotit xh.sh., unë i dhashë lavdërime e falënderime të pafundme Allahut xh.sh., i Cili më dha besimin, burimin e këtyre mirësive të panumërta. Dhe duke parë se ishte e drejta ime të jepja falënderime për Allahun xh.sh. me të gjitha qëniet të cilat mbulonin botën time private, e cila është aq e gjërë sa gjithë dynjaja, dhe t'i bëja ato të marrin pjesë me mua në ato falënderime e lavdërime për Allahun, dhe nëpërmjet nijetit -qëllimit- t'i përdorja ato, dhe të themi bashkarisht me gjuhën e gjendjes së çdo individi prej individëve të qënieve dhe nëpërmjet gjuhës së gjendjes së të gjithëve gjithashtu: ***El- Hamdu Lil-lahi ala Nuril Iman,*** *lavdi Zotit për dritën e besimit".*

Për më tepër, kënaqësitë e jetës dhe ëndjet e saj të cilat ishin pakësuar e zhdukur menjëherë nga gjendja ime e pakujdesshme dhe e tmerrshme shpirtërore, dhe shpresat e mia të cilat ishin këputur e tharë përfundimisht, dhe ëndja e mirësitë e mia personale të cilat mbeten të kufizuara brenda limiteve më të ngushta dhe madje qenë të shkatërruara, papritmas nëpërmjet dritës së besimit, ato u transformuan dhe u ndryshuan; ashtu siç e kemi provuar në pjesë të tjera të Risale-i Nurit, ajo dritë e zgjeroi aq shumë atë sferë të ngushtë përreth zemrës sime, saqë e transformoi zemrën time në një sferë aq të gjërë saqë ajo përfshin të gjithë universin, dhe i bëri dynjanë dhe Ahiretin si dy tryeza të mbushura me mirësi dhe i transformoi ato në dy tryeza mbështetëse të mëshirës, në vend të atyre mirësive të cilat thahen dhe humbasin shijet e tyre në kopshtin e medresesë Horhor.

Dhe nuk u përkufizua vetëm tek kjo, por i bëri secilën prej syve, veshët, zemrën dhe si shembulli i këtyre shqisave dhe gjymtyrëve, madje njëqind gjymtyrë të njeriut, i bëri si një dorë e shtrirë sipas shkallëve të besimtarit që shtrihen për tek ato dy tryeza të mbushura me mirësi, ku të mund të marrë mirësi nga të gjitha anët e vendet; prandaj unë thashë fjalët vijuese edhe për të shprehur këtë të vërtetë të lartësuar, edhe si falënderime për ato mirësi të pafundme.

اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ عَلٰى نُوْرِ الْاِيْمَانِ الْمُصَوِّرِ لِلدَّارَيْنِ مَمْلُوَّتَيْنِ مِنَ النِّعْمَةِ وَالرَّحْمَةِ

لِكُلِّ مُؤْمِنٍ حَقًّا يَسْتَفِيْدُ مِنْهُمَا بِحَوَاسِّهِ الْكَثِيْرَةِ الْمُنْكَشِفَةِ بِاِذْنِ خَالِقِهِ

"Me sa të kem mundësi, me të gjitha grimcat e qënies sime, unë i jap falënderime e lavdërime Krijuesit tim për dritën dhe për mirësinë e besimit, sepse ajo më tregon mua se kjo dynja dhe Ahireti janë të mbushura me mirësi dhe me mëshirë, dhe më lejon mua dhe të gjithë besimtarët të përfitojmë nga ato dy tryeza të mëdha me duart e të gjitha shqisave të tyre, të cilat zhvillohen dhe hapen nëpërmjet dritës së besimit dhe islamit".

Meqenëse besimi është kaq shumë i dobishëm në këtë botë, sigurisht në botën e përjetshme ai do të ketë fruta dhe shkëlqime të tilla saqë ato as nuk mund të kapen me mend në botë, as nuk mund të përshkruhen.

Dhe kështu, o vëllezërit e mi të moshuar dhe o motrat e mia të moshuara dhe o ju që përjetoni ashtu si unë dhimbjet e ndarjes nga të dashur të shumtë për shkak të pleqërisë! Unë e imagjinoj veten time më të plakur se sa ju në kuptim edhe në qoftë se duket se midis jush ndodhet dikush që është më i madh se unë në moshë, sepse meqenëse nga natyra unë ndiej një keqardhje e një dhembshuri të tepruar për bijtë e llojit tim, unë kam përjetuar vuajtjet e mijëra vëllezërve të mi përveç dhimbjeve të mia personale, dhe prandaj unë ndjehem sikur kam jetuar qindra vite.

Ndërsa ju, sado që të keni vuajtur fatkeqësinë e ndarjes, nuk jeni zbuluar para asaj fatkeqësie aq shumë sa unë. Sepse unë nuk kam fëmijë që të mendoj për të.

Unë ndiej dhimbje e keqardhje përballë dëshpërimeve e brengave të mijëra bijve muslimanë dhe madje ndiej dhimbje edhe për kafshët e pafajshme, për shkak të kësaj keqardhjeje dhe dhembshurie të tepruar në natyrën time. Unë nuk kam një shtëpi timen që të mendoj vetëm për të. Përkundrazi, unë jam i lidhur nëpërmjet zellit islamik me këtë vend dhe madje edhe me botën islame, sikur ato të ishin shtëpia ime.

Prandaj unë pikëllohem shumë për dhimbjet e besimtarëve në ato dy shtëpi të mëdhaja dhe brengosem e lëndohem për ndarjen nga ata.

Kështu, drita e besimit ishte e mjaftueshme për mua dhe për të gjitha dëshpërimet që buronin nga pleqëria dhe nga dhimbjet e ndarjes; ai më dha mua një shpresë të pashuar, një besim të pakundërshtueshëm, një dritë të pashuar, një ngushëllim të pashtershëm. Atëherë besimi është më se i mjaftueshëm për ju përballë errësirës, pakujdesisë, brengave dhe dëshpërimeve të pleqërisë. Në realitet, pleqëria e cila është krejtësisht e errët, me mungesë drite e ngushëllimi dhe ndarja më e dhimbshme e më e tmerrshme, është pleqëria dhe ndarja e njerëzve të çudhëzimit dhe të shthurjes. Të përjetuarit e një besimi i cili jep një shpresë të tillë, dritë, ngushëllim dhe efektet e tij, është i mundshëm nëpërmjet zbatimit të një qëndrimi të vetëdijshëm adhurues, i denjë për pleqërinë dhe e përshtatshme për islamin. Nuk është i mundur nëpërmjet përpjekjes për të imituar të rinjtë, duke e zhytur kokën në pakujdesi dhe duke harruar pleqërinë.

Shqyrtojeni hadithin, kuptimi i të cilit është ky:

خَيْرُ شَبَابِكُمْ مَنْ تَشَبَّهَ بِكُهُولِكُمْ وَشَرُّ كُهُولِكُمْ مَنْ تَشَبَّهَ بِشَبَابِكُمْ.

"Të rinjtë më të mirë midis jush janë ata të cilët imitojnë ata që janë të matur, të vjetër, ndërsa të moshuarit më të këqinj janë ata që imitojnë të rinjtë". Domethënë, më të mirët e të rinjve tuaj janë ata që u ngjasojnë të moshuarve në vetëpërmbajtje dhe në largimin nga e keqja, ndërsa më të këqinjtë e të moshuarve janë ata që u ngjasojnë të rinjve duke i zhytur vetvetet në shthurje e pakujdesi.

Vëllezërit e mi dhe motrat e moshuara! Ndodhet një hadith i cili thotë:

"Mëshira Hyjnore do të turpërohej t'i linte pa përgjigje duatë e bëra për tek Divani Hyjnor nga besimtarët e moshuar gjashtëdhjetë apo shtatëdhjetëvjeçarë"..

Meqenëse mëshira Hyjnore ju mban ju në një respekt të tillë, edhe ju gjithashtu jini të respektuar ndaj këtij respekti duke kryer adhurimin tuaj.

■ SHPRESA E KATËRMBËDHJETË

Në fillim të Rrezes së katërt erdhi një komentim i vërsetit Kuranor,

"Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve",[27] dhe përmbledhja e të cilit është kjo:

Kur njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje më kishin zhveshur e privuar nga çdo gjë dhe unë rashë në pesë lloje mërgimesh. Për shkak të pakujdesisë që buroi nga dëshpërimi, unë nuk i pashë dritat ngushëlluese të Risale-i Nurit të cilat do të më kishin ndihmuar, por unë shikova drejtpërdrejtë zemrën time dhe kërkova shpirtin tim. Unë pashë se një dëshirë shumë e fortë për pavdekshmëri, një dashuri e zjarrtë për ekzistencë dhe një mallëngjim shumë i madh për jetë, së bashku me një pafuqi të pafundme dhe varfëri e nevojë të pafundme po sundonin mbi mua.

Mirëpo një përkohshmëri e tmerrshme po e shuante atë pavdekshmëri dhe po e zhdukte. Ndërkohë unë thashë ashtu siç tha poeti me zemër të djegur:

Ndërsa zemra deshi pavdekshmërinë e saj, realiteti deshi kalimin e trupit tim.

Unë u godita me një sëmundje të pakurueshme, të cilën as Lukmani nuk mundi ta shëronte.

Unë ula kokën time në dëshpërim. Papritmas vërseti,

حَسْبُنَا اللهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ *"Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve"* më erdhi në ndihmë duke më bërë

[27] Kuran 3:173

thirrje ta lexoja atë me vëmendje duke më thënë: "Më lexo mua me kujdes e me shqyrtim". Kështu unë e lexova atë pesëqind herë në çdo ditë. Sa më shumë e lexoja, nga dritat e tij të shumta nëntë nivele të kuptimeve të tij më shfaqeshin, jo vetëm në nivelin e 'sigurisë së shkallës së njohjes' por në atë të 'sigurisë së shkallës së të shikuarit'.

Niveli i parë i vërsetit dritëdhënës *"Allahu vetëm na mjafton neve".*

Për shkak të një hijeje në qënien time esenciale prej një manifestimi të një Emri prej Emrave të të Gjithëlavdishmit Hirplot Absolut i Cili zotëron plotësim absolut dhe qëndrueshmëri absolute dhe i Cili është i Dashur për vetveten, domethënë jo vetëm për ndonjë motiv apo arsye tjetër, unë kisha një dëshirë të fortë të bashkëlindur për pavdekshmëri, që nuk ishte drejtuar tek pavdekshmëria ime, po tek ekzistenca, plotësimi dhe tek pavdekshmëria e Atij të Ploti Absolut.

Mirëpo për shkak të pakujdesisë, ajo dëshirë e fortë e bashkëlindur e kishte humbur rrugën e saj, u bë e lidhur me hijen dhe dashuroi marrëzisht pavdekshmërinë e pasqyrës. Atëherë vërseti حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve"* e ngriti perden. Unë pashë, ndjeva dhe përjetova në shkallën e 'sigurisë absolute' se kënaqësia dhe lumturia e pavdekshmërisë sime qëndron ekzaktësisht dhe në një formë më të plotë në pavdekshmërinë e të Qëndrueshmit të Vetëm Zotëruesit të Plotësimit dhe në vërtetimin e Furnizuesit tim dhe Zotit tim, në të besuarin tek Ai dhe në nënshtrimin ndaj Tij.

Dëshmitë për këtë janë shpjeguar në Rrezen e Katërt, në trajtesën mbi vërsetin, *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve"* në dymbëdhjetë pjesë, të cilat janë shumë të thella dhe të holla dhe do t'i mbushin me habi ata që kanë ndjeshmëri të holla.

Niveli i dytë i vërsetit dritëdhënës *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".*

Në kohën kur në pleqërinë time, në mërgimin, në vetminë dhe në izolimin, njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje po më sulmonin me spiunat e tyre dhe me dredhitë pavarësisht pafuqisë së pakufishme në

natyrën time, pikërisht në këtë kohë, unë i thashë zemrës sime: "të gjitha ushtritë po sulmojnë një burrë të vetëm duart e të cilit janë të lidhura dhe është i sëmurë dhe i dobët. A nuk ka ai, domethënë unë, ndonjë pikë mbështetje, a nuk ka ai diçka prej së cilës të kërkojë ndihmë? Unë përdora vërsetin حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ *"Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve"*. Dhe vërseti më njofoi çka vijon:

Nëpërmjet dokumentit të besimit, ti bëhesh i lidhur me një Sundimtar të një fuqie absolute i Cili në çdo pranverë pajis me pajime me rregull të plotë të gjitha ushtritë e bimëve e të kafshëve të shpërndara në faqen e tokës. I pajis të gjitha ato ushtri të përbëra nga katërqind mijë lloje të kombeve të ndryshme. Dhe ua shpërndan të gjitha furnizimet ushtrisë madhështore të gjallesave, me në krye njeriun, jo në mënyrën që e ka zbuluar njeriu në kohët e fundit prej ekstrakteve të mishit, të sheqerit e të tjera, por në një formë njëqind herë më të plotë e të mirë ekstraktesh. Ato janë ekstrakte që përmbajnë të gjitha llojet e ushqimeve, madje ato janë ekstrakte të të Gjithëmëshirshmit.. ato që quhen farëra e bërthama..

Përveç kësaj, Ai gjithashtu i mbështjell ato ekstrakte me mbulesa të paracaktuara që përshtaten me përpjekjen e tyre, me shtrirjen e tyre dhe me zhvillimin, dhe i vendos ato e i ruan në kutiat e tyre të vockëla mbrojtëse. Këto sunduqe -kutia- gjithashtu prodhohen me një shpejtësi shumë të madhe dhe me një lehtësi absolute dhe me një bollëk të madh në Fabrikën كَافْ*نُونْ *Kaf-nun*, e cila sundohet nga urdhëri i كُنْ *"Kun fejekun", "Bëhu! Dhe ajo bëhet në çast"*, saqë Kurani i gjithurtë thotë:

"Krijuesi vetëm urdhëron dhe ajo gjë vjen menjëherë në ekzistencë".

Atëherë duke pasur një pikë të tillë mbështetjeje si kjo nëpërmjet dokumentit të lidhjes së besimit, ti mund të mbështetesh tek një forcë e madhe dhe tek një fuqi absolute. Në të vërtetë, unë ndjeja një forcë të madhe shpirtërore sa herë që e merrja atë mësim prej atij vërseti Kuranor dhe ndjeja se unë kisha një fuqi me të cilën mund t'i sfidoja të gjithë armiqtë e mi në botë dhe jo vetëm armiqtë e mi të tanishëm para meje. Prandaj unë përsërisja nga thellësitë e shpirtit tim vërsetin,

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ *"Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve".*

Niveli i tretë i vërsetit dritëdhënës *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".*

Në kohën kur, duke gjetur se lidhjet e mia me dynjanë po këputeshin për shkak të vuajtjes dhe shtypjes së atyre mërgimeve dhe sëmundjeve, besimi më udhëzoi e më kujtoi se unë isha i caktuar për lumturi të përjetshme në një botë të amshuar, në një mbretëri të përhershme, unë i braktisa ofshamat me rënkim e keqardhje dhe e ndryshova këtë me atë që sihariqonte mirësi e gëzim dhe më bënte të isha në dhënie të vazhdueshme lavdërimesh.

Mirëpo ky qëllim i imagjinatës dhe i shpirtit dhe si rezultat i natyrës së njeriut mund të realizoheshin vetëm nëpërmjet fuqisë së të Gjithëfuqishmit Absolut i Cili i njeh dhe i regjistron të gjitha lëvizjet dhe pushimin e krijesave të Tij, qëndrimet dhe gjendjet e tyre në fjalë e në vepra, dhe i Cili merr si mikun e Tij dhe si të adresuarin e Tij njeriun e vogël, të papërfillshëm dhe absolutisht të pafuqishëm duke i dhënë atij një pozitë shumë të lartë e të nderuar midis krijesave të tij. Kjo do të mund të realizohej veçse nëpërmjet mirësive të Tij të pakufishme ndaj njeriut dhe rëndësisë që Ai i jep atij. Ndërsa po mendoja për këto dy pika, domethënë për aktivitetin e një fuqie të tillë të pakufishme dhe për rëndësinë reale që i dha Krijuesi i Gjithëlavdishëm këtij njeriu i cili duket i papërfillshëm e i vogël, unë dëshiroja një shpjegim për këto dy pika i cili do të thellonte besimin dhe do të kënaqte zemrën. Përsëri unë përdora atë vërset dhe ai më tha: vëreje përemrin نَا *'Na'* i cili është tek حَسْبُنَا *'Hasbuna', "Allahu vetëm na mjafton"* dhe shikoji ata që thonë حَسْبُنَا *'Hasbuna'* së bashku me ty, sido që ta shprehin, me gjuhën e gjendjes apo me gjuhën e fjalës; kushtoju vëmendje atyre.. Po kështu më urdhëroi vërseti! Ndërkohë unë hodha vështrimin dhe pashë zogj të panumërt dhe miza të pallogaritshme, të cilat janë si zogj të zvogëluar, dhe kafshë të panumërta dhe bimë të pafundme dhe pemë të pafund po recitonin, ashtu si unë, nëpërmjet gjuhës së gjendjes së tyre të natyrshme.

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".*

Ato i kujtojnë gjithkujt paanësinë dhe madhësinë e kësaj fuqie absolute e cila përpara syve tonë dhe veçanërisht në pranverë krijon me bollëkun më të madh, me lehtësinë më të madhe dhe në shkallën më të gjërë, nga vezët, farërat, dhe nga pikëlat e lëngut, të cilat që të gjitha i ngjasojnë njëri-tjetrit dhe substanca e të cilave është e njëjta, qindrat e mijërat e specieve të zogjve, qindrat e mijërat e llojeve të bimëve dhe qindrat e mijërat e llojeve të pemëve pa gabim, pa mangësi e pa ngatërresë, në mënyrë të zbukuruar, të drejtëpeshuar e të mirësistemuar, dhe në forma të gjitha të ndryshme nga njëra-tjetra. Duke u bërë në këtë mënyrë së bashku, njëra brenda tjetrës duke i ngjasuar njëra-tjetrës dhe në të njëjtën mënyrë, ato na demonstrojnë Unitetin e Tij dhe Njësinë. Unë kuptova se çdo ndërhyrje apo pjesëmarrje në aktin Hyjnor krijues i cili shfaq kështu mrekulli të pallogaritshme ishte e pamundur. Ata që dëshirojnë ta kuptojnë identitetin tim personal dhe karakterin tim human, i cili është si ai i të gjithë besimtarëve, dhe ata që dëshirojnë të jenë si unë, duhet ta shikojnë shpjegimin e '*Unit*' në vetën e parë shumës نَا '*Na'*, '*neve'* në vërsetin حَسْبُنَا '*Hasbuna'*, '*Allahu vetëm na mjafton neve'*, domethënë shpjegimin e vetes sime dhe të reflektojnë se vendi i saj është në atë shumës. Dhe të kuptojnë se ç'është ekzistenca ime dhe trupi im i cili duket si i vogël, i varfër e i parëndësishëm, ashtu si trupi i çdo besimtari?! Le të dinë, ç'është vetë jeta? Madje çfarë është humanizmi? Ç'është islami? Ç'është besimi i vërtetë, i sigurtë? Ç'është njohja e Zotit? Si arrihet dashuria e Zotit xh.sh... le ta kuptojnë... le të marrin mësim në të!

Niveli i katërt i vërsetit dritëdhënës *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".*

Njëherë kur ngjarjet si pleqëria, mërgimi, sëmundja dhe qënia ime i mposhtur po lëkundnin qënien time koinçiduan me një periudhë të pakujdesisë sime, sikur qënia ime me të cilën isha e lidhur fort po shkonte në mosekzistencë, madje ekzistenca e të gjitha krijesave po asgjësohej e po përfundonte në zhdukje, largimi i të gjithë atyre për në mosekzistencë shkaktoi tek unë një shqetësim të madh dhe një tronditje

të dhimbshme; unë përsëri përdora vërsetin *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve"*. Vërseti më tha: Vëreji me kujdes kuptimet e mia dhe shikoji ato nëpërmjet teleskopit të besimit.

Kështu unë i shikova kuptimet e tij me syrin e besimit dhe pashë se ashtu si të gjithë besimtarët, qënia ime shumë e vogël si një grimcë, ishte pasqyra për një Qënie të pakufishme, dhe nëpërmjet një shtrirje të pafundme, mjeti për të fituar ekzistenca të panumërta, dhe një fjalë urtësie duke prodhuar frutat e ekzistencave të shumta të qëndrueshme shumë më të çmueshme se sa qënia ime.

Unë mësova me 'sigurinë e shkallës së njohjes' se në këtë lidhje besimi, të jetoje për një çast ishte aq e vlefshme sa vlera e një ekzistence të përjetshme, sepse nëpërmjet vetëdijes së besimit unë kuptova se kjo qënia ime ishte vepra e artit, artifakti dhe manifestimi i Krijuesit të Vetëm të domosdoshëm. Kështu duke pas shpëtuar nga shqetësimi i vetmisë dhe nga ndarje të panumërta dhe nga dhimbjet e tyre, unë formova lidhje dhe hallka vëllazërie me qëniet aq sa numri i akteve dhe i Emrave Hyjnorë të lidhur me qëniet, sidomos me qëniet e gjalla, dhe unë njoha se ishte një lidhje e përhershme me të gjitha qëniet që i doja nëpërmjet një ndarjeje të përkohshme.

Dhe kështu nëpërmjet besimit dhe lidhjeve të besimit, ashtu si të gjitha qëniet, qënia ime fitoi dritat e ekzistencave të panumërta të paprekura nga ndarja. Madje edhe sikur të ikte qënia ime, qëndrueshmëria e atyre llojeve të ekzistencës pas saj, e qetëson ekzistencën time edhe sikur ajo të qëndronte vetë e plotë.

Shkurtazi: vdekja nuk është ndarje, por është bashkim; është një ndryshim banese; është prodhimi i një fruti të përjetshëm...

Niveli i pestë i vërsetit dritëdhënës حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".*

Njëherë kur jeta ime po tronditej nga rrethana shumë të vështira, vëmendja ime u drejtua drejt jetës. Unë pashë se jeta ime po largohej me shpejtësi; Ahireti po afrohej gjithnjë e më shumë; për shkak të shtypjes që vuaja jeta ime kishte filluar të shuhej. Por detyrat e rëndësishme të jetës, veçoritë e saja të larta dhe dobitë e saja të

çmueshme nuk përshtateshin me këtë shuarje të shpejtë, përkundrazi, ato përshtateshin me një jetë të gjatë e të vazhdueshme.

Ashtu siç është shpjeguar në pjesën e Risale-i Nurit rreth Emrit *I Gjalli i përjetshëm,* ndërkohë mendova për këtë me të gjithë dhimbjen dhe dëshpërimin. Atëherë përdora profesorin tim, vërsetin, *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve"*, dhe ai më tha: "Shikoje jetën nga këndvështrimi i ***El-Hajju El Kajjum,*** *i Gjalli i Përjetshëm* dhe tek *Vetekzistuesi i Përhershëm* i Cili të jep ty jetë.

Kështu, unë e hodha vështrimin dhe pashë se aspektet e jetës sime që shikonin tek unë ishin një, ndërsa ato që i shikonin tek ***El-Hajju El Kajjum,*** *i Gjalli i Përjetshëm* dhe tek *Vetekzistuesi i Përhershëm* ishin njëqind. Dhe në qoftë se, nga rezultatet e saj, njëri shikon tek unë, një mijë rezultate shikojnë tek Krijuesi im. Atëherë meqenëse është kështu, të jetosh për një çast brenda limiteve të kënaqësisë Hyjnore është e mjaftueshme; prandaj nuk ka nevojë për një kohë të gjatë. Kjo e vërtetë mund të shpjegohet në katër çështje. Ata që nuk janë të vdekur ose që dëshirojnë të jenë të gjallë duhet të kërkojnë natyrën dhe realitetin e jetës dhe të drejtat e tyre të vërteta në ato katër çështje; ata do t'i gjejnë ato dhe do të vijnë në jetë!

Një përmbledhje e saj është kjo:

Sa më shumë të shikojë jeta tek '*i Gjalli i Përjetshëm* dhe tek *Vetekzistuesi i Përhershëm,* dhe sa më shumë të bëhet besimi jeta dhe shpirti i jetës, aq më shumë ajo bëhet e përhershme dhe do të prodhojë fruta të qëndrueshëm. Gjithashtu ajo bëhet aq e lartësuar saqë ajo merr manifestimin e përjetësisë; dhe ajo nuk shikon më tek jetëshkurtësia apo jetëgjatësia.

Niveli i gjashtë i vërsetit dritëdhënës *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".*

Në kohën kur nëpërmjet pleqërisë e cila më paralajmëronte për ndarjen time të veçantë dhe nëpërmjet ngjarjeve të kohës së fundit të cilat njoftojnë për shkatërrimin e dynjasë brenda ndarjeve të përgjithshme të gjithanshme dhe nëpërmjet zbulimit të gjërë të jashtëzakonshëm në fundin e jetës sime, të ndjenjave në natyrën time për dashurinë e së bukurës dhe pasionin për hijeshinë e për joshjen pas

plotësimit, nëpërmjet të gjitha këtyre, unë pashë me një qartësi të jashtëzakonshme dhe me dëshpërim se zhdukja e përkohshmëria të cilat janë gjithmonë shkatërruese, dhe vdekja e mosekzistenca të cilat shkaktojnë ndarje vazhdimisht që po e prishnin në mënyrë të tmerrshme këtë dynja të bukur dhe këto krijesa të bukura dhe duke e shkatërruar bukurinë e tyre; dashuria metaforike në natyrën time po ziente e rebelohej kundra kësaj situate. Me qëllim që të gjej ngushëllim, unë përsëri përdora vërsetin *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve"*. Ai më tha: "Më lexo mirë, shikoji kuptimet e mia me kujdes!"

Kështu unë hyra në observatorin e vërsetit në suren *el-Nur*, اَللّٰهُ نُوْرُ السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضِ *"Allahu është drita e qiejve dhe e tokës (*deri në fund të vërsetit*),"*[28] dhe shikova nëpërmjet teleskopit të besimit nivelet më të largëta të vërsetit *All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve"*..

Pastaj nëpërmjet mikroskopit të vetëdijes së besimit pashë misteret e tij më të holla, siç vijon:

Pasqyrat, copat e qelqit, gjërat e tejdukshme dhe madje edhe flluskat e detit tregojnë bukuritë e ndryshme të fshehura të dritës së diellit dhe të shtatë ngjyrave në dritën e tij; dhe nëpërmjet zhdukjes dhe ripërtëritjeve të tyre dhe të aftësive të ndryshme dhe përthyerjeve, ato ripërtërijnë bukurinë; dhe nëpërmjet reflektimeve të tyre, ato shfaqin bukuritë e fshehura dhe hijeshinë e diellit dhe të dritës së tij.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, me qëllim që të veprojnë si pasqyra për bukurinë e shenjtë të Hirplotit të Gjithëlavdishëm i Cili është Dielli i Parapërjetshëm dhe i paspërjetshëm, dhe për hijeshinë e Emrave të Tij më të bukur, dhe për të ripërtërirë manifestimet e tyre, këto krijesa të bukura, këto artifakte të këndshme, këto qënie të shkëlqyera vijnë e shkojnë pa ndalim. Të shpjeguara në Risale-i Nur janë prova të fuqishme duke demonstruar se bukuritë e shfaqura mbi ato krijesa nuk janë veçoritë e tyre, por shenjat, treguesit, shkreptimat dhe manifestimet e asaj bukurie të shenjtë, të lartësuar e të amshuar e cila dëshiron të bëhet e dukshme dhe që do të shikohet e të dëshmohet.

[28] Kuran 24:35

Treguesit e kësaj janë shpjeguar në mënyrë të detajuar në Risale-i Nur, sidomos në atë trajtesë e cila fillon me: "Këtu do të përmendim tre argumente në mënyrë shumë të përmbledhur e të arsyeshme".

Cilido njeri që e shikon këtë trajtesë nga njerëzit e perceptimit të hollë nuk mund të mbetet pa habi, pa çudi e vlerësim, madje përveç përfitimit të vetë personave të tyre prej saj, ata e shohin të domosdoshme të përpiqen që t'i bëjnë edhe të tjerët për të fituar prej saj, sidomos pesë pikat e përmendura në provën e dytë. Ai që mendja e të cilit nuk është dëmtuar dhe që nuk e ka zemrën të prishur, do ta vlerësonte, do ta admironte dhe do ta miratonte duke thënë: *Mashallah... Barakallah*.. dhe do ta perceptonte e vërtetonte se ajo është një mrekulli vërtet e jashtëzakonshme e cila do t'i lartësojë qëniet e tyre të ulëta e të varfëra në dukje.

■ SHPRESA E PESËMBËDHJETË[29]

Një herë kur isha në banesën e detyrueshme në Emirdag[30] duke qenë i vetmuar dhe i izoluar, unë u mërzita nga jeta për shkak të torturave e mundimeve që ata më dhanë me mbikëqyrjen e tyre dhe me trajtimin e tyre arbitrar, të cilin e gjeta shumë të vështirë për t'u duruar dhe u dëshpërova që isha liruar nga burgu. Madje unë dëshirova me të gjithë zemrën time që të kthehesha në Burgun e Denizlit ose të hyja në varr pasi burgu apo varri ishin më të preferueshme se sa të jetoje kështu në këtë mënyrë. Ndërsa po mendoja kështu, përkujdesja Hyjnore më erdhi në ndihmë: Ajo u dhuroi studentëve të *El medresetu Ez-Zehra*[31],

[29] Kjo shpresa e pesëmbëdhjetë u shkrua nga një student i Risale-i Nurit për të plotësuar në të ardhmen "*trajtesën për të moshuarit*", dhe që të ishte si një burim për hartimin e saj, meqenëse periudha e shkrimit të Risale-i Nurit kishte përfunduar para tre vitesh. Autori

[30] Një qytet i vogël në Anadollin qëndror, ku Bediuzzamani u internua në 1944, duke ndjekur lirimin e tij nga burgu i Denizlit. Ai qëndroi në banesën e detyrueshme këtu gjer në 1951... Përkthyesi.

[31] Emri i universitetit për të cilin Bediuzzaman u përpoq gjatë gjithë jetës së tij për ta ndërtuar në Anadollin lindor në të cilin do të jepeshin mësim edhe shkencat fetare edhe ato moderne njëherësh. Megjithëse ai mori fonde nga sulltan Reshati dhe i vuri themelet në brigjet e liqenit të Vanit në 1911, ai nuk u përfundua për shkak të shpërthimit të luftës së parë botërore. Me përhapjen e Risale-i Nurit në dekadat e para të republikës, medresetë e Risale-i Nurit ose vendet ku studiohej Risale-i Nuri ose kopjet e të cilit shkruheshin, u hapën gjithandej Turqisë. Atëherë Bediuzzamani i quajti studentët e Risale-i Nurit, 'Studentët e medresetu Ez-Zehra'.

penat e të cilëve ishin si ciklostilë -makina shumëfishimi, një nga makinat shumëfishuese e cila sapo ishte shfaqur.

Menjëherë, pesëqind kopje prej secilit nga koleksionet e vlefshme të Risale-i Nurit u shfaqën nëpërmjet një pene të vetme. Këto shenja që flisnin për fitore të reja në të ardhmen më bënë mua ta doja atë jetë dëshpëruese e shqetësuese, madje më bënë të jap një mijë e një falënderime për Krijuesin xh.sh..

Pasi kaloi një periudhë e shkurtër kohe armiqtë e fshehur të Risale-i Nurit, meqë nuk qenë në gjendje të durojnë fitoret e Risale-i Nurit, nxitën qeverinë që të veprojë kundra nesh. Përsëri jeta filloi të bëhej e vështirë për mua. Pastaj papritmas u shfaq mirësia e përkujdesja Hyjnore: zyrtarët e lidhur me çështjen, të cilët ishin më të nevojshmit për Risale-i Nurin, i studiuan kopjet e konfiskuara të tij, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me shumë kureshtje e me kujdes, dhe trajtesat e tij i bënë zemrat e tyre nëpërmjet mirësisë së Krijuesit të anonin e të prireshin drejt tij. Kështu u zgjerua sfera e shkollave të Risale-i Nurit, meqë ata filluan ta vlerësojnë e ta admirojnë në vend që ta kritikojnë apo ta plagosin.

Ky rezultat na solli përfitime njëqind herë më të mëdhaja se sa humbjet tona materiale, duke e pakësuar dhe duke e larguar krejtësisht mërzitjen dhe dëshpërimin tonë.

Pastaj, sapo kaloi një periudhë e shkurtër, hipokritët, të cilët janë armiqtë e fshehur, drejtuan vëmendjen e qeverisë ndaj personit tim. Ata u sollën ndërmend atyre aktivitetet e mia të mëparshme politike. Ata shkaktuan iluzione dhe ngjallën dyshime rreth meje në radhët e dikastereve të drejtësisë, të edukimit, të rendit dhe në ministrinë e brendshme. Për shkak të partive të ndryshme dhe të nxitjes së anarkistëve të fshehur komunistë, ato dyshime u përhapën më shumë. Ata filluan të bëjnë presion mbi ne, na arrestuan dhe konfiskuan pjesët e Risale-i Nurit që ranë në duart e tyre. Aktivitetet e studentëve të Risale-i Nurit u ndërprenë. Një numër zyrtarësh bënë akuza të rreme të cilat absolutisht asnjë nuk mund t'i besonte. Ata u përpoqën të bënin shpifje të jashtëzakonshme, por nuk mundën ta bënin asnjë që t'i besonte ato.

Pastaj ata më arrestuan gjatë ditëve shumë të ftohta të dimrit me disa pretekste bajate dhe më futën në një qeli të mbyllur në burg në një

sallë të madhe, tej mase të ftohtë, i vetmuar, duke më lënë dy ditë pa sobë. Duke pasë qenë mësuar ta ndizja sobën time disa herë në ditë në dhomën time të vogël, dhe duke pasur gjithmonë në mangall thëngjill -prush- të ndezur për shkak se isha i sëmurë e i dobët, dhe qeshë në gjendje ta përballoja atë me shumë vështirësi. Ndërsa duke u përpjekur e luftuar në këtë gjendje duke vuajtur edhe nga ethet e shkaktuara nga i ftohti, nga dëshpërimi i tmerrshëm dhe nga zemërimi, nëpërmjet mirësisë Hyjnore një e vërtetë u shfaq në zemrën time. Ajo shfaqi paralajmërimin e mëposhtëm për shpirtin tim.

"Ti e quajte burgun: '*Medrese Jusufie, shkolla e profetit Jusuf*'. Ty të dha burgu i Denizlit rezultate e dobi një mijë herë më të mëdhaja se sa një dëshpërim të fortë. Dhe ju dha kënaqësi të fortë, gëzim të madh dhe përfitime të shumta shpirtërore. Edhe të burgosurit përfituan me ty nëpërmjet Risale-i Nurit, madje edhe në qarqet më të larta zyrtare, saqë kjo të bëri ty të jepje falënderime të vazhdueshme në vend të ankimeve duke i transformuar çdo orë nga orët e burgut e të ngushticës në vlerën e dhjetë orëve ibadeti, dhe i bëri ato orë të kaluara të përjetshme.

Edhe kjo shkollë e tretë Jusufie[32], gjithashtu, do të japë, me leje të Zotit një nxehtësi -ngrohtësi- të mjaftueshme që ta ngrohë këtë të ftohtë të ashpër dhe do të japë gëzim e kënaqësi çka do ta largojnë këtë ngushticë e dëshpërim të rëndë nëpërmjet përfitimit të atyre -të cilët janë goditur nga fatkeqësia- prej Risale-i Nurit dhe duke gjetur ngushëllim në të. Në qoftë se ata me të cilët ti je zemëruar janë të mashtruar dhe të keqtrajtojnë pa e kuptuar, ata nuk meritojnë urrejtje e zemërim, sepse të bëjnë padrejtësi pa qëllim, pa dijeni e pavetëdije..

Ndërsa në qoftë se ata të mundojnë e të bëjnë të vuash me vetëdije, me dijeni, prej inati dhe për llogari të çudhëzimit, ata në një kohë shumë të shkurtër do të ndëshkohen me vdekjen të cilën ata e përfytyrojnë si një ekzekutim me vdekje të përjetshme, dhe do ta shikojnë ngushtësinë e fortë të vazhdueshme që ngrihet në burgun e vetmuar fillikat i cili është varri. Për shkak të shtypjes së tyre, ti fiton shpërblim të madh, merita dhe kënaqësi shpirtërore dhe i bën orët e përkohshme, të përjetshme dhe gjithashtu po e kryen misionin tënd shkencor e fetar me sinqeritet".

[32] Domethënë, Burgu i Afjonit. Përkthyesi.

Kështu pra erdhi ky kuptim në shpirtin tim dhe unë thashë me të gjithë fuqinë: *Lavdi Zotit, falënderimi i takon Allahut*. Nga humanizmi im më erdhi keq për ata tiranë dhe u luta: "O Krijuesi im! reformoji ata dhe rregulloji!" Ashtu siç shkrova në deklaratën time për ministrinë e punëve të brendshme: në këtë incident të ri ata të cilët në realitet janë fajtorë janë tiranët të cilët, në dhjetë drejtime, veprojnë në mënyrë të paligjshme në emrin e ligjit. Ata gjetën pretekstet më të jashtëzakonshme dhe ndoqën shpifje të ndryshme deri në atë shkallë që do t'i bënin ata që i dëgjojnë të qeshnin e t'i bënin dashuruesit e së vërtetës të qanin, dhe shfaqën për njerëzit e drejtë, të paanshëm, se ata nuk gjejnë në emër të ligjit e të së vërtetës asnjë justifikim për të sulmuar Risale-i Nurin dhe studentët e tij, dhe kështu ata ranë në marrëzi, në përçartje e çmenduri. Për shembull, zyrtarët që na spiunuan për një muaj nuk mundën të gjenin asgjë për të na akuzuar, kështu ata shkruan një memorandum duke thënë: "Një shërbyes i Saidit bleu raki dhe ia çoi atë atij". Ata nuk gjetën asnjë që ta nënshkruante këtë raportim si miratim, dhe më në fund arrestuan një të huaj të dehur dhe e detyruan atë të nënshkrojë nën kërcënim; ai person refuzoi duke thënë: "Zot na fal! Kush do ta nënshkruante këtë gënjeshtër të jashtëzakonshme?" Kështu që ata u detyruan ta grisnin atë raportim.

Shembulli i dytë: Një person të cilin nuk e njihja dhe akoma nuk e njoh, më dha kalin e tij me qëllim që unë të bëja shëtitje. Në verë unë dilja për shëtitje në shumicën e ditëve për dy orë për shkak të sëmundjes sime dhe me qëllim që të merrja ajër të pastër. Unë i kisha dhënë fjalën se do t'i jepja pronarit të kalit e të pajtonit libra me vlerën e pesëdhjetë librave, me qëllim që të mos e thyeja rregullin tim edhe të mos i mbetesha borxh atij. A ka ndonjë mundësi për të ardhur ndonjë dëm nga një gjë e tillë?

Mirëpo atëherë, edhe guvernatori, drejtoria e policisë dhe digasteri i drejtësisë dhe i rendit pyetën më shumë se pesëdhjetë herë: i kujt është ky kalë dhe i kujt është ky pajton? Sikur të kishte ndodhur një ngjarje e rëndë politike që do të prishte rendin e qetësinë publike! Me qëllim që t'i jepej fund kësaj çështjeje të pakuptim, u detyrua një person në mënyrë vullnetare dhe madje tha besnikërisht se kali ishte i tij dhe një tjetër tha se pajtoni ishte i tij, dhe të dy ata u arrestuan së bashku me mua. Ne shikuam çapkënëri të shumta foshnjarake si këto dy shembuj dhe qeshnim derisa qanim. Dhe kuptuam se ata që sulmonin Risale-i Nurin dhe studentët e tij tregoheshin budallenj.

Një incident zbavitës -qesharak- prej atyre shembujve: Arsyeja e shkruar në letër që autorizonte arrestimin tim ishte "prishja e rendit publik". Duke mos e pasë parë dokumentin, unë i thashë palës akuzuese, prokurorit:

Unë të kam përgojuar ty mbrëmë, sepse i thashë njërit prej punonjësve të policisë i cili po më pyeste mua në vend të drejtorit të policisë: "Në qoftë se unë nuk i kam shërbyer sigurisë së rendit publik të këtij vendi më shumë se një mijë drejtora rendi dhe më shumë se një mijë prokurorë shteti, Allahu më shkatërroftë! Thashë tri herë.

Pastaj në kohën që isha në nevojën më të madhe për të pushuar, që të mos shqetësohesha me çështjet e dynjasë dhe të largohesha përfundimisht nga i ftohti, unë u mposhta nga zemërimi dhe nga mërzia ndaj atyre që më kishin dërguar në këtë mërgim të padurueshëm, në këtë izolim, burgosje e shtypje në një mërgim që shkruan e zbrazën urrejtjen dhe qëllimet e këqija.

Por mirësia dhe kujdesi Hyjnor më erdhën në ndihmë dhe në zemrën time u shfaq kuptimi që vijon:

"Kaderi Hyjnor, i cili është thjesht drejtësi e pastër, ka një pjesë shumë të madhe në shtypjen e padrejtë që po bëjnë mbi ty këta njerëz. Dhe rizku -ushqimi yt- në këtë burg të ka ftuar ty për në burg; atëherë ty të duhet ta takosh këtë pjesë me kënaqësi e nënshtrim. Edhe Urtësia Hyjnore dhe mëshira e saj kanë një pjesë të madhe, e cila është për t'i ndriçuar ata në këtë burg dhe për t'i ngushëlluar, dhe ti të fitosh thevab e shpërblim. Kjo pjesë duhet të takohet me falënderime të pafundme dhe me durim. Edhe nefsi yt ka një pjesë në të, për shkak të gabimeve dhe mangësive të tij të cilat ti nuk i njeh. Përballë kësaj pjese, ti duhet t'i thuash nefsit tënd se ai e meritonte këtë goditje, nëpërmjet pendesës dhe duke kërkuar falje.

Dhe disa nga armiqtë e tu të fshehur kanë një pjesë në të, me intrigat e tyre duke mashtruar disa zyrtarë naivë e frikacakë e duke i shtyrë ata për të kryer një padrejtësi të tillë. Përballë kësaj pjese, goditjet e tmerrshme jolëndore të dhëna nga Risale-i Nuri mbi ata hipokritë e kanë marrë hakun tuaj krejtësisht ndaj tyre. Këto goditje janë të mjaftueshme për ata.

Pjesa e fundit janë ata zyrtarë të cilët janë mjete reale, aktualë. Përballë kësaj pjese, për hir të përfitimit të tyre prej Risale-i Nurit lidhur me besimin, donin apo nuk donin, të cilin ata e shikuan me qëllim për ta kritikuar e plagosur, t'i falësh ata në përputhje me parimin:

وَالْكَاظِمِينَ الْغَيْظَ وَالْعَافِينَ عَنِ النَّاسِ *"...Ata të cilët përmbajnë zemërimin dhe ata që i falin njerëzit, vërtet Allahu i do shumë ata që bëjnë mirë"*[33] është një akt shpirtëmadhësie e zemërgjërësie.

Për shkak të lumturisë dhe ndjenjës së falënderimeve që përjetova si rrjedhojë i këtij paralajmërimi të vërtetë, unë vendosa që të mbetem i duruar dhe mirënjohës i gëzuar në këtë shkollë të re *Jusufie*, madje vendosa që t'i ndihmoj e t'i përkrah edhe ata të cilët më bëjnë keq e që më kundërshtojnë duke e disiplinuar nefsin tim.

Pastaj dikush si unë që është shtatëdhjetë e pesë vjeç, lidhjet e të cilit janë këputur me dynjanë, që nuk ka mbetur gjallë nga të dashurit e tij veçse pesë nga shtatëdhjetë veta, varri ishte njëqind herë më i preferueshëm për të se sa ky burg, sepse shtatëdhjetë mijë kopje të trajtesave të Risale-i Nurit ishin në qarkullim të lirë dhe do t'i kryenin detyrat e mia që lidhen me Risale-i Nurin, dhe unë kisha vëllezër e trashëgimtarë të cilët do të vazhdonin t'i shërbenin besimit me mijëra gjuhë në vend të një gjuhe të vetme timen. Ky burg gjithashtu ishte njëqind herë më i rehatshëm dhe më i dobishëm se sa liria e lidhur -e palirë- jashtë dhe e zbuluar para tiranisë dhe shtypjes, sepse njeriu duron i detyruar së bashku me qindra të burgosur të tjerë një trajtim arbitrar prej disa zyrtarëve, si drejtori i burgut dhe shefi i rojeve duke marrë parasysh detyrat e tyre, dhe gjen ngushëllim e respekt vëllazëror prej shokëve të shumtë përreth tij, ndërsa jashtë ai duhet të vuajë i vetëm trajtimin arbitrar të qindra zyrtarëve.

Gjithashtu dhembshuria islame dhe natyra njerëzore tregojnë mëshirë për të moshuarit dhe sidomos për ata që janë në këtë gjendje; ato të dyja i transformojnë vështirësitë dhe mundimet e burgut në mëshirë.. për hir të kësaj, unë u bëra i kënaqur me burgun.

[33] Kuran 3:134

Kur u solla për të marrë pjesë në këtë gjyq të tretë, unë u ula në një karrige jashtë derës së gjykatës, për shkak të vështirësisë sime për të qëndruar në këmbë për shkak të dobësisë sime, pleqërisë dhe sëmundjes. Papritmas u shfaq gjykatësi dhe me zemërim tha në një mënyrë fyese: "Përse ky nuk pret në këmbë?" Unë u zemërova në thellësitë e mia për shkak të mungesës së dhembshurisë ndaj pleqërisë.

Ndërkohë unë sodita përreth dhe pashë se një numër i madh muslimanësh ishin grumbulluar rreth nesh dhe po na shikonin në mënyrën më të përzemërt e vëllazërore, saqë nuk mundi askush që t'i largonte ata nga ky tubim. Papritmas më erdhën në zemër këto dy të vërteta:

E para: Armiqtë e mi dhe armiqtë e fshehur të Risale-i Nurit kishin mashtruar disa zyrtarë naivë me qëllim që të ndalonin pushtimet dhe fitoret e Risale-i Nurit duke shkatërruar opinionin e mirë publik për mua, gjë të cilën unë nuk e kam dashur, dhe për të shkatërruar karakterin tim në shikimin e njerëzve; ata i kishin nxitur ata zyrtarë për t'u sjellur në atë mënyrë me përbuzje e përçmim ndaj meje.

Kështu përballë asaj fyerje që buroi nga një burrë i vetëm, përkujdesja Hyjnore e drejtoi shikimin tim drejt këtyre njëqind njerëzve duke vlerësuar shërbimin e besimit që e paraqesin Risale-i Nuri dhe studentët e tij, duke thënë:

"Shikoji këta! Ata kanë ardhur për të të uruar mirëseardhje për atë shërbimin tënd, me zemra të mbushura me dhembshuri, me dëshpërim, me admirim dhe me lidhje të ngushtë". Madje edhe në ditën e dytë kur po u përgjigjesha pyetjeve të hetuesit, u grumbulluan një mijë njerëz në sheshin përballë dritareve të gjykatës duke shfaqur shqetësimin e tyre. Çehret e fytyrave të tyre shprehnin gjendjen e tyre të natyrshme dhe thonin: "Mos i ngushtoni dhe mos i shqetësoni këta", dhe nga lidhja e fortë që ata kishin me ne, policia qe e pamundur që t'i shpërndante, dhe ndërkohë erdhi në zemrën time ç'ka vijon:

Këta njerëz në këtë kohë të vështirë e të rrezikshme dëshirojnë një ngushëllim të vërtetë, një dritë të pashuar, një besim të fortë dhe disa sihariqe për lumturinë e përjetshme, dhe se ata e kërkojnë këtë nga natyra. Ata duhet të kenë dëgjuar se ajo që ata kërkojnë duhet të gjendet në Risale-i Nur, prandaj ata shfaqin këtë respekt e vlerësim për personin tim, i cili është i parëndësishëm, shumë më tepër se sa e

meritoj për shkak se kam kryer ndonjë shërbim të vogël për besimin; shpresoj që të kem bërë ndonjë shërbim për të.

E vërteta e dytë: Në zemër më erdhi ç'ka vijon:

Kundrejt fyerjes dhe përbuzjes ndaj nesh me pretekstin se kishim prishur rendin publik dhe përballë largimit të vëmendjes së njerëzve ndaj nesh nëpërmjet keqtrajtimeve të cilat i kryenin disa njerëz të përbuzur e të mashtruar, ishin miratimi, brohoritja dhe vlerësimi i njerëzve të panumërt të realitetit dhe i bijve të brezave të ardhshëm.

Po, nëpërmjet fuqisë së besimit të sigurt e të verifikuar, në çdo pjesë të këtij vendi, Risale-i Nuri dhe studentët e tij e ndalojnë korrupsionin e tmerrshëm dhe përpjekjet anarkiste për të prishur rendin publik nën maskën e komunizmit. Studentët e Risale-i Nurit punojnë për të siguruar rendin dhe qetësinë publike në vend të panikut dhe të anarkisë. Për njëzet vitet e kaluara nuk është shfaqur asnjë incident që përmban prishjen e rendit publik lidhur me studentët e Risale-i Nurit, të cilët janë të shumtë dhe gjenden në çdo anë të vendit. Askush prej policëve nuk ka gjetur dhe nuk ka regjistruar ndonjë ngjarje në dhjetë provinca dhe nëpërmjet katër gjykatave të lidhura e të interesuara për këtë. Madje policët e paanshëm, të drejtë të tre provincave thanë: "Studentët e Risale-i Nurit janë policë moralë e shpirtërorë, për sigurinë në vend; ata ndihmojnë në ruajtjen e rregullit e të rendit. Nëpërmjet besimit të sigurtë e të verifikuar, ata lënë në kokën e gjithkujt që lexon Risale-i Nurin diçka që i pengon ata nga kryerja e akteve të dënueshme. Ata janë si rojtarë dhe përpiqen të sigurojnë rendin publik.

Një shembull i kësaj është burgu i Denizlit. Kur studentët e Risale-i Nurit hynë atje dhe trajtesa "*Frutat e besimit*" e cila u shkrua për të burgosurit, brenda një hapësire kohore tre ose katër muajsh, më shumë se dyqind prej atyre të burgosurve u bënë jashtëzakonisht të bindur dhe fituan një sjellje të tillë fetare e të drejtë, saqë një njeri i cili kishte vrarë tre apo katër njerëz, tani kishte frikë e ruhej që të mos vriste edhe tartabiqet. Ata u bënë anëtarë plotësisht të mëshirshëm e të padëmshëm për kombin. Zyrtarët u habitën shumë nga kjo situatë dhe e shikuan me vlerësim. Madje disa të rinj deklaruan para se të merrnin vendimin e gjykatës -dënimin: "Në qoftë se studentët e Risale-i Nurit do të qëndronin në burg, ne do t'i gjykonim vetet tona dhe do t'i dënonim me

qëllim që të qëndrojmë me ta, të mësojmë prej tyre dhe të reformojmë e të rregullojmë vetet tona nëpërmjet udhëzimit të tyre dhe të bëhemi si ata."

Ata që akuzojnë studentët e Risale-i Nurit, të cilët janë kështu, për prishje të rendit publik, sigurisht ata janë të mashtruar rëndë, ose janë bërë të marrë, ose me dijeni apo pa dijeni mashtrojnë qeverinë për hir të anarkisë e të terrorit, dhe prandaj ata përpiqen të na shtypin e të na dëbojnë ne.

"Meqenëse vdekja nuk vritet dhe dera e varrit nuk mund të mbyllet dhe karvanet njerëzore në bujtinën e kësaj dynjaje hynë në të dhe me shpejtësi të madhe fshihen e zhduken, atëherë sigurisht ne do të ndahemi nga njëri-tjetri shumë shpejt. Ju do të merrni dënimin për tiraninë tuaj në mënyrën më të frikshme. Të paktën do të ngjiteni tek litarët e vdekjes dhe tek asgjësimi i përjetshëm -vdekja-, e cila është një letër lirimi për njerëzit e besimit. Kënaqësitë e përkohshme që keni marrë në këtë dynja duke i imagjinuar ato të jenë të përhershme, do të transformohen në dhimbje pikëlluese të përjetshme.

Me keqardhje, armiqtë tanë të fshehur shtiracakë ndonjëherë i ngjisin emrin "Sufizm" realitetit të islamit, i cili është fituar e ruajtur nëpërmjet shpatave dhe gjakut të qindra milionë martirëve të cilët ishin në shkallën e shenjtërisë dhe nëpërmjet luftës heroike të ish muxhahidëve të këtij kombi fetar. Ndërsa rruga e sufizmit është vetëm një rreze nga ai diell; ata e shfaqin atë të jetë dielli dhe mashtrojnë disa zyrtarë të qullët të qeverisë. T'i quash studentët e Risale - i Nurit 'Sufi' apo anëtarë të një grupi politik, për shkak se ata punojnë me efektshmëri për të vërtetat e Kuranit e të besimit, dëshirojnë t'i nxisin ata kundra nesh. Ne u themi atyre që i dëgjojnë ata për të dalë kundra nesh, ashtu siç thamë përpara gjykatës së Denizlit:

"Le të vetëflijohemi për këtë të vërtetë të shenjtë për të cilën qindra e milionë të tjerë janë vetëflijuar, madje edhe në qoftë se ju do t'i vini zjarrin botës rreth nesh, ne që sakrifikojmë vetet tona për të vërtetat e Kuranit nuk do t'i lëshojmë armët tona përpara ateizmit; ne nuk do ta braktisim detyrën tonë të shenjtë, në dashtë Allahu!"

Lavdi Zotit, për ngushëllimin e shenjtë që buroi nga besimi dhe nga Kurani për dhimbjet e dëshpërimin e ngjarjeve të pleqërisë, unë nuk do ta ndryshoja këtë vit pikëllues të pleqërisë sime me dhjetë vite më të

lumtura të rinisë sime -sidomos meqenëse për ata që pendohen dhe kryejnë namazet e detyruara, çdo orë në burg është e barabartë me dhjetë orë ibadeti dhe, për sa ka të bëjë me meritat, çdo ditë që kalon në sëmundje a në shtypje fiton thevabin e dhjetë ditëve të jetës së përhershme.

Kështu, unë kuptova nga këto paralajmërime se sa të merituesshme për falënderime janë këto ditë për dikë si unë që pret radhën e tij në derën e varrit. Ndërkohë unë thashë: Falënderime të pafundme qofshin për Krijuesin tim!" dhe isha i lumtur për pleqërinë time dhe i kënaqur me burgosjen time. Meqenëse jeta nuk ndalon por madje kalon shpejt, në qoftë se ajo kalon në kënaqësi e lumturi, meqenëse ikja e kënaqësisë shkakton dhimbje, ajo bëhet kalimtare, duke kaluar pa falënderime e në pakujdesi. Jeta, duke lënë në vendin e saj mëkatet, ikën e largohet. Ndërsa në qoftë se ajo kalon në burg e në vështirësi, meqenëse ikja e dhimbjes është një lloj kënaqësie, dhe meqenëse ajo konsiderohet të jetë një lloj ibadeti, ajo bëhet e përjetshme nga një drejtim, dhe nëpërmjet frutave të saj të mira, fiton jetë të përhershme. Ajo bëhet nga një drejtim tjetër shlyerje për gabimet që ishin shkaku i mëkateve të kaluara dhe i burgosjes, dhe pastrim nga gjynahet. Nga ky këndvështrim, ata midis të burgosurve të cilët i kryejnë farzet, detyrimet fetare, duhet të japin falënderime me durim.

■ SHPRESA E GJASHTËMBËDHJETË

Kur më çuan në internim në Kastamonu[34] pasi plotësova një vit dënimin tim në Burgun Eskishehir, ndërsa isha i plakur, unë qëndrova për dy tre muaj si mysafir i lënë në pritje në stacionin e policisë. Mund të kuptohet se sa shumë tortura e mundime ka vuajtur dikush si unë në vende të tilla si këto, i cili ishte i veçuar nga njerëzit, që nuk mund të qëndrojë madje as me shokët e tij besnikë dhe që nuk mund të ndryshonte as veshjen me të cilën ishte mësuar ta mbante[35]. Ndërsa duke vuajtur këtë gjendje pikëlluese, papritmas, mirësia Hyjnore më erdhi në ndihmë në pleqëri. Inspektorët dhe policët në stacionin e policisë u bënë si shokë të ngushtë e besnikë. Ata nuk insistuan

[34]Një qytet që ndodhet në veri të Turqisë. Bediuzzamani u internua atje në Mars të vitit 1936, pasi u lirua nga Burgu Eskishehir. Ai qëndroi në Kastamonu për shtatë vite deri në 1943, kur ai u dërgua për tek Burgu i Denizlit. Përkthyesi.

[35] Kjo i referohet zbatimit të detyruar të veshjes Europiane pasi miratuan ligjet për veshjen në vitet e para të Republikës.

asnjëherë që unë të vishja kapele me strehë, dhe ashtu si shërbyesit e mi, ata më merrnin mua për të ecur e shëtitur rreth qytetit.

Pastaj unë qëndrova në medresenë e Risale-i Nurit në Kastamonu, përballë stacionit të Policisë, dhe fillova të shkruaj pjesë të tjera të Risale-i Nurit. Studentët heroikë të Risale-i Nurit si Fejziu, Emini, Hilmiu, Sadiku dhe Salahuddini e të tjerë si këta, merrnin pjesë në medrese me qëllim që t'i shumëfishonin e t'i përhapnin trajtesat. Madje ne zhvilluam debate shkencore më të ndritshme e të çmueshme se sa ato që kisha mbajtur në rininë time me studentët e mi të hershëm.

Pastaj armiqtë tanë të fshehur ngjallën dyshime për ne tek disa zyrtarë, tek disa hoxhallarë egoistë dhe tek disa shejh të tarikatit sufi. Ata shkaktuan që ne dhe studentët e Risale-i Nurit nga pesë ose gjashtë provinca të grumbulloheshin së bashku në shkollën *Jusufie* të burgut të Denizlit. Detajet e kësaj *'Shpresës së Gjashtëmbëdhjetë'* përshkruhen qartë në letrat e shkurtëra që ua dërgoja fshehtazi vëllezërve të mi kur isha në Burgun e Denizlit, në ato që dërgoheshin nga Kastamonu dhe në koleksionin që përmban fjalën mbrojtëse përpara gjykatës së Denizlit. Kështu duke ia referuar detajet atyre Letrave dhe Fjalës sime mbrojtëse, unë do të aludoj për të vetëm shkurt këtu:

Unë i fsheha disa trajtesa të veçanta dhe koleksionet e rëndësishme dhe sidomos ato që hulumtojnë Dexhalin e muslimanëve -Sufjanin- dhe kerametet e Risale-i Nurit, nën stivën e druve dhe nën qymyr me qëllim që ato të mund të botoheshin pas vdekjes sime ose pasi autoritetet shtetërore të vinin në vete dhe t'i vinin vesh të vërtetës. Unë isha i qetë nga kjo çështje, por papritmas disa zbulues policorë dhe disa ndihmës të prokurorit të përgjithshëm hynë me dhunë e bastisën shtëpinë time dhe i nxorën ato trajtesa të rëndësishme e të fshehura nën stivën e druve dhe nën qymyr.

Pastaj më arrestuan dhe më dërguan në Burgun e Ispartas, ndonëse unë isha në gjendje të keqe shëndetësore. Ndërsa isha shumë i zemëruar nga dëmi që i kishte ardhur Risale-i Nurit, mirësia Hyjnore na erdhi të gjithëve në ndihmë, sepse autoritetet që ishin më të nevojshmit për leximin e atyre trajtesave të çmueshme të fshehura, filluan t'i studionin me të gjithë vëmendjen e me zell.

Ndërsa filluan t'i lexonin me idenë për t'i kritikuar, ata nisën t'i vlerësonin ato. Madje në Denizli, megjithëse ne nuk ishim në dijeni,

shumë njerëz, qofshin zyrtarë ose jozyrtarë, lexonin trajtesën *El-Ajetul-Kubra* që ishte botuar me fshehtësi të plotë dhe kishin shtuar e forcuar besimin e tyre dhe u bënë shkak për ta bërë fatkeqësinë tonë sikur të mos kishte ndodhur.

Pastaj ata na çuan në Burgun e Denizlit dhe më vendosën në një qeli të mbyllur në një paradhomë të neveritshme, erëkeqe, të ftohtë e me lagështirë. Unë u bëra shumë i dëshpëruar nga pleqëria, nga sëmundja dhe nga vështirësitë që u ranë shokëve të mi për shkakun tim, dhe isha shumë i pikëlluar për konfiskimin e Risale-i Nurit dhe për ndërprerjen e aktiviteteve të tij. E gjitha kjo më bëri shumë të shqetësuar e të brengosur.. Ndërkohë, papritmas, mirësia dhe përkujdesja Hyjnore më erdhën në ndihmë. Ajo e transformoi atë burg të tmerrshëm në një medrese të Risale-i Nurit, duke provuar se burgu ishte një shkollë "Jusufie". Risale-i Nuri filloi të përhapej nëpërmjet penave prej diamanti të heronjve të *El-Medresetu Ez-zehra*. Madje Heroi i madh i Risale-i Nurit, në ato rrethana të vështira shkroi më shumë se njëzet kopje nga Trajtesa "*Frutet e besimit*" dhe nga "*Koleksioni i fjalës mbrojtëse"* gjatë një periudhe tre katër mujore. Ato kopje u bënë shkak për pushtime edhe brenda burgut edhe jashtë tij, dhe në atë fatkeqësi i transformoi dëmin dhe humbjen tonë në dobi e fitim dhe i transformoi dëshpërimin e shqetësimin tonë në gëzim, duke shfaqur përsëri një mister nga misteret e vërsetit,

عَسَىٰٓ أَن تَكْرَهُوا۟ شَيْـًٔا وَهُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ "*E, ndodh që ju mund të mos e pëlqeni një gjë që është në të vërtetë e mirë për ju..."*[36]

Pastaj ne u zbuluam para kritikave të ashpra për shkak të një raporti të pasaktë e sipërfaqësor i paraqitur nga ana e komitetit të ekspertëve të parë, dhe ministri i arsimit ndërmori një sulm të ashpër kundra nesh; ai botoi një deklaratë kundra nesh. Dhe pikërisht atëherë kur sipas disa raporteve ata u përpoqën duke kërkuar për t'i ekzekutuar disa nga ne, mirësia e përkujdesja Hyjnore na erdhi në ndihmë. Para së gjithash, ndërsa ne prisnim një raport të ashpër kritik nga grupi i ekspertëve në Ankara, ata dërguan raporte lavdëruese e miratuese. Megjithëse ata gjetën më pak se dhjetë gabime në pesë sënduqe kopjesh të Risale-i Nurit, ne provuam në gjykatë se pikat që ata i kishin shfaqur të jenë

[36] Kur'an, 2:216

gabime ishin krejtësisht të sakta, por vetë ekspertët ishin të gabuar në çështjet për të cilat thanë se ishin gabime; dhe shpjeguam se në raportin e tyre që përmbante pesë faqe ishin rreth dhjetë gabime. Dhe ndërsa ne prisnim raprezalje e kërcënime të ashpra nga shtatë qarqet zyrtare tek të cilat u dërguan trajtesat '*Frutat e besimit*' dhe '*Koleksioni i fjalës mbrojtëse*', ashtu siç u dërguan të gjitha trajtesat në ministrinë e drejtësisë, dhe në mënyrë të veçantë për ato trajtesa të veçanta që përmbanin goditje të forta dhe kundërshtim ndaj njerëzve të çudhëzimit...

Po, ndërsa ne prisnim kërcënime të rënda prej tyre, kur ç'të shohësh, ata u përgjigjën me shumë butësi nëpërmjet raporteve të tyre ngushëlluese të cilat i ngjasonin asaj letre që na dërgoi kryeministri, tamam sikur ata shfaqën dëshirën e tyre për pajtim me ne, dhe kështu nuk na sulmuan. E gjitha kjo provoi prerazi se të vërtetat e Risale-i Nurit nëpërmjet mirësisë, përkujdesjes dhe nderimit Hyjnor triumfuan dhe i mposhtën ata, saqë Risale-i Nuri i bëri ta lexojnë e të udhëzohen nëpërmjet tij, dhe i transformoi ato qarqe të gjëra zyrtare në atë që u ngjasonte shkollave të dritës, dhe shpëtoi besimin e shumë njerëzve që ishin ngurrues e të habitur; gjë e cila na dha një gëzim shpirtëror e dobi shumë herë më të mëdhaja se sa dëshpërimi e brenga që vuanim.

Pastaj, armiqtë tanë të fshehur futën helm në ushqimin tim, dhe Hafiz Aliu i ndjerë, heroi martir i Risale-i Nurit, shkoi në spital në vendin tim, pastaj udhëtoi në botën e ndërmjetme në vendin tim dhe na bëri ne të qanim me dëshpërim për të. Përpara se të ndodhte kjo fatkeqësi, unë thashë një ditë kur isha në malin e Kastamonus, madje thërrita shpesh: "O Vëllezërit e mi, mos i jepni mish kalit dhe bar luanit! Domethënë, mos ia jepni të gjitha trajtesat gjithësecilit, që të mos i përdorin për të na sulmuar". Megjithëse, Hafiz Aliu, Allahu e mëshiroftë, ishte rreth shtatë ditë larg në këmbë, sikur ai dëgjoi me telefonin e tij shpirtëror këtë fjalën time; dhe në të njëjtën kohë ai më shkroi duke më thënë: "Po, o profesori im... Është një nga kerametet e Risale-i Nurit dhe nga veçoritë e tij që të mos u jepet mishi kuajve dhe as bari luanëve. Përkundrazi, meqenëse bari u jepet kuajve dhe mishi luanëve, ai i dha atij hoxhe trajtesën e "*Sinqeritetit"*. Unë mora letrën e tij pas shtatë ditëve. Ne filluam ta shqyrtojmë dhe mësuam se ai e kishte shkruar atë shprehje të çuditshme pikërisht në kohën që unë e përsërisja në majë të malit Kastamonu.

Kështu në kohën që vdiq ai hero i Risale-i Nurit dhe ne po na bëhej presion nga hipokritët e fshehur të cilët po përpiqeshin të na ndëshkonin nëpërmjet intrigave të tyre kundra nesh, dhe unë isha shumë i mërzitur se ata do të më çonin në spital me urdhër zyrtar për shkak se isha i sëmurë nga helmi, pikërisht në këtë gjendje të trishtueshme, më erdhi në ndihmë mirësia e përkujdesja Hyjnore.

Nëpërmjet duave të sinqerta të vëllezërve të mi të bekuar, rreziku i jetës sime nga helmi kaloi, dhe ndodhen shenja shumë të fuqishme se ai hero martir, po preokupohej në varrin e tij me Risale-i Nurin, dhe u përgjigjej me Risale-i Nurin pyetjeve të melekëve; dhe heroi i Denizlit Hasan Fejziu, Allahu e mëshiroftë, i cili do të punonte sipas sistemit të Hafiz Aliut, dhe shokët e tij besnikë do t'i shërbenin fshehurazi Risale-i Nurit në mënyrë të efektshme; dhe për shkak se edhe të burgosurit e tjerë po reformoheshin nga Risale-i Nuri, madje edhe armiqtë tanë e mbështetën lirimin tonë nga burgu; dhe ashtu si shokët e shpellës, studentët e Risale-i Nurit e transformuan atë vend prove në një shpellë asketësh të kohëve të mëparshme; e gjitha kjo, së bashku me përpjekjet e tyre në shkrimin dhe në përhapjen e Risale-i Nurit me zemra të qeta, provoi se mirësia dhe përkujdesja Hyjnore na kishte ardhur në ndihmë.

Gjithashtu iu shfaq zemrës sime se, përderisa një interpretues i madh i sheriatit, si Imam A'dham Ebu Hanifeja dhe imamë të tjerë muxhtehidinë si ai, kishin vuajtur burgimin dhe u torturuan rëndë, si imam Ahmed Ibn Hanbel dhe si shembulli i tij prej muxhahidinëve të mëdhenj, dhe u torturuan për hir të një çështjeje të vetme nga çështjet e Kuranit, dhe i përballuan ato me durim të plotë, dhe nuk qëndruan të heshtur rreth çështjes në fjalë; dhe disa udhëheqës fetarë dhe shkollarë patën qenë krejtësisht të duruar e të palëkundur duke dhënë falënderime, pavarësisht vuajtjes së torturave shumë më të rënda se sa të tuat; atëherë sigurisht ti je i detyruar të japësh falënderime të pafundme për pikërisht vështirësitë e pakta që ti po vuan, ndonëse shpërblimi dhe fitimi që ti merr janë të mëdhaja për ato të vërteta të shumta të Kuranit. Po, unë do të përshkruaj shkurtazi një manifestim të mirësisë Hyjnore nëpërmjet tiranisë që e kryen njeriu:

Kur isha njëzet vjeç, unë thoja në mënyrë të përsëritur: Në fundin e jetës sime unë do të tërhiqem nga jeta shoqërore dhe do të jetoj i veçuar në një shpellë ose në një mal, si ata të cilët hoqën dorë nga dynjaja dhe u tërhoqën nëpër shpella në kohët e lashta. Gjithashtu unë vendosa kur

mbahesha si rob lufte në verilindje të Rusisë në luftën e Parë Botërore se unë do t'i kaloja ditët e mbetura të jetës sime nëpër shpella duke u larguar nga jeta shoqërore e politike. Është e mjaftueshme tani nga përzierja me ta". Në këtë pikë, edhe mirësia Hyjnore, edhe drejtësia e kaderit Hyjnor, u manifestuan si mëshirë ndaj pleqërisë sime, dhe ato të dyja i shndërruan ato shpella, të cilat i përfytyroja, në diçka më të mira e më të këndshme se sa ato, gjë që kalonte shumë përtej dëshirës dhe vendimit tim.. Ata të dyja i ndryshuan ato në burgje, në vende të veçuara e në vetmi, dhe më dhanë mua *Shkolla Jusufie* në vend të atyre shpellave në male për ata që tërhiqen në vetmi dhe për asketët, me qëllim që të mos i çonim më kot kohët tona, pasi në ato shpella ka dobi për Ahiretin, dhe kjo përveç kryerjes së misionit të xhihadit për hir të Kuranit dhe të të vërtetave të imanit. Madje unë pata vendosur ta shfaq veten time fajtor për ndonjë krim dhe të qëndroja në burg pasi shokët e mi ishin liruar. Njerëz të vetmuar si Husrevi dhe Fejziu do të qëndronin me mua, dhe me ndonjë pretekst unë do të kisha qëndruar në qeli të burgut me qëllim që të mos takohesha me njerëz e të harxhoja kohën kot në biseda të panevojshme dhe në artificializëm egoist. Por atëherë Kaderi Hyjnor dhe rizku -fati- që na kishte caktuar Allahu xh.sh. na shtynë në një vend tjetër të veçuar e të mbyllur. Në përputhje me vërsetin,

اَلْخَيْرُ فِي مَا اخْتَارَهُ اللهُ ۞ عَسَىٰ أَنْ تَكْرَهُوا شَيْئًا وَهُوَ خَيْرٌ لَكُمْ

"E ndodh që ju mund të mos e pëlqeni një gjë që është në të vërtetë e mirë për ju..."[37] dhe sipas thënies "*E mira qëndron në atë që zgjedh Allahu*", nga mëshira për pleqërinë time dhe me qëllim që të na bëjë të punojmë më shumë në shërbim të besimit, detyrat na u dhanë jashtë vullnetit dhe fuqisë sonë në këtë shkollë të tretë *Jusufie*.

Po, ndodhen tri shembuj urtësie dhe dobi të rëndësishme lidhur me shërbimin e Risale-i Nurit nga mirësia Hyjnore duke i transformuar -nga mëshira për pleqërinë time- shpellat e veçanta për rininë time, kur unë nuk kisha armiq të fuqishëm e të fshehur, në paradhoma të veçuara burgu.

[37] Kur'an, 2:216

Shembulli i Parë i Urtësisë dhe i Dobisë:

Në këtë kohë është e mundur për studentët e Risale-i Nurit të grumbullohen bashkë pa dëm vetëm në *Shkollën e Jusufit*. Ndërsa jashtë saj do të kushtonte shtrenjtë dhe do të ngjallte dyshime në qoftë se ata takohen. Madje disa nga ata që vinin për të më takuar, shpenzonin dyzet ose pesëdhjetë lira, dhe atëherë ose më takonin për vetëm njëzet minuta, ose ktheheshin duke mos pasë mundësi të më takonin. Unë zgjodha me gatishmëri vështirësinë e burgut me qëllim që të isha më afër disa vëllezërve të mi. Kjo do të thotë se për ne burgu është mirësi dhe shembull mëshire.

Shembulli i Dytë i Urtësisë dhe i Dobisë:

Shërbimi i besimit në këtë kohë duhet të jetë nëpërmjet shpalljes dhe njoftimit të tij në çdo drejtim dhe duke tërhequr vëmendjen e atyre që kanë nevojë për të. Kështu vëmendja tërhiqet për tek Risale-i Nuri nëpërmjet burgosjes sonë; kjo është si një shpallje.

Më kryeneçët dhe më të nevojshmit për të e gjejnë atë dhe ai shpëton besimin e tyre; kokëfortësia e tyre thyhet dhe ata shpëtojnë nga rreziku, dhe rrethi i studimit të Risale-i Nurit zgjerohet.

Shembulli i Tretë i Urtësisë dhe i Dobisë:

Studentët e Risale-i Nurit që janë dërguar në burg mësojnë nga sjellja e njëri-tjetrit, nga cilësitë, nga sinqeriteti dhe nga vetëflijimi, dhe ata nuk kërkojnë më përfitime lidhur me dynjanë në shërbimin e tyre ndaj Risale-i Nurit. Po, meqenëse, në këtë *shkollë Jusufie*, ata i kanë parë me sytë e tyre dhjetë dhe ndoshta njëqind dobitë e fituara për çdo mundim e vështirësi, dhe rezultatet e mira, dhe shërbimi i sinqertë ndaj besimit, ata janë të suksesshëm për të fituar sinqeritet të pastër, dhe nuk i ulin më vetvetet duke kërkuar dobi të pjesshme e vetjake.

Për mua, këto vende të veçuara e të mbyllura janë të holla e të zymta, veçse ama ato janë të këndshme e të kënaqshme; ato janë siç vijon:

Unë shikoj këtu të njëjtat situata të cilat i shihja në medresenë time të vjetër në vendlindjen time në rininë time. Sepse tradicionalisht në provincat lindore, ushqimi i një pjese prej studentëve të medreseve, u

vinte nga jashtë shkollës, ndërsa një grup tjetër e gatuanin në mes tyre në shkolla. Dhe kishte edhe mënyra të tjera që i ngjasonin këtij vendi prove. Ndërsa shikoja burgun këtu, duke ndjerë një simpati e mallëngjim të këndshëm, unë udhëtoj me imagjinatën time tek ato kohë të ëmbëla të hershme të rinisë, dhe harroj vështirësitë e pleqërisë.

* * *

Shtojca e Shkreptimës së Njëzet e gjashtë.

Kjo është letra e Njëzet e Njëtë, e cila meqenëse është përfshirë në koleksionin e Letrave, nuk është shtuar këtu.

* * *

SHKREPTIMA E NJËZET E SHTATË

Kjo përbëhet nga Fjala mbrojtëse përpara gjykatës së Eskishehirit, e cila është botuar në koleksionin "*Biografia e Ustadhit*".

* * *

SHKREPTIMA E NJËZET E TETË

[Kjo shkreptimë përmban disa nga pjesët e shkurtëra të cilat i shkrova për ngushëllim për zemrat e vëllezërve të mi të cilët ishin me mua në burgun e Eskishehirit, në kohën që isha i ndaluar të përzihesha me të tjerët dhe as të flisja me ta.]



Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

Një bashkëbisedim zbavitës e tërheqës me Sulejman Rushtun[1], i cili është i njohur për besnikërinë e tij dhe i shquar për sinqeritetin e tij të zemrës.

Një pikë e vogël lidhur me një vërset të Rëndësishëm.

Ishte vjeshtë dhe po afrohej koha kur mizat po shkarkoheshin nga detyrat e tyre, dhe për shkak të shqetësimit të vogël që ato japin, njerëzit egoistë po përdornin lëndë kimike tek qelia ime në burg me qëllim që t'i vrisnin e t'i zhduknin ato. Ky veprim ngjalli tek unë një keqardhje të madhe duke ditur se mizat shumoheshin akoma më shumë se më parë pavarësisht përdorimit të barit helmues vrasës. Ndodhej një spango për të shtrirë rrobat për tharje në qelinë time në burg. Në mbrëmje ato zogj të zvogëluar rreshtoheshin në atë spango në formën më të rregullt e të bukur.

[1] Njëri nga studentët e parë të Ustadhit në Isparta. Përkthyesi

Kur donte t'i shtrinte rrobat, unë i thashë Rushtus: "Mos i shqetëso ato zogj të zvogëluar; vari ato në një vend tjetër". Ai m'u përgjigj me seriozitet të plotë: "Ne na duhet spangoja; le të gjejnë mizat një vend tjetër për vete".

Sidoqoftë, në mëngjesin e hershëm vijues nisi një bashkëbisedim lidhur me krijesat e shumta të vogëla si mizat, bletët dhe për insektet e shumta, dhe u shkëmbyen fjalë rreth tyre. Unë i thashë atij ç'ka vijon:

"Speciet si këto, kopjet e të cilave shumohen kaq shumë, kanë detyra të rëndësishme dhe vlerë të madhe, ashtu siç shumohen kopjet e një libri duke parë vlerën dhe rëndësinë e tij.

Domethënë, speciet e mizave kanë detyra të rëndësishme dhe vlerë të madhe saqë Krijuesi i Gjithurtë i shumon shumë kopjet e atyre mesazheve të Kaderit Hyjnor dhe kopjet e fjalëve të Fuqisë Hyjnore.

Kur'ani i gjithurtë thotë:

"O Njerëz! Është parashtruar një përngjasim për ju, kështu që dëgjoni mirë: Me të vërtetë që ata të cilëve ju u drejtoheni në vend të Allahut, nuk mund të krijojnë as edhe një mizë, edhe sikur të mblidheshin të gjithë së bashku për t'ia arritur qëllimit. Dhe nëse miza merr diçka prej tyre, ata nuk do të kenë aspak fuqi për ta çliruar atë prej mizës. Kësisoj, të dobët janë (që të dy) edhe lutësi, edhe i luturi".[2]

Domethënë, në qoftë se shkaqet dhe ato gjëra që pretendohen nga njerëzit e çudhëzimit të jenë zotra përveç Allahut do të grumbulloheshin për të krijuar vetëm një mizë të vetme, ato do të ishin të paaftë për të. Domethënë, krijimi i një mize është një mrekulli e tillë Hyjnore dhe një shenjë e madhe krijueshmërie, saqë sikur të grumbulloheshin të gjitha shkaqet, ato nuk do të ishin në gjendje të krijonin një shenjë të tillë Hyjnore, as nuk do ta kopjonin, nuk do ta imitonin dhe as nuk do të mund ta kundërshtonin. Ajo mrekulli -miza- subjekti domethënës i vërsetit të lartëpërmendur, shpartalloi Nimrudin, dhe kur Musai a.s. u ankua për shqetësimin që ato i jepnin, duke thënë: O Krijuesi im! Përse i ke shumuar kaq shumë këto krijesa ngacmuese?" Ndërkohë përgjigjja që vijon i erdhi nëpërmjet inspirimit:

[2] Kur'an, 22:73

"Ti ke shfaqur kundërshtim njëherë rreth mizave ndërsa mizat kanë pyetur shumë herë duke thënë: "O Krijuesi ynë! Ky njeri gjigant ka një kokë të madhe, megjithatë ai të lavdëron vetëm me një gjuhë dhe ndonjëherë ai neglizhon për të të përmendur. Në qoftë se Ti do të kishe krijuar vetëm nga koka e tij krijesa si ne, do të kishte pasur me mijëra krijesa duke të të lavdëruar me mijëra gjuhë!"

Për më tepër, mizat, të cilat e mbrojtën kështu urtësinë në krijimin e tyre kundra ankimit të Musait a.s. në mënyrë të fuqishme për t'u bërë ballë një mijë kundërshtimeve të tilla, gjithashtu bëjnë një pastrim të madh. Këto insekte në mënyrë të vazhdueshme i lajnë fytyrat e tyre, sytë dhe krahët sikur të merrnin avdes dhe kanë detyra të rëndësishme. Mirëpo këndvështrimi i përgjithshëm i njeriut është dritëshkurtër, ai është akoma i paaftë për t'i perceptuar ato detyra.

Në të vërtetë, Allahu i Plotëfuqishëm ka krijuar një grup prej kafshëve të egra mishngrënëse, sikur të ishin nëpunëse të shërbimit shëndetësor dhe të urdhëruara për pastrim; ato e kryejnë detyrën e tyre me perfeksionim të plotë; pastrojnë sipërfaqen e detit duke grumbulluar kërmat e miliona kafshëve të tjera të detit të cilat ngordhin në çdo ditë dhe pengojnë që deti të bëhet i ndotur dhe i neveritshëm me kërmat e tyre[3].

Në qoftë se ata nëpunës të shërbimit shëndetësor të detit nuk do t'i përmbushnin detyrat e tyre tej mase të rregullta, deti nuk do shkëndijonte, shkumëzonte e shndriste si një pasqyrë; përkundrazi, ai do të shfaqte një turbullirë të zymtë e prekëse.

Gjithashtu Allahu i Gjithëfuqishëm ka krijuar kafshë të egra dhe shpendë mishngrënës të cilat janë si pastruese dhe si nëpunëse të

[3] Një peshk prodhon mijëra vezë dhe mijëra të vegjël, prandaj, me qëllim që të ruhet ekuilibri në det, ndonjëherë nga numri i peshqive të rinj duke dalë nga një putargë -vezë- që përbëhet nga miliona vezë, ato që mbijetojnë janë të barabartë me ato që ngordhin. Për më tepër, është një manifestim i mëshirës Hyjnore që për shkak të ndryshimit të madh në vëllim, midis peshkut nënë dhe të vegjëlve të saj, ajo nuk është në gjendje që t'i mbajë nën mbikëqyrje; ajo nuk mund të futet në vendet që fshihen të vegjëlit e saj. Prandaj, i Gjithurti Mëshirëplotë cakton njërin midis të vegjëlve që të jetë drejtuesi dhe mbikëqyrësi i tyre duke e përdorur atë krijesë të vockël në detyrat e nënës.

shërbimit shëndetësor, dhe mbledhin kërmat e miliarda kafshëve të egra dhe të zogjve që ngordhin në çdo ditë, pastrojnë faqen e tokës prej atyre eshtrave të kalbura dhe i shpëtojnë qëniet e tjera të gjalla nga pamje të tilla prekëse e të trishtueshme. Disa prej atyre kafshëve, si shqiponjat për shembull, nëpërmjet shtytjes prej inspirimit Hyjnor, në mënyrë të mrekullueshme kapin e nuhasin vendndodhjet e atyre kërmave prej një largësie që arrin pesë ose gjashtë orë, ndonëse ato janë të fshehura e të largëta, dhe shpejtojnë për tek ato vende me qëllim që t'i heqin ato kërma. Në qoftë se këto nëpunëse për shërbimin shëndetësor të tokës nuk do të ishin plotësisht të afta e të rregullta për t'i përmbushur detyrat e tyre në mënyrën më të mirë, faqja e tokës do të merrte një formë që do t'i bënte të gjithë të vajtonin për të.

Ushqimi hallall i kafshëve të egra është mishi i kafshëve të ngordhura. Mishi i kafshëve të gjalla është haram, i pavlefshëm për to; në qoftë se ato do ta hanin mishin e kafshëve të gjalla, ato marrin ndëshkim. Hadithi sherif i cili thotë se *"madje edhe delja pa brira do të marrë hakun e saj prej deles me brira në ditën e kijametit"*, tregon se megjithëse trupat e tyre prishen e zhduken, midis kafshëve, shpirtërat e të cilave janë të pavdekshëm, ndodhet një shpërblim dhe një ndëshkim në një mënyrë të përshtatshme për to në botën e përjetshme. Si rrjedhojë e kësaj, mund të thuhet se mishi i kafshëve të gjalla është haram për kafshët e egra.

Po kështu mizat janë ngarkuar si nëpunëse pastruese për të grumbulluar kërmat e krijesave të vockëla, grimcat e vogëla dhe copat e mirësive Hyjnore. Atyre u jepen detyra si nëpunëse të shërbimit shëndetësor për t'i ruajtur grimcat e vockëla të mirësive Hyjnore nga harxhimi më kot, nga shkelja me këmbë, nga përbuzja dhe nga kotësia dhe për të grumbulluar kërmat e krijesave të tjera të vockëla.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, mizat janë ngarkuar me detyrat e pastrimit të lëndëve helmuese dhe të mikrobeve të cilat shkaktojnë sëmundje dhe janë të padukshëm për syrin njerëzor. Ato nuk japin sëmundje, përkundrazi, nëpërmjet thithjes e përthithjes së mikrobeve të dëmshme, ato i shkatërrojnë dhe i bëjnë të transformohen ato në një gjendje të ndryshme; ato ndalojnë përhapjen e shumë sëmundjeve ngjitëse.

Një shenjë se mizat janë punonjëse shëndetësie dhe nëpunëse pastruese dhe kimiste dhe se në ekzistencën e tyre ndodhet një urtësi e gjërë Hyjnore është fakti se ato janë jashtëzakonisht të shumta në numër, sepse gjërat e çmueshme e të dobishme shumohen.[4]

O Njeri që synon vetëm interesin tënd vetjak! Përveç mijëra shembujve të urtësisë në krijimin e mizave, merr në konsideratë vetëm dobinë e vogël vijuese që lidhet me ty dhe braktise armiqësinë tënde ndaj tyre. Ashtu siç të japin ato pak familjaritet në mërgimin tënd, në veçimin dhe në vetminë tënde, po ashtu ato të zgjojnë nga gjumi i pakujdesisë dhe nga çoroditja e mendimit dhe nga jermimi. Ti i shikon mizat të cilat nëpërmjet mënyrës së tyre delikate dhe larjes së fytyrave dhe syve të tyre sikur të merrnin avdes e të faleshin, të japin ty mësim dhe të kujtojnë detyrat njerëzore si lëvizjen, aktivitetin dhe pastërtinë, ashtu siç vëzhgohet qartë.

Për më tepër, bletat, të cilat mund të mendohen si një lloj prej mizave, të japin ty mjalt për të ngrënë, i cili është më i ëmbli, më i holli dhe më i shijshmi i ushqimeve. Dhe meqenëse, ashtu siç deklarohet nga Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm, bletët dallohen nga marrja e *ilhamit* -inspirimit- Hyjnor, të jesh armiqësor ndaj tyre në një kohë që ato duhet të duhen; madje të shfaqësh armiqësi ndaj atyre kafshëve që e ndihmojnë njeriun dhe që përpiqen gjithmonë për t'i bërë shoqëri atij, do të ishte një padrejtësi dhe shkelje ndaj të drejtave të tyre. Ne mund t'i luftojmë kafshët e dëmshme vetëm për të zmbrapsur dëmin e tyre.

Ne, për shembull, luftojmë ujqërit me qëllim që t'i mbrojmë delet nga sulmi i tyre.

Mushkonjat dhe pleshtat hidhen mbi gjakun e turbullt -e prishur- i cili vërshon në vena dhe që është i ndotur nga substanca të dëmshme; madje ato janë ngarkuar me detyrën e konsumimit të gjakut të ndotur, kështu në kohë të nxehtë kur ka gjak të tepërt mbi nevojat e trupit, përse të mos jenë ato kupavënëse të natyrshme? Kjo është e mundshme...

---

[4] Sa bukur e hollë aludojnë rreshtat vijues të të shquarit Junus Emre për veprat e mrekullueshme të artit Hyjnor që janë në krahët dhe në trupin e mizës:

"Unë e ngarkova krahun e një mize mbi dyzet qerre; të dyzetat nuk qenë në gjendje ta mbanin; ajo mbeti kështu e shkruar -e dekretuar". Autori

Lavdi Zotit, prej artit të të Cilit çuditen mendjet..!

Në një ditë ndërsa po luftoja me nefsin tim urdhërues për të liga, i cili duke i imagjinuar mirësitë që ia kishte dhënë Allahu të ishin pronë e tij, kur i pa në vetvete ai u bë mendjemadh, krenar dhe mburravec. Unë i thashë: "Kjo pronë nuk është e jotja, ajo është thjesht amanet, të është lënë në besim". Ndërkohë nefsi hoqi dorë nga mburja dhe nga krenaria, mirëpo u bë dembel; ai tha: "Përse të shqetësohem për atë që nuk është e imja? U shkatërroftë ajo, ç'është ajo për mua?" Papritmas, unë pashë se një mizë ishte ulur në dorën time dhe filloi të pastrojë fytyrën, sytë dhe krahët e saj, të cilat janë amanet tek ajo, në mënyrën më të bukur, ashtu siç i pastron ushtari armën dhe uniformën e tij, të cilat ia ka dhënë shteti. Ndërkohë i thashë nefsit tim: "Shikoje këtë mizë!" Ai e pa dhe mori prej saj një mësim të mirë. Dhe kështu, miza u bë një profesoreshë për nefsin tim dembel e mburravec.

Jashtëqitja e mizave nuk është e dëmshme sipas pikëpamjes mjekësore, madje ajo mund të jetë si një shurup i ëmbël -dhe ushqim për insektet e tjera-, sepse nuk është e largët nga urtësia Hyjnore, madje është funksion i asaj urtësie që t'i bëjë mizat si makineri pastrimi dhe aparate transformimi duke parë se mizat përmbajnë mijëra substanca të ndryshme të dëmshme, mikrobe dhe helme nëpërmjet atyre që ato hanë.

Po, përveç bletëve, ndodhen specie të tjera prej insekteve që fluturojnë[5] të cilat hanë substanca të ndryshme të kalbura e të prishura

[5]Në fund të pranverës ndodhet një specie prej mizave të vogëla e cila krijohet në formën e një grumbulli të zi që bëhet i ngjitur me degët e bajames dhe të kajsisë së egër, dhe qëndron aty. Dhe në vend të jashtëqitjeve, rrjedhin vazhdimisht prej asaj specie pika që i ngjasojnë mjaltit dhe grumbullohen rreth tyre speciet e tjera të mizave dhe i thithin ato.

Një specie tjetër mizash janë të ngarkuara me detyrën e pjalmimit të luleve të bimëve dhe të disa pemëve frutore si fiku. Ashtu si xixëllonja, e cila është një lloj mizash që vezullon e shkreptin dhe shndrit natën, që është e denjë për t'u vëzhguar e për t'u hulumtuar, po ashtu disa specie të tjera që janë të praruara dhe që shndrisin si flori, meritojnë të vërehen e të shqyrtohen.

Gjithashtu ne nuk duhet t'i harrojmë mizat e armatosura me shtiza, dhe grerëzat që janë si banditë. Në qoftë se frerat e këtyre mizave nuk do të ishin në Dorën e Krijuesit Mëshirëplotë, dhe nëse ato do të sulmonin gjallesat dhe njeriun, do ta asgjësonin llojin njerëzor ashtu siç vranë Nimrudin dhe do të na shpjegonin kuptimin e nënkuptuar të vërsetit,

dhe pastaj në mënyrë të vazhdueshme nxjerrin jashtë pika prej lëndëve të ëmbëla, shurup, në vend të papastërtive. Duke i transformuar ato substanca të kalbura dhe helmuese në një shurup të ëmbël e shërues, si ëmbëlsirë e Fuqisë Hyjnore që bie në gjethet e pemëve, ato provojnë se janë makineri për shndërrimin e një substance në një tjetër dhe demonstrojnë përpara syve se çfarë kombi madhështor dhe çfarë grupi janë këto indvidë të vegjël. Nëpërmjet gjuhëve të gjendjeve të tyre ato thonë: "Mos shikoni tek vogëlsia jonë, shikoni gjërësinë e species sonë dhe deklaroni *"I Gjithë lavdërimi i takon Allahut!"*

* * *

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Sigurisht që Urdhri i Tij, kur Ai do një gjë, është vetëm se Ai t'i thotë asaj: "Bëhu!" dhe ajo është e bërë (në çast)!"[6]

Ashtu siç tregon ky vërset, krijimi realizohet nëpërmjet një urdhri. Thesaret e Fuqisë Hyjnore janë në *Kaf* dhe në *Nun*[7]. Disa nga shumë aspekte të këtij misteri të hollë janë shpjeguar në vende të ndryshme të Risale-i Nurit.

Kurse tani ne do të përpiqemi që ta bëjmë të kuptueshëm këtë mister me një shembull material të perceptueshëm me qëllim që t'i bëjmë më të kapshme për shikimin e këtij shekulli ateist hadithet profetike rreth veçorive, cilësive dhe efekteve materiale të shkronjave

---

"Dhe nëse miza merr diçka prej tyre, ata nuk do të kenë aspak fuqi për ta çliruar atë prej mizës. Kështu lloji i mizave i cili përfshin qindra specie që kanë këto cilësi e veçori të veçanta që u përmendën, kanë rëndësi aq të madhe saqë ky vërset madhështor i bën ato si subjektin e tij:

"*O njerëz! Është parashtruar një përngjasim për ju, kështu që dëgjoni mirë: Me të vërtetë që ata të cilëve ju u drejtoheni në vend të Allahut, nuk mund të krijojnë as edhe një mizë, edhe sikur të mblidheshin të gjithë së bashku për t'ia arritur qëllimit...* " (deri në fund)

[6] Kur'an, 36:82

[7] Dy shkronjat e alfabetit arab në fjalën *Nun*, domethënë, *Bëhu, Ji!".* Përkthyesi

të Kur'anit, dhe në mënyrë të veçantë të "Shkronjave të shkëputura" në fillimin e disa sureve.

Krijuesi i Gjithëlavdishëm, Pronari i Fronit më të lartë, ka katër Frone me anë të të cilëve, Ai i drejton krijesat në tokë, e cila është si një qendër shpirtërore e botës, dhe zemra dhe kibleja e universit.

Njëri *është Froni i Ruajtjes dhe i jetës*, i cili është dheu. Ky është manifestimi i Emrave të Bukur Hyjnorë, ***El-Hafidhu*** dhe ***El-Muhji***, *Ruajtësi* dhe *Jetëdhënësi*.

Froni i Dytë *është Froni i mirësisë dhe i mëshirës*, i cili është elementi i ujit.

I Treti *është froni i Njohjes dhe i urtësisë*, i cili është elementi i dritës.

I Katërti *është Froni i urdhrit dhe i dëshirës*, i cili është elementi i ajrit.

Ne shikojmë me sytë tonë se nga një dhé i thjeshtë, formohen minerale dhe bimë të ndryshme të panumërta, nëpërmjet të cilave plotësohen nevojat e kërkesat e panumërta të kafshëve dhe të qënieve humane, formohet shumësia e pakufishme nga Uniteti me rregull të përkryer, një shumëllojshmëri e pafundme speciesh nga një element i thjeshtë, qëndisje të mirërregulluara të panumërta në një fletë të thjeshtë. Dhe ndërsa uji dhe sidomos sperma e kafshëve, është një lëng i ngjashëm me ujin, mrekulli të panumërta arti shfaqen nëpërmjet tij në shumë krijesa të gjalla të shumëllojshme. Kjo tregon se e ngjashme me këto dy Frone, pavarësisht natyrës së tyre të thjeshtë, drita dhe ajri janë vendet e manifestimit të mrekullive të mahnitshme të Penës së Njohjes, Urdhrit, dhe Dëshirës së Skalitësit të Parapërjetshëm, të Gjithëditurit të Gjithëlavdishëm.

Për tani ne do ta lëmë mënjanë elementin e dritës dhe, në lidhje me çështjen tonë këtu, do të përpiqemi të zbulojmë pak çudirat dhe mrekullitë e Urdhrit dhe të Dëshirës brenda elementit të ajrit, i cili për globin tokësor është Froni i Urdhrit dhe i Dëshirës Hyjnore.

Ashtu siç i mbjellim shkronjat dhe fjalët nëpërmjet ajrit i cili është në gjuhët tona, të cilat mbijnë dhe çelin e japin fruta përnjëherë,

domethënë, për një çast, sikur të ishte pa kohë, fjala bëhet një farë në ajër; duke çelur në ajrin rrethues.

Ajo nxjerr filizat e shembujve të panumërt të të njëjtës fjalë, të vogla e të mëdha gjithandej ajrit. Po ashtu ne e vështrojmë elementin e ajrit dhe shohim se ai është aq i bindur dhe i nënshtruar ndaj urdhrit "***Kun fe jekun,****"Bëhu!" dhe ajo është e bërë (në çast)!"* saqë ashtu si një ushtar në një ushtri të rregullt, secila nga grimcat e molekulat e tij është në pritje të urdhërave në çdo moment, duke demonstruar bindjen dhe nënshtrimin e plotë ndaj urdhërave të manifestuar prej komandës ***Kun,*** *Bëhu*, që arrin në çast, menjëherë, qoftë për më të largëtën e grimcave dhe për më të afërtën e tyre.

Për shembull, fakti se fjalimi njerëzor mund të dëgjohet në çdo vend në tokë në ajër nëpërmjet radiotransmetuesve dhe radiomarrësve - me kusht që të ketë aparate radioje- në të njëjtin moment, menjëherë, në çast, që demonstron se sa në mënyrë të plotë çdo molekulë ajri i përshtatet me bindje të plotë manifestimit të Urdhrit "***Kun Fejekun***, *Bëhu! Dhe ajo bëhet në çast!*

Po kështu çështja është edhe me shkronjat, të cilat janë të paqëndrueshme në ajër, mund të manifestojnë shumë efekte të jashtme dhe cilësi materiale për sa ka të bëjë me shenjtërinë dhe sipas misterit të bindjes e të nënshtrimit.

Shenja të panumërta si këto tregojnë se meqenëse shkronjat, të cilat janë qëniet e ajrit, dhe veçanërisht shkronjat e shenjta dhe shkronjat Kur'anore në fillimin e disa sureve, që janë shkronja të shkëputura, i dëgjojnë urdhërat me rregullsi e vetëdije të përkryer dhe me ndjeshmëri të plotë dhe menjëherë, në çast. Nuk ka dyshim se kjo e shtyn njeriun të pranojë veçoritë materiale dhe cilësitë e jashtëzakonshme të treguara të shkronjave që janë në molekulat e ajrit për sa i përket shenjtërisë, dhe në të cilat reflektohet manifestimi i Dëshirës së parapërjetshme dhe një shkëlqim prej urdhrit të *"**Kun fejekun** Bëhu! Dhe ajo bëhet (në çast)!"*

Si rrjedhojë e këtij misteri, ndonjëherë Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm i përshkruan veprat e fuqisë Hyjnore sikur të buronin nga Atributi e Dëshirës dhe nga Atributi i të Folurit që ndërtohet mbi këtë mister. Ato shprehje Kur'anore tregojnë se qëniet krijohen me shpejtësinë më të madhe dhe janë të nënshtruara dhe të bindura

plotësisht ndaj urdhërave, ato sundojnë si fuqia, sikur vendimi i urdhrit të ekzekutohej si fuqia. Domethënë, shkronjat që burojnë nga urdhri Krijues sundojnë në ekzistencën e qënieve si një forcë fizike. Dhe Urdhri Krijues shfaqet njëlloj si vetë fuqia dhe bëhet pikërisht fuqia e dëshira.

Po, veprat e dëshirës dhe Urdhri Krijues shfaqen të jenë njëlloj me fuqinë në qëniet e këtij lloji, ekzistenca fizike e të cilave është e padukshme, ashtu si ajri, të cilat sikur janë gjysëm lëndore dhe gjysëm jolëndore; madje ato janë njëlloj me fuqinë.

Dhe kështu, me qëllim që të tërheqë vëmendjen për tek qëniet të cilat janë një berzah -ngushticë- ndërmjet lëndorës dhe jolëndorës, Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm thotë:

"Sigurisht që Urdhri i Tij, kur Ai do një gjë, është vetëm se Ai t'i thotë asaj: "Bëhu! Dhe ajo është e bërë (në çast)!"[8]

Prandaj, është shumë e arsyeshme që shkronjat e shkëputura që janë në fillimet e sureve si shembulli i: *Elif, Lam, Mim, Ta, Sin, Ha, Mim,* e të tjera prej shifrave Hyjnore, të jenë secila prej tyre çelësa, takues, midis grimcave të ajrit për t'u shkaktuar telave të lidhjeve të fshehura e të holla të dridhen dhe kështu të jenë mjetet e radiotelegrafisë së shenjtë jolëndore dhe të telekomunikacioneve ndërmjet tokës dhe Fronit Hyjnor; është krejtësisht e arsyeshme që ky duhet të jetë funksioni i atyre shkronjave.

Përveç detyrave të secilës dhe çdo molekuleje ajri të shpërndara nëpër të gjitha pjesët e botës duke u përshtatur lidhur me gjëra të tilla si radiotelegrafi, radiot, telefonat, telegrafitë dhe të vepruarit si marrësit dhe si përcjellës të forcave të holla si elektriciteti, unë madje pashë me intuitë të sigurtë një detyrë tjetër, përveç atyre që u përmendën, në lulet e pemës së bajames. Pemët e shpërndara nëpër vendet e sipërfaqes së tokës janë si një ushtri e mirorganizuar që marrin të njëjtin urdhër në një çast; thjesht me fryrjen e flladit të hollë -të butë-, ato marrin urdhër prej atyre grimcave dhe shfaqet një situatë e veçantë. Kjo gjendje më dha një bindje aq të sigurt sa siguria "dy edhe dy bëjnë katër".

[8] Kur'an, 36:82

Domethënë, ajri është një shërbyes i shkathët e i shpejtë, aktivist dhe besnik në faqen e tokës, ai u shërben miqve të të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit të cilët banojnë në faqen e tokës; në të njëjtën kohë ai përçon urdhërat e të Gjithëmëshirshmit nëpërmjet grimcave të tij që u ngjasojnë radiomarrësve, telefonave dhe ushtarëve nën urdhër, të gjitha molekulat e tij u përcjellin urdhëresat e shenjta të Atij të Gjithëmëshirshmi bimëve dhe kafshëve. Me urdhrin e ***Kun fejekun,*** *Bëhu dhe ajo bëhet (në çast)!",* ato kryejnë me rregull detyra të shumta, si të qenurit freskues e fllad për krijesat, ndihmojnë frymëmarrjen; domethënë, pasi të kryejnë detyrën e pastrimit të gjakut të tyre, ujit të jetës, dhe pasi të ndezin nxehtësinë e tyre trupore, zjarrin e jetës, ato shfaqen prej tyre dhe janë mjeti për formimin e fjalëve në gojët e tyre.

Si rrjedhojë e kësaj veçorie të ajrit, kur shkronjat, të cilat janë qëniet e ajrit, fitojnë shenjtëri; domethënë, kur ato marrin pozitën e përcjelljes e të marrjes, bëhet e tyre një pjesë e madhe prej asaj veçorie.

Prandaj, për shkak se ato janë shkronjat e Kur'anit, dhe bëhen si takues -çelësa; shkronjat e shkëputura në fillimin e disa sureve bëhen si çelësa qëndrorë të ndjeshëm të atyre lidhjeve të fshehta, ashtu si ekzistencat e tyre në ajër që e posedojnë këtë veçori, po kështu bëjnë ekzistencat e tyre në mendje dhe madje si skalitje kanë një pjesë prej asaj veçorie.

Domethënë, nëpërmjet leximit të atyre shkronjave dhe nëpërmjet shkrimit të tyre është i mundur fitimi i shërimit, ashtu si ilaçi material, si dhe mund të arrish qëllime të tjera...

Said Nursi.

*** * ***

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Thuaj (o Muhammed a.s.m. njerëzimit) "Sikur deti të ishte bojë (për të shkruar) Fjalët e Zotit tim, pa asnjë mëdyshje se deti do të shterohej para se

të mbaronin Fjalët e Zotit tim, madje sikur të sillnin edhe një det të dytë si ai në ndihmë të tij".[9]

[Ky vërset madhështor është i shtrirë, i lartësuar dhe një det i gjërë. Njeriut do t'i duhej të shkruante një vëllim të madh me qëllim që t'i përshkruajë të gjithë xhevahiret e tij. Kështu, duke i shtyrë për një kohë tjetër në dashtë Zoti ato xhevahire të çmuar, tani ne do të shpjegojmë disa rreze të një pike të hollë me qëllim për t'i kujtuar ato të vërteta. Duke m'u shfaqur të zbehta, ato më tërhoqën vëmendjen para pak ditësh pas tesbihateve që recitohen pas pesë namazeve të detyrara, e cila është një kohë e rëndësishme për mua dhe më e mira për ardhjen e realiteteve. Veçse ama unë nuk munda ta shënoj atë pikë në atë kohë, dhe gradualisht ajo rreze u bë më e zbehtë, e largët. Kështu, ne do të përmendim disa fjalë sikur t'i rrethoja ato me qëllim që të kapim një manifestim të atyre pikave para se ato të humbasin krejtësisht.]

Fjala e Parë:

Fjala e parapërjetshme është një atribut Hyjnor, ashtu si Njohja dhe Fuqia. Prandaj Fjala Hyjnore është e pakufishme dhe e pafundme.

Sigurisht, në qoftë se detet do të ishin bojë për diçka të pafundme, ato nuk do të mundeshin kurrë ta plotësonin.

Fjala e Dytë:

Gjëja më e qartë dhe më e fuqishme që e bën të kuptueshme ekzistencën e dikujt, është të folurit e tij. Dëgjimi i një fjale që buron nga dikush e provon ekzistencën e tij aq qartë saqë tejkalon një mijë prova, madje e provon aq qartë sikur ta shihje atë, pra me shkallën e të shikuarit. Atëherë, nëpërmjet kuptimit aludues, ky vërset thotë:

"Në qoftë se deti do të ishte bojë për të llogaritur e numëruar Fjalën Hyjnore, e cila demonstron ekzistencën e Tij xh.sh. dhe pemët të ishin pena për ta shkruar atë numër, fjala e Zotit nuk do të mbaronte, ato nuk do të arrinin kurrë në fundin e atyre Fjalëve. Domethënë, fjalët që tregojnë të Vetmin e përjetshëm absolut -siç tregon fjala Folësin- nuk

[9] Kur'an, 18:109

numërohen, nuk llogariten dhe janë të pakufishme; edhe sikur detet të ishin bojë, ato përsëri do të ishin të pamjaftueshëm për t'i shkruar".

Fjala e Tretë:

Në përputhje me urtësinë e vërtetimit, verifikimit, të bindjes për të vërtetën, duke ua mësuar të vërtetat e besimit të gjitha klasave të njerëzimit duke i ngulitur ato në zemrat dhe në mendjet e tyre, Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm në pamje të jashtme e përsërit të njëjtën vërtetësi. Ky vërset, në efekt, është një përgjigje ndaj sulmeve krejtësisht të pajustifikueshme të dijetarëve hebrenj, të cilët ishin njerëzit e ditur të librit të asaj kohe, kundra Profetit të shquar a.s.m. lidhur me qënien e tij analfabet dhe jo i ditur. Vërseti thotë: Përsëritja e çështjeve të mëdha që secila prej tyre ka vlerën e një mijë çështjeve dhe përmban mijëra të vërteta -ashtu si në çështjet e shtyllave të besimit- duke u përsëritur në mënyrë të mrekullueshme dhe në mënyra të ndryshme dhe përsëritja e një realiteti të vetëm i cili përmban dobi e rezultate të shumta me qëllim që t'i vërtetojë e t'i ngulisë ato në zemrat e të gjithë njerëzve dhe veçanërisht tek njerëzit e zakonshëm.. kjo përsëritje, të cilën e kërkojnë shembuj të shumtë urtësie -si verifikimi, bindja e vërtetimi- nuk buron nga folja e kufizuar, as nga mangësia intelektuale dhe as nga mungesa e kapitalit apo nga pafuqia, përkundrazi, sikur detet të ishin bojë, qëniet e vetëdijshme të ishin shkrues dhe bimët të ishin pena, madje, sikur grimcat të ishin majat e penave për të numëruar fjalët e ligjëratës së parapërjetshme Hyjnore, ato përsëri nuk do të vinin në fundin e tyre; ato Fjalë përsëri nuk do të soseshin, sepse të gjitha ato që u përmendën janë të pafundme, dhe Fjalët e Allahut janë të pafundme; ato janë burimi i Kur'anit që është orientuar tek bota e dukshme prej botës së padukshme duke iu adresuar xhindëve, njerëzve, melekëve dhe shpirtërorëve, duke kumbuar në veshët e secilit prej tyre. Atëherë s'është për t'u habitur, Kur'ani ka zbritur prej thesarit të Fjalës Hyjnore i cili nuk shteron kurrë.

Fjala e Katërt:

Dihet qartë se dalja e fjalës nga diçka e paparashikuar rrit e shton efektshmërinë e Fjalës dhe të shtyn për ta dëgjuar, sidomos jehonat e ngjashme me Fjalën që burojnë nga trupat e mëdhenj si retë dhe atmosfera, ato e bëjnë gjithësecilin t'i dëgjojë me vëmendje të madhe.

Tingujt e një gramafoni me përmasën e një mali do ta tërhiqnin vëmendjen edhe më shumë.

Ndërsa jehona qiellore e Kur'anit i cili i merr nivelet e qiejve si pllaka gramafoni, vjen -del- për ta bërë të gjithë globin tokësor që ta dëgjojë e t'i kushtojë vëmendje. Gjithashtu, nëpërmjet fuqisë së radios, molekulat e ajrit bëhen si marrësit dhe përcjellësit e shkronjave të Kur'anit dhe si qendrat e transmetimit të tyre. Duke aluduar për faktin se molekulat e ajrit bëhen pasqyra për reflektimin e dritave, si veshë që dëgjojnë tingujt, si gjuhë për t'i përmendur dhe si maja gjilpërash të një aparati të madh për shkronjat e Kur'anit të gjithurtë dhe duke treguar se sa të rëndësishme, të çmueshme, domethënëse, dhe të gjalla janë ato shkronja.

Kuptimi aludues i vërsetit thotë: "Kur'ani që është Fjalë Hyjnore, është aq i gjallë dhe i çmueshëm saqë sikur të gjithë detet të bëheshin bojë, melekët të ishin shkruesit, grimcat e vockëla pika dhe bimët e flokët pena për numrin e veshëve që i dëgjojnë dhe i kushtojnë vëmendje, dhe për numrin e fjalëve të shenjta që futen në ato veshë, ato përsëri nuk do të mundeshin kurrë ta arrinin fundin e tyre".

Jo, ata nuk mund të vijnë kurrë në fundin e tyre, sepse në qoftë se Allahu i Gjithëfuqishëm i Cili e shumon foljen e dobët e të pashpirt të njeriut miliona herë në ajër, sigurisht secila fjalë nga ligjërata e Atij Sovrani të pashoq të qiejve e të tokës, e cila orientohet tek e gjithë toka e qiejt dhe u adresohet të gjitha qënieve të vetëdijshme në tokë e në qiej, do të përmbante fjalë sa numrat e grimcave në ajër.

Fjala e Pestë:

Kjo përbëhet nga dy shkronja:

Shkronja e Parë: Ashtu siç ka fjalë Atributi i të Folurit, po ashtu ka fjalë të mishëruara edhe Atributi i Fuqisë. Edhe Njohja gjithashtu ka fjalë të urta të Kaderit Hyjnor, të cilat janë qëniet, sidomos qëniet e gjalla dhe veçanërisht krijesat e vogëla. Secila prej tyre është një fjalë Hyjnore që tregon Folësin e parapërjetshëm në një mënyrë më të fuqishme se sa Fjala. Kështu ky vërset i Kur'anit shikon tek ky kuptim gjithashtu në mënyrë aluduese.

Njohja i përket vetëm Allahut. Asnjë nuk e di të panjohurën përveç Allahut.

*** * ***

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Dhe Ne zbritëm hekur në të cilin ka forcë të madhe (në çështjet e luftës) si dhe shumë përfitime për njerëzimin...".[10]

[Një përgjigje shumë e rëndësishme dhe e shkurtër për një pyetje që lidhet me këtë vërset të Kur'anit. Këtë pyetje e shtroi një personalitet i shquar i cili kishte njohuri në shkencat moderne. Me këtë pyetje ai heshti disa dijetarë e hoxhallarë.]

Pyetje: Thuhet se hekuri nxirret prej tokës dhe nuk zbret prej qiellit, sa të thuhet: "*Ne e zbritëm*". Përse nuk tha Kur'ani, "*E nxorëm"* në vend të "*Ne e zbritëm*"? Kjo në dukje nuk përputhet me realitetin?

Përgjigjja: Me frazën "*Ne e zbritëm*", Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm sjell ndërmend mirësinë e gjërë e të rëndësishme në jetë që përfshihet në hekur; sepse Kur'ani i gjithurtë nuk tërheq vëmendjen për tek vetë lënda e hekurit që të thotë, "Ne e nxorëm", por thotë "*Ne e zbritëm*" për të sjellë ndërmend mirësinë madhështore që ndodhet në hekur dhe sa i nevojshëm është njerëzimi për të.

Dhe meqenëse aspekti i mirësisë nuk del nga poshtë lart por vjen prej thesarit të mëshirës dhe pa dyshim thesari i mëshirës është i lartësuar, lart dhe me një nivel të lartë, kështu mirësia zbret nga lart poshtë, dhe niveli i njerëzimit nevojtar për të sigurisht është poshtë. Dhe mirëbërësia është sipër nevojës. Prandaj mënyra e saktë për të shprehur faktin se mirësia vjen nga thesari i mëshirës për të plotësuar nevojën e njerëzimit është, "*Ne e zbritëm*", dhe jo "Ne e nxorëm".

Gjithashtu, meqenëse nxjerrja graduale e hekurit realizohet nëpërmjet dorës së njeriut, fjala *nxjerr* nuk e zgjon një person të pakujdesshëm për aspektet e tij të mirësisë dhe as që t'i ndjejë ato. Po,

[10] Kur'an, 57:25

në qoftë se ajo synohet do të ishte substanca materiale e hekurit, atëherë shprehja "nxjerrje" është për sa ka të bëjë me situatën e tij fizike, me vendin lëndor. Por cilësitë e hekurit, dhe mirësia që është kuptimi i synuar këtu, janë jolëndore; prandaj ky kuptim nuk orientohet tek vendi lëndor, tek situata fizike, por tek shkalla jolëndore apo tek niveli jolëndor. Mirësitë që burojnë nga thesari i mëshirës e cila është njëra nga manifestimet e shkallëve të lartësuara pafundësisht të të Gjithëmëshirshmit, sigurisht dërgohen nga stacioni më i lartë për tek niveli më i ulët. Kështu, shprehja e saktë e kësaj është: *"Ne e zbritëm".* Kur'ani i gjithurtë i kujton njerëzimit se hekuri është një nga mirësitë e mëdhaja Hyjnore.

Po, burimi i të gjitha industrive të njerëzimit dhe i përparimit dhe i progresit të tij dhe boshti i forcës dhe i fuqisë së tij, është hekuri. Kështu, me qëllim që ta sjellë ndërmend këtë mirësi madhështore Kur'ani e përmend me të gjithë madhështinë, me dinjitetin e në stil të lartë dhënien e kësaj dhurate duke thënë:

"Dhe Ne zbritëm hekur në të cilin ka forcë të madhe (në çështjet e luftës) si dhe shumë përfitime për njerëzimin", ashtu siç përmend mrekullinë më të madhe të Hazreti Dautit a.s. nëpërmjet Fjalës së Zotit xh.sh. *"Dhe Ne ia bëmë atij hekurin të butë".*[11]

Domethënë, ai e tregon dhe e shfaq zbutjen e hekurit, një mrekulli të madhe dhe një mirësi të madhe për një profet të madh.

Së Dyti: *Lart* e *poshtë* janë shprehje relative. Ato janë lart e poshtë në lidhje me qendrën e globit tokësor.

Në fakt, diçka që është poshtë në lidhje me ne është lart nga këndvështrimi i kontinentit Amerikan. Kjo do të thotë se situata e substancave që vijnë nga qendra e tokës për tek sipërfaqja e saj ndryshon sipas pozitës së njerëzve në sipërfaqen e tokës.

Me gjuhën e mrekullisë, Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm deklaron se hekuri përmban aq shumë dobi e avantazhe të mëdha, saqë ai nuk është një substancë e zakonshme që nxirret nga magazina e tokës që është vendbanimi i njeriut, dhe as nuk është një mineral

[11] Kur'an, 34:10

natyral që përdoret në nevoja mbarë e prapë, kuturu. Përkundrazi, me qëllim që të shprehë dobitë e përgjithshme të hekurit ai deklaron se ai është një mirësi e depozituar nga Krijuesi i Universit në thesarin e mëshirës dhe e ka përgatitur në uzinën madhështore të Universit, të cilin e zbriti nëpërmjet titullit të Tij madhështor "*Krijuesi i qiejve dhe i tokës"* për të përmbushur nevojat e banorëve të tokës. Ashtu siç kanë dobi lëvizja, nxehtësia dhe drita që vijnë nga qielli, po ashtu edhe hekuri përmban dobi të gjithanshme të tilla, saqë ai u dërgua nga Uzina e Universit dhe jo nga magazina e ngushtë e tokës. Ai u dërgua duke pasë qenë i përgatitur në thesarin e madh të mëshirës në pallatin e Universit, pastaj u dërgua në tokë dhe u vendos në magazinën e tij me qëllim që të nxirret gradualisht nga ajo magazinë sipas nevojës së shekujve.

Kur'ani i gjithurtë nuk dëshiron ta shprehë hekurin i cili nxirret pak e nga pak prej kësaj magazine të vogël, prej tokës, por dëshiron të sqarojë se ajo mirësi madhështore u zbrit nga thesari më i madh i universit së bashku me globin tokësor. Domethënë, gjëja më e domosdoshme për shtëpinë e tokës është hekuri, sepse kur Krijuesi i Gjithëlavdishëm e ndau tokën nga qielli zbriti së bashku me të hekurin për të përmbushur me të nevojat më të mëdhaja të njerëzimit. Kur'ani i gjithurtë thotë në mënyrë të mrekullueshme në kuptim: "*Realizoni punët tuaja me këtë hekur dhe përpiquni të përfitoni prej tij duke e nxjerrë nga brendësia e tokës".*

Ky vërset madhështor tregon dy lloje mirësish të cilat janë boshti për të zmbrapsur armiqtë dhe për të tërhequr dobitë. Sigurisht që u shikua arritja e dobive të rëndësishme të hekurit për njerëzimin para shpalljes së kur'anit, por ama me frazën, *"Në të cilin ka forcë të madhe (në çështjet e luftës).*",[12] ai tregon se në të ardhmen, duke u përdorur për udhëtime nëpër det, ajër dhe tokë, hekuri do ta nënshtronte globin në një mënyrë të jashtëzakonshme e të çuditshme, dhe do të demonstronte një fuqi të jashtëzakonshme që kërcënon me vdekje. Kështu, nga llojet e tij të ndryshme të mrekullisë, vërseti shfaq një shkreptimë mrekullie duke njoftuar për të ardhmen.

*** * ***

[12] Kur'an, 57:25

Ndërsa po diskutonim pikën e lartëpërmendur, u hap fjala rreth Pupëzës së Sulejmanit a.s.. Njëri nga vëllezërit tonë i cili ngulmon në pyetje, pyeti[13]: Pupëza e përshkruan Krijuesin Gjithëbujar xh.sh. me fjalinë,

"... i Cili nxjerr në dritë çfarë fshihet në qiej dhe në tokë..."[14]

Cila është arsyeja që ajo e përmend në këtë stacion madhështor me këtë përshkrim të hollë në lidhje me Atributet madhështore, ndërsa ndodhen atribute më të rëndësishme Hyjnore?

Përgjigjja: Njëra nga veçoritë e fjalës elokuente është që të bëjë të kuptueshme prokopinë ose mjeshtërinë me të cilën preokupohet krejtësisht folësi. Ashtu si falltorët nomadë të cilët nëpërmjet intuitës së tyre të ngjashme me kerametin, zbulonin vendet e fshehura ku gjendej ujë në shkretëtirën e Gadishullit Arabik, po ashtu si një falltore -njohëse- midis zogjve dhe kafshëve, pupëza e Sulejmanit ishte një zog i bekuar i urdhëruar për të gjetur ujë dhe bënte punën e ideatorit tek Hazreti Sulejmani a.s., kështu ai mund të vihej në punë. Ajo deklaron nëpërmjet masës së artit të vet se Allahu i Plotëfuqishëm e provon përshtatshmërinë e Tij për të qenë i Adhuruar dhe për t'i rënë në sexhde duke bërë të njohur gjërat e fshehura në qiej e në tokë.

Po, sa mirë e pa atë pupëza! sepse prirja e natyrshme e numrave të pallogaritshme të farërave, të bërthamave dhe të mineraleve nën tokë është të dalin nga poshtë lartë; sepse trupat e rëndë, qënie të tilla që janë pa shpirt dhe pa zgjedhje -dëshirë- nuk ngjiten vetë lart, por bien nga lartë poshtë. Në mënyrë të veçantë një trup i fshehur nën rëndesën -peshën- e tokës, nuk mund ta heqë vetë atë peshë të rëndë nga shpatullat e tij të pajetë dhe të shfaqej lart. Kjo do të thotë se ai do ta bënte këtë vetëm se nëpërmjet një fuqie të jashtëzakonshme, dhe jo vetë.

Pupëza kuptoi nëpërmjet parashikimit, artit të saj, më të fshehurën dhe më të rëndësishmen e provave të përshtatshmërisë Hyjnore për të

[13]Kjo i referohet Refetit, i cili është i zellshëm në bërjen e pyetjeve, por përtac në shkrimin e Risaleve. Autori

[14] Kur'an, 27:25

qenurit e Allahut i Adhuruar, dhe Ai të Cilit i bëhet sexhde, kështu Kur'ani i gjithurtë dha një mrekulli duke u shprehur lidhur me të.

*** * ***

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Dhe Ai zbriti për ju nga bagëtitë tetë palë. Ai ju krijon ju në barkun (mitrat) e nënave tuaja, krijim pas krijimi (hap pas hapi në faza të caktuara) nën tri perde errësire...".[15] Ky vërset përmban të njëjtën pikë që ne shpjeguam në diskutimin e vërsetit,

"Dhe Ne zbritëm hekur..."[16]

Ajo edhe e mbështet atë, dhe njëkohësisht mbështetet prej saj. Po, duke thënë në suren *el-Zumer:* "*Dhe Ai zbriti për ju nga bagëtitë tetë palë",* dhe duke mos thënë: "Dhe Ai krijoi për ju nga bagëtitë tetë palë", Kur'ani i Gjithurtë deklaron se, tetë llojet e kafshëve të bekuara janë zbritur për ju dhe janë dërguar për tek ju nga thesari i mëshirës Hyjnore, sikur ato të ishin dërguar nga xhenneti, sepse ato kafshë të bekuara janë mirësi për njerëzimin me të gjitha pjesët e tyre, sepse nga leshi i tyre ose nga qimet e tyre bëhen rrobat, nga mishi i tyre përgatiten ushqimet më të shijshme, nga qumështi i tyre nxirren ushqimet më të mira dhe nga lëkurat e tyre prodhohen këpucë e sandale dhe materiale të tjera të dobishme, madje dhe plehu i tyre është si ushqim për bimësinë, për të mbjellat dhe si lëndë djegëse për njeriun. Sikur ato kafshë të bekuara janë thjesht një mirësi e pastër dhe mëshirë e mishëruar.

Për shkak të kësaj, ashtu si shiu që është quajtur *rahmet* -mëshirë- edhe këto kafshë të bekuara janë quajtur *an'am* -mirësi.

Ashtu si mëshira e mishëruar që bëhet shi, po ashtu mirësia e mishëruar merr formën e dhive, deleve, gjedhëve, bullicave dhe deveve. Sigurisht trupat e tyre fizikë krijohen në tokë, por meqenëse

[15] Kur'an, 39:6
[16] Kur'an, 39:25

atributi i të qenurit mirësi dhe kuptimi kanë mbisundim të plotë mbi qëniet e tyre fizike, atëherë në përputhje me frazën "*Dhe Ai zbriti*", Krijuesi Mëshirëplotë i dërgoi këto kafshë të bekuara drejtpërdrejtë nga shkalla e mëshirës së Tij të lartë dhe nga Parajsa e Tij e lartësuar jolëndore, si dhurata nga thesari i mëshirës, si dhurata për në faqen e tokës pa ndërmjetësi.

Po, ndonjëherë një art me vlerën e pesë lirave përfshihet në një material me vlerën e pesë qindarkave. Atëherë nuk merret në konsideratë materiali i gjësë, por i jepet rëndësi artit që gjendet mbi të, ashtu si arti i madh Hyjnor që gjendet në trupin e vockël të mizës. Ndonjëherë, në një material të vlefshëm është një art i pakët, i pavlerë. Atëherë materiali ka dominancë.

Në të njëjtën mënyrë, ndonjëherë, një lëndë fizike mund të mbajë kuptimet e mëshirës dhe kuptimet e mirësive aq të shumta saqë janë njëqind herë më të rëndësishme se sa lënda e saj, saqë sikur lënda fizike e asaj gjëje fshihet dhe tërhiqet para madhështisë së rëndësisë së mirësisë dhe të mëshirës, prandaj aspekti i saj i të qenurit mirësi është mbisundues.

Ashtu si dobitë e mëdha që ka hekuri dhe produktet e tij të shumta që fshihen në aspektin e tij material, po ashtu mirësia që është e pranishme në çdo pjesë të kafshëve të bekuara, që u përmendën lart, e ka transformuar lëndën e tyre fizike në mirësi dhe atributet e tyre jolëndore janë marrë në konsideratë, duke mos marrë parasysh qëniet e tyre fizike; prandaj u shpreh për to në vërsetin Kur'anor me frazat: *"Ai zbriti..."*, dhe *"Ne zbritëm"*.

Po, shprehjet, "*Dhe Ai zbriti...* dhe *Ne zbritëm*", ashtu siç tregojnë pikat e lartëpërmendura për sa ka të bëjë me realitetin, ato gjithashtu shprehin në mënyrë të mrekullueshme një kuptim të rëndësishëm lidhur me elokuencën. Ai është siç vijon:

Së bashku me natyrën e tij tej mase të fortë, qënien e tij i fshehur, shpeshherë i thellë nën tokë, hekuri gjendet në çdo vend, dhe i është dhënë cilësia e zbutjes së tij me lehtësi si brumi. Atëherë gjithësecili mund ta sigurojë atë me lehtësi gjithandej dhe mund ta përdorë për çdo punë.

Me qëllim që ta shprehë këtë ai pohon nëpërmjet frazës "*Dhe Ne e zbritëm hekurin*" duke treguar këtë kuptim, domethënë, sikur hekuri është një mirësi prej mirësive të natyrshme qiellore që mund të arrihet me lehtësi dhe sikur çdo material hekuri të zbriste nga një uzinë e lart sublime dhe i dorëzohet -i jepet- me lehtësi dorës së njeriut.

Gjithashtu kafshët gjigante si gjedhët, bullicat, devetë dhe të tjera nga krijesat e mëdha, janë të nënshtruara, të shtruara e të bindura madje edhe për një fëmijë të vogël, pasi ato mund të drejtohen edhe nga fëmijët. Me qëllim që ta shprehë kuptimin e nënshtrimit të tyre, vërseti,

"Dhe Ai zbriti për ju nga bagëtitë tetë palë", pohon se duke mos qenë as të egra dhe as të rrezikshme, këto kafshë të bekuara nuk u ngjasojnë kafshëve të kësaj dynjaje. Përkundrazi, ato janë të dobishme dhe të padëmshme si kafshë qiellore. Ato janë zbritur prej lart, domethënë, prej thesarit të mëshirës.

Është e mundur se pohimi i disa komentatorëve që thonë se këto kafshë janë zbritur nga Parajsa buron nga ky kuptim që u përmend[17].

Nuk duhet të thuhet se është e zgjatur të shkruash një faqe për një shkronjë të vetme të Kur'anit të gjithurtë, sepse ai është Fjala e Zotit. Prandaj, nuk ka qenë e tepërt të shkruarit e dy ose tri faqeve për shprehjen "*Dhe Ne e zbritëm*".

Ndonjëherë një shkronjë e Kur'anit është çelësi për një thesar të madh jolëndor.

* * *

[17] Disa komentatorë kanë thënë: Origjinat e këtyre kafshëve kanë ardhur nga qiejt. Synimi i tyre për këtë është ky:

Ekzistenca e vazhdueshme e kafshëve të quajtura si *an'am* është nëpërmjet *Rizkut* -ushqimit; rizqet e tyre janë bari e bimët, rizku i bimëve vjen nga shiu; shiu është uji i jetës dhe mëshirë e zbritur nga qielli: kështu rizku vjen nga qiejt. Ajeti *"Dhe në qiell është rizku juaj"* (Kur'an, 51:22) tregon këtë kuptim. Meqenëse ekzistencat e ripërtërira vazhdimisht të atyre kafshëve qëndrojnë tek shiu që vjen nga qiejt, atëherë shprehja "*Dhe Ne e zbritëm*" është me vend dhe e përshtatshme, pasi shpreh kuptimin e të qenurit i zbritur nga qiejt. Autori.

\Pjesë të shkruara në Burgun Eskishehir si një ngushëllim i vërtetë për studentët e Risale-i Nurit.

Vëllezërit e mi të dashur!

Unë isha shumë i shqetësuar për ju; Po dërrmohesha nga pikëllimi, por m'u shfaq mua në zemër se Kaderi Hyjnor dhe fati juaj ua ka dhënë të gjithëve këtë ujë burgu për ta pirë dhe këtë bukë për ta ngrënë. Unë pashë se si një shenjë e mëshirës Hyjnore dhe si një manifestim i favorit Hyjnor, ngrënia juaj bashkarisht këtë bukë dhe pirja e këtij uji ishte më e kollajta, më e lehta, më e mira dhe më e lavdërueshmja e rrugëve, e mënyrave; që ky burg ishte vendi më i dobishëm i udhëzimit për studentët e Risale-i Nurit dhe vendi më i shndritshëm i provës; ishte vendi më i saktë i provimit duke instruktuar se sa thelbësore është të sillesh me maturi e kujdes përballë armiqve të gjithkujt. Unë e pashë atë në formën e një vendi më të shndritshëm studimi dhe një *teqe* për të mësuar e për të përfituar nga cilësitë e larta dhe veçoritë e holla të shokëve tanë këtu, të cilat janë të gjitha të ndryshme dhe për të ndërtuar e ripërtërirë vëllazërinë ndërmjet tyre. Prandaj unë nuk shfaqa ankesë rreth kësaj situate, por dhashë falënderime me të gjithë shpirtin tim. Po, rruga jonë është të japësh falënderime, dhe është të shohësh një aspekt mëshire dhe një aspekt mirësie në çdo gjë.

Nga vëllai juaj i cili pikëllohet për dhimbjet e ju të gjithëve.

Said Nursi.

*** * ***

Një Rregull

Studentët e Risale-i Nurit nuk duhet të kërkojnë dritë jashtë rrethit të Risale-i Nurit dhe nuk duhet që ata ta bëjnë një gjë të tillë.

Në qoftë se ndonjëri prej tyre do ta kërkonte, ai do të gjente veçse një llambë në vend të një dielli shpirtëror i cili jep dritë nëpërmjet dritares së Risale-i Nurit, dhe madje ai ndoshta mund ta humbasë diellin.

Pastaj, metoda e pastër dhe e fuqishme e shoqërisë dhe e vëllazërisë brenda rrethit të Risale-i Nurit, e cila fiton shpirtëra të shumtë për çdo individ dhe shfaq një mister prej mistereve të vëllazërisë të cilën e trashëguan Sahabët e nderuar prej dritës së profetësisë; kjo metodë nuk lë nevojë për të kërkuar një *murshid* -udhëzues shpirtëror- apo një baba jashtë asaj sfere, në një mënyrë që është e dëmshme për ta në tre aspekte; ajo siguron shumë vëllezër më të mëdhenj, në vend të një babai të vetëm. Nuk ka dyshim se llojet e dhembshurisë që burojnë nga zemrat e vëllezërve më të mëdhenj e bëjnë dhembshurinë e babait të vetëm si asgjë.

Po, ai i cili mori për veten e tij një *shejh* para se të hynte në sferën e Risale-i Nurit, mund t'i ruajë lidhjet e tij me shejhun e tij apo me murshidin brenda sferës së Risale-i Nurit gjithashtu. Por ai që nuk ka patur shejh para hyrjes në Risale-i Nur, ai mund të kërkojë udhëzues vetëm brenda rrethit të Risale-i Nurit.

Për më tepër, njohja e realitetit që mësohet brenda rrethit të Risale-i Nurit, i cili jep shkëlqimin e trashëgimisë profetike, e *Shenjtërisë më të madhe,* nuk lë nevojë për t'u lidhur me tarikatet Sufi jashtë atij rrethi; veçse ai që e keqkupton mënyrën e tarikatit, që është i dhënë pas ëndrrave të këndshme, imagjinatave, dritave dhe kënaqësive shpirtërore, dëshirave të dynjasë, ëndjeve imagjinare, të cilat janë të ndryshme me virtytet e Ahiretit, dhe që kërkon një rang për t'iu referuar ashtu si adhuruesit e nefsit.

Kjo dynja është vend urtësie, vend pune e shërbimi; shpërblimi është i përpjesëtueshëm me mundimin dhe vështirësinë; ajo nuk është vend shpërblimi e kompensimi. Për shkak të kësaj, njerëzit e realitetit nuk u japin rëndësi ëndjeve dhe dritave të ndriçimeve dhe të kerameteve. Në të vërtetë, ata ndoshta ikin prej tyre dhe dëshirojnë t'i fshehin.

Për më tepër, rrethi i Risale-i Nurit është shumë i gjërë dhe studentët e tij janë tepër të shumtë. Ai nuk i kërkon ata të dalin prej atij rrethi; ai nuk u jep aspak rëndësi atyre dhe ndoshta nuk do t'i pranojë përsëri ata brenda rrethit të tij; sepse njeriu ka vetëm një zemër, dhe një zemër e vetme nuk mund të jetë njëherësh edhe brenda rrethit, edhe jashtë tij.

Gjithashtu, ata që janë të dëshirueshëm për udhëzim jashtë rrethit të Risale-i Nurit, nuk duhet të preokupohen e të merren me studentët e Risale-i Nurit, pasi është e mundur që ata të marrin dëm në tre drejtime. Kështu studentët të cilët janë brenda rrethit të *Takvasë*, frikës ndaj Zotit, nuk kanë nevojë për udhëzim, duke ditur se jashtë rrethit janë shumë prej atyre që kanë braktisur kryerjen e pesë namazeve të përditshme të detyruara. Atëherë t'i lësh ata dhe të preokupohesh me këta të devotshëm nuk është aspak udhëzim. Në qoftë se një person i tillë i do këta studentë, ai le të futet së pari brenda rrethit dhe le të jetë për ta një vëlla dhe jo një baba, dhe në qoftë se është shumë i virtytshëm e me cilësi të larta, le të jetë për ta një vëlla i madh.

Gjithashtu është bërë e qartë nga kjo ngjarje se të qenurit i lidhur me Risale-i Nurin ka një rëndësi të madhe dhe një çmim shumë të lartë. Një person i udhëzuar i cili i bën këta sakrifica dhe që e lufton ateizmin në emrin e botës islamike, në qoftë se do të ishte i ndjeshëm, nuk do ta linte këtë mënyrë, metodë, e cila është më e çmueshme se sa diamanti dhe nuk do të mund të përqafonte metoda të tjera.

Said Nursi

* * *

Një pjesë e shkurtër e shkruar në Burgun Eskishehir

Vëllezërit e mi!

Në shumë raste unë i kam mbrojtur studentët e Risale-i Nurit në mënyrën që u përshtatet atyre. Në dashtë Zoti xh.sh., unë do ta them atë në gjykatë me zërin tim më të lartë dhe do të bëj që të gjithë ta dëgjojnë Risale-i Nurin dhe rangun e vlerën e studentëve të tij. Unë do t'ju kujtoj ju ç'ka vijon:

Kushti për mbajtjen e kësaj përmendjeje të vlerës suaj në mbrojtjen time është që ndjenja juaj të mos preket e ofendohet për shkak të eksperiencave të dhimbshme dhe të trysnive të kësaj ngjarjeje dhe të tjerave si kjo, as të mos preket vëllai prej profesorit të tij, as të mos ndjehet i ftohur nga vëllezërit me pretekstin e vështirësive dhe të mundimeve që vuan, as të mos gjurmojnë të metat dhe as të mos akuzojnë njëri-tjetrin.

Ju do ta kujtoni se në trajtesën rreth Kaderit Hyjnor ne kemi provuar se ndodhen dy aspekte për padrejtësitë që i bien njeriut: njëri është aspekti i njeriut, dhe tjetri është i Kaderit Hyjnor.

Në një ngjarje të vetme njeriu bën padrejtësi, por Kaderi Hyjnor është i drejtë dhe vepron me drejtësi.

Në këtë çështjen tonë, ne duhet të mendojmë më shumë rreth drejtësisë së Kaderit Hyjnor dhe misterit të urtësisë Hyjnore se sa të mendojmë rreth tiranisë dhe padrejtësisë së njeriut.

Po, Kaderi Hyjnor i ka ftuar studentët e Risale-i Nurit për tek ky tubim. Dhe urtësia e shfaqjes së xhihadit *Maënevij* i ka shtyrë ata për tek kjo *shkollë Jusufie*, e cila është vërtet mbytëse dhe dëshpëruese. Dhe tirania e njeriut dhe pretekstet u bënë mjetet për të. Prandaj, ruhuni, kini kujdes! Mos i thoni njëri-tjetrit: "Në qoftë se nuk do të kisha vepruar kështu, unë nuk do të isha arrestuar."

Said Nursi

*** * ***

Pjesë nga fjala ime mbrojtëse, e cila u përfshi këtu dhe pastaj nuk u hoq, nuk u lëviz.

Unë kërkoj një të drejtë të rëndësishme nga kryetari dhe nga anëtarët e gjykatës, ajo është siç vijon:

Në këtë çështje nuk është vetëm personi im që mbahet nën mbykëqyrje saqë duke më shfajësuar e duke u bërë të vetëdijshëm për realitetin e çështjes, çështja do të zgjidhej; sepse personaliteti kolektiv i njerëzve të devotshëm dhe i njerëzve të dijes është akuzuar e fajësuar në sytë e kombit, dhe një mungesë besimi është ngjallur në qeveri ndaj dijetarëve fetarë dhe ndaj të devotshmive dhe ata kanë nevojë të dinë se si do t'i shmangin përpjekjet e rrezikshme e të dëmshme kundër tyre.

Prandaj unë kërkoj që kjo pjesa e fundit e mbrojtjes sime të botohet në letrat e reja dhe të shpërndahet. Atëherë, të drejtit dhe dijetarët nuk do të mashtroheshin nga intrigat, as nuk do të hynin në ngjarje e aventura të rrezikshme e të dëmshme.

Personaliteti i tyre kolektiv do të shpëtonte nga të qenurit objekt dyshimi në sytë e kombit. Edhe qeveria gjithashtu do të kishte mirëbesim tek dijetarët dhe do t'i jepte fund këtij keqkuptimi. Atëherë incidentet dhe keqkuptimet si këto, të cilat janë tej mase të dëmshme për qeverinë, kombin dhe vendin, nuk do të përsëriteshin.

Said Nursi

*** * ***

Vëllezërit e mi!

Në qoftë se gjithësecili, madje edhe unë, do të tërhiqeshim nga mbrojtja dhe ruajtja e Risale-i Nurit, pesë nga vëllezërit tonë nuk duhet të tërhiqen. Këto janë: Husejn Usta, Halil Ibrahim, Refet Bey, Husrev dhe Haki Efendi. Mungesa e pavullnetshme e kujdesit të tre të parëve... për shkak të inateve personale të armiqve të hapur të dy të fundit - qëllimi ishte për t'i shkaktuar dëm të madh Risale-i Nurit. Në qoftë se nuk do të kishte rezultuar, përfunduar me një mirësi të madhe si Risale-i Nuri duke u përhapur e duke u bërë i njohur deri në një shkallë të

rëndësishme, këta vëllezër do të kishin qenë shumë të mërzitur për shkaktimin e mjerimit për shumë studentë të pafajshëm të Risale-i Nurit. Kështu, më shumë se çdokush tjetër, këta pesë vëllezër duhet të jenë të kujdesur e të bashkuar.

Said Nursi

*** * ***

Vëllezërit e mi!

Iu shfaq zemrës sime se, ashtu si *Methnevi Rumi* që u bë pasqyrë për një të vërtetë prej shtatë të vërtetave që shfaqen nga drita e diellit të Kur'anit të Gjithurtë, duke fituar kështu një pozitë të lartë dhe një prestigj sublim, saqë u bë udhëzues i pavdekshëm për shumë 'njerëz të zemrës', përveç *mevlevive*, po ashtu Risale-i Nuri, do të arrijë në dashtë Zoti një pozitë të lartë dhe një shquarsi të shenjtë në shtatë drejtime, dhe do të jetë një udhëzues i përjetshëm dhe mësues për njerëzit e Realitetit, sa shtatë herë Methnevi Rumiu, sa shtatë Methnevi Rumi; sepse Risale-i Nuri përfaqëson shtatë dritat e dritës së diellit të Kur'anit të gjithurtë dhe shtatë ngjyrat e ndryshme në dritën e tij, dhe i përfaqëson bashkarisht në pasqyrën e Risale-i Nurit.

Said Nursi

*** * ***

Vëllezërit e mi!

Shikojeni mbrojtjen e Ruajtësit të Gjithëlavdishëm! Si një koinçidencë me numrin e trajtesave të Risale-i Nurit, njëqind e njëzet njerëz u morën në pyetje bashkë me dokumentet e tyre të besuara. Megjithatë, pavarësisht intrigave të të huajve dhe dredhive të organizatave të fshehta, asgjë nuk u gjet që të tregonte lidhjen e ndonjë studenti të Risale-i Nurit me ndonjërën prej organizatave të shumta ekzistuese. Ky ishte shembulli më i qartë i shndritshëm i mbrojtjes Hyjnore, i ruajtjes Hyjnore dhe një favor nga i Gjithëmëshirshmi duke

mbështetur parashikimet e mrekullueshme lidhur me Risale-i Nurin që bënë Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të, dhe Gauthul Aëdham, Zoti qoftë i kënaqur me të. Duart e ngritura për dua të dyzet e dy vëllezërve tonë të pafajshëm ndaj të cilëve u bë padrejtësi, duke u lutur para Derës Hyjnore ndaluan një raketë të drejtuar ndaj tyre, e kthyen mbrapsht atë dhe në efekt e shpërthyen atë mbi kokat e atyre të cilët e kishin lëshuar. Humbjet tona llogariten të jenë vetëm pak prerje të pjesshme e lëndime të cilat do të na bëjnë ne të fitojmë shpërblim. Është një mrekulli të shpëtosh me një plagë të tillë të vogël prej një arme që ishte duke u mbushur në vitin e kaluar. Njeriu duhet t'i përgjigjet një mrekullie të tillë të madhe me falënderime e me gëzim. Pas kësaj jetët tona nuk do të ishin tonat, sepse sipas planeve të përhapësve të korrupsionit, ne duhet të zhdukeshim. Kjo do të thotë se pas kësaj ne duhet t'i vëmë e t'i japim jetët tona jo për vetet tona, por për të vërtetën dhe për realitetin. Ne duhet gjithmonë të përpiqemi ta shohim këtë gjurmë, fytyrë dhe këtë esencë mëshire në gjërat, të cilat do të na bënin ne jo të ankohemi, por të japim falënderime.

Said Nursi

*** * ***

Unë u kërkoj vëllezërve të mi që të mos mbeten të ofenduar nga njëri-tjetri për shkak të ngushticës së madhe, shqetësimit, ose të dëshpërimit shpirtëror ose nazeve ose për shkak të të qenurit i mashtruar nga dredhitë e shejtanit ose për shkak të gjuhës fyese të shprehur nga disa prej tyre. Ata nuk duhet të thonë se nderi i tyre është prekur e fyer. Unë i marr mbi vete çdo fjalë të keqe që është thënë. Ata nuk duhet të ofendohen. Në qoftë se do të kisha njëqind ndere, unë do t'i sakrifikoja të gjitha ato për dashurinë dhe për përzemërsinë midis vëllezërve të mi.

Said Nursi

*** * ***

Vëllezërit e mi!

Unë kam kuptuar me siguri se dy apo tri ditët e shkuara, për fat të keq, ne morën një goditje nga mëshira Hyjnore. Madje unë kuptova se një prej shumë treguesve të një vërseti lidhur me njerëzit e mosbindjes shikon nga larg për tek ne.

Ajo është kështu:

"Kështu, kur ata harruan këshillën (paralajmërimin) që ata patën marrë, që u qe kujtuar.... Ne i morëm ata në ndëshkim..."[18]

Domethënë, kur ata harruan udhëzimin dhe këshillën me të cilat Ne i patëm paralajmëruar dhe ata nuk vepruan në përputhje me to, Ne i morëm ata në ndëshkim dhe u zbritëm fatkeqësi".

Po, kohët e fundit, u nxitëm të shkruanim një trajtesë mbi kuptimin e sinqeritetit. Në të vërtetë, ajo ishte një trajtesë shumë e lartë e sublime dhe një rregull i shndritshëm për vëllazërinë dhe një parim i shenjtë i cili u lejon dhjetë burrave t'u bëjnë ballë fatkeqësive dhe ngjarjeve të cilave normalisht do të mund t'u bëhej ballë vetëm me fuqinë e dhjetë mijë vetave -dhe kjo me misterin e atij sinqeriteti- por unë me keqardhje them: Ne nuk mundëm, me mua në krye, të veprojmë në përputhje me atë paralajmërim shpirtëror dhe ky vërset na ndëshkoi ne me kuptimin e tij aludues, dhe u sprovua një grup prej nesh me një goditje disiplinuese të dhënë nga mëshira Hyjnore. Ndërsa ajo nuk ishte goditje disiplinuese për disa të tjerë, por një mjet ngushëllimi mbi ta dhe që të fitonin nëpërmjet saj thevab për veten e tyre. Në përputhje me kuptimin aludues të vërsetit, sipas shkencës së *xhefrit* vlera e "*Ne i morëm ata në ndëshkim*", është një mijë e treqind e pesëdhjetë e dy. Ne u arrestuam në të njëjtën datë.

Po, që prej tre muajsh, për shkak se kam qenë i ndaluar nga përzierja me të tjerët, unë nuk kam mundur të njihem me gjendjet e vëllezërve të mi veçse qysh prej tre ditësh. Ndodhi një ngjarje e paimagjinueshme që ishte në kundërshtim me kuptimin e sinqeritetit, në të cilën u përfshinë vëllezërit, të cilët i kisha supozuar të ishin më të sinqertit. Nga kjo unë kuptova se një kuptim aludues i vërsetit,

[18] Kur'an, 6:44

"Por, kur ata harruan këshillën (paralajmërimin) që patën marrë... Ne i morëm ata në ndëshkim", na shikonte ne nga larg.

Për njerëzit e çudhëzimit, për të cilët vërseti u shpall, ky është ndëshkim për ta, ndërsa për ne ai është një goditje mëshire dhe disiplinuese me qëllim që të edukojmë vetet tona dhe si shlyerje për gjynahet tona dhe që ne mund të zhvillojmë shkallët shpirtërore.

Dëshmia që ne e morëm këtë goditje për shkak se nuk e vlerësuam plotësisht vlerën e mirësisë Hyjnore që ne patëm marrë është se ne nuk qemë të kënaqur me shërbimin tonë të shenjtë të Kur'anit nëpërmjet Risale-i Nurit i cili përmban *xhihadin maënevij,* xhihadin më të shenjtë në rrugën e Zotit, që arriti shenjtërinë më të madhe nëpërmjet shkëlqimit të trashëgimisë profetike dhe që është mjeti për të arritur esencën e rrugës së Sahabëve të nderuar. Nëpërmjet paralajmërimeve të mia të ashpra në disa raste, dëshira për t'iu bashkuar një tarikati Sufi u parandalua, avantazhet, dobitë, e të cilit janë shumë të pakta për ne në kohën e tanishme dhe vetëm do të kishte qenë e mundur që të na shkaktonte shumë dëm në këtë situatë. Përndryshe, edhe uniteti ynë do të ishte prishur, dhe do të kishte shkaktuar ndryshime në ide e mendime, të cilat do ta kishin ulur vlerën e katër Elifave (IIII) -të cilët nëpërmjet solidaritetit, duke qenë të bashkuar, kanë vlerën e një mijë e njëqind e njëmbëdhjetës- në katër, dhe antipatia, urrejtja e ndërsjellë, e cila do ta pakësonte fuqinë tonë duke e zbritur në asgjë.

Autori i "*Gjylistanit*", Shejh Sadi Shirazi, rrëfen:

Unë pashë njërin prej njerëzve të zemrës në një *teqe* ndërsa merrej me udhëtimin e tij shpirtëror. Pas disa ditësh unë e pashë atë në medrese midis studentëve të shkencave të sheriatit. Ndërkohë unë e pyeta atë: Përse e le teqenë e cila jep drita dhe erdhe në këtë medrese? Ai tha: Atje gjithësecili do të mund të shpëtonte vetveten në qoftë se do të ishin të suksesshëm, ndërsa këtu në këtë shkollë fetare, këta persona me zell të lartë po përpiqeshin të shpëtonin shumë njerëz të tjerë përkrah veteve të tyre. Fisnikëria, zelli dhe entuziazmi i lartë ishte tek këta; virtyti dhe përpjekja ishin tek ata.

Prandaj unë erdha këtu.

Kështu Shejh Sadi Shirazi shkroi një përmbledhje të kësaj ngjarje në veprën e Tij "Gjylistani".

Në qoftë se çështjet e thjeshta të studentëve duke analizuar foljet gramatikisht si "*Nesare, Nasren e Nesariu*" janë më të preferueshme e më të larta se sa virdet që bëhen nëpër teqe, atëherë po Risale-i Nuri i cili i jep mësim në mënyrën më të qartë dhe më të sigurtë të vërtetat e shenjta të imanit në pohimin e besimit: *"Unë besoj në Zotin, në Melekët e Tij, në librat e Tij, në Profetët e Tij dhe në Ditën e fundit"* dhe i hesht edhe ateistët më kryeneçë dhe filozofët më kokëfortë; sa i gabuar do të ishte ai që e braktis këtë metodë ose që e shfuqizon, ose që nuk bindet me të apo që futet nëpër teqe të mbyllura duke ndjekur tekat e tij, pa kërkuar leje nga Risale-i Nuri! Në të njëjtën kohë kjo tregon se sa shumë ne e meritojmë këtë goditje disiplinuese të mëshirës Hyjnore.

Said Nursi

* * *

PARALAJMËRIM

[Dy tregime të shkurtëra]

Tregimi i Parë: kur isha zënë rob në veri të Rusisë para pesë vitesh[19], unë së bashku me nëntëdhjetë oficerë po mbaheshim robër në sallën e një uzine të madhe, disa polemika e trazira u shkaktuan për shkak të ngushtësisë së vendit dhe të kushteve të rënda shtypëse. Unë i qetësova, meqenëse ata të gjithë kishin respekt të madh për mua. Pastaj unë caktova katër ose pesë oficerë për të mbajtur qetësi dhe u thashë: Sa herë që të dëgjoni zhurmë apo trazirë në ndonjë anë, shkoni e ndihmoni cilëndo anë që është në gabim". Në të vërtetë zhurma pushoi si rezultat i kësaj mase paraprake. Ndërkohë ata më pyetën: Përse ti the: Ndihmoni palën që s'ka të drejtë? Në përgjigje unë u thashë:

"Ata të cilët janë në gabim janë të padrejtë. Ata nuk lënë as edhe një dobi të vetme prej rehatisë së tyre për hir të qetësisë publike që është dyzet herë më e madhe.

Ndërsa dikush që është në të drejtën, ai është i paanshëm. Ai e sakrifikon dhe heq dorë nga e drejta e tij, që ka vlerë të pakët, një dirhem për hir të rehatisë dhe të dobisë së shokut të tij, e cila është pjesë e qetësisë publike dhe që ka shumë vlerë, dyzet dirhem. Zhurma dhe trazira pushojnë dhe paqja vendoset e përgjithëson. Kështu rehatohen nëntëdhjetë oficerët që banojnë në këtë dhomë. Por, në qoftë se do të ndihmohej personi që ishte në të drejtën, zhurma do të shtohej edhe më shumë. Në jetën e përbashkët të këtij lloji, dobia dhe interesi i përgjithshëm merr përparësi".

Dhe kështu, o vëllezërit e mi! Në këtë jetën tonë të përbashkët, mos thoni:

"Unë jam i mërzitur me vëllain tim, sepse ai ka qenë i padrejtë me mua". Ky do të ishte një gabim i madh në këtë jetën tonë dhe në këtë shoqërinë tonë. Në qoftë se shoku yt të ka shkaktuar ty pak dëm, sa një

19

dirhem, të qenurit tënd i mërzitur prej tij na shkakton një dëm të një çmimi të lartë, sa dyzet dirhem. Madje do të ishte e mundur t'i shkaktonte një dëm të madh, sa dyzet lira Risale- Nurit. Por, lavdi Zotit xh.sh., mbrojtjet tona të drejta, të fuqishme dhe shumë të goditura i parandaluan shkuarjen e vëllezërve tonë për t'u pyetur në mënyrë të përsëritur, dhe asnjë dëm nuk u erdhi mbrojtjeve tona të fuqishme e të drejta, dhe u shkul nga rrënjët e keqja. Përndryshe, mërzitja që ndodh midis vëllezërve na shkakton dëme të mëdha, ashtu si rënia e një fije kashte në sy ose si rënia e një shkëndije në barut.

Tregimi i Dytë: Ndodhej një grua e moshuar e cila kishte tetë djem. Ajo u dha secilit prej tyre nga një rriskë buke, por asnjë rriskë nuk mbeti për të. Pastaj gjithësecili prej tyre i ktheu asaj gjysmën e rriskës së bukës; dhe u bënë për të katër rriska buke, kurse buka e gjithësecilit prej tyre u pakësua në gjysëm rriske.

O vëllezërit e mi! Unë ndiej në veten time gjysmën e dhimbjeve shpirtërore prej të cilave lëndohet secili prej jush që arrini numrin dyzet, unë nuk shqetësohem për dhimbjet dhe për mundimet e mia personale. Një ditë unë u trondita dhe thashë: "A mos vallë ky është një ndëshkim për ndonjë gabimin tim që kisha bërë dhe për të cilin unë po ndëshkohem? Ndërkohë, unë hulumtova dhe studiova situatën time të mëparshme. Unë pashë se nuk kisha aspak pjesë në nxitjen dhe në shkaktimin e kësaj fatkeqësie; përkundrazi, unë pata përdorur çdo mjet të mundshëm për ta shmangur atë.

Domethënë, kjo fatkeqësi që na ra ishte vendim Hyjnor... Ajo ishte kurdisur kundra nesh nga intrigantët e ngatërrestarët qysh prej një viti, dhe u bë i pashmangshëm prej nesh. Ishte e pamundur që t'i shmangeshe. Ishte e pashmangshme se ne do të ndërlikoheshim në të.

Një mijë falënderime qofshin për Allahun e Plotëfuqishëm i Cili e lehtësoi dhe e zbriti fatkeqësinë nga njëqind në një.

Atëherë, si rrjedhojë e këtij fakti, mos më qortoni duke thënë: "Ne po e vuajmë këtë fatkeqësi për shkakun tënd!" Përkundrazi, më falni, dhe bëni lutje për mua. Dhe mos e kritikoni njëri-tjetrin, duke thënë:

"Në qoftë se nuk do ta kishe bërë këtë, kjo nuk do të kishte ndodhur". Për shembull, njëri nga vëllezërit tanë duke përmendur dy

ose tre nënshkrime -firma (për Risale-i Nurin), shpëtoi shumë; kjo e zbuti dhe e ngushtoi planin që kishin kurdisur keqbërësit me qëllim që të ndërlikonin shumë njerëz në fatkeqësi. Ky ishte shkaku jo për dëm, por për një dobi të madhe; sepse u bë një mjet për t'i shpëtuar shumë të pafajshëm nga kjo fatkeqësi.

Said Nursi

*** * ***

[Kjo pjesë është shumë e vlefshme. Gjithësecili mund të përfitojë prej saj deri në pikën e Dytë.]

Në lidhje me disa situata të pakëndshme të cilat shfaqen në Burgun Eskishehir, jo për shkak të moralit të keq, por si rezultat i ankthit. Kjo është rreth një pike të hollë të një vërseti të mirënjohur që ka mbetur i pazbuluar -i fshehur- dhe një pikë lidhur me sjelljen e mirë.

Pika e Parë

Nga plotësia e Allahut xh.sh., nga gjërësia e mëshirës së Tij dhe nga drejtësia, Zoti i Gjithëfuqishëm ka përfshirë një shpërblim të menjëhershëm brenda veprave të mira dhe ka fshehur një ndëshkim të menjëhershëm në veprat e në aktet e këqija dhe në të ligat. Ai ka përfshirë në veprat e mira kënaqësi shpirtërore që të kujtojnë mirësitë e Ahiretit, kurse në veprat e këqija ndodhen tortura shpirtërore të cilat të kujtojnë dënimin pikëllues të Ferrit në Ahiret.

Për shembull, të shfaqësh dashurinë dhe selamin midis besimtarëve është një veprim i lavdërueshëm për njerëzit e besimit. Të përfshira për ta në atë vepër të mirë janë një kënaqësi shpirtërore, një lumturi në zemër dhe një qetësi e rehati në zemër të cilat kujtojnë shpërblimet shpirtërore të Ahiretit.

Cilido që i referohet zemrës së tij do ta ndiejë këtë kënaqësi.

Dhe për shembull, armiqësia dhe urrejtja ndërmjet besimtarëve është një akt i keq i shëmtuar. Kjo e keqe i bën shpirtërat fisnikë të ndjejnë një torturë të ndërgjegjjes të mjaftueshme për të mposhtur zemrën dhe shpirtin. Unë vetë e kam përjetuar atë ndoshta më shumë se

njëqind herë gjatë jetës sime; kur unë kam ushqyer armiqësi ndaj një vëllai besimtar, unë kam vuajtur një torturë të tillë, saqë nuk mbetej më asnjë dyshim se kjo torturë ishte një ndëshkim i menjëhershëm për aktin tim të keq që bëra. Pikërisht për këtë, unë ndëshkohem e torturohem.

Dhe për shembull, të respektosh ata që janë të denjë për respekt e nderim; të shfaqësh simpati e mëshirë ndaj atyre që e meritojnë dhe t'i ndihmosh ata, janë vepra të mira për besimtarët. Në këto vepra të mira ndodhet një kënaqësi e një ëndje aq të mëdhaja shpirtërore saqë ato të bëjnë të ndjesh shpërblimet e Ahiretit. Ato e shtojnë respektin dhe mëshirën deri në atë shkallë saqë e bëjnë personin të gatshëm të sakrifikojë pikërisht jetën e tij. Në qoftë se dëshiron, vëreje kënaqësinë dhe shpërblimin që merr një nënë nëpërmjet mëshirës që ajo ndien për fëmijën e saj që mund të jenë aq të mëdhaja sa që ajo do të vetëflijonte vetë jetën e saj për shkak të fëmijës. Pula që sulmon një luan me qëllim që ta shpëtojë zogun e saj është një shembull i kësaj të vërtete në botën e kafshëve.

Njerëzit e mëdhenj me aspirata të larta e ndjejnë këtë dhe për këtë arsye ata marrin qëndrimin e tyre heroik.

Dhe për shembull, në lakmi e në harxhim të tepruar është një ndëshkim i tillë saqë e bëjnë njeriun të vuajë në zemrën e tij dhe në shpirtin e tij; e bëjnë njeriun të jetë ankues dhe i shqetësuar dhe e çorodisin atë. Edhe në xhelozi e në smirë ndodhet një ndëshkim i menjëhershëm saqë e djegin njeriun smirëzi para tjetrit.

Ndërsa në vetëmjaftueshmëri -kënaqësi- dhe në mbështetjen tek Zoti xh.sh. ndodhet një shpërblim i menjëhershëm dhe i kënaqshëm i tillë saqë ajo largon të gjitha dhimbjet dhe fatkeqësitë e varfërisë dhe të nevojës.

Dhe për shembull, në krenari e në mburje është një peshë e rëndë, sepse njeriu mendjemadh dëshiron respekt nga gjithkush. Dhe për arsye se përbuzet për shkak të kësaj dëshire, ai vuan torturë të vazhdueshme. Po, respekti dhurohet, ai nuk mund të kërkohet.

Dhe për shembull, në modesti dhe në braktisjen e egoizmit është një shpërblim i kënaqshëm nga i cili personi shpëton nga pesha e rëndë e përpjekjes për ta bërë vetveten të pëlqehet, nga artificializmi.

Dhe për shembull, në mendimin e keq, në keqinterpretim e në pesimizëm ndodhet një ndëshkim i menjëhershëm në këtë dynja.

Në përputhje me rregullin, "Kushdo që godet, goditet", ata që kanë mendim të keq për njerëzit zbulohen përfundimisht para mendimit të keq të njerëzve ndaj tij. Ata që i keqinterpretojnë veprat e vëllezërve të tyre besimtarë, padyshim do të zbulohen para pikërisht të njëjtit ndëshkim, ato do të keqinterpretohen.

Dhe kështu me radhë, të gjitha veprat e mira e të këqija duhet të maten në përputhje me këtë masë jardi. Unë i kërkoj mëshirës Hyjnore se ata të cilët e dëshmojnë mrekullinë e Kur'anit e shfaqur në këtë kohë në Risale-i Nur, që t'i përjetojnë e t'i shijojnë këto kënaqësi shpirtërore; ata nuk do të vuajnë nga moralet e këqija, në dashtë Zoti xh.sh..

*** * ***

Pika e Dytë

[E dyta e Njëzet e Dy Pikave]

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ ۞ مَا أُرِيدُ مِنْهُم مِّن رِّزْقٍ وَمَا أُرِيدُ

أَن يُطْعِمُونِ ۞ إِنَّ اللَّهَ هُوَ الرَّزَّاقُ ذُو الْقُوَّةِ الْمَتِينُ

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Dhe Unë (Allahu) nuk i krijova njerëzit dhe xhindet, veçse që ata duhet të më adhurojnë vetëm Mua".

Dhe nuk dua prej tyre ndonjë furnizim (për veten e tyre, ose për krijesat e Mia) dhe as nuk dua që ata të më ushqejnë Mua (të ushqejnë vetveten ose krijesat e mia)."

"Vërtet që Allahu, Ai është padyshim Gjithëfurnizuesi, Zotëruesi i Fuqisë, i Përhershmi më i fortë".[20]

Për një kohë të gjatë këto vërsete preokupuan mendjen time, meqë sipas shumë komenteve të Kur'anit, kuptimi i tyre i jashtëm nuk reflektonte mrekullinë e lartë të Kur'anit. Unë tani do të shpjegoj shkurt tre aspekte të kuptimeve të tyre shumë të bukura e të larta, të cilat burojnë nga shkëlqimi i Kur'anit.

Aspekti i Parë: Ndonjëherë, Allahu i Gjithëfuqishëm i atribuon Vetvetes disa gjendje që mund t'i përkisnin të Dërguarit të Tij, me qëllim për ta nderuar e lartësuar atë. Këtu gjithashtu, vërsetet, "Unë ju krijova ju për adhurim; jo që të më jepni furnizim apo që të më ushqeni", kanë këtë kuptim: "I Dërguari Im nuk dëshiron rrogë, shpërblim apo thevab, apo të ushqehet në shkëmbim të detyrës së tij të profetësisë dhe për komunikimin e detyrave të adhurimit ndaj jush. Ato i referohen Profetit të nderuar a.s.m. të cilit i jepet ushqim e furnizim. Përndryshe, në qoftë se nuk do të ishte ky kuptim i synuar, atëherë ai do të njoftonte diçka që është e vetëkuptueshme dhe e qartë, dhe do të ishte e papërshtatshme me elokuencën e mrekullueshme të Kur'anit.

Aspekti i Dytë: Njeriu është tej mase i preokupuar me furnizimin e tij, dhe supozon se përpjekja për të siguruar furnizimin e pengon atë nga adhurimi;

Kështu, me qëllim që të mos mashtrohet, për ta larguar atë iluzion dhe që të mos e marrë atë si pretekst dhe një justifikim për të braktisur ibadetin -adhurimin- ajeti kerim thotë: *"Dhe Unë nuk i krijova njerëzit dhe xhindet, veçse për të më adhuruar"*, dhe përcakton se qëllimi i krijimit tuaj është adhurimi ndaj Allahut; dhe se përpjekja për të fituar Rizkun, mjetet e jetesës, -nga këndvështrimi i qënies së saj një urdhër Hyjnor- është gjithashtu adhurim ndaj Zotit xh.sh..

[20] Kur'an, 51:56-8

Sa për sigurimin e rizkut për krijesat e Mia, për veten tuaj, për familjet tuaja dhe madje edhe Rizkun e kafshëve tuaja, vetëm Unë jam Garant dhe Sigurues për të. Ju nuk u krijuat për të siguruar ushqim e furnizim; çështja e rizkut dhe e të ushqyerit më përket vetëm Mua; sepse Vetëm Unë jam Furnizuesi; Unë siguroj furnizim për ata që lidhen me ju prej robërve e shërbëtorëve të Mi. Prandaj mos e bëni këtë një justifikim për të braktisur ibadetin!"

Në qoftë se nuk do të ishte ky kuptimi i synuar, atëherë ky do të bëhej një pohim i diçkaje që është e njohur dhe e qartë, sepse t'i sigurosh rizk -ushqim- Allahut të Plotëfuqishëm, në mënyrë të vetëkuptueshme e të qartë, është e pamundur. Ndodhet një rregull i vendosur në retorikë që tregon:

Në qoftë se kuptimi i fjalisë është i njohur në mënyrë të vetëkuptueshme, atëherë nuk është ky kuptim ai që synohet, por një kuptim që kërkohet medoemos prej tij dhe që është i varur prej tij.

Për shembull, në qoftë se ti do t'i thoje një njeriu i cili është hafiz i Kuranit: "Ti je hafiz"; kjo fjalë është një pohim i asaj që njihet në mënyrë të vetëkuptueshme. Kuptimi i synuar është: "Unë e di që ti je hafiz". Ti po e njofton atë për shkak se ai nuk e dinte që ti e dije; dhe ajo është njohja ime që ai është Hafiz Kur'ani.

Kështu, si rrjedhojë e këtij rregulli, kuptimi i vërsetit, në të cilën ndalimi i dhënies ushqim e furnizim Krijuesit të Gjithëlavdishëm është një metaforë; ajo është kështu:

*"*Ju nuk u krijuat me qëllim që të prodhoni ushqim për krijesat e Mia, të cilat janë të Miat, dhe sigurimin e ushqimit të të cilave Unë e kam marrë përsipër. Detyra juaj themelore është adhurimi. Megjithatë, të përpiqesh për të siguruar rizkun -mjetet e jetesës- në përputhje me urdhërat e Mia është gjithashtu në vetvete një lloj adhurimi.

Aspekti i Tretë: Kuptimi i jashtëm i ajetit Kur'anor لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ *"Ai as nuk lind, as nuk është i lindur"*[21] në suren *Ihlas* është i njohur në mënyrë të vetëkuptueshme; një kuptim tjetër është i synuar i cili bëhet i

[21] Kur'an, 112: 3

domosdoshëm prej tij. Domethënë, Allahu i Gjithëfuqishëm deklaron shumë qartë në mënyrë të vetëkuptueshme se Ai لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ "*as nuk lind, as nuk është i lindur"*, që shpreh kuptimin që vijon: Ata me një baba dhe nënë nuk mund të jenë kurrë Zot, dhe nuk mund të jenë as të Parapërjetshëm, as të Paspërjetshëm; pra Krijuesi është i Parapërjetshëm dhe i Paspërjetshëm; -ky vërset tregon mohimin e Hyjnisë së Isait -Jezusit- a.s., të Uzejrit, të Melekëve, të yjeve dhe të zotrave të tjerë të rremë. Pikërisht në të njëjtën mënyrë, në shembullin tonë gjithashtu, vërseti,

"*Dhe nuk dua prej tyre ndonjë furnizim dhe as nuk dua që ata të më ushqejnë"* ka kuptimin vijues:

"Gjërat me aftësi për të marrë furnizim e ushqim nuk mund të jenë Zotra e objekte adhurimi", dhe shpreh kuptimin:

Qëniet të cilat kanë nevojë për ushqim e për t'u furnizuar nuk janë të përshtatshme për t'u adhuruar.

Said Nursi

* * *

بِسْمِ اللهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ

أَوْ هُمْ قَآئِلُونَ

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"... ose kur flinin në pushimin pas drekës".[22]

Kjo u shkrua në lidhje me Re'fetin që nga kureshtja pyeti për kuptimin e Fjalës قَآئِلُونَ "*Ka'ilun*" që erdhi në vërsetin Kur'anor

[22] Kur'an, 7:4

اَوْهُمْ قَآئِلُوْنَ *"... ose kur flinin në pushimin pas drekës".* Ky studim u shkrua për të mos lejuar që të bëhet përtace -e papunë- pena e tij prej diamanti në burg për shkak të letargjisë -plogështisë- që shkaktohet nga gjumi pas faljes së agimit, ashtu si të tjerët me të në burg.

Gjumi është tri llojesh:

Lloji i Parë është *Gajlule*. Ky gjumë është nga pas agimit deri në dyzet minuta e pak pasi të ketë lindur dielli, koha kur falja është e ligjshme por e kritikueshme, *vaktul-kerahet*. Gjumi në këtë kohë është në kundërshtim me sunnetin e pastër Profetik, sepse shkakton pakësim rizku dhe zhdukjen e bereqetit, ashtu siç ka ardhur në hadithin profetik a.s.m. *"Koha më e përshtatshme për t'u përgatitur njeriu për punë për të siguruar mjetet e jetesës është kur është freskët, pas agimit. Kur kjo kohë ka kaluar, bie një letargji, plogështi."*

Është vërtetuar nëpërmjet shumë eksperimenteve se ashtu siç është kjo e dëmshme për punën e asaj dite dhe në mënyrë të tërthortë për mjetet e jetesës së njeriut, po ashtu ajo shkakton zhdukjen e bereqetit të tij.

I Dyti është *Fejlule*. Ky është gjumi pas faljes së ikindisë deri në perëndim të diellit. Ky gjumë shkakton pakësim të jetës, domethënë, ai e bën jetën në atë ditë më të shkurtër dhe e bën atë të kalojë në një gjendje gjysmëgjumi për shkak të përgjumësisë, duke shkaktuar kështu një mangësi fizike për jetën. Gjithashtu nga një aspekt jolëndor, meqenëse shumica e rezultateve të asaj dite, materiale dhe jomateriale, bëhen të dukshme pas faljes së iqëndisë, ta kalosh atë kohë në gjumë sikur i pengon ato rezultate për t'u parë dhe e bën ditën sikur të mos ishte jetuar nga njeriu.

I Treti është *Kajlule*, i cili sipas sunnetit të pastër profetik, fillon koha e tij nga *Ed-duha* -mesi i mëngjesit- deri pas faljes së *Dhuhrit*, drekës. Ky gjumë është pjesë e sunnetit profetik meqë ai e ndihmon njeriun që të ngrihet natën për t'u falur. Gjithashtu në Gadishullin Arabik duke e ndërprerë punën në drekë kur i nxehti është i fortë është bërë zakon për njerëzit dhe për zonën dhe kështu e ka ngulitur edhe më shumë këtë sunnet të profetit Muhammed a.s.m.. Ky gjumë zgjat jetën dhe shton rizkun, sepse gjysëm ore nga ky gjumë *Kajluleh* është i barabartë sa dy orë gjumi nga gjumi i natës. Domethënë, ai e shton

jetën e ditës së tij një orë e gjysëm dhe gjithashtu shpëton një orë e gjysëm nga dora e gjumit, i cili është vëllai i vdekjes, dhe e bën atë të jetojë duke ia shtuar atë kohës së punës së tij për të fituar mjetet e jetesës; dhe zgjat kohën e përpjekjes dhe të punës.

Said Nursi

*** * ***

Kjo është një kujtesë e bukur

Kur po lexoja Fjalinë

اَلْفُ اَلْفِ صَلٰوةٍ وَاَلْفُ اَلْفِ سَلَامٍ عَلَيْكَ يَا رَسُوْلَ اللّٰهِ ***"El-fu el-fi salatin ve elfu elfi selamin alejke Ja Resulall-llah",*** *"Njëmijë e një bekime dhe njëmijë e një selame, qofshin për ty o i dërguari i Zotit xh.sh"* në tesbihatet që recitohen pas namazeve, unë pashë nga larg një pikë të hollë e cila m'u zbulua nga ato lavdërime, por unë nuk munda ta ngërtheja atë plotësisht, dhe unë do të tregoj një ose dy fjali duke aluduar për të.

Unë pashë se bota e natës i ngjasonte një banese të re që hapet për banesën e dynjasë. Unë hyra në atë botë gjatë faljes së *Ishasë* -namazit të jacisë- që kryhet kur fillon të bie nata. Meqenëse natyra e njeriut është i lidhur me të gjithë dynjanë, nëpërmjet një shtrirjeje të jashtëzakonshme të imagjinatës, unë pashë se kjo dynja madhështore u bë në atë natë si një banesë shumë e vogël saqë gati nuk shiheshin krijesat e vogëla dhe njeriu; ata gati u bënë të padukshëm. Unë vëzhgova me imagjinatë se qënia e vetme që e ndriçonte atë banesë, që e mbushte me gëzim, me familjaritet dhe me kënaqësi, ishte personaliteti kolektiv i Muhammedit a.s.m..

Ashtu siç jep selam në fillim njeriu kur hyn në një shtëpi, po ashtu unë gjeta një përmallim të madh dhe një dëshirë të zjarrtë për të thënë: ***"Elfu Elfi Salatin ve elfu e lfi selamin alejke Ja Resulall-llah".***[23]

[23] Mëshira Hyjnore e cila i zbriti Muhammedit a.s.m. orientohet tek nevojat e të gjithë ummetit të tij nëpër të gjithë përjetësinë. Për këtë arsye, përshëndetjet e

Ndërkohë unë e gjeta veten time sikur po e përshëndesja atë sa numri i të gjithë njerëzve dhe xhindeve. Domethënë, unë shpreha këtë kuptim me përshëndetjet që ia çova: Unë ripërtërij besën time me ty, unë pranoj misionin tënd dhe u nënshtrohem e u bindem ligjeve dhe urdhërave që ti solle, dhe deklaroj nëpërmjet përshëndetjeve se ato do të jenë të sigurta se nuk do të sulmohen nga unë. Domethënë, sikur unë po e jepja këtë selam, duke i shprehur ato kuptime në emrin e çdo individi prej individëve të botës sime, të cilët janë qëniet e vetëdijshme prej njerëzve e xhindëve dhe në emër të të gjitha krijesave.

Ashtu siç e ndriçoi botën time nëpërmjet dritës dhe dhuratës që ai solli, po ashtu ai i ndriçon dhe i mbush me mirësi botët e gjithësecilit në këtë dynja.

Ndërkohë përballë kësaj mirësie madhështore, unë thashë:

"O Zot, zbrit mbi të një mijë *Salate*, bekime!" se mbase kjo do të ishte një përgjigje me mirënjohje e me falënderim ndaj kësaj dhurate. Domethënë, ne nuk mund t'i përgjigjemi kësaj mirësisë tënde, "kështu ne shfaqim mirënjohjen tonë ndaj teje duke u lutur që mëshira të zbresë mbi ty nga thesari i mëshirës së Krijuesit tonë sa numri i banorëve të qiejve". Unë e kapa këtë kuptim me imagjinatën time.

Ai, Profeti Muhammed a.s.m., kërkon *salat* -bekime- të cilat kanë kuptimin e 'Mëshirës' për sa ka të bëjë me qënien e tij 'Rob' dhe i kthyer nga krijesa për tek Krijuesi. Ndërsa për sa ka të bëjë me qënien e tij *i dërguar* nga Krijuesi për tek krijesa, ai meriton *selam* - përshëndetje. Ashtu siç është i denjë për *selame* sa numri i xhindeve dhe i njerëzve, dhe ripërtërijmë me të besëlidhjen e përgjithshme sa

---

pafundme që i dhurohen atij janë shumë me vend e të përshtatshme. Në qoftë se një person do të hynte në një shtëpi të boshatisur, të errët e të vetmuar -si dynjaja e errët, e shkretë dhe e boshatisur nëpërmjet pakujdesisë-, sa i frikësuar e i tmerruar do të ishte ai. Por sa do ta gëzonte, do ta kënaqte, do t'i jepte familjaritet dhe do ta ndriçonte në qoftë se do të shikonte se një njeri shfaqet në atë shtëpi dhe i bën të njohur gjithçka që ndodhet në të. Po në qoftë se ky person është i dashuri, i përnderuari dhe miku, që është i Dërguari i Zotit xh.sh., i cili shfaqet në shtëpinë e botës, që përshkruan e na e bën të njohur Pronarin Mëshirëplotë e Gjithëbujar nëpërmjet të gjithë gjërave që ndodhen në të. Bëj ti analogji me këtë me qëllim që të kesh mundësi të çmosh vlerën dhe kënaqësinë e salavateve mbi Profetin Muhammed a.s.m.. Autori

numri i tyre gjithashtu, po ashtu ai është i denjë për *salavate* nga thesari i mëshirës sa numri i banorëve të qiejve dhe në emrin e të gjithë atyre; sepse drita që ai solli është ajo që shfaq plotësimin e çdo gjëje në ekzistencë dhe nxjerr në pah vlerën e çdo qënie, dhe nëpërmjet saj shikohet detyra Hyjnore e çdo krijese, dhe manifestohen qëllimet Hyjnore prej çdo krijese. Prandaj, në qoftë se çdo gjë do të kishte gjuhë, sigurisht ajo do të thonte në mënyrë të përsëritur*:*

اَلصَّلٰوةُ وَالسَّلٰامُ عَلَيْكَ يَا رَسُوْلَ اللّٰهِ ***"Es-salatu Ves-selamu alejke ja Resulall-llah!"*** *"Bekimet dhe përshëndetjet qofshin mbi ty, o i Dërguari i Zotit xh.sh.!*

Ndërsa ne themi në emrin e të gjitha krijesave:

اَلْفُ اَلْفِ صَلٰوةٍ وَاَلْفُ اَلْفِ سَلٰامٍ عَلَيْكَ يَا رَسُوْلَ اللّٰهِ بِعَدَدِ الْجِنِّ

وَالْاِنْسِ وَبِعَدَدِ الْمَلٰكِ وَالنُّجُوْمِ

"Bekime e përshëndetje të pafundme qofshin mbi ty o i Dërguar i Zotit xh.sh. sa numri i njerëzve dhe i xhindeve dhe sa numri i melekëve dhe i yjeve!"

فَيَكْفِيكَ اَنَّ اللّٰهَ صَلّٰى بِنَفْسِهٖ وَاَمْلَاكُهٗ صَلَّتْ عَلَيْهِ وَسَلَّمَتْ

Është e mjaftueshme që Allahu i jep atij bekime,

Edhe melekët e Tij i çojnë atij Salat e selam...

Said Nursi

*** * ***

Vëllai im i dashur!

Ti kërkon një shpjegim për Unitetin e Ekzistencës. Në njërën nga shkreptimat e "Letrës së Tridhjetë e Njëtë" është një përgjigje shumë e

fuqishme dhe sqaruese për idetë e Muhjiddin Ibnu Arebij lidhur me këtë çështje.

Për tani, ne do të themi ç'ka vijon: T'ua japësh mësim këtë çështje të Unitetit të Ekzistencës njerëzve në këtë kohë, do t'i dëmtonte shumë ata. Ashtu si metaforat dhe shëmbëllimet[24] që kur kalojnë nga duart e të diturve për tek ato të njerëzve të zakonshëm dhe nga dora e dijes për tek dora e injorancës, ato metafora do të mendoheshin të ishin realitete të mirëfillta, po ashtu kur të vërteta të tilla si Uniteti i Ekzistencës do të kalonin tek të pakujdesshmit dhe tek njerëzit e zakonshëm të zhytur në ndikimin e shkaqeve, ato do të mendoheshin të ishte Natyra, dhe do të shkaktonin tre shembuj të rëndësishëm dëmi.

I Pari: Rruga e unitetit të Ekzistencës, megjithëse është si të mohonte ekzistencën e universit përballë ekzistencës së Krijuesit, për llogari të Krijuesit, veçse ama sa herë që ajo futet midis njerëzve të zakonshëm dhe kalon me ta derisa të arrijë duke hyrë në idetë e të pakujdesshmive prej tyre dhe sidomos tek ata që janë ndotur me mendimin materialist, ajo do të çonte në mohimin e Hyjnisë për llogari të universit dhe të materies.

Dëmi i Dytë: Rruga e unitetit të Ekzistencës e mohon hyjninë e çdo gjëje tjetër përveç Allahut me aq vrull saqë ajo mohon gjithçka përveç Zotit xh.sh. dhe largon dualizmin, dhe nuk e njeh -shikon- ekzistencën e pavarur të nefsit dhe të asnjë gjëje tjetër cilado qoftë, mirëpo në këtë kohë në të cilën sundojnë idetë e Natyrës, mburja dhe egoizmi duke mbushur me krenari nefsin urdhërues për të liga dhe duke bërë që të harrohen Krijuesi dhe Ahireti deri në një far shkalle; atëherë të ngulësh unitetin e ekzistencës në mendjen e njerëzve, nefset urdhërues për të liga të të cilëve janë si faraonë të vegjël dhe mjaft thjesht janë të prirur për t'i marrë vetvetet e tyre si objektet e tyre të adhurimit, duke fryrë dhe mbushur kështu me krenari nefset e tyre urdhërues për të liga derisa të mos i përmbajë më gjë, ruajna Zot nga kjo!

Dëmi i Tretë: Ndërsa Ekzistuesi i Vetëm i domosdoshëm, Krijuesi i Gjithëlavdishëm është i lirë, i përjashtuar, i pastër, i lartësuar, i shenjtë

[24] Ashtu si dy melekët e mëdhenj të quajtur Demi dhe Peshku që u transformuan, nëpërmjet misterit të metaforës, tek njerëzit e zakonshëm në formën e një Demi gjigant dhe të një Peshku të madh. Autori

dhe larg çdo ndryshimi, ndërrimi, copëtimi dhe nga të qenurit i përfshirë në kohë e në vend, Uniteti i Ekzistencës u jep shkas koncepteve që nuk janë të përshtatshme për Ekzistencën e Tij të domosdoshme, për shenjtërinë e Tij dhe për qënien e Tij i lirë dhe larg çdo mangësie; dhe me këtë bëhet shkak për të dhënë mësime të rreme.

Po, ai që flet për unitetin e ekzistencës, ai duhet të ngjitet me mendim nga toka për në Plejada duke e lënë prapa universin dhe e fikson shikimin e tij tek Froni Hyjnor, dhe në ekstazë e konsideron Universin të jetë mosekzistent, dhe nëpërmjet fuqisë së besimit të tij ai mund ta shohë çdo gjë të jetë drejtpërdrejtë nga i Vetmi i Unitetit. Por ama për atë që qëndron prapa universit, që e sheh atë dhe i shikon shkaqet përpara vetes së tij dhe vështron nga toka, ka mundësi që ai të bëhet i zhytur në shkaqe dhe i mbytur në moçalin e Natyrës. Ndërsa ai që ngjitet me mendim tek Arshi Hyjnor ashtu si Xhelaluddin Rumi, mundet të thotë:

"Dëgjo! Ti mund të dëgjosh prej gjithësecilit -si të ishin gramafonë natyralë- atë që ti dëgjon nga Krijuesi i Gjithëfuqishëm". Por në qoftë se ti do t'i thoje dikujt që nuk mund të ngjitet aq lart aq sa Xhelaluddin Rumiu, as nuk mund t'i shohë të gjitha qëniet nga toka për tek Froni Hyjnor në formën e pasqyrave -për manifestimet e Tij xh.sh.-, në qoftë se do t'i thoje: "Dëgjoje gjithësecilin që të dëgjosh prej tij fjalën e Zotit xh.sh.", ai në kuptim do të binte nga Froni në tokë dhe gjithashtu do të goditej nga imagjinata të rreme në kundërshtim me të vërtetën!...

قُلِ اللّٰهُ ثُمَّ ذَرْهُمْ فِي خَوْضِهِمْ يَلْعَبُونَ ۞ مَا لِلتُّرَابِ وَلِرَبِّ الْأَرْبَابِ

سُبْحَانَ مَنْ تَقَدَّسَ عَنِ الْأَشْبَاهِ ذَاتُهُ وَتَنَزَّهَتْ عَنْ مُشَابَهَةِ

الْأَمْثَالِ صِفَاتُهُ وَشَهِدَ عَلَى رُبُوبِيَّتِهِ آيَاتُهُ جَلَّ جَلَالُهُ وَلَا إِلٰهَ إِلَّا هُوَ

"*Thuaj*: *"Allahu (e zbriti atë), pastaj lëri të luajnë në bisedat e cikërrimat e tyre të kota".*[25]

[25] Kur'an, 6:91

Lavdi të Vetmit, Esenca e të Cilit është e shenjtë mbi çdo gjë për t'i ngjasuar, që atributet e të Cilit janë të lartësuar mbi çdo gjë dhe larg çdo përngjasimi me to, dhe shenjat e Cilit dëshmojnë Hyjninë e Tij:

I lartësuar është Madhëria e Tij, dhe nuk ka Zot tjetër përveç Atij xh.sh.

Said Nursi

*** * ***

Përgjigje ndaj një Pyetjeje

Unë nuk kam kohë të peshoj idetë e Mustafa Sabriut[26] dhe ato të Musa Bekufit[27]; Unë do të mjaftohem vetëm me fjalën që vijon:

Njëri prej atyre të dyve e teproi, kaloi cakun, ndërsa tjetri e la mangët. Megjithëse Mustafa Sabriu ishte i drejtë në mbrojtjet e tij në krahasim me Musa Bekufin, veçse ama ai nuk ka të drejtë të denigrojë dikë si Muhjiddin Ibnu Arebij, i Cili ishte një mrekulli e shkencave islame.

Po, Muhjiddin Ibn Arebij është i drejtuar dhe i pranuar, por në të gjitha veprat e tij ai nuk mund të jetë udhëzues, as instruktor dhe as shembull. Meqenëse ai shumë shpesh kalonte pa peshore nëpër realitete, dhe kundërshtonte rregullat e Sunitëve, dhe disa nga thëniet e tij shprehin çudhëzim në anën e jashtme, ndonëse ai vetë është i lirë prej çudhëzimit, ai nuk është në çudhëzim. Ndonjëherë një fjalë mund të duket mohim në pamje të jashtme, kurse ai që e tha nuk është mohues.

[26] Mustafa Sabriu (1868-1954). Një dijetar fetar dhe një figurë publike në dekadat e fundit të perandorisë Osmane; ai ishte botues i gazetës së përditshme "Bejanul- hakk, dhe shejhul islam nga 1919-1920. Ai e la Turqinë më 1922 dhe mbeti në mërgim në Egjipt deri kur vdiq.

[27] Musa Jarullah Bigijef, një vendas i Turkistanit, një dijetar "reformist" i islamit dhe një figurë e shquar. Ai u dërgua në mërgim nga Rusët 1904 së bashku me Abdurrashid Ibrahimin, dhe ishte autori i shumë veprave.

Mustafa Sabriu nuk i mori këto pika në konsideratë, ai kaloi në ekstrem lidhur me disa pika për shkak të fanatizmit të tij ndaj rregullave të Sunitëve.

Sa për Musa Bekufin, për shkak të qënies së tij tej mase në favor të ripërtëritjes dhe për shkak të lëshimeve që ai bëri për modernizimin për sa ka të bëjë me idetë e tij, ai ishte shumë në gabim. Ai prishi disa nga të vërtetat e islamit me interpretimet e tij të gabuara. Duke e mbajtur të pranuar një person të refuzuar, si Abdul-Ala el-Maarri në një nivel më të lartë se sa dijetarët autoritarë e të besuar të islamit, dhe duke favorizuar në mënyrë të shpërpjesëtuar çështjet e Muhjiddinit që kundërshtojnë Sunitët për shkak se ato iu përshtateshin ideve të tija, ai kaloi shumë në ekstrem.

Muhjiddini tha: قَالَ مُحْيِ الدِّيْنِ : تَحْرُمُ مُطَالَعَةُ كُتُبِنَا عَلَى مَنْ لَيْسَ مِنَّا

"Ata që nuk janë njëri prej nesh dhe që nuk e njohin stacionin tonë, nuk duhet t'i lexojnë librat tona, pasi kjo mund të jetë e dëmshme për ta". Po, në këtë kohë është e dëmshme të lexosh librat e Muhjiddinit, dhe në mënyrë të veçantë çështjet rreth Unitetit të Ekzistencës.

Said Nursi

* * *

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

Me Emrin e Allahut i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

Kur po i shikoja prej dritares së burgut të qeshurat e njerëzimit që do të ktheheshin në të qara në festivalin e një nate të shkëlqyer, po shikoja nëpërmjet thjerrëzave -xhamave- të mendimit dhe të largpamësisë, të ardhmen dhe ankthin për të, u zbulua para shikimit të imagjinatës sime kjo situatë, të cilën do ta shpjegoj:

Ashtu siç shikohen në kinema gjendjet e jetës së atyre që tashmë flenë në varreza, edhe unë sikur pashë përpara meje kufomat lëvizëse të atyre që do të banonin në varreza në të ardhmen e afërt... Ndërkohë unë qava për ato që po qeshnin tani. Papritmas një ndjenjë vetmie,

keqardhjeje e dhimbjeje më goditi mua. Unë iu ktheva mendjes sime dhe e pyeta për realitetin duke i thënë: "Ç'është kjo imagjinatë?" Realiteti u përgjigj duke thënë:

Pas pesëdhjetë vitesh, prej këtyre që po qeshin dhe po kënaqin vetveten me një gëzim të tillë, pesë do të jenë me shpina të kërrusura e të gërmuqura dhe do t'u jenë afruar të shtatëdhjetave, kurse dyzet e pesë prej tyre do të jenë kalbur në varreza. Ato fytyra e çehre të bukura dhe buzëqeshjet gazmore do të jenë transformuar në të kundërtat e tyre. Në përputhje me rregullin كُلُّ آتٍ قَرِيبٌ "*Çdo gjë që do të vijë është e afërt",* meqenëse deri diku është e vërtetë se gjërat që do të ndodhin në të ardhmen e afërt shihen të kenë arritur tashmë, atëherë sigurisht ajo që ti shikon nuk është imagjinatë.

Për më tepër, meqenëse të qeshurat e karakterizuara me pakujdesi të dynjasë janë të përkohshme dhe të zbuluara para zhdukjes, dhe mbulojnë këto gjendje të hidhura e vajtuese të këtilla, atëherë nuk ka dyshim se ajo që gëzon zemrën e njeriut të mjerë të përmalluar për përjetësi dhe që e kënaq shpirtin e tij të dashuruar marrëzisht pas pavdekshmërisë, është zbavitja e pafajshme, kënaqësia e pastër dhe ëndjet e gëzimet që do të jenë të qëndrueshme përjetësisht nëpërmjet shpërblimit të tyre brenda caqeve të hallallit -të lejuarës- duke përmbushur falënderimin me qetësinë e zemrës dhe të shpirtit dhe duke qenë larg pakujdesisë. Me qëllim që të parandalohet pakujdesia që të mos mbisundojë në shpirtëra gjatë festave dhe që të mos shtyhet njeriu për të dalë jashtë caqeve të hallallit, kanë ardhur shumë midis haditheve që inkurajojnë e nxisin fuqishëm dhënien e falënderimeve dhe përmendjen e Allahut xh.sh. në ato ditë festash. Nëse do të bëhej kjo në kohë të tilla, do të mund të transformoheshin mirësitë e gëzimit dhe të lumturisë në falënderime që do t'i bënin ato mirësi të vazhdojnë e të shtohen, sepse falënderimi i shton mirësitë dhe zhduk pakujdesinë.

Said Nursi

*** * ***

بِسْمِ اللهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ ۞ إِنَّ النَّفْسَ لَأَمَّارَةٌ بِالسُّوءِ

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

Kjo[28] lidhet me një pikë të përfshirë në vërsetin,

"Padyshim që Uni (nefsi njerëzor) është i prirur drejt së keqes"[29] dhe me hadithin profetik kuptimi i të cilit është,

اَعْدٰى عَدُوِّكَ نَفْسُكَ الَّتِي بَيْنَ جَنْبَيْكَ *"Armiku yt më i keq është nefsi yt midis kraharorit tënd."*[30]

Po, ai që e do vetveten,nefsin e tij urdhërues për të liga, i cili nuk pastrohet, dhe që i pëlqen vetja, ai në realitet nuk do askënd tjetër përveç vetes. Madje edhe në qoftë se ai në pamje të jashtme do dikë, ai nuk e do atë me sinqeritet nga zemra, por ndoshta e do atë për ndonjë interes apo përfitim që ka prej tij. Ai gjithmonë përpiqet për ta bërë veten e tij të pëlqehet nga të tjerët. Gjithashtu ai nuk i përshkruan gabime e faje vetes së tij; ai e mbron dhe e shfajëson veten si një avokat. Ai e lavdëron veten, duke ekzagjëruar dhe madje duke gënjyer, duke e shfaqur veten të jetë pa gabime e faje, sikur ta shenjtëronte vetveten, madje ai arrin deri në atë shkallë në këtë çështje, saqë për të bëhet realitet vërseti,

مَنِ اتَّخَذَ إِلٰهَهُ هَوٰيهُ *A e ke parë atë i cili merr nepsin e tij për ilah (të adhuruar, për Zot)?*[31] dhe atëherë merr goditjet e këtij vërseti -sipas shkallës së tij- dhe vetëmburrja e tij dhe përpjekjet për ta bërë veten e tij të pëlqehet nga të tjerët, do të jepnin efekte të kundërta, pasi ai do të tërhiqte përbuzjen dhe do të trajtohej me ftohtësi. Gjithashtu ai do të humbiste sinqeritetin në veprat e tij të cilat shohin për tek Ahireti dhe do të bëheshin të përziera me hipokrizi. Ai mposhtet nga emocionet dhe dëshirat e nefsit, të cilat janë të verbëra për pasojat, që nuk

[28] Kjo pjesë është e dobishme për gjithkënd
[29] Kur'an, 12:53
[30] Transmeton Bejhekiu
[31] Kur'an,45:23

mendojnë për rezultatet dhe që robërohen marrëzisht pas kënaqësive të çastit; ai do të bënte një vit burg për shkak të një kënaqësie që nuk zgjat më shumë se një orë e cila u kërkua nga ndjenjat e tij që kanë humbur rrugën e tyre. Ai do të vuante dënimin me dhjetë vjet burgim për shkak të ndjenjës së krenarisë që nuk zgjat një minut dhe për shkak të hakmarrjes. Shembulli i tij është si ai i një fëmije idiot i cili nuk e çmon vlerën e një *xhuzi* -pjese- Kur'ani që e lexon dhe e studion dhe e shet atë për të blerë një copë të lirë ëmbëlsire, pasi ai i shpenzon -harxhon- veprat e tij të mira të cilat janë më të shtrenjta se sa diamanti dhe i transformon ato në copa të papërfillshme xhami, ato janë emocionet e tij, vetëmburrja dhe egoizmi i tij. Dhe kështu ai humbet rëndë në një kohë që duhej të fitonte përfitime të mëdha.

اَللّٰهُمَّ احْفَظْنَا مِنْ شَرِّ النَّفْسِ وَالشَّيْطَانِ وَمِنْ شَرِّ الْجِنِّ وَالْإِنْسَانِ

O Zot! Na ruaj nga e keqja e nefsit dhe e Shejtanit, dhe nga e keqja e xhindeve dhe e njerëzve.

*** * ***

Një Pyetje

Si mund të jetë një dënim i drejtë qëndrueshmëria përjetësisht në burgun e xhehennemit për një mohim në një kohë të shkurtër?

Përgjigjja: Duke e llogaritur vitin të jetë treqind e gjashtëdhjetë e pesë ditë, ligji i drejtësisë kërkon për një vrasje që ndodh për një minut që vrasësi të dënohet me shtatë milion e tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë minuta burgimi. Kështu, meqenëse mohimi i një minuti është si një mijë vrasje, sipas ligjit të drejtësisë humane, ai që jeton një jetë prej njëzet vitesh në mosbesim dhe vdes në atë gjendje, meriton të burgoset për pesëdhjetë e shtatë bilion e dyqind e një mijë e dyqind milion vite. Nga kjo mund të kuptohet se sa në harmoni me drejtësinë Hyjnore është vërseti,

خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا *"Në të cilin ata do të mbeten përherë".*[32]

Arsyeja për lidhjen ndërmjet këtyre dy numrave kaq të largët nga njëri-tjetri, është ky: Meqenëse vrasja dhe mohimi janë shkatërrim dhe agresion, ato kanë një ndikim tek të tjerët. Një vrasje që ndodh për një minut merr të paktën pesëdhjetë vjet nga jeta e të vrarit, viktimës, sipas gjendjes së jashtme, prandaj vrasësi burgoset në vendin e tyre. Ndërsa meqenëse një minut nga mosbesimi, mohon një mijë e një Emra të Bukur Hyjnorë, denigron skalitjet e tyre, shkel të drejtat e qënieve të universit dhe mohon plotësimet e tyre, përgënjeshtron dëshmitë e panumërta të Unitetit Hyjnor dhe refuzon dëshminë e tyre, mohuesi flaket tek më i ulëti i niveleve për më shumë se një mijë vite, dhe mbetet në burgimin e Fjalës së Zotit خَالِدِينَ "*Halidine.. -do të mbeten përherë"-* siç u përmend lart në vërset.

Said Nursi

*** * ***

Një 'koinçidencë' domethënëse dhe e hollë.

'Koinçidenca' e nenit 163[33] në bazë të të cilit u akuzuan studentët e Risale-i Nurit dhe që kërkonte t'u jepte atyre dënimin; ky numër koinçidonte me numrin e deputetëve të cilët miratuan projektligjin e veçantë në Parlament i cili u jepte njëqind e pesëdhjetë mijë lira për ndërtimin e medresesë së autorit të Risale-i Nurit. Ishin 163 deputetë prej dyqind deputetëve në parlamentin e popullit turk.

Një "koinçidencë" tjetër e hollë dhe domethënëse është kjo*:*

Njëqind e njëzet e tetë pjesët e Risale-i Nurit janë formuar në njëqind e pesëmbëdhjetë broshura -libërtha. Numri i ditëve që kur studentët e Risale-i Nurit dhe autori i tij u arrestuan më 27 prill 1935

[32] Kur'an, 33:65

[33] Kjo 'koinçidencë' në kuptim thotë: Nënshkrimet, firmat vlerësuese dhe admiruese të njëqind e gjashtëdhjetë e tre deputetëve të qeverisë së Republikës e shfuqizojnë nenin 163 të kodit penal që lidhet me të.


deri në datën në të cilën gjykata shpalli vendimin me 19 gusht 1935 ishte njëqind e pesëmbëdhjetë duke koinçiduar me numrin e broshurave të Risale-i Nurit.

Gjithashtu, numri njëqind e pesëmbëdhjetë i njerëzve të akuzuar e që u morën në pyetje 'koinçidon' me pikërisht atë numër.

Kjo 'koinçidencë' tregon se fatkeqësia që u ra studentëve të Risale-i Nurit dhe autorit të tij organizohet nga një Dorë i Përkujdesjes Hyjnore.[34]

* * *

Pika e Njëzet e Tetë e Shkreptimës së Njëzet e Tetë.



Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"(Kështu) ata nuk mund të dëgjojnë grupin më të lartë (të meleqëve) pasi ata mbyten me zjarr (bombardohen nga çdo anë)."

"Të përzënë dhe i tyri është një ndëshkim i pandërprerë (i dhimbshëm)"

[34] Ja vlen të vërehet se arrestimi për disa studentë të Risale-i Nurit filloi me 25 prill 1935 dhe numri i atyre që u akuzuan me vendimin e gjykatës ishte 117 veta, meqë emrat e dy prej tyre u përsëritën dy herë. Ky numër 'koinçidoi' me njëqind e shtatëmbëdhjetë ditët që nga data që grupi u arrestua deri tek data e shpalljes së vendimit të gjykatës, duke i shtuar një hollësi tjetër "koinçidencës" së mëparshme.

"Përveç ndonjërit që shkëput ndonjë grimcë vjedhurazi dhe janë të ndjekur me zjarr flakërues me shkëlqim të fortë.[35]

"Dhe vërtet që Ne e kemi zbukuruar qiellin më të afërt me drita dhe Ne i kemi bërë drita të tilla gjuajtëse për të larguar Shejtanët".[36]

Një pikë e rëndësishme lidhur me vërsete të tilla si këto do të shpjegohet në lidhje me kritikat e bëra nga njerëzit e çudhëzimit. Ajo është si më poshtë vijon:

Këto ajete tregojnë se spiunat nga xhindet dhe nga shejtanët përgjojnë ngjarjet në qiejt dhe ua sjellin ato njoftime të së padukshmes falltarëve, mediumeve dhe disa spiritualistëve, atyre që merren me sjelljen e shpirtërave. Me qëllim që dhënia e njoftimeve të tyre nga e padukshmja të mos u jap shkas dyshimeve kur u shpall Kur'ani, spiunazhi i tyre i vazhdueshëm u ndalua në shkallën më të madhe dhe ata u përzunë nga yjet gjuajtës.

Ne do të shpjegojmë një përgjigje shumë të shkurtër rreth një pyetjeje shumë të rëndësishme në tre pjesë lidhur me vërsetet e lartëpërmendur, të cilat janë rreth këtij subjekti.

Pyetje: Nga vërsete të tilla si këto kuptohet se shejtanët spiunë depërtojnë e futen në mbretërinë e qiejve që janë shumë të largëta me qëllim që të mësojnë prej disa ngjarjeve të pjesshme dhe madje personale nga e Padukshmja; sikur ajo ngjarje e pjesshme të ishte objekt kërkimi në çdo pjesë të asaj mbretërie të gjërë, dhe cilido shejtan të mundej me hyrë nga cilido vend në qiej, e të përgjonte një version të ngatërruar raportimesh dhe ta sillte atë kështu në tokë. Megjithatë, arsyeja dhe shkenca nuk mund t'i pranojnë këto gjëra që kuptohen nga vërsetet Kur'anore.

Pastaj, disa nga njerëzit e profetësisë, pejgamberët, dhe disa Evlija, njerëzit e kerameteve, sikur i këpusin shumë nga afër frutat e Xhennetit, i cili sipas disa vërseteve të qarta të Kur'anit, është mbi qiejt, dhe ndonjëherë e shohin Parajsën shumë nga afër. Kjo çështje do

[35] Kur'an, 37: 8-10
[36] Kur'an, 67: 5

të thotë: Largësia e pafundme është brenda afërsisë së pafundme, gjë të cilën nuk e përfshin mendja e këtij shekulli.

Gjithashtu, një gjendje e pjesshme e një personi të parëndësishëm duke qenë subjekt diskutimi i asamblesë më të lartë në qiejt e lartë e shumë të shtrirë, nuk është në harmoni me administrimin e universit i cili lëviz me urtësinë më të skajshme. Megjithatë, këto tri çështje konsiderohen të jenë midis të vërtetave të islamit.

Përgjigjja:

Së Pari: Vërseti Kur'anor,

وَلَقَدْ زَيَّنَّا السَّمَاءَ الدُّنْيَا بِمَصَابِيحَ وَجَعَلْنَاهَا رُجُومًا لِلشَّيَاطِينِ *"Vërtet që Ne e kemi zbukuruar qiellin më të afërt me drita dhe Ne i kemi bërë drita të tilla gjuajtëse për të larguar shejtanët...",* tregon se spiunët shejtanë të cilët përpiqen të ngjiten në qiej për spiunazh dëbohen nëpërmjet yjeve të qiejve.

Unë e kam trajtuar mirë këtë çështje në Fjalën e Pesëmbëdhjetë dhe e kam provuar me aq siguri saqë ajo i bind edhe materialistët më kryeneçë, madje kjo i hesht ata dhe i detyron ta pranojnë, dhe kjo nëpërmjet shtatë parathënieve të provuara prerazi të cilat janë si shtatë shkallë për t'u ngjitur tek kuptimi i këtij vërseti.

Së Dyti: Ne do të aludojmë për këto tri të vërteta të islamit, të cilat supozohen të jenë larg nga arsyeja, me një krahasim i cili do t'i sjellë ato më afër mendjeve të ngushta.

Për shembull, supozo se zyra ushtarake e një shteti është në lindje të vendit, ministria e tij e drejtësisë në perëndim, ministria e arsimit në veri, departamenti i çështjeve të fesë në jug, administrata shtetërore në qendër, dhe çdo departament e ministri komunikon dhe është e lidhur me të tjerat nëpërmjet radios, telefonit dhe telegrafit në mënyrën më të rregullt e të sistemuar.

Kështu, të gjitha vendet, mjaft thjesht, do të ishin si një zyrë e vetme e njëjtë si ministria e drejtësisë, ose si departamenti i ushtrisë, ose si departamenti i çështjeve të fesë, ose si administrata shtetërore, dhe kështu me radhë.

Dhe për shembull, ndonjëherë ndodh që shumë vende e shtete, kryeqytetet e të cilëve janë të ndryshme, kanë sovranitet mbi një vend të vetëm duke marrë pjesë bashkarisht mbi një mbretëri të vetme në mënyra të ndryshme, nëpërmjet kolonive, nëpërmjet dhënies me koncesion, ose nëpërmjet tregtisë. Megjithëse nënshtetasit e vendit e të kombit janë një, nëpërmjet koncesioneve të tij, secili shtet ka lidhje me ta. Çështjet e atyre shteteve, që janë të largëta nga njëri-tjetri, e prekin njëri-tjetrin dhe afrohen me njëri-tjetrin në të gjitha shtëpitë e vendit, madje marrin pjesë me çdo individ, saqë edhe çështjet e pjesshme të atij populli shikohen në një sferë të pjesshme në pikat e tij të kontaktit, dhe nuk merret çdo çështje e pjesshme nga sfera universale.

Mirëpo kur ato çështje të pjesshme diskutohen, ato diskutohen sikur të merreshin nga sfera universale, meqë ato kanë lidhje të drejtëpërdrejta me ligjet universale të asaj sfere: dhe atyre u jepet një formë si të ishte një çështje e diskutuar në atë sferë universale.

Dhe kështu, si këto dy krahasime, megjithëse mbretëria e qiejve është shumë larg për sa ka të bëjë me qendrën dhe kryeqytetin, ajo ka telefona jolëndorë që shtrihen prej tyre për tek zemrat e njerëzve në mbretërinë e tokës. Për më tepër, bota e qiejve nuk shikon vetëm botën fizike, por meqenëse ajo përmban edhe botën e shpirtërave, edhe botën e dimensioneve të brendshme të gjërave, ajo -bota e qiejve- rrethon e përfshin nën perde edhe botën e dukshme nga një aspekt.

Gjithashtu sfera e influencës së Parajsës, e cila është nga bota e përjetshmërisë dhe nga bota e qëndrueshmërisë, shtrihet dhe shpërndahet në mënyrë të ndritshme nën perden e botës së dukshme, pavarësisht largësisë së saj të pafundme. Dhe ashtu si shqiset e njeriut, të cilat i vendosi Krijuesi i Gjithurtë, i Gjithëmëshirshëm me urtësinë e Tij dhe me fuqinë e Tij në kokën e njeriut, dhe pavarësisht se qendrat e tyre janë të ndryshme, secila prej tyre sundon mbi të gjithë trupin dhe e merr atë brenda sferës së drejtimit të saj, po ashtu universi, i cili është një njeri më i madh, përfshin mijëra bota të ngjashme me sfera të ndërfutura njëra brenda tjetrës si rrathë bashkëqendrorë. Ndonjëherë situatat dhe ngjarjet që ndodhin në ato botëra janë objekt shikimi për sa ka të bëjë me universalitetin e tyre dhe me veçantinë, dhe me pjesshmërinë e tyre dhe me madhështinë. Domethënë, të pjesshmet shihen në vendet e pjesshme të afërta, kurse universalet dhe çështjet madhështore shikohen në stacionet universale e madhështore. Por

ndonjëherë, një ngjarje e pjesshme e veçantë sundon një botë madhështore. Në cilëndo qoshe të botës që dëgjohet, ti do të dëgjosh rreth asaj ngjarje. Dhe ndonjëherë, një mobilizim i madh i ushtarëve nuk ishte kundra forcave të armikut, por për të shfaqur madhështi e bujë.

Për shembull, ngjarja e Muhammed Mustafasë dhe ndodhia e shenjtë e shpalljes së Kuranit ishin ngjarjet më të rëndësishme në botën e të gjithë qiejve duke u dëgjuar në çdo qoshe të tij. Si një shenjë Hyjnore duke njoftuar shkallën e madhështisë së shpalljes së kuranit, sovranitetin e tij vezullues dhe shkallën e vërtetësisë së tij, tek e cila asnjë dyshim nuk mund të futet, të shprehura e të ilustruara nga rojet e vënë në largësi në ato bastione e kështjella të larta, prej atyre qiejve të lartë, të lartësuar e shumë të largët duke lëshuar raketa për t'i zmbrapsur shejtanët dhe për t'i përzënë ato nga qiejt -në atë kohë në fillimin e shpalljes kishte më shumë yje gjuajtës që binin për të larguar shejtanët. Kurani i shpjegimit të mrekullueshëm e interpreton atë shpallje kozmike madhështore duke aluduar për ato shenja qiellore.

Po, shfaqja e këtyre shenjave madhështore qiellore, shfaqja e dyluftimit të shejtanëve me melekët, me mundësinë e përzënies së shejtanëve spiunë me një frymë nga një melek, është vetëm për të demonstruar madhështinë e shpalljes Kuranore, lartësinë dhe epërsinë e tij. Pastaj ky shpjegim madhështor i Kuranit, dhe shfaqja e mobilizimit madhështor qiellor nuk është për të shprehur se xhindet dhe shejtanët kanë ndonjë fuqi e forcë saqë i shtyu banorët e qiejve për t'i luftuar e për t'u mbrojtur kundra tyre, por për të treguar se nuk ka asnjë hyrje për shejtanët e për xhindet në cilindo vend prej vendeve të kësaj rruge të gjatë të shtrirë nga zemra e profetit më të madh e më të nderuar a.s.m., për tek bota e qiejve dhe për tek Froni më i lartë.

Dhe me këtë, Kurani shpreh se shpallja e Kuranit është një e vërtetë madhështore e denjë për të qenë objekt përmendjeje e diskutimi nga melekët më të mëdhenj dhe nga të gjithë melekët në ato qiej madhështorë; ku detyrohen shejtanët të ngjiten tek ato qiej me qëllim që të marrin diçka prej njoftimeve të tyre, por shejtanët u qëlluan dhe u përzunë, dhe nuk morën gjë.

Kurani i gjithurtë tregon me këtë goditje ndaj shejtanëve se Shpallja Kur'anore që zbriti në zemrën e Muhammedit a.s.m., dhe Xhebraili i

cili erdhi në prezencën e tij, në vendin e tij, dhe të vërtetat e së Padukshmes që u shfaqën për shikimin e tij, janë të shëndosha, të drejta e të sakta, dhe asnjë dyshim nuk mund të hyjë absolutisht në to në cilindo aspekt prej tyre.

Kurani i shpjegimit të mrekullueshëm e shpreh këtë çështje në mënyrë të mrekullueshme.

Sa për Parajsën duke u shikuar nga shumë afër, pavarësisht largësisë së madhe të saj dhe duke qenë pjesë e botës së përjetësisë, dhe ndonjëherë frutat duke u marrë prej saj, ashtu siç mund të kuptohet nga dy shembujt e mësipërm: se kjo botë e përkohshme, bota e dukshme, është një perde për botën e Padukshme dhe për botën e përjetshmërisë. Është e mundshme që të shihet Parajsa në çdo anë nëpërmjet pasqyrës së botës së shëmbëllesës, pavarësisht se qendra e saj madhështore është në një vend të largët. Gjithashtu nëpërmjet besimit me shkallën e 'sigurisë absolute', Parajsa mund të ketë lloje të kolonive dhe të ministrive në këtë botë të përkohshme -nuk ka gabim në krahasime- dhe nëpërmjet telefonit të zemrës, mund të komunikohet me shpirtërat e lartësuar, dhe dhuratat e saj mund t'u vijnë atyre.

Sa për një sferë universale duke u preokupuar e duke u marrë me një çështje të pjesshme personale, domethënë, një aspekt i realitetit të përshkruar në komentet e Kuranit. Për shejtanët duke u ngjitur në qiej dhe duke përgjuar me qëllim që t'u sjellin falltarëve njoftime të trilluara nga e Padukshmja; realiteti i kësaj duhet të jetë kështu.

Ajo nuk është një ngjitje për tek kryeqyteti i botës së qiejve për të marrë atë njoftim të pjesshëm, por ajo është një ngjitje për tek disa vende të pjesshme në atmosferë -të cilën e përfshin kuptimi i qiejve- si stacionet policore -metafora nuk është gabim- të cilat kanë lidhje me këto vende të pjesshme në mbretërinë e tokës. Shejtanët përgjojnë në ato vende të pjesshme që të marrin ngjarje të pjesshme. Madje zemra e njeriut është njëra nga ato vende në të cilin bën dyluftim meleku i inspirimit kundra shejtanit personal.

Sa për të vërtetat e Kuranit dhe të Imanit dhe ngjarjet e profetit Muhammed a.s.m., sado që të jenë të pjesshme, ato janë si më e madhja, më universalja dhe më e lartësuara e ngjarjeve në sferën e qiejve dhe në Fronin më të lartë. Saqë sikur ato botohen në gazeta

jolëndore të ngjarjeve të paracaktuara Hyjnore të Universit -nuk ka gabim në krahasim- meqë këto çështje diskutohen e përmenden në çdo qoshe prej qosheve të qiejve; pasi duke filluar nga zemra e Profetit më të nderuar a.s.m. dhe duke përfunduar me sferën e Fronit më të lartë, që të gjitha janë të mbrojtura e të siguruara prej çdo ndërhyrjeje qoftë nga shejtanët.

Kurani duke shpjeguar këtë, sigurisht i shpreh ato shenja madhështore se: asnjë dredhi, asnjë mundësi dhe asnjë mjet nuk kanë shejtanët për të marrë njoftimet e qiellit veçse përgjimin.

Kështu, Kurani u shpall dhe tregon në mënyrën më elokuente, madje të mrekullueshme, se sa të larta e të vërteta janë shpallja e Kuranit dhe Profetësia e Muhammedit a.s.m. dhe se është krejtësisht e pamundur që t'i kundërshtosh ato apo t'u afrohesh atyre me dredhi, me dyshim apo me ndonjë formë tjetër.

Said Nursi

* * *

SHKREPTIMA E NJËZET E NËNTË



Bismil-lahir-rahmanir Rahim

Trajtesa e reflektimit të lartë rreth besimit, dhe e Njohjes së Njësisë së lartë.

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi!

Kjo trajtesa e reflektimit është shumë e lartë dhe e vlefshme, dhe emërtimi që i dha imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, duke e quajtur ***El-Ajetul-Kubra,*** *Shenja më e madhe* -nga një aspekt- e shpjegon plotësisht vlerën e saj të lartë.

Kjo është një trajtesë rreth Njohjes së besimit, e cila erdhi në zemër me shkallën e Shikimit të besimit të sigurt, gjatë kohës që po recitoja Dhikrin e tesbihatet e namazit dhe kjo prodhoi shumë trajtesa të Risale-i Nurit. Kjo u bë ushqim për mendjen e për mendimin dhe ilaç për ato të dyja për një kohë tridhjetë vjeçare. Atëherë do të ishte më e përshtatshmja që kjo të përfshihej midis koleksionit të *Lemeatit* dhe të botoheshin dyzet apo pesëdhjetë kopje prej saj.

Said Nursi

Kjo shkreptimë u shkrua gjatë një privimi absolut në Burgun Eskishehir para njëzet vitesh.




Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

Dhe Atij ne i kërkojmë ndihmë.

Lavdërimi i takon Zotit të të gjitha botëve, dhe bekimet, paqja e përshëndetjet qofshin për profetin Muhammed a.s.m. dhe mbi familjen e tij dhe mbi të gjithë Sahabët e tij.

Sqarim

Para trembëdhjetë vitesh, zemra ime u kombinua me mendjen time dhe më shtynë mua për tek rruga e mendimit Reflektiv të cilën e Urdhëron Kurani i shpjegimit të mrekullueshëm me vërsete të tilla si,



"... me qëllim që të mendoni, reflektoni,..."[1]

"Me qëllim që mbase ju mendoni".[2]

"Se ndoshta mund të reflektojnë".[3]

A nuk mendojnë thellë në veten e tyre? Allahu nuk i ka krijuar qiejt dhe tokën me gjithë ç'është ndërmjet tyre veçse me të vërtetën e me drejtësi..."[4]

[1] Kur'an, 2:219
[2] Kur'an, 2:266
[3] Kur'an, 7:176

"Vërtet që në këto gjëra ka shenja e tregues për njerëzit që reflektojnë, mendojnë",[5] e të tjerë.

Hadithi profetik, kuptimi i të cilit është

تَفَكُّرُ سَاعَةٍ خَيْرٌ مِنْ عِبَادَةِ سَنَةٍ *"mendimi reflektiv i një ore është më i mirë se sa adhurimi (vullnetar) i një viti",* pohon se në raste të ndryshme reflektimi i një ore mund të jetë i barabartë me adhurimin e një viti. Gjithashtu ai jep nxitje të fuqishme për mendimin reflektiv.

Për veten time, me qëllim që t'i ruaj dritat e shtrira dhe të vërtetat e zgjatura të cilat iu shfaqën mendjes dhe zemrës sime gjatë trembëdhjetë viteve, unë e kam ndjekur këtë rrugë. Unë kam shënuar një numër frazash nëpërmjet treguesve, jo për t'i treguar ato drita, por për të treguar ekzistencën e tyre, për të lehtësuar reflektimin në to dhe për të ruajtur rregullin e tyre. Unë i recitoja ato fraza me gojë në terma shumë të ndryshme arabe kur unë mora përsipër rrugën e reflektimit.

Duke bërë përsëritje me mijëra herë gjatë kësaj periudhe të gjatë kohe, unë as nuk u bëra i mërzitur, as kënaqësia që ato më dhanë nuk u pakësua, dhe as nevoja e shpirtit për to nuk u pakësua. Sepse, meqenëse gjithë ai reflektim përbëhej nga shkreptimat e vërseteve Kur'anore, cilësitë e mosdhënies mërzi dhe ruajtjes së ëmbëlsive të tyre, të cilat janë cilësitë e vërseteve, përfaqësoheshin në pasqyrën e atij mendimi reflektiv.

Unë në kohët e fundit kuptova se burimi i fuqishëm i jetës dhe dritat e shndritshme në pjesët e ndryshme të Risale-i Nurit janë shkreptimat e atyre vargjeve të mendimit, reflektimit. Duke menduar se ato do të kishin të njëjtin ndikim mbi të tjerët ashtu siç patën ndikuar tek unë, bëra nijet që t'i regjistroja e t'i grumbulloja aty nga fundi i jetës sime. Sigurisht, pjesët shumë të rëndësishme të tyre janë përfshirë në Risale-i Nurin, por një forcë e mëtejshme dhe një vlerë do të gjendet në to në tërësinë e tyre.

[4] Kur'an, 30: 8
[5] Kur'an, 13: 3

Meqenëse fundi i jetës nuk është i qartë, dhe meqenëse kushtet e burgimit tim këtu në Eskishehir kanë marrë një formë më të keqe se sa ajo e vdekjes, duke mos e pritur fundin e jetës, dhe me ngulmimin dhe imponimin e vëllezërve të mi, ato vargje mendimesh, reflektimesh u shkruan, pa i ndryshuar, si Shtatë 'kapitujt'.

[Gjashtë kapitujt e mbetur të kësaj shkreptime janë publikuar në botimet e shumëfishuara me dorë të Shkreptimave dhe nuk janë përfshirë këtu]

Kapitulli i Tretë

اَلْبَابُ الثَّالِثُ فِي مَرَاتِبِ اللهُ اَكْبَرُ

Rreth shkallëve të 'All-llahu Ekber'!

Ne do të përmendim shtatë prej tridhjetë e tre shkallëve të këtij kapitulli. Një pjesë e rëndësishme e atyre shkallëve është shpjeguar në Stacionin e Dytë të Letrës së Njëzet, dhe në fundin e vendqëndrimit të Dytë të Fjalës së Tridhjetë e dytë, dhe në fillimin e vendqëndrimit të tretë.

Ata që dëshirojnë ta kuptojnë realitetin e atyre shkallëve, le t'u referohen atyre pjesëve të Risale-i Nurit.

اَلْمَرْتَبَةُ الْاُوْلٰى: وَقُلِ الْحَمْدُ لِلّٰهِ الَّذِي لَمْ يَتَّخِذْ وَلَدًا وَلَمْ يَكُنْ لَهُ شَرِيكٌ فِي الْمُلْكِ

وَلَمْ يَكُنْ لَهُ وَلِيٌّ مِنَ الذُّلِّ وَكَبِّرْهُ تَكْبِيرًا

لَبَّيْكَ وَسَعْدَيْكَ جَلَّ جَلَالُهُ ۞ اَللّٰهُ اَكْبَرُ مِنْ كُلِّ شَيْءٍ قُدْرَةً وَعِلْمًا

اِذْ هُوَ الْخَالِقُ الْبَارِئُ الْمُصَوِّرُ الَّذِي صَنَعَ الْاِنْسَانَ بِقُدْرَتِهِ كَالْكَائِنَاتِ
وَكَتَبَ الْكَائِنَاتِ بِقَلَمِ قَدَرِهِ كَمَا كَتَبَ الْاِنْسَانَ بِذٰلِكَ الْقَلَمِ اِذْ ذَاكَ
الْعَالَمُ الْكَبِيرُ كَهٰذَا الْعَالَمِ الصَّغِيرِ مَصْنُوعُ قُدْرَتِهِ مَكْتُوبُ قَدَرِهِ اِبْدَاعُهُ
لِذَاكَ صَيَّرَهُ مُسَبِّحًا اِيجَادُهُ لِهٰذَا صَيَّرَهُ سَاجِدًا اِنْشَائُهُ لِذَاكَ صَيَّرَ ذَاكَ

مُلْكًا بِنَائُهُ لِهٰذَا صَيَّرَهُ مَمْلُوكًا صَنْعَتُهُ فِي ذَاكَ تَظَاهَرَتْ كِتَابًا
صِبْغَتُهُ فِي هٰذَا تَزَاهَرَتْ خِطَابًا قُدْرَتُهُ فِي ذَاكَ تُظْهِرُ خِشْمَتَهُ رَحْمَتُهُ فِي هٰذَا
تُنَظِّمُ نِعْمَتَهُ خِشْمَتُهُ فِي ذَاكَ تَشْهَدُ هُوَ الْوَاحِدُ نِعْمَتُهُ فِي هٰذَا تُعْلِنُ هُوَ الْاَحَدُ
سِكَنُهُ فِي ذَاكَ فِي الْكُلِّ وَالْاَجْزَاءِ سُكُونًا حَرَكَةً خَاتَمُهُ فِي هٰذَا فِي الْجِسْمِ

وَالْاَعْضَاءِ مُحَيِّرَةً ذَرَّةً

فَانْظُرْ اِلٰى اٰثَارِهِ الْمُتَّسِقَةِ كَيْفَ تَرٰى كَالْفَلَقِ سَخَاوَةً مُطْلَقَةً مَعَ اِنْظِمَامٍ
مُطْلَقٍ فِي سُرْعَةٍ مُطْلَقَةٍ مَعَ اِتِّزَانٍ مُطْلَقٍ فِي سُهُولَةٍ مُطْلَقَةٍ مَعَ اِتْقَانٍ مُطْلَقٍ فِي
وُسْعَةٍ مُطْلَقَةٍ مَعَ حُسْنِ صُنْعٍ مُطْلَقٍ فِي بُعْدَةٍ مُطْلَقَةٍ مَعَ اِتِّفَاقٍ مُطْلَقٍ فِي
خِلْطَةٍ مُطْلَقَةٍ مَعَ اِمْتِيَازٍ مُطْلَقٍ فِي رُخْصَةٍ مُطْلَقَةٍ مَعَ غُلُوٍّ مُطْلَقٍ ۞ فَهٰذِهِ

ٱلْكَيْفِيَّةُ ٱلْمَشْهُودَةُ شَاهِدَةٌ لِلْعَاقِلِ ٱلْمُحَقِّقِ مُجْبِرَةٌ لِلْأَحْمَقِ ٱلْمُنَافِقِ عَلَىٰ قَبُولِ
ٱلصَّنْعَةِ وَٱلْوَحْدَةِ لِلْحَقِّ ذِي ٱلْقُدْرَةِ ٱلْمُطْلَقَةِ ۞ وَهُوَ ٱلْعَلِيمُ ٱلْمُطْلَقُ ۞ وَفِي
ٱلْوَحْدَةِ سُهُولَةٌ مُطْلَقَةٌ وَفِي ٱلْكَثْرَةِ وَٱلشَّرِكَةِ صُعُوبَةٌ مُنْغَلِقَةٌ ۞ إِذْ ٱسْنِدَ
كُلُّ ٱلْأَشْيَاءِ لِلْوَاحِدِ فَالْكَائِنَاتُ كَالنَّخْلَةِ وَٱلنَّخْلَةُ كَالثَّمَرَةِ سُهُولَةً فِي
ٱلِابْتِدَاعِ ۞ إِذْ ٱسْنِدَ لِلْكَثْرَةِ فَالنَّخْلَةُ كَالْكَائِنَاتِ وَٱلثَّمَرَةُ كَالشَّجَرَاتِ
صُعُوبَةً فِي ٱلِامْتِنَاعِ ۞ إِذِ ٱلْوَاحِدُ بِٱلْفِعْلِ ٱلْوَاحِدِ يُحَصِّلُ نَتِيجَةً وَوَضْعِيَّةً
لِلْكَثِيرِ بِلَا كُلْفَةٍ وَلَا مُبَاشَرَةٍ ۞ لَوْ أُحِيلَتْ تِلْكَ ٱلْوَضْعِيَّةُ وَٱلنَّتِيجَةُ إِلَى
ٱلْكَثْرَةِ لَا يُمْكِنُ أَنْ تَصِلَ إِلَيْهَا إِلَّا بِتَكَلُّفَاتٍ وَمُبَاشَرَاتٍ وَمُشَاجَرَاتٍ

۞ كَٱلْأَمِيرِ مَعَ ٱلنَّفَرَاتِ وَٱلْبَانِي مَعَ ٱلْحَجَرَاتِ وَٱلْأَرْضِ مَعَ ٱلسَّيَّارَاتِ
وَٱلْفَوَّارَةِ مَعَ ٱلْقَطَرَاتِ وَنُقْطَةِ ٱلْمَرْكَزِ مَعَ ٱلنُّقَطِ فِي ٱلدَّائِرَةِ بِسِرِّ أَنَّ فِي
ٱلْوَحْدَةِ يَقُومُ ٱلِانْتِسَابُ مَقَامَ قُدْرَةٍ غَيْرِ مَحْدُودَةٍ ۞ وَلَا يَضْطَرُّ ٱلسَّبَبُ

لِحَمْلِ مَنَابِعِ قُوَّتِهِ وَيَتَعَاظَمُ ٱلْأَثَرُ بِٱلنِّسْبَةِ إِلَى ٱلْمُسْنَدِ إِلَيْهِ ۞ وَفِي ٱلشَّرِكَةِ
يَضْطَرُّ كُلُّ سَبَبٍ لِحَمْلِ مَنَابِعِ قُوَّتِهِ فَيَتَصَاغَرُ ٱلْأَثَرُ بِنِسْبَةِ جِرْمِهِ وَمِنْ هُنَا
غَلَبَتِ ٱلنَّمْلَةُ وَٱلذُّبَابَةُ عَلَى ٱلْجَبَابِرَةِ وَحَمَلَتِ ٱلنَّوَاةُ ٱلصَّغِيرَةُ شَجَرَةً عَظِيمَةً

وَبِسِرِّ اَنَّ فِي اِسْنَادِ كُلِّ الْاَشْيَاءِ اِلَى الْوَاحِدِ لَا يَكُوْنُ الْاِيْجَادُ مِنَ الْعَدَمِ الْمُطْلَقِ
بَلْ يَكُوْنُ الْاِيْجَادُ عَيْنَ نَقْلِ الْمَوْجُوْدِ الْعِلْمِيِّ اِلَى الْوُجُوْدِ الْخَارِجِيِّ كَنَقْلِ الصُّوْرَةِ
الْمُتَمَثِّلَةِ فِي الْمِرْاٰةِ اِلَى الصَّحِيْفَةِ الْفُطُوْغْرَافِيَّةِ لِتَثْبِيْتِ وُجُوْدٍ خَارِجِيٍّ لَهَا بِكَمَالِ
السُّهُوْلَةِ اَوْ اِظْهَارِ الْخَطِّ الْمَكْتُوْبِ بِمِدَادٍ لَا يُرٰى بِوَاسِطَةِ مَادَّةٍ مُظْهِرَةٍ لِلْكِتَابَةِ
الْمَسْتُوْرَةِ ۞ وَفِي اِسْنَادِ الْاَشْيَاءِ اِلَى الْاَسْبَابِ وَالْكَثْرَةِ يَلْزَمُ الْاِيْجَادُ مِنَ
الْعَدَمِ الْمُطْلَقِ .. وَهُوَ اِنْ لَمْ يَكُنْ مُحَالًا لَا يَكُوْنُ اَصْعَبَ الْاَشْيَاءِ ۞
فَالسُّهُوْلَةُ فِي الْوَحْدَةِ وَاصِلَةٌ اِلٰى دَرَجَةِ الْوُجُوْبِ ۞ وَالصُّعُوْبَةُ فِي الْكَثْرَةِ
وَاصِلَةٌ اِلٰى دَرَجَةِ الْاِمْتِنَاعِ ۞ وَبِحِكْمَةِ اَنَّ فِي الْوَحْدَةِ يُمْكِنُ الْاِبْدَاعُ
وَاِيْجَادُ الْاَيْسِرِ(١) مِنَ اللَّيْسِرِ(٢) يَعْنِي اِبْدَاعُ الْمَوْجُوْدِ مِنَ الْعَدَمِ الصِّرْفِ بِلَا
مُدَّةٍ وَلَا مَادَّةٍ .. وَاِفْرَاغُ الذَّرَّاتِ فِي الْقَالَبِ الْعِلْمِيِّ بِلَا كُلْفَةٍ وَلَا خِلْطَةٍ ۞
وَفِي الشَّرِكَةِ وَالْكَثْرَةِ لَا يُمْكِنُ الْاِبْدَاعُ مِنَ الْعَدَمِ بِاتِّفَاقِ كُلِّ اَهْلِ
الْعَقْلِ فَلَا بُدَّ لِوُجُوْدِ ذِي حَيَاةٍ جَمْعُ ذَرَّاتٍ مُنْتَشِرَةٍ فِي الْاَرْضِ وَالْعَنَاصِرِ ..

وَبَعْدَ الْقَالَبِ الْعِلْمِيِّ يَلْزَمُ لِحِفْظَةِ الذَّرَّاتِ فِي جِسْمِ ذِي الْحَيَاةِ وُجُوْدُ عِلْمٍ
كُلِّيٍّ وَاِرَادَةٍ مُطْلَقَةٍ فِي كُلِّ ذَرَّةٍ ۞ وَمَعَ ذٰلِكَ اَنَّ الشُّرَكَاءَ مُسْتَغْنِيَةٌ
عَنْهَا وَمُمْتَنِعَةٌ بِالذَّاتِ بِخَمْسَةِ وُجُوْهٍ مُتَدَاخِلَةٍ ۞ وَالشُّرَكَاءُ الْمُسْتَغْنِيَةُ عَنْهَا

وَٱلْمُمْتَنِعَةُ بِالذَّاتِ تَحْكِيَّةٌ مَحْضَةٌ لَا اَمَارَةَ عَلَيْهَا وَلَا اِشَارَةَ اِلَيْهَا فِي شَيْءٍ مِنَ
ٱلْمَوْجُودَاتِ اِذْ خِلْقَةُ ٱلسَّمٰوَاتِ وَ ٱلْاَرْضِ تَسْتَلْزِمُ قُدْرَةً كَامِلَةً غَيْرَ مُتَنَاهِيَةٍ
بِالضَّرُورَةِ فَاسْتُغْنِيَ عَنِ ٱلشُّرَكَآءِ وَ اِلَّا لَزِمَ تَحْدِيدُ وَ انْتِهَآءُ قُدْرَةٍ كَامِلَةٍ غَيْرِ

بِتِلْكَ ٱلْوُجُوهِ لَآ اِشَارَةَ اِلَى وُجُودِهَا وَلَآ اَمَارَةَ عَلَى تَحَقُّقِهَا فِي شَيْءٍ مِنَ
ٱلْمَوْجُودَاتِ فَقَدِ ٱسْتَفْسَرْنَا هٰذِهِ ٱلْمَسْئَلَةَ (فِي ٱلْمَوْقِفِ ٱلْاَوَّلِ) مِنَ ٱلرِّسَالَةِ
ٱلثَّانِيَةِ وَ ٱلثَّلَاثِينَ مِنَ ٱلذَّرَّاتِ اِلَى ٱلسَّيَّارَاتِ.. (وَ فِي ٱلْمَوْقِفِ ٱلثَّانِي)
مِنَ ٱلسَّمٰوَاتِ اِلَى ٱلشَّخْصَاتِ ٱلْوَجْهِيَّةِ فَاَعْطَتْ جَمِيعُهَا جَوَابَ رَدِّ ٱلشِّرْكِ
بِاِرَائَةِ سِكَّةِ ٱلتَّوْحِيدِ فَكَمَا لَا شُرَكَآءَ لَهُ كَذٰلِكَ لَا مُعِينَ وَلَا وُزَرَآءَ لَهُ ﷻ

وَمَا ٱلْاَسْبَابُ اِلَّا حِجَابٌ رَقِيقٌ عَلَى تَصَرُّفِ ٱلْقُدْرَةِ ٱلْاَزَلِيَّةِ لَيْسَ لَهَا تَاْثِيرٌ
اِيجَادِيٌّ فِي نَفْسِ ٱلْاَمْرِ ۞ اِذْ اَشْرَفُ ٱلْاَسْبَابِ وَ اَوْسَعُهَا اِخْتِيَارًا هُوَ ٱلْاِنْسَانُ
مَعَ اَنَّهُ لَيْسَ فِي يَدِهِ مِنْ اَظْهَرِ اَفْعَالِهِ ٱلْاِخْتِيَارِيَّةِ كَٱلْاَكْلِ وَ ٱلْكَلَامِ
وَ ٱلْفِكْرِ مِنْ مِئَاتِ اَجْزَآءٍ اِلَّا جُزْءٌ وَاحِدٌ مَشْكُوكٌ فَاِذَا كَانَ ٱلسَّبَبُ

ٱلْاَشْرَفُ وَ ٱلْاَوْسَعُ اِخْتِيَارًا مَغْلُولَ ٱلْاَيْدِي عَنِ ٱلتَّصَرُّفِ ٱلْحَقِيقِيِّ كَمَا
تَرٰى فَكَيْفَ يُمْكِنُ اَنْ تَكُونَ ٱلْبَهِيمَاتُ وَ ٱلْجَمَادَاتُ شَرِيكًا فِي ٱلْاِيجَادِ وَ
ٱلرُّبُوبِيَّةِ لِخَالِقِ ٱلْاَرْضِ وَ ٱلسَّمٰوَاتِ فَكَمَا لَا يُمْكِنُ اَنْ يَكُونَ لِظَرْفٍ ٱلَّذِي

وَضَعَ ٱلسُّلْطَانُ فِيهِ ٱلْهَدِيَّةَ اَوِ ٱلْمَنْدِيلُ ٱلَّذِى لَفَّ فِيهِ ٱلْعَطِيَّةَ اَوِ ٱلنَّفَرُ ٱلَّذِى اَرْسَلَ عَلٰى يَدِهِ ٱلنِّعْمَةَ اِلَيْكَ شُرَكَاءَ لِلسُّلْطَانِ فِى سَلْطَنَتِهِ كَذٰلِكَ لَا يُمْكِنُ اَنْ يَكُونَ ٱلْاَسْبَابُ ٱلْمُرْسَلَةُ عَلٰى اَيْدِيهِمِ ٱلنِّعَمُ اِلَيْنَا وَٱلظُّرُوفُ ٱلَّتِى هِىَ صَنَادِيقُ لِلنِّعَمِ ٱلْمُدَّخَرَةِ لَنَا وَٱلْاَسْبَابُ ٱلَّتِى اِلْتَفَتْ عَلٰى عَطَايَا اِلٰهِيَّةٍ مُهْدَاتٌ اِلَيْنَا شُرَكَاءَ اَعْوَانًا اَوْ وَسَائِطَ مُؤَثِّرَةً ..

اَلْمَرْتَبَةُ ٱلثَّانِيَةُ : جَلَّ جَلَالُهُ اَللّٰهُ اَكْبَرُ مِنْ كُلِّ شَىْءٍ قُدْرَةً وَعِلْمًا اِذْ هُوَ ٱلْخَلَّاقُ ٱلْعَلِيمُ ٱلصَّانِعُ ٱلْحَكِيمُ ٱلرَّحْمٰنُ ٱلرَّحِيمُ ٱلَّذِى هٰذِهِ ٱلْمَوْجُودَاتُ ٱلْاَرْضِيَّةُ وَٱلْاَجْرَامُ ٱلْعُلْوِيَّةُ فِى بُسْتَانِ ٱلْكَائِنَاتِ مُعْجِزَاتُ قُدْرَةِ خَلَّاقٍ عَلِيمٍ بِٱلْبَدَاهَةِ ❁ وَهٰذِهِ ٱلنَّبَاتَاتُ ٱلْمُتَلَوِّنَةُ ٱلْمُتَزَيِّنَةُ ٱلْمَنْثُورَةُ وَهٰذِهِ ٱلْحَيَوَانَاتُ ٱلْمُنَوَّعَةُ ٱلْمُنْبَرِجَةُ ٱلْمَنْشُورَةُ فِى حَدِيقَةِ ٱلْاَرْضِ خَوَارِقُ صَنْعَةِ صَانِعٍ حَكِيمٍ بِٱلضَّرُورَةِ وَهٰذِهِ ٱلْاَزْهَارُ ٱلْمُتَبَسِّمَةُ وَٱلْاَثْمَارُ ٱلْمُتَزَيِّنَةُ فِى جِنَانِ هٰذِهِ ٱلْحَدِيقَةِ

هَا يَا رَحْمَتِ رَحْمٰنٍ رَحِيمٍ بِٱلْمُشَاهَدَةِ تَشْهَدُ هَاتِيكَ وَتُنَادِى تَاكَ وَتُعْلِنُ هٰذِهِ بِاَنَّ خَلَّاقَ هَاتِيكَ وَمُصَوِّرَ تَاكَ وَوَاهِبَ هٰذِهِ عَلٰى كُلِّ شَىْءٍ قَدِيرٌ وَبِكُلِّ شَىْءٍ عَلِيمٌ قَدْ وَسِعَ كُلَّ شَىْءٍ رَحْمَةً وَعِلْمًا تَتَسَاوٰى بِٱلنِّسْبَةِ اِلٰى قُدْرَتِهِ ٱلذَّرَّاتُ وَٱلنُّجُومُ وَٱلْقَلِيلُ وَٱلْكَثِيرُ وَٱلصَّغِيرُ وَٱلْكَبِيرُ وَٱلْمُتَنَاهِى وَغَيْرُ ٱلْمُتَنَاهِى وَكُلُّ ٱلْوُقُوعَاتِ ٱلْمَاضِيَةِ وَغَرَائِبُهَا مُعْجِزَاتُ صَنْعَةِ صَانِعٍ

حَكِيمٍ تَشْهَدُ عَلٰى اَنَّ ذٰلِكَ الصَّانِعَ قَدِيرٌ عَلٰى كُلِّ الْاِمْكَانَاتِ الْاِسْتِقْبَالِيَّةِ وَ
عَجَائِبِهَا اِذْ هُوَ الْخَلَّاقُ الْعَلِيمُ وَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ۞
فَسُبْحَانَ مَنْ جَعَلَ حَدِيقَةَ اَرْضِهِ مَشْهَرَ صَنْعَتِهِ مَحْشَرَ فِطْرَتِهِ مَظْهَرَ قُدْرَتِهِ
مَدَارَ حِكْمَتِهِ مَزْهَرَ رَحْمَتِهِ مَزْرَعَ جَنَّتِهِ مَمَرَّ الْمَخْلُوقَاتِ مَسِيلَ الْمَوْجُودَاتِ

مَكِيلَ الْمَصْنُوعَاتِ ۞ فَمُزَيَّنُ الْحَيَوَانَاتِ مُنَقَّشُ الطُّيُورَاتِ مُثَمَّرُ الشَّجَرَاتِ
مُزَهَّرُ النَّبَاتَاتِ مُعْجِزَاتُ عِلْمِهِ خَوَارِقُ صُنْعِهِ هَدَايَاءُ جُودِهِ بَرَاهِينُ لُطْفِهِ ۞
تَبَسُّمُ الْاَزْهَارِ مِنْ زِينَةِ الْاَثْمَارِ تَسَجُّعُ الْاَطْيَارِ فِي نَسْمَةِ الْاَسْحَارِ تَهَزُّجُ الْاَمْطَارِ
عَلٰى خُدُودِ الْاَزْهَارِ تَرَحُّمُ الْوَالِدَاتِ عَلَى الْاَطْفَالِ الصِّغَارِ تَعَرُّفُ وَدُودٍ تَوَدُّدُ

رَحْمٰنٍ تَرَحُّمُ حَنَّانٍ تَحَنُّنُ مَنَّانٍ لِلْجِنِّ وَ الْاِنْسَانِ وَ الرُّوحِ وَ الْحَيَوَانِ وَ الْمَلَكِ
وَ الْجَانِّ ۞ وَ الْبُذُورُ وَ الْاَثْمَارُ وَ الْحُبُوبُ وَ الْاَزْهَارُ مُعْجِزَاتُ الْحِكْمَةِ خَوَارِقُ
الصَّنْعَةِ هَدَايَاءُ الرَّحْمَةِ بَرَاهِينُ الْوَحْدَةِ شَوَاهِدُ لُطْفِهِ فِي دَارِ الْاٰخِرَةِ شَوَاهِدُ

صَادِقَةٌ بِاَنَّ خَلَّاقَهَا عَلٰى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ وَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ قَدْ وَسِعَ كُلَّ شَيْءٍ
بِالرَّحْمَةِ وَ الْعِلْمِ وَ الْخَلْقِ وَ التَّدْبِيرِ وَ الصُّنْعِ وَ التَّصْوِيرِ ۞ فَالشَّمْسُ كَالْبَذْرَةِ
وَ النَّجْمُ كَالزَّهْرَةِ وَ الْاَرْضُ كَالْحَبَّةِ لَا تَثْقُلُ عَلَيْهِ بِالْخَلْقِ وَ التَّدْبِيرِ وَ الصُّنْعِ وَ

اَلتَّصْوِيرِ ۞ فَالْبُذُورُ وَالْاَثْمَارُ مَرَايَاءُ الْوَحْدَةِ فِي قَطَارِ الْكَثْرَةِ اِشَارَاتُ
اَلْقَدَرِ رُمُوزَاتُ الْقُدْرَةِ بِاَنَّ تِلْكَ الْكَثْرَةَ مِنْ مَنْبَعِ الْوَحْدَةِ تَصْدُرُ شَاهِدَةً
لِوَحْدَةِ الْفَاطِرِ فِي الصُّنْعِ وَالتَّصْوِيرِ ثُمَّ اِلَى الْوَحْدَةِ تَنْتَهِي ذَاكِرَةً لِحِكْمَةِ الصَّانِعِ
فِي الْخَلْقِ وَالتَّدْبِيرِ ۞ وَتَلْوِيحَاتُ الْحِكْمَةِ بِاَنَّ خَالِقَ الْكُلِّ بِكُلِّيَّةِ النَّظَرِ اِلَى الْجُزْئِيِّ
يَنْظُرُ ثُمَّ اِلَى جُزْئِهِ اِذْ اِنْ كَانَ ثَمَرًا فَهُوَ الْمَقْصُودُ الْاَظْهَرُ مِنْ خَلْقِ هٰذَا الشَّجَرِ
فَالْبَشَرُ ثَمَرٌ لِهٰذِهِ الْكَائِنَاتِ فَهُوَ الْمَقْصُودُ الْاَظْهَرُ لِخَالِقِ الْمَوْجُودَاتِ وَالْقَلْبُ
كَالنَّوَاتِ فَهُوَ الْمِرْاٰةُ الْاَنْوَرُ لِصَانِعِ الْمَخْلُوقَاتِ ۞ مِنْ هٰذِهِ الْحِكْمَةِ فَالْاِنْسَانُ
اَلْاَصْغَرُ فِي هٰذِهِ الْكَائِنَاتِ هُوَ الْمَدَارُ الْاَظْهَرُ لِلنَّشْرِ وَالْمَحْشَرِ فِي هٰذِهِ الْمَوْجُودَاتِ
وَالتَّخْرِيبِ وَالتَّبْدِيلِ وَالتَّحْوِيلِ وَالتَّجْدِيدِ لِهٰذِهِ الْكَائِنَاتِ اَللّٰهُ اَكْبَرُ يَا كَبِيرُ
اَنْتَ الَّذِي لَا تَهْدِي الْعُقُولُ لِكُنْهِ عَظَمَتِهِ
كِهْلَا اِلٰهَ اِلَّا هُوَ بَرَابَرِي زَنَنْدْ هَرْ شَيْ دَمَادَمْ جُويَدَنْدْ يَا حَقْ سَرَاسَرْ كُويَدَنْدْ يَا حَيْ

اَلْمَرْتَبَةُ الثَّالِثَةُ اِيضَاحُهَا فِي رَأْسِ الْمَوْقِفِ الثَّالِثِ مِنَ

اَلرِّسَالَةِ الثَّانِيَةِ وَثَلَاثِينَ اَللّٰهُ اَكْبَرُ مِنْ كُلِّ شَيْءٍ قُدْرَةً وَعِلْمًا اِذْ هُوَ
اَلْقَدِيرُ الْمُقْتَدِرُ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ الْمُصَوِّرُ الْكَرِيمُ اللَّطِيفُ الْمُزَيِّنُ الْمُنْعِمُ الْوَدُودُ
الْمُتَعَرِّفُ الرَّحْمٰنُ الرَّحِيمُ الْمُتَحَنِّنُ الْجَمِيلُ ذُو الْجَمَالِ وَالْكَمَالِ الْمُطْلَقِ

اَلنَّقَّاشُ الْاَزَلِيُّ الَّذِي مَا حَقَائِقُ هٰذِهِ الْكَائِنَاتِ كُلًّا وَاَجْزَاءً وَصَحَائِفَ وَ
طَبَقَاتٍ وَمَا حَقَائِقُ هٰذِهِ الْمَوْجُوْدَاتِ كُلِّيًّا وَجُزْئِيًّا وَ وُجُوْدًا وَبَقَاءً اِلَّا وَهِيَ
خُطُوْطُ قَلَمِ قَضَائِهِ وَقَدَرِهِ بِتَنْظِيْمٍ وَتَقْدِيْرٍ وَعِلْمٍ وَحِكْمَةٍ وَاِلَّا نُقُوْشُ
بَرْكَارِ عِلْمِهِ وَحِكْمَتِهِ بِصُنْعٍ وَتَصْوِيْرٍ وَاِلَّا تَزْيِيْنَاتُ يَدِ بَيْضَاءِ
صُنْعِهِ وَتَصْوِيْرِهِ وَتَزْيِيْنِهِ وَتَنْوِيْرِهِ بِلُطْفٍ وَكَرَمٍ وَاِلَّا اَزَاهِيْرُ

لَطَائِفِ لُطْفِهِ وَكَرَمِهِ وَتَعَرُّفِهِ وَتَوَدُّدِهِ بِرَحْمَةٍ وَنِعْمَةٍ وَاِلَّا ثَمَرَاتُ فَيَّاضِ
عَيْنِ رَحْمَتِهِ وَنِعْمَتِهِ وَتَرَحُّمِهِ وَتَحَنُّنِهِ بِجَمَالٍ وَكَمَالٍ وَاِلَّا لَمَعَاتُ جَمَالٍ
سَرْمَدِيٍّ وَكَمَالٍ دَيْمُوْمِيٍّ بِشَهَادَةِ تَفَانِيَةِ الْمَرَايَا وَسَيَّالِيَةِ الْمَظَاهِرِ
مَعَ دَوَامِ تَجَلِّي الْجَمَالِ عَلٰى مَرِّ الْفُصُوْلِ وَالْعُصُوْرِ وَالْاَدْوَارِ وَمَعَ دَوَامِ الْاِنْعِكَاسِ
عَلٰى مَرِّ الْاَنَامِ وَالْاَيَّامِ وَالْاَعْوَامِ ۞ نَعَمْ تَفَانِي الْمِرْاٰةِ زَوَالُ الْمَوْجُوْدَاتِ

مَعَ التَّجَلِّي الدَّائِمِ مَعَ الْفَيْضِ الْمُلَازِمِ مِنْ اَظْهَرِ الظَّوَاهِرِ مِنْ اَبْهَرِ الْبَوَاهِرِ
عَلٰى اَنَّ الْجَمَالَ الظَّاهِرَ اَنَّ الْكَمَالَ الزَّاهِرَ لَيْسَا مُلْكَ الْمَظَاهِرِ مِنْ اَفْصَحِ بَيَانٍ
مِنْ اَوْضَحِ بُرْهَانٍ لِلْجَمَالِ الْمُجَرَّدِ لِلْاِحْسَانِ الْمُجَدَّدِ لِلْوَاجِبِ الْوُجُوْدِ لِلْبَاقِي الْوَدُوْدِ ۞
نَعَمْ فَالْاَثَرُ الْمُكَمَّلُ يَدُلُّ بِالْبَدَاهَةِ عَلَى الْفِعْلِ الْمُكَمِّلِ ثُمَّ الْفِعْلُ الْمُكَمَّلُ
يَدُلُّ بِالضَّرُوْرَةِ عَلَى الْاِسْمِ الْمُكَمِّلِ وَالْفَاعِلِ الْمُكَمِّلِ ثُمَّ الْاِسْمُ الْمُكَمَّلُ

يَدُلُّ بِلَا رَيْبٍ عَلَى الْوَصْفِ الْمُكَمِّلِ ثُمَّ الْوَصْفُ الْمُكَمِّلُ يَدُلُّ بِلَا شَكٍّ عَلَى
الشَّأْنِ الْمُكَمِّلِ ثُمَّ الشَّأْنُ الْمُكَمِّلُ يَدُلُّ بِالْيَقِينِ عَلَى كَمَالِ الذَّاتِ
بِمَا يَلِيقُ بِالذَّاتِ وَهُوَ الْحَقُّ الْيَقِينُ ..

الْمَرْتَبَةُ الرَّابِعَةُ: جَلَّ جَلَالُهُ اللهُ اَكْبَرُ اِذْ هُوَ الْعَدْلُ الْعَادِلُ الْحَكَمُ الْحَاكِمُ
الْحَكِيمُ الْأَزَلِيُّ الَّذِي اَسَّسَ بُنْيَانَ شَجَرَةِ هٰذِهِ الْكَائِنَاتِ فِي سِتَّةِ اَيَّامٍ بِاُصُولِ
مَشِيئَتِهِ وَحِكْمَتِهِ وَفَصَّلَهَا بِدَسَاتِيرِ قَضَائِهِ وَقَدَرِهِ وَنَظَّمَهَا بِقَوَانِينِ عَادَتِهِ
وَسُنَّتِهِ وَزَيَّنَهَا بِنَوَامِيسِ عِنَايَتِهِ وَرَحْمَتِهِ وَنَوَّرَهَا بِجَلَوَاتِ اَسْمَائِهِ وَصِفَاتِهِ
بِشَهَادَاتِ انْتِظَامَاتِ مَصْنُوعَاتِهِ وَتَزَيُّنَاتِ مَوْجُودَاتِهِ وَتَشَابُهِهَا وَتَنَاسُبِهَا
وَتَجَاوُبِهَا وَتَعَاوُنِهَا وَتَعَانُقِهَا وَاِتْقَانِ الصَّنْعَةِ الشُّعُورِيَّةِ فِي كُلِّ شَيْءٍ عَلَى
مِقْدَارِ قَامَةِ قَابِلِيَّتِهِ الْمُقَدَّرَةِ بِتَقْدِيرِ الْقَدَرِ فَالْحِكْمَةُ الْعَامَّةُ فِي تَنْظِيمَاتِهَا
وَالْعِنَايَةُ التَّامَّةُ فِي تَزْيِينَاتِهَا وَالرَّحْمَةُ الْوَاسِعَةُ فِي تَلْطِيفَاتِهَا وَالْاِرْتِزَاقُ
وَالْاِعَاشَةُ الشَّامِلَةُ فِي تَرْبِيَتِهَا وَالْحَيَاةُ الْعَجِيبَةُ الصَّنْعَةِ بِمَظْهَرِيَّتِهَا لِلشُّؤُنِ
الذَّاتِيَّةِ لِفَاطِرِهَا وَالْمَحَاسِنُ الْقَصْدِيَّةُ فِي تَحْسِينَاتِهَا وَدَوَامُ تَجَلِّي الْجَمَالِ الْمُنْعَكِسِ
مَعَ زَوَالِهَا وَالْعِشْقُ الصَّادِقُ فِي قَلْبِهَا لِمَعْبُودِهَا وَالْاِنْجِذَابُ الظَّاهِرُ فِي جَذْبَتِهَا
وَاتِّفَاقُ كُلِّ كُمَّلِهَا عَلَى وَحْدَةِ فَاطِرِهَا وَالتَّصَرُّفُ لِمَصَالِحِ فِي اَجْزَائِهَا

وَالتَّدْبِيرُ الْحَكِيمُ لِنَبَاتَاتِهَا وَالتَّرْبِيَةُ الْكَرِيمَةُ لِحَيَوَانَاتِهَا وَالِانْتِظَامُ الْمُكَمَّلُ
فِي تَغَيُّرَاتِ أَزْكَانِهَا وَالْغَايَاتُ الْجَسِيمَةُ فِي انْتِظَامِ كُلِّيَّتِهَا وَالْحُدُوثُ دَفْعَةً مَعَ
غَايَةِ كَمَالِ حُسْنِ صَنْعَتِهَا بِلَا احْتِيَاجٍ إِلَى مُدَّةٍ وَمَادَّةٍ وَالتَّشَخُّصَاتُ
الْحَكِيمَةُ مَعَ عَدَمِ تَحْدِيدِ تَرَدُّدِ إِمْكَانَاتِهَا وَقَضَاءُ حَاجَاتِهَا عَلَى غَايَةِ كَثْرَتِهَا
وَتَنَوُّعِهَا فِي أَوْقَاتِهَا اللَّائِقَةِ الْمُنَاسِبَةِ مِنْ حَيْثُ لَا يَحْتَسِبُ وَمِنْ حَيْثُ لَا يُشْعَرُ
مَعَ قِصَرِ أَيْدِيهَا مِنْ أَصْغَرِ مَطَالِبِهَا وَالْقُوَّةُ الْمُطْلَقَةُ فِي مَعْدَنِ ضَعْفِهَا وَالْقُدْرَةُ
الْمُطْلَقَةُ فِي مَنْبَعِ عَجْزِهَا وَالْحَيَاةُ الظَّاهِرَةُ فِي جُمُودِهَا وَالشُّعُورُ الْمُحِيطُ فِي
جَهْلِهَا وَالِانْتِظَامُ الْمُكَمَّلُ فِي تَغَيُّرَاتِهَا الْمُسْتَلْزِمُ لِوُجُودِ الْمُغَيِّرِ الْغَيْرِ الْمُتَغَيِّرِ
وَالِاتِّفَاقُ فِي تَسْبِيحَاتِهَا كَالْمَدَائِرِ الْمُتَدَاخِلَةِ الْمُتَّحِدَةِ الْمَرْكَزِ وَالْمَقْبُولِيَّةُ فِي دَعَوَاتِهَا
الثَّلَاثِ بِلِسَانِ اسْتِعْدَادِهَا وَبِلِسَانِ احْتِيَاجِهَا الْفِطْرِيَّةِ وَبِلِسَانِ اضْطِرَارِهَا
وَالْمُنَاجَاةُ وَالشُّهُودَاتُ وَالْفُيُوضَاتُ فِي عِبَادَاتِهَا وَالِانْتِظَامُ فِي قَدَرِيَّهَا
وَالِاطْمِئْنَانُ بِذِكْرِ فَاطِرِهَا وَكَوْنُ الْعِبَادَةِ فِيهَا خَيْطَ الْوُصْلَةِ بَيْنَ
مُنْتَهَيْهَا وَمَبْدَئِهَا وَسَبَبُ ظُهُورِ كَمَالِهَا وَلِتَحَقُّقِ مَقَاصِدِ صَانِعِهَا وَهَكَذَا
بِسَائِرِ شُئُونَاتِهَا وَأَحْوَالِهَا وَكَيْفِيَّاتِهَا شَاهِدَاتٌ بِأَنَّهَا كُلَّهَا بِتَدْبِيرِ مُدَبِّرٍ
حَكِيمٍ وَاحِدٍ وَفِي تَرْبِيَةِ مُرَبٍّ كَرِيمٍ أَحَدٍ صَمَدٍ وَكُلَّهَا خُدَّامُ سَيِّدٍ وَاحِدٍ
وَتَحْتَ تَصَرُّفِ مُتَصَرِّفٍ وَاحِدٍ وَمَصْدَرُهُمْ قُدْرَةُ الْوَاحِدِ الَّذِي تَظَاهَرَتْ

وَتَكاثَرَتْ خَواتِمُ وَحْدَتِهِ عَلىٰ كُلِّ مَكْتُوبٍ مِنْ مَكْتُوباتِهِ فِي كُلِّ صَفْحَةٍ مِنْ
صَفَحاتِ مَوْجُوداتِهِ ﴿نَعَمْ فَكُلُّ زَهْرَةٍ وَثَمَرٍ وَكُلُّ نَباتٍ وَشَجَرٍ بَلْ كُلُّ حَيَوانٍ
وَحَجَرٍ بَلْ كُلُّ ذَرٍّ وَمَدَرٍ فِي كُلِّ وادٍ وَجَبَلٍ وَكُلِّ بادٍ وَقَفْرٍ خاتَمٌ بَيِّنُ
النَّقْشِ وَالْأَثَرِ يُظْهِرُ لِدِقَّةِ النَّظَرِ بِأَنَّ ذا ذاكَ الْأَثَرِ هُوَ كاتِبُ ذاكَ الْمَكانِ بِالْعِبَرِ

فَهُوَ كاتِبُ ظَهْرِ الْبَرِّ وَبَطْنِ الْبَحْرِ فَهُوَ نَقّاشُ الشَّمْسِ وَالْقَمَرِ فِي صَحِيفَةِ السَّمَواتِ
ذاتِ الْعِبَرِ جَلَّ جَلالُ نَقّاشِها اللهُ أَكْبَرُ كِبْرِكِبْرِ لا إِلٰهَ إِلّا هُوَ بَرا بَرْمِيذَنْدْ عالَمْ

الْمَرْتَبَةُ الْخامِسَةُ: (*) اللهُ أَكْبَرُ إِذْ هُوَ الْخَلّاقُ الْقَدِيرُ الْمُصَوِّرُ الْبَصِيرُ
الَّذِي هٰذِهِ الْأَجْرامُ الْعُلْوِيَّةُ وَالْكَواكِبُ الدُّرِّيَّةُ نَيِّراتُ بَراهِينِ أُلُوهِيَّتِهِ
وَعَظَمَتِهِ وَشُعاعاتُ شَواهِدِ رُبُوبِيَّتِهِ وَعِزَّتِهِ تَشْهَدُ وَتُنادِي عَلىٰ شَعْشَعَةِ

سَلْطَنَةِ رُبُوبِيَّتِهِ وَتُنادِي عَلىٰ وُسْعَةِ حُكْمِهِ وَحِكْمَتِهِ وَعَلىٰ حَشْمَةِ
عَظَمَةِ قُدْرَتِهِ فَاسْتَمِعْ إِلَى الْآيَةِ .. ﴿أَفَلَمْ يَنْظُرُوا إِلَى السَّماءِ فَوْقَهُمْ كَيْفَ بَنَيْناها
وَزَيَّنّاها﴾ الخ .. ثُمَّ انْظُرْ إِلىٰ وَجْهِ السَّماءِ كَيْفَ تَرىٰ سُكُوتًا فِي سُكُونَةٍ
حَرَكَةً فِي حِكْمَةٍ تَلَأْلُؤًا فِي حَشْمَةٍ تَبَسُّمًا فِي زِينَةٍ مَعَ انْتِظامِ الْخِلْقَةِ مَعَ اتِّزانِ

الصَّنْعَةِ تَشَعْشُعُ سِراجِها لِتَبْدِيلِ الْمَواسِمِ تَهْلِيلُ مِصْباحِها لِتَنْوِيرِ الْمَعالِمِ تَلَأْلُؤُ
نُجُومِها لِتَزْيِينِ الْعَوالِمِ تُعْلِنُ لِأَهْلِ النُّهىٰ سَلْطَنَةً بِلا انْتِهاءٍ لِتَدْبِيرِ هٰذَا الْعالَمِ فَذٰلِكَ
الْخَلّاقُ الْقَدِيرُ عَلِيمٌ بِكُلِّ شَيْءٍ وَمُرِيدٌ بِإِرادَةٍ شامِلَةٍ ما شاءَ كانَ وَما لَمْ يَشَأْ

لَمْ يَكُنْ وَهُوَ قَدِيرٌ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ بِقُدْرَةٍ مُطْلَقَةٍ مُحِيطَةٍ ذَاتِيَّةٍ وَكَمَا لَا يُمْكِنُ

وَلَا يُتَصَوَّرُ وُجُودُ هٰذِهِ الشَّمْسِ فِي هٰذَا الْيَوْمِ بِلَا ضِيَاءٍ وَلَا حَرَارَةٍ كَذٰلِكَ
لَا يُمْكِنُ وَلَا يُتَصَوَّرُ وُجُودُ إِلٰهٍ خَالِقٍ لِلسَّمٰوَاتِ بِلَا عِلْمٍ مُحِيطٍ وَبِلَا قُدْرَةٍ
مُطْلَقَةٍ فَهُوَ بِالضَّرُورَةِ عَلِيمٌ بِكُلِّ شَيْءٍ بِعِلْمٍ مُحِيطٍ لَازِمٍ ذَاتِيٍّ لِلذَّاتِ يَلْزَمُ تَعَلُّقُ
ذٰلِكَ الْعِلْمِ بِكُلِّ الْأَشْيَاءِ لَا يُمْكِنُ أَنْ يَنْفَكَّ عَنْهُ شَيْءٌ بِسِرِّ الْحُضُورِ

وَالشُّهُودِ وَالنُّفُوذِ وَالْإِحَاطَةِ النُّورَانِيَّةِ فَمَا يُشَاهَدُ فِي جَمِيعِ الْمَوْجُودَاتِ
مِنَ الْانْتِظَامَاتِ الْمَوْزُونَةِ وَالِاتِّزَانَاتِ الْمَنْظُومَةِ وَالْحِكَمِ الْعَامَّةِ وَالْعِنَايَاتِ
التَّامَّةِ وَالْأَقْدَارِ الْمُنْتَظِمَةِ وَالْأَقْضِيَةِ الْمُثْمِرَةِ وَالْآجَالِ الْمُعَيَّنَةِ وَالْأَرْزَاقِ

الْمُقَنَّنَةِ وَالْإِتْقَانَاتِ الْمُفْنَنَةِ وَالْاِهْتِمَامَاتِ الْمُزَيَّنَةِ وَغَايَةِ كَمَالِ الْامْتِيَازِ وَ
الِاتِّزَانِ وَالْانْتِظَامِ وَالْإِتْقَانِ وَالشُّهُولَةِ الْمُطْلَقَةِ شَاهِدَاتٌ عَلَىٰ إِحَاطَةِ عِلْمِ
عَلَّامِ الْغُيُوبِ بِكُلِّ شَيْءٍ وَآيَةٌ ﴿أَلَا يَعْلَمُ مَنْ خَلَقَ وَهُوَ اللَّطِيفُ الْخَبِيرُ﴾
تَدُلُّ عَلَىٰ أَنَّ الْوُجُودَ فِي الشَّيْءِ يَسْتَلْزِمُ الْعِلْمَ بِهِ وَنُورَ الْوُجُودِ فِي الْأَشْيَاءِ يَسْتَلْزِمُ

نُورَ الْعِلْمِ فِيهَا فَنِسْبَةُ دَلَالَةِ حُسْنِ صَنْعَةِ الْإِنْسَانِ عَلَىٰ شُعُورِهِ إِلَىٰ نِسْبَةِ
دَلَالَةِ خِلْقَةِ الْإِنْسَانِ عَلَىٰ عِلْمِ خَالِقِهِ كَنِسْبَةِ لُمَيْعَةِ بُخَيْمَةِ الذُّبَابَةِ فِي اللَّيْلَةِ
الدَّهْمَاءِ إِلَىٰ شَعْشَعَةِ الشَّمْسِ فِي نِصْفِ النَّهَارِ عَلَىٰ وَجْهِ الْغَبْرَاءِ وَكَمَا أَنَّهُ عَلِيمٌ بِكُلِّ
شَيْءٍ فَهُوَ مُرِيدٌ لِكُلِّ شَيْءٍ لَا يُمْكِنُ أَنْ يَتَحَقَّقَ شَيْءٌ بِدُونِ مَشِيَّتِهِ وَكَمَا

اَنَّ الْقُدْرَةَ تُؤَثِّرُ وَاَنَّ الْعِلْمَ تُمَيِّزُ كَذٰلِكَ اَنَّ الْاِرَادَةَ تُخَصِّصُ .

ثُمَّ يَتَحَقَّقُ وُجُودُ الْاَشْيَاءِ فَالشَّوَاهِدُ عَلٰى وُجُودِ اِرَادَتِهِ تَعَالٰى وَاِخْتِيَارِهِ سُبْحَانَهُ بِعَدَدِ كَيْفِيَّاتِ الْاَشْيَاءِ وَاَحْوَالِهَا وَشُئُونَاتِهَا نَعَمْ فَتَنْظِيمُ الْمَوْجُودَاتِ وَتَخْصِيصُهَا بِصِفَاتِهَا مِنْ بَيْنِ الْاِمْكَانَاتِ الْغَيْرِ الْمَحْدُودَةِ وَمِنْ بَيْنِ الطُّرُقِ الْعَقِيمَةِ وَمِنْ بَيْنِ الْاِحْتِمَالَاتِ الْمُشَوَّشَةِ وَتَحْتَ اَيْدِي السُّيُولِ الْمُتَشَاكِسَةِ بِهٰذَا النِّظَامِ الْاَدَقِّ الْاَرَقِّ وَتَوْزِينُهَا بِهٰذَا الْمِيزَانِ الْحَسَّاسِ الْحَسَّاسِ الْمَشْهُودَيْنِ وَاَنَّ خَلْقَ الْمَوْجُودَاتِ الْمُخْتَلِفَاتِ الْمُنْتَظَمَاتِ الْحَيَوِيَّةِ مِنَ الْبَسَائِطِ الْجَامِدَةِ كَالْاِنْسَانِ بِجِهَازَاتِهِ مِنَ النُّطْفَةِ وَالطَّيْرِ بِجَوَارِحِهِ مِنَ الْبَيْضَةِ وَالشَّجَرِ بِاَعْضَائِهِ الْمُنَوَّعَةِ مِنَ النَّوَاتِ تَدُلُّ عَلٰى اَنَّ تَخَصُّصَ كُلِّ شَيْءٍ وَتَعَيُّنَهُ بِاِرَادَتِهِ وَاِخْتِيَارِهِ وَمَشِيَّتِهِ سُبْحَانَهُ فَكَمَا اَنَّ تَوَافُقَ الْاَشْيَاءِ مِنْ جِنْسٍ وَالْاَفْرَادِ مِنْ نَوْعٍ فِي اَسَاسَاتِ الْاَعْضَاءِ يَدُلُّ بِالضَّرُورَةِ عَلٰى اَنَّ صَانِعَهَا وَاحِدٌ كَذٰلِكَ اَنَّ تَمَايُزَهَا فِي التَّشَخُّصَاتِ الْحَكِيمَةِ الْمُشْتَمِلَةِ عَلٰى عَلَامَاتٍ فَارِقَةٍ مُنْتَظِمَةٍ تَدُلُّ عَلٰى اَنَّ ذٰلِكَ الصَّانِعَ الْوَاحِدَ الْاَحَدَ هُوَ فَاعِلٌ مُخْتَارٌ مُرِيدٌ يَفْعَلُ مَا يَشَاءُ وَيَحْكُمُ مَا يُرِيدُ جَلَّ جَلَالُهُ وَكَمَا اَنَّ ذٰلِكَ الْخَلَّاقَ الْعَلِيمَ الْمُرِيدَ عَلِيمٌ بِكُلِّ شَيْءٍ وَمُرِيدٌ لِكُلِّ شَيْءٍ لَهُ عِلْمٌ مُحِيطٌ وَاِرَادَةٌ شَامِلَةٌ وَاِخْتِيَارٌ تَامٌّ كَذٰلِكَ لَهُ قُدْرَةٌ كَامِلَةٌ ضَرُورِيَّةٌ ذَاتِيَّةٌ نَاشِئَةٌ مِنَ الذَّاتِ وَلَازِمَةٌ لِلذَّاتِ فَمُحَالٌ تَدَاخُلُ ضِدِّهَا وَاِلَّا لَزِمَ جَمْعُ الضِّدَّيْنِ الْمُحَالُ بِالْاِتِّفَاقِ فَلَا مَرَاتِبَ فِي تِلْكَ الْقُدْرَةِ فَتَسَاوٰى بِالنِّسْبَةِ اِلَيْهَا الذَّرَّاتُ وَالنُّجُومُ وَالْقَلِيلُ

وَالْكَثِيرُ وَالصَّغِيرُ وَالْكَبِيرُ وَالْجُزْئِيُّ وَالْكُلِّيُّ وَالْجُزْءُ وَالْكُلُّ وَالْإِنْسَانُ
وَالْعَالَمُ وَالنَّوَاتُ وَالشَّجَرُ بِسِرِّ النُّورَانِيَّةِ وَالشَّفَافِيَّةِ وَالْمُقَابَلَةِ وَالْمُوَازَنَةِ

وَالِانْتِظَامِ وَالِامْتِنَاعِ بِشَهَادَةِ الِانْتِظَامِ الْمُطْلَقِ وَالِاتِّزَانِ الْمُطْلَقِ وَالِامْتِيَازِ الْمُطْلَقِ
فِي السُّرْعَةِ وَالسُّهُولَةِ وَالْكَثْرَةِ الْمُطْلَقَاتِ بِسِرِّ امْتِدَادِ الْوَاحِدِيَّةِ وَيُسْرِ الْوَحْدَةِ

وَتَجَلِّي الْأَحَدِيَّةِ وَبِحِكْمَةِ الْوُجُوبِ وَالتَّجَرُّدِ وَمُبَايَنَةِ الْمَاهِيَّةِ وَبِسِرِّ عَدَمِ
التَّقَيُّدِ وَعَدَمِ التَّحَيُّزِ وَعَدَمِ التَّحَزِّي وَبِحِكْمَةِ انْقِلَابِ الْعَوَائِقِ وَالْمَوَانِعِ إِلَى
الْوَسَائِلِ فِي التَّسْهِيلِ إِنْ احْتِيجَ إِلَيْهِ وَالْحَالُ أَنَّهُ لَا احْتِيَاجَ كَاعْصَابِ الْإِنْسَانِ
وَالْخُطُوطِ الْحَدِيدِيَّةِ لِنَقْلِ السَّيَّارَاتِ اللَّطِيفَةِ بِحِكْمَةِ أَنَّ الذَّرَّةَ وَالْجُزْءَ وَالْجُزْئِيَّ

وَالْقَلِيلَ وَالصَّغِيرَ وَالْإِنْسَانَ وَالنَّوَاتِ لَيْسَتْ بِأَقَلَّ جَزَالَةً مِنَ النَّجْمِ وَالنَّوْعِ وَ
الْكُلِّ وَالْكُلِّيِّ وَالْكَثِيرِ وَالْكَبِيرِ وَالْعَالَمِ وَالشَّجَرِ فَمَنْ خَلَقَ هٰؤُلَاءِ لَا يُسْتَبْعَدُ
مِنْهُ خَلْقُ هٰذِهِ إِذِ الْمُحَاطَاتُ كَالْأَمْثِلَةِ الْمَكْتُوبَةِ الْمُصَغَّرَةِ أَوْ كَالنُّقَطِ الْمَحْلُوبَةِ

الْمُعَصَّرَةِ فَلَا بُدَّ بِالضَّرُورَةِ أَنْ يَكُونَ الْمُحِيطُ فِي قَبْضَةِ تَصَرُّفِ خَالِقِ الْمُحَاطِ لِيُدْرِجَ
مِثَالَ الْمُحِيطِ فِي الْمُحَاطَاتِ بِدَسَاتِيرِ عِلْمِهِ وَأَنْ يَعْصُرَهَا مِنْهُ بِمَوَازِينِ حِكْمَتِهِ فَالْقُدْرَةُ
الَّتِي أَبْرَزَتْ هَاتِيكَ الْجُزْئِيَّاتِ لَا يَتَعَسَّرُ عَلَيْهَا إِبْرَازُ تِلْكَ الْكُلِّيَّاتِ فَكَمَا أَنَّ نُسْخَةَ قُرْآنِ

الْحِكْمَةِ الْمَكْتُوبَةِ عَلَى الْجَوْهَرِ الْفَرْدِ بِذَرَّاتٍ لَا تُحْصَى لَيْسَتْ بِأَقَلَّ جَزَالَةً مِنْ
نُسْخَةِ قُرْآنِ الْعَظَمَةِ الْمَكْتُوبَةِ عَلَى صَحَائِفِ السَّمَوَاتِ بِمِدَادِ النُّجُومِ وَالشُّمُوسِ

كَذٰلِكَ لَيْسَتْ خِلْقَةُ نَحْلَةٍ وَنَمْلَةٍ بِاَقَلَّ جَزَالَةً مِنْ خِلْقَةِ النَّخْلَةِ وَالْفِيلِ وَلَا صَنْعَةُ وَرْدِ

الزَّهْرَةِ بِاَقَلَّ جَزَالَةً مِنْ صَنْعَةِ دُرِّيِّ نَجْمِ الزُّهْرَةِ وَهٰكَذَا فَقِسْ فَكَمَا اَنَّ غَايَةَ كَمَالِ السُّهُولَةِ فِي اِيجَادِ

الْاَشْيَاءِ اَوْقَعَتْ اَهْلَ الضَّلَالَةِ فِي الْتِبَاسِ التَّشْكِيكِ بِالتَّشَكُّلِ الْمُسْتَلْزِمِ لِلْمُحَالَاتِ الْخُرَافِيَّةِ

الَّتِي تَمُجُّهَا الْعُقُولُ بَلْ تَتَنَفَّرُ عَنْهَا الْاَوْهَامُ كَذٰلِكَ ثَبَتَتْ بِالْقَطْعِ وَالضَّرُورَةِ لِاَهْلِ الْحَقِّ

وَالْحَقِيقَةِ تَسَاوِيَ السَّيَّارَاتِ مَعَ الذَّرَّاتِ بِالنِّسْبَةِ اِلَى قُدْرَةِ خَالِقِ الْكَائِنَاتِ جَلَّ

جَلَالُهُ وَعَظُمَ شَانُهُ وَلَا اِلٰهَ اِلَّا هُوَ..

اَلْمَرْتَبَةُ السَّادِسَةُ: جَلَّ جَلَالُهُ وَعَظُمَ شَانُهُ اَللّٰهُ اَكْبَرُ مِنْ كُلِّ شَيْءٍ

قُدْرَةً وَعِلْمًا اِذْ هُوَ الْعَادِلُ الْحَكِيمُ الْقَادِرُ الْعَلِيمُ الْوَاحِدُ الْاَحَدُ السُّلْطَانُ

الْاَزَلِيُّ الَّذِي هٰذِهِ الْعَوَالِمُ كُلُّهَا فِي تَصَرُّفِ قَبْضَتَيْ نِظَامِهِ وَمِيزَانِهِ وَتَنْظِيمِهِ

وَتَوْزِينِهِ وَعَدْلِهِ وَحِكْمَتِهِ وَعِلْمِهِ وَقُدْرَتِهِ وَمَظْهَرِ سِرِّ وَاحِدِيَّتِهِ وَاَحَدِيَّتِهِ

بِالْحَدْسِ الشُّهُودِيِّ بَلْ بِالْمُشَاهَدَةِ اِذْ لَا خَارِجَ فِي الْكَوْنِ مِنْ دَائِرَةِ النِّظَامِ وَالْمِيزَانِ

وَالتَّنْظِيمِ وَالتَّوْزِينِ وَهُمَا بَابَانِ مِنَ الْاِمَامِ الْمُبِينِ وَالْكِتَابِ الْمُبِينِ وَهُمَا

عُنْوَانَانِ لِعِلْمِ الْعَلِيمِ الْحَكِيمِ وَاَمْرِهِ وَقُدْرَةِ الْعَزِيزِ الرَّحِيمِ وَاِرَادَتِهِ فَذٰلِكَ

النِّظَامُ مَعَ ذٰلِكَ الْمِيزَانِ فِي ذٰلِكَ الْكِتَابِ مَعَ ذٰلِكَ الْاِمَامِ بُرْهَانَانِ نَيِّرَانِ لِمَنْ لَهُ

فِي رَاْسِهِ اِذْعَانٌ وَفِي وَجْهِهِ الْعَيْنَانِ اَنْ لَا شَيْءَ مِنَ الْاَشْيَاءِ فِي الْكَوْنِ

وَالزَّمَانِ يَخْرُجُ مِنْ قَبْضَةِ تَصَرُّفِ رَحْمٰنِ وَتَنْظِيمِ حَنَانٍ وَتَرْبِيَةِ مَنَانٍ وَتَوْزِينِ دَيَّانٍ ..

اَلْحَاصِلُ : اِنَّ تَجَلِّيَ الْاِسْمِ الْاَوَّلِ وَالْاٰخِرِ فِي الْخَلَائِقِ النَّاظِرِيْنَ اِلَى الْمَبْدَاِ وَالْمُنْتَهٰى وَالْاَصْلِ وَالنَّسْلِ وَالْمَاضِي وَالْمُسْتَقْبَلِ وَالْاَمْرِ وَالْعِلْمِ الْمُشِيرَانِ اِلَى الْاِمَامِ الْمُبِيْنِ وَتَجَلِّيَ الْاِسْمِ الظَّاهِرِ وَالْبَاطِنِ عَلَى الْاَشْيَاءِ فِي ضِمْنِ الْخَلَائِقِ يُشِيرَانِ اِلَى الْكِتَابِ الْمُبِيْنِ فَالْكَائِنَاتُ كَشَجَرَةٍ عَظِيمَةٍ وَكُلُّ عَالَمٍ مِنْهَا اَيْضًا كَالشَّجَرَةِ فَنُمَثِّلُ شَجَرَةً جُزْئِيَّةً لِخِلْقَةِ الْكَائِنَاتِ وَاَنْوَاعِهَا وَعَوَالِمِهَا وَهٰذِهِ الشَّجَرَةُ الْجُزْئِيَّةُ لَهَا اَصْلٌ وَمَبْدَاٌ وَهُوَ النَّوَاةُ الَّتِي تَنْبُتُ عَلَيْهَا وَكَذَا لَهَا نَسْلٌ يُدِيمُ وَظِيفَتَهَا بَعْدَ مَوْتِهَا وَهُوَ النَّوَاةُ فِي ثَمَرَاتِهَا فَالْمَبْدَاُ وَالْمُنْتَهٰى مَظْهَرَانِ لِتَجَلِّي الْاِسْمِ الْاَوَّلِ وَالْاٰخِرِ فَكَانَّ الْمَبْدَاَ وَالنَّوَاةَ الْاَصْلِيَّةَ بِكَمَالِ الْاِنْتِظَامِ وَالْحِكْمَةِ فِهْرِسْتَةٌ وَتَعْرِفَةٌ مُرَكَّبَةٌ مِنْ مَجْمُوعِ دَسَاتِيرَ تَشَكُّلِ الشَّجَرَةِ وَالنَّوَاتَاتُ فِي ثَمَرَاتِهَا الَّتِي فِي نِهَايَاتِهَا مَظْهَرٌ لِتَجَلِّي الْاِسْمِ الْاٰخِرِ فَتِلْكَ النَّوَاتَاتُ فِي الثَّمَرَاتِ بِكَمَالِ الْحِكْمَةِ كَاَنَّهَا صُنَيْدِقَاتٌ صَغِيرَةٌ اُودِعَتْ فِيهَا فِهْرِسْتَةٌ وَتَعْرِفَةٌ لِتَشَكُّلِ مَا يُشَابِهُ تِلْكَ الشَّجَرَةَ وَكَاَنَّهَا كُتِبَ فِيهَا بِقَلَمِ الْقَدَرِ دَسَاتِيرُ تَشَكُّلِ شَجَرَاتٍ اٰتِيَةٍ وَظَاهِرُ الشَّجَرَةِ مَظْهَرٌ لِتَجَلِّي الْاِسْمِ الظَّاهِرِ فَظَاهِرُهَا بِكَمَالِ الْاِنْتِظَامِ وَالتَّزْيِينِ وَالْحِكْمَةِ كَاَنَّهَا حُلَّةٌ مُنْتَظِمَةٌ مُزَيَّنَةٌ مُرَصَّعَةٌ قَدْ قُدَّتْ عَلَى مِقْدَارِ قَامَتِهَا بِكَمَالِ الْحِكْمَةِ وَالْعِنَايَةِ وَبَاطِنُ تِلْكَ الشَّجَرَةِ

مَظْهَرٌ تَجَلِّيَ الْاِسْمِ الْبَاطِنِ فَبِكَمَالِ الْاِنْتِظَامِ وَالتَّدْبِيرِ الْمُحَيِّرِ لِلْعُقُولِ وَتَوْزِيعِ
مَوَادِّ الْحَيٰوةِ اِلَى الْاَعْضَاءِ الْمُخْتَلِفَةِ بِكَمَالِ الْاِنْتِظَامِ كَانَ بَاطِنُ تِلْكَ الشَّجَرَةِ مَاكِينَةً
خَارِقَةً فِي غَايَةِ الْاِنْتِظَامِ وَالْاِتْزَانِ فَكَمَا اَنَّ وَرَقَهَا تَعْرِفَةٌ عَجِيبَةٌ وَاٰخِرَهَا فِهْرِسَتَةٌ
خَارِقَةٌ يُشِيرَانِ اِلَى الْاِمَامِ الْمُبِينِ .. كَذٰلِكَ اِنَّ ظَاهِرَهَا كَحُلَّةٍ عَجِيبَةِ الصَّنْعَةِ وَ

بَاطِنُهَا كَمَاكِينَةٍ فِي غَايَةِ الْاِنْتِظَامِ تُشِيرَانِ اِلَى الْكِتَابِ الْمُبِينِ .. فَكَمَا اَنَّ
الْقُوَاتِ الْحَافِظَاتِ فِي الْاِنْسَانِ تُشِيرُ اِلَى اللَّوْحِ الْمَحْفُوظِ وَتَدُلُّ عَلَيْهِ كَذٰلِكَ اَنَّ
النَّوَامِيَاتِ الْاَصْلِيَّةَ وَالثَّمَرَاتِ تُشِيرَانِ فِي كُلِّ شَجَرَةٍ اِلَى الْاِمَامِ الْمُبِينِ وَالظَّاهِرُ

وَالْبَاطِنُ يَرْمُزَانِ اِلَى الْكِتَابِ الْمُبِينِ فَقِسْ عَلٰى هٰذِهِ الشَّجَرَةِ الْجُزْئِيَّةِ شَجَرَةَ الْاَرْضِ
بِمَاضِيهَا وَمُسْتَقْبَلِهَا وَشَجَرَةَ الْكَائِنَاتِ بِاَوَائِلِهَا وَاَتِيهَا وَشَجَرَةَ الْاِنْسَانِ
بِاَجْدَادِهَا وَاَنْسَالِهَا وَهٰكَذَا جَلَّ جَلَالُ خَالِقِهَا وَلَا اِلٰهَ اِلَّا هُوَ يَا كَبِيرُ اَنْتَ
الَّذِي لَا تَهْدِي الْعُقُولُ لِوَصْفِ عَظَمَتِهِ وَلَا تَصِلُ الْاَفْكَارُ اِلٰى كُنْهِ جَبَرُوتِهِ ..

اَلْمَرْتَبَةُ السَّابِعَةُ : جَلَّ جَلَالُهُ اَللّٰهُ اَكْبَرُ مِنْ كُلِّ شَيْءٍ قُدْرَةً وَعِلْمًا

اِذْ هُوَ الْخَلَّاقُ الْفَتَّاحُ الْفَعَّالُ الْعَلَّامُ الْوَهَّابُ الْفَيَّاضُ شَمْسُ الْاَزَلِ

اَلَّذِي هٰذِهِ الْكَائِنَاتُ بِاَنْوَاعِهَا وَمَوْجُودَاتِهَا ظِلَالُ اَنْوَارِهِ وَاٰثَارُ اَفْعَالِهِ وَالْوَانُ
نُقُوشِ اَنْوَاعِ تَجَلِّيَاتِ اَسْمَائِهِ وَخُطُوطُ قَلَمِ قَضَائِهِ وَقَدَرِهِ وَمَرَايَا تَجَلِّيَاتِ صِفَاتِهِ

وَجَمَالِهِ وَجَلَالِهِ وَكَمَالِهِ بِإِجْمَاعِ الشَّاهِدِ الْأَزَلِيِّ بِجَمِيعِ كُتُبِهِ وَصُحُفِهِ وَآيَاتِهِ التَّكْوِينِيَّةِ وَالْقُرْآنِيَّةِ وَبِإِجْمَاعِ الْأَرْضِ مَعَ الْعَالَمِ بِافْتِقَارَاتِهَا وَاحْتِيَاجَاتِهَا فِي ذَاتِهَا وَدَرَّاتِهَا مَعَ تَظَاهُرِ الْغِنَاءِ الْمُطْلَقِ وَالتَّزْوَةِ الْمُطْلَقَةِ عَلَيْهَا وَبِإِجْمَاعِ كُلِّ أَهْلِ الشُّهُودِ مِنْ ذَوِي الْأَرْوَاحِ النَّيِّرَةِ وَالْقُلُوبِ الْمُنَوَّرَةِ وَالْعُقُولِ النُّورَانِيَّةِ

مِنَ الْأَنْبِيَاءِ وَالْأَوْلِيَاءِ وَالْأَصْفِيَاءِ بِجَمِيعِ تَحْقِيقَاتِهِمْ وَكُشُوفَاتِهِمْ وَفُيُوضَاتِهِمْ وَمُنَاجَاتِهِمْ فَإِنَّ كُلًّا مِنْهُمْ وَمِنَ الْأَرْضِ وَالْأَجْرَامِ الْعُلْوِيَّةِ وَالسُّفْلِيَّةِ بِمَا لَا يُحَدُّ مِنْ شَهَادَاتِهِمُ الْقَطْعِيَّةِ وَتَصْدِيقَاتِهِمُ الْيَقِينِيَّةِ بِقَبُولِ شَهَادَاتِ الْآيَاتِ

التَّكْوِينِيَّةِ وَالْقُرْآنِيَّةِ؛ وَشَهَادَاتِ الصُّحُفِ وَالْكُتُبِ السَّمَاوِيَّةِ الَّتِي هِيَ شَهَادَةُ الْوُجُوبِ لِلْوُجُودِ عَلَى أَنَّ هَذِهِ الْمَوْجُودَاتِ آثَارُ قُدْرَتِهِ وَمَكْنُونَاتُ قَدَرِهِ وَمَرَايَا أَسْمَائِهِ وَتَشَلُّعَاتُ أَنْوَارِهِ جَلَّ جَلَالُهُ وَلَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ..

مُتَنَاهِيَةٍ فِي وَقْتِ عَدَمِ التَّنَاهِي بِقُوَّةٍ مُتَنَاهِيَةٍ بِلَا ضَرُورَةٍ مَعَ الضَّرُورَةِ فِي عَكْسِهِ وَهُوَ مُحَالٌ فِي خَمْسَةِ أَوْجُهٍ فَامْتَنَعَتِ الشُّرَكَاءُ مَعَ أَنَّ الشُّرَكَاءَ الْمُمْتَنِعَةَ

Shkalla e Parë

"Dhe thuaj: "Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun i Cili nuk ka lindur bir dhe i Cili nuk ka asnjë shok a të barabartë në mbisundimin e Tij, as nuk është Ai aq poshtë sa të ketë veli (ndihmues, mbrojtës). Dhe lartësoje Atë me gjithë Madhështinë e Madhërinë, thuaj Alla-llahu Ekber (Allahu është më i madhi!)"[6]

Allahu është më i madhi, Ai është i lartësuari! Në lidhje me fuqinë dhe me njohjen Ai është më i madh se çdo gjë tjetër; sepse Ai është Krijuesi, Shpikësi, Formëdhënësi, i Cili nëpërmjet fuqisë së Tij e krijoi dhe e modeloi njeriun si universin; Ai e shkroi universin me penën e kaderit të Tij ashtu siç e shkroi njeriun po me të njëjtën penë; sepse ajo botë e madhe ashtu si kjo botë e vogël, të dyja janë krijuar nga fuqia e Tij dhe të skalituara nga Pena e Kaderit të Tij. Ai e krijoi botën e madhe si një vend sexhdeje, ndërsa i dha ekzistencë botës së vogël duke e bërë atë të bie në sexhde; Ai e solli të parën në ekzistencë dhe e bëri atë si një pronë, ndërsa i dha ekzistencë të dytës duke e bërë si të pronësuar dhe të nevojshëm për pronë; Arti në të parën e shfaq atë si një libër, ndërsa ngjyrimi i dytë në të dytën shndrit nëpërmjet ligjëratës; fuqia e Tij në të parën shfaq madhështinë e Tij, kurse mëshira e Tij në të dytën rendit, radhit mirësinë e Tij; Madhështia e Tij në të parën dëshmon se Ai është Një; ndërsa mirësia e Tij në të dytën shpall se Ai është i Vetëm, i Pandashëm; Stampa e Tij në të parën është mbi të gjitha gjërat, në universalet dhe në të pjesshmet, qofshin në pushim apo në lëvizje, ndërsa vula e Tij në të dytën është mbi trupin, mbi gjymtyrët, në qelizat e tyre dhe në grimca.

Tani, soditi veprat e Tij si një e tërë: ti do të shohësh aq qartë si drita e ditës një shumicë, bollëk brenda një rregullshmërie e një sistemi absolut; në një shpejtësi absolute me një drejtpeshim absolut, në një lehtësi absolute me një mjeshtëri absolute, në një gjërësi absolute me një bukuri absolute arti, në një largësi absolute me një unitet të plotë të llojit, në një përzierje absolute me një dallueshmëri absolute, në një lirshmëri absolute -mungesë shpenzimi- së bashku me një vlerë absolute. Kjo situatë e shikuar dëshmon për mendjen e shëndoshë verifikuese dhe i detyron hipokritët të pranojnë se ky art dhe ky unitet

[6] Kur'an, 17:117

janë vepra e Një të Vetmi i Cili Zotëron Fuqi Absolute dhe që është i Gjithëditur Absolut.

Në unitet ndodhet një lehtësi absolute, ndërsa në shumësi dhe në të përshkruarit ortakë me Zotin ndodhen vështirësi të pakuptueshme.

Në qoftë se të gjitha gjërat do t'i atribuoheshin një të Vetmi, atëherë krijimi i universit është aq i lehtë sa krijimi i një druri palme, dhe druri i palmës është aq i lehtë sa fruti.

Por, në qoftë se gjërat do t'i atribuoheshin shumësisë, atëherë krijimi i një druri palme do të ishte aq i vështirë sa krijimi i universit, dhe secili frut do të ishte aq i vështirë sa pema, kështu aq i vështirë sa të jetë e pamundur, sepse me një akt të vetëm, një person i vetëm mund të sigurojë një rezultat dhe një situatë për gjëra të shumta pa vështirësi dhe pa përdorur mjete të tjera. Ndërsa në qoftë se ajo situatë dhe ai rezultat do t'i referoheshin shumësisë, do të ishte e pamundur që t'i arrije ato veçse me vështirësi të mëdha, duke ndjekur mjete të tjera dhe me kundërshtime. Do të ishte si një oficer që ua referon detyrën ushtarëve, mjeshtri ndërtues t'ua referonte gurëve të ndërtesës, toka planetëve, ujëvara pikave të ujit dhe pika qëndrore e një rrethi t'ua referonte të gjitha pikave në perimetër.

Nëpërmjet misterit të 'lidhjeve' një fuqi e pakufishme është e pranishme në unitet. Një gjë apo një shkak nuk detyrohet të mbajë burimet e forcës së saj, dhe puna që rezulton prej shkakut fiton madhështi në lidhje me gjënë mbi të cilën ai mbështetet. Por kur shoqërohen e përshkruhen ortakë me Allahun, të gjitha shkaqet detyrohen t'i mbajnë vetë burimet e fuqisë së tyre, dhe punët që rezultojnë prej tyre zvogëlohen deri në shkallën e vëllimit të tyre. Për shkak të kësaj, një bletë dhe një mizë shpartalluan tiranët, dhe një bërthamë e vogël mban mbi vete një pemë të madhe.

Në qoftë se të gjitha gjërat do t'i atribuoheshin një të Vetmi, nuk do të kishte nevojë për të krijuar nga mosekzistenca absolute, përkundrazi, krijimi përbëhet nga transferimi i një qënieje që ka ekzistencë në njohje për tek ekzistenca e jashtme, ashtu si transferimi i imazhit, fotos në pasqyrë për tek letra fotografike duke vërtetuar kështu ekzistencën e saj të jashtme me lehtësi të plotë, ose si duke zbuluar fjalët e shkruara me bojë të padukshme me anë të shpërndarjes së një substance të veçantë mbi shkrim e cila e shfaq shkrimin e fshehur.

Kur gjërat u atribuohen shkaqeve dhe shumësisë, kjo do të bënte të domosdoshme që ato të ishin krijuar nga një mosekzistencë absolute, dhe kjo në qoftë se nuk do të ishte e pamundur, do të ishte më e vështira e gjërave. Në unitet është një lehtësi; është aq e lehtë derisa është e domosdoshme. Kurse në shumësi është një vështirësi e madhe; është aq e vështirë sa është e pamundur.

Në përputhje me urtësinë, me unitetin, është e pamundur të krijosh një qënie nga mosekzistenca absolute.

Domethënë, ta krijosh një qënie nga mosqënia e pastër menjëherë në çast, pa lëndë, dhe t'i derdhësh grimcat në kallëpin që ka ekzistencë në njohje pa vështirësi apo ngatërresë. Ndërsa, ashtu siç pajtohen në mendim të gjithë njerëzit e arsyes, me shumësinë dhe me të përshkruarit ortakë me Zotin xh.sh., krijimi origjinal është i pamundur nga mosekzistenca, sepse për ekzistencën e një krijese të gjallë, duhet të grumbullohen së bashku grimcat dhe elementet e shpërndara gjithandej tokës.

Dhe kur nuk ka kallëp, model ekzistues në njohje, për t'i ruajtur grimcat në trupin e një krijese të gjallë, secila grimcë duhet të posedonte një njohje gjithëpërfshirëse e të gjithanshme dhe një dëshirë absolute.

Përveç kësaj, nuk ekziston absolutisht nevoja për ato gjëra që supozohen të jenë ortakë me Zotin xh.sh. ashtu siç është e pamundur për to që të jenë ortakë. Atëherë të pretendosh se ato janë ortakë, ky pretendim do të ishte një arbitraritet i pastër; nuk ka asgjë në qënie që sugjeron se ato kanë ndonjë rol në krijimin e tyre, dhe asnjë shenjë nuk ekziston për të; sepse krijimi i qiejve dhe i tokës bën të domosdoshëm një fuqi të plotë e të pakufishme, e cila të mos ketë absolutisht asnjë nevojë për ortakë; ose përndryshe, nëse do të kishte ortakë, do të bëhej e domosdoshme ta përkufizosh dhe ta sjellësh në përfundim një fuqi të plotë të pafundme në kohë të pafundme me një fuqi që ka fund, megjithëse nuk ka domosdoshmëri për këtë, madje ndonëse e kundërta është e domosdoshme; dhe kjo është e pamundur në pesë drejtime. Atëherë ortakë të tillë janë të pamundur dhe të papranuar. Për më tepër, qëniet në asnjë mënyrë nuk sugjerojnë dhe as nuk tregojnë për ekzistencën e tyre.

Ne e kemi shpjeguar këtë çështje në vendqëndrimin e Parë të Fjalës së Tridhjetë e dytë, duke treguar se si të gjitha gjërat nga grimcat e vockëla deri tek planetët, dhe nga planetët për tek tiparet individuale të fytyrës në vendqëndrimin e Dytë, e refuzojnë të përshkruarin ortakë me Zotin xh.sh. dhe shfaqin stampën e Unitetit Hyjnor mbi të gjitha ato.

Ashtu siç nuk ka Ai ortakë, po ashtu Ai nuk ka as ndihmës as ministër. Shkaqet nuk janë gjë tjetër veçse perde të holla për drejtimin e Fuqisë së parapërjetshme; në realitet ato nuk kanë efekt krijues -në asnjë gjë-; sepse më e larta e shkaqeve, dhe ai me dëshirën më të shtrirë është njeriu; dhe nga njëqind pjesët e akteve më të dukshme të vullnetshme të tilla si të ngrënit, të folurit dhe të menduarit, ai ka vetëm një pjesë të dyshimtë.

Në qoftë se fuqia e vërtetë në dispozicion e më të lartit të shkaqeve dhe ai me dëshirën më të shtrirë është kështu i kufizuar siç e keni parë, atëherë si do të ishte e mundur për kafshët e për krijesat e gjalla të kenë pjesë në krijimin dhe në Hyjninë e Krijuesit të qiejve e të tokës?

Ashtu si zarfi në të cilin një mbret ka vendosur një dhuratë, ose shamia në të cilën ai mbështjell një dhuratë ose mbajtësi, shoqëruesi, i cili e sjell dhuratën tek ty, të cilët nuk mund të jenë partnerë në sovranitetin e mbretit, po ashtu shkaqet nëpërmjet të cilave dërgohen dhuratat për tek ne, nuk mund të jenë partnerë apo ndihmës për Zotin, apo ndërmjetësi që të kenë ndonjë efekt.

Shkalla e Dytë

Allahu është më i madh, Ai është më i lartësuari; Në lidhje me fuqinë dhe me njohjen, Ai është më i madh se sa çdo gjë tjetër.

Ai është *Krijuesi*, *i Gjithëdituri*, *Autori i Gjithurtë*, *i Gjithëmëshirshmi* dhe *Mëshirëploti*; sepse qëniet e tokës dhe trupat e lartë qiellorë në kopshtin e universit, në mënyrë të vetëkuptueshme, janë mrekullitë e fuqisë së Krijuesit të Gjithëditur, dhe këto bimë të stolisura e shumëngjyrëshe të shpërndara në parkun e tokës dhe shumë lloje të kafshëve të shfaqura e të shpërndara gjithandej parkut janë në mënyrë të domosdoshme çudirat e jashtëzakonshme të artit të një Autori të Gjithurtë; dhe lulet buzëqeshëse dhe frutat e zbukuruara në kopshtet e këtij parku janë në mënyrë të qartë dhuratat e mëshirës së të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotë.

Këto mrekullira të Fuqisë, këto çudira të jashtëzakonshme të artit dhe këto dhurata të mëshirës dëshmojnë, thërrasin dhe shpallin se Krijuesi i tyre, Modelisti dhe Dhuruesi është i Plotëfuqishëm mbi të gjitha gjërat, i Njeh të gjitha gjërat dhe Mëshira dhe njohja e Tij i rrethojnë dhe i përfshijnë të gjitha gjërat.

Në lidhje me fuqinë e Tij, grimcat dhe yjet janë të barabarta; e pakta dhe e shumta janë njëlloj; e vogla dhe e madhja, e fundmja -e kufizuara- dhe e pafundmja janë të barabarta. Të gjitha ngjarjet e së shkuarës dhe ndodhitë e saja të çuditshme, janë mrekullitë e artit të Krijuesit të Gjithurtë dhe dëshmojnë se ky Krijues është i Gjithëfuqishëm për të gjitha mundësitë e së ardhmes dhe për ndodhitë e saja të çuditshme, sepse Ai është Krijuesi i Gjithëditur, i Larti dhe i Gjithurti.

Lavdia i takon Atij i Cili e bëri parkun e tokës ekspozitën e artit të Tij, vendtubimin e krijesave të Tij, manifestimin e fuqisë së Tij, boshtin e urtësisë së Tij, kopshtin e mëshirës së Tij, fushën e kultivueshme të Parajsës së Tij, vendkalimin e krijesave, vendi nëpërmjet të cilit vërshojnë qëniet, dhe masën e artifakteve të Tij.

Kafshët e stolisura, zogjtë e zbukuruar, pemët e bëra frytdhënëse dhe bimët e zbukuruara me lule janë mrekullitë e njohjes së Tij, çudirat e jashtëzakonshme të modelimit të Tij, dhuratat e Bujarisë së Tij dhe provat e mirëbërësisë së Tij.

Lulet duke buzëqeshur me stolinë e frutave, zogjt duke kënduar në flladin e mëngjesit të hershëm, shiu duke kërcitur në petalet e luleve, nënat duke përqafuar me dhembshuri e butësi të vegjëlit e tyre, që të gjitha bëjnë të njohur të Dashurin e Vetëm, bëjnë të dashur të Gjithëmëshirshmin e Vetëm dhe Dashamirësin Gjithëbujar për xhindet e për njerëzit, për qëniet shpirtërore, për melekët dhe për kafshët.

Farërat dhe frutat, kokrrat dhe lulet janë mrekullitë e Fuqisë, çudirat e Artit, dhuratat e mëshirës, provat e unitetit; ato dëshmojnë për mirësitë e Tij në botën e Ahiretit. Ato janë dëshmitarë të vërtetë që dëshmojnë se Krijuesi i tyre është i Gjithëfuqishëm mbi të gjitha gjërat dhe i Gjithëditur për të gjitha gjërat; që me mëshirën e Tij, me njohjen, krijueshmërinë e planifikimin, artin dhe modelimin, Ai i rrethon dhe i përfshin të gjitha gjërat. Në lidhje me krijimin e Tij, planifikimin, artin dhe modelimin, dielli është si një farë e vockël, një yll si një lule, dhe

toka si një kokërr drithi; sepse farërat dhe frutat janë pasqyrat e unitetit në çdo pjesë të shumësisë; ato tregojnë Kaderin Hyjnor; ato janë shenjat e Fuqisë që tregojnë unitetin e burimit të kësaj shumësie. Duke ardhur nga ai burim, ato dëshmojnë unitetin e artit dhe të modelimit të Krijuesit të tyre. Atëherë, duke ardhur në fund në unitet, ato përmendin urtësinë e krijueshmërisë dhe të planifikimit të Krijuesit.

Farërat dhe frutat janë gjithashtu aluzionet e urtësisë duke treguar se Krijuesi i universales sheh me shikimin e Tij gjithëpërfshirës tek e pjesshmja dhe pastaj tek pjesët e saj, sepse frutat janë qëllimi më i qartë i krijimit të pemës. Kështu, njeriu është qëllimi i universit dhe qëllimi kryesor i Krijuesit të qënieve.

Zemra e njeriut është si një farë dhe pasqyra më e ndritshme e Krijuesit të krijesave. Për shkak të kësaj urtësie në univers, njeriu i vogël është boshti kryesor, dhe arsyeja për ringjalljen e këtyre qënieve, për shkatërrimin, transformimin, ndryshimin, dhe për ripërtëritjen e këtij universi.

Allahu është më i Madhi!

O Madhështor i Vetëm!

Mendjet nuk mund të depërtojnë tek Esenca e Madhështisë Tënde!

Të gjitha qëniet thonë bashkarisht: ***La ilahe il-la Hu****, Nuk ka Zot tjetër përveç Atij!*

Në mënyrë të përsëritur duke kërkuar plotësimin e nevojave të tyre, ato deklarojnë:

Ja Hakk!*, o i Vërtetë!*

Së bashku ato recitojnë duke thënë:

Ja Hajj, *o i Gjallë i Përjetshëm!*

Shkalla e Tretë[7]

[7] Kjo shkallë e tretë merr në konsideratë një lule dhe një grua të bukur. Pranvera e madhe është një lule, po kështu është parajsa. Ato janë vendet e manifestimit të kësaj shkalle. Ashtu si bota që është një qënie humane e bukur dhe e madhe, po ashtu

Kjo është shpjeguar e sqaruar në fillimin e vendqëndrimit të Tretë të Fjalës së Tridhjetë e Dytë.

Allahu Ekber! Allahu është më i Madhi, lavdia i takon Atij! Në lidhje me fuqinë dhe njohjen Ai është më i Madhi se sa të gjitha gjërat, sepse Ai është *i Gjithëfuqishëm, Përcaktues, i Gjithëditur, i Gjithurtë, Formëdhënës, Gjithëbujar, Hirplotë, Zbukurues, Mirëbërës, I Dashur, Ai që e bën të njohur Madhështinë e Vet, I Gjithëmëshirshëm, Mëshirëplotë, Dashamirës, I Bukur, Hirploti i Vetëm që Zotëron bukuri e plotësi absolute, Skalitësi i parapërjetshëm,* që realitetet e universit si një tërësi apo me pjesët e tij, dhe me nivelet e tij dhe faqet dhe në lidhje me ekzistencën e tyre dhe me qëndrueshmërinë, realitetet e tyre janë veçse:

- Shkrime të mirërenditura e të drejtpeshuara të Penës së Kaderit e të Vendimit të Tij, në përputhje me njohjen dhe urtësinë;

- Janë përshkrimet e skalitjet e kompaseve të Njohjes dhe të urtësisë së Tij të shkruara me art;

- Janë zbukurimet e Dorës vezulluese të Artit të Tij dhe dhënia e formës, zbukurimi i Tij dhe ndriçimi, me mirësi e bujari;

- Janë lulet e hollësive të mirësisë së Tij dhe të bujarisë, të bërjes së njohur e të dashur të Vetvetes së Tij, bujarisht e me mëshirë;

- Janë frutat e begatisë së pranverës së mëshirës së Tij dhe të mirësisë së Tij dhe të butësisë, me bukuri e plotësim;

- Dhe janë shkreptimat e bukurisë së përjetshme, të plotësimit të vazhdueshëm, të dëshmuara nga përkohshmëria e pasqyrave dhe nga rrjedhshmëria e vendeve të reflektimit së bashku me vazhdimësinë e manifestimit të bukurisë nëpërmjet kalimit të stinëve, të shekujve dhe të epokave, së bashku me vazhdimin e mirëbërësisë gjatë kalimit të krijesave, të kohës dhe të qënieve.

---

huritë, qëniet shpirtërore -kafshët dhe njerëzit, që të gjithë ashtu si botërat e qënieve mbajnë kuptimin e qënies humane, si të ishin një njeri i madh e i bukur që nëpërmjet fletëve të tyre, ato reflektojnë Emrat e bukur Hyjnorë të cilët i përshkruan dhe i paraqet kjo shkallë.

Po, natyra kalimtare e pasqyrave dhe kalimi i qënieve së bashku me manifestimet e vazhdueshme dhe me shkëlqimet tregojnë me qartësinë më të madhe se ajo bukuri e qartë dhe Ai plotësim i shndritshëm nuk u përkasin vendeve të manifestimit; ato provojnë në mënyrën më të qartë e me elokuencë se ato i përkasin Bukurisë së shenjtë, Dhuruesit të Shenjtë, Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm, Të Qëndrueshmit dhe të Dashurit.

Sepse një vepër e plotë në mënyrë të vetëkuptueshme tregon një akt të plotë. Dhe një akt i plotë në mënyrë të domosdoshme tregon një emër të plotë dhe një autor të plotë të aktit. Dhe një emër i plotë, padyshim, tregon një atribut të plotë. Dhe një atribut i plotë padyshim tregon një cilësi të plotë. Dhe një cilësi e plotë sigurisht që tregon plotësinë në një mënyrë të denjë për esencën e Tij. Kjo është absolutisht e sigurtë.

Shkalla e Katërt

Allahu Ekber, *Allahu është më i Madhi*. I Lartësuar është Vetëm Ai! Sepse Ai është i Drejtë, Gjykatësi i Përjetshëm i Gjithurtë dhe Sovrani Absolut i Cili e themeloi trungun e pemës së Universit për gjashtë ditë në përputhje me parimet e Urtësisë dhe të Dëshirës së Tij. Ai e ndau atë në pjesë në përputhje me rregullat e Kaderit dhe të Vendimit të Tij. Ai e organizoi atë nëpërmjet ligjeve të Praktikave të Tij. Ai e stolisi dhe e zbukuroi në përputhje me ligjet e mëshirës dhe të përkujdesjes së Tij. Ai e ndriçoi atë nëpërmjet manifestimeve të Emrave dhe të Atributeve të Tij. E gjitha kjo dëshmohet nga sistemi, dhe nga rregullshmëria e artifakteve të Tij, nga zbukurimi i qënieve të Tij, nga ngjashmëria dhe harmonia e tyre e ndërsjellë, nga ndihma dhe nga bashkëveprimi i ndërsjellë dhe nga përqafimi i tyre me njëri-tjetrin dhe nga arti i vetëdijshëm e plot mjeshtëri në të gjitha gjërat në përputhje me masën e kapaciteteve të tyre të specifikuar nga Kaderi Hyjnor.

- Urtësia universale në rregullin e Universit,
- Përkujdesja e Plotë në zbukurimin e tij,
- Mëshira e gjithanshme në mirësinë që i është dhuruar atij,

- Ushqimi -rizku- dhe furnizimet gjithëpërfshirëse për të ushqyer qëniet e tij,

- Nëpërmjet shfaqjes së tij të Atributeve esenciale të Krijuesit të tij, jetës së çuditshme dhe artit që ai shfaq,

- Dhe bukuritë e synuara të zbukurimit të tij,

- Dhe pavarësisht përkohshmërisë së tij, manifestimi i vazhdueshëm i bukurisë së reflektuar në të,

- Dhe dashuria e vërtetë në zemrën e tij për Atë të Vetëm të Cilin e adhuron,

- Dhe tërheqja e dukshme në ekstazën e saj,

- Dhe pajtueshmëria në mendim e të gjithë të plotësuarve në të, lidhur me Unitetin e Krijuesit të tij,

- Dhe dobitë e njëpasnjëshme në të gjitha pjesët e tij,

- Dhe rezultatet e tij të arritura nëpërmjet planit të gjithurtë dhe planifikimi i gjithurtë i bimëve të tij.

- Të ushqyerit bujarisht e me bollëk i qënieve të tij,

- Rregulli i plotë në ndryshimet e elementeve kryesore të tij

- Qëllimet e mëdhaja të ndjekura në rregullin e tërësisë së tij,

- Dhe krijimi i menjëhershëm, në çast, me një art krejtësisht të plotë, pa pasur nevojë as për kohë e as për lëndë,

- Individualitetet e urta që u janë dhënë qënieve të tij ngurruese midis mundësive të pakufishme,

- Nevojat më të shumta e të ndryshme të qënieve të tij që u plotësohen në kohët më të përshtatshme në mënyra të paparashikuara, dhe madje edhe dëshirat e tyre më të vogëla, duart e të cilave nuk mund t'i arrijnë ato nevoja, nuk mund t'i plotësojnë.

- Fuqia absolute e manifestuar në mineralin e dobësisë së tij,

- Forca absolute e manifestuar në burimin e pafuqisë së tij,

- Jeta e shfaqur në pagjallërinë e tij, në pajetësinë.

- Vetëdija e gjithanshme e shfaqur në padituri në e tij;

- Rregulli i plotë brenda ndryshimeve të tij, duke bërë të domosdoshme ekzistencën e një Tjetri i Cili është i Pandryshueshëm,

- Pajtimi në tesbihatet e tij si rrathë bashkëqëndrorë të përqëndruar në një pikë,

- Pranueshmëria e tre llojeve të duave të bëra nëpërmjet gjuhëve të gjendjeve të tyre të natyrshme, me gjuhën e nevojave të tyre të bashkëlindura dhe me gjuhën e kërkesës së domosdoshme.

- Lutjet, shikimet dhe shkëlqimet në adhurimin e tij,

- Rregulli në paracaktimin e tij,

- Qetësia e gjetur në përmendjen e Krijuesit të tij,

- Adhurimi në të duke qenë një mjet për ta sjellë bashkë fillimin e tij dhe fundin, dhe shkaku i plotësimeve të tij duke u bërë të dukshme dhe qëllimet e Krijuesit të tij duke u realizuar,

- Dhe së bashku me këto, të gjitha atributet e tjera të universit, gjendjet dhe rrethanat dëshmojnë se të gjitha qëniet e tij janë nën drejtimin e një Planifikuesi të Vetëm të Gjithurtë, dhe të mbështetur nga një Furnizues i Vetëm Gjithëbujar; se ato të gjitha janë shërbëtorët e Një Udhëzuesi të Vetëm; nën drejtimin e një Drejtuesi të Vetëm, dhe se burimi i tyre është fuqia e një të Vetmi, vulat e shumta të Unitetit të të Cilit janë të dukshme në të gjitha letrat e të gjitha faqeve të qënieve të Tij:

Po, të gjitha lulet, frutat, bimët, pemët, kafshët, gurët dhe madje edhe grimcat dhe balta, në të gjitha luginat dhe mbi të gjitha malet, dhe shkretëtirat dhe djerrinat janë vula midis skalitjeve dhe veprave, për ata që shikojnë me vëmendje, ato tregojnë se Ai që e bëri veprën, është pikërisht Ai që e shkroi mbishkrimin i cili përfshin vendin. Ai gjithashtu është Shkruesi e Skalitësi i faqes së tokës dhe poshtë deteve. Ai gjithashtu i skaliti diellin dhe hënën në faqen e qiejve të cilët përmbajnë shumë mesazhe të tilla. Lavdia i takon Skalitësit të Lartësuar të tyre***! All-llahu Ekber***! *Allahu është më i Madhi*!

Bota dhe gjithçka që ndodhet brenda saj recitojnë bashkërisht: *"Nuk ka Zot tjetër përveç Tij".*

Shkalla e Pestë[8]

Allahu Ekber! *Zoti është më i Madhi*! Sepse Ai është Krijuesi, i Gjithëdituri, Formëdhënësi dhe Gjithëshikuesi për Hyjninë dhe Madhështinë e të Cilit këto trupa qiellorë dhe yjet e shndritshëm vezullues janë prova; ato janë rreze që dëshmojnë Hyjninë dhe Madhështinë e Tij. Ato dëshmojnë e shpallin Sovranitetin e Tij të ndritshëm dhe Hyjninë e Tij; ato shpallin shtrirjen e gjërë të sundimit të Tij e të Urtësisë së Tij, si dhe gjërësinë Madhështore të Fuqisë së Tij.

Dëgjoje vërsetin:

"A nuk e kanë parë qiellin mbi ta, si Ne e kemi ndërtuar atë dhe zbukuruar, dhe s'ka asnjë të çarë në të?"[9]

Pastaj hidhe vështrimin tek faqja e qiejve, ti do të shohësh se si ai është i heshtur në qetësinë e vet, si ai është në lëvizje me urtësi, si ai është vezullues me madhështi, si ai buzëqesh me zbukurimin e tij, brenda rregullit të krijimit të tij, simetrisë së artit të tij.

Shkëlqimi i llambës së tij -diellit- për ndryshimin e stinëve, fazat e fenerit të tij -hënës- për të ndriçuar gjurmët dhe vezullimi i yjeve të tij për të stolisur botërat shpallin për ata, të cilët mendojnë, një sovranitet të pakufishëm e të pafundmë duke rregulluar këtë botë.

Kështu, Krijuesi i Gjithëfuqishëm është i Gjithëditur për të gjitha gjërat, Dëshira e Tij është e gjithanshme; ajo që Ai ka dashur është, dhe ajo që Ai nuk ka dashur nuk është. Ai është i Gjithëfuqishëm mbi të gjitha gjërat nëpërmjet fuqisë së Tij esenciale gjithëpërfshirëse absolute. Ashtu siç nuk është as e mundur dhe as e imagjinueshme për diellin sot të ekzistonte pa dritë e pa nxehtësi, po ashtu është e pamundur dhe e paimagjinueshme ekzistenca e një Zoti, Krijues i qiejve dhe i tokës, të ekzistonte pa njohje gjithëpërfshirëse dhe pa fuqi absolute. Nga domosdoshmëria, Ai është i Gjithëditur për të gjitha

[8] Kjo është shpjeguar e ilustruar në Shtojcën e Vendqëndrimit të Parë të Fjalës së Tridhjetë e Dytë dhe në Stacionin e Dytë të Fjalës së Tridhjetë

[9] Kur'an, 50: 6

gjërat me njohuri gjithëpërfshirëse esenciale për Qënien e Tij. Nga domosdoshmëria një njohuri e tillë është e lidhur me të gjitha gjërat; nëpërmjet misterit të prezencës, të shikimit, depërtimit dhe të gjithëpërfshirjes së ndritshme, asgjë nuk ka mundësi të jetë e ndarë, e shkëputur, apo jashtë një njohjeje të tillë.

Drejtpeshimi dhe rregulli që vëzhgohen në të gjitha qëniet, përpjestueshmëria e rregullt dhe e drejtpeshuar, urtësia universale, mirëbërësia e plotë, rregullshmëria e mirëbalancuar, prodhimtaria - frytëzimi- i paracaktuar, çasti i përcaktuar i vdekjes, furnizimi me rregull, përsosuria e plotë dhe saktësia, siç vërtetohet nga shkenca, bukuria e kujdesshme, dallueshmëria krejtësisht e përkryer, drejtpeshimi, rregulli, mjeshtëria dhe lehtësia absolute, që të gjitha këto dëshmojnë njohjen gjithëpërfshirëse mbi të gjitha gjërat të Njohësit të së Padukshmes.

Vërseti, *"A nuk e di Ai i Cili i ka krijuar? Dhe Ai është më i Buti dhe më Dashamirësi (ndaj robëve të Tij), i Mirënjohuri për çdo gjë".*[10] tregon se ekzistenca e një gjëje bën të domosdoshme njohjen rreth saj, dhe drita e ekzistencës së gjërave bën të domosdoshme dritën e njohjes rreth tyre.

Krahasimi ndërmjet artit të bukur të njeriut duke treguar zgjuarsinë e tij me dëshminë e krijimit të njeriut për njohjen e Krijuesit të tij, është si krahasimi i dritës pambarimisht e vogël e një xixëllonje në një natë të errët me shkëlqimin madhështor të diellit në mesditë mbi faqen e tokës.

Dhe ashtu siç është Ai i gjithëditur për gjithçka, po ashtu Ai është Dëshirues për gjithçka, sepse nuk është e mundur për diçka që të realizohet pa u dëshiruar. Ashtu si fuqia që është e efektshme, që ndikon dhe njohja bën dallueshmërinë, po ashtu dëshira specifikon e përcakton; pastaj realizohet ekzistenca e gjërave.

Ndodhen dëshmi për ekzistencën e Dëshirës Hyjnore dhe për zgjedhjen aq sa numri i gjendjeve, i fazave dhe i cilësive të gjërave.

Po, të gjitha gjërave duke iu dhënë rregulli dhe duke u përcaktuar me cilësi të veçanta midis mundësive të pakufishme, midis rrugëve shterpa prej rrjedhave të ngatërruara të elementeve të paujdisura, duke

[10] Kuran, 67:14

iu dhënë një rregull të tillë të hollë e të ndjeshëm, dhe duke iu dhënë atyre një drejtpeshim me një balancë të tillë të hollë e të ndjeshme, ashtu siç vëzhgohen qartë; dhe krijimi i qënieve të gjalla të mirërregulluara nga lënda e thjeshtë e pajetë -si njeriu dhe sistemet e tij fizike nga sperma- dhe zogjt dhe gjymtyrët e tyre nga vezët, dhe pemët dhe pjesët e tyre të ndryshme nga farërat- tregojnë se të gjitha gjërat specifikohen dhe përcaktohen me anë të Dëshirës së Tij, të zgjedhjes dhe të vullnetit. Ashtu si gjërat e të njëjtit lloj që i korrespondojnë njëra-tjetrës dhe gjymtyrët e të njëjtës specie që i ngjasojnë njëra-tjetrës për sa ka të bëjë me gjymtyrët bazë, gjë e cila tregon se nga domosdoshmëria Krijuesi i tyre është Një i Vetëm, po ashtu çdo gjymtyrë duke pasur një individualitet të urtë duke përmbajtur shenja e tipare dalluese të mirërregulluara, tregon se Ai Krijues i Vetëm, Një, është Veprues me dëshirë e me zgjedhje, i Cili vepron siç dëshiron dhe urdhëron çfarë të dojë.

Dhe ashtu si Ai Krijues i Gjithëditur e Dëshirues që ka njohuri për të gjitha gjërat dhe është Dëshirues për çdo gjë dhe ka njohje gjithëpërfshirëse, dëshirë të gjithanshme dhe zgjedhje të plotë; po ashtu Ai ka një fuqi të domosdoshme, esenciale dhe të plotë, e cila buron nga Esenca e Tij dhe është e domosdoshme për atë Esencë. Ndërhyrja e të kundërtës së saj është e pamundur, sepse ajo do të bënte të domosdoshme bashkimin e të kundërtave, gjë e cila është e pamundur, ashtu siç pajtohen të gjithë me këtë mendim. Atëherë nuk ka shkallë në fuqinë e Tij. Grimcat dhe yjet janë të barabarta në lidhje me atë fuqi, ashtu siç janë të barabarta për të; e shumta dhe e pakta, e vogla dhe e madhja, e pjesshmja dhe universalja, pjesa dhe e tëra, njeriu dhe Universi dhe bërthama dhe pena.

- Nëpërmjet misterit të 'Dritësisë', 'Tejdukshmërisë', 'Reciprocitetit', 'drejtpeshimit', 'Rregullit' dhe 'përshtatjes'.

- Sipas dëshmisë së rregullit absolut, drejtpeshimit absolut, dallueshmërisë absolute, së bashku me shpejtësinë absolute, lehtësinë dhe shumësinë.

- Nëpërmjet misterit të 'Mbështetjes së Unitetit', 'Lehtësisë së Unitetit', dhe Manifestimit të Njësisë.

- Nëpërmjet urtësisë së 'Domosdoshmërisë', 'Shkëputjes -veçimit- të plotë dhe çlirimit' dhe 'tjetërisë së plotë të Esencës'.

- Nëpërmjet misterit të ‘pakufizueshmërisë’, duke mos qenë i lidhur nga hapësira, dhe nga ‘pandashmëria’;

- Nëpërmjet urtësisë së transformimit të pengesave dhe të vështirësive në mjete për lehtësim nëse do të ishte nevoja, ndonëse nuk ka asnjë nevojë -si venat dhe damarët e njeriut dhe si telat metalikë për përcjelljen e elektricitetit dhe të forcave të holla.

- Nëpërmjet urtësisë së grimcave që nuk janë më me pak elokuencë se sa yjet, as të pjesshmet nuk janë më me pak elokuencë se sa universalet, as pjesët nuk janë më me pak elokuencë se sa të tërat, as të paktat nuk janë më me pak elokuencë se sa të shumtat, as të voglat nuk janë më me pak elokuencë se sa të mëdhatë, as njeriu nuk është më me pak elokuencë se sa bota dhe as farërat nuk janë më me pak elokuencë se sa pema.

- Në përputhje me të gjitha këto, grimcat janë të barabarta me yjet përpara asaj fuqie, të paktat janë të barabarta me të shumtat, të voglat janë të barabarta me të mëdhatë, pjesët janë të barabarta me të tërat, të pjesshmet janë të barabarta me universalet, njeriu është i barabartë me botën, dhe fara është e barabartë me pemën; nuk mund të vlerësohet si e pagjasë se Ai që krijon të parën, krijon edhe të dytën, sepse qëniet që janë gjithëpërfshirëse janë shembuj të zvogëluar të universit duke rrethuar e gjithëpërfshirë qëniet, dhe si mesazhe të vogla, ose si pika të distiluara prej tyre. Domethënë, gjëja që është e gjithëpërfshirë duhet të jetë në kapjen e Fuqisë së Krijuesit të gjësë së rrethuar me qëllim që shembulli i zvogëluar i qënies së rrethuar mund të përfshihet brenda gjësë së rrethuar nëpërmjet parimeve të njohjes së Tij, dhe përmbledhja e gjësë së rrethuar të mund të shtypet prej saj në përputhje me balancën e urtësisë së Tij. Atëherë fuqia që i krijon këto të pjesshme, nuk e ka të vështirë që t’i krijojë ato universale.

Dhe ashtu si një kopje e Kuranit të urtësisë e shkruar në një atom në grimcat e eterit që nuk është më me pak elokuencë se sa një kopje madhështore e Kuranit e shkruar në faqet e qiejve me bojën e diellit e të yjeve, po ashtu krijimi i një blete apo i një mize nuk është më me pak elokuencë se sa krijimi i një hurme arabie ose i një elefanti, dhe arti i një luleje, trëndafili, nuk është më me pak elokuencë se sa ai i një ylli vezullues. Dhe kështu me rradhë, mund të bëhen shembuj të tjerë në të njëjtën mënyrë.

Për më tepër, lehtësia e plotë në krijimin e gjërave i ka çuar njerëzit e çudhëzimit që të ngatërrojnë formimin e gjërave me vetëformimin, gjë e cila do të bënte të domosdoshme pamundësi besëtytnore, të cilat jo vetëm mendjet i refuzojnë, por ftohen e largohen prej tyre madje edhe iluzionet, kurse për njerëzit e së vërtetës dhe të Realitetit, ajo provon me siguri dhe në mënyrë të domosdoshme se përpara fuqisë së Krijuesit të Universit, yjet dhe grimcat janë të barabarta.

Lavdia i takon Atij, E lartësuar është madhështia e Tij; dhe s'ka Zot tjetër përveç Atij.

Shkalla e Gjashtë[11]

I Lartësuar, i Lavdëruar dhe i Shenjtëruar është Allahu! ***Allahu Ekber****! Zoti është më i Madhi!* Në lidhje me fuqinë dhe me njohjen, Ai është më i madh se çdo gjë, sepse Ai është i Drejti, i Gjithurti, i Gjithëfuqishmi, i Gjithëdituri, Një, i Vetmi dhe Sulltani i Parapërjetshëm. Të gjitha botërat janë brenda kapjes së rregullit dhe të balancës së Tij, brenda organizimit dhe drejtpeshimit të Tij, brenda drejtësisë së Tij, urtësisë, njohjes së Tij dhe Fuqisë; ato manifestojnë unitetin e Tij dhe njësinë, ashtu siç mund të kapet me intuitë në mënyrë të sigurtë, dhe madje mund të vëzhgohet, sepse nuk ndodhet asgjë në ekzistencë e cila të jetë jashtë limiteve të rregullit, balancës, organizimit dhe drejtpeshimit. Ato janë dy dyer prej *Regjistrit të Qartë*, dhe *Librit të Qartë*, këto janë dy tituj:

E Para është prej njohjes dhe urdhrit të të Gjithëditurit dhe të Gjithurtit, dhe *i dyti* i fuqisë dhe i Dëshirës së Madhështorit dhe të Mëshirëplotit; sepse rregulli dhe balanca e këtij *Libri* dhe *Regjistri* janë dy prova të shndritshme për ata që kanë arsye në kokë dhe që kanë dy sy në fytyrën e tyre se, absolutisht asgjë në ekzistencë apo në kohë nuk është jashtë kapjes së Fuqisë së një të Gjithëmëshirshmi të Vetëm, organizimit të Një Dashamirësi të Vetëm, stolisjes së Një Zemërbuti të Vetëm dhe drejtpeshimit të Një Shpaguesi të Vetëm.

[11] Në qoftë se kjo shkalla e gjashtë do të ishte shkruar ashtu si shkallët e tjera, do të kishte qenë shumë e zgjatur, sepse "Libri i Qartë", dhe "Regjistri i Qartë" nuk mund të shpjegohen në terma të përmbledhura. Megjithatë, meqenëse ajo është diskutuar pak në Fjalën e Tridhjetë, ne e kemi prerë shkurt diskutimin këtu, dhe e kemi lënë shpjegimin e detajuar të saj për t'u studiuar gjatë mësimit". Autori

Shkurtazi: Manifestimet e Emrave Hyjnorë ***El-Ev-Velu Vel-A'hiru,*** *I Pari dhe i Fundit* shikojnë tek fillimet dhe përfundimet e qënieve, tek origjinat e tyre dhe tek pasardhjet, tek e shkuara dhe e ardhmja dhe tek Urdhri Hyjnor dhe njohja; ato tregojnë *Regjistrin e Qartë*. Ndërsa manifestimet e Emrave Hyjnorë ***Edh-Dhahir, El-Bàtin,*** *i Dukshmi* dhe *i Padukshmi* në krijimin e gjërave tregojnë *Librin e Qartë*.

Sepse universi është si një pemë e gjërë, dhe botërat brenda tij janë gjithashtu si pemë. Prandaj ju mund të bëni një krahasim midis krijimit të një peme të pjesshme me atë të universit së bashku me të gjitha llojet dhe botërat e tij. Kjo pemë e pjesshme ka një origjinë e një burim që është bërthama mbi të cilën ajo mbin, dhe ajo ka një pasardhje e cila i vazhdon funksionet e saj pas vdekjes së saj që është bërthama në frutin e saj.

Kështu, fillimi i saj dhe fundi janë manifestimet e Emrave Hyjnorë, ***El-Ev-vel*** dhe ***El-A'hir***, i *Pari* dhe *i Fundit*. Nëpërmjet rregullit dhe urtësisë fillimi i saj dhe fara origjinale sikur janë një indeks dhe një program që përfshijnë të gjitha ligjet e formimit të pemës. Bërthamat, farat, në frutat e saj, të cilat janë fundi i saj, janë vendi i manifestimit të Emrit Hyjnor ***El-A'hiru,*** *i Fundit*.

Ato farëra në frutet e saj të krijuara me urtësi të plotë janë si arka të vogëla, sunduqe, në të cilat janë vënë një indeks dhe një program për formimin e një peme të ngjashme. Të përshkruara e të skalitura në to me Penën e Kaderit Hyjnor janë ligjet e formimit të pemëve të së ardhmes.

Aspekti i jashtëm i pemës është manifestimi i Emrit Hyjnor ***Edh-Dhahiru****, i Jashtmi, i Dukshmi*, sepse paraqitja e saj e jashtme shfaq një rregull të përkryer, një balancim dhe urtësi, sikur të ishte një mantel i zbukuruar dhe i stolisur me të cilin është veshur pema me urtësi të plotë dhe me mirësi në përputhje me masën e shtatit të saj.

Aspekti i brendshëm i pemës është manifestimi i Emrit Hyjnor ***El-B'atinu****, i Brendshmi, i Padukshmi*. Ai shfaq një rregull të plotë dhe një planifikim dhe i çudit mendjet.

Ai shpërndan lëndët e nevojshme për jetën e pemës tek të gjitha pjesët e ndryshme të saj me rregullsi të plotë, sikur ky aspekt i

brendshëm të ishte një makineri e jashtëzakonshme që punon me drejtpeshimin më të skajshëm të mirorganizuar.

Kështu, origjina e saj është një program i jashtëzakonshëm dhe fundi i saj është një indeks i çuditshëm, që të dyja duke treguar *Regjistrin e Qartë*. Kurse aspekti i saj i jashtëm është si një mantel i mrekullueshëm plot art, dhe aspekti i saj i brendshëm është si një makineri me një rregullsi të skajshme; që të dy tregojnë *Librin e Qartë.*

Dhe ashtu si aftësia e kujtesës së njeriut që tregon ***El-leuhul-Mahfudh,*** *Pllakën e Ruajtur* dhe është një provë për të, po ashtu bërthamat origjinale të të gjitha pemëve dhe frutat e tyre tregojnë *Regjistrin e Qartë*. Kurse aspektet e tyre të jashtëm e të brendshëm aludojnë për *Librin e Qartë*. Atëherë krahasimet mund të bëhen ndërmjet kësaj peme të pjesshme, pemës së tokës dhe të shkuarës dhe të ardhmes së saj, dhe pemës së universit, fillimit të tij dhe të ardhmes së tij dhe pemës së njeriut me paraardhësit e tij dhe me pasardhësit. Dhe kështu me rradhë.

Lartësuar dhe i Gjithëlavdishëm është Allahu! Nuk ka Zot tjetër përveç Atij!

O i Lartësuar! Ti nuk i drejton mendjet për tek Esenca e vërtetë e Madhështisë Tënde, dhe as nuk arrijnë mendimet tek Substanca e Madhësisë Tënde të jashtëzakonshme absolute -sepse mendja është e pafuqishme për t'i kapur ato.

Shkalla e Shtatë

I Lartësuar dhe i Gjithëlavdishëm është Zoti xh.sh.! ***Allahu Ekber****! Allahu është më i Madhi*! Në lidhje me fuqinë dhe me njohjen Ai është më i Madh se të gjitha gjërat, sepse Ai është Krijuesi[12], Hapësi, Vepruesi, Njohësi, Dhuruesi, Rrezatuesi, Dielli i Parapërjetshëm. Universi së bashku me botërat e tij dhe me qëniet është një hije prej Dritave të Tij; ato janë veprat e akteve të Tij, dhe ngjyrat e skalitjeve të llojeve të manifestimeve të Emrave të Tij, dhe vijat e shkruara nga

[12] Duke shikuar nëpërmjet teleskopëve të këtyre Emrave të Bukur Hyjnorë dhe akteve dhe veprave Hyjnore nën manifestimet e tyre pas këtyre qënieve mund të kalohet tek Ai i Cili quhet ***Dhil Xhelali-Vel Ikram,*** *Zotëruesi i Gjithëlavdisë dhe i Bujarisë e i Mirëbërësisë.*

Pena e Kaderit dhe e vendimit të Tij, dhe pasqyrat për manifestimet e Atributeve të Tij, të bukurisë së Tij, të lavdisë dhe të plotësisë.

- Sipas konsensusit të dëshmitarit të parapërjetshëm, i njohur nëpërmjet të gjithë librave të Tij dhe shkrimeve të mëparshme, vërseteve të Tij Kuranore dhe shenjave krijuese.

- Nëpërmjet konsensusit të tokës me të gjitha botërat e saj, së bashku me kërkesat dhe nevojat e tyre esenciale dhe totale, dhe pasurisë e mbushullisë absolute të shfaqura tek ato.

- Nëpërmjet konsensusit të të gjithë Profetëve, Evlijave, shenjtorëve, dijetarëve të pastër, njerëzve të ndriçimit me shpirtëra të ndritur, zemrave të mbushura me dritë dhe mendjeve të ndriçuara, nëpërmjet kërkimeve të të gjithë atyre, zbulesave, shkëlqimeve dhe duave e përgjërimeve të tyre...

- Ata të gjithë kanë qenë të pajtuar në mendim, nga toka për tek trupat e lartë e të ulët me dëshmitë e tyre të pafundme të sigurta dhe me vërtetimin e tyre të sigurt, me pranueshmërinë e tyre të dëshmisë së shenjave krijuese dhe të vërseteve Kuranore, të librave të shpallur dhe të shkrimeve qiellore të cilat janë pikërisht dëshmia e Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm, se të gjitha qëniet janë veprat e Fuqisë së Tij, letrat dhe mesazhet e Kaderit të Tij, pasqyrat e Emrave të Tij të bukur dhe përfaqësimet e Dritave të Tij.

I Lartësuar dhe i Madhëruar është Ai, nuk ka Zot tjetër përveç Atij!

* * *

SHKREPTIMA E TRIDHJETË

Shkreptima e Tridhjetë e Letrës së Tridhjetë e Një dhe Një frut i Burgut të Eskishehir.

Kjo përbëhet nga Gjashtë Pika.

[Ashtu si Trajtesa "*Frutet e besimit*" që ishte leksioni më i lartë i shkollës *Jusufie* të Denizlit, dhe trajtesa *El-Huxh-xhetu Ez-zehra*, *Prova vezulluese*, që ishte leksioni më i çmueshëm i Shkollës *Jusufie* të Afjonit, po ashtu një mësim i fuqishëm i rëndësisë më të madhe i Burgut të Eskishehir është kjo Shkreptima e Tridhjetë, e cila shpjegon Gjashtë Pika rreth Gjashtë Emrave Hyjnorë duke mbajtur Emrin më të madh.

Gjithësecili nuk do t'i kuptojë menjëherë dhe nuk do t'i vlerësojë çështjet e thella dhe të shtrira në pjesët rreth Emrave Hyjnorë ***El-Hajj,*** *I Gjalli i Përjetshëm* dhe ***El-Kajjum***, *Vetekzistuesi i Përhershëm* prej Emrit më të madh, por megjithatë ata nuk do të mbeten pa pjesë prej tyre.]

*** * ***

PIKA E PARË

Emri Hyjnor **El-Kuddus**, *Më i Shenjti.*

[Kjo pikë lidhet me një aspekt të Emrit Hyjnor ***El-Kuddus***. Ajo është e përshtatshme që të formojë një shtesë për Shtojcën e Fjalës së Tridhjetë.]



Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Edhe tokën Ne e shtruam. Dhe sa Shtrues të shkëlqyer jemi Ne![1]

Një manifestim e Emrit Hyjnor, ***El-Kuddus***, *Më i Shenjti*, i Cili është njëri kuptim i vërsetit të lartëpërmendur dhe është Emri më i Madh dhe njëra prej gjashtë dritave të përfshira në Emrin më të Madh, m'u bë i qartë në muajin Hënor *Sha'ëban* në Burgun Eskishehir. Ajo demonstroi me qartësi të plotë edhe ekzistencën Hyjnore. Unë e pashë atë si më poshtë vijon:

Ky univers dhe ky glob tokësor janë si një fabrikë e madhe duke punuar në mënyrë të vazhdueshme dhe i ngjasojnë një hoteli të madh ose një bujtine e cila në mënyrë të vazhdueshme mbushet e boshatiset, duke ditur se bujtina kaq të gjëra si këto, dhe me kaq shumë individë që vijnë e shkojnë, mbushen me plehra, mbeturina e me gërmadha, dhe e bëjnë çdo gjë të ndotur, dhe kushtet dhe shkaqet e jetës bëhen të ngushta e të vështira në to.

Në qoftë se nuk do të punonte në to dora e pastrimit dhe e mirërregullimit në mënyrë të vazhdueshme, ato papastërtira e

[1] Kuran, 51:48

mbeturina do të çonin në mbytjen e njeriut dhe në pamundësinë e tij për të jetuar...

Pavarësisht se ne gati nuk shohim në këtë fabrikën madhështore të universit dhe në këtë bujtinë të Globit tokësor shenja mbeturinash, ashtu siç nuk gjendet në asnjë qoshe të tyre ndonjë lëndë e padobishme apo jo e domosdoshme, apo të jetë lëshuar kot. Madje edhe në qoftë se do të shfaqej ndonjë lëndë si këto, me t'u shfaqur, ajo lëshohet nëpër makineri transformimi dhe ato e kthejnë atë në lëndë të pastër..

Kjo do të thotë se Ai i Cili kujdeset pas kësaj fabrike, kujdeset në mënyrën më të mirë e të përkryer. Pronari i saj është i Tillë saqë Ai urdhëron për t'u fshirë, për t'u pastruar dhe për t'u sistemuar vazhdimisht fabrika e madhe dhe pallati i shtrirë sikur ato të ishin dhoma të vogla, dhe nuk shikohen më në to, pavarësisht madhështisë së tyre, shenja plehrash e mbeturinash të cilat mund të jenë në përpjesëtim me madhësinë e fabrikës dhe me përmasën e saj shumë të madhe.

Atëherë përkujdesja për pastrim është e vazhdueshme, vëmendja për fshirje është e përhershme dhe në harmoni me madhësinë e fabrikës dhe të gjërësisë së saj.

Në qoftë se një njeri nuk e lan vetveten dhe nuk e pastron dhomën e tij të vogël për një muaj, ato do të bëheshin jashtë mase të pista e të ndotura. Domethënë, pastrimi, shkëlqimi, pastërtia në këtë pallat të botës buron nga një pastrim i vazhdueshëm, i urtë, i zellshëm dhe i kujdesshëm. Në qoftë se nuk do të ishte ky pastrim, kjo fshirje dhe kjo përkujdesje e vazhdueshme për pastërti, do të mbyteshin për një vit qindra e mijëra speciet e kafshëve në faqen e tokës.

Gjithashtu, rrënojat e planeteve në hapësirë dhe të qiejve, të cilët manifestojnë jetën dhe vdekjen, dhe ato të satelitëve dhe të yjeve do të kishin copëtuar jo vetëm kokat tona dhe ato të kafshëve të tjera, por gjithashtu edhe kokën e vetë tokës dhe atë të botës sonë. Ato do të kishin lëshuar mbi kokat tona shkëmbinj me madhësinë e maleve dhe do të na kishin dëbuar prej atdheut tonë në këtë botë. Por për një periudhë shumë të gjatë kohore në të shkuarën, si një paralajmërim disa meteorë kanë rënë si rezultat i shkatërrimit dhe rindërtimit në ato botëra të larta, dhe ato nuk kanë goditur asnjë njeri, por kanë qenë veçse për të nxjerrë mësime.

Për më tepër, kërmat e qindra mijëra specieve të kafshëve dhe gërmadhat e mbeturinat e dyqind mijë llojeve të bimëve në çdo vit në faqen e tokës që shkaktohen nga Qarkullimi dhe luftërat për jetën dhe vdekjen, do ta kishin ndotur aq shumë tokën dhe detin, saqë krijesat e vetëdijshme, në vend që ta donin e të përmalloheshin për faqen e tokës, do të ndjeheshin të neveritura e të ftohura prej një shëmtie e fëlliqësie të tillë dhe do të iknin prej saj për tek vdekja dhe për tek mosekzistenca.

Ashtu siç i pastron zogu krahët e tij me lehtësi, ose siç i pastron shkruesi fletët e librit të tij me lehtësi të plotë, po kështu pastrohen fletët e kësaj toke fluturuese së bashku me zogjt qiellorë në hapësirë; fletët e këtij libri madhështor të universit, pastrohen, stolisen dhe bëhen të bukur ashtu si shembulli i asaj lehtësie e kollajllëku. Madje pastrimi i kësaj faqes së tokës, fshirja, rregullimi, sistemimi dhe stolisja është nga plotësimi i artit dhe i përkryerjes gjë e cila i bën ata që nuk shohin nëpërmjet besimit të tyre -bukurinë e Ahiretit ta duan fort këtë bukuri dhe këtë pastërti të kësaj bote të kësaj dynjaje, madje ata mund ta adhurojnë atë!

Domethënë, ky pallat i botës dhe kjo bukuri e universit shfaqin manifestimin më të madh të Emrit Hyjnor ***El-Kuddus***.

Saqë kur shfaqen urdhërat e shenjta Hyjnore lidhur me fshirjen dhe me pastrimin, ato nuk lëshohen vetëm për kafshët e mëdhaja mishngrënëse të detit, të cilat kryejnë detyrën e pastrimit, dhe për shkabat dhe skifterët e tokës të cilët u binden atyre urdhërave të shenjtë për pastrim, por ato urdhëra i dëgjojnë gjithashtu edhe llojet e krimbave dhe të milingonave të cilat i mbledhin kërmat dhe marrin përsipër detyrën e punonjësve të shërbimit të përgjithshëm shëndetësor duke u përkujdesur për to në këtë botë; madje këto urdhëra të shenjta edhe rruazat e kuqe e të bardha të gjakut qarkullojnë në trup dhe e bëjnë pastrimin në qelizat e trupit, madje edhe frymëmarrja kryen pastrimin e gjakut. Dhe ashtu si kapakët e hollë të syrit që u binden këtyre urdhërave për të pastruar syrin në mënyrë të vazhdueshme, po ashtu edhe mizat u binden atyre urdhërave dhe bëjnë gjithmonë pastrimin e krahëve të tyre.

Ashtu siç u binden atyre urdhërave të shenjta për pastrim të gjitha ato që u përmendën lart, gjithashtu atyre u binden edhe atmosfera e

shtrirë dhe retë e rënda dhe erërat që fryjnë. Këto e pastrojnë faqen e tokës nga plehrat dhe mbeturinat, sfungjerët e reve spërkasin me shi kopshtin e tokës dhe e qetësojnë pluhurin e dheun. Pastaj ato tërhiqen e fshehin vetveten me një rregullsi të plotë me të gjitha mjetet e tyre, me qëllim që të kthehet bukuria e shndritshme në faqen e qiellit duke shkëlqyer e vezulluar.

Dhe ashtu si yjet, elementet, mineralet dhe bimët që u binden urdhrave për pastrim, po ashtu të gjitha grimcat dhe atomet u binden atyre urdhërave; ato i kushtojnë vëmendje pastrimit në përmbysjet e çuditshme të ndryshimit dhe të transformimit. Ato kurrë nuk grumbullohen ndokund në mënyrë të panevojshme dhe të zënë rrugën. Edhe në qoftë se bëhen të ndotura, ato pastrohen shpejt. Ato shtyhen nga një dorë urtësie për të fituar më të pastërtën, më të papërzierën, më të shkëlqyerën e gjendjeve, më të bukurën, më të pastërtën dhe më të hollën e formave.

Kështu, ky akt i veçantë, domethënë, akti i pastrimit, që është një e vërtetë e vetme, është një manifestim më i madh i Një Emri më të madh, prej manifestimeve të Emrit ***El-Kud-dus*** i cili e shfaq vetveten në sferën më të lartë, domethënë, në sferën më të gjërë të sferave të universit; Saqë e sqaron ekzistencën Hyjnore dhe e shfaq unitetin Hyjnor së bashku me Emrat e Tij të bukur në mënyrën më të qartë ashtu si dielli i shndritshëm, dhe ua shfaq atë syve largpamës.

Është vërtetuar me prova vendimtare në shumë pjesë të Risale-i Nurit se meqenëse akti i organizimit dhe i rregullimit, i cili është manifestimi i Emrave Hyjnorë ***El-Hakem*** dhe ***El-Hakim***, *i Dituri* dhe *i Gjithurti*; dhe akti i peshimit dhe i balancimit është manifestimi i Emrave Hyjnorë, ***El-Adl*** dhe ***El-A'dil***, *Drejtësia* dhe *i Gjithëdrejti*; dhe akti i stolisjes dhe i mirëbërësisë, i cili është një nga manifestimet e Emrave Hyjnorë, ***El-Xhemilu***, ***El-Kerim***, *Hirploti, Gjithëbujari*; dhe akti i mbështetjes, i edukimit dhe i të dhuruarit i cili është një nga manifestimet e Emrave Hyjnorë, ***Er-Rabb, Er-Rahim***; *Mbështetësi - Zhvilluesi, Mëshirëploti..*

Secili nga këto akte, është një akt i vetëm dhe e vërtetë e vetme që shikohen me qartësi në horizontet e të gjithë universit, dhe secili prej tyre tregon domosdoshmërinë e ekzistencës së Një të Vetmi, dhe e shfaq me qartësi unitetin e Tij.

Gjithashtu, akti i të pastruarit dhe i fshirjes i cili është një nga manifestimet e Emrit Hyjnor ***El-Kuddus***, *Më i Shenjti*, tregon për ekzistencën e Atij të domosdoshmi, ashtu si dielli, dhe e shpjegon Unitetin e Tij aq qartë si dita..

Dhe ashtu si aktet e përmendura të rregullimit, drejtpeshimit, zbukurimit dhe pastrimit e të tjera si këto prej akteve të urta të cilat tregojnë një Krijues të Vetëm nëpërmjet unitetit të tyre të llojit në sferën më të lartë, po kështu bëjnë shumica e Emrave të Bukur. Madje secili prej *Një Mijë e Një Emrave* ka një manifestim më të madh në sferën më të lartë nga sferat e këtij universi. Akti që buron nga ai manifestim tregon *Të Vetmin Unik* me një qartësi të tillë duke iu përshtatur atij akti dhe qartësisë së tij.

Po, urtësia universale e cila ia nënshtron çdo gjë ligjit dhe sistemit të saj, dhe përkujdesja e gjithanshme zbukuron dhe stolis çdo gjë, dhe mëshira e gjërë e cila fut gëzimin e kënaqësinë tek çdo gjë duke e bërë atë të jetë në dhënie të vazhdueshme lavdërimesh, furnizimi universal me rizk i cili i ushqen dhe u jep kënaqësi të gjitha gjërave, dhe jeta dhe dhënia e jetës e cila e lidh çdo gjë me të gjitha gjërat dhe çdo gjë të përfitojë prej të gjitha gjërave, si të ishte pronarja e gjërave..

Këto të vërteta të vetëkuptueshme dhe aktet e veçanta që vëzhgohen qartë, të karakterizuara me unitetin, që e bëjnë faqen e tokës të shndërisë me shkëlqim dhe që nisin me gëzim e kënaqësi, tregojnë në mënyrë të vetëkuptueshme të Gjithurtin, Gjithëbujarin, Mëshirëplotin, Furnizuesin, të Gjallin e Vetëm Jetëdhënës, ashtu siç tregon drita diellin, dhe Allahut i takon krahasimi më i lartë.

Në qoftë se ato qindra akte të shtrira, secili prej tyre është një provë e qartë e Unitetit të Zotit xh.sh., nuk do t'i atribuoheshin Një të Vetmi, atëherë secili prej tyre do të bëhej domosdoshmërisht i pamundur në qindra drejtime. Për shembull, le t'i lëmë të vërtetat e vetëkuptueshme dhe dëshmitë e njësisë, si urtësinë, furnizimin me rizk, mëshirën, mbështetjen dhe dhënien e jetës; në qoftë se vetëm akti i pastrimit nuk do t'i atribuohej Krijuesit të universit, atëherë do të bëhej e domosdoshme -në rrugën e mohimit dhe të çudhëzimit- që çdo gjë të kishte lidhje me pastrimin duke filluar nga grimcat, për tek insektet, mizat, elementet dhe deri tek yjet, dhe që të gjitha këto krijesa duhet të kishin aftësinë e dijes, njohjes dhe të pastrimit të këtij universi

madhështor, të stolisjes së tij, të zbukurimit dhe të drejtpeshimit të gjithçkaje që ndodhet në të!! Dhe të vepronin në përputhje me to; ose secila nga ato duhej të karakterizohej nga atributet e shenjta të Krijuesit të botëve, ose tek secila duhej të ishte i pranishëm një takim konsultativ, një kuvend me masën e universit me qëllim që të rregullonte ekuilibrin e zbukurimit dhe të pastrimit të universit dhe të hyrat dhe të dalat e tij, dhe ta formonte këtë tubim, kuvend, me grimca të panumërta, me miza dhe me yje!!

Dhe kështu, qindra besëtytni, gjepura dhe pamundësi sofistike si këto do të ndodhnin me qëllim që zbukurimi dhe pastrimi universal, gjithëpërfshirës dhe i lartësuar të shfaqeshin e të shiheshin gjithandej. Sa për këtë, kjo nuk është e mundur një herë, por qindra e mijëra herë.

Në qoftë se drita e ditës dhe diejt imagjinarë të zvogëluar të përfaqësuar në të gjitha objektet e shndritshëm në tokë nuk do t'i atribuoheshin diellit dhe nëse nuk thuhet se ato janë manifestimi i reflektimit të diellit, atëherë do të bëhej e domosdoshme ekzistenca e një dielli të vërtetë të ishte i pranishëm në të gjitha copat e xhamit, në pikat e ujit dhe në flokët e borës të cilat shkëlqejnë në faqen e tokës, dhe madje në të gjitha grimcat e ajrit, me qëllim që të shfaqej ajo dritë e cila përgjithëson ekzistencën!!

Dhe kështu:

Urtësia është gjithashtu një dritë; mëshira e gjithanshme është një dritë; zbukurimi, drejtpeshimi, rregullimi dhe pastrimi, secili prej tyre është një dritë gjithëpërfshirëse; ato të gjitha janë rrezet e Diellit të parapërjetshëm. Atëherë, shiko me dritën e besimit se si çudhëzimi dhe mosbesimi kanë hyrë në një moçal prej të cilit nuk mund të dalin, dhe shiko se sa idiote është injoranca e çudhëzimit! Thuaj:

"Lavdi Zotit për fenë islame dhe për plotësimin e imanit!"

Po, ky pastrim i lartësuar universal i cili e mban të pastër pallatin e universit është manifestimi dhe kërkesa e Emrit Hyjnor ***El-Kuddus***, *Më i Shenjti*. Dhe ashtu siç shikojnë tesbihatet e të gjitha krijesave tek Emri

El-Kuddus, po ashtu Emri ***El-Kuddus*** kërkon pastrimin e të gjitha atyre krijesave.[2]

Për shkak të kësaj lidhje të shenjtë të pastërtisë, hadithi,

اَلنَّظَافَةُ مِنَ الْإِيمَانِ *"Pastërtia është pjesë e besimit"*[3] e vlerëson pastërtinë si një dritë të besimit. Dhe vërseti

إِنَّ اللهَ يُحِبُّ التَّوَّابِينَ وَيُحِبُّ الْمُتَطَهِّرِينَ *"Vërtet Allahu i do shumë ata të cilët i kthehen Atij me pendim; dhe Ai i do ata të cilët e pastrojnë vetveten, që e mbajnë vetveten të pastër",* [4] tregon se pastërtia është mjet për të tërhequr dashurinë e Zotit xh.sh..

* * *

PIKA E DYTË

Emri Hyjnor **El-Adl**,*i Drejti*

وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا عِنْدَنَا خَزَائِنُهُ وَمَا نُنَزِّلُهُ إِلَّا بِقَدَرٍ مَعْلُومٍ ۞

"*Dhe s'ka asgjë që Ne të mos i kemi për të thesaret e pashtershëm dhe Ne nuk e dërgojmë atë veçse në masë të drejtë e të ditur*".[5]

Një pikë lidhur me këtë vërset dhe një dritë nga dritat e manifestimeve të Emrit Hyjnor, ***El-Adl***,*i Drejti*, i cili është një Emër më i madh ose njëri nga gjashtë dritat që përfshijnë Emrin më të madh, ashtu si *Pika e Parë*, m'u shfaq mua nga larg ndërsa isha në Burgun Eskishehir. Me qëllim që ta sjellim atë më afër të kuptuarit, përsëri nëpërmjet një krahasimi, ne themi sa vijon:

---

[2] Ne nuk duhet të harrojmë se cilësitë e këqija, besimet e rreme, mëkatet dhe bidatet, të gjitha janë shembujt e papastërtisë morale e shpirtërore.

[3] Muslimi

[4] Kuran, 2:222

[5] Kur'an, 15:21

Universi është një pallat, por është një pallat i tillë i mahnitshëm i cili përfshin një qytet të gjërë që në mënyrë të vazhdueshme lëkundet nga shkatërrimi e rindërtimi. Dhe në atë qytet ndodhet një mbretëri e gjërë e cila zien e trazohet vazhdimisht nga dukuritë e forta të luftës e të emigracionit. Dhe brenda asaj mbretërie është një botë e cila papushim rrotullohet midis vdekjes dhe jetës.

Mirëpo një balancë e tillë e çuditshme, një drejtpeshim dhe një baraspeshim sundon në pallat, në qytet, në mbretëri dhe në botë saqë në mënyrë të vetëkuptueshme provon se transformimet, të hyrat e të dalat e dukshme në këto qënie të padukshme maten e drejtpeshohen në çdo moment në pjatat e peshores së Një të Vetmi i Cili e mbikëqyr dhe e kontrollon të gjithë universin.

Sepse në qoftë se do të kishte qenë ndryshe, në qoftë se shkaqet do të kishin qenë të lira e të pakufizuara duke iu lënë rastësisë së paqëllim, ose forcave të verbëra, ose natyrës së errët të pavetëdijshme, atëherë vezët e një peshku të vetëm që janë më shumë se një mijë, do ta prishnin atë balancim, madje farat e një luleje të vetme, si Hashashi e cila prodhon më shumë se njëzet mijë farëra, do ta prishnin drejtpeshimin, dhe nëpërmjet sulmit të rreptë dhe furisë së ndryshimit dhe të elementeve duke vërshuar si rrjedha dhe, ndryshimet e transformimet e mëdha të cilat ndodhin në anët e universit.. secila prej tyre, në qoftë se do të kishte qenë e lirë dhe e pakufizuar, do të mund ta shkatërronte atë ekuilibër të hollë të vendosur midis krijesave, dhe do ta prishte atë drejtpeshim të plotë midis pjesëve të universit brenda një viti, ose madje brenda një dite do ta shihje botën në kaos. Domethënë, detet do të kishin qenë mbushur me gjëra rrënoja, me kërma, mbeturina e gjëra të prishura; atmosfera do të ishte helmuar me gazra të dëmshëm; ndërsa toka do të ishte kthyer në një kapicë plehu, një therrtore dhe një moçalishte. Bota do të ishte mbytur, do t'i ishte zënë fryma.

Nëse dëshiron, hidhe vështrimin tek të gjitha krijesat, duke filluar nga qelizat e trupit, rruazat e kuqe e të bardha të gjakut, transformimet e grimcave të vogla, përpjesëtimi i drejtë dhe harmonia midis gjymtyrëve të trupit, të hyrat e të dalat prej deteve, të ardhurat dhe shpenzimet e burimeve nën tokë, midis lindjes dhe vdekjes së kafshëve dhe të bimëve, shkatërrimit të vjeshtës dhe rindërtimit të pranverës, detyrave të elementeve dhe lëvizjes së yjeve, ndryshimeve, luftërave

dhe përplasjeve të vdekjes dhe të jetës, dritës dhe errësirës dhe nxehtësisë dhe të ftohtit si dhe midis gjërave të tjera të ngjashme me to, me qëllim që të shikosh se të gjitha: peshohen e vlerësohen me një balancë aq të ndjeshme, me një masë aq të hollë, sa që mendja njerëzore nuk mund të shikojë askund ndonjë harxhim të tepërt apo kotësi, ashtu siç vëzhgojnë shkenca njerëzore dhe filozofia rregullin më të plotë dhe simetrinë më të bukur të cilat demonstrohen në çdo gjë.

Madje shkencat tek të cilat ka arritur njeriu janë vetëm se interpretimi i atij sistemi të mrekullueshëm dhe manifestimi i atij drejtpeshimi dhe i asaj simetrie.

Atëherë, eja dhe shikoje balancën dhe ekuilibrin e diellit dhe të dymbëdhjetë Planeteve. A nuk tregon kjo balancë aq qartë si dielli të Gjithëlavdishmin e Vetëm i Cili është *i Drejti i Gjithëfuqishëm*?

Pastaj hidhe vështrimin në tokë -e cila është njëra nga planetët, kjo anije që ecën duke notuar në hapësirë që përshkon vetëm gjatë një viti një distancë gjatësia e së cilës vlerësohet njëzet e katër mijë vite. Pavarësisht kësaj shpejtësie të jashtëzakonshme, nuk shpërndahen dhe nuk lëkunden gjërat e depozituara e të vëna turrë në faqen e saj, dhe as nuk i hedh ato nëpër hapësirë.. Në qoftë se shpejtësia e saj do të kishte qenë shtuar apo pakësuar vetëm pak, ajo do t'i kishte hedhur banorët e saj në atmosferë, dhe do t'i kishte shpërndarë ato nëpër hapësirë. Dhe në qoftë se ekuilibri i saj do të prishej vetëm për një minut, apo madje për një sekond, ajo do të shkatërronte botën. Madje ajo do të përplasej me një trup tjetër dhe do të bëhej kijameti.

Pastaj sodite në mënyrë të veçantë balancën e mrekullueshme me mëshirë që shfaqet në lindjet, në vdekjet, në mjetet e jetesës dhe në jetët e katërqind mijë llojeve të bimëve dhe të kafshëve në tokë; kjo të tregon në mënyrë aq të qartë siç tregon dita diellin, *Krijuesin e Drejtë Mëshirëplotë*. Pastaj shiko gjymtyrët, aftësitë e holla dhe shqiset e vetëm të një qënieje të gjallë midis atyre gjallesave të panumërta.. Ato janë të lidhura me njëra-tjetrën me një balancim dhe ekuilibër aq të hollë saqë drejtpeshimi, harmonia e plotë dhe raporti i ndërsjellë i tyre të tregon në mënyrë të vetëkuptueshme Atë Krijues i Cili është *I Drejti i Gjithurtë.*

Dhe në mënyrë të veçantë qelizat dhe enët e gjakut në trupat e kafshëve, qelizat e gjakut dhe grimcat në ato truptha, qeliza gjaku; ato

kanë një balancim të tillë të hollë, të ndjeshëm dhe të mrekullueshëm saqë në mënyrë të vetëkuptueshme provon se ato ushqehen e administrohen nëpërmjet balancës, ekuilibrit, ligjit dhe rregullit të Krijuesit të Vetëm, të *Drejtit të Gjithurtë* në dorën e të Cilit janë frerat e të gjitha gjërave, i Cili ka çelësin për të gjitha gjërat, për të Cilin asgjë nuk është një pengesë për ndonjë gjë tjetër, duke i drejtuar gjërat me aq lehtësi si drejtimi i një gjëje të vetme.

Ai që nuk beson se veprat e xhindëve dhe të njerëzve në ditën e Ringjalljes më të madhe do të peshohen me peshoren e drejtësisë Hyjnore dhe e vlerëson këtë si të pagjasë dhe nuk e pranon, unë i them në qoftë se ai do të mund ta vërente me kujdes këtë peshore të madhe, të cilën ai mund ta shohë në këtë dynja me vetë sytë e tij, sigurisht ai nuk do ta vlerësonte atë më si të pagjasë -të pamundur.

O Njeri prishanik, i pakursyer, tiran, i padrejtë, i papastër dhe fatkeq! Ti nuk ke vepruar në përputhje me kursimtarinë, me pastërtinë dhe me drejtësinë të cilat janë parimet gjithëpërfshirëse nëpërmjet të cilave vepron i gjithë universi dhe të gjitha qëniet. Ndërsa ti duke vepruar në kundërshtim me të gjitha qëniet që ecin sipas këtyre parimeve të gjithanshme ndesh ftohje e largim prej tyre dhe bëhesh objekt zemërimi dhe ti e meriton këtë... Mbi çfarë gjëje mbështetesh ti saqë nëpërmjet padrejtësisë tënde, çekuilibrimit, harxhimit të tepërt dhe papastërtisë, i bën të gjitha qëniet të zemëruara ndaj teje?

Po, urtësia e përgjithshme që sundon në univers, e cila është manifestimi më i madh i Emrit Hyjnor ***El-Hakim***, *i Gjithurti*, rrotullohet rreth boshtit të kursimit dhe mos'harxhimit të tepërt; madje ajo urdhëron për të prishur me ekonomi, me masë.

Ndërsa Drejtësia e plotë që sundon në univers, e cila buron nga manifestimi më i madh i Emrit Hyjnor ***El-Adl***, *i Drejti* administron balancën e të gjitha gjërave. Dhe ai e urdhëron njerëzimin për të vendosur drejtësi.

Duke e përmendur fjalën 'Balancë' katër herë, këto vërsete në sure *Er-Rahman,*

وَالسَّمَآءَ رَفَعَهَا وَوَضَعَ الْمِيزَانَ ۝ أَلَّا تَطْغَوْا فِي الْمِيزَانِ ۝

وَأَقِيمُوا الْوَزْنَ بِالْقِسْطِ وَلَا تُخْسِرُوا الْمِيزَانَ

"Dhe qiellin Ai e ka ngritur lart dhe Ai ka vendosur Baraspeshën",

"Me qëllim që ju të mos e tejkaloni Baraspeshën",

"Dhe përmbajuni peshojës me paanësi dhe mos e cënoni peshojën" [6]

tregojnë katër shkallë dhe katër lloje të balancës, duke treguar madhësinë e saj, rëndësinë më të lartë dhe vlerën e saj më të madhe në univers.

Po, ashtu siç nuk ka harxhim të tepërt në asgjë, po ashtu nuk ka padrejtësi të vërtetë dhe çekuilibrim. Pastërtia dhe pastrimi që burojnë nga manifestimi më i madh i Emrit Hyjnor ***El-Kuddus*** i pastron dhe i bën të bukura të gjitha qëniet në univers. Për sa kohë që dora e papastër e njeriut të mos ndërhyjë, nuk ka papastërti reale apo shëmti në ndonjë gjë.

Kështu, ju mund të kuptoni se sa themelore për jetën e njeriut janë parimet e 'Drejtësisë', kursimit dhe pastërtisë, të cilat janë të vërtetat e Kuranit dhe parimet islame. Dhe dijeni se sa të lidhura ngushtë me universin janë urdhëresat e Kuranit, duke shpërndarë rrënjët e tyre të forta në çdo vend, dhe se do të ishte e pamundur që t'i shkatërrosh ato të vërteta, ashtu siç është e pamundur që ta shkatërrosh universin dhe ta ndryshosh formën e tij.

A do të ishte e mundur që megjithëse qindra nga këto të vërteta gjithëpërfshirëse si këto tre drita të gjëra, të tilla si Mëshira, mirësia dhe ruajtja, mbikëqyrja, të cilat kërkojnë e bëjnë të domosdoshme ringjalljen e të vdekurve dhe Ahiretit; të vërteta të fuqishme dhe gjithëpërfshirëse si mëshira, përkujdesja, drejtësia, urtësia, kursimi dhe pastërtia, të cilat sundojnë në univers dhe tek të gjitha qëniet, a do të ishte e mundur që këto të transformoheshin në mosmirësi, në tirani, në mungesë urtësie, në harxhim të tepruar, në papastërti dhe në kotësi nëpërmjet mosndodhjes së Ringjalljes dhe mosardhjes së Ahiretit?

Ruajna Zot! Një mijë herë, Ruajna Zot! A do të ishte e mundur që një mëshirë dhe një urtësi e tillë të cilat me mëshirë ruajnë të drejtat e

[6] Kur'an, 55: 7-9

jetës së një mize, të shkelnin të drejta të pallogaritshme të jetës së të gjitha qënieve të vetëdijshme dhe të drejtat e panumërta të qënieve të panumërta, duke mos shkaktuar Ringjalljen?

Dhe në qoftë se do të lejohej shprehja, a do të ishte e mundur për Një Hyjni Madhështore e cila shfaq një ndjeshmëri të pafundme dhe një kujdes të tillë në mëshirën e saj, në dhembshurinë, në drejtësinë dhe në urtësinë dhe një sovranitet Hyjnor i Cili zbukuron universin me aktet e Tij të mrekullueshme të Pafundme dhe me mirësitë me qëllim që të shfaqë plotësimet e Tij dhe që ta bëjë Vetveten të njohur e të Dashur, -a do- të lejonte të mos kishte ringjallje, e cila do të zhvlerësonte në asgjë vlerën e krijesave dhe të gjitha plotësimet e tyre dhe t'i bënte ato të mohoheshin? Ruajna Zot! Një bukuri Absolute e tillë në mënyrë të qartë nuk do të lejonte një shëmti të tillë absolute.

Po, ai që dëshiron të mohojë Ahiretin duhet së pari të mohojë të gjithë botën dhe të gjitha të vërtetat e saj. Përndryshe, bota së bashku me të gjitha të vërtetat e saj do ta përgënjeshtronin atë me qindra e mijëra gjuhë, duke provuar natyrën e tij si gënjeshtari më i madh. *Fjala e Dhjetë* provon me dëshmi të sigurta se ekzistenca e Ahiretit është aq e sigurtë dhe e padyshimtë sa ekzistenca e kësaj bote.

*** * ***

PIKA E TRETË

E cila aludon për të Tretën e Gjashtë Dritave

të Emrit më të madh,

Emri Hyjnor, *El-Hakem,* *I Dituri*

أُدْعُ إِلَىٰ سَبِيلِ رَبِّكَ بِالْحِكْمَةِ *"Ftoji në udhën e Zotit tënd me urtësi..."*[7]

[Një manifestim i Emrit Hyjnor ***El-Hakem***, *I Dituri*, i Cili është një Emër më i madh i Allahut xh.sh. ose njëri nga Gjashtë dritat e Emrit

[7] Kur'an, 16:125

më të madh, dhe një pikë e hollë e vërsetit të lartëpërmendur, m'u shfaq në muajin e Ramazanit ndërsa isha në Burgun Eskishehir. Kjo *Pika e Tretë* përbëhet nga pesë çështje, dhe formon vetëm një aluzion të tij. Duke u shkruar me shpejtësi të madhe, ajo ka mbetur në gjendjen e draftit të parë.]

● **Çështja e Parë**

Ashtu siç është treguar në *Fjalën e Dhjetë*, manifestimi më i madh i Emrit Hyjnor ***El-Hakem**, I Dituri* e ka bërë universin si një libër, në çdo faqe të të cilit janë shkruar qindra libra, në çdo rresht të të cilit janë përfshirë qindra faqe, në çdo fjalë të tij janë qindra rreshta, në çdo shkronjë të tij janë qindra fjalë dhe në çdo pikë të të cilit gjendet një indeks i shkurtër i librit.. Ky libër me faqet e tij, me rreshtat dhe madje edhe me pikat e tij tregon me një qartësi të tillë të shndritshme - nëpërmjet qindra aspekteve- Formëdhënësin dhe shkruesin e tij, saqë ai libër i madh i universit dëshmon dhe e provon ekzistencën e unitetit të shkruesit të tij në një shkallë më të madhe se sa e tregon libri ekzistencën e vet. Sepse në qoftë se një shkronjë e vetme e tregon ekzistencën e vet dhe e shpreh vetveten me masën e një shkronje, ajo e tregon dhe i shpreh cilësitë e shkruesit të saj me masën e një rreshti..

Po, njëra faqe e këtij libri madhështor është faqja e tokës. Librat sa numri i bimëve dhe i kafshëve duhet të vëzhgohen në këtë faqe në pranverë, njëri brenda tjetrit, së bashku, në të njëjtën kohë, pa gabim, krah për krah dhe në formën më të plotë..

Një rresht i vetëm i faqes është një kopsht. Ne shohim se në këtë rresht janë shkruar poema të hartuara mirë aq sa numri i luleve, i pemëve dhe i kafshëve, së bashku, njëra brenda tjetrës, krah për krah, dhe pa gabim.

Një fjalë e rreshtit është një pemë e cila i ka çelur lulet e saj, ka lëshuar sythet dhe ka nxjerrë gjethet me qëllim që të prodhojë frutat e saj. Kjo fjalë përbëhet nga pjesë kuptimplota e domethënëse duke lavdëruar e lartësuar të *Diturin Hirplotë, Zotërues të Bukurisë*, aq sa numri i gjetheve të saj të mirërenditura, i luleve të saj të zbukuruara dhe i frutave të saj të drejtpeshuara, saqë sikur ajo pemë me lule të çelura të ishte një poezi e hartuar mirë duke kënduar lavdërime e

lartësime për Mirësitë e Krijuesit të saj, Formëdhënësit të Gjithëlavdishëm.

Dhe sikur *i Gjithurti, Zotëruesi i Madhështisë* dëshiron që robët e Tij t'i shikojnë veprat antike të mrekullueshme të Tij dhe çudirat e krijesave të Tij të shfaqura në ekspozitën e tokës së mrekullueshme, me mijëra sy.

Sikur ato dhurata të çmueshme, ato dekorata të shtrenjta dhe ato uniforma të holla që i janë dhënë asaj peme prej Allahut të Plotëfuqishëm, i kanë dhënë një formë të bukur e të stolisur, një trajtë të drejtpeshuar e të mirorganizuar, dhe forma domethënëse e të urta me qëllim që t'i paraqesë ato për shikimin e Mbretit Madhështor dhe për paradën e Tij të përgjithshme për krijesat në pranverë, saqë secila prej luleve dhe frutave të saja dëshmon në mënyra të shumta dhe brenda shumë dëshmive njëra brenda tjetrës për Ekzistencën e Skalitësit të saj, për Emrat e Tij të bukur.

Për shembull, në të gjitha lulet e saj dhe në frutat është një balancim. Balanca është brenda rregullit, dhe rregulli është brenda një organizimi e drejtpeshimi i cili ripërtërihet në mënyrë të vazhdueshme. Organizimi e drejtpeshimi është brenda një arti dhe një zbukurimi, zbukurimi dhe arti janë brenda parfumave domethënëse dhe shijeve të urta. Kështu secila lule e tregon *të Diturin e Gjithëlavdishëm* sa numri i luleve të asaj peme.

Dhe në pemën, e cila është një Fjalë, dhe frutat e saj që janë si shkronjat e asaj fjale, dhe farërat e frutave sikur të ishin pikat e atyre shkronjave të cilat përmbajnë indeksin dhe programin e të gjithë pemës. Dhe kështu me radhë. Për të vazhduar të njëjtën analogji, si me pemën, nëpërmjet manifestimit të Emrit ***El-Hakem****, i Dituri* dhe ***El-Hakim****, i Gjithurti*, të gjitha rreshtat dhe faqet e librit të universit- dhe jo vetëm rreshtat e tij, por të gjitha fjalët e tij, shkronjat dhe pikat janë bërë si mrekulli saqë sikur të mblidheshin bashkë të gjitha shkaqet, ato nuk do të mund ta bënin përngjasimin e një pike të vetme -domethënë si farën- dhe as nuk mund ta kundërshtonin atë.

Po, meqenëse secila prej shenjave krijuese të këtij Kurani madhështor të Universit shfaq mrekulli sa numri i pikave dhe i shkronjave të atyre shenjave, atëherë në asnjë mënyrë nuk mund të ndërhyjnë Rastësia e ngatërruar, forca e verbër dhe natyra e paqëllim,

anarkiste dhe e pavetëdijshme në atë balancim të urtë, ndjesore të veçantë dhe në këtë rregull të hollë të karakterizuar nga një ndjeshmëri e lartë. Në qoftë se ato do të kishin ndërhyrë, shenjat e ngatërresës me siguri do të ishin shfaqur. Por nuk shihet asnjë çrregullim apo defekt në ndonjë vend.

● **Çështja e Dytë**

Kjo ndahet në dy çështje të tjera:

Çështja e Parë:

Ashtu siç është shpjeguar në Fjalën e Dhjetë, është një rregull shumë themelor se "Bukuria e plotë pafundësisht dhe plotësimi i bukur pafundësisht dëshirojnë ta shohin vetveten, ta tregojnë dhe ta ekspozojnë. Si rrjedhojë e këtij rregulli themelor të përgjithshëm, Skalitësi i Parapërjetshëm i librit madhështor të Universit, nëpërmjet universit dhe nëpërmjet të gjitha faqeve të tij, rreshtave dhe madje shkronjave dhe pikave të tij, nëpërmjet gjuhëve të shumta të të gjitha qënieve duke filluar nga më e vogla e të pjesshmeve për tek më e madhja e universaleve, bëjnë të njohur e të dashur bukurinë e plotësimit të Tij dhe përsosmërinë e bukurisë së Tij, bëjnë të njohur Esencën e Tij më të shenjtë, plotësimet dhe Atributet e Tij të larta, shfaqin bukurinë e Tij dhe e bëjnë Esencën e Tij të Dashur.

O Njeri i pavëmendshëm! Ky i Gjithurtë, i Dituri dhe Sunduesi Zotërues i Madhështisë dhe i bukurisë, duke e bërë Veten e Tij të njohur për ty dhe të dashur prej teje nëpërmjet të gjitha krijesave të Tij në këtë mënyrë të shndritshme dhe të pafundme, në qoftë se ti nuk do ta njihje Atë me besim dhe nëse nuk e bën veten tënde të dashur prej Tij me adhurimin tënd, atëherë sa e madhe do të ishte injoranca jote dhe sa humbje e turpshme do të ishte për ty!..

Prandaj, eja në vete!

*Çështja e dytë e **çështjes së dytë**:*

Nuk ka absolutisht vend për t'i përshkruar ortakëri Krijuesit në këtë univers madhështor të cilin e krijoi Autori i Gjithëfuqishëm i Gjithurtë nëpërmjet fuqisë dhe urtësisë së Tij, sepse ekzistenca e një rregulli të përkryer pafundësisht në çdo gjë, nuk do ta lejonte kurrë përshkrimin e

ortakërisë me Hyjninë; në qoftë se do të ndërhynin duar të shumta në krijimin e ndonjë gjëje, do të bëhej i dukshëm ndryshimi dhe konfuzioni në atë gjë, ashtu siç do të ngatërroheshin punët në qoftë se do të ndodheshin dy mbretër në një vend, dy guvernatorë në një qytet apo dy kryepleq në një fshat, çrregullimi do të ndodhte në të gjitha çështjet e vendit, qytetit dhe të fshatit. Fakti se edhe nëpunësi më i thjeshtë nuk pranon ndërhyrjen e të tjerëve në detyrat e tij, tregon se karakteristika, veçoria themelore e sundimit është 'pavarësia' dhe 'vetmia', të qenurit tek, një. Domethënë, rregulli bën të domosdoshëm unitetin, dhe sundimi bën të domosdoshëm pavarësinë.

Në qoftë se një hije e përkohshme e sundimit tek ky njeri i pafuqishëm e i nevojshëm për ndihmë e refuzon me vrull ndërhyrjen, atëherë si mund ta pranonte ndërhyrjen Sundimi i Vërtetë Absolut i cili është në shkallën e Hyjnisë absolute tek i Gjithëfuqishmi absolut, a nuk do ta refuzonte prerazi ortakërinë?

Në qoftë se do të supozohej se do të kishte pasur ndërhyrje sa një grimcë, do të prisheshin rregulli, harmonia, simetria dhe ekuilibri. Duke ditur se universi është krijuar në një mënyrë të tillë saqë me qëllim që të krijohet një farë, një fuqi e mjaftueshme për të krijuar një pemë do të ishte e domosdoshme. Dhe me qëllim që të krijohet një pemë, një fuqi e mjaftueshme për të krijuar universin do të ishte e domosdoshme. Dhe në qoftë se do të kishte qenë ndonjë ortakë i cili do të kishte ndërhyrë në univers, ai duhet të kishte ndërhyrë edhe në farën më të vockël. Sepse fara është një shembull i universit. Atëherë dy hyjni të cilat nuk mund të qëndrojnë e të vendosen së bashku në universin e gjërë, do të duhej të vendoseshin në një farë dhe madje në një grimcë të vockël. Dhe kjo është më e pamundura, dhe më e pakuptimta e pamundësive dhe më e rremja e imagjinatave.

Mësoje nga kjo se çfarë kontradikte pafundësisht e madhe, çfarë gabimi dhe çfarë gënjeshtre janë mosbesimi dhe të përshkruarit ortakë me Krijuesin, pasi këto të dyja do të bënin të domosdoshme pafuqinë e të Gjithëfuqishmit absolut i Cili mban qiejt e tokën që të mos bien, në Dorën e të cilit janë frerat e qiejve e të tokës dhe i Cili i drejton ato me balancën e drejtësisë së Tij dhe me rregullin e urtësisë së Tij.. Ato të dyja do të bënin të domosdoshme pafuqinë e Krijuesit xh.sh. madje edhe në një farë të vockël!!

Dhe mësoje se çfarë e vërtete pafundësisht e madhe, çfarë realiteti dhe çfarë vërtetësie është Uniteti Hyjnor, dhe thuaj:

"Të gjitha lavdërimet e falënderimet i takojnë Allahut për besimin!"

● **Çështja e Tretë**

Krijuesi i Gjithëfuqishëm, nëpërmjet Emrit Hyjnor ***El-Hakem*** dhe ***El-Hakim,*** *i Dituri* dhe *i Gjithurti* ka përfshirë në këtë botë me mijëra botëra të mirorganizuara të mrekullueshme. Brenda atyre botërave, Ai e krijoi njeriun dhe e bëri atë si qendrën e atyre botërave dhe boshtin e tyre; njeriu midis të gjitha krijesave i manifeston më shumë urtësitë e synuara në univers dhe është mjeti më i rëndësishëm për t'i shfaqur ato. Dhe më të rëndësishmet e shembujve të urtësisë dhe të gjërave të dobishme në sferën e universit shikojnë tek njeriu. Në sferën humane, Ai e bëri rizkun -furnizimin- një qendër; në botën humane; shumica e shembujve të urtësisë dhe të dobive shikojnë e orientohen tek Rizku, furnizimi, dhe bëhen të dukshme e të qarta nëpërmjet tij. Prandaj manifestimet e Emrit Hyjnor ***El-Hakim,*** *I Gjithurti* duken të qarta në formën më të shndritshme tek njeriu nëpërmjet vetëdijes së tij dhe të kënaqësive të Rizkut. Ndërkohë që secila prej qindra shkencave të zbuluara nëpërmjet vetëdijes njerëzore përshkruan vetëm një manifestim të Emrit Hyjnor ***El-Hakem***, *I Dituri* në njërin prej llojeve, në njërën botë të krijimit.

Për shembull, në qoftë se shkenca e mjekësisë do të pyetej: "Çfarë është universi?" Ajo do të përgjigjej duke thënë: "Është një farmaci jashtë mase e gjërë, e mirorganizuar dhe e përkryer. Të gjitha ilaçet përgatiten e depozitohen në të në mënyrën më të mirë".

Në qoftë se do të pyetej shkenca e kimisë: Ç'është globi tokësor? Ajo do të përgjigjej: "Është një laborator kimie i mirorganizuar, i mrekullueshëm dhe i plotë".

Ndërsa shkenca e inxhinierisë do të përgjigjej: "Ajo është një fabrikë e mirorganizuar krejtësisht e përkryer dhe pa asnjë defekt".

Dhe shkenca e bujqësisë do të përgjigjej: "Është një fushë pafundësisht prodhuese, e rregullt dhe e mirorganizuar dhe një kopsht i cili prodhon të gjitha llojet e farërave në kohën e kërkuar".

Shkenca e tregtisë do të përgjigjej: "Është një ekspozitë tregtare madhështore, një treg i mirorganizuar dhe një dyqan i mbushur me artikujt e mallrat më të çmueshme e artistike".

Shkenca e ekonomisë do të përgjigjej: "Është një depo shumë e mirësistemuar e cila përmban të gjitha furnizimet ushqimore me të gjitha llojet dhe varietetet e tyre".

Shkenca e dietetikës do të përgjigjej: "Është një kuzhinë Hyjnore në të cilën gatuhen në mënyrën më të rregullt qindra e mijëra prej ushqimeve të shijshme krah për krah me një sistem shumë të mrekullueshëm e të përkryer."

Shkenca e shërbimit ushtarak do të përgjigjej: "Toka është një kamp ushtarak, megjithëse ndodhen katërqindmijë kombe të ndryshëm në atë ushtri në pranverë, sërish merren nën armë me çadrat e tyre të ngrehura në faqen e tokës; atyre u jepen racionet, uniformat, armët, stërvitja dhe çmobilizimet, të cilat janë të ndryshme për çdo komb, me rregull të përkryer, pa ngatërresë, pa harruar asnjë, nëpërmjet urdhrit, fuqisë dhe mëshirës së Një Komandanti të përgjithshëm, nga mëshira e Tij; ato të gjitha administrohen në mënyrën më të rregullt".

Dhe në qoftë se do të pyetej shkenca e elektricitetit: "Ç'është kjo botë? Ajo me siguri do të përgjigjej: "Çatia e këtij pallati madhështor të universit është stolisur me llamba elektrike të panumërta, të mirërregulluara e të drejtpeshuara. Mirëpo rregulli dhe balanca janë aq të mrekullueshme saqë me në krye diellin dhe ato llamba qiellore të cilat janë një mijë herë më të mëdhaja se sa toka, nuk e prishin balancën e tyre, ndonëse ato janë të ndezura vazhdimisht; ato nuk shpërthejnë në flakë. Shpenzimi dhe harxhimi i atyre llambave është i pafund, atëherë nga vijnë të ardhurat e tyre, lënda djegëse, karburanti? Përse nuk sosen dhe nuk mbarojnë ato? Përse nuk prishet ekuilibri me ndezjen e tyre? Duke ditur se drita e një llambe të vogël vaji do të shuhej e do të ikte në qoftë se nuk do të tregohej kujdes për të në mënyrë të rregullt e të vazhdueshme. Shikoje urtësinë dhe fuqinë e të Gjithëfuqishmit dhe të të Gjithurtit të Gjithëlavdishëm, i Cili e krijoi dhe e ndozi diellin, që sipas astronomisë është një milion herë më i

madh se sa toka dhe një milion vite më i vjetër[8], nuk është shuar dhe vazhdon të jetë i ndezur pa lëndë djegëse, pa qymir apo karburant.

Shqyrtoje këtë dhe thuaj *Lavdi Zotit*, bëj tesbihate në Emrin e Zotit tënd Madhështor dhe thuaj ***Ma Sha all-llah, Tebarekall-llah*** dhe ***La i lahe il-lall-llah***.. *Çfarë çudirash ka dashur Allahu! I bekuar është Allahu! Nuk ka Zot tjetër përveç Tij!* Thuaje këtë sa numri i sekondave të ekzistencës së diellit..

Nuk ka dyshim se një sistem i mrekullueshëm është ai i cili sundon në këto llamba dritëdhënëse qiellore dhe atyre u kushtohet vëmendje me kujdesin më të madh. Është sikur kaldaja e atyre masave gjigante të shumta të ndezura është Xhehennemi -Ferri- nxehtësia e të cilit nuk mbaron kurrë; Ferri u dërgon atyre nxehtësi pa dritë, kurse makineria dhe uzina qëndrore e atyre llambave elektrike të panumërta është një Xhennet i Përjetshëm -Parajsa; Xhenneti u dërgon atyre dritë dhe ndiçim. Nëpërmjet manifestimit më të madh të Emrit Hyjnor ***El-Hakem*** dhe ***El-Hakim***, i *Dituri* dhe *i Gjithurti*, ato vazhdojnë të jenë të ndezura në mënyrën më të rregullt.

Dhe kështu, nëpërmjet dëshmisë së sigurt të qindra shkencave si këto, universi është zbukuruar me shembuj të panumërt urtësie, qëllimi dhe gjërash të dobishme brenda një rregulli të përkryer dhe pa të meta.

Dhe rregulli dhe urtësia e dhënë nëpërmjet asaj urtësie të mrekullueshme dhe gjithëpërfshirëse për tërësinë e universit janë përfshirë në masa më të vogëla në fara dhe në krijesat e gjalla të vockëla. Është e qartë dhe e vetëkuptueshme se qëllimet, synimet, shembujt e urtësisë dhe dobitë mund të ndodhin nëpërmjet zgjedhjes, dëshirës, qëllimit dhe vullnetit, dhe jo nëpërmjet ndonjë mënyre tjetër. Dhe ashtu siç nuk mund të jenë ato vepra e shkaqeve të pavetëdijshme dhe të Natyrës, të cilave u mungon dëshira, zgjedhja dhe qëllimi, po ashtu ato nuk mund të ndërhyjnë në to. Domethënë, nuk mund të

[8] Ju mund ta llogarisni se sa shumë dru, qymyr ose karburant do të ishin të domosdoshme për sobën ose për llambën e diellit, e cila ngroh pallatin e botës. Sipas llogaritjes së astronomisë, që ai të ndizet për çdo ditë, do të ishte e domosdoshme të kishte turra drush sa një milion toka dhe me mijëra oqeanë vaj. Tani mendo! dhe thuaj **SubhanAllah.. MashaAllah.. TebarekAllah..** sa numri i grimcave të diejve përballë madhështisë, urtësisë dhe fuqisë së të Gjithëfuqishmit të Vetëm të Lavdisë, i Cili e bëri atë të japë dritë në mënyrë të vazhdueshme pa lëndë djegëse dhe pa karburant. Autori

përshkruhet se sa injorancë e jashtëzakonshme dhe sa marrëzi do të ishte të mos njohësh apo të mohoje Krijuesin e Gjithurtë, Vepruesin me zgjedhje, për të Cilin tregojnë universi dhe të gjitha qëniet e tij të panumërta nëpërmjet rregullit të tyre të pafundmë dhe shembujve të urtësisë që ato përmbajnë. Po, në qoftë se ndodhet ndonjë gjë që të habit në botë, ajo është një mohim i tillë. Sepse aspektet e pafundme të rregullit dhe të shembujve të urtësisë në qëniet në univers dëshmojnë për ekzistencën dhe për Unitetin e Tij, saqë madje edhe injoranti më i madh do të mund ta kuptonte se çfarë verbërie e injorancë do të ishte nëse nuk do ta shihje apo nuk do ta njihje Atë Krijues të Gjithurtë. Madje unë mund të të them se midis njerëzve të mosbesimit, sofistët që supozohen të jenë idiotë për shkak se ata mohuan ekzistencën e universit, janë inteligjentët e njerëzve të mohimit; sepse të besosh ekzistencën e universit dhe pastaj të mohosh Krijuesin e tij -Allahun- është krejtësisht e pamundur dhe e papranuar. Prandaj ata filluan të mohojnë ekzistencën e universit dhe mohuan edhe ekzistencën e vetveteve të tyre gjithashtu. Duke thënë: "Nuk ka absolutisht asgjë", ata braktisën mendjet e tyre, dhe duke shpëtuar nga një paarsyeshmëri e pakufishme -nën maskën e arsyes- e mohuesve të tjerë, ata në një sens u afruan tek arsyeja.

- **Çështja e Katërt**

Ashtu siç tregohet në Fjalën e Dhjetë, në qoftë se një arkitekt i aftë e i urtë do të ndërtonte një pallat të lartë, dhe ka vendosur në çdo gurë të tij qindra shembuj urtësie, dobi e përfitime, dhe pastaj të mos ndërtonte çatinë e pallatit që ta ruante atë, pasi ndryshe ai do të shembej e bëhej rrënoja dhe të gjitha qëllimet e panumërta dhe shembujt e urtësisë do të humbisnin, kjo do të ishte diçka të cilën asnjë qënie e vetëdijshme nuk mund ta pranonte. Pikërisht në të njëjtën mënyrë i Gjithurti Absolut ndërton prej një fare të vockël qindra tone përfitimesh, shembuj urtësish dhe qëllimesh, dhe i ndjek dhe i drejton ato, atëherë nuk do të mund të përfytyrohej për dikë me arsye që të përhapte kotësi dhe harxhime të tepruara, gjëra të cilat bien në kundërshtim plotësisht me urtësinë absolute të Atij të Gjithurti absolut dhe të investonte e të bënte harxhime shumë të mëdha në një pemë madhështore me qëllim që ajo të prodhojë një dobi të vetme, një qëllim të vetëm të vogël dhe një frut të vetëm që s'vlen pothuajse asgjë, duke

ditur se ai shpenzon për zhvillimin e saj dhe që ajo të prodhojë shumë!..

Po, ashtu siç nuk mund ta përfytyrojë këtë apo atë absolutisht asnjë njeri me mend, po ashtu nuk mund ta përfytyrojë asnjë njeri me mend, që nga "Krijuesi i Gjithurtë të buronte kotësia, harxhimi i tepruar me mosardhjen e Ahiretit dhe me mosbërjen e Ringjalljes dhe të Kijametit, pasi Ai i bashkangjiti çdo krijese në këtë pallatin e universit qindra shembuj urtësie e dobie, pasi i pajisi ato për të kryer qindra detyra dhe i dha çdo peme shembuj urtësie sa numri i frutave të saj dhe i dha detyra sa numri i detyrave të saj; atëherë që Ai i Gjithurtë i Gjithëlavdishëm", të mos e shkaktonte ringjalljen e të vdekurve dhe tubimin e madh dhe që të gjitha ato numra të pallogaritshëm qëllimesh, shembuj urtësie dhe ato detyra të pafundme të ishin të pakuptimta, të kota dhe pa qëllim apo përfitim, kjo do t'i atribuonte pafuqi absolute fuqisë së të Gjithëfuqishmit absolut, t'i përshkruaje kotësi dhe paqëllimshmëri urtësisë së përkryer të të Gjithëditurit absolut, shëmti të plotë bukurisë së mëshirës së Mëshirëplotit absolut, t'i atribuoje tirani të pakufishme drejtësisë së plotë të të Drejtit Absolut, domethënë të mohoje urtësinë, mëshirën dhe drejtësinë në univers, të cilat mund të shihen qartë prej gjithësecilit. Kjo do të ishte një pamundësi e jashtëzakonshme që përmban absurditete të panumërta. Njerëzit e çudhëzimit duhet të vijnë e të shohin se çfarë terri i tmerrshëm ndodhet në çudhëzimin e tyre dhe, si vendet tek të cilat do të hyjnë janë të errëta e të mbushura me akrepa e gjarpërinj, ashtu si varrezat e tyre në të cilat do të futen. Dhe ata duhet ta dinë se besimi në Ahiretin është një rrugë e bukur dhe e ndritshme si Parajsa, dhe duhet të përqafojnë imanin -besimin.

● **Çështja e Pestë**

Kjo përbëhet nga dy çështje

*Çështja e Parë***:**

Fakti që, i kërkuar medoemos nga Emri ***El-Hakim***, *i Gjithurti*, Krijuesi i Gjithëlavdishëm ndjek metodën më të lehtë, rrugën më të shkurtër, mënyrën më të kollajtë dhe formën më të dobishme tregon se nuk ka harxhim të tepruar, kotësi dhe mungesë dobie në natyrën e gjërave. Harxhimi i tepruar është në kundërshtim me Emrin ***El-Hakim***,

i Gjithurti, ndërsa kursimi kërkohet medoemos nga Ai Emër dhe është parimi i Tij themelor.

O prishanik që harxhon me tepricë! Dije se duke mos e zbatuar kursimin, parimin më themelor në Univers, ti ke vepruar në një mënyrë krejtësisht në kundërshtim me realitetin! Ti duhet ta kuptosh se çfarë parimi esencial dhe gjithëpërfshirës udhëzon vërseti, كُلُوا وَاشْرَبُوا وَلَا تُسْرِفُوا *"Hani e pini, por mos shpërdoroni me marrëzi e pamasë..."*[9]

Çështja e Dytë:

Mund të thuhet se Emri ***El-Hakem**, i Dituri* dhe ***El-Hakim**, i Gjithurti* në mënyrë të vetëkuptueshme tregojnë e bëjnë të domosdoshme profetësinë dhe mesazhin e të Dërguarit të Zotit xh.sh., Muhammedit a.s.m..

Po, meqenëse një libër tepër domethënës kërkon medoemos një mësues të shkëlqyer për ta dhënë mësim, dhe një bukuri e jashtëzakonshme kërkon një pasqyrë për ta shfaqur vetveten dhe për ta parë vetveten, bukurinë dhe hijeshinë e vet.. dhe një vepër e përkryer arti kërkon një lajmëtar për ta shpallur; atëherë sigurisht midis njerëzimit, Ai të Cilit iu adresua libri madhështor i universit, në çdo shkronjë të të cilit ka qindra prej kuptimeve dhe shembujve të urtësisë, do të ishte një udhëzues i përkryer dhe një mësues i lartë; sepe Ai do të jepte mësim urtësinë e shenjtë e të vërtetë në libër; domethënë, do të bënte të njohur ekzistencën e urtësisë dhe të qëllimeve në univers; madje ai do të ishte mjeti i shfaqjes dhe i ekzistencës së qëllimeve Hyjnore në krijimin e universit; do të bënte dhe do të vepronte si një pasqyrë për artin e përsosur të Krijuesit, dhe bukurinë e Emrave të Tij të Bukur, të cilët Ai deshi t'i shfaqë gjithandej universit, duke shfaqur rëndësinë e tyre.

Dhe meqenëse Krijuesi dëshiron ta bëjë Vetveten të dashur nëpërmjet të gjitha qënieve të Tij dhe për t'iu përgjigjur të gjitha krijesave të Tij të vetëdijshme, njëri prej tyre do t'i përgjigjej me adhurim gjithëpërfshirës në emrin e të gjithë atyre që ndodhen përballë atyre manifestimeve Hyjnore gjithëpërfshirëse; ai do ta sillte tokën dhe

[9] Kur'an, 7:31

detin në ekstazë, do t'i kthente shikimet e atyre krijesave të vetëdijshme për tek i Vetmi Unik i Cili e bëri artin me një shpallje e me një lartësim të zhurmshëm që do t'i bënte qiejt dhe tokën të ushtonin dhe me udhëzimin e shenjtë, me mësimdhënien prej Kuranit të gjithurtë do të tërhiqte vëmendjen e të gjithë njerëzve të arsyeshëm, do të demonstronte në mënyrën më të mirë qëllimet Hyjnore të Atij Krijuesi të Ditur e të Gjithurtë, dhe i cili do t'u përgjigjej në mënyrën më të plotë e të përkryer manifestimeve të të gjithë shembujve të Tij të urtësisë, të bukurisë dhe të lavdisë; ekzistenca e një njeriu të tillë të rëndësishëm është aq e domosdoshme dhe aq thelbësore për universin, sa ekzistenca e diellit. Dhe ai që e bëri këtë dhe i përmbushi ato funksione në mënyrën më të plotësuar, në mënyrë të vetëkuptueshme që shihet qartë, ishte profeti më i nderuar a.s.m.. Prandaj e gjithë urtësia në univers bën të domosdoshme profetësinë e Muhammedit a.s.m. ashtu siç e bën të domosdoshme dielli dritën, dhe si drita që bën të domosdoshme ditën.

Po, ashtu si nëpërmjet manifestimeve të tyre më të mëdhaja, Emrat Hyjnorë ***El-Hakem, El-Hakim,*** *i Dituri, i Gjithurti* që bëjnë të domosdoshme profetësinë e Muhammedit a.s.m. në shkallën më të lartë, po ashtu Emrat e bukur Hyjnorë të tillë si ***Allah, Er-Rahman, Er-Rahim, El-Vedud, El-Mun'im, El-Kerim, El-Xhemil, Er-Rabb*** e të tjerë.. *Allahu, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti, i Dashuri, Mirëbërësi, Gjithëbujari, Hirploti, Mbështetësi,* bëjnë të domosdoshëm nëpërmjet manifestimit të tyre më të madh të dukshëm në univers, në shkallën më të lartë dhe me siguri absolute, profetësinë e Muhammedit a.s.m..

Për shembull, mëshira gjithëpërfshirëse që është manifestimi i Emrit Hyjnor ***Er-Rahim***, *Mëshirëploti,* është e dukshme nëpërmjet Atij i cili u dërgua si një mëshirë për të gjitha botërat. Dhe Allahu i Plotëfuqishëm duke e bërë Vetveten të njohur e të dashur, duke qenë manifestimi i Emrit ***El-Vedud***, *i Dashuri,* çojnë tek rezultatet e tyre, japin frutin e Atij të Dashuri të Krijuesit të të gjitha botëve dhe gjejnë përgjigje në të. Të gjithë shembujt e bukurisë, të cilët janë manifestimi i Emrit Hyjnor ***El-Xhemil***, *Hirploti, i Bukuri,* domethënë, bukuria e Esencës Hyjnore, bukuria e Artit dhe bukuria e krijesave, shikohen e shfaqen në pasqyrën e Muhammedit a.s.m.. Manifestimet e Madhështisë së Hyjnisë dhe Sovraniteti i Hyjnisë njihen, bëhen të dukshme e të kuptueshme dhe konfirmohen e mbështeten nëpërmjet profetësisë së Muhammedit a.s.m., lajmëtarit të mbisundimit të

Hyjnisë. Dhe kështu me radhë, si këto shembuj, shumica e Emrave më të bukur janë prova të shndritshme të profetësisë së Muhammedit a.s.m..

Shkurtazi: Meqenëse universi ekziston dhe nuk mund të mohohet, të vërteta që duken qartë si urtësia, mirësia, bukuria, rregulli, balanca dhe stolisja, të cilat janë si ngjyrat, si zbukurimet, dritat, rrezet, artet, jetët dhe lidhjet e universit, kurrësesi nuk mund të mohohen. Meqenëse nuk është e mundur t'i mohosh këto atribute e akte, atëherë sigurisht, Ekzistuesi i Vetëm i domosdoshëm, i Cili është *i Gjithurti, Mëshirëploti, Hirploti, i Dituri* dhe *i Drejti*, i Cili cilësohet nga ato atribute, dhe është Bërësi i atyre veprave dhe Dielli dhe Burimi i atyre dritave, kurrësesi nuk mund të mohohen. Dhe sigurisht Profetësia e Muhammedit a.s.m. i cili është udhëzuesi më i madh, mësuesi më i përkryer, lajmëtari më i shquar, zgjidhësi i talismanit, enigmës së universit, pasqyra e të *Kërkuarit Përjetësisht*, i Dashuri i Zotit xh.sh. dhe boshti i shfaqjes së atyre atributeve dhe i njoftimit të atyre akteve, madje i plotësimeve të tyre, dhe madje i realizimit të tyre, kurrësesi nuk mund të mohohen.

Ashtu si dritat e botës së realitetit dhe realitetit të universit, ai është Drita më vezulluese e Universit.

عَلَيْهِ وَعَلَىٰ آلِهِ وَصَحْبِهِ ٱلصَّلَاةُ وَٱلسَّلَامُ بِعَدَدِ عَاشِرَاتِ ٱلْأَيَّامِ وَذَرَّاتِ ٱلْأَنَامِ

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ ٱلْعَلِيمُ ٱلْحَكِيمُ

Bekimet dhe paqja qofshin mbi të sa numri i sekondave të ditëve dhe të grimcave të krijesave.

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë, që Vetëm Ti je i Gjithëdituri, I Gjithurti"[10]

* * *

[10] Kur'an, 2:32

PIKA E KATËRT

Emri Hyjnor ***El-Ferd,*** *I Vetmi.*



Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Thuaj: "Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm".[11]

[Ndërsa isha në Burgun Eskishehir në muajin Shev-val, m'u shfaq një prej pikave të holla të këtij ajeti, dhe m'u shfaq një pishtar prej dritave të Emrit më të madh Hyjnor ***El-Ferd,*** *I Vetmi* -ose "Ai është Një" prej gjashtë dritave të tij- i cili përfshin dy Emrat Hyjnorë ***El-Vahid, El-Ehad****, Një i Vetëm, Unik* prej Emrave të bukur Hyjnorë.

Ne do të shpjegojmë këtu shumë shkurt pohimin e vërtetë të Unitetit Hyjnor të cilin e demonstron ai manifestim më i madh në shtatë tregues të përmbledhur shkurt.]

● **Treguesi i Parë**

Fjala e Njëzet e Dytë dhe Letra e Tridhjetë e Tretë kanë treguar në detaje se nëpërmjet manifestimit më të madh, Emri ***El-Ferd,*** *i Vetmi* ka vendosur një vulë, një stampë të Unitetit Hyjnor mbi univers si tërësi dhe mbi çdo botë të qënieve në të, dhe mbi çdo qënie individuale. Këtu ne do të tregojmë vetëm tre stampa.

Stampa e Parë: Manifestimi më i madh i të Qenurit i Vetëm Një ka vënë një vulë Uniteti në të gjithë faqen e "universit" me anë të të cilës e ka bërë atë si një tërësi të pandashme.

Ai që nuk ka fuqi të ushtrojë mbi tërësinë e Universit, nuk mund të jetë pronar i vërtetë i asnjë pjese të tij. Vula është kjo:

Ashtu si makineria më e hollë e çuditshme në një fabrikë, qëniet dhe botërat e qënieve në univers ndihmojnë njëra-tjetrën dhe punojnë për të plotësuar funksionet e njëra-tjetrës. Me solidaritetin e tyre dhe

[11] Kur'an, 1I2: 1

me kooperimin, përgjigjja e tyre ndaj kërkesave të njëra-tjetrës dhe nxitimi për të ndihmuar njëra-tjetrën, përqafimi i tyre me njëra-tjetrën dhe duke qenë njëra brenda tjetrës, ato formojnë një unitet ekzistence në përputhje me të cilin, ashtu si gjymtyrët e trupit human, ato nuk mund të ndahen nga njëra-tjetra. Në qoftë se dikush do të ushtronte një kontroll në njërën prej gjymtyrëve të tij, por megjithatë ai nuk ka kontroll mbi të gjitha ato, kontrolli i tij mbi një gjymtyrë të vetme, nuk do të jetë kontroll i vërtetë.

Atëherë, ky kooperim, solidaritet, përgjigje e ndërsjellë dhe ky përqafim me njëri-tjetrin formon një vulë të shndritshme e të lartë të Unitetit Hyjnor.

Stampa e Dytë: Nëpërmjet manifestimit vezullues të Emrit Hyjnor ***El-Ferd,*** *i Vetmi* në faqen e tokës dhe sidomos në pranverë, ndodhen një vulë e ndritshme e tillë e Njësisë Hyjnore dhe një stampë Uniteti saqë ajo provon se ai që nuk i administron të gjitha krijesat e gjalla në faqen e globit së bashku me individët, atributet dhe gjendjet e tyre; që nuk i njeh dhe nuk i shikon të gjitha ato përnjëherësh; dhe që nuk mund t'i krijojë ato, ai nuk mund të ndërhyjë në asgjë për sa ka të bëjë me krijimin.

Stampa është kjo:

Duke lënë mënjanë stampat vërtet të mirërregulluara por të fshehura të lëndëve minerale, të elementeve dhe të krijesave të pashpirt të tokës, hidhe vështrimin tek stampa vijuese e thurur me fijet e dyqind mijë specieve të kafshëve dhe e dyqind mijë llojeve të bimëve: ne shohim me sytë tonë në pranverë në tokë se të gjitha gjërat me detyrat e tyre të ndryshme, me format e ndryshme, me furnizime të ndryshme ushqimore dhe me gjymtyrë të ndryshme, pavarësisht qënies së tyre njëra brenda tjetrës dhe të gjitha të përziera bashkarisht, u jepet gjithçka që atyre u nevojitet, pa ngatërresë e pa gabim, me dallueshmëri e shquarsi të plotë, me balancë krejtësisht të ndjeshme, pa vështirësi, tamam në kohën e duhur dhe nga vende të paparashikuara. Kjo situatë, ky planifikim dhe ky administrim formon një vulë të tillë të Unitetit Hyjnor dhe një stampë Njësie saqë ai i cili nuk mund t'i krijojë të gjitha ato krijesa menjëherë nga asgjëja, nuk mund të ndërhyjë absolutisht në asgjë për sa ka të bëjë me Hyjninë dhe krijimin, sepse në qoftë se ata do të kishin ndërhyrë, ekuilibri i atij administrimi

pafundësisht i gjërë do të ishte i prishur, dhe kjo përveç asaj detyre sipërfaqësore të dukshme që e kryen njeriu -nëpërmjet urdhrit Hyjnor- për zbulimin e atyre ligjeve Hyjnore dhe bukurinë e rrjedhës së tyre.

Stampa e Tretë: Kjo Stampë e Njësisë Hyjnore është në fytyrën e njeriut, në fytyrën e cilitdo njeriu qoftë, sepse çdo njeri ka një shenjë dalluese në fytyrën e tij që e dallon nga të tjerët. Atëherë ai që nuk mundet t'i vendosë ato shenja në çdo fytyrë dhe që nuk mundet t'i shohë të gjitha fytyrat që kanë ardhur e që do të vijnë qysh nga koha e Ademit a.s. deri në ditën e kijametit, nuk mund ta shtrijë dorën e tij lidhur me krijimin dhe sjelljen në ekzistencë me qëllim që të vendosë ato shenja të mëdhaja dalluese në atë fytyrë të vogël të një njeriu të vetëm.

Po, ai që e vendosi në fytyrën e njeriut atë stampë të shquar dhe atë shenjë madhështore nëpërmjet atyre shenjave dalluese, duhet patjetër që të gjithë individët e njerëzimit të jenë nën shikimin dhe vëzhgimin dhe brenda sferës së njohjes së tij me qëllim që ta vendosë atë vulë të Njësisë në atë fytyrë, sepse ndonëse gjymtyrët bazë të fytyrës së çdo personi i ngjasojnë njëra-tjetrës, por prapëseprapë ato kanë pika dallueshmërie. Fakti se të gjitha gjymtyrët e fytyrës, si syri dhe veshi, i ngjasojnë njëra-tjetrës, kjo është një stampë Uniteti duke dëshmuar se Krijuesi i llojit njerëzor është Një, kështu shumë ndryshime të urta, ndryshe nga speciet e tjera, duke u dalluar njëra nga tjetra me qëllim që ato të mos ngatërrohen dhe që të ruhen të drejtat e të gjitha atyre, përveç se tregojnë dëshirën e Krijuesit të Unitetit, të zgjedhjes dhe të vullnetit, janë të gjitha të ndryshme, janë stampa të holla të Njësisë Hyjnore. Ato tregojnë se ai që nuk mund t'i krijojë të gjithë njerëzit dhe kafshët, madje dhe universin, ai nuk mund ta përdorë atë stampë.

- **Treguesi i Dytë**

Botërat, speciet dhe elementet e universit janë aq të ndërthurura dhe të ndërlidhura saqë një shkak që nuk e posedon universin si një tërësi nuk mund të ketë kontroll mbi asnjë prej elementeve të tij. Manifestimi i unitetit që buron nga Emri Hyjnor ***El-Ferd,*** *I Vetmi* e ka përfshirë të gjithë universin brenda një uniteti saqë çdo gjë e shpall atë. Për shembull, llamba e universit, dielli, duke qenë një tregon se tërësia e universit i përket vetëm njërit, po kështu, sfungjerët e reve të cilët ujisin kopshtin e tokës duke qenë një, e njëjta, dhe shiu i cili vjen për të

ndihmuar të gjitha krijesat e gjalla duke qenë një, i njëjti, dhe duke rënë gjithandej; dhe shumica e llojeve të kafshëve dhe të bimëve duke u shpërndarë të lira sipër tokës dhe speciet dhe habitatet e tyre duke qenë një, të njëjtat; sigurisht këto janë shenjat më të sigurta dhe dëshmitë që tregojnë se të gjitha ato qënie, së bashku me vendet ku ato gjenden, janë pronë e Një Pronari të Vetëm Unik.

Duke ndjekur këtë analogji, botërat e qënieve në univers janë aq të ndërthurura saqë ato e kanë bërë universin në një tërësi e cila është e pandashme për sa ka të bëjë me krijimin. Një shkak që nuk ka sundim mbi të gjithë universin, nuk mund të sundojë e drejtojë absolutisht asgjë lidhur me Hyjninë dhe krijueshmërinë; ai nuk mund ta bëjë asnjë grimcë të vetme që t'i kushtojë vëmendje atij.

● **Treguesi i Tretë**

Nëpërmjet manifestimit të tij më të Madh, Emri Hyjnor ***El-Ferd,*** *i Vetmi* e ka bërë universin në Letra e mesazhe të panumërta të të *Kërkuarit të Vetëm* përjetësisht të cilat janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, dhe secila prej tyre përmban Vula të Njësisë Hyjnore dhe Stampa Uniteti sa numri i fjalëve të qënieve të universit -si të ishin të botuara- dhe secila prej tyre tregon shkruesin e saj sa numri i atyre vulave.

Po, të gjitha lulet, të gjitha frutat, i gjithë bari dhe madje të gjitha kafshët e pemët janë Vula të Njësisë Hyjnore dhe stampa të Unitetit Hyjnor, të cilat së bashku me vendet që ato gjenden, dhe që marrin formën e mesazheve, janë si nënshkrime, firma që tregojnë Atë që i shkroi, që krijoi vendin. Për shembull, një luleverdhë në një kopsht është si një vulë e skalitësit të kopshtit. Vula e cilitdo që të jetë lulja, të gjitha lulet e atij lloji në faqen e tokës tregojnë qartë se ato janë fjalët e Tij, edhe kopshti gjithashtu është shkrimi i Tij. Kjo do të thotë se të gjitha gjërat ia atribuojnë çdo gjë Një të Vetmi i Cili i krijoi ato, duke treguar në shkallën më të lartë pohimin e Unitetit Hyjnor.

● **Treguesi i Katërt**

Përveç të qenurit i qartë si dielli, manifestimi më i madh i Emrit Hyjnor ***El-Ferd,*** *i Vetmi* është aq i arsyeshëm sa bëhet i domosdoshëm dhe mund të pranohet me lehtësi absolute, ashtu siç janë shpjeguar qartë në pjesë të ndryshme të Risale-i Nurit. Kurse prova të shumta

demonstrojnë se *Shirku* -të përshkruarit ortakë me Allahun- që është opozita dhe e kundërta e atij manifestimi, është pafundësisht i vështirë dhe pafundësisht larg arsyes deri tek limiti i pamundësisë dhe i papranueshmërisë.

Këtu do të shpjegojmë vetëm 'Tre pika' prej atyre provave e treguesve, ndërsa detajet e pikave të atyre provave ua referojmë trajtesave të tjera të Risale-i Nurit.

Pika e Parë: Ne kemi demonstruar me provat më të sigurta dhe në mënyrë të përmbledhur tek fundi i Fjalës së Dhjetë dhe tek Fjala e Njëzet e Nëntë dhe në mënyrë të hollësishme tek *Fundi i Mektubatit të* Njëzet, se në lidhje me fuqinë e të *Vetmit Unik*, krijimi i gjësë më të madhe është aq i lehtë sa krijimi i më të voglës. Ai e administron pemën e madhe me aq lehtësi sa frutin e vogël. Ndërsa në qoftë se do t'u referohej shkaqeve, çdo frut do të bëhej aq i vështirë dhe i shtrenjtë sa një pemë, dhe një lule do të bëhej aq e vështirë dhe me telashe aq sa pranvera.

Po, në qoftë se pajisja tërësisht e një ushtrie me pajime e furnizime bëhet me urdhërin që lëshohet nga një Komandant i Vetëm dhe nga një burim i vetëm, kjo do të ishte aq e lehtë dhe e thjeshtë sa pajisja e një ushtari të vetëm, ndërsa në qoftë se pajisja e të gjithë ushtarëve do të bëhej prej fabrikave të ndryshme dhe, administrimi i ushtrisë do të kalonte prej një oficeri të vetëm tek shumë të tillë, atëherë çdo ushtar do të kërkonte aq fabrika sa numri i ushtarëve të ushtrisë.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, në qoftë se çdo gjë do t'i atribuohej *Të Vetmit Unik*, atëherë krijimi i anëtarëve të panumërt të një specie të vetme të qënieve do të bëhej aq i lehtë sa krijimi i një anëtari të vetëm. Kurse në qoftë se do t'u atribuohej shkaqeve, atëherë krijimi i çdo individi do të bëhej aq i vështirë sa e gjithë specia e gjërë dhe e panumërt.

Po, Uniteti dhe Vetmia e bëjnë çdo gjë të lidhur e të mbështetur tek Esenca e Vetme e shenjtë Hyjnore; kjo lidhje e kjo mbështetje bëhen një fuqi e pakufishme për atë gjë. Nëpërmjet forcës së mbështetjes dhe lidhjes, ajo gjë e vogël mund të kryejë vepra të mëdha që tejkalonte mijëra herë fuqinë e saj individuale dhe prodhon rezultate të mëdha. Ndërsa ndonjë gjë shumë e fuqishme e cila nuk mbështetet tek Pronari i asaj fuqie madhështore dhe tek Zotëruesi i saj *El-Ferdu*, *El-Ehadu*, *i*

Vetmi Unik" dhe nuk është e lidhur me Të, mund të kryejë vepra të vogëla sipas fuqisë së saj individuale, dhe po sipas fuqisë së saj rezultatet ulen. Për shembull:

Ai i cili është i lidhur tek një komandant madhështor dhe mbështetet tek ai nëpërmjet cilësisë së qënies së tij ushtar, kjo lidhje dhe kjo mbështetje bëhen për të një forcë mbështetëse që nuk shterron kurrë, dhe si rrjedhojë, ai nuk detyrohet t'i mbajë vetë burimet e fuqisë së tij dhe furnizimet. Nëpërmjet fuqisë së lidhjes së tij, ai mund të zërë rob edhe një mareshall të ushtrisë së shpartalluar të armikut, së bashku me mijëra ushtarët e tjerë me të.. Ndërsa një njeri i fortë e guximtar i cili nuk është një ushtar i rregullt, do të detyrohej t'i mbante vetë municionet dhe furnizimet, dhe kështu mund të rezistonte vetëm përkohësisht kundra dhjetë individëve prej armikut; sepse fuqia e tij individuale është e kufizuar.

Domethënë, në Unitetin Hyjnor dhe në Vetminë Hyjnore, nëpërmjet fuqisë së lidhjes dhe mbështetjes, një milingonë mund të shpartallojë një Faraon dhe një mushkonjë mposht një Nimrud, një mikrob mund të zhdukë një tiran dhe një farë e vockël mund të mbajë mbi shpatullat e saj një pemë shumë të madhe pishe.. dhe e gjitha kjo bëhet nëpërmjet emrit të asaj lidhjeje dhe misterit të asaj mbështetjeje. Po, një komandant i madh mund të dërgojë një ushtri për t'i ardhur në ndihmë një ushtari dhe grumbullon të gjithë ushtrinë pas ushtarit, kështu ushtari ka mbështetjen morale të ushtrisë dhe nëpërmjet asaj fuqie, ai mund të realizojë vepra të mëdha në emrin e komandantit.

E ngjashme me këtë, meqenëse Monarku i Parapërjetshëm është Një i Vetëm Unik, atëherë Ai nuk ka absolutisht asnjë lloj nevoje. Në qoftë se do të supozonim se do të lindte nevoja në ndonjë drejtim, Ai do t'i dërgonte të gjitha gjërat për t'u ardhur në ndihmë çdo gjëje dhe do ta grumbullonte ushtrinë e universit pas një gjëje dhe çdo gjë do të mund të mbështetej tek një fuqi aq e madhe sa universi, dhe kështu çdo gjë në ekzistencë do të merrte fuqi prej asaj fuqie Hyjnore madhështore absolute.. prej Atij *Të Vetmi Unik xh.sh.*. Po të mos ishte *Vetmia Hyjnore*, çdo gjë do ta humbiste të gjithë këtë fuqi dhe do të bëhej si asgjë; edhe rezultatet e tyre gjithashtu do të katandiseshin në hiçgjë.

Kështu, shfaqja e këtyre veprave vërtet të mrekullueshme dhe i rezultateve të mëdha prej gjërave të thjeshta e të papërfillshme, të cilat

ne i shohim gjatë gjithë kohës me sytë tonë, në mënyrë të vetëkuptueshme demonstrojnë Vetminë Hyjnore dhe Njësinë Hyjnore. Në qoftë se nuk do të ishin ato, rezultatet dhe frutat e çdo gjëje, do të mbeteshin të kufizuara tek fuqia e saj dhe tek substanca e saj më e vogël, dhe si rrjedhojë, rezultatet do të binin, madje do të zhdukeshin. A nuk i sheh gjërat tepër të çmueshme e të vlefshme, si frutat, perimet e të tjera të cilat janë pafundësisht të bollshme e me lirësi të madhe çmimi para nesh. Kjo ndodh vetëm se nëpërmjet misterit të Unitetit Hyjnor, të asaj lidhjeje dhe të grumbullimit të të gjitha forcave. Po të mos ishte Vetmia Hyjnore, ne nuk do ta siguronim me mijëra dirhem atë shalqi apo shegë që ne i blejmë vetëm me një shumë të vogël parash -dirhemësh. Po, e gjithë lehtësia në çështjet që ne i shohim, i gjithë bollëku dhe e gjithë lirësia në botë burojnë nga rezultatet e Unitetit Hyjnor dhe dëshmojnë Vetminë Hyjnore.

***Pika e Dytë*:** Qëniet krijohen dhe shfaqen në ekzistencë në dy mënyra:

E Para: është krijimi nga hiçi, që quhet *Zanafilla* dhe *Shpikja.*

E Dyta: është dhënia ekzistencë nëpërmjet grumbullimit së bashku të elementeve dhe gjërave ekzistuese që quhet *Përbërja* dhe *montimi*.

Në qoftë se do t'i shikonim qëniet nga këndvështrimi i misterit të Njësisë Hyjnore dhe manifestimit të *Vetmisë Hyjnore*, ne vërejmë se krijimi dhe sjellja e tyre në ekzistencë ndodhin me një lehtësi të pafundme, një lehtësi e tillë është në shkallën e domosdoshmërisë dhe të vetëkuptueshmërisë. Ndërsa në qoftë se çështja e krijimit dhe e sjelljes në ekzistencë nuk do t'i atribuohej Unitetit dhe Vetmisë Hyjnore, ajo do të bëhej pafundësisht e vështirë dhe e paarsyeshme, e vështirë deri në shkallën e pamundësisë dhe të papranueshmërisë. Mirëpo, fakti se qëniet në univers vijnë në ekzistencë me një lehtësi të pafundme, dhe me një kollajllëk të tillë, pa asnjë vështirësi dhe në formë të plotë, në mënyrë të vetëkuptueshme tregon manifestimin e *Vetmisë Hyjnore* dhe provon se çdo gjë në ekzistencë është drejtëpërdrejtë prej artit të të *Vetmit Unik,* Zotëruesit të madhështisë dhe të mirëbërësisë.

Po, në qoftë se çështja e krijimit do t'i atribuohej *Të Vetmit Unik*, atëherë secila gjë krijohet nga hiçi sa çel e mbyll sytë me një kollajllëk e lehtësi absolute, nëpërmjet fuqisë së Tij absolute, madhështia e së

cilës kapet nëpërmjet veprave të saja të dukshme. Dhe nëpërmjet njohurisë së Tij gjithëpërfshirëse absolute, çdo gjëje i paracaktohet një masë si një kallëp jolëndor. Grimcat e të gjitha gjërave vendosen me lehtësi në kallëpin ekzistues në njohje, në përputhje me formën dhe planin e çdo gjëje në pasqyrën e njohjes dhe ato i ruajnë pozitat e tyre në sistem të mirë.

Në qoftë se do të ishte e domosdoshme të grumbulloheshin bashkë grimcat prej anëve të ndryshme, në përputhje me parimet gjithëpërfshirëse të fuqisë dhe të ligjeve të Njohjes, grimcat lidhen së bashku në formë të rregullt ashtu si ushtarët e bindur të një ushtrie të disiplinuar. Të shtyrë nga fuqia sipas njohjes, ato vijnë, futen në kallëpin ekzistues në Njohje në përputhje me masën e Kaderit Hyjnor, i cili rrethon dhe gjithëpërfshin ekzistencën e gjësë, dhe me lehtësi formon qënien e saj. Ashtu siç shfaqet imazhi i përfaqësuar në pasqyrë mbi një letër të ndjeshme, dhe i vishet një ekzistencë e ndjeshme e jashtme nëpërmjet një kamere, aparati fotografik dhe, ashtu siç shfaqet dhe shikohet shkrimi i fshehur dhe i padukshëm kur përhapet mbi letër një lëndë e veçantë kimike, po ashtu është çështja në formën e të gjitha qënieve, dhe natyra e të gjitha gjërave ekzistuese në pasqyrën e Njohjes Hyjnore të të Vetmit Unik; Fuqia Hyjnore absolute u vesh atyre - me një lehtësi të pafundme - një ekzistencë të jashtme të ndjeshme, dhe shfaqet për sytë në botën e dukshme, pasi ishte në botën e kuptimit dhe në botën e së padukshmes."

Por, në qoftë se çështja e krijimit nuk do t'i atribuohej *Të Vetmit Unik*, atëherë do të bëhej e domosdoshme për krijimin e një mize të vetme të prekje e të kërkoje të gjithë faqen e tokës, të shoshisje të gjitha elementet e saj dhe të sillje prej çdo vendi grimcat e veçanta për qënien e saj. Dhe me qëllimin që t'i vendosësh grimcat në rregull e në vendin e duhur në qënien e saj do të ishte e domosdoshme të ndodhej një kallëp fizik, madje do të duheshin kallëpe jolëndorë sa numri i gjymtyrëve dhe i organeve të saj të bëra artistikisht.

Pastaj, shqisat gjithashtu në qënien e saj, dhe aftësitë e saja të holla jolëndore si shpirti do të duhej të peshoheshin në një masë të veçantë nga botërat jolëndore.

Kështu, krijimi i një mize në këtë mënyrë do të ishte aq e vështirë sa ai i universit. Vështirësitë do të shumëfishoheshin qindra herë, madje kjo do të ishte një pamundësi e shumëfishtë.

Prandaj të gjithë njerëzit e besimit dhe të dijes kanë rënë dakort dhe janë pajtuar unanimisht në mendimin se "Askush përveç Krijuesit ***El-Ferd,*** *i Vetmi* nuk mund të krijojë prej hiçit apo prej mosekzitencës". Për këtë arsye, në qoftë se çështja do t'u atribuohej shkaqeve dhe Natyrës, atëherë do të bëhej e domosdoshme për ekzistencën e një gjëje të vetme grumbullimi prej shumicës së gjërave.

Pika e Tretë: Ne do të shpjegojmë shkurtazi dy ose tre krahasime të cilat janë shpjeguar në pjesët e tjera të Risale-i Nurit, duke treguar se '*të atribuarit e krijimit të Vetmit Unik*' e bën krijimin e të gjitha gjërave aq të lehtë sa krijimin e një gjëje të vetme, ndërsa ndryshe, në qoftë se do t'u atribuohej natyrës dhe shkaqeve, ekzistenca e një gjëje të vetme do të bëhej aq e vështirë sa ajo e të gjitha gjërave.

Për shembull: Në qoftë se pozicionet dhe administrimi i një mijë ushtarëve do t'i referohej një oficeri, dhe administrimi i një ushtari të vetëm do t'u referohej dhjetë oficerëve, atëherë administrimi e komandimi i një ushtari të vetëm do të ishte dhjetë herë më i vështirë se sa komandimi i një batalioni, sepse ata që do ta komandonin atë do të formonin pengesa për njëri-tjetrin. Dhe në çrregullimin që do të shkaktohej, ushtari nuk do të gjente qetësi në mes të grindjes së komandantëve të tij. Ndërsa për të arritur rezultatin e dëshirës dhe situatën një batalion do t'i referohej një oficeri të vetëm, ai do të mund ta arrinte rezultatin me lehtësi, pa vështirësi dhe do ta realizonte atë situatë që dëshiron. Në qoftë se për ta arritur rezultatin dhe situatën e dëshiruar, do t'u referohej ushtarëve pa një shef, pa udhëheqës ose pa rreshter, ato rezultate do të mund të arriheshin vetëm me shumë kundërshti e vështirësi, në çrregullim të madh dhe me mangësi.

Krahasimi i Dytë: Për shembull, në qoftë se çështja e ndërtimit të kubesë së xhamisë së *Aja Sofias* do t'i caktohej e dorëzohej një ndërtuesi mjeshtër të talentuar, ai do ta realizonte me shumë lehtësi e kollaj, ndërsa në qoftë se ndërtimi i saj do t'u ngarkohej a caktohej gurëve të saj, do të bëhej e domosdoshme që çdo gurë të kishte edhe një dominim absolut mbi gurët e tjerë dhe njëkohësisht i varur prej tyre me qëllim që gurët të mbështesin njëri-tjetrin në atë pozicion të varur

pezull dhe që kubeja të marrë formën e saj! Ndërsa ndërtuesi mjeshtër harxhonte pak përpjekje -për shkak se çështja ishte e lehtë për të-, tani qindra ndërtues -gurët- do të harxhonin e do të bënin përpjekje qindra herë më të mëdha pa arritur rezultatin!!

Krahasimi i Tretë: Për shembull, meqenëse globi tokësor është një nëpunës, një ushtar i të *Vetmit Unik xh.sh.* dhe si ushtar i bindur ndaj *Allahut të Vetëm Unik*, dhe kur merr urdhrin e vetëm që lëshohet prej Urdhëruesit të saj të vetëm, atëherë rezultatet arrihen ashtu si ndryshimi i stinëve, si ndërrimi i ditës dhe i natës, si lëvizjet e larta e madhështore të qiejve dhe si ndryshimi i pamjeve qiellore ashtu si ndryshimi i skenave kinematografike. Me të marrë urdhrin nga Urdhëruesi i saj i Vetëm, me gëzim të papërmbajtur tek detyra e saj, një ushtar i vetëm si toka ngrihet për t'u rrotulluar në dy drejtime si një dervish mevlevi në ekstazë, dhe është mjeti për arritjen e atyre rezultateve madhështore.

Është sikur toka të ishte komandantja e atyre manovrave ushtarake madhështore midis yjeve të universit.

Po, në qoftë se çështja nuk do t'i atribuohej *Të Vetmit Unik* i Cili nëpërmjet Sundimit të Hyjnisë së Tij ka rrethuar e gjithëpërfshirë të gjithë universin dhe urdhri e Sundimi i të Cilit i mbulon të gjitha qëniet, atëherë ato rezultate, ato manovra qiellore dhe ato stinë tokësore do të mund të arriheshin nëpërmjet miliona yjesh e globesh një mijë herë më të mëdhaja se sa toka duke përshkuar distancën e gjatë prej miliona vitesh në çdo Njëzet e Katër orë dhe në çdo vit.

Kështu, ato rezultate duke u arritur nëpërmjet dy lëvizjeve -në orbitën e saj dhe në boshtet e saj si një *mevlevi dervish* në ekstazë- nga një nëpunëse e vetme si toka, është një shembull i lehtësisë së pafundme dhe natyrshmërisë që ndodhet në Unitetin Hyjnor dhe në Vetminë Hyjnore, dhe në të njëjtën kohë kjo na bën të qartë se sa e mbushur me pamundësi të pakufishme dhe me gjëra absurde e të palogjikshme është rruga e *shirkut*, të përshkruarit ortakë me Zotin xh.sh. dhe e mosbesimit.

Tani vëreje injorancën e atyre që adhurojnë shkaqet dhe Natyrën nëpërmjet teleskopit të këtij shembulli vijues që të kuptosh se sa larg arsyes dhe mendimit të shëndoshë janë ata:

Një fabrikë madhështore.. Një libër i mahnitshëm.. një pallat madhështor.. ose një orë e mrekullueshme.. Nuk ka dyshim se ai që i bëri secilën prej këtyre në formën më të sistemuar e të rregullt nëpërmjet artit të tij të mrekullueshëm dhe që e administroi në mënyrën më të përkryer dhe që shfaqi përkujdesje, nuk ka dyshim se ai deshi të shfaqë nëpërmjet secilës bukuritë e artit të tij dhe çudirat e veprës së tij nëpërmjet bërjes së çdonjërës prej tyre. Në qoftë se dikush do t'ua referonte administrimin e fabrikës vetë makinerive të fabrikës dhe, do t'ia atribuonte ndërtimin e pallatit madhështor vetë gurëve të pallatit dhe t'ua atribuonte kuptimet e bukura të librit vetë shkronjave, ai sikur e paska bërë çdo pjesë prej pjesëve të fabrikës një poseduese të një fuqie madhështore për të organizuar vetveten dhe të tjerat! Dhe sikur t'i kishte bërë secilën prej shkronjave të librit, madje dhe fletët e penën, si të ishin një gjë e jashtëzakonshme dhe të hartonte vetë librin. Domethënë, ai ua referon bukurinë e sistemit në fabrikë vetë makinerive të fabrikës; ua atribuon kuptimin në libër harmonisë dhe koinçidencës së shkronjave vetvetiu!!

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, ata që ua atribuojnë krijimin shkaqeve dhe Natyrës bien në një injorancë të shumëfishtë e të përbërë si kjo; sepse Natyra dhe shkaqet janë vepra arti jashtëzakonisht të mirësistemuara; ato gjithashtu janë artifakte dhe të krijuara si krijesat e tjera. Ai që i krijoi ato -në këtë formë të mrekullueshme- është pikërisht ai që i krijon pasojat dhe rezultatet e tyre gjithashtu.. Ai që krijoi farën, krijon gjithashtu edhe pemën sipër saj, dhe është po Ai i Cili i prodhon frutat dhe lulet sipër saj.

Ndërsa, në qoftë se krijimi i shkaqeve dhe i natyrës së bashku me pasojat dhe rezultatet e tyre nuk do t'i atribuoheshin të Vetmit Unik, atëherë do të bëhej e domosdoshme për ekzistencën e llojeve të shkaqeve dhe të modeleve të ndryshme të Natyrës, të kishte natyra të tjera të mirorganizuara dhe shkaqe të harmonizuara. Dhe kështu, njeriu do të duhej të pranonte ekzistencën e një zinxhiri të rremë, të pafundmë, të pakuptim dhe të pamundur. Kjo do të ishte injoranca më e jashtëzakonshme.

● **Treguesi i Pestë**

Ne kemi demonstruar me prova vendimtare në shumë vende se veçoritë më themelore të sundimit janë pavarësia dhe Mëvetësia -

ndarja-, saqë ky njeri i cili është jashtëzakonisht i pafuqishëm dhe që nuk ka veçse një hije të zbehtë prej sundimit, refuzon me gjithë vrull çfarëdo lloj ndërhyrje qoftë prej njerëzve në çështjet e tij dhe nuk i lejon të tjerët të përzihen në detyrën e tij me qëllim që të ruajë pavarësinë dhe mëvetësinë e Tij. Madje historia përmend se shumë mbretër kanë ekzekutuar me vdekje në mënyrë të pamëshirshme fëmijët e tyre të pafajshëm dhe vëllezërit e dashur kur kuptuan ndërhyrjen e tyre në punët e tyre. Domethënë, pavarësia, mëvetësia dhe refuzimi i ndërhyrjes së të tjerëve janë nga veçoritë më themelore të sundimit të vërtetë, madje ato janë domosdoshmëritë e tij të pandashme dhe esencat e vazhdueshme.

Për shkak të kësaj veçorie thelbësore, Sundimi Hyjnor, i cili është në shkallën e Hyjnisë absolute, e refuzon në mënyrën më të fuqishme Shirkun, të përshkruarin ortakë me Krijuesin, pjesëmarrjen dhe ndërhyrjen e të tjerëve. Gjithashtu, Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm me ngulm, në mënyrë të përsëritur dhe me rreptësi tregon Unitetin Hyjnor dhe e refuzon me kërcënime të ashpra të përshkruarin ortakë me Allahun.

Atëherë, ashtu siç e kërkon medoemos Sundimi Hyjnor -i cili është në Hyjninë absolute- Unitetin dhe Njësinë Hyjnore në mënyrën më të sigurt dhe shfaq një motiv shumë të fuqishëm dhe një domosdoshmëri të fortë për të, po ashtu rregullsia e përkryer dhe harmonia e mahnitshme që shihen në univers -duke filluar nga yjet, bimët, kafshët, toka dhe mineralet dhe duke përfunduar tek të pjesshmet, individët dhe grimcat e vockëla- secila prej tyre është një dëshmitare e vërtetë dhe një provë e qartë e Atij Uniteti e Vetmie, dhe nuk lejon absolutisht asnjë dyshim apo iluzion, sepse po të kishte pasur ndërhyrje, përveç të Vetmit Unik, ky sistem i mrekullueshëm dhe kjo rregullsi në univers do të ishin prishur, dhe ky drejtpeshim tej mase i ndjeshëm dhe harmonia në të gjitha pjesët e gjithësisë do të ishin të prishur dhe shenjat e çrregullimit do të dukeshin qartë.

Në përputhje me kuptimin e vërsetit, لَوْ كَانَ فِيهِمَآ ءَالِهَةٌ إِلَّا ٱللَّهُ لَفَسَدَتَا *"Po të kishte pasur në to (në qiej dhe në tokë) perëndi të tjera përveç*

Allahut, atëherë padyshim që të dyja (qiejt dhe toka) do të ishin shkatërruar..."[12]

Ky rregull i mahnitshëm e i përkryer i universit do të ishte flakur në rrëmujë dhe do të ishte prishur. Ndërsa sipas kuptimit të qartë të vërsetit,

فَارْجِعِ الْبَصَرَ هَلْ تَرَىٰ مِن فُطُورٍ "*Kthe pra shikimin përsëri: "A mund të shohësh ndonjë të çarë?"*[13] duke filluar nga grimcat e vockëla për tek planetet dhe nga toka për tek Froni Hyjnor, nuk shihet asnjë shenjë defekti, mangësie apo rrëmuje. Atëherë, rregulli i universit dhe i krijesave dhe balanca, ekuilibri i qënieve demonstrojnë në mënyrën më të shndritshme manifestimin më të madh të Emrit Hyjnor ***El-Ferd*** dhe dëshmojnë Unitetin Hyjnor. Për më tepër, meqenëse nëpërmjet misterit të manifestimit të Njësisë Hyjnore, krijesa e gjallë më e vockël është një model i zvogëluar i Universit dhe një indeks i vogël i tij; Vetëm Ai që në kapjen e fuqisë së të Cilit është i gjithë Universi mund të jetë pronar i vërtetë i asaj krijese të gjallë të vogël. Dhe meqenëse, lidhur me krijimin, një bërthamë nuk është më e ulët se sa një pemë e madhe, dhe një pemë është si një univers i vogël dhe të gjitha qëniet e gjalla janë si universe dhe si botëra të vogëla, ky mister i Njësisë Hyjnore e ka bërë të pamundur *shirkun*, të përshkruarin ortakë me Allahun.

Nëpërmjet këtij misteri, universi nuk është vetëm një tërësi e pandashme, por për sa ka të bëjë me natyrën e tij si një Universale, tërësore ndarja e së cilës ose copëzimi në pjesë është e pamundshme dhe nuk pranon pjesëmarrje dhe duar të shumta në krijimin e tij.

Kështu, meqenëse çdo pjesë e tij është si një e pjesshme dhe si një individ dhe gjithë universi është gjithashtu si tërësorja, atëherë nuk ka asnjë mundësi në asnjë drejtim për pjesëmarrjen e të tjerëve në të. Ky manifestim më i madh i Emrit Hyjnor ***El-Ferd****, i Vetmi* e provon realitetin e Unitetit Hyjnor nëpërmjet misterit të Njësisë Hyjnore me shkallën e të qenurit e vetkuptueshme.

Po, meqenëse botërat e qënieve në univers janë të ndërlidhura e të ndërthurura, dhe funksionet e secilës prej tyre i shikojnë të gjitha

[12] Kur'an, 21:22
[13] Kur'an, 67: 3

qëniet, kjo e ka bërë universin, lidhur me Hyjninë dhe krijimin, si një tërësi të pandashme; Gjithashtu aktet e përgjithshme gjithëpërfshirëse në univers janë të ndërthurura e të ndërfutura. Domethënë, për shembull, brenda aktit të dhënies së jetës, shfaqet menjëherë në të njëjtën kohë edhe akti i të ushqyerit dhe ai i furnizimit me rizk. Dhe brenda këtyre akteve të të ushqyerit dhe të dhënies së jetës, shikohet menjëherë akti i organizimit të trupit të asaj gjallese dhe zbukurimi e vendosja në rregull e gjymtyrëve të tij dhe pajisja me atë që i nevojitet dhe që e ka të domosdoshme. Dhe brenda atyre akteve të të ushqyerit, dhënies së jetës, organizimit, pajisjes dhe të zbukurimit, në të njëjtën kohë aktet e dhënies së formave, të zhvillimit dhe të rregullimit vihen në veprim.

Dhe kështu me radhë, meqenëse akte të tilla të përgjithshme e gjithëpërfshirëse janë të ndërfutura, njëri brenda tjetrit dhe të shkrirë e të përzier së bashku si shtatë ngjyrat në dritë, madje janë të bashkuara me njëra-tjetrën; dhe meqenëse duke qenë të njëjta për sa ka të bëjë me natyrat e tyre, secili prej atyre akteve rrethon e gjithëpërfshin shumicën e qënieve dhe janë si një akt i vetëm; dhe meqenëse Ai që i kryen aktet duhet të jetë Një i njëjti; dhe meqenëse secili akt prej atyre akteve pushton dhe depërton në të gjithë universin dhe bashkohet me aktet e tjera në kooperim e ndihmesë; kjo e ka bërë universin si një tërësi të pandashme. Gjithashtu, meqenëse të gjitha krijesat e gjalla janë si fara, indekse dhe shembuj e modele të universit, kjo e ka bërë universin nga këndvështrimi i Hyjnisë si diçka tërësore, ndarja në pjesë apo copëzimi i të cilës është e pamundur.

Domethënë, universi është një tërësi e tillë sa që për të qenë Zot dhe Mbështetës i një pjese të tij, do të ishte e mundur vetëm duke qenë Zoti dhe Mbështetësi i tërësisë së tij. Ai gjithashtu është një tërësore e tillë saqë çdo pjesë e tij bëhet si një anëtar i veçantë apo si një individ; dhe nuk mund të jetë Zot apo Mbështetës për individin e veçantë, veçse Ai i Cili i ka frerat e të tërës në dorën e Tij dhe që e nënshtron atë.

● Treguesi i Gjashtë

Vetmia Hyjnore dhe Uniteti Hyjnor janë boshti dhe baza e të gjitha plotësimeve[14], dhe burimi dhe origjina e qëllimeve dhe e urtësisë në

[14] Në fakt prova më e qartë dhe dëshmia më e fuqishme për ekzistencën e plotësimeve të pafundme Hyjnore dhe për bukurinë është Uniteti Hyjnor, sepse në

krijimin e universit. Ato gjithashtu janë burimi dhe boshti i vetëm për të arritur e përmbushur dëshirat dhe aspiratat e qënieve të vetëdijshme dhe të qënieve të arsyeshme dhe veçanërisht për njeriun. Në qoftë se nuk do të ishte Vetmia Hyjnore, do të ishte shuar drita e të gjitha dëshirave dhe e kërkesave të njeriut. Rezultatet e krijimit të universit do të katandiseshin në hiçgjë, dhe shumica e plotësimeve ekzistuese, të sigurta e të qëndrueshme do të asgjësoheshin.

Për shembull, njeriu ka një dëshirë të fortë të patundur, të papërmbajtur e të zjarrtë për pavdekshmëri. Vetëm Ai që nëpërmjet misterit të Vetmisë e mban të gjithë universin në kapjen e në Dorën e Tij dhe që mund ta mbyllë këtë dynja dhe të hapë Ahiretin me aq lehtësi si të mbyllte një shtëpi dhe të hapte një tjetër, mund ta qetësonte e përmbushte këtë dëshirë. Dhe ashtu si kjo dëshirë, mijërat e dëshirave të njeriut të cilat shtrihen deri në përjetësi dhe që janë shpërndarë gjithandej universit janë lidhur me misterin e Vetmisë dhe të realitetit të Unitetit Hyjnor. Në qoftë se nuk do të ishte Vetmia Hyjnore, ai mister, këto dëshira nuk do të ishin; ato do të ishin shterpa, të pafrutshme. Dhe në qoftë se nuk do të ishte i Vetmi i Cili nëpërmjet Unitetit Hyjnor ushtron kontroll mbi të gjithë Universin, ato dëshira nuk do të ndodhnin. Madje edhe në qoftë se do të supozohej se do të ndodhnin, ato do të ndodhnin me shumë mangësi.

Për shkak të këtij misteri madhështor, Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm në mënyrë të përsëritur, me shumë pasion e me zjarr, dhe me elokuencë të lartësuar jep mësim Unitetin Hyjnor dhe Vetminë Hyjnore. Gjithashtu, të gjithë profetët, dijetarët e pastër dhe evlijatë, shenjtorët, e kanë gjetur kënaqësinë e tyre më të madhe dhe lumturinë në pranimin e Unitetit Hyjnor, duke thënë: ***Lailahe il-la Huve,*** *Nuk ka Zot tjetër përveç Atij*.

---

qoftë se do të njihej se autori i universit është *Një i Vetëm, Unik*, atëherë të gjitha plotësimet dhe bukuria e universit do të njiheshin se janë hijet, manifestimet, shenjat dhe distilimet e plotësimeve të shenjta dhe e bukurisë që është e pranishme tek Autori i Unitetit. Ndërsa në qoftë se nuk do të njihej Autori i Vetëm, atëherë plotësimet dhe bukuritë e universit do t'u përkisnin krijesave dhe shkaqeve, dhe thesari i përjetshëm i plotësimeve Hyjnore do të kishte mbetur i panjohur për mendjen njerëzore, sepse ajo ka humbur çelësin e atyre thesareve të përjetshme.

● **Treguesi i Shtatë**

Ashtu si Muhammedi a.s.m. i cili e dha mësim, e provoi dhe e shpalli në formën më të plotë pohimin e vërtetë të Unitetit Hyjnor në të gjitha shkallët e tij, po ashtu profetësia e tij u vërtetua me aq siguri e prerazi si Uniteti Hyjnor. Sepse meqenëse Ai e dha mësim Unitetin Hyjnor, realitetin më të madh në sferën e ekzistencës së bashku me të gjitha të vërtetat e tij, mund të thuhet se të gjithë argumentet duke provuar në mënyrë vendimtare Unitetin Hyjnor provojnë profetësinë e tij, vërtetësinë e detyrës së tij dhe drejtësinë e çështjes së tij. Po, një profetësi e cila zbuloi dhe me të vërtetë dha mësim Vetminë Hyjnore dhe Unitetin dhe e cila përmban mijëra prej shembujve të këtyre të vërtetave të larta duke i grumbulluar ato, nuk ka dyshim se ajo është profetësi të cilën e kërkon dhe e bën të domosdoshme ajo Vetmi dhe Ai Unitet; ato sigurisht e kërkojnë atë.

Kështu, Muhammedi a.s.m. e kreu amanetin dhe detyrën në mënyrën më të mirë dhe e përçoi mesazhin në formën më të bukur.

Tani ne do të shpjegojmë nëpërmjet shembullit tre prej dëshmive të shkaqeve të shumta të cilat dëshmojnë rëndësinë dhe lartësinë e personalitetit të tij kolektiv të këtij profeti të nderuar, duke provuar se ai është Fanari ndriçues i këtij universi dhe dielli i tij rrezatues.

Dëshmia e Parë: Sipas rregullit '*Shkaku është si vepruesi'*, barasvlera e të gjitha veprave të mira të kryera gjatë gjithë shekujve nga të gjithë individët e komunitetit të tij ka kaluar tek libri i veprave të mira të Muhammedit a.s.m., sepse ai është shkaku në arritjen e çdo sevabi që e fiton ummeti i tij deri në ditën e kijametit.

Shqyrtoje këtë dhe pastaj mendo për stacionin madhështor të përshtatshëm të cilin e kërkon medoemos tërësia e duave të panumërta prej salevateve të pranuara që ngrihen çdo ditë prej të gjithë ummetit që të kuptosh shkallën e tij të lartë e sublime dhe të kuptosh se personaliteti i tij kolektiv është dielli i universit dhe fanari ndriçues i të gjithë krijimit.

Dëshmia e Dytë: Mendo për përparimin shpirtëror të Muhammedit a.s.m., qënia esenciale e të cilit ishte burimi, bërthama, jeta dhe boshti i pemës madhështore të botës së islamit: Ai përparim shpirtëror buroi nga kryerja e tij me kapacitetin e tij të jashtëzakonshëm dhe me aftësitë

e tij të adhurimit të shenjtë dhe salevatet që përbëjnë aspektet shpirtërore të botës së islamit, duke kapur e perceptuar të gjithë kuptimin dhe shkallët e adhurimit të tij; pastaj ti mund të kuptosh se sa shumë më e lartësuar se sa shenjtëritë e tjera ishte shenjtëria e adhurimit të Muhammedit a.s.m, nëpërmjet së cilës ai u ngrit në shkallën e të qenurit *i Dashuri i Zotit xh.sh*. dhe kuptoje përçuesin e lartësisë së saj.

Një ditë Allahu hapi për mua në një sexhde në namaz, disa kuptime dhe drita rrezatuese prej frazës "*Subhane Rabbijel Aëla*" në një mënyrë të afërt me atë se si Sahabët e Profetit Muhammed a.s.m. e kuptonin atë, dhe ajo m'u shfaq aq e rëndësishme sa adhurimi i një muaji. Unë nëpërmjet kësaj kuptova vlerën e lartë të Sahabëve.

Kjo do të thonte se në fillim të islamit, shkëlqimi dhe drita që buronin nga fjalët e shenjta kishin një cilësi të ndryshme.

Nëpërmjet ripërtëritjes së tyre, ato kishin një aromë të ndryshme, një hollësi e një freski të cilat me kalimin e kohës janë bërë të fshehura e të mbuluara dhe janë zvogëluar nëpërmjet neglizhencës. Muhammedi a.s.m. i mori ato me kapacitetin e tij të mrekullueshëm të reja e të freskëta prej burimit të tyre origjinal, Esencës më të pastër e më të shenjtë, dhe i përthithi, i tërhoqi dhe i asimiloi. Si rrjedhojë e kësaj, ai mundi të marrë shkëlqim prej tesbihatit të vetëm që të tjerët mund ta merrnin vetëm duke bërë një vit adhurim.

Kështu, nga ky këndvështrim ju mund të kuptoni se deri në cilën shkallë përparoi Profeti Muhammed a.s.m. nëpër shkallët e plotësimeve, të cilat janë pa caqe apo limite.

***Dëshmia e Tretë*:** Meqenëse njerëzimi është boshti i të gjitha qëllimeve Hyjnore në univers; dhe meqenëse me kuptueshmërinë e tij të lartë, njerëzimi i ka marrë të gjithë adresimet e të Vetmit të Gjithëlavdishëm; dhe meqenëse Muhammedi a.s.m. ishte më i famshmi dhe më i shquari i njerëzimit, dhe ashtu siç e dëshmojnë veprat dhe arritjet e tij, ishte indvidi më i plotë dhe më madhështor i njerëzimit; Ai i Vetëm i Gjithëlavdishëm e mori Muhammedin a.s.m. si të adresuarin e Vet në emrin e të gjithë njerëzimit, dhe madje në emrin e të gjithë universit; Ai bëri të dukshme tek personi i tij shkëlqime të pakufishme dhe plotësime të pafundme.

Kështu, ndodhen shumë pika si këto të trija të cilat provojnë në mënyrë vendimtare se ashtu siç është personaliteti kolektiv i Muhammedit a.s.m. dielli shpirtëror i universit, po ashtu ai është shenja më e lartë e Kur'anit madhështor i njohur si universi, dhe Emri më i madh i atij dalluesi më të lartë midis të vërtetës dhe të shtrembërës dhe pasqyra e manifestimit më të madh i dritave të Emrit Hyjnor ***El-Ferd**, i Vetmi.*

O Allah! O i Vetëm, Unik dhe i Kërkuari përjetësisht! Zbrit prej bekimeve të thesarit të mëshirës Tënde që nuk shteron kurrë salevate e selame mbi atë qënie të bekuar profetike sa numri i grimcave të universit të shumëzuara me të gjitha sekondat e të gjitha minutave të të gjitha kohëve të universit.

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që Vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".[15]

*** * ***

PIKA E PESTË

Emri Hyjnor ***El-Hajj,** i Gjalli i Përjetshëm*

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

فَانْظُرْ إِلَىٰ آثَارِ رَحْمَتِ اللَّهِ كَيْفَ يُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا إِنَّ ذَٰلِكَ لَمُحْيِي الْمَوْتَىٰ

وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

Me emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

[15] Kur'an, 2:32

"Shihni, pra tek pasojat e Mëshirës së Allahut, se si Ai ringjall tokën pas vdekjes së saj. Sigurisht që (Allahu i Cili siç ringjall tokën pas vdekjes së saj) do të ngrejë me siguri të vdekurit (Ditën e Ringjalljes) dhe Ai është i Zoti për të bërë çdo gjë".[16]

اَللّٰهُ لَآ اِلٰهَ اِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّوْمُ لَا تَاْخُذُهٗ سِنَةٌ وَّلَا نَوْمٌ *"All-llah! Nuk ka Zot tjetër përveç Atij. Ai është i Gjalli i Përjetshëm dhe Vetekzistuesi dhe Mbajtësi i gjithçkaje që ekziston; as kotje e as gjumë nuk e kap Atë..."*[17]

Në horizontin e mendjes sime u shfaq një pikë prej pikave të holla të të dy vërseteve Kur'anore të lartëpërmendur dhe një manifestim prej manifestimeve të Emrit më të madh ***El-Hajj,*** *i Gjalli i Përjetshëm*, ose njëra prej dy dritave të Emrit më të madh ose një dritë prej gjashtë dritave të tij në muajin *Shev-val* kur isha në burgun Eskishehir. Unë nuk e shënova atë, sepse në atë kohë nuk qeshë në gjendje ta kapja atë zog të shenjtë. Tani pasi ai është larguar, unë të paktën do të tregoj shkurtazi nëpërmjet një numri shenjash disa rreze të asaj të vërtete të lartë dhe të asaj drite sublime.

○ **Shenja e Parë**

Ç'është *Jeta*, që është një manifestim më i madh i Emrit të Zotit ***El-Hajj, El-Muhji,*** *i Gjalli i Përjetshëm* dhe *Jetëdhënësi*?

Cila është natyra e saj?

Cili është misioni i saj?

Përgjigjjen e kësaj pyetje do ta përfshijmë në formën e një indeksi, sa vijon:

Jeta është:

- Qëllimi më i rëndësishëm i universit;
- Rezultati i tij më i madh;
- Drita e tij më vezulluese;

[16] Kur'an, 30:50
[17] Kur'an, 2:255

- Esenca e tij e distiluar;
- Fruti i tij më i përsosur e i plotë;
- Plotësimi i tij më i lartësuar;
- Bukuria e tij më e hollë;
- Stolia e tij më e bukur;
- Misteri i pandashmërisë së tij;
- Lidhja e unitetit të tij;
- Burimi i plotësimeve të tij;
- Dhe në lidhje me artin dhe natyrën, është qënia më e çuditshme e pajisur me shpirt;
- Dhe një realitet i mrekullueshëm i cili e bën edhe krijesën më të vockël si një botë në vetvete;
- Ajo është mrekullia më e jashtëzakonshme e Fuqisë Hyjnore, duke e bërë qënien e gjallë si një univers të zvogëluar, sikur ajo - domethënë jeta, të ishte një mjet për përfshirjen e universit në atë gjallesë të vogël, duke shfaqur në të atë çfarë i ngjason indeksit të universit të madh, dhe e bën atë gjallesë të lidhur ngushtë me pjesën më të madhe të qënieve..
- Ajo është një art Hyjnor i jashtëzakonshëm e cila e zmadhon pjesën e vockël duke qenë e tëra më e madhe, madje ajo e bën individin, të veçantën, si botën dhe si të ishte universale -tërësore- dhe, tregon se në lidhje me Hyjninë, universi është një tërësi e pandashme ose një universale që nuk mund të ndahet në pjesë dhe që nuk pranon pjesëmarrje e copëzim;
- Ajo është prova më e shndritshme, më vendimtare dhe më e plotë që dëshmon ekzistencën e domosdoshme të të Gjallit të përjetshëm dhe të Vetekzistuesit të përhershëm dhe tregon për Unitetin dhe Njësinë e Tij xh.sh.; dhe midis arteve Hyjnore ajo është qëndisja më brilante, më e fshehura, më e dukshmja, më e çmueshmja, më e pastërta, më e bollshmja dhe më kuptimplota e artit Hyjnor;

- Ajo është manifestimi më i hollë, më i butë e më delikat i Mëshirës Hyjnore e cila i bën krijesat e tjera që t'i shërbejnë asaj;

- Është pasqyra më gjithëpërfshirëse e Atributeve Hyjnore;

- Është një çudi e krijimit Hyjnor që përmban manifestimet e shumë Emrave të bukur Hyjnorë si ***Er-Rahman, Er-Rez-zak, Er-Rahim, El-Kerim, El-Hakim*** etj. *i Gjithëmëshirshmi, Furnizuesi, Mëshirëploti, Gjithëbujari, i Gjithurti* etj, dhe i bën të dukshme të vërteta të shumta si, Rizkun -furnizimin- urtësinë, përkujdesjen dhe mëshirën t'i nënshtrohen asaj dhe i drejton; dhe është burimi dhe origjina e të gjitha shqiseve si të parit, të dëgjuarit dhe të prekurit;

- Ajo është një makineri madhështore pastrimi dhe një aparat i çuditshëm transformimi në fabrikën e universit, e cila në mënyrë të vazhdueshme pastron gjithandej, dëlirëson, i jep gjësë përparim dhe e ndriçon atë. Sikur trupi i cili është foleja e jetës, të ishte banesa, shkolla, kapanoni për të udhëzuar karvanet e grimcave, duke i bërë të afta ato që të përmbushin detyrat dhe që të ushtrohen për detyrat e tyre.

- Ajo është një mjet nëpërmjet të cilës i Gjalli i Përjetshëm e Jetëdhënës ndriçon botën e errët, kalimtare e të ulët të dynjasë dhe i jep asaj një lloj qëndrueshmërie duke e përgatitur atë të shkojë për tek një botë tjetër e qëndrueshme dhe e amshuar;

- Pastaj dy fytyrat e jetës, domethënë, fytyrat e saj të brendshme e të jashtme, janë të ndritshme, të lartësuara, të pandotura dhe pa mangësi; ajo është një krijesë e veçantë dhe e dalluar nga çdo krijesë tjetër mbi të cilën shkaqet e jashtme nuk janë vendosur si perde për aktet e Fuqisë Hyjnore -ashtu siç është tek gjërat e tjera-, me qëllim që të tregojë qartë se jeta është shfaqur drejtpërdrejtë pa perde apo ndërmjetësi prej Dorës së fuqisë Hyjnore;

- Dhe realiteti i jetës shikon tek gjashtë shtyllat e besimit, duke i provuar ato në kuptim dhe në mënyrë të nënkuptuar, të tërthortë, domethënë, ajo është një e vërtetë e ndritshme e cila sheh e provon;

- Edhe Ekzistencën e domosdoshme të Ekzistuesit të domosdoshëm, edhe jetën e Tij të amshuar.

- Edhe botën e Ahiretit dhe jetën e përhershme,

- Ekzistencën e Melekëve

- Edhe shtyllat e tjera të besimit.

- Gjithashtu, ashtu siç është jeta esenca më e pastër e universit, e distiluar prej të gjithë atij, po ashtu ajo është një mister madhështor që shkakton e fiton falënderime, adhurim, lavdërime e dashuri të cilat janë qëllimet më të rëndësishme Hyjnore në univers dhe rezultati më i rëndësishëm për krijimin e kësaj bote.

Kështu, shqyrtoji këto njëzet e nëntë veçori kuptimplote e të çmueshme të jetës dhe detyrat e saja të larta të gjithanshme, dhe pastaj shiko madhështinë e Emrit Hyjnor ***El-Hajj,*** *i Gjalli i Përjetshëm* prapa Emrit ***El-Muhji,*** *Jetëdhënësi*. Kupto gjithashtu se si me këto veçori madhështore dhe me frutat e jetës, Emri ***El-Hajj,*** *i Gjalli i Përjetshëm* është Emri më i Madh Hyjnor.

Gjithashtu kupto se meqenëse jeta është rezultati më i madh i universit, qëllimi më i madh i tij dhe fruti më i çmueshëm, po ashtu jeta duhet të ketë një qëllim dhe një rezultat aq të madh sa universi sepse ashtu si rezultati i pemës që është fruti i saj, dhe rezultati i frutit është pema e ardhshme në të ardhmen nëpërmjet bërthamës së tij.

Po, ashtu si qëllimi dhe rezultati i kësaj jete që është jeta e përhershme, dhe ashtu si njëri frut prej frutave të saj është falënderimi, adhurimi, lavdërimi dhe dashuria ndaj Dhuruesit të jetës ***El-Hajj, El-Muhji***, dhe ky falënderim, kjo dashuri, ky lavdërim dhe ky adhurim janë fruti i jetës ashtu siç janë qëllimi i universit.

Kupto gjithashtu nga kjo, se ata të cilët e kufizojnë dhe e ngushtojnë qëllimin e kësaj jete në "Të jetuarit rehat, duke kënaqur vetveten në pakujdesi dhe duke e zhytur atë në ëndje e epshe", ata poshtërojnë e fyejnë me injorancë të shëmtuar e me mohim mirësinë më të çmueshme të jetës, dhuratën e vetëdijes, mirësinë e arsyes, dhe çfarë mosmirënjohje të lemerishme tregojnë ata.

- **Shenja e Dytë**

Për t'i shpjeguar të gjitha shkallët, atributet dhe detyrat e jetës -e cila është manifestimi më i madh i Emrit Hyjnor ***El-Hajj,*** *i Gjalli i Përjetshëm*, dhe manifestimi më i hollë i Emrit Hyjnor ***El-Muhji***

Jetëdhënësi, të përmendur në indeksin tek Shenja e Parë, njeriu duhet të shkruante trajtesa sa numri i atyre atributeve.

Kështu, meqenëse disa prej atyre veçorive, shkallëve dhe detyrave janë shpjeguar në Pjesë të ndryshme të Risale-i Nurit, ne ju referojmë ju tek ato për disa detaje, dhe këtu do të shpjegojmë vetëm pak.

Kështu, u tha në veçorinë e Njëzet e tre prej Njëzet e nëntë veçorive të jetës se, dy fytyrat e jetës janë të tejdukshme, të pastra e të panjollosura; dhe Fuqia Hyjnore nuk ka vendosur shkaqe të jashtme në të si perde për ushtrimin e asaj fuqie.

Po, kuptimi i kësaj veçorie është siç vijon:

Sigurisht çdo gjë në univers përmban të mirën; dhe në të ndodhet bukuria dhe e mira. Ndërsa e keqja dhe shëmtia janë shumë të pjesshme; dhe ato janë si dy njësi matëse, domethënë ato gjenden për të treguar shkallët dhe realitetet e shumta të së mirës dhe të bukurisë;

Prandaj, e keqja konsiderohet e mirë dhe shëmtia e bukur nga ky këndvështrim; domethënë nga këndvështrimi i qënies së atyre të dyjave si mjete për të shfaqur shkallët dhe realitetet. Mirëpo, me qëllim që ankesat dhe zemërimi, të cilat burojnë nga ajo që për shikimin sipërfaqësor të qënieve të vetëdijshme duken shëmti, e keqe, sprova e fatkeqësi, të mos drejtohen për tek i *Gjalli i përjetshëm* dhe tek *Vetekzistuesi i përhershëm*, ***El-Hajj, El-Kajjum***, u vendosën shkaqet e jashtme si perde për ushtrimin e Fuqisë Hyjnore, me qëllim që ta shenjtërojë e largojë fuqinë Hyjnore nga ato kundërshtime sipërfaqësore; duke ditur se shkaqet nuk mund të krijojnë gjë në vetvete, por ato janë vendosur për të ruajtur dinjitetin, shenjtërinë dhe natyrën e patëmetë të Fuqisë Hyjnore, dhe me qëllim që ato shkaqe të jashtme të mbeten si objektiv, tabelë e qitjes, për ankesat e padrejta dhe për kundërshtimet e kota.

Ashtu siç është shpjeguar në Stacionin e Dytë të Fjalës së Njëzet e Dytë, meleku i vdekjes, Azraili a.s. iu përgjërua Allahut të Gjithëfuqishëm lidhur me detyrën e tij të marrjes së shpirtërave të të vdekurve. Ai tha: "Shërbëtorët e Tu do të jenë të zemëruar me mua".

Atij iu tha në përgjigje: "Unë do të vendos perden e sëmundjes dhe të fatkeqësisë ndërmjet detyrës tënde dhe vdekjes, kështu ata do t'i

hedhin shigjetat e tyre të ankesave dhe të kundërshtimeve, jo tek ty, por tek ato perde".

Dhe sipas kuptimit të kësaj lutje, ashtu si detyra e Azrailit a.s. që është një perde, në të njëjtën mënyrë siç janë shkaqet e tjera të jashtme perde e maska, po ashtu zemërimi dhe ankesat e atyre të cilët nuk e shohin fytyrën e vërtetë e të bukur të vdekjes -të bukur për njerëzit e besimit- dhe që nuk e njohin manifestimin e mëshirës në të, të mos drejtohen tek i Gjalli i Përjetshëm dhe tek Vetekzistuesi i përhershëm.

Po, "Dinjiteti dhe Madhështia" kërkojnë që shkaqet të jenë perde për Dorën e Fuqisë Hyjnore përpara shikimit të mendjes, ndërsa "Uniteti Hyjnor dhe Gjithëlavdia" kërkojnë që shkaqet t'i tërheqin prapa duart e tyre dhe të mos kenë ndikim të vërtetë.

Por, meqenëse dy fytyrat e jashtme e të brendshme të jetës, njëra që shikon tek dimensionet e jashtme të gjërave dhe tjetra që shikon dimensionet e tyre të brendshme, janë të panjollosura, të patëmeta e të pafajshme, të dëlira, të plota e pa mangësi, atëherë ashtu siç nuk ndodhet në to asgjë që të nxisë ankesa e kundërshtime, po ashtu në ato nuk ka papastërti apo shëmti gjë të cilat kundërshtojnë dinjitetin dhe shenjtërinë e Fuqisë. Prandaj, këto fytyra të jetës i janë nënshtruar drejtpërdrejtë, pa perde, Dorës së Emrit Hyjnor ***El-Muhji***, *Jetëdhënësit*, Allahut, ***El-Hajj, El-Kajjum***.

Drita është e njëjta, si jeta; dhe kështu janë ekzistenca dhe dhënia e ekzistencës. Për këtë arsye, krijimi dhe dhënia e ekzistencës shikojnë drejtpërdrejtë pa perde tek Fuqia e Krijuesit xh.sh.. Madje edhe shiu, meqenëse është një lloj jete e mëshire, koha e zbritjes së tij nuk i është nënshtruar një ligji të rregullt, me qëllim që në të gjitha kohët e nevojës duart të ngrihen lart duke bërë dua përpara derës së mëshirës, duke kërkuar mëshirë; sepse në qoftë se shiu do të binte sipas një ligji të rregullt -ashtu si lindja e perëndimi i diellit- nuk do të bënin njerëzit dua për rënie shiu në kohë nevoje për atë mirësi jetike.

○ **Shenja e Tretë**

Në veçorinë e Njëzet e Nëntë të jetës u tha se ashtu si rezultati i universit është jeta, po ashtu falënderimet dhe adhurimi janë rezultati i jetës; këto të dyja janë shkaku dhe arsyeja përfundimtare i krijimit të universit dhe rezultati i tij i synuar.

Po, Krijuesi i Universit ***El-Hajju, El-Kajjum***, *I Gjalli i Përjetshëm, Vetekzistuesi i Përhershëm* sigurisht kërkon falënderime prej krijesave të gjalla në shkëmbim të bërjes së njohur e të dashur të Vetvetes së Tij nëpërmjet kaq shumë llojeve të pakufishme mirësish, dhe Ai kërkon lavdërimin e vlerësimin për artet e çmueshme të Tij dhe që ata t'u përgjigjen me adhurim e bindje urdhërave të Tij Hyjnorë.

Dhe kështu, në përputhje me këtë mister të Hyjnisë, falënderimi dhe ibadeti janë qëllimi më i madh e më i rëndësishëm për të gjitha llojet e jetës, dhe me rolin e tyre ato janë qëllimi i të gjithë universit.. Prandaj ne shohim se Kurani i shpjegimit të mrekullueshëm i nxit me pasion të zjarrtë, me intensitet dhe me ëmbëlsi dhe shtyn për tek falënderimet dhe tek adhurimi. Ai deklaron në mënyrë të përsëritur dhe shpjegon me qartësi se, Adhurimi është vetëm për Zotin xh.sh.; Falënderimi e lavdërimi i takojnë vetëm Atij xh.sh.. dhe çështjet në jetë janë vetëm në drejtimin e Autoritetit të Tij, dhe me këtë ai i refuzon në mënyrë të qartë ndërmjetësitë dhe shkaqet, duke ia dorëzuar jetën, me çfarë përmban ajo, Dorës së Fuqisë së të *Gjallit të Përjetshëm dhe Vetekzistuesit të Përhershëm*, ***El-Hajj El-Kajjum;*** Për shembull, ai thotë:

وَهُوَ الَّذِي يُحْيِي وَيُمِيتُ وَلَهُ اخْتِلَافُ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ ۚ هُوَ الَّذِي يُحْيِي وَيُمِيتُ فَإِذَا

قَضَىٰ أَمْرًا فَإِنَّمَا يَقُولُ لَهُ كُن فَيَكُونُ ۝ فَيُحْيِي بِهِ الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا

"Dhe është Ai i Cili jep jetë dhe sjell vdekje, i Tij është edhe këmbimi i vazhdueshëm i ditës dhe i natës".[18]

"Ai është i Cili jep jetë dhe sjell vdekje, dhe kur Ai vendos për një gjë, Ai i thotë asaj: "Bëhu!" dhe ajo është e bërë".[19]

"... Ai e ringjall tokën pas vdekjes së saj..."[20]

Po, ajo që të fton për falënderim, lavdërim e mirënjohje dhe ajo që nxit ndjenjën e dashurisë dhe të vlerësimit -pas mirësisë së jetës- janë

[18] Kur'an, 23:80
[19] Kur'an, 40:68
[20] Kur'an, 30:24

furnizimi me rizk, shërimi dhe zbritja e shiut dhe të tjera si këto prej motiveve që të nxisin për të bërë falënderime e lavdërime.

Edhe këto mjete gjithashtu janë të veçanta e të kufizuara tërësisht tek Dora e Furnizuesit Shërues ***Er-Rez-zak Esh-Shafi*** xh.sh.. Shkaqet janë vetëm se perde dhe ndërmjetësi; sepse shenja e kufizimit dhe e përcaktimit -sipas rregullave të gjuhës arabe- është përemri i përcaktuar هُوَالَّذِى ۞ هُوَالرَّزَّاقُ ***Huve Er-rez-zak***, *Ai është Furnizuesi*, dhe ***Huve el-ledhi,*** *Ai është Ai i Cili*, është e qartë

në vërsetet Kuranore që vijojnë.

هُوَالرَّزَّاقُ ذُو الْقُوَّةِ الْمَتِينُ ۞ وَإِذَا مَرِضْتُ فَهُوَيَشْفِينِ ۞ وَهُوَالَّذِى

يُنَزِّلُ الْغَيْثَ مِنْ بَعْدِ مَا قَنَطُوا

"...Ai është padyshim Gjithëfurnizuesi, Zotëruesi i Fuqisë, i Përhershmi më i Fortë"[21]

"Dhe kur unë jam i sëmurë, është Ai i Cili më shëron".[22]

"Dhe Ai është i Cili zbret shiun (edhe) pasi ata kanë humbur çdo shpresë..."[23]

Këto vërsete dhe të tjera si këto tregojnë se, furnizimi me rizk, shërimi dhe zbritja e shiut janë të veçanta për Të dhe përkufizohen krejtësisht në Dorën e Fuqisë së *të Gjallit të Përjetshëm, Vetekzistuesit të Përhershëm,* ***El-Hajj, El-Kajjum.*** Atëherë Ai që u jep ilaçeve veçoritë e tyre dhe që krijon efektet e tyre, pikërisht Ai është Ai *Shërues* i vërtetë.

○ **Shenja e Katërt**

Në lidhje me veçorinë e Njëzet e Tetë të jetës, u shpjegua se jeta shikon gjashtë shtyllat e besimit dhe i provon ato; ajo tregon të vërtetën e tyre.

---

[21] Kur'an, 52:58
[22] Kur'an, 26:80
[23] Kur'an, 42:28

Po, meqenëse rezultati më i rëndësishëm, fruti i universit dhe qëllimi i krijimit të tij është jeta, sigurisht ai realitet i lartë nuk përkufizohet tek kjo jetë kalimtare, e shkurtër e mangët dhe e dhimbshme e kësaj dynjaje. Qëllimi dhe rezultati i pemës së jetës, madhështia e së cilës kuptohet nëpërmjet njëzet e nëntë veçorive të saj, janë jeta e përhershme dhe jeta e Ahiretit; është jeta në botën e lumturisë, që gurët, pemët dhe dheu i së cilës janë të gjalla. Ose përndryshe do të bëhej e domosdoshme që të mbetej pema e jetës e pajisur me aparatura e gjymtyrë të ndryshme e domethënëse për qëniet e vetëdijshme dhe veçanërisht për njeriun, pa frut, pa dobi, pa qëllim e pa realitet. Atëherë njeriu, kapitali dhe aftësitë e jetës së të cilit janë njëzet herë më të mëdhaja e më të shumta se ato të trumcakut, që është krijesa më e lartësuar dhe më e rëndësishme në univers dhe gjallesa më e lartë, do të binte njëzet herë më poshtë se ai për sa ka të bëjë me lumturinë e jetës, dhe do të bëhej më i mjeri, më i dëshpëruari e fatkeqi.

Për më tepër, mendja e tij e cila është mirësia më e madhe, do të bëhej një bela e fatkeqësi për njeriun duke menduar për hidhërimet e kohës së shkuar dhe për ankthet e së ardhmes, dhe e torturon vazhdimisht zemrën e njeriut, për shkak se i përzien nëntë dhimbje me një kënaqësi të vetme!

Nuk ka dyshim se kjo është fallco në shkallën e njëqindfishtë. Domethënë, jeta e kësaj dynjaje provon në mënyrë vendimtare shtyllën e "besimit në Ahiretin", dhe në pranverë shtron para syve tonë më shumë se treqind mijë shembuj të ringjalljes së të vdekurve.

A do të ishte e mundur që Rregulluesi i Gjithëfuqishëm i punëve, i Cili përgatit me urtësi, me mirësi, me përkujdesje e me mëshirë në kopshtin tënd dhe në vendin tënd të gjitha gjërat, aparatet dhe gjymtyrët e domosdoshme për jetën tënde; i Cili i bën ato të mbërrijnë tek ty në kohën e duhur; i Cili njeh e dëgjon lutjen më të pjesshme e të vogël për ushqim që bëhet nga stomaku nëpërmjet dëshirave të tij për ekzistencë të vazhdueshme; duke shfaqur pranimin e asaj duaje nëpërmjet dërgimit të ushqimeve të shijshme të panumërta që ta qetësojë atë stomak! A do të ishte e mundur që Ai i Gjithëfuqishëm të mos të të njohë? Dhe mos të të shohë? Dhe të mos përgatiste gjithçka të domosdoshme për jetën e përhershme, që është qëllimi më i madh i njerëzimit, dhe të mos pranonte duanë më të ngutshme, më të

rëndësishme dhe universale për pavdekshmëri, dhe të mos i përgjigjej asaj duaje me ndërtimin e jetës së Ahiretit dhe të krijimit të parajsës; që Ai të mos dëgjonte duanë e këtij njeriu -i cili është krijesa më e lartësuar në univers, madje ai është Sulltani i tokës dhe rezultati i saj-, atë dua të përgjithshme të fuqishme që buron nga thellësirat, e cila jehonon, kumbon, nga toka për tek Froni Hyjnor! A do të ishte e mundur që Ai të mos shqetësohej për të e të mos e mbante aq të rëndësishme sa një stomak dhe të mos e kënaqte këtë njeri? Dhe t'i zbulonte urtësinë e Tij të plotë dhe mëshirën e Tij absolute përpara mohimit? Jo, kurrë! Ruajna Zot, një mijë herë, jo!

Dhe a do të ishte e mundur që Ai të dëgjonte zërin më të fshehur të pjesës më të vogël të jetës, t'ia vinte veshin ankimit të saj, ta ndihmonte e t'ia lehtësonte dhimbjen, t'u përgjigjej nevojave të saj, ta ushqente me kujdes të plotë e përkujdesje të madhe, t'i bënte të tjerët që t'i shërbejnë asaj me vëmendje dhe t'i bënte krijesat e Tij më të mëdhaja që ta ndihmojnë? dhe atëherë të mos dëgjonte zërin gjëmimtar të jetës më të madhe, më të vlefshme të pavdekshme dhe më të hollë? A do të ishte e arsyeshme që Ai të mos tregonte shqetësim për duanë e tij shumë të rëndësishme -që është duaja për përjetshmëri- dhe të mos merrte në konsideratë përgjërimin e tij të fuqishëm dhe lutjen për pavdekshmëri?

Atëherë do të ishte si ai që do të pajiste me pajime -me përkujdesje të plotë- një ushtar të vetëm dhe të shpërfillte një ushtri të madhe të bindur e të disiplinuar! Dhe do të ishte si ai që shikon një atom dhe nuk sheh diellin! Ose si ai që dëgjon zukatjen e mushkonjës dhe nuk dëgjon gjëmimin e rrufesë! Ruajna Zot! Një mijë herë, Ruajna Zot!

Dhe a do ta pranonte arsyeja në ndonjë mënyrë që i Gjithëfuqishmi i Gjithurtë i Cili zotëron mëshirë të pafundme, dashuri dhe dhembshuri të gjithanshme; i Cili e do shumë artin e Tij dhe nëpërmjet tij e bën Vetveten të dashur për krijesat e Tij dhe i do shumë ata të cilët e duan Atë, a do të ishte e arsyeshme që Ai ta dënonte me vdekje të përhershme jetën e atij të cilin Ai e do më shumë se çdo gjë; i cili është i dashuri, i denjë për dashuri; dhe i cili e adhuron Krijuesin e tij nga natyra, dhe gjithashtu ta dënonte me vdekje të përhershme esencën dhe substancën e jetës e cila është shpirti!! A do ta ofendonte e ta bënte të zemëruar ndaj Vetvetes së Tij për të gjithë përjetësinë atë mik të dashur të Tij dhe duke e plagosur atë në mënyrë të tmerrshme ta dënonte

misterin e mëshirës së Tij dhe dritën e dashurisë së Tij duke i zbuluar ato para mohimit! Ruajna Zot! Një mijë herë!

Bukuria absolute e cila stolis universin me manifestimin e saj; mëshira absolute e cila i bën të gëzuara e të lumtura të gjitha krijesat, sigurisht, ajo bukuri e mëshirë janë të lartësuara e të shenjtëruara pafundësisht dhe janë larg pa limit prej një tiranie të tillë absolute, prej një shëmtie të tillë absolute dhe prej një mizorie të tillë.

Përfundim: Meqenëse në dynja ka jetë, ata njerëz që e kuptojnë misterin e jetës dhe nuk i keqpërdorin jetët e tyre, do të jenë të denjë për një jetë të përhershme në botën e përjetësisë dhe në parajsën e përhershme. Në këtë ne besojmë!

Pastaj, objektet e shndritshme në faqen e tokës duke vezulluar e xixëlluar me reflektimin e diellit, dhe flluskat në sipërfaqen e detit duke shkëndijuar, xixëlluar dhe duke u shuar me shkreptimat e dritës, dhe flluskat e shkumat që vijnë pas tyre duke vepruar përsëri si pasqyra për diej të zvogëluar të imagjinuar, në mënyrë të vetëkuptueshme tregojnë se ato shkreptima janë reflektimet dhe manifestimet e një dielli të vetëm të lartësuar. Ato të kujtojnë ekzistencën e diellit me gjuhë të ndryshme, dhe e tregojnë atë me gishtat e tyre të dritës.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, nëpërmjet manifestimit më të madh të Emrit Hyjnor ***El-Muhji*** *-Jetëdhënësi-* i *Të Gjallit të Përjetshëm, dhe i Vetekzistuesit të përhershëm,* krijesat e gjalla në tokë e në det shndrisin e vezullojnë nëpërmjet Fuqisë Hyjnore. Dhe me qëllim që të bëjnë vend e të hapin rrrugë për ato që vijnë pas tyre, thonë ***Ja Hajj****, O i Gjallë i përjetshëm* dhe zhduken nga pamja prapa perdes së të Padukshmes, duke treguar e dëshmuar kështu për jetën e ekzistencës së domosdoshme të *të Gjallit të Përjetshëm* dhe *të Vetekzistuesit të Përhershëm*, ***El-Hajj, El-Kajjum***, i Cili ka jetë të amshuar.

Për më tepër, të gjitha dëshmitë duke dëshmuar Njohjen Hyjnore, efekti i së cilës është i dukshëm në organizimin dhe në sistemimin e të gjitha krijesave; dhe të gjitha provat duke demonstruar fuqinë e cila ushtron kontroll mbi të gjithë universin; dhe të gjitha shenjat dhe mrekullitë duke provuar misionet e profetëve, të cilat janë boshti i Fjalës Hyjnore dhe i shpalljes Hyjnore; dhe të gjitha dëshmitë që vërtetojnë shtatë atributet Hyjnore -të gjitha këto me unanimitet tregojnë, shprehin e dëshmojnë- jetën e *Të Gjallit të përjetshëm* dhe *të*

Vetekzistuesit të Përhershëm ***El-Hajj El-Kajjum***; sepse në qoftë se një gjë ka shikim, ajo gjithashtu ka jetë; dhe në qoftë se ajo ka dëgjim, kjo është një shenjë e jetës së saj; në qoftë se ajo ka të folur, kjo tregon ekzistencën e jetës; dhe në qoftë se ajo ka dëshirë e zgjedhje, kjo tregon jetë. Kështu, atribute të tilla si fuqia absolute, dëshira gjithëpërfshirëse dhe njohja e gjithanshme ekzistenca e të cilave është e qartë dhe e sigurt për shkak të veprave dhe të efekteve në univers dëshmojnë nëpërmjet të gjithë treguesve e dëshmive të tyre jetën dhe ekzistencën e domosdoshme të *të Gjallit të Përjetshëm* dhe *të Vetekzistuesit të Përhershëm* ***El-Hajj El-Kajjum***, jeta e përhershme e të Cilit ndriçon të gjithë universin me një hije të vetme të saj, dhe nëpërmjet një manifestimi të vetëm prej manifestimeve të saj i jep jetë botës së Ahiretit dhe madje edhe grimcave të saj.

Jeta gjithashtu shikon tek shtylla e "besimit në melekët", dhe e provon atë në mënyrë të tërthortë; sepse meqenëse rezultati më i rëndësishëm i universit është jeta, dhe qëniet e gjalla -për shkak të vlerës së tyre- janë më të shumta e të përhapura gjërësisht dhe kopjet e tyre janë më të shumëfishuarat, dhe të cilat e popullojnë bujtinën e tokës me karvanet e tyre udhëtuese njëri pas tjetrit; dhe meqenëse globi tokësor është mbushur me kaq shumë qënie të gjalla, dhe për shkak të ripërtëritjes dhe shumimit të qënieve të gjalla, ai në mënyrë të vazhdueshme boshatiset dhe rimbushet; dhe meqenëse jeta është krijuar mbi të edhe në lëndë të kalbura e të prishura dhe ajo është bërë një masë mikroorganizmash; dhe meqenëse vetëdija dhe inteligjenca, esenca më e pastër e distiluar e jetës, dhe shpirti, substanca e saj më e hollë e më e qëndrueshme, janë krijuar me bollëk të madh në tokë, dhe mjaft thjesht, sikur toka jeton dhe zbukurohet me jetë, me mendje, me vetëdije dhe me shpirt dhe është e populluar në atë mënyrë; meqenëse kjo është kështu, atëherë sigurisht trupat qiellorë, të cilët janë më të hollë, më me dritë, më të mëdhenj e më të rëndësishëm se sa toka, nuk mund të jenë të vdekura, të pagjalla të pajeta dhe pavetëdije; kjo do të ishte përtej limiteve të mundësisë. Atëherë ato që do t'i popullonin qiejt, që do t'i gëzonin e stolisnin diejt dhe yjet dhe që do t'u jepnin gjallëri dhe që përfaqësojnë rezultatin e krijimit të qiejve dhe të frutit të tyre, dhe ata që do të nderoheshin me marrjen e adresimit Hyjnor, ata janë banorë të vetëdijshëm dhe të gjallë të qiejve të përshtatshëm me to, meqë ato gjenden atje nëpërmjet misterit të jetës.. dhe ato janë melekët.

Gjithashtu natyra esenciale e jetës shikon tek shtylla e "besimit në Profetët", dhe e provon atë në mënyrë të tërthortë. Po, meqenëse universi u krijua për jetën dhe jeta është manifestimi më i madh, skalitja më e plotë dhe akti më i bukur i *Të Gjallit të Përjetshëm* dhe *i Vetekzistuesit të Përhershëm* ***El-Hajj El-Kajjum*** xh.sh.. dhe meqenëse jeta e të Përhershmit xh.sh. e shfaq Vetveten nëpërmjet dërgimit të Profetëve dhe shpalljes së shkrimeve dhe të librave qiellorë, sepse në qoftë se nuk do të kishte pasur *Profetë* dhe as *Libra qiellorë*, nuk do të ishte njohur ajo jetë e parapërjetshme. Ashtu si folja e individid që tregon jetën e tij dhe se ai është i gjallë, po ashtu pejgamberët dhe mesazhierët a.s. dhe librat e shpallur qiellorë mbi ta, shpjegojnë e tregojnë për Atë Folës të Gjallë i Cili urdhëron e ndalon nëpërmjet fjalëve dhe mesazheve të Tij nga prapa botës së Padukshme, nën perden e universit,

Nuk ka dyshim se jeta që është në univers, ashtu siç tregon në mënyrë të prerë të *Gjallin e Parapërjetshëm* xh.sh. dhe domosdoshmërinë e ekzistencës së Tij, po ashtu ato tregojnë për rrezet e asaj jete të parapërjetshme, manifestimet dhe komunikimet e saj, dhe ajo gjithashtu shikon tek shtyllat e besimit në '*Dërgimin e Profetëve'* dhe në '*Shpalljen e Librave qiellorë'*. Dhe i vërtetojnë ato në mënyrë të tërthortë. Dhe meqenëse Profetësia e Muhammedit a.s.m. dhe shpallja e Kuranit janë si shpirti dhe si mendja e jetës, atëherë mund të thuhet se e vërteta e tyre është aq e sigurtë sa ekzistenca e jetës.

Po, ashtu si jeta që është esenca e distiluar e universit; dhe vetëdija dhe shqisa perceptuese distilohen nga jeta dhe janë esenca e jetës; dhe mendja gjithashtu distilohet nga vetëdija dhe nga shqisa perceptuese dhe është esenca e vetëdijes; dhe shpirti është substanca e pastër dhe e panjollosur e jetës, është esenca e saj e qëndrueshme dhe e mëvetësishme, po ashtu jeta fizike e shpirtërore e Muhammedit a.s.m. është kuintesenca e distiluar nga jeta dhe nga shpirti i universit; dhe profetësia e Muhammedit a.s.m. është pikërisht esenca më e pastër e distiluar prej shqisës, vetëdijes dhe mendjes së universit. Madje, jeta fizike dhe shpirtërore e Muhammedit a.s.m., nëpërmjet dëshmisë së veprave të saja, është pikërisht jeta e jetës së universit. Dhe profetësia e Muhammedit a.s.m. është vetëdija dhe drita e vetëdijes së universit. Ndërsa shpallja e Kuranit, sipas dëshmisë së të vërtetave të tij të gjalla, është shpirti i jetës së universit dhe mendja e Vetëdijes së tij.. Po.. Po..

Po. Në qoftë se drita e profetësisë së Muhammedit a.s.m. do të largohej nga universi, universi do të vdiste.

Në qoftë se Kurani do të largohej, universi do të bëhej i marrë, toka do ta humbiste kokën dhe arsyen e saj; madje ajo do ta përplaste kokën e saj tashmë të pavetëdijshme me një planet dhe do të ndodhte kijameti.

Jeta gjithashtu shikon tek shtylla e '*besimit në Kaderin Hyjnor'* dhe e provon atë në mënyrë të tërthortë. Kjo për shkak se, meqenëse jeta është drita e botës së dukshme dhe e rrethon dhe ka dominim mbi të, dhe është rezultati dhe qëllimi i ekzistencës, dhe meqenëse ajo është pasqyra më gjithëpërfshirëse e Krijuesit të Universit dhe shembulli më i plotë dhe indeksi i aktivitetit Hyjnor, dhe -le të mos ketë gabim në krahasime- është si një lloj programi; atëherë sigurisht, misteri i jetës bën të domosdoshëm që krijesat në Botën e së Padukshmes, domethënë e shkuara dhe e ardhmja, domethënë krijesat që kanë qenë e që do të vijnë, janë parapërgatitur për t'iu përshtatur sistemit, rregullit, për të qenë të njohura e të shikuara, të paracaktuara dhe të parapërgatitura për t'iu nënshtruar urdhërave krijuese.

Fara origjinale e një peme dhe rrënjët e saj, po ashtu farërat e përfshira në frutin e saj dhe rezultati përfundimtar, që të gjitha këto manifestojnë një lloj jete jo më të vogël se sa vetë pema; madje ato mbajnë brenda vetvetes ligje jete më të holla se sa ato të pemës.

Gjithashtu, farërat dhe rrënjët e lëna nga vjeshta e kaluar, përpara pranverës së tanishme, si dhe farërat dhe rrënjët që do të lihen për pranverat vijuese pasi kjo pranverë të ketë kaluar - të gjitha këto mbajnë manifestimet e jetës, ashtu si kjo pranverë, dhe u nënshtrohen ligjeve të jetës. Pikërisht në të njëjtën mënyrë, të gjitha degët e shkarpurinat e pemës së kozmosit, secila prej tyre ka një të shkuar dhe një të ardhme. Ato kanë një zinxhir që përbëhet nga fazat dhe rrethanat e së shkuarës dhe të së ardhmes; dhe çdo lloj dhe çdo pjesë prej tij ka ekzistenca të shumta dhe periudha të ndryshme në njohjen Hyjnore duke formuar me këtë një zinxhir ekzistence në njohjen e Zotit xh.sh., dhe ashtu si një ekzistencë e jashtme, ekzistenca e saj në njohjen e Zotit xh.sh. është një manifestim i jetës universale që i merr të gjitha aspektet e jetës së saj nga këto Tabela kuptimplote e jetike të Kaderit Hyjnor.

Fakti se bota e shpirtërave -e cila është njëra formë e botës së Padukshme- është mbushur plot me shpirtëra të cilët janë esenca e jetës dhe lënda e saj, thelbi i saj dhe substancat e saj, sigurisht bëjnë të domosdoshme e kërkojnë që e shkuara dhe e ardhmja -të cilat janë një formë tjetër e Botës së Padukshme dhe një segment i dytë i saj- gjithashtu të marrin manifestimin e jetës. Përveç kësaj, rregulli i përkryer dhe harmonia e plotë, rrethanat kuptimplote dhe rezultatet e periudhat e brendaqenësishme në ekzistencën e një gjëje brenda njohjes Hyjnore, gjithashtu demonstrojnë manifestimin e një lloji jete. Një manifestim i tillë jete, e cila është drita e diellit të jetës së parapërjetshme nuk do të kufizoheshin vetëm në këtë botën e dukshme, as në këtë kohë të tanishme dhe në këtë ekzistencë të jashtme, përkundrazi, çdo botë e merr manifestimin e asaj drite në përputhje me kapacitetin e saj, dhe kozmosi bashkë me të gjithë botërat e tij është i gjallë dhe i ndriçuar prej manifestimit të asaj drite. Përndryshe, ashtu siç e imagjinojnë të çudhëzuarit, nën këtë jetë të përkohshme e të dukshme, secila botë është si një kufomë e madhe e tmerrshme dhe një botë e rrënuar e errët.

Atëherë, një aspekt i gjërë i shtyllës së '*besimit në Kaderin Hyjnor'* dhe në Vendimin e Tij, kuptohet nëpërmjet misterit të jetës dhe vërtetohet prej saj. Ashtu si jeta dhe gjallëria e botës së dukshme dhe e krijesave ekzistuese të dukshme që bëhen të qarta nga rregulli i tyre dhe nga rezultatet e ekzistencës së tyre, po kështu krijesat e së shkuarës dhe të së ardhmes të cilat konsiderohen prej botës së Padukshme kanë një ekzistencë jolëndore dhe një lloj jete dhe një prani shpirtërore në Njohjen e Zotit xh.sh.. Shenja e kësaj jete dhe prania e saj bëhet e dukshme dhe e njohur nëpërmjet Tabelave të Kaderit Hyjnor dhe të Vendimit dhe nëpërmjet të gjitha fazave dhe rrethanave të jetëve dhe të ekzistencave të tyre të jashtme.

○ **Shenja e Pestë**

Gjithashtu, u tha lidhur me veçorinë e gjashtëmbëdhjetë të jetës se kur jeta hyn në një gjë, ajo e bën atë një botë në vetvete; në qoftë se është një pjesë, ajo i jep asaj gjithëpërfshirjen e të tërës; dhe në qoftë se është e pjesshme, ajo i jep shtrirjen e universales.

Po, jeta ka një shtrirje të tillë sa që ajo është thjesht një pasqyrë gjithëpërfshirëse e Njësisë Hyjnore, duke shfaqur në vetvete shumicën

e Emrave të bukur Hyjnorë të manifestuar gjithandej universit. Kur jeta futet në trup, ajo e bën atë një botë të vogël; sikur ajo e transformon atë si një farë duke mbajtur indeksin e Pemës së universit, dhe ashtu siç mund të jetë fara vetëm se vepra e fuqisë së Krijuesit të pemës së saj, po ashtu Ai i Cili krijoi gjallesën më të vogël, duhet padyshim të jetë pikërisht Ai Krijuesi i gjithë universit.

Kështu, nëpërmjet kësaj gjithëpërfshirjeje jeta demonstron në vetvete një mister më të fshehtë të Njësisë Hyjnore. Domethënë, ashtu si Dielli madhështor që është i pranishëm nëpërmjet dritës së tij, reflektimit dhe shtatë ngjyrave në çdo pikë të ujit dhe në çdo copë xhami përballë tij, po ashtu Emrat dhe Atributet Hyjnore të cilat e rrethojnë dhe e gjithëpërfshijnë universin manifestohen së bashku në të gjitha qëniet e gjalla. Nga ky këndvështrim, lidhur me krijimin dhe Hyjninë, jeta e bën universin në një tërësi të pandashme, dhe e bën atë si universalen e cila nuk mund të copëzohet dhe nuk pranon pjesëmarrje; pra pjesëmarrja e të tjerëve në të është përtej limiteve të mundësisë.

Po, vula të cilën e ka vënë Krijuesi xh.sh. në fytyrën tënde tregon në mënyrë të vetëkuptueshme se Ai i Cili të krijoi ty është pikërisht Ai që e krijon të gjithë llojin njerëzor. Sepse natyra e krijimit të njeiut është e njëjta; ajo nuk mund të ndahet e të shpërbëhet. Gjithashtu nëpërmjet jetës, pjesët e universit janë si anëtarët e veçantë të njerëzimit, dhe universi si speciet. Ajo shfaq Vulën e Njësisë Hyjnore dhe stampën e të *Synuarit të Përjetshëm* në çdo individ në të njëjtën mënyrë ashtu siç i shfaq ato mbi tërësinë; kështu në çdo mënyrë e refuzon prerazi *shirkun*, të përshkruarin ortakë me Krijuesin.

Gjithashtu, ka mrekulli e çudira të jashtëzakonshme të tilla të artit Hyjnor në jetë saqë Ai që nuk ka fuqi të krijojë të gjithë universin, ai nuk mund të krijojë as gjallesën më të vogël në të. Po, një penë që shkruan në një farë të vogël indeksin e një druri të madh pishe dhe programin e jetës së tij, si të shkruante Kuranin në një qiqër të rëndomtë, sigurisht mund të jetë vetëm se pena që shkroi qiejt së bashku me yjet. Dhe Ai që vendos në kokën e një blete aftësitë dhe kapacitetin për të njohur lulet në kopshtin e universit, të jetë e lidhur me shumicën e botërave të tij, të japë një dhuratë të mëshirës Hyjnore si mjalti, dhe e shtyn atë të njohë kushtet e jetës qysh nga dita që vjen në botë, nuk ka dyshim se Ai është Krijuesi i të gjithë universit.

Shkurtazi: Jeta është një Vulë e ndritshme e Unitetit Hyjnor në faqen e universit; dhe për sa ka të bëjë me jetën, të gjitha qëniet e pajisura me jetë janë stampa të Njësisë Hyjnore; dhe qëndisjet dhe arti në çdo qënie të gjallë formojnë një Vulë të Krijuesit të Përjetshëm; dhe krijesat e gjalla vendosin nënshkrimet, firmat e tyre me jetët e tyre mbi mesazhin e universit të Përhershëm ***El-Hajj, El-Kajjum*** aq sa numri i tyre, dhe janë Vulat e Unitetit Hyjnor Stampat e Njësisë Hyjnore, Shenjat e Krijuesit të Përjetshëm. Gjithashtu, ashtu si të gjitha qëniet e gjalla që janë Vulat e Unitetit Hyjnor në këtë libër të Universit, si jeta, po ashtu një Vulë e Njësisë Hyjnore është vendosur në faqet dhe në çehret e çdo qënieje.

Për më tepër, ashtu si jeta që formon nënshkrime, firma e vula duke dëshmuar Unitetin *e të Gjallit të Përjetshëm* dhe *të Vetekzistuesit të Përhershëm* ***El-Hajj, El-Kajjum***, sa numri i të pjesshmeve të saj dhe i qënieve të gjalla, ashtu si akti i ringjalljes, i risjelljes në jetë, po ashtu ajo vendos firma, nënshkrime për Unitetin Hyjnor sa numri i qënieve.

Për shembull, ringjallja e tokës, që është një shembull i vetëm ringjalljeje, dëshmon Unitetin Hyjnor aq ndritshëm sa dielli, sepse në risjelljen në jetë të tokës në pranverë, treqind mijë specie dhe anëtarët e panumërt të llojeve ringjallen, vijnë në jetë, njëri brenda tjetrit, pa gabim e pa mangësi, me rregull të plotë e me sistem të përkryer.

Ai që kryen një akt të vetëm të tillë së bashku me akte të tjerë të panumërt me rregull, sigurisht duhet të jetë Krijuesi i të gjitha qënieve dhe i *Gjalli i Përjetshëm* dhe *Vetekzistuesi i Përhershëm* ***El-Hajj, El-Kajjum*** dhe është i Vetmi Unik që asnjë lloj ortakërie në Hyjninë e të Cilit nuk është e mundur.

Për tani, ky numër i vogël i veçorive të jetës është shpjeguar shkurtazi, dhe ne ua referojmë shpjegimin dhe diskutimin e hollësishëm të veçorive të tjera të saj Risale-i Nurit dhe një kohe tjetër.

*** * ***

Përfundim

Emri më i madh nuk është i njëjti për gjithësecilin; ai ndryshon. Për shembull, për Imam Aliun, Zoti qoftë i kënaqur me të, ishin gjashtë Emrat e bukur Hyjnorë: ***Ferdun, Hajjun, Kajjum, Hakem, Adl, Kuddus*** *i Vetmi, i Gjalli i Përjetshëm, Vetekzistuesi i Përhershëm, i Dituri, i Drejti* dhe *Më i Shenjti.*. Për Ebu Hanifen, Imamul-A'dhami ishin dy Emrat Hyjnorë: ***Hakemun, Adlun*** *I Dituri, I Drejti*; për Shejh Gejlanin, iu shenjtëroftë sekreti i tij, ishte Emri Hyjnor ***Ja Hajju***! *O i Gjallë i Përjetshëm*; për Imam Rabbanin, Zoti qoftë i kënaqur me të, Emri më i Madh ishte: ***El-Kajjum,*** *Vetekzistuesi i përhershëm* dhe kështu me radhë; shumë njerëz të tjerë nga dijetarët e mëdhenj gjenialë e konsideruan Emrin më të Madh të jenë Emra të ndryshëm.

Dhe meqenëse kjo pika e Pestë lidhet me Emrin Hyjnor ***El-Hajj,*** *I Gjalli i Përjetshëm*, si një bekim, si një dëshmi, si një tregues, si një provë e shenjtë, si një dua për veten tonë dhe si një mbyllje e mirë për këtë trajtesë, ne do të përfshijmë sa vijon, atë çfarë është shprehur nga Profeti më i madh e më i nderuar Muhammed a.s.m. në një dua shumë të lartë e quajtur ***Xhaushan el-Kebir***, e cila tregon shkallën më të lartë e gjithëpërfshirëse të njohjes së tij lidhur me Krijuesin. Ne do të shkojmë me imagjinatë tek ajo kohë dhe do të themi Amin.. Amin.. për atë që tha Profeti më i nderuar Muhammed a.s.m. dhe do të shprehim të njëjtën dua me zërin e tij sikur ta thonim vetë atë:

يَا حَيُّ قَبْلَ كُلِّ حَيٍّ ۞ يَا حَيُّ بَعْدَ كُلِّ حَيٍّ ۞ يَا حَيُّ الَّذِي لَيْسَ كَمِثْلِهِ حَيٌّ
يَا حَيُّ الَّذِي لَا يُشْبِهُهُ شَيْءٌ ۞ يَا حَيُّ الَّذِي لَا يَحْتَاجُ إِلَى حَيٍّ ۞ يَا حَيُّ الَّذِي
لَا يُشَارِكُهُ حَيٌّ ۞ يَا حَيُّ الَّذِي يُمِيتُ كُلَّ حَيٍّ ۞ يَا حَيُّ الَّذِي يَرْزُقُ كُلَّ
حَيٍّ ۞ يَا حَيُّ الَّذِي يُحْيِي الْمَوْتَى ۞ يَا حَيُّ الَّذِي لَا يَمُوتُ ۞ سُبْحَانَكَ يَا لَا إِلَهَ

إِلَّا أَنْتَ الْأَمَانَ الْأَمَانَ نَجِّنَا مِنَ النَّارِ آمِينَ

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

O Ti që ishe i Gjallë para të gjitha qënieve të gjalla;

Dhe O Ti që do të jesh i gjallë përjetësisht pas të gjitha qënieve të gjalla:

O i Gjallë i Përjetshëm që nuk Të ngjason asnjë qënie e gjallë;

O i Gjallë i Përjetshëm që asnjë i gjallë tjetër nuk është si Ti;

O i Gjallë i Përjetshëm që s'ke nevojë për asnjë qënie të gjallë;

O i Gjallë i Përjetshëm që nuk merr si ortakë asnjë qënie të gjallë;

O i Gjallë i Përjetshëm që i bën të gjitha qëniet e gjalla të vdesin;

O i Gjallë i Përjetshëm që i furnizon me ushqim të gjitha qëniet e gjalla;

O i Gjallë i Përjetshëm që ringjall të vdekurit;

O i Gjallë i Përjetshëm që nuk vdes kurrë;

Lavdia të takon Ty! Nuk ka Zot tjetër përveç Teje! Mëshirë! Mëshirë! Na shpëto ne prej zjarrit të Xhehennemit! Amin!

"*Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që Vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti*"[24].

• • •

PIKA E GJASHTË

Shikon tek Emri më i Madh Hyjnor

El-Kajjum, *Vetekzistuesi i Përhershëm*

[Përmbledhja e Pikës së Pestë rreth Emrit Hyjnor ***El-Hajj,*** u bë si një shtojcë e burimit të dritës, dhe gjithashtu ajo konsiderohet e përshtatshme të jetë një shtojcë për Fjalën e Tridhjetë.]

[24] Kur'an, 2:32

Një shfajësim

Këto çështje të rëndësishme lidhur me manifestimin më të thellë, më gjithëpërfshirës dhe më të madh të Emrit Hyjnor ***El-Kajjum***, *Vetekzistuesi i Përhershëm* m'u shfaqën mua si shkreptima të ndara dhe jo njëra pas tjetrës të sistemuara; dhe prandaj ato nuk janë të mirërregulluara. Për më tepër, ato kanë mbetur në formën e një kopjeje të shkruar me shpejtësi, të parregulluar të pakorrektuar dhe të palimuar. Për këto arsye, shumë mangësi e parregullsi mund të shfaqen në frazeologji dhe në mënyrën e shprehjes. Ju duhet t'i falni mangësitë e mia për hir të bukurive të përfshira në çështjet e diskutuara.

Një Kujtues

Pikat që lidhen me Emrin më të madh janë gjithëpërfshirëse në shkallën më të skajshme dhe janë gjithashtu tej mase të thella, sidomos çështjet që lidhen me Emrat ***El-Hajj, El-Kajjum*** dhe në mënyrë të veçantë ato të Rrezes së Parë[25]. Për më tepër, meqenëse këto të fundit shikojnë tek materialistët dhe kanë depërtuar në subjekt në një shkallë më të madhe, jo gjithkush do të jetë në gjendje ta kuptojë çdo çështje në të gjitha aspektet e saja. Megjithatë, gjithësecili do të jetë në gjendje të kapë një pjesë prej secilës çështje deri në një shkallë. Në përputhje me rregullin:

"Edhe në qoftë se një çështje nuk kapet plotësisht, ajo përsëri nuk duhet të braktiset plotësisht"; nuk do të ishte e arsyeshme të lihej mënjanë krejtësisht një çështje e tillë, duke thënë:

"Unë nuk mund t'i këpus të gjithë frutat në këtë kopshtjolëndor". Por ato fruta që i kap njeriu, ajo sasi do të ishte e dobishme dhe fitim për të.


Sepse ashtu si çështjet e lidhura me Emrin më të madh që janë të shtrira deri në atë shkallë që nuk mund të kapen -kuptohen-, po ashtu ato janë aq të holla deri në atë shkallë që mendja nuk mund t'i dallojë ato. Mendja e gjithësecilit nuk mund t'i arrijë Pikën e Pestë dhe Pikën e Gjashtë lidhur me Emrat Hyjnorë ***El-Hajj, El-Kajjum*** dhe në mënyrë të

[25] Në qoftë se lexuesi i kësaj trajtese nuk ka njohuri të gjërë në shkenca, ai nuk duhet ta lexojë këtë rreze, ose ta lexojë atë në fund, dhe le të fillojë me rrezen e dytë. Autori

veçantë me aluzionet e jetës duke përfshirë shtyllat e besimit dhe veçanërisht shtyllën e Kaderit dhe të Vendimit Hyjnor në Pikën e Pestë, por megjithatë nuk do të mbeten pa ndonjë pjesë prej tyre, dhe në çdo rast këto çështje do ta forcojnë besimin e tyre. Rëndësia e forcimit të besimit, i cili është çelësi për lumturi të përjetshme, është vërtet e madhe. Madje edhe në qoftë se do ta shtonte besimin sa një grimcë, kjo do të ishte një thesar i madh.

Imam Rabbani, Ahmed El-Faruku ka thënë: "Në shikimin tim, zbulimi vetëm në një aspekt të vogël prej çështjeve të besimit do të ishte më i preferueshëm se sa qindra ndriçime e keramete".

* * *



Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"... në Duart e të Cilit është Mbizotërimi i çdo gjëje..."[26]

"Të Tij janë çelësat e qiejve dhe të tokës",[27]

"Dhe s'ka gjë që Ne të mos i kemi për të thesaret e pashtershëm..."[28]

"Nuk ka asnjë krijesë të gjallë që Ai të mos e ketë mbërthyer pas balukeve të ballit (ta ketë nën sundimin e Tij të plotë)"[29]

[26] Kur'an, 36:83
[27] Kur'an, 39:63
[28] Kur'an, 15:21
[29] Kur'an, 11:56

Një pikë lidhur me vërsetet si këto aludojnë për *Vetekzistencën e përhershme Hyjnore*, një manifestim më i madh i Emrit Hyjnor ***El-Kajjum*** *Vetekzistuesi i Përhershëm*, i cili ose është Emri më i madh, ose i Dyti prej dy dritave të Emrit më të madh, ose i Gjashti prej gjashtë dritave të tij, iu shfaq mendjes sime gjatë muajit *Dhul-Kade* kur isha në Burgun Eskishehir. Mirëpo rrethanat e mia në burg nuk më lejuan që ta shpjegoja plotësisht atë dritë më të madhe. Meqenëse Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të, e shfaqi Emrin më të madh në *Kasiden* -poemën e tij- të quatur *Arxhuza* nën Emrin e lartësuar të *Sakinah*, dhe në poemën e tij *Xhel-xhelutija*, ai i konsideroi së bashku me disa Emra të tjerë sublimë këto gjashtë Emra të përfshirë brenda Emrit më të madh duke deklaruar për to të jenë më të mëdhenjtë dhe më të rëndësishmit. Për më tepër, unë kam marrë ngushëllim të jashtëzakonshëm prej diskutimit të tij lidhur me to. Dhe kështu, ashtu siç bëmë me pesë Emrat e Tjerë të mëparshëm, ne do të aludojmë në mënyrë të përmbledhur për këtë dritë më të madhe të Emrit Hyjnor ***El-Kajjum,*** *Vetekzistuesi i Përhershëm*, dhe do t'i bëjmë ato aluzione në pesë Rreze.

■ Rrezja e Parë

Krijuesi i Gjithëlavdishëm i Universit është *Vetekzistuesi i Përhershëm*. Domethënë, Ai ekziston, vazhdon e mbahet nga Vetvetja, Vetvetiu. Të gjitha gjërat ekzistojnë e vazhdojnë nëpërmjet Tij; ato mbeten në ekzistencë dhe kanë qëndrueshmëri nëpërmjet Tij. Në qoftë se ajo lidhje e Vetekzistencës do të këputej nga universi për më pak se një sekond, universi do të asgjësohej.

Për më tepër, ashtu siç e përshkruan Kurani i gjithurtë, Ai i Gjithëlavdishëm së bashku me Vetekzistencën e Tij,

لَيْسَ كَمِثْلِهِۦ شَىْءٌ *"Asgjë nuk i përngjet Atij..."*[30]

Domethënë, as në Esencën e Tij, as në Atributet e Tij dhe as në aktet e Tij, Ai nuk ka të ngjashëm, as të barabartë, as shokë dhe as ortakë.

[30] Kur'an, 42:11

Po, për më të Shenjtin e Vetëm i Cili e merr universin me rrethanat e funksionet e tij në kapjen e Hyjnisë së Tij dhe i Cili e rregullon, e administron, e mbështet dhe e ushqen atë me rregullsi të plotë si të ishte një shtëpi apo një pallat, që Ai të ketë ndonjë të ngjashëm, të barabartë, ortakë apo shokë është e pamundur, kjo është tërësisht e pamundur.

Po, Ai për të Cilin krijimi i yjeve është aq i lehtë sa ai i grimcave dhe fuqisë së të Cilit i nënshtrohet gjëja më e madhe në të njëjtën mënyrë siç i nënshtrohet më e vogëla, dhe për të Cilin asgjë nuk mund të jetë pengesë për ndonjë gjë tjetër dhe asnjë veprim nuk bllokon ndonjë veprim tjetër, dhe në shikimin e të Cilit individë të panumërt janë të pranishëm në të njëjtën mënyrë siç është i pranishëm një individ i veçantë, dhe i Cili i dëgjon të gjithë zërat në të njëjtën kohë dhe është në gjendje t'u përgjigjet nevojave të pakufishme të të gjithëve përnjëherësh, dhe asnjë gjë cilado qoftë ajo apo situatë nuk mund të dalë prej sferës së dëshirës së Tij dhe prej rrethit të Vullnetit të Tij - siç dëshmohet nga rregulli dhe nga balanca e drejtpeshimi i qënieve në univers, dhe i Cili ndonëse nuk e përkufizon asnjë vend, është i pranishëm në çdo vend me fuqinë dhe me njohjen e Tij, dhe megjithëse çdo gjë është absolutisht larg prej Tij, Ai është më afër asaj gjëje se sa ndonjë gjë tjetër.. Ky *i Gjallë i Përjetshëm* dhe *Vetekzistues i Përhershëm* ***El-Hajj, El-Kajjum***, Ky Zotërues i Madhështisë, sigurisht në asnjë mënyrë nuk mund të ketë ndonjë përngjasues, të barabartë, ortakë, ministër, shok apo të kundërt; kjo është krejtësisht e pamundur. Cilësitë e Tij të shenjta dhe atributet mund të shqyrtohen e shikohen vetëm nëpërmjet alegorisë dhe krahasimit. Të gjitha krahasimet dhe alegoritë në Risale-i Nur janë prej këtij lloji.

Kështu kjo Esencë Më e Shenjtë nuk ka përngjasues, është ekzistuesi i domosdoshëm, i zhveshur krejtësisht nga lënda, dhe është përtej vendit e hapësirës; ndarja apo copëzimi i Tij është absolutisht e pamundur, po ashtu është i pamundur ndryshimi apo ndërrimi i Tij; Qënia e Tij i nevojshëm apo i pafuqishëm është tërësisht përtej limiteve të mundësisë. Dhe megjithatë, një grup i njerëzve të çudhëzimit i supozojnë disa manifestime të Esencës më të Pastër e më të shenjtë të cilat manifestohen në faqet e universit dhe në nivelet e qënieve, -i supozojnë- të jenë Vetë Esenca më e pastër e më e shenjtë dhe ua atribuojnë shkallët e Hyjnisë disa krijesave; ata ia atribuojnë disa vepra të të Gjithëlavdishmit të Vetëm Natyrës dhe shkaqeve.

Mirëpo, është demonstruar me prova vendimtare në vende të shumta në Risale-i Nur se Natyra është një art Hyjnor; ajo nuk mund të jetë artisti; ajo është një libër Hyjnor; dhe nuk mund të jetë shkruesi; ajo është një skalitje; nuk mund të jetë skalitësi: Ajo është një regjistër; nuk mund të jetë llogaritari, pronari i regjistrit; ajo është një model; nuk mund të jetë burim për ekzistencën; ajo është marrëse dhe është pasive, dhe nuk mund të jetë autori; ajo është një ligj; nuk mund të jetë fuqia; ajo është një rregull, nuk mund të jetë rregullatori; ajo është një kod i krijimit dhe nuk mund të jetë themeluesi i kodit.

Në qoftë se, për të supozuar të pamundurën, krijimi i gjallesës më të vogël do t'i referohej Natyrës dhe do t'i thuhej asaj: Eja dhe krijoje këtë gjallesë -për shembull- atëherë do t'i duhej medoemos Natyrës të përgatiste kallëpe lëndorë dhe makineri aq sa numri i gjymtyrëve dhe i sistemeve trupore të asaj gjallese me qëllim që të ishte në gjendje ta kryente atë punë!! Kjo është demonstruar në shumë vende në Risale-i Nur me prova vendimtare.

Për më tepër, megjithëse një grup prej njerëzve të çudhëzimit të quajtur materialistë e perceptuan manifestimin më të madh të krijueshmërisë Hyjnore dhe të fuqisë Hyjnore brenda transformimeve me rregull të grimcave të vogëla, meqenëse ata nuk e dinin prej nga vinin ato manifestime dhe nuk mund ta kuptonin se prej ku drejtohej ajo forcë universale, e cila buronte prej manifestimit të fuqisë së të Përjetshmit absolut, duke i supozuar lëndën dhe forcën të ishin të parapërjetshme, ata filluan t'ua atribuonin veprat Hyjnore grimcave dhe lëvizjeve të tyre. Subhanall-llah! Sa çudi! A do të ishte e mundur për qëniet njerëzore të jenë kaq injorantë sa t'ua atribuojnë aktet dhe veprat të cilat mund të kryhen vetëm nga Ai i Cili është edhe përtej hapësirës dhe gjithashtu edhe i pranishëm në një mënyrë që i sheh, i njeh dhe i drejton të gjitha gjërat në krijimin e të gjitha gjërave gjithandej -t'ua atribuojnë- grimcave dhe lëvizjes së tyre, të cilat tunden e tronditen në stuhitë e rastësisë së pajetë, të verbër e të pavetëdijshme, që u mungon dëshira dhe balanca? Ata që kanë madje sa një grimcë arsye duhet ta shohin se sa ide prej injoranti dhe bestytnore është kjo.

Për shkak se këto fatkëqinj e kanë braktisur unitetin absolut, kanë rënë në një shumësi të pakufishme e të pafundme; domethënë, meqenëse ata nuk pranojnë një Zot të Vetëm, detyrohen të pranojnë

zotra të pafundmë, që do të thotë, meqenëse ata janë të paaftë të kapin me mendjet e tyre të prishura Parapërjetshmërinë e Esencës më të pastër e më të Shenjtë dhe krijueshmërinë e Tij, të cilat janë dy cilësi të domosdoshme dhe esenciale për Të, u detyruan nga mendimet e tyre të pranonin parapërjetësinë dhe madje Hyjninë e atyre grimcave të pakufishme, të pafundme dhe të pajeta.

Atëherë, eja dhe shihe këtë injorancë të plotë në të cilën ata kanë rënë!

Po, manifestimi i dukshëm i *Të Gjallit të Përjetshëm* dhe i *Vetekzistuesit të Përhershëm* ***El-Hajj, El-Kajjum*** në grimcat i ka transformuar ato në diçka që i ngjason një ushtrie madhështore të mirëdisiplinuar nëpërmjet forcës, fuqisë dhe urdhrit të Allahut Fuqiplotë. Në qoftë se urdhri dhe fuqia e komandantit më të madh do të tërhiqeshin, sikur për një sekond prej atyre grimcave të pajeta, të pavetëdijshme e të pamend, ato do të bëheshin si ushtarë të parregullt, madje ato do të pushonin krejtësisht së ekzistuari.

Për më tepër, sikur një grup tjetër njerëzish shohin madje edhe më larg; domethënë, ata janë më shumë të çudhëzuar dhe më shumë të zhytur në injorancë se sa grupi i mëparshëm. Ata e imagjinojnë lëndën e njohur si eter që të jetë burimi dhe autori meqenëse ajo vepron si një pasqyrë për manifestimet e Hyjnisë së Krijuesit xh.sh.! Duke ditur se ajo është faqja më e hollë, më delikate, më e bindur dhe më e nënshtruara e fletëve të aktiviteteve të Krijuesit të Gjithëlavdishëm, dhe si një mjet për transmetimin e Urdhërave të Tij; ajo është boja e hollë për shkrimet e Tij, një mantel i hollë për ushtrimin e fuqisë së Tij, një veshje e hollë për krijimin e Tij, tharmin -farën- e artifakteve të Tij dhe një tokë për farërat e Tij.

Nuk ka dyshim se kjo injorancë e jashtëzakonshme bën të domosdoshme pamundësi të pafundme, sepse eteri është një lëndë që është e pavetëdijshme, e pajetë, pa vullnet dhe është më e hollë se sa lënda e grimcave në të cilën u mbytën materialistët në moçalin e çudhëzimit dhe është më e dendur se sa indeksi i lëndës së parë, zanafillës, me të cilën filozofët e lashtë ranë në çudhëzim dhe humbën rrugën. Ajo është një lëndë e pajetë, pa dëshirë, pa zgjedhje dhe pa vetëdije, atëherë t'ia atribuosh veprat kësaj lënde që mund të copëzohet e të ndahet pa kufi dhe është pajisur me cilësi, me detyra, me aftësitë e

transmetimit dhe me veçorinë e të qenurit pasive -t'ua atribuosh- grimcave të vockëla të saj, të cilat janë shumë më të vogla se sa grimcat e lëndëve të tjera, aktet dhe veprat që ekzistojnë nëpërmjet vullnetit dhe fuqisë së Atij që i shikon, i njeh dhe i drejton të gjitha gjërat në të gjitha gjërat, do të ishte një gabim aq i madh sa numri i grimcave të eterit.

Akti i krijimit që është i dukshëm në krijesa është i tillë saqë demonstron se ai buron nga një fuqi dhe nga një vullnet që i shikon dhe i njeh shumicën e gjërave, madje që sheh të gjithë universin në cilëndo gjë qoftë, sidomos në qoftë se ajo është një qënie e gjallë, dhe që njeh të gjitha gjërat që lidhen me të; pastaj e vendos atë gjë në vendin e saj të përshtatshëm, i siguron asaj qëndrueshmëri në atë vend, domethënë, shkaqet e paditura materiale nuk mund të jenë në asnjë mënyrë autorja e saj.

Po, akti i krijimit -sado i pjesshëm të jetë- tregon një dëshmi madhështore, nëpërmjet misterit të *Vetekzistueshmërisë së përhershme*, se ai është akti i drejtpërdrejtë i Krijuesit të gjithë universit. Kështu, për shembull, akti i orientuar tek krijimi i një blete demonstron se ai është i veçantë për Krijuesin e Universit në dy drejtime.

Drejtimi i Parë: Fakti se të gjitha bletët e tjera gjithandej botës duke i ngjasuar asaj blete të veçantë manifeston të njëjtin akt dhe në të njëjtën kohë demonstron se akti i veçantë e individual është tipi i një akti gjithëpërfshirës i cili përqafon e rrethon faqen e tokës. Prandaj, Ai që është autori dhe pronari i atij akti të madh e të shtrirë, duhet të jetë gjithashtu autori i aktit të veçantë.

Drejtimi i Dytë: Me qëllim që të jesh autori i aktit të pjesshëm që orientohet drejt krijimit të bletës në çështje, do të duhej që -Autori- të kishte njohuri për kushtet e jetës së asaj blete, për aparatet, gjymtyrët e saj dhe për lidhjet e saj dhe qëniet e tjera, për mënyrën e garantimit të jetës së saj dhe të mjeteve të saj të jetesës, atëherë do të bëhej e domosdoshme që ai që e kryen aktin e pjesshëm do të ishte në gjendje për ta realizuar atë plotësisht, vetëm nëpërmjet pasjes autoritet mbi pjesën më të madhe të universit.

Kështu, akti më i pjesshëm e i vogël demonstron në dy drejtime që është i veçantë për Krijuesin e të gjitha gjërave.

Kështu, gjëja më e jashtëzakonshme dhe e çuditshme për njeriun dhe që i tërheq vëmendjen është kjo:

Parapërjetshmëria dhe amshueshmëria janë nga cilësitë më të veçanta të Hyjnisë dhe veçoria më e domosdoshme për Esencën më të shenjtë, për Pronarin e nivelit më të fuqishëm në ekzistencë, i Cili është Ekzistuesi i domosdoshëm që Zotëron "domosdoshmëri", që ka nivelin më të qëndrueshëm e të pandryshueshëm në ekzistencë, që është 'Veçimi absolut prej lëndës', që ka gjendjen më të largët prej zhdukjes në ekzistencë e cila është "Liria absolute prej hapësirës"; që ka cilësinë më të shëndoshë prej cilësive të ekzistencës dhe më të shenjtën e tyre, më të largëtën prej ndryshimit dhe mosekzistencës, që është Uniteti.

Unë them: gjëja më e çuditshme për njeriun, që e shqetëson dhe që i tërheq vëmendjen është: t'ua atribuosh parapërjetësinë dhe amshueshmërinë, të cilat janë cilësitë më të domosdoshme, më esenciale dhe të veçanta për Të, gjërave si eteri dhe grimcave, të cilat janë lëndë materiale dhe që kanë nivelin më të dobët prej niveleve të ekzistencës dhe shkallën më të hollë në të, më të ndryshueshmen dhe më të transferueshmen e gjendjeve dhe më të shpërndarat nëpër hapësirë dhe që kanë shumësi të pakufishme; ata ua përshkruajnë parapërjetësinë atyre dhe i imagjinojnë ato të jenë të parapërjetshme; madje disa prej tyre supozojnë se një pjesë prej veprave Hyjnore burojnë prej tyre.

Është demonstruar nëpërmjet argumenteve të pakundërshtueshme në vende të shumta në Risale-i Nur se sa në kundërshtim me të vërtetën dhe realitetin, dhe sa ide e paarsyeshme dhe absurde është kjo.

■ Rrezja e Dytë

Kjo përbëhet nga dy "çështje".

***Çështja e Parë*:**

لَا تَأْخُذُهُ سِنَةٌ وَلَا نَوْمٌ ۚ مَا مِنْ دَآبَّةٍ إِلَّا هُوَ آخِذٌ بِنَاصِيَتِهَا ۚ لَهُ مَقَالِيدُ

السَّمٰوَاتِ وَالْأَرْضِ

"As kotje e as gjumë nuk e kap Atë".[31]

"Nuk ka asnjë krijesë të gjallë që Ai të mos e ketë mbërthyer pas balukeve të ballit (ta ketë nën sundimin e Tij të plotë)".[32]

"Të Tij janë çelësat e qiejve dhe të tokës",[33]

Këto vërsete tregojnë manifestimin më të madh të Emrit Hyjnor ***El-Kajjum*** *Vetekzistuesi i Përhershëm*.

Një aspekt i vetëm i asaj të vërtete madhështore që tregojnë këto dhe vërsete të ngjashëm me këto, është sa vijon:

Ekzistenca, vazhdimësia dhe qëndrueshmëria e trupave qiellorë në univers janë lidhur me misterin e *Vetekzistueshmërisë,* ***El-Kajjumijjeh***. Në qoftë se manifestimi i *Vetekzistueshmërisë* do të largonte a kthente fytyrën për një çast, atëherë, si rrjedhojë, me miliona globe disa prej tyre një mijë herë më të mëdhenj se sa globi tokësor do të shpërndaheshin nëpër zbrazëtirën e pakufishme të hapësirës, dhe duke u përplasur me njëri-tjetrin, do të binin në asgjësi.

Për shembull, fuqia e Vetekzistueshmërisë së të Vetmit i Cili i mban me mijëra pallate madhështorë në qiell me rregullsi të plotë dhe i bën ato të udhëtojnë si avionë nëpër hapësirë, matet nëpërmjet qëndrueshmërisë së atyre pallateve në hapësirë. Po ashtu, faktet që *i Gjithëlavdishmi i Vetëm* dhe *Vetekzistuesi i Përhershëm* u dhuron trupave të panumërt qiellorë brenda lëndës eterike një stabilitet, qëndrueshmëri dhe vazhdimësi brenda rregullit dhe balancimit më të skajshëm nëpërmjet misterit të *Vetekzistueshmërisë së përhershme,* ***El-Kajumijjeh***, dhe së bashku me mbajtjen pa mbështetëse e pa shtyllë në zbrazëtirë të miliona globeve madhështorë, disa prej tyre një mijë herë dhe disa të tjerë një milion herë më të mëdhenj se sa toka, duke i ngarkuar të gjithë ata me detyra të veçanta dhe duke i bërë ato të nënshtrohen me bindje të plotë si një ushtri madhështore e mirëdisiplinuar, duke iu bindur plotësisht urdhërave që lëshohen prej Atij që është Pronari i Urdhrit "***Kun, Fejekun***" *Bëhu dhe ajo është e bërë (në çast)!* Edhe këto janë një masë e manifestimit më të madh të

[31] Kur'an, 2:255
[32] Kur'an, 11:56
[33] Kur'an, 39:63

Emrit Hyjnor ***El-Kajjum*** *Vetekzistuesi i Përhershëm*. Në të njëjtën mënyrë, grimcat e të gjitha qënieve gjithashtu ekzistojnë, ashtu si yjet, nëpërmjet misterit të *Vetekzistueshmërisë së Përhershme*, dhe janë të qëndrueshme dhe vazhdojnë nëpërmjet Tij.

Grimcat në trupin e një qënieje të gjallë nuk shpërndahen por mblidhen në grupe e sisteme të veçanta për çdo gjymtyrë, dhe pa u shpërndarë, ruajnë pozitën e tyre brenda stuhive dhe valëve të elementeve që vërshojnë si rrëke dhe qëndrojnë të rregullta e në sistem. Meqenëse kjo në mënyrë të vetëkuptueshme nuk ndodh nga vetvetja e tyre por nëpërmjet misterit të *Vetekzistueshmërisë së Përhershme*, dhe meqenëse çdo trup është si një regjiment i mirorganizuar dhe secila specie si një ushtri e rregullt, këto grimca shpallin misterin e Vetekzistueshmërisë së Përhershme me gjuhë të panumërta, në të njëjtën mënyrë ashtu siç e shpallin atë vazhdimësia dhe lëvizja e të gjitha krijesave të gjalla dhe grumbullimi i tyre në tokë dhe ajo e yjeve në botën e Hapësirës.

Çështja e Dytë: Ky 'stacion' kërkon të tregohen disa nga dobitë dhe shembujt e urtësisë në gjërat që lidhen me misterin e *Vetekzistueshmërisë së Përjetshme*.

Urtësia në ekzistencën e të gjitha gjërave dhe qëllimet e natyrave të tyre, dobitë në krijimin e tyre dhe rezultatet e jetëve të tyre janë tre llojesh.

Lloji i Parë shikon tek vetja e çdo gjëje, tek njeriu dhe tek çështjet e njeriut.

Lloji i Dytë është më i rëndësishëm se sa i pari: ai është se, çdo gjë në ekzistencë është një shenjë madhështore, si një mesazh Hyjnor, si një libër, një poemë për qëniet e vetëdijshme për ta studiuar, një shenjë duke bërë të njohur manifestimin e Emrave të bukur të Krijuesit të Gjithëlavdishëm; domethënë çdo gjë shpreh kuptimet e saj të shumta për lexuesit e saj të cilët janë të panumërt.

Lloji i Tretë: Ky ka të bëjë me Krijuesin e Gjithëlavdishëm dhe orientohet e shikon tek Ai xh.sh... Ndërsa dobitë dhe rezultatet e gjithçkaje që shikojnë tek vetë gjërat janë një, ato që shikojnë tek Krijuesi i Gjithëlavdishëm janë me qindra dobi, sepse Krijuesi i Gjithëlavdishëm i shikon Vetë çudirat e artit të Tij, Ai e vështron

manifestimin e Emrave të Tij në qëniet të cilat Ai Vetë i ka modeluar e formuar. Për sa ka të bëjë me këtë llojin e tretë madhështor, vetëm një sekond do të ishte i mjaftueshëm për qëniet që të jetojnë.

Gjithashtu ndodhet një mister i *Vetekzistueshmërisë së Amshuar* duke kërkuar ekzistencën e të gjitha gjërave, që do të shpjegohet në *Rrezen e Tretë.*

Një ditë unë po shqyrtoja dobitë dhe urtësitë në qëniet nga këndvështrimi i zbulimit të *Talismanit të Universit* dhe *enigmën e krijimit*, dhe thashë:

"Jam kureshtar të di, pse këto gjëra e shfaqin vetveten në këtë mënyrë dhe pastaj zhduken e humbasin?

Unë vështroj tek tiparet e tyre individuale, dhe shoh se ato janë stolisur, hijeshuar e zbukuruar në mënyrën më të rregullt e të qëllimshme dhe u dërguan për tek kjo shfaqje dhe tek kjo ekspozitë. Por pastaj ato zhduken brenda një ose dy ditësh, dhe disa prej tyre brenda pak minutash; Më kot e pa dobi ato zhduken. Cili është qëllimi i qënies së tyre duke u parë prej nesh për kaq kohë të shkurtër? Unë isha shumë kureshtar për ta ditur këtë mister.

Pastaj, në atë kohë, nëpërmjet nderimit Hyjnor, unë zbulova një shembull të rëndësishëm të urtësisë së ardhjes së qënieve, dhe veçanërisht të gjallesave, në shkollën e tokës; urtësia është kjo: Çdo gjë -dhe sidomos qënia e gjallë- është një fjalë Hyjnore, një mesazh Hyjnor, një poemë Hyjnore dhe një njoftim i qartë me elokuencë dhe me urtësi të skajshme. Pasi ajo gjë të jetë shikuar e studiuar nga të gjitha qëniet e vetëdijshme dhe pasi të ketë dhënë të gjitha kuptimet e saj për lexues të panumërt, atëherë forma e saj trupore, e cila është si një letër ose si një fjalë, zhduket duke lënë kuptimet e saj në ekzistencë. Për afro një vit njohja e këtij shembulli urtësie ishte i mjaftueshëm për mua. Pastaj pasi kaloi viti u zbuluan para meje mrekullitë e holla të artit që gjenden në krijesa dhe në mënyrë të veçantë tek qëniet e gjalla. Unë kuptova se këto hollësi të artit që janë kaq të bukura e të çuditshme nuk janë thjesht për të shprehur kuptimet e tyre para shikimeve të qënieve të vetëdijshme, sepse megjithëse krijesa të vetëdijshme të panumërta mund ta studiojnë çdo qënie, veçse ama studimi i tyre është edhe i kufizuar dhe përveç kësaj të gjitha ato mund të jenë të paafta për të depërtuar tek të gjitha hollësitë e artit në

ato krijesa të gjalla. Domethënë, rezultati më i rëndësishëm i krijimit të qënieve të gjalla dhe qëllimi më kuptimplotë i natyrave të tyre është: Shfaqja e mrekullive të Artit të *Vetekzistuesit të Parapërjetshëm* ***El-Kajjumul-Ezelijj*** përpara shikimit të Tij xh.sh., dhe shfaqja e dhuratave të mëshirës së Tij dhe të mirësive të përgjithshme të Cilat Ai ua ka dhuruar qënieve të gjalla, përpara vështrimit të Tij xh.sh., ky qëllim më dha një qetësi të plotë dhe një bindje të plotë për një kohë të gjatë. Dhe prej tij kuptova sa vijon:

Ekzistenca e hollësive të pafundme të artit dhe të mrekullive të krijimit në çdo qënie -dhe veçanërisht tek qëniet e gjalla- është vetëm për t'u paraqitur përpara *Vetekzistuesit të Parapërjetshëm,* domethënë, urtësia e krijimit është që *Vetekzistuesi i Parapërjetshëm* ***El-Hajjul Ezelijj*** t'i shikojë Vetë mrekullitë e krijimit të Tij.. dhe ky shikim e meriton këtë bollëk e mbushulli madhështore në krijesat.

Por pasi kaloi një kohë.. unë pashë se hollësitë e artit në tiparet individuale dhe në format e qënieve nuk vazhdonin dhe nuk qëndronin; ato ripërtëriheshin dhe i nënshtroheshin ndryshimit me shpejtësi të madhe; ato transformoheshin brenda një aktiviteti dhe krijueshmërie të pafundme. Ndërkaq unë po e shqyrtoja thellë për pak kohë, duke thënë:

"Urtësia në këtë krijueshmëri dhe në këtë aktivitet duhet të jetë medoemos aq e shtrirë sa vetë aktiviteti". Atëherë dy shembujt e urtësisë që u përmendën lart filluan të shfaqeshin të mangëta.. dhe fillova të kërkoja e të hulumtoja me përmallim të fortë e me interesim të madh ndonjë urtësi tjetër apo ndonjë qëllim.. Pas pak kohe -lavdi Zotit- m'u shfaq një urtësi e madhe dhe e pakufishme dhe një qëllim madhështor i pafundmë, nëpërmjet shkëlqimit të dritës së Kuranit të shpjegimit të mrekullueshëm që buruan prej misterit të *Vetekzistueshmërisë së amshuar,* ***El-Kajjumijjeh***..

Nëpërmjet saj unë kuptova një mister të madh Hyjnor në krijimin, atë mister të quajtur Talismani i universit dhe enigma e krijimit! Meqenëse kjo është shpjeguar në detaje në letrën e Njëzet e Katërt, këtu në Rrezen e Tretë ne do të përmendim shkurt dy ose tri pika.

Po, shikoje nga ky këndvështrim manifestimin e misterit të *Vetekzistueshmërisë së amshuar*:

Allahu xh.sh. i ka nxjerrë qëniet prej errësirave të mosekzistencës dhe u ka dhënë ekzistencë; dhe sipas kuptimit të vërsetit,

اَللّٰهُ الَّذِیْ رَفَعَ السَّمٰوٰتِ بِغَیْرِ عَمَدٍ تَرَوْنَهَا *"Allahu është Ai i Cili ngriti qiejt pa shtylla që t'i shihni"*,[34]

Ai e ka bërë secilin prej tyre të mbetet në një hapësirë të pafundme. Duke u dhuruar atyre stabilitet e qëndrueshmëri, Ai kështu u ka shkaktuar të gjithë atyre të shfaqin manifestimin e misterit të *Vetekzistueshmërisë së amshuar* -***El-Kajjumijjeh***. Në qoftë se nuk do të kishte qenë kjo mbështetje madhështore dhe kjo bazë e fortifikuar për qëniet, asgjë fare nuk do të kishte mundur të vazhdonte së ekzistuari nga vetvetja. Gjithçka do të shembej në një zbrazëtirë të pafundme dhe do të rrëzohej e binte në mosekzistencë.

Për më tepër, ashtu si të gjitha qëniet që mbështeten tek *Vetekzistuesi i Parapërjetshëm* -***El-Kajjumul-Ezelij*** për ekzistencën e tyre, stabilitetin dhe qëndrueshmërinë, dhe vazhdojnë në ekzistencë nëpërmjet Tij, po ashtu sipas kuptimit të vërsetit,

وَاِلَیْهِ یُرْجَعُ الْاَمْرُ كُلُّهٗ *"Dhe tek Ai kthehen të gjitha çështjet (për gjykim e vendim)..."*[35] majat e mijëra zinxhirëve ose linjave në gjendjet dhe në kushtet e qënieve janë lidhur tek misteri i *Vetekzistueshmërisë së amshuar* -***El-Kajjumijjeh*** e cila -në qoftë se nuk do të kishte gabim në krahasim- është si qendra ose poli qëndror i linjave të telegrafit. Në qoftë se ato nuk do të mbështeteshin në atë pikë të ndritshme mbështetjeje, atëherë me mijëra vargje të pafundmë shkaqesh, do të ishin të domosdoshëm, gjë e cila sipas dijetarëve është një nocion krejtësisht i pamundur dhe i rremë; në fakt, duhet të kishte aq shumë prej këtyre vargjeve absurde të pafundme shkaqesh, aq sa numri i qënieve. Për shembull, një gjë -mbrojtja ose drita ose ekzistenca ose furnizimi me rizk e të tjera prej cilësdo qoftë- mbështetet -nga një drejtim- tek një gjë tjetër, kjo mbështetet tek një tjetër dhe kjo mbështetet tek një tjetër, e kështu me radhë.. atëherë patjetër duhet që të ketë një fund, sepse nuk pranohet me arsye që ajo të mos vijë në një fund. Kështu, fundi i të gjithë atyre linjave dhe zinxhirëve qëndron në

[34] Kur'an, 13: 2
[35] Kur'an, 11:123

misterin e *Vetekzistueshmërisë së amshuar* -***El-Kajjumijjeh*.** Dhe pasi u kuptua ky mister -misteri i *Vetekzistueshmërisë*- atëherë nuk mbetet kuptim që individët e atyre zinxhirëve të imagjinuar të mbështeteshin tek njëri-tjetri, madje ato zhduken krejtësisht; dhe çdo gjë shikohet të jetë e orientuar drejtpërdrejtë tek misteri i *Vetekzistueshmërisë* -***El-Kajjumijjeh***!

■ Rrezja e Tretë

Nëpërmjet një ose dy pikave paraprake, ne do të tregojmë në një shkallë të vogël zbulesën e misterit të *Vetekzistueshmërisë së Amshuar* brenda krijueshmërisë Hyjnore dhe aktivitetit Hyjnor për të cilat aludojnë vërsetet që vijojnë:

كُلَّ يَوْمٍ هُوَ فِي شَأْنٍ ۝ فَعَّالٌ لِّمَا يُرِيدُ ۝ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ ۝ بِيَدِهِ
مَلَكُوتُ كُلِّ شَيْءٍ ۝ فَانظُرْ إِلَىٰ آثَارِ رَحْمَتِ اللَّهِ كَيْفَ يُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا

"Çdo ditë Ai është i angazhuar në ndonjë çështje".[36]

"Gjithëvepruesi për gjithçka që Ai dëshiron".[37]

"Ai krijon çfarë do Ai"[38]

"Në Duart e të Cilit është mbizotërimi i çdo gjëje".[39]

"Shihni pra pasojat e Mëshirës së Allahut, se si Ai ringjall tokën pas vdekjes së saj..."[40]

E Para: Kur ne e vështrojmë universin me syrin e hulumtimit, ne shohim se një grup krijesash, të cilat janë hedhur në rrymën e kohës dhe vijojnë njëri pas tjetrit karvan pas karvani, vijnë për një sekond dhe pastaj menjëherë zhduken. Një grup tjetër vjen për një minut dhe pastaj kalon. Një specie ndalon në Botën e dukshme për një orë dhe pastaj

[36] Kur'an, 55:29
[37] Kur'an, 85:16
[38] Kur'an, 30:54
[39] Kur'an, 36:83
[40] Kur'an, 30:50

futet për në botën e padukshme. Disa prej tyre vijnë e ulen në botën e dukshme për një ditë, disa të tjerë për një vit, disa për një shekull dhe pastaj largohen dhe disa kalojnë disa shekuj dhe pastaj e lënë këtë botë.. Gjithësecili prej tyre vjen, dhe pasi të ketë kryer detyrat e veta, largohet.

Ky udhëtim i çuditshëm dhe ky kalim i qënieve, kjo rrymë dhe ky fluks i krijesave shtyhet e drejtohet me një rregullsi të tillë, me një balancë e urtësi, dhe Ai i Cili i komandon ato, ato karvane dhe këtë udhëtim të vazhdueshëm me një njohuri të tillë, me qëllim e planifikim saqë sikur të bashkoheshin të gjitha mendjet e të bëheshin një mendje, përsëri kjo do të ishte e pamundur që ta kapte e perceptonte këtë drejtim të urtë; ajo do të ishte e pamundur të gjente ndonjë të metë në të dhe kështu nuk do të mund ta kritikonte atë.

Kështu, brenda këtij aktiviteti Hyjnor, Krijuesi i shtyn ato krijesa plot art të hollë të dashura për Të -dhe veçanërisht gjallesat- për tek bota e padukshme pa ua shtyrë afatin që të zgjerohen në këtë botë. Ai i shkarkon ato nga misionet e tyre në jetën e tyre të dynjasë duke i lejuar të shtrihen e të marrin frymë. Ai vazhdimisht e mbush bujtinën e kësaj bote me mysafyrë dhe e boshatis prej tyre pa kënaqësinë e tyre. Duke e bërë globin tokësor si një pllakë dërrase shkrimi në të cilën shkruan vazhdimisht pena e Kaderit Hyjnor dhe e Vendimit të Tij shkrimet e Tij, i ripërtërin ato dhe i ndryshon nëpërmjet manifestimit të Atij يُحْيِي وَيُمِيتُ *"I Cili jep jetë dhe sjell vdekje".*[41]

Dhe kështu, një mister prej mistereve të këtij aktiviteti Hyjnor dhe të kësaj Krijueshmërie Hyjnore dhe një kërkesë themelore dhe një shkak shtytës për tek ato është një urtësi madhështore e pakufishme dhe e pafundme, dhe kjo urtësi mund të ndahet në tri degë të rëndësishme.

Dega e Parë e asaj urtësie është kjo: çdo lloj aktiviteti, qoftë i pjesshëm ose universal shkakton e sjell një kënaqësi, ose më drejtë, në çdo aktivitet ka një kënaqësi. Madje, vetë aktiviteti është një kënaqësi e pastër. Ose aktiviteti është manifestimi i esencës, i cili është vetëkënaqësia dhe ai është shkundja duke u larguar prej mosekzistencës, e cila është pikërisht dhimbja e vuajtja.

[41] Kur'an, 2:258

Gjithkush me aftësi ndjek me kënaqësi zbulimin e aftësisë së tij nëpërmjet aktivitetit. Zbulimi i talentëve të lindura nëpërmjet aktivitetit buron nga një kënaqësi dhe rezulton e shkakton kënaqësi. Gjithkush që ka disa plotësime, e ndjek me kënaqësi zbulimin e tyre nëpërmjet aktivitetit.

Meqenëse në çdo aktivitet janë të pranishme një plotësim e një kënaqësi të cilat janë kështu të dashura e të kërkuara; dhe meqenëse në botën e krijesave të gjalla janë të dukshme manifestimet e parapërjetshme të një mëshire të pakufishme dhe të një dashurie të pafundme të cilat burojnë nga një jetë e amshuar dhe e parapërjetshme; ato manifestime tregojnë se, si kërkesë e asaj jete të amshuar e cila është e përshtatshme për Ekzistuesin e Vetëm të domosdoshëm i Cili do kështu dhe është Gjithëmëshirues, e bën Vetveten të dashur dhe është i denjë për shenjtërinë e Tij, atëherë, ndodhen -në qoftë se do të lejoheshin termat- tek niveli më i skajshëm cilësi të shenjta në jetën e më të Pastërtit dhe më të Shenjtit si, pasioni Hyjnor, dashuria e shenjtëruar dhe kënaqësia e pastër, e lartësuar e sublime. Dhe janë pikërisht këto cilësi që në mënyrë të vazhdueshme e ripërtërijnë, e trazojnë dhe e ndryshojnë universin nëpërmjet aktivitetit të pafundmë dhe një krijueshmërie të pafundme.

Dega e Dytë e Urtësisë në aktivitetin e pafundmë Hyjnor i cili shikon tek misteri i Vetekzistueshmërisë së amshuar *El-Kajjumijjeh*. Kjo urtësi shikon tek Emrat Hyjnorë. Dihet qartë se gjithkush që ka bukuri, dëshiron edhe ta shohë atë, edhe t'ua shfaqë bukurinë e vet të tjerëve; Gjithkush që ka ndonjë mjeshtëri, dëshiron dhe pëlqen të tërheqë vëmendjen për tek mjeshtëritë dhe tek talenti i tij duke i ekspozuar dhe duke i shpallur ato; ai e dëshiron dhe do që talenti i tij, që është një e vërtetë e bukur dhe një kuptim i bukur që kanë mbetur të mbuluara e të fshehura, të zbulohet dhe të gjejë admirues të zjarrtë.

Këto rregulla themelore janë në fuqi në të gjitha gjërat në përputhje me shkallën e secilës. Sipas dëshmisë së universit dhe dëshmisë së manifestimeve dhe qëndisjeve të Një mijë e Një Emrave të bukur Hyjnorë të Hirplotit absolut dhe të Vetekzistuesit të Gjithëlavdishëm, ndodhen në çdo shkallë të secilit prej atyre Emrave të bukur një dashuri e vërtetë, një plotësi e vërtetë, një bukuri e vërtetë dhe një e vërtetë e bukur e ndritshme; Madje në çdo shkallë prej shkallëve të çdo Emri

prej Emrave të bukur Hyjnorë, ndodhen lloje të ndryshme të pafundme dashurie dhe të vërteta të bukura të panumërta.

Meqenëse ky univers dhe të gjitha këto qënie janë pasqyra për të reflektuar manifestimet e bukurisë së këtyre Emrave të shenjtë.. dhe janë tablo të mrekullueshme në të cilat shfaqen qëndisjet e atyre Emrave të bukur.. dhe ato janë faqet e tyre që shprehin të vërtetat e tyre të bukura.

Atëherë medoemos, ato Emra të vazhdueshëm e të përjetshëm do t'i shfaqin manifestimet e tyre të pakufishme dhe do t'i ekspozojnë qëndisjet e tyre të urta të panumërta dhe do t'i shfaqin fletët e librave të tyre para shikimit dëshmues të të Vetekzistuesit të Gjithëlavdishëm, dhe para shikimit hulumtues të numrave të pallogaritshëm të krijesave të vetëdijshme dhe krijesave të pajisura me shpirt, me qëllim që të shfaqin tablotë e pafundme prej një gjëje të kufizuar, dhe individë të panumërt nga një individ i vetëm dhe të shfaqin të vërteta të shumta prej një të vërtete të vetme.

■ Rrezja e Katërt

Dega e Tretë e Urtësisë në aktivitetin e vazhdueshëm e të çuditshëm në univers. Gjithkush që është i mëshirshëm gëzohet duke u dhënë kënaqësi të tjerëve; gjithkush që është i mirë kënaqet duke i bërë të tjerët të lumtur; gjithkush që është i dashur gëzohet duke i kënaqur të tjerët të cilët janë të denjë për t'u kënaqur; dhe gjithkush që është zemërmirë e fisnik gjen kënaqësi duke i bërë të tjerët të kënaqur; gjithkush që është i drejtë gëzohet me vendosjen e drejtësisë duke fituar mirënjohjen e atyre, të drejtat e të cilëve janë mbrojtur duke u dhënë ndëshkim atyre që e meritojnë; dhe çdo mjeshtër i talentuar krenohet duke ekspozuar veprat e tij, kur shpikjet e tij funksionojnë e japin rezultat në formën më të mirë ashtu siç kishte përfytyruar ai të funksiononin, dhe që ato po jepnin rezultatet e dëshiruara.

Kështu, secili nga parimet e lartëpërmendur është një rregull themelor që është në fuqi gjithandej universit dhe në botën e njerëzimit. Tre shembuj duke demonstruar se këto rregulla funksionojnë në manifestimet e Emrave Hyjnorë janë shpjeguar në Vendqëndrimin e

Tretë të Fjalës së Tridhjetë e Dytë. Meqenëse është e përshtatshme të shkruash një përmbledhje për to në këtë pikë, ne themi sa vijon:

Për shembull, një person i cili është jashtë mase i mirë, bujar, dorëgjërë e zemërmirë i cili ka marrë në një anije të madhe nevojtarë e të varfër, i kënaq ata duke përgatitur për ta tryeza të mbushura me mirësi, me të cilët lundron nëpër detet rreth tokës me qëllim që të fusë gëzimin e kënaqësinë brenda një udhëtimi të këndshëm dhe një shëtitjeje të bukur e të hollë. Ky person kënaqet nga shenjat e mirënjohjes që burojnë prej atyre të varfërve dhe gëzohet shumë kur shikon kënaqësinë e tyre duke gëzuar bukuritë e mirësive, dhe krenohet me gëzimin e tyre.. E gjitha kjo ndodh me kërkesë të veçorive dhe të cilësive të larta të cilat Allahu i ka vendosur në natyrën e tij.

Në qoftë se njeriu që është thjesht një nëpunës shpërndarje i mirësive të Krijuesit Gjithëbujar merr një gëzim e një kënaqësi të tillë me këtë sasi nderimi që u bën të tjerëve në një gosti të pjesshme, atëherë, po kur bëhet fjalë për *Të Gjallin e Përjetshëm* dhe *Vetekzistuesin e amshuar* ***El-Hajj El-Kajjum*** i Cili i ka ngarkuar të gjitha kafshët, njerëzit, engjëjt e panumërt, xhindet dhe qëniet shpirtërore në anijen e të Gjithëmëshirshmit, -në anijen e tokës; i Cili e ka përhapur faqen e tokës para tyre si një tryezë Hyjnore të mbushur me varietete ushqimesh dhe me kënaqësi e furnizime për të gjitha shqisat; Ai i bën ata nevojtarë dhe ata të varfër krijesa falënderuese, mirënjohëse dhe të gëzuar duke lundruar nëpër zonat e universit, dhe nuk i gëzon ata me të gjitha këto mirësi vetëm në këtë botë, por gjithashtu Ai e bën secilën prej atyre mirësive një tryezë në banketet e pafundme në xhennetet e botës së përjetshme. Prandaj, kuptimi i Hyjnisë i synuar nga cilësitë Hyjnore që burojnë nga falënderimet, mirënjohja, gëzimi dhe nga kënaqësia e atyre krijesave të cilat shikojnë dhe janë orientuar tek *i Gjalli i Përjetshëm* dhe tek *Vetekzistuesi i Amshuar* ***El-Hajj, El-Kajjum***, për të cilat ne jemi të pafuqishëm dhe gjithashtu nuk na lejohet që t'i shprehim, si: *Kënaqësia e Shenjtë, Krenaria e Shenjtë* dhe *Gëzimi i Shenjtë* bëjnë të domosdoshëm këtë aktivitet të vazhdueshëm dhe krijueshmërinë e pandërprerë.

Dhe për shembull, në qoftë se një mjeshtër i aftë ndërton apo prodhon një gramafon i cili nuk kërkon pllaka, disqe, dhe ai luan e punon ashtu siç ai dëshironte, sa krenar e i lumtur do të ishte ai; dhe do

të thonte me vete: ***Ma sha'all-llah***! *Çfarë çudirash ka dashur Zoti xh.sh.!*

Në qoftë se një pjesë e vogël formale arti në të cilën nuk ka krijim të vërtetë shkakton një ndjenjë të tillë krenarie dhe kënaqësie në shpirtin e mjeshtrit të aftë, atëherë, po kur merret në konsideratë kjo që vijon:

Krijuesi i Gjithurtë i Cili i krijoi të gjitha këto qënie dhe i bëri ato si një orkestër Hyjnore duke shprehur falënderimet e tyre, tesbihatet, lavdërimet dhe shenjtërimet e tyre nëpërmjet llojeve të panumërta të këngëve dhe himneve, ashtu siç i bëri ato një punishte të çuditshme; Ai i shfaq të gjitha speciet, të gjitha botët në univers nëpërmjet një mjeshtërie të veçantë dhe nëpërmjet mrekullive të ndryshme arti, dhe Ai jo vetëm modelon shumë makineri, aparatura, në kokat e krijesave të gjalla, secila prej tyre duke qenë si një gramafon, kamer ose telegraf, por Ai gjithashtu modelon në kokat e të gjitha qënieve humane, jo vetëm një gramafon pa pllaka, një kamer pa film, një telegraf për tela, por një makineri njëzet herë më të mrekullueshme. Prandaj, kuptimet si Krenari e shenjtë, kënaqësi e shenjtë dhe cilësi e kuptime të larta të këtij lloji që burojnë nga Hyjnia dhe vijnë prej krijimit të makinerive të tilla, dhe funksionimi i tyre në mënyrën e kërkuar dhe dhënia e rezultateve të dëshiruara -këto të gjitha- bëjnë të domosdoshëm këtë aktivitet të dukshëm të pandërprerë.

Dhe për shembull, ashtu si një sundimtar i drejtë i cili gjen kënaqësi e ëndje, që është i kënaqur dhe ndjehet krenar kur merr pjesën e të shtypurit kundra tiranëve me qëllim që të vendosë drejtësinë, dhe duke mbrojtur të varfërit kundra padrejtësisë dhe shtypjes së të fuqishmëve, dhe duke i dhënë gjithësecilit të drejtën që i takon.. meqë të gjitha këto kërkohen prej sundimit dhe drejtësisë dhe janë rregullat e tyre themelore, atëherë shqyrto ç'ka vijon:

I Gjalli i Përjetshëm dhe *Vetekzistuesi i Amshuar*, i Cili është Sundimtari i Gjithurtë dhe i Drejti absolut, u dhuron të gjitha krijesave dhe veçanërisht gjallesave kushtet e domosdoshme për jetën, të cilat njihen si *të drejtat e jetës;* dhe me qëllim që të ruajnë jetët e tyre, Ai u jep atyre aftësitë dhe gjymtyrët e domosdoshme; dhe Ai me dhembshuri e mëshirë mbron të dobëtit nga të këqijat e të fuqishmive. Prandaj, cilësitë Hyjnore dhe kuptimet e shenjta, për të cilat ne jemi të

pafuqishëm për t'i shprehur, që burojnë nga kjo dhe nga përmbledhja e misterit të drejtësisë, që në këtë botë, është e plotë lidhur me vendosjen e drejtësisë për të gjitha qëniet e gjalla dhe pjesërisht lidhur me ndëshkimin e keqbërësve, dhe sidomos ajo që buron nga misteri i drejtësisë më të lartë tek Gjykata më e lartë e Ditës së Ringjalljes.. të gjitha këto e kërkojnë medoemos këtë aktivitet të vazhdueshëm në univers.

Atëherë, ashtu siç tregojnë këto tri shembuj, meqenëse secili prej Emrave më të bukur Hyjnorë është një bosht për disa cilësi të shenjta Hyjnore në këtë aktivitet të pandërprerë dhe, meqenëse zhvillimi, zbulimi dhe lulëzimi i të gjitha aftësive dhe kapaciteteve shkaktojnë gëzim, shtrirje e kënaqësi; dhe meqenëse me kryerjen dhe plotësimin e një detyre dhe duke u liruar prej saj, gjithësecili, të cilit iu ngarkua një detyrë e tillë, përjeton një ndjenjë të madhe qetësie dhe mirënjohjeje; dhe meqenëse për të marrë shumë fruta nga një farë e vetme dhe për të siguruar një fitim të njëqindfisht prej një gjëje të vetme, të fitosh njëqind dirhem prej një dirhemi të vetëm, gjë e cila është rasti më i kënaqshëm për njerëzit dhe konsiderohet një tregti shumë fitimprurëse për ta.. atëherë sigurisht, Ai i Cili i bën të gjitha aftësitë e panumërta të të gjitha krijesave të zbulohen, pasi i ka vënë të gjitha krijesat në detyra të vlefshme, do t'i shkarkojë nga ato detyra, por me këtë lirim Ai do t'i ngrejë ato në shkallë më të larta e sublime - ashtu siç i ngre elemetet tek niveli i mineraleve; mineralet tek niveli i bimëve; bimët tek niveli i jetës shtazore nëpërmjet rizkut, furnizimit me ushqim; dhe kafshët tek niveli i lartë i jetës humane, i jetës së njeriut, jetë e cila është e vetëdijshme.

Atëherë mund të kuptohet se sa të rëndësishme janë kuptimet e shenjta dhe çështjet Hyjnore të Perëndisë që burojnë nga aktiviteti i vazhdueshëm dhe nga krijueshmëria Hyjnore, që me mbarimin e ekzistencave të tyre të jashtme, u shkakton të gjitha krijesave të gjalla të lënë prapa tyre ekzistencat e shumta të marra prej tyre, esencat, identitetet, format dhe ekzistencat në botën e shëmbëllesës, në botën e Njohjes dhe në botën e padukshme, këllëfet e shpirtërave të tyre dhe trupat qiellorë, që të gjithë ato janë ngarkuar me detyra në vendet e tyre. Kjo është shpjeguar në Letrën e Njëzet e Katërt.

Një Përgjigje vendimtare për një pyetje të rëndësishme.

Një grup prej njerëzve të çudhëzimit thotë se Ai i Cili e ndryshon dhe e transformon universin me këtë aktivitet të vazhdueshëm duhet që Ai Vetë t'i nënshtrohet ndryshimit dhe ndërrimit.

Përgjigjja: Ruajna Zot! Një mijë herë, Ruajna Zot! Fakti që pasqyrat në tokë ndryshojnë, nuk demonstron se dielli në qiell ndryshon, por përkundrazi, ai demonstron se manifestimet e tij janë duke u ripërtërirë. Për më tepër, ndryshimi dhe ndërrimi janë krejtësisht të pamundura për Esencën më të pastër e më të shenjtë, i Cili është i parapërjetshëm, i paspërjetshëm, i përhershëm, në çdo drejtim i plotë absolutisht, i vetëmjaftueshëm absolutisht; tërësisht i lirë, i shkëputur dhe përtej lëndës, hapësirës, kufizimit dhe mundësisë. Ndryshimi në univers nuk tregon ndryshimin e Tij, por tregon mosndryshimin dhe mostransformimin e Tij xh.sh.; sepse Ai që në mënyrë të vazhdueshme shkakton ndryshim dhe u shkakton gjërave të shumta të lëvizin, duhet që Ai vetë të jetë i pandryshueshëm dhe të mos lëvizë.

Për shembull, në qoftë se ti do të lëvizje globe të mëdhenj dhe topa të vegjël që janë të lidhur me disa fije spangoje, duke i bërë ato të lëvizin pandërprerë brenda një rregulli, dhe duke i vënë ato në pozicione të mirorganizuar, do të ishte e domosdoshme që ti të qëndroje në një vend dhe jo ta ndryshosh atë apo ta lëvizësh; sepse në qoftë se ti do të lëvizje, kjo do ta prishte rregullin.

Midis rregullave të mirënjohur është rregulli vijues:

"Ai që i bën objektet të lëvizin me rregull, duhet që Ai Vetë të mos lëvizë; dhe Ai që i ndryshon gjërat në mënyrë të vazhdueshme, duhet që Vetë të jetë i pandryshueshëm me qëllim që këto akte të mund të vazhdojnë në një mënyrë të rregullt.

Së Dyti: Ndryshimi dhe ndërrimi burojnë nga Krijueshmëria, nga të qenurit i ripërtërirë me qëllim për t'u plotësuar; nga nevoja, nga lëndësia, materia, dhe nga mundësia. Mirëpo, meqenëse esenca më e pastër dhe më e shenjtë është e Parapërjetshme dhe e Paspërjetshme, dhe në çdo drejtim është absolutisht i plotë, absolutisht i Vetëmjaftueshëm dhe krejtësisht i shkëputur nga lënda dhe është Ekzistuesi i Vetëm i domosdoshëm; atëherë sigurisht ndryshimi dhe ndërrimi është i pamundur për Të; është absolutisht i pamundur.

■ Rrezja e Pestë

Çështja e Parë:

Në qoftë se ne do të dëshironim të shihnim manifestimin më të madh të Emrit Hyjnor ***El-Kajjum***, *Vetekzistuesi i amshuar*, ne do të duhej ta bënim imagjinatën tonë shumë të shtrirë me qëllim që ajo të mund ta shohë të gjithë universin, dhe do të duhej të bënim prej saj dy teleskopë që njëri prej tyre të shikonte distancat më të largëta, objektet më të skajshme, kurse tjetri të shikonte grimcat më të vockëla.

Kështu në qoftë se do të vështronim nëpërmjet teleskopit të parë, ne do të shihnim se, nëpërmjet manifestimit të Emrit Hyjnor ***El-Kajjum***, *Vetekzistuesi i amshuar* dhe pa ndonjë shtyllë mbështetëse me miliona globe e yje mijëra herë më të mëdhenj se sa toka, disa janë bërë të palëvizshëm në dukje në lëndën e njohur si eter, i cili është më i hollë se sa ajri, ndërsa të tjerët janë bërë të udhëtojnë në dukje për të përmbushur detyrat e tyre të mëdha.

Tani le të vështrojmë nëpërmjet teleskopit të dytë, i cili është mikroskopi i imagjinatës, me qëllim që të mund të shikojmë grimcat e vockëla. Nëpërmjet misterit të *Vetekzistueshmërisë së amshuar* ***El-Kajjumijjeh***, duke marrë një pozitë të rregullt ashtu si yjet, grimcat në trupat e të gjitha krijesave të gjalla në tokë janë në lëvizje dhe janë duke kryer detyrat e tyre. Ne shohim se kokërrzimet e vockëla duke formuar grimcat e njohura si rruazat e kuqe dhe rruazat e bardha në gjakun e qënieve të gjalla, ashtu si planetet, lëvizin me dy lëvizje të mirësistemuara që u ngjasojnë lëvizjeve të dervishëve mevlevi.

Një Përmbledhje[42]

Një përmbledhje është e përshtatshme këtu me qëllim që të shpjegojë dritën e shenjtë të cilën e formojnë Gjashtë Emrat e Emrit më të madh, të përzier së bashku si shtatë ngjyrat e dritës së Diellit - dhe

[42] Kjo është një përmbledhje shumë e shkurtër e Gjashtë Emrave Hyjnorë të cilët mbajnë Emrin më të madh dhe janë baza dhe subjekti i Gjashtë pjesëve kryesore të Shkreptimës së Tridhjetë.

Allahut i takon krahasimi më i lartë. Dhe me qëllim që ta shikojmë këtë dritë po japim këtë përmbledhje:

Hidhe vështrimin përtej manifestimit të Emrit më të madh ***El-Kajjum,*** *Vetekzistuesi i amshuar,* i Cili i mban kështu dhe u jep qëndrueshmëri e vazhdimësi të gjitha qënieve në univers, që të shohësh: se manifestimi më i madh i Emrit ***El-Hajj*** *i Gjalli i Përjetshëm,* i ka bërë ato qënie të gjalla të ndritshme e rrezatuese nëpërmjet manifestimit të Tij vezullues. Ai e ka ndriçuar universin. Ai i ka zbukuruar të gjitha qëniet e gjalla me manifestimin e Tij.

Tani, shiko përsëri: Përtej Emrit Hyjnor ***El-Hajj***,*I Gjalli i Përjetshëm,* manifestimi më i madh i Emrit ***El-Ferd***, *I Vetmi*, i përfshin tërësinë e universit me të gjitha elementet dhe pjesët e tij në një unitet. Ai vendos një stampë uniteti në ballin e çdo gjëje. Ai vendos një vulë Njësie në fytyrën e çdo qënie. Kjo i bën ato të shfaqin manifestimin e Tij me gjuhë të pafundme e të panumërta.

Dhe tani shikoje manifestimin më të madh të Emrit ***El-Hakem***, *I Dituri* përtej Emrit ***El-Ferd***, *I Vetmi*; ai i përfshin secilën prej qënieve që ne i vëzhgojmë nëpërmjet dy teleskopëve të imagjinatës, duke filluar nga yjet për tek grimcat, qoftë universale ose e pjesshme, nga sfera më e madhe për tek më e vogla, në një rregull të frytshëm, në një rregullsi të urtë dhe në një harmoni të qëllimshme të përshtatshme për secilën. Ai i stolis dhe i zbukuron të gjitha qëniet. Pastaj, vështro matanë manifestimit më të madh të Emrit ***El-Hakem***, *I Dituri* tek manifestimi më i madh i Emrit ***El-Adl***, *I Drejti* -ashtu siç e shpjeguam në Pikën e dytë- që ta shohësh atë duke administruar të gjithë universin me të gjitha qëniet e tij me një balancë të tillë, me një ekuilibër e një masë brenda një aktiviteti të pandërprerë, saqë në qoftë se vetëm njëri prej trupave qiellorë do ta humbiste balancën e tij sikur vetëm për një sekond, domethënë, në qoftë se do të çlirohej prej manifestimit të Emrit ***El-Adl***, *I Drejti*, kjo do të shkaktonte kaos midis yjeve dhe padyshim do të çonte në ndodhjen e kijametit.

Kështu, të gjitha qëniet dhe të gjitha botët e ndryshme të qënieve duke filluar prej ushtrisë së yjeve për tek ushtria e grimcave të vockëla, domethënë, nga sfera më e madhe që quhet Rruga e Qumështit për tek sfera e lëvizjes së qelizave, rruazave të kuqe e të bardha, duke qëndruar sup më sup në një mënyrë të matur me balancën më të hollë dhe me

masën më të drejtë, secila prej tyre demonstron se të gjitha ato qënie janë të bindura dhe të nënshtruara plotësisht ndaj urdhërave që burojnë prej Atij që është Pronari i urdhrit ***Kun Fejekun,*** *Bëhu, dhe ajo është bërë (në çast)"!*

Tani, hidhe vështrimin matanë manifestimit më të madh të Emrit ***El-Adl,*** *I Drejti* tek manifestimi më i madh i Emrit Hyjnor ***El-Kud-dus***, *Më i Shenjti*, i cili është shpjeguar në Pikën e Parë: fakti se ai i ka bërë të gjitha qëniet në univers aq të pastërta, safi, të kulluara, të dëlira, të lara, të bukura, të stolisura dhe të ndritshme, demonstron se Ai u ka dhuruar universit dhe të gjitha qënieve formën e pasqyrave të bukura të denja dhe të përshtatshme për të reflektuar bukurinë krejtësisht esenciale të Hirplotit Absolut dhe hijeshinë e pashoqe të Emrave më të Bukur Hyjnorë.

Shkurtazi: Këto Gjashtë Emra dhe Gjashtë drita të Emrit më të madh kanë mbështjellur, mbuluar e përfshirë universin dhe të gjitha qëniet me ngjyra gjithnjë të ndryshme e të larmishme dhe me qëndisje e stolisje.

Çështja e Dytë e Rrezes së Pestë:

Ashtu si manifestimi *i* Vetekzistueshmërisë së amshuar në univers që është tek niveli i Unitetit dhe i Madhështisë, po ashtu ai manifestim është tek njeriu, i cili është qendra, boshti dhe fruti i vetëdijshëm i universit tek niveli i Njësisë dhe i Bukurisë.

Domethënë, ashtu si universi që ekziston nëpërmjet misterit të *Vetekzistueshmërisë së amshuar*, ***El-Kajjumijjeh***, po ashtu ai ekziston -nga një drejtim- nëpërmjet njeriut, i cili është vendi më i plotë i manifestimit të Emrit ***El-Kajjum***, *Vetekzistuesi i amshuar*, sepse meqenëse shumica e urtësive, synimeve, qëllimeve dhe dobive të dukshme në univers orientohen e shikojnë tek njeriu, është sikur manifestimi i *Vetekzistueshmërisë* tek ai të ishte një mbështetje për universin. Po, mund të thuhet se, *I gjalli i Përjetshëm* dhe *Vetekzistuesi i amshuar* e deshi ekzistencën e njeriut në këtë univers dhe e krijoi universin për hir të tij; sepse me gjithëpërfshirjen e natyrës së tij; njeriu mund të kuptojë e të marrë kënaqësi në të gjithë Emrat e bukur Hyjnorë. Në mënyrë të veçantë, ai mund të kuptojë shumë Emra Hyjnorë nëpërmjet kënaqësisë që gjendet në rizk, në furnizimin me

ushqime. Kurse melekët, engjëjt, nuk mund t'i njohin ato nëpërmjet asaj kënaqësie.

Si rrjedhojë e kësaj gjithëpërfshirjeje të rëndësishme të njeriut, *i Gjalli i Përjetshëm dhe Vetekzistuesi i Amshuar* ***El-Hajj, El-Kajjum*** i ka dhënë njeriut një stomak dhe një oreks nëpërmjet të cilit Ai e lejon atë të kuptojë të gjithë Emrat Hyjnorë dhe për të shijuar të gjitha varietetet e mirësive të Tij, dhe Ai me bujari ka shtruar tryezën e gjërë sa toka me shumëllojshmëri të pafundme ushqimesh për stomakun e njeriut. Pastaj Ai i dha njeriut jetë dhe e bëri këtë jetë si ai stomak fizik; dhe përpara shqisave, të cilat janë si duart e stomakut të jetës, Ai ka shpërndarë sofrën më të madhe të mirësive. Nëpërmjet shqiseve të saj, jeta jep falënderime e lavdërime për çdo lloj dobie e mirësie që janë mbi tryezën e mirësive.

Dhe pas stomakut të jetës, Ai i ka dhuruar njeriut stomakun e humanizmit, i cili kërkon ushqim e mirësi në një sferë më të gjërë se sa jeta. Ai i bëri mendjen, mendimin dhe imagjinatën, si duart e këtij stomaku, të përfitojnë prej tryezës së Mëshirës, e cila është aq e gjërë sa qiejt dhe toka, dhe jep falënderime e lavdërime përpara Krijuesit të Vet.

Dhe pas stomakut të humanizmit, Ai ka shpërndarë para njeriut një tryezë tjetër mirësish e cila është pafundësisht e gjërë. Ai i ka bërë besimet e islamit dhe të imanit si një stomak jolëndor duke kërkuar shumë ushqim dhe e ka shtrirë tryezën e tij jashtë sferës së mundësisë dhe ka përfshirë në të Emrat Hyjnorë. Kështu, nëpërmjet këtij stomaku dhe kënaqësisë më të madhe të ushqimit, njeriu kupton e ndjen manifestimet e Emrave Hyjnorë ***Er-Rahman*** dhe ***El-Hakim*** *I Gjithëmëshirshmi, i Gjithurti* dhe në mënyrë të përsëritur thotë:

"I Gjithë lavdërimi i takon Allahut për mëshirën e Tij të gjërë dhe për urtësinë e Tij madhështore!".. Dhe kështu, njeriu është në gjendje të përfitojë prej mirësive të pakufishme Hyjnore nëpërmjet këtij stomaku të madh jolëndor. Dhe ndodhet një sferë tjetër në këtë stomak, e cila është kënaqësia e dashurisë Hyjnore...

Kështu, *i Gjalli i Përjetshëm* dhe *Vetekzistuesi i amshuar* ***El-Hajj, El-Kajjum***, e ka bërë njeriun një qendër dhe një bosht për universin; Ai ka shpërndarë përpara tij një tryezë mirësish aq të gjërë sa universi, dhe

ia ka nënshtruar universin atij me qëllim që të shijojë llojet lëndore dhe jolëndore të stomakut të tij.

Arsyeja për këtë dhe për universin, nga një drejtim, duke u mbajtur e qëndruar nëpërmjet misterit të Vetekzistueshmërisë së amshuar e manifestuar nëpërmjet njeriut janë për shkak të tre detyrave të rëndësishme:

Detyra e Tij e Parë

Të gjitha varietetet e mirësive të shpërndara gjithandej universit janë vënë në rregull nëpërmjet njeriut, dhe janë lidhur me hallkat e dobive të cilat i përkasin njeriut, ashtu siç vihen në rregull tesbihet e faljes nëpërmjet spangos, dhe lidhen majet e spangove të mirësive nëpërmjet njeriut, dobive dhe përfitimeve të tij, dhe bëhet njeriu i ngjashëm me një indeks për të gjitha llojet e thesareve të mëshirës Hyjnore dhe si një model për përmbajtjen e tyre.

Detyra e Tij e Dytë

Nëpërmjet gjithëpërfshirjes së tij, kjo është për njeriun të jetë marrësi më i plotë i adresimit të *të Gjallit të Përjetshëm* dhe *Vetekzistuesit të amshuar*, ***El-Hajj, El-Kajjum***; nëpërmjet vlerësimit e admirimit të arteve të Tij të çuditshme, të jetë lajmëtari i Tij më i lartë; dhe nëpërmjet dhënies së çdo lloji prej falënderimeve të vetëdijshme, të japë lavdërime, lartësime e falënderime për të gjitha shumëllojshmëritë e mirësive të Tij dhe për varietetet e ndryshme të pakufishme të dhuratave të Tij.

Detyra e Tij e Tretë

Nëpërmjet jetës së tij, ai duhet të veprojë si një pasqyrë për *Të Gjallin e përjetshëm* dhe *Vetekzistuesin e amshuar* ***El-Hajj, El-Kajjum*** dhe për të gjitha cilësitë dhe atributet e gjithanshme në tre aspekte:

Aspekti i Parë: Kjo është që njeriu të kapë e të ndjejë nëpërmjet pafuqisë së tij absolute fuqinë absolute të Krijuesit të Tij dhe nivelet e asaj fuqie absolute, dhe nëpërmjet shkallëve të pafuqisë së tij të kapë e kuptojë shkallët e fuqisë së Krijuesit. Është të kuptojë, nëpërmjet varfërisë së tij absolute, mëshirën e Krijuesit dhe shkallët e mëshirës së Tij, dhe nëpërmjet dobësisë së tij të kuptojë fuqinë madhështore të

Krijuesit xh.sh... e kështu me rradhë. Nëpërmjet cilësive të tij të mangëta e të pjesshme të jetë një pasqyrë e cila është si një instrument matës për atributet e plotësimit të Krijuesit të tij. Në të njëjtën mënyrë siç është errësira e natës një pasqyrë e plotë për të shfaqur dritën elektrike, shkëlqimin e dritës duke qenë në raport me errësirën e natës, edhe njeriu vepron si një pasqyrë për plotësimet Hyjnore nëpërmjet cilësive të tij të mangëta e të pjesshme.

***Aspekti i Dytë**:* Duke përdorur universin si një masë jardi dhe nëpërmjet dëshirës së vogël, pronësisë në pamje të jashtme, dhe nëpërmjet ndërtimit të shtëpisë së vet, njeriu mund të kuptojë e të veprojë si një pasqyrë për pronësinë, artin, dëshirën dhe për njohjen e Formëdhënësit të universit.

Aspekti i Tretë: Veprimi i njeriut si një pasqyrë në këtë drejtim ka dy fytyra:

E Para: është të shfaqë në vetveten qëndisjet gjithnjë të ndryshme të Emrave të Bukur Hyjnorë. Për ta shprehur më thjeshtë, nëpërmjet gjithëpërfshirjes së tij, njeriu është si një indeks i vogël dhe një model i zvogëluar i universit dhe kështu shfaq manifestimet dhe qëndisjet e të gjithë Emrave të bukur Hyjnorë.

Fytyra e Dytë: Kjo fytyrë vepron si një pasqyrë për Atributet Hyjnore. Domethënë, ashtu siç e tregon njeriu jetën e *të Gjallit të Përjetshëm dhe të Vetekzistuesit të amshuar* ***El-Hajj, El-Kajjum*** nëpërmjet jetës së tij, po kështu ai vepron si një pasqyrë dhe i bën të njohur atributet e të *Gjallit të Përjetshëm* dhe *Vetekzistuesit të amshuar* të tilla si dëgjimi e shikimi, nëpërmjet shqisës së tij të të dëgjuarit dhe shqisës së të parit që zhvillohen gjatë jetës së tij.

Për më tepër, njeriu vepron si një pasqyrë për atributet e shenjta të të *Gjallit të Përjetshëm* dhe *Vetekzistuesit të amshuar* ***El-Hajj El-Kajjum*** nëpërmjet pikërisht shqiseve të shumta dhe përgjigjëse, kuptimeve dhe emocioneve që janë të pranishme me jetën e tij, të cilat mund të mos zhvillohen brenda jetës së tij - por ziejnë në formën e ndjenjave dhe të emocioneve. Për shembull, si rezultat i emocioneve të tilla, nëpërmjet kuptimeve si; dashuria, ndjenja e krenarisë, e kënaqësisë, e gëzimit dhe e lumturisë, ai vepron si një pasqyrë për atributet e atij lloji, me kusht që ato të jenë të përshtatshme e të denja

për shenjtërinë dhe për vetëmjaftueshmërinë absolute të Esencës më të pastër e më të shenjtë.

Gjithashtu, nëpërmjet jetës së tij gjithëpërfshirëse, njeriu është një instrument i cili i njeh, i mat atributet madhështore të Krijuesit dhe aktet e Tij të urta, dhe është një indeks për manifestimin e Emrave të bukur Hyjnorë dhe është një pasqyrë e vetëdijshme dhe, kështu me radhë, ai vepron si një pasqyrë për të *Gjallin e Përjetshëm* dhe *Vetekzistuesin e amshuar* ***El-Hajj, El-Kajjum*** në shumë drejtime. Gjithashtu njeriu është një njësi matje, një indeks, një peshore dhe një balancë për të vërtetat e universit.

Për shembull, një dëshmi tepër vendimtare e ekzistencës së *Pllakës së Ruajtur -El-leuhul-Mahfudh-* në univers dhe një shembull i saj është aftësia e kujtesës tek njeriu. Dhe një dëshmi vendimtare e ekzistencës së Botës së shëmbëllesës dhe një shembull i saj është aftësia e imagjinatës së njeriut. Dhe një dëshmi e ekzistencës së qënieve me shpirt në univers dhe një shembull i tyre janë forcat dhe aftësitë e holla tek njeriu.[43] Dhe kështu me radhë. Në një masë të vogël njeriu mund të shfaqë, në një mënyrë që nuk mund të mohohet, të vërtetat e besimit në univers.

Kështu, njeriu kryen shumë funksione të rëndësishme si detyrat që u përmendën lart. Ai është një pasqyrë për manifestimin e bukurisë së qëndrueshme. Ai është vendi i manifestimit duke shpallur e treguar plotësimin e amshuar. Ai është nevojtar e mirënjohës për mëshirën e gjërë të përjetshme. Meqenëse bukuria, plotësimi dhe mëshira janë të përhershme, atëherë sigurisht është e domosdoshme dhe e pashmangshme që njeriu, i cili është një pasqyrë e dëshirueshme për bukurinë e qëndrueshme, një lajmëtar i magjepsur pas plotësimit të amshuar dhe mirënjohës e nevojtar për mëshirë të përjetshme, do të shkojë në botën e përhershme me qëllim që të mbetet atje përjetësisht,

[43] Po, elementet e njeriut tregojnë elementet në univers, kockat e tij tregojnë gurët dhe shkëmbinjtë; floku i tij bimët dhe pemët, dhe gjaku që rrjedh e qarkullon në trupin e tij dhe lëngjet e ndryshme që dalin prej syve të tij, veshëve, hundës dhe gjuhës tregojnë burimet e tokës dhe ujërat minerale të tokës. Gjithashtu shpirti i njeriuit tregon botën e shpirtërave, aftësia e tij e kujtesës tregon Pllakën e Ruajtur, ***El-leuhul-Mahfudhin***, dhe fuqia e tij e imagjinatës tregon botën e shëmbëllesës, dhe kështu me radhë. Secila nga gjymtyrët dhe nga aftësitë e tij tregon një botë të ndritshme dhe jep dëshmi vendimtare për ekzistencën e tyre.

që të shkojë në përjetësi me qëllim që t'i shoqërojë ato cilësi të përjetshme dhe do të shoqërojë atë bukuri të përjetshme, plotësimin e amshuar dhe mëshirën e përhershme për të gjithë përjetësinë. Sepse një bukuri e përjetshme nuk mund të jetë e kënaqur me një admirues të përkohshëm dhe me një dashurues të vdekshëm. Meqenëse bukuria e do vetveten, ajo dëshiron dashuri si shpërblim për dashurinë e saj. Ndërsa përkohshmëria dhe paqëndrueshmëria e transformojnë një dashuri të tillë në armiqësi. Në qoftë se njeriu nuk do të shkonte në përjetësi dhe nuk do të qëndronte atje përjetësisht, në vend të dashurisë të tij të bashkëlindur për bukurinë e përjetshme, do të kishte armiqësi ashtu siç është shpjeguar në një shënim në Fjalën e Dhjetë, një herë një bukuroshe e famshme kur e dëboi një dashuruesin e saj prej pranisë së saj, u transformua dashuria për bukurinë tek dashuruesi i dëbuar në shëmti e urrejtje, saqë ai filloi ta ngushëllonte vetveten duke thënë: Uf! Sa e shëmtuar është ajo! Duke mohuar e fyer kështu bukurinë e saj.

Po, njeriu është armiqësor ndaj asaj që është e panjohur për të, ashtu siç dëshiron të jetë armiqësor e të zbulojë të metat e defektet e gjërave të cilat ai nuk mund t'i marrë apo t'i shtie në dorë. Meqenëse, ashtu siç dëshmon i gjithë universi, i Dashuri i Vërtetë dhe Hirploti Absolut e bën njeriun që ta dojë Atë nëpërmjet Emrave të Tij më të bukur, të cilët janë që të gjithë të bukur, të shkëlqyer e të dëshirueshëm për njeriun që ta dojë Atë, atëherë sigurisht Ai nuk do ta pajiste njeriun, i cili është edhe i dashuri i Tij edhe Dashuruesi i Tij, me një armiqësi të bashkëlindur dhe ta bënte të mërzitur me Veten e Tij nga larg; Ai nuk do ta pajiste shpirtin e njeriut me një armiqësi të fshehur, gjë e cila do të ishte krejtësisht në kundërshtim me natyrën e njeriut, i cili nga natyra është më i dashuri dhe krijesa më e dashur dhe më e jashtëzakonshme që Ai ka krijuar për adhurim. Sepse njeriu do të ishte në gjendje të kuronte plagët e thella të shkaktuara nga ndarja e përjetshme prej një bukurie absolute të cilën ai e do dhe vlerën e së cilës ai e çmon ndaj saj, duke u mërzitur me të dhe duke e mohuar.

Pikërisht nga kjo pikë buron armiqësia e mohuesve ndaj Zotit të Plotëfuqishëm.. Prandaj, Bukuria e parapërjetshme sigurisht që do të bënte për këtë njeri një jetë të përhershme në një botë të qëndrueshme me qëllim që të jenë të pranishme së bashku me të i cili është një pasqyrë e përmalluar për Atë në udhëtimin drejt paspërjetësisë.

Meqenëse njeriu është krijuar në një mënyrë të tillë që nga pikërisht natyra e tij ai përmallohet për një bukuri të qëndrueshme dhe u krijua dashurues për atë bukuri - dhe bukuria e qëndrueshme nuk kënaqet me një përmallues të përkohshëm.. dhe njeriu i qetëson dhimbjet e tij dhe dëshpërimet që burojnë nga ndonjë qëllim që ai nuk e njeh, ose që nuk mund ta arrijë apo ta shtie në dorë, ai kërkon të meta e defekte në të, madje e qetëson vetveten me armiqësi të fshehur ndaj tij duke e ngushëlluar vetveten me këtë armiqësi.. Dhe meqenëse universi u krijua për hir të këtij njeriu, dhe njeriu u krijua për ta njohur e për ta dashur Zotin xh.sh.; dhe meqenëse Krijuesi i Universit bashkë me Emrat e Tij të bukur, është i përjetshëm; dhe meqenëse manifestimi i Emrave të Tij do të jetë i Përjetshëm i amshuar dhe i paspërjetshëm, atëherë sigurisht njeriu do të shkojë për tek një botë e përjetshme dhe do të manifestojë një jetë të përhershme.

Për më tepër, Muhammedi arab a.s.m., i cili është njeriu më i plotë dhe udhëzuesi më i madh për tek Allahu xh.sh. demonstroi në formën më të plotë në veten e tij dhe në fenë e tij vlerën dhe të gjitha plotësimet dhe detyrat që ne i kemi shpjeguar lart lidhur me njeriun, kjo demonstron se universi u krijua për njerëzimin, domethënë qëllimi i tij dhe synimi i tij është njerëzimi. Po ashtu qëllimi dhe synimi i njerëzimit dhe anëtari i tij më i zgjedhur e më i vlefshëm dhe pasqyra e tij më e ndritshme për të Vetmin Unik të Amshuar është Muhammedi a.s.m.. Mbi Të, mbi familjen e tij dhe mbi sahabët qofshin përshëndetjet e bekimet sa numri i të mirave të ummetit të tij..

عَلَيْهِ وَعَلٰى آلِهِ اَلصَّلٰاةُ وَالسَّلٰامُ بِعَدَدِ حَسَنَاتِ اُمَّتِهِ يَا اَللّٰهُ ، يَا رَحْمٰنُ

يَا رَحِيمُ يَا فَرْدُ ، يَا حَيُّ ، يَا قَيُّومُ ، يَا حَكَمُ ، يَا عَدْلُ ، يَا قُدُّوسُ ، نَسْئَلُكَ

بِحَقِّ فُرْقَانِكَ اَلْحَكِيمِ وَبِحُرْمَةِ حَبِيبِكَ اَلْاَكْرَمِ ، وَبِحَقِّ اَسْمَائِكَ اَلْحُسْنٰى

وَبِحُرْمَةِ اِسْمِكَ اَلْاَعْظَمِ ، اِحْفَظْنَا مِنْ شَرِّ اَلنَّفْسِ وَالشَّيْطَانِ وَمِنْ شَرِّ اَلْجِنِّ

وَالْاِنْسَانِ اٰمِينَ

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

O Allah! O i Gjithëmëshirshëm! O Mëshirëplotë! O i Vetëm! O i Gjallë i Përjetshëm! O i Ditur! O i Drejtë! O i Shenjtë! Ne të lutemi nëpërmjet të vërtetës së kriterit Tënd dallues të gjithurtë midis të vërtetës dhe të shtrembërës -Kuranit- dhe nëpërmjet nderimit të të dashurit Tënd më të nderuar, dhe nëpërmjet të vërtetës së Emrave të Tu më të bukur, dhe nëpërmjet nderimit për Emrin Tënd më të madh, të na ruash ne nga e keqja e nefsit urdhërues për të liga, nga e keqja e shejtanit dhe nga e keqja e xhindëve dhe e njerëzve. Amin!

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".[44]

* * *

[44] Kur'an, 2:32

SHKREPTIMA E TRIDHJETË E NJËTË

Kjo shkreptimë është ndarë në *Rreze,* dhe do të botohet në një vëllim më vete në dashtë Zoti xh.sh.

* * *

SHKREPTIMA E TRIDHJETË E DYTË

Kjo përbëhet nga *Rrezëllimat,* vepra e fundit e Saidit të Vjetër, e cila në vetvete merr formën e poezisë, u shkrua për njëzet ditë gjatë muajit të Ramazanit. Ajo është përfshirë në fund të koleksionit të *Fjalëve.*

* * *

SHKREPTIMA E TRIDHJETË E TRETË

Kjo përbëhet nga veprat e quajtura në arabisht *Katre, Habbe, Sheme, Zerre, Hubab, Zyhre* dhe *Shule,* dhe shtojcat e tyre, veprat e para të Saidit të Ri, të inspiruara në zemrën e tij prej *Realitetit.* Përkthimet e tyre janë përfshirë në veprën *Methnevi-i Nurijjeh,* pjesë e koleksionit të Risale-i Nurit.

* * *



Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim

O Allah! O i Gjithëmëshirshëm! O Mëshirëplotë! O i Vetëm! O i Gjallë i Përjetshëm! O Vetekzistues i amshuar! O i Ditur! O i Drejtë! O i Shenjtë! Për hir të Emrit Tënd më të madh dhe në nderim të Kuranit të shpjegimit të mrekullueshëm dhe në nderim të Profetit më të nderuar a.s.m., jepu lumturi të përjetshme në parajsë botuesve të këtij libri, dhe atyre që i ndihmojnë ata. Amin!

Dhe jepu atyre sukses të pafundmë në shërbimin e besimit dhe të Kuranit. Amin!

Dhe për çdo fjalë të Shkreptimave shkruaju një mijë merita në librat e veprave të tyre të mira. Amin!

Dhe dhuroju atyre qëndrueshmëri, vazhdimësi e sinqeritet në botimin e Risale-i Nurit. Amin!

O më Mëshiruesi i mëshiruesve! Jepu lumturi në këtë botë dhe në tjetrën të gjithë studentëve të Risale-i Nurit, Amin!

Ruaji ata prej të keqes së shejtanëve midis xhindëve dhe njerëzve. Amin!

Në emrin e të gjithë studentëve të Risale-i Nurit,

Said Nursi

* * *

BOSH

BOSH

BOSH

PËRMBAJTJA

..........1 - 4

PARATHENIE ..... 5 - 10

SHKREPTIMA E PARË: Lutja e Hazreti Junusit a.s. dhe shpjegimi i nevojës së çdo njeriu për atë lutje .....11 - 16

SHKREPTIMA E DYTË: Duaja e Hazreti Ejjubit a.s. dhe shpjegimi i nevojës sonë për të.

E Para: në çdo mëkat ndodhet një rrugë për në mohim...

E Dyta: Njeriu nuk ka të drejtë të shfaqë ankesa prej fatkeqësisë...

E Treta: Njeriu i goditur nga fatkeqësia duhet të mendojë për shpërblimin me qëllim që të ngjitet tek shkalla e falënderimit....

E Katërta: ka të bëjë me shpjegimin e forcës së durimit tek njeriu...

E Pesta: Tre çështje...

E Para: fatkeqësia e vërtetë është ajo që godet fenë dhe shpjegimi i kurimit të saj...

E Dyta: Sa herë që e zmadhon fatkeqësinë, ajo bëhet e madhe, dhe shpjegimi i kurimit të saj...

E Treta: Sëmundja tek të rinjtë është një mirësi në këtë kohë...

Përfundim: Sëmundjet i shpërthejnë thesaret e pafuqisë dhe të varfërisë tek njeriu... .....17 - 29

SHKREPTIMA E TRETË: Shpjegimi i dy të vërtetave të rëndësishme nëpërmjet Frazës: "*Ja Baki, Entel-Baki*" në tre pika**E Para:** Çlirimi i zemrës prej çdo gjëje tjetër përveç Zotit xh.sh...

E Dyta: Dashuria për qëndrueshmëri e ngulitur në natyrën e njeriut...

E Treta: Ndryshimi i ndikimit të kohës në përkohshmërinë e gjërave, dhe mënyra e transformimit të jetës së përkohshme në të përhershme... .....30 - 38

SHKREPTIMA E KATËRT: Trajtesa e Rrugës së sunnetit të Profetit Muhammed a.s.m

Pika e Parë: Dhembshuria e Profetit Muhammed a.s.m. dhe mëshira e tij për komunitetin e tij...

Pika e Dytë: Pajtimi dhe harmonia midis detyrës së madhe të Profetësisë dhe orientimi i tij a.s.m. në çështjet e pjesshme e të veçanta...

Pika e Tretë: komentimi i fjalës së Zotit xh.sh. *"... veçse dashurinë për Ehlibejtin"...*

Pika e Katërt: mosmarrëveshjet midis sunitëve dhe shiitëve, dhe shpjegimi se nuk ka hajr, mirësi, as në tepri dhe as në mangësi; ekstremet janë të dëmshëm... .....39 - 55

SHKREPTIMA E PESTË: Është përfshirë në Shkreptimën e Njëzet e nëntë .....56 - 56

SHKREPTIMA E GJASHTË: Edhe kjo gjithashtu është përfshirë në shkreptimën e Njëzet e Nëntë .....57 - 57

SHKREPTIMA E SHTATË: Kjo përshkruan shtatë lloje parashikimesh rreth së padukshmes në tre ajetet e fundit të Sures *El-Fet'h...*

Ndërsa në *Përfundim* demonstrohet një shembull i qartë i një aspekti tjetër të mrekullisë së tij, *Et-tevafukat, Koinçidenca.* .....58 - 75

SHKREPTIMA E TETË: është botuar në "*Sikke i Tasdiki Gajbi*" dhe nuk është përfshirë në këtë koleksion.....76 - 76

SHKREPTIMA E NËNTË: Përgjigje për katër pyetje të bëra nga studenti i Bediuzzamanit, Hulusi Bej

E Para: lidhur me prejardhjen e Hulusiut prej Ehli Bejtit, familjes së Profetit a.s.m...

E Dyta: tregon me qartësi të ndritshme rrugën e unitetit të Ekzistencës, dhe mangësitë e holla në atë rrugë...

E Treta: lidhet me shkencën e *xhefrit*...

E Katërta: është rreth pretendimit se Hazreti Isai a.s. na paska pasur një baba njerëzor...

Së fundi, një *shtojcë* për pyetjen rreth Muhjid-din Ibn, El-Arebi dhe rreth Unitetit të Ekzistencës... .....77 - 92

SHKREPTIMA E DHJETË: Katërmbëdhjetë goditje nga mëshira Hyjnore të marra prej studentëve të Risale-i Nurit në shërbimin e tyre të Kuranit, për gabimet që ata kanë bërë për shkak të natyrës njerëzore..

.....93 - 107

SHKREPTIMA E NJËMBËDHJETË: E titulluar "Shkalla e sunnetit Profetik a.s.m. dhe kundërhelmi ndaj sëmundjes së bidatit". Kjo trajtesë e rëndësishme përbëhet nga "*Njëmbëdhjetë pika"* rreth sunnetit të Profetit Muhammed a.s.m .....108 - 129

SHKREPTIMA E DYMBËDHJETË:

Përgjigje ndaj dy Pyetjeve: dy vërsete janë shpjeguar të cilët kanë qenë kritikuar nga shkencëtarët...

I Pari: shpjegon në dy "Pika" se Rizku, furnizimi, vjen drejtpërdrejtë nga i Gjithëfuqishmi absolut, prej thesarit të mëshirës së Tij...

I Dyti: provon në dy çështje të rëndësishme;

E Para rreth tokës që ka shtatë nivele ashtu si qiejt...

E Dyta: rreth shtatë qiejve.....130 - 142

SHKREPTIMA E TREMBËDHJETË: kjo shpjegon nëpërmjet trembëdhjetë "treguesve" kuptimin e frazës "*I kërkoj mbrojtje Allahut që të më ruajë nga Djalli i mallkuar"...* .....143 - 175

SHKREPTIMA E KATËRMBËDHJETË Përbëhet nga Dy Stacione...

Stacioni i Parë: Në përgjigje të *pyetjes së parë* rreth tokës duke qëndruar mbi një dem dhe mbi një peshk; kjo vendos tre parime të rëndësishme për të kuptuar hadithet...

Pyetja e Dytë është rreth njerëzve të mantelit...

Stacioni i Dytë: kjo pjesë e rëndësishme shpjegon "Gjashtë mistere të përfshirë në *Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim*".. .....176 - 195

SHKREPTIMA E PESËMBËDHJETË: Indekset e koleksioneve të *Fjalëve, Letrave* dhe të *Shkreptimave* nga e Para deri tek e Pesëmbëdhjeta. Ato janë përfshirë në volumet përkatës .....196 – 196

SHKREPTIMA E GJASHTËMBËDHJETË: Përgjigje për pyetje të ndryshme:

E Para: Si mund t'i parashikojnë njerëzit e shenjtërisë ato gjëra që i kundërshton realiteti?

E Dyta: Përse autori i Risale-i Nurit nuk doli kundër atyre që po e shtypnin?

E Treta: Përse Ai e kundërshtoi luftën?

E Katërta: Përse Ai i këshilloi studentët e tij të jenë të kujdesshëm dhe të mos ua tregojnë të gjitha pjesët e Risale-i Nurit gjithkujt?

Përfundim: Përgjigje për një pyetje rreth mjekrës së Profetit Muhammed a.s.m....

Përgjigje për tre çështje të tjera të kundërshtuara prej ateistëve:

E Para: Dhulkarnejni "*Pa diellin të perëndonte në një burim me ujë të turbullt"...*

E Dyta: Ku është Pengesa e Dhul-karnejnit"? Kush ishin Xhuxh Maxhuxhët -Gog magogët?

*E Treta***:** është rreth Isait a.s. -Jezusit- duke ardhur në fundin e kohës dhe duke vrarë Dexhalin...

Një përgjigje rreth dy prej pesë gjërave të fshehura...

Përgjigjja për një pyetje rreth dhjetë aftësive të holla të njeriut...

.....197 - 215

SHKREPTIMA E SHTATËMBËDHJETË: Përbëhet nga pesëmbëdhjetë shënime të marra nga vepra e Bediuzzamanit e titulluar *Zÿhre*...

Shënimi i Parë tregon realitetin e atyre gjërave të cilat e robërojnë nefsin njerëzor, dhe këputja e lidhjes së tij me to, e kthen fytyrën e njeriut drejt përjetësisë...

Shënimi i Dytë përshkruan parimin Kuranor të modestisë...

Shënimi i Tretë ilustron me një krahasim fytyrën e vërtetë të vdekjes dhe të jetës...

Shënimi i Katërt demonstron se çdo individ do të kthehet i njëjti në Ditën e Ringjalljes së madhe...

Shënimi i Pestë zbulon nëpërmjet një krahasimi me një udhëzim Kuranor, fytyrën e vërtetë të civilizimit perëndimor. Duke i bërë besimtarët të ndjejnë neveri ndaj civilizimit të shthurur: ajo jep ilaçe prej farmacisë së Kuranit....

Shënimi i Gjashtë zbulon një dredhi djallëzore që i lëkund besimtarët në besimin e tyre për shkak të numrave të mëdhenj të jobesimtarëve dhe pajtueshmërisë së tyre në mohimin e disa të vërtetave të besimit...

Shënimi i Shtatë i heshtë ata pseudopatriotë të cilët i tërheqin muslimanët drejt përparimit të tipit perëndimor, dhe lakmisë dhe ambicies së kësaj bote, dhe jep ilaçe Kuranore për këtë...

Shënimi i Tetë demonstron se me Bujarinë e Tij, Allahu i Plotëfuqishëm ka përfshirë në të gjithë aktivitetet dhe në përpjekjet një shpërblim e një kënaqësi...

Shënimi i Nëntë shpjegon se Profetësia është esenca e plotësimit...

.

Shënimi i Dhjetë: Dritat e njohjes Hyjnore janë tre pjesë, tre provat për njohjen e Zotit xh.sh. secila pjesë kërkon...

Shënimi i Njëmbëdhjetë: mëshira e gjërë e Kuranit në mënyrën e adresimit...

Shënimi i Dymbëdhjetë: Një dua, lutje dhe përgjërim...

Shënimi i Trembëdhjetë: Pesë çështje të cilat kanë qenë shkak konfuzioni...

E Para: Ata që përpiqen në rrugën e së vërtetës duhet të mendojnë vetëm për detyrat e tyre dhe të mos përzihen në ato gjëra që i përkasin Zotit xh.sh...

E Dyta: Adhurimi ndaj Allahut duhet të shikojë vetëm tek urdhri Hyjnor dhe tek kënaqësia Hyjnore...

E Treta: Mbi kuptimin e "*I Lumtur është njeriu i cili i njeh limitet e tij dhe nuk i tejkalon ato*"...

E Katërta shpjegon se nuk është e lejueshme të pranosh dhuratat apo mirësitë që nuk jepen në Emrin e Dhuruesit të Vërtetë -ajo që i ngatërron njerëzit është shkaku dhe pasoja duke ardhur së bashku- dhe demonstron qartë natyrën e vërtetë të shkaqeve të jashtme...

E Pesta: Arritjet e një komuniteti nuk duhet t'i atribuohen Udhëheqësit të tij apo drejtuesit....

Shënimi i Katërmbëdhjetë përbëhet nga Katër "Shenja" duke aluduar për Unitetin Hyjnor...

Shenja e Parë: Nuk ka të Adhuruar të vërtetë që i përshtatet njeriut përveç Atij i Cili sundon mbi tokën dhe mbi qiejt...

Shenja e Dytë: Ajo dashuri e fortë për pavdekshmëri në natyrën e njeriut është një manifestim i Emrit Hyjnor ***El-Baki,*** *I Qëndrueshmi i Gjithëlavdishëm...*

Shenja e Tretë: Bëj kujdes që të mos i mbysësh aftësitë e tua të holla në ngrënie apo në fjalë...

Shenja e Katërt: Jeta e kësaj bote dhe jeta e trupit janë si një varr i ngushtë. Duke hyrë në jetën e zemrës dhe të shpirtit, njeriu hyn në një

sferë të gjërë jete, dhe çelësi për atë botë është *"Nuk ka Zot tjetër përveç Atij*"...

Shënimi i Pesëmbëdhjetë përshkruan manifestimin më të lartë të Emrit Hyjnor ***El-Hafidhu***, *Ruajtësi*..... 216 - 258

SHKREPTIMA E TETËMBËDHJETË

Është botuar në veprën "*Sikkei Tasdik El-Gajbi*"..... 259 -259

SHKREPTIMA E NËNTËMBËDHJETË:

Kursimi, ekonomia. Shtatë pika duke shpjeguar vërsetin *"Hani e pini por mos e teproni"*..... 260 - 274

SHKREPTIMA E NJËZET: Sinqeriteti.

Shtatë shkaqe për gjendjen e tmerrshme të treguar nga pyetja: Cila është arsyeja për konfliktin ndërmjet njerëzve të së vërtetës, kurse të çudhëzuarit bashkëpunojnë e kanë pajtueshmëri?.....275 - 292

SHKREPTIMA E NJËZET E NJË: Sinqeriteti. Katër "Rregulla" me anë të të cilave njeriu mund të fitojë sinqeritetin, parimin më të rëndësishëm në veprat që i përkasin Ahiretit...

Një letër private për disa nga vëllezërit e mi..... 293 - 307

SHKREPTIMA E NJËZET E DY Përbëhet nga tre "tregues" të cilët përmbajnë pyetje rreth autorit të Risale-i Nurit, dhe përgjigjet e tyre...

Treguesi i Parë: Përse ndërhyjnë njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje në Ahiretin tënd?...

I Dyti: Përse nuk drejtohesh tek ne? Pastaj ankohesh...

I Treti: Përse u shmangesh dhe nuk i zbaton ligjet e republikës...

Përfundim: Një sulm i çuditshëm..... 308 - 320

SHKREPTIMA E NJËZET E TRE:

Natyra...

Parathënie: Tre fraza, duke përfaqësuar tre rrugë, të përdorura nga besimtarët rreth ekzistencës së gjërave pa kuptuar nënkuptimet e tyre...

Rruga e Parë: Formimi i gjërave nëpërmjet ardhjes bashkërisht të shkaqeve në univers...

Pamundësia e Parë: ardhja bashkërisht e elementeve të qënieve të gjalla, nga rastësia, në masë të plotë e në drejtpeshim...

Pamundësia e Dytë: Në qoftë se një mizë, për shembull, do t'i atribuohej shkaqeve, kjo do të bënte të domosdoshme që shumë nga elementet dhe shkaqet në univers të ndërhynin fizikisht në qënien e saj... ***Pamundësia e Tretë:*** "Në qoftë se një gjë ka unitet, ajo mund të ketë dalë vetëm prej një dore", dhe sidomos në qoftë se ajo manifeston jetë, së bashku me rregullin e plotë dhe balancimin...

Rruga e Dytë: "Ajo formon vetveten".

Pamundësia e Parë: Meqenëse trupi i ngjason një makinerie të hollë të mirërregulluar, në qoftë se grimcat e tij nuk do të vepronin sipas ligjit të të Gjithëfuqishmit të parapërjetshëm, atëherë çdo grimcë do të duhej të kishte një sy me të cilin të shikonte të gjitha pjesët e trupit dhe të gjithë universin, dhe të kishte mendje për të kuptuar lidhjet e saj...

Pamundësia e Dytë: Do të duhej që çdo grimcë të ishte edhe mbisunduese, edhe e varur në të njëjtën kohë...

Pamundësia e Tretë do të ishte e domosdoshme ekzistenca e kallëpeve aq sa numri i qelizave në trupin tënd...

Rruga e Tretë: Natyra e bën të domosdoshme atë dhe e bën atë.

Pamundësia e Parë: Do të duhej që natyra të vendoste në çdo gjë aparate të pakufishme jolëndore...

Pamundësia e Dytë: Do të duhej që natyra të sillte punishte të pakufishme në çdo grusht dheu...

Pamundësia e Tretë: "Dy krahasime"

I Pari: Hyrja e një njeriu primitiv në një pallat madhështor...

I Dyti: Hyrja e një njeriu fshatarak në një ushtri madhështore dhe në Xhaminë e Aja Sofia...

Përfundim: Tre pyetje dhe përgjigjet e tyre.

E Para: Çfarë nevoje ka Krijuesi xh.sh. për adhurimin tonë?...

E Dyta: Cili është sekreti në lehtësinë tek krijimi dhe formimi i gjërave?...

I Treti: Filozofët thonë se ka vetëm përbërje e shpërbërje.

A është e saktë kjo?..... 321 - 354

SHKREPTIMA E NJËZET E KATËRT:

Kurani urdhëron mbulesën e grave.

Katër shembuj urtësie në këtë....

Një bashkëbisedim me gratë, motrat e mia besimtare të Ahiretit:

Tre pika duke treguar se meqenëse mëshira është njëri nga parimet kryesore të Risale-i Nurit dhe gratë janë kampionet e mëshirës, ato nga natyra janë të tërhequra pas saj. Për fat të keq në kohët e tanishme, disa rryma po përpiqen ta shfrytëzojnë atë karakteristikë të vlefshme. Atëherë lumturia e grave në të dyja botët mund të ruhet duke ndjekur e aderuar tek praktikat islamike..... 355 -370

SHKREPTIMA E NJËZET E PESTË:

Mesazh për të sëmurët. Kjo përbëhet nga Njëzet e pesë ilaçe...

..... 371 - 403

SHKREPTIMA E NJËZET E GJASHTË:

Trajtesa për të moshuarit. Kjo përbëhet nga njëzet e gjashtë "Shpresa"..... 404 - 482

SHKREPTIMA E NJËZET E SHTATË:

Është përfshirë tek libri i "Biografisë së jetës së Ustadhit".

..... 483 - 483

SHKREPTIMA E NJËZET E TETË

Përbëhet nga pjesë të shkurtëra të shkruara në Burgun EskiShehir....

◦ Një Pikë e hollë lidhur me mizat....

◦ Shkronjat e Kuranit...

◦ Fjalët Hyjnore...

◦ Zbritja e hekurit...

◦ Përshkrimi i Hud-hudit -pupëzës- Krijuesin e saj..

◦ Zbritja e kafshëve...

◦ Një parim...

◦ Një paragraf që u shkrua në Burgun Eskishehir....

◦ Dinjiteti i lartë i Risale-i Nurit ...

◦ Një goditje mëshire...

◦ Dy tregime të shkurtëra...

◦ Dy Pika:

E Para: shpërblimi i shpejtë për të mirat e për të këqiat...

E Dyta: Shpjegimi i aspekteve të mrekullisë në vërsetin Kuranor *"Ma Uridu minhum min rizkin"*...

◦Një pyetje rreth vërsetit "*Eu Hum Ka'ilune*"...

◦ Një kujtesë e bukur...

◦ Rreth unitetit të ekzistencës dhe rreth dëmeve të tij në këtë kohë...

◦ Përgjigje rreth pyetjes lidhur me unitetin e Ekzistencës...

◦ Hulumtim prej dritares së burgut...

◦ Armiku më i keq është nefsi yt...

◦ Si mund të jetë drejtësi qëndrimi i përhershëm në Xhehennem?...

◦ Një koinçidencë e hollë...

◦ Një shpjegim i disa vërseteve rreth xhindëve spiunë dhe shpirtërave të këqinj dhe dëbimi i tyre, gjë e cila ka qenë kritikuar nga njerëzit e çudhëzimit..... 484 - 541

SHKREPTIMA E NJËZET E NËNTË:

Në arabisht, kjo u shkrua në përshtatje me urdhrin Kuranor për të reflektuar rreth shenjave krijuese në univers, dhe tregon esencën e rrugës së Risale-i Nurit, mendimin reflektiv. E treta e Gjashtë kapitujve të saj është përfshirë në koleksionin e tanishëm. Ajo është rreth frazës "*All-llahu Ekber*" dhe përmban shtatë shkallë..... 542 - 581

SHKREPTIMA E TRIDHJETË:

Rreth Gjashtë Emrave Hyjnorë që mbajnë Emrin më të madh...

● **Pika e Parë:** Emri Hyjnor ***"El-Kuddus***"...

● **Pika e Dytë:** lidhet me Emrin Hyjnor "***El-Adl***

● **Pika e Tretë:** lidhet me Emrin Hyjnor "***El-Hakem***....

Pika e Parë: Universi një libër i madh....

Pika e Dytë**:** *Dy çështje*

E Para: Bukuria dhe Plotësimi kërkojnë ta shohin vetveten dhe ta zbulojnë

E Dyta: nuk ka absolutisht vend për të përshkruar ortakë me Allahun xh.sh...

Pika e Tretë: Dijet dhe shkencat bëjnë të njohur Emrin Hyjnor ***El-Hakim,*** *I Gjithurti...*

Pika e Katër: Urtësitë e shikuara, të cilat i dëshmojnë të gjitha qëniet, kërkojnë ringjalljen e të vdekurve.

Pika e Pestë: *Dy Çështje...*

E Para: nuk ka harxhim të tepërt në natyrën e gjërave;

E Dyta: Emri Hyjnor "*El-hakem" "I Dituri*" kërkon profetësinë e Muhammedit a.s.m....

● **Pika e Katër:** lidhet me Emrin *"El-Ferd" "i Vetmi*"

Treguesi i Parë: Tre "stampat" e Unitetit Hyjnor në qëniet...

Vula e Parë: bashkëpunimi midis pjesëve përbërëse të Universit...

Vula e Dytë: administrimi i jetës në tokë...

Vula e Tretë: tiparet e fytyrës së njeriut...

Treguesi i Dytë:një ligj i vetëm ...

Treguesi i Tretë: mesazhe Hyjnore të Përjetshme...

Treguesi i Katërt: Njësia është e natyrshme ndërsa shirku është i pamundur...

*Pika e Parë***:** forca e lidhjes dhe e mbështetjes...

Pika e Dytë: lehtësia e krijimit në unitet...

Pika e Tretë: t'ia atribuosh krijimin Të Vetmit e bën atë të lehtë...

Treguesi i Pestë: Pavarësia dhe vetmia.

Treguesi i Gjashtë: Balsami shërues...

Treguesi i Shtatë: Fanari ndriçues...

● **Pika e Pestë** lidhet me Emrin Hyjnor ***El-Hajj*** *I Gjalli i Përjetshëm...*

Shenja e Parë: Cila është natyra e jetës dhe misioni i saj?...

Shenja e Dytë: Fytyrat e brendshme e të jashtme të jetës janë të tejdukshme...

Shenja e Tretë: Rezultati i jetës: Falënderimi dhe adhurimi

Shenja e Katër: Jeta i vërteton shtyllat e besimit...

Shenja e Pestë: Jeta shfaq Emrat e bukur Hyjnorë...

● **Pika e Gjashtë:** kjo ka të bëjë me Emrin Hyjnor ***El-Kajjum*** *Vetekzistuesi i amshuar....*

Një shfajësim dhe një paralajmërim...

Rrezja e Parë: Krijuesi është Vetekzistues i Parapërjetshëm...

Rrezja e Dytë: Dy çështje...

E Para: Njohja e Vetekzistueshmërisë së amshuar xh.sh...

E Dyta: Dobitë e gjërave dhe urtësitë e tyre të lidhura me misterin e Vetekzistueshmërisë së amshuar...

Rrezja e Tretë: misteri i Vetekzistueshmërisë së amshuar dhe urtësia e aktivitetit të pandërprerë...

Rrezja e Katërt: Dega e tretë e urtësisë në aktivitetin e vazhdueshëm dhe të çuditshëm në univers...

Rrezja e Pestë: Dy çështje...

E Para: Të shikuarit e universit nëpërmjet manifestimit më të madh të dritave të Emrit më të madh.

E Dyta: Njeriu dhe misteri i Vetekzistueshmërisë së amshuar...

..... 582 - 674

SHKREPTIMA E TRIDHJETË E NJËTË,

SHKREPTIMA E TRIDHJETË E DYTË,

SHKREPTIMA E TRIDHJETË E TRETË,

..... 675 - 677

Përmbajtja... .....678 - 690